

BIBLËN MUND TA KUPTOSH DHE TI!

***Kujtimet dhe letrat e dishepullit të dashur:
Ungjilli i Gjonit, 1, 2 dhe 3 Gjonit***

BOB UTLEY
PROFESOR I HERMENEUTIKËS
(INTERPRETIMIT BIBLIK)

Shqipëroi: FLORENC MENE

***SERIA E KOMENTARËVE STUDIMORË UDHËZUES
DHIATA E RE, VËLLIMI 4***

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEKSAS
2011

NJË FJALË NGA AUTORI

SI MUND TË TË NDIHMOJË KY KOMENTAR?

Interpretimi biblik është një proces arsyetues dhe shpirtëror që përpiqet të kuptojë një shkrimtar të lashtë të frymëzuar, në mënyrë të tillë që mesazhi i dhënë nga Perëndia të mund të kuptohet dhe të zbatohet në kohën tonë.

Procesi shpirtëror është kyç, por i vështirë për t'u përcaktuar. Ai kërkon qëndrim të dorëzuar dhe të hapur ndaj Perëndisë. Duhet të kesh uri (1) për Perëndinë, (2) për ta njohur atë dhe (3) për t'i shërbyer. Ky proces përfshin lutjen, rrëfimin dhe gatishmërinë për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Fryma është kyç në procesin interpretues, por mbetet mister pse të krishterët e sinqertë dhe të perëndishëm e kuptojnë Biblën ndryshe nga njëri-tjetri.

Procesi arsyetues është më i lehtë për t'u shpjeguar. Duhet të jemi konsekuentë dhe të ndershëm me tekstin, dhe të mos ndikohemi nga anësitë tona personale apo denominacionale. Të gjithë jemi të kushtëzuar historikisht. Askush prej nesh s'është interpretues objektiv dhe asnjans. Ky komentuar ofron një proces të kujdesshëm arsyetues që përmban tri parime interpretuese, që janë strukturuar për të na ndihmuar të tejkalojmë anësitë tona.

Parimi i parë

Parimi i parë është të vërejmë sfondin historik ku u shkrua libri biblik, si dhe shkasin e veçantë historik për autorësinë e tij. Autori fillestar donte të përçonte një synim, një mesazh. Teksti nuk mund të ketë për ne një kuptim që nuk e pati kurrë për autorin fillestar, të lashtë e të frymëzuar. Çelësi është synimi i autorit, jo nevoja jonë historike, emocionale, kulturore, personale, apo denominacionale. Zbatimi është partner i pandashëm i interpretimit, por interpretimi i drejtë duhet t'i paraprijë gjithmonë zbatimit. Duhet ritheksuar se çdo tekst biblik ka një kuptim të vetëm dhe jo më tepër. Ky kuptim është ai që synonte t'i përçonte kohës së vet autori biblik fillestar përmes udhëheqjes së Frymës. Ky kuptim i vetëm mund të ketë shumë zbatime të mundshme për kultura dhe situata të ndryshme. Këto zbatime duhen lidhur me të vërtetën qendrore të autorit fillestar. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon që të sigurojë një hyrje për secilin libër të Biblës.

Parimi i dytë

Parimi i dytë është të identifikojmë njësitë letrare. Secili libër biblik përbën një dokument të unifikuar. Interpretuesit nuk kanë të drejtë të izolojnë njërin aspekt të së vërtetës duke përjashtuar të tjerët. Prandaj, duhet të rrekemi të kuptojmë synimin e gjithë librit biblik përpara se të interpretojmë njësitë e veçanta letrare të tij. Pjesët e veçanta (kapitujt, paragrafët, apo vargjet) nuk mund të kenë një kuptim ndryshe nga ai i gjithë njësisë në tërësi. Interpretimi duhet të zhvendoset nga qasja deduktive ndaj tërësisë drejt qasjes induktive ndaj pjesëve. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që të analizojë strukturën e secilës njësi letrare sipas paragrafëve. Ndarjet sipas paragrafëve apo kapitujve nuk janë të frymëzuara, por na ndihmojnë që të identifikojmë njësitë e mendimit.

Interpretimi në nivelin e paragrafit (jo në nivelin e periudhës, fjalisë, frazës apo fjalës) është çelësi për të ndjekur kuptimin e synuar të autorit biblik. Paragrafët bazohen në një tematikë të unifikuar, shpesh e quajtur tema, ose fjalia temë. Çdo fjalë, frazë, fjali dhe periudhë e paragrafit lidhet në njëfarë mënyre me këtë temë të unifikuar. Ato e kufizojnë, zgjerojnë, shpjegojnë dhe/ose e vënë në pikëpyetje. Një çelës i vërtetë për interpretimin e saktë është të ndjekim mendimin e autorit fillestar paragraf për paragraf përmes njësive të veçanta letrare që përbëjnë librin biblik. Ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që ta bëjë këtë duke krahasuar përkthimet e sotme në gjuhën angleze. Këto përkthime janë përzgjedhur për shkak se përdorin teori të ndryshme përkthimi:

1. Teksti greqisht i United Bible Society (Shoqëria e Bashkuar Biblike) është botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴). Ky tekst është ndarë në paragrafë nga studiues të sotëm teksti.
2. Versioni New King James (NKJV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm i bazuar në traditën e dorëshkrimeve greqisht të njohur si *Textus Receptus*. Ndarjet e paragrafëve të tij janë më të gjata se në përkthimet e tjera. Këto njësi më të gjata e ndihmojnë studiuesin që të shohë temat e unifikuara.

[Kur autori i komentarit citon nga NKJV, përkthyesit në shqip citojnë nga versioni LIM, i cili i përket të njëjtës familje tekstuale si NKJV. Shënim i përkthyesit.]

3. Versioni New Revised Standard (NRSV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm, por i modifikuar. Ai përbën një pikë të ndërmjetme mes dy versioneve të mëposhtme moderne. Ndarjet e tij të paragrafëve janë tejet të dobishme për identifikimin e temave.
4. Versioni Today's English (TEV) është një përkthim ekuivalent dinamik i botuar nga Shoqëria e Bashkuar Biblike. Ai përpiket ta përkthejë Biblën në mënyrë të tillë që çdo lexues ose folës modern i anglishtes të mund të rrokë kuptimin e tekstit greqisht. Shpesh, sidomos në ungjijtë, ai i ndan paragrafët sipas folësve, jo sipas temës, në të njëjtën mënyrë si NIV. Për synimet e interpretuesit, kjo nuk është e dobishme. Është interesante të vërejmë se, si UBS⁴, ashtu dhe TEV, janë botuar nga e njëjta organizatë, e megjithatë ndarja e paragrafëve të tyre ndryshon.
5. Bibla e New Jerusalem (NJB) është një përkthim ekuivalent dinamik i bazuar në përkthimin katolik francez. Është shumë i dobishëm për krahasimin e ndarjes së paragrafëve nga pikëvështrimi evropian.
6. Teksti i shtypur është ai i New American Standard Bible (NASB), i përditësuar në vitin 1995, i cili është një përkthim i fjalëpërfjalshëm. Paragrafët e tij ndiqen nga komentet e mia varg për varg. [Në shqip, përkthyesi ka përkthyer drejtpërdrejt NASB-në sa herë që përdoret në komentar. Shënim i përkthyesit.]

Parimi i tretë

Parimi i tretë është ta lexojmë Biblën në përkthime të ndryshme me qëllim që të kapim gamën më të gjerë të mundshme kuptimore (fusha semantike) që mund të kenë fjalët ose frazat biblike. Shpesh, fraza ose fjala greqisht mund të kuptohet në një sërë mënyrash. Këto përkthime të ndryshme i nxjerrin në pah këto alternativa dhe ndihmojnë në identifikimin dhe shpjegimin e varianteve në dorëshkrimet greqisht. Këto nuk ndikojnë në doktrinë, por, gjithsesi, na ndihmojnë në përpjekjen për t'u kthyer te teksti origjinal i shkruar nga shkrimtari i frymëzuar në lashtësi.

Ky komentar ofron një mënyrë të shpejtë që studiuesi të kontrollojë interpretimet e veta. Ai nuk synon që të thotë fjalën e fundit, por të jetë informues dhe të nxisë mendimin. Shpesh, interpretimet e tjera të mundshme na ndihmojnë që të mos bëhemi tepër të provincialë, dogmatikë dhe denominacionalë. Interpretuesve u nevojitet një gamë më e gjerë alternativash interpretuese për të kuptuar sesa i vagullt mund të jetë teksti i lashtë. Është tronditëse sesa pak konsensus ekziston mes të krishterëve që pretendojnë se burimi i tyre i së vërtetës është Bibla.

Këto parime më kanë ndihmuar të tejkaloj një pjesë të mirë të kushtëzimit tim historik, pasi më kanë detyruar të "përleshem" me tekstin e lashtë. Shpresoj se kjo gjë do të jetë bekim edhe për ty.

Bob Utley
East Texas Baptist University
27 qershor 1996

UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIK: KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet? E verifikojmë dot logjikisht? A ekziston autoriteti absolut? A ka vlera absolute që mund të na udhëheqin jetën dhe botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë? Këto pyetje (pyetje që përsiasin të gjithë njerëzit e logjikshëm) e kanë përndjekur mendjen njerëzore që nga agu i kohës (Pred. 1:13-18; 3:9-11). Më kujtohet kërkimi im vetjak për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në moshë të re, kryesisht në bazë të dëshmisë së disa personave të rëndësishëm në familjen time. Me rritjen drejt pjekurisë, m'u rritën edhe pyetjet për veten dhe botën time. Klishtë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk u jepnin kuptim përjetimeve për të cilat lexoja dhe me të cilat ndeshesha. Ishte një kohë pështjellimi, kërkimi, përmallimi dhe, shpesh, e një mungese shprese përballë botës së pandjeshme dhe të ashpër ku jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje për këto pyetje absolute, por, pas hulumtimeve dhe përsiatjeve, vërejtja se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite të lashta, (3) përjetime personale, ose (4) projeksione psikologjike. Kisha nevojë për njëfarë mase verifikimi, njëfarëlloj prove, një logjikë mbi të cilën të bazoja botëkuptimin tim, qendrën time integruese, arsyen për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin e Biblës. Fillova të shqyrtoja për prova për vërtetësinë e saj, të cilat i gjeta në (1) besueshmërinë historike të Biblës, e vërtetuar nga arkeologjia, (2) saktësinë e profecive të Dhiatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës gjatë një mijë e gjashtëqind viteve të prodhimit të saj, dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve të cilëve iu ndryshoi jeta një herë e përgjithmonë nga kontakti me Biblën. Krishterimi, si sistem i unifikuar besimi dhe bindjesh, ka aftësinë që të trajtojë pyetjet e koklavitura të jetës njerëzore. Kjo jo vetëm që më siguroi një kornizë logjike, por aspekti përjetues i besimit biblik më solli edhe gëzim e qëndrueshmëri emocionale.

Mendova se e gjeta qendrën integruese për jetën time: Krishtin, siç kuptohet përmes Shkrimeve. Ishte një përjetim ngazëllues, një çlirim emocional. Megjithatë, ende më kujtohet tronditja dhe dhimbja që pata kur fillova të kuptoja se sa shumë interpretime të ndryshme të këtij libri propagandoheshin, nganjëherë edhe brenda të njëjtave kisha dhe shkolla mendimi. Pohimi i frymëzimit dhe vërtetësisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i vërtetoj ose mohoj interpretimet e larmishme dhe të kundërta të pasazheve të shumta e të vështira në Bibël, që ofroheshin nga ata që besonin në autoritetin dhe vërtetësinë e saj?

Kjo detyrë u bë synimi i jetës sime dhe shtegtimi i besimit tim. E dija se besimi në Krishtin (1) më kishte sjellë paqe dhe gëzim të madh. Mendja ime kërkonte me ngulm disa vlera absolute në mes të relativitetit të kulturës sime (postmodernizmit); (2) dogmatizmi i sistemeve të kundërta fetare (feve botërore); dhe (3) arroganca denominacionale. Në kërkimin tim për qasje të vlefshme për interpretimin e literaturës së lashtë, u habita kur zbulova dhe vetë anësitë e mia historike, kulturore, denominacionale dhe përjetuese. Shpesh, Biblën e kisha lexuar për të përforcuar pikëpamjet e mia. E përdorja si burim dogme për të sulmuar të tjerët dhe për të ripërkrahur vetë pasiguritë dhe mangësitë e mia. Sa të dhimbshëm e pata këtë ndërgjegjësim!

Ndonëse nuk mund të jem kurrë plotësisht objektiv, mund të bëhem lexues më i mirë i Biblës. Mund t'i kufizoj anësitë e mia duke i identifikuar dhe duke pranuar praninë e tyre. Ende nuk jam i çliruar prej tyre, por jam përballur me dobësitë e mia. Shpesh, interpretuesi është armiku më i keq i leximit të mirë biblik!

Më lejo të rendis disa nga presupozimet që sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ti, si lexues, t'i shqyrtosh bashkë me mua:

I. Presupozime

- A. Unë besoj se Bibla është e vetmja vetëzbulesë e frymëzuar e të vetmit Perëndi të vërtetë. Si rrjedhojë, duhet interpretuar në dritën e synimit të autorit fillestar hyjnor (Frymës) përmes shkrimtarit njerëzor në një sfond të veçantë historik.
- B. Unë besoj se Bibla është shkruar për njeriun e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia na u përshtat për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk e fsheh të vërtetën – ai dëshiron të kuptojmë! Si rrjedhojë, Bibla duhet interpretuar në dritën e kohës së vet, jo sonës. Për ne, Bibla nuk duhet të ketë kurrë një kuptim të ndryshëm nga ajo që kuptuan ata që e lexuan dhe dëgjuan për herë të parë. Ajo është e kuptueshme nga mendja e zakonshme njerëzore dhe përdor forma e teknika normale të komunikimit njerëzor.
- C. Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe synim të unifikuar. Ajo nuk bie në kundërshti me veten, ndonëse vërtet përmban pasazhe të vështira dhe paradoksale. Kështu, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.

- D. Unë besoj se çdo pasazh (përjashto profecitë) ka vetëm një kuptim, i bazuar në synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Ndonëse s'mund të jemi kurrë absolutisht të sigurt se e njohim synimin e autorit fillestar, shumë tregues na dëftojnë në drejtimin e tij:
1. Gjinia (lloji letrar) e zgjedhur për të shprehur mesazhin
 2. Sfondi historik dhe/ose shkasi i veçantë që solli në ekzistencë shkrimin
 3. Konteksti letrar i gjithë librit, si dhe i çdo njësie letrare
 4. Modeli (përvijimi) tekstual i njësisve letrare në mënyrën si lidhen me gjithë mesazhin
 5. Tiparet e veçanta gramatikore që janë përdorur për të komunikuar mesazhin
 6. Fjalët e zgjedhura për të paraqitur mesazhin
 7. Pasazhet paralele

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të pasazhit. Përpara se të shpjegoj metodologjinë time për leximin e mirë të Biblës, më lejoni të përvijoj disa nga metodat e papërshtatshme që po përdoren sot, të cilat kanë shkaktuar kaq shumë larmi interpretimesh dhe që, si rrjedhojë, duhen shmangur:

II. Metoda të papërshtatshme

- A. Anashkalimi i kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo periudhe, fjalie, madje dhe fjalësh të veçanta si pohime të së vërtetës pa lidhje me synimin e autorit ose kontekstin më të gjerë. Shpesh, ky quhet “përdorim i teksteve si provë”.
- B. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke e zëvendësuar me një sfond të hamendësuar historik që ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
- C. Anashkalimi i sfondit historik të librave dhe leximi i tyre si gazetën lokale të mëngjesit, të shkruar kryesisht për të krishterët e sotëm si individë.
- D. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke alegorizuar tekstin në një mesazh teologjiko-filozofik tërësisht pa lidhje me dëgjuesit e parë apo me synimin e autorit fillestar.
- E. Anashkalimi i mesazhit fillestar duke e zëvendësuar me sistemin tonë të teologjisë, ndonjë doktrinë që e kemi për zemër, apo me ndonjë çështje bashkëkohore pa lidhje me synimin dhe mesazhin e shprehur të autorit fillestar. Shpesh, ky fenomen vijon pas leximit fillestar të Biblës si mënyrë për të mbështetur autoritetin e folësit. Rëndom, ky quhet “reagim i lexuesit” (interpretim i llojit “çfarë më thotë teksti mua?”).

Në çdo komunikim njerëzor me shkrim mund të gjenden tre përbërës të lidhur me njëri-tjetrin:



Në të shkuarën, teknikat e ndryshme të leximit janë fokusuar në njërin nga këta tre përbërës. Por, për të pohuar vërtet frymëzimin unik të Biblës, do të ishte më i përshtatshëm një diagram i ndryshuar:



Në të vërtetë, në procesin interpretues duhen përfshirë të tre këta përbërës. Për qëllime vërtetimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori fillestar dhe teksti. Ndoshta, po reagoj ndaj keqpërdorimeve që kam përmendur: (1) alegorizimi ose shpirtërizimi i teksteve dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (ç’kuptim ka teksti për mua). Keqpërdorimi mund të ndodhë në secilën fazë. Duhet t’i kontrollojmë

gjithmonë motivet, anësitë, teknikat dhe zbatimet tona. Por si t'i kontrollojmë nëse nuk ka asnjë kufi, cak, apo kritere për interpretimet? Pikërisht këtu, synimi autorial dhe struktura e tekstit më sigurojnë disa kritere për t'ua kufizuar gamën interpretimeve të vlefshme të mundshme.

Në dritën e këtyre teknikave të përshtatshme leximore, cilat janë disa qasje të mundshme për leximin dhe interpretimin e mirë të Biblës, të cilat na ofrojnë një shkallë vërtetimi dhe konsistence?

III. Qasje të mundshme për leximin e mirë të Biblës

Në këtë pikë, nuk po diskutojmë për teknikat unike të interpretimit të gjinive të veçanta, por për parimet e përgjithshme hermeneutike që janë të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për qasjet sipas gjinive të ndryshme është *How To Read the Bible For All Its Worth (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, botuar nga Zondervan.

Metodologjia ime fokusohet fillimisht te fakti se lexuesi duhet t'i lejojë Frymës së Shenjtë që të hedhë dritë mbi Biblën përmes katër ciklesh personale leximi. Kjo i jep Frymës, tekstit dhe lexuesit vend parësor, jo dytësor. Po kështu, kjo e mbron lexuesin që të mos ndikohet në mënyrë të panevojshme nga komentuesit. Kam dëgjuar se dikush ka thënë: "Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret". Ky nuk synohet si koment zhvlerësues për ndihmat studimore, por si thirrje për përdorimin e tyre në kohën e duhur.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimet t'i mbështesim me vetë tekstin. Tri zona sigurojnë të paktën një vërtetim të kufizuar:

1. Autori fillestar
 - a. sfondi i tij historik
 - b. konteksti letrar
2. Zgjedhja nga ana e autorit fillestar e
 - a. strukturave gramatikore (sintaksës)
 - b. përdorimit të fjalëve të kohës
 - c. gjinisë letrare
3. Të kuptuarit nga ana jonë e
 - a. pasazheve të përshtatshme paralele
 - b. marrëdhënies mes doktrinaeve (paradoksi)

Duhet të jemi në gjendje të japim arsyet dhe logjikën e interpretimeve tona. Bibla është burimi ynë i vetëm për besimin dhe praktikën. Mjerisht, shpesh, të krishterët nuk bien dakord për ato që mëson ose pohon ajo. Është vetëkundërshtuese që ne besimtarët të pohojmë frymëzimin e Biblës dhe, pastaj, të mos jemi në gjendje të biem dakord se çfarë na mëson dhe kërkon ajo!

Katër ciklet e leximit synojnë të na sigurojnë të dhënat interpretuese të mëposhtme:

- A. Cikli i parë i leximit
 1. Lexo gjithë librin njëherësh. Lexoje sërish me një përkthim tjetër, ndoshta me një teori të ndryshme përkthimi
 - a. fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 2. Kërko qëllimin qendror të gjithë shkrimit. Identifiko idenë e tij kryesore.
 3. Izolo (nëse është e mundur) një njësi letrare, kapitull, paragraf, apo fjali që shpreh qartë qëllimin ose idenë e tij qendrore.
 4. Identifiko gjininë mbizotëruese letrare
 - a. Dhiata e Vjetër
 - (1) Narrativa hebraike
 - (2) Poezia hebraike (letërsi urtësie, psalm)
 - (3) Profecia hebraike (prozë, poezi)
 - (4) Kodet e ligjit
 - b. Dhiata e Re
 - (1) Narrativa (ungjijtë, Veprat)
 - (2) Shëmbëlltyra (ungjijtë)
 - (3) Letra
 - (4) Letërsia apokaliptike

- B. Cikli i dytë i leximit
1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh temat ose subjektet kryesore.
 2. Përvijoj temat madhore dhe shpreh shkurtimisht përmbajtjen e tyre me një pohim të thjeshtë.
 3. Kontrolllo pohimin e synimit dhe përvijimin tënd të përgjithshëm me anë të ndihmave studimore.
- C. Cikli i tretë i leximit
1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh sfondin historik dhe shkasit e veçantë për shkrimin e tij, duke u bazuar në të dhënat e vetë këtij libri biblik.
 2. Rendit elementet historike që përmenden në librin biblik
 - a. Autori
 - b. Data
 - c. Marrësit
 - d. Arsyeja e veçantë për shkrimin e tij
 - e. Aspekte të sfondit kulturor që lidhen me qëllimin e shkrimit
 - f. Përmendje të njerëzve dhe ngjarjeve historike
 3. Zgjerohet përvijimin tënd në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpreton. Gjithmonë identifikoj dhe përvijoj njësinë letrare. Kjo mund të përbëhet nga një sërë kapitujsh ose paragrafesh. Kjo gjë të mundëson të ndjekësh logjikën dhe modelin tekstual të autorit fillestar.
 4. Kontrolllo sfondin historik duke përdorur ndihma studimore.
- D. Cikli i katërt i leximit
1. Lexo sërish njësinë e veçantë letrare në disa përkthime
 - a. Fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. Ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. Parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 2. Gjej strukturat letrare ose gramatikore
 - a. Fraza të përsëritura, Efe. 1:6, 12, 14
 - b. Struktura të përsëritura gramatikore, Rom. 8:31
 - c. Koncepte të kundërta
 3. Rendit elementet e mëposhtme
 - a. Terma të rëndësishëm
 - b. Terma të pazakontë
 - c. Struktura të rëndësishme gramatikore
 - d. Fjalë, fjali dhe periudha tejet të vështira
 4. Gjej pasazhet e duhura paralele
 - a. Gjej pasazhin më të qartë mësimor për temën tënde duke përdorur
 - (1) Libra “të teologjisë sistematike”
 - (2) Bibla me referenca
 - (3) Përkues biblikë
 - b. Gjej një çift të mundshëm paradoksal brenda temës tënde. Shumë të vërteta biblike paraqiten në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale vijnë nga mbështetja e njëanshme të gjysma e një tensioni biblik. Gjithë Bibla është e frymëzuar, ndaj duhet të përpiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që t’i sigurojmë një drejtpeshim biblik interpretimit tonë.
 - c. Kërko për paralele brenda të njëjtit libër, të njëjtit autor, ose të njëjtës gjini letrare; Bibla është interpretuesja më e mirë e vetes, pasi ajo ka një autor të vetëm, Frymën.
 5. Përdor ndihmat studimore për të kontrolluar vëzhgimet e tua për sfondin dhe shkasit historik
 - a. Bibla studimore
 - b. Enciklopedi, manualë dhe fjalorë biblikë
 - c. Hyrje biblike
 - d. Komentarë biblikë (në këtë pikë në studimin tënd, lejo komunitetin besimtar, të kaluar dhe të tashëm, që të të ndihmojë në studimin tënd personal dhe të ta korrigjojë).

IV. Zbatimi i interpretimit të Biblës

Në këtë pikë, i kthehemi zbatimit. Ke kaluar kohë për të kuptuar tekstin në sfondin e vet fillestar; tani, duhet ta zbatosh në jetën dhe kulturën tënde. Unë e përcaktoj autoritetin biblik si “të kuptuarit e asaj që po i thoshte autori fillestar biblik kohës së vet dhe zbatimin e asaj të vërtete në kohën tonë”.

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e synimit të autorit fillestar si nga ana kohore, ashtu dhe ajo logjike. Nuk mund ta zbatojmë pasazhin biblik në kohën tonë pa kuptuar se çfarë po thoshte ai në kohën e vet! Pasazhi biblik nuk duhet të ketë një kuptim që nuk e pati kurrë vetë!

Si udhërrëfyes do të kesh përvijimin tënd të detajuar në nivelin e paragrafit (cikli i tretë i leximit). Zbatimi duhet bërë në nivelin e paragrafit, jo fjalës. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst; periudhat kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar, që është i përfshirë në procesin interpretues, është autori fillestar. Ne ndjekim vetëm udhëheqjen e tij me anë të përndritjes së Frymës së Shenjtë. Por përndritja nuk është frymëzim. Për të thënë, “kështu thotë Zoti”, duhet t’i qëndrojmë besnikë synimit të autorit fillestar. Zbatimi duhet të ketë lidhje të veçantë me synimin e përgjithshëm të gjithë shkrimit, me njësinë e veçantë letrare dhe me zhvillimin e mendimit në nivelin e paragrafit.

Mos lejo që problematikat e kohës sonë të interpretojnë Biblën; lër Biblën të flasë vetë! Kjo mund të na kërkojë që t’i nxjerrim parimet nga teksti. Kjo është e vlefshme nëse teksti mbështet një parim të caktuar. Fatkeqësisht, shumë herë, parimet tona janë thjesht të tilla, parime “tonat” – jo parime të tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të kujtojmë se (përveçse në rastin e profecisë) vetëm një kuptim i vetëm është i vlefshëm për një tekst të caktuar biblik. Ai kuptim lidhet me synimin e autorit fillestar teksa trajtonte një krizë apo nevojës të kohës. Nga ky kuptim i vetëm mund të nxirren shumë zbatime të mundshme. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve, por duhet të ketë lidhje me kuptimin e autorit fillestar.

V. Aspekti shpirtëror i interpretimit

Deri tani, kam diskutuar për procesin logjik dhe tekstual që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin. Tani, më lejoni të diskutoj shkurtimisht për aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme më ka rezultuar e dobishme:

- A. Lutu për ndihmën e Frymës (shih 1 Kor. 1:26-2:16).
- B. Lutu për falje dhe pastrim personal nga mëkatet e njohura (shih 1 Gjonit 1:9).
- C. Lutu për një dëshirë më të madhe për të njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e më tej; 119:1 e më tej).
- D. Çdo mësim të ri zbatoje menjëherë në jetë.
- E. Vazhdo të jesh i përgjithshëm dhe i mësueshëm.

Është shumë e vështirë të ruash ekuilibrin mes procesit logjik dhe udhëheqjes shpirtërore të Frymës së Shenjtë. Citimet e mëposhtme më kanë ndihmuar t’i ekuilibroj këto të dyja:

A. nga James W. Sire, *Scripture Twisting (Shtrembërimi i Shkrimit)*, f. 17-18:

“Përndritja i vjen në mendje popullit të Perëndisë – jo vetëm elitës shpirtërore. Nuk ka asnjë klasë *guru*-sh në krishterimin biblik, asnjë *iluminati*, as njerëz përmes të cilëve duhet të vijë çdo interpretim i saktë. Prandaj, ndonëse Fryma e Shenjtë jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe mprehtësie shpirtërore, ai nuk i cakton këta të krishterë të dhuntishëm që të jenë të vetmit interpretues të autoritetshëm të Fjalës së tij. Është në dorën e secilit individ të popullit të tij që të mësojë, të gjykojë dhe të dallojë në lidhje me Biblën, e cila qëndron si autoritet edhe mbi ata të cilëve Perëndia u ka dhënë aftësi të veçanta. Si përmbledhje, supozimi që shpreh në gjithë këtë libër është se Bibla është zbuluesja e vërtetë e Perëndisë për gjithë njerëzimin, se ajo është autoriteti ynë absolut për të gjitha çështjet për të cilat flet, dhe se ajo nuk është mister i plotë, por mund të kuptohet mjaftueshëm nga njerëzit e zakonshëm në çdo kulturë”.

B. për Kirkegardin, gjetur në Bernard Ramm, *Protestant Biblical Interpretation (Interpretimi biblik protestant)*, f. 75:

Sipas Kirkegardit, studimi gramatikor, leksikor dhe historik i Biblës është hap i nevojshëm, por paraprak, drejt leximit të vërtetë të Biblës. “Për ta lexuar Biblën *si fjalë të Perëndisë*, njeriu duhet ta lexojë me emocion të madh, në majtë gishtave, me pritshmëri të madhe, në kuvendim me Perëndinë. Nëse Biblën e lexon shkel e shko, pa kujdes, apo në mënyrë akademike, apo profesionale, nuk po e lexon si Fjalë të Perëndisë. Kur njeriu e lexon Biblën siç lexon një letër dashurie, atëherë po e lexon si Fjalë të Perëndisë”.

C. H. H. Rowley në *The Relevance of the Bible (Natyra aktuale e Biblës)*, f. 19:

“Asnjë kuptim thjesht mendor i Biblës, sado i plotë, s’mund t’ia zotërojë dot të gjitha thesaret asaj. Ajo nuk e përçmon këtë lloj kuptimi, sepse ai është thelbësor për të shkuar drejt të kuptuarit të plotë. Por kjo duhet të të çojë në një të kuptuar shpirtëror të thesareve shpirtërore të këtij libri, në mënyrë që të plotësohet. Dhe, për këtë të kuptuar shpirtëror, është e nevojshme diçka më tepër sesa vigjilenca mendore. Gjërat shpirtërore dallohen shpirtërisht, ndaj studiuesit të Biblës i nevojitet një qëndrim

shpirtëror pranues, një zell për të gjetur Perëndinë që t'i dorëzohet atij, në mënyrë që të kalojë, përtej studimit të tij shkencor, në trashëgiminë më të pasur të librit më madhështor në botë”.

VI. Metoda e këtij komentuari

Komentari studimor udhëzues synon të të ndihmojë në procedurat interpretuese në mënyrat vijuese

- A. Një përvijim i shkurtër historik shërben si hyrje e çdo libri. Pasi të kesh kryer “ciklin tre të leximit”, kontrollo këtë informacion.
- B. Mësimet kontekstuale gjenden në fillim të secilit kapitull. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh sesi është strukturuar njësia letrare.
- C. Në fillim të çdo kapitulli ose njësie letrare kryesore, kam dhënë ndarjet e paragrafëve dhe titujt e tyre përshkruar nga një sërë përkthimesh moderne:
 1. Teksti greqisht i United Bible Society, botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴)
 2. The New American Standard Bible, përditësimi i vitit 1995 (NASB)
 3. The New King James Version (NKJV)
 4. The New Revised Standard Version (NRSV)
 5. Today's English Version (TEV)
 6. The Jerusalem Bible (JB)Ndarjet sipas paragrafëve nuk janë të frymëzuara. Ato duhen vërtetuar nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime moderne që nisen nga teori të ndryshme përkthimi dhe pikëvështrime të ndryshme teologjike, jemi në gjendje të analizojmë strukturën e hamendësuar të mendimit të autorit fillestar. Secili paragraf përmban nga një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalë të mëdha”, ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretimin e duhur historik dhe gramatikor. S’duhet kurrë të interpretojmë, të predikojmë, ose të japim mësim nga më pak se një paragraf! Gjithmonë kujto se çdo paragraf ka lidhje me paragrafët rrethues. Ja pse është kaq e rëndësishme të bësh një përvijim të të gjithë librit në nivelin e paragrafëve. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim rrjedhën logjike të temës që po trajtohet nga autori i frymëzuar fillestar.
- D. Shënimet e Bobit ndjekin një qasje interpretimi “varg për varg”. Kjo na shtrëngon të ndjekim mendimin e autorit fillestar. Shënimet sigurojnë informacion për pikat e mëposhtme:
 1. kontekstin letrar
 2. të dhënat historike dhe kulturore
 3. informacione gramatikore
 4. studime fjalësh
 5. pasazhe paralele të rëndësishme
- E. Në pika të ndryshme gjatë këtij komentari, tekstit të shtypur të New American Standard Version (përditësimi i vitit 1995) do t’i shtojmë edhe përkthimet e një sërë versionesh të tjera moderne:
 1. The New King James Version (NKJV), i cili ndjek dorëshkrimet tekstuale të “Textus Receptus”.
 2. The New Revised Standard Version (NRSV), i cili është një rishikim “fjalë për fjalë” i Revised Standard Version, i kryer nga Këshilli Kombëtar i Kishave (National Council of Churches).
 3. The Today's English Version (TEV), i cili është një përkthim ekuivalent dinamik i Shoqërisë Biblike Amerikane.
 4. The Jerusalem Bible (JB), i cili është një përkthim anglisht i bazuar në një përkthim ekuivalent dinamik nga ana e katolikëve francezë.
- F. Për ata që s’lexojnë greqisht, krahasimi i përkthimeve anglisht mund t’i ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
 1. variantet në dorëshkrime
 2. kuptimet e ndryshme të fjalëve
 3. tekstet dhe strukturat që janë të vështira nga ana gramatikore
 4. tekstet e paqartaNdonëse përkthimet anglisht nuk i zgjidhin dot këto probleme, gjithsesi i shigjetojnë si pjesë që kanë nevojë për një studim më të thellë dhe më tërësor.
- G. Në përmbyllje të çdo kapitulli, jepen pyetje të vlefshme diskutimi, të cilat përpiqen të shigjetojnë çështjet kryesore interpretuese të atij kapitulli.

HYRJE PËR GJONIN

SHËNIME HYRËSE

- A. Mateu dhe Luka fillojnë me lindjen e Jezusit, Marku ia nis nga pagëzimi i tij, ndërsa Gjoni fillon para krijimit.
- B. Gjoni paraqet natyrën e plotë hyjnore të Jezusit të Nazaretit që në vargun e parë të kapitullit të parë dhe këtë theks e përsërit gjatë gjithë ungjillit. Ungjijtë sinoptikë e fshehin këtë të vërtetë deri nga fundi i prezantimeve të tyre (“sekreti mesianik”).
- C. Me sa duket, Gjoni e zhvillon ungjillin e vet në dritën e pohimeve themelore të ungjijve sinoptikë. Ai përpiket të shtojë dhe të interpretojë jetën dhe mësimet e Jezusit në dritën e nevojave të kishës së hershme (fondi i shekullit të parë).
- D. Gjoni duket se e strukturon prezantimin që i bën Jezus Mesisë rreth
 1. shtatë mrekullish/shenjash dhe interpretimit të tyre
 2. njëzeteshtatë intervistash dhe/ose dialogësh me individë
 3. ditësh të caktuara adhurimi dhe festash
 - a. Shabati
 - b. Pashka (shih Gjoni 5-6)
 - c. Festa e Tabernakujve (shih Gjoni 7-10)
 - d. Hanuka (shih Gjoni 10:22-39)
 4. Pohimeve “Unë jam”
 - a. të lidhura me emrin hyjnor (JHVH)
 - 1) unë jam ai (Gjoni 4:26; 8:24, 28; 13:19; 18:5-6)
 - 2) përpara se të ishte Abrahami, unë jam (Gjoni 8:54-59)
 - b. me kallëzues emëror
 - 1) unë jam buka e jetës (Gjoni 6:35, 41, 48, 51)
 - 2) unë jam drita e botës (Gjoni 8:12)
 - 3) unë jam dera e deleve (Gjoni 10:7, 9)
 - 4) unë jam bariu i mirë (Gjoni 10:11, 14)
 - 5) unë jam ringjallja dhe jeta (Gjoni 11:25)
 - 6) unë jam udha, e vërteta dhe jeta (Gjoni 14:6)
 - 7) unë jam hardhia e vërtetë (Gjoni 15:1, 5)
- E. Ndryshimet mes Gjunit dhe ungjijve të tjerë
 1. Ndonëse është e vërtetë se qëllimi parësor i Gjunit është teologjik, përdorimi që i bën historisë dhe gjeografisë është jashtëzakonisht i saktë dhe i hollësishëm. Arsyeja e sigurt për mospërputhjet mes ungjijve sinoptikë dhe Gjunit është e paqartë
 - a. një shërbesë e hershme në Jude (pastrimi i hershëm i tempullit)
 - b. kronologjia dhe data e javës së fundit të jetës së Jezusit
 - c. një ristrukturim i qëllimshëm teologjik
 2. Do të ishte e dobishme të kalonim një çast për të diskutuar dallimin e dukshëm mes Gjunit dhe ungjijve sinoptikë. Më lejoni të citoj George Eldon Ladd nga *A Theology of the New Testament (Teologji e Dhiatës së Re)* për dallimet:
 - a. “Ungjilli i katërt është kaq i ndryshëm nga sinoptikët saqë duhet të përballemi ndershmërisht me pyetjen nëse ai i raporton saktësisht mësimet e Jezusit, apo nëse besimi i krishterë e ka modifikuar kaq shumë traditën saqë historia është përpirë nga interpretimi teologjik” (f. 215).
 - b. “Zgjidhja që duket si më e kapshme është se mësimet e Jezusit shprehen me zhargonin johanin. Nëse kjo është zgjidhja e saktë, dhe nëse duhet të arrijmë në përfundim se ungjilli i katërt është i veshur me zhargonin johanin, ngrihet kjo pyetje e rëndësishme: në çfarë shkalle teologjia e ungjillit të katërt është e Gjunit, dhe jo e Jezusit? Në çfarë shkalle është asimiluar

mësimi i Jezusit kaq shumë në mendjen e Gjonit saqë ajo që kemi përpara është më tepër një interpretim johanin sesa një paraqitje e saktë e vetë mësimi të Jezusit?” (f. 215).

- c. Ladd citon dhe W. F. Albright, nga “Recent Discoveries in Palestine and the Gospel of John” (Zbulimet e kohëve të fundit në Palestinë dhe ungjilli i Gjonit) në *The Background of the New Testament and Its Eschatology (Sfondi i Dhiatës së Re dhe eskatologjia e saj)*, redaktuar prej W. D. Davies dhe D. Daube

“Nuk ka asnjë dallim themelor në mësim midis Gjonit dhe sinoptikëve; kontrasti mes tyre gjendet në përqendrimin e traditës rreth disa aspekte të veçanta të mësimëve të Krishtit, veçanërisht ato që duket se i ngjanin më ngushtësisht mësimi të esenëve.

Nuk ka absolutisht asgjë që të demonstrojë se ndonjë nga mësimet e Jezusit është shtrembëruar apo falsifikuar, apo se atyre u është shtuar ndonjë element i ri jetik. Faktin se nevojat e kishës së hershme ndikuan në përzgjedhjen e elementeve që do të përfshiheshin në ungjill mund ta pranojmë pa ngurrim, por nuk ka arsye të hamendësojmë se nevojat e asaj kishe ishin përgjegjëse për ndonjë shpikje apo risi me vlerë teologjike.

Një nga supozimet më të çuditshme të studiuesve dhe teologëve kritikë të Dhiatës së Re është se mendja e Jezusit ishte kaq e kufizuar saqë çdo kontrast në dukje mes Gjonit dhe sinoptikëve duhet të jetë për shkak të dallimeve mes teologëve të krishterë të hershëm. Çdo mendimtar dhe personalitet i madh ka për t’u interpretuar ndryshe nga miqtë dhe dëgjuesit e ndryshëm, të cilët do të përzgjedhin atë që duket si më e pëlqyeshme ose më e dobishme nga ato që kanë parë dhe dëgjuar” (f. 170-171).

- d. Dhe sërish nga George E. Ladd:

“Dallimi mes tyre nuk është se Gjoni është teologjik ndërsa të tjerët jo, por se të gjithë janë teologjikë në mënyra të ndryshme. Historia e interpretuar mund t’i paraqesë më vërtetësisht faktet e një situatë sesa kronika e thatë e ngjarjeve. Nëse Gjoni është interpretim teologjik, ai është një interpretim ngjarjesh që Gjoni është i bindur se ndodhën në histori. Qartazi, synimi i ungjijve sinoptikë nuk është të japin raportimin e *ipsissima verba* (fjalëve të sakta) të Jezusit, apo një biografi të ngjarjeve të jetës së tij. Ato janë portrete të Jezusit dhe përmbledhje të mësimi të tij. Mateu dhe Luka ndihen të lirë të rirëndisin materialin e Markut dhe të raportojnë mësimin e Jezusit me liri të madhe. Nëse Gjoni tregoi më tepër liri se Mateu dhe Luka, këtë e bëri pasi dëshironte të jepte një portret më të thellë dhe, në fund fare, më real të Jezusit” (f. 221-222).

AUTORI

- A. Ungjilli është anonim, por aludon për autorësinë e Gjonit.
1. autori është dëshmitar okular (shih Gjoni 19:35)
 2. fraza “dishepulli i dashur” (si Polikrati, ashtu dhe Ireneu, e identifikojnë me Gjon apostullin)
 3. Gjoni, biri i Zebedeut, s’përmendet kurrë me emër
- B. Sfondi historik është i qartë nga vetë ungjilli; si rrjedhojë, çështja e autorësisë nuk është faktor kyç për interpretimin. Thelbësor është pohimi i një autori të frymëzuar!
- Autorësia dhe data e ungjillit të Gjonit nuk prekin frymëzimin, por interpretimin. Komentuesit kërkojnë një sfond historik, një shkas që i dha shtysë shkrimit të librit. A duhet të krahasojmë dualizmin e Gjonit me
1. dy epokat judaike
 2. mësuësia e drejtësisë të Kumranit
 3. fenë zoroastriane
 4. mendimin gnostik
 5. perspektivën unike të Jezusit?
- C. Pikëpamja e hershme tradicionale është se apostulli Gjon, biri i Zebedeut, është burimi njerëzor si dëshmitar okular. Kjo duhet qartësuar pasi burimet e jashtme nga shekulli i dytë duket se lidhin disa të tjerë me prodhimin e ungjillit:

1. Bashkëbesimtarët dhe pleqtë efesianë inkurajuan apostullin e moshuar që të shkruante (Euzebi citon Klementin e Aleksandrisë)
 2. Një bashkë-apostull, Andrea (Fragmenti Muratorian, 180-220 pas K., nga Roma)
- D. Disa studiues të sotëm kanë supozuar një autor tjetër në bazë të një sërë supozimesh për stilin dhe lëndën e ungjillit. Shumë syresh supozojnë një datim në fillim të shekullit të dytë (përpara 115 pas K.):
1. shkruar nga dishepujt e Gjonit (një rreth ndikimi johanin), të cilët kujtonin mësimet e tij (J. Weiss, B. Lightfoot, C. H. Dodd, O. Cullmann, R. A. Culpepper, C. K. Barrett)
 2. shkruar nga “plaku Gjon” (njëri prej një sërë drejtuesve të hershëm nga Azia që u ndikuan nga teologjia dhe terminologjia e apostullit Gjon), një ide e deduktuar nga një pasazh i paqartë të Papis (70-146 pas K.), cituar nga Euzebi (280-339 pas K.).
- E. Prova për vetë Gjonin si burimi parësor për materialin e ungjillit
1. provat e brendshme
 - a. autori njihnte mësimet dhe ritualet judaike dhe ndante botëkuptimin e tyre të Dhiatës së Vjetër
 - b. autori njihnte Palestinën dhe Jerusalemin në gjendjen e tyre para vitit 70
 - c. autori pretendon se është dëshmitar okular
 - 1) Gjoni 1:14
 - 2) Gjoni 19:35
 - 3) Gjoni 21:24
 - d. autori ishte anëtar i grupit apostolik, sepse njeh:
 - 1) hollësitë e kohës dhe vendit (grykimet natën)
 - 2) hollësitë e numrave (enëve të ujit te Gjoni 2:6 dhe peshqit te Gjoni 21:11)
 - 3) hollësitë e personave
 - 4) autori njihnte hollësitë e ngjarjeve dhe reagimin ndaj tyre
 - 5) autori duket se përcaktohet si “dishepulli i dashur”
 - a) Gjoni 13:23, 25
 - b) Gjoni 19:26-27
 - c) Gjoni 20:2-5,8
 - d) Gjoni 21:7, 20-24
 - 6) autori duket se është anëtar i rrethit të brendshëm, bashkë me Pjetrin
 - a) Gjoni 13:24
 - b) Gjoni 20:2
 - c) Gjoni 21:7
 - 7) Emri “Gjoni, biri i Zebedeut” nuk shfaqet kurrë në këtë ungjill, gjë që duket tejet e pazakontë, pasi ai ishte anëtar i rrethit të brendshëm apostolik
 2. Provat e jashtme
 - a. Ungjilli njihet nga
 - 1) Ireneu (120-202 pas K.), i cili shoqërohej me Polikarpin, njihnte apostullin Gjon (shih *Historia Ecclesiastica* e Euzebit, 5:20:6-7) – “Gjoni, dishepulli i Zotit, i cili mbështetej në gjoksin e tij dhe vetë botoi ungjillin në Efes të Azisë” (*Haer.*, 3:1:1, cituar nga Euzebi në *Hist. Eccl.* 5:8:4).
 - 2) Klementi i Aleksandrisë (153:217 pas K.) – “Gjoni, i cili u nxit nga miqtë e vet dhe u shty në mënyrë hyjnore nga Fryma, përpiloi një ungjill shpirtëror” (Euzebi, *Historia Ecclesiastica* 6:14:7).
 - 3) Justin Martiri (110-165 pas K.), në librin e tij *Dialog me Trifonin* 81:4
 - 4) Tertuliani (145-220 pas K.)
 - b. Autorësia e Gjonit pohohet nga dëshmitarë shumë të hershëm
 - 1) Polikarpi (70-156 pas K., dokumentuar nga Ireneu), i cili ishte peshkop i Smirnës (155 pas K.)
 - 2) Papis (70-146 pas K., dokumentuar nga Prologu anti-Markonit në Romë dhe nga Euzebi), i cili ishte peshkopi i Hierapolit në Frigji dhe thuhej se ishte dishepull i apostullit Gjon
- F. Arsyet që përdoren për të dyshuar autorësinë tradicionale
1. Lidhja e ungjillit me motive gnostike

2. Shtojca e dukshme e kapitullit 21
3. Mospërputhjet kronologjike me ungjijtë sinoptikë
4. Gjoni nuk do ta kishte quajtur veten “dishepulli i dashur”
5. Jezusi i Gjonit përdor fjalor dhe gjini të ndryshme letrare nga sinoptikët

G. Nëse supozojmë se autori ishte apostulli Gjon, atëherë çfarë mund të supozojmë për këtë njeri?

1. Ai shkroi nga Efesi (Ireneu thotë se “botoi ungjillin nga Efesi”)
2. Ai shkroi kur ishte më i moshuar (Ireneu thotë se jetoi deri në mbretërimin e Trajanit, 98-117 pas K.)

DATA

A. Nëse pranojmë apostullin Gjon

1. përpara 70 pas K., kur Jerusalemi u shkatërrua nga gjenerali (më vonë, perandori) romak Titi
 - a. në Gjoni 5:2: “Në Jerusalem, pranë portës së dhenve është një pellg që në hebraisht quhet Betesda, dhe ka pesë portikë...”
 - b. përdorimi i përsëritur i titullit të hershëm “dishepuj” për të përcaktuar grupin e apostujve
 - c. elemente, që supozoheshin se i përkisnin gnosticizmit të mëvonshëm, tani janë zbuluar në Pergamenat e Detit të Vdekur, të cilat tregojnë se ishin pjesë e zhargonit teologjik të shekullit të parë
 - d. asnjë përmendje e shkatërrimit të Tempullit dhe qytetit të Jerusalemit në 70 pas K.
 - e. arkeologu i famshëm amerikan, W. F. Albright, pohon për ungjillin një datim në fundin e viteve 70“ ose fillimin e viteve ,80
2. më vonë në shekullin e parë
 - a. teologjia e zhvilluar e Gjonit
 - b. rënia e Jerusalemit nuk përmendet, pasi ndodhi para rreth njëzet vitesh
 - c. përdorimi i frazave dhe thekseve të llojit gnostik nga ana e Gjonit
 - d. traditat e hershme të kishës
 - 1) Ireneu
 - 2) Euzebi

B. Nëse supozojmë “plakun Gjon”, atëherë data do të ishte fillimi ose mesi i shekullit të dytë. Kjo teori nisi me refuzimin e autorësisë së apostullit Gjon nga Dionisi (për arsye letrare). Euzebi, i cili e refuzoi autorësinë e apostullit Gjon për Zbulesën për arsye teologjike, mendonte se kishte gjetur një tjetër “Gjon” në kohën dhe në vendin e duhur në citimin e Papiasit (*Historia Ecclesiastica* 3:39:5, 6), i cili rendit dy “Gjona”: (1) apostullin dhe (2) një plak (presbiter).

MARRËSIT

A. Fillimisht u shkrua për kishat e provincës romake të Azisë së vogël, veçanërisht për Efesin.

B. Për shkak të thjeshtësisë kuptimplotë dhe thellësisë së këtij rrëfimi të jetës dhe personit të Jezusit së Nazaretit, ky u bë ungjill i preferuar, si për besimtarët helenistë dhe johebrenj, ashtu dhe për grupet gnostike.

QËLLIMET

A. Vetë ungjilli pohon synimin e vet ungjillëzues, Gjoni 20:30-31

1. për lexuesit hebrenj
2. për lexuesit johebrenj
3. për lexuesit e hershëm gnostikë

B. Duket se ka një shtysë apologjetike

1. kundër ndjekësve fanatikë të Gjon Pagëzorit
2. kundër mësuesve të rremë të gnosticizmit që po mbinte (sidomos Prologu); këto mësimë të rreme gnostike formojnë dhe sfondin e librave të tjerë të Dh.R.:

- a. Efesianët
 - b. Kolosianët
 - c. Letrat pastorale (1 Timoteu, Titi, 2 Timoteu)
 - d. 1 Gjoni (1 Gjoni mund të ketë funksionuar si letër shpjeguese për ungjillin)
- C. Ekziston mundësia që pohimi i synimit të Gjoni 20:31 të kuptohet sikur nxit jo vetëm ungjillizimin, por edhe doktrinën e qëndrueshmërisë, për shkak të përdorimit të vazhdueshëm të KOHËS SË TASHME për të përshkruar shpëtimin. Në këtë kuptim, Gjoni, ashtu si Jakobi, ndoshta po drejtpeshon një mbitheksim të teologjisë së Palit nga ana e disa grupeve në Azinë e vogël (shih 2 Pjetri 3:15-16). Është e habitshme që tradita e kishës së hershme identifikon Gjoningin, dhe jo Palin, me Efesin (shih F. F. Bruce, *Peter, Stephen, James and John: Studies in Non-Pauline Christianity* [Pjetri, Stefani, Jakobi dhe Gjoni: studime për krishterimin jopalian], f. 120-121).
- D. Epilogu (Gjoni 21) duket se u përgjigjet pyetjeve të veçanta të kishës së hershme
1. Gjoni plotëson rrëfimet e ungjijve sinoptikë. Sidoqoftë, ai fokusohet në shërbesën në Jude, veçanërisht në Jerusalem.
 2. Tre pyetjet që mbulon Shtojca, Gjoni 21
 - a. rimëkëmbja e Pjetrit
 - b. jetëgjatësia e Gjoningit
 - c. kthimi i vonuar i Jezusit
- E. Disa mendojnë se Gjoni i heq theksin sakramentalizmit duke anashkaluar qëllimisht dhe duke mos shënuar ose diskutuar vetë sakramentet, pavarësisht mundësive të përsosura kontekstuale në Gjoni 3 (për pagëzimin) dhe Gjoni 6 (për eukaristinë, ose Darkën e Zotit).

TIPARE TË PËRVIJIMIT TË GJONIT

- A. Një prolog filozofik/teologjik (Gjoni 1:1-18) dhe një epilog praktik (Gjoni 21)
- B. Shtatë shenja mrekullie gjatë shërbesës publike të Jezusit (kapitujt 2-12) dhe interpretimi i tyre:
1. ndryshimi i ujit në verë në festën e dasmës në Kanë (Gjoni 2:1-11)
 2. shërimi i birit të nëpunësit të mbretit në Kapernaum (Gjoni 4:46-54)
 3. shërimi i ulokut në pellgun e Betesdës në Jerusalem (Gjoni 5:1-18)
 4. ushqyerja e rreth 5,000 vetëve në Galile (Gjoni 6:1-15)
 5. ecja mbi Detin e Galilesë (Gjoni 6:16-21)
 6. shërimi i burrit që kishte lindur i verbër në Jerusalem (Gjoni 9:1-41)
 7. ringjallja e L Lazarit në Betani (Gjoni 11:1-57)
- C. Intervistat dhe dialogët me individë të ndryshëm
1. Gjoni Pagëzori (Gjoni 1:19-34; 3:22-36)
 2. dishepuj
 - a. Andrea dhe Pjetri (Gjoni 1:35-42)
 - b. Filipi dhe Natanaeli (Gjoni 1:43-51)
 3. Nikodemi (Gjoni 3:1-21)
 4. gruaja nga Samaria (Gjoni 4:1-45)
 5. judenjtë në Jerusalem (Gjoni 5:10-47)
 6. turma në Galile (Gjoni 6:22-66)
 7. Pjetri dhe dishepujt (Gjoni 6:67-71)
 8. vëllezërit e Jezusit (Gjoni 7:1-13)
 9. judenjtë në Jerusalem (Gjoni 7:14-8:59; 10:1-42)
 10. dishepujt në dhomën e sipërme (Gjoni 13:1-17:26)
 11. arrestimi dhe gjykimi judaik (Gjoni 18:1-27)
 12. gjykimi romak (Gjoni 18:28-19:16)
 13. bisedat pas ringjalljes, 20:11-29
 - a. me Marinë
 - b. me dhjetë apostujt

- c. me Thomain
14. dialogu në epilog me Pjetrin, Gjoni 21:1-25.
15. (Gjoni 7:53-8:11, ndodhia e gruas kurorëshkelëse, nuk ishte pjesë e ungjillit të Gjonit që në fillim!)

D. Disa ditë adhurimi/festash

1. shabatet (Gjoni 5:9; 7:22; 9:14; 19:31)
2. pashkët (Gjoni 2:13; 6:4; 11:55; 18:28)
3. festa e Tabernakujve (Gjoni 8-9)
4. Hanuka (festivali i dritave, shih Gjoni 10:22)

E. Përdorimi i pohimeve “unë jam”

1. “Unë jam „Ai” (Gjoni 4:26; 6:20; 8:24, 28, 54-59; 13:19; 18:5-6, 8)
2. “Unë jam buka e jetës” (Gjoni 6:35, 41, 48, 51)
3. “Unë jam drita e botës” (Gjoni 8:12; 9:5)
4. “Unë jam dera e deleve” (Gjoni 10:7, 9)
5. “Unë jam bariu i mirë” (Gjoni 10:11, 14)
6. “Unë jam ringjallja dhe jeta” (Gjoni 11:25)
7. “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6)
8. “Unë jam hardhia e vërtetë” (Gjoni 15:1, 5)

CIKLI NJË I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

GJONI 1

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Fjala u bë mish	Fjala e përjetshme	Prolog	Fjala e jetës	Prolog
1:1-5	1:1-5	1:1-5	1:1-5	1:1-18
	Dëshmia e Gjonit: Drita e vërtetë			
1:6-13	1:6-13	1:6-9 1:10-13	1:6-9 1:10-13	
	Fjala u bë mish			
1:14-18	1:14-18	1:14-18	1:14 1:15 1:16-18	1:8-15
Dëshmia e Gjon Pagëzorit	Një zë në shkretëtirë	Dëshmia e Gjonit	Mesazhi i Gjon Pagëzorit	Dëshmia e Gjonit
1:19-28	1:19-28	1:19-23 1:24-28	1:19 1:20 1:21a 1:21b 1:21c 1:22a 1:22b 1:23 1:24-25 1:26-27 1:28	1:19-28
Qengji i Perëndisë	Qengji i Perëndisë		Qengji i Perëndisë	
1:29-34	1:29-34	1:29-34	1:29-31 1:32-34	1:29-34
Dishepujt e parë	Dishepujt e parë	Dëshmia e dishepujve të parë të Jezusit	Dishepujt e parë të Jezusit	Dishepujt e parë
1:35-42	1:35-42	1:35-42	1:35-36 1:37-38a 1:38b 1:39 1:40-42a	1:35-39

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

Thirrja e Filipit Nataelaelit	Filipi dhe Natanaeli		1:42b	
1:43-51	1:43-51	1:43-51	Jezusi thërret Filipin dhe Nataelaelin	1:43-51
			1:46a	
			1:46b	
			1:47	
			1:48a	
			1:48b	
			1:49	
			1:50-51	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-18

- A. Përvijimi teologjik i poezisë/himnit/kredos
 1. Krishti i përjetshëm, hyjnor, krijues dhe shpengues, v. 1-5 (Jezusi si Fjala)
 2. Dëshmia profetike për Krishtin, v. 6-9, 15 (Jezusi si Drita)
 3. Krishti i mishëruar zbulon Perëndinë, v. 10-18 (Jezusi si Bir)
- B. Struktura teologjike e v. 1-18 dhe temat e përsëritura
 1. Jezusi ishte paraekzistues me Perëndinë Atë (1a)
 2. Jezusi ishte në bashkësi të ngushtë me Perëndinë Atë (1b, 2, 18c)
 3. Jezusi ka pikërisht të njëjtën substancë si Perëndia Atë (1c, 18b)
 4. Mjeti i shpengimit dhe birësimit që jep Perëndia Atë (12-13)
 5. Mishërimi, hyjnia bëhet njeri (9, 14)
 6. Zbuluesi, hyjnia plotësisht e zbuluar dhe e kuptuar (18d)
- C. Sfondi hebraik dhe grek i *logos* (fjala)
 1. Sfondi hebraik
 - a. fuqia e fjalës së folur (Isa. 55:11; Psa. 33:6; 107:20; 147:15, 18), si në Krijim (Zan. 1:3, 6, 9, 11, 14, 20, 24, 26, 29) dhe në bekimin patriarkal (Zan. 27:1 e më tej; 49:1)
 - b. Fjalët e Urta 8:12-23 personifikon “Urtësinë” si krijimin e parë të Perëndisë dhe si vepruesin e gjithë krijimit (shih Psa. 33:6 dhe librin jokanonik *Urtësia e Solomonit*, 9:9)
 - c. Targumët (përkthime dhe komentare në aramaisht) e zëvendësojnë fjalën *logos* me frazën “Fjala e Perëndisë” për shkak të sikletit që ndienin nga termat antropomorfikë
 2. Sfondi grek
 - a. Herekleiti – bota është në gjendje ndryshimi; *logos*-i hyjnor, jopersonal dhe i pandryshueshëm e mban të bashkuar dhe i prin procesit të ndryshimit

- b. Platoni – *logos*-i jopersonal dhe i pandryshueshëm mban planetët në orbitat e tyre dhe përcakton stinët
- c. Stoikët – *logos*-i është “arsyeja” ose administratori i botës, por është gjysmëpersonal
- d. Filoja – konceptin e *logos*-it e personifikonte si “Kryepriifti që vendos shpirtin e njeriut përpara Perëndisë”, ose “ura midis njeriut dhe Perëndisë”, ose “leva me të cilën Timonieri i universit drejton gjithçka” (*kosmokrator*).

D. Elementet e sistemeve të zhvilluara teologjiko-filozofike gnostike në shekullin e dytë pas K.

1. Një dualizëm ontologjik (i përjetshëm) antagonist midis Shpirtit dhe materies
2. Materia është e ligë dhe kryeneçe; Shpirti është i mirë
3. Sistemi gnostik përcakton një sërë nivelesh engjëllore (*aeon*) midis një perëndie të lartë e të mirë dhe një perëndie më të ulët, i cili ishte në gjendje të formonte materien. Madje, disa pohojnë se ky perëndi më i ulët ishte JHVH i DhV (si Markioni)
4. Shpëtimi vinte nga
 - a. Një njohuri e fshehtë (ose fjalëkalime), që i lejonte njeriut të kalonte përmes këtyre niveleve engjëllore në rrugën drejt bashkimit me Perëndinë
 - b. Një shkëndijë hyjnore në të gjithë njerëzit, për të cilën ata nuk ishin të vetëdijshëm deri në çastin kur merrnin njohurinë e fshehtë
 - c. Një veprues i veçantë personal zbuluese, i cili ia jepte këtë njohuri të fshehtë njerëzimit (Fryma e Krishtit)
5. Ky sistem mendimi pohonte natyrën hyjnore të Jezusit, por mohonte realitetin e mishërimit të tij të përhershëm dhe vendin e tij qendror në shpëtim!

E. Sfondi historik

1. Vargjet 1-18 janë një përpjekje për t’u akomoduar mendjeve hebraike dhe greke me anë të përdorimit të termit *logos*.
2. Herezia e gnosticizmit është sfondi filozofik i kësaj hyrjeje tejet të strukturuar të ungjillit sipas Gjonit. I Gjonit mund të ketë qenë letër shpjeguese e ungjillit. Sistemi teologjik i mendimit i quajtur “gnosticizëm” është i panjohur me shkrim para shekullit të dytë, por motivet fillestare gnostike gjenden në Pergamenat e Detit të Vdekur dhe te Filoja.
3. Ungjijtë sinoptikë (sidomos Marku) e fshehin natyrën hyjnore të Jezusit (sekretin mesianik) deri në Kalvar, ndërsa Gjoni, që shkroi shumë kohë më vonë, zhvillon motivet kyçe të Jezusit si plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri (Biri i Njeriut, shih Ezek. 2:1 dhe Dan. 7:13) në kapitullin një.

F. Shih Temën e Veçantë: Gjoni 1, krahasuar me 1 Gjonin 1 te 1 Gjonit 1:1.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:1-5

¹Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte me Perëndinë, dhe Fjala ishte Perëndi. ²Ai ishte në fillim me Perëndinë. ³Të gjitha gjërat u krijuan me anë të tij, dhe pa të nuk u krijua asgjë që është krijuar. ⁴Në të ishte jeta, dhe jeta ishte Drita e njerëzve. ⁵Drita shkëlqen në errësirë, dhe errësira nuk e kuptoi.

1:1 “Në fillim” Kjo reflekton Zanafillën 1:1, madje përdoret edhe te 1 Gjonit 1:1 si referencë për mishërimin. Ka gjasa që 1 Gjonit të ketë qenë letër shpjeguese për ungjillin. Të dyja trajtojnë gnosticizmin. Vargjet 1-5 janë pohim i paraekzistencës hyjnore të Jezu Krishtit përpara krijimit (shih 1:15; 8:56-59; 16:28; 17:5; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3; 10:5-9).

DhR përshkruhet si

1. krijim i ri, i panjollësuar nga Rënia (d.m.th., Zan. 3:15 e përmbushur për njerëzimin)
2. pushtim i ri (Toka e Premtuar)
3. eksod i ri (profecia e përmbushur)
4. Moisi i ri (ligjvënës)
5. Jozue i ri (shih Heb. 4:8)
6. mrekulli e re uji (shih Heb. 3-4)

7. mana e re (shih Gjoni 6)
dhe shumë e shumë më tepër, sidomos te Hebrenjve.

TEMË E VEÇANTË: *ARCHË*

Termi “zotërim” është fjala greke *archē*, që do të thotë “fillimi” ose “origjina” e diçkaje.

1. fillimi i rendit të krijuar (shih Gjoni 1:1; 1 Gjonit 1:1; Heb. 1:10)
2. fillimi i ungjillit (shih Marku 1:1; Fil. 4:15; 2 Thes. 2:13; Heb. 2:3)
3. dëshmitarët e parë (shih Luka 1:2)
4. shenjat e fillimit (mrekullitë, shih Gjoni 2:11)
5. parimet fillestare (shih Heb. 5:12)
6. siguria fillestare, bazuar në të vërtetat e ungjillit (shih Heb. 3:14)
7. fillimi (Kol. 1:18; Zbu. 3:14)

Më vonë, u përdor për “sundimin”, ose “autoritetin”

1. për zyrtarët qeveritarë njerëzorë
 - a. Luka 12:11
 - b. Luka 20:20
 - c. Romakëve 13:3; Titi 3:1
2. për autoritetet engjëjlore
 - a. Romakëve 8:38
 - b. 1 Kor. 15:24
 - c. Efe. 1:21; 3:10; 6:12
 - d. Kol. 1:16; 2:10, 15
 - e. Juda 6

Këta mësues të rremë përçmojnë çdo autoritet, tokësor dhe qiellorë qoftë. Ata janë njerëz të shthurur antinomianë. Ata vendosin veten dhe dëshirat e tyre përpara Perëndisë, engjëjve, autoriteteve civile dhe drejtuesve të kishave.

■ **“ishte”** (tri herë) Kjo është në KOHËN E PAKRYER (shih v. 1, 2, 4, 10), që përqendrohet te ekzistenca e vazhduar në kohën e shkuar. Kjo KOHË përdoret për të treguar paraekzistencën e Logosit (shih 8:57-58; 17:5, 24; 2 Kor. 8:9; Kol. 1:17; Heb. 10:5-7). Vihet në kontrast me KOHËT AORISTE të v. 3, 6 dhe 14.

■ **“Fjala”** termi greqisht *logos* i referohet një mesazhi, jo një fjale të vetme. Në këtë kontekst, është një titull që grekët e përdornin për të përshkruar “arsyen në botë”, ndërsa për hebrenjtë ishte e ngjashme me “Urtësinë”. Gjoni e zgjodhi këtë term për të pohuar se Fjala e Perëndisë është edhe person, edhe mesazh. Shih Mësimet Kontekstuale, C.

■ **“me Perëndinë”** “Me” mund të parafrazohet “ballë për ballë”. Përshkruan një bashkësi të ngushtë. Po kështu, dëfton drejt konceptit të një substance hyjnore dhe tre shfaqjesh personale të përjetshme (shih Temë e Veçantë: Trinia, në 14:26). DhR pohon paradoksin se Jezusi është i veçuar nga Ati, por edhe se ai është një me Atin.

■ **“Fjala ishte Perëndi”** Kjo FOLJE është në KOHËN E PAKRYER si në v. 1a. Nuk ka NYJË (që identifikon KRYEFJALËN, shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 66) para fjalës *Theos*, por *Theos* është vendosur e para në frazën greqisht për theksim. Ky varg, si dhe v. 18, janë pohime të forta të natyrës së plotë hyjnore të Logosit paraekzistues (shih 5:18; 8:58; 10:30; 14:9; 17:11; 20:28; Rom. 9:5; Heb. 1:8; 2 Pet. 1:1). Jezusi është plotësisht hyjnor dhe plotësisht njerëzor (shih 1 Gjonit 4:1-3). Ai nuk është i njëjti person si Perëndia Atë, por është plotësisht i së njëjtës substancë hyjnore si Ati.

DhR pohon natyrën e plotë hyjnore të Jezusit të Nazaretit, por mbron dhe personalitetin e veçantë të Atit. Kjo substancë e vetme hyjnore theksohet në Gjoni 1:1; 5:18; 10:30, 34-38; 14:9-10; dhe 20:28, ndërsa veçantitë e tyre theksohen në Gjoni 1:2, 14, 18; 5:19-23; 8:28; 10:25, 29; 14:11, 12, 13, 16.

1:2 Ky është paralel me v. 1 dhe thekson sërish të vërtetën tronditëse në dritën e monoteizmit se Jezusi, i cili lindi rreth 6-5 para K., ka qenë gjithmonë me Atin dhe, si rrjedhojë, është Hyjni.

1:3 “Të gjitha gjërat u krijuan me anë të tij” Logosi ishte vepruesi i Atit për krijimin e gjërave të dukshme dhe të padukshme (shih v. 10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2). Kjo është e ngjashme me rolin që urtësia luan në Psa. 104:24 dhe Fja. 3:19; 8:12-23 (në hebraisht, “urtësia” është EMËR në gjininë FEMËRORE).

■ **“pa të nuk u krijua asgjë që është krijuar”** Ky është refuzim i mësimin të rremë gnostik me aeon-at engjëllorë midis perëndisë së mirë e të lartë dhe një qenieje më të ulët shpirtërore që formoi materien paraekzistuese (shih Mësimet Kontekstuale, D).

1:4 “në të ishte jeta” Kjo frazë po thekson se vetë “jeta” vjen nga Biri, Fjala. Gjoni përdor termin *zoē* për t’u referuar jetës së ringjalljes, jetës së përtjetshme, jetës së Perëndisë (shih 1:4; 3:15, 36; 4:14, 36; 5:24, 26, 29, 39, 40; 6:27, 33, 35, 40, 47, 48, 51, 53, 54, 63, 65, etj.). Termi tjetër grek për “jetën”, *bios*, përdoret për jetën tokësore dhe biologjike (shih 1 Gjonit 2:16).

■ **“jeta ishte Drita e njerëzve”** Drita është një metaforë e zakonshme që Gjoni e përdor për të vërtetën dhe njohurin e Perëndisë (shih Gjoni 3:19; 8:12; 9:5; 12:46). Vini re se jeta ishte për të gjithë njerëzit (aludim i mundshëm i Psa. 36:5-9)! Edhe drita me errësirën ishin tema të përhapura në Pergamenat e Detit të Vdekur. Shpesh, Gjoni shprehet me terma dhe kategori dualiste (ballafaqese).

1:5 “Drita shkëlqen” Kjo është në KOHËN E TASHME, që do të thotë, vendim i vazhduar. Jezusi ka ekzistuar gjithmonë, por tani i është shfaqur qartazi botës (shih 8:12; 9:5; 12:46). Në DhV, shfaqja fizike ose njerëzore e Perëndisë shpesh identifikohet me engjëllin e Zotit (shih Zan. 16:7-13; 22:11-15; 31:11, 13; 48:15-16; Eks. 3:2, 4; 13:21; 14:19; Gjyq. 2:1; 6:22-23; 13:3-22; Zak. 3:1-2). Disa pohojnë se ky ishte Logosi i paramishëruar.

TEMË E VEÇANTË: ENGJËLLI I ZOTIT

Është e qartë se hyjnia e shfaq veten fizikisht në formë njerëzore në DhV. Për trinitarianët, pyetja shtrohet se cili person i Trinisë e përmbush këtë rol. Meqë Perëndia Atë (JHVH) dhe Fryma e tij janë gjithmonë jotruporë, duket e mundshme të sugjerojmë që këto shfaqje njerëzore kryhen nga Mesia i paramishëruar.

Për të demonstruar vështirësitë me të cilat përballemi kur përpiqemi të identifikojmë një teofani nga takimet me engjëjt, lista e mëposhtme na shërben si ilustrim.

1. engjëlli i Zotit si engjëll
 - a. Zan. 24:7, 40
 - b. Eks. 23:20-23; 32:34
 - c. Num. 22:22
 - d. Gjyq. 5:23
 - e. 2 Sam. 24:16
 - f. 1 Kron. 21:15-30
 - g. Zak. 1:12-13
2. engjëlli i Zotit si teofani
 - a. Zan. 16:7-13; 18:1-19:1; 22:11-15; 31:11, 13; 48:15-16
 - b. Eks. 3:2, 4; 14:19 (13:21)
 - c. Gjyq. 2:15; 6:22-24; 13:3-23
 - d. Osea 12:3-4
 - e. Zak. 3:1-5

■
NASB, NKJV “errësira nuk e kuptoi”
NRSV “errësira nuk e mposhti”
TEV “errësira nuk e shoi kurrë”
NJB “dhe errësira nuk arriti dot ta mposhte”

Kuptimi rrënjë i këtij termi (*katalambanō*) është “rrok”. Si rrjedhojë, mund të ketë ose kuptimin (1) rrok në mënyrë që të mposht dikë (shih Mat. 16:18) ose (2) rrok në mënyrë që të kuptoj ose perceptoj. Gjoni mund ta ketë përdorur këtë dykuptimësi për të sugjeruar të dyja idetë. Ungjëlli i Gjonit karakterizohet nga loja me fjalët dykuptimëshe (p.sh., “i rilindur” dhe/ose “i lindur nga lart”, 3:3 dhe “era” dhe/ose “fryma”, 3:8).

FOLJA (*katalambanō*) shfaqet vetëm dy herë në shkrimet e Gjonit (përdorimi i saj në 8:3, 4 nuk është origjinal). Në 1:5, errësira nuk mund të kuptojë/mposhtë, ndërsa, në 12:35, errësira që refuzon dritën (Jezusin/ungjillin) nuk mund të mposhtet. Refuzimi çon në pështjellim; pranimi çon në adhurim!

Manfred T. Brauch, *Abusing Scripture*, f. 35, karakterizon gjendjen njerëzore.

1. Gjendja e humbur, Luka 15
2. Errësira, Gjoni 1:5
3. Armiqësia, Rom. 5:10
4. Ndarja, Efe. 2:15-17
5. Paperëndishmëria, Rom. 1:18
6. Tëhuajtja nga jeta e Perëndisë, Efe. 4:17-18
7. Përmbledhja më e mirë e mëkatit njerëzor gjendet në Rom. 1:18-3:23

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:6-8

⁶Erdhi një njeri i dërguar nga Perëndia, emri i të cilit ishte Gjon. ⁷Ai erdhi si dëshmitar, për të dëshmuar për Dritën, në mënyrë që të gjithë të besojnë përmes tij. ⁸Ai nuk ishte Drita, por *erdhi* që të dëshmonte për Dritën.

1:6-8 Këto vargje dhe v. 15 (një kujtim si parantezë) shënojnë dëshminë e Gjon Pagëzorit për Jezusin. Ai ishte i fundmi profet i DhV. Është e vështirë t'i vësh këto vargje në formë poetike. Ka patur shumë debat mes studiuesve nëse ky prolog është poezi apo prozë.

Gjon Pagëzori ishte profeti i fundit i DhV (në kuptimin e mesazhit dhe pikëvështrimit të tij). Ai ishte pararendësi i parathënë në Mal. 3:1 dhe 4:5 (shih Gjoni 1:20-25). Gjon apostulli mund t'i ketë futur vargjet 6-8 për shkak të keqkuptimeve të hershme që u zhvilluan rreth Gjon Pagëzorit (shih Luka 3:15; Veprat 18:25; 19:3). Gjoni, i cili shkroi më vonë se shkruesit e tjerë të ungjijve, e vërejti zhvillimin e këtij problemi.

Është interesante të vërejmë se Krishti përshkruhet me FOLJE në KOHËN E PAKRYER (paraekzistenca e tij), ndërsa Gjoni përshkruhet me KOHËN AORISTE (i shfaqur në kohë) dhe atë TË KRYER (një ngjarje historike me rezultate që zgjasin) (shih v. 6). Jezusi ka ekzistuar gjithmonë.

1:7 “që të gjithë të besojnë përmes tij” Kjo është një fjali qëllimore. Ungjilli i Gjonit, ashtu si gjithë ungjijtë (një gjini letrare që është në mënyrë unike e krishterë), është një trakt ungjillëzues. Kjo është oferta e mrekullueshme e shpëtimit për gjithë ata që ushtrojnë besim në Krishtin, i cili është drita e botës (shih v. 12; Gjoni 3:16; 4:42; 20:31; 1 Tim. 2:4; Titi 2:11; 2 Pjet. 3:9; 1 Gjonit 2:1; 4:14).

1:7, 12 “besojnë” Kjo FOLJE është përdorur 78 herë në ungjillin e Gjonit, 24 herë në letrat e Gjonit. Është interesante se ungjilli i Gjonit nuk përdor kurrë formën EMËRORE, por vetëm FOLJEN. Besimi nuk është pikësëpari një përgjigje mendore apo emocionale, por, në thelb, një përgjigje vullneti. Ky term greqisht përkthehet me tre fjalë: besoj, kam besim, dhe besim. Është paralele me termin “mirëprite atë” (shih v. 11), dhe “pranoje atë” (shih v. 12). Shpëtimi është falas nga hiri i Perëndisë dhe nga vepra e përfunduar e Krishtit, por duhet pranuar. Shpëtimi është një marrëdhënie besëlidhjeje me privilegje dhe përgjegjësi.

TEMË E VEÇANTË: BESIM, BESOJ, OSE KAM BESIM (*Pistis* [EMËR], *Pisteuo* [FOLJE], *Pistos* [MBIEMËR])

- A. Ky është një term shumë i rëndësishëm në Bibël (shih Heb. 11:1, 6). Është tema e predikimit të hershëm të Jezusit (shih Marku 1:15). Ekzistojnë të paktën dy kërkesa për besëlidhjen e re: pendimi dhe besimi (Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21).
- B. Etimologjia e tij
1. Termi “besim” në DhV donte të thoshte besnikëri ose besueshmëri dhe ishte përshkrim i natyrës së Perëndisë, jo sonës
 2. Vinte nga një term hebraisht (*emun, emunah*), që donte të thoshte “të jesh i sigurt, ose i qëndrueshëm”. Besimi shpëtues është pranim mendor (grup të vërtetash), jetesë morale (stil jetese) dhe, pikë së pari, një përkushtim në marrëdhënie (mirëseardhja e një personi) dhe i vullnetshëm (një vendim) ndaj atij personi.
- C. Përdorimi i saj në DhV
- Duhet theksuar se besimi i Abrahamit nuk ishte në një Mesi të ardhshëm, por në premtimin e Perëndisë se do të kishte një fëmijë dhe pasardhës (shih Zanafilla 12:2; 15:2-5; 17:4-8; 18:14). Abrahami iu përgjigj këtij premtimi duke besuar në Perëndinë. Ai ende kishte dyshime dhe probleme për këtë premtim, për të cilin u deshën trembëdhjetë vjet për t’u përmbushur. Megjithatë, Perëndia ia pranoi besimin e tij të papërsosur. Perëndia është i gatshëm të punojë me qenie njerëzore me të meta, të cilët i përgjigjen atij dhe premtimeve të tij me besim, edhe nëse ky besim ka madhësinë e një fare sinapi (shih Mat. 17:20).
- D. Përdorimi i saj në DhR
- Termi “besoi” vjen nga fjala greke (*pisteuō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “siguri në diçka”. Për shembull, ky EMËR nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në Gjoni 2:23-25 ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termit “besoj” gjenden në Gjoni 8:31-59 dhe Veprat 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa reagim fillestar. Ai duhet pasuar nga procesi i dishepullizimit (shih Mat. 13:20-22, 31-32).
- E. Përdorimi i saj me PARAFJALË
1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vënë besimin në Jezusin
 - a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjoni 5:13)
 - b. në të (Gjoni 2:11; 3:15,18; 4:39; 6:40; 7:5,31,39,48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45,48; 12:37,42; Mat. 18:6; Veprat 10:43; Fil. 1:29; 1 Pje. 1:8)
 - c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25,26; 12:44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20)
 - d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjoni 5:10)
 - e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat 19:4; Gal. 2:16)
 - f. në Dritën (Gjoni 12:36)
 - g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)
 2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat 5:14
 3. *epi* do të thotë “në” ose mbi, si te Mat. 27:42; Veprat 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5,24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pjet. 2:6
 4. RASA DHANORE pa asnjë PARAFJALË, si te Gal. 3:6; Veprat 18:8; 27:25; 1 Gjoni 3:23; 5:10
 5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, jep përmbajtjen e asaj që duhet besuar
 - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)
 - b. Jezusi është Unë Jami (Gjoni 8:24)
 - c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në të (Gjoni 10:38)
 - d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)
 - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)
 - f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
 - g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
 - h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)
 - i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
 - j. Ne do të jetojmë me të (Rom. 6:8)
 - k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)

1:8 Ka mundësi që Gjon Apostulli, i cili shkroi shumë më vonë se shkruesit e tjetër të ungjillit, të ketë kuptuar problemin që u zhvillua ndër ndjekësit e Gjon Pagëzorët, të cilët nuk kishin dëgjuar dhe besuar Jezusin (shih Veprat 18:25-19;7).

TEMË E VEÇANTË: ENGJËLLI I ZOTIT

EMRI (*marturia*) dhe FOLJA e saj (*martureō*) “dëshmoj” janë fjalë kyçe të Gjoni. Ka shumë dëshmitarë për Jezusin.

1. Gjon Pagëzori (shih Gjoni 1:7, 8, 15; 3:26, 28; 5:33)
2. Vetë Jezusi (shih Gjoni 3:11; 5:31; 8:13-14)
3. Gruaja samaritane (shih Gjoni 4:39)
4. Perëndia Atë (shih Gjoni 5:32, 34, 37; 8:18; 1 Gjonit 5:9)
5. Shkrimi (shih Gjoni 5:39)
6. Turma në ringjalljen e Lazarit (shih Gjoni 12:17)
7. Fryma (shih Gjoni 15:26-27; 1 Gjonit 5:10, 11)
8. Dishepujt (shih Gjoni 15:27; 19:35; 1 Gjonit 1:2; 4:14)
9. Vetë autori (shih Gjoni 21:24)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:9-13

⁹Ishte Drita e vërtetë që, duke ardhur në botë, ndriçon çdo njeri. ¹⁰Ai ishte në botë, dhe botë u bë me anë të tij, por bota nuk e njohu. ¹¹Ai erdhi të të vetët, por të vetët nuk e pranuan. ¹²Por të gjithëve atyre që e pranuan, ai u dha të drejtën të bëhen fëmijë të Perëndisë, *pikërisht* atyre që besojnë në emrin e tij, ¹³të cilët janë lindur, jo nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i njeriut, por nga Perëndia.

1:9 “drita e vërtetë” Kjo është “e vërtetë” në kuptimin e diçkaje origjinale ose reale, jo thjesht si e kundërta e së rremes. Kjo mund të ketë lidhje me të gjitha kristologjitë e rreme të shekullit të parë. Ky është një MBIEMËR i zakonshëm në shkrimet e Gjoni (shih 4:23, 37; 6:32; 7:28; 15:1; 17:3; 19:35 dhe 1 Gjonit 2:8; 5:20 dhe dhjetë herë të Zbulesa). Shih Temat e Veçanta: e Vërteta të 6:55 dhe Bota të 14:17. Jezusi është drita e botës (shih 3:19; 8:12; 9:5; 12:46; 1 Gjonit 1:5, 7; 2:8, 9, 10). Besimtarët duhet të pasqyrojnë dritën e tij (shih Fil. 2:15). Kjo është në kontrast të fortë me errësirën e vërtetë që ekziston në rendin e krijuar për shkak të rebelimit të

1. njerëzve
2. engjëjve

■ **“duke ardhur në botë”** Gjoni e përdor shpesh këtë frazë për t’i referuar lënies së qiellit, sferës shpirtërore, nga ana e Jezusit dhe hyrjes së tij në sferën fizike të kohës dhe hapësirë (shih 6:14; 9:39; 11:27; 12:46; 16:28). Në këtë varg, duket se i referohet mishërimit të Jezusit. Kjo është një nga dualizmat e zakonshëm të literaturës johanine (d.m.th., lart / poshtë).



NASB “ndriçon çdo njeri”

NKJV “i jep dritë çdo njeriu”

NRSV “ndriçon gjithkënd”

TEV “ndriçon mbi gjithë njerëzit”

NJB “që i jep dritë çdokujt”

Kjo frazë mund të kuptohet në dy mënyra. Së pari, duke supozuar një sfond kulturor grek, ajo i referohet dritës së brendshme të zbulesës në çdo njeri, shkëndijës hyjnore. Kjo është mënyra si e interpretojnë këtë varg kuejkërsat. Megjithatë, ky lloj koncepti nuk shfaqet kurrë të Gjoni. Sipas Gjoni, “drita” zbulon ligësinë e njerëzimit (shih 3:19-21).

Së dyti, ajo mund t’i referohet, jo zbulesës së natyrshme (pra, Perëndisë së njohur përmes natyrës [shih Psa. 19:1-5; Rom. 1:19-20], apo një ndjesie të brendshme morale [shih Rom. 2:14-15]), por, përkundrazi, ofertës së Perëndisë për përndritje dhe shpëtim përmes Jezusit, të vetmes dritë të vërtetë.

1:10 “bota” Gjoni e përdor termin *kosmos* në tre mënyra të veçanta.

1. universi fizik (1:10, 11; 11:9; 16:21; 17:5, 24; 21:25)
2. gjithë njerëzimi (1:10, 29; 3:16, 17; 4:42; 6:33; 12:19, 46-47; 18:20)

3. shoqëria e rënë njerëzore, e organizuar dhe duke funksionuar veçmas Perëndisë (7:7; 15:18-19; 1 Gjonit 2:15; 3:1, 13)

Në këtë kontekst, bëhet fjalë për alternativën nr. 2. Shih Temën e Veçantë te 14:17.

■ **“bota nuk e njohu”** As kombet e rëna të johebrenjve dhe as kombi i zgjedhur jude nuk e njohu Jezusin si Mesinë e premtuar. Termi “njoh” pasqyron një idiomë hebraike për marrëdhënien e ngushtë, më tepër sesa një pranim mendor të fakteve (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5).

TEMË E VEÇANTË: NJOH (duke përdorur si paradigmë kryesisht Ligjin e Përtërirë)

Fjala hebraisht “njoh” (BDB 393) ka një sërë kuptimesh (fushash semantike) në formën *Kal*.

1. kuptoj të mirën dhe të keqen – Zan. 3:22; LiP. 1:39; Isa. 7:14-15; Jona 4:11
2. njoh duke kuptuar – LiP. 9:2, 3, 6; 18:21
3. njoh përmes përvojës – LiP. 3:19; 4:35; 8:2, 3, 5; 11:2; 20:20; 31:13; Joz. 23:14
4. shqyrtoj – LiP. 4:39; 11:2; 29:16
5. njoh personalisht
 - a. një person – Zan. 29:5; Eks. 1:8; LiP. 22:2; 33:9
 - b. një perëndi – LiP. 11:28; 13:2, 6, 13; 28:64; 29:26; 32:17
 - c. JHVH – LiP. 4:35, 39; 7:9; 29:6; Isa. 1:3; 56:10-11
 - d. Seksualisht – Zan. 4:1, 17, 25; 24:16; 38:26
6. një aftësi ose njohuri e mësuar – Isa. 29:11, 12; Amosi 5:16
7. të jesh i mençur – LiP. 29:4; Fja. 1:2; 4:1; Isa. 29:24
8. njohuria e Perëndisë
 - a. për Moisiun – LiP. 34:10
 - b. për Izraelin – LiP. 31:21, 27, 29

1:11 “Ai erdhi te të vetët, por të vetët nuk e pranuan” “Të vetët” përdoret dy herë në v. 11. Forma e parë gramatikore është në SHUMËSIN ASNJANËS dhe i referohet (1) gjithë krijimit ose (2) gjeografikisht, Judesë ose Jerusalemit. E dyta është në SHUMËSIN MASHKULLOR dhe i referohet popullit jude.

1:12 “Por të gjithëve atyre që e pranuan” Kjo tregon pjesën e njerëzimit në shpëtim (shih v. 16). Njerëzit duhet t’i përgjigjen ofertës së hirit të Perëndisë në Krishtin (shih 3:16; Rom. 3:24; 4:4-5; 6:23; 10:9-13; Efe. 2:8-9). Patjetër që Perëndia është sovran, por, në sovranitetin e vet, ai ka nisur një marrëdhënie besëlidhjeje të kushtëzuar me njerëzimin e rënë. Njerëzimi i rënë duhet të pendohet, të besojë, të bindet dhe të këmbëngulë në besim.

Ky koncept i “pranimit” është paralel nga ana teologjike me “rrefimin”, i cili nënkuptonte një rrefim publik besimi në Jezusin si Krishti (shih Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; 1 Tim. 6:12; 1 Gjonit 2:23; 4:15). Shpëtimi është një dhuratë që duhet pranuar dhe njohur.

Ata që “pranojnë” Jezusin (1:12), pranojnë dhe Atin që e dërgoi (shih 13:20; Mat. 10:40). Shpëtimi është një marrëdhënie personale me Perëndinë Triun!

■ **“Ai u dha të drejtën”** Ky term greqisht (pra, *eksousia*) mund të ketë kuptimin (1) autoritet ligjor, ose (2) e drejtë a privilegj (shih 5:27; 17:2; 19:10, 11). Përmes birërisë dhe misionit hyjnor të Jezusit, njerëzimi i rënë tani mund të njohë Perëndinë dhe ta pranojë si Perëndi dhe Atë.

■ **“të bëhen fëmijë të Perëndisë”** Shkruesit e DhR përdorin vazhdimisht metafora familjare për të përshkruar krishterimin: (1) Atë; (2) Bir; (3) fëmijë; (4) i lindur sërish; dhe (5) birësim. Krishterimi është i ngjashëm me një familje, jo një produkt (biletë për në qiell, politikë për sigurimin kundër zjarrit). Besimtarët në Krishtin janë bërë populli i ri eskatologjik i Perëndisë. Si fëmijë, ne duhet të pasqyrojmë karakterin e Atit, njësoj siç bëri dhe Biri (shih Efe. 5:1; 1 Gjonit 2:29; 3:3) “unik” (shih v. 14; 3:16). Ç’titull tronditës për mëkatarët (shih 1:52; Rom. 8:14, 16, 21; 9:8; Fil. 2:15; 1 Gjonit 3:1, 2, 10; 5:2; Os. 1:10, cituar në Rom. 9:26; dhe 2 Kor. 6:18).

Po kështu, është interesante se, nga dy termat grekë për fëmijët, njëri përdoret gjithmonë për Jezusin (*huios*), ndërsa tjetri (*teknon, tekna*) përdoret për besimtarët. Të krishterët janë fëmijë të Perëndisë, por nuk janë në të njëjtën kategori si Biri i Perëndisë, Jezusi. Marrëdhënia e tij është unike, por e ngjashme me ta.

Fjala “kishë” (*ekklësia*) nuk shfaqet te Marku, Luka, ose Gjoni. Ata përdorin metafora familjare për bashkësinë e re dinamike, individuale dhe kolektive, të Frymës.

■ **“atyre që besojnë”** Kjo është një PJESORE VEPRORË NË TË TASHMEN, që do të thotë “ata që vazhdojnë të besojnë”. Sfondi etimologjik i këtij termi ndihmon në përcaktimin e kuptimit të tij në atë kohë. Në hebraisht, në fillim, ai nënkuptonte një person me qëndrim të palëkundur. Më vonë, u përdor në mënyrë metaforike për njeriun që ishte i besueshëm, besnik, ose i besueshëm. Ekuivalenti greqisht përkthehet në gjuhët e tjera me termat “besim”, “besoj” dhe “kam besim te”. Besimi biblik nuk është pikësepari diçka që bëjmë, por dikush ne të cilin vendosim besimin. Fokusi këtu është besnikëria e Perëndisë, jo e jona. Njerëzimi i rënë beson në besnikërinë e Perëndisë, ka bindje në besnikërinë e tij, beson në të Dashurin. Fokusi nuk është te bollëku ose intensiteti i besimit njerëzor, por te objekti i atij besimi. Shih Temat e Veçanta në 1:7 dhe 2:23.

■ **“në emrin e tij”** Në DhV, emri i njeriut ishte shumë i rëndësishëm. Ishte një profeci me shpresë/e mundshme për karakterin e atij personi, ose përshkrim i karakterit të tij. Të besosh në emrin e një personi do të thotë të besosh dhe të pranosh atë person (shih 2:23; 3:18; 20:31; 1 Gjonit 5:13). Shih Tema e Veçantë: Emri i Zotit në 14:13-14.

1:13

NASB, NKJV, NRSV “të cilët janë lindur, jo nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i njeriut”
TEV “ata nuk u bënë fëmijë të Perëndisë me anë të lindjes, pra, duke u lindur si fëmijë të një ati njerëzor”
NJB “i cili u lind, jo nga raca njerëzore, as nga nxitja e mishit, apo vullneti i njeriut”

Disa etër të kishës së hershme (pra, Ireneu, Origeni, Tertuliani, Ambrozi, Jeronimi, Augustini) mendojnë se kjo frazë i referohet Jezusit (pra, në NJËJËS), por të dhënat dërrmuese tekstuale në greqisht shfaqin numrin SHUMËS (SHUMËSI i kësaj fjale gjendet vetëm këtu në DhR; UBS⁴ e klasifikon si “A”), që do të thotë se ky varg u referohet besimtarëve në Jezusin (shih 3:5; 1 Pjet. 1:3, 23), pra, jo privilegjit racor, as prejardhjes seksuale njerëzore (fjalë për fjalë “gjakrave”), por zgjedhjes nga ana e Perëndisë dhe tërheqjes së atyre që besojnë në Birin e tij (shih 6:44, 65). Vargjet 12 dhe 12 shfaqin drejtpeshimin e besëlidhjes midis sovranitetit të Perëndisë dhe nevojës për reagimin njerëzor.

FOLJA në greqisht (në DËFTOREN AORISTE PËSORE) është vendosur në fund të fjalisë në greqisht për theksim. Kjo thekson rolin iniciues dhe sovran të Perëndisë në lindjen e dytë (pra, “por nga Perëndia”, që është pjesë e frazës së fundit, shih 6:44, 65).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:14-18

¹⁴Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne, dhe ne pamë lavdinë e tij, lavdi si ajo e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir dhe të vërtetë. ¹⁵Gjoni dëshmoi për të dhe bërtiti duke thënë: “Ky është ai për të cilin ju thashë, „Ai që vjen pas meje është i një rangu më të lartë se unë, sepse ai ekzistonte përpara meje””. ¹⁶Sepse nga plotësia e tij morëm të gjithë ne, dhe hir mbi hir. ¹⁷Sepse ligji u dha përmes Moisiut; hiri dhe e vërteta u përmbushën përmes Jezu Krishtit. ¹⁸Asnjë nuk e ka parë ndonjëherë Perëndinë; i vetëmlinduri Perëndi, i cili është në gjirin e Atit, ai e ka shpjeguar.

1:14 **“Fjala u bë mish”** Gjoni po sulmon doktrinën e rreme të gnostikëve, të cilët po përpiqeshin ta shkrinin krishterimin me mendimin pagan grek. Jezusi ishte vërtet njeri dhe vërtet Perëndi (shih 1 Gjonit 4:1-3) në përmbushje të premtimit të Emanuelit (shih Isa. 7:14). Perëndia banoi si njeri mes njerëzimit të rënë (fjalë për fjalë, “vendosi tendën”). Termi “mish” te Gjoni nuk i referohet kurrë natyrës mëkatore si në shkrimet e Palit.

TEMË E VEÇANTË: MISH (*sarks*)

Kjo i referohet urtësisë njerëzore, ose standardeve të botës (shih 1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:180. Pali e përdor termin “mish” (pra, *sarks*) në disa mënyra në shkrimet e veta.

1. trupi njerëzor (shih Rom. 2:28; 1 Kor. 5:5; 7:28)
2. prejardhja njerëzore (pra, atë-bir, shih Rom. 1:3; 4:1; 1 Kor. 10:18)
3. njerëzimi në tërësi (shih 1 Kor. 1:26, 29)
4. dobësia njerëzore për shkak të rënies së njerëzimit në Zanafilla 3 (shih Rom. 6:19; 7:18)

■ **“banoi ndër ne”** Fjalë për fjalë, përkthehet “vendosi banesën”. Vinte nga sfondi judaik i periudhës së endjes në shkretëtirë dhe Tabernakullit (shih Zbu. 7:15; 21:3). Më vonë, këtë përvojë në shkretëtirë judenjtë e quajtën

“periudhë të muajit të mjaltit” midis JHVH dhe Izraelit. Perëndia nuk ishte kurrë më pranë Izraelit sesa gjatë asaj periudhe. Termi judaik për renë e veçantë hyjnore që i priu Izraelit gjatë kësaj periudhe ishte “*Shekina*”, termi hebraik që përkthehet “banoj me”.

■ **“ne pamë lavdinë e tij”** Fjala *kabod* (lavdi) e DhV tani është personifikuar, mishëruar. Kjo i referohet (1) diçkaje në jetën e Jezusit, si shndërrimit në mal ose ngjitjes në qiell (pra, dëshmia apostolike, shih 2 Pjet. 1:16-17), ose (2) konceptit se JHVH i padukshëm tani është i dukshëm dhe plotësisht i njohur. Ky është i njëjti theks si dhe te 1 Gjonit 1:1-4, i cili thekson edhe natyrën njerëzore të Jezusit në kundërshtim me theksin e rremë gnostik për marrëdhënien antagonistike midis shpirtit dhe materies.

Në DhV, fjala më e zakonshme hebraisht për termin “lavdi” (*kabod*, BDB 458) në fillim ishte term tregtar (që i referohej peshores), fjalë për fjalë, “rëndoj”. Ajo që rëndonte ishte e vlefshme, ose kishte vlerë të qenësishme. Shpesh, koncepti i shkëlqimit i shtohet kësaj fjale për të shprehur madhështinë e Perëndisë (pra, në fillim në malin Sinai, reja e lavdisë *Shekina*, drita eskatologjike, shih Eks. 13:21-22; 24:17; Isa. 4:5; 60:1-2). Vetëm ai është i denjë dhe i nderuar. Ai është tepër i shkëlqyer që ta kundërojë njerëzimi i rënë (shih Eks. 33:17-23; Isa. 6:5). Perëndia mund të njihet vërtet vetëm nëpërmjet Krishtit (shih Gjoni 1:14, 18; Kol. 1:15; Heb. 1:3).

TEMË E VEÇANTË: LAVDI (*Doksa*)

Koncepti biblik i “lavdisë” është i vështirë për t’u shpjeguar. Lavdia e besimtarëve është se kuptojnë ungjillin dhe lavdinë e Perëndisë; ajo nuk qëndron në veten e tyre (shih 1:29-31; Jer. 9:23-24).

Në DhV, fjala më e zakonshme hebraisht për termin “lavdi” (*kabod*, BDB 458) në fillim ishte term tregtar (që i referohej peshores), fjalë për fjalë, “rëndoj”. Ajo që rëndonte ishte e vlefshme, ose kishte vlerë të qenësishme. Shpesh, koncepti i shkëlqimit i shtohet kësaj fjale për të shprehur madhështinë e Perëndisë (pra, në fillim në malin Sinai, reja e lavdisë *Shekina*, drita eskatologjike, shih Eks. 13:21-22; 24:17; Isa. 4:5; 60:1-2). Vetëm ai është i denjë dhe i nderuar. Ai është tepër i shkëlqyer që ta kundërojë njerëzimi i rënë (shih Eks. 33:17-23; Isa. 6:5). Perëndia mund të njihet vërtet vetëm nëpërmjet Krishtit (shih Gjoni 1:14, 18; Kol. 1:15; Heb. 1:3; Jakobi 2:1).

Termi “lavdi” është disi i paqartë.

1. mund të jetë paralel me “drejtësinë e Perëndisë”
2. mund t’i referohet “shenjtërisë” ose “përsosmërisë” së Perëndisë
3. mund t’i referohet shëmbëlltyrës së Perëndisë në të cilën u krijua njerëzimi (shih Zan. 1:26-27; 5:1; 9:6), por që më vonë u njollos për shkak të rebelimit (shih Zan. 3:1-22). Në fillim u përdor për praninë e JHVH-së me popullin e tij gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë, te Eksodi 16:7, 10; Levitiku 9:23; dhe Numrat 14:10

■ **NASB, NKJV “lavdi si ajo e të vetëmlindurit prej Atit”**

NRSV “lavdi si ajo e birit të vetëm të një ati”

TEV “Lavdia që ai mori si Biri i vetëm i Atit”

NJB “lavdia që është e tij si Biri i vetëm i Atit”

Ky term, “i vetëm” (*monogenēs*), do të thotë “i pashoq”, “unik për nga lloji” (shih 3:16, 18; 1 Gjonit 4:9; shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 24-25). Vulgata e përktheu “i vetëmlinduri” dhe, mjerisht, përkthimet më të vjetra anglisht e pasuan (shih Luka 7:12; 8:42; 9:38; Heb. 11:17). Fokusi është tek e pashoqja dhe unikja, jo te lindja seksuale.

■ **“Ati”** DhV prezanton metaforën e ngushtë familjare të Perëndisë si Atë.

1. kombi i Izraelit përshkruhet shpesh si “biri” i JHVH-së (shih Os. 11:1; Mal. 3:17)
2. edhe më herët, te Ligji i Përtërirë, përdoret analogjia e Perëndisë si Atë (1:31)
3. te Ligji i Përtërirë 32, Izraeli quhet “fëmijët e tij”, ndërsa Perëndia quhet “Ati juaj”
4. kjo analogji përdoret në Psa. 103:13 dhe zhvillohet në Psa. 68:5 (ati i jetimëve)
5. ishte i zakonshëm në profetët (shih Isa. 1:2; 63:8; Izraeli si bir, Perëndia si Atë, 63:16; 64:8; Jer. 3:4, 19; 31:9).

Jezusi e merr këtë analogji dhe e thëllon në një bashkësi të plotë familjare, sidomos në Gjoni 1:14, 18; 2:16; 3:35; 4:21, 23; 5:17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 26, 36, 37, 43, 45; 6:27, 32, 37, 44, 45, 46, 57; 8:16, 19, 27, 28,

38, 42, 49, 54; 10:15, 17, 18, 25, 29, 30, 32, 36, 37, 38; 11:41; 12:26, 27, 28, 49, 50; 13:1; 14:2, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 16, 20, 21, 23, 24, 26, 28, 31; 15:1, 8, 9, 10, 15, 16, 23, 24, 26; 16:3, 10, 15, 17, 23, 25, 26, 27, 28, 32; 17:1, 5, 11, 21, 24, 25; 18:11; 20:17, 21!

■ **“plot hir dhe të vërtetë”** Ky çiftëzim ndjek termat e DhV *hesed* (dashuria dhe besnikëria e besëlidhjes) dhe *emet* (besueshmëri), të cilat përdoren dhe shtjellohen në Eks. 34:6; Neh. 9:17; Psa. 103:8; të dyja fjalët shfaqen së bashku në Fja. 16:6. Kjo përshkruan karakterin e Jezusit (shih v. 17) me terma të besëlidhjes së DhV. Shih Temën e Veçantë “E vërteta” në 6:55 dhe 17:3.

TEMË E VEÇANTË: DASHAMIRËSI (*Hesed*)

Ky term ka një fushë të gjerë semantike. BDB e karakterizon në këtë mënyrë (338-339).

- A. I përdorur në lidhje me qeniet njerëzore
 1. mirësi ndaj njerëzve të tjerë (shih 1 Sam. 20:14; 2 Kro. 24:22)
 2. mirësi ndaj të varfërve dhe nevojtarëve (p.sh., Mikea 6:8)
 3. mirëdashje (shih Jer. 2:2; Os. 6:4)
 4. dukje (shih Isa. 40:6)
- B. I përdorur në lidhje me Perëndinë
 1. dashuri dhe besnikëri besëlidhjeje
 - a. “në shpengim nga armiqtë dhe vështirësitë” (p.sh., Jer. 31:3; Esdra 7:28; 9:9)
 - b. “në ruajtjen e jetës nga vdekja” (p.sh., Jobi 10:12; Psa. 86:13)
 - c. “në ringjalljen e jetës shpirtërore” (p.sh., Psa. 119:41, 76, 88, 124, 149, 150)
 - d. “në shpengimin nga mëkati” (shih Psa. 25:7; 51:1)
 - e. “në zbatimin e besëlidhjeve” (p.sh., 2 Kro. 6:14; Neh. 1:5; 9:32)
 2. përshkruan një cilësi hyjnore (p.sh., Eks. 34:6; Mikea 7:20)
 3. mirësia e Perëndisë
 - a. “e pasur” (p.sh., Neh. 9:17; Psa. 103:8)
 - b. “e madhe në shtrirje” (p.sh., Eks. 20:6; LiP. 5:10; 7:9)
 - c. “e përjetshme” (p.sh., 1 Kro. 16:34, 41; 2 Kro. 5:13; 7:3, 6; 20:21; Esdra 3:11)
 4. vepra dashamirësie (p.sh., 2 Kro. 6:42; Psa. 89:2; Isa. 55:3; 63:7; Vaj. 3:22)

TEMË E VEÇANTË: BESOJ, KAM BESIM, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHIATËN E VJETËR (יָמַס)

I. Shënim hyrës

Duhet pohuar se përdorimi i këtij koncepti teologjik, kaq jetik për DhR, nuk është përcaktuar dhe aq qartë në DhV. Pa dyshim që ekziston aty, por demonstron në pasazhe dhe persona kyç e të përzgjedhur.

DhV shkrin

1. individin me komunitetin
2. takimin personal dhe bindjen e besëlidhjes

Besimi është edhe takim personal, edhe stil i përditshëm jetese! Është më e lehtë ta përshkruash në një person, sesa në formë leksikore (pra, me studime fjale). Ky aspekt personal ilustron më së miri në

1. Abrahamin dhe farën e tij
2. Davidin dhe Izraelin

Këta burra u takuan/u poqën me Perëndinë dhe jeta e tyre ndryshoi një herë e përgjithmonë (jo jetë të përsosura, por besim i vazhdueshëm). Sprovimi zbuloi dobësitë dhe pikat e forta të takimit të besimit të tyre me Perëndinë, por marrëdhënia e ngushtë dhe plot besim vazhdoi gjatë gjithë kohës! Ajo u provua dhe u përpunua, por vazhdoi të dëshmohej në përkushtimin dhe stilin e tyre të jetesës.

II. Rrënja kryesore që përdoret

A. יָמַס (BDB 52)

1. FOLJA

- a. Rrënja *Kal* – mbështes, ushqej (p.sh., 2 Mbret. 10:1, 5; Ester 2:7, përdorimi joteologjik)
- b. Rrënja *Nifal* – bëj të sigurt ose të patundur, themeloj, pohoj, jam besnik ose i besueshëm

- (1) për njerëzit, Isa. 8:2; 53:1; Jer. 40:14
 - (2) për gjërat, Isa. 22:23
 - (3) për Perëndinë, LiP. 7:9; Isa. 49:7; Jer. 42:5
- c. Rrënja *Hifil* – qëndroj i patundur, besoj, kam besim
- (1) Abrahami besoi në Perëndinë, Zan. 15:6
 - (2) Izraelitët në Egjipt besuan, Eks. 4:31; 14:31 (mohuar në LiP. 1:32)
 - (3) Izraelitët besonin se JHVH fliste përmes Moisiut (Eks. 19:9; Ps. 106:12, 24)
 - (4) Ahazi nuk i besoi Perëndisë, Isa. 7:9
 - (5) Kushdo që beso në të, Isa. 28:16
 - (6) Besoni të vërtetat për Perëndinë Isa. 43:10-12
2. EMRI (MASHKULLOR) – besnikëri (shih LiP. 32:20; Isa. 25:1; 26:2)
 3. NDAJFOLJA – me të vërtetë, ashtu është, jam dakord, ashtu qoftë (shih LiP. 27:15-26; 1 Mbret. 1:36; 1 Kro. 16:36; Isa. 65:16; Jer. 11:5; 28:6). Ky është përdorimi liturgjik i “amen” në DhV dhe DhR.
- B. מִשְׁפָּחָא (BDB 54) EMRI FËMEROR, patundshmëri, besnikëri, e vërtetë
1. për njerëzit, Isa. 10:20; 42:3; 48:1
 2. për Perëndinë, Eks. 34:6; Psa. 117:2; Isa. 38:18-19; 61:8
 3. për të vërtetën, LiP. 32:4; 1 Mbret. 22:16; Psa. 33:4; 98:3; 100:5; 119:30; Jer. 9:5; Zak. 8:16
- C. מִשְׁפָּחָא (BDB 53), patundshmëri, qëndresë, besnikëri
1. për duart, Eks. 17:12
 2. për kohët, Isa. 33:6
 3. për njerëzit, Jer. 5:3; 7:28; 9:2
 4. për Perëndinë, Psa. 40:11; 88:11; 89:1, 2, 5, 8; 119:138
- III. Përdorimi i këtij koncepti të DhV nga Pali
- A. Pali e bazon kuptimin e tij të ri të JHVH-së dhe DhV në takimin e vet personal me Jezusin në rrugën për në Damask (shih Veprat 9; 22; 26).
 - B. Ai gjeti mbështetje në DhV për botëkuptimin e tij të ri në dy pasazhe kyçe të DhV, të cilat përdorin rrënjën מִשְׁפָּחָא.
 1. Zan. 15:6 – takimi personal i Abrahamit, i nisur nga Perëndia (Zanafilla 12) rezultoi në një jetë bindjeje dhe besimi (Zan. 12-22). Pali aludon për këtë në Romakëve 4 dhe Galatasve 5.
 2. Isa. 28:16 – ata që besojnë në të (pra, në gurin e sprovuar të qoshes të Perëndisë, i cili është vendosur në mënyrë të patundur), kurrë
 - a. Rom. 9:33, “nuk do të turpërohen” apo “zhgënjehen”
 - b. Rom. 10:11, njësoj si më lart
 3. Hab. 2:4 – ata që njohin Perëndinë besnik do të bëjnë jetë besnike (shih Jer. 7:28). Pali e përdor këtë pasazh në Rom. 1:17 dhe Gal. 3:11 (vini re dhe Heb. 10:38).
- IV. Përdorimi i këtij koncepti të DhV nga Pjetri
- A. Pjetri kombinon
 1. Isa. 8:14 – 1 Pjet. 2:8 (guri i pengesës)
 2. Isa. 28:16 – 1 Pjet. 2:6 (guri i qoshes)
 3. Psa. 118:22 – 1 Pjet. 2:7 (guri i refuzuar)
 - B. Ai i kthehet gjuhës unike që përshkruan Izraelin, “racë e zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë, popull për zotërimin e Perëndisë” nga
 1. LiP. 10:15; Isa. 43:21
 2. Isa. 61:6; 66:21
 3. Eks. 19:6; LiP. 7:6
 dhe tani e përdor për besimin e kishës në Krishtin
- V. Përdorimi i këtij koncepti nga Gjoni
- A. Përdorimi në DhR

Termi “besoi” vjen nga termi greqisht (*pisteuō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “bindje”. Për shembull, EMRI nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në Gjoni 2:23-25, ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termit “besoj” gjenden në Gjoni 8:31-59 dhe Veprat 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa një reagim fillestar. Ai duhet vijuar nga një proces dishepullizimi (shih Mat. 13:20-22, 31-32).

B. Përdorimi i tij me PARAFJALË

1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vendosin besimin në Jezusin
 - a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjonit 5:13)
 - b. në të (Gjoni 2:11; 3:15, 18; 4:39; 6:40; 7:5, 31, 39, 48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45, 48; 12:37, 42; Mat. 18:6; Veprat 10:43; Fil. 1:29; 1 Pje. 1:8)
 - c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25-26; 12:44, 46; 14:1, 12; 16:9; 17:20)
 - d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjonit 5:10)
 - e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat 19:4; Gal. 2:16)
 - f. në Dritën (Gjoni 12:36)
 - g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)
2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat 5:14
3. *epi* do të thotë “në” ose “mbi”, si te Mat. 27:42; Veprat 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5, 24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pje. 2:6
4. RASA DHANORE pa PARAFJALË, si te Gal. 3:6; Veprat 18:8; 27:25; 1 Gjonit 3:23; 5:10
5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, i jep përmbajtje asaj që besohet
 - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)
 - b. Jezusi është Unë Jam-i (Gjoni 8:24)
 - c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në të (Gjoni 10:38)
 - d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)
 - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)
 - f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
 - g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
 - h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)
 - i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
 - j. Ne do të jetojmë me të (Rom. 6:8)
 - k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)

VI. Përmbyllje

Besimi biblik është reagimi njerëzor ndaj një fjale/premtimi Hyjnor. Perëndia është gjithmonë nismëtari (p.sh., Gjoni 6:44-45), por pjesë e këtij komunikimi hyjnor është nevoja që njerëzit t’i përgjigjen.

A. besimi

B. bindja ndaj besëlidhjes

Besimi biblik është

1. marrëdhënie personale (besimi fillestar)
2. pohim i së vërtetës biblike (besim në zbulesën e Perëndisë)
3. reagim i duhur dhe plot bindje ndaj tij (besimi i përditshëm)

Besimi biblik nuk është biletë për në qiell, apo policë sigurimi. Ai është marrëdhënie personale.

Ky është synimi i krijimit dhe bërjes së njerëzve në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë me Perëndinë (shih Zan. 1:26-27). Çështja qëndron te “ngushtësia e marrëdhënies”. Perëndia dëshiron bashkësi, jo një qëndrim të caktuar teologjik! Por bashkësia me Perëndinë e shenjtë kërkon që fëmijët e tij të shfaqin karakteristikat e “familjes” (pra, shenjtërinë, shih Lev. 19:2; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:15-16). Rënia (Zanafilla 3) na preku aftësinë për t’u përgjigjur në mënyrën e duhur. Si rrjedhojë, Perëndia veproi në emrin tonë (shih Ezek. 36:27-38), duke na dhënë një “zemër të re” dhe një “frymë të re”, që na mundëson, përmes besimit dhe pendimit, që të kemi bashkësi me të dhe t’i bindemi!

Të tria këto janë kyçe. Të tria duhen ruajtur. Synimi është të njohim Perëndinë (si në kuptimin hebraisht, ashtu dhe atë greqisht) dhe të reflektojmë karakterin e tij në jetë. Synimi i besimit nuk është qielli një ditë, por ngjashmëria me Krishtin përditë!

Besnikëria njerëzore është rezultati (DhR), jo baza (DhV), për një marrëdhënie me Perëndinë: besimi i njeriut në besnikërinë e tij; besimi i njeriut në besueshmërinë e tij. Thelbi i pikëpamjes së DhR për shpëtimin është se njerëzit duhet t’i përgjigjen fillimisht dhe vazhdimisht hirit dhe mëshirës së Perëndisë, të demonstruar në Krishtin. Ai ka dashur, ai ka dërguar, ai ka siguruar; ne duhet t’i përgjigjemi me besim dhe besnikëri (shih Efe. 2:8-9 dhe 10)!

Perëndia besnik do njerëz besnikë për t’u zbuluar kësaj bote pa besim dhe për t’i sjellë ata në një besim personal në të.

1:15 “sepse ai ekzistonte përpara meje” Kjo është doktrina e Gjon Pagëzorit, ku ai pohon fuqishëm paraekzistencën e Jezusit (shih 1:1; 8:56-59; 16:28; 17:5; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3; 10:5-8). Doktrinat e paraekzistencës dhe profecisë parathënëse pohojnë se ekziston një Perëndi mbi historinë dhe përtej saj, por i cili punon brenda historisë. Kjo është pjesë e pandashme e botëkuptimit të krishterë/biblik.

▣ Ky varg është i sikletshëm dhe iu bënë shumë ndryshime kopjuesish në përpjekjen për të qartësuar dhe thjeshtëzuar tekstin. Shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 197-198.

Ky është dhe një shembull i mirë se kohët e foljeve në greqisht nuk mund të standardizohen. Ky është një veprim i shkuar i regjistruar në kohën E TASHME. Shih Shtojcën Një.

1:16-18 Një nga karakteristikat e ungjillit të Gjonit është mënyra sesi autori depërton në ngjarjen historike, dialogun, apo sesionin mësimor, me komentet e veta. Shpesh, është e pamundur të bësh dallimin mes fjalëve të Jezusit, personave të tjerë, apo Gjonit. Shumica e studiuesve pohojnë se v. 16-19 janë komentet e autorit, Gjonit (shih 3:14-21).

1:16 “plotësia” Ky është termi grek *pleroma*. Mësuesit e rremë gnostikë e përdornin për të përshkruar aeon-at engjëlllore midis perëndisë së lartë dhe qenieve më të ulëta shpirtërore. Jezusi është i vetmi ndërmjetës (pra, e vetmja plotësi e vërtetë) midis Perëndisë dhe njeriut (shih Kol. 1:19; 2:9; Efe. 1:23; 4:13). Sërish, këtu, duket se apostulli Gjon po sulmon pikëpamjen e hershme gnostike për realitetin.

▣

NASB, NRSV “dhe hiri mbi hiri”

NKJV “dhe hiri për hiri”

TEV “duke në dhënë bekim pas bekimi”

NJB “një dhuratë që zëvendëson tjetrën”

Pyetja interpretuese është si të kuptojmë “hirin”. A është

1. mëshira e Perëndia në Krishtin për shpëtim
2. mëshira e Perëndisë për jetën e krishterë
3. mëshira e Perëndisë në besëlidhjen e re përmes Krishtit?

Mendimi kyç është “hiri”; hiri i Perëndisë na është dhënë në mënyrë të mahnitshme në mishërimin e Jezusit. Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për njerëzimin e rënë (shih 2 Kor. 1:20).

1:17 “Ligji” Ligji i Moisiut nuk ishte i keq, por ishte përgatitor dhe i paplotë për sa i përket sigurimit të një shpëtimi të plotë (shih 5:39-47; Gal. 3:23-29; Romakëve 4). Edhe letra e Hebrenjve ballafaqon dhe krahason veprën/zbulesat/besëlidhjet e Moisiut dhe Jezusit.

TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT

Ligji është i mirë dhe vjen nga Perëndia (shih Rom. 7:12, 16).

- A. Ai nuk është rruga për te drejtësia dhe pranimi nga Perëndia (madje, mund të jetë mallkim, shih Galatasve 3).
- B. Ai është ende vullneti i Perëndisë për besimtarët, sepse është vetëzbuluesia e Perëndia (Pali e citon shpesh DhV për të qortuar dhe/ose inkurajuar besimtarët).
- C. Besimtarët informohen nga DhV (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 10:6, 11), por nuk shpëtohen nga DhV (shih Veprat 15; Romakëve 4; Galatasve 3; Hebrenjve)
- D. Ai funksionon në besëlidhjen e re:
 - 1. për të treguar mëkatshmërinë (shih Gal. 3:15-29)
 - 2. për të udhëzuar njerëzimin e shpënguar në shoqëri
 - 3. për të informuar vendimet etike të të krishterëve

Është pikërisht ky spektër teologjik nga mallkimi dhe kalimtarja te bekimi dhe vazhdimësia që shkakton problemin për të kuptuar pikëpamjen e Palit për Ligjin e Moisiut. Në *A Man in Christ*, James Stewart tregon mendimin dhe shkrimin paradoksal të Palit:

“Normalisht, ne do të prisnim që një njeri, që i ka vënë qëllim vetes të ndërtojë një sistem mendimi dhe doktrine, do të nguliste sa më ngurtësisht të mundte kuptimet e termave që përdorte. Do të prisnim që ai të synonte saktësi në frazeologjinë e ideve të tij kryesore. Do të prisnim që një fjalë e caktuar, e përdorur një herë nga shkrimtari në një kuptim të caktuar, të kishte kurdoherë po atë kuptim. Por do të zhgënjehesh po e kërkoje këtë nga Pali. Një pjesë e mirë e frazeologjisë së tij është e rrjedhshme, jo e ngurtë... „Ligji është i shenjtë“, shkruan ai, „dhe unë gëzohem në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm“ (shih Rom. 7:12, 22), por është pa dyshim një tjetër aspekt i *nomos* që e bën Palin të thotë gjatë: „Krishti më ka shpënguar nga mallkimi i ligjit“ (shih Gal. 3:13)” (f. 26).

■ **“hiri”** Kjo i referohet dashurisë së pamerituar të Perëndisë për njerëzimin e rënë (shih Efe. 2:8). Ky term, hiri (*kharis*), kaq i rëndësishëm në shkrimet e Palit, përdoret vetëm në këtë paragraf në ungjillin e Gjonit (shih 1:14, 16, 17). Shkrimtarët e Dhiatës së Re, nën frymëzim, ishin të lirë të përdornin fjalorin, analogjitë dhe metaforat e tyre.

Jezusi bëri realitet “besëlidhjen e re” të Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38.

■ **“e vërteta”** Kjo përdoret në kuptimin e (1) besnikërisë, ose (2) të vërtetës përkundër mashtrimit (shih 1:14; 8:32; 14:6). Vini re se, si hiri, ashtu dhe e vërteta, erdhën përmes Jezusit (shih v. 140. Shih Temën e Veçantë në 17:3).

■ **“Jezusi”** Ky është përdorimi i parë i emrit njerëzor të birit të Marisë në Prolog. Biri paraekzistues tani bëhet Biri i Mishëruar!

1:18 “Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë” Disa thonë se kjo bie në kundërshtim me Eks. 33:20-23. Sidoqoftë, termi hebraisht në pasazhin e Eksodit i referohet “pashkëlqimit”, jo pamjes fizike të vetë Perëndisë. Thelbi i këtij pasazhi është se vetëm Jezusi e zbulon plotësisht Perëndinë (shih 14:8 e më tej). Asnjë njeri mëkatar nuk e ka parë Perëndinë (shih 6:46; 1 Tim. 6:16; 1 Gjonit 4:12, 20).

Ky varg thekson zbuluesin unike të Perëndisë në Jezusin e Nazaretit. Ai është zbuluesia e plotë dhe e vetme hyjnore. Të njohësh Jezusin do të thotë të njohësh Perëndinë. Jezusi është zbuluesia absolute që Ati i ka bërë vetes. Nuk mund ta kuptojmë qartë natyrën hyjnore pa të (shih Kol. 1:15-19; Heb. 1:2-3). Jezusi “sheh” Atin, ndërsa besimtarët e “shohin” Atin përmes Jezusit (jetës, fjalëve dhe veprave të tij). Ai është zbuluesia e plotë dhe e përsosur e Perëndisë së padukshëm (shih Kol. 1:15; Heb. 1:3).

■	
NASB	“Perëndia i vetëmlindur”
NKJV	“Biri i vetëmlindur”
NRSV	“Është Biri i vetëm i Perëndisë”
TEV	“Biri i vetëm”
NJB	“Biri i vetëm”

Shih shënimin për *monogenēs* në 1:14. Jezusi është plotësisht Perëndi dhe njeri. Shih shënimet e plota në 1:1.

Këtu ekziston një variant në dorëshkrimet greke. *Theos*/Perëndia gjendet në dorëshkrimet e hershme greke P⁶⁶, P⁷⁵, B dhe C, ndërsa “Perëndia” zëvendësohet me fjalën “Bir” vetëm në dorëshkrimet A dhe C³. Termi “Bir” ndoshta vjen nga kopjuesit, të cilëve u kujtohej termi “Biri i vetëmlindur” në Gjoni 3:16, 18 dhe në 1 Gjonit 4:9 (shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 198). Ky është një pohim i fuqishëm i natyrës së plotë dhe të përsosur hyjnore të Jezusit! Ka mundësi që ky varg po na jep tre tituj për Jezusin: (1) i vetëmlindur, (2) Perëndi, dhe (3) i cili është në gjë të Atit.

Në librin e Bart D. Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture (Shprishja e Shkrimit nga ortodoksët)*, f. 78-82, gjendet një diskutim interesant i mundësisë së ndryshimit të qëllimshëm të këtij vargu nga kopjuesit ortodoksë.

■ **“i cili është në gjirin e Atit”** Nga ana kuptimore, kjo është shumë e ngjashme me frazën “me Perëndinë”, në vargjet 1 dhe 2. Nënkupton një bashkësi të ngushtë. Mund të ketë parasysh (1) bashkësinë e tij paraekzistuese me Atin, ose (2) bashkësinë e tij të ripërtërirë (pra, Ngjitjen në qiell).

■

NASB “Ai e ka shpjeguar”

NKJV “Ai e ka shpallur”

NRSV, NJB “i cili e ka bërë të njohur”

TEV “ai e ka bërë të njohur”

Termin anglisht “exegesis” ([eksegezë, shtjellim], fjalë për fjalë, “nxjerr”, DËFTORE AORISTE MESORE [me kuptim aktiv]) nga fjala greke që përdoret në 1:18, e cila nënkupton një zbulues të plotë dhe të përfunduar. Një nga detyrat kryesore të Jezusit ishte të zbulonte Atin (shih Gjoni 14:7-10; Heb. 1:2-3). Kur shih dhe njeh Jezusin është si të shohësh dhe të njohësh Atin (kur duam mëkatarët, ndihmojmë të varfrit, pranojmë të përjashtuarit, ndihmojmë fëmijët dhe gratë)!

Në greqisht, kjo fjalë përdoret për ata që shpjegojnë ose interpretojnë një mesazh, ëndërr, apo dokument. Sërish, këtu, Gjoni ndoshta po përdor një fjalë që kishte kuptim specifik si për judenjtë, ashtu dhe për johebrenjtë (si *Logos* i v. 1). Gjoni po përpiqet t’u komunikojë edhe judenjve, edhe grekëve, me prologun e vet. Kjo fjalë mund të ketë kuptimin

1. dikush që shpjegon ligjin (për judenjtë)
2. dikush që shpjegon ose interpreton perënditë (për grekët).

Në Jezusin – dhe vetëm në Jezusin – mund të kuptojnë dhe shohin njerëzit plotësisht Atin!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Përcakto *logos*-in në përdorimet e tij të lashta fetare, laike dhe biblike.
2. Pse është kaq e rëndësishme doktrina e paraekzistencës së Jezusit?
3. Cili është roli i njerëzimit në shpëtim? Si mund të pranojmë Jezusin?
4. Pse ishte e nevojshme që Fjala të bëhej mish?
5. Pse është kaq e vështirë të përvijosh këtë pasazh?
6. Rendit të vërtetat e ndryshme teologjike që përdoren për të përshkruar Jezusin (janë të paktën 8).
7. Pse është kaq i rëndësishëm vargu 18?

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 19-51

- A. Ky pasazh në lidhje me Gjon Pagëzorin trajton dy keqkuptime të kishës së hershme:
 1. keqkuptimi që u zhvillua në lidhje me personin e Gjon Pagëzorit dhe që debatohet në v. 6-9, 20, 21, 25; dhe 3:22-36;

2. keqkuptimi që kishte të bënte me personin e Krishtit dhe që trajtohet në v. 32-34. Po kjo herezi e gnosticizmit sulmohet edhe te 1 Gjonit 1. 1 Gjoni mund të ketë qenë letër shpjeguese e ungjillit të Gjonit.
- B. Ungjilli i Gjonit është i heshtur për pagëzimin e Jezusit nga Gjon Pagëzori. Sakramentet e kishës, pagëzimi dhe eukaristia, spikasin për nga mungesa e tyre në rrëfimin që i bën Gjoni jetës së Krishtit. Ka të paktën dy arsye të mundshme për këtë mungesë:
1. ngritja e sakramentalizmit në kishën e hershme e shtyu Gjonin që t'ia ulte theksin këtij aspekti të krishterimit. Ungjilli i tij përqendrohet në marrëdhëniet, jo në rituale. Ai nuk diskuton apo dokumenton aspak dy sakramentet e pagëzimit dhe Darkës së Zotit. Mungesa e diçkaje kaq të pritur duhet t'ua ketë tërhequr vëmendjen lexuesve.
 2. Gjoni, i cili shkroi më vonë se shkruesit e tjerë të ungjijve, e përdori rrëfimin e vet të jetës së Krishtit për t'ua shtuar të tjerëve. Meqë të gjithë sinoptikët i përmendin këto sakramente, Gjoni jep vetëm informacione shtesë për ngjarjet rreth tyre. Një shembulli i kësaj është dialogu dhe ngjarjet që ndodhën në dhomën e sipërme (kapitujt 13-17), por jo vetëm darka.
- C. Ky rrëfim thekson dëshminë e Gjon Pagëzorit në lidhje me personin e Jezusit. Gjoni bën pohimin e mëposhtëm kristologjik:
1. Jezusi është Qengji i Perëndisë (v. 29), një titull që Jezusi e përdori vetëm këtu dhe te Zbulesa
 2. Jezusi është paraekzistues (v. 30)
 3. Jezusi është marrësi dhe dhënësi i Frymës së Shenjtë (v. 33)
 4. Jezusi është Biri i Perëndisë (v. 34)
- D. Të vërtetat për personin dhe veprën e Krishtit zhvillohen nga dëshmia personale e
1. Gjon Pagëzorit
 2. Andreas dhe Simonit
 3. Filipit dhe Natanaelit

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:19-23

¹⁹Kjo është dëshmia e Gjonit, kur judenjtë i dërguan priftërinj dhe levitë nga Jerusalemi për ta pyetur: “Kush je ti?” ²⁰Dhe ai rrëfeu e nuk e mohoi, por rrëfeu: “Unë nuk jam Krishti”. ²¹Ata e pyetën: “Po kush je? A je Elija?” Dhe ai u tha: “Nuk jam ai”. “A je Profeti?” Dhe ai u përgjigj: “Jo”. ²²Atëherë, ata e pyetën: “Kush je, që t’u japim një përgjigje atyre që na dërguan? Çfarë thua për veten?” ²²Ai tha: “Unë jam ZËRI I NJËRIT QË BËRTET NË SHKRETËTIRË: “DREJTOJANI UDHËN ZOTIT”, siç tha profeti Isaia”.

1:19 “judenjtë” Te Gjoni, kjo nënkupton (1) njerëzit e Judesë që ishin armiqësorë ndaj Jezusit, ose (2) vetëm drejtuesit fetare të judenjve (shih 2:18; 5:50; 7:13; 9:22; 12:42; 18:12; 19:38; 20:19). Disa studiues kanë argumentuar se asnjë jude nuk u referohej judenjve të tjerë në këtë mënyrë negative. Mirëpo kundërshtimi i judenjve ndaj krishterimit u përforcua pas Këshillit të Javnes në vitin 90 pas K.

Në thelb, fjala “jude” nënkupton dikë që vjen nga fisi i Judës. Pasi dymbëdhjetë fiset u ndanë në vitin 922 para K., Juda u bë emri që përfaqësonte tri fiset e jugut. Të dyja mbretëritë judaike, Izraeli dhe Juda, u çuan në robëri, por vetëm pak vetë, kryesisht nga Juda, u kthyen pas ediktit të Kirit më 538 para K. Në atë kohë, termi “jude” u bë titull për pasardhësit e Jakobit që jetonin në Palestinë dhe që ishin shpërndarë në mbarë botën mesdhetare.

Te Gjoni, ky term është kryesisht negativ, por përdorimi i tij i zakonshëm mund të shihet në 2:6 dhe 4:22.

■ **“priftërinj dhe levitë”** Me sa duket, Gjon Pagëzori kishte dhe prejardhje priftërore (shih Luka 1:5 e më tej). Kjo është e vetmja herë kur termi “levitë” shfaqet në ungjillin e Gjonit. Me gjasë, ata ishin policia e tempullit. Ky ishte një grup zyrtar “verifikuesish”, të dërguar nga autoritetet fetare në Jerusalemi (shih v. 24). Zakonisht, priftërinjtë dhe levitët ishin saducenj, ndërsa skribët zakonisht ishin farisenj (shih v. 24). Të dyja këto grup u përfshinë në pyetjet hetuese që i bënë Gjon Pagëzorit. Kundërshtarët politikë dhe fetarë bashkuan forcat për t’ua kundërvënë Jezusit dhe ndjekësve të tij.

■ **“Kush je ti?”** Kjo pyetje i bëhet dhe Jezusit te 8:25. Gjoni dhe Jezusi mësonin dhe vepronin në mënyra që i vinin në siklet udhëheqësit zyrtarë, pasi ata dallonin te të dy këta burra disa motive dhe terma eskatologjikë të DhV. Kështu, kjo pyetje lidhet me shpresën judaike për ardhjen e personazheve të fundit të kohës, pra, të Epokës së Re.

1:20 “Dhe ai rrëfeu, e nuk e mohoi, por rrëfeu” Kjo shprehje përbën një mohim të fortë e të trefishtë se Gjoni s’ishite Mesia (Krishti) i prituar dhe i premtuar. Për fjalën “rrëfej”, shih Temën e Veçantë në 9:22-23.

■ **“Krishti”** “Krishti” është përkthim në greqisht i fjalës hebraike “*māšîah*”, që donte të thoshte “i vajosur”. Në DhV, koncepti i vajosjes ishte një mënyrë për të theksuar thirrjen dhe pajisjen e veçantë nga ana e Perëndisë për një detyrë të veçantë. Mbretërit, priftërinjtë dhe profetët vajoseshin. Ky veprim u identifikua me të Veçantin, i cili do të sillte epokën e re të drejtësisë. Shumë mendonin se ky Mesi i premtuar ishte Gjon Pagëzori (shih Luka 3:15), pasi ai ishte zëdhënësi i parë i frymëzuar i JHVH_së që nga koha e shkruarve të DhV rreth katërqind vjet më herët.

Në këtë pikë, dua të përfshij komentet e mia nga Dan. 9:26 për “Mesinë”.

Danieli 9:26

NASB “Mesia”

NKJV “Mesia”

NRSV “i vajosuri”

TEV “udhëheqësi i zgjedhur i Perëndisë”

NJB “Një i Vajosur”

Vështirësia në interpretimin e këtij vargu vjen për shkak të kuptimeve të mundshme që shoqërohen me termin Mesia, ose i vajosur (BDB 603):

1. përdorej për mbretërit judenj (p.sh., 1 Sam. 2:10; 12:3)
2. përdorej për priftërinjtë judenj (p.sh., Lev. 4:3, 5)
3. përdorej për Kirin (shih Isa. 45:1)
4. # 1 dhe # 2 kombinohen me njëri-tjetrin në Psalmi 110 dhe Zakaria 4
5. përdorej për Mbretin e ardhshëm e të veçantë davidik të Perëndisë, i cili do të sillte epokën e re të drejtësisë
 - a. pasardhja e Judës (shih Zan. 49:10)
 - b. familja e Jeseut (shih 2 Samueli 7)
 - c. mbretërim universal (shih Psalmi 2; Isa. 9:6; 11:1-5; Mik. 5:1-4 e më tej)

Personalisht, mua më tërheq identifikimi i “të vajosurit” me Jezusin e Nazaretit për këto arsye:

1. prezantimi i një Mbretërie të përjetshme në kapitullin 2 gjatë perandorisë së katërt
2. prezantimi i “një biri njeriu” në 7:13, të cilit i jepet një mbretëri e përjetshme
3. fjalitë shpenguese të 9:24, të cilat dëftojnë drejt pikës kulmore të historisë së botës së rënë
4. përdorimi që i bën Jezusi librit të Danielit në DhR (shih Mat. 24:15; Marku 13:14)

1:21 “Po kush je? Mos je Elija?” Për shkak se Elija nuk vdiq, por u mor në qiell me një shakullinë ere (shih 2 Mbret. 2:1), ai pritej të vinte përpara Mesisë (shih Mal. 3:1; 4:5). Gjon Pagëzori dukej si Elija dhe vepronte në mënyrë shumë të ngjashme me të (shih Zak. 13:4).

■ **“Nuk jam ai”** Gjon Pagëzori nuk e shihte veten në rolin eskatologjik të Elisë, por Jezusi e shihte vërtet sikur funksiononte si një përmbushje e profecisë së Malakisë (shih Mat. 11:14; 17:12).

■ **“A je Profeti?”** Moisiu paratha se një si ai (të cilin e quajti “Profeti”) do të vinte pas tij (shih LiP. 18:15, 18; Gjoni 1:25; 6:14; 7:40; Veprat 3:22-23; 7:37). Ka dy mënyra të veçanta sesi përdorej ky term në DhR: (1) si një personalitet eskatologjik i dalluar nga Mesia (shih 7:40-41), ose (2) si një personalitet që identifikohet me Mesinë (shih Veprat 3:22).

1:23 “Unë jam ZËRI I NJËRIT QË BËRTET NË SHKRETËTIRË” Ky është citim nga përkthimi i Septuagintës i Isa. 40:3, me një aludim të vargut paralel Mal. 3:1.

■ **“DREJTOJANI UDHËN ZOTIT”** Ky është citim (Isa. 40:3) nga njësia letrare e Isaisë (kapitujt 40-54), ku shfaqen Këngët e Shërbëtorit (shih 42:1-9; 49:1-7; 50:4-11; 52:13-53:12). Në fillim, i referohen Izraelit, por, te 52:13-53:12, kjo fraza individualizohet. Koncepti i drejtimit të rrugës përdorej për përgatitjen e vizitës së mbretërve. Termi “drejt” lidhet me etimologjinë e termit “drejtësi”. Shih Temën e Veçantë të 1 Gjonit 2:29.

Gjithë ky paragraf mund t’i ketë shërbyer synimit të apostullit Gjon që të ulte vlerën e Gjon Pagëzorit për shkak të zhvillimit të një sërë grupesh heretike në shekullin e parë që e konsideronin Gjon Pagëzorian udhëheqësin e tyre shpirtëror.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:24-28

²⁴Ata ishin dërguar nga farisenjtë. ²⁵Ata e pyetën dhe i thanë: “Po, atëherë, pse po pagëzon, nëse s’je as Krishti, as Elija dhe as Profeti?” ²⁶Gjoni iu përgjigj, duke thënë: “Unë pagëzoj në ujë, por midis jush qëndron Njëri që nuk e njihni. ²⁷Ky është ai që vjen pas meje, të cilit nuk jam i denjë as t’i zgjidh lidhëset e sandaleve”. ²⁸Këto gjëra ndodhën në Betani përtej Jordanit, ku po pagëzonte Gjoni.

1:24 “Ata ishin dërguar nga farisenjtë” Ky varg është i paqartë. Mund të nënkuptojë se (1) farisenjtë dërguan hetuesit e Gjonit (shih v. 19), ose (2) hetuesit ishin farisenj, gjë që është e pazakontë kur kemi parasysh faktin se shumica e priftërinjve ishin saducenj (shih v. 9). Duket se i referohet një tjetër grupi nga ai i vargu 19.

TEMË E VEÇANTË: FARISENJTË

- I. Ky term kishte një nga fillesat e mundshme, si më poshtë:
 - A. “jam i veçuar”. Ky grupim u zhvillua gjatë periudhës makabease. (Kjo është pikëpamja e pranuar më gjerësisht).
 - B. “ndaj”. Ky është një tjetër kuptim nga e njëjta rrënjë në hebraisht. Disa thonë se nënkuptonte “interpretues” (shih 2 Tim. 2:15).
 - C. “persian”. Ky është një tjetër kuptim nga e njëjta rrënjë në aramaisht. Disa prej doktrinave të farisenjve kanë shumë të përbashkëta me dualizmin zoroastrian persian.
- II. Ata u zhvilluan gjatë periudhës makabease nga *hasidim*-ët (të përshpirtshmit). Nga reagimi antihelen kundër Antiokut IV Epifan mbinë një sërë grupimesh të ndryshme, si esenët. Farisenjtë përmenden për herë të parë në librin e Jozefusit, *Lashtësitë e judenjve* 8.5.1-3.
- III. Doktrinat e tyre kryesore.
 - A. Besimi në ardhjen e një Mesie, i cili ndikohej nga letërsia judaike apokaliptike në periudhën ndërthjatore, si 1 Enoku.
 - B. Perëndia është veprues në jetën e përditshme. Kjo ishte drejtpërdrejt në kundërshtim me saducenjët. Shumë doktrina fariseike ishin në kundërshtime teologjike me doktrinat e saducenjve.
 - C. Një jetë tjetër, e orientuar nga ana fizike, e bazuar në jetën tokësore, e cila përfshinte shpërblime dhe ndëshkime (shih Dan. 12:2).
 - D. Autoriteti i DhV dhe Traditave Gojore (Talmudi). Ata ishin të vetëdijshëm se po u bindeshin porosive të Perëndisë në DhV, siç interpretoheshin dhe zbatoheshin nga shkollat e studiuesve rabinikë (konservatori Shamai dhe liberali Hilel). Interpretimi rabinik bazohej në një dialog mes rabinëve të dy filozofive të ndryshme, njëri konservator e tjetri liberal. Në fund, këto diskutime gojore për kuptimin e Shkrimit u shkruan në dy forma: Talmudi babilonas dhe Talmudi i paplotë palestinas. Ata besonin se Moisiu i kishte marrë këto interpretime gojore në malin Sinai. Fillesa historike e këtyre diskutime nisi me Ezrën dhe me burrat e “Sinagogës së Madhe” (më vonë, të quajtur Sinedër).
 - E. Angjelologji tejet e zhvilluar. Këtu futeshin edhe qenie shpirtërore të mira, edhe të këqija. Kjo u zhvillua nga dualizmi persian dhe nga letërsia judaike ndërthjatore.

1:25 “Po, atëherë, pse po pagëzon?” Pagëzimi i prozelitëve ishte detyrim në judaizmin e lashtë për ata johebrenj që donin të ktheheshin në besim, por ishte tejet e pazakontë që vetë judenjtë të pagëzoheshin (judenjtë sektarë të Kumranit praktikonin vetëpagëzimet, ndërsa adhuruesit në tempull bënin banjë përpara se të hynin). Ky varg mund të ketë nënkuptime mesianike të marra nga Isa. 52:15; Ezek. 36:25; Zak. 13:1.

■ **“nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, e cila merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare.

■ **“nuk je as Krishti, as Elija, as Profeti”** Në dritën e Pergamenave të Detit të Vdekur, është interesante se këta tre personazhe përfaqësonin pikëpamjen esene se do të vinin tre personalitete të ndryshme mesianike. Po kështu, është interesante se disa drejtues të kishës së hershme besonin se Elija do të vinte fizikisht përpara Ardhjes së Dytë të Krishtit (p.sh., Gojarti, Jeronimi, Gregori dhe Augustini).

1:26 “Unë pagëzohet me ujë” PARAFJALA “në” mund të ketë edhe kuptimin “me”. Cilëndo alternativë të zgjedhësh, ajo duhet të përputhet me frazën paralele në v. 33 në lidhje me “Frymën”.

■ **“por midis jush qëndron Njëri”** Ka disa variante tekstuale që lidhen me KOHËN e FOLJES “qëndron”. UBS⁴ e vlerëson KOHËN E KRYER si të shkallës “B” (pothuajse të sigurt).

Bruce M. Metzger thotë se KOHA E KRYER është karakteristike për Gjonin dhe nënkupton një idiomë hebraishte të tillë: “është Njëri që ka zënë vend në mesin tuaj” (f. 199).

1:27 “të cilin nuk jam i denjë as t’i zgjidh lidhëset e sandaleve” Kjo nënkuptonte detyrën e skllavit që të zgjidhte sandalet e të zotit kur hynte në shtëpi (kjo konsiderohej si detyra më e ulët dhe më poshtëruese që mund të kryente skllavi). Judaizmi rabinik pohonte se dishepulli i rabinut duhet të ishte i gatshëm të bënte gjithçka që bënte skllavi, përveç t’i zgjidhte sandalet. Këtu kemi dhe nënkuptimin e pashprehur të heqjes së sandaleve dhe vendosjes së tyre në një vend të caktuar për këtë punë. Kjo është metaforë e përlules së skajshme.

1:28 “Betani” Versioni King James përmban emrin “Bethabara” (dorëshkrimet α^2 , C^2). Kjo ndodhi për shkak të mbështetjes së përkthyesve të KJV në keqkuptimin e Origenit (dhe alegorizmin e emrit të vendit) për vendndodhjen e qytetit. Leximi i duhur është Betania (Papirusi i Bodmerit, P⁶⁶), jo ajo në juglindje të Jerusalemit (shih 11:18), por qyteti përballë Jerikos, në anën tjetër të lumit Jordan (ana lindore).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:29-34

²⁹Ditën tjetër, ai pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: “Ja, Qengji i Perëndisë që heq mëkatën e botës!” ³⁰Ky është ai për të cilin thashë: „Pas meje vjen një Burrë që është i një rangu më të lartë se unë, sepse ai ekzistonte përpara meje“. ³¹Unë nuk e njihja, por, që ai t’i zbulohet Izraelit, erdha të pagëzohet në ujë“. ³²Gjoni dëshmoi duke thënë: “Kam parë Frymën duke zbritur si pëllumb nga qielli, dhe qëndroi mbi të. ³³Unë nuk e njihja, por ai që më dërgoi të pagëzoja me ujë më tha: „Ai mbi të cilin sheh Frymën të zbresë e të qëndrojë mbi të, ky është Ai që pagëzon në Frymën e Shenjtë“. ³⁴Unë vetë kam parë dhe kam dëshmuar se ky është Biri i Perëndisë”.

1:29 “Ja, Qengji i Perëndisë” Festa e Pashkës nuk ishte larg (shih 2:13). Si rrjedhojë, kjo ndoshta i referohet qengjit të Pashkës, që simbolizonte çlirimin (pra, shpëtimin) nga Egjipti (shih Eksodi 12). Gjoni e vendos edhe vdekjen e Jezusit në të njëjtën ditë kur therej qengji i Pashkës (pra, “Dita e Përgatitjes”). Megjithatë, ka patur dhe interpretime të tjera:

1. mund t’i referohet Shërbëtorit të Përvuajtur të Isa. 53:7
2. mund t’i referohet kafshës që u kap në shkurre, në Zan. 22:8, 13.
3. mund t’i referohet ofrimit të përditshëm në tempull që quhej “i vazhdueshëm” (shih Eks. 29:38-46).

Cilido qoftë shoqërimi i saktë, qengji dërgohej me qëllim që të flijohet (shih Marku 10:45).

Kjo metaforë e fuqishme për vdekjen flijuese të Jezusit nuk u përdor kurrë nga Pali dhe u përdor vetëm rrallë nga Gjoni (shih 1:29, 36; shih dhe Veprat 8:32 dhe 1 Pje. 1:19). Termi grek “qengji i vogël” (i vogël, sepse ishte vetëm njëvjeçar, mosha normale e ofrimeve flijuese). Gjoni përdor një fjalë tjetër te 21:15, si dhe 28 herë të tjera në librin e Zbulesës.

Figura letrare e Gjon Pagëzorit mund të përbëjë dhe një mundësi tjetër: letërsia apokaliptike ndërhytore ku “qengji” është luftëtari fitimtar. Aspekti flijues është ende i pranishëm, por qengji si gjykatës eskatologjik është në pamje të parë (shih Zbu. 5:5-6, 12-13).

■ **“që heq mëkatën e botës!”** Faza “heq” nënkuptonte “marr dhe largoj”. Kjo FOLJE është shumë e ngjashme me konceptin e “cjapit fajshlyes” te Levitiku 16. Vetë fakti se përmendet mëkati i botës aludon për natyrën

universale të detyrës së qengjit (shih v. 9; 3:16; 4:42; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titi 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14). Vini re se mëkati është NJËJËS, jo SHUMËS. Jezusi e ka zgjidhur problemin e “mëkatis” të botës.

1:30 “sepse ai ekzistonte përpara meje” Kjo është përsëritje për theksim e v. 15. Ky është një tjetër theksim i paraekzistencës dhe natyrës hyjnore të Mesisë (shih Gjoni 1:1, 15; 8:58; 16:28; 17:5, 24; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3).

1:31 “që ai t’i zbulohet Izraelit” Kjo është një frazë e zakonshme e Gjonit (shih 2:11; 3:21; 7:4; 9:3; 17:6; 21:14; 1 Gjonit 1:2; 2:19, 28; 3:2, 5, 8; 4:9), por është e rrallë në ungjijtë sinoptikë, pasi shfaqet vetëm te Marku 4:22. Është lojë fjalësh e bazuar në termin hebraik “njoh”, që nënkupton marrëdhënien personale me dikë, dhe jo thjesht njohjen e fakteve për dikë. Synimi i pagëzimit të Gjonit ishte i dyfishtë: (1) të përgatiste popullin dhe (2) të zbulonte Mesinë.

Kjo FOLJE, “shfaqem” (*faneroō*) duke sikur zëvendëson foljen “zbuloj (*apokaluptō*) në shkrimet e Gjonit. Jezusi sjell qarta në dritë/pamje personin dhe mesazhin e Perëndisë!

1:32-33 Ky është një theksim i trefishtë i faktit se Gjoni pa Frymën tek zbriste dhe qëndronte mbi Jezusin.

1:32 “Frymën duke zbritur si pëllumb nga qielli” Kjo ishte mënyra e Isaisë (kapitujt 40-66) për të dalluar Mesinë (shih Isa. 42:1; 59:21; 61:1). Kjo nuk nënkupton se Jezusi nuk e kishte Frymën përpara këtij çasti. Ky ishte simbol i zgjedhjes dhe pajisjes së veçantë nga ana e Perëndisë. Nuk synohej pikë së pari për Jezusin, por për Gjon Pagëzorian!

Judenjtë kishin një botëkuptim me dy epoka (shih Tema e Veçantë te 1 Gjonit 2:17), epoka e tanishme e ligë dhe epoka e ardhshme e drejtësisë. Epoka e re quhej epoka e Frymës. Ky vegim duhet t’i ketë bërë të ditur Gjon Pagëzorit (1) se ky është Mesia dhe (2) se epoka e re ka aguar.

■ **“pëllumb”** Ky përdorej

1. si simbol rabinik për Izraelin (shih Os. 7:11)
2. si aludim për Frymën si zog femër që “rri si kllonjë” mbi krijimin, te Zan. 1:2 në Targumet
3. si simbol urtësie te Filoja
4. si metaforë e mënyrës sesi zbriti Fryma (Fryma nuk është zog)

■ **“qëndroi”** shih Temën e Veçantë: “Banimi” në shkrimet e Gjonit, te 1 Gjonit 2:10.

1:33 “nuk e njihja” Kjo nënkupton se Gjon Pagëzori nuk e njihje Jezusin si Mesi, jo se nuk e njihje fare. Si kushërinj, patjetër që ata duhet të jenë takuar në tubimet familjare ose fetare me kalimin e viteve.

■ **“Ai që më dërgoi të pagëzoja në ujë më tha”** Perëndia foli me Gjonin siç kishte bërë dhe me profetët e tjerë të DhV. Gjoni do ta dallonte Mesinë me anë të këtyre veprimeve të veçanta që do të ndodhnin në pagëzimin e tij.

Pagëzimi i Gjonit nënkuptonte autoritet fetar. Delegacioni zyrtar nga Jerusalemi (shih v. 19-28) donte të dinte burimin e këtij autoriteti. Gjon Pagëzori ia atribuon atë autoritet Jezusit. Pagëzimi i Jezusit me Frymën ishte më i lartë se pagëzimi i Gjonit me ujë. Vetë pagëzimi i Jezusit në ujë do të bëhet shenjë e pagëzimit të Frymës, përfshirja në epokën e re!

■ **“ky është Ai që pagëzon në Frymën e Shenjtë”** Nga 1 Kor. 12:13, duket se ky koncept lidhet me përfshirjen fillestare të një njeriu në familjen e Perëndisë. Fryma e bind për mëkat, e tërheq drejt Krishtit, e pagëzon në Krishtin dhe formon Krishtin në besimtarin e ri (shih Gjoni 16:8-13). Shih Temën e Veçantë: I Shenjti, te 1 Gjonit 2:20.

1:34 “Unë vetë kam parë dhe kam dëshmuar” Këto janë të dyja në DËFTOREN E KRYER AKTIVE, që nënkupton një veprim të shkuar të përfunduar, por rezultatet e të cilit vazhdojnë. Kjo është shumë e ngjashme me 1 Gjonit 1:1-4.

■ **“se ky është Biri i Perëndisë”** Ndoshta, fjala greke *paīs*, që normalisht përkthehet “shërbëtor”, duke reflektuar termin hebraisht *‘ebed* (BDB, 712) në LXX, mund të jetë sfondi për fjalën “Bir”. Nëse është kështu, atëherë Isaia 53 (si dhe “qengji” i Perëndisë në 1:29) është aludimi nga DhV, dhe jo Dan. 7:13. Jezusi është edhe Biri, edhe Shërbëtori! Ai do të shndërrojë besimtarët në “fëmijë”, jo në “shërbëtor”!

Po ky titull përdoret edhe nga Natanaeli te Gjoni 1:49. Përdoret edhe nga Satani te Mat. 4:3. Në dorëshkrimet P⁵ dhe א*, gjendet një variant interesant grek, që në vend të “Biri i Perëndisë” përmban “i Zgjedhuri i Perëndisë” (UBS⁴ i jep “Birit të Perëndisë” vlerësimin “B”). Fraza “Biri i Perëndisë” është e zakonshme për Gjonin. Por, nëse ndjekim parimet racionale të kritikës tekstuale, pra se terminologjia më e ngathët dhe më e pazakontë ka gjasa të jetë origjinale, atëherë ekziston të paktën mundësia e një përkthimi ndryshe ndonëse dëshmia e dorëshkrimeve është e kufizuar. Gordon Fee e diskuton këtë variant tekstual në artikullin e vet “The Textual Criticism of the New Testament” (Kritika e tekstit të Dhiatës së Re) f. 419-433, në vëllimin hyrës të *The Expositor’s Bible Commentary (Komentari biblik i ekspozuesit)*:

“Në Gjoni 1:34, a tha Gjon Pagëzori, „Ky është Biri i Perëndisë“ (KJV, RSV), apo “Ky është i Zgjedhuri i Perëndisë“ (NEB, JB)? Të dhënat e dorëshkrimeve janë të kufizuara, edhe midis llojeve të hershme të teksteve. „Bir“ gjendet në dëshmitarët kyçë aleksandrianë (P⁶⁶, P⁷⁵, B, C, L copbo), si dhe në një sërë dorëshkrimesh të vjetra latine (aur, c, flg) dhe dëshmitarët e mëvonshëm siriakë, ndërsa „i Zgjedhuri“ mbështetet nga aleksandrianët P⁵, א, copsa, si dhe dorëshkrimet në latinishten e vjetër a, b, e, ff², dhe siriakja e vjetër.

“Në fund, kjo çështje duhet zgjidhur mbi bazat e të dhënave të brendshme. Sa për gjasat shkrimore, një gjë është e qartë: varianti është i qëllimshëm, jo rastësor (shih Bart D. Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture*, f. 69-70). Por a e ndryshoi një kopjues i shekullit të dytë tekstin për të mbështetur një lloj kriptologjie adopcioniste, apo mos vallë një kopjues ortodoks ndjeu mundësinë që se titulli „i Zgjedhuri“ mund të përdorej për të mbështetur adopcionizmin dhe, si rrjedhojë, e ndryshoi për arsye ortodokse? Për sa u përket gjasave, kjo e dyta duket shumë më e mundshme, sidomos për faktin se „Biri“ nuk ndryshohet gjëkund tjetër në ungjill për t’u përshtatur pikëpamjeve adopcioniste.

“Por vendimi përfundimtar duhet të përfshijë eksegjezën. Meqë ajo që tha Gjon Pagëzori synohej pothuajse pa dyshim si term mesianik, dhe jo si shprehje e teologjisë së krishterë, pyetja është nëse kjo reflekton mesianizmin e një pasazhi të tillë si Psalmi 2:7, apo atë të Isaias 42:1. Në dritën e motivit të qengjit të përvuajtur, ose pashkor, të Gjonit 1:29, pa dyshim që mund të argumentojmë se „i Zgjedhuri“ përputhet me kontekstin e ungjillit” (f. 431-432).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:35-42

³⁵Sërisht, ditën tjetër, Gjon po qëndronte me dy dishepujt e vet, ³⁶dhe vështroi Jezusin tek po ecte, dhe tha: “Ja, Qengji i Perëndisë!” ³⁷Dy dishepujt e dëgjuan që foli, dhe ndoqën Jezusin. ³⁸Jezusi u kthye, i pa që po e ndiqnin dhe u tha: “Çfarë kërkoni?” Ata i thanë: “Rabbi, (që, e përkthyer, do të thotë Mësues) ku po qëndron?” ³⁹Ai u tha: “Ejani dhe shihni”. Kështu, ata shkuan dhe panë ku po qëndronte; dhe qëndruan me të atë ditë, sepse ishte rreth orës së dhjetë. ⁴⁰Një nga ata të dy që dëgjuan Gjonin të fliste dhe ndoqën Jezusin ishte Andrea, vëllai i Simon Pjetrit. ⁴¹Ai gjeti së pari të vëllanë, Simonin, dhe i tha: “Kemi gjetur Mesinë” (që, i përkthyer, do të thotë Krisht). ⁴²Ai e çoi te Jezusi. Jezusi e vështroi dhe tha: “Ti je Simoni, biri i Gjonit; ti do të quhesh Kefa” (që përkthehet Pjetër).

1:35 “dy nga dishepujt e tij” Marku 1:16-20 duket se është një rrëfim i ndryshëm i thirrjes së këtyre dy dishepujve. Është e paqartë sa kontakt të mëparshëm kishte patur Jezusi me dishepujt e tij galileas. Në kohën e Jezusit, kishte faza të veçanta disipline në procesin e bërjes ndjekës me kohë të plotë i një rabini. Këto procedura shprehen qartë në burimet rabinike, por nuk ndiqen ekzaktësisht në rrëfimet e ungjijve. Dy dishepujt e përmendur janë Andrea (shih v. 40) dhe apostulli Gjon (i cili nuk e përmend kurrë veten me emër në këtë ungjill).

Termi dishepull mund të nënkuptojë (1) nxënës dhe/ose (2) ndjekës. Ky ishte një emër i hershëm i besimtarëve në Jezu Krishtin si Mesia i premtuar i judenjve. Është e rëndësishme të vërejmë se DhR bën thirrje për dishepuj, jo thjesht për vendime (shih Mateu 13; 28:18-20). Krishterimi është një vendim fillestar (pendimi dhe besimi) që ndiqet nga një vendim i vazhdueshëm për bindje dhe qëndresë. Krishterimi nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për qiellin, por një marrëdhënie e përditshme shërbëtor/mik me Jezusin.

1:37 “Dy dishepujt e dëgjuan që foli” Gjon Pagëzori tregoi përtej vetes, drejt Jezusit (shih 3:30).

1:38 “Rabbi (që, e përkthyer, do të thotë Mësues)” Ky titull ishte i zakonshëm në judaizmin e shekullit të parë; identifikonte ata që ishin në gjendje të shtjellonin domethënien dhe zbatimet e Ligjit të Moisiut dhe Traditës Gojore (Talmudi). Fjalë për fjalë, do të thotë “zotëria im”. Përdoret nga Gjon apostulli si fjalë e barabartë me “mësues” (shih 11:8, 28; 13:13-14; 20:16). Fakti se Gjonin i shpjegon termat e veta (shih v. 38, 41, 42) tregon se po u shkruante johebrenjve.

■ **“ku po qëndron?”** Kjo duket se ndjek procedurat tradicionale të formimit të lidhjes unike mes mësuesit dhe nxënësit. Kjo pyetje nënkupton se këta dy burra donin që të kalonin më tepër kohë me Jezusin sesa thjesht t’i bënin disa pyetje në rrugë (shih v. 39).

Fjala *menō* (qëndroj) shfaqet tri herë në v. 38 dhe 39. Mund të nënkuptojë një vend fizik, ose një vend shpirtëror. Këto tre përdorime duket sikur nënkuptojnë një tjetër lojë fjalësh, duke i bashkuar të dyja këto ngjyrimet, gjë që është shumë e zakonshme te Gjoni (p.sh., 1:1, 5; 3:3; 4:10-11; 12:32). Kjo dykuptimësi e qëllimshme është karakteristike për shkrimet e Gjoni!

1:39 “ishte rreth orës së dhjetë” Është e paqartë nëse Gjoni po përdor orarin romak, që fillonte në (1) 12.00 të drekës, apo (2) në agim, apo orarin judaik, që fillonte në 6:00 të pasdites (në muzg). Kur krahasojmë Gjoni 19:14 me Markun 15:25, duket se ai po nënkupton orën romake. Megjithatë, kur shohim Gjoni 11:9, duket sikur ky nënkupton orarin judaik. Ndoshta, Gjoni i përdori të dyja. Këtu, duket sikur nënkupton orarin romak, nr. 2, ose rreth orës 4:00 të pasdites.

1:40 “Një nga ata të dy që dëgjuan Gjoni” Shkrimtari (apostulli Gjoni) nuk e përmend kurrë veten me emër në ungjill (p.sh., 21:2). Pa dyshim, ka mundësi që nga dy dishepujt që dëgjuan Gjoni Pagëzorin kur bëri këtë shpallje ishte Gjoni, biri i Zebedeut (p.sh., Mat. 4:21; Marku 1:19).

1:41

NASB “Ai gjeti së pari të vëllanë”

NKJV, NRSV “Së pari, ai gjeti vëllanë e vet”

TEV “Menjëherë, ai gjeti”

NJB “Gjëja e parë që bëri Andrea”

Ekziston një variant dorëshkrimor që ndikon në përkthimet e ndryshme. Mundësitë janë

1. gjëja e parë që bëri Andrea
2. personi i parë që gjeti Andrea
3. Andrea ishte i pari që shkoi dhe i tha

■ **“Mesinë (që i përkthyer do të thotë “Krishti”)** Shih shënimin e 1:20.

1:42 “Jezusi e vështroi” Kjo fjalë nënkupton një “vështrim të ngulët”.

■ **“Simoni, biri i Gjoni”** Në DhR ka njëfarë pështjellimi në lidhje me emrin e të atit të Pjetrit. Te Mat. 16:17, Pjetri quhet “biri i Jonës” (*Iōnas*), kurse këtu quhet “biri i Gjoni” (*Iōannēs*). Emri “Gjon” gjendet në dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, 8 dhe L. Dorëshkrimi B përmban të njëjtin emër, por vetëm me një “n” (*Iōanēs*). Emri “Jona” shfaqet në dorëshkrimet A, B³, K dhe në shumicën e dorëshkrimeve të mëvonshme greqisht. Duket sikur kjo pyetje s’ka përgjigje të qartë. Germëzimet e ndryshme janë të zakonshme për emrat e tejskronjëzuara nga aramaishtja.

Michael Magill, *The New Testament TransLine (Dhiata e Re në përkthim me rreshta)*, f. 303, thotë: “„Jona” dhe „Gjon” mund të jenë shqiptime të ndryshme greqisht të të njëjtit emër hebraisht, si „Simon” dhe „Simeon””.

■ **“ti do të quhesh Kefa (që përkthehet Pjetër)”** Termi Kefa është një fjalë aramaike që përkthehet “shkëmb” (*kefa*), që në greqisht vjen në formën *kefas*. Ky emër të sillte ndërmend patundshmëri, forcë dhe qëndrueshmëri.

Ky është një nga komentet e shumta të autorit të ungjillit për t’u shpjeguar lexuesve johebrenj jetën dhe mësimet e Jezusit.

Është interesante se, më tej, në këtë kapitull, shfaqen dy termat (si FOLJE) e mëvonshëm teknike për interpretimin biblik.

1. eksegjezë, drejtoj jashtë, e përdorur në 1:18
2. hermeneutikë, shpjegoj, interpretoj, përkthej, e përdorur në 1:42

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:43-51

⁴³ Të nesërmen, ai synonte të shkonte në Galile dhe gjeti Filipin. Dhe Jezusi u tha: “Më ndiq”.
⁴⁴ Filipi ishte nga Betsaida, qyteti i Andreas dhe Pjetrit. ⁴⁵ Filipi gjeti Natanaelin dhe i tha: “Kemi gjetur atë për të cilin shkroi Moisiu, në Ligj, dhe Profetët: Jezusin e Nazaretit, birin e Jozefit”. ⁴⁶ Natanaeli i tha: “A mund të dalë diçka e mirë nga Nazareti?” Filipi i tha: “Eja dhe shih”. ⁴⁷ Jezusi pa se Natanaeli po vinte drejt tij dhe i tha: “Ja, një izraelit i vërtetë, në të cilin nuk ka mashtrim!” ⁴⁸ Natanaeli i tha: “Nga më njeh?” Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Përpara se të të thërriste Filipi, kur ishe nën pemën e fikut, të pashë”. ⁴⁹ Natanaeli iu përgjigj: “Rabbi, ti je Biri i Perëndisë; ti je Mbreti i Izraelit”. ⁵⁰ Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Për shkak se të thashë se të pashë nën pemën e fikut, ti më beson? Ke për të parë gjëra më të mëdha se këto”. ⁵¹ Dhe i tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: do të shihni qiejt të hapur dhe engjëjt e Perëndisë që ngjiten e zbresin mbi Birin e Njeriut”.

1:43 “Të nesërmen” Gjoni përfshin shënjes kronologjikë gjatë gjithë ungjillit (shih 1:29, 35, 43; 2:1; etj.). Konteksti i përgjithshëm (1) fillon në v. 19, që mund të jetë dita e parë; (2) v. 29, 35, 43 thonë “ditën tjetër”; dhe (3) 2:1 thotë “ditën e tretë”.

■ **“ai synonte të shkonte në”** Gjoni regjistron një periudhë të hershme të shërbesës së Jezusit në Jude, e cila nuk është regjistruar në ungjijtë sinoptikë. Ungjilli i Gjonit fokusohet në shërbesën e Jezusit në Jude dhe, veçanërisht, në Jerusalem. Mirëpo, këtu Jezusi dëshiron të shkojë në Galile, ndoshta për dasmën në Kanë (Gjoni 2).

■ **“Më ndiq”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORRE. Ajo ishte thirrje rabinike për t’u bërë dishepull i përhershëm. Judenjtë kishin vendosur rregulla që përcaktonin këtë marrëdhënie.

1:44 “Filipi ishte nga Betsaida” Emri i këtij qyteti do të thotë “shtëpi e peshkimit”. Ajo ishte edhe shtëpia e Andreas dhe Pjetrit.

1:45 “Natanaeli” Ky është një emër hebre, që do të thotë “Perëndia ka dhënë”. Ai nuk përmendet me këtë emër në ungjijtë sinoptikë. Studiuesit e sotëm supozojnë se ai është personi që quhet “Bartolome”, por ky mbetet vetëm hamendësim.

TEMË E VEÇANTË: GRAFIKU ME EMRAT E APOSTUJVE

	Mateu 10:2-4	Marku 3:16-19	Luka 6:14-16	Veprat 1:12-18
Grupi i parë	Simoni (Pjetri) Andrea (vëllai i Pjetrit) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit)	Simoni (Pjetri) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit) Andrea	Simoni (Pjetri) Andrea (vëllai i Pjetrit) Jakobi (biri i Zebedeut) Gjoni (vëllai i Jakobit)	Pjetri Gjoni Jakobi Andrea
Grupi i dytë	Filipi Bartolomeu Thomai Mateu (tagrambledhësi)	Filipi Bartolomeu Mateu Thomai	Filipi Bartolomeu Mateu Thomai	Filipi Thomai Bartolomeu Mateu
Grupi i tretë	Jakobi (biri i Alfeut) Tadeu Simoni (kanaaniti) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Tadeu Simoni (kanaaniti) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Simoni (zeloti) Juda (biri i Jakobit) Juda (Iskarioti)	Jakobi (biri i Alfeut) Simoni (zeloti) Juda (biri i Jakobit)

■ **“në Ligj, dhe në Profetët”** Këtu bëhet fjalë për dy nga tre pjesët e kanonit hebraik: Ligji, Profetët dhe Shkrimet (e cila vazhdoi të diskutohej ende në Javne, më 90 pas K.). Kjo ishte një shprehje që i referohej gjithë Dhiatës së Vjetër.

■ **“Jezusi i Nazaretit, biri i Jozefit”** Kjo duhet kuptuar në dritën e përdorimit judaik. Asokohe, Jezusi jetonte në Nazaret dhe babai i shtëpisë quhej Jozef. Kjo nuk mohon lindjen e Jezusit në Betlehem (shih Mikea 5:2), as lindjen e tij të virgjër (shih Isa. 7:14). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI NAZAREAS

Ka një sërë termash të ndryshëm greqisht që përdor DhR për të folur për Jezusin.

A. Termat e DhR

1. Nazareti – qyteti në Galile (shih Luka 1:26; 2:4, 39, 51; 4:16; Veprat 10:38). Ky qytet nuk përmendet në burimet e kohës, por është gjetur në mbishkrime të mëvonshme. S'ishte kompliment që Jezusi ishte nga Nazareti (shih Gjoni 1:46). Shenja mbi kryqin e Jezusit, që përfshiu dhe emrin e këtij vendi, ishte shenjë e përçmimit të judenjve.
2. *Nazarēnos* – duket se i referohet edhe një vendndodhjeje gjeografike (shih Luka 4:34; 24:19).
3. *Nazōraios* – mund t'i referohet një qyteti, por mund të jetë edhe lojë fjalësh me termin mesianik hebre "Dega" (*necer*, shih Isa 4:2; 11:1; 53:2; Jer. 23:5; 33:15; Zak. 3:8; 6:12; në DhR, Zbu. 22:16). Luka e përdor për Jezusin në 18:37 dhe në Veprat 2:22; 3:6; 4:10; 6:14; 22:8; 24:5; 26:9.
4. Lidhet me #3, *nāzīr*, që do të thotë "i shenjtëruar me anë të një betimi".

B. Përdorimet historike jashtë DhR.

1. Përcaktonte një grup heretik jude (para krishterimit) (në aramaisht, *nāsōrayyā*).
2. U përdor në qarqet judaike për të përshkruar besimtarët në Krishtin (shih Veprat 24:5, 14; 28:22, *nori*).
3. U bë fjala e zakonshme për të përcaktuar besimtarët në kishat siriane (aramaie). "I krishterë" përdorej në kishat greke për të përcaktuar këta besimtarë.
4. Diku pas rënies së Jerusalemit, farisenjtë u riorganizuan në Javne dhe nisën ndarjen formale mes sinagogës dhe kishës. Një shembull i llojit të formulave të mallkimit kundër të krishterëve gjendet në "Tetëmbëdhjetë Bekimet" nga *Berakoth* 28b-29a, ku besimtarët quhen "nazareas" "Nazareasit dhe heretikët u zhdukshin në një çast; ata do të fshihen nga libri i jetës dhe nuk do të shkruhen me besnikët".
5. U përdor nga Justin Martiri, *Dial.* 126:1, i cili përdori termin *necer* të Isaisë për Jezusin.

C. Mendimi i autorit

Habitem nga kaq shumë shqiptime që ka ky term, ndonëse e di se nuk është e padëgjuar në DhV, ku "Jozueu" shfaqet në një sërë shqiptimesh të ndryshme në hebraisht. Pikat e mëposhtme më bëjnë të mbetem i pasigurt për kuptimin e saktë të kësaj fjale:

1. shoqërimi i ngushtë me termin mesianik "Dega" (*necer*), ose termin e ngjashëm *nāzīr* (dikush që shenjtërohet me anë të një betimi)
2. ngjyrimi negativ që e lidhte me Galilenë
3. dokumentimi i pakët, ose i munguar, i kohës për qytetin e Nazaretit në Galile
4. fakti se vjen nga goja e një demoni në kuptimin eskatologjik (pra, "Ke ardhur të na shkatërrosh?").

Për një bibliografi të plotë të studimeve për këtë grup fjalësh, shih Colin Brown (red.), *New International Dictionary of New Testament Theology*, vëll. 2, f. 346, ose Raymond E. Brown, *Birth*, f. 209-213, 223-225.

1:46 "Natanaeli i tha: "A mund të dalë diçka e mirë nga Nazareti" Me sa duket, Filipi dhe Natanaeli i njihnin profecitë e DhV; Mesia do të vinte nga Betlehemi (shih Mikea 5:2) pranë Jerusalemit, jo nga Nazareti në Galilenë e johebrenjve, por Isa. 9:1-7 nënkupton pikërisht këtë gjë!

1:47

NASB, NKJV,

NRSV, "në të cilin nuk ka mashtrim"

TEV "nuk ka asgjë të rreme në të"

NJB "Në të cilin nuk ka mashtrim"

Kjo nënkupton një njeri të drejtpërdrejtë, që s'ka motive të fshehura (shih Psa. 32:2), një përfaqësim i vërtetë i popullit të zgjedhur, Izraelit.

1:48 "Jezusi u përgjigj dhe i tha: „Përpara se të të thërriste Filipi, kur ishe nën pemën e fikut, të pashë" Qartazi, Jezusi përdori njohurinë e vet të mbinatyrshme (p.sh., 2:24-25; 4:17-19, 29; 6:61, 64, 71; 13:1, 11, 27, 28; 16:19, 30; 18:4) për t'i dhënë një shenjë Natanaelit se ai ishte Mesia.

Është e vështirë të kuptojmë sesi funksiononte natyra hyjnore dhe njerëzore e Jezusit. Në disa pasazhe, është e paqartë nëse Jezusi po përdorte fuqi “të mbinatyrshme”, apo aftësi njerëzore. Këtu, nënkuptohet aftësia “e mbinatyrshme”.

1:49 “Natanaeli iu përgjigj: “Rabbi, ti je Biri i Perëndisë... Mbreti i Izraelit” Vini re dy titujt! Të dy kanë domethënie nacionaliste mesianike (p.sh., Psalmi 2). Këta dishepuj të hershëm e kuptonin Jezusin sipas kategorive judaike të shekullit ë parë. Ata nuk e kuptuan plotësisht personalitetin dhe veprën e tij si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isa. 53) deri pas ringjalljes.

1:51

NASB “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them”

NKJV “Me siguri, po ju them”

NRSV “Me shumë vërtetësi, po ju them”

TEV “Po ju them të vërtetën”

NJB “Me vërtetësi të plotë”

Fjalë për fjalë, thuhet “Amen! Amen!” Përdorimi i dyfishtë që i bën Jezusi kësaj fjale gjendet vetëm në ungjillin e Gjonit, ku shfaqet njëzet e pesë herë. “Amen” është një formë e fjalës hebraike besim (*emeth*), që donte të thoshte “të jesh i patundur” (shih Tema e Veçantë në 1:14). Ajo përdorej në DhV si metaforë për qëndrueshmërinë dhe besnikërinë. Më vonë, u përkthye “besim” ose “besnikëri”. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, filloi të përdorej si pohim. Në këtë pozicion fillestar në fjali, ajo ishte mënyrë unike për t’ia përqendruar vëmendjen dëgjuesit te pohimet e rëndësishme dhe besnike të Jezusit, ose te Zbulesa që vinte nga JHVH (shih 1:51; 2:3, 5, 11; 5:19, 24, 25; 6:26, 32, 47, 53; 8:34, 51, 58; 10:1, 7; 12:24; 13:16, 20, 21, 38; 14:12; 16:20, 23; 21:18).

Vini re ndryshimin nga njëjësi në SHUMËS (PËREMRI dhe FOLJA). Kjo duhet t’u jetë drejtuar të gjithë atyre që po qëndronin aty.

TEMË E VEÇANTË: AMEN

I. DHIATA E VJETËR

A. Termi “Amen” vjen nga një fjalë hebraike që do të thotë

1. “e vërtetë” (*emeth*, BDB 49)
2. “vërtetësi” (*emun, emunah*, BDB 53)
3. “besim” ose “besnikëri”
4. “besim te dikush” (*dmn*, BDB 52)

B. Etimologjia e saj vjen nga qëndrimi fizik i qëndrueshëm i dikujt. E kundërta do të ishte një njeri që është i paqëndrueshëm, që rrëshqet (shih Psalmi 40:2; 73:18; Jeremia 23:12), ose që pengohet (shih Psa. 73:2). Nga ky përdorim i fjalëpërfjalshëm u zhvillua zgjerimi metaforik i kuptimit “besnik, i besueshëm, i besës dhe me integritet” (shih Zan. 15:6; Hab. 2:4).

C. Përdorimet e veçanta

1. Shtyllë, 2 Mbret. 18:16 (1 Tim. 3:15)
2. Siguri, Eks. 17:12
3. Palëvizshmëri, Eks. 17:12
4. Qëndrueshmëri, Isa. 33:6
5. I vërtetë, 1 Mbret. 10:6; 17:24; 22:16; Fja. 12:22
6. I patundur, 2 Kro. 20:20; Isa. 7:9
7. I besueshëm (Torahu), Psa. 119:43, 142, 151, 160

D. Në DhR përdoren dhe ty fjalë të tjera hebraisht për besimin veprues.

1. *bathakh* (BDB, 105), besim
2. *jëra* (BDB 431), frikë, respekt, adhurim (shih Zan. 22:12)

E. Nga kuptimi i besimit ose besueshmërisë u zhvillua dhe një përdorim liturgjik që u përdor për të mbështetur një pohim besnik ose të vërtetë të një tjetri (shih LiP. 27:15-26; Neh. 8:6; Psa. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48).

F. Çelësi teologjik për këtë term nuk është besnikëria e njerëzimit, por ajo e JHVH-së (shih Eks. 34:6; LiP. 32:4; Psa. 108:4; 115:1; 117:2; 138:2). Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është besnikëria besnike dhe e mëshirshme e JHVH-së ndaj besëlidhjes dhe premtimet e tij. Ata që

njohin JHVH-në duhet të jenë si ai (shih Hab. 2:4). Bibla është historia që dokumenton ripërtëritjen që i bën Perëndia shëmbëllimit të vet (shih Zan. 1:26-27) në njerëzimin. Shpëtimi i rikthen njerëzimit aftësinë për të patur bashkësi të ngushtë me Perëndinë. Kjo është arsyeja pse jemi krijuar.

II. DHIATA E RE

- A. Përdorimi i fjalës “amen” si pohim përmbyllës liturgjik i besueshmërisë së një pohimi të caktuar është i zakonshëm në DhR (shih 1 Kor. 14:16; 2 Kor. 1:20; Zbu. 1:7; 5:14; 7:12).
- B. Përdorimi i këtij termi në përmbyllje të lutjeve është i zakonshëm në DhR (shih Rom. 1:25; 9:5; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; 6:18; Efe. 3:21; Fil. 4:20; 2 Thes. 3:18; 1 Tim. 1:17; 6:16; 2 Tim. 4:18).
- C. Jezusi është i vetmi që përdori këtë term (shpesh, i dyfishuar te Gjoni) për të prezantuar pohime të rëndësishme (shih Luka 4:24; 12:37; 18:17, 29; 21:32; 23:43)
- D. Përdoret si titull për Jezusin te Zbu. 3:14 (ndoshta, titull i JHVH-së nga Isa. 65:16).
- E. Koncepti i besueshmërisë, besimit, besnikërisë, ose besimit në dikë shprehet me termin greqisht *pistos* ose *pistis*, që në anglisht përkthehet “besim te dikush”, “besim në dikë”, “besoj”.

■ **“ju, ju”** Këto janë të dyja në SHUMËS. Jezusi po u drejtohet të gjithë atyre që po qëndronin aty dhe, në njëfarë kuptimi, gjithë njerëzimit!

■ **“qiejt të hapur”** Kjo frazë ka tingëllim teofanik nga DhV.

1. Ezekieli, Ezek. 1:1
2. Jezusi, Mat. 3:16; Marku 1:10; Luka 3:21
3. Stefani, Veprat 7:56
4. Korneli, Veprat 10:11
5. Ardhja e dytë, Zbu. 19:11

Kjo është një PJESORE VEPRORE E KRYER që nënkupton se qiejt mbetën të hapur. Termi “qiejt” është në SHUMËS, pasi në hebraisht ky term është në SHUMËS. Ai mund të nënkuptojë (1) atmosferën mbi tokë, si te Zanafilla 1, ose (2) vetë praninë e Perëndisë.

TEMË E VEÇANTË: QIEJT

Në DhV, termi “qiell” zakonisht është në SHUMËS (pra, *shamajim*, BDB 1029). Kjo fjalë hebraisht do të thotë “lartësi”. Perëndia banon në lartësi. Ky koncept pasqyron shenjtërinë dhe transcendencën e Perëndisë.

Në Zan. 1:1, SHUMËSI “qiejt dhe toka” është marrë në kuptimin se Perëndia krijoi (1) atmosferën mbi këtë planet, ose (2) si mënyrë referimi për gjithë realitetin (pra, shpirtëror dhe fizik). Nga ky kuptim bazë, pasazhe të tjera citoheshin sikur u referoheshin niveleve të qiellit: “qielli i qiejve” (shih Psa. 68:33), ose “qielli dhe qielli i qiejve” (shih LiP. 10:14; 1 Mbre. 8:27; Neh. 9:6; Psa. 148:4). Rabinët hamendësonin se mund të kishte

1. dy qiej (p.sh., R. Judah; Hagigah 12b)
2. tre qiej (Test. Levi 2-3; Ngjitja e Isa. 6:-7; Midrash Tehillim për Psa. 114:1)
3. pesë qiej (III Barukut)
4. shtatë qiej (R. Simon b. Lakish; 2 Enokut 8; Ngjitja e Isa. 9:7)
5. dhjetë qiej (2 Enokut 20:3b; 22:1)

Të gjitha këto sinonin të tregonin veçimin e Perëndisë nga krijimi fizik dhe/ose transcendencën e tij. Numri më i zakonshëm i qiejve në judaizmin rabinik ishte shtatë. A. Cohen, *Everyman's Talmud* (f. 30), thotë se kjo lidhej me sferat astronomike, por unë mendoj se i referohet shtatës si numri i përsosur (pra, ditët e krijimit, ku shtata përfaqësonte pushimin e Perëndisë te Zan. 1).

Pali, në 2 Kor. 12:2, përmend qiellin “e tretë” (greqisht, *ouranos*) si mënyrë për të nënkuptuar praninë personale dhe madhështore të Perëndisë. Pali pati takim personal me Perëndinë!

■ **“engjëjt e Perëndisë që ngjiten e zbresin”** Ky është aludim për përjetimin e Jakobit në Betel (shih Zan. 28:10 e më tej). Jezusi po pohon se, ashtu si Perëndia premtoi se do t'i përmbushte të gjitha nevojat Jakobit, Perëndia po përmbushte dhe gjithë nevojat e Jezusit!

■ **“Biri i Njeriut”** Ky është termi që Jezusi zgjedh për veten. Ishte një frazë hebraike që nënkuptonte qenien njerëzore (shih Psa. 8:4; Ezek. 2:1). Por, për shkak të përdorimit të tij te Dan. 7:13, ky term mori cilësi hyjnore. Nuk kishte ngjyrimet nacionaliste apo militariste, pasi nuk përdorej nga rabinët. Jezusi e zgjodhi për shkak se ky term kombinonte dy aspektet e natyrës së tij (njerëzore dhe hyjnore, shih 1 Gjonit 4:1-3). Gjoni përmend Jezusin duke përdorur këtë term për veten trembëdhjetë herë.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse e pyet komiteti nga Jerusalemi Gjon Pagëzori nëse është një nga tre personazhet e Dhiatës së Vjetër?
2. Identifiko pohimin kristologjik që bën Gjon Pagëzori për Jezusin në vargjet 19-30.
3. Pse ndryshojnë kaq shumë ungjijtë sinoptikë nga Gjoni për thirrjen e dishepujve?
4. Çfarë kuptonin këta burra për Jezusin? Vini re titujt me të cilët e thërrasin (vargu 38).
5. Si e quajti Jezusi veten? Pse?

GJONI 2

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Dasma në Kanë 2:1-11	Uji kthehet në verë 2:1-12	Dasma në Kanë 2:1-11	Dasma në Kanë 2:1-3 2:4 2:5 2:6-10 2:11 2:12	Dasma në Kanë 2:1-10 2:11-12
2:12		2:12		
Pastrimi i tempullit 2:13-22	Jezusi pastron tempullin 2:13-22	Pastrimi i tempullit 2:13-22	2:13-17 2:18 2:19 2:20 2:21-22	Pastrimi i tempullit 2:13-22
Jezusi njih gjithë njerëzit 2:23-25	Dalluesi i zemrave 2:23-25	2:23-25	Njohja e natyrës njerëzore nga Jezusi 2:23-25	Jezusi në Jerusalem 2:23-25

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 2:1-11

- A. Jezusi ishte plotësisht ndryshe nga udhëheqësit e tjerë fetarë të kohës së vet. Ai hante dhe pinte me njerëzit e zakonshëm. Gjon Pagëzori ishte njeri i veçuar nga shkretëtira, ndërsa Jezusi ishte person publik me njerëzit e zakonshëm.
- B. Shenja e tij e parë ishte tejet shtëpiake, tejet familjare! Përkujdesja dhe preokupimi për njeriun e zakonshëm e karakterizojnë Jezusin, ndërsa zemërimi i tij ndaj fetaristëve që shpallnin veten të drejtë pasqyron anën tjetër të karakterit të tij. Përparësia e njerëzve, jo traditave apo ritualeve të detyrueshme, zbulon lirinë e Jezusit, por edhe nderimin e tij për pritshmëritë kulturore.
- C. Kjo ishte e para e shtatë shenjave që Gjoni përdor për të zbuluar karakterin dhe pushtetin e Jezusit (kapitujt 2-11).
 1. uji në verë (2:1-11)

2. shërimi i djalit (4:46-54)
3. shërimi i të paralizuarit (5:1-18)
4. ushqyerja e turmës (6:1-15)
5. ecja mbi ujë (6:16-21)
6. shërimi i të verbrit (9:1-41)
7. ringjallja e Llazarit (11:1-57)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:1-11

¹Ditën e tretë, u bë një dasmë në Kanë të Galilesë, dhe nëna e Jezusit ishte atje; ²edhe Jezusi me dishepujt e vet ishin ftuar në dasmë. ³Kur mbaroi vera, nëna e Jezusit i tha: “S’kanë verë”. ⁴Dhe Jezusi i tha: “Grua, ç’lidhje ka kjo me ne? Ora ime s’ka ardhur ende”. ⁵Nëna e tij u tha shërbëtorëve: “Çfarëdo t’ju thotë ai, bëjeni”. ⁶Aty ishin vendosur gjashtë enë uji prej guri për zakonin judaik të pastrimit; secili prej tyre mbante nga 70 deri në 100 litra. ⁷Jezusi u tha: “Mbushni enët me ujë”. Kështu, ata i mbushën deri në grykë. ⁸Dhe ai u tha: “Nxirrni ca tani dhe çojani të parit të dasmës”. Kështu, ata ia çuan. ⁹Kur i pari i dasmës shijoi ujin që ishte bërë verë, dhe nuk e dinte nga kishte ardhur (por e dinin shërbëtorët, të cilët kishin nxjerrë ujin), thirri dhëndrin ¹⁰dhe i tha: “Çdo njeri shërben verën e mirë të parën, pastaj kur njerëzit kanë pirë shumë, ai u shërben verën e keqe; por ti e ke ruajtur verën e mirë për tani!”. ¹¹Këtë fillim të shenjave të veta Jezusi e bëri në Kanë të Galilesë, dhe shfaqti lavdinë e vet, dhe dishepujt besuan në të.

2:1 “u bë një dasmë” Dasmat e fshatit ishin evenimente të rëndësishme shoqërore. Shpesh, aty përfshihej gjithë komuniteti dhe mund të zgjasnin me ditë të tëra.

■ **“Kanë”** Ky term përmendet vetëm në ungjillin e Gjonit (2:1, 11; 4:46; 21:2). Dimë disa gjëra për të.

1. vendlindja e Natanaelit
2. vendi i mrekullisë së parë të Jezusit
3. afër Kapernaumit

Ekzistojnë katër vendndodhje të hamendësuar (AB, vëll. 1, f. 827)

1. Ain Kana, vetëm 1.6 kilometra në veri të Nazaretit
2. Kafr Kanna, rreth 5 kilometra në verilindje të Nazaretit
3. Kirbet Kana, një vendndodhje arkeologjike 13.5 km në veri të Nazaretit, në një kodër
4. Kana në Pllajën e Asokit, e përmendur nga Jozefusi (*Jeta*, 86, 206).

Vendndodhja në pllajë duket se përputhet me emrin Kana, që në hebraisht do të thotë “kallam”.

■ **“nëna e Jezusit ishte atje”** Me sa duket, Maria po ndihmonte me përgatitjet e dasmës. Kjo mund të shihet nga fakti se (1) ajo urdhëron shërbëtorët (shih, v. 5) dhe (2) se shqetësohej për pijet (shih v. 3). Ka gjasa që atë të kenë qenë të afërm ose miq familjeje.

2:3 “Nuk kanë verë” Ishte zakon i detyrueshëm hebraik që të zotët e dasmës të siguronin verën. Duket se kjo verë ishte fermentuar, gjë që shihet në (1) komentin e të parit të dasmës, v. 9-10; (2) zakonet judaike të kohës së Jezusit; ose (3) nga mungesa e proceseve higjienike ose shtuesve kimikë.

TEMË E VEÇANTË: QËNDRIMET BIBLIKE NDAJ ALKOOLIT DHE ALKOOLIZMIT

I. Termat biblikë

A. Dhiata e Vjetër

1. *Jajin* – ky është term i përgjithshëm për verën (BDB 406), që përdoret 141 herë. Etimologjia e tij është e paqartë pasi nuk vjen nga një rrënjë hebraisht. Gjithmonë ka kuptimin “lëng fryti i fermentuar”, zakonisht nga rrushi. Disa pasazhe tipike janë Zan. 9:21; Eks. 29:40; Num. 15:5, 10.
2. *Tirosh* – Kjo është “verë e re” (BDB 440). Për shkak të kushteve klimatike të Lindjes së Afërt, fermentimi fillonte që gjashtë orë pas nxjerrjes së lëngut. Ky term i referohet verës në procesin e fermentimit. Për disa pasazhe tipike, shih LiP. 12:17; 18:4; Isa. 62:8-9; Os.

4:11.

3. *Asis* – Qartazi, këtu bëhet fjalë për pije alkoolike (“verë e ëmbël”, BDB 779, p.sh., Joeli 1:5; Isa. 49:26).
4. *Sekar* – ky term do të thotë “pije e fortë” (BDB 1016). Rrënja hebraisht përdoret në termin “i dehur” ose “pijanec”. Atij i shtohet diçka për ta bërë më dehës. Është fjalë paralele me *jajin* (shih Fja. 20:1; 31:6; Isa. 28:7).

B. Dhiata e Re

1. *Oinos* – fjala greqisht që është e barasvlershme me *jajin*
2. *Neos oinos* (verë e re) – fjala greqisht e barasvlershme me *tiros* (shih Marku 2:22).
3. *Gleukos oinos* (verë e ëmbël, *asis*) – verë në fazat e para të fermentimit (shih Veprat 2:13).

II. Përdorimi biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Vera është dhuratë nga Perëndia (Zan. 27:28; Psa. 104:14-15; Pred. 9:7; Os. 2:8-9; Joeli 2:19, 24; Amosi 9:13; Zak. 10:7).
2. Vera është pjesë e ofrimit flijues (Eks. 29:40; Lev. 23:13; Num. 15:7, 10; 28:14; LiP. 14:26; Gjyq. 9:13).
3. Vera përdoret si ilaç (2 Sam. 16:2; Fja. 31:6-7).
4. Vera mund të jetë problem i vërtetë (Noeu – Zan. 9:21; Loti – Zan. 19:33, 35; Samsoni – Gjyq. 16; Nabali – 1 Sam. 25:36; Uriahu – 2 Sam. 11:13; Amoni – 2 Sam. 13:28; Elahu – 1 Mbret. 16:9; Benhadadi – 1 Mbret. 20:12; Sundimtarët – Amosi 6:6; dhe Zonjat – Amosi 4).
5. Me verën mund të abuzohet (Fja. 20:1; 23:29-35; 31:4-5; Isa. 5:11, 22; 19:14; 28:7-8; Osea 4:11).
6. Vera iu ndalohej grupeve të caktuara (priftërinjve në detyrë, Lev. 10:9; Ezek. 44:21; naziritëve, Num. 6; dhe sundimtarëve, Fja. 31:4-5; Isa. 56:11-12; Osea 7:5).
7. Vera përdoret në kontekstin eskatologjik (Amosi 9:13; Joeli 3:18; Zak. 9:17).

B. Periudha ndërhyjëtare

1. Vera, me masë, është shumë e dobishme (*Ekleziasti* 31:27-30).
2. Rabinët thonë: “Vera është ilaçi më i shkëlqyer; aty ku vera mungon, atëherë nevojiten ilaçet” (BB 58b).

C. Dhiata e Re

1. Jezusi shndërroi një sasi të madhe uji në verë (Gjoni 2:1-11).
2. Jezusi piu verë (Mat. 11:18-19; Luka 7:33-34; 22:17 e më tej).
3. Pjetri u akuzua për dehje me “verë të re” në ditën e Rrëshajave (Veprat 2:13).
4. Vera mund të përdoret si ilaç (Marku 15:23; Luka 10:34; 1 Tim. 5:23).
5. Drejtuesit nuk duhet të jenë abuzues me verë. Kjo nuk do të thotë se duhet të mos pinë fare alkool (2 Tim. 3:3, 8; Titi 1:7; 2:3; 1 Pje. 4:3).
6. Vera përdoret në kontekste eskatologjike (Mateu 22:1 e më tej; Zbu. 19:9).
7. Dehja shihet me sy të keq (Mat. 24:49; Luka 12:45; 21:34; 1 Kor. 5:11-13; 6:10; Gal. 5:21; 1 Pje. 4:3; Rom. 13:13-14).

III. Mësime teologjike

A. Tensioni dialektik

1. Vera është dhuratë nga Perëndia.
2. Dehja përbën problem të madh.
3. Në disa kultura, besimtarët duhet t’i kufizojnë liritë e tyre për hir të ungjillit (Mat. 15:1-20; Marku 7:1-23; 1 Korintasve 8-10; Romakëve 14).

B. Prirja për t’i kaluar caqet e dhëna

1. Perëndia është burimi i të gjitha gjërave të mira.
2. Njerëzimi i rënë ka abuzuar me të gjitha dhuratat e Perëndisë duke i çuar përtej kufijve të caktuar nga Perëndia.

C. Abuzimi është faji ynë, jo i gjërave. Nuk ka asgjë të keqe në krijimin fizik (shih Marku 7:18-23; Rom. 14:14, 20; 1 Kor. 10:25-26; 1 Tim. 4:4; Titi 1:15).

IV. Kultura dhe fermentimi judaik në shekullin e parë

A. Fermentimi fillon shumë herët, rreth 6 orë pasi është shtypur rrushi.

B. Tradita judaike thotë se, kur në sipërfaqe shfaqet një shkumë e lehtë (shenjë e fermentimit), ajo

duhet t'f nënshtrohet të dhjetave të verës (*Maaseroth* 1:7). Quhet “verë e re” ose “verë e ëmbël”.

- C. Fermentimi i parë i fortë përfundonte pas një jave.
 - D. Fermentimi dytësor kërkonte rreth 40 ditë. Në këtë fazë, konsiderohej “verë e vjetruar” dhe mund të ofrohej në altar (*Edhujjoth*, 6:1).
 - E. Vera që kishte pushuar mbi llumin e vet (vera e vjetër) konsiderohej e mirë, por duhej kulluar mirë përpara përdorimi.
 - F. Vera konsiderohej e vjetruar sa duhet zakonisht pas një viti fermentimi. Tre vite ishte periudha më e gjatë kohore që vera mund të magazinohet e sigurt. Ajo quhej “verë e vjetër” dhe duhej holluar me ujë.
 - G. Vetëm në 100 e fundit është arritur të vonohet periudha e fermentimit, për shkak të mjedisit steril dhe kimikateve të shtuara. Bota e lashtë nuk e ndalonte dot procesin e natyrshëm të fermentimit.
- V. Pohime përmbyllëse
- A. Sigurohu që përvoja, teologjia dhe interpretimi yt biblik të mos nënvlerësojë Jezusin dhe kulturën judaike/të krishterë të shekullit të parë! Është e qartë se ata nuk ishin njerëz që s'pinin fare alkool.
 - B. Nuk po mbroj përdorimin shoqëror të alkoolit. Megjithatë, shumë vetë e kanë ekzagjeruar pozicionin e Biblës për këtë temë dhe, tani, pretendojnë drejtësi më të lartë për shkak të anshmërisë së tyre kulturore/denominacionale.
 - C. Për mendimin tim, Romakëve 14 dhe 1 Korintasve 8-10 na sigurojnë mësimet dhe udhëzime të bazuara në dashurinë dhe respektin për bashkëbesimtarët dhe për përhapjen e ungjillit në kulturën tonë, dhe jo liri vetjake apo kritika plot gjykim. Nëse Bibla është i vetmi burim për besimin dhe praktikën, atëherë, ndoshta të gjithë ne duhet ta mendojmë nga e para këtë çështje.
 - D. Nëse themi se mospirja absolute e alkoolit është vullneti i Perëndisë, çfarë po themi për Jezusin, si dhe për ato kultura që përdorin rregullisht verë (p.sh., Evropa, Izraeli, Argjentina)?

2:4 “Grua” Në shqip, kjo tingëllon e ashpër, por ishte term hebraisht, titull respekti (shih 4:21; 8:10; 19:26; 20:15).



NASB “ç’lidhje ka kjo me ne?”

NKJV “ç’lidhje ka shqetësimi yt me mua?”

NRSV “pse duhet të shqetësohemi ne të dy për këtë?”

TEV “Mos më thuaj se ç’të bëj”

NJB “Ç’do prej meje?”

Kjo është shprehje hebraike, që fjalë për fjalë do të thotë “çfarë për mua dhe për ty” (shih Gjyq. 11:12; 2 Sam. 16:10; 19:22; 1 Mbret. 17:18; 2 Mbret. 3:13; 2 Kor. 35:21; Mat. 8:29; Marku 1:24; 5:7; Luka 4:34; 8:28; Gjoni 2:4). Ka gjasa që ky të ketë qenë fillimi i marrëdhënies së re të Jezusit me familjen e vet (shih Mat. 12:46 e më tej; Luka 11:27-28).

■ **“ora ime s’ka ardhur ende”** Kjo tregon vetëndërgjegjësimin e Jezusit për synimin që i ishte caktuar (shih Marku 10:45). Gjoni e përdor termin “orë” në mënyra të ndryshme.

1. për kohën (shih 1:39; 4:6, 52, 53; 11:9; 16:21; 19:14; 19:27)
2. për fundin e kohës (shih 4:21, 23; 5:25, 28)
3. për ditët e fundit të Jezusit (arrestimi, gjyqet, vdekja, shih 2:4; 7:30; 8:20; 12:23, 27; 13:1; 16:32; 17:1)

2:5 “Çfarëdo t’ju thotë ai, bëjeni” Maria nuk mendoi se përgjigjja e Jezusit përjashtonte plotësisht faktin se ai do të vepronte për hir të saj në këtë situatë.

2:6

NASB “për zakonin judaik të pastrimit”

NKJV “sipas mënyrës së pastrimit”

NRSV “për ritet judaike të pastrimit”

TEV “judenjtë kanë rregulla për pastrimin ritual”

NJB “për larjet që ishin rregull ndër judenjtë”

Këto enë uji përdorshin për larjet ceremoniale të këmbëve, duarve, enëve, etj. Gjoni e bën këtë koment për të ndihmuar johebrenjtë që të kuptojnë kontekstin.

2:6-7 “gjashtë enë uji prej guri” Siç ndodh shpesh te Gjoni, kjo duket se është një shenjë me synime të dyfishta.

1. për të ndihmuar çiftin që martohej
2. në fund fare, ishte shenjë që tregonte drejt Jezusit si përmbushja e judaizmit. Arsyet pas këtij pohimi të fundit mund të jenë
 - a. numri “6” është simbol i përpjekjeve njerëzore
 - b. kërkesa e Jezusit që t’i mbushnin deri në grykë duket se ka kuptim simboli, dhe jo thjesht që t’u sigurojë më tepër verë
 - c. sasia e stërmadhe e verës, që ishte tejet e tepërt për një festë dasme për fshatin
 - d. vera ishte simbol i bollëkut në epokën e re (shih Jer. 31:12; Os. 2:22; 14:7; Joeli 3:18; Amosi 9:12-14).

■ **“secila prej tyre mbante nga 70 deri në 100 litra”** Masa e përdorur ishte termi hebraisht *bath*. Në kohën e Jezusit përdorshin tre masa të ndryshme *bath*-i, kështu që sasia është e paqartë, por kjo mrekulli përfshiu një sasi të stërmadhe uji!

TEMË E VEÇANTË: PESHAT DHE VËLLIMET (METROLOGJIA) NË LINDJEN E AFËRT NË LASHTËSI

Peshat dhe masat që përdorshin në tregti ishin jetike për ekonominë e lashtë bujqësore. Bibla nxit judenjtë që të jenë të ndershëm në shitblerjet me njëri-tjetrin (shih Lev. 19:35-36; LiP. 25:13-16; Fja. 11:1; 16:11; 20:10). Problemi i vërtetë nuk ishte vetëm ndershmëria, por edhe termet e sistemet e pastandardizuara që përdorshin në Palestinë. Me sa duket, kishte dy lloje peshash; një “e lehtë” dhe një “e rëndë” për çdo masë (shih *The Interpreter’s Dictionary of the Bible*, vëll. 4, f. 831). Po kështu, sistemi dhjetor (me bazë 10) i Egjiptit ishte kombinuar me atë gjashtor (me bazë 6) të Mesopotamisë.

Shumë prej “masave” dhe “sasive” të përdorura bazoheshin në gjymtyrët njerëzore, barrët e kafshëve dhe enët e fermerëve, dhe asnjëra prej tyre nuk ishte standardizuar. Si rrjedhojë, grafikët e mëposhtëm janë vetëm vlerësime të përafërta dhe hamendësime. Mënyra më e lehtë për të treguar peshat dhe masat është me anë të një grafiku që i krahason me njëra-tjetrën.

I. Termet vëllimorë që përdorshin më shpesh

A. Masat e thata

1. Homer (BDB 330, ndoshta “barrë gomari”, BDB 331), p.sh., Lev. 27:16; Osea 3:2
2. Letekh (ose letheekh, BDB 547, ndoshta e aluduar në Osea 3:2)
3. Efa (BDB 35), p.sh., Eks. 16:36; Lev. 19:36; Ezek. 45:10-11, 13, 24
4. Se’*a* (BDB 684), p.sh., Zan. 18:6; 1 Sam. 25:18; 1 Mbret. 18:32; 2 Mbret. 7:1, 16, 18
5. Omer (BDB 771 II, ndoshta “kapule” [një radhë gruri i rënë], BDB 771 I), p.sh., Eks. 16:16, 22, 36; Lev. 23:10-15.
6. „Issaron (BDB 798, “një e dhjeta” e efës), p.sh., Eks. 29:40; Lev. 14:21; Num. 15:4; 28:5, 13.
7. Kav (or Kab, BDB 866), shih 2 Mbret. 6:25

B. Masat e thata

1. Kor (BDB 499), p.sh., Ezek. 45:14 (mund të jetë masë e thatë, shih 2 Kro. 2:10; 27:5)
2. Bath (BDB 144 II), p.sh., 1 Mbret. 7:26, 38; 2 Kro. 2:10; 4:5; Isa. 5:10; Ezek. 45:10-11, 14
3. Hin (BDB 228), p.sh., Eks. 29:40; Lev. 19:36; Ezek. 45:24
4. Log (BDB 528), shih Lev. 14:10, 12, 15, 21, 24

C. Grafik (i marrë nga Roland deVaux, *Ancient Israel*, vëll. 1, f. 201 dhe *Encyclopedia Judaica*, vëll. 16, f. 379)

homer (i thatë) = kor (i lëngët ose i thatë)	1			
efa (i thatë) = bath (i lëngët)	10	1		
se’ <i>a</i> (i thatë)	30	3	1	
hin (i lëngët)	60	6	2	1

omer/issaron (i thatë)	100	10	-	-	1		
kav/kab (i thatë)	180	18	6	3	-	1	
log (i lëngët)	720	72	24	12	-	4	1

II. Termat e peshës që përdoren më shpesh

A. Tri peshat më të përdorura janë talenti, shekeli dhe gera.

1. Pësia më e rëndë në DhV është talenti. Nga Eks. 38:25-26 mësojmë se një talent ishte baras me 3,000 shekelë (pra, “peshë e rumbullakosur”, BDB 503).
2. Termi shekel (BDB 1053, “peshë”) përdoret kaq shpesh saqë nënkuptohet, por nuk shprehet në tekst. Ka një sërë vlerash shekeli që përmenden në DhV.
 - a. “standardi tregtar” (NASB, Zan. 23:16)
 - b. “shekeli i shenjtërores” (NASB, Eks. 30:13)
 - c. “sipas peshës së mbretit” (NASB, 2 Sam. 14:26), e quajtur edhe “pësia mbretërore” në papiruset Elefantine.
3. Gera (BDB 176 II) vlerësohet në 20 të tilla për shekel (shih Eks. 30:13; Lev. 27:25; Num. 3:47; 18:16; Ezek. 45:12). Këto raporte ndryshojnë nga Mesopotamia në Egjipt. Izraeli ndiqte vlerësimin më të përhapur në Kanaan (Ugarit).
4. Mina (BDB 584) vlerësohet në 50 ose 60 shekelë. Ky term përdoret kryesisht në librat e mëvonshëm të DhV (p.sh., Ezek. 45:12; Esdra 2:69; Neh. 7:71-72). Ezekieli përdorte raportin 60 me 1, ndërsa Kanaani përdorte raportin 50 me 1.
5. Beka (BDB 132, “gjysmë shekeli”, shih Zan. 24:22) përdoret vetëm dy herë në DhV (shih Zan. 24:22; Eks. 38:26) dhe vlerësohet sa gjysma e një shekeli. Emri i saj do të thotë “ndaj”.

B. Grafik

1. Bazuar në Pentatukun

talent	1				
mina	60	1			
shekel	3,000	50	1		
beka	6,000	100	2	1	
gera	60,000	1,000	20	10	

2. Bazuar te Ezekieli

talent	1				
mina	60	1			
shekel	3,600	60	1		
beka	7,200	120	2	1	
gera	72,000	1,200	20	10	1

2:8

NASB “i pari i dasmës”

NKJV “kryesuesi i dasmës”

NRSV “kryeshërbëtori”

TEV “njeriu që organizonte festën”

NJB “kryesuesi i festës”

Ky person mund të ketë qenë, ose (1) një i ftuar i nderuar që ishte në krye të festës, ose (2) një skllav që kishte si detyrë t’u shërbente të ftuarve.

2:10 Ideja është se, rëndom, vera më e mirë shërbehet në fillim. Pasi dasmorët vinin nën efektin e saj, shërbehet një gradë vere më e dobët. Por, këtu, më e mira u shërbye në fund! Kjo duket se tregon një kontrast mes besëlidhjes së vjetër (vera e vjetër) në judaizëm dhe besëlidhjes së re (vera e re) në Jezusin (shih librin e Hebrenjve). Pastrimi i tempullit nga Jezusi (shih 2:13-25, me sa duket, i vendosur jashtë radhës kronologjike nga Gjoni për synime teologjike) ndoshta simbolizon këtë të vërtetë.

2:11 “Këtë fillim të shenjave të veta” Ungjilli i Gjonit është ndërtuar rreth shtatë shenjash dhe interpretimit të tyre. Kjo është e para. Shih Tema e Veçantë: *Archē*, te vargu 1:1.

■ “dhe shfaqti lavdinë e vet, dhe dishepujt e tij besuan në të” Shfaqja (shih shënimin për FOLJEN në 1:31) e lavdisë së Jezusit (shih Tema e Veçantë, te 1:14) ishte synimi i kësaj mrekullisë/ve. Kjo mrekulli, si shumë të tjera, dukej se u drejtohej pikësëpari dishepujve të tij! Këtu nuk bëhet fjalë për veprimin e tyre fillestar të besimit, por për të kuptuarit e vazhdueshëm të personalitetit dhe veprës së tij. Shenjat zbulojnë personalitetin dhe veprën e vërtetë të Mesisë. Është e paqartë nëse dasmorët e morën vesh ndonjëherë atë që ndodhi.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:12

¹²Pas kësaj, ai zbriti në Kapernaum, bashkë me të ëmën, vëllezërit dhe dishepujt e tij; dhe qëndruan aty pak ditë.

2:12 “Kapernaum” Pas mosbesimit të Nazaretit (shih Luka 4:16-30) kjo u bë qendra e Jezusit në Galile (shih Mat. 4:13; Marku 1:21; 2:1; Luka 4:23, 31; Gjoni 2:12; 4:46-47).

■ Ky është një vështrim unik për shërbesën e Jezusit ndaj familjes së vet, në dritën e kësaj mrekullie në Kanë.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 2:13-25

A. Ka patur shumë diskutime ndër studiuesit e DhR se sa herë e pastroi Jezusi tempullin. Gjoni e regjistron pastrimin shumë herët në shërbesën e Jezusit, ndërsa ungjijtë sinoptikë (Mat. 21:12; Marku 11:15 dhe Luka 19:45) përshkruajnë një pastrim që ndodh gjatë javës së fundit të jetës së Jezusit. Bazuar në dallimet mes këtyre dy rrëfimeve, mund të kenë ndodhur, jo një, po dy pastrime të tempullit.

Megjithatë, është pa dyshim e mundur që Gjoni po i strukturon veprimet e Jezusit për qëllime teologjike (pra, Gjoni thekson natyrën e plotë hyjnore të Jezusit që nga kapitulli 1). Secili nga shkrimtarët e ungjijve kishte lirinë që, nën frymëzim, të përzgjidhte, të përshtaste, të rendiste dhe të përmbledhonte veprimet dhe mësimet e Jezusit. Nuk besoj se kishin lirinë që të vinin fjalë të pathëna në gojën e Jezusit apo të shpiknin ngjarje. Duhet të mos harrojmë se ungjijtë nuk janë biografi moderne, por trakte ungjillëzuese që synonin lexues të caktuar. Ungjijtë nuk janë kronologjikë, as nuk regjistrojnë fjalët e Jezusit një për një (më tepër, janë si përmbledhje). Kjo nuk nënkupton se janë të pasaktë. Letërsia lindore bazohej në pritshmëri të ndryshme kulturore nga letërsia perëndimore. Shih Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How To Read the Bible for All Its Worth*, f. 127-148.

B. Pastrimi i tempullit përputhet me synimin e përgjithshëm teologjik të Jezusit, sipas të cilit Jezusi merret së pari me kombin jude. Kjo mund të shihet në diskutimin e tij me Nikodemin në kapitullin 3 (judaizmi ortodoks). Sidoqoftë, në kapitullin 4, Jezusi fillon të merret me një grupim më të gjerë (madje, me një grup heretik të judaizmit sektar), duke ia nisur me një grua samaritane.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:13-22

¹³Pashka e judenjve ishte afër, dhe Jezusi u ngjiti në Jerusalem. ¹⁴Në tempull, gjeti ata që po shisnin qe, dele dhe pëllumba, ndërsa këmbyesit e parave ishin ulur në tryezat e tyre. ¹⁵Ai bëri një kamxhik me litarë dhe i dëboi të gjithë nga tempulli, bashkë me delet dhe qetë; po kështu, derdhi monedhat e këmbyesve të parave dhe ua përmbysi tryezat; ¹⁶dhe atyre që po shisnin pëllumba u tha: “Hiqni këto gjëra që këtej; mjaft e bëtë shtëpinë e Atit tim vend tregtie”. ¹⁷Dishepujve të tij iu kujtua që ishte shkruar: “Zelli PËR SHTËPINË TËNDE MË PËRPIN”. ¹⁸Atëherë, judenjtë i thanë: “Çfarë shenje na tregon për autoritetin tënd, që po i bën këto gjëra?” ¹⁹Jezusi iu përgjigj: “Shkatërroni këtë tempull dhe për tri ditë do ta ngre përsëri”. ²⁰Atëherë, judenjtë i thanë: “U deshën dyzet e gjashtë vjet që të ndërtohej ky tempull, ndërsa ti do ta ngrësh për tri ditë?” ²¹Por ai po fliste për tempullin e trupit të vet. ²²Kështu, pasi u ringjall nga vdekja, dishepujve të tij iu kujtua që kishte thënë kështu; dhe i besuan Shkrimet dhe fjalës që kishte thënë Jezusi.

2:13 “Pashka” Kjo festë e përvitshme përshkruhet te Eksodi 12 dhe LiP. 16:1-6. Kjo festë është e vetmja mënyrë që kemi për të datuar shërbesën e Jezusit. Ungjijtë sinoptikë lënë të kuptohet se Jezusi shërbeu për vetëm një vit (pra, përmendet një Pashkë). Kurse Gjoni përmend tre Pashkë: (1) 2:13, 23; (2) 6:4 dhe (3) 11:55; 12:1; 13:1; 18:28, 39; 19:14. Ekzistoi dhe mundësia e një Pashke të katërt në 5:1. Nuk e dimë se zgjati shërbesa aktive

publike e Jezusit, por ungjilli i Gjonit lë të kuptohet se zgjati të paktën tri vjet, ose, mundësisht, edhe katër ose pesë.

Gjoni e strukturoi ungjillin e vet rreth festave të judenjve (Pashkët, Çadrat dhe Hanuka, shih Richard N. Longenecker, *Biblical Exegesis in the Apostolic Period*, bot. i 2, f. 135-139).

TEMË E VEÇANTË: PASHKA

- I. Vërejtje hyrëse
 - A. Ky akt gjykimi hyjnor i egjiptianëve dhe çlirimi i Izraelit është gur prove i dashurisë së JHVH-së për Izraelin dhe themelimin e tij si komb (p.sh., sidomos për Profetët)
 - B. Eksodi ishte përmbushje e veçantë e premtimit që JHVH i kishte dhënë Abrahamit në Zan. 15:12-21. Pashka përkujton eksodin.
 - C. Ky është dënimi i fundit, më i përhapur (gjeografikisht, pra në Egjipt dhe në Goshen) dhe më shkatërrimtari (u vranë të parëlindurit e njerëzve dhe bagëtive) nga dhjetë dënimet që dërgoi JHVH mbi Egjipt përmes Moisiut.

- II. Vetë termi (BDB 820, KB 947)
 - A. Kuptimi i EMRIT është i paqartë
 1. lidhet me “goditjen”, pra, “godas me grusht” (shih, Eks. 11:1); engjëlli i JHVH-së godet të parëlindurit e njerëzve dhe bagëtive
 - B. Kuptimi i FOLJES
 1. “çaloj” ose “ec çalë-çalë” (shih 2 Sam. 4:4), e përdorur në kuptimin “kërcej mbi shtëpitë e shënuara” (shih, Eks. 12:13, 23, 27, BDB 619, etimologji e përhapur)
 2. “kërcej” (shih 1 Mbret. 18:21)
 3. akadisht – “qetësoj”
 4. egjiptiane – “godas” (shih A. 1.)
 5. FOLJE paralele në Isa. 31:5, “rri si roje mbi diçka” (shih REB Eks. 12:13)
 6. Lojë tingujsh e njohur për të krishterët e hershëm, mes fjalës *pasah* në hebraisht dhe fjalës greke *paschō*, “vuaj”
 - C. Precedentë të mundshëm historikë
 1. Flijim barinjsh për vitin e ri
 2. Flijim beduniësh dhe darkë kolektive për të larguar syrin e keq në kohën e lëvizjes së çadrave drejt kullotave pranverore
 3. Flijim për të larguar syrin e keq nga populli nomad
 - D. Arsytet pse është kaq e vështirë të jemi të sigurt për kuptimin e vetë fjalës, por edhe për fillesat e saj, është se në rituale të tjera të lashta gjenden shumë tipare të ndryshme të Pashkës.
 1. Koha e pranverës
 2. Etimologjia e paqartë e EMRIT
 3. Lidhet me rojet e natës
 4. Përdorimi i gjakut
 5. Simbolizmi i engjëjve/demonëve
 6. Vakti i veçantë
 7. Elementet bujqësore (buka pa maja)
 8. S’ka priftërinj, as altar, por një fokus lokal

- III. Evenimenti
 - A. Vetë evenimenti jepet te Eksodi 11-12.
 - B. Festa vjetore përshkruhet te Eksodi 12 dhe kombinohet si festë me tetë ditë së bashku me Festën e të Ndormeve.
 1. në fillim, ishte eveniment lokal, shih Eks. 12:21-23; LiP. 16:5 (shih Numrat 9)
 - a. pa prift
 - b. pa altar të veçantë
 - c. përdorime të specializuara gjaku
 2. u bë eveniment në faltoren qendrore
 3. ky kombinim i një flijimi lokal (pra, gjaku i qengjit për të përkujtuar kalimin e engjëllit të

vdekjes) me një festë të korrash në shenjtëroren qendrore u arrit nga afërsia e ngushtë e datave *Abib* ose *Nisan* 14 dhe 15-21.

- C. Pronësia simbolike e gjithë të parëlindurve të njerëzve dhe bagëtive, si dhe shpengimi i tyre, përshkruhet te Eksodi 13

IV. Rrëfimet historike të kremtimit të saj

- A. Pashka e parë u kremtua në Egjipt, Eksodi 12
B. Në Malin Horeb/Sinai, Numrat 9
C. Pashka e parë u kremtua në Kanaan (Gilgal), Joz. 5:10-12
D. Në kohën e përkushtimit të tempullit nga Solomoni, 1 Mbret. 9:25 dhe 2 Kro. 8:12 (ndoshta, por nuk thuhet në mënyrë të veçantë)
E. Ajo në kohën e mbretërimit të Ezekias, 2 Kron. 30
F. Ajo gjatë reformave të Josisë, 2 Mbret. 23:21-23; 2 Kro. 35:1-18
G. Vini re se 2 Mbret. 23:22 dhe 2 Kro. 35:18 përmendin neglizhimin që i bën Izraelit kremtimit të kësaj feste vjetor

V. Vlera e saj

- A. Kjo është një nga tre ditët e detyrueshme të festave (shih Eks. 23:14-17; 34:22-24; LiP. 16:16):
1. Pashka/Buka e Ndorme
2. Festa e Javëve
3. Festa e Çadrave
B. Moisiu parashikon ditën kur Pashka do të kremtohet në shenjtëroren qendrore (si dy festat e tjera) në Ligjin e Përtërirë.
C. Jezusi përdori rastin e darkës vjetore të Pashkës (ose ditën para saj) për të zbuluar Besëlidhjen e Re në simbolin e bukës dhe verës, por nuk përdori qengjin:
1. darka kolektive
2. flijimi shpengues
3. vlera e vazhdueshme për brezat e mëvonshëm

■ **“dhe Jezusi u ngjiti në Jerusalem”** Judenjtë flisnin gjithmonë për Jerusalem më tepër në këtë kuptim teologjik sesa në kuptimin gjeografik ose topografik.

2:14 “në tempull” Tempulli i Herodit të Madh (një idumeas, që jetoi në Palestinë nga 37-4 para K.) ishte ndarë në shtatë oborre të ndryshme. Oborri i jashtëm ishte Oborri i Johebrenjve, ku tregtarët kishin vendosur dyqanet me qëllim që t’u shërbenin atyre që donin të ofronin flijime dhe të sillnin ofrime të veçanta.

■ **“qe, dele dhe pëllumba”** Njerëzit që vinin nga rrugë e largët kishin nevojë të blinin kafshë të pranueshme për flijim. Mirëpo këto dyqane ishin nën kontrollin e familjes së kryepriiftit, e cila u vinte çmime të kripura kafshëve. Dimë gjithashtu se, nëse njerëzit sillnin vetë kafshë në tempull, priftërinjtë u thoshin se ishin të skualifikuara për shkak të ndonjë mangësie fizike. Si rrjedhojë, u duhej t’i blinin kafshët nga këta tregtarë.

■ **“këmbyesit e parave”** Ka dy shpjegime për nevojën për këta persona: (1) e vetmja monedhë që pranonte tempulli ishte shekeli. Meqë shekeli jude nuk pritej më si monedhë, tempulli pranonte vetëm shekelin nga Tiri në kohën e Jezusit, ose (2) nuk lejohej asnjë monedhë që mbarnte shëmbëlltyrën e një perandori romak. Sigurisht, për këtë paguhej një komision!

2:15 “Ai bëri një kamxhik me litarë dhe i dëboi të gjithë nga tempulli” Në këtë rrëfim shihet qartë zemërimi i Jezusit. Vendi ku mund të njihej JHVH nuk ishte më vend adhurimi dhe zbulese! Zemërimi, në vetvete, nuk është mëkat! Pohimi i Palit te Efë. 4:26 ndoshta me këtë veprim lidhet. Ka disa gjëra që duhet të na zemërojnë.

2:16 “Hiqni këto gjëra që këtej” Kjo është një URDHËRORE AORISTE VEPRORE: “nxirrni këtej këto gjëra!”

■ **“mjafit e bëtë shtëpinë e Atit tim vend tregtie”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME me një PJESËZ MOHORE, që zakonisht nënkuptonte ndalimin e një veprimi tashmë në proces e sipër. Ungjijtë e tjerë (p.sh., Mat.

21:13; Marku 11:17; Luka 19:46) citojnë Isa. 56:7 dhe Jer. 7:11; por te Gjoni këto profeci të DhV nuk përmenden. Ky mund të jetë një aludim i mundshëm për profecinë mesianike të Zak. 14:21.

2:17 “dishepujve të tij iu kujtua” Ky pohim nënkupton se, edhe në dritën e shërbesës së Jezusit dhe ndihmës së Frymës, këta burra e panë të vërtetën shpirtërore të veprimeve të Jezusit vetëm më vonë (shih v. 22; 12:16; 14:26).

■ **“se ishte shkruar”** Kjo është një PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE që, fjalë për fjalë, do të thotë “qëndron e shkruar”. Ishte mënyrë tipike për të pohuar frymëzimin e DhV (shih 6:31, 45; 10:34; 12:14; 20:30). Ky është citim nga Psa. 69:9 në LXX. Ky Psalm, ashtu si Psalmi 22, përputhet me kryqëzimin e Jezusit. Zelli i Jezusit për Perëndinë dhe adhurimin e tij të vërtetë do të çonte në vdekjen e tij, e cila ishte vullneti i Perëndisë (shih Isa. 53:4, 10; Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28).

2:18

NASB “Çfarë shenje na tregon për autoritetin tënd, që po i bën këto gjëra”

NKJV “Çfarë shenje na tregon, meqë po bën këto gjëra?”

NRSV “Çfarë shenje mund të na tregosh, që po bën këto gjëra”

TEV “Çfarë mrekulli mund të kryesh për të na treguar se ke të drejtë ta bësh këtë”

NJB “Çfarë shenje mund të na tregosh pse vepron në këtë mënyrë”

Kjo ishte pyetja qendrore që kishin judenjtë për Jezusin. Farisenjtë pretendonin se fuqia e tij vinte nga djalli (shih 8:48-49, 52; 10:20). Ata po prisnin që Mesia të bënte disa gjëra të caktuara në mënyra të caktuara. Kur nuk i kreu këto veprime të veçanta, filluan të dyshonin për të (shih Marku 11:28; Luka 20:2), siç bëri dhe Gjon Pagëzori.

2:19 “Shkatërroni këtë tempull dhe për tri ditë do ta ngre përsëri” Fjala greqisht për tempullin (*hieron*) në v. 14 dhe 15 i referohet zonës së tempullit, ndërsa termi *naos* në v. 19, 20 dhe 21 i referohet vetë shenjtërores së brendshme. Ka patur shumë diskutime për këtë pohim. Qartazi, te Mat. 26:60 e më tej; Marku 14:57-59; Veprat 6:14, kjo i referohet kryqëzimit dhe ringjalljes së Jezusit. Gjithsesi, në këtë kontekst, duhet të ketë njëfarë lidhjeje me shkatërrimin e vetë tempullit në vitin 70 pas K. nga Titi (shih Mat. 24:1-2). Këto dy pohime lidhen me të vërtetën se Jezusi po ngrinte një adhurim të ri shpirtëror i cili fokusohet te vetë Jezusi, dhe jo te judaizmi i lashtë (shih 4:21-24). Sërish, Gjoni përdor një fjalë në dy kuptime!

2:20 “U deshën dyzet e gjashtë vjet që të ndërtohej ky tempull” Herodi i Madh e zgjeroi dhe rimodeloi tempullin e dytë (nga koha e Zerubabelit, shih Hagai), në përpjekje për të qetësuar judenjtë për faktin se ai ishte idumeas. Jozefusi na thotë se kjo filloi në vitin 20 ose 19 para K. Nëse kjo është e saktë, do të thotë se ky incident i caktuar ndodhi në vitin 27-28 pas K. Po kështu, dimë se puna në tempull vazhdoi deri në vitin 64 pas K. Ky tempull ishte bërë shpresa e madhe e judenjve (shih Jeremia 7). Ai do të zëvendësohet nga vetë Jezusi, Tempulli i ri. Në 1:14, Jezusi pasqyrohet si tabernakulli, ndërsa, tani, si tempulli! Ç’metafora tronditëse për një zdrukthëtar nga Nazareti! Perëndia dhe njerëzimit tani takohen me njërit-tjetrin dhe kanë bashkësi në Jezusin!

2:21 “Por ai po fliste për tempullin e trupit të vet” Në kohën që Jezusi tha këto fjalë, dishepujt nuk e kuptuan (shih v. 17). Mos harroni se Gjoni po shkruan dekada më vonë.

Jezusi e dinte pse erdhi. Duket se ka të paktën tri synime.

1. për të zbuluar Perëndinë
2. për të dhënë modelin e njerëzimit të vërtetë
3. për të dhënë jetën e vet si shpengim për shumë njerëz

Pikërisht synimit të fundit i përgjigjet ky varg (shih Marku 10:45; Gjoni 12:23, 27; 13:1-3; 17:1).

2:22 “dishepujve të tij iu kujtua që kishte thënë kështu” Shpesh, fjalët dhe veprimet e Jezusit ishin më tepër për dobinë e dishepujve sesa për njerëzit që u drejtohej. Ata nuk e kuptonin gjithmonë për momentin.

■ **“i besuan Shkrimin”** Ndonëse vetë pasazhi nuk shprehet se për ç’Shkrim bëhet fjalë, ndoshta Psa. 16:10 është vargu i ringjalljes për të cilin po aludon Jezusi (shih Veprat 2:25-32; 13:33-35). Po ky pasazh (ose koncept teologjik – ringjallja) përmendet edhe te Gjoni 20:9.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:23-25

²³Ndërsa ai ishte në Jerusalem për Pashkë, gjatë festës, shumë besuan në emrin e tij, duke vëzhguar shenjat që po bënte ai. ²⁴Por vetë Jezusi nuk u zinte besë atyre, sepse i njilhte të gjithë njerëzit, ²⁵dhe sepse nuk kishte nevojë që dikush t'i dëshmonte për njeriun, sepse ai vetë e dinte se ç'kishte brenda njeriut.

2:23 “shumë besuan në emrin e tij” Termi “besuan” vjen nga fjala greke (*pisteō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim” ose “siguri besimi”. Si EMËR nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në këtë kontekst, ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të fjalës “besoj” janë Gjoni 8:31-59 dhe Veprat 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër se një reagim fillestar. Ai duhet vijuar nga një proces dishepullizimi (shih Mat. 13:20-22, 31-32).

Me sa duket, këta besimtarë sipërfaqësorë tërhiqeshin nga Jezusi për shkak të mrekullive të tij (shih 2:11; 7:31). Synimi i këtyre mrekullive ishte të vërtetonin personalitetin dhe veprën e Jezusit. Mirëpo duhet vërejtur se besimi në veprat e fuqishme të Jezusit nuk ishte kurrë besim i mjaftueshëm dhe i qëndrueshëm (shih 4:38; 20:29). Objekti i besimit duhet të jetë vetë Jezusi. Mrekullitë nuk janë automatikisht shenjë e Perëndisë (shih Mat. 24:24; Zbu. 13:13; 16:14; 19:20). Veprat e Jezusit synonin t'i çonin njerëzit në besim tek ai (shih 2:23; 6:14; 7:31; 10:42); shpesh njerëzit shihnin shenjë, por refuzonin të besonin (shih 6:27; 11:47; 12:37).

TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I FOLJES “BESOJ” NGA GJONI (EMRI është i rrallë)

Kryesisht, Gjoni e kombinon foljen “besoj” me një PARAFJALË

1. *Eis* do të thotë “brenda”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vendosin besimin/bindjen e tyre në Jezusin
 - a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjoni 5:13)
 - b. në të (Gjoni 2:11; 3:15,18; 4:39; 6:40; 7:5,31,39,48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45,48; 12:37,42)
 - c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25,26; 12:44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20)
 - d. në atë që ai ka dërguar (Gjoni 6:28-29)
 - e. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjoni 5:10)
 - f. në Jezusin (Gjoni 12:11)
 - g. në Dritën (Gjoni 12:36)
 - h. në Perëndinë (Gjoni 12:44; 14:1)
2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15 (Marku 1:15)
3. RASA DHANORE, pa PARAFJALË (Gjoni 4:50; 1 Gjoni 3:23; 5:10)
4. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, jep përmbajtjen e asaj që duhet besuar. Disa shembuj janë
 - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (6:69)
 - b. Jezusi është Unë Jam-i (8:24)
 - c. Jezusi në Atin dhe Ati në të (10:38)
 - d. Jezusi është Krishti (11:27; 20:31)
 - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (11:27; 20:31)
 - f. Jezusi u dërgua nga Ati (11:42; 17:8, 21)
 - g. Jezusi është një me Atin (14:10-11)
 - h. Jezusi erdhi nga Ati (16:27, 30)
 - i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (8:24; 13:19)Besimi biblik është edhe në një person, edhe në një mesazh! Provat e tij janë bindja, dashuria dhe qëndresa.

2:25 Kjo është një fjali e vetme në greqisht. Termi i rëndësishëm “i zë besë dikujt” (DËFTORJA E PAKRYER VEPRORE e foljes “besoj” në mohore) përdoret në këtë kontekst për të përshkruar veprimet dhe qëndrimet e Jezusit. Nënkupton shumë më tepër sesa pohim fillestar apo reagim emocional. Kjo fjali pohon dhe njohurinë që kishte Jezusi për dobësinë dhe ligësinë e zemrës njerëzore (kjo pasqyron njohurinë e Perëndisë, shih Zan. 6:11-12, 13; Psa. 14:1-3). Ky paragraf ilustron nga Nikodemi në kapitullin 3. Edhe ky “Z. Fetar” ishte i paafët që, me përpjekjet, njohurinë, pozitën apo prejardhjen e vet të pranohej nga Perëndia. Drejtësia vjen vetëm nëpërmjet besimit/besës/bindjes në Jezusin (shih Rom. 1:16-17; 4).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'ia kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse e ktheu Jezusi ujin në verë? Çfarë simbolizonte kjo?
2. Përshkruaj zakonet e dasmave në kohën e Jezusit.
3. A mund të vizatosh planimetrinë e tempullit të Herodit? Je në gjendje të tregosh vendndodhjen e mundshme të blerësve dhe shitësve?
4. Pse nuk e regjistrojnë ungjijtë sinoptikë këtë pastrim fillestar të tempullit?
5. A parashikoi Jezusi shkatërrimin e tempullit të Herodit?
6. Përcakto dhe shpjego fjalën greqisht që përkthehet “besim”, “besoj” dhe “bindje”.

GJONI 3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi dhe Nikodemi 3:1-15	Lindja sërish 3:1-21	Jezusi dhe judaizmi zyrtar 3:1-10 3:11-15	Jezusi dhe Nikodemi 3:1-2 3:3 3:4 3:5-8 3:9 3:10-13 3:14-17	Biseda me Nikodemin 3:1-8
3:16-21		3:16 3:17-21	3:18-21	
Jezusi dhe Gjon Pagëzori 3:22-30	Gjon Pagëzori lartëson Krishtin 3:22-36	Dëshmia e mëtejshme e Gjonit 3:22-24 3:25-30	Jezusi dhe Gjoni 3:22-24 3:25-26 3:27-30	Gjoni dëshmon për herë të parë 3:22-24 3:25-36
Ai që vjen nga qielli 3:31-36		3:31-36	Ai që vjen nga qielli 3:31-36	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:1-3

¹Ishte një njeri nga farisenjtë, i quajtur Nikodem, një udhëheqës i judenjve; ²ky njeri erdhi te Jezusi natën dhe i tha: “Rabbi, ne e dimë se ti ke ardhur nga Perëndia si mësues; sepse askush s’i bën dot shenjat që bën ti nëse Perëndia nuk është me të”. ³Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë, po të them; nëse dikush nuk rilind, nuk mund të shohë mbretërinë e Perëndisë”.

3:1 “farisenjtë” Rrënjët e këtij grupimi politiko-fetar kthehen pas në periudhën makabease. Emri i tyre mund të ketë kuptimin “të veçuarit”. Ata ishin të sinqertë dhe të përkushtuar për të zbatuar ligjet e Perëndisë siç përcaktoheshin dhe shpjegoheshin nga tradita gojore (Talmudi). Ashtu si sot, disa prej tyre ishin vërtet njerëz të

besëlidhjes (Nikodemi, Jozefi i Arimatesë), por disa ishin kryelartë, legalistë, gjykues, pra, njerëz të besëlidhjes vetëm “në dukje” (shih Isa. 6:9-10; 29:13). Zemra është jetike! “Besëlidhja e re” (Jer. 31:31-34) përqendrohet në motivimin e brendshëm (pra, te zemra e re, mendja e re, ligji i shkruar në zemër). Përpjekja njerëzore është provuar e pamjaftueshme, si gjithmonë. Rrethprerja e zemrës, në LiP. 10:16; 30:6, është një metaforë e besimit personal që rezulton në bindje dhe në një jetë plot mirënjohje!

Konservatorizmi dhe/ose liberalizmi fetar mund të jenë gjëra të shëmtuara. Teologjia duhet të rrjedhë nga dashuria dhe besimi. Shih Temën e Veçantë: Farisenjtë, te 1:24.

■ **“Nikodemi”** Është e habitshme që një jude në Palestinë të kishte vetëm një emër grek (si Filipi dhe Andrea, shih 1:40, 43), që kishte kuptimin “ngadhënjyes i popullit” (shih 7:50; 19:39).

■

NASB, NKJV “një udhëheqës i judenjve”

NRSV, NJB “një drejtues i judenjve”

TEV “një drejtues jude”

Në këtë kontekst, kjo është një frazë teknike për anëtarët e Sinedrit (në kontekste të tjera mund të nënkuptojë drejtuesin e një sinagoge lokale), gjykata e lartë me shtatëdhjetë anëtarë e popullit jude në Jerusalem. Autoriteti i saj ishte kufizuar me lezet nga romakët, por mbartte gjithsesi rëndësi të madhe simbolike për popullin jude. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

Ka gjasa që Gjoni po e përdor Nikodemin si përfaqësues të judaizmit ortodoks të shekullit të parë. Atyre që mendonin se kishin mbërritur shpirtërisht në destinacion u thuhej se duhet t’ia nisnin nga e para. Qytetarinë në Mbretëri e përcakton besimi në Jezusin, jo bindja ndaj rregullave (qoftë dhe rregullave të perëndishme, shih Kol. 2:16-23), apo sfondi racor (shih 8:31-59). Dera për pranimin hyjnor është dhurata e Perëndisë në Krishtin, jo fetaria e sinqertë dhe agresive njerëzore. Pranimi që Nikodemi i bën Jezusit si mësues nga Perëndia, ndonëse i vërtetë, nuk ishte i mjaftueshëm. Besimi personal, besimi unik, besimi absolut në Jezusin si Mesi është shpresa e vetme e njerëzimit të rënë (shih 1:12)!

TEMË E VEÇANTË: SINEDRI

I. Burime informacioni

A. Vetë Dhiata e Re

B. *Lashtësitë e judenjve*, e Flavius Jozefus

C. Pjesa e Mishnas në Talmud (p.sh., Traktati “Sinedri”)

Fatkeqësisht, DhR dhe Jozefusi nuk përputhen me shkrimet rabinike, të cilat duket se flasin për dy Sinedra në Jerusalem, njëri priftëror (pra, saduceas), i kontrolluar nga Kryepriifti, që trajtonte çështje të drejtësisë civile dhe penale, dhe i dyti, i kontrolluar nga farisenjtë dhe skribët, që trajtonte çështje fetare dhe tradicionale. Megjithatë, shkrimet rabinike datojnë nga viti 200 pas K. dhe pasqyrojnë situatën kulturore pas rënies së Jerusalemit në duart e gjeneralit romak Titi, më 70 pas K. Judenjtë e rithemeluan jetën e tyre fetare në një qytet të quajtur Javne dhe, më pas (pra, 188 pas K.), u transferuan në Galile.

II. Terminologjia

Problemi me identifikimin e këtij trupi gjyqësor lidhet me emra e ndryshëm me të cilët njihet. Ka një sërë fjalësh që përdoren për të përshkruar grupet gjyqësore brenda komunitetit judaik të Jerusalemit.

A. *Gerousia* – “senati” ose “këshilli”. Ky është termi më i vjetër, i cili u përdor nga fundi i periudhës perse (shih *Lashtësitë e Jozefusit*, 12.3.3 dhe *2 Makabejve* 11:27). Ai përdoret nga Luka në Veprat 5:21, së bashku me “Sinedrin”. Mund të ketë qenë mënyrë për t’ua shpjeguar këtë term lexuesve greqishtfolës (shih *1 Mak.* 12:35).

B. *Synedrion* – “Sinedri”. Kjo është një fjalë e përbërë nga *syn* (së bashku me) dhe *hedra* (ndenjësë). Për habi, ky term përdoret në aramaisht, por reflekton një fjalë greqisht. Nga fundi i periudhës makabease, ky ishte bërë termi i pranuar për të përcaktuar gjykatën e lartë të judenjve në Jerusalem (shih Mat. 26:59; Marku 15:1; Luka 22:66; Gjoni 11:47; Veprat 5:27). Problemi del kur e njëjta terminologji përdoret edhe për këshillat gjyqësorë lokalë jashtë Jerusalemit (shih Mat. 5:22; 10:17).

- C. *Presbyterion* – “këshilli i pleqve” (shih Luka 22:66). Ky është një përcaktim i DhV për krerët e fiseve. Gjithsesi, më vonë u përdor për gjykatën e lartë në Jerusalem (shih Veprat 22:5).
- D. *Boulē* – Ky term, “këshill”, u përdor nga Jozefusi (p.sh., *Luftërat* 2.16.2; 5.4.2, por jo në DhR) për të përshkruar një sërë entesh gjyqësore: (1) Senati në Romë; (2) gjykatat lokale romake; (3) gjykata e lartë judaike në Jerusalem; dhe (4) gjykatat lokale judaike. Jozefi i Arimatesë përshkruhet si anëtar i Sinedrit me anë të një forme të këtij termi (pra, *bouleutēs*, që do të thotë “këshilltar”, shih Marku 15:43; Luka 23:50).

III. Zhvillimi historik

Thuhet se, në fillim, Esdra formoi Sinagogën e Madhe (shih Targumi, te Kënga e Këngëve 6:1) në periudhën pas kthimit nga robëria, që duket se u shndërrua në Sinedrin në kohën e Jezusit.

- A. Mishna (pra, Talmudi) bën të ditur se kishte dy gjykata madhore në Jerusalem (shih Sanh. 7:1).
 - 1. Njëra përbëhej nga 70 (ose 71) anëtarë (*Sand.* 1:6 madje pohon se Sinedrin e parë e formoi Moisiu te Num. 11, shih Num. 11:16-25).
 - 2. Tjetra përbëhej nga 23 anëtarë (por kjo mund t’u referohet gjykatave të sinagogave lokale).
 - 3. Disa studiues judaikë besojnë se në Jerusalem kishte tre Sinedre me nga 23 anëtarë. Kur këta të tre mblihdeshin si një grup, së bashku me dy krerët, përbënin “Sinedrin e Madh” me 71 anëtarë (p.sh., *Nasi* dhe *Av Bet Din*).
 - a. njëri priftëror (pra, saducenjtë)
 - b. tjetri ligjor (pra, farisenjtë)
 - c. tjetri aristokratik (pra, pleqtë)
- B. Në periudhën pas kthimit nga robëria, pasardhja e kthyer davidike ishte Zerubabeli ndërsa pasardhja e kthyer aronike ishte Jozueu. Pas vdekjes së Zerubabelit, nuk vazhdoi më pasardhja davidike, kështu që manteli gjyqësor iu kaloi në mënyrë unike priftërinjve (shih *1 Mak.* 12:6) dhe pleqve lokalë (shih Neh. 2:16; 5:7).
- C. Ky rol priftëror në vendimet gjyqësore dokumentohet nga Diodori (40:3:4-5) gjatë periudhës helenistike.
- D. Ky rol priftëror në qeverisje vazhdoi edhe gjatë periudhë seleukase. Jozefusi citon Antiokun “e Madh” II (223-187 para K.) në *Lashtësitë* 12.138-142.
- E. Ky pushtet priftëror vazhdoi edhe gjatë periudhës makabease sipas Jozefusit, *Lashtësitë* 13.10.5-6; 13.15.5.
- F. Gjatë periudhës romake, guvernatori i Sirisë (pra, Gabini, 57-55 para K.) themeloi pesë “Sinedra” rajonale (shih Jozefusi, *Lashtësitë* 14.5.4; dhe *Luftërat* 1.8.5), por kjo u anulua më vonë nga Roma (pra, 47 para K.).
- G. Sinedri pati një përballje politike me Herodin (shih, *Lashtësitë* 14.9.3-5), i cili, më 37 para K., u hakmor dhe vrau shumicën e anëtarëve të gjykatës së lartë (shih, Jozefusi, *Lashtësitë* 14.9.4; 15.1.2).
- H. Nën prokuratorët romakët (pra, 6-66 pas K.), Jozefusi na thotë (shih *Lashtësitë* 20.200.251) se Sinedri fitoi sërish pushtet dhe ndikim të konsiderueshëm (shih Marku 14:55). Në DhR regjistroheshin tre gjyqe, ku Sinedri, nën udhëheqjen e familjes së Kryepriftit, ekzekuton drejtësinë.
 - 1. Gjyqi i Jezusit (shih Marku 14:53-15:1; Gjoni 18:12-23, 28-32)
 - 2. Pjetri dhe Gjoni (shih Veprat 4:3-6)
 - 3. Pali (shih veprat 22:25-30)
- I. Kur judenjtë bënë kryengritje më 66 pas K., romakët shkatërruan shoqërinë judaike dhe Jerusalemin më 70 pas K. Sinedri u shkri një herë e përgjithmonë, ndonëse farisenjtë në Javne u përpoqën të rikthenin një gjykatë të lartë juridike (pra, *Beth Din*) në jetën fetare (por jo civile, apo politike) të judenjve.

IV. Anëtarësia

- A. Përmendja e parë biblike e një gjykate të lartë në Jerusalem është 2 Kro. 19:8-11. Ajo përbëhej nga (1) levitët; (2) priftërinjtë; dhe (3) krerët e familjeve (pra, pleqtë, shih 1 Mak. 14:20; 2 Mak. 4:44).
- B. Gjatë periudhës makabease, ajo dominohej nga (1) familjet priftërore të saducenjve dhe (2) aristokracia lokale (shih 1 Mak. 7:33; 11:23; 14:2). Më vonë, në këtë periudhë, “skribët”

(juristët e Moisiut, zakonisht farisenj) iu shtuan Sinedrit, me sa duket nga gruaja e Aleksandër Janeut, Salomeja (76-67 para K.). Thuhet se ajo i bëri farisenjtë grupin mbizotërues (shih Jozefusi, *Luftërat e judenjve* 1.5.2).

- C. Në kohën e Jezusit, kjo gjykatë përbëhej nga
1. familjet e kryepriфтërinjve
 2. burra lokalë të familjeve të pasura
 3. skribët (shih Luka 19:47)

V. Burimet e konsultuara

- A. *Dictionary of Jesus and the Gospels* [Fjalori i Jezusit dhe ungjijve], IVP, f. 728-732.
B. *The Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible* [Enciklopedia e Pikturuara e Biblës e Zondervan], vëll. 5, f. 268-273.
C. *The New Schaff-Herzog Encyclopedia of Religious Knowledge* [Enciklopedia e re e njohurisë fetare e Schaff-Herzog], vëll. 10, f. 203-204.
D. *The Interpreter's Dictionary of the Bible* [Fjalori i interpretuesit të Biblës], vëll. 4, f. 214-218.
E. *Encyclopedia Judaica* [Enciklopedia judaike], vëll. 14, f. 836-839.

3:2 “natën” Rabinët thoshin se nata është koha më e mirë për të studiuar Ligjin, pasi nuk ka ndërprerje. Ndoshta, Nikodemi nuk donte ta shihnin me Jezusin, kështu që (ndoshta, bashkë me të tjerë) shkoi natën tek ai.

Në shkrimet e Gjonit, interpretuesi duhet të vrasë gjithmonë mendjen nëse bëhet fjalë për një kuptim të dyfishitë. Gjoni karakterizohet nga një kontrast i përsëritur mes errësirës dhe dritës (shih NET Bible, f. 1898, #7 sn).

▣ **“Rabbi”** Te Gjoni, kjo do të thotë “mësues” (shih 1:38; 4:31; Marku 9:5; 11:21). Një nga gjërat që bezdiste krerët e judenjve ishte se Jezusi nuk kishte mësuar në shkollat teologjike të rabinëve. Ai s’kishte bërë studime talmudike pas studimit në sinagogën lokale në Nazaret.

▣ **“ti ke ardhur nga Perëndia”** Kjo pjesë vendoset e para në fjali për theks. Ndoshta, aludon për profecinë e LiP. 18:15, 18. Nikodemi e kuptoi fuqinë e fjalëve dhe veprave të Jezusit, por kjo nuk donte të thoshte se ishte në pozitë të drejtë shpirtërore me Perëndinë.

▣ **“nëse Perëndia nuk është me të”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË që nënkupton një realitet të mundshëm.

3:3, 5, 11 “me të vërtetë, me të vërtetë” Fjalë për fjalë, “Amen, amen”. Vjen nga fjala e DhV “besim”. Vjen nga rrënja “jam i patundur”, ose “jam i sigurt”. Jezusi e përdorte si parathënie për pohime të rëndësishme. Edhe më vonë u përdor si mënyrë për të mbështetur pohime të vërteta. Dyfishimi në fillim të fjalisë është unik për ungjillin e Gjonit. Këto dyfishime të përsëritura të termit “amen” zbulojnë fazat në dialogun mes Jezusit dhe Nikodemit. Shih Temën e Veçantë: Amen, te 1:51.

3:3 “nëse dikush nuk” Edhe kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, njësoj si pohimi i Nikodemit te 3:2.

▣

NASB, NKJV,

TEV “rilind”

NRSV, NJB “lindet nga lart”

Kjo është LIDHORE AORISTE PËSORE. Fjala (*anōthen*) mund të ketë kuptimin

1. “lindur fizikisht për herë të dytë”
2. “lindur nga fillimi” (shih Veprat 26:4)
3. “lindur nga lart”, që përputhet me këtë kontekst (shih 3:7, 31; 19:11)

Ndoshta, ky është një tjetër shembull i përdorimit të termave me dy kuptime (dykuptimësi) nga ana e Gjonit, ku të dyja janë të vërteta (shih Bauer, Arndt, Gengrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon of the New Testament*, f. 77). Siç është e qartë nga v. 4, Nikodemi e kuptoi si alternativën #1. Gjoni dhe Pjetri (shih 1 Pje. 1:23) e përdorin

këtë metaforë familjare për shpëtimin, siç përdor Pali termin “birësim”. Fokusi është te vepra e lindjes nga ana e Atit (shih 1:13). Shpëtimi është dhuratë dhe akt i Perëndisë (shih 1:12-13; Rom. 3:21-24; 6:23; Efe. 2:8-9).

■ **“nuk mund të shohë”** Kjo frazë idiomatike paralelizohet në v. 5 nga fraza “nuk mund të hyjë”.

■ **“mbretërinë e Perëndisë”** Kjo frazë përdoret vetëm dy herë te Gjoni (shih v. 5). Ajo është frazë shumë kyçe në ungjijtë sinoptikë. Predikimi i parë dhe i fundit i Jezusit, si dhe shumica e shëmbëlltyrave të tij, e trajtojnë këtë temë. Ajo bën fjalë për mbretërimin e Perëndisë në zemrën e njerëzve tani! Është e habitshme që Gjoni e përdor këtë frazë vetëm dy herë (dhe asnjëherë në shëmbëlltyrat e Jezusit). Shih Temën e Veçantë më poshtë. Për Gjoni, “jeta e përjetshme” është një term dhe metaforë kyçe.

Kjo frazë lidhet me shtysën eskatologjike (të kohëve të fundit) të mësimëve të Jezusit. Ky paradoks i tipit “tashmë, por ende jo” lidhet me konceptin judaik të dy epokave: epoka e tanishme e ligë dhe epoka e ardhme e drejtë, e cila do të inaugurohet nga Mesia. Judenjtë prisnin vetëm një ardhje të një udhëheqësi ushtarak të fuqizuar nga Fryma (si gjyqtarët në DhV). Dy ardhjet e Jezusit shkaktuan një mbivendosje të dy epokave. Mbretëria e Perëndisë ka depërtuar në historinë njerëzore në mishërimin e Jezusit në Betlehem. Megjithatë, Jezusi nuk erdhi si pushtuesi ushtarak i Zbulesës 19, por si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53) dhe si një drejtues i përlulur (shih Zak. 9:9). Si rrjedhojë, Mbretëria është inauguruar (shih Mat. 3:2; 4:17; 10:7; 11:12; 12:28; Marku 1:15; Luka 9:2, 11; 11:20; 21:31-32), por nuk është përbushur (shih Mat. 6:10; 16:28; 26:64).

Besimtarët jetojnë në tensionin mes këtyre dy epokave. Ata kanë jetën e ringjalljes, por ende po vdesin shpirtërisht. Janë çliruar nga fuqia e mëkatit, por ende mëkatojnë. Jetojnë në tensionin eskatologjik “tashmë, por ende jo!”

Një shprehje e dobishme e tensionit të “tashmë, por ende jo” te Gjoni gjendet në librin e Frank Stagg, *New Testament Theology [Teologji e Dhiatës së Re]*:

“Ungjilli i Gjoni thekson fort një ardhje të ardhshme (14:3, 4. 28; 16:16, 22) dhe flet qartazi për ringjalljen dhe gjykimin përfundimtar „në ditën e fundit“ (5:28 f.; 6:39 f. 44, 54; 11:24; 12:48); megjithatë, gjatë gjithë ungjillit të katërt, jeta e përjetshme, gjykimi dhe ringjallja janë realitete të tanishme (3:18 f.; 4:23; 5:25; 6:54; 11:23 e më tej; 12:28, 31; 13:31 f.; 14:17; 17:26)” (f. 311).

TEMË E VEÇANTË: MBRETËRIA E PERËNDISË

Në DhV, JHVH mendohej si Mbreti i Izraelit (shih 1 Sam. 8:7; Psa. 10:16; 24:7-9; 29:10; 44:4; 89:18; 95:3; Isa. 43:15; 44:6), ndërsa Mesia si mbreti ideal (shih Psa. 2:6; Isa. 9:6-7; 11:1-5). Me lindjen e Jezusit në Betlehem (6-4 para K.), mbretëria e Perëndisë hyri furishëm në historinë njerëzore me fuqi të re dhe me shpengim (besëlidhja e re, shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:27-36). Gjoni Pagëzori shpalli afërsinë e mbretërisë (shih Mat. 3:2; Marku 1:15). Jezusi mësoi qartë se mbretëria ishte e pranishme në atë vetë dhe në mësimet e tij (shih Mat. 4:17, 23; 9:35; 10:7; 11:11-12; 12:28; 16:19; Marku 12:34; Luka 10:9, 11; 11:20; 12:31-32; 16:16; 17:21). Mirëpo mbretëria është edhe e ardhshme (shih Mat. 16:28; 24:14; 26:29; Marku 9:1; Luka 21:31; 22:16, 18).

Në paralelet sinoptike te Marku dhe Luka gjejmë frazën “mbretëria e Perëndisë”. Kjo temë e zakonshme e mësimëve të Jezusit kishte të bënte me mbretërimin e tanishëm të Perëndisë në zemrat e njerëzve, që, një ditë, do të përbushej mbi gjithë tokën. Kjo pasqyrohet në lutjen e Jezusit te Mat. 6:10. I shkruar për judenjtë, ungjilli i Mateut preferonte frazën që nuk përdorte emrin e Perëndisë (Mbretëria e qiejve), ndërsa Marku dhe Luka, që iu shkruan johebrenjve, përdorën termin e zakonshëm, duke përdorur emrin e hyjnisë.

Kjo është një frazë shumë kyçe në ungjijtë sinoptikë. Predikimi i parë dhe i fundit i Jezusit, si dhe shumica e shëmbëlltyrave të tij, trajtojnë këtë temë. Ajo flet për mbretërimin e Perëndisë në zemrat e njerëzve tani! Është e habitshme që Gjoni e përdor këtë frazë vetëm dy herë (dhe asnjëherë në shëmbëlltyrat e Jezusit). Në ungjillin e Gjoni, metaforë kyçe është “jeta e përjetshme”.

Tensioni në këtë frazë shkaktohet nga dy ardhjet e Krishtit. DhV përqendrohej vetëm te një ardhje e Mesisë së Perëndisë – një ardhje ushtarake, gjykuese dhe e lavdishme – por DhR tregon se, herën e parë, ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaia 53 dhe si mbreti i përlulur i Zak. 9:9. Dy epokat judaike, epoka e ligësisë dhe epoka e re e drejtësisë, mbivendosen. Tani, Jezusi mbretëron në zemrat e besimtarëve, por, një ditë, do të mbretërojë mbi gjithë krijimin. Ai do të vijë siç paratha DhV! Besimtarët jetojnë në periudhën “tashmë, por ende jo” të mbretërisë së Perëndisë (shih Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 131-134).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:4-8

⁴Nikodemi i tha: “Si mund të lindë sërish njeriu kur është plak? Ai s’mund të hyjë për herë të dytë në barkun e nënës e të lindë, apo jo?” ⁵Jezusi iu përgjigj: “Me të vërtetë, me të vërtetë po të them: nëse dikush nuk lind nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë. ⁶Ajo që lind nga mishi është mish, ndërsa ajo që lind nga Fryma është frymë. ⁷Mos u habit që po të them ,duhet të lindeni sërish“. ⁸Era fryn ku të dëshirojë, dhe ti ia dëgjon zhurmën, por nuk e di nga vjen dhe ku po shkon; kështu është cilido që lind nga Fryma”.

3:5 “nëse dikush nuk lind nga uji dhe nga Fryma” Kjo është një tjetër FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË. Siç është tipike për shkrimet e Gjonit, mund të kemi të bëjmë me një kontrast

1. fizikja me shpirtëroren (“fryma” nuk ka NYJË SHQUESE)
2. tokësorja me qielloren

Ky kontrast nënkuptohet në v. 6.

Teoritë për kuptimin e “ujit” janë:

1. rabinët e përdorin për spermën e mashkullit
2. uji i lindjes së fëmijës
3. pagëzimi i Gjonit që simbolizonte pendimin (shih 1:26; 3:23)
4. sfondi i DhV, që nënkupton spërkatjen ceremoniale nga Fryma (shih Ezek. 36:25-27)
5. pagëzimi i krishterë (ndonëse Nikodemi s’mund ta ketë kuptuar në atë mënyrë; e përmendur për herë të parë nga Justini dhe Ireneu)

Në kontekst, teoria #3 (pagëzimi me ujë i Gjonit dhe pohimi i Jezusit për faktin se Mesia do t’i pagëzonte me Frymën e Shenjtë) i bie të jetë kuptimi më i dukshëm. Në këtë kontekst, lindja është metaforike dhe nuk duhet të lejojmë që keqkuptimi i këtyre termave nga Nikodemi të mbizotërojë interpretimin. Si rrjedhojë, teoria #1 është e pavend. Ndonëse Nikodemi nuk do të kishte kuptuar se fjalët e Jezusit lidheshin me pagëzimin e mëvonshëm të krishterë, apostulli Gjon e ndërftoi shpesh teologjinë e vet në fjalët historike të Jezusit (shih v. 14-21). Teoria #2 do të përputhej me dualizmin e Gjonit, lart dhe poshtë, pra, sfera e Perëndisë dhe sfera tokësore. Në përcaktimin e këtyre termave, duhet të përcaktojmë nëse po bëhet ballafaqim mes tyre (#1 ose #2), apo nëse po plotësojnë njëra-tjetrën (#4).

Don A. Carson, *Exegetical Fallacies*, përmend një alternativë tjetër: se të dyja këto fjalë flasin për një lindje të vetme, një lindje eskatologjike që ndjek Ezek. 36:25-27, që përshkruan “besëlidhjen e re” të Jer. 31:31-34 (f. 42).

Edhe F. F. Bruce, *Answers to Questions*, pikas një aludim nga DhV në fjalët e Jezusit. Mund të ketë qenë dhe referencë për pagëzimin e prozelitëve, të cilin duhet ta kryejë edhe Nikodemi, një mësues i shquar rabinik! (f. 67).

■ **“mbretërinë e Perëndisë”** Një dorëshkrim i lashtë greqisht (pra, MS α), si dhe shumë etër të kishës, kanë frazën “mbretërinë e qiejve”, që është e zakonshme për ungjillin e Mateut. Mirëpo fraza “mbretëri e Perëndisë” shfaqet në v. 3 (v. 3 dhe 5 janë të vetmet vende ku kjo frazë shfaqet te Gjoni). Gjoni, që u shkruan johebrenjve (si Marku dhe Luka), nuk përdor perifrazimet judaike për emrin e Perëndisë.

3:6 Edhe ky është një dualizëm vertikal (lart përkundër poshtë), tejet i përdorur te Gjoni (shih v. 11).

3:7 “ti... ju” E para është NJËJËS, sepse i drejtohet Nikodemit, ndërsa e dyta është SHUMËS, sepse i referohet një parimi të përgjithshëm që vlen për gjithë qeniet njerëzore (e njëjta lojë mes NJËJËSIT dhe SHUMËSIT në v. 11).

Ekziston tundimi që këtë ta interpretojmë në dritën e prirjes judaike për t’i besuar prejardhjes së tyre racore (shih 4:12; 8:53). Por Gjoni, i cili shkruan nga fundi i shekullit të parë, qartazi po kundërshton gnosticizmin, por dhe arrogancën racore të judenjve.

■ **“duhet”** FOLJA në greqisht *dei* (fjalë për fjalë, “është e nevojshme”, [BAGD, 172], DËFTORE E TASHME VEPRORE) përdoret tri herë në kapitullin 3 (v. 7, 14, 30). Ajo nënkupton gjërat që duhet të ndodhin në mënyrë që plani i Perëndisë të ecë përpara (shih 4:24; 9:4; 10:16; 12:34; 20:9).

3:8 Bëhet një lojë fjalësh mes fjalës hebraisht (dhe aramaisht) (*ruakh*) dhe fjalës greqisht (*pneuma*), ku të dyja kanë kuptimet “erë”, “frymë”, dhe “shpirt”. Ideja është se era ka liri, njësoj si dhe Fryma. Njeriu s’e sheh dot erën, por efektet e saj; kështu ndodh dhe me Frymën. Shpëtimi nuk është në dorën e njeriut, por në dorën e Frymës (shih Ezekieli 37). Ka mundësi që v. 5-7 të reflektojnë të njëjtën të vërtetë. Shpëtimi është një kombinim i nismës së Frymës (shih 6:44, 65) me përgjigjen me besim/pendim të individit (shih 1:12; 3:16, 18).

Ungjilli i Gjonit përqendrohet në mënyrë unike te personi dhe vepra e Frymës (shih 14:17, 25-26; 16:7-15). Ai e sheh epokën e re të drejtësisë si epokën e Frymës së Perëndisë.

Vargu 8 thekson enigmën pse disa njerëz besojnë kur dëgjojnë/shohin ungjillin, ndërsa disa të tjerë, jo. Gjoni pohon se askush nuk mund të besojë nëse nuk preket nga Fryma (shih 1:13; 6:44, 65). Ky varg e përforcon atë teologji. Gjithsesi, pyetja e reagimit ndaj besëlidhjes (pra, pranimit njerëzor i ofertës hyjnore) supozon se Fryma i prek të gjithë. Se pse disa refuzojnë të besojnë është misteri i madh i paudhësisë (pra, i egoizmit që erdhi nga Rënia). Sa më tepër më kalon mosha, sa më tepër studioj Biblën, sa më tepër i shërbej popullit të Perëndisë, aq më tepër shkruaj fjalën “mister” mbi jetën. Të gjithë ne jetojmë në mjegullën e errët (shih 1 Kor. 13:12) të kryengritjes njerëzore! Aftësia për ta shpjeguar misterin, apo thënë ndryshe, zhvillimi i një teologjie sistematike, nuk është aq e rëndësishme se besimi te Perëndia në Krishtin. Jobit nuk ia thanë kurrë “pse”-në!

TEMË E VEÇANTË: FRYMË, ERË, SHPIRT

Termi hebraisht *ruakh* (BDB 924) dhe termi greqisht *pneuma* mund të kenë kuptimin “shpirt”, “frymë” ose “erë” (shih Gjoni 3:5, 8). Shpesh, Fryma shoqërohet me krijimin (shih Zan. 1:2; Jobi 26:13; Psa. 104:30). DhV nuk e përcakton qartë marrëdhënien mes Perëndisë dhe frymës. Te Jobi 28:26-28; Psa. 104:24 dhe Fja. 3:19; 8:22-23, Perëndia përdor urtësinë (një EMËR FEMËROR) për të krijuar gjithçka. Në DhR, Jezusi thuhet se ishte vepruesi i Perëndisë në krijim (shih Gjoni 1:1-3; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15-17; Heb. 1:2-3). Si në shpengim, ashtu edhe në krijim, përfshihen të tre personat e Hyjnisë. Vetë Zanafilla 1 nuk thekson asnjë shkak dytësor.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:9-15

⁹Nikodemi i tha: “Si mund të ndodhin këto gjëra?” ¹⁰Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Ti je mësuesi i Izraelit dhe nuk i kupton këto gjëra? ¹¹Me të vërtetë, me të vërtetë, po të them; ne flasim për ato që dimë dhe dëshmojmë për ato që kemi parë, dhe ju nuk e pranoni dëshminë tonë. ¹²Nëse ju fola për gjëra tokësore dhe ju nuk besoni, si do të besoni nëse ju flas për gjëra qiellore? ¹³Askush s’është ngjitur në qiell, përveç atij që zbriti nga qielli: Biri i njeriut. ¹⁴Ashtu si Moisiu ngriti gjarprin në shkretëtirë, kështu duhet të ngrihet dhe Biri i Njeriut, ¹⁵që kushdo që beson, të ketë jetën e përjetshme në të.

3:9-10 Nikodemi duhet ta kishte kuptuar terminologjinë simbolike të Jezusit në dritën e (1) pagëzimit të prozelitëve në judaizëm dhe (2) predikimit të Gjon Pagëzorit.

Ky mund të ketë qenë një nënçmim i qëllimshëm i njohurisë njerëzore; as dikush si Nikodemi, një ndër krerët e judenjve, nuk i kuptonte dot plotësisht gjërat shpirtërore. Ungjilli i Gjonit u shkrua për të luftuar fazat e para të gnosticizmit, një herezi që theksonte njohurinë njerëzore si mjet shpëtimi. Vetëm Jezusi është drita e vërtetë (v. 19) për të gjithë, jo vetëm për një grup elitari.

3:11 “ne flasim për ato që dimë” Këta PËREMRA në SHUMËS i referohen Jezusit dhe apostullit Gjon (v. 11), ose Jezusit dhe Atit, që i përshtatet më mirë kontekstit (v. 12). Ungjilli nuk është hamendësim, por zbulesë hyjnore!

■ “ju nuk e pranoni dëshminë tonë” Gjoni i përdor shpesh në një kuptim teologjik. termat “pranoj/marr” (*lambanō*) dhe format e tyre të përbëra PARAFJALORE .

1. për pranimin e Jezusit
 - a. në mënyrë negative (1:11; 3:11, 32; 5:43, 47)
 - b. në mënyrë pozitive (1:12; 3:11, 33; 5:43; 13:20)
2. për marrjen e Frymës
 - a. në mënyrë negative (14:17)
 - b. në mënyrë pozitive (7:39)
3. për pranimin e fjalëve të Jezusit
 - a. në mënyrë negative (12:48)
 - b. në mënyrë pozitive (17:8)

Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në 1:8.

3:12 “nëse... nëse” E para është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. E dyta është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim të mundshëm.

▣ **“ju”** PEREMRI dhe FOLJET janë në SHUMËS. Nikodemi mund të ketë patur me vete nxënës, ose farisenj të tjerë, kur erdhi te Jezusi, ose ky mund të jetë një pohim i përgjithshëm (pra, Nikodemi si përfaqësues i një grupi) për gjithë judenjtë mosbesues, si në v. 7 dhe 11.

3:13 Ky varg synon të mbështesë zbuluesën e Atit nga Jezusi si të vërtetë, të plotë, okulare dhe të pashoqe (shih 1:1-14). Ky është një tjetër shembull i dualizmit vertikal te Gjoni: qielli përkundër tokës, fizikja përkundër shpirtërore, origjina e Nikodemit përkundër origjinës së Jezusit (shih 1:51; 6:33, 38, 41, 50, 51, 58, 62). Ky varg pohon (1) natyrën hyjnore; (2) paraekzistencën; dhe (3) mishërimin e Personit të Dytë e të përjetshëm të Trinitisë (për Trininë, shih Temën e Veçantë në 14:26).

▣ **“Biri i Njeriut”** Ky është vetëpërcaktimi i Jezusit; nuk përmbante ngjyrimet mesianike nacionaliste dhe ushtarake në judaizmin e shekullit të parë. Ky term vjen nga Ezek. 2:1 dhe Psa. 8:4, ku nënkuptonte “qenie njerëzore” dhe nga Dan. 7:13, ku nënkuptonte hyjninë. Ky term kombinon paradoksin e personit të Jezusit, plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri (shih 1 Gjoni 4:1-3).

3:14-21 Është e vështirë të kuptojmë me siguri se ku ndalon biseda e Jezusit me Nikodemin dhe ku fillojnë komentet e mëtejshme të apostullit Gjon. Ka mundësi që ungjijtë sinoptikë dokumentojnë shërbesën mësimdhënëse publike të Jezusit, ndërsa Gjoni regjistron sesionet e tij private me dishepujt. Vargjet 14-21 mund të përvijohen si më poshtë:

1. v. 14-15 lidhen me Jezusin
2. v. 16-17 lidhen me Atin
3. v. 18-21 lidhen me njerëzimin

Mos harroni se, qoftë nëse këtu po flet Jezusi, apo Gjoni, kjo nuk e cenon aspak të vërtetën e këtyre pohimeve!

3:14 “Ashtu si Moisiu ngriti gjarpurin” Kjo i referohet Num. 21:4-9, që rrëfen një përjetim gjykimi gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë. E vërteta qendrore është se njerëzit duhet t’i besojnë dhe t’i binden fjalës së Perëndisë, edhe kur nuk e kuptojnë plotësisht. Perëndia u siguroi izraelitëve një mënyrë si të shpëtonin nga kafshimet e gjarpërinjve, mjafton që ata të besonin. Ky besim evidentohet nga bindja e tyre ndaj fjalës/premtimit të tij (shih Num. 21:8).

▣ **“ngriti”** Kjo fjalë greqisht (shih 8:28; 12:32, 34) shpesh përkthehej “shumë i lartësuar” (shih Veprat 2:33; 5:31; Fil. 2:9) dhe është një tjetër term që Gjoni e përdor me dy kuptime (dykuptimësia, shih 1:5; 3:3, 8). Ashtu si Perëndia kishte premtuar çlirim nga vdekja prej kafshimit të gjarpurit për ata që besonin në fjalën e Perëndisë dhe e ngulnin vështrimin te gjarpri i bronzë, kështu dhe ata që besojnë në fjalën e Perëndisë (ungjilli për Krishtin, ai që u ngrit në kryq) dhe i besojnë Jezusit do të çlirohen (shpëtohen) nga kafshimi i gjarpurit (Djallit, mëkatit) të ligësisë (shih 12:31-32).

3:15-18 “kushdo” (v. 15) “kushdo” (v. 16) “ai që” (v. 18) Dashuria e Perëndisë është një ftesë për gjithë njerëzimin (shih. Isa. 55:1-3; Ezek. 18:23,32; Gjoni 1:29; 3:16; 6:33,51; 2 Kor. 5:19; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titi 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjoni 2:2; 4:14). Oferta e shpëtimit është e përbotshme, por pranimi i saj, jo!

3:15 “beson” Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE. Besimi është besim i vazhdueshëm. Shih shënimin në 1:12 dhe Temat e Veçanta në 1:7 dhe 2:23.

▣ **“në të”** Kjo u referohet jo vetëm fakteve (të vërtetave teologjike) për Jezusin, por edhe marrëdhënies personale me të. Shpëtimi është (1) një mesazh që duhet besuar; (2) një person që duhet pranuar dhe që duhet t’i bindemi; dhe (3) një jetë siç jetoi dhe ai person!

Forma gramatikore këtu është e pazakontë. Është PËREMRI me PARAFJALËN *en*, që gjendet vetëm këtu te Gjoni; zakonisht, duhet të ishte PARAFJALA *eis*. Ka gjasa që kjo duhet përkthyer “të mund të ketë jetën e përjetshme” (shih *The New Testament in Basic English*, nga Harold Greenlee).

3:15, 16 “jeta e përjetshme” Ky term greqisht (*zoē*) i referohej cilësisë dhe sasisë (shih 5:24). Në Mat. 25:46, kjo fjalë përdoret për ndarjen e përjetshme. Te Gjoni, *zoē* (e përdorur 33 herë, kryesisht në kapitujt 5 dhe 6) zakonisht (FOLJA e përdorur për jetën fizike, 4:50, 51, 53) i referohet ringjalljes, jetës eskatologjike, ose jetës së Epokës së Re, pra, jetës së vetë Perëndisë. Gjoni është unik ndër ungjijtë për theksin e tij te “jeta e përjetshme”. Ajo është motiv dhe synim madhor i ungjillit të tij (shih 3:15; 4:36; 5:39; 6:54, 68; 10:28; 12:25; 17:2, 3).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:16-21

¹⁶Sepse kaq shumë e deshi Perëndia botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindur, në mënyrë që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme. ¹⁷Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin në botë për të gjykuar botën, por që bota të mund të shpëtohet përmes tij. ¹⁸Ai që beson në të nuk do të gjykohej; ai që nuk beson është gjykuar tashmë, sepse nuk ka besuar në emrin e Birit të vetëmlindur të Perëndisë. ¹⁹Ky është gjykimi, se Drita ka ardhur në botë, por njerëzit deshën errësirën me tepër se Dritën, sepse veprat e tyre ishin të liga. ²⁰Sepse kushdo që bën ligësi, urren Dritën, dhe nuk vjen të Drita, sepse ka frikë mos i dalin në shesh veprat e veta. ²¹Por ai që praktikon të vërtetën vjen te Drita, në mënyrë që të shfaqet se veprat e tij janë bërë në Perëndinë.

3:16 “kaq shumë e deshi Perëndia” Kjo është folje DËFTORE AORISTE VEPRORE (si dhe FOLJA “dha”), që këtu bën fjalë për një veprim të përfunduar në të shkuarën (Perëndia dërgoi Jezusin). Vargjet 16-17 bëjnë fjalë kryesisht për dashurinë e Atit (shih 1 Gjonit 4:7-21, sidomos v. 9-10). “Deshi” është termi *agapaō*. Nuk përdorej shumë në greqishten klasike. Kisha e hershme e mori dhe e mbushi me kuptim të veçantë. Në disa kontekste, ajo bën fjalë për dashurinë e Atit ose të Birit, por përdoret negativisht për dashurinë njerëzore (shih 3:19; 12:43; 1 Gjonit 2:15). Teologjikisht, është sinonimike me *hesed* në DhV, që nënkuptonte dashurinë dhe besnikërinë e Perëndisë ndaj besëlidhjes. Në greqishten *koine* të kohës së Gjonit, termat *agapaō* dhe *fileō* janë sinonime në thelb (krahaso 3:35 me 5:20).

Interpretuesit duhet të kenë parasysh se të gjitha fjalët e përdorura për të përshkruar Perëndinë mbartin dhe bagazh njerëzor (antropomorfik). Ne jemi të detyruar të përdorim fjalë që përshkruajnë botë, ndjenjat dhe pikëvështrimin tonë historik në përpjekje për të përshkruar një Qenie (Perëndinë) të përjetshme, të shenjtë, të pashoqe dhe shpirtërore. Deri në njëfarë mase, gjithë fjalori njerëzor është analog ose metaforik. Ajo që na është zbuluar është padyshim e vërtetë, por jo absolute. Njerëzimi i rënë, i përkohshëm dhe i fundmë nuk mund të rrokë realitetin absolut.

TEMË E VEÇANTË: PERËNDIA I PËRSHKRUAR SI NJERI (TERMINOLOGJIA ANTROPOMORFIKE)

- I. Kjo lloj terminologjie është shumë e zakonshme në DhV (disa shembuj)
 - A. Gjymtyrë fizike
 1. sy – Zan. 1:4,31; 6:8; Eks. 33:17; Num. 14:14; LiP. 11:12; Zak. 4:10
 2. duar – Eks. 15:17; Num. 11:23; LiP. 2:15
 3. krah – Eks. 6:6; 15:16; LiP. 4:43; 5:15
 4. veshë - Num. 11:18; 1 Sam. 8:21; 2 Mbret. 19:16; Psa. 5:1; 10:17; 18:6
 5. fytyrë - Eks. 33:11; Num. 6:25; LiP. 34:10; Psa. 114:7
 6. gisht - Eks. 8:19; 31:18; LiP. 9:10; Psa. 8:3
 7. zë – Zan. 3:8, 10; Eks. 15:26; 19:19; LiP. 26:17; 27:10
 8. këmbë – Eks. 24:10; Ezek. 43:7
 9. formë njerëzore - Eks. 24:9-11; Psa. 47; Isa. 6:1; Ezek. 1:26
 10. engjëlli i Zotit - Zan. 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16; Eks. 3:4,13-21; 14:19; Gjyq. 2:1; 6:22-23; 13:3-22
 - B. Veprime fizike
 1. të folurit si mekanizëm i krijimit - Zan. 1:3,6,9,11,14,20,24,26
 2. ecja (pra, zhurma e ecjes) në Eden – Zan. 3:8; 18:33; Lev. 26:12; LiP. 23:14
 3. mbyllja e derës së arkës së Noes – Zan. 7:16
 4. nuhatja e flijimeve – Zan. 8:21; Lev. 26:31; Amosi 5:21
 5. zbritja – Zan. 11:5; 18:21; Eks. 3:8; 19:11, 18, 20
 6. varrosja e Moisiut – LiP. 34:6

C. Ndjenja njerëzore (disa shembuj)

1. keqardhje/pendim - Zan. 6:6,7; Eks. 32:14; Gjyq. 2:18; 1 Sam. 15:29,35; Amos 7:3,6
2. zemërim - Eks. 4:14; 15:7; Num. 11:10; 12:9; 22:22; 25:3,4; 32:10,13,14; LiP. 6:15; 7:4; 29:20
3. xhelozit - Eks. 20:5; 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15; 32:16,21; Joz. 24:19
4. neveri/pështirosje - Lev. 20:23; 26:30; LiP. 32:19

D. Terma familjarë

1. Atë
 - a. i Izraelit - Eks. 4:22; LiP. 14:1; Isa. 1:2; 63:16; 64:8; Jer. 31:9; Os. 11:1
 - b. i mbretit - 2 Sam 7:11-16; Psa. 2:7
 - c. metafora të veprimeve atërore - LiP. 1:31; 8:5; 32:6-14; Psa. 27:10; Pro. 3:12; Jer. 3:4,22; 31:20; Osea 11:1-4; Mal. 3:17
2. Prind – Osea 11:1-4
3. Nënë – Isa. 49:15; 66:9-13 (analogjia e nënës që jep gjë)
4. I dashuri besnik në moshë të re – Osea 1-3

II. Arsyet për përdorimin e kësaj lloj terminologjie

- A. Është e domosdoshme që Perëndia t'ua zbulohet vetë qenieve njerëzore. Vetë koncepti i përhapur i Perëndisë si mashkull është antropomorfizëm, pasi Perëndia është frymë!
- B. Perëndia merr aspektet më kuptimplota të jetës njerëzore dhe i përdor për t'ua zbuluar njerëzimit (atë, nënë, prind, i dashur)
- C. Ndonëse e domosdoshme, Perëndia nuk dëshiron të kufizohet nga asnjë formë fizike (shih Eksodi 20; Ligji i Përtërirë 5)
- D. Antropomorfizmi më absolut është mishërimi i Jezusit! Perëndia u bë fizik, i prekshëm (shih 1 Gjonit 1:1-3). Mesazhi i Perëndisë u bë Fjala e Perëndisë (shih Gjonit 1:1-18).

■ **“kaq”** Fjalë për fjalë, kjo do të thotë “në mënyrë të tillë” (p.sh., 7:46; 11:48; 18:22). Ajo shpreh metodë, jo ndjenjë! Perëndia e demonstroi dashurinë e vet (shih Rom. 5:8) duke dhënë (v. 16) dhe duke dërguar (v. 17, të dyja janë DËFTORE AORISTE VEPRORE) Birin e vet që të vdiste për hir të njerëzimit (shih Isaia 53; Rom. 3:25; 2 Kor. 5:21; 1 Gjonit 2:2).

■ **“botën”** Gjoni e përdori këtë term, *kosmos*, në disa kuptime (shih shënimin te 1:10 dhe Temën e Veçantë te 14:17).

Po kështu, ky varg hodhi poshtë dualizmin gnostik midis shpirtit (Perëndisë) dhe materies. Grekët prireshin që t'ua atribuonin ligësi materies. Për ta, materia (pra, trupi njerëzor) ishte burgu i shkëndijës hyjnore në gjithë njerëzit. Gjoni nuk e quan të ligë materien, apo mishin. Perëndia e deshi botën (planetin, shih Rom. 8:18-22) dhe qeniet njerëzore (mishi, shih Rom. 8:23). Kjo mund të jetë një paqartësi (dykuptimësi) e qëllimshme, diçka e zakonshme për Gjonin (shih 1:5; 3:3, 8).

■ **“Birin e vetëmlindur”** Do të thotë “unik, i pashoq”. Nuk duhet kuptuar si “i vetëmlindur” në (1) kuptimin seksual, apo (2) në kuptimin se nuk ka fëmijë të tjerë. Nuk ekzistojnë të tjerë fëmijë si Jezusi. Shih shënimin e plotë te 1:14.

■ **“kushdo që beson në të”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE, e cila thekson besimin fillestar dhe të vazhdueshëm. Shih Temat e Veçanta te 1:14 dhe 2:23. Ky pohim përsëritet nga v. 15 për theksim. Lavdi Zotit për fjalën “kushdo”! Kjo duhet të shërbejë si kundërpeshë për çdo mbitheksim të ndonjë grupimi të veçantë (racor, intelektual, apo teologjik). Jo se “soveraniteti i Perëndisë” dhe “vullneti i lirë njerëzor” përjashtojnë njeri-tjetrin; ata janë të dy të vërtetë! Perëndia është gjithmonë ai që i jep fillesë përgjigjes dhe cakton agjendën (shih 6:44, 65), por ai e ka strukturuar marrëdhënien e vet me njerëzit me anë të besëlidhjes. Ata duhet të përgjigjen dhe të vazhdojnë t'ua përgjigjen ofertës dhe kushteve të tij! *fileō*

TEMË E VEÇANTË: PARACAKTIMI (KALVINIZMI) KUNDËR VULLNETIT TË LIRË NJERËZOR (ARMINIANIZMI)

Titit 2:11 shërben si drejtpeshues për pasazhet e tjera të DhR për zgjedhjen. Mendoj se do të ishte më e dobishme nga ana teologjike po t'ju siguroj shënimet e komentarit tim nga Romakëve 8:29 dhe 9, si dhe nga Efesianëve 1.

- I. Romaëkve 8:29 – Pali përdor “paranjohu (*proginōskō*, “njoh më parë”) dy herë, këtu dhe te 11:2. Te 11:2, bëhet fjalë për dashurinë e besëlidhjes së Perëndisë për Izraelin përpara se të fillonte koha. Mos harroni se termi “njoh” në hebraisht fliste për një marrëdhënie të ngushtë dhe personale, jo për fakte rreth dikujt (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). Këtu, ajo u përfshi në një zinxhir ngjarjesh të përjetshme (shih Rom. 8:29-30). Ky term lidhej me paracaktimin. Megjithatë, duhet thënë se paranjohja e Perëndisë nuk është baza e zgjedhjes sepse, po të ishte kështu, atëherë zgjedhja do të bazohej në reagimin e ardhshëm të njerëzimit të rënë, gjë që do të ishte arritje njerëzore. Ky term gjendet edhe te Veprat 26:5; 1 Pjet. 1:2, 20 dhe 2 Pjet. 3:17.

A. “paranjohu” (*proginōskō*, “njoh më parë”)

Termet “paranjoh” dhe “paracaktaj” janë të dy fjalë të përbëra me PARAFJALËN “përpara” dhe, si rrjedhojë, duhen përkthyer “njoh më parë”, “caktoj kufij më parë”, ose “shënjoj më parë”. Pasazhet më të qarta për paracaktimin në DhR janë Rom. 8:28-30; Efe. 1:13-14; dhe Romakëve 9. Qartazi, këto pasazhe theksojnë se Perëndia është sovran. Ai është në kontroll të plotë të gjithçkaje. Ekziston një plan i paracaktuar hyjnor që po zbatohet në kohë. Megjithatë, ky plan nuk është arbitrar apo përzgjedhës. Ai bazohet, jo vetëm në sovranitetin dhe paranjohjen e Perëndisë, por edhe në karakterin e tij të pandryshueshëm plot dashuri, mëshirë dhe hir të pamerituar.

Duhet të kemi kujdes që individualizmi ynë perëndimor, apo zelli ynë ungjillor, të mos e ngjyrosë këtë të vërtetë të mahnitshme. Po kështu, duhet të ruhem se mos polarizohemi nga konfliktet historike dhe teologjike midis Augustinit dhe Pelagiusit, apo midis kalvinizmit dhe arminianizmit.

B. “paracaktaj” (*proorizō*, “caktoj kufij më parë”)

Paracaktimi nuk është një doktrinë që synon të kufizojë dashurinë, hirin dhe mëshirën e Perëndisë, as që të përjashtojë disa nga ungjilli. Ai synon që të forcojë besimtarët duke u formësuar botëkuptimin. Perëndia është për gjithë njerëzimin (shih 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9). Perëndia është në kontroll të gjithçkaje. Kush, apo çfarë, mund të na ndajë prej tij (shih Rom. 8:31-39)? Perëndia e sheh gjithë historinë si të tashme; njerëzit janë të kufizuar nga koha. Pikëvështrimi dhe aftësitë tona mendore janë të kufizuara. Nuk ka kundërshtim mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë të njerëzimit. Kjo është një strukturë besëlidhjeje. Është një shembull tjetër i së vërtetës që na jepet në tension dialektik. Doktrinat biblike na paraqiten nga pikëvështrime të ndryshme. Shpesh, na duken paradoksale. E vërteta është një drejtpeshim midis dysheve që, në dukje, janë të kundërta. Nuk duhet ta largojmë tensionin duke zgjedhur vetëm njërin nga të vërtetat. S’duhet të izolojmë asnjë të vërtetë biblike në dhomëza të veçuara.

Po kështu, është e rëndësishme të shtojmë se synimi i zgjedhjes nuk është vetëm qielli pasi të vdesim, por ngjashmëria me Krishtin tani (shih Rom. 8:29; Efe. 1:4; 2:10). Ne jemi zgjedhur që të jemi “të shenjtë dhe të panjolllosur”. Perëndia zgjedh të na ndryshojë në mënyrë që të tjerët të shohin ndryshimin dhe t’i përgjigjen me besim Perëndisë në Krishtin. Paracaktimi nuk është një privilegj personal, por një përgjegjësi besëlidhjeje. Kjo është e vërteta madhore e këtij pasazhi. Ky është synimi i krishterimit. Shenjtëria është vullneti i Perëndisë për çdo besimtar. Zgjedhja e Perëndisë është për ngjashmëri me Krishtin (shih Efe. 1:4), jo një pozitë e veçantë. Shëmbëlltyra e Perëndisë, që iu dha njeriut në krijim (shih Zan. 1:26; 5:1, 3; 9:6) duhet rimëkëmbur.

C. “për t’u bërë të ngjashëm me shëmbëllimin e Birit të tij” – Synimi përfundimtar i Perëndisë është rikthimi i shëmbëllimit të humbur nga Rënia. Besimtarët janë paracaktuar për ngjashmëri me Krishtin (shih Efe. 1:4).

II. Romakëve 9

A. Romakëve 9 është një nga pasazhet më të forta të DhR për sovranitetin e Perëndisë (tjetri është Efe. 1:3-14), ndërsa kapitulli 10 shpreh qartë dhe në mënyrë të përsëritur vullnetin e lirë të njerëzve (shih “të gjithë” v. 4; “kushdo” v. 11, 13; “të gjithë” v. 12 [dy herë]). Pali nuk

përpiqet kurrë të pajtojë këtë tension teologjik. Të dyja anët janë të vërteta! Shumica e doktrinave biblike na paraqiten si dyshe paradoksale ose dialektike. Shumica e sistemeve teologjike janë gjysmë të vërteta logjike. Augustinianizmi dhe kalvinizmi kundër gjysmë-pelagianizmit dhe arminianizmit përmbajnë elemente të vërtete dhe gabimi. Tensioni biblik midis doktrinave duhet preferuar në dallim nga sistemi teologjik dogmatik, racional dhe i bazuar në pasazhe të përzgjedhura, i cili e fut me zor Shkrimin brenda një kornize të parajgykuar interpretuese.

- B. Po kjo e vërtetë (që gjendet në Rom. 9:23) pohohet edhe te Rom. 8:29-30 dhe Efe. 1:4, 11. Ky kapitull është shprehja më e fortë e sovranitetit të Perëndisë në DhR. Nuk ka diskutim se Perëndia është në kontroll të plotë të krijimit dhe shpengimit. Kjo e vërtetë madhështore nuk duhet zbutur, apo dobësuar, kurrë. Megjithatë, ajo duhet ekuilibruar me zgjedhjen e besëlidhjes nga Perëndia si mjet për t'u lidhur me krijimin njerëzor të krijuar në shëmbëllimin e tij. Pa dyshim, është e vërtetë se disa besëlidhje të DhV, si Zanafilla 15, janë të pakushtëzuara dhe nuk kanë fare lidhje me reagimin njerëzor, por disa besëlidhje të tjera kushtëzohen nga reagimi njerëzor (p.sh., Edeni, Noeu, Moisiu, Davidi). Perëndia ka një plan shpengimi për krijimin e vet; asnjë njeri s'mund ta prishë këtë plan. Perëndia ka zgjedhur të lejojë individët që të marrin pjesë në planet e tij. Kjo mundësi për pjesëmarrje është një tension teologjik midis sovranitetit (Romakëve 9) dhe vullnetit të lirë njerëzor (Romakëve 10).

Nuk është e drejtë të përzgjedhësh një theksim biblik duke anashkaluar tjetrin.

Ekziston një tension mes doktrinave për shkak se njerëzit e lindjes e paraqesin të vërtetën në dyshe dialektike, ose të mbushura me tension. Doktrinat duhen ruajtur në marrëdhënie me doktrinat e tjera. E vërteta është një mozaik të vërtetash.

III. Efesianëve 1

- A. Zgjedhja është doktrinë e mrekullueshme. Megjithatë, ajo nuk është thirrje për favoritizëm, por thirrje për t'u bërë kanal, instrument, ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në DhV, ky term përdoret kryesisht për shërbesë; në DhR, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili çon në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i mbështet të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik do të ishte Romakëve 9 për zgjedhjen sovranë të Perëndisë dhe Romakëve 10 për përgjigjen e duhur njerëzore (shih 10:11, 13).

Çelësi për këtë tension teologjik mund të gjendet në 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të (Karl Bart). Jezusi është "po"-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Bart). Efesianëve 1:4 ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje edhe duke pohuar se synimi i paracaktimit nuk është vetëm qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne tërhiqemi nga dobitë e ungjillit, por anashkalojmë përgjegjësitë e tij! Thirrja e Perëndisë (zgjedhja) është për kohën, jo vetëm për përjetësinë!

Doktrinat vijnë në lidhje me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të palidhura dhe të veçuara. Një analogji e mirë do të ishte yjësia në dallim me një yll të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet të heqim tensionin e shkaktuar nga dyshtet dialektike (paradoksale) të të vërtetave doktrinor (Perëndia si transcendent në dallim nga Perëndia si imanent; siguria përkundër qëndresës; Jezusi si i barabartë me Atin por edhe Jezusi si i nënshtruar ndaj Atit; liria e krishterë përkundër përgjegjësisë së krishterë ndaj një partneri të besëlidhjes, etj.).

Koncepti teologjik i "besëlidhjes" e bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili merr gjithmonë nismën dhe përcakton planin e veprimit) me reagimin njerëzor me besim pendues të vazhdueshëm. Ruhë nga përdorimi i pasazheve të caktuara të njerës anë të paradoksit duke zhvlerësuar anën tjetër! Ruhë se mos pohon vetëm doktrinën ose sistemin teologjik të parapëlqyer.

- B. "Ai na zgjodhi", te Efe. 1:4, është DËFTORE AORISTE MESORE, që thekson KRYEFJALËN. Ajo fokusohet në zgjedhjen nga ana e Atit përpara kohës. Zgjedhja e Perëndisë nuk duhet kuptuar në sensin islamik të determinizmit, as në kuptimin ultra-kalvinist si disa njerëz kundër të tjerëve, por në kuptimin e besëlidhjes. Perëndia premtoi se do të shpengonte njerëzimin e rënë (shih Zan. 3:15). Perëndia thirri dhe zgjodhi Abrahamin që të zgjidhte gjithë njerëzit (shih Zan. 12:3; Eks. 19:5-6). Vetë Perëndia zgjodhi gjithë njerëzit që do të ushtronin besim në Krishtin. Perëndia merr gjithmonë nismën në shpëtim (shih Gjoni

6:44, 65). Ky pasazh, si dhe Romakëve 9, janë baza biblike për doktrinën e paracaktimit, e theksuar nga Augustini dhe Kalvini.

Perëndia i zgjodhi besimtarët jo vetëm për shpëtim (shfajësimi), por edhe për shenjtërim (shih Kol. 1:10-12). Kjo mund të ketë lidhje me (1) pozitën tonë në Krishtin (shih 2 Kor. 5:21), ose (2) dëshirën e Perëndisë për të riprodhuar karakterin e vet në fëmijët e tij (shih 2:10; Rom. 8:28-29; Gal. 4:19). Vullneti i Perëndisë për fëmijët e tij është, si qielli një ditë, ashtu dhe ngjashmëria me Krishtin tani!

“Në të” është koncept kyç te Efe. 1:4. Bekimet, hiri dhe shpëtimi i Atit rrjedhin përmes Krishtit (shih Gjoni 14:6). Vini re përsëritjen e kësaj forme gramatikore (VENDORE E SFERËS) në v. 3, “në Krishtin”; v. 4, “në të”; v. 7, “në të”; v. 9, “në të”; v. 10, “në Krishtin”, “në të”; v. 12, “në Krishtin” dhe v. 13, “në të” (dy herë). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për njerëzimin e rënë (Karl Bart). Jezusi është njeriu i zgjedhur dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të. Të gjitha bekimet e Perëndisë Atë rrjedhin përmes Krishtit.

Fraza “përpara themelimit të botës” përdoret edhe te Mat. 25:34; Gjoni 17:24; 1 Pje. 1:19-20 dhe Zbu. 13:8. Ajo tregon veprimtarinë shpenguese të Perëndisë Triun edhe përpara Zan. 1:1. Njerëzit janë të kufizuar nga koncepti i tyre për kohën; gjithçka për ne është e shkuar, e tashme dhe e ardhme, por s’është kështu për Perëndinë.

Synimi i paracaktimit është shenjtëria, jo privilegji. Thirrja e Perëndisë nuk është vetëm për disa të përzgjedhur nga fëmijët e Adamit, por për të gjithë! Ajo është një thirrje për të qenë siç synon Perëndia të jetë njerëzimi, pra si vetë ai (shih 1 Thes. 5:23; 2 Thes. 2:13); në shëmbëllimin e tij (shih Zan. 1:26-27). Ta kthesh paracaktimin në dogmë teologjike dhe jo në një jetë të shenjtë është tragjedi. Shpesh, teologjia jonë flet më fort se teksti biblik.

Termi “i panjollë” (*amōmos*), apo “pa asnjë të metë”, përdoret për (1) Jezusin (shih Heb. 9:14; 1 Pjet. 1:19); (2) Zakarinë dhe Elizabetën (shih Luka 1:6); (3) Palin (shih Fil. 3:6); dhe (4) gjithë të krishterët e vërtetë (shih Fil. 2:15; 1 Thes. 3:13; 5:23). Vullneti i pandryshueshëm i Perëndisë për çdo të krishterë nuk është vetëm qielli më vonë, por ngjashmëria me Krishtin tani (shih Rom. 8:29-30; Gal. 4:19; 1 Pjet. 1:2). Besimtarët duhet të pasqyrojnë karakteristikat e Perëndisë në një botë të humbur me synim ungjillizimin.

Gramatikisht, fraza “në dashuri”, në këtë varg, mund të lidhet ose me v. 4, ose me v. 5. Sidoqoftë, kur kjo frazë përdoret në pasazhe të tjera te Efesianët gjithmonë i referohet dashurisë njerëzore për Perëndinë (shih 3:17; 4:2, 15, 16).

- C. Në Efe. 1:5, fraza “ai na paracaktoi” është PJESORE AORISTE VEPRORE. Ky term greqisht është fjalë e përbërë nga “përpara” dhe “shënjoj”. Bën fjalë për planin shpengues e të paracaktuar të Perëndisë (shih Luka 22:22; Veprat 2:23; 4:28; 17:31; Rom. 8:29-30). Paracaktimi është një nga të vërtetat e shumta që lidhen me shpëtimin e njerëzimit. Është pjesë e një modeli teologjike, ose serie të vërtetash të lidhura me njëra-tjetrën. Paracaktimi nuk duhet kurrë të theksohej i izoluar! E vërteta biblike na është dhënë nëpërmjet një sërë dyshesh paradoksale, të mbushura me tension. Denominacionalizmi është prirur ta largojë tensionin biblik duke theksuar vetëm njërin nga të vërtetat dialektike (paracaktimi përkundër vullnetit të lirë; siguria e besimtarit përkundër qëndresës së shenjtorëve; mëkati fillestar përkundër mëkatis të vullnetshëm; pamëkatshmëria përkundër mëkatimit më pak; shenjtërimit të shpallur aty për aty përkundër shenjtërimit të përshkallëzuar; besimi kundër veprave; liria e krishterë përkundër përgjegjësisë së krishterë; transcendenca përkundër imanencës).

Zgjedhja e Perëndisë nuk bazohet në paranjohjen e përpjekjes njerëzore, por në karakterin e tij të hirshëm (shih v. 9 dhe 11). Ai dëshiron që të gjithë (jo vetëm disa të veçantë, si gnostikët, apo ultra-kalvinistët e ditëve tona) të shpëtohen (shih Ezek. 18:21-23, 32; Gjoni 3:16-17; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titi 2:11; 2 Pjet. 3:9). Hiri i Perëndisë (karakterit i Perëndisë) është çelësi teologjik i këtij pasazhi (shih v. 6a, 7c, 9b), ashtu si mëshira e Perëndisë është çelësi për pasazhin tjetër të paracaktimit, Romakëve 9-11.

Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është hiri dhe mëshira e Perëndisë (shih Isa. 53:6 dhe një sërë pasazhesh të tjera nga DhV, që citohen në Rom. 3:9-18). Është thelbësore që, kur interpretojmë këta kapituj të parë teologjikë, të kuptojmë se Pali thekson ato gjëra që s’kanë fare lidhje me përpjekjet njerëzore: përcaktimin (kap. 1), hirin (kap. 2) dhe planin e përjetshëm të Perëndisë për shpengimin (misteri, 2:11-3:13). Kjo duhet të shërbente si kundërpeshë për theksimin që i bënin mësuesit e rremë meritës dhe krenarisë njerëzore.

■ **“të mos humbasë”** Nënkuptimi është se disa do të humbasin (LIDHORE AORISTE MESORE). Humbja e tyre (*apollumi*, LIDHORE AORISTE MESORE) është e lidhur drejtpërdrejt me mungesën e reagimit të tyre me besim ndaj Jezusit (shih 11:25). Perëndia nuk shkakton, drejton, apo dëshiron mosbesimin e tyre (shih Ezek. 18:23, 32; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9).

Shumë janë përpjekur ta marrin në mënyrë të fjalëpërfjalshme këtë term dhe, në këtë mënyrë, nënkuptojnë asgjësimin e të ligjve. Kjo do të binte në kundërshtim me Dan. 12:2 dhe Mat. 25:46. Ky është një shembull i mirë sesi besimtarët e singertë e fusin me detyrim literaturën tejet të figurshme lindore brenda një formati interpretues perëndimor (të fjalëpërfjalshëm dhe logjik). Për një diskutim të mirë për këtë term, shih Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, f. 275-277. Shih Temën e Veçantë: Shkatërrim (*apollumi*) në 10:10.

Sërish, vini re sesi Gjoni mendon dhe shkruan me kategori dualiste (pra, humbas në kontrast me jetën e përjetshme). Fjalori dhe strukturimi teologjik i mësimëve të Jezusit janë shumë të ndryshëm nga ata të ungjijve sinoptikë. Kjo të bën të pyesësh veten se sa liri (nën udhëzimin hyjnor, pra, nën frymëzim) kishin shkrimtarët e ungjijve kur përgatitën paraqitjet e tyre ungjillëzuese të Jezusit para audiencave të tyre të zgjedhura. Shih Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 127-148.

3:17 “për të gjykuar botën” Ka disa pasazhe të Gjonit që pohojnë se Jezusi erdhi si Shpëtimtar, jo si Gjykatës (shih 3:17-21; 8:15; 12:47). Megjithatë, ka disa pasazhe të tjera të Gjoni që pohojnë se Jezusi erdhi për të gjykuar, dhe do të gjykojë (shih 5:22-23, 27; 9:39; si dhe pjesë të tjera të DhR, Veprat 10:42; 17:31; 2 Tim. 4:1; 1 Pjet. 4:5).

Është vendi të bëjmë disa komente teologjike.

1. Perëndia i dha gjykimin Jezusit, siç i dha dhe krijimin e shpengimin, si shenjë nderimi (shih 5:23)
2. Jezusi nuk erdhi herën e parë për të gjykuar, por për të shpëtuar (shih 3:17), por për shkak se njerëzit e refuzojnë, gjykojnë veten
3. Jezusi do të kthehet si Mbret i mbretërve dhe si Gjykatës (shih 9:39)

3:18 Ky varg përsërit motivin e shpëtimit falas përmes Krishtit në kontrast me gjykimin që njeriu sjell mbi veten. Njerëzit në ferr nuk i dërgon Perëndia. Ata dërgojnë veten aty. Besimi ka rezultate të vazhdueshme (“duke besuar”, PJESORE E TASHME VEPRORE); po kështu dhe mosbesimi (“është gjykuar”, DËFTORE E KRYER PËSORE dhe “nuk ka besuar”, DËFTORE E KRYER PËSORE). Shih Temat e Veçanta të 2:23 dhe 9:7.

3:19-21 “njerëzit deshën errësirën më tepër se dritën” Shumë njerëz që kanë dëgjuar ungjillin e refuzojnë, jo për arsye mendore apo kulturore, por, kryesisht për arsye morale (shih Jobi 24:13). Drita nënkupton Krishtin (shih 1:9; 8:12; 9:5; 12:46) dhe mesazhin e tij për dashurinë e Perëndisë, nevojën e njerëzimit, sigurimin e Krishtit dhe përgjigjen e nevojshme. Ky është një motiv i përsëritur nga 1:1-18.

3:19 “Ky është gjykimi” Gjykimi, ashtu si shpëtimi, është edhe realitet i tanishëm (shih 3:19; 9:39) edhe përmbushje në të ardhmen (shih 5:27-29; 12:31, 48). Besimtarët jetojnë në “tashmë” (eskatologjia e përmbushur), por edhe në “jo ende” (eskatologjia e përmbushur). Jeta e krishterë është gëzim dhe betejë e tmerrshme; është fitore pas një sërë dështimesh; është siguri, por edhe një sërë paralajmërimesh për qëndresë!

3:21 “praktikon të vërtetën” Meqë “Drita” (shih v. 19, 20 [dy herë], 21) është referencë e qartë për Jezusin, ka mundësi që edhe “e vërteta” duhet shkruar me V të madhe. Robert Hanna, në *A Grammatical Aid to the Greek New Testament*, citon N. Turner dhe librin e tij *Grammatical Insights into the New Testament*, i cili e përkthen “njeriu që është dishepull i së Vërtetës” (f. 144).

Nga ana teologjike, ky varg shpreh të njëjtën të vërtetë si Mateu 7. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme. Njeriu nuk mund të mbetet i njëjti pasi takohet vërtet me Perëndinë në Krishtin dhe mbushet me Frymën e Shenjtë. Shëmbëlltyra e tokës dhe farës përqendrohet në prodhimin e frytit, jo në mbirjen e farës (shih Mat. 13; Marku 4; Luka 8). Vini re gjithashtu diskutimin e Gjonit në 15:1-11). Veprat nuk fitojnë shpëtimin, por janë provë e tij (shih Efe. 2:8-9, 10).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'ia kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Cili është kuptimi i frazës “rilindur”?
2. Sipas teje, kujt i referohet “uji” në vargun 5 dhe pse?
3. Çfarë nënkupton “besoj” (besimi shpëtues)?
4. A është Gjoni 3:16 një pasazh për dashurinë e Jezusit për njerëzimin, apo për dashurinë e Atit?
5. Si lidhet kalvinizmi me Gjonin 3:16?
6. A nënkupton “humbas” asgjësimin përfundimtar?
7. Përcakto fjalën “drita”.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 22-36

- A. Theksimi që i bën Gjoni natyrës së plotë hyjnore të Jezu Krishtit përçohet që nga fillimi i ungjillit përmes dialogëve dhe takimeve personale. Ky kapitull e vazhdon atë format.
- B. Gjoni, i cili e shkroi ungjillin e vet nga fundi i shekullit të parë, po trajton disa nga pyetjet që ishin zhvilluar që nga koha kur u shkruan ungjijtë sinoptikë. Një prej tyre ka të bëjë me ndjekësit e shumë dhe, me sa duket, me herezitë e hershme që lidheshin me Gjon Pagëzorin (shih Veprat 18:24-19:7). Është domethënëse se, në 1:6-8, 19-36 dhe 3:22-36, Gjon Pagëzori pohon pozicionin e tij më të ulët në marrëdhënie me Jezusin e Nazaretit dhe mbështet rolin mesianik të Jezusit.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:22-24

²²Pas këtyre gjërave, Jezusi dhe dishepujt e tij erdhën në tokën e Judesë, dhe aty ai kaloi kohë me ta dhe pagëzonte. ²³Edhe Gjoni po pagëzonte në Enon, pranë Salimit, ngaqë aty kishte shumë ujë; dhe njerëzit vinin dhe po pagëzoheshin, ²⁴sepse Gjoni nuk ishte futur ende në burg.

3:22 “erdhi në tokën e Judesë” Kjo shërbesë e hershme në Jude dhe në Galile nuk diskutohet në ungjijtë sinoptikë. Ungjijtë nuk janë biografi kronologjike të Krishtit. Shih Gordon Fee dhe douglas Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 127-148.

▣ **“ai kaloi kohë me të”** Jezusi u predikoi turmave, por kuvendoi gjerë e gjatë me dishepujt e vet. Ai u jepej me gjithë zemër. Kjo metodologji është fokusi i dy librave të mrekullueshëm të Robert E. Coleman, *The Master Plan of Evangelism* dhe *The Master Plan of Discipleship*, të cilët theksojnë përfshirjen personale të Jezusit me një grup të vogël!

▣ **“dhe pagëzonte”** Nga 4:2 mësojmë se nuk po pagëzonte vetë Jezusi, por dishepujt e tij. Mesazhi i Jezusit në fillim ishte shumë i ngjashëm me atë të Gjon Pagëzorit. Ishte një mesazh i DhV për pendim dhe përgatitje. Pagëzimi i përmendur këtu nuk është pagëzimi i krishterë, por një pagëzim që simbolizonte pendimin dhe gjendjen e hapur shpirtërore.

3:23 “Edhe Gjoni po pagëzonte në Enon, pranë Salimit” Vendndodhja e këtij vendi është e paqartë.

1. Disa besojnë se ishte në Perea, në zonën përtej Jordanit
2. Disa besojnë se ishte në Samarinë verilindore
3. Disa besojnë se ishte 4.5 kilometra në lindje të qytetit të Shekemit

Meqë “*aenon*” duket se nënkupton “rrjedhë”, #3 përputhet më së miri. Cilido qoftë vendi i saktë, Jezusi po shërbente në Jude, ndërsa Gjoni ishte diku në largësi të shkurtër në veri të tij.

3:24: “sepse Gjoni nuk ishte futur ende në burg” Është e paqartë pse shtohet ky element kronologjik në këtë pikë. Disa thonë se është përpjekje për të sinkronizuar kronologjinë e Gjonit me atë të sinoptikëve (shih Mat. 14:1-12; Marku 6:14-29). Ai funksionon si mënyrë datimi për këtë përballje në jetën e Krishtit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:25-30

²⁵Atëherë, lindi një diskutim nga ana e dishepujve të Gjonit me një jude për pastrimin. ²⁶Dhe ata erdhën te Gjoni dhe i thanë: “Rabbi, ai që ishte me ty përtej Jordanit, për të cilin ke dëshmuar, ja, ai po pagëzon dhe të gjithë po shkojnë tek ai”. ²⁷Gjoni u përgjigj dhe tha: “Njeriu nuk mund të marrë asgjë nëse ajo nuk i jepet atij nga qielli. ²⁸Ju vetë më jeni dëshmitarë që thashë: „unë nuk jam Krishti”, por „jam dërguar përpara tij”. ²⁹Ai që ka nusen është dhëndri; por miku i dhëndrit, i cili qëndron dhe e dëgjon, gëzohet se tepërmi nga zëri i dhëndrit. Prandaj, ky gëzimi im është përbushur. ³⁰Ai duhet të rritet, ndërsa unë duhet të zvogëlohem”.

3:25 “lindi një diskutim nga ana e dishepujve të Gjonit me një jude” “Diskutim” (NASB, NRSV, NJB) është fjalë e fortë, që do të thotë “debat”, ose “përballje”. Disa dorëshkrime greqisht kanë SHUMËSIN “judenj”. Dorëshkrimet e lashta greqisht janë të ndara në mënyrë të barabartë. Për shkak se NJËJËSI është më i pazakontë (p.sh., MSS P²⁵, K², A, B, L, W), ka gjasa të jetë origjinali. UBS⁴ i jep një vlerësim “B” (pothuajse i sigurt). Priorja e kopjuesve të lashtë ishte të harmonizonin dhe të “lëmonin” tekstin. Po kështu, është interesante të vërejmë se, ndoshta, këtë debat e nisën dishepujt e Gjonit.



NASB, NKJV,

NRSV, NJB “për pastrimin”

TEV

“çështja e larjes rituale”

Ka patur një sërë teorish për fokusin e kësaj polemike (NKJV).

1. ndoshta, ndjekësit e Gjonit po diskutonin për marrëdhënien mes pagëzimit të Gjonit dhe atij të Jezusit në lidhje me traditat judaike të larjeve; i njëjti term përdoret edhe te 2:6.
2. disa besojnë se kjo lidhet me kontekstin e atypëratyshëm, ku Jezusi po mëson se jeta dhe shërbesa e tij përbushnin plotësisht judaizmin
 - a. 2:1-12, dasma në Kanë
 - b. 2:13-22, pastrimi i tempullit
 - c. 3:1-21, diskutimi me Nikodemin, një ndër krerët e judenjve
 - d. 3:22-36, larjet e judenjve dhe pagëzimet e Gjon Pagëzorit dhe Jezusit.

Fakti se konteksti nuk shtjellohet më tej për këtë diskutim të veçantë thekson faktin se ai i dha Gjon Pagëzorit një mundësi tjetër që të dëshmonte për epërsinë e Jezusit të Nazaretit.

3:26 “për të cilin ke dëshmuar, ja, ai po pagëzon dhe të gjithë po shkojnë tek ai” Dishepujve iu kujtua dëshmia më e hershme e Gjonit për Qengjin e Perëndisë (shih 1:19-36), dhe, me sa duket, ishin disi ziliqarë për suksesin (hiperbolë) e Jezusit. Edhe Jezusi ishte i ndjeshëm ndaj çdo fryme konkurrimi (shih 4:1).

3:27 “Njeriu nuk mund të marrë asgjë nëse ajo nuk i jepet atij nga qielli” Ky është një pohim tejet i drejtpërdrejtë se nuk ka konkurrencë në çështje shpirtërore. Gjithçka që kanë besimtarët iu është dhënë nga hiri i Perëndisë. Sidoqoftë, ka patur shumë diskutime për kuptimin e “ajo” dhe “atij”.

1. disa thonë se “atij” i referohet besimtarit, ndërsa “ajo” është ardhja e njeriut te Krishti për shpëtim (Perëndia ka nismën, njerëzit mjafton të përgjigjen, shih Gjoni 6:44, 65)
2. të tjerë besojnë se “atij” i referohet Jezusit, ndërsa “ajo” u referohet besimtarëve (shih Gjoni 6:39; 10:29; 17:2, 9, 11, 24)

Dallimi mes këtyre dy pikëpamjeve do të ishte se termi “i jepet” nënkupton, ose shpëtimin e besimtarit si individ, ose se të gjithë besimtarët janë vetë dhuratë e Perëndisë për Jezusin (shih 17:2).

3:28: “unë nuk jam Krishti” Gjon Pagëzori pohon në mënyrë të veçantë, siç bëri dhe te 1:20, se ai nuk është Mesia, por pararendësi i tij. Ky është dukshëm aludim për pasazhet profetike të Mal. 3:1; 4:5-6, kombinuar me Isainë 40 (shih Gjoni 1:23). Shihni shënimin për “Mesinë” te 1:20 dhe Temën e Veçantë te 4:25.

3:29 “ai që ka nusen është dhëndri” Është goditëse që ka kaq shumë aludime nga DhV për këtë metaforë martese për të përshkruar marrëdhënien mes Perëndisë dhe Izraelit (shih Isa. 54:5; 62:4, 5; Jer. 2:2; 3:20; Ezek. 16:8; 23:4; Os. 2:21). Edhe Pali e përdor te Efe. 5:22 e më tej. Martesa e krishterë është shembulli më i mirë sot për marrëdhënien e besëlidhjes.

▣ **“Prandaj, ky gëzimi im është përmbushur”** EMRI “gëzim” dhe FOLJA “gëzohem” përdoren tri herë në këtë varg. Në vend që të kishte një shpirt konkurrues, Gjon Pagëzori e kuptoi qartë pozicionin e vet dhe u gëzua në Jezusin.

3:30 “Ai duhet të rritet, ndërsa unë duhet të zvogëlohem” Termi “duhet” (*dei*) këtu është domethënës. Është përdorur tashmë në 3:14, por përdoret edhe te 4:4. Përbën një pohim të fuqishëm të faktit se Gjoni e kuptonte veten thjesht si pararendës të shërbesës më të madhe dhe më të rëndësishme të Jezusit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:31-36

³¹“Ai që vjen nga lart është mbi të gjithë; ai që është nga dheu vjen nga dheu dhe flet për dheun. Ai që vjen nga qielli është mbi të gjithë. ³²Ai dëshmon për atë që ka parë dhe dëgjuar; dhe askush nuk e pranon dëshminë e tij. ³³Ai që ka pranuar dëshminë e tij ka vendosur vulën e tij mbi këtë: pra, se Perëndia është i vërtetë. ³⁴Sepse ai që ka dërguar Perëndia flet fjalët e Perëndisë; sepse ai jep Frymën pa masë. ³⁵Ati e do Birin dhe i ka dhënë të gjitha gjërat në duart e tij. ³⁶Ai që beson në Birin ka jetën e përjetshme; por ai që nuk i bindet birin, nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të”.

3:31-36 Ka patur shumë diskutime ndër komentatorët nëse këto vargje janë

1. thënie të pashkëputura verbale të Gjon Pagëzorit
2. fjalë të Jezusit (shih 3:11-12)
3. fjalë të apostullit Gjon

Këto vargje u kthehen tematikave të v. 16-21.

3:31 “Ai që vjen nga lart” Është domethënëse se dy titujt e përdorur për Mesinë theksojnë paraekzistencën dhe natyrën e tij të plotë (të nënkuptuara në v. 31), mishërimin e tij, si dhe misionin që i kishte dhënë Perëndia (e nënkuptuar në v. 34). Termi “nga lart” është i njëjti term i përdorur në frazën “lindur sërish” ose “lindur nga lart” në v. 3.

Ky dualizëm “lart/poshtë”, apo sfera e Perëndisë në dallim nga sfera tokësore e njerëzimit, është karakteristik për Gjonin. Ai ndryshon nga dualizmi eskatologjik i Pergamenave të Detit të Vdekur. Po kështu, ndryshon edhe nga dualizmi gnostik i shpirtit dhe lëndës. Te Gjoni, vetë krijimi dhe trupi njerëzor nuk janë të ligj, apo të mëkatshëm, në vetvete.

▣ **“mbi të gjithë... mbi të gjithë”** Pjesa e parë e këtij vargu aludon për natyrën hyjnore dhe paraekzistencën e Krishtit, gjë që vjen nga qielli (shih 1:1-18; 3:11-12). Pjesa e dytë e këtij vargu pohon se Jezusi është mbi krijimin e Perëndisë. Është e paqartë nga teksti greqisht nëse “të gjithë” është MASHKULLORE apo ASNJANËSE, pra, nëse i referohet gjithë njerëzimit apo gjithë gjërave. “Mbi të gjithë” e dytë mungon në disa tekste greqisht. UBS⁴ nuk arrin do të vendosë për përfshirjen e saj, presupozimet e kritikës së tekstit (shih Shtojcën Dy) do të preferonin përfshirjen e saj.

▣

NASB “ai që është nga dheu, vjen nga dheu dhe flet për dheun”

NKJV “ai që është nga toka, është tokësor dhe flet për tokën”

NRSV “Ai që është nga toka, i përket tokës dhe flet për gjëra tokësore”

TEV “ai që vjen nga toka i përket tokës dhe flet për gjëra tokësore”

NJB “ai që është nga tokë, është vetë tokësor dhe flet në mënyrë tokësore”

Ky nuk është pohim negativ për Gjonin. Këtu, termi “nga dheu” (*gē*, 12:32; 17:4; 1 Gjonit 5:8, por 76 herë në Zbulesë) nuk është i njëjti term si “bota” (*kosmos*), që përdoret shpesh në mënyrë negative nga Gjoni. Ky pohim thotë thjesht se Jezusi foli në bazë të asaj që dinte, nga qielli, ndërsa gjithë qeniet njerëzore flasin në bazë të asaj që dinë, nga dheu. Si rrjedhojë, dëshmia e Jezusit është shumë më e lartë se ajo e çdo profeti apo predikuesi tokësor (shih Heb. 1:1-4).

3:32 “Ai dëshmon për atë që ka parë dhe dëgjuar” Në këtë varg kemi një lojë fjalësh me KOHËT E FOLJEVE: (1) “parë” është në KOHËN E KRYER; (2) dëgjuar” është në KOHËN AORISTE; dhe (3) “dëshmon” është në KOHËN E TASHME. Jezusi është zbulues absolute e Perëndisë (shih 1 Kor. 8:6; Kol. 1:13-20; Heb. 1:2-3). Ai flet nga (1) përvoja e tij personale me Perëndinë Atë dhe (2) nga natyra e vet hyjnore.

▣ **“dhe askush nuk e pranon dëshminë e tij”** Ky është një ekzagjerim lindor, pasi v. 23-26 tregojnë se shumë njerëz po shkonin tek ai. Kjo frazë i referohet judaizmit në tërësi (shih 3:11), jo vetëm kontekstit të atypëratyshëm.

3:33 “Ai që” Kjo tregon dashurinë e përbotshme dhe të pakufizuar të Perëndisë për gjithë qeniet njerëzore. Nuk ka pengesa në lidhje me ungjillin e Perëndisë; njeriu duhet të pendohet dhe të besojë (shih Marku 1:15; Veprat 20:21), por oferta është e hapur për të gjithë (shih 1:12; 3:16-18; 4:42; 1 Tim. 2:4; Titi 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:1; 4:14).

▣ **“ka pranuar dëshminë e tij”** Vargu 33 është PJESORE AORISTE, ndërsa v. 36 është PJESORE E TASHME. Kjo tregon se besimi te Perëndia për shpëtim nuk është vetëm një vendim fillestar, por edhe një jetë dishepullizimi. I njëjti pohim i nevojës për pranim është shprehur më herët te 1:12 dhe 3:16-18. Vini re dikotominë midis pranim të dëshmisë (v. 33) dhe vazhdimësisë së ecjes në të (v. 36). Termi “pranoj”, njësoj si termi “besim”, ka dy ngjyrimë në DhR.

1. pranimi personal i Krishtit dhe ecja në të
2. pranimi i të vërtetave dhe doktrinave që përfshihen në ungjill (shih Juda 3, 20)

▣

NASB “ka vendosur vulën e tij mbi këtë: pra, se Perëndia është i vërtetë”

NKJV, NRSV “ka vërtetuar se Perëndia është i vërtetë”

TEV “me këtë pohon se Perëndia është i vërtetë”

NJB “po pohon se Perëndia është i vërtetë”

Kur besimtarët e vendosin besimin e tyre personal në Krishtin, pohojnë se mesazhi i Perëndisë për veten, botën, njerëzimin dhe Birin e vet, është i vërtetë (shih Rom. 3:4). Kjo është temë e përsëritur te Gjoni (shih 3:33; 7:28; 8:26; 17:3; 1 Gjonit 5:20). Jezusi është i vërtetë pasi, në mënyrë absolute, ai na zbulon Perëndinë e vetëm të vërtetë (shih 3:7, 14; 19:11).

Për FOLJEN “vulos” (DËFTORE AORISTE VEPRORE) shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: VULË

Vula mund të ketë qenë mënyrë e lashtë për të treguar

1. të vërtetën (shih Gjoni 3:33)
2. pronësinë (shih Gjoni 6:27; 2 Tim. 2:19; Zbu. 7:2-3)
3. siguri ose mbrojtje (shih Zan. 4:15; Mat. 27:66; Rom. 15:28; 2 Kor. 1:22; Efe. 1:13; 4:30)
4. mund të jetë edhe shenjë e realitetit të premtimit të një dhurate nga Perëndia (shih Rom. 4:11 dhe 1 Kor. 9:2)

Qëllimi i kësaj vule është të identifikojë popullin e Perëndisë në mënyrë që zemërimi i Perëndisë të mos i prekë. Vula e Satanit identifikon njerëzit e tij, të cilët janë objekt i zemërimit të Perëndisë. Në Zbuluesë, “mundimi” (pra, *thlipsis*) nënkupton gjithmonë përndjekjen e besimtarëve nga jobesimtarët, ndërsa zemërimi/tërbimi (pra, *orgē* ose *thumos*) është gjithmonë gjykimi i Perëndisë mbi jobesimtarët në mënyrë që ata të pendohen dhe të kthehen në besim te Krishti. Ky synim pozitiv i gjykimit mund të shihet në mallkimet/bekimet e besëlidhjes te Ligji i Përtërirë 27-28.

Fraza “Perëndia i gjallë” është lojë fjalësh me titullin JHVH (shih Eks. 3:14; Psa. 42:2; 84:2; Mat. 16:16). Kjo lojë fjalësh gjendet edhe në zotimet biblike, “ashtu si Zoti jeton”.

3:34: “Ai që ka dërguar Perëndia flet fjalët e Perëndisë” Ka dy pohime paralele në v. 34, të cilat tregojnë se autoriteti i Jezusit vjen nga Perëndia

1. Ai është dërguar nga Perëndia
2. Ai ka plotësinë e Frymës

■ **“sepse ai e jep Frymën pa masë”** Fjalë për fjalë, ky pohim ka formë mohuese, por, për lexuesit anglishtfolës forma pohore e rrok mirë kuptimin. Ka dy mënyra të ndryshme si të kuptojmë këtë plotësi të Frymës: disa besojnë se

1. Jezusi u jep plotësinë e Frymës besimtarëve (shih 4:10-14; 7:37-39)
2. se plotësia e Frymës nënkupton dhuratën që Perëndia i dha Mesisë (shih v. 35)

Rabinët e përdorin termin “masë” për të përshkruar frymëzimin e profetëve nga Perëndia. Po kështu, rabinët shtonin se asnjë profet nuk kishte masën e plotë të Frymës. Si rrjedhojë, Jezusi është më i lartë se profetët (shih Heb. 1:1-2) dhe, në këtë mënyrë, përbën zbuluesin e plotë të Perëndisë.

3:35 “Ati e do Birin” Ky pohim përsëritet në 5:20 dhe në 17:23-26. Marrëdhënia e besimtarëve me Perëndinë themelohet në dashurinë e tij për Mesinë (Biri i pashoq, shih Heb. 1:2; 3:5-6; 5:8; 7:28). Vini re numrin e arsyeve që shprehen në këtë kontest përse njerëzit duhet të kenë besim në Jezusin si Mesi.

1. sepse ai është nga lart dhe mbi gjithë të tjerët (v. 31)
2. sepse ai është dërguar nga Perëndia me misionin e shpengimit (v. 34)
3. sepse Perëndia vazhdon t’i japë plotësinë e Frymës (v. 34)
4. sepse Perëndia e do (v. 35)
5. sepse Perëndia i ka dhënë në dorë gjithçka (v. 35)

Ka një sërë fjalësh greqisht për “dashurinë”, të cilat nënkuptojnë marrëdhënie të ndryshme njerëzore.

Agapaō dhe *fileō* kanë një mbivendosje semantike. Të dyja përdoren për të përshkruar dashurinë e Atit për Birin.

1. 3:35; 17:23, 24, 26 - *agapaō*
2. 5:2 - *fileō*

Duket se ekziston vërtet një dallim kontekstual mes këtyre fjalëve në dialogun e Jezusit me Pjetrin te 21:15-17. Mos harroni, kuptimin e fjalëve e përcakton “konteksti, konteksti, konteksti!”, jo leksiku/fjalori!

■ **“i ka dhënë të gjitha gjërat në duart e tij”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Është idiomë hebraisht që nënkupton pushtet ose autoritet mbi dikë tjetër (shih 10:28; 13:3; Veprat 4:28; 13:11). Kjo është frazë jashtëzakonisht interesante dhe ka paralele të shumta (shih Gjoni 17:2; Mat. 11:27; 28:18; Efe. 1:20-22; Kol. 2:10; 1 Pjet. 3:22).

3:36

NASB “Ai që beson në Birin ka jetën e përjetshme; por ai që nuk i bindet Birit, nuk do të shohë jetë”

NKJV “Ai që beson në Birin ka jetën pa fund; dhe ai që nuk beson në Birin, nuk do të shohë jetë”

NRSV “Kushdo që beson në Birin ka jetën e përjetshme; kushdo që s’i bindet Birit, nuk do të shohë jetë”

TEV “Kushdo që beson në Birin ka jetën e përjetshme; kushdo që s’i bindet Birit, nuk do të ketë jetë”

NJB “Kushdo që beson në Birin ka jetën e përjetshme, por kushdo që refuzon të besojë në Birin nuk do të shohë kurrë jetë”

Këto FORMA FOLJORE janë të gjitha TË TASHME VEPRORE, pra flasin për veprim të vazhduar.

Besimi është më tepër sesa vendim i një momenti, pavarësisht sa i sinqertë apo emocional të ketë qenë (shih Mat. 13:20). Kjo do të thotë se, pa njohur Jezusin, njeriu nuk mund të njohë Atin (shih Gjoni 12:44-50 dhe 1 Gjonit 5:10). Shpëtimi vjen vetëm nëpërmjet një marrëdhënie të vazhdueshme me Jezusin, Birin (shih 10:1-18; 14:6).

KOHA E TASHME flet jo vetëm për veprim të vazhduar, por edhe për realitetin e tanishëm të shpëtimit. Shpëtimi është diçka që besimtarët e kanë tani, por që nuk është përfunduar ende plotësisht. Është dualizmi i “tashmë” por edhe “ende jo”-së së dy epokave (shih Tema e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka e Ardhshme, te 1 Gjonit 2:17). Shih Temën e Veçantë: Kohët e Foljeve të Përdorura për Shpëtimin në 9:7.

Gjithashtu, është interesant edhe kontrasti i “besoj” me “bindem” në këtë varg. Ungjilli nuk është vetëm një person që ne mirëpresim dhe një e vërtetë që pranojmë, por edhe një jetë që jetojmë (shih Luka 6:46; Efe. 2:8-10).

■ **“por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të”** Ky është i vetmi vend në shkrimet e Gjonit (përveç 5 herëve në Zbuluesin) ku shfaqet fjala “zemërim” (*orgē*). Ky koncept është i përhapur dhe, zakonisht, lidhet me termin “gjykim”. Folja është DËFTORE E TASHME VEPRORE. “Besimi”, “bindja” dhe “zemërimi” janë realitete të tanishme që do të përmbushen në të ardhmen. Ky është i njëjti tension që ekziston edhe midis koncepteve “tashmë” dhe “jo ende” të Mbretërisë së Perëndisë. Për një diskutim të plotë biblik për zemërimin e Perëndisë shih Rom. 1:18-3:20.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'ia kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Si ngjason mesazhi i hershëm i Jezusit me atë të Gjon Pagëzorit?
2. A është ky pagëzim i njëjtë me pagëzimin e krishterë?
3. Pse theksohen kaq shumë fjalët e Gjon Pagëzorit në kapitujt hyrës të Gjonit?
4. Përshkruaj numrin dhe llojin e kontrasteve që përdor autori, Gjoni, për të përshkruar marrëdhënien midis Gjon Pagëzorit dhe Jezusit?
5. Si lidhet termi “pranoj” në v. 33 me termin “besoj” në v. 36? Si lidhet me këtë diskutim termi “nuk bindet” në v. 36?
6. Rendit numrin e arsyeve që përmenden pse njerëzit duhet të besojnë në Jezusin e Nazaretit si shpresa e tyre e vetme për shpëtim? (vargjet 31-36)
7. Shpjego pse termi “zemërim” në vargun 36 është FOLJE NË KOHËN E TASHME.

GJONI 4

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi dhe gruaja nga Samaria 4:1-6	Një samaritanë takon Mesinë e saj 4:1-26	Jezusi dhe samaritanët 4:1-6	Jezusi dhe samaritanët 4:1-4 4:5-6	Jezusi ndër samaritanët 4:1-10
4:7-16		4:7-15	4:7-8 4:9 4:10 4:11-12 4:13-14 4:15	4:11-14 4:15-24
4:16-26		4:16-26	4:16 4:17a 4:17b-18 4:19-20 4:21-24 4:25	
4:27-30	Të korrat zbardhojnë 4:27-38	4:27-30	4:26 4:27 4:28-30	4:25-26 4:27-30
4:31-38		4:31-38	4:31 4:32 4:33	4:31-38
4:39-42	Shpëtimtari i botës 4:39-42	4:39-42	4:34-38 4:39-40 4:41-42	4:39-42
Shërimi i birit të nëpunësit 4:43-45	Mirëseardhja në Galile 4:43-45	Jezusi dhe johebrenjtë 4:43-45	Jezusi shëron të birin e nëpunësit 4:43-45	Jezusi në Galile 4:43-45
4:46-54	I biri i fisnikut shërohet 4:46-54	4:46-54	4:46-48 4:49 4:50-51 4:52-53 4:54	Shërimi i birit të një nëpunësi oborri 4:46-53 4:54

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-54

- A. Ekziston një strukturë e qëllimshme në kapitujt 3 dhe 4
 1. Z. Fetar (Nikodemi) në dallim nga Znsh. e Përrjashtuar (gruaja te pusi)
 2. Judaizmi me bazën në Jerusalem (ortodoksi) përkundër judaizmit samaritan (heretik)
- B. Të vërtetat për personin dhe veprën e Jezusit zhvillohen më tej nga
 1. dialogu me gruan te pusi (v. 1-26);
 2. dialogu me dishepujt e vet (v. 27-38);
 3. dëshmia e fshatarëve (v. 39-42);
 4. pranimi i galileasve (v. 43-45);
 5. shenja/mrekullia e pushtetit të Jezusit mbi sëmundjet (v. 46-54).

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:1-6

¹Kështu, kur Zoti mësoi se farisenjtë kishin dëgjuar se Jezusi po bënte dhe po pagëzonte më tepër dishepuj se Gjoni, ²(ndonëse nuk po pagëzonte Jezusi vetë, por dishepujt e tij), ³e la Judenë dhe shkoi përsëri në Galile. ⁴Dhe i duhej të kalonte përmes Samarisë. ⁵Kështu, erdhi në një qytet të Samarisë të quajtur Sikar, pranë ngastrës së tokës që Jakobi i kishte dhënë të birit, Jozefit; ⁶dhe aty ishte pusi i Jakobit. Kështu, Jezusi, duke qenë i lodhur nga rrugëtimi, u ul përbri pusit. Ishte rreth orës së gjashtë.

4:1 “Zoti” Vite më vonë, teksa kalon nëpër mendje këtë ngjarje (me anë të Frymës), Gjoni përdor fjalët “Zot” dhe “Jezus” në të njëjtën fjali për t’u referuar të njëjtit person.

Një sërë dorëshkrimesh greke kanë fjalën “Jezus” dy herë në v. 1 (pra, κ , D, NRSV, NJB, REB), por “Zoti” gjendet në dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, A, B, C, L (NASB, NKJV). Megjithatë, pavarësisht se ka dëshmi shumë më të fortë në dorëshkrime për termin “Zot”, UBS⁴ vendos në tekst “Jezusin” dhe i jep vlerësimin “C” (vështirë për t’u vendosur).

▣ **“farisenjtë”** Shih Temën e Veçantë te 1:24.

▣ **“kishin dëgjuar se Jezusi po bënte dhe po pagëzonte më tepër dishepuj se Gjoni”** Jezusi e la këtë zonë për shkak të tensioneve të mundshme mes dishepujve të vet dhe atyre të Gjoni Pagëzorit, të nxitur nga farisenjtë. Sinoptikët thonë se ai u largua ngaqë Herod Antipa kishte arrestuar Gjoni Pagëzorin (shih Mat. 4:12; Marku 1:14; Luka 3:20).

4:2 “nuk po pagëzonte Jezusi vetë” Ky nuk është koment zhvlerësues për pagëzimin (shih Mat. 28:19; Veprat 2:38; 8:12; 16:33; 22:16), por pranimi i natyrës egoiste të njerëzimit (pra, “unë u pagëzova nga Jezusi”, ose nga Pali, shih 1 Kor. 1:17). Me sa duket, Jezusi pagëzoi vërtet në fillim të shërbesës së vet (shih 3:22), por, më vonë, e la. Gjoni po korrigjonte një pohim të rremë të farisenjve.

4:3 “e la Judenë dhe shkoi përsëri në Galile” Këto janë dy FOLJE DËFTORE AORISTE VEPRORË, që përdoren për të theksuar lëvizjet gjeografike të Jezusit.

4:4 “i duhej të kalonte përmes Samarisë” “I duhej” është FOLJA greke *dei*, që përdoret disa herë në këtë kontekst (shih 3:7, 14, 30). Zakonisht, përkthehet “duhet”, ose “është e nevojshme”. Ky itinerar ka synim hyjnor

për Jezusin. Ajo është rruga më e shkurtër; Jozefusi na thotë se judenjtë nga Galileja zakonisht këtë rrugë përdornin. Ndërsa judenjtë e Judesë i urrenin samaritanët dhe nuk ecnin përmes vendit të tyre, ngaqë i konsideronin gjakpërzier fetarë.

TEMË E VEÇANTË: RACIZMI

I. Hyrje

- A. Racizmi është shprehje e përbotshme e njerëzimit të rënë brenda shoqërisë së vet. Kjo është egoja e njerëzimit, të mbështesësh veten mbi kurrizin e të tjerëve. Në shumë mënyra, racizmi është fenomen modern, ndërsa nacionalizmi (ose tribalizmi) është fenomen më i lashtë.
- B. Nacionalizmi nisi në Babel (Zanafilla 11) dhe, në fillimisht lidhej me tre bijtë e Noeut, prej të cilëve u zhvilluan të ashtuquajturat raca (Zanafilla 10). Sidoqoftë, është e qartë nga Shkrimi se njerëzimi vjen prej një burimi të vetëm (shih Zanafilla 1-3; Veprat 17:24-26).
- C. Racizmi është vetëm një nga paragjykimet e shumta. Disa të tjera janë (1) snobizmi arsimor; (2) arroganca socio-ekonomike; (3) legalizmi kryeneç fetar; dhe (4) përkatësitë dogmatike politike.

II. Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

- 1. Zan. 1:27 – Njerëzimi, mashkulli dhe femra, u krijuan në ngjashmërinë dhe shëmbëllimin e Perëndisë, gjë që i bën unikë. Po kështu, kjo tregon dhe vlerën e dinjitetit e çdo individi (shih Gjoni 3:16).
- 2. Zan. 1:11-25 – regjistron frazën “... sipas llojit të tyre...” dhjetë herë. Kjo është përdorur nga disa për të mbështetur ndarjen racore. Mirëpo, nga konteksti, është e qartë se kjo u referohet kafshëve dhe bimëve, dhe jo njerëzimit.
- 3. Zan. 9:18-27 – Kjo është përdorur për të mbështetur dominimin racor. Duhet të kujtojmë se Kanaanin nuk e mallkoi Perëndia. Atë e mallkoi Noeu, i gjyshi, pasi u zgjua nga dehja. Bibla nuk thotë askund se Perëndia e mbështeti këtë betim/mallkim. Edhe sikur ta kishte bërë, kjo nuk prekte aspak racën e zezë. Kanaani ishte ati i atyre që banuan në Palestinë, dhe arti mural egjiptian tregon se ata nuk ishin të zinj.
- 4. Jozueu 9:23 – Është përdorur për të provuar se njëra racë do t’i shërbejë tjetrës. Mirëpo, në këtë kontekst, gibeonasi ishin nga i njëjti grup racor si judenjtë.
- 5. Esdra 9-10 dhe Nehemia 13 – Shpesh, këto janë përdorur në kuptimin racor, por konteksti tregon se ato martesë u dënuan, jo për shkak të racës (ata vinin nga i njëjti bir i Noeut, Zanafilla 10), por për arsye fetare.

B. Dhiata e Re

1. Ungjijtë

- a. Jezusi e përdori në një sërë rastesh si shembull urrejtjen mes judenjve dhe samaritanëve, gjë që tregon se urrejtja racore është e pavend.
 - (1) shëmbëlltyra e Samaritanit të Mirë (Luka 10:25-37)
 - (2) gruaja te pusi (Gjoni 4)
 - (3) lebrozi mirënjohës (Luka 17:11-19)
- b. Ungjilli është për gjithë njerëzimin
 - (1) Gjoni 3:16
 - (2) Luka 24:46-47
 - (3) Hebrenjve 2:9
 - (4) Zbulesa 14:6
- c. Mbretëria do të përfshijë gjithë njerëzimin
 - (1) Luka 13:29
 - (2) Zbulesa 5

2. Veprat

- a. Veprat 10 është një pasazh vendimtar për dashurinë e përbotshme të Perëndisë dhe për mesazhin e përbotshëm të ungjillit.
- b. Pjetri u sulmua për veprimet e tij në Veprat 11, dhe ky problem nuk u zgjidh derisa u mblodh Këshilli i Jerusalemit (Veprat 15) dhe arriti në një zgjidhje. Tensioni mes judenjve dhe johebrejve në shekullin e parë ishte shumë i lartë.

3. Pali
 - a. Nuk ka pengesa në Krishtin
 - (1) Gal. 3:26-28
 - (2) Efe. 2:11-22
 - (3) Kol. 3:11
 - b. Perëndia nuk bën dallime mes njerëzve
 - (1) Rom. 2:11
 - (2) Efe. 6:9
4. Pjetri dhe Jakobi
 - a. Perëndia nuk bën dallime mes njerëzve (1 Pjet. 1:17)
 - b. Për shkak se Perëndia nuk tregon anshmëri, as populli i tij s'është ta bëjë (Jakobi 2:1)
5. Gjoni
 - a. Një nga pohimet më të forta të përgjegjësive së besimtarëve gjendet në 1 Gjonit 4:20

III. Përfundim

- A. Racizmi, si dhe paragjykimet e çdo lloji, janë plotësisht të pavenda për fëmijët e Perëndisë. Ja një citim nga Henlee Barnette, që foli në një forum në Glorieta të Nju Meksikos, për Komisionin e Jetës së Krishterë më 1964.

“Racizmi është heretik, sepse është jobiblik dhe jo i krishterë, për të mos përmendur faktin se është dhe joshkencor”.
- B. Ky problem u jep të krishterëve mundësinë që të tregojnë dashurinë, faljen dhe kuptueshmërinë e tyre të krishterë ndaj një bote të humbur. Refuzimi i të krishterit në këtë zonë tregon papjekuri dhe i jep mundësinë të ligut që të vonojë besimin, sigurinë dhe rritjen e besimtarit. Po kështu, kjo do të veprojë si pengesë që njerëzit e humbur të vijnë te Krishti.
- C. Çfarë mund të bëj unë? (Kjo pjesë është marrë nga një trakt i Komisionit të Jetës së Krishterë, me titull “Marrëdhëniet racore”
 “NË NIVELIN PERSONAL”
 - ★ Prano përgjegjësinë tënde për të zgjidhur problemet që lidhen me racën.
 - ★ Përmes lutjes, studimit biblik dhe bashkësisë me njerëz nga raca të tjera, përpiku të çlirosh jetën tënde nga paragjykimet racore.
 - ★ Shpreh bindjet e tua për racën, sidomos aty ku ata që nxisin urrejtjen racore nuk sfidohen prej askujt.
 “NË JETËN FAMILJARE”
 - ★ Prano rëndësinë e ndikimit familjar në zhvillimin e qëndrimeve kundrejt racave të tjera.
 - ★ Përpiku të zhvillosh qëndrime të krishtera duke folur për ato që dëgjojnë prindërit dhe fëmijët për problemet racore jashtë shtëpisë.
 - ★ Prindërit duhet të kujdesen që të bëhen shembull i krishterë në marrëdhëniet me njerëzit e racave të tjera.
 - ★ Gjej mundësi për të bërë miqësi familjare përtej kufijve racorë.
 “NË KISHË”
 - ★ Duke predikuar dhe mësuar të vërtetën biblike për racat, bashkësia mund të motivohet të bëhet shembull për gjithë komunitetin.
 - ★ Sigurohuni që adhurimi, bashkësia dhe shërbesa në kishë të jetë e hapur për të gjithë, ashtu si kishat e DhR nuk kishin fare pengesa racore (Efe. 2:11-22; Gal. 3:26-29).
 “NË JETËN E PËRDITSHME”
 - ★ Ndihmo në mposhtjen e çdo diskriminimi racor në vendin e punës.
 - ★ Punoni, nëpërmjet organizatave komunitare të të gjitha llojeve, që të siguroni të drejta dhe mundësi të barabarta, duke mos harruar se duhet të sulmoni problemin racor, jo njerëzit. Synimi është të nxisni mirëkuptimin, jo të ngjallni zemërim.
 - ★ Nëse ju duket e mençur, organizoni një komitet të veçantë me qytetarë të shqetësuar me qëllim që të hapni linja komunikimi në komunitet për edukimin e publikut të gjerë dhe për veprime të veçanta në përmirësimin e marrëdhënieve racore.
 - ★ Mbështesni legjislacione dhe legjislatorë në aprovimin e ligjeve që përkrahin drejtësinë racore dhe u kundërvihen atyre që e shfrytëzojnë paragjykimin për përfitime politike.
 - ★ Lavdëroni zyrtarët e zbatimit të ligjit që i zbatojnë ligjet pa diskriminim.

- ★ Qëndroni larg dhunës dhe nxisni respektin për ligjin, duke bërë të pamundurën si qytetarë të krishterë që të siguroheni që strukturat ligjore të mos bëhen mjete në duart e atyre që nxisin diskriminimin.
- ★ Mishëroni mendjen dhe frymën e Krishtit në çdo marrëdhënie njerëzore.

▣ **“përmes Samarisë”** Kishte urrejtje të fortë mes samaritanëve dhe judeasve, e cila kishte nisur që në shekullin e tetë para K. Më 722 para K., dhjetë fiset veriore të Izraelit, me kryeqytet Samarinë, u morën robër nga Asiria dhe u deportuan në Media (shih 2 Mbret. 17:6). Në Palestinën veriore u vendosën popuj të tjerë robër (shih 2 Mbret. 17:24). Me kalimin e viteve, këta paganë u martuan me atë popullsi izraelite që kishte mbetur aty. Judenjtë i konsideronin samaritanët gjakpërzier dhe heretikë fetarë (shih Esdra 4:1-4). Kjo i jep kontekst v. 9.

4:5 “një qytet të Samarisë të quajtur Sikar, pranë ngastrës së tokës që Jakobi i kishte dhënë të birit, Jozefit” (shih Zan. 33:18, 19; Joz. 24:32). Shumë mendojnë se Sikari është Shekemi, ndonëse kjo nuk shprehet në DhR.

4:6 “aty ishte pusi i Jakobit” Në fakt, kjo ishte një cisternë e gërmuar në tokë, rreth 30 metra e thellë. Nuk ishte ujë i rrjedhshëm (burim), por ujë i mbledhur nga shirat. Nuk përmendet kurrë në DhV, por ky emër e lidh zonën me një traditë patriarkale.

▣ **“Jezusi, duke qenë i lodhur nga rrugëtimi”** Këtu, shohim qartë natyrën njerëzore të Jezusit (shih Luka 2:52), por ai nuk lodhej kurrë së dashuri njerëzit!

▣

NASB, NKJV,

JB “Ishte rreth orës së gjashtë”

NRSV, TEV “Ishte rreth mesditës”

Ka shumë diskutime se cilën metodë për llogaritjen e kohës përdori Gjoni në ungjillin e vet. Disa referenca duket se janë sipas orarit judaik, disa të tjera sipas orarit romak. Judenjtë e fillojnë ditën më 6 të mëngjesit (romakët në mesditë); si rrjedhojë, Jezusi erdhi te pusi në kohën më të nxehtë të ditës, në mesditë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:7-14

⁷Erdhi një grua nga Samaria për të nxjerrë ujë. Jezusi i tha: “Më jep të pi”. ⁸Sepse dishepujt e tij kishin shkuar në qytet për të blerë ushqime. ⁹Kështu, samaritanja i tha: “Si ka mundësi që ti, ndonëse je jude, kërkon të pish prej meje, ndonëse jam grua samaritane?” (Sepse judenjtë nuk kanë marrëdhënie me samaritanët.) ¹⁰Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Nëse do të njihje dhuratën e Perëndisë dhe kush është ai që po të thotë „Më jep të pi”, ti do t’i kërkoje dhe ai do të të jepte ujë të gjallë”. ¹¹Ajo i tha: “Zotëri, ti s’ke me çfarë të nxjerrësh ujin dhe pusi është i thellë; atëherë, ku e ke atë ujin e gjallë? ¹²Ti s’je më i madh se ati ynë Jakobi, që na dha pusin, madje piu vetë prej tij, bashkë me bijtë dhe bagëtitë e veta, apo jo?” ¹³Jezusi u përgjigj dhe i tha: “Kushdo që pi nga ky ujë do të ketë sërish etje; ¹⁴por kushdo që pi nga uji që do t’i jap unë, nuk do të ketë më etje kurrë; por uji që do t’i jap do të bëhet në të një burim uji që gufon në jetë të përjetshme”.

4:7 “Erdhi një grua nga Samaria” Kjo grua kishte ardhur e vetme te një pus i largët në një orë të pazakontë të ditës për shkak të pozitës së saj shoqërore në fshat.

▣ **“Më jep të pi”** Kjo është një URDHËRORE AORISTE VEPRORE, e cila përçonte idenë e një urgjence.

4:8 Ky varg përcakton skenën për bisedën private të Jezusit me këtë grua të përjashtuar, e cila i përkiste një sektit heretik të judaizmit. Ky është një tjetër shënim paranteze nga Gjoni.

4:9 “Si ka mundësi që ti, ndonëse je jude, kërkon të pish prej meje, ndonëse jam grua samaritane” Judenjtë nuk u lejohej as të pinin nga e njëjta kovë me samaritanët (shih traditat judaike, të bazuara te Levitiku 15). Jezusi po anashkalonte dy pengesa kulturore: (1) po fliste me një person nga Samaria dhe (2) po fliste me një grua në publik.

■ **“(sepse judenjtë nuk kanë marrëdhënie me samaritanët)”** Kjo parantezë (NASB, NRSV), që përbën një tjetër shtesë shpjeguese nga Gjoni, mungon në dorëshkrimet \aleph^* dhe D, por është e pranishme në $P^{63,66,75,76}$, \aleph^1 , A, B, C, L. UBS⁴ i jep përfshirjes së saj vlerësimin “A” (e sigurt).

4:10 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “kundër faktit”. Pra, bëhet një pohim i rremë për të theksuar një përfundim që është, gjithashtu, i rremë.

Ky është i vetmi përdorim i fjalës “dhuratë” në ungjillin e Gjonit. Këtu, i referohet Jezusit si dhurata e Perëndisë (shih 3:16) që jep jetë të përjetshme. Te Gjoni 7:38-39 dhe te Veprat, përdoret për dhënien e Frymës së Shenjtë (shih Veprat 2:38; 8:20; 10:45; 11:17). Fokusi është te hiri i pamerituar i Perëndisë, i cili zbulohet në Krishtin dhe në Frymën.

■ **“uji i gjallë”** Ky term ka sfond metaforik nga DhV (Psa. 36:9; Isa. 12:3; 44:3; Jer. 2:13; 17:13; Zak. 14:8). Jezusi e përdor termin “uji i gjallë” si sinonimik me “jetën shpirtërore”. Mirëpo gruaja samaritane mendonte se ai po fliste për ujin e rrjedhshëm, në dallim nga uji i shirave të cisternës. Është karakteristike për ungjillin e Gjonit që Jezusi (drita e botës) keqkuptohet rregullisht (p.sh., nga Nikodemi). Sfera e rënë tokësore nuk mund të rrokë dot sferën qiellore (pra, mesazhin e Jezusit).

4:11 “Zotëri” Ky është termi grek *kurios* në formën e vet THIRRORE *kurie*. Mund të përdoret si formë politese (zotëri), ose si pohim teologjik (ZOT), që i referohet Jezusit si plotësisht Perëndi, si te v. 1 dhe Rom. 10:13. Këtu, shprehet në formë politese.

4:12 “Ti nuk je më i madh se ati ynë, Jakobi, apo jo” Gramatika pret përgjigjen “jo”. Qartazi, ky është një pohim ironik. Gruaja samaritane po mburrej me madhësinë e prejardhjes së saj, të cilën samaritanët e gjurmonin përmes Efraimit dhe Menaseut deri te Jakobi. Gjëja e mahnitshme është se Jezusi po pretendonte pikërisht epërsinë e vet!

Kjo bisedë trajton dy çështje teologjike.

1. Dashuria e Perëndisë/Jezusit për të përjashtuarit (pra, samaritanët, gratë)
2. Epërsia e Jezusit ndaj judaizmit dhe krenarisë racore

4:13-14 “kushdo që pi nga uji që do t’i jap unë, nuk do të ketë më etje kurrë” Ndoshta, kjo kishte ngjyrimë mesianike (shih Isa. 12:3; 48:21; 49:10). Kjo frazë është një formë e fortë dhe e dyfishtë mohore. Bëhet një lojë me KOHËT E FOLJEVE. PJESORJA E TASHME VEPRORE e v. 13 nënkupton pirje në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa LIDHORJA AORISTE VEPRORE e v. 14 nënkupton pirje vetëm një herë.

4:14 “një burim uji që gufon në jetë të përjetshme” Kjo është një PJESORE E TASHME, që nënkupton “kërcim të vazhdueshëm të ujit” (shih Isa. 58:11 dhe Gjoni 7:38). Për njerëzit e shkretëtirës, uji ishte simbol i jetës dhe furnizimit hyjnor.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:15-26

¹⁵Gruaja i tha: “Zotëri, më jep nga ky ujë dhe nuk do të kem më etje, as nuk do të bëj më gjithë këtë rrugë deri këtu për të nxjerrë ujë”. ¹⁶Ai i tha: “Shko, thirr burrin tënd dhe ejani këtu”. ¹⁷Gruaja iu përgjigj dhe i tha: “Unë s’kam burrë”. ¹⁸Jezusi i tha: “Me të drejtë the „s’kam burrë“, ke patur pesë burra, dhe ai që ke tani nuk është burri yt; ke thënë të vërtetën”. ¹⁹Gruaja i tha: “Zotëri, e kuptoj se je profet. ²⁰Etërit tanë adhuroan në këtë mal, ndërsa ju thoni se në Jerusalem është vendi ku duhet të vijmë njerëzit për adhurim”. ²¹Jezusi i tha: “Grua, më beso, po vjen ora kur, as në këtë mal, as në Jerusalem, nuk do të adhuroni Atin. ²²Ju adhuroni atë që nuk njihni; ne adhurojmë atë që njohim, sepse shpëtimi vjen nga judenjtë. ²³Por po vjen ora, madje ajo ka ardhur, kur adhuresit e vërtetë do të adhurojnë Atin në frymë dhe në të vërtetë; sepse të tillë njerëz kërkon Ati që të jenë adhures të tij. ²⁴Perëndia është frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet ta adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën”. ²⁵Gruaja i tha: “E di se po vjen Mesia (i cili quhet Krisht); kur të vijë ai, do të na shpallë çdo gjë”. ²⁶Jezusi i tha: “Unë jam ai që po të flet”.

4:15 Gruaja, ashtu si Nikodemi, ende po e kupton Jezusin në një nivel tejet fizik (të fjalëpërfjalshëm). Kjo nuk është e pazakontë as për dishepujt. Shpesh, ata e keqinterpretimin Jezusin ngaqë s’kuptonin gjuhën e tij metaforike (shih Gjoni 4:31-33; 11:11-13).

4:16 UBS4 as nuk e përmend mundësinë se emri “Jezus” mund të jetë shtuar (shih NKJV, NRSV, NJB, REB). Bibla NET jep të dhënat dorëshkrimore për përfshirjen e këtij emri (f. 1903, pra, dorëshkrimet κ^{*c} , A, C², D, L dhe W, por mungon nga dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, B, C). Kopjuesit prireshin ta bënin tekstin më të qartë dhe më të lehtë për t’u ndjekur.

■ **“Shko, thirr”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE, e ndjekur nga një URDHËRORE AORISTE VEPRORE.

4:17 “Nuk kam burrë” Mëkati duhet ballafaquar. Jezusi nuk e pranon këtë sjellje të mëkatshme, por as nuk e dënon.

4:18 “ti ke patur pesë burra” Jezusi përdor njohurinë e mbinatyrshme për ta shkundur gruan nga sfera fizike në sferën shpirtërore (shih 1:48).

4:19 “E kuptoj se je profet” Gruaja nuk e perceptonte ende si Mesi. Ajo po përpiqej t’i shmangej çështjes kryesore, marrëdhënies së saj me Perëndinë, duke përdorur një kompliment (njësoj si Nikodemi te 3:2).
Komentatorë të tjerë e shohin këtë si referencë mesianike nga LiP. 18:15-22.

TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHV

I. HYRJE

A. Të dhëna hyrëse

1. Komuniteti i besimtarëve nuk bie dakord sesi të interpretojë profecinë. Të vërteta të tjera janë përcaktuar si pozicion ortodoks me kalimin e shekujve, por jo kjo.
2. Profecia e DhV ka një sërë fazash të mirëpërcaktuara
 - a. paramonarkikë
 - (1) individë të quajtur profetë
 - (a) Abrahami – Zan. 20:7
 - (b) Moisiu – Num. 12:6-8; LiP 18:15; 34:10
 - (c) Aaroni – Eks. 7:1 (zëdhënës i Moisiut)
 - (d) Miriami – Eks. 15:20
 - (e) Medadi dhe Eldadi – Num. 11:24-30
 - (f) Debora – Gjyq. 4:4
 - (g) pa emër – Gjyq. 6:7-10
 - (h) Samueli – 1 Sam. 3:20
 - (2) përmendje të profetëve si grup – LiP. 13:1-5; 18:20-22
 - (3) grupe ose shkolla profetike – 1 Sam. 10:5-13; 19:20; 1 Mbret. 20:35, 41; 22:6, 10-13; 2 Mbret. 2:3, 7; 4:1, 38; 5:22; 6:1, etj.
 - (4) Mesia quhet profet – LiP. 18:15-18
 - b. monarkikë, por pa shkrime (ata i drejtohen mbretit):
 - (1) Gadi – 1 Sam. 22:5; 2 Sam. 24:11; 1 Kro. 29:29
 - (2) Natani – 2 Sam. 7:2; 12:25; 1 Mbret. 1:22
 - (3) Ahijahu – 1 Mbret. 11:29
 - (4) Jehu – 1 mbret. 16:1, 7, 12
 - (5) Pa emër – 1 Mbret. 18:4, 13; 20:13, 22
 - (6) Elija – 1 Mbret. 18 - 2 Mbret. 2
 - (7) Milkajahu – 1 Mbret. 22
 - (8) Elizeu – 2 Mbret. 2:8, 13
 - c. profetët shkrues klasikë (ata i drejtohen jo vetëm mbretit, por edhe kombit): Isaia-Malakia (përveç Danielit)

B. Termat bibliکہ

1. *Ro'eh* = “shikues”, 1 Sam. 9:9. Vetë kjo referencë tregon kalimin për te termi *nabi*. *Ro'eh* vjen nga termi i përgjithshëm “shoh”. Ky person kuptonte udhët dhe planet e Perëndisë dhe konsultohej për të vërtetuar vullnetin e Perëndisë për ndonjë çështje.

2. *Hozeh* = “shikues”, 2 Sam. 24:11. Në thelb, është sinonim me *Ro'eh*. Vjen nga një term më i rrallë, “shikoj”. Forma pjesore përdoret më shpesh për t’u referuar profetëve (pra, “kundroj”).
3. *Nabi'* = “profet”, e afrishme me FOLJEN akadiane *Nabu* = “thërras” dhe arabisht *Naba'a* = “shpall”. Ky është termi më i zakonshëm në DhV për të përcaktuar profetin. Përdoret mbi 300 herë. Etimologjia e saktë është e paqartë, por, për momentin, “thërras” duket alternativa më e mirë. Ndoshta, kuptimi më i mirë i saj vjen nga përshtkrimi që i bën Jahve marrëdhënies së Moisiut me faraonin përmes Aaronit (shih Eks. 4:10-16; 7:1; LiP. 5:5). Profeti është dikush që i flet popullit në emër të Perëndisë (Amosi 3:8; Jer. 1:7, 17; Ezek. 3:4).
4. Të tre këta terma përdoren për ofiqin e profetit te 1 Kro. 29:29; Samueli – *Ro'eh*; Natani – *Nabi'* dhe Gadi – *Hozeh*.
5. Frazja, *'isha ha-'elohim*, “Njeriu i Perëndisë”, është një përcaktim më i gjerë i zëdhënësit të Perëndisë. Përdoret rreth 76 herë në DhV në kuptimin “profet”.
6. Termi “profet” e ka origjinën nga greqishtja. Vjen nga: (1) *pro* – “më parë” ose “për” dhe (2) *femi* = “flas”.

II. PËRCAKTIMI I PROFECISË

- A. Termi “profeci” kishte një fushë më të gjerë semantike në hebraisht sesa në greqisht. Librat historikë, nga Jozueu deri te Mbretërve (përveç Ruthit), etiketoheshin nga judenjtë si “profetët e hershëm”. Si Abrahami (Zan. 20:7; Psa. 105:5), ashtu dhe Moisiu (LiP. 18:18), përcaktohen si profetë (edhe Miriami, Eks. 15:20). Si rrjedhojë, kujdes nga ndonjë përcaktim i supozuar perëndimor!
- B. “Profetizmi mund të përcaktohet me të drejtë si ai botëkuptim i historisë që e pranon kuptimin vetëm në kuadër të preokupimi, synimit dhe pjesëmarrjes hyjnore”, *Interpreter's Dictionary of the Bible*, vëll. 3, f. 896.
- C. “Profeti s’është, as filozof, as teolog sistematik, por ndërmjetës besëlidhjeje, i cili i përçon fjalën e Perëndisë popullit të vet me qëllim që t’u formësojë të ardhmen duke u reformuar të tashmen”, “Profetët dhe Profecia”, *Encyclopedia Judaica*, vëll. 13, f. 1152.

III. QËLLIMI I PROFECISË

- A. Profecia është një mënyrë sesi Perëndia i flet popullit të vet, duke u siguruar udhëheqje në kontekstin e tanishëm dhe shpresë për kontrollin e tij në jetën e tyre dhe në ngjarjet botërore. Mesazhi i profetëve, në thelb, ishte kolektiv. Synonte të qortonte, nxiste, ngjallte besim dhe pendim, dhe të informonte popullin e Perëndisë për Perëndinë dhe për planet e tij. Profecitë i bëjnë thirrje popullit të Perëndisë për besnikëri ndaj besëlidhjeve të Perëndisë. Kësaj i duhet shtuar se, shpesh, profecia përdoret për të zbuluar qartë zgjedhjen e një zëdhënësi nga Perëndia (LiP. 13:1-3; 18:20-22). Në fund fare, ky zëdhënës i referohej Mesisë.
- B. Shpesh, profeti merrte një krizë historike ose teologjike të ditës dhe e projektonte në një kontekst eskatologjik. Kjo pikëpamjeje “fund-bote” e historisë është unike për Izraelin dhe për konceptin e tij për zgjedhjen hyjnore dhe premtimet e besëlidhjes.
- C. Ofiqi i profetit duket se drejtpeshon (Jer. 18:18) dhe uzurpon ofiqin e Kryepiftit si mënyrë për të njohur vullnetin e Perëndisë. Urimi dhe Thumimi shndërrohen në mesazh verbal nga zëdhënësi i Perëndisë. Po kështu, ofiqi i profetit duket se reshti në Izrael pas Malakisë. Ai shfaqet vetëm 400 vjet më vonë me Gjon Pagëzorin. Është e paqartë se si lidhet dhuntia e “profecisë” në DhR me Dhiatën e Vjetër. Profetët e Dhiatës së Re (Veprat 11:27-28; 13:1; 15:32; 1 Kor. 12:10,28-29; 14:29,32,37; Efe. 4:11) nuk janë zbulues të ndonjë zbuluese ose Shkrimi të ri, por janë folës dhe parathënës të vullnetit të Perëndisë në situata besëlidhjeje.
- D. Profecia nuk ka vetëm, ose kryesisht, natyrë parashikuese. Parashikimi është një mënyrë për të vërtetuar këtë ofiqin dhe mesazhin e profetit, por duhet vërejtur se “më pak se 2% e profecive në DhV janë mesianike. Më pak se 5% e tyre përshkruajnë në mënyrë të veçantë epokën e Besëlidhjes së Re. Më pak se 1% e kësaj profecie bën fjalë për ngjarje të ardhshme”. (Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 166)
- E. Profetët përfaqësojnë Perëndinë para popullit, ndërsa piftërinjtë përfaqësojnë popullin para Perëndisë. Ky është një pohim i përgjithshëm. Ka dhe përjashtime si Habakuku, i cili i drejton

pyetje Perëndisë.

- F. Një arsye pse është e vështirë të kuptojmë profetët është se nuk dimë sesi strukturoheshin librat e tyre. Ata nuk janë kronologjikë. Duket se janë tematikë, por jo gjithmonë ashtu siç e presim. Shpesh, nuk ka asnjë kontekst të qartë historike, as kornizë kohore, as ndarje të qartë mes profecive. Këta libra janë të vështirë (1) të përfundohen me një lexim të vetëm; (2) të përvijohen sipas temave; dhe (3) të sigurohesh për të vërtetën qendrore ose synimin autorial në secilën profeci.

IV. KARAKTERISTIKAT E PROFECISË

- A. Në Dhiatën e Vjetër, duket se ka një zhvillim të konceptit “profet” dhe “profeci”. Në Izraelin e hershëm, u zhvillua një bashkësi profetësh, e kryesuar nga një drejtues i fortë karizmatik si Elija ose Elizeu. Nganjëherë, fraza “bij të profetëve” përdorej për të përcaktuar këtë grup (2 Mbret. 2). Profetët karakterizoheshin nga forma ekstaze (1 Sam. 10:10-13; 19:18-24).
- B. Megjithatë, nga kjo periudhë u kalua shpejt te profetët si individë. Kishte nga ata profetë (të vërtetë e të rremë) që identifikoheshin me mbretin dhe jetonin në pallatin mbretëror (Gadi, Natani). Po kështu, kishte nga ata që ishin të pavarur, nganjëherë tërësisht të palidhur me statuko-në e shoqërisë izraelite (Amosi). Kishte edhe profetë edhe profetsha (2 Mbret. 22:14).
- C. Shpesh, profeti ishte zbulues i së ardhmes, e kushtëzuar nga reagimi i atypëratyshëm i njeriut. Shpesh, detyra e profetit ishte shpalosja e planit të përbotshëm të Perëndisë për krijimin e vet, gjë që nuk ndikohej nga reagimi njerëzor. Ky plan i përbotshëm eskatologjik është unik ndër profetët e Lindjes së Afërt në lashtësi. Parashikimi dhe besnikëria ndaj besëlidhjes janë dy pika kyçe të mesazheve profetike (shih Fee dhe Stuart, f. 150). Kjo nënkupton se profetët kanë, pikësëpari, fokus kolektiv. Zakonisht, por jo gjithmonë, ata i drejtohen kombit.
- D. Shumica e materialit profetik prezantohej gojarisht. Më vonë, kombinoheshin me anë të tematikave, kronologjisë, ose modeleve të tjera të letërsisë në Lindjen e Afërt, të cilat s’i kemi më. Për shkak se ishte gojor, ky material s’është aq i strukturuar sa proza e shkruar. Kjo i bën librat të vështirë për t’u lexuar nga fillimi në fund dhe të vështirë për t’u kuptuar pa një kontekst të veçantë historik.
- E. Profetët përdorin një sërë modelesh për të përçuar mesazhet e tyre.
1. Skena e oborrit mbretëror – Perëndia e çon popullin e vet në gjyq, shpesh bëhet fjalë për një rast divorci, ku Jahve refuzon gruan e vet (Izraelin) për tradhtinë e saj (Osea 4: Mikea 6).
 2. Këngë vajtimi për funeral – metri i veçantë i këtij lloji mesazhi dhe fjala e tij karakteristike, “mjerë”, e veçon si formë më vete (Isaia 5; Habakuku 2).
 3. Shpallja e bekimit të besëlidhjes – theksohet natyra e kushtëzuar Besëlidhjes dhe jepen pasojat, pozitive dhe negative, për të ardhmen (Lip. 27-28).

V. UDHËZIME TË DOBISHME PËR TË INTERPRETUAR PROFECINË

- A. Gjej synimin e profetit fillestar (redaktorit) duke vërejtur kontekstin historik dhe kontekstin letrar të secilës pjesë të profecisë. Zakonisht, ajo ka lidhje, në ndonjëfarë mënyre, me thyerjen e besëlidhjes së Moisiut nga ana e Izraelit.
- B. Lexo dhe interpreto gjithë profecinë, jo thjesht një pjesë të saj; përvijojta përmbajtjen. Shiko sesi lidhet ajo me profecitë rreth vetes. Përpiqu të përvijosh gjithë librin.
- C. Supozo një interpretim të fjalëpërfjalshëm të pasazhit derisa diçka në tekst të të dëftojë një përdorim të figurshëm; pastaj, vëre gjuhën e figurshme në prozë.
- D. Analizo veprimin simbolik në dritën e kontekstit historik dhe pasazheve paralele. Mos harro se kjo letërsi e Lindjes së Afërt në lashtësi nuk është letërsi moderne, apo përëndimore.
- E. Trajtoji parashikimet me kujdes.
1. A vlejnjë vetëm për kohën e autorit?
 2. A përmbushen më vonë në historinë e Izraelit?
 3. A janë ngjarje që ende s’kanë ndodhur?
 4. A kanë një përmbushje bashkëkohore dhe një përmbushje të ardhme?
 5. Lejo që përgjigjet e tua të drejtohen nga autorët e Biblës, jo nga autorët e sotëm.
- F. Preokupime të veçanta

1. A cilësohet parashikimi nga ndonjë reagim i kushtëzuar?
2. A është e qartë se kujt i drejtohet profecia (dhe pse)?
3. A ka mundësi, nga ana biblike dhe/ose historike, për një përmbushje të shumëfishtë?
4. Autorët e DhR, nën frymëzim, ishin në gjendje të shihnin Mesinë në shumë pasazhe të DhV që nuk janë të dukshme për ne. Duket se ata përdornin tipologjinë ose lojën e fjalëve. Meqë ne s'jemi të frymëzuar, më mirë t'ua lemë atyre këtë qasje.

VI. LIBRA TË DOBISHËM

- A. *A Guide to Biblical Prophecy (Udhëzues për profecinë biblike)*, nga Carl E. Amending and W. Ward Basque
- B. *How to Read the Bible for All Its Worth (Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart
- C. *My Servants the Prophets (Shërbëtorët e mi, profetët)*, nga Edward J. Young
- D. *Plowshares and Pruning Hooks: Rethinking the Language of Biblical Prophecy and Apocalyptic (Plugje dhe krasitëse: të rimendojmë terminologjinë e profecisë biblike dhe apokaliptikës)*, nga D. Brent Sandy
- E. *New International Dictionary of Old Testament Theology and Exegesis (Fjalori i ri ndërkombëtar i teologjisë dhe eksegezës së Dhiatës së Vjetër)*, vëll. 4, f. 1067-1078

TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHIATËN E RE

- I. Nuk është e njëjta gjë si profecia e DhV (BDB 611), e cila ka ngjyrimin rabinik të zbulesave të frymëzuara nga JHVH (shih Veprat 3:18, 21; Rom. 16:26). Vetëm profetët mund të shkruanin Shkrimin.
 - A. Moisiu quhej profet (shih LiP. 18:15-21).
 - B. Librat historikë (Jozue-Mbretërve [përveç Ruthit]) quheshin “profetët e hershëm” (shih Veprat 3:24).
 - C. Profetët zënë vendin e Kryepiftit si burim informacioni nga Perëndia (shih Isaia-Malakia)
 - D. Ndarja e dytë e kanonit hebraik është “Profetët” (shih Mat. 5:17; 22:40; Luka 16:16; 24:25, 27; Rom. 3:21).
- II. Në DhR, ky koncept përdoret në një sërë mënyrash të ndryshme.
 - A. për t’u referuar profetëve të DhV dhe mesazhit të tyre të frymëzuar (shih Mat. 2:23; 5:12; 11:13; 13:14; Rom. 1:2)
 - B. për t’u referuar një mesazhi për një individ të caktuar, jo për një grup kolektiv (p.sh., profetët e DhV i flisnin kryesisht Izraelit)
 - C. për t’u referuar, si Gjon Pagëzorit (shih Mat. 11:9; 14:5; 21:26; Luka 1:76), ashtu dhe Jezusit, si shpallës të Mbretërisë së Perëndisë (shih Mat. 13:57; 21:11, 46; Luka 4:24; 7:16; 13:33; 24:19). Po kështu, Jezusi pohoi se ishte më i lartë edhe se profetët (Mat. 11:9; 12:41; Luka 7:26).
 - D. profetë të tjerë në DhR
 1. Elizabeta (shih Luka 1:41-42)
 2. Zakaria (shih Luka 1:67-79)
 3. Simeoni (shih Luka 2:25-35)
 4. Ana (shih Luka 2:36)
 5. parashikime ironike (shih Kajafa, Gjoni 11:51)
 - E. për t’u referuar dikujt që shpall ungjillin (lista e dhuntive shpallëse te 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
 - F. për t’u referuar një dhuntie të vazhdueshme në kishë (shih Mat. 23:34; Veprat 13:1; 15:32; Rom. 12:6; 1 Kor. 12:10,28-29; 13:2; Efe. 4:11). Nganjëherë, mund t’u referohet grave (shih Luka 2:36; Veprat 2:17; 21:9; 1 Kor. 11:4-5).
 - G. për t’u referuar librit apokaliptik të Zbulesës (shih Zbu. 1:3; 22:7, 10, 18, 19)

III. Profetët e DhR

- A. Ata nuk japin zbuluesë të frymëzuar në të njëjtin kuptim si profetët e DhV (pra, Shkrimi). Ky pohim është i mundshëm për shkak të përdorimit të frazës “besim” (pra, kuptimi i një ungjilli të plotësuar) në Veprat 6:7; 13:8; 14:22; Gal. 1:23; 3:23; 6:10; Fil. 1:27; Juda 3, 20).
- Ky koncept është i qartë nga fraza e plotë e përdorur në Juda 3, “besimi që iu dorëzua një herë e përgjithmonë shenjtoreve”. Besimi “një herë e përgjithmonë” u referohet të vërtetave, doktrinave, koncepteve, mësimëve të botëkuptimit të krishterë. Ky theksim i dhënë një herë e përgjithmonë është baza biblike pse frymëzimin e kufizojmë teologjikisht vetëm për shkrimet e DhR, pa lejuar që shkrimet e mëvonshme ose të tjera të konsiderohen zbuluesë. Ka shumë zona të paqarta, të pasigurta dhe gri në DhR, por besimtarët pohojnë me besim se gjithçka që “nevojitet” për besimin dhe praktikën është përfshirë me qartësi të mjaftueshme në DhR. Ky koncept është përvijuar në atë që quhet “trekëndëshi i zbuluesës”
1. Perëndia e ka zbuluar veten në historinë kohë-hapësirë (ZBULESA)
 2. Ai ka zgjedhur disa shkrimtarë njerëzorë për të dokumentuar dhe shpjeguar veprat e tij (FRYMËZIMI)
 3. Ai ka dhënë Frymën e vet për të hapur mendjen dhe zemrën e njerëzve që të kuptojnë këto shkrime, jo në mënyrë absolute, por aq sa mjafton për shpëtim dhe për një jetë të krishterë të efektshme (PËRNDRITJE). Ideja e kësaj është se frymëzimi vlen vetëm për shkruarit e Shkrimit. Nuk ka shkrime, vegime apo zbuluesë të mëtejshme të autoritetshme. Kanoni është mbyllur. Ne kemi gjithë të vërtetën që na nevojitet për t’iu përgjigjur si duhet Perëndisë. Kjo e vërtetë mund të shihet më së miri në përkimin e shkrimtarëve biblike, në dallim nga mosmarrëveshjet e besimtarëve të sinqertë e të perëndishëm. Asnjë shkrimtar ose folës i sotëm nuk ka nivelin e udhëheqjes hyjnore që kishin shkrimtarët e Shkrimit.
- B. Në disa mënyra, profetët e DhR janë të ngjashëm me profetët e DhV.
1. parashikimi i ngjarjeve të ardhshme (p.sh., Pali, Veprat 27:22; Agabi, Veprat 11:27-28; 21:10-11; profetë të tjerë pa emër, Veprat 20:23)
 2. shpallin gjykimin (shih Pali, Veprat 13:11; 28:25-28)
 3. akte simbolike që portretizojnë në mënyrë të gjallë një ngjarje të caktuar (shih Agabin, Veprat 21:11)
- C. Nganjëherë, i shpallin të vërtetat e ungjillit në mënyra parashikuese (shih Veprat 11:27-28; 20:23; 21:10-11), por ky nuk është fokusi parësor. Profetizimi te 1 Korintasve, në thelb, është komunikimi i ungjillit (shih 14:24, 39).
- D. Ata janë mjeti bashkëkohor i Frymës për zbuluesën e zbatimeve bashkëkohore dhe praktike të së vërtetës së Perëndisë në çdo situatë të re, kulturë, apo periudhë kohore (shih 1 Kor. 14:3).
- E. Ata ishin aktivë në kishat e hershme paliane (shih 1 Kor. 11:4-5; 12:28,29; 13:2,8,9; 14:1,3,4,5,6,22,24,29,31,32,37,39; Efe. 2:20; 3:5; 4:11; 1 Thes. 5:20) dhe përmenden në *Didake* (shkruar në fund të shekullit të parë ose në shekullin e dytë, data është e paqartë) dhe në montanizmin e shekujve të dytë e të tretë në Afrikën perëndimore.

IV. A kanë reshtur dhuntitë e DhR?

- A. Është e vështirë t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Në qartësimin e kësaj çështjeje na ndihmon përcaktimi i synimit të dhuntive. A synohen dhuntitë që të mbështesin predikimin fillestar të ungjillit, apo përbëjnë mënyra të vazhdueshme sesi kisha „i shërben vetes dhe botës së humbur?
- B. A duhet të shqyrtojmë historinë e kishës për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, apo vetëm DhR? Në DhR nuk na tregohet se dhuntitë shpirtërore ishin të përkohshme. Ata që përpiqen të përdorin 1 Kor. 13:8-13 për të trajtuar këtë çështje abuzojnë me synimin autorial të pasazhit, i cili pohon se gjithçka, përveç dashurisë, do të kalojë.
- C. Tundohem të them se, meqë autoriteti ynë është DhR, jo historia e kishës, besimtarët duhet të pohojnë se dhuntitë vazhdojnë. Megjithatë, besoj se kultura ndikon në interpretim. Disa tekste shumë të qarta nuk janë më të zbatueshme (p.sh., puthja e shenjtë, veshja e mbulesës së kokës nga gratë, takimi i kishave nëpër shtëpi, etj). Nëse kultura ndikon në pasazhet, atëherë pse të mos bëjë të njëjtën gjë dhe historia e kishës?
- D. Kjo është thjesht një pyetje që nuk mund të marrë përgjigje përfundimtare. Disa besimtarë

përkrahin “pushimin”, ndërsa disa të tjerë “mospushimin”. Në këtë fushë, si dhe në shumë çështje interpretuese, çelësi është zemra e besimtarit. DhR është e vagullt dhe kulturore. Vështirësia është se duhet të jemi në gjendje të përcaktojmë se cilat pasazhe preken nga kultura/historia dhe cilat janë për gjithë kohën dhe për gjithë kulturat (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 14-19 dhe 69-77). Pikërisht këtu janë kyçe diskutimet për lirinë dhe përgjegjësinë, që gjenden në Rom. 14:1-15:13 dhe 1 Kor. 8-10. Mënyra sesi i përgjigjemi kësaj pyetjeje është e rëndësishme në dy mënyra.

1. Secili besimtar duhet të ecë me besim në dritën e asaj që ka. Perëndia na shqyrton zemrën dhe motivet.
 2. Secili besimtar duhet të lejojë besimtarët e tjerë që të ecin sipas kuptimit të besimit të tyre. Duhet të ekzistojë tolerancë brenda caqeve biblike. Perëndia dëshiron që ta duam njëri-tjetrin njësoj si ai.
- E. Për të përmbledhur çështjen, krishterimi është jetë besimi dhe dashurie, jo teologji e përsosur. Marrëdhënia me të, e cila ndikon në marrëdhënien tonë me të tjerët, është më e rëndësishme se informacioni absolut, apo përsosuria e kredove tona.

4:20 “Etërit tanë” Bëhet fjalë për Abrahamin dhe Jakobin (shih Zan. 12:7; 33:20). Ajo po pohon ndjesinë e vet për përfshirjen në besëlidhje (shih 8:31-59).

▣ **“adhuruan në këtë mal”** Kjo i referohet argumentit teologjik se ku duhej adhuruar Perëndia (JHVH). Judenjtë theksonin malin Moria (vendin e tempullit jude), ndërsa samaritanët theksonin malin Gerizim (tempulli samaritan u shkatërrua më 129 para K. nga Gjon Hirkani).

Në kohën tonë, kjo është përpjekja që bëjnë disa njerëz që ne u dëshmojnë në mënyrë që t’i shmangen çështjes së marrëdhënies së tyre me Krishtin duke nxjerrë argumente teologjike pa vlerë. Njerëzve u pëlqen të studiojnë fenë dhe filozofinë për sa kohë që nuk i prek personalisht (shih 3:19-21).

4:21 “po vjen ora kur, as në këtë mal, as në Jerusalem, nuk do të adhuroni Atin” Ky duhet të ketë qenë pohim tronditës për samaritanen, por edhe për dishepujt e Jezusit. Çështja nuk është ku, por kë!

4:22 “sepse shpëtimi është nga judenjtë” Ky është një pohim për origjinën e Mesisë (shih Zan. 12:2-3; 49:8-12; Isa. 2:3; Rom. 9:4-5).

4:23 “Por po vjen ora, dhe madje ka ardhur” Ky mund të jetë aludim për Mal. 1:11 për adhurimin e përbotshëm. Është e qartë se Jezusi solli dhuratën e jetës së përjetshme, jo vetëm pas vdekjes së vet, por edhe gjatë jetës së vet. Ky pohim reflekton tensionin që ekziston midis dy ardhjeve të Mesisë. Dy epokat judaike (shih Temën e Veçantë, te 1 Gjonit 2:17) tani janë mbivendosur. Epoka e re e Frymës është e pranishme, por ende jetojmë në epokën e vjetër të ligësisë dhe mëkatit.

Pa dyshim, Jezusi po pohon se epoka e re ka nisur në të. Epoka e Frymës, epoka e Mesisë, është inauguruar!

▣ **“në frymë dhe në të vërtetë”** Termi “frymë” (shih Temën e Veçantë te 3:8) bën fjalë për një adhurim që nuk ka bazë lokale apo fizike. Termi “i vërtetë” përdorej në botën greke për të nënkuptuar një koncept mendor, ndërsa sfondi hebre ishte ai i besnikërisë ose vërtetësisë. Shih Temat e Veçanta për të Vërtetën te 6:55 dhe 17:3.

▣ **“Ati”** Ishte tejet e pazakontë të quhej Perëndia “Atë” në Dhiatën e Re pa shtuar një referencë për Jezusin si Birin e tij unik.

TEMË E VEÇANTË: ATI

DhV prezanton metaforën e ngushtë familjare të Perëndisë si Atë:

1. kombi i Izraelit përshkruhet shpesh si “biri” i JHVH (shih Os. 11:1; Mal. 3:17)
2. edhe më herët, në Ligjin e Përtërirë, përdoret analogjia e Perëndisë si Atë (1:31)
3. në LiP. 32, Izraeli quhet “fëmijët e tij”, ndërsa Perëndia quhet “ati juaj”
4. kjo analogji shprehet te Psa. 103:13 dhe zhvillohet në Psa. 68:5 (ati i jetimëve)
5. ishte i zakonshëm në profetët (shih Isa. 1:2; 63:8; Izraeli si bir, Perëndia si Atë, 63:16; 64:8; Jer. 3:4, 19; 31:9).

Jezusi fliste aramaisht, që do të thotë se shumë prej pasazheve ku shfaqet “Ati” në greqisht, si *Pater*, mund të reflektojnë aramaishten *Abba* (shih Marku 14:36). Ky term familjar, “Babi”, ose “Baba” pasqyron marrëdhënien e ngushtë të Jezusit me Atin. Fakti se ai ua zbuloi këtë ndjekësve të vet nxit edhe marrëdhënien tonë të ngushtë me atin. Termi “Atë” përdorej rrallë në DhV për JHVH, por Jezusi e përdori shpesh dhe gjerësisht. Kjo është një zbuluesë madhore e marrëdhënies së re të besimtarëve me Perëndinë përmes Krishtit (shih Mateu 6:9).

▣ **“sepse të tillë njerëz kërkon Ati që të jenë adhurues të tij”** Perëndia po kërkon në mënyrë aktive njerëzimin e humbur (shih Isa. 55; Ezek. 18:23, 32; Luka 19:10; Gjoni 1:12; 3:16).

4:24 “Perëndia është frymë” Në shkrimet e Gjonit ka një sërë frazash të shkurtra që përshkruajnë karakterin e Perëndisë: (1) Perëndia është dashuri; (2) Perëndia është dritë; (3) Perëndia është frymë. Kjo mund të ketë kuptimin (1) nuk është fizik; (2) nuk kufizohet në një vend të vetëm; (3) nuk lidhet me sekuencën kohore, ose (4) është qiellor, në dallim nga tokësorja.

4:25 “Mesia po vjen” Termi Mesia shfaqet vetëm dy herë në DhR, të dyja në ungjillin e Gjonit (shih 1:41; 4:25).

TEMË E VEÇANTË: MESIA

Kjo është marrë nga shënimet e komentarit tim për Danielin 9:6. Vështirësia në interpretimin e këtij vargu vjen për shkak të kuptimeve të mundshme që shoqërohen me termin Mesia, ose i Vajosuri (BDB 603).

1. përdorej për mbretërit judenj (p.sh., 1 Sam. 2:10; 12:3)
2. përdorej për priftërinjtë judenj (p.sh., Lev. 4:3, 5)
3. përdorej për Kirin (shih Isa. 45:1)
4. # 1 dhe # 2 kombinohen me njëri-tjetrin në Psalmi 110 dhe Zakaria 4
5. përdorej për Mbretin e ardhshëm e të veçantë davidik të Perëndisë, i cili do të sillte epokën e re të drejtësisë
 - a. pasardhja e Judës (shih Zan. 49:10)
 - b. familja e Jeseut (shih 2 Samueli 7)
 - c. mbretërim universal (shih Psalmi 2; Isa. 9:6; 11:1-5; Mik. 5:1-4 e më tej)

Personalisht, mua më tërheq identifikimi i “të vajosurit” me Jezusin e Nazaretit për këto arsye:

1. prezantimi i një Mbretërie të përjetshme në kapitullin 2 gjatë perandorisë së katërt
2. prezantimi i “një biri njeriu” në 7:13, të cilit i jepet një mbretëri e përjetshme
3. fjalitë shpenguese të 9:24, të cilat dëftojnë drejt pikës kulmore të historisë së botës së rënë
4. përdorimi që i bën Jezusi librit të Danielit në DhR (shih Mat. 24:15; Marku 13:14)

▣ **“kur të vijë ai, do të na shpallë çdo gjë”** Kjo tregon se samaritanët po prisnin një Mesi. Gjithashtu, tregon se ata mendonin se Mesia do të vinte për të zbuluar plotësinë e Perëndisë.

4:26 “Unë jam ai që po të flet” Ky mund të jetë aludim për Isa. 52:6. Është pohim i qartë dhe i hapur i natyrës së tij hyjnore (shumë e ndryshme nga ungjijtë sinoptikë)! Është lojë fjalësh me termin “Unë Jam”, që reflektonte emrin e besëlidhjes së Perëndisë në DhV, JHVH (shih Eks. 3:12, 14). Jezusi e përdori këtë emër të Perëndisë nga DhV si mënyrë për të folur për vetëzbuluesën e JHVH-së qartë dhe dukshëm në Jezusin (shih Gjoni 8:24, 28, 58; 13:19; 18:5; krahaso me Isa. 41:4; 43:10; 46:4). Ky përdorim i specializuar i termit “Unë Jam” duhet dalluar nga

pohimet e mirënjohura “Unë Jam” (Gjoni 6:35, 51; 8:12; 10:7, 9, 11, 14; 11:25; 14:6; 15:1, 5), të cilat ndiqen nga EMRA cilësues.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:27-30

²⁷Në atë çast, erdhën dishepujt, dhe u çuditën që ai po fliste me një grua, por askush nuk i tha “Çfarë do?”, ose “Pse po flet me të?” ²⁸Kështu, gruaja la kovën e saj, shkoi në qytet dhe u tha njerëzve: ²⁹“Ejani, shihni një njeri që më ka treguar gjithçka që kam bërë; mos është Krishti vallë?” ³⁰Ata dolën nga qyteti dhe po vinin tek ai.

4:27 “ata u çuditën që ai po fliste me një grua” Nga ana kulturore, judenjtë ortodoksë nuk e bënë kurrë këtë gjë.

■ **“por askush nuk i tha „Çfarë do?“, ose „Pse po flet me të?“** Ky është koment prej dëshmitari okular nga Gjoni. Atij duhet t’i jetë kujtuar mirë kjo ngjarje tronditëse!

4:28 “gruaja la kovën” Ky është një shënim kaq i bukur historik prej dëshmitari okular, i cili tregon ngazëllimin e asaj gruaje teksa u kthye turravrap në fshat për të dëshmuar (shih v. 29-30).

4:29 “mos është Krishti vallë?” Forma gramatikore pret përgjigjen “jo”, por konteksti tregon se ajo besonte se ai ishte Krishti vërtet! Konteksti është më i rëndësishëm se gramatika!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:31-38

³¹Ndërkaq, dishepujt po e nxisnin duke i thënë: “Rabbi, ha”. ³²Por ai u tha: “Unë kam një ushqim për të ngrënë që ju nuk e njihni”. ³³Kështu, dishepujt po i thoshin njëri-tjetrit: “Askush s’i solli ndonjë gjë për të ngrënë, apo jo?” ³⁴Jezusi u tha: “Ushqimi im është të bëj vullnetin e atij që më ka dërguar dhe të kryej punën e tij. ³⁵A nuk thoni: „ka dhe katër muaj, dhe pastaj vjen korrja?“ Shihni, po ju them, ngrini sytë dhe shikoni fushat, që janë të bardha për korrje. ³⁶Tashmë, korrësi po merr shpërblimin dhe po mbledh fryte për jetën e përjetshme, që mbjellësi dhe korrësi të mund të gëzojnë së bashku. ³⁷Sepse në këtë rast është e vërtetë thënia: „njëri mbjell e tjetri korr“. ³⁸Unë ju dërgova të korni atë për të cilën nuk u munduat; të tjerët janë munduar dhe ju hytë në mundimin e tyre”.

4:32 Ky është një tjetër aludim për dualizmin “qiell/tokë”, “shpirtërorja/fizikja”. Jezusi ishte në një mision ungjillëzues dhe zbulues. Përparësia ishin/janë njerëzit!

4:34: “Ushqimi im është të bëj vullnetin e atij që më ka dërguar dhe të kryej punën e tij” Gjoni 17 është shprehje e qartë e ndërgjegjësimit të Jezusit se çfarë donte Ati prej tij (Marku 10:45; Luka 19:10; Gjoni 6:29).

Kontrasti midis Jezusit të dërguar nga lart, nga vetë prania e Perëndisë, dhe misionit të tij për të zbuluar Atin dhe për të kryer punën e Atit. Ky është dualizmi vertikal që është tejet karakteristik për Gjoni (lart/poshtë; shpirti/fryma).

Ka dy terma të ndryshëm që përdoren për dërgimin e Jezusit.

1. *pempō* (4:34; 5:23,24,30,37; 6:38,39,40,44; 7:16,18,28,33; 8:16,18,26,29; 9:4; 12:44,45,49; 14:24; 5:21; 16:5)

2. *apostellō* (3:17,24; 5:36,38; 6:29,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,18,21,23,25; 20:21)

Siç tregon 20:21, këto janë sinonime. Po kështu, kjo tregon se edhe besimtarët dërgohen në një botë të humbur si përfaqësues të Atit me qëllim shpengimin (shih 2 Kor. 5:13-21).

TEMË E VEÇANTË: VULLNETI (*thelēma*) I PERËNDISË

UNGJILLI I GJONIT

- Jezusi erdhi për të bërë vullnetin e Atit (4:34; 5:30; 6:38)
- për të ngritur ditën e fundit të gjithë ata që Ati i dha Birit (shih 6:39)
- që të gjithë të besojnë në Birin (shih 6:29, 40)
- përgjigje ndaj lutjeve që lidhen me kryerjen e vullnetit të Perëndisë (shih 9:31 dhe 1 Gjonit 5:14)

UNGJIJTË SINOPTIKË

- kryerja e vullnetit të Perëndisë ka rëndësi jetike (shih Mat. 7:21)
- kryerja e vullnetit të Perëndisë e bën besimtarin vëlla ose motër me Jezusin (shih Mat. 12:50; Marku 3:35)
- nuk është vullneti i Perëndisë që njerëzit të humbasin (shih Mat. 18:14; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9)
- Kalvari ishte vullneti i Atit për Jezusin (shih Mat. 26:42; Luka 22:42)

LETRAT E PALIT

- pjekuria dhe shërbesa e gjithë besimtarëve (shih Rom. 12:1-2)
- besimtarët çlirohen nga kjo epokë e ligë (shih Gal. 1:4)
- vullneti i Perëndisë ishte plani i tij shpengues (shih Efe. 1:5, 9, 11)
- besimtarët përjetojnë dhe jetojnë jetën e mbushur me Frymën (shih Efe. 5:17-18)
- besimtarët mbushen me njohurinë e Perëndisë (shih Kol. 1:9)
- besimtarët përsosen dhe përmbushen (shih Kol. 4:12)
- besimtarët shenjtërohen (shih 1 Thes. 4:3)
- besimtarët japin falënderim për të gjitha gjërat (shih 1 Thes. 5:18)

LETRAT E PJETRIT

- besimtarët bëjnë gjënë e duhur (pra, u nënshtrohen autoriteteve qeverisëse) dhe, në këtë mënyrë, u mbyllin gojën njerëzve të marrë, duke siguruar një mundësi për ungjillizim (shih 1 Pjet. 2:15)
- besimtarët vuajnë (shih 1 Pjet. 3:17; 4:19)
- besimtarët nuk bëjnë jetë egoiste (shih 1 Pjet. 4:2)

LETRAT E GJONIT

- besimtarët mbeten përjetë (shih 1 Gjonit 2:17)
- besimtarët kanë rol kyç në përgjigjen e lutjeve (shih 1 Gjonit 5:14)

4:35 “ka dhe katër muaj, dhe pastaj vjen korrja” Kjo është një frazë metaforike që tregon se mundësia për përgjigje shpirtërore ishte tani! Njerëzit shpëtoheshin me anë të besimit në Jezusin, jo vetëm pas ringjalljes, por edhe gjatë jetës së tij.

4:36-38 “njëri mbjell, e tjetri korr” Këto vargje lidhen me shërbesën e profetëve, ose, ndoshta, të Gjon Pagëzorit. Kjo përdoret edhe te 1 Kor. 3:6-8 për marrëdhënien midis shërbesës së Palit dhe shërbesës së Apollos.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:39-42

³⁹Nga ai qytet, shumë prej samaritanëve besuan në të për shkak të fjalëve që dëshmoi gruaja: “Ai më tregoi gjithçka që kam bërë”. ⁴⁰Kështu, kur samaritanët erdhën te Jezusi, po i kërkonin që të rrinte me ta; dhe ai qëndroi dy ditë aty. ⁴¹Shumë të tjerë besuan për shkak të fjalës së tij; ⁴²dhe ata i thoshin gruas: “nuk po besojmë më për shkak të asaj që the ti, por sepse dëgjuam vetë dhe e dimë se Ky është me të vërtetë Shpëtimtari i botës”.

4:39 “shumë prej samaritanëve besuan në të” Gjoni përdor FOLJEN “besoj” në kombinim me disa terma të tjerë: “besoj në” (*en*), “besoj se” (*hoti*) dhe, më shpesh, “besoj te” (*eis*) ose vendos besimin në dikë (shih 2:11,23; 3:16,18,36; 6:29,35,40; 7:5,31,38, 48; 8:30; 9:35,36; 10:42; 11:25,26,45,48; 12:11,37,42,44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20). Në fillim, samaritanët besuan për shkak të dëshmisë së gruas (v. 39), por, pasi dëgjuan Jezusin, i besuan personalisht dëshmisë së tij (v. 41-42). Jezusi erdhi te delet e humbura të Izraelit, por ungjilli i tij ishte për gjithë njerëzimin: për samaritanët, gratë siro-fenikase, ushtarët romakë (shih Rom.10:12; 1 Kor. 12:13; Gal. 3:28-29; Kol. 3:11). Shih Temën e Veçantë, në 2:23.

■ **“për shkak të fjalëve që dëshmoi gruaja”** Nëse Perëndia përdori dëshminë e kësaj gruaje heretike dhe imorale, mund të përdorë edhe dëshminë tënde e timen! Ky varg tregon rëndësinë e dëshmisë personale. Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, te 1:8.

4:40

NASB, NRSV “i kërkonin”

NKJV “e nxisnin”

TEV, NJB “e përgjëronin”

Ky është një term i fortë grek që duhet përkthyer “nxis”, ose “përgjërohem”. Intensiteti i këtij termi mund të shihet në përdorimin e tij në v. 47 (shih Luka 4:38).

4:42 “Shpëtimtari i botës” Ky titull universal përdoret edhe te 1 Gjonit 4:14. Përdoret edhe në kuptimin universal të dashurisë së Perëndisë për gjithë njerëzimin (shih 1 Tim. 2:6; Heb. 2:9; 1 Gjonit 2:2). Premtimi i Zan. 3:15 është përbushur! Në shekullin e parë, kjo frazë përdorej shpesh për Cezarin. Përndjekja romake ndodhi për shkak se të krishterët e përdornin këtë titull vetëm për Jezusin. Ky titull tregon gjithashtu sesi autorët e DhR i atribuonin Birit titujt e Perëndisë Atë: Titi 1:3 – Titi 1:4; Titi 2:10 – Titi 2:13; Titi 3:4 – Titi 3:6.

Judenjtë e patën refuzuar Jezusin (shih 1:11), kurse samaritanët e pranuan shpejt dhe lehtësisht (shih 1:12)!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:43-45

⁴³Pas dy ditësh, ai shkoi prej andej në Galile. ⁴⁴Sepse vetë Jezusi dëshmoi se profeti nuk nderohet në vendin e vet. ⁴⁵Kështu, kur erdhi në Galile, galileasit e pranuan, pasi kishin parë të gjitha ato që ai kishte bërë në Jerusalem gjatë festës; sepse dhe ata vetë kishin shkuar në festë.

4:43 Ky varg tregon se Jezusi lëvizte më lirisht dhe më shpesh midis Judesë dhe Galilesë nga ç’mund të mendosh në bazë të ungjijve sinoptikë.

4:44 Ky është varg tejet i pazakontë, pasi nuk përputhet me kontekstin paraprirës. Mund t’i referohet shërbesës galilease që do të fillonte pas pak (shih 4:3). Ky proverb gjendet edhe te Mat. 13:57; Marku 6:4; Luka 4:24. Në ungjijtë sinoptikë, i referohet Galilesë, kurse këtu i referohet Judesë.

Thuhet se edhe galileasit e “pranuan” Jezusin, por shumë prej tyre nuk e vazhduan edhe më vonë atë pranim dhe e braktisën. “Besoj” dhe “pranoj” nënkuptojnë më tepër sesa pranimin fillestar (shih Shëmbëlltyrën e Mbjellësit dhe Farës te Mat. 13:18-23; Marku 4:12-20; Luka 8:11-15). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për Qëndresë, në 8:31.

4:45 “Galileasit e pranuan” Ata i kishin përjetuar tashmë mësimet dhe mrekullitë e Jezusit gjatë një vizite Pashke në Jerusalem. Kjo nënkupton se, të paktën deri në njëfarë mase (shih v. 48), ata besonin në Jezusin si Mesia i Perëndisë (shih 1:12).

■ “sepse dhe ata vetë kishin shkruar në festë” Bibla NET e konsideron koment në kllapa prej autorit, bashkë me gjithë v. 44 (shih NRSV, NIV).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:46-54

⁴⁶Kështu, ai erdhi sërish në Kanë të Galilesë, ku e kishte kthyer ujin në verë. Dhe aty ishte një nëpunës i mbretit, i cili kishte djalin të sëmurë në Kapernaum. ⁴⁷Kur dëgjoi se Jezusi kishte ardhur nga Judea në Galile, shkoi tek ai dhe po i përgjërohej që të zbriste e t’ia shëronte të birin; sepse ishte gati për të vdekur. ⁴⁸Kështu, Jezusi i tha: “Nëse ju nuk shihni shenja e mrekulli, nuk besoni”. ⁴⁹Nëpunësi i mbretit i tha: “Zotëri, zbrit përpara se të më vdesë fëmija”. ⁵⁰Jezusi i tha: “Shko; yt bir jeton”. Ai njeri i besoi fjalës që i tha Jezusi dhe u nis. ⁵¹Ndërsa po zbriste, skllëvërit i dolën përpara dhe i thanë se biri i tij jetonte. ⁵²Kështu, ai i pyeti për orën kur filloi të ndihej më mirë. Dhe ata i thanë: “Dje, në orën e shtatë, e lanë ethet”. ⁵³Kështu, babai e kuptoi se ajo ishte ora kur Jezusi i tha: “Yt bir jeton”, dhe ai vetë besoi, bashkë me gjithë familjen e vet. ⁵⁴Sërish, kjo ishte një shenjë e dytë që kreu Jezusi kur shkoi nga Judea në Galile.

4:46

NASB, NRSV,

NJB “nëpunës i mbretit”

NKJV “njëfarë fisniku”

TEV “një zyrtar i qeverisë”

Ky ishte një zyrtar qeveritar në shërbim të familjes së Herodit.

4:48 “Nëse ju nuk shihni shenja e mrekulli, nuk besoni” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË me MOHIM TË DYFISHTË kategorik. Jezusi i drejtohet atij njeriu në SHUMËS. Judenjtë kërkonin shenja (shih 2:18; 6:2, 30; Mat. 12:38; 16:1). Por ky shërbëtor i Herodit besoi përpara se t’i jepej shenja.

4:49 “fëmija” Në tre vargje, Gjoni përdor tre terma të ndryshëm.

1. v. 49 – *paidion* (NASB, “fëmijë”)
2. v. 50 – *hyiōs* (NASB, “bir”)
3. v. 51 – *pais* (NASB, “bir”)

Qartazi, këto terma përdoren si sinonime.

4:50 Ky varg rrok thelbin e ungjillit të Gjunit: beso në Jezusin, beso në fjalët e tij, beso në veprat e tij, beso në Personin e tij! Besimi i këtij njeriu vërtetoi bindjen e tij pa parë premtimet e Jezusit.

4:53 “ai vetë besoi, bashkë me gjithë familjen e vet” Ky është rrëfimi i parë ndër të shumtët ku besimi i një personi preku gjithë familjen e tij.

1. Korneli (Veprat 10:44-48)
2. Lidia (Veprat 16:15)
3. Gardiani në Filipi (Veprat 16:31-34)
4. Krispi (Veprat 18:8)
5. Stefanai (1 Kor. 1:16)

Ka patur shumë diskutime për këto kthime në besim të familjeve të tëra, por duhet theksuar se të gjithë anëtarët duhet të pranonin vetë personalisht Jezusin. Lindja e Mesme është shumë më fisnore dhe më e orientuar ndaj familjes se kulturat moderne. Po kështu, është e vërtetë se njerëzit e rëndësishëm në jetën tonë ndikojnë në zgjedhjet tona.

4:54 Shenja e parë publike ishte ajo në gostinë e dasmës në Kanë (shih 2:1-11).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse u largua Jezusi nga zona e Judesë?
2. Ç’orar përdor Gjoni? Orarin romak, apo atë të judenjve?
3. Pse është kaq e rëndësishme që Jezusi po flet me një grua nga Samaria?
4. Si ndikon vargu 20 në marrëdhëniet mes denominacioneve sot?
5. Shpjego pohimin e habitshëm që bëu Jezusi në vargun 26.
6. A ushtruan besim të vërtetë galileasit?

GJONI 5

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërimi te pellgu	Një burrë shërohet në pellgun e Betsedës	Shërimi i ulokut në shabat	Shërimi te pellgu	Shërimi i një të sëmuri në pellgun e Betsedës
5:1-9a	5:1-15	5:1 5:2-9a	5:1-6 5:7 5:8-9a	5:1-9a
5:9b-18		5:9b-18	5:9b-10 5:11 5:12 5:14 5:16 5:15-17 5:18	5:9b-18
Autoriteti i Birit	Nderoni Atin dhe Birin 5:16-23	Marrëdhënia e Jezusit me Perëndinë	Autoriteti i Birit	
5:19-29	Jeta dhe gjykimi janë përmes Birit 5:24-30	5:19-24 5:25-29	5:19-23 5:24-29	5:19-47
5:30		Provat e marrëdhënies së Jezusit me Perëndinë 5:30	Dëshmitarët për Jezusin 5:30	
Dëshmitarët për Jezusin	Dëshmia e katërfishtë			
5:31-40	5:31-47	5:31-38 Jezusi qorton ata që s'ia pranojnë ofertën 5:39-47	5:31-40	
5:41-47			5:41-47	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:1-9a

¹Pas këtyre gjërave, ishte një festë e judenjve dhe Jezusi u ngjit në Jerusalem. ²Tani, në Jerusalem, pranë portës së dhenve, ishte një pellg, që në hebraisht quhet Betesda, i cili kishte pesë portikë. ³Nën to dergjeshin një numër i madh i atyre që ishin të sëmurë, të verbër, të çalë e të paralizuar, ⁴[duke pritur lëvizjen e ujit; sepse një engjëll i Zotit zbriste në kohë të caktuara në pellg dhe trazonte ujin; pastaj, pasi përzihej uji, kush zbriste i pari shërohej nga çfarëdo sëmundjeje të kishte.] ⁵Aty ishte një burrë që kishte tridhjetë e tetë vjet sëmurë. ⁶Kur Jezusi e pa tek dergjej aty, dhe e kuptoi se kishte tashmë një kohë të gjatë në atë gjendje, i tha: “A dëshiron të shërohesh?” ⁷I sëmuri i tha: “Zotëri, s’kam njeri që të më fusë në pellg kur trazohet uji, por ndërsa unë shkoj, dikush tjetër zbrret përpara meje”. ⁸Jezusi i tha: “Ngrihu, merr shtrojën tënde dhe ec!” ⁹Menjëherë, burri u shërua, mori shtrojën e vet dhe filloi të ecte.

5:1 “një festë” Disa dorëshkrime të lashta greqisht, të tipit uncial, Ɑ dhe C, shkruajnë “festa”, por shumica e dorëshkrimeve shkruajnë “një festë” (P⁶⁶, P⁷⁵, A, B, dhe D). Kishte tre ditë festash vjetore që ishin të detyrueshme për pjesëmarrjen e meshkujve judenj nëse ishte e mundur (shih Levitiku 23): (1) Pashka; (2) Rrëshajat; dhe (3) Festa e Çadrave. Nëse kjo i referohet Pashkës, atëherë Jezusi pati një shërbesë publike katërvjeçare, jo trevjeçare (shih 2:13, 23; 6:4; 12:1). Tradicionalisht, është menduar se Jezusi pati një shërbesë publike trevjeçare pas pagëzimit nga Gjoni. Kjo shifër sigurohet vetëm nga numri i festave të Pashkës që përmenden në ungjillin e Gjonit.

■ **“Jezusi u ngjit në Jerusalem”** Te Gjoni, na thuhet se Jezusi shkoi për festa në Jerusalem disa herë (shih 2:13; 5:1; 7:10; 12:12).

Jerusalemi ishte ndërtuar mbi shtatë kodra dhe ishte më i lartë se toka përreth. Kështu, fraza “u ngjit” mund të jetë fizikisht e vërtetë. Gjithsesi, duket se është përdorur si idiomë metaforike epërsie. Jerusalemi, për shkak të tempullit, ishte vendi i lartë i tokës dhe qendra (kërthiza) e tokës.

5:2 “pranë portës së dhenve” Kjo “portë e bagëtive” ishte në pjesën verilindore të murit të Jerusalemit. Përmendet në ripërkushtimin dhe rindërtimin e mureve të qytetit nga ana e Nehemisë (shih Neh. 3:1, 32; 12:39).

■ **NASB, NKJV “një pellg, që në hebraisht quhet Betesda”**

NRSV “që në hebraisht quhet Bet-zata”

TEV “që në hebraisht quhet Betzata”

NJB “i quajtur Betesda në hebraisht”

Ekzistojnë një sërë shqiptimesh të ndryshme të këtij emri. Edhe Jozefusi e quajti sipas emrit hebre “Betzata”, që ishte emri i kësaj pjese të Jerusalemit. Quhet edhe “Betsaida” në disa dorëshkrime greqisht. Pergamenat e bakërta të Kumranit e quajnë “Betesda”, që do të thotë “shtëpia e mëshirës”, ose “shtëpia e dy burimeve”. Sot, njihet si pellgu (pellgjet) e shën Anës.

Në kohën e Jezusit, judenjtë e Palestinës flisnin aramaisht, jo hebraisht. Te Gjoni, kur thuhet “hebraisht” nënkuptohet “aramaisht” (shih 5:2; 19:13, 17, 20; 20:16; Zbu. 9:11; 16:16). Të gjitha pohimet e Jezusit, si

1. *Talitha kum*, Marku 5:41
2. *Effata*, Marku 7:34
3. *Eloi, Eloi, lama sabaktthani*, Marku 15:34

janë në aramaisht.

5:4 Ky varg (3b-4) është një komentari i mëvonshëm i një kopjuesi, që përpiket të shpjegojë

1. praninë e gjithë të sëmurëve përbri pellgut
2. pse ky burrë kishte kaluar kaq kohë aty
3. pse ai donte që dikush ta fuste në ujë, v. 7

Kjo është qartazi një përrallë judaike. Nuk ishte pjesë e ungjillit origjinal të Gjonit. Provat pse ky varg nuk duhet përfshirë janë:

1. nuk gjendet në dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, Ɑ, B, C*, D
2. shënohet me asterisk në mbi 20 dorëshkrime të mëvonshme greqisht, duke treguar se kjo pjesë mendohej se nuk ishte origjinale

3. në këtë varg të shkurtër përmenden një sërë fjalësh që Gjoni s'ï përdor askund tjetër. Ai përfshihet në një sërë dorëshkrimesh të hershme unciale greke, A, C³, K dhe L. Po kështu, përfshihet në Diatesaron (rreth vitit 180), si dhe në shkrimet e Tertulianit (200 pas K.), Ambrozit, Gojartit dhe Kirilit. Kjo tregon lashtësinë e kësaj pjese, por jo përfshirjen e saj në ungjillin e frymëzuar origjinal. Ajo përfshihet në KJV, NASB (rishikimi i 1995, në kllapa katrore) dhe në NKJV, por lihet jashtë te NASB (1970), NRSV, NJB, REB, Bibla NET dhe NIV.

Për një diskutim të mirë të variantit në dorëshkrime nga një kritik tekstual ungjillor, shih Gordon Fee, *To What End Exegesis?* f. 17-28.

5:5-6 Arsyeja pse Jezusi zgjodhi këtë njeri në veçanti është e panjohur për ne. Ndoshta, ai kishte qenë më gjatë se të tjerët aty. Pak besim kërkohet nga ana e këtij njeriu. Me sa duket, Jezusi po përpiqej të niste një përballje me udhëheqësit judenj. Kjo i dha mundësinë të mbështeste pretendimin e vet mesianik. Pasazhi eskatologjik i Isa. 35:6 mund të lidhet me këtë shërim mesianik.

Shumë prej mrekullive të Jezusit nuk kryheshin pikësisht për individin, por për ata që vështronin.

1. dishepujt
2. autoritetet judaike
3. turma

Ungjijtë përzgjedhin disa mrekulli për të zbuluar qartë se kush ishte Jezusi. Këto ngjarje përfaqësojnë veprimet e tij të përditshme. Ato përzgjidhen për të treguar

1. personalitetin e tij
2. dhembshurinë e tij
3. pushtetin e tij
4. autoritetin e tij
5. zbulesën e qartë të Atit nga Jezusi
6. zbulesën e qartë të epokës mesianike nga ai

5:8 “Ngrihu, merr shtrojën tënde dhe ec” Kjo është një seri urdhrash.

1. një URDHËRORE E TASHME VEPRORE
2. e ndjekur nga një URDHËRORE AORISTE VEPRORE
3. pastaj, nga një tjetër URDHËRORE E TASHME VEPRORE

Shtroja ishte një si jastëk cohe që të varfrit e përdornin për të fjetur. Për këta të sëmurë, të çalë dhe të paralizuar, ai shërbente si ndenjësë gjatë ditës (shih Marku 2:4, 9, 11, 12; 6:55; Veprat 9:33).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:9b-18

^{9b}Atë ditë ishte shabat. ¹⁰Kështu, judenjët i thanë atij që u shërua, “Është shabat, dhe nuk është e lejueshme që të mbartësh shtrojën”. ¹¹Por ai iu përgjigj: “Ai që më shëroi ishte ai që më tha: „Merr shtrojën tënde dhe ec?”. ¹²Ata e pyetën: “Kush është ai që të tha: „Merr shtrojën tënde dhe ec?”” ¹³Por ai që u shërua nuk e dinte se kush ishte, sepse Jezusi ishte larguar ndërsa kishte ende turmë në atë vend. ¹⁴Më pas, Jezusi e gjeti në tempull dhe i tha: “Ja, u shërove; mos mëkato më, që të mos të të ndodhë diçka më e keqe”. ¹⁵Burri u largua dhe u tha judenjve se ai që e kishte shëruar ishte Jezusi. ¹⁶Për këtë arsye e përndiqnin judenjët Jezusin, sepse po i bënte këto gjëra ditën e shabatit. ¹⁷Por ai iu përgjigj atyre: “Ati im po vepron deri tani, ndaj dhe unë po veproj”. ¹⁸Prandaj, për këtë arsye, judenjët po përpiqeshin edhe më tepër ta vrisnin, sepse ai jo vetëm që po shkelte shabatit, por edhe po e thërriste Perëndinë Atë, duke barazuar veten me Perëndinë.

5:9b “Atë ditë ishte shabat” Krerët e judenjve as nuk u gëzuan që u shërua ai burri, por u fyen që Jezusi shkeli traditën gojore (që, më vonë, u kodifikua në Talmud) që kishte të bënte me shabatit (shih v. 16, 18; Mat. 7:1-23). Shërimet e Jezusit në shabat mund të shpjegohen në dy mënyra.

1. Ai shëronte çdo ditë, por polemikat u krijuan për shkak të shërimeve në shabat
2. Ai zgjodhi këtë rast për të shkaktuar polemikë, si një mundësi për t'ï përfshirë udhëheqësit fetarë në dialog teologjik.

Jezusi shëronte shpesh në shabat (shih Mat. 12:9-14; Marku 1:29-31; 3:1-6; Luka 6:6-11; 14:1-6; Gjoni 5:9-18; 9:14). Madje, dëbonte dhe demonë në shabat (shih Marku 1:21-28; Luka 13:10-17). Jezusi i mbrojti dishepujt kur hëngrën në shabat (shih Mat. 12:1-8; Marku 2:23-28). Ai nisi tema polemizuese në sinagogë ditën e shabatit (shih Luka 4:16-30; Gjoni 7:14-24).

5:13 “Jezusi ishte larguar” Fjalë për fjalë, “kthej kokën mënjane”. Jezusi dukej si jude normal i kohës. Ai përzihej lehtë me turmën.

5:14

NASB, NRSV,

NJB “mos mëkato më”

NKJV “mos mëkato më”

TEV “prandaj, mos mëkato më”

Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE, që shpesh nënkuptonte ndalimin e një veprimi që po kryhej tashmë, por në këtë kontekst kjo duket e pagjasë (shih Bibla NET, f. 1907 #8). Teologët judenj të shekullit të parë e lidhnin sëmundjen me mëkatin (shih Jakobi 5:14-15). Kjo nuk shpjegon çdo sëmundje, siç mund të shihet nga sjellja e Jezusit me një njeri që ishte lindur i verbër (shih Gjoni 9) dhe fjalët e Jezusit te Luka 13:1-4.

Jezusi ende po merrej me jetën shpirtërore të atij njeriu. Veprimet tona pasqyrojnë zemrën dhe besimin që kemi. Besimi biblik është edhe objektiv, edhe subjektiv, edhe besim, por edhe veprim.

Sot, në kishë, vihet shumë theksi te shërimi fizik. Patjetër që Perëndia ende shëron. Por shërimi hyjnor duhet të rezultojë në një ndryshim shpirtëror të jetës dhe përparësive të njeriut. Një pyetje e mirë do të ishte: “pse dëshiron të shërohesh?”

TEMË E VEÇANTË: A ËSHTË SHËRIMI PLANI I PERËNDISË PËR ÇDO EPOKË?

1. Shërimi ishte aspekt i rëndësishëm i shërbesës së Jezusit dhe apostujve.
2. Synimi parësor i tij ishte të mbështeste mesazhin e tyre rrënjësisht të ri për Perëndinë dhe për mbretërinë e tij.
3. Shërimi tregon zemrën e Perëndisë për njerëzit e vuajtur.
4. Perëndia nuk ka ndryshuar (Mal. 3:6), por ende vepron me dashuri në shërim.
5. Ka shembuj ku shërimi nuk ndodhte.
 - a. Pali, 2 Kor. 12:7-10
 - b. Trofimi, 2 Tim. 4:20
6. Mëkati dhe sëmundja lidheshin me njëra-tjetrën nga rabinët dhe nga Jakobit (shih Gjoni 9:2; Jakobi 5:13-18)
7. Shërimi nuk ishte garanci e Besëlidhjes së Re. Nuk ishte pjesë e shpengimit të përshkruar të Isaia 53 dhe Psalmi 103.
8. Është mister i vërtetë pse disa shërohen dhe disa të tjerë, jo.
9. Ka mundësi që, ndonëse shërimi është i pranishëm në çdo epokë, pati një shtim të fortë të tij gjatë jetës së Jezusit; ky shtim do të ndodhë sërish pak para se të kthehet Jezusi.

5:15 “Burri u largua dhe u tha judenjve” Motivi i saktë pse ai informoi autoritetet e judenjve është i paqartë.

1. Ngjan si veprim i pamenduar dhe mendjelehtë, që tregon se shërimi nuk fillon gjithmonë me besimin, as përfundon me të
2. Jezusi i tha ta bënte këtë (shih Mat. 8:4; Marku 1:44; Luka 5:14; 17:14)

5:16 “sepse po i bënte këto gjëra ditën e shabatit” FOLJA është DËFTORE E PAKRYER VEPRORE, që nënkupton një veprim të vazhduar në të shkuarën. Ky s’ishte shërimi i parë (as i fundit) që bënte Jezusi në shabat!

5:17

NASB “Por ai iu përgjigj”

NKJV, REV,

NRSV, NIV “Por Jezusi iu përgjigj”

NJB “Përgjigjja e tij për ta ishte”

Kopjuesit që kopjuan dorëshkrimet e hershme greke kishin prirjen që

1. të thjeshtëzonin gramatikën
2. t’i bënin të qartë referentët përemërorë
3. të standardizonin frazat

Është e vështirë të dimë se cila formë e v. 17 ishte origjinale.

1. “por ai...” – P⁷⁵, x, B, W
2. “por Jezusi...” – P⁶⁶, A, D, L
3. “por Zoti...” ose “Zoti Jezus” – përkthimet siriane

UBS⁴ i jep mundësisë #2 vlerësimin “C” (e vështirë për t’u vendosur).

■ **“Ati im po vepron deri tani, ndaj dhe unë po veproj”** Këto janë të dyja FOLJE DËFTORE TË TASHME MESORE (me kuptim vepror). Jezusi po pohonte se Ati nuk pushon së bëri të mira ditën e shabatit, dhe Biri vepron njësoj (për një diskutim të mirë të këtij vargu, shih Manfred Brauch, *Abusing Scripture*, f. 219). Në një kuptim të vërtetë, ky ishte pohim i mënyrës si e kuptonte Jezusi marrëdhënien e vet unike me Atin (shih v. 19-29).

Koncepti judaik i monoteizmit (shih LiP. 6:4) shprehej praktikisht me shpjegimin “me një shkak” të ngjarjeve të kësaj bote (shih Gjyq. 9:23; Jobi 2:10; Pred. 7:14; Isa. 45:7; 59:16; Vaj. 3:33-38; Amosi 3:6). Në fund fare, të gjitha veprimet janë veprime të Perëndisë së vetëm e të vërtetë. Kur Jezusi pranoi dyfishësinë e veprimeve të Perëndisë në botë, ai pohoi një dualizëm të shkakësisë hyjnore. Ky është problemi i vështirë i Trinisë. Një Perëndi, por tre shfaqje personale (shih Mat. 3:16-17; 28:19; Gjoni 14:26; Veprat 2:33-34; Rom. 8:9-10; 1 Kor. 12:4-6; 2 Kor. 1:21-22; 13:14; Gal. 4:4; Efe. 1:3-14; 2:18; 4:4-6; Titi 3:4-6; 1 Pjet. 1:2). Shih Temën e Veçantë: Trinia, te 14:26.

5:18 “për këtë arsye, judenjtë po përpiqeshin edhe më tepër ta vrisnin” Ka dy arsye pse judenjtë donin të vrisnin Jezusin.

1. Ai theu (fjalë për fjalë, “zgjidhi”, DËFTORE E PAKRYER VEPRORE, shih Mat. 5:19) publikisht traditën gojore (Talmudin) në lidhje me shabatit
2. Pohimet e tij tregonin se ata kuptonin se ai po pohonte se ishte i barabartë me Perëndinë (shih 8:58-59; 10:33; 19:7)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:19-23

¹⁹Prandaj, Jezusi u përgjigj dhe iu tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them; Biri s’mund të bëjë asgjë nga vetja, përveç asaj që sheh se bën Ati; sepse, çfarëdo gjë që bën Ati, këto gjëra i bën dhe Biri në të njëjtën mënyrë. ²⁰Sepse Ati e do Birin dhe i tregon të gjitha gjërat që po bën vetë; dhe Ati do t’i tregojë vepra edhe më të mëdha se këto, që ju të mrekulloheni. ²¹Sepse, ashtu si Ati ringjall të vdekurit dhe u jep jetë, kështu dhe Biri i jep jetë kujtdo që dëshiron. ²²Sepse as Ati nuk gjykon asnjë, por gjithë gjykimin ia ka dhënë Birit, ²³që të gjithë të nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin. Ai që nuk nderon Birin, nuk nderon Atin, që e ka dërguar.

5:19, 24, 25 “Me të vërtetë, me të vërtetë” Fjalë për fjalë “Amen, amen”. Termi “amen” është tejskronjzim nga hebraishtja. Në fillim, kishte kuptimin besueshmëri. Më vonë, u përdor për të pohuar një të vërtetë. Jezusi është i vetmi që njihet se e përdorte këtë fjalë në fillim të një pohimi. Ai e përdorte si parathënie për pohime të rëndësishme. Gjoni është i vetmi që regjistron dyfishimin e këtij termi fillestar. Shih Temën e Veçantë: Amen, te 1:51.

5:19 “Biri” Në disa vargjet në vijim bëhet një përsëritje e rëndësishme teologjike e termit “Bir”. Përdoret tetë herë në këtë kontekst të shkurtër. Kjo tregon mënyrën unike sesi e kuptonte Jezusi marrëdhënien e vet me Atin dhe pasqyron titujt “Biri i Njeriut” dhe “Biri i Perëndisë”.

■ **“Biri s’mund të bëjë asgjë nga vetja”** Siç është shpesh e vërtetë, DhR e paraqet Jezusin në shprehje paradoksale. Në disa pasazhe

1. ai është një me Atin (1:1; 5:18; 10:30,34-38; 14:9-10; 20:28)
2. është veçmas nga Ati (1:2,14,18; 5:19-23; 8:28; 10:25,29; 14:10,11,12,13,16; 17:1-2)
3. madje, është i nënshtruar ndaj tij (5:20,30; 8:28; 12:49; 14:28; 15:10,19-24; 17:8)

Ndoshta, synimi i kësaj është të tregojë se Jezusi është plotësisht hyjnor, por edhe një shfaqje e veçantë, e dallueshme, personal dhe e përvetshme e hyjnisë.

Në komentarin e redaktuar nga John Raymond E. Brown, *The Jerome Biblical Commentary*, jepet një argument i fortë:

“Nënkuptimi i nënshtrimit këtu nuk duhet hequr duke i kuptuar fjalët e Jezusit sikur i referohen vetëm natyrës së tij njerëzore... Kjo do të thoshte të mos kuptonim një pikë të mprehtë të kristologjisë së

Gjonit. Përkundrazi, Jezusi po këmbëngul për një harmoni absolute aktiviteti mes Atit dhe Birit që, sigurisht, kërkon rrënjësisht një njëjtësi natyre; ky proces përdoret edhe te 16:12 e më tej për t'iu referuar lidhjes së Frymës së Shenjtë me Birin. Por, në gjithë këtë ungjill, nuk e gjejmë kurrë Trininë të trajtohet si tezë teologjike abstrakte; ajo shihet gjithmonë nga pikëvështrimi i vlerës që ka për soteriologjinë” (f. 434).

■ **“përveç asaj që sheh se bën Ati”** Njerëzimi s’e ka parë kurrë Atin (shih v. 37 dhe 1:18), por Biri po pohon njohurinë e ngushtë, personale dhe të tashme të tij (shih 1:1-3).

■ **“sepse, çfarëdo gjë që bën Ati, këto gjëra i bën dhe Biri në të njëjtën mënyrë”** Në veprimet dhe mësimet e Jezusit, njerëzit shohin qartë Perëndinë e padukshëm (shih Kol. 1:15; Heb. 1:3).

5:20 “Ati e do Birin dhe i tregon të gjitha gjërat që po bën vetë” Të dyja këto janë DËFTORE TË TASHME VEPRORE, që flasin për një veprim të vazhduar. Ky është termi grek për dashurinë, *fileō*. Normalisht, do të kishim pritur fjalën *agapaō*, si te 3:35. Këto dy fjalë për dashurinë kanë një mbivendosje të gjerë semantike në greqishten *koine* (shih D. A. Carson, *Exegetical Fallacies*, bot. 2, f. 32-33, dhe F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 73).

■ **“vepra më të mëdha”** Në këtë kontekst, kjo bën fjalë për ringjalljen e të vdekurve (v. 21, 25-26) dhe ekzekutimin e gjykimit (v. 22, 27).

■ **“që ju të mrekulloheni”** Kjo FJALI QËLLIMI tregon qartë se qëllimi i mrekullive është që judenjtë (SHUMËSI ju) të besojnë në Birin e pashoq (shih v. 23; Veprat 13:41 [Hab. 1:5]).

5:12 “Ati ringjall të vdekurit... kështu dhe Biri” Në Dhiatën e Vjetër, JHVH është i vetmi që mund të japë jetë (shih LiP. 32:39). Fakti se Jezusi mund të ringjallë të vdekurit është pohim barazie me JHVH (shih v. 26). Jezusi jep jetë të përgjeshme tani (shih 2 Kor. 5:17; Kol. 1:13), që lidhet me shfaqjen fizike të jetës në epokën e re në v. 26 (shih 1 Thes. 4:13-18). Duket se takimi i zgjatur i Gjonit me Jezusin është mbi baza individuale, ndonëse ende mbetet një ngjarje e ardhshme kolektive (gjykimi dhe shpëtimi).

■ **“kështu dhe Biri i jep jetë kujtdo që dëshiron”** Kujt zgjedh Biri t’i japë jetë? Në këtë kontekst, ky s’është varg prove për kalvinizmin, por një pohim se besimi në Jezusin sjell jetë (shih 1:12; 3:16). Tensioni vjen nga 6:44, 65. A zgjedh Fryma “të gjithë” apo “disa”? Mendoj se është e qartë që njerëzit e rënë nuk marrin nismën në sferën shpirtërore, por jam i përkushtuar biblikisht edhe ndaj faktit se ata duhet t’i përgjigjen (dhe të vazhdojnë t’i përgjigjen) nxitjes së Frymës me anë të pendimit, besimit, bindjes dhe qëndresës! Misteri i vërtetë është përse disa, që dëgjojnë ungjillin, thonë “Jo”! Këtë, e quaj “misteri i mosbesimit”. Në të vërtetë, ky është “Mëkati i Pafalshëm” i ungjijve dhe “Mëkati që çon në vdekje” i 1 Gjonit. Shih Temën e Veçantë të 1 Gjonit 5:16.

TEMË E VEÇANTË: PROCEDURA EKSEGJETIKE PËR INTERPRETIMIN E “MËKATIT TË PAFALSHËM”

- A. Mos harroni se ungjijtë reflektojnë një kontekst judaik
 1. Dy lloje mëkatesh (shih Lev. 4:2, 22, 27; 5:15, 17-19; Num. 15:27-31; LiP. 1:43; 17:12-13)
 - a. të paqëllimshëm
 - b. të qëllimshëm
 2. Konteksti judaik para Rrëshajave (pra, përmbushja e ungjillit dhe Frymës nuk janë shfaqur ende)
- B. Vini re kontekstin letrar të Markut 3:22-30
 1. Mosbesimi i vetë familjes së Jezusit (shih 3:31-32)
 2. Mosbesimi i farisenjve (shih 2:24; 3:1, 6, 22)
- C. Krahasoni paralelet ku titulli “Bir i Njeriut” ndryshon në “bij njerëzish”
 1. Mat. 12:22-37 (pra, 12:32, “një fjalë kundër Birit të Njeriut”)
 2. Luka 11:14-26; 12:8-12 (pra, 12:10, “një fjalë kundër Birit të Njeriut”)
 3. Marku 3:28 (pra, “Të gjitha mëkatet do t’u falen bijve të njerëzve”)

5:22 MOHORJA E DYFISHTË e fortë dhe **FOLJA NË KOHËN E KRYER** theksojnë faktin se gjykimi i është dorëzuar Birit (shih 5:27; 9:39; Veprat 10:42; 17:31; 2 Tim. 4:1; 1 Pjet. 4:5). Paradoksi në dukje mes këtij vargu dhe Gjtonit 13:17 shpjegohet nga fakti se Jezusi, gjatë këtyre “ditëve të fundit”, nuk gjykon asnjë, por njerëzit gjykojnë veten me reagimin e tyre ndaj Jezu Krishtit. Gjykimi eskatologjik i Jezusit (ndaj jobesimtarëve) bazohet në pranimin ose refuzimin e tij.

Dhënia e jetës ose gjykimit të përjetshëm ishte tematika e 3:17-21, 36. Dashuria e Perëndisë në Krishtin, kur ai refuzohet, kthehet në zemërimin e Perëndisë! Ka vetëm dy alternativa! Ka vetëm një mënyrë për të marrë jetën e përjetshme – besimi në Krishtin (shih 10:1-18; 14:6 1 Gjtonit 5:9-12)!

5:23 “që të gjithë të nderojnë Birin” Termi përfshirës “të gjithë” mund t’i referohet një skene gjykimi eskatologjik (shih Fil. 2:9-11).

■ **“Ai që nuk nderon Birin, nuk nderon Atin, që e ka dërguar”** Ky pohim është shumë i ngjashëm me 1 Gjtonit 5:12. Askush nuk mund të njohë Perëndinë nëse nuk njeh Birin e tij, dhe anasjellas, askush nuk mund të nderojë ose përlëvdojë Atin nëse nuk përlëvdon Birin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:19-23

²⁴“Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them; ai që dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar, ka jetën e përjetshme dhe nuk vjen nën gjykim, por ka kaluar nga vdekja në jetë. ²⁵Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them; po vjen ora, madje ka ardhur, kur të vdekurit do të dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë, dhe ata që do të dëgjojnë, do të jetojnë. ²⁶Sepse, ashtu si Ati ka jetë në vetvete, kështu i ka dhënë dhe Birit që të ketë jetë në vetvete; ²⁷dhe ai i ka dhënë autoritet për të ekzekutuar gjykimin, sepse ai është Biri i Njeriut. ²⁸Mos u habitni nga kjo; sepse po vjen një orë, kur të gjithë që janë në varre do të dëgjojnë zërin e tij ²⁹dhe do të dalin prej tyre; ata që bënë vepra të mira në ringjalljen e jetës, ndërsa ata që bënë vepra të liga në ringjalljen e gjykimit.

5:24 “Me të vërtetë, me të vërtetë” Dyfishimi unik i fjalëve të Jezusit (v. 25) te Gjtoni përbën hyrje karakteristike për pohime të rëndësishme. Shih Temën e Veçantë “Amen” në 1:51.

■ **“ai që dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar, ka jetën e përjetshme”** Këto janë tre FORMA FOLOJRE TË TASHME VEPRORE. Këtu po vihet theksi te besimi (shih Temën e Veçantë te 2:23) në Atin, i cili ushtrohet me anë të besimit në Birin (shih 1 Gjtonit 5:9-12). Në ungjijtë sinoptikë, jeta e përjetshme është shpesh një ngjarje e ardhshme që shpresohet me besim, por te Gjtoni ajo është në mënyrë karakteristike një realitet i tanishëm (pra, 8:51; 11:25). Ka mundësi që termi “dëgjoj” të reflektojë termin hebraisht *shema*, që donte të thoshte “dëgjoj me qëllim që të bindem” (shih LiP. 6:4).

■ **“[ai] që ma ka dërguar”** FOLJA *apostellō* (PJESORE AORISTE VEPRORE) është forma rrënjë e fjalës “apostull” (shih v. 36). Rabinët e përdornin në kuptimin e “dikujt që dërgohet si përfaqësues zyrtar me një mision të caktuar”. Shpesh, te Gjtoni, ky term përdoret për dërgimin e Birit si përfaqësues i Atit. Shih shënimin te 4:34.

TEMË E VEÇANTË: DËRGOJ (*APOSTELLË*)

Kjo është fjalë e zakonshme greqisht që do të thotë “dërgoj” (pra, *apostellë*). Ky term ka një sërë përdorimesh teologjike.

1. rabinët e përdornin në kuptimin e dikujt që thirret dhe dërgohet si përfaqësues zyrtar i një tjetri, pak a shumë si fjala jonë “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20)
2. shpesh, ungjijtë e përdorin këtë term për dërgimin e Jezusit nga Ati. Te Gjoni, ky term merr ngjyrimë mesianike (Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48 dhe veçanërisht Gjoni 5:36,38; 6:29,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3, 8, 18, 21, 23, 25; 20:21). Përdoret për dërgimin e besimtarëve nga Jezusi (shih Gjoni 17:18; 20:21 [në v. 21 përmendet, si *apostellë*, ashtu dhe sinonimi i tij *pempō*).
3. DhR e përdori për dishepujt
 - a. rrethi i brendshëm fillestar i dymbëdhjetë dishepujve (p.sh., Marku 6:30; Luka 6:13; Veprat 1:2, 26)
 - b. një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkëpunëtorësh apostolikë
 - (1) Barnaba (shih Veprat 14:4, 14)
 - (2) Androniku dhe Juniasi (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)
 - (3) Apollo (shih 1 Kor. 4:6-9)
 - (4) Jakobi, vëllai i Zotit (Gal. 1:19)
 - (5) Silvani dhe Timoteu (1 Thes. 2:6)
 - (6) ndoshta Titi (2 Kor. 8:23)
 - (7) ndoshta Epafroditi (Fil. 2:25)
 - c. një dhunti e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
4. Pali e përdor këtë titull për vete në shumicën e letrave të tij si mënyrë për të pohuar autoritetin hyjnor të tij si përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titi 1:1).

■ **“por ka kaluar nga vdekja në jetë”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORË; diçka që ka ndodhur në të shkuarën dhe tani është bërë gjendje ekzistence. Mbretëria e Perëndisë është e tashme, por edhe e ardhshme; kështu ndodh edhe me jetën e përvetshme (shih v. 25-26; 1 Gjonit 3:14). Vargu 25 është pohim i fortë i pranisë së Mbretërisë tani!

5:25 “po vjen ora, madje ajo ka ardhur” Kjo lloj terminologjie karakterizon shkrimet Gjoni. Shpesh, fjalët dhe frazat kanë dy kuptime. Në këtë rast, “ora” do të thotë

1. ora e shpëtimit
2. ora e gjykimit

Korniza kohore është, edhe e tashme, edhe e ardhme (shih v. 29; 6:39, 44, 54). Ajo që njeriu bën me Jezusin tani do të përcaktojë atë që do t’i ndodhë në të ardhmen. Shpëtimi dhe gjykimi janë edhe realitet i tanishëm, edhe përmbushje në të ardhmen (shih v. 28).

TEMË E VEÇANTË: ORA

Termi “orë përdoret në disa mënyra të ndryshme në ungjijtë, si

1. referencë kohore (shih Mat. 8:13; Luka 7:21; Gjoni 11:9)
2. metaforë për një periudhë sprove dhe sprovimi (shih Mat. 10:19; Marku 13:11; Luka 12:12)
3. metaforë për fillimin e shërbesës së Jezusit (shih Gjoni 2:4; 4:23)
4. metaforë për ditën e gjykimit (pra, Ardhja e Dytë, Mat. 24:36,44; 25:13; Marku 13:32; Gjoni 5:25,28)
5. metaforë për mundimin e Krishtit (shih Mat. 26:45; Marku 14:35,41; Gjoni 7:30; 8:20; 12:23,27; 13:1; 16:32; 17:1)

■ **“kur të vdekurit do të dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë”** Vargu 25 flet për të vdekurit shpirtërorë; v. 29 flet për ringjalljen e gjithë atyre që janë fizikisht të vdekur. Bibla flet për tre lloje vdekjeje.

1. vdekja shpirtërore (shih Zanafilla 3)

2. vdekja fizike (shih Zanafilla 5)
3. vdekja e përjetshme (shih Efe. 2:2; Zbu. 2:11; 20:6, 14), ose liqeni i zjarrit, ferri (*Gehenna*).

Ky është një përdorim i rrallë i frazës “Biri i Perëndisë”. Shih Temën e Veçantë të 1 Gjonit 3:8. Një arsye pse kjo frazë nuk përdorej më shpesh është për shkak të pikëpamjes fetare greke për perënditë (mali Olimp), të cilët merrnin femra njerëzore si gra ose të dashura. Statusi i Jezusit si Biri i Perëndisë nuk reflekton riprodhim seksual apo vijimësi kohore, por marrëdhënie të ngushtë. Është metaforë judaike që vjen nga familja. Jezusi po pohonte natyrën e vet hyjnore përpara këtyre krerëve judenj në mënyrë tejet të qartë dhe të veçantë, duke përdorur kategori nga DhV (shih 5:21, 26).

5:26 “sepse ashtu si Ati ka jetë në vetvete” Në thelb, ky është kuptimi i termit JHVH nga Eks. 3:14. Kjo formë e emrit të Besëlidhjes të Perëndisë vjen nga FOLJA hebraisht “jam”. Do të thotë Ai që jeton gjithmonë, dhe i vetmi që jeton gjithmonë. Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë, në 6:20. Në DhV, vetëm JHVH ka “jetë” (shih 1 Tim. 1:17; 6:16) dhe vetëm ai mund t’ua japë të tjerëve (shih Jobi 10:12; 33:4; Psa. 36:9). Jezusi pohon se JHVH ia jep këtë pushtet unik atij!

▣ **“kështu i ka dhënë dhe Birit që të ketë jetë në vetvete”** Ky është pohim i fuqishëm i natyrës hyjnore të Jezusit (shih 1:4; 1 Gjonit 5:11).

5:27 Arsyja pse Jezusi është në gjendje (*eksousia*, ka autoritet, shih 10:18; 17:2; 19:11) të gjykojë drejt është se ai është plotësisht Perëndi, por edhe plotësisht njeri. Fraza “Bir i Njeriut” nuk ka NYJË SHQUESE (shih Ezek. 2:1; dhe Psa. 8:4). Ai na njih plotësisht (shih Heb. 4:15); ai e njih plotësisht Perëndinë (shih 1:18; 5:30).

Është e habitshme që, në një kontekst ku Jezusi e quan veten “biri” (shih v. 19 [dy herë], 20, 21, 22, 23 [dy herë], 25, 26), në v. 27 përdoret titulli “bir i njeriut” (por pa NYJËN e zakonshme SHQUESE). Megjithatë, i njëjti kalim ndodh edhe te (1) 3:13, 14 përkundër 3:16, 17, 18, 35, 36; (2) 6:27, 53 përkundër 6:40; dhe (3) 8:28 përkundër 8:35, 36. Jezusi i përdori të dy këta tituj për veten në mënyrë të ndërëmbyeshme.

5:28 “Mos u habitni nga kjo” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE me një PJESËZ MOHORE që, zakonisht, nënkuptonte ndalimin e një veprimi që ishte tashëm në kryerje e sipër. Sado tronditëse të kenë qenë fjalët e mëparshme të Jezusit për këta krerë judenj, pohimi vijues i tij do t’i trondiste plotësisht.

▣ **“të gjithë që janë në varre do të dëgjojnë zërin e tij”** Kjo duket se reflekton bërthmën e Mesisë në Ardhjen e Dytë (shih 1 Thes. 4:16). Llazari (shih 11:43) është model paradigmatic i asaj ngjarjeje. Kjo nuk mohon të vërtetën e 2 Kor. 5:6, 8. Por pohon gjykimin universal dhe autoritetin e Birit.

Një pjesë e mirë e këtij konteksti lidhet me realitetin e jetës shpirtërore në kohën e tashme (eskatologjia e realizuar). Por kjo frazë pohon edhe një ngjarje eskatologjike të ardhshme, në fund të kohës. Ky tension midis “tashmë” dhe “ende jo” në Mbretërinë e Perëndisë karakterizon mësimet e Jezusit në ungjijtë sinoptikë, por veçanërisht në ungjillin e Gjonit.

5:29 Bibla flet për ringjalljen e të ligjve dhe të drejtëve (shih Dan. 12:2; Mat. 25:46; Veprat 24:15). Shumica e pasazheve theksojnë vetëm ringjalljen e të drejtëve (shih Jobi 19:23-29; Isa. 26:19; Gjoni 6:39-40,44,54; 11:24-25; 1 Kor.15:50-58).

Kjo nuk i referohet gjykimin bazuar në veprat, por gjykimin bazuar në mënyrën e jetesës së besimtarëve (shih Mat. 25:31-46; Gal. 5:16-21). Në Fjalën e Perëndisë dhe në botë ekziston një parim i përgjithshëm: njerëzit korrin atë që mbjellin (shih Fja. 11:24-25; Gal. 6:6). Ose, që ta themi me një citim nga DhV: “Perëndia do t’i shpërblejë njerëzit sipas veprave” (shih Psa. 62:12; 28:4; Jobi 34:11; Fja. 24:12; Mat. 16:27; Rom. 2:6-8; 1 Kor. 3:8; 2 Kor. 5:10; Efe. 6:8 dhe Kol. 3:25).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:30

³⁰Unë s’bëj dot asgjë me nismën time. Sipas asaj që dëgjoj, gjykoj; dhe gjykimi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e atij që më dërgoi.

5:30 Jezusi, Fjala e mishëruar e Perëndisë, iu përlu dhe iu nënshtrua Atit. Ky theksim i fortë i nënshtrimit shfaqet edhe në v. 19 (“Biri s’mund të bëjë dot asgjë”). Kjo nuk do të thotë se Biri është më i ulët, por se Trinia i ka ndarë detyrat shpenguese sipas tre personave të veçantë, Atit, Birit dhe Frymës.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:31-47

³¹Nëse unë jam i vetmi që dëshmoj për veten, dëshmia ime nuk është e vërtetë. ³²Është dikush tjetër që dëshmon për mua, dhe e di se dëshmia që jep ai për mua është e vërtetë. ³³Ju keni dërguar te Gjoni, dhe ai ka dëshmuar për të vërtetën. ³⁴Por dëshmia që marr unë nuk vjen nga njeriu, por i them këto gjëra që ju të mund të shpëtoheni. ³⁵Ai ishte kandili që digjej e ndriçonte dhe ju ishit të gatshëm që të gëzoheshit për pak kohe në dritën e tij. ³⁶Por dëshmia që kam unë është më e madhe se ajo e Gjunit; sepse veprat që më ka dhënë Ati të kryej – pikërisht ato vepra që bëj – dëshmojnë për mua, se Ati më ka dërguar. ³⁷Dhe Ati që më dërgoi, ka dëshmuar për mua. Ju as nuk ia keni dëgjuar ndonjëherë zërin, as i keni parë formën. ³⁸Ju nuk keni fjalën e tij që të banojë në ju, sepse ju nuk besoni në atë që dërgoi Ati. ³⁹Ju hetoni Shkrimet, sepse mendoni se në to keni jetën e përjetshme; pikërisht ato dëshmojnë për mua; ⁴⁰por ju nuk jeni të gatshëm të vini tek unë që të keni jetën. ⁴¹Unë nuk marr lavdi nga njerëzit; ⁴²por ju njoh dhe e di se nuk keni dashurinë e Perëndisë në veten tuaj. ⁴³Unë kam ardhur në emrin e Atit tim, por ju nuk më pranoni; po të vinte dikush tjetër në emrin e vet, do ta pranoni. ⁴⁴Si mund të besoni ju, kur lavdinë e merrni nga njëri-tjetri dhe nuk kërkoni lavdinë që vjen nga i vetmi Perëndi? ⁴⁵Mos mendoni se do t'ju akuzoj përpara Atit; ai që ju akuzon është Moisiu, në të cilin keni varur shpresat. ⁴⁶Sepse nëse do të besoni në Moisiun, do të më besoni mua, sepse ai ka shkruar për mua. ⁴⁷Por, nëse s'ju besoni shkrimeve të tij, si do t'ju besoni fjalëve të mia?

5:31 Në Dhiatën e Vjetër, nevojiteshin dy dëshmitarë për të vërtetuar një çështje (shih Num. 35:30; LiP. 19:15). Në këtë kontekst, Jezusi jep pesë dëshmitarë për veten.

1. Ati (v. 32, 37)
2. Gjon Pagëzori (v. 33, shih dhe 1:19-51)
3. Vetë veprat e Jezusit (shih v. 36)
4. Shkrimi (shih v. 39)
5. Moisiu (shih v. 46), që reflekton LiP. 18:15-22

Shih Temën e Veçantë te 1:8.

▣ **“Nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për një veprim të mundshëm.

▣ **“Dëshmia ime nuk është e vërtetë”** Kjo duket sikur bie në kundërshti me 8:14. Konteksti tregon se këto pohime bëhen në kontekste të ndryshme. Këtu, Jezusi tregon sa dëshmitarë të tjerë janë, por në 8:14 ai pohon se vetëm dëshmia e tij mjafton!

Për termin “i vërtetë” shih Temën e Veçantë: E vërteta te Gjoni, te 6:55.

5:32 “Është dikush tjetër që dëshmon për mua” Kjo bën fjalë për Perëndinë Atë (shih 1 Gjoni 5:9), për shkak të përdorimit të termit *allos*, që do të thotë “një tjetër i një lloji tjetër”, në dallim nga *heteros*, që do të thotë “një i një lloji tjetër”, ndonëse ky dallim po zhdukej në greqishten *koine*. Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, 1:8.

5:33 “Ju keni dërguar te Gjoni” Kjo i referohet Gjon Pagëzorit (shih 1:19).

5:34 “I them këto gjëra në mënyrë që të mund të shpëtoheni” Kjo është LIDHORE AORISTE PËSORE. DIATEZA PËSORE nënkupton veprimtarinë e Perëndisë ose Frymës (shih 6:44, 65). Mos harroni se ungjijtë janë shpallje (pra, trakte) ungjillëzuese, jo biografi historike. Në gjithçka që regjistrohet gjendet një synim ungjillëzues (shih 20:30-31).

5:35 “ai ishte kandili” Këtu theksohet sërish drita, që, këtu, bën fjalë për mesazhin përgatitor të Gjunit (shih 1:6-8).

5:36 “pikërisht ato vepra që bëj dëshmojnë për mua” Veprimet e Jezusit ishin përmbushje të profecive të DhV për Mesinë. Judenjtë e kohës së tij duhet t'i kenë kuptuar këto shenja të mrekullueshme: shërimi i të verbërve, ushqyerja e të varfërve, shërimi i të çalëve (shih Isa. 29:18; 32:3-4; 35:5-6; 42:7). Fuqia e mësimave të Jezusit, mënyra e jetesës me drejtësi, dhembshuri, si dhe mrekullitë e fuqishme (shih 2:23; 10:25, 38; 14:11; 15:24) dëshmonin qartë se kush ishte ai, nga kishte ardhur dhe kush e kishte dërguar.

5:37 “Ai ka dëshmuar për mua” “Ai” nënkupton Atin. Në këtë kontekst, kjo frazë duket se i referohet DhV (shih Heb. 1:1-3). Këtu përfshiheshin të gjitha referencat mesianike nga DhV (shih v. 39).

▣ **“Ju as nuk ia keni dëgjuar ndonjëherë zërin, as i keni parë formën”** Jezusi po pohonte se, ndonëse judenjtë duhet ta kishin njohur Perëndinë përmes Shkrimeve dhe përmes përjetimeve personale në adhurim, në fakt ata s’e njihnin aspak (shih 8:43; Isa. 1:1-15; 6:9-10; 29:13; Jer. 5:21).

Në DhV, mendohej se po të shihje Hyjninë, kjo të shkaktonte vdekjen. I vetmi person që foli ballë për ballë me JHVH-në ishte Moisiu, madje dhe atëherë, takimi kryhej përmes perdes së Resë. Shumë kanë menduar se Eks. 33:23 bie në kundërshtim me Gjonin 1:18. Mirëpo termat hebraisht te Eksodi nënkuptojnë “lavdinë e pastajme”, jo formën fizike.

5:38 “fjalën e tij që të banojë në ju” Këto janë dy metafora të fuqishme në shkrimet e Gjonit. Fjala e Perëndisë (*logos*) duhet pranuar dhe, pasi të pranohet (shih 1:12) duhet të qëndrojë (të banojë, shih Gjoni 8:31; 15:4,5,6,7,10; 1 Gjonit 2:6,10,14,17,24,27,28; 3:6,14,15,24). Jezusi është zbulësia e plotë e Perëndisë (shih Gjoni 1:1-18; Fil. 2:6-11; Kol. 1:15-17; Heb. 1:1-3). Shpëtimi konfirmohet me anë të një marrëdhënieje të vazhdueshme (kuptimi hebraisht i fjalës “njoh”, shih Zan. 4:1; Jer. 1:5) dhe me anë të pohimit të të vërtetave të ungjillit (kuptimi greqisht i fjalës „njoh”, shih 2 Gjonit 9).

Ky term, “banimi”, përdoret në kuptimin e marrëdhënies së ngushtë e personale me qëndresë. Banimi është kusht për shpëtimin e vërtetë (shih kapitulli 15). Ai përdoret në disa kuptime te Gjoni.

1. Biri në Atin (shih 10:38; 14:10,11,20,21; 17:21)
2. Ati në Birin (shih 10:38; 14:10,11,21; 17:21,23)
3. besimtarët në Birin (shih 14:20,21; 15:5; 17:21)
4. besimtarët në Birin dhe në Atin (shih 14:23)
5. besimtarët në fjalën (shih 5:38; 8:31; 15:7; 1 Gjonit 2:14).

Shih Temën e Veçantë, te 1 Gjonit 2:10.

5:39 “Ju hetoni Shkrimet” Kjo mund të jetë DËFTORË E TASHME VEPRORE, ose URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Meqë gjendet në një listë dëshmitarësh që judenjtë i kishin refuzuar, ndoshta është në DËFTORE.

Këtu qëndron tragjedia e krerëve të judenjve: ata kishin Shkrimet, i lexonin, i studionin, i mësonin përmendësh, por, prapëseprapë, nuk kuptonin njeriun për të cilin flisnin Shkrimet! Pa Frymën, edhe Shkrimet janë të paefektshme! Jeta e vërtetë vjen vetëm përmes një marrëdhënieje personale besimi plot bindje (shih LiP. 4:1; 8:13; 30:15-20; 32:46-47).

▣ **“pikërisht ato dëshmojnë për mua”** Këtu bëhet fjalë për Shkrimet e DhV, të cilat Jezusi i përmbush (p.sh., 1:45; 2:22; 5:46; 12:16,41; 19:28; 20:9). Shumica e predikimeve të hershme të Pjetrit (shih Veprat 3:18; 10:43) dhe Palit (shih Veprat 13:27; 17:2-3; 26:22-23, 27) te Veprat përdorin profecinë e përmbushur si provë për faktin se Jezusi është Mesia. Në DhR, të gjitha pasazhet, përveç njërit (1 Pjet. 3:15-16), të cilët pohojnë autoritetin e Shkrimeve (shih 1 Kor. 2:9-13; 1 Thes. 2:13; 2 Tim. 3:16; 1 Pjet. 1:23-25; 2 Pjet. 1:20-21), bëjnë fjalë për DhV. Jezusi e shihte qartazi veten si përmbushjen dhe synimin (dhe interpretuesin e duhur, shih Mat. 5:17-48) e DhV.

TEMË E VEÇANTË: KERIGMA E KISHËS SË HERSHME

- A. Premtimet që Perëndia kishte bërë në Dhiatën e Vjetër tani janë përmbushur me ardhjen e Jezus Mesisë (Veprat 2:30-31; 3:19,24; 10:43; 26:6-7,22; Rom. 1:2-4; 1 Tim. 3:16; Heb. 1:1-2; 1 Pjet. 1:10-12; 2 Pjet. 1:18-19).
- B. Jezusi u vajosi si Mesi nga Perëndia kur u pagëzua (Veprat 10:38).
- C. Jezusi e filloi shërbesën e vet në Galile pas pagëzimit (Veprat 10:37).
- D. Shërbesa e tij karakterizohej nga veprat e mira dhe nga kryerja e veprave të fuqishme me anë të fuqisë së Perëndisë (Marku 10:45; Veprat 2:22; 10:38).
- E. Mesia u kryqëzua sipas synimit të përjetshëm të Perëndisë (Marku 10:45; Gjoni 3:16; Veprat 2:23; 3:13-15,18; 4:11; 10:39; 26:23; Rom. 8:34; 1 Kor. 1:17-18; 15:3; Gal. 1:4; Heb. 1:3; 1 Pjet. 1:2,19; 3:18; 1 Gjonit 4:10).
- F. Ai u ringjall nga vdekja dhe iu shfaq dishepujve (Veprat 2:24,31-32; 3:15,26; 10:40-41; 17:31; 26:23; Rom. 8:34; 10:9; 1 Kor. 15:4-7,12ff; 1 Thes. 1:10; 1 Tim. 3:16; 1 Pjet. 1:2; 3:18,21).
- G. Jezusi u lartësua nga Perëndia, i cili i dha emrin “Zot” (Veprat 2:25-29,33-36; 3:13; 10:36; Rom. 8:34; 10:9; 1 Tim. 3:16; Heb. 1:3; 1 Pjet. 3:22).
- H. Ai dha Frymën e Shenjtë për të formuar komunitetin e ri të Perëndisë (Veprat 1:8; 2:14-18,38-39; 10:44-47; 1 Pjet. 1:12).
- I. Ai do të kthehet sërish për gjykimin dhe ripërtëritjen e të gjitha gjërave (Veprat 3:20-21; 10:42; 17:31; 1 Kor. 15:20-28; 1 Thes. 1:10).
- J. Të gjithë ata që dëgjojnë mesazhin duhet të pendohen dhe të pagëzohen (Veprat 2:21,38; 3:19; 10:43,47-48; 17:30; 26:20; Rom. 1:17; 10:9; 1 Pjet. 3:21).

Kjo skemë shërbente si thelbi i shpalljes së kishës së hershme, ndonëse autorë të ndryshëm të Dhiatës së Re mund të lënë pa përmendur një pjesë të saj, ose theksojnë disa veçori të tjera në predikimin e tyre. Gjithë ungjilli i Markut ndjek ngushtë aspektin pjetrin të *kerigmës*. Tradicionalisht, mendohet se Marku strukturoi predikimet e Pjetrit, të bëra në Romë, në një ungjill të shkruar. Si Mateu, ashtu dhe Luka, ndjekin strukturën bazë të Markut.

5:41-44 Këto vargje duket se reflektojnë faktin se krerëve fetarë të judenjve u pëlqente duartrokitja e kolegëve. Ata mburreshin duke cituar rabinët nga e kaluara, por për shkak të verbërisë shpirtërore, nuk njohën mësuesin më të madh të të gjitha kohërave, i cili ishte në mes të tyre. Ky është një nga denoncimet më të forta të Jezusit kundër judaizmit rabinik të shekullit të parë (shih dhe shëmbëlltyrën te Mat. 21:33-46; Marku 12:1-12; Luka 20:9-19).

5:41

NASB, NRSV “unë nuk marr lavdi nga njerëzit”

NKJV “unë nuk marr nder nga njerëzit”

TEV “unë nuk po kërkoj lavdërim njerëzor”

NJB “Lavdia njerëzore s’ka vlerë për mua”

Termi “lavdi”, *doksa*, është i vështirë të përkthehet në mënyrë të njëtrajtshme (shih Temën e Veçantë te 1:14). Ajo pasqyron termin hebraisht “lavdi”, *kabodh*, që përdorej si mënyrë për të shprehur praninë rrëzëlluese dhe të shkëlqyer të Perëndisë (shih Eks. 16:10; 24:17; 40:34; Veprat 7:2), si dhe për të lavdëruar dhe nderuar Perëndinë për karakterin dhe veprat e tij. Një varg i mirë që kombinon këto ngjyime është 2 Pjet. 1:17. Ky aspekt i shkëlqyer i pranisë dhe karakterit të Perëndisë lidhet me

1. engjëjt (shih Luka 2:9; 2 Pjet. 2:10)
2. epërsinë e Jezusit (shih Gjoni 1:14; 8:54; 12:28; 13:31; 17:1-5,22,24; 1 Kor. 2:8; Fil. 4:21)
3. në mënyrë të rrjedhuar, besimtarët (shih Rom. 8:18,21; 1 Kor. 2:7; 15:43; 2 Kor. 4:17; Kol. 3:4; 1 Thes. 2:12; 2 Thes. 2:14; Heb. 2:10; 1 Pjet. 5:1,4)

Gjithashtu, është interesante të vërejmë se kryqëzimin e Jezusit Gjoni e quan përlëvdim të tij (shih 7:39; 12:16, 23; 13:31). Sidoqoftë, kjo mund të përkthehet edhe “nderim” ose “falënderim” (shih Luka 17:18; Veprat 12:23; Rom. 4:20; 1 Kor. 10:31; 2 Kor. 4:15; Fil.1:11; 2:11; Zbu. 11:13; 14:7; 16:9; 19:7). Kështu përdoret në këtë kontekst.

5:43 “ju nuk më pranoni” Në gjithë ungjillin e Gjonit, fokusi i besimit në Jezusin nuk është një kredo e detyrueshme teologjike, por një takim personal me të (shih v. 39-40). Besimi fillon me një vendim për të besuar në të. Kjo fillon me një marrëdhënie personal dishepullizimi që sa vjen e rritet dhe arrin kulmin në pjekurinë doktrinale dhe në jetesën në ngjashmëri me Krishtin.

▣ “po të vinte dikush tjetër në emrin e vet” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË.

▣ “ju do ta pranoni” Kjo është lojë fjalësh me metodat studimore të rabinëve, që krahasonin mësuesit nga shkolla të ndryshme rabinike nga Talmudi.

Michael Magill, *New Testament Transline*, përmban një citim me vend:

“Krerët e judenjve janë gati të pranojnë një mësues njerëzor ose rabin që nuk pretendon se është dërguar nga Perëndia. Me mësuesin njerëzor, ata janë në një marrëdhënie reciproke kolegësh, duke shkëmbyer lavdi në mënyrë të barabartë. Në rastin e një profeti të dërguar nga Perëndia, ata duhet të jenë në një pozitë të nënshtruar, ku të dëgjojnë e të binden. Kjo ka qenë gjithmonë rrënja e arsyes pse refuzoheshin profetët e Perëndisë” (f. 318).

5:44 Shih shënimin për 17:3.

5:45-47 Jezusi po pohon se shkrimet e Moisiut zbulonin Jezusin. Kjo është ndoshta një referencë e LiP. 18:15-22. Në v. 45, Shkrimi personifikohet si akuzues. Ai synon të jetë udhërrëfyes (shih Luka 16:31). Kur refuzohet, udhërrëfyesi shndërrohet në kundërshtar (shih Gal. 3:8-14, 23-29).

5:46, 47 “nëse... nëse” Vargu 46 është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “në kundërshtim me faktet”, pra po pohon se krerët e judenjve nuk besonin vërtet në shkrimet e Moisiut dhe se Jezusi (Moisiu eskatologjik [pra, Profeti i LiP. 18:15-19]) do të ishte gjykatësi i tyre në ditën e fundit. “Nëse” e v. 47 prezanton një FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, e cila merret si e vërtetë (NIV e përkthen “meqë”).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse nuk përfshihet vargu 4 në përkthimet moderne?
2. Pse e shëroi Jezusi këtë njeri në veçanti?
3. A përfshihej besimi nga ana e këtij njeriu në shërimin e tij? A nënkupton shërimi fizik një shërim shpirtëror?
4. A lidhjet sëmundja e tij me mëkatin e tij personal? A lidhet çdo sëmundje me mëkatin personal?
5. Pse judenjtë donin të vrisnin Jezusin?
6. A është jeta e përjetshme një realitet i tanishëm, apo një shpresë e ardhshme?
7. A bazohet gjykimi i fundit në vepra, apo në besim? Pse?

GJONI 6

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ^d	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:1-15	Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:1-14	Ushqyerja e pesë mijë vetëve 6:1-15	Jezusi ushqen pesë mijë vetë 6:1-6 6:7 6:8-9 6:10-13 6:14-15	Mrekullia e bukëve 6:1-4 6:5-15
Ecja mbi ujë 6:16-21	Jezusi ecën mbi det 6:15-21	Jezusi ecën mbi det 6:16-21	Jezusi ecën mbi ujë 6:16-21	Jezusi vjen te dishepujt duke ecur mbi ujë 6:16-21
Jezusi, buka e jetës 6:22-33	Buka nga qielli 6:22-40	Jezusi, buka e jetës 6:22-24 6:25-40	Njerëzit kërkojnë Jezusin 6:22-24 Jezusi, buka e jetës 6:25 6:26-27 6:28 6:29 6:30-31 6:32-33 6:34 6:35-40	Ligjërata në sinagogën e Kapernaumit 6:22-27 6:28-40
6:34-40	I refuzuar nga të vetët		6:34 6:35-40	
6:41-51	6:41-59	6:41-51	6:41-42 6:43-51	6:41-51
6:52-59		6:52-59	6:52 6:53-58 6:59	6:52-58 6:59-63
Fjalët e jetës së përjetshme 6:60-65	Shumë dishepuj e braktisin 6:60-71	6:60-65	Fjalët e jetës së përjetshme 6:60 6:61-65	6:64-66 Rrëfimi i besimit të Pjetrit

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË GJONIT 6:1-71

- A. Ungjilli i Gjonit nuk përmban vetë Darkën e Zotit, ndonëse kapitujt 13-17 shënojnë dialogun dhe lutjen në Dhomën e Sipërme. Kjo mospërmendje mund të jetë e qëllimshme. Kisha e shekullit të dytë filloi t'f'i shihte urdhërimet e pagëzimit dhe Darkës së Zotit në kuptimin sakramental. Ata i konsideronin kanale hiri. Ndoshta, Gjoni po reagon ndaj pikëpamjes sakramentale duke mos regjistruar pagëzimin e Jezusit apo Darkën e Zotit.
- B. Gjoni 6 është në kontekstin e ushqyerjes së pesë mijë vetëve. Megjithatë, shumë e përdorin për të mësuar një pikëpamje sakramentale për Eukaristinë. Ky është burimi i doktrinës katolike të transsubstancimit (v. 53-56).
- Pyetja sesi lidhet kapitulli 6 me Eukaristinë tregon natyrën e dyfishtë të ungjijve. Qartazi, ungjijtë tregojnë jetën dhe fjalët e Jezusit, por ata u shkruan disa dhjetëvjeçarë më vonë dhe shprehnin komunitetin e besimit të autorëve si individë. Kështu, ka tre nivele të synimit autorial.
1. Fryma
 2. Jezusi dhe dëgjuesit e parë
 3. Shkruesit e ungjijve dhe lexuesit e tyre
- Si t'f'i interpretojmë? E vetmja mënyrë e verifikueshme duhet të jetë qasja kontekstuale, gramatikore dhe leksikore, e informuar nga konteksti historik, dhe jo anasjellas.
- C. Duhet të mos harrojmë se audienca ishte judaike dhe sfondi kulturor ishte pritshmëria rabinike se Mesia do të ishte një super-Moisi (shih v. 30-31), sidomos në lidhje me përjetimet e Eksodit si “mana”. Rabinët përdornin si varg-provë Psa. 72:16. Pohimet e pazakonta të Jezusit (shih v. 60-62, 66) synonin të kundërshtonin pritshmëritë e rreme mesianike të turmës (shih v. 14-15).
- D. Etërit e hershëm të kishës nuk binin të gjithë dakord se ky pasazh i referohet Darkës së Zotit. Klementi i Aleksandrisë, Origeni dhe Euzebi nuk e përmendin kurrë Darkën e Zotit në diskutimet e tyre për këtë pasazh.
- E. Metaforat e këtij pasazhi janë shumë të ngjashme me fjalët e Jezusit të përdorura me “gruan te pusi” në Gjoni 4. Uji dhe buka tokësore përdoren si metafora të jetës së përjetshme dhe të realiteteve shpirtërore.
- F. Ky shumëfishim i bukës është e vetmja mrekulli që regjistrohet në të katërt ungjijtë (Mat. 14:13-21; Marku 6:32-44; Luka 9:10-17)!
- G. Michael Magill, *New Testament TransLine* (f. 325) jep një vëzhgim interesant lidhur me grupet e ndryshme në Kapernaum dhe lidhjen e tyre me fjalët tronditëse të Jezusit.
1. Turma, v. 24
 2. Judenjtë, v. 41, 52
 3. Dishepujt, v. 60, 66
 4. Të dymbëdhjetët, v. 67
- Në thelb, Jezusi
1. kishte ndaluar turmën që të mos e bënte mbret ngaqë i ushqeu (6:15)
 2. kishte sfiduar krerët e judenjve me pohimet e tij radikale si person
 3. kishte bërë që shumë ndjekës periferikë ta braktisnin

4. kishte nxitur një shpallje besimi të vazhdueshëm dhe të thelluar nga ana e të Dymbëdhjetëve (6:68-69)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:1-14

¹Pas këtyre gjërave, Jezusi shkoi në anën tjetër të Detit të Galilesë (ose Tiberiadës). ²Një turmë e madhe e ndiqte, sepse shihnin shenjat që kryente me ata që ishin të sëmurë. ³Pastaj, Jezusi u ngjit në mal dhe u ul aty me dishepujt e vet. ⁴Dhe Pashka, festa e judenjve, ishte afër. ⁵Prandaj, Jezusi, ngriti sytë, pa se një turmë e madhe po vinte drejt tij, dhe i tha Filipit: “Ku të blejmë bukë, që këta të mund të hanë?” ⁶Këtë ai po e thoshte për ta vënë në provë, sepse ai vetë e dinte se çfarë synonte të bënte. ⁷Filipi iu përgjigj: “Dyqind dinarë bukë nuk mjaftojnë për ta, që secili prej tyre të marrë një çikë”. ⁸Një prej dishepujve të tij, Andrea, vëllai i Simon Pjetrit, i tha: ⁹“Është një djalë këtu që ka pesë bukë elbi dhe dy peshq, por ç’janë për gjithë këta njerëz?” ¹⁰Jezusi iu përgjigj: “Thuajini njerëzve të ulen”. Në atë vend kishte shumë bar. Kështu, njerëzit u ulën dhe ishin rreth pesë mijë në numër. ¹¹Atëherë, Jezusi mori bukët, dhe pasi falënderoi, ua shpërndau atyre që ishin ulur; në mënyrë të ngjashme, edhe me peshqit, aq sa dëshironin. ¹²Pasi u ngopën, u tha dishepujve: “Mblidhni copat që tepruan, që asgjë të mos humbet”. ¹³Kështu, ata i mblodhën dhe mbushën dymbëdhjetë shporta me copa të mbetura nga pesë bukët prej elbi që kishin ngrënë ata. ¹⁴Atëherë, kur njerëzit panë shenjën që kishte kryer ai, thanë: “Ky është me të vërtetë Profeti që duhet të vijë në botë”.

6:1 “Deti i Galilesë (ose Tiberiada)” Ky grumbullim uji njihej me disa emra të tjera. Në DhV, quhej Kineret (shih Num. 34:11). Njihej edhe si Liqeni i Genesaretit te Luka 5:1 dhe, sipas emrit romak, Deti i Tiberiadës te Gjoni 21:1. Kjo parantezë është një tjetër koment redaktorial nga autori. Kjo tregon se ungjilli i Gjonit synohej për njerëz që jetonin jashtë Palestinës (shih 6:4, 6, 64, 71).

6:2 Vini re arsyen pse e ndiqte turma.

6:3 Jezusi përdori amplifikimin natyror të ujit me anën e kodrës për të përhapur zërin e tij. Fakti se ai “u ul” tregon se ky ishte një sesion zyrtar mësimdhënieje me dishepujt e vet. Një pyetje është nëse mali synonte që t’u kujtonte atyre kontekstin e Moisiut, si te Mateu 5-7.

Në këto sesione të mëdha mësimore, shpesh, Jezusi u drejtohej grupimeve të ndryshme në turmë. Përreth këmbëve të tij, ai rrethohej nga dishepujt e ngushtë; përtej tyre, ishin kureshtarët, të pasurit dhe “populli” i zakonshëm “i vendit”; dhe, në grupe të vogla, kërret fetarë (farisenjtë, skribët, saducenjtë dhe, mundësisht, esenët).

6:4 “Pashka, festa e judenjve” E vetmja mënyrë për të përcaktuar kohëzgjatjen e shërbesës publike të Jezusit janë Pashkat e përmendura në ungjillin e Gjonit (e para, 2:13; e dyta, 6:4; e treta, 11:55 & 13:1). Nëse edhe Gjoni 5:1 bën fjalë për një festë Pashke, atëherë kemi tre vjet e gjysmë, ose katër vjet, shërbesë publike. Ka shumë gjëra që nuk dimë nga jeta e Jezusit (shih 20:30; 21:25).

6:6 “Këtë ai po e thoshte që ta vinte në provë” Ky term grek, “vë në provë” (*peirazō*), zakonisht mbarë një ngjyrim të keqdashës (shih Temën e Veçantë te 1 Gjonit 4:1, shih dhe Mat. 4:1). Ky është një shembull i mirë që tregon se interpretuesit e sotëm përpiqen që t’i fusin me detyrim fjalët e DhR brenda një përcaktimi të vetëm. Greqishtja *koine* po humbiste shumë prej veçorive gramatikore dhe gjuhësore të greqishtes klasike (shih shënimin te 5:20).

Jezusi po e vinte në sprovë Filipin, por si?

1. për besimin e tij te Jezusi si furnizues?
2. për njohurinë e tij të DhV (shih Num. 11:13, pyetjen që Moisiu i bën Perëndisë për t’u siguruar ushqime)?
3. për përkujdesjen dhe preokupimin e Jezusit për turmën?

6:7

NASB, NKJV, JB “dyqind dinarë”

Një dinar ishte paga ditore e një punëtori (shih Mat. 20:2) dhe një ushtari. Kjo shumë ishte sa rreth dy të tretat e rrogës së një viti.

TEMË E VEÇANTË: MONEDHAT QË PËRDORESHIN NË PALESTINË NË KOHËN E JEZUSIT

- I. Monedha bakri
 - A. *kherma* – vlerë e ulët (shih Gjoni 2:15)
 - B. *khalkos* – vlerë e ulët (shih Mat. 10:9; Marku 12:41)
 - C. *assarion* – monedhë bakri romake, që vlente rreth 1/16 e një *dēnarius* (shih Mat. 10:29)
 - D. *kodrantes* – monedhë bakri romake, që vlente rreth 1/64 e një *dēnarius* (shih Mat. 5:26)
 - E. *lepton* – monedhë bakri judaike, që vlente rreth 1/128 e një *dēnarius* (shih Marku 12:42; Luka 21:2)
 - F. *kuadrans/qindarkë* – monedhë bakri romake me vlerë të ulët
- II. Monedha argjendi
 - A. *arguros* (“monedhë argjendi”) – shumë më e vlefshme se monedhat prej bakri ose bronzi (shih Mat. 10:9; 26:15)
 - B. *dēnarius* – monedhë argjendi romake, e barasvlershme me një *dēnarius* (shih Luka 15:9)
 - C. *di-drakhmon* – dy *drakhma*, e barabartë me gjysmë shekeli judaik (shih Mat. 17:24)
 - D. *statēr* – monedhë argjendi, e vlefshme rreth katër *dēnarii* (shih Mat. 17:27)
- III. Monedha floriri – *khrusos* (“monedha floriri”) – monedhat më të vlefshme (shih Mat. 10:9)
- IV. Terma të përgjithshëm për peshën e metaleve
 - A. *mnaa* - latinisht *mina*, një peshë metali e barabartë me 100 *dēnarii* (shih Luka 19:13)
 - B. *talanton* – njësi peshe greke (shih Mat. 18:24; 25:15, 16, 20, 24, 25, 28)
 1. e argjendit, vlente 6,000 *dēnarii*
 2. e florinjtit, vlente 180,000 *dēnarii*
 - C. *shekel* – peshë argjendi judaike në DhV (shih Zan. 23:15; 37:28; Eks. 21:32)
 1. *pīm* – 2/3 e shekelit
 2. *beka* – 1/2 e shekelit
 3. *gerah* – 1/20 e shekelitNjësi më të mëdha
 1. *maneh* – 50 shekel
 2. *kikkar* – 3,000 shekel

6:8-9 “Andrea, vëllai i Simon Pjetrit” Ky kontekst është përshkrim shumë i bukur i besimit dhe sigurisë së thjeshtë të Andreas në aftësinë dhe personin e Jezusit.

6:9 “bukë elbi” Kjo konsiderohej buka më e lirë dhe më pak e dëshirueshme. Ishte buka e të varfrit. Jezusi nuk i përdori fuqitë e veta për të siguruar ushqime të shtrenjta!

6:10 “Thuajuni njerëzve të ulen” Njerëzit e asaj kulture, normalisht, hanin ose të ulur përtokë, ose të mbështetur rreth një tryeze të ulët në formë “U”-je.

▣ **“në atë vend kishte shumë bar”** Ky është një koment (redaktorial) i apostullit si dëshmitar okular.

▣ **“Kështu njerëzit u ulën, rreth pesë mijë vetë”** Në fakt, është emërtim i gabuar ta quajmë këtë ngjarje “ushqyerja e pesë mijë vetëve”, pasi të ditë kishte më tepër njerëz aty. Pesë mijë është numër i rrumbullakosur dhe nënkupton vetëm burrat e rritur (pra, 13 vjeç e lart) dhe nuk përfshin gratë dhe fëmijët (shih Mat. 14:21). Megjithatë, është e paqartë sa gra ose fëmijë duhet (ose mund) të kenë marrë pjesë (shih Mat. 14:21).

6:11 “dhe pasi falënderoi, ua shpërndau” Mrekullia e shumëfishimit duhet të ketë ndodhur në duart e Jezusit. Në kontekstin e shpresës mesianike të judenjve, kjo ngjarje duhet të ketë qenë shenja e pritur, se Jezusi po siguronte ushqim siç kishte siguruar mana dhe Moisiu.

Termi greqisht “falënderoj” (*eucharisteō*) më vonë u bë emri i Darkës së Fundit (shih 1 Kor. 11:23-24). A e përdori Gjoni këtu duke patur parasysh këtë përcaktim të ardhshëm e teknik? Ungjijtë e tjerë, që nuk kanë aludimet për Eukaristinë, përdorin një term të ndryshëm (*eulogeō*, shih Mat. 14:19; Marku 6:41). Ata vërtet e përdorin termin *eucharisteō* (shih Mat. 15:36; Marku 8:6; Luka 17:16; 18:11), por jo në mënyrë të njëtrajtshme në kontekstin e Darkës së Fundit. Ata e përdorin këtë term për të përshkruar lutjen falënderuese të Jezusit në dhomën e sipërme (shih Mat. 26:27; Marku 14:23; dhe Luka 22:17-19). Si rrjedhojë, ndonëse ky përdormi nuk është uniform, Gjoni do të duhet ta kishte bërë aludimin e vet më të qartë nëse synonte që lexuesit e mëvonshëm ta interpretonin në një kontekst eukaristik!

6:12 “humbet” Shih Temën e Veçantë: *Apollumi* te 10:10.

6:13 “Kështu, ata i mblohdën dhe mbushën dymbëdhjetë shporta” Termi “shportë” këtu i referohet një shporte të madhe në formë kanistre. Është domethënëse se Jezusi nuk çoi dëm asgjë nga ushqimi i shumëfishuar. As nuk ia ndryshoi natyrën (ose llojin) bukës. A ka domethënie simbolike termi “dymbëdhjetë”? Është e vështirë të jesh i sigurt. Ai është interpretuar si referencë për fiset e Izraelit (Jezusi përmbush DhV), ose nga një shportë për çdo dishepull (Jezusi siguron për dishepujt e tij dhe i ngop), por mund të ketë qenë edhe thjesht një hollësi prej dëshmitari okular (si v. 19).

TEMË E VEÇANTË: NUMRI DYMBËDHJETË

Dymbëdhjeta ka qenë gjithmonë numër simbolik organizimi

A. Jashtë Biblës

1. dymbëdhjetë shenjat e Zodiakut
2. dymbëdhjetë muajt e vitit

B. Në DhV (BDB 1040, plus 797)

1. bijtë e Jakobit (fiset judaike)
2. reflektohet në
 - a. dymbëdhjetë shtyllat e altarit, te Eks. 24:4
 - b. dymbëdhjetë gurët e çmuar në gjoksoren e kryepriftit (që nënkupton dymbëdhjetë fiset) në Eks. 28:21
 - c. dymbëdhjetë çyrekët e bukës në vendin e shenjtë të tabernakullit, Lev. 24:5
 - d. dymbëdhjetë spiunët e dërguar në Kanaan, në Num. 13 (një nga secili fis)
 - e. dymbëdhjetë shufrat (flamujt fisnorë) në rebelimin e Korës, Num. 17:2
 - f. dymbëdhjetë gurët e Jozueut, Joz. 4:3, 9, 20
 - g. dymbëdhjetë ndarjet administrative në administrimin e Solomonit, 1 Mbret. 4:7
 - h. dymbëdhjetë gurët e altarit të Elisë për JHVH-në, 1 Mbret. 18:31

C. Në DhR

1. dymbëdhjetë apostujt e zgjedhur
2. dymbëdhjetë shportat me bukë (një për secilin apostull) në Mat. 14:20
3. dymbëdhjetë frone, ku do të ulen dishepujt e DhR (që i referohet 12 fiseve të Izraelit), në mat. 19:28
4. dymbëdhjetë legjionet me engjëj për të shpëtuar Jezusin, Mat. 26:53
5. simbolizmi i Zbulesës
 - a. 24 pleqtë në 24 frone, 4:4
 - b. 144,000 (12x12,000), në 7:4; 14:1, 3
 - c. dymbëdhjetë yje në kurorën e gruas, 12:1
 - d. dymbëdhjetë porta, dymbëdhjetë engjëj që reflektojnë dymbëdhjetë fiset në 21:12
 - e. dymbëdhjetë gurët e themelit të Jerusalemit të ri dhe, mbi ta, emrat e dymbëdhjetë apostujve, 21:14
 - f. dymbëdhjetë mijë stade, te 21:16 (madhësia e qytetit të ri, Jerusalemit të Ri)
 - g. muri është 144 kubitë, te 21:17
 - h. dymbëdhjetë portat me perla, te 21:21
 - i. pemët në Jerusalemin e ri me dymbëdhjetë lloje frutash (një për çdo muaj), 22:2

6:14 “Profeti” Ky është aludim për referencën mesianike të LiP. 18:15-22 (shih Veprat 3:22; 7:37). Turma e kuptoi pushtetin e Jezusit, por keqkuptoi natyrën e misionit dhe shenjave të tij.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:15

¹⁵Kështu, Jezusi, si e kuptoi që ata po synonin të vinin e ta kapnin forcërisht për ta bërë mbret, u tërhoq sërish në mal i vetëm.

6:15 Turma u ngazëllye nga mrekullia mesianike e Jezusit në sigurimin e ushqimit. Ky varg mund të ketë lidhje me tundimin e të ligut, të Mateu 4:3.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:16-21

¹⁶Kështu, kur ra nata, dishepujt e tij zbritën drejt detit, ¹⁷dhe, si hipën në varkë, u nisën përtej detit drejt Kapernaumit. Ishte bërë errësirë tashmë, dhe Jezusi nuk kishte shkuar ende te ta. ¹⁸Deti nisi të trazohej dhe filloi të frynte një erë e fortë. ¹⁹Pastaj, pasi rremuan nja tre a katër milje, panë Jezusin që po ecte mbi det dhe po i afrohej varkë, dhe u frikësuan. ²⁰Por ai u tha: “Jam unë; mos kini frikë”. ²¹Kështu ata deshën ta merrnin në varkë, por menjëherë varka arriti në bregun ku ishin nisur.

6:17 “Kapernaum” Kjo ishte selia e Jezusit gjatë shërbesës së tij galilease për shkak të mosbesimit në qytetin e tij, Nazaret (shih Luka 4:28-29).

6:19 “pasi rremuan nja tre a katër milje” Ata ishin pothuajse në gjysmë të udhëtimit përmes liqenit kur Jezusi shkoi te ta mbi ujë. Mateu e zgjeron këtë rrëfim duke përfshirë ecjen e Pjetrit drejt tij mbi ujë.

■ **“ata u frikësuan”** Këta dishepuj ende po e vlerësonin Jezusin sipas standardeve tokësore. Frika e dishepujve shprehet të Marku 6:49. Pësha e përbashkët e këtyre “shenjave” i detyroi të rivlerësonin personin e tij.

6:20 “Jam unë” Fjalë për fjalë, kjo është (*egō eimi*) “Unë Jam” (shih 4:26; 8:24, 28, 54-59; 13:19; 18:5-6), që reflekton emrin e besëlidhjes së Perëndisë në DhV, JHVH i Eks. 3:12-15. Jezusi është i dukshmi “Unë Jam”, vetëzbuluesi e plotë e Perëndisë, Logosi (fjala) i mishëruar i Perëndisë, Biri i vetëm dhe i vërtetë. Shih D në Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË

A. *El* (BDB 42, KB 48)

1. Kuptimi fillestar i këtij termi të përgjithshëm e të lashtë për Perëndinë është i paqartë, ndonëse shumë studiues besojnë se vjen nga rrënja akadiane “jam i fortë”, ose “jam i fuqishëm” (shih Zan. 17:1; Num. 23:19; LiP. 7:21; Psa. 50:1).
2. Në panteonin kanaanit, perëndia i lartë është *El* (tekstet e Ras Shamras).
3. Në Bibël, zakonisht, *El* shoqërohet me terma të tjerë. Këto kombinime bëhen një mënyrë për të karakterizuar Perëndinë.
 - a. *El-Eljon* (Perëndia Shumë i Lartë, BDB 42 & 751 II), Zan. 14:18-22; LiP. 32:8; Isa. 14:14
 - b. *El-Roi* (“Perëndia që sheh”, ose “Perëndia që zbulon veten”, BDB 42 & 909), Zan. 16:13
 - c. *El-Shaddai* (“Perëndia i Gjithëfuqishëm”, ose “Perëndia i Gjithëmëshirshëm”, ose “Perëndia i malit”, BDB 42 & 994), Zan. 17:1; 35:11; 43:14; 49:25; Eks. 6:3
 - d. *El-Olam* (Perëndia i Përrjetshëm, BDB 42 & 761), Zan. 21:33. Ky term lidhet nga ana teologjike me premtimin e Perëndisë për Davidin, 2 Sam. 7:13, 16
 - e. *El-Berit* (“Perëndia i Besëlidhjes”, BDB 42 & 136), Gjyq. 9:46
4. *El* barazohet me
 - a. JHVH, në Psa. 85:8; Isa. 42:5
 - b. *Elohim* në Zan. 46:3; Jobi 5:8, “Unë jam *El*, *Elohim* i atit tuaj”
 - c. *Shaddai*, në Zan. 49:25
 - d. “xhelozinë”, në Eks. 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15
 - e. “mëshirën” në LiP. 4:31; Neh. 9:31;

- f. “i madh dhe i mahnitshëm” në LiP. 7:21; 10:17; Neh. 1:5; 9:31; Dan. 9:4
 - g. “njohurinë”, në 1 Sam. 2:3
 - h. “streha ime e fuqishme”, në 2 Sam. 22:33
 - i. “hakmarrësi im”, në 2 Sam. 22:49
 - j. “i shenjtë”, në Isa. 5:16
 - k. “fuqi”, në Isa. 10:21
 - l. “shpëtimi im”, në Isa. 12:2
 - m. “i madh dhe i fuqishëm”, në Jer. 32:19
 - n. “shpagim”, në Jer. 51:56
5. Një kombinim i të gjithë emrave kryesore të Perëndisë në DhV gjendet në Jozueu 22:22 (*El, Elohim, JHVH*, të përsëritur)
- B. *Eljon* (BDB 751, KB 832)
- 1. Kuptimi bazë i kësaj fjale është “i lartë”, “i lartësuar”, ose “i ngritur lart” (shih Zan. 40:17; 1 Mbret. 9:8; 2 Mbret. 18:17; Neh. 3:25; Jer. 20:2; 36:10; Psa. 18:13).
 - 2. Përdoret në kuptim paralel me disa emra/tituj të tjerë të Perëndisë.
 - a. *Elohim* - Ps. 47:1-2; 73:11; 107:11
 - b. *JHVH* – Zan. 14:22; 2 Sam. 22:14
 - c. *El-Shaddai* – Psa. 91:1, 9
 - d. *El* – Num. 24:16
 - e. *Elah* – përdoret shpesh te Danieli 2-6 dhe Esdra 4-7, lidhet me *illair* (aramaisht, “Perëndia i Lartë”), te Dan. 3:26; 4:2; 5:18, 21
 - 3. Përdoret shpesh nga johebrenjtë.
 - a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:16
 - c. Moisiu, që u flet kombeve te LiP. 32:8
 - d. Ungjilli i Lukës në DhR, që u shkruhet johebrenjve, përdor ekuivalentin grek *Hupsistos* (shih 1:32, 35, 76; 6:35; 8:28; Veprat 7:48; 16:17)
- C. *Elohim* (SHUMËS), *Eloah* (NJËJËS), që përdoren kryesisht në poezi (BDB 43, KB 52)
- 1. Ky term nuk gjendet jashtë Dhiatës së Vjetër.
 - 2. Kjo fjalë mund të nënkuptojë Perëndinë e Izraelit ose perënditë e kombeve (shih Eks. 12. 12; 20:3). Familja e Abrahamit ishte politeiste (shih Joz. 242).
 - 3. Mund t’u referohet gjyqtarëve të Izraelit (shih Eks. 216; Psa. 82:6).
 - 4. Termi *elohim* përdoret edhe për qenie të tjera shpirtërore (engjëjt, demonët), si te LiP. 32:8 (LXX) Psa. 8:5; Jobi 1:6; 38:7.
 - 5. Në Bibël, ky është emri/titulli i parë i Hyjnisë (shih Zan. 1:1). Është i vetmi që përdoret deri te Zan. 2:4, ku kombinohet me JHVH. Në thelb, nga ana teologjike, nënkupton Perëndinë si krijues, ruajtës dhe sigures i gjithë jetës në këtë planet (shih Psalmi 104).
Është sinonim me *El* (shih LiP. 32:15-19). Mund të jetë edhe term paralel me JHVH, pasi Psalmi 14 (*Elohim*) është plotësisht njësoj si Psalmi 53 (JHVH), me përjashtim të ndryshimit të emrave hyjonrë.
 - 6. Ndonëse SHUMËSI mund të përdoret edhe për perënditë e tjera, shpesh, ky term nënkupton Perëndinë e Izraelit, por zakonisht ajo që tregon kuptimin monoteist është FOLJA në NJËJËS.
 - 7. Ky term gjendet në gojën e joizraelitëve si emri i hyjnisë.
 - a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:2
 - c. Moisiu, kur flet për kombet, LiP. 32:8
 - 8. Është e çuditshme që një emër i zakonshëm i Perëndisë monoteiste të Izraelit është në SHUMËS!
Ndonëse nuk ka siguri, këto janë teoritë.
 - a. Hebraishtja ka shumë SHUMËSA, që shpesh përdoren për theksim. E lidhur ngushtë me këtë është një veçori e mëvonshme gramatikore e hebraishtes, që quhet “shumësi i madhështisë”, ku SHUMËSI përdoret për të përforcuar një koncept.
 - b. Kjo mund t’i referohet këshillit të engjëjve, me të cilët Perëndia takohet në qiell dhe të cilët bëjnë vullnetin e tij (shih 1 Mbret. 22:19-23; Jobi 1:6; Psa. 82:1; 89:5, 7).
 - c. Madje, është e mundur që kjo të reflektojë zbulesën në DhR e të një Perëndie në tre persona. Te Zan. 1:1, Perëndia krijon; Zan. 1:2, Fryma rri mbi ujërat, dhe, nga DhR, Jezusi

është vepruesi i krijimit të Atit Perëndi (shih Gjoni 1:3, 1 Rom. 11:36; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15; Heb. 1:2; 2:10).

D. JHVH (BDB 217, KB 394)

1. Ky është emri që reflekton Hyjninë si Perëndia që bën besëlidhje; Perëndia si shpëtimtar, shpëngues! Njerëzit i thyejnë besëlidhjet, kurse Perëndia është besnik ndaj fjalës, premtimit, besëlidhjes së vet (shih Psalmi 103).

Ky emër përmendet për herë të parë në kombinim me *Elohim* në Zan. 2:4. Te Zan. 1-2 nuk gjenden dy rrëfime të krijimit, por dy theksime të tij: (1) Perëndia si krijuesi i universit (fizik) dhe (2) Perëndia si krijuesi i veçantë i njerëzimit. Zanafilla 2:4-3:24 nis zbulesën e veçantë për pozicionin dhe synimin e privilegjuar të njerëzimit, si dhe për problemin e mëkatit dhe rebelimit që shoqërojnë këtë pozitë unike.
2. Në Zan. 4:26, thuhet se “njerëzit filluan t’i bënin thirrje emrit të ZOTIT” (JHVH). Mirëpo Eks. 6:3 nënkupton se populli i hershëm i besëlidhjes (patriarkët dhe familjet e tyre) e njihnin Perëndinë vetëm si *El-Shaddai*. Emri JHVH shpjegohet vetëm një herë në Eks. 3:13-16, sidomos në v. 14. Megjithatë, shkrimet e Moisiut shpesh i interpretojnë fjalët me lojëra të njohura fjalësh, jo me etimologji (shih Zan. 17:5; 27:36; 29:13-35). Ka patur disa teori për kuptimin e këtij emri (marrë nga IDB, vëll. 2 f. 409-11).
 - a. nga një rrënjë fjale arabisht, “tregoj dashuri të zjarrtë”
 - b. nga një rrënjë fjale arabisht, “fryj” (JHVH si Perëndia i furtunës)
 - c. nga një rrënjë fjale ugarite (kanaanite), “flas”
 - d. nga një mbishkrim fenikas, një PJESORE SHKAKORE që do të thotë “Ai që mban”, ose “Ai që themelon”
 - e. nga forma *Kal* në hebraisht, “Ai që është”, ose “Ai që është i pranishëm” (në kuptimin e ardhshëm, “Ai që do të jetë”)
 - f. nga forma *Hifil* në hebraisht, “Ai që bën të jetë”
 - g. nga rrënja e fjalës hebraisht “jetoj” (p.sh. Zan. 3:20), që do të thotë “Ai që është i vetmi që jeton dhe që jeton gjithmonë”
 - h. nga konteksti i Eks. 3:13-16, një lojë fjalësh me formën E PAKRYER të përdorur në një kuptim TË KRYER, “Unë do të vazhdoj të jem ai që isha”, ose “do të vazhdoj të jem ai që kam qenë gjithmonë” (shih J. Wash Watts, *A Survey of Syntax in the Old Testament*, f. 67). Emri i plotë JHVH shpesh shprehet në formë të shkurtuar, ose, mundësisht, në një formë fillestare.
 - (1) *Jah* (p.sh. Halelu – jah, BDB 219, shih Eks. 15:2; 17:16; Psa. 89:8; 104:35)
 - (2) *Jahu* (fundit i emrave me “jah”, p.sh., Isa-jah)
 - (3) *Jo* (emrat që fillojnë me “Jo”, p.sh., Jozueu ose Joeli)
3. Në judaizmin e mëvonshëm, ky emër i besëlidhjes u bë kaq i shenjtë (tetragramatoni), sa që judenjtë druheshin ta përdornin se mos shkelnin urdhrin e Eks. 20:7; LiP. 5:11; 6:13. Kështu, ata e zëvendësuan me termin hebraisht “pronar”, “zotëri”, “bashkëshort”, “zot” – *adon* ose *adonai* (zoti im). Kur vinin te fjala JHVH në leximin e pasazheve të DhV, ata shqiptonin “zot”. Ja pse JHVH shkruhet me të mëdha ZOT në përkthimet në anglisht.
4. Si në rastin e *El*-it, edhe JHVH shpesh kombinohet me terma të tjerë për të theksuar disa karakteristika të Perëndisë së Besëlidhjes me Izraelin. Ndonëse ka shumë terma të mundshëm për këto kombinime, ja disa prej tyre.
 - a. *JHVH – Jire* (JHVH do të sigurojë, BDB 217 & 906), Zan. 22:14
 - b. *JHVH – Rofekha* (JHVH është shëruesi yt, BDB 217 & 950, PJESORJA *Kal*), Eks. 15:26
 - c. *JHVH – Nissi* (JHVH është flamuri im, BDB 217 & 651), Eks. 17:15
 - d. *JHVH – Mekaddishkem* (JHVH, Ai që të shenjtëron, BDB 217 & 872, PJESORE *Piel*), Eks. 31:13
 - e. *JHVH – Shalom* (JHVH është Paqe, BDB 217 & 1022), Gjyq. 6:24
 - f. *JHVH – Sabaoth* (JHVH i ushtrive, BDB 217 & 878), 1 Sam. 1:3, 11; 4:4; 15:2; shpesh në Profetët
 - g. *JHVH – Ro’I* (JHVH është bariu im, BDB 217 & 944, PJESORE *Kal*), Psa. 23:1
 - h. *JHVH – Cidkenu* (JHVH është drejtësia jonë, BDB 217 & 841), Jer. 23:6
 - i. *JHVH – Shamma* (JHVH është aty, BDB 217 & 1027), Ezek. 48:35

6:21 “menjëherë, varka arriti në bregun ku ishin nisur”. Me sa duket, kjo është një tjetër ngjarje e mrekullueshme (shih 22-25), pasi ungjilli i Markut vënë dukje se ata kishin rremuar pothuajse deri në gjysmë të liqenit (shih Marku 6:47). Gjithsesi, kjo nuk përmendet në ungjijtë e tjerë (shih Mat. 14:32, ose Marku 6:51).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:22-25

²²Të nesërmen, turma, që kishte qëndruar në anën tjetër të detit, pa se nuk kishte asnjë varkë të vogël tjetër përveç njërës, dhe se Jezusi nuk kishte hipur me dishepujt në varkë, por se dishepujt ishin larguar vetëm. ²³Nga Tiberiada, pranë vendit ku kishin ngrënë bukë pasi Zoti kishte falënderuar, kishin ardhur varka të tjera të vogla. ²⁴Kështu, kur turma pa se Jezusi nuk ishte atje, dhe as dishepujt e tij, ata vetë hipën në varkat e vogla dhe erdhën në Kapernaum duke kërkuar Jezusin. ²⁵Kur e gjetën në anën tjetër të detit, i thanë: “Rabbi, kur erdhe këtu?”

6:23 “Tiberiada” Ky qytet u ndërtua nga Herod Antipa më 22 pas K. dhe u bë kryeqyteti i tij.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:26-34

²⁶Jezusi u përgjigj dhe u tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them, ju më kërkon, jo për shkak se patë shenjat, por ngaqë hëngrët bukët dhe u ngopët. ²⁷Mos punoni për ushqimin që priset, por për ushqimin që mbetet për jetë të përjetshme, të cilin do t’ju japë Biri i Njeriut, sepse mbi të Ati, pra Perëndia, ka vënë vulën e vet. ²⁸Prandaj, ata i thanë: “Çfarë të bëjmë që të mund të kryejmë veprat e Perëndisë?” ²⁹Jezusi u përgjigj dhe u tha: “Kjo është vepra e Perëndisë, që të besoni në atë që ai ka dërguar”. ³⁰Kështu, ata i thanë: “Po atëherë, çfarë shenje bën ti, që ne ta shohim dhe të të besojmë? Çfarë vepre kryen?” ³¹Etërit tanë hëngrën manën në shkretëtirë; siç është shkruar: „AI U DHA TË HANIN BUKË NGA QIELLI”. ³²Atëherë, Jezusi u tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: nuk është Moisiu ai që ju ka dhënë bukën nga qielli, por Ati im është ai që ju jep bukën e vërtetë nga qielli. ³³Sepse buka e Perëndisë është ajo që zbret nga qielli dhe i jep jetë botës”. ³⁴Atëherë, ata i thanë: “Zot, na jep gjithmonë këtë bukë”.

6:26, 32, 53 “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them” “Amen”, “Amen”. Kjo është një frazë hebraishte që gjen tre përdorime të veçanta.

1. Në DhV, kjo fjalë përdorej në kuptimin “besim”. Kuptimi i saj i figurshëm ishte “jam i patundur” dhe përdorej për të përshkruar besimin e dikujt.
2. Përdorimi që i bën Jezusi nënkupton hyrjen e thënieve të rëndësishme dhe kuptimplota. Nuk kemi asnjë përdorim të kohës të fjalës “amen” në këtë mënyrë.
3. Në kishën e hershme, ashtu si në DhV, ajo u bë fjalë pohimi ose rënieje dakord.

Shih Temën e Veçantë: Amen, në 1:51.

■ **“por ngaqë hëngrët bukët”** Motivet e tyre ishin fizike dhe të çastit, jo shpirtërore dhe të përjetshme.

■ **“dhe u ngopët”** Ky term kishte kuptimin “ha me babëzi” dhe, shpesh, përdorej për kafshët (sidomos lopët).

6:27 “Mos punoni” Kjo është URDHËRORE E TASHME MESORE me PJESËZËN MOHORE, që zakonisht nënkuptonte ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Sfondi i DhV i këtij pasazhi është Isaia 5. Kjo bisedë ka shumë ngjashmëri me atë me gruan te pusi, në Gjoni 4.

■ **“priset”** Shih Temën e Veçantë: *Apollumi* në 10:10.

■ **“ka vënë vulën e vet”** Fjalë për fjalë, kjo do të thotë “vulosi”. Ishte shenjë vërtetësie, pronësie, autoriteti dhe sigurie (shih NEB dhe Mat. 28:18; Gjoni 17:2). TEV dhe NIV e përkthejnë “miratim”, pasi përdoret për të theksuar miratimin e Atit për shërbesën e Jezusit. Shih Temën e Veçantë: Vula te 3:33, ku mund t’i referohet Frymës së Shenjtë.

6:28 “Çfarë të bëjmë që të kryejmë veprat e Perëndisë” Kjo ishte pyetja qendrore fetare për judaizmin e shekullit të parë (shih Luka 18:18). Judeu fetar supozohej se ishte në rregull me Perëndinë për shkak të (1) prejardhjes së tij dhe (2) zbatimit të Ligjit të Moisiut, siç interpretohej nga Tradita Gojore (Talmudi).

6:29 “që të besoni në atë që ai ka dërguar” Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE, e ndjekur nga një DËFTORE AORISTE VEPRORE. Fjala “besoj” është kyçe për të kuptuar mësimet e DhR për shpëtimin. Shih Temën e Veçantë në 2:23. Orientimi parësor i kësaj fjale është besimi i vullnetshëm. Grupi i fjalës greke *pistis* mund të përkthehet “besoj”, “besim”, ose “besim te dikush”. Fokusi i besimit njerëzor duhet të jetë “në të” (shih 1:12; 3:16), jo në sinqeritetin, përkushtimin apo entuziazmin njerëzor. Orientimi i atypëratyshëm i këtij pasazhi është drejt një marrëdhënieje personale me Jezu Krishtin, jo drejt teologjisë ortodokse për të, ndonjë rituali të pritur fetar, apo dhe jetesës etike. Të gjitha këto gjëra janë të dobishme, por jo parësore. Vini re se Jezusi e ndryshon SHUMËSIN “vepra” të pyetjes së tyre në “veprën” në NJËJËS.

Për fjalën “i dërguar”, shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*), në 5:24.

6:30-33 Mos harrojmë se ky grup sapo kishte marrë pjesë në ushqyerjen e mrekullueshme të pesë mijë vetëve. Ata e kishin marrë tashmë shenjën e tyre! Judaizmi rabinik mendonte se Mesia do të përsëriste disa veprime të DhV, si dërgimin e manës (shih 2 Baruku 29:8). Rabiët përdronin si tekst-provë Psa. 72:16 për këtë pikëpamje të një lloji Mesie të tipit “super-Moisi” (shih 1 Kor. 1:22).

Midis “besoni në të”, vargu 29, dhe “besojmë në ty”, vargu 30, ekziston një tipar i rëndësishëm gramatikor. I pari përqendrohet në konstruktin e zakonshëm të Gjonit “besim në” Jezusin. Është një fokus personal. I dyti përqendrohet në besimin në fjalët ose pretendimet e Jezusit, pra ky është një fokus përmbajtjeje. Mos harroni: ungjilli është edhe person, edhe mesazh. Shih Temën e Veçantë në 2:23.

6:31 “siç është shkruar” Kjo është PJESORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE. Kjo ishte forma gramatikore standarde për të prezantuar citime biblike nga DhV. Ishte një idiomë që pohonte frymëzimin dhe autoritetin e DhV. Ky citim mund t’i referohet njërit nga disa pasazhe të DhV, ose një kombinimi të tyre: Psa. 78:24; 105:40; Eks. 16:4, 15, ose Neh. 9:15.

6:32 Jezusi i drejtohet teologjisë tradicionale të judenjve. Ata pohonin se Mesia duhet të kryente vepra të mahnitshme si Moisiu, për shkak të LiP. 18:15, 18. Jezusi ua korrigjoi supozimin në disa pika.

1. Ai që dha manën ishte Perëndia, jo Moisiu
2. Mana nuk kishte orgjinë qiellore, ndonjëse njerëzit ashtu mendonin se ishte (shih Psa. 78:23-250)
3. Buka e vërtetë nga qielli ishte Jezusi, i cili nuk ishte veprim i shkuar, por realiteti i tanishëm

6:33 “është ajo që zbret nga qielli” Ky është një motiv i ripërsëritur te Gjoni (shih 3:13). Është pjesë e dualizmit vertikal të Gjonit. Në këtë kontekst, zbritja e Jezusit pohohet shtatë herë (shih 6:33, 38, 41, 42, 50, 51, 58). Ajo tregon origjinën paraekzistuese dhe hyjnore të Jezusit (shih v. 33, 38, 41, 42, 50, 51, 58 dhe 62). Ajo është dhe lojë fjalësh me “manën”, e cila zbriti nga qielli njësoj si Jezusi, Buka e vërtetë, Buka e jetës.

Fjalë për fjalë, “buka e Perëndisë është ai që zbret nga qielli”. Këtu, PJESORJA MASHKULLORE E TASHME VEPRORE i referohet (1) “bukës”, ose (2) një njeriu, Jezusit. Shpesh, te Gjoni, këto dykuptimësi janë të qëllimshme (kuptime të dyfishta).

■ **“i jep jetë botës”** Ky është qëllimi pse erdhi Jezusi (shih 3:16; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). Synimi është “jeta e re”, “jeta e përrjetshme”, “jeta e epokës së re”, “lloji i jetës së Perëndisë” për një botë të humbur dhe rebele, jo për ndonjë grup të caktuar (judenj/johebrenj, të zgjedhur/të pazgjedhur, konservatorë/liberalë), por për të gjithë!

6:34

NASB, NKJV “Zot”

NRSV, TEV,

NJB, NET,

NIV, REB “Zotëri”

Këto dy terma reflektojnë përdorime të ndryshme semantike të fjalës *kurios*. Në këtë kontekst, alternativa e dytë duket më e mira. Turma nuk e kuptonte Jezusin, as fjalët e tij. Ata nuk e perceptonin si Mesi (shih dhe shënimin 4:11; 5:7).

■ **“na jep gjithmonë këtë bukë”** Kjo është e ngjashme me pohimin e gruas te pusi, në Gjoni 4:15. As këta judenj nuk i kuptonin metaforat shpirtërore të Jezusit. Ky është motiv i përsëritur te Gjoni.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:35-40

³⁵Jezusi u tha: “Unë jam buka e jetës; ai që vjen tek unë nuk do të ketë uri, dhe ai që beson në mua nuk do të ketë kurrë etje. ³⁶Por unë ju thashë se ju me keni parë, por prapë nuk besoni. ³⁷Gjithçka që Ati më jep mua do të vijë tek unë, dhe atë që vjen tek unë, me siguri që nuk do ta flak jashtë, ³⁸Sepse unë kam zbritur nga qielli, jo që të bëj vullnetin tim, por vullnetin e atij që më dërgoi. ³⁹Ky është vullneti i atij që më dërgoi, që nga gjithçka që më ka dhënë ai të mos humbas asgjë, por ta ringjall ditën e fundit. ⁴⁰Sepse ky është vullneti i Atit tim, që kushdo që kundron Birin dhe beson në të të ketë jetë të përjetshme, dhe unë vetë do ta ringjall ditën e fundit”.

6:35 “Unë jam buka e jetës” Kjo është një nga pohimet “Unë Jam”, që është shumë karakteristike për Gjonin (shih 6:35, 41, 48, 52; 8:12; 10:7, 9, 11, 14; 11:25; 14:6; 15:1, 5). Ungjilli i Gjonit fokusohet te personi i Krishtit. Kjo lidhet me pritshmëritë mesianike të judenjve për manën dhe për Ligdhënesin e ri, i cili do të sillte një eksod të ri (nga mëkati). Shih shënimin te 8:12.

▣ **“atë që vjen tek unë me siguri nuk do ta flak jashtë”** Këto janë dy MOHORE TË DYFISHTA, pra, të forta, në greqisht: “kurrën e kurrës nuk do të ndodhë diçka” (shih v. 37).

Ekziston një marrëdhënie paralele mes “vjen” dhe “beson” (shih 7:37-38, e ngjashme me “sheh” dhe “dëgjon”). Të dyja janë PJESORE TË TASHME. Ardhja dhe besimi i besimtarëve nuk janë vendime që bëhen vetëm një herë, por ky është vetëm fillimi i një mënyrë jetese plot bashkësi, miqësi dhe ndjekje (të Jezusit).

▣ **“uri... etje”** Uria dhe etja përdoren shpesh për të përshkruar realitetin shpirtëror (shih Psa. 42:1; Isa. 55:1; Amosi 8:11-12; Mat. 5:6).

6:36 “më keni parë” Disa dëshmitarë të lashtë (dorëshkrimet x, A, si dhe shumë versione të lashta latine, Vulgata dhe ato siriake) nuk e përfshijnë fjalën “më”, duke bërë që ky pohim i Jezusit t’i referohet shenjës së tij (pra, ushqyerjes së turmës). PËREMRI përfshihet në kaq shumë dorëshkrime greqisht, si dhe versione në gjuhë të tjera, saqë UBS⁴ nuk ishte në gjendje të vendoste se cila ishte origjinale.

6:37 “Gjithçka që Ati më jep mua do të vijë tek unë” Theksi kryesor i këtij pasazhi është sovraniteti i Perëndisë. Dy pasazhet absolute për këtë të vërtetë teologjike janë Romakëve 9 dhe Efe. 1:3-14. Është interesante se, në të dyja këto kontekste, kërkohet përgjigjja e njerëzimit. Romakëve 10 ka shtatë fraza gjithëpërfshirëse. Kështu ndodh dhe me Efesianëve 2, ku diskutimet për hirin e Perëndisë (v. 1-7) çojnë në një thirrje për besim (v. 8-9). Paracaktimi është një doktrinë për të shpenguarit, jo pengesë për të pashpëtuarit. Çelësi për të shkyçur këtë doktrinë është dashuria dhe hiri i Perëndisë, jo dekretet e përjetshme. Vini re se gjithçka që Perëndia i jep Jezusit, do të “vijë” tek ai. Perëndia është ai që merr gjithmonë nismën (shih v. 44, 65), por njerëzit duhet t’i përgjigjen (shih 1:12; 3:16). Shih Temën e Veçantë, në 3:16.

▣ **“atë që vjen tek unë, me siguri nuk do ta flak jashtë”** Kjo është një tjetër MOHORE E DYFISHTË, pra e fortë. Kjo thekson të vërtetën se Perëndia i bën thirrje dhe fton gjithkënd që të shkojë tek ai përmes Krishtit (shih Ezek. 18:21-23; 30:32; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9). Perëndia është ai që ndërmerr gjithmonë nismën (shih v. 44, 65), por njerëzit duhet të përgjigjen (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ç’pasazh i mrekullueshëm për sigurinë (shih Rom. 8:31-39)!

TEMË E VEÇANTË: SIGURIA E KRISHTERË

Siguria është (1) e vërtetë biblike, (2) përjetim i besimit të besimtarit, dhe (3) mënyrë jetese.

A. Baza biblike për sigurinë është

1. Karakteri i Atit Perëndi

a. Zanafilla 3:15; 12:3

b. Psalmi 46:10

c. Gjoni 3:16; 10:28-29

d. Romakëve 8:38-39

e. Efesianëve 1:3-14; 2:5, 8-9

f. Filipianëve 1:6

g. 2 Timoteut 1:12

- h. 1 Pjetrit. 1:3-5
- 2. Vepra e Birit Perëndi
 - a. Lutja e tij priftërore, Gjoni 17:9-24, veçanërisht v. 12
 - b. Flijimi i tij zëvendësues
 - 1) Romakëve 8:31
 - 2) 2 Korintasve 5:21
 - 3) 1 Gjonit 4:9-10
 - c. Ndërmjetësimi i tij i vazhdueshëm
 - 1) Romakëve 8:34
 - 2) Hebrenjve 7:25
 - 3) 1 Gjonit 2:1
- 3. Aftësimi i Perëndisë Frymë
 - a. Thirrja e tij, Gjoni 6:44, 65
 - b. Vulosja e tij
 - 1) 2 Korintasve 1:22; 5:5;
 - 2) Efesianëve 1:13-14; 4:30
 - c. Siguria e tij personale
 - 1) Romakëve 8:16-17
 - 2) 1 Gjonit 5:7-13
- B. Përgjigjja e domosdoshme e besëlidhjes nga ana e besimtarit është
 - 1. Pendimi dhe besimi fillestar dhe i vazhdueshëm
 - a. Marku 1:15
 - b. Gjoni 1:12
 - c. Veprat 3:16; 20:21
 - d. Romakëve 10:9-13
 - 2. Të kujtojë se synimi i shpëtimit është ngjashmëria me Krishtin
 - a. Romakëve 8:28-29
 - b. Efesianëve 1:4; 2:10; 4:13
 - 3. Të kujtojë se siguria vërtetohet nga mënyra e jetesës
 - a. Jakobi
 - b. 1 Gjonit
 - 4. Të kujtojë se siguria vërtetohet nga besimi dhe qëndresa aktive
 - a. Marku 13:13
 - b. 1 Korintasve 15:2
 - c. Hebrenjve 3:14; 4:14
 - d. 2 Pjetrit 1:10
 - e. Juda, v. 20-21

6:38 “unë kam zbritur nga qielli” Kjo është KOHA E KRYER, që i referohet Mishërimit (shih Gjoni 1:1 e më tej; Efe. 4:8-10) dhe rezultatet e kësaj mbeten. Po kështu, tregon dhe origjinën qiellore të Jezusit (shih v. 41, 62).

■ **“jo që të bëj vullnetin tim, por vullnetin e atij që më dërgoi”** DhR pohon edhe unitetin e Trinisë (shih Temën e Veçantë, 14:26; shembull 14:8-9), edhe personalitetin e tre personave të Trinisë. Ky varg është pjesë theksimit të vazhdueshëm që i bën Gjoni nënshtrimit të Jezusit ndaj Atit. Shih shënimin e plotë të 5:19. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*), të 5:24.

6:39 “që nga gjithçka që më ka dhënë ai të mos humbas asgjë” Ekziston një lidhje e qartë mes NJËJËSIT ASNJANËS “gjithçka që” (v. 37) dhe NJËJËSIT ASNJANËS (v. 39). Gjoni e përdor disa herë këtë formë të pazakontë (shih 17:2, 24). Me sa duket, kjo thekson tërësinë kolektive (shih v. 40, 45).

Ky është premtim madhështor për fuqinë ruajtëse të Perëndisë, një burim i sigurisë së krishterë (shih Gjoni 10:28-29; 17:2, 24; shih Temën e Veçantë të 1 Gjonit 5:13). Vini re se KOHA E FOLJES së v. 39 është KOHA E TASHME, ndërsa në v. 39 është KOHA E KRYER. Dhurata e Perëndisë qëndron! Po kështu, të dyja pohimet e fundit të v. 39 janë në AORISTEN VEPRORË; Jezusi nuk humbet asgjë nga ajo që i ka dhënë Ati (v. 37 dhe 39), madje ai ringjall në ditën e fundit të gjithë ata që i janë dhënë (shih v. 44). Këtu kemi premtimet hyjnore të (1) zgjedhjes dhe (2) qëndresës!

Ky koncept i një dite përmbushjeje (si pozitive, ashtu dhe negative) thërritet me tituj të ndryshëm.

1. ditët e fundit, 6:39,40,44,54; 11:24; 12:48; 2 Tim. 3:1; 1 Pjet. 1:5; 2 Pjet. 3:3
2. koha e fundit, 1 Gjonit 2:18; Juda v. 18
3. ajo ditë, Mat. 7:22; 2 Tim. 1:12, 18; 4:8
4. një ditë, Veprat 17:31
5. dita e madhe, Juda v. 6
6. dita, Luka 17:30; 1 Kor. 3:13; 1 Thes. 5:4; Heb. 10:25
7. dita e tij, Luka 17:24
8. Dita e Zotit, 1 Thes. 5:2; 2 Thes. 2:2
9. dita e Krishtit, Fil. 1:10; 2:16
10. dita e Zotit Jezus Krisht, 1 Kor. 1:8; 5:5
11. dita e Zotit Jezus, 2 Kor. 1:14
12. dita e Krishtit Jezus, Fil. 1:6
13. dita e Birit të Njeriut, Luka 17:24 (shih dhe #7)
14. dita e gjykimit, Mat. 10:15; 11:22,24; 12:36; 2 Pjet. 2:9; 3:7; 1 Gjonit 4:17
15. dita e zemërimit, Zbu. 6:17
16. dita e madhe e Perëndisë – Zbu. 16:14

■ **“por do ta ringjall ditën e fundit”** Kjo bën fjalë për ditën e ringjalljes për besimtarët, e cila do të jetë ditë gjykimi për jobesimtarët (shih v. 40, 44, 54; 5:25, 28; 11:24 dhe 1 Kor. 15). Frank Stagg ka një shprehje të dobishme në këtë pikë në librin e tij *A New Testament Theology*:

“Ungjilli i Gjonit e thekson fort ardhjen e ardhshme të Jezusit (14:3, 18, f. 28; 16:16, 22) dhe flet qartë për ringjalljen dhe gjykimin përfundimtar në “ditën e fundit” (5:28 e më tej; 6:39 e më tej, 44, 54; 11:24; 12:48); megjithatë, gjatë gjithë Ungjillit të Katërt, jeta e përjetshme, gjykimi dhe ringjallja janë realitete të tashme (3:18 f.; 4:23; 5:25; 6:54; 11:23 ff.; 12:28,31; 13:31 f.; 14:17; 17:26)” (f. 311).

6:40 “ky është vullneti i Atit tim” Kjo është përgjigja e Jezusit për pyetjen e v. 28: “çfarë do të bëjmë që të kryejmë veprat e Perëndisë?” Shih Temën e Veçantë: Vullneti i Perëndisë, te 4:34.

■ **“që kushdo që kundron Birin”** PJESORET E TASHME VEPRORE të foljeve “kundroj” dhe “besoj” janë paralele (si “vjen” dhe “beson” në v. 35, si “shikon” dhe “dëgjon”). Këto janë veprime të vazhdueshme, jo ngjarje që ndodhin vetëm një herë. Termi “kundroj” do të thotë “shikoj me vështrim të ngulët” diçka në mënyrë që ta kuptoj ose ta njoh.

Mua më pëlqen termi “gjithsekush” (*pas*), vini re

1. që të gjithë të besojnë përmes tij, 1:7
2. ndriçon çdo njeri, 1:9
3. kushdo që beson të ketë jetën e përjetshme në të, 3:15
4. që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme, 3:16
5. që të gjithë të nderojnë Birin, 5:23,
6. nr. 6-9; Gjoni 6:37, 39, 40, 45
10. kushdo që më do dhe beson në mua nuk do të vdesë kurrë, 11:26
11. unë, nëse lartësohem nga toka, do t’i tërheq gjithë njerëzit drejt vetes, 12:32
12. kushdo që beson në mua të mos rrijë në errësirë, 12:46

Ky është misteri i sovranitetit (shih v. 38-39; 17:2, 24, kundrejt vullnetit të lirë). Të dyja janë, në njëfarë mënyre, të vërteta. Për mua, koncepti teologjik i “besëlidhjes” i bashkon më së miri!

■ **“beson në të”** Mos harroni se shpëtimi është, pikësëpari, marrëdhënie personale, jo kredo, teologji e saktë, apo mënyrë jetese morale (shih 3:16; 11:25-26). Theksi është te objekti i besimit, jo te fortësia e besimit. Shih Temën e Veçantë, te 2:23.

Vini re ekuilibrin e theksit të zgjedhja sovraane e Perëndisë në v. 37a, 39, 44, 65 dhe përgjigjen e njerëzimit me besim në v. 37b, 40. Këto tensione biblike duhen ruajtur. Sovraniteti i Perëndisë dhe vullneti i lirë njerëzor formojnë aspektet binjake të besëlidhjes biblike.

■ **“të ketë jetë të përjetshme”** Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE; pritet një përgjigje (shih 1 Gjonit 5:11). Vini re gjithashtu se v. 39 është kolektiv, ndërsa v. 40 është individual. Ky është paradoksi i shpëtimit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:41-50

⁴¹Prandaj, judenjtë po murmurisnin për të, ngaqë tha: “Unë jam buka që zbriti nga qielli”. ⁴²Ata po thoshin: “A nuk është ky Jezusi, biri i Jozefit, të cilit ia njohim babanë dhe nënën? Si thotë tani: „unë kam zbritur nga qielli?”” ⁴³Jezusi u përgjigj dhe u tha: “Mos murmurisni me njëri-tjetrin. ⁴⁴Askush nuk mund të vijë tek unë nëse nuk e tërheq Ati, i cili më ka dërguar; dhe unë do ta ringjall ditën e fundit. ⁴⁵Është shkruar te Profetët: „DHE TË GJITHË DO TË JENË TË MËSUAR NGA PERËNDIA”. Kushdo që ka dëgjuar dhe ka mësuar nga Ati, vjen tek unë. ⁴⁶Jo se e ka parë dikush Atin, përveç atij që është dërguar nga Perëndia; ai e ka parë Atin. ⁴⁷Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: ai që beson, ka jetën e përjetshme. ⁴⁸Unë jam buka e jetës. ⁴⁹Etërit tuaj hëngrën manën në shkretëtirë dhe vdiqën. ⁵⁰Kjo është buka që zbret nga qielli, që ai që ha prej saj të mos vdesë. ⁵¹Unë jam buka e gjallë që zbriti nga qielli; nëse dikush ha nga kjo bukë, do të jetojë përjetë; dhe buka që do të jap unë për jetën e botës është mishi im”.

6:41 “Prandaj, judenjtë po murmurisnin” Kjo është në KOHËN E PAKRYER, që nënkupton se ata filluan të murmurisnin, ose se po murmurisnin në mënyrë të vazhdueshme. Paralelja me periudhën e endjes në shkretëtirë (shih Eks. dhe Num.) është goditëse. Edhe izraelitët e asaj kohe e kishin mohuar Moisiun, përfaqësuesin e Perëndisë, i cili u kishte siguruar ushqim.

6:42 Kjo tregon se judenjtë i kuptonin fjalët e Jezusit për veten. Qartazi, ai po përdorte idioma judaike për të pohuar se ishte paraekzistues dhe hyjno! Fjalët e Jezusit janë tronditëse, sidomos për faktin se vijnë nga një zdrukthëtar galileas! Jezusi bënte pohime të tilla të forta për veten. Prandaj, ai është ose

1. Biri i mishëruar i Perëndisë, i cili sjell jetë të përjetshme me fjalët dhe veprat e tij, ose
2. mashtrues me qëllim, ose
3. i marrë (përtuar nga Josh McDowell, *Provat që kërkojnë vendim*)

Vërtetësia e pohimeve të Jezusit është thelbi i krishterimit.

6:43 “Mos murmurisni me njëri-tjetrin” Kjo është URDHËRORE E TASHME me një PJESËZ MOHORE që, zakonisht, do të thotë të ndalosh një veprim në kryerje e sipër.

6:44 “Askush nuk mund të vijë tek unë nëse nuk e tërheq Ati” Perëndia merr gjithmonë nismën (shih v. 65 dhe 15:16). Të gjitha vendimet shpirtërore janë rezultati i joshjes së Frymës, jo i fetarisë së njerëzimit (shih Isa. 53:6). Sovraniteti i Perëndisë dhe përgjigjja e detyruar njerëzore janë të lidhura në mënyrë të pandashme nga vullneti dhe mëshira e Perëndisë. Ky është koncepti i DhV për besëlidhjen.

Ekuilibri i “tërheqjes së Perëndisë” gjendet te 12:32, ku Jezusi “tërheq gjithë njerëzit te vetja”. Kjo tërheqje e përmbys modelin e DhV, ku populli i Perëndisë nuk i përgjigjet fjalës së tij profetike (shembuj: Isa. 6:9-13; 29:13; Jeremia). Tani, Perëndia nuk i flet përmes profetëve Izraelit, por përmes Birit të vet gjithë njerëzimit (shih Heb. 1:1-3). Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*), te 5:24.

6:45 “Është shkruar në Profetët” Ky është citim nga Isa. 54:13, ose Jer. 31:34, ku përshkruhet aspekti i brendshëm (zemra e re, mendja e re) e “Besëlidhjes së Re”.

■ **“Jo se e ka parë dikush Atin”** Pohimi i Jezusit është se vetëm përmes tij mund të njohim dhe kuptojmë vërtet Perëndinë (shih Gjoni 1:18; 14:6, 9). As Moisiu nuk e pa vërtet JHVH-në (shih shënimi, 5:32).

6:47 Ky varg përmbledh ofertën e Jezusit, pra, shpëtimin falas të të gjithë njerëzve (“ai që beson”, PJESORE E TASHME VEPRORE; “jeta e përjetshme”, shih v. 51, 58; 3:15, 16, 36; 5:24; 11:26; 20:31). Jezusi është e vetmja zbulesë e vërtetë e Perëndisë, e vetmja derë e vërtetë te Perëndia (ekskluzivizmi i ungjillit, shih 10:1-6, 7-9; 14:6), por kjo është e disponueshme për gjithë bijtë dhe bijat e Adamit (inkluzivizmi i ungjillit përmbush 1:4, 7, 12; 3:16; Zan. 3:15; 12:3).

6:50 Ky varg, ashtu si 31-35, është lojë fjalësh me kuptimin e bukës, bukës fizike (mana) dhe bukës qiellore (Jezusi). Njëra jep dhe ruan jetën fizike, por duhet përsëritur dhe, në fund, nuk e ndalon dot vdekjen. Tjetra jep dhe ruan jetën e përjetshme, por duhet pranuar dhe ushqyer; ajo i jep fund të atypëratyshëm vdekjes shpirtërore (miqësisë së thyer me Perëndinë; miqësisë së ngushtë me mëkatën dhe veten).

6:51 “Unë jam buka e gjallë” Kjo është një nga shprehjet e famshme “Unë Jam” të ungjillit të Gjonit (shih 6:35, 48, 51). Ishte teknikë letrare e Jezusit për të përqendruar vëmendjen te personi i tij. Shpëtimi, njësoj si zbulesa, në fund fare është një person.

▣ **“për jetën e botës është mishi im”** Kjo është një metaforë që thekson se nevoja jonë qendrore është vetë Jezusi, jo ndonjë furnizim ushqimor. Qartazi, kjo frazë lidhet me 1:14.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:52-59

⁵²Atëherë, judentjë filluan të diskutonin me njëri-tjetrin, duke thënë: “Si mund të na japë ky njeri mishin e vet që ta hamë?” ⁵³Kështu, Jezusi u tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: nëse nuk hani mishin e Birit të Njeriut dhe nuk pini gjakun e tij, nuk keni jetë në vetvete. ⁵⁴Ai që ha mishin tim dhe pi gjakun tim ka jetë të përjetshme, dhe unë do ta ringjall ditën e fundit. ⁵⁵Sepse mishi im është ushqim i vërtetë, dhe gjaku im është pije e vërtetë. ⁵⁶Ai që ha mishin tim dhe pi gjakun tim qëndron në mua, dhe unë në të. ⁵⁷Ashtu si Ati i gjallë më dërgoi mua, dhe unë jetoj për shkak të Atit, kështu dhe ai që më ha mua, do të jetojë për shkakun tim. ⁵⁸Kjo është buka që zbriti prej qielli; jo siç hëngrën etërit dhe vdiqën; ai që ha këtë bukë do të jetojë përjetë”. ⁵⁹Këto gjëra ai i tha në sinagogë, duke mësuar në Kapernaum.

6:52

NASB “diskutinin”

NKJV “grindeshin”

NRSV “debatonin”

TEV “debat i zemëruar”

NJB “duke diskutuar”

KOHA E PAKRYER nënkuptonte fillimin e diçkaje, ose vazhdimin e diçkaje në të shkuarën. Kjo është një fjalë e fortë greqisht që do të thotë “luftoj” (shih Veprat 7:26; 2 Tim. 2:23-24; Titi 3:9) dhe u përdor në mënyrë metaforike te 2 Kor. 7:5 dhe Jakobi 4:1-2.

▣ **“Si mund të na japë ky njeri mishin e vet që ta hamë”** Te Gjoni, Jezusi flet me gjuhë metaforike, e cila keqkuptohet vazhdimisht në kuptimin e fjalëpërfjalshëm: (1) Nikodemi, 3:4; (2) gruaja samaritane, 4:11; (3) turma e judenjve, 6:52; dhe (4) dishepujt, 11:11.

6:53-57 FORMAT FOLOJRE në v. 53 dhe 54 janë shumë interesante. Në v. 53, “ha” dhe “pi” janë LIDHORE AORISTE VEPRORE, që bëjnë fjalë për një veprim nismëtar të mundshëm dhe të dëshiruar. FORMAT FOLOJRE në v. 53, “ha” dhe “pi”, janë PJESORE TË TASHME VEPRORE, të cilat theksojnë një veprim të vazhduar (shih v. 56, 57, 58). Duket se kjo pohon faktin se, së pari, njeriu duhet t’i përgjigjet Jezusit dhe pastaj të vazhdojë t’i përgjigjet (shih v. 44).

S“duhet harruar se marrja e këtij pasazhi në kuptimin e fjalëpërfjalshëm është keqkuptim i tmerrit të judenjve për të mos pirë gjak (shih Lev. 17:10-14). Nëse aludimet e qarta të Jezusit për manën në shkretëtirë (shih v. 58) i përdorim si fraza të fjalëpërfjalshme që lidhen me Eukaristinë, po bëjmë një manipulim të kontekstit historik dhe kontekstit letrar për arsye liturgjike.

6:54 “mishi... gjaku” Kjo është mënyrë judaike metaforike që i referohet gjithë individit, njësoj si “zemra”.

6:55 “ushqim i vërtetë... pije e vërtetë” Ky është përdorimi karakteristik që i bën Gjoni termit “e vërtetë” (shih temën e veçantë më poshtë). Gjoni, i cili shkruan më vonë se shkrimtarët e tjerë të DhR, ka parë zhvillimin e një sërë herezish (mbitheksimi i Gjon Pagëzorit, mbitheksimi i sakramentalizmit, mbitheksimi i njohurisë njerëzore – gnosticizmi).

TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” (SI KONCEPT) NË SHKRIMET E GJONIT

Në njëfarë kuptimi, Gjoni kombinon sfondin hebraik me sfondin greke në rastin e *alētheia*, “e vërteta”, siç bëri dhe me *logos* (shih 1:1-14). Në hebraisht, *emeth* (BDB 53) nënkupton diçka që është e vërtetë, ose e besueshme (shpesh, shoqërohet në Septuagintë me *pisteuō*). Në greqisht, kjo fjalë lidhet me realitetin e Platonit përkundër jorealitetit, qiellores përkundër tokësore. Kjo përputhet me dualizmin e Gjoni. Perëndia e ka zbuluar qartë veten (etimologjia e *alētheia* është “nxjerr në dritë, zbuloj, demonstroj qartazi”) në Birin e vet. Kjo shprehet në disa mënyra.

1. EMRI, *alētheia*, e vërteta
 - a. Jezusi është plot hir e të vërtetë (shih 1:14, 17 – terma të besëlidhjes në DhV)
 - b. Jezusi është fokusi i dëshmisë së Gjon Pagëzorit (shih 1:32-34; 18:37 – profeti i fundit i DhV)
 - c. Jezusi thotë të vërtetën (shih 8:40, 44, 45, 46 – zbulues është e shprehshme dhe personale)
 - d. Jezusi është udha, e vërteta dhe jeta (shih 14:6)
 - e. Jezusi i shenjtëron në të vërtetën (shih 17:17)
 - f. Jezusi (*Logos*, 1:1-3) është e vërteta (shih 17:17)
 2. MBIEMRI, *alēthēs*, e vërtetë, e besueshme
 - a. Dëshmia e Jezusit (shih 5:31-32; 7:18; 8:13-14)
 - b. Gjykimi i Jezusit (shih 8:16)
 3. MBIEMRI, *alēthinos*, e vërtetë
 - a. Jezusi është drita e vërtetë (shih 1:9)
 - b. Jezusi është buka e vërtetë (shih 6:32)
 - c. Jezusi është hardhia e vërtetë (shih 15:1)
 - d. Jezusi është dëshmia e vërtetë (shih 19:35)
 4. NDAJFOLJA, *alēthōs*, vërtet
 - a. Dëshmia e samaritanëve për Jezusin si Shpëtimtar i botës (shih 4:42)
 - b. Jezusi është vërtet ushqim dhe pije, në dallim nga mana e kohës së Moisiut (shih 6:55)
- Termi “e vërtetë” dhe fjalët që rrjedhin prej saj shprehin dhe dëshminë e të tjerëve për Jezusin, *alēthēs*
- a. Dëshmia e Gjon Pagëzorit është e vërtetë (shih 10:41)
 - b. Dëshmia e Gjoni (autorit të ungjillit) është e vërtetë (shih 19:35; 21:24)
 - c. Jezusi shihet si profeti i vërtetë (shih 6:14; 7:40)

Për një diskutim të mirë të së vërtetës në DhV dhe në DhR, shih George E. Ladd, *A Theology of the New Testament*, f. 263-269.

6:56 “qëndron në mua dhe unë në të” Kjo e vërtetë shprehet dhe te Gjoni 15:4-7; 1 Gjonit 2:6, 27, 28; 3:6, 24, shih Temën e Veçantë: Qëndroj, te 1 Gjonit 2:10. Ky është theksimi i vazhdueshëm në DhR i qëndresës së shenjtoreve (shih Gal. 6:9; Zbu. 2:7, 11, 17, 26; 3:5, 12, 21, shih Temën e Veçantë te 8:31). Përgjigjia e vërtetë vleftësohet nga përgjigjia e vazhdueshme e besimtarit. Ky theksim i qëndresës është elementi që i mungon botës ungjillore amerikane. Njeriu duhet t’ia fillojë me besim, por edhe të përfundojë me besim (Hebrenjve 11). Jonathan Edwards tha: “Prova e sigurt e zgjedhjes është kur njeriu duron deri në fund”. W. T. Conner tha: “Shpëtimi i një njeriu të zgjedhur për shpëtim është i sigurt nga përjetësia në përjetësi në mendjen dhe qëllimin e Perëndisë, mirëpo kushtëzohet nga besimi, madje nga një besim që bën qëndresë dhe ngadhënjën”.

6:57 “Ati i gjallë” Kjo frazë është unike, por ky koncept përdoret shpesh në Bibël. Ka disa mënyra të ndryshme si të interpretojmë origjinën e këtij titulli për Perëndinë.

1. emri bazë i Perëndisë së Besëlidhjes (shih Eks. 3:12, 14-16; 6:2-3, shih Temën e Veçantë, te 6:20)
2. betimet e Perëndisë, “ashtu siç unë jetoj”, ose në emër të Perëndisë, “ashtu siç jeton Zoti” (shih Num. 14:21, 28; Isa. 49:18; Jer. 4:2)
3. si përshkrim i Perëndisë (shih Psa. 42:2; 84:2; Joz. 3:10; Jer. 10:10; Dan. 6:20,26; Os. 1:10; Mat. 16:16; 26:63; Veprat 14:15; Rom. 9:26; 2 Kor. 3:3; 6:16; 1 Thes. 1:9; 1 Tim. 3:15; 4:19; Heb. 3:12; 9:14; 10:21; 12:22; Zbu. 7:2)
4. thënie të Gjoni 5:26, se Ati ka jetë në vetvete dhe ia ka dhënë Birit, dhe te 5:21, ku Ati ngjall të vdekurit, siç bën dhe Biri.

6:58 Ky është krahasim i Dhiatës së Vjetër me atë të Re, i Moisiut me Jezusin. (Shih librin e Hebrenjve, sidomos kapitujt 3, 4).

■ “etërit hëngrën dhe vdiqën” Kjo mund t’i ketë shërbyer edhe funksionit teologjik të mohimit të shpëtimit me anë të prejardhjes (shih 8:33-39), ose me anë të ligjit të Moisiut (Torahu).

■ “përjetë” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: PËRJETË (‘OLAM)

Etimologjia e termit hebraisht *‘olam*, [אָלַם] (BDB 761) është e paqartë (NIDOTTE, vëll. 3, f. 345). Ajo përdoret në disa kuptime (zakonisht, përcaktohen nga konteksti). Më poshtë janë vetëm disa shembuj të përzgjedhur.

1. gjëra të lashta
 - a. popujt, Zan. 6:4; 1 Sam. 27:8; Jer. 5:15; 28:8
 - b. vende, Isa. 58:12; 61:4
 - c. Perëndia, Psa. 93:2; Fja. 8:23; Isa. 63:16
 - d. gjëra, Zan. 49:26; Jobi 22:15; Psa. 24:7, 9; Isa. 46:9
 - e. koha, LiP. 32:7; Isa. 51:9; 63:9, 11
2. koha e ardhshme
 - a. jeta e dikujt, Eks. 21:6; LiP. 15:17; 1 Sam. 1:22; 27:12
 - b. hiperbolë për mbretin, 1 Mbret. 1:31; Psa. 61:7; Neh. 2:3
 - c. ekzistencë e vazhdueshme
 - (1) toka, Psa. 78:69; 104:5; Pred. 1:4
 - (2) qiejt, Psa. 148:6
 - d. ekzistenca e Perëndisë
 - (1) Zan. 21:33
 - (2) Eks. 15:18
 - (3) LiP. 32:40
 - (4) Psa. 93:2
 - (5) Isa. 40:28
 - (6) Jer. 10:10
 - (7) Dan. 12:7
 - e. besëlidhja
 - (1) Zan. 9:12, 16; 17:7, 13, 19
 - (2) Eks. 31:16
 - (3) Lev. 24:8
 - (4) Num. 18:19
 - (5) 2 Sam. 23:5
 - (6) Psa. 105:10
 - (7) Isa. 24:5; 55:3; 61:
 - (8) Jer. 32:40; 50:5
 - f. besëlidhja e veçantë me Davidin
 - (1) 2 Sam. 7:13, 16, 25, 29; 22:51; 23:5
 - (2) 1 Mbret. 2:33, 45; 9:5
 - (3) 2 Kro. 13:5
 - (4) Psa. 18:50; 89:4, 28, 36, 37
 - (5) Isa. 9:7; 16:5; 37:35; 55:3
 - g. Mesia i Perëndisë
 - (1) Psa. 45:2; 72:17; 89:35-36; 110:4
 - (2) Isa. 9:6
 - h. ligjet e Perëndisë
 - (1) Eks. 29:28; 30:21
 - (2) Lev. 6:18,22; 7:34; 10:15; 24:9
 - (3) Num. 18:8,11,19
 - (4) Psa. 11:9; 89, 160
 - (5) Isa. 59:21

- i. premtimet e Perëndisë
 - (1) 2 Sam. 7:13, 16, 25; 22:51
 - (2) 1 Mbret. 9:5
 - (3) Psa. 18:50
 - (4) Isa. 40:8
- j. Pasardhësit e Abrahamit dhe Toka e Premtuar
 - (1) Zan. 13:15; 17:19; 48:4
 - (2) Eks. 32:13
 - (3) 1 Kro. 16:17
- k. festat e besëlidhjes
 - (1) Eks. 12:14, 17, 24
 - (2) Lev. 23:14, 21, 41
 - (3) Num. 10:8
- l. përjetësia, e përjetshme
 - (1) 1 Mbret. 8:13
 - (2) Psa. 61:7-8; 77:8; 90:2; 103:17; 145:13
 - (3) Isa. 26:4; 45:17
 - (4) Dan. 9:24
- m. çfarë thonë Psalmet se do të bëjnë përjetë besimtarët
 - (1) do të falënderojnë, Psa. 30:12; 79:13
 - (2) banojnë në prani të tij, Psa. 41:12; 61:4, 7
 - (3) do të besojnë në mëshirën e tij, Psa. 52:8
 - (4) do të lavdërojnë Zotin, Psa. 52:9
 - (5) do të këndojnë lavde, Psa. 61:8; 89:1
 - (6) do të shpallin drejtësinë e tij, Psa. 75:9
 - (7) do të përlevdojnë emrin e tij, Psa. 86:12; 145:2
 - (8) do të bekojnë emrin e tij, Psa. 145:1
- 3. si mbrapa, ashtu dhe para, në kohë (“nga përjetësia në përjetësi”)
 - a. Psa. 41:13 (lavdi Zotit)
 - b. Psa. 90:2 (vetë Perëndia)
 - c. Psa. 103:17 (dashamirësia e Zotit)

Mos harro, konteksti përcakton gjerësinë e kuptimit të këtij termi. Besëlidhjet dhe premtimet e përjetshme janë të kushtëzuara (p.sh., Jeremia 7). Kujdes që të mos i imponosh pikëpamjen tënde moderne për kohën, ose teologjinë tënde sistematike të DhR, çdo pasazhi të DhV që përmend këtë fjalë të rrjedhshme. DhR i universalizoi premtimet e DhV.

6:59 Jezusi praktikoi judaizmin e kohës. Ai kishte mësuar në shkollën e sinagogës. Adhuronte në sinagogë dhe jepte mësim në sinagogë. Ai përmbushi të gjitha pritshmëritë e Ligjit.

Në thelb, sinagogat filluan gjatë robërisë babilonase (605-538 para K.). Judenjtë hapën vende të veçanta adhurimi dhe mësimdhënieje kudo ku kishte dhjetë burra judenj. Këto u bënë ruajtëse të kulturës dhe zakoneve judaike. Kur judenjtë u kthyen në Jude dhe në shërbesën në tempull, i ruajtën këto qendra lokale.

Në kapitullin 6 nuk na thuhet kur hyri Jezusi në sinagogën e Kapernaumit (shih v. 24).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:60-65

⁶⁰Kështu, shumë prej dishepujve të tij, pasi dëgjuan këto thanë: “Kjo është thënie e vështirë; kush është në gjendje ta dëgjojë?” ⁶¹Por Jezusi, i vetëdijshëm se dishepujt e tij po murmurisnin për këtë, u tha: “Mos kjo ju bën të pengoheni? ⁶²Po sikur të shihni Birin e Njeriut duke u ngjitur aty ku ishte më parë? ⁶³Është Fryma ai që jep jetë; mishi nuk vlen asgjë; fjalët që ju kam thënë janë frymë dhe janë jetë. ⁶⁴Por ka disa prej jush që nuk besojnë”. Sepse Jezusi e dinte që nga fillim se kush ishin ata që do të besonin, dhe kush do ta tradhtonte. ⁶⁵Dhe u thoshte: “Për këtë arsye ju thashë se askush s’vjen dot tek unë nëse nuk i është dhënë nga Ati im”.

6:60 “Kështu, shumë prej dishepujve të tij” Ky përdorim i termit “dishepull” ka kuptim të gjerë. Te Gjoni, kjo fjalë, si dhe “besoj”, përdoren si për (1) ndjekësit e vërtetë (v. 68), ashtu dhe për (2) ndjekësit e përkohshëm (v. 64, shih 8:31-47).

■ **“dëgjuan... dëgjojë”** Kjo është lojë fjalësh me “dëgjoj” (*akouō*). Ata i dëgjuan fjalët e Jezusit, por nuk i kuptuan dhe nuk vepruan në bazë të tyre. Në këtë kuptim, kjo fjalë greqisht funksionon si hebraishtja *shema* (shih LiP. 4:1; 5:1; 6:3, 4; 27:9-10).

6:62 Kjo është një FJALI e paplotë KUSHTORE E KLASIT TË PARË, pa përmbyllje. Ideja është se ata do ta shihnin vërtet këtë gjë (shih Veprat 1). Pas vdekjes/ringjalljes/ngjitjes së Jezusit dhe pas ardhjes së Frymës, shumë prej mësimeve dhe veprimeve të Jezusit do të merrnin kuptim për dishepujt.

■ **“duke u ngjitur aty ku ishte më parë”** Ky është theksimi i vazhdueshëm i faktit se Jezusi “zbriti nga qielli”. Kjo flet për paraekzistencën e tij me Atin në qiell dhe për bashkësinë e tij të ngushtë me Atin në qiell (shih 17:5, 24).

TEMË E VEÇANTË: NGJITJA NË QIELL

Ka një numër fjalësh të ndryshme greqisht që përdoren për të përshkruar ngjitjen e Jezusit sërish në qiell.

Veprat 1:2, 11, 22; *analambanō*, ngre lart (shih 1 Tim. 3:16), që përdoret edhe në Septuagint te 2 Mbret. 2:9, 11 për ngjitjen e Elisë në qiell, si dhe te Makabenjve 2:58

1. Veprat 1:9, *epairō*, ngjit, ngre lart, lartësoj
2. Luka 9:51, *analēpsis* (formë e #1)
3. Luka 24:51, *diistēmi*, largohem
4. Gjoni 6:62, *anabainō*, ngjitem

Kjo ngjarje nuk regjistrohet në ungjillin e Mateut, apo Markut. Ungjilli i Markut përfundon në 16:8, por një nga tre shtesat e mëvonshme të kopjuesve e përshkruan këtë ngjarje te 16:19 (pra, *analambanō*).

6:63 Për shkak të kontekstit më të gjerë të kapitullit 6, ky varg ndoshta ka të bëjë me kontrastin midis besëlidhjes së vjetër dhe asaj të re, midis Moisiut dhe Jezusit (shih v. 58; 2 Kor. 3:6, shih krahasimet mes dy besëlidhjeve në librin e Hebrenjve).

■ **“Është Fryma ai që jep jetë”** Kjo është një nga frazat e shumta që përdoren si për Jezusin, ashtu dhe për Frymën.

1. Fryma është ujë jetëdhënës (7:38-39)
2. Jezusi është uji i gjallë (4:10-14)
3. Fryma e Shenjtë është Fryma e së vërtetës (14:17; 15:26; 16:13)
4. Jezusi është e vërteta (14:6)
5. Fryma është parakleti (14:16, 26; 15:26; 16:7)
6. Edhe Jezusi është paraklet (1 Gjonit 2:1)

Shih Temën e Veçantë, te 14:16.

Vini re se, në këtë varg, “fryma” (*pneuma*) përdoret në dy kuptime të veçanta.

1. Fryma e Shenjtë (shih 1:32, 33; 3:34; 7:39; 14:17; 15:26; 16:13)
2. Shpirtërore (shih 4:24; 11:33; 13:21)

Te Gjoni 3:5, 6, 8, është e vështirë të dish se për cilin prej këtyre dy kuptimeve bëhet fjalë. Meqë bëhet fjalë për Gjonin, ndoshta të dyja bashkë.

TEMË E VEÇANTË: FRYMA (*PNEUMA*) NË DhR

Termi greqisht “frymë” përdoret në mënyra të ndryshme në DhR. Ja disa klasifikime dhe shembuj përfaqësues.

- A. për Perëndinë Triun
 1. për Atin (shih Gjoni 4:24)
 2. për Birin (shih Rom. 8:9-10; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11)
 3. për Frymën e Shenjtë (shih Marku 1:11; Mat. 3:16; 10:20; Gjoni 3:5,6,8; 7:39; 14:17; Veprat 2:4; 5:9; 8:29,35; Rom. 1:4; 8:11,16; 1 Kor. 2:4,10,11,13,14; 12:7)
- B. për forcën e jetës njerëzore
 1. për Jezusin (shih Marku 8:12; Gjoni 11:33,38; 13:21)
 2. për njerëzimin (shih Mat. 22:43; Veprat 7:59; 17:16; 20:22; Rom. 1:9; 8:16; 1 Kor. 2:11; 5:3-5; 7:34; 15:45; 16:18; 2 Kor. 2:13; 7:13; Fil. 4:23; Kol. 2:5)
- C. për botën shpirtërore
 1. qeniet shpirtërore
 - a. të mira (pra, engjëjt, shih Veprat 23:8-9; Heb. 1:14)
 - b. të këqija (pra, demonët, shih Mat. 8:16; 10:1; 12:43,45; Veprat 5:16; 8:7; 16:16; 19:12-21; Efe. 6:12)
 - c. fantazmat (shih Luka 24:37)
 2. dallueshmëria shpirtërore (shih Mat. 5:3; 26:41; Gjoni 3:6; 4:23; Veprat 18:25; 19:21; Rom. 2:29; 7:6; 8:4,10; 12:11; 1 Kor. 14:37)
 3. gjërat shpirtërore (shih Gjoni 6:63; Rom. 2:29; 8:2,5,9,15; 15:27; 1 Kor. 9:11; 14:12)
 4. dhuntitë shpirtërore (shih 1 Kor. 12:1; 14:1)
 5. frymëzimi i Frymës (shih Mat. 22:43; Luka 2:27; Efe. 1:17)
 6. trupi shpirtëror (shih 1 Kor. 15:44-45)
- D. Karakterizon
 1. qëndrimin e botës (shih Rom. 8:15; 11:8; 1 Kor. 2:12)
 2. procesin e mendimit të njerëzve (shih Veprat 6:10; Rom. 8:6; 1 Kor. 4:2)
- E. për sferën fizike
 1. era (shih Mat. 7:25, 27; Gjoni 3:8; Veprat 2:2)
 2. hukatja (shih Veprat 17:25; 2 Thes. 2:8)

Është e qartë se ky term duhet interpretuar në bazë të kontekstit të atypëratyshëm. Ka ngjyrimë të ndryshme kuptimore që mund t’i referohen (1) botës fizike; (2) botës së padukshme; (3) si dhe personave të kësaj bote fizike, ose të sferës shpirtërore.

Fryma e Shenjtë është ai person i Perëndisë trium që është më së tepërmi veprues në këtë fazë të historisë. Epoka e re e Frymës ka mbërritur. Gjithçka që është e mirë, e shenjtë, e drejtë dhe e vërtetë lidhet me Frymën. Prania, dhuntitë dhe shërbesa e tij janë kyçe për përhapjen e ungjillit dhe për suksesin e mbretërisë së Perëndisë (shih Gjoni 14 dhe 16). Ai dënon, bind, josh, pagëzon dhe pjek gjithë besimtarët (shih Gjoni 16:8-11).

6:64 Ky grup ndjekësish në dukje, por të rremë, reduktohet te ndjekësi i rremë – Juda (shih v. 70-71; 13:11). Pa dyshim, ekziston një mister në lidhje me nivelet e besimit.

TEMË E VEÇANTË: FEMOHIMI (*AFISTËMI*)

Ky term greqisht, *afistēmi*, ka fushë të gjerë semantike. Gjithsesi, termi anglisht “apostasy” [shqip, “femohim”] rrjedh nga ky term dhe e paragjykon përdorimin e tij në mendjen e lexuesve anglishtfolës. Si gjithmonë, konteksti është ka vlerë kyçe, dhe jo ndonjë përcaktim paraprak.

Kjo është një fjalë e përbërë nga parafjala *apo*, që do të thotë “prej” ose “larg nga” dhe *histēmi*, “ulem”, “qëndroj”, ose “ngulis”. Vini re përdorimet e mëposhtme (joteologjike):

1. heq fizikisht
 - a. nga tempulli, Luka 2:37
 - b. nga një shtëpi, Marku 13:34
 - c. nga një njeri, Marku 12:12; 14:50; Veprat 5:38

- d. nga të gjitha gjërat, Mat. 19:27, 29
2. heq politikisht, Veprat 5:37
3. heq nga ana e marrëdhënieve, Veprat 5:38; 15:38; 19:9; 22:29
4. heq ligjërisht (divorcoj), LiP. 24:1, 3 (LXX) dhe DhR, Mat. 5:31; 19:7; Marku 10:4; 1 Kor. 7:11
5. largoj një borxh, Mat. 18:27
6. tregoj moskokëçarje duke u larguar, Mat. 4:20; Gjoni 4:28; 16:32
7. tregoj preokupim duke mos u larguar, Gjoni 8:29; 14:18
8. lejoj ose jap leje, Mat. 13:30; 19:14; Marku 14:6; Luka 13:8

Në kuptimin teologjik, edhe FOLJA ka përdorim të gjerë:

1. anuloj, fal, largoj fajin e mëkatit, Eks. 32:32 (LXX); Num. 14:19; Jobi 42:10 dhe DhR, Mat. 6:12, 14-15; Marku 11:25-26
2. i qëndroj larg mëkatit, 2 Tim. 2:19
3. neglizhoj duke u larguar prej
 - a. Ligjit, Mat. 23:23; Veprat 21:21
 - b. Besimit, Ezek. 20:8 (LXX); Luka 8:13; 2 Thes. 2:3; 1 Tim. 4:1; Heb. 3:12

Besimtarët e sotëm bëjnë shumë pyetje teologjike që shkrimtarëve të DhR as nuk u kanë shkuar kurrë në mendje. Një prej këtyre lidhet me prirjen moderne për ta ndarë besimin nga besnikëria.

Ka persona në Bibël që përfshihen në popullin e Perëndisë dhe ndodh diçka.

- I. Dhiata e Vjetër
 - A. Ata që dëgjuan lajmin e dymbëdhjetë (dhjetë) spiunëve, Numrat 14 (shih Heb. 3:16-19)
 - B. Korahu, Numrat 16
 - C. Bijtë e Elit, 1 Samuelit 2, 4
 - D. Sauli, 1 Samueli 11-31
 - E. Profetët e rremë (shembuj)
 1. LiP. 13:1-5; 18:19-22 (mënyrat si të njihet profeti i rremë)
 2. Jeremia 28
 3. Ezekieli 13:1-7
 - F. Profeteshat e rreme
 1. Ezekieli 13:17
 2. Nehemia 6:14
 - G. Drejtuesit e ligj të Izraelit (shembuj)
 1. Jeremia 5:30-31; 8:1-2; 23:1-4
 2. Ezekieli 22:23-31
 3. Mikea 3:5-12
- II. Dhiata e Re
 - A. Fjalë për fjalë, ky term greqisht do të thotë “femohim”. Dhiata e Vjetër dhe ajo e Re konfirmojnë shtimin e ligësisë dhe mësimin të rremë përpara Ardhjes së Dytë (shih Mat. 24:24; Marku 13:22; Veprat 20:29,30; 2 Thes. 2:9-12; 2 Tim. 4:4). Qartazi, këta mësues të rremë nuk ishin të krishterë, por vinin nga brenda (shih Veprat 20:29-30; 1 Gjonit 2:19); megjithatë, ata janë në gjendje të joshin dhe të bëjnë për vete besimtarët e papjekur (shih Heb. 3:12).
Pyetja teologjike është kjo: a kishin qenë ndonjëherë besimtarë këta mësues të rremë? Është e vështirë t’i përgjigjemi, pasi në kishat lokale kishte mësues të rremë (shih 1 Gjonit 2:18-19). Shpesh, traditat tona teologjike ose denominacionale i përgjigjen kësaj pyetjeje pa iu referuar pasazheve të veçanta biblike (përveç metodës së “pasazhit-provë”, pra, e citimit të një vargu jashtë konteksti gjoja për të provuar anshmërinë tënde).
 - B. Besim në dukje
 1. Juda, Gjoni 17:12
 2. Simon Magjistari, Veprat 8
 3. Ata që përmenden te Mat. 7:13-23
 4. Ata që përmenden te Mateu 13; Marku 4; Luka 8
 5. Judenjtitë e Gjonit 8:31-59
 6. Aleksandri dhe Himeneu, 1 Tim. 1:19-20
 7. Ata të 1 Tim. 6:21
 8. Himeneu dhe Fileti, 2 Tim. 2:16-18

9. Dema, 2 Tim. 4:10
 10. Mësuesit e rremë, 2 Pjetri 2:19-22; Juda v. 12-19
 11. Antikrishtët, 1 Gjonit 2:18-19
- C. Besim pa fryt
1. 1 Korintasve 3:10-15
 2. 2 Pjetrit 1:8-11

Ne rrallëherë mendojmë për këto pasazhe për shkak se teologjia jonë sistematike (kalvinizëm, arminianizëm, etj.) na dikton përgjigjen e detyruar. Ju lutem, mos më paragjykoni pse po e shtroj këtë temë. Preokupimi im është procedura e saktë hermeneutike. Duhet t'i lejojmë Biblës të na flasë dhe s' duhet të përpiqemi ta fusim Biblën brenda një teologjie të paracaktuar. Shpesh, kjo është e dhimbshme dhe tronditëse për shkak se një pjesë e mirë e teologjisë sonë është denominacionale, kulturore, ose sociale (prindi, miku, pastori), jo biblike. Disa që janë Popull i Perëndisë dalin se nuk janë pjesë e Popullit të Perëndisë (p.sh., Rom. 9:6).

6:65 Kjo shpreh të njëjtën të vërtetë si v. 44. Njerëzimi i rënë nuk e kërkon Perëndinë me nismën e vet (shih Rom. 3:9-18 për një sërë citimesh nga DhV, që theksojnë mëkatën dhe rebelimin e njerëzimit).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:66-71

⁶⁶Për shkak të kësaj, shumë prej dishepujve e tij e braktisën dhe nuk ecën më me të. ⁶⁷Kështu, Jezusi u tha të dymbëdhjetëve: “S’besoj se dhe ju doni të largoheni, apo jo?” ⁶⁸Simon Pjetri iu përgjigj: “Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalët e jetës së përjetshme. ⁶⁹Ne kemi besuar dhe kemi kuptuar se ti je i Shenjti i Perëndisë”. ⁷⁰Jezusi iu përgjigj: “A nuk ju zgjodha unë vetë ju të dymbëdhjetëve? Por njëri prej jush është djall”. ⁷¹Në fakt, ai po fliste për Judën, birin e Simon Iskariotit, sepse ai, një prej të dymbëdhjetëve, do ta tradhtonte.

6:67 “të dymbëdhjetëve” Ky është përdorimi i parë te Gjoni i kësaj fjale kolektive për apostujt (shih 6:70, 71; 20:24). Shih Temën e Veçantë te 6:13.

6:68 “Simon Pjetri iu përgjigj” Pjetri është zëdhënësi i të Dymbëdhjetëve (shih Mat. 16:16). Me këtë, nuk po nënkuptohet se ata e shihnin Pjetrin si drejtuesin e tyre (shih Marku 9:34; Luka 9:46; 22:24).

▣ **“Ti ke fjalët e jetës së përjetshme”** Krishterimi është edhe (1) një e vërtetë e përmbajtur në një mesazh, “fjalët e jetës së përjetshme”, edhe (2) një e vërtetë e shprehur në një person, pra, në Jezusin. Kështu, ungjilli është edhe mesazh ,edhe person. Fjala *pistis* mund të ketë lidhje edhe me (1) një mesazh (shih Juda 3, 20), edhe me (2) një person (shih Gjoni 1:12; 3:15-16). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

6:69 “Ne kemi besuar dhe kemi kuptuar” Këto janë të dyja DËFTORE TË KRYERA VEPRORE. Këtu, shpëtimi është në KOHËN E KRYER, që nënkupton një veprim të shkuar dhe të përfunduar që tani është bërë gjendje e vazhdueshme ekzistence. Shpëtimi i vërtetë përfshin gjithë KOHËT E FOLJES në greqisht. Shih Temën e Veçantë: Kohët e Foljeve Greke që Përdoren për Shpëtimin, në 9:7.



NASB, NRSV,

NJB “Ti je i Shenjti i Perëndisë”

NKJV “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë”

TEV “Ti je i Shenjti, i cili ka ardhur nga Perëndia”

Në këtë pikë ka një problem në dorëshkrime. Teksti më i shkurtër (NASB, NRSV, NJB) mbështetet nga dorëshkrimet e lashta greke P⁷⁵, s, B, C*, D, L dhe W. Qartazi, disa kopjues të mëvonshëm futën fjalët shtesë, të marra nga rrëfimi i Martës në 11:27, ose nga ai i Pjetrit në Mat. 16:16. UBS⁴ i jep versionit më të shkurtër vlerësimin “A” (e sigurt).

Fraza “i Shenjti i Perëndisë” është titull mesianik i DhV. Aludohet në Luka 1:35 dhe Veprat 3:14. Ai është titulli me të cilin demoniaku iu drejtua Jezusit te Marku 1:24; Luka 4:34. Shih Temën e Veçantë te 1 Gjonit 2:20. Ky është një tjetër rrëfim besimi i të Dymbëdhjetëve, i ngjashëm me Mateun 16.

6:70 “A nuk ju zgjedha unë vetë” Ky është një tjetër theksim i zgjedhjes hyjnore të dishepujve (shih v. 44 dhe 65). Vini re pyetjen e Jezusit në v. 67. Zgjedhja hyjnore dhe vullneti njerëzor duhet të qëndrojnë në tension biblike. Ato janë dy anë të një marrëdhënieje besëlidhjeje.

■ **“Por njëri prej jush është djall”** Ç’thënie befasuese! Ajo nuk bën fjalë për ndonjë nga dishepujt anësore që i kthyen shpinën (shih v. 66), por për një nga dymbëdhjetë apostujt e zgjedhur, të cilët pretendonin se besonin në të. Shumë e kanë lidhur këtë me 13:2 ose 27. Ka një sërë pyetjesh për mënyrën si ta kuptojmë këtë varg: (1) pse zgjodhi Jezusi një djall? Dhe (2) Ç’kuptim ka ky term në këtë kontekst?

Pyetja e parë ka të bëjë me profecinë parashikuese (shih 17:12; Psa. 41:9). Jezusi e dinte se çfarë do të bënte Juda. Juda është shembulli absolut i mëkatit të pafalshëm. Ai mohoi Jezusin pasi e dëgjoi, e pa dhe pasi kaloi disa vite me të.

Pyetja e dytë ka dy kuptime të mundshme.

1. Disa e lidhin këtë me djallin (i përdorur pa NYJË SHQUESE për Satanin, te Veprat 13:10 dhe Zbu. 20:2), i cili hyri te juda (shih 13:2, 27)
2. Ndoshta, ky term po përdoret në mënyrë të përgjithshme (pa NYJË, si te 1 Tim. 3:11; 2 Tim. 3:3; dhe Titi 2:3).

Juda ishte akuzues në kuptimin e DhV, siç ishte dhe Satani (shih Temën e Veçantë në 12:31). Në greqisht, kjo fjalë nënkupton një përgojues ose mashtrues. Në greqisht, kjo fjalë është e përbërë: “hedh nga njëra anë në tjetrën”.

6:71 “Simon Iskarioti” Ka një sërë teorish që lidhen me këtë fjalë (ajo shkruhet ndryshe në dorëshkrime të ndryshme greke). Mund të nënkuptojë

1. një burrë nga Kerioti, një qytet i Judesë
2. një burrë nga Kartani, një qytet i Galilesë
3. çantën prej lëkure që përdorej për të transportuar paratë
4. fjalën hebraisht që do të thotë “mbys”
5. fjalën greqisht që përdoret për thikën e vrasësit

Nëse #1 është i vërtetë, Juda ishte i vetmi judeas ndër të Dymbëdhjetët. Nëse #5 është i vërtetë, ai ishte zelot, njësoj si Simoni.

Kohët e fundit, është shkruar një libër që e interpreton Judën në mënyrë pozitive. Libri titullohet *Judas, Betrayer or Friend of Jesus?* (*Juda, tradhtari apo miku i Jezusit?*), nga William Klassen, Fortress Press, 1996. Problemi im me të është se nuk i merr seriozisht komentet e ungjillit të Gjonit.

■ **“tradhtojë”** Kjo fjalë greqisht përkthehet në mënyrë të gjerë dhe në shumicën e konteksteve është neutrale. Megjithatë, në lidhje me faktin se Juda e dorëzoi Jezusin te autoritetet, ajo merr ngjyrimet e liga. Shih shënimin në 18:2.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A është Gjoni 6 një diskutim i Darkës së Zotit? Pse, ose pse jo?
2. Cili ishte pretendimi i Jezusit kur tha: “Unë jam buka e jetës”?
3. Pse po i bënte Jezusi kësaj turme pohime kaq befasuese?

GJONI 7

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mosbesimi i vëllezërve të Jezusit	Vëllezërit e Jezusit nuk besojnë	Jezusi, uji i jetës	Jezusi dhe vëllezërit e tij	Jezusi ngjitet në Jerusalemin për festën dhe jep mësim aty
7:1-9	7:1-9	7:1-9	7:1-9	7:1
Jezusi në festën e çadrave	Studiuesi qiellor		Jezusi në festivalin e Strehëve	7:2-9
7:10-13	7:10-24	7:10-13	7:10-11 7:12-13	7:10-13
7:14-24		7:14-18 7:19-24	7:14-15 7:16-19 7:20 7:21-24	7:14-24
A është Krishti ky?	Mund të jetë Krishti ky?		Mesia është ai?	Njerëzit diskutojnë për origjinën e Mesisë
7:25-31	7:25-31	7:25-31	7:25-27 7:28-29 7:30-31	7:25-27 7:28-29 7:30
Dërgohen roja për të kapur Jezusin	Jezusi dhe krerët fetarë		Dërgohen roja për të arrestuar Jezusin	Jezusi parathotë largimin e tij të afërt 7:31-34
7:32-36	7:32-36	7:32-36	7:32-34 7:35-36	7:35-36
Lumenj uji të gjallë	Premtimi i Frymës së Shenjtë		Përrenj uji jetëdhënës	Premtimi i ujit të gjallë
7:37-39	7:37-39	7:37-39	7:37-39	7:37-38 7:39
Ndasitë në popull	Kush është ai?		Ndasi në popull	Zbulime të reja për origjinën e Mesisë
7:40-44	7:40-44	7:40-44	7:40-44	7:40-44
Mosbesimi i atyre me autoritet	I mohuar nga autoritetet		Mosbesimi i autoriteteve judaike	
7:45-52	7:45-52	7:45-52	7:45 7:46 7:47-49 7:50-51 7:52	7:45-52

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË GJONIT 7:1-52

- A. Konteksti i kapitujve 5 dhe 6 është festa e Pashkës. Konteksti i 7:1 deri në 10:21 është festa e Çadrave (7:2 e më tej).
- B. Festa e Çadrave ishte, pikësëpari, falënderim për të korrat (e quajtur festa e të Vjelave, shih Eks. 23:16; 34:22). Ajo ishte dhe një kohë për të kujtuar përvojën e Daljes (e quajtur festa e Kasolleve, shih Lev. 23:29-44 dhe LiP. 16:13-15). Kjo ndodhte më 15 Tishri, që përkon me fundin e shtatorit ose fillimin e tetorit.
- C. Kapitujt 7 dhe 8 tregojnë armiqësinë e institucioneve judaike ndaj thyerjes së shabatit prej Jezusit (5:16) dhe ndaj pretendimeve të tij se ishte një me JHVH-në (5:18). Vini re sa herë përmend teksti përprjekjet e tyre
 1. për ta arrestuar, 7:30, 32, 44; 10:39
 2. për ta vrarë, 7:1, 19, 25; 8:3, 40 (shih dhe 11:53)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:1-9

¹Pas këtyre gjërave, Jezusi lëvizte në Galile, sepse nuk donte të endej në Jude ngaqë judenjtë po përpiqeshin ta vrisnin. ²Dhe festa e judenjve, ajo e Kasolleve, ishte afër. ³Kështu, vëllezërit e vet i thanë: “Largohu prej këtej dhe shko në Jude, që edhe dishepujt e tu të mund të shohin veprat që po bën. ⁴Sepse askush nuk bën gjëra në fshehtësi kur vetë kërkon të njihet botërisht. Nëse bën këto gjëra, shfaqja veten botës”. ⁵Sepe as vëllezërit e tij nuk besonin në të. ⁶Prandaj, Jezusi u tha: “Koha ime s’ka ardhur ende, por koha juaj është gjithmonë gati. ⁷Bota s’mund t’ju urrejë, por mua më urren ngaqë dëshmoj për të, se veprat e saj janë të këqija. ⁸Ngjituni vetë në festë; unë nuk do të ngjitem në këtë festë sepse koha ime s’është përmbushur ende”. ⁹Si u tha këto gjëra, qëndroi në Galile.

7:1 “Pas këtyre gjërave” Kjo është një mënyrë letrare për të kaluar më tej në rrëfim, jo një shenjë kohore (shih 5:1; 6:1; 7:1; 21:1).

▣ **“judenjtë po përpiqeshin ta vrisnin”** Te Gjoni, shpesh, fjala “judenjtë” ka ngjyrim negativ (shih 1:19; 2:18, 20; 5:10,15,16; 6:41,52; 7:1,11,13,35; 8:22,52,57; 9:18,22; 10:24,31,33; 11:8; 19:7,12; 20:19). Urrejtja dhe synimi i tyre vrastar shënohet shumë herë (shih 5:16-18; 7:19,30,44; 8:37,40,59; 10:31,33,39; 11:8,53).

7:2 “festa e judenjve, ajo e Kasolleve” Kjo quhej edhe festa e Çadrave (shih Lev. 23:34-44; LiP. 16:13-17) ngaqë, gjatë korrjeve, fshatarët jetonin në kasolle të vogla në fusha, gjë që u kujtonte judenjve përjetimin e Eksodit. Ritualit dhe liturgjia e kësaj feste siguron sfondin për mësimet e Jezusit në 7:1-10:21, siç bëri dhe festa e Pashkëve në kapitujt 5-6.

7:3 “vëllezërit e tij” Kjo është përmendja e parë e familjes së Jezusit që nga 2:12. Është e qartë se ata nuk e kuptonin motivin, metodën, apo synimin e Jezusit.

▣ **“Largohu prej këtej dhe shko në Jude”** Kjo i referohet karvanit të përvitshëm të pelegrinëve (shih Luka 2:41-44), të cilët linin Galilenë dhe rrugëtonin drejt Jerusalemit. Mos harroni se ungjilli i Gjonit përqendrohet në shërbesën e Jezusit në Jerusalem.

7:4 “botërisht” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: GUXIM (*PARRËSIA*)

Kjo fjalë greke përbëhet nga “të gjithë” (*pan*) dhe “ligjëratë” (*rhēsis*). Kjo liri ose guxim ligjërata, shpesh, kishte ngjyrimin e guximit në mes të kundërshtisë ose refuzimit (shih Gjoni 7:13; 1 Thes. 2:2).

Në shkrimet e Gjonit (e përdorur 13 herë), shpesh, ajo nënkupton një shpallje publike (shih Gjoni 7:4, si dhe në shkrimet e Palit, Kol. 2:15). Sidoqoftë, nganjëherë do të thotë thjesht “qartazi” (shih Gjoni 10:24; 11:14; 16:25, 29).

Në Veprat, apostujt flasin mesazhin për Jezusin në të njëjtën mënyrë (me guxim) si, foli dhe Jezusi për Atin dhe për planet e premtimet e tij (shih Veprat 2:29; 4:13,29,31; 9:27-28; 13:46; 14:3; 18:26; 19:8; 26:26; 28:31). Po kështu, Pali kërkoi lutje që të predikonte me guxim ungjillin (shih Efe. 6:19; 1 Thes. 2:2) dhe të jetonte ungjillin (shih Fil. 1:20).

Shpresa eskatologjike në Krishtin i dha Palit guximin dhe sigurinë që të predikonte ungjillin në këtë epokë të tanishme të ligë (shih 2 Kor. 3:11-120 Po kështu, ai kishte sigurinë se ndjekësit e Jezusit do të vepronin në të njëjtën mënyrë (shih 2 Kor. 7:4).

Kjo fjalë ka dhe një aspekt tjetër. Letra e Hebrejve e përdorur në kuptimin unik të guximit në Krishtin për t’iu afruar Perëndisë dhe për të folur me të (shih Heb. 3:6; 4:16; 10:19, 35). Besimtarët janë plotësisht të pranuar dhe të mirëpritur në marrëdhënie të ngushtë me Atin përmes Birit!

Në DhR përdoret në një sërë mënyrash.

1. bindje, guxim, ose siguri në lidhje me
 - a. njerëzit (shih Veprat 2:29; 4:13, 31; 2 Kor. 3:12; Efe. 6:19)
 - b. Perëndinë (shih 1 Gjonit 2:28; 3:21; 4:12; 5:14; Heb. 3:6; 4:16; 10:19)
2. të flasësh hapur, qartazi, dhe jo me dy kuptime (shih Marku 8:32; Gjoni 7:4, 13; 10:24; 11:14; 16:25; Veprat 28:31)
3. të flasësh botërisht (shih Gjoni 7:26; 11:54; 18:20)
4. forma e lidhur me të (*parrhēsiptomai*) përdoret për predikimin me guxim në mes të situatave të vështira (shih Veprat 18:26; 19:8; Efe. 6:20; 1 Thes. 2:2)

Në këtë kontekst, bën fjalë për sigurinë eskatologjike. Besimtarët nuk i druhen Ardhjes së Dytë të Krishtit; ata e përqafojnë me entuziazëm të sigurt, sepse banojnë në Krishtin dhe bëjnë jetë si Krishti.

▣ **“Nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit.

▣ **“shfaqja veten botës”** Jezusi shfrytëzoi përdorimin e fjalës “botë” nga ana e tyre në v. 4 dhe komentoi për të në v. 7. Bota nuk e pranonte, as e pëlqente atë, por ishte armiqësore ndaj tij (shih 15:18-19; 17:14; 1 Gjonit 3:13) sepse Jezusi zbuloi rebelimin dhe mëkatën e saj (shih 3:19-20).

Mendimi i vëllezërve për mënyrën sesi duhet të zbulonte veten Jezusi (pra, me mrekulli) ishte shumë e ndryshme nga mënyra e Jezusit (kryqi). Këtu vjen qartazi në fokus profecia e Isa. 55:8-11!

7:5 “Sepse as vëllezërit e tij nuk besonin në të” Ky është një tjetër koment redaktorial nga autori. Duhet të ketë qenë shumë e vështirë të pranoje Jezusin si Mesi kur ishte rritur në të njëjtën shtëpi me të (shih Marku 3:20-31). Jezusi i donte gjysmëvëllezërit dhe gjysmëmotrat e tij. Një nga shfaqjet e tij pas ringjalljes pati si synim që t’u zbulohet dhe atyre. Ata besuan (shih Veprat 1:14)! Jakobi u bë udhëheqësi i kishës së Jerusalemit. Po kështu, Jakobi dhe Juda shkruan libra që u përfshinë në kanonin e DhR.

7:6 “Koha ime s’ka ardhur ende” Fjala “kohë” (*kairos*) përdoret vetëm këtu (dy herë) dhe në v. 8 në ungjillin e Gjonit dhe në letrat e tij. BAGD jep tre kuptime bazë.

1. - një kohë e mirëpritur (p.sh., 2 Kor. 6:2)
- një kohë e duhur (p.sh., Luka 4:13)
- një kohë e caktuar (p.sh., Marku 13:33; Veprat 3:20; 1 Pjet. 1:11)
 2. një kohë e përshtatshme ose e favorshme
- koha e duhur (p.sh., Mat. 24:45; Luka 1:20)
- koha e përcaktuar (p.sh., Gjoni 7:8; 2 Tim. 4:6)
 3. një kohë eskatologjike (p.sh., Luka 21:8; Rom. 13:11; 1 Thes. 5:1; 2 Thes. 2:6)
- Numrat 2 dhe 3 kanë një mbivendosje semantike.

Jezusi e kuptonte misionin e vet (shih 12:23; 13:1; 17:1-5). Ekzistonte një afat kohor hyjnor kur duhet të shpaloseshin këto ngjarje të ungjillit (shih Luka 22:22; Gjoni 7:30; 8:20; Veprat 2:23; 3:18; 4:28).

7:7 “bota” Shih Temën e Veçantë: *Kosmos* në 14:17.

7:8

NASB “Ngjituni vetë në festë; unë nuk do të ngjitem në festë”

NKJV “Ngjituni ju në këtë festë. Unë s’do të ngjitem ende në këtë festë”

NRSV, NJB “Ngjituni vetë në këtë festival. Unë s’do të shkoj në këtë festival”

TEV “Ngjituni ju në festival. Unë nuk do të shkoj në këtë festival”

Një sërë dorëshkrimesh të lashta greqisht (Ⲁ, D dhe K) nuk e kanë NDAJFOLJEN “ende”. Duket se kjo ishte një përpjekje e kopjuesve për të hequr kontradiktën në dukje mes vargjeve 8 dhe 10. NDAJFOLJA përfshihet në dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, B, L, T dhe W (NKJV, The Twentieth Century New Testament, NIV).

Kjo thënie e shkurtër duhet kuptuar kështu

1. unë nuk po vij me ju (jo për synimet tuaja)
2. unë do të shkoj në mes të festës tetëditëshe (për t’u zbuluar përmes simbolizmave të festës)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:10-13

¹⁰Por vëllezërit e tij u ngjitën në festë, atëherë u ngjit dhe ai vetë, jo haptazi, por si në fshehtësi. ¹¹Kështu, judenjtë po e kërkonin në festë dhe po thoshin: “Ku është ai?” ¹²Kishte shumë murmuritje nëpër turma në lidhje me të; disa po thoshin: “Ai është njeri i mirë”; të tjerë po thoshin: “Jo, përkundrazi, ai mashtron njerëzit”. ¹³Por askush nuk fliste haptazi për të nga frika e judenjve.

7:11 “judenjtë” Në këtë kapitull ka katër grupe të veçanta që ndërveprojnë me Jezusin.

1. vëllezërit e vet
2. “judenjtë”, që nënkupton krerët fetarë
3. “turma”, që nënkupton pelegrinët që vinin për festën e Çadrave
4. “populli i Jerusalemit”, që ishin njerëzit vendas, të cilët e njihnin Sinedrin dhe planet e tyre për të vrarë Jezusin

7:12 “Kishte shumë murmuritje nëpër turma në lidhje me të” Kjo është tipike për reagimet që ngjall ungjilli në çdo turmë. Kjo tregon aftësitë dhe e ndryshme shpirtërore dhe nivelet e ndryshme të të kuptuarit që janë të pranishme brenda njerëzimit (shih 7:40-44).

■ “ai mashtron njerëzit” FOLJA *planaō* përdoret për

1. mësuesit e rremë (p.sh., Mat. 24:11; 2 Tim. 3:13; 1 Gjonit 1:8; 2:26; 3:7)
2. Mesitë e rremë (p.sh., Mat. 24:4-5,24; te Gjoni, për atë që judenjtë mendonin se ishte Jezusi (shih Gjoni 7:12,47; Mat. 27:63)
3. njerëzit që mashtrojnë veten (shih 1 Kor. 3:18; 1 Gjonit 1:8), ose
4. kur mashtrohesh (shih 1 Kor. 6:9; 15:33; Gal. 6:7; Jakobi 1:16)

Kjo fjalë përdorej për planetet që nuk ndiqnin orbitat e rregullta të yjësive. Ata quheshin “endacakë”.

7:13 “judenjtë” Gjithë kjo turmë ishte judaike. Kjo tregon qartazi përdorimi e specializuar të këtij termi nga Gjoni për të nënkuptuar krerët fetarë në Jerusalem. Shih shënimin në 7:1.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:14-18

¹⁴Por, kur ishte mes i festës, Jezusi u ngjit në tempull dhe filloi të jepte mësim. ¹⁵Atëherë, judenjtë u mahnitën dhe than: “Si është bërë i mësuar ky njeri, ndonëse s’është arsimuar kurrë?” ¹⁶Kështu, Jezusi iu përgjigj dhe tha: “Mësimi im nuk është i imi, por i atij që më dërgoi. ¹⁷Nëse dikush është i gatshëm të bëjë vullnetin e tij, do të kuptoj nëse ky mësim është nga Perëndia apo nëse unë flas nga vetja ime. ¹⁸Ai që flet nga vetja kërkon lavdinë e vet; por ai që kërkon lavdinë e atij që e dërgoi, ai është i vërteti dhe nuk ka padrejtësi në të”.

7:14 “Por, kur ishte mesi i festës” Arsyeja e saktë pse Jezusi priti deri në këtë çast është e paqartë, por mund të supozojmë se kjo u dha kohë pelegrinëve dhe njerëzve të qytetit që të diskutonin për të dhe për shërbesën e tij. Po kështu, kjo u dha kohë krerëve judenj që të zbulonin haptazi armiqësinë e tyre (shih v. 13).

■ **“jepje mësimit”** Momentet kur Jezusi flet karakterizohen nga

1. mësimdhënia, Mat 4:23; 5:2, 19; 7:29, etj.: Gjoni 6:59; 7:14, 28, 35; 8:20, 28
2. predikimi, Luka 4:18; 7:22; 9:6; 20:1

Këto duket se përdoren në mënyrë sinonimike për të nënkuptuar faktin se Jezusi po i përçonte krijimit njerëzor të vërtetat e Perëndisë. Zbulesa synonte gjithmonë që të informonte dhe të reformonte njeriun. Ajo kërkonte një vendim të shoqëruar nga ndryshimi i përparësive të jetesës. E vërteta ndryshon gjithçka!

7:15 “Si është bërë i mësuar ky njeri, ndonëse s’është arsimuar kurrë” Kjo do të thotë thjesht se ai nuk kishte shkuar në ndonjë shkollë zyrtare rabinike, dhe as nuk kishte qenë dishepull i njërit prej rabinëve të famshëm. Përdorimi i frazës “ky njeri” ka një ngjyrim mosrespektimi (shih 18:17, 29).

Shpesh, mësimi i Jezusit i habiste dëgjuesit e tij (shih Mark 7 1:21-22; Luka 4:22) për shkak të (1) përmbajtjes dhe (2) formës. Rabinët e tjerë citonin njëri-tjetrin; Jezusi pohonte se citonte Perëndinë!

7:16 Sërish, Jezusi tërheq vëmendje jo vetëm me anë të nënshtrimit të vet (shih shënimin në 5:19) ndaj Atit, por edhe me anë të njohurisë unike që kishte për Atin. Ata kishin mësues tokësorë; ai kishte Mësuesin qiellor.

7:17 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim potencial ose të mundshëm. Ky është paradoksi i ofertës së përbotshme të ungjillit (shih 1:12; 3:16) dhe sovranitetit të Perëndisë (shih 6:44, 65). Fryma duhet të hapë zemrën (shih 16:8-130).

7:18 Jezusi pohon natyrën e vet unike në dallim nga njerëzimi i rënë: (1) ai nuk kërkon lavdinë e vet; (2) ai kërkon lavdinë e Atit; (3) ai është i vërtetë; dhe (4) ai është i pamëkatë.

■ **“lavdinë e atij”** shih shënimin në 1:14.

■ **“nuk ka padrejtësi në të”** Jezusi ishte në gjendje të vdiste në vendin tonë, pasi nuk kishte nevojë të vdiste për mëkatën e vet (2 Kor. 5:21). Pamëkatshmëria e Jezusit është një çështje teologjike kyçe. Ajo shprehet shpesh dhe në mënyra të ndryshme.

1. Luka 23:41
2. Gjoni 6:69; 7:18; 8:46; 14:30
3. 2 Kor. 5:21
4. Heb. 4:15; 7:26; 9:14
5. 1 Pjet. 1:19; 2:22 (Isa. 53:9)
6. 1 Gjonit 2:29; 3:5, 7.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:19-24

¹⁹“A nuk jua ka dhënë Moisiu Ligjin, e megjithatë asnjëri prej jush nuk e zbaton Ligjin? Pse kërkonit të më vrisni?” ²⁰Turma iu përgjigj: “Ti ke demon! Kush po përpiqet të të vrasë?” ²¹Jezusi iu përgjigj: “unë bëra një vepër dhe të gjithë jeni mrekulluar. ²²Prandaj jua dha Moisiu rrethprerjen (jo se ajo është nga Moisiu, por nga etërit), dhe në shabat ju e rrethprisni njeriun. ²³Nëse dikush merr rrethprerjen në shabat, në mënyrë që Ligji i Moisiut të mos thyhet, ju zemëroheni me mua sepse shërova tërësisht një njeri në shabat? ²⁴Mos gjykoni nga dukja, por gjykoni me gjykim të drejtë”.

7:19 Konstrukti gramatikor pret përgjigjen “po”.

■ **“megjithatë asnjëri prej jush nuk e zbaton ligjin”** Kjo duhet të ketë qenë thënie tronditëse për këta judenj që po merrnin pjesë në një festë të detyrueshme në Jerusalem.

Ligji i Moisiut e ndalonte qartazi vrasjen me paramendim, mirëpo pikërisht këtë po planifikonin krerët. Vendasit e dinin këtë, por s’kishin vullnetin që t’ua ndalonin planet, apo qoftë dhe të ankoheshin.

■ **“Pse kërkonti të më vrisni”** Pyetja e v. 20 nuk bëhet nga krerët fetarë, por nga turma e pelegrinëve, të cilët nuk dinin asgjë për komplotin e vrasjes së tij. Më vonë, në v. 25, populli i Jerusalemit e dinte komplotin për të vrrarë Jezusin.

Krerët fetarë e akuzuan Jezusin edhe si njeri të demonizuar me qëllim që të justifikonin fuqinë dhe njohurinë e tij (shih Mat 9:34; 11:18; 12:24; Marku 3:22-30; Gjoni 8:48-52; 10:20-21).

7:20 “Ti ke demon” Qartazi, kushdo që takonte Jezusin e kuptonte se ai kishte fuqi shpirtërore. Pyetja ishte: nga vinte kjo fuqi? Krerët e judenjve nuk i mohonin “shenjat/mrekullitë” e Jezusit, kështu që këtë fuqi ia atribuonin Satanit dhe demonëve (shih 8:48-49, 52; 10:20).

Në këtë kontekst, turma e pelegrinëve që merrte pjesë në festën e Çadrave përdor të njëjtën frazë, por në një kuptim të ndryshëm. Ata po pohojnë se Jezusi po vepron në mënyrë të paarsyeshme dhe paranojake.

TEMË E VEÇANTË: DEMONIAKE (FRYMË E NDYRË)

- A. Popujt e lashtë ishin animistë. Ata u vishnin personalitet njerëzor forcave të natyrës, kafshëve dhe objekteve natyrore. Jeta shpjegohej përmes ndërveprimit të këtyre qenieve shpirtërore me njerëzimin.
- B. Ky personifikim u shndërrua në politeizëm (shumë perëndi). Zakonisht, demonët (*genii, xhindet*) ishin perëndi më të ulëta ose gjysmëperëndi (të mirë ose të këqinj) që ndikonin në jetën e njeriut si individ.
1. Mesopotami, kaos dhe konflikt
 2. Egjipt, rend dhe funksion
 3. Kanaan, shih W. F. Albright, *Archaeology and the Religion of Israel* [Arkeologjia dhe feja e Izraelit], botimi i pestë, f. 67-92
- C. DhV nuk flet shumë (dhe as zhvillon) për temën e perëndive më të ulëta, engjëjve, ose demonëve, ndoshta për shkak të monoteizmit të saj të rreptë (shih Eks. 8:10; 9:14; 15:11; LiP. 4:35,39; 6:4; 33:26; Psa. 35:10; 71:19; 86:8; Isa. 46:9; Jer. 10:6-7; Mik. 7:18). Gjithsesi, ajo përmend perënditë e rreme të kombeve pagane (*Shedim*, shih LiP. 32:17; Psa. 106:37), madje jep dhe emra për disa prej tyre.
1. *Se'im* (satirët ose demonët leshatakë, shih Lev. 17:7; 2 Kro. 11:15)
 2. *Lilith* (demon femër, ose joshës, shih Isa. 34:14)
 3. *Mavet* (fjalë hebraisht për vdekjen, që përdorej për perëndinë kanaanite të nënbotës, *Mot*, shih Isa. 28:15, 18; Jer. 9:21; dhe ndoshta LiP. 28:22)
 4. *Reshef* (fatkeqësi, shih LiP. 32:24; Psa. 78:48; Hab. 3:5)
 5. *Dever* (murtajë, shih Psa. 91:5-6; Hab. 3:5)
 6. *Az'azel* (emri i paqartë, por, ndoshta, demon shkretëtire ose emër vendi, shih Lev. 16:8, 10, 26) (Këta shembuj janë marrë nga *Encyclopaedia Judaica*, vëll. 5, f. 1523.)
- Gjithsesi nuk ka dualizëm apo pavarësi engjëllore nga JHVH në DhV. Satani është shërbëtor i JHVH-së (shih Jobi 1-2; Zakaria 3), jo një armik i pavarur, që e drejton vetë veten (shih A. B. Davidson, *A Theology of the Old Testament* [Teologji e Dhiatës së Vjetër], f. 300-306).
- D. Judaizmi u zhvillua gjatë robërisë babilonase (586-538 para K.). Teologjikisht, u ndikua nga dualizmi i personifikuar persian i zoroastrianizmit, me një perëndi të mirë e të lartë, të quajtur *Mazda* ose *Ormazd*, dhe një kundërshtar të lig, të quajtur *Ahriman*. Kjo lejoi brenda judaizmit të pasrobërisë dualizmin e personifikuar mes JHVH-së e engjëjve të tij dhe Satanit e engjëjve (ose demonëve) të tij.

Teologjia e ligësisë së personifikuar në judaizëm shpjegohet dhe dokumentohet më së miri nga Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah* [Jeta dhe koha e Jezus Mesisë], vëll. 2, shtojca XIII (f. 749-863) dhe XVI (f. 770-776). Judaizmi e personifikonte ligësinë në tre mënyra.

1. Satani, ose Sammaeli
2. Synimi i lig (*jecer hara*) brenda njerëzimit.
3. Engjëlli i Vdekjes

Edersheim i karakterizon këta si (1) Akuzuesi; (2) Tunduesi; dhe (3) Ndëshkuesi (vëll. 2, f. 756). Ka një dallim të madh teologjik mes judaizmit pas robërisë dhe prezantimit e shpjegimit që i bën DhR ligësisë.

E. DhR, veçanërisht në ungjijtë, pohon ekzistencën dhe kundërshtimin e qenieve të këqija shpirtërore ndaj njerëzimit dhe JHVH-së (në judaizëm, Satani ishte armik i njerëzimit, por jo i Perëndisë). Ata i kundërvihen vullnetit, sundimit dhe mbretërisë së Perëndisë.

Jezusi i kundërshtoi dhe i dëboi nga njerëzit këto qenie demoniake, të quajtura edhe (1) frymë të liga (shih Luka 4:36; 6:18), ose (20 frymë të liga (shih Luka 7:21; 8:2). Jezusi bëri qartazi dallimin mes sëmundjes (fizike dhe mendore) dhe pushtimit demoniak. Ai e demonstroi fuqinë dhe njohurinë e vet shpirtërore duke dalluar dhe dëbuar këto frymë të liga. Shpesh, ata e njihnin dhe përpiqeshin t'i drejtoheshin atij, por Jezusi ua hidhte poshtë dëshminë e tyre, kërkonte që të heshtnin dhe i dëbonte. Dëbimet janë shenjë e disfatës së mbretërisë së Satanit.

Ka një mungesë të habitshme informacioni në letrat apostolike të DhR për këtë temë. Dëbimi i demonëve nuk renditet kurrë si dhunti shpirtërore, dhe as nuk na jepet një metodologji apo procedurë për brezat e ardhshëm të predikuesve ose besimtarëve.

F. Ligësia është reale; ligësia është personale; ligësia është e pranishme. As origjina, as synimi i saj nuk na zbulohen. Bibla pohon realitetin e saj dhe kundërshton me forcë ndikimin e saj. Perëndia ka plotësisht situatën nën kontroll; ligësia mposhtet, gjykohet dhe do të shfaroset nga njerëzimi.

G. Populli i Perëndisë duhet të kundërshtojë ligësinë (shih Jakobi 4;7). Ata nuk mund të kontrollohen prej saj (shih 1 Gjonit 5:18), por mund të tundohen dhe kjo mund t'u dëmtojë dëshminë dhe ndikimin (shih Efe. 6:10-18). Ligësia është pjesë e zbuluar e pikëpamjes së të krishterit. Të krishterët e sotëm nuk kanë të drejtën të ripërcaktojnë ligësinë (çmitologjizimi i Rudolf Bultmann), të çpersonalizojnë ligësinë (strukturat shoqërore të Paul Tillich), apo të përpiqen ta shpjegojnë plotësisht me terma psikologjikë (Zigmund Frojd). Ndikimi i ligësisë është i gjerë, por ajo është mposhtur. Besimtarët duhet të ecin në fitoren e Krishtit!

7:22

NASB, NKJV “(jo se ajo është nga Moisiu, por nga etërit)”

NRSV “(sigurisht, ajo nuk është nga Moisiu, por nga Patriarkët)”

TEV “ndonëse ajo u fillua, jo nga Moisiu, por nga paraardhësit tuaj”

NJB “–jo se ajo filloi me të, por i ka fillesat te patriarku –”

Riti i rrethprerjes nuk filloi me Ligjin e Moisiut (shih Eks. 12:48; Lev. 12:3), por iu dha Abrahamit si shenjë e besëlidhjes së veçantë me JHVH-në (shih Zan. 17:9-14; 21:4; 34:22).

☐ **“dhe në shabat ju e rrethprisni njeriun”** Thelbi i argumentit të Jezusit ishte se ata ishin të gatshëm të anashkalonin rregullat e tyre për shabatin në mënyrë që të rrethprisnin foshnjat (shih *Shab* 132a; *Sabh*. 18:3; 19:1-6), por nuk pranonin të anashkalonin rregullat e tyre për shabatin që dikush të shërohej. Është domethënëse të kuptojmë se Jezusi po përdorte logjikën dhe format e mendimit të judaizmit rabinik në gjithë këtë pjesë.

7:23 **“Nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrintarit, ose për synimet e tij letrare.

☐ **“ju zemëroheni me mua sepse shërova tërësisht një njeri në shabat”** Kjo nënkupton, ose shërimin e Jezusit, të regjistruar në 5:1-9, ose ndonjë shërim të paregjistruar gjatë festës.

Fjala greke “i zemëruar” (*kholāō*) është një fjalë e rrallë, që gjendet vetëm këtu në DhR. Gjendet rrallëherë në gjithë literaturën greke (BAGD, f. 883 dhe MM, f. 689) Ajo lidhet me fjalën “vrer” (*kholē*, shih Mat. 27:34). Arsyeya pse Jezusi përdori këtë fjalë (pra, ngjyrimin e saj) është e paqartë. Ndoshta, nënkupton një “zemërim hyjnor” në kuptimin se ata mendonin se po mbronin vullnetin dhe ligjet e Perëndisë, të cilat Jezusi po i shkelte.

7:24 **“Mos gjykoni nga dukja, por gjykoni me gjykim të drejtë”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME me PJESËZËN MOHORE, që nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Ajo ndiqet nga një URDHËRORE AORISTE, që nënkupton urgjencë. Mund të jetë aludim për Isa. 11:3.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:25-31

²⁵Atëherë, disa njerëz nga Jerusalemi thanë: “A nuk është ky njeriu që po kërkonin të vrisnin?
²⁶Ja, ai po flet haptazi, dhe ata s’po i thonë asgjë. S’besoj se krerët e dinë vërtet se ky është Krishti, apo jo?”
²⁷Sidoqoftë, ne e dimë nga vjen ky njeri; por, kur të vijë Krishti, askush nuk do ta dijë nga vjen ai”.
²⁸Atëherë Jezusi bërtiti në tempull, duke mësuar dhe thënë: “Ju më njihni dhe e dini nga vij; dhe unë nuk kam ardhur nga vetja, por ai që më dërgoi mua është i vërtetë, të cilin ju nuk e njihni. ²⁹Unë e njoh atë, sepse jam prej tij, dhe ai më dërgoi”.
³⁰Kështu, ata po përpiqeshin ta kapnin; por askush nuk vuri dorë mbi të, sepse ora e tij nuk kishte ardhur ende. ³¹Por shumë nga turma besuan në të; dhe po thoshin: “Kur të vijë Krishti, s’ka për të kryer më tepër shenja se ato që bën ky njeri, apo jo?”

7:25 “A nuk është ky njeriu që po kërkonte të vrisnin” Forma gramatikore kësaj pyetje pret përgjigjen “po” (shih 5:47; 7:19). Kjo është e para e një sërë pyetjesh deri në v. 36.

7:26

NASB, REV,

NET “Ai po flet haptazi”

NKJV “Ai po flet me guxim”

NRSV, NJB “Ai po flet hapur”

Shih Temën e Veçantë: Guximi (*parrhësia*) në 7:4.

■

NASB “S’besoj se krerët e dinë vërtet se ky është Krishti, apo jo”

NKJV “Mos krerët e dinë vallë se ky është vërtet Krishti”

NRSV “Mos, ndoshta, autoritetet e dinë vërtet se ky është Mesia”

TEV “Mos, vallë, ata e dinë vërtet se ai është Mesia”

NJB “A mund të jetë e vërtetë se autoritetet kanë kuptuar që ai është Krishti”

Ky konstrukt gramatikor pret përgjigjen “jo”. Sidoqoftë, shpreh një mundësi (shih 1:31; 4:29).

7:27 “ne e dimë nga vjen ky njeri; por, kur të vijë Krishti, askush nuk do ta dijë nga vjen ai” Kjo bën fjalë për një traditë mesianike të rabinëve, e bazuar në Mal. 3:1, se Mesia do të shfaqej papritmas në tempull. Kjo gjendet në 1 Enokut 48:6 dhe IV Ezra 13:51-52.

7:28 Në këtë varg, Jezusi bën dy pohime.

1. se e kishte dërguar Perëndia (shih 3:17,34; 5:36,38; 6:29; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,18,21,23,25; 20:21)

2. se ata nuk e njihnin Perëndinë (shih 5:37,42; 8:19,27,54-55; 16:3)

Gjoni njofton se Jezusi “bërtiti” (shih 7:37; 12:44; Mat. 8:29). Jezusi ngriti zërin që ta dëgjonin. Në një kuptim, kjo funksionon në kuptimin letrar si përdorimi nistor i fjalës “Amen”, ose “Amen, amen”, nga Jezusi. Ai donte që këto pohime ironike të theksoheshin! Vargu 29 tregon problemin! Ata mendonin se ai ishte nga Galileja (shih v. 41), por, në të vërtetë, ai është nga qielli!

■ **“Ai që më dërgoi është i vërtetë”** Ati është i vërtetë (shih 3:33; 8:26; 1 Gjonit 5:20), edhe Biri është i vërtetë (shih 7:18; 8:16). Shih Temën e Veçantë në 6:55.

7:29 “Unë e njoh atë, sepse jam prej tij, dhe ai më ka dërguar” Ky është një tjetër shembull i dualizmit vertikal të Gjoni. Kjo thënie u konsiderua blasfemi nga krerët judenj dhe u vërtetoi nevojën se duhet të vrisnin Jezusin. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*) në 5:24.

7:30 “ata po përpiqeshin ta kapnin” Kjo është një FOLJE NË KOHËN E PAKRYER, që nënkupton (1) se ata filluan të përpiqeshin ta kapnin, ose (2) se po përpiqeshin vazhdimisht që ta arrestonin, por nuk donin të shkaktonin kryengritjen e pelegrinëve, të cilët besonin se ai ishte Mesia.

■ **“sepse ora e tij nuk kishte ardhur ende”** Kjo është një thënie e përsëritur profetike, e cila pohon një afat kohor hyjnor (shih 2:4; 7:6, 30; 8:20; 12:23, 27; 13:1; 17:1).

7:31 “Por shumë nga turma besuan në të” Ky ishte besimi i vërtetë në Jezusin, ndonëse ishte mbushur me keqkuptime për detyrën e tij mesianike. Askush nuk ka besim “të përsosur” (për shembull, Noeu, Abrahami, Moisiu, Davidi, të Dymbëdhjetët). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

Kjo ndodh gjithmonë kur paraqitet ungjilli. Disa besojnë, disa dyshojnë, ndërsa disa zemërohen. Këtu kemi ndërthurjen e misterit të

1. zgjedhjes hyjnore me
2. mëkatshmerinë njerëzore

Këtu kemi një mister. Unë gjithmonë tronditem nga mosbesimi kur kemi të pranishme një dritë kaq të fortë. Kjo është ndoshta fillesa e fjalëve të Jezusit se anëtarët e familjes do të ngrihen kundër njëri-tjetrit. Disave, ungjilli u sjell paqe, të tjerëve u sjell konflikte!

■ **“Kur të vijë Krishti, s’ka për të kryer më tepër shenja se ato që bën ky njeri, apo jo”** Forma gramatikore greke pret përgjigjen “jo”.

Në *A Theology of the New Testament [Teologji e Dhiatës së Re]*, George E. Ladd bën një koment interesant për përdorimin e “shenjave” për të nxitur besimin në Jezusin:

“Çështja e marrëdhënies së shenjave me besimin nuk është e lehtë, pasi të dhënat duket sikur shohin në dy drejtime të ndryshme. Nganjëherë, shenjat synohen që të çojnë në besimin te Jezusi (2:23; 6:14; 7:31; 10:42). Nga ana tjetër, ishin dhe ata që shihnin shenjat por nuk besonin (6:27; 11:47; 12:37). Për më tepër, nganjëherë, Jezusi qorton judenjtë sepse nuk besojnë nëse nuk shohin shenja (4:48; 6:30). Përgjigjja duhet gjetur në një lloj tensioni mes shenjave dhe besimit. Nevojitet besim për të rrokur kuptimin e vërtetë të shenjave dhe dëshmimin e tyre për Jezusin: për ta që s’kanë besim, shenjat janë thjesht bëma të pakuptimita. Për ata që reagojnë pozitivisht, shenjat janë mjete të vërtetimit dhe thellimit të besimit. Nga ana tjetër, veprat e Jezusit janë dëshmi e mjaftueshme për ata që janë në gjendje të shohin se çfarë po ndodh në misionin e tij. Veprat e Jezusit do të shërbejnë si mjet dënimi dhe përforcimi të njerëzve të verbër në mëkatshmerinë e tyre” (f. 274).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:32-36

³²Farisenjtë dëgjuan që turma po murmuriste këto gjëra për të, dhe krerët e priftërinjve dhe farisenjtë dërguan roja që të kapnin. ³³Atëherë, Jezusi tha: “Edhe për pak kohë do të jem me ju, pastaj do të shkoj tek ai që më dërgoi. ³⁴Do të më kërkoni, por nuk do të më gjeni; dhe aty ku do të jem unë, ju nuk mund të vini”. ³⁵Atëherë, judenjtë thanë me njëri-tjetrin: “Ku ka ndërmend të shkojë ky njeri që në të mos e gjejmë? S’besoj se ka ndërmend të shkojë në Diasporën ndër grekët, dhe të mësojë grekët, apo jo? ³⁶Çfarë është kjo thënie që bëri ai: „Do të më kërkoni, dhe nuk do të më gjeni; dhe aty ku do të jem unë, ju nuk mund të vini?”

7:32 “krerët e priftërinjve dhe farisenjtë” Bëhet fjalë për anëtarët e Sinedrit (shih Temën e Veçantë në 3:1). Kishte vetëm një kryepriest, por, që nga koha e pushtimit romak, ky ofiq ishte bërë dhuratë politike për të cilën bëhej pazar mes disa familjeve të kamura judaike, dhe transmetohej nga njëri familjar te tjetri.

■ **“dërguan roja për ta kapur”** Bëhet fjalë për “Policinë e Tempullit”, të cilët duhet të kenë qenë levitë. Ata kishin autoritet të kufizuar edhe jashtë zonës së vetë tempullit (shih 7:45, 46; 18:3, 12, 18, 22)

7:33 “Edhe për pak kohë do të jem me ju” Kjo është frazë e zakonshme te Gjoni (shih 12:35; 13:33; 14:19; 16:16-19). Jezusi e dinte kush ishte, çfarë do t’i ndodhte, dhe kur (shih 12:23; 13:1; 17:1-5).

■ **“do të shkoj tek ai që më dërgoi”** Këtu bëhet fjalë për ngjarjet përmbyllëse të misionit shpengues të Jezusit: kryqëzimi, ringjallja, ngjitja te Ati dhe rikthimi te lavdia paraekzistuese (shih 17:1-5; Veprat 1).

7:34 Kjo terminologji është shumë e ngjashme me diskutimin e Jezusit me dishepujt në dhomën e sipërme (13:33; shih 7:36 dhe 8:21). Gjithsesi, këtu ajo u referohet jobesimtarëve (pra, turmës, jerusalemasve dhe krerëve të judenjve).

7:35-36 “S’besoj se ka ndërmend të shkojë në Diasporën ndër grekët, dhe të mësojë grekët, apo jo” Konstrukti gramatikor në greqisht pret përgjigjen “jo”. Ky është një tjetër përdorim i ironisë. Kjo ka qenë gjithmonë vullneti i Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Isa. 2:2-4). Gjatë festës së Çadrave, ofroheshin shtatëdhjetë

dema për kombet e botës. Judenjtë ishin të detyruar të luteshin për johebrenjtë dhe t'u sillnin dritë atyre. Ndoshta, kjo reflekton kontekstin kulturore të kësaj thënieje. Termi “grekët” përdoret në kuptimin “johebrenjtë”. Termi *disperia* nënkuptonte popullin jude në tokat johebreje (shih Jakobi 1:1; 1 Pjet. 1:1). Ky është një tjetër shembull kur turma keqkupton gjuhën metaforike të Jezusit.

Ky është një tjetër shembull i dualizmit vertikal të Jezusit. Turma e kishte keqkuptuar ngaqë ia interpretonin në mënyrë të fjalëpërfjalshme pohimet, në vend që të përdornin kategoritë “lart” dhe “poshtë” të mësimëve të tij. Jezusi vinte nga Ati dhe do të kthehej tek ai.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:37-39

³⁷Ditën e fundit, në ditën e madhe të festës, Jezusi u ngrit dhe bërtiti, duke thënë: “Nëse ndokush është i etur, le të vijë tek unë dhe të pijë.” ³⁸Ai që beson në mua, siç thotë Shkrimi: „nga brendësia e qenies së tij do të rrjedhin lumenj uji të gjallë”. ³⁹Por këtë ai e tha për Frymën, të cilin do të merrnin ata që do të besonin në të; sepse Fryma nuk ishte dhënë ende, ngaqë Jezusi nuk ishte përlëvduar ende.

7:37 “Ditën e fundit, në ditën e madhe të festës” Ka njëfarë debati nëse kjo ishte një festë shtatëditore (shih LiP. 16:13), apo festë tetëditore (shih Lev. 23:36; Neh. 8:17; 2 Makabejve 10:60 dhe Jozefusi). Me sa duket, në kohën e Jezusit, kjo ishte festë tetëditore, megjithatë, në ditën e fundit, nuk merrej uji nga pellgu i Siloamit që të derdhej në altar siç bëhej në shtatë ditët e tjera. Për këtë ceremoni lexojmë në Traktatin Sukkah të Talmudit, që citon Isa. 12:3. Kjo mund të ketë qenë një lutje e vizualizuar për shi për të mbjellat.

▣ **“Nëse”** Kjo është një fjali KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

▣ **“ndokush është i etur”** Ftesa e përbotshme për besim në Jezusin! Shih shënimin në 7:17.

▣ **“le të vijë tek unë dhe të pijë”** Jezusi përdor të njëjtën metaforë në 4:13-15. Ndoshta, kjo i referohet Jezusit si Shkëmbi mesianik që siguronte ujë (shih 1 Kor. 10:4). Qartazi, kjo lidhet me ftesën e Isa. 55:1-3 në DhV dhe me mundësinë kulturore të derdhjes simbolike të ujit gjatë festës.

Disa dorëshkrime të lashta e të hershme greke nuk e kanë fjalën “tek unë” (shih P⁶⁶, κ^* dhe D). Por kjo fjalë përfshihet në P^{66c}, P⁷⁵, κ^c , L, T, W dhe nënkuptohet nga konteksti. UBS⁴ i jep përfshirjes së kësaj fjale vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt). Te Gjoni, njerëzit nxiten që të besojnë në të. Ungjilli ka fokus personal.

7:38 “Ai që beson në mua” Vini re se kjo është në KOHËN E TASHME. Tregon theksimin e marrëdhënies së vazhdueshme personale që nevojitet në procesin e besimit, si fjala “banoj/qëndroj” te Gjoni 15. Shih Temën e Veçantë: Kohët e foljeve greke që përdoren për shpëtimin, në 9:7.

▣ **“siç thotë Shkrimi”** Është e vështirë të gjejmë një pasazh të veçantë për këtë citim. Mund të jetë Isa. 12:3; 43:19-20; 44:3; 58:11; Ezek. 47:1; Joeli 3:18; Zak. 13:1; ose 14:8, të cilat përmendin në mënyrë metaforike ujin eskatologjik si simbol të pranisë së Perëndisë. Në këtë rast, uji i premtuar i epokës së re të bekimit bujqësore ndryshohet për t'u bërë metaforë e natyrës së brendshme të besëlidhjes së re. Fryma do të jetë veprues në zemër dhe në mendje (shih Ezek. 36:27-38).

▣ **“nga brendësia e qenies së tij do të rrjedhin lumenj uji të gjallë”** Ka patur disa teori se kujt i referohet PËRËMËRI “së tij”.

1. Vetë Jezusit (shih etërit e hershëm të kishës)
2. Besimtarëve si individë, që kanë besuar në Krishtin.
3. Jerusalemit. Në aramaisht, “e tij” mund të ketë edhe kuptimin “i saj” dhe mund t'i referohet qytetit (ky ishte pozicioni i rabinëve, shih Ezek. 47:1-12 dhe Zak. 14:8)

Ekziston një diskutim i mirë, i shkurtër dhe i thjeshtëzuar i dy teorive, në bazë të mënyrës sesi e pikëzojmë v. 37b dhe 38a, te NIDOTTE, vëll. 1, f. 683.

Jezusi e ka quajtur veten “uji i gjallë” (shih 4:10). Tani, në këtë kontekst, ai që siguron dhe prodhon ujin e gjallë në ndjekësit e Jezusit është Fryma e Shenjtë (shih v. 39). Kjo është paralel me veprën e Frymës në formimin e Krishtit të besimtari (shih Rom. 8:29; Gal. 4:19; Efe. 4:13).

7:39 “sepse Fryma nuk ishte dhënë ende, ngaqë Jezusi nuk ishte përlëvduar ende” Me sa duket, kjo reflekton mendimin e mëvonshëm të Gjoni (pra, është një koment redaktorial) për domethënien e këtij pohimi (shih 16:7).

Po kështu, ajo tregon domethënien e Kalvarit dhe Rrëshajave si “lavdi” (shih Gjoni 3:14; 12:16, 23; 17:1, 5). Ka një sërë variantesh kopjuesish që përpiqen të shpjegojnë se ç’ nënkuptonte Gjoni me këtë thënie të shkurtër.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:40-44

⁴⁰Prandaj, disa nga njerëzit, kur dëgjuan këto fjalë, thanë: “Ky është patjetër Profeti”. ⁴¹Disa të tjerë po thoshin: “Ky është Krishti”. Kishte dhe të tjerë që po thoshin: “Pa dyshim, Krishti nuk do të vijë nga Galileja, apo jo?” ⁴²A nuk ka thënë Shkrimi se Krishti vjen nga pasardhësit e Davidit, dhe nga Betlehemi, fshati i Davidit?” ⁴³Kështu, pati përçarje në turmë për shkak të tij. ⁴⁴Disa prej tyre donin që ta kapnin, por askush s’vuri dorë mbi të.

7:40 “Ky është patjetër Profeti” Ky është aludim për premtimin mesianik të Moisiut, që gjendet në LiP. 18:15, 18. Shumë e pranuan Jezusin si profet (shih 4:19; 6:14; 9:17; Mat. 21:11). Ata e kuptonin fuqinë e Jezusit, por ia keqkuptonin personalitetin dhe veprën. Edhe Islami e përdor këtë titull për Jezusin, por ia keqkupton mesazhin.

7:41 “Të tjerë po thoshin: „Ky është Krishti” Kjo tregon se termi “Krisht” është i njëjtë me termin hebraisht “Mesia”, që do të thotë “i vajosur”. Në DhV, mbretërit, priftërinjtë dhe profetët vajoseshin si shenjë e thirrjes dhe pajisjes së Perëndisë. Shih Temën e Veçantë: Vajosja në Bibël, në 11:2.

■ **“Kishte dhe të tjerë që po thoshin: „Pa dyshim, Krishti nuk do të vijë nga Galileja, apo jo”** Ky konstrukt gramatikor në greqisht pret përgjigjen “jo” për këtë pyetje. Po Isa. 9:1?

7:42 Konstrukti gramatikor i kësaj pyetjeje pret përgjigjen “po”.

■ **“pasardhës i Davidit”** (shih 2 Samueli 7; Mat. 21:9; 22:42).

■ **“nga Betlehemi, fshati i Davidit”** Ky është një tjetër përdorim i ironisë (shih Mikea 5:2-3 dhe Mat. 2:5-6).

7:43 Jezusi dhe mesazhi i tij gjithmonë shkaktonin përçarje (shih 7:48-52; 9:16; 10:19; Mat. 10:34-39; Luka 12:51-53). Ky është misteri i shëmbëlltyrës së mbjellësit dhe farës (shih Mat. 13). Disa kanë veshë shpirtërorë, ndërsa disa të tjerë, jo (shih Mat. 10:27; 11:15; 13:9, 15 (dy herë), 16, 43; Marku 4:9, 23; 7:16; 8:18; Luka 8:8; 14:35).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:45-52

⁴⁵Atëherë, rojat erdhën te krerët e priftërinjve dhe farisenjtë, dhe u thanë: “Pse nuk e sollët?” ⁴⁶Rojat u përgjigjën: “Kurrë nuk ka folur dikush siç flet ky njeri”. ⁴⁷Atëherë, farisenjtë iu përgjigjën: “Mos jeni mashtruar dhe ju? ⁴⁸Asnjë nga krerët apo farisenjtë s’ka besuar në të, apo jo? ⁴⁹Por kjo turmë, që nuk njuh Ligjin, është e mallkuar”. ⁵⁰Nikodemi (ai që kishte shkuar te Jezusi më parë, dhe ishte njëri prej tyre) u tha: ⁵¹“Ligji ynë nuk gjykon një njeri pa dëgjuar më parë atë vetë që të mësojë se çfarë po bën ai, apo jo?” ⁵²Ata iu përgjigjën: “Mos je dhe ti nga Galileja? Heto dhe do të shohësh se nga Galileja nuk del asnjë profet”.

7:46 “Rojat u përgjigjën: „Kurrë nuk ka folur dikush siç flet ky njeri” Sërish, ironia e Gjonit! Kjo është një dëshmi shumë befasuese.

1. ata nuk përmendën frikën që patën nga turma, gjë që do të kishte qenë justifikim i mirë për ta
2. këta policë të tempullit ishin njëzëri në mendimin e tyre për Jezusin, ndërsa turma ishte e përçarë
3. këta burra ishin mësuar të zbatonin urdhrat, jo të jepnin mendime.

7:48 “Asnjë nga krerët apo farisenjtë s’ka besuar në të, apo jo” Konstrukti gramatikor greqisht, si në v. 47 ashtu dhe në v. 48, pret përgjigjen “jo”. Termi “krerët” nënkupton Sinedrin. Këtu shohim saducenjtë dhe farisenjtë (gjithë Sinedri), të cilët normalisht ishin armiqësorë me njëri-tjetrin, që bashkohen në kundërshtimin e tyre ndaj Jezusit (shih 11:47, 57; 18:3).

7:49 “Por kjo turmë, që nuk njuh Ligjin, është e mallkuar” Kjo bën fjalë për “popullin e vendit” ((‘*am hā’ārec*), të cilët shiheshin me nënçmim nga krerët fetarë pasi nuk kryenin gjithë Traditat Gojore (shih LiP.

27:26). Ironia e Gjonit vazhdon të shihet në v. 51, ku Nikodemi u ven ë dukje se ata po shkelnin Ligjin me trajtimin që po i bënin Jezusit.

O, tragjedia e fetarisë! Pikërisht ata që mallkojnë (*eparatos*, që gjendet vetëm këtu në DhR) popullin e thjeshtë janë vetë të mallkuar! Nëse drita bëhet errësirë, sa e madhe është kjo errësirë! Kujdes, ju fetaristë modernë, konservatorë dhe të arsimuar!

7:51 “Ligji ynë nuk gjykon një njeri pa dëgjuar më parë atë vetë që të mësojë se çfarë po bën ai, apo jo”
Konstrukti gramatikor greqisht pret përgjigjen “jo” (shih Eks. 23:1; LiP. 1:16).

7:52 “Mos je dhe ti nga Galilea” Kjo tregon kundërshtimin emocional të Sinedrit ndaj Jezusit.

▣ **“Heto dhe do të shohësh”** Në judaizëm, “heto” nënkuptonte studimin e Shkrimit (shih 5:39). Sërish, kjo tregon përdorim ironie nga ana e Gjonit. Po Elija (shih 1 Mbret. 17:1), Jona (shih 2 Mbret. 14:25), Osea dhe Nahumi? Ata duhet të kenë patur ndërmend PROFETIN e LiP. 18:15, 19; Zan. 49:10; 2 Samueli 7.

7:53-8:11 Shih shënimin në fillim të kapitullit 8.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Cili ishte sfondi i festivalit në fjalët e Jezusit në kapitullin 7?
2. Përshkruaj dhe shpjego synimin e “festës së Çadrave”.
3. Pse ishin kaq armiqësorë me Jezusin krerët fetarë?
4. Rendit grupet e ndryshme që flasin për Jezusin në këtë kapitull.

GJONI 8

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Gruaja e kapur në kurorëshkelje	Kurorëshkelësja përballat me Dritën e botës	Gruaja e kapur në kurorëshkelje	Gruaja e kapur në kurorëshkelje	Gruaja kurorëshkelëse
7:53-8:11	7:53-8:12	7:53-8:11	7:53-8:11	7:53-8:11
Jezusi, Drita e botës	Jezusi mbron dëshminë për veten	Jezusi, Drita e botës	Jezusi, Drita e botës	Jezusi, Drita e botës
8:12-20		8:12-20	8:12	8:12
				Një diskutim për dëshminë e Jezusit për veten
	8:13-20		8:13	8:13-18
			8:14-18	
			8:19a	8:19a
			8:19b	8:19b
			8:20	8:20
Aty ku po shkoj unë, ju s'mund të vini	Jezusi parathotë largimin e tij		Ju s'mund të vini aty ku po shkoj unë	
8:21-30	8:21-29	8:21-30	8:21	8:21
			8:22	8:22-24
			8:23-24	
			8:25a	8:25a
			8:25b-26	8:25b-26
	E vërteta do t'ju çlirojë		8:27-29	8:27-29
	8:30-36		8:30	8:30
E vërteta do t'ju çlirojë			E vërteta do t'ju çlirojë	Jezusi dhe Abrahami
8:31-38		8:31-33	8:31-32	8:31-32
			8:33	8:33-38
	Fara e Abrahamit dhe Satani	8:34-38	8:34-38	
Ati juaj, djalli	8:37-47			
8:39-47		8:39-47	8:39a	8:39-41a
			8:39b-41a	
			8:41b	8:41b-47
			8:42-47	
Përpara se të ishte Abrahami, unë jam	Përpara se të ishte Abrahami, unë jam		Jezusi dhe Abrahami	
8:48-59	8:48-59	8:48-59	8:48	8:48-51
			8:49-51	
			8:52-53	8:52-56
			8:54-56	
			8:57	8:57-58
			8:58	
			8:59	8:59

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

SFONDI TEKSTUAL I 7:53-8:11

- A. Gjoni 7:53-8:11 nuk ishte pjesë origjinale e ungjillit të Gjonit.
- B. Të dhënat për mospërfshirjen e këtij pasazhi (një fjali në greqisht) në ungjilli janë
 1. Të dhënat e jashtme
 - a. mungon në dorëshkrimet më të vjetra greke
 - 1) papiruset – P⁶⁵ (fillimshekulli i tretë), P⁷⁵ (shekulli i tretë)
 - 2) uncialët (me shkronja të mëdha) – Ⲙ (shekulli i katërt), B (shekulli i katërt), ndoshta mungon në A dhe C. Këto janë dëmtuar në këtë ikë të Gjonit, por kur maten fletët e mbijetuara të dorëshkrimit, nuk ka vend për këtë pasazh.
 - b. shumë prej dorëshkrimeve të mëvonshme greke që e përfshijnë këtë pjesë, e shënojnë me një shenjë ose simbol të veçantë, si asterisku, për të treguar se nuk ishte origjinale.
 - c. gjendet në vendndodhje të ndryshme në dorëshkrime të ndryshme të mëvonshme
 - 1) pas Gjonit 7:36
 - 2) pas Gjonit 7:44
 - 3) pas Gjonit 7:25
 - 4) te Luka, pas 21:38
 - 5) te Luka, pas 24:53
 - d. mungon në dorëshkrimet e lashta
 - 1) përkthimi i vjetër latin
 - 2) përkthimi i vjetër siriak
 - 3) kopjet e vjetra të Peshitës (siriakja e mëvonshme)
 - e. asnjë nga etërit grekë të kishës (deri në shekullin e dymbëdhjetë) nuk komenton fare për këtë pasazh
 - f. është i pranishëm në kodikun D (Beza), një dorëshkrim perëndimor i shekullit të gjashtë, në Vulgatën latine dhe në botimet e mëvonshme të Peshitës.
 2. Të dhënat e brendshme
 - a. fjalori dhe stili i kësaj pjese i ngjan më tepër Lukës se Gjonit. Në disa dorëshkrime greke ishte vendosur pas Lukës 21:38 dhe, në disa të tjera, pas Lukës 24:53.
 - b. ajo e ndërpret plotësisht kontekstin e diskutimit të Jezusit me krerët judenj pas festës së Çadrave, 7:1-52; 8:12-59.
 - c. nuk ka paralele me ungjijtë sinoptikë
 3. për një diskutim të plotë teknik, shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 219-221.
- C. Ky rrëfim mund të jetë një traditë e vërtetë gojore nga jeta e Jezusit. Sidoqoftë, ka shumë rrëfime nga jeta e Jezusit që shkruesit e ungjijve nuk zgjodhën t'ri regjistrin (Gjoni 20:30-31). Ata që ishin të frymëzuar ishin vetë shkruesit e ungjijve. Kopjuesit e mëvonshëm nuk kishin të drejtë të përfshinin një rrëfim të jetës së Jezusit, edhe sikur të ishte i vërtetë, që nuk ishte përfshirë nga autori i frymëzuar origjinal. Vetëm autorët fillestarë kishin njohurinë, nën udhëheqjen e Frymës së Shenjtë, për të

përzgjedhur, renditur dhe përshtatur veprat dhe fjalët e Jezusit. Ky pasazh nuk është origjinal, prandaj, nuk është i frymëzuar dhe nuk duhet përfshirë në Bibël!

- D. Kam vendosur të mos komentoj për këtë pasazh, pasi nuk besoj se vjen nga pena e Gjonit dhe, si rrjedhojë, nuk është pjesë e tekstit të frymëzuar (edhe sikur të jetë historik).

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:12-20

¹²Atëherë, Jezusi u foli sërish dhe tha: “Unë jam Drita e botës; ai që më ndjek mua nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë Dritën e jetës”. ¹³Kështu, farisenjtë i thanë: “Ti po dëshmon për veten; dëshmia jote nuk është e vërtetë”. ¹⁴Jezusi u përgjigj dhe u tha: “Edhe nëse dëshmoj për vete, dëshmia ime është e vërtetë, sepse unë e di nga erdha dhe ku po shkoj; por ju nuk e dini nga vij dhe as ku po shkoj. ¹⁵Ju gjykoni sipas mishit; unë nuk po gjykoj askënd. ¹⁶Por, edhe nëse gjykoj, gjykimi im është i vërtetë; sepse unë nuk jam i vetëm për të, por jam unë dhe Ati që më dërgoi. ¹⁷Edhe në ligjin tuaj është shkruar se dëshmia e dy vetëve është e vërtetë. ¹⁸Unë jam ai që dëshmon për vetveten dhe Ati që më dërgoi dëshmon për mua”. ¹⁹Kështu, ata i thanë: “Kush është Ati yt?” Jezusi u përgjigj: “Ju nuk më njihni, as mua, as Atin tim; nëse do të më njihnit, do të njihnit dhe Atin tim”. ²⁰Këto fjalë ai i tha në vendin e thesarit, ndërsa jepte mësim në tempull; dhe askush nuk e kapi, sepse ora e tij s’kishte ardhur ende.

8:12 “Atëherë, Jezusi u foli sërish” “Turma” nuk përmendet në këtë kapitull. Ndoshta, festa e Çadrave kishte mbaruar dhe Jezusi mbeti në zonën e tempullit duke u përpjekur të arsyetonte me krerët e judenjve dhe t’u dëshmonte.

Megjithatë, ashtu siç kishte përdorur ceremoninë e ujit të festës për t’u zbuluar atyre, në këtë pjesë Jezusi përdor ceremoninë e ndriçimit të festës për t’u zbuluar. Është patjetër e mundshme që 8:12-10:21 të jetë vendosur në ditën e fundit të festës së Çadrave (Kasolleve).

■ **“Unë jam Drita”** Kapitujt 6, 7 dhe 8 duket se lidhen periudhën e “endjes në shkretëtirë” në historinë e Izraelit, burimi i metaforave që Jezusi përdor për veten.

1. kapitulli 6 përdor “mana” dhe “buka e jetës”.
2. kapitulli 7 përdor “ujë” dhe “uji i gjallë”
3. kapitulli 8 përdor “dritë” dhe “lavdia e *Shekinas*”.

Kjo metaforë e dritës përsëritet gjatë gjithë Gjonit (shih 1:4-5, 8-9; 3:19-21; 9:5; 12:46).

Ka patur njëfarë debati për kuptimin e saktë të kësaj.

1. frika e lashtë nga errësira
2. titull i Perëndisë në DhV (shih Psa. 27:1; Isa. 60:20; 1 Gjonit 1:5)
3. sfondi i festës së Çadrave, ndezja e shandanit me qirinj në Oborin e Grave
4. aludim për renë e lavdisë *Shekina* në periudhën e endjes në shkretëtirë, që simbolizonte praninë e Perëndisë
5. titujt mesianikë në DhV (shih Isa. 42:6; 49:6; Luka 2:32).

Rabinët përdornin edhe “dritën” si titull për Mesinë. Qartazi, ndezja e fenerëve të mëdhenj në Oborin e Grave gjatë festës së Çadrave është konteksti i thënies së Jezusit. Domethëniet mesianike të dritës dhe përmendjet e veçanta në 1:4, 8 përkohë me ceremoninë në tempull; kështu, Jezusi vazhdon të zbulojë origjinën e vet të vërtetë.

Kjo është një nga shtatë thëniet me “unë jam” në ungjillin e Gjonit (e ndjekur nga një kallëzor)

1. Unë jam Buka e jetës (6:35, 41, 48, 51)
2. Unë jam Drita e botës (8:12; 9:5; shih dhe 1:4, 9; 12:46)
3. Unë jam dera e dhenve (10:7, 9)
4. Unë jam bariu i mirë (10:11, 14)
5. Unë jam ringjallja dhe jeta (11:25)
6. Unë jam udha, e vërteta dhe jeta (14:6)
7. Unë jam hardhia e vërtetë (15:1, 5)

Këto thënie unike, që gjenden vetëm te Gjoni, tregojnë drejt personit të Jezusit. Gjoni fokusohet në këto aspekte personale të shpëtimit. Ne duhet t’i besojmë Jezusit!

■ **“e botës”** Ky term (*kosmos*, shih Temën e Veçantë në 14:17) tregon gamën e përbotshme të ungjillit të Jezu Krishtit (shih 3:16).

■ **“ai që më ndjek mua”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE. Duhet të mos harrojmë se krishterimi nuk është pikësëpari një kredo, apo një teologji, por është një marrëdhënie personale e ndjekur nga një stil jetese dishepullizimi (shih Mat. 28:18-20; 1 Gjonit 1:7).

■ **“nuk do të ecë në errësirë”** Ky është aludim për konceptin teologjik se Satani “ka verbuar sytë e të pashpenzuarve” (shih 2 kor. 4:4). Më tej, ky është aludim për ato pasazhe të DhV që flasin për fjalën e Perëndisë si “kandil për këmbën time dhe dritë për shtegun tim” (shih Psa. 119:105).

Ata që pranojnë “Dritën” duhet të bëjnë jetë ndryshe (shih 1 Gjonit 1:7)!

■ **“Drita e jetës”** Jezusi zotëron jetën e Perëndisë dhe ua jep ndjekësve të vet (shih Mat. 5:14), atyre që i ka dhënë Perëndia.

8:13 “Farisenjtë” Shih Temën e Veçantë në 1:24.

■ **“dëshmia jote nuk është e vërtetë”** Judenjtë po përdornin teknikalitetin ligjor të provave (pra, kërkesa për dy dëshmitarë, shih Num. 35:30; LiP. 17:6; 19:15-21). Jezusi kishte folur më herët pikërisht për këtë kundërshtim (shih Gjoni 5:31 e më tej) dhe kishte dhënë një sërë dëshmitarësh. Në këtë kontekst, dëshmitari i tij është Ati!

8:14, 16 “nëse... nëse” Këto janë të dyja janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkuptojnë një veprim të mundshëm. Shumica e kushteve deri në kapitullin 8 janë të këtij lloji.

■ **“unë e di nga erdha dhe ku po shkoj”** Sërish, ky është dualizmi “lart dhe poshtë”. Jezusit i kujtohej në mënyrë të vetëdijshme paraekzistenca e vet me Atin, e kuptonte misionin e vet, si dhe kuptonte afatet profetike (shih Gjoni 1:1-4, 14-18; 7:28-29; 13:1; 17:5).

■ **“por ju nuk e dini nga vij, as se ku po shkoj”** Kjo duhet lidhur me kapitullin 7. Ata nuk e dinin vendlindjen e Jezusit (shih v. 41-42), dhe as se ku po shkonte ai (shih 7:34-36; 8:21). Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në 1:8.

8:15 “Ju gjykoni sipas mishit” Edhe ky është aludim për kapitullin 7 (shih v. 240). Shih Temën e Veçantë: Mish (*sarks*) në 1:14.

■ **“unë nuk po gjykoj askënd”** Disa shohin një kundërthënie këtu midis Gjonit 3:17 dhe 9:39. Jezusi nuk erdhi për të gjykuar, por për të dhënë jetë. Por, nga vetë fakti i ardhjes së tij, ata që e refuzojnë Jezusin janë të gjykuar (shih 3:18-21).

8:16-18 Sërish, kjo ishte çështja e nevojës për dy dëshmitarë në një çështje gjyqësore (shih Num. 35:30; LiP. 17:6; 19:15). Në mënyrë të qartë, Jezusi pohon se është një me Atin (shih 7:29; 14:9). Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në 1:8.

8:16

NASB (1970),

NJB, REB “ai që më dërgoi”

NASB (1995),

NKJV, NRSV,

NIV

“Ati që më dërgoi”

Ashtu si ka mospërputhje mes dy botimeve të NASB, ka mospërputhje edhe midis UBS^{3,4}

1. UBS³ i jep “Atit” vlerësimin “C” (dorëshkrimet P^{39,66,75}, N², B, L, T, W)

2. UBS⁴ i jep “Atit” vlerësimin “A” (dorëshkrimet N*, D dhe disa versione të vjetra latine dhe siriane nuk e përmbajnë)

Jezusi nuk është kurrë vetëm! Ati është gjithmonë me të (shih v. 16, 29; 16:32), ndoshta me përjashtim të kryqit (shih Marku 15:34).

Gëzimi dhe përmbushja e bashkësisë është thelbi i shpëtimit. Synimi i krijimit ishte që Perëndia që kishte dikë me të cilin të kishte bashkësi, prandaj ai (pra, Krishti, shih Gjn. 1:3; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2) i krijoi ata në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e JHVH-së (shih Zan. 1:26, 27). Kjo humbje bashkësie është ndëshkimi për mëkatin. Rikthimi i saj është synimi i misionit të Jezusit!

8:19 “Ku është Ati yt” Ata ende po e kuptonin Jezusin në nivelin fizik dhe të fjalëpërfjalshëm. Mendja e tyre, plot paragjykime dhe krenari, ishte e mbyllur ndaj së vërtetës (shih v. 27). Ky keqkuptim është një karakteristikë letrare e ungjillit të Gjonit.

■ **“nëse do të më njihnit, do të njihnit dhe Atin tim”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË. Shpesh, ajo quhet “në kundërshtim me fakte”. “Nëse do të më njihnit mua, gjë që nuk e bëni, atëherë do të njihnit dhe Atin tim, gjë që nuk e bëni”. Ky motiv përsëritet nga 5:37, shih shënimin e plotë në 7:28. Është e vështirë të përvijosh ungjillin e Gjonit pikërisht për shkak se është si tapiceri me motive të përsëritura, ose si simfoni me melodi të përsëritura.

8:20 “i tha në vendin e thesarit” Me sa duket, ky varg është një tjetër koment redaktorial nga një dëshmitar okular. Vendi i thesarit nuk ishte godinë më vete. Tradita rabinike (*Shekalim* 6) thotë se kishte trembëdhjetë enë me formë trumbete, secila e shënuar për një qëllim të veçantë, dhe ndodheshin në Oborrin e Grave (shih Marku 12:41), ku ndizeshin kandilat e mëdhenj gjatë festës së Çadrave.

■ **“ora e tij nuk kishte ardhur ende”** Shih shënimin në 2:4.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:21-30

²¹Pastaj, u tha sërish: “Unë po shkoj, dhe ju do të më kërkoni, dhe do të vdisni në mëkatin tuaj; aty ku po shkoj unë, ju s’mund të vini”. ²²Kështu, judenjtë po thoshin: “Me siguri ky do të vrasë veten, apo jo, pasi po thotë „Aty ku po shkoj unë, ju s’mund të vini?” ²³Dhe po u thoshte: “Ju jeni nga poshtë, unë jam nga lart; ju jeni të kësaj bote, unë nuk jam i kësaj bote. ²⁴Prandaj ju thashë se do të vdisni në mëkatet tuaja; sepse, nëse nuk besoni se unë jam ai, do të vdisni në mëkatet tuaja”. ²⁵Kështu, ata i thanë: “Kush je ti?” Jezusi u tha: “Çfarë ju kam thënë që nga fillimi? ²⁶Kam shumë gjëra për të thënë dhe për të gjykuar në lidhje me ju, por ai që më dërgoi është i vërtetë; dhe gjërat që kam dëgjuar prej tij, këto ia them botës”. ²⁷Ata nuk e kuptonin se ai po u fliste për Atin. ²⁸Prandaj, Jezusi tha: “Kur të keni lartuar Birin e Njeriut, atëherë do të dini se unë jam ai, dhe se nuk bëj asgjë me nismën time, por këto gjëra i them siç m’i mësoi Ati. ²⁹Dhe ai që më dërgoi është me mua; ai nuk më ka lënë të vetëm, sepse unë bëj gjithmonë gjërat që e kënaqin”. ³⁰Teksa thoshte këto gjëra, shumë besuan në të.

8:21-22 “aty ku po shkoj unë, ju s’mund të vini... Me siguri ky do të vrasë veten, apo jo” Pyetja e v. 22 pret përgjigjen “jo”. Nga konteksti, është e qartë se, ndonëse ia keqkuptuan thënien Jezusit (shih 7:34-36), ata e lidhën me vdekjen e tij. Nga Jozefusi mësojmë se vetëvrasja e dënonte njeriun në pjesët më të ulëta të Hadesit. Me sa duket, pyetja e tyre tregon se mendonin se aty e kishte vendin Jezusi.

8:21 “dhe do të vdisni në mëkatin tuaj” Fjalë për fjalë, “në mëkatin tuaj, ju do të vdisni”. Termi “mëkat” është NJËJËS në v. 21 dhe SHUMËS në v. 24. Pikësëpari, kjo lidhet me refuzimin e tyre të Jezusit si Krishtit (shih v. 24). Në fakt, ky është mëkati i pafalshëm i ungjijve sinoptikë. Krerët e tyre po mohonin Jezusin ndonëse ishin në praninë e dritës madhështore të fjalëve dhe shenjave të tij.

Shih shënimet e mëposhtme nga komentari im për Markun.

Marku 3:29 “kushdo që blasfemon kundër Frymës së Shenjtë” Kjo duhet kuptuar në kontekstin e vet historik para Rrëshajave. Përdorej në kuptimin e refuzimit të së vërtetës së Perëndisë. Mësimi i këtij vargu është quajtur rëndom “mëkati i pafalshëm”. Duhet interpretuar në dritën e kriterëve të mëposhtme:

1. dallimi në DhV midis “mëkateve të qëllimshme” dhe “të paqëllimshme” (shih Num. 15:27-31)
2. mosbesimi i vetë familjes së Jezusit i kontrastuar me mosbesimin e farisenjve në këtë kontekst
3. thëniet për faljen në v. 28
4. dallimet mes paraleleve të ungjijve, sidomos ndryshimi i “birit ë njeriut” (shih Mat. 12:32; Luka 12:10) në “bijtë e njerëzve” (shih Mat. 12:31; Marku 3:28).

Në dritën e sa më lart, ky mëkat kryhet nga ata që, në prani të dritës dhe njohurisë së madhe, prapëseprapë e refuzojnë Jezusin si mjeti i zbulesës dhe shpëtimit të Perëndisë. Ata e kthejnë dritën e ungjillit në errësirën e Satanit (shih Marku 3:30). Refuzojnë tërheqjen dhe bindjen e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Mëkati i pafalshëm nuk është refuzim nga Perëndia për shkak të ndonjë veprimi apo fjale të vetme, por si pasojë e refuzimit të vazhdueshëm dhe të pandalshëm të Perëndisë në Krishtin me anë të mosbesimit kokëfortë (p.sh., skribët dhe farisenjtë).

Ky mëkat mund të kryhet vetëm nga ata që janë ekspozuar ndaj ungjillit. Ata që kanë dëgjuar mesazhin për Jezusin janë qartazi më përgjegjësit për refuzimin e tij. Kjo është veçanërisht e vërtetë për kulturat moderne që kanë akses të vazhdueshëm në ungjillin, por nuk e pranojnë Jezusin (p.sh., Amerika, kultura perëndimore).

8:23 “Ju jeni nga poshtë; unë jam nga lart” Ky është një tjetër shembull i dualizmit vertikal të Gjonit (pra, lart/poshtë, shih 7:35-36; 18:36).

Kontrasti që i bën Gjoni Jezusit që është nga lart dhe judenjve që janë në poshtë, formon një dualizëm që është unik në ungjijtë. Ungjijtë sinoptikë (Mateu, Marku, Luka) bëjnë përballjen mes dy epokave judaike, epokës së tashme të ligë dhe epokës së ardhshme të drejtësisë. Ky dallim përshkruhet me anë të dualizmit horizontal dhe atij vertikal. A i mësoi këto të dyja Jezusi në kontekste të ndryshme? Ka mundësi që sinoptikët të kenë regjistruar mësimet publike të Jezusit, ndërsa Gjoni mësimet private të Jezusit për dishepujt.

▣ **“ju jeni të kësaj bote”** Bota gjendet nën pushtetin e të Ligut (shih 2 Kor. 4:4; Efe. 2:2; dhe 1 Gjonit 5:19). Për botën (*kosmos*) shih Temën e Veçantë në 14:17.

8:24 “nëse nuk” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

▣

NASB, NKJV **“besoni se unë jam ai”**

NRSV, JB **“besoni se unë jam ai”**

TEV **“besoni se „Unë Jam Ai që Jam”**

NJB **“besoni se unë jam ai”**

Kjo është një nga thëniet më të forta të konceptit që kishte Jezusi për natyrën e vet hyjnore (ose, ka mundësi që, në këtë kontekst, referenti të jetë “Mesia”). Ai përdor titullin e DhV për JHVH (shih “unë jam”, i Eks. 3:14). Kjo dallon nga pohimet e famshme “unë jam” të Gjonit. Ajo nuk ka kallëzues (shih 4:26; 6:20; 8:24, 25, 58; 13:19; 18:5, 6, 8). Shih Temën e Veçantë: Përdorimi që i bën Gjoni fjalës “besoj” në 2:23.

8:25 “Kush je ti?” Autoritetet e judenjve po kërkonin baza ligjore për akuzën e blasfemisë (shih Mat. 26:57-68; Marku 14:53-65)! Ata e donin të vranë. Nuk po kërkonin informacione, por dënim.

Jezusi e zbulon veten qartazi të Gjonit (në dallim nga ungjijtë sinoptikë)1 Fjalët (p.sh., v. 24) dhe veprimet tij (p.sh., shërimi ditën e shabatit) tregojnë qartazi autoritetin e tij.

▣

NASB **“Çfarë ju kam thënë që nga fillimi”**

NKJV **“Pikërisht atë që ju kam thënë që nga fillimi”**

NRSV **“Kot që po flas me ju”**

TEV **“Ajo që ju kam thënë që nga fillimi”**

NJB **“Ajo që ju kam thënë që në krye të herës”**

Në fillim, dorëshkrimet greke nuk kishin fare hapësira mes fjalëve. Si rrjedhojë, shkronjat greke mund të ndahen në vende të ndryshme për të krijuar fjalë që përputhen me kontekstin. Dallimet mes përkthimeve nuk lidhen me ndryshimet në dorëshkrime, por me ndarjen e fjalëve. Ja cilat janë alternativat.

1. *hote* – ju kam thënë që nga fillimi (NASB, NKJV, TEV, NJB, NIV)

2. *ho ti* si idiomë semitike habitore – kot që flas me ju (NRSV, shënimi në fund të faqes në TEV)

Ka mundësi të jetë një nga lojërat e fjalëve të Gjonit, sepse termi “në fillim” përdoret në përkthimin e Septuagintës së Zan. 1:1 (krijimi) dhe të Gjonit 1:1 (shërbesa e tij). Jezusi është që nga “fillimi” dhe këtë gjë ua ka thënë gjithë kohës me fjalë dhe me vepra!

8:26-27 Këto motive përsëriten të Gjonit për theksim.

1. Ati më dërgoi (shih 3:17,34; 4:34; 5:36,38; 6:29,44,57; 7:28-29; 8:16,26,42; 10:36; 11:42; 12:49; 14:24; 15:21; 17:3,18,21,23,25; 20:21)
2. Ati është i vërtetë (shih 3:33; 7:28)
3. Mësimet e Jezusit janë nga Ati (shih 3:11; 7:16-17; 8:26,28,40; 12:49; 14:24; 15:15)
4. Jezusi zbulon Atin (shih 1:18; 8:26-29; 12:49-50; 14:7, 9)

▣ **“bota”** Shih shënimin në 1:10.

8:27 Një tjetër koment redaktorial nga autori. Po t’ia kishin kuptuar gjuhën e qartë metaforike dhe simbolike, ashtu si judenjtë e tjerë, edhe ata do të ishin përpjekur ta vrisnin (shih 5:18; 8:59; 10:33). Pohimet e tij nuk ishin dhe aq të fshehura!

8:28 “Kur të keni lartuar Birin e Njeriut” Ky është aludim për Num. 21:4-9 në DhV, e cila diskutohet në Gjoni 3:14. Ky term, ashtu si shumë të tjerë te Gjoni, ka kuptim të dyfishtë. Mund të ketë kuptimin “i ngritur lart” si në kryq (shih 3:14; 12:32, 34), por shpesh përdorej edhe në kuptimin “i lartësuar”, si te Veprat 2:33, 5:31; Fil. 2:9. Jezusi e dinte se kishte ardhur që të vdiste (shih Marku 10:45).

▣ **“Birin e Njeriut”** Ky është titulli i zgjedhur nga vetë Jezusi, pasi nuk kishte ngjyrimë ushtarake apo nacionaliste nga brenda judaizmit rabinik. Ai zgjodhi këtë titull ngaqë lidh konceptin e natyrës njerëzore (shih Ezek. 2:1; Psa. 8:4) me atë të natyrës hyjnore (shih Dan. 7:13).

▣ **“atëherë do të dini se unë jam ai”** As dishepujt (dhe as familja e tij) nuk e kuptuan plotësisht këtë deri (shih 7:39) pas Rrëshajave! Fryma erdhi me fuqi syhapëse për të gjithë ata që kishin sy dhe veshë shpirtërorë!

Për pohimin unik gramatikor “unë jam ai” shih shënimin në v. 24. Ata do të dinë

1. kush është (pra, Mesia)
2. se ai zbulon Atin (shih 5:19-20)
3. se ai dhe Ati janë një (v. 29)

8:29 “ai nuk më ka lënë të vetëm” Bashkësia e Jezusit me Atin e forconte (shih 8:16; 16:32). Prandaj dhe bashkësia e thyer në kryq ishte kaq e vështirë për Jezusin (shih Marku 15:34).

8:30 “shumë besuan në të” Përdorimi i fjalës “besoj” në këtë pasazh ka spektër të gjerë. Duket se ai nënkupton besimin e cekët të disa dëgjuesve (shih Mat. 13; Marku 4). Ata ishin të gatshëm të pranonin se ai ishte Mesia, por i bazuar në kuptimin e tyre të kësaj fjale. Konteksti i 8:30-58 tregon qartazi se ata nuk ishin besimtarë të vërtetë (shih 2:23-25). Te Gjoni, shohim nivele të ndryshme besimi, dhe jo të gjitha të çojnë në shpëtim. Shih Temën e Veçantë në 2:23.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:31-33

³¹Kështu, Jezusi po u thoshte atyre judenjve që besuan në të: “Nëse qëndroni në fjalën time, atëherë jeni vërtet dishepuj të mi. ³²dhe do të njihni të vërtetën, dhe e vërteta do t’ju çlirojë”. ³³Ata iu përgjigjën: “Ne jemi pasardhës të Abrahamit dhe nuk jemi skllavëruar kurrë nga ndokush; si mund të thuash ti: „do të çlirohemi“?”

8:31 “Nëse qëndroni” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Ky theksim i besimit të vazhdueshëm shprehet qartazi edhe në Gjoni 15. Ky është element që i mungon shpalljes së ungjillit në qarqet ungjillore. Fjalës duhet t’i besojmë (shih 5:24), t’i bindemi dhe të qëndrojmë në të. Shih Temën e Veçantë: Qëndrimi, në 1 Gjonit 2:10.

TEMË E VEÇANTË: NEVOJA PËR QËNDRESË

Doktrinat biblike që lidhen me jetën e krishterë janë të vështira të shpjegohen, pasi paraqiten në dyshe dialektike, që janë tipike për botën lindore. Këto dyshe duken kontradiktore, por janë të dyja biblike. Të krishterët perëndimorë janë prirur që të zgjedhin njëren të vërtetë dhe të anashkalojnë ose zhvlerësojnë të vërtetën e kundërt. Më lejoni t'ju jap disa shembuj.

- A. A është besimi një vendim fillestar për të besuar në Krishtin, apo një përkushtim dishepullizimi gjithë jetën?
- B. A është shpëtimi një zgjedhje që bën Perëndia sovran me anë të hirit, apo është një përgjigje e njerëzimit me besim dhe me pendim ndaj ofertës hyjnore?
- C. Pasi merret shpëtimi, a është i pamundur të humbet, apo ekziston nevoja për zell të vazhdueshëm? Çështja e qëndresës ka qenë polemike gjatë gjithë historisë së kishës. Problemi fillon me disa pasazhe në DhR që duket sikur janë në kundërshti me njëra-tjetrën:
 - A. pasazhet për sigurinë e shpëtimit
 1. thëniet e Jezusit (Gjoni 6:37; 10:28-29)
 2. thëniet e Palit (Rom. 8:35-39; Efe. 1:13; 2:5,8-9; Fil. 1:6; 2:13; 2 Thes. 3:3; 2 Tim. 1:12; 4:18)
 3. thëniet e Pjetrit (1 Pjet. 1:4-5)
 - B. pasazhet për nevojën për qëndresë
 1. thëniet e Jezusit (Mat. 10:22; 13:1-9,24-30; 24:13; Marku 13:13; Gjoni 8:31; 15:4-10; Zbu. 2:7,17,26; 3:5,12,21)
 2. thëniet e autorit të Hebrenjve (2:1; 3:6, 14; 4:14; 6:11)
 3. thëniet e Gjonit (1 Gjonit 2:6; 2 Gjonit 9)
 4. thëniet e Atit (Zbu. 21:7)

Shpëtimi biblik rrjedh nga dashuria, mëshira dhe hiri i Perëndisë Triun dhe sovran. Asnjë njeri nuk mund të shpëtohet pa nismën e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Perëndia vjen në fillim dhe përcakton rendin, por kërkon që njerëzit të përgjigjen me besim dhe pendim, si në fillim, ashtu dhe në vazhdim. Perëndia punon me njerëzimin në një marrëdhënie besëlidhjeje. Ka edhe privilegje, edhe përgjegjësi!

Shpëtimi u ofrohet gjithë njerëzve. Vdekja e Jezusit i dha fund problemit të mëkatit në krijimin e rënë. Perëndia ka siguruar një rrugë dhe kërkon që gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin e tij t'i përgjigjen dashurisë dhe asaj që na ka siguruar ai në Jezusin.

Nëse dëshiron të lexosh më tepër për këtë temë nga një pikëvështrim jokalvinist, shih

1. Dale Moody, *The Word of Truth [Fjala e së vërtetës]*, Eerdmans, 1981 (f. 348-365)
2. Howard Marshall, *Kept by the Power of God [I ruajtur me anë të fuqisë së Perëndisë]*, Bethany Fellowship, 1969
3. Robert Shank, *Life in the Son [Jeta në Birin]*, Westcott, 1961

Bibla trajton dy probleme të ndryshme në këtë pikë: (1) të mos e marrim sigurinë e shpëtimit si leje për të bërë jetë të pafrytshme dhe egoiste; dhe (2) të inkurajojë ata që kanë vështirësi në shërbesë apo me mëkatin personal. Problemi është se grupet e gabuara po marrin mesazhin e gabuar dhe po ndërtojnë sisteme teologjike mbi pasazhe të kufizuara biblike. Disa të krishterë kanë nevojë të dëshpëruar për mesazhin e sigurisë së shpëtimit, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për paralajmërime të rrepta! Në cilin grup bën pjesë ti?

■ **“në fjalën time, atëherë jeni vërtet dishepuj të mi”** Jezusi theksoi bindjen gjatë gjithë jetës (ndaj porosive të tij, shih v. 51,52,55; 14:15,21,23,24; 15:10,20; 17:6; Luka 6:46; 2 Gjonit 9). Në një kuptim, ky varg reflekton *shema*-n, një fjalë hebraisht që do të thotë “dëgjoj në mënyrë që të zbatoj” (shih LiP. 6:4-6).

8:32 “do të njihni” Kjo përdoret në kuptimin e DhV, pra, “njoh”, që nënkuptonte “një marrëdhënie personale”, jo thjesht kuptimin e “së vërtetës si informacion” (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). E vërteta është person! Ky varg, që gjendet shumë shpesh në institucionet arsimore, nuk i referohet njohurisë së akumuluar njerëzore. Kjo njohuri është provuar se përçan dhe robëron, jo çliron, njerëzit. “E vërteta” që përmendet këtu është ungjilli dhe personi i Jezu Krishtit. Nuk ka të vërtetë, paqe, apo shpresë pa të!

8:32, 40, 44, 45, 46 “e vërteta” Ky është koncepti kyç i këtij konteksti. Ky term ka dy kuptime.

1. Besueshmëri
2. E vërteta në dallim nga gënjeshtria

Të dyja këto kuptime janë të vërteta për jetën dhe shërbesën e Jezusit. Ai është edhe përmbajtja, edhe synimi, i ungjillit. E vërteta është pikësëpari një person! Jezusi zbulon Atin personal. Ky varg, shpesh, hiqet nga konteksti dhe përdoret në institucione arsimore. Faktet, qoftë dhe ato të vërteta, madje dhe shumë fakte të vërteta, nuk e çlirojnë njeriun (shih Pred. 1:18). Shih Temën e Veçantë: e Vërteta, në 6:55 dhe 17:3.

8:32 “do t’ju çlirojë” Besimtarët janë të lirë nga legalizmi, ritualizmi dhe fetaria njerëzore e orientuar drejt veprave njerëzore. Ndërsa besimtarët e vërtetë e lidhin veten për hir të ungjillit (shih Rom. 14:1-15:6; 1 Kor. 8-10).

8:33 “Ne jemi pasardhës të Abrahamit dhe nuk jemi skllavëruar kurrë nga ndokush” Është e habitshme sa e verbër është krenaria raciale. Po Egjipti, Siria, Babilonia, Persia, Greqia, Siria dhe Roma?

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:34-38

³⁴Jezusi u përgjigj: “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them; kushdo që kryen mëkat është skllav i mëkatit. ³⁵Skllavi nuk qëndron në shtëpi përjetë; biri mbetet përjetë. ³⁶Kështu, nëse Biri ju bën të lirë, do të jeni të lirë vërtet. ³⁷Unë e di se jeni pasardhës të Abrahamit; mirëpo ju përpiqeni të më vrisni, ngaqë Fjala ime nuk ka vend në ju. ³⁸Unë flas për gjërat që kam parë te Ati im; prandaj, edhe ju bëni gjërat që keni dëgjuar nga ati juaj”.

8:34 “kushdo që kryen mëkat është skllav i mëkatit” Jezusi po përpiqej t’i çonte te realiteti shpirtëror pas frazës së tij të mëparshme “do t’ju çlirojë” në v. 32, që thënia në v. 33 tregon se ata e keqkuptuan. Kjo thënie lidhet me akuzat e forta të Jezusit në v. 21 dhe 24. Dënimet e tij për këta ndjekës periferikë arrijnë kulmin në v. 44-47.

Siç pohon Frank Stagg në *New Testament Theology*: “ironia e gjendjes së vështirë të njeriut është se skllavëria është rezultat i përpjekjeve të tij për t’u bërë i lirë” (f. 32).

FOLJA këtu është PJESORE E TASHME VEPRORE, “duke bërë”, që nënkupton mëkat të vazhdueshëm. Të krishterët ndeshen me mëkatin, por të humburit kënaqen me të dhe nuk e kuptojnë!

Bibla NET (f. 1921 #21) shton një koment të saktë se mëkati kontekstual te Gjoni është “mosbesimi” (mëkati i pafalshëm). Ky nuk është një kontekst etik, por “një kontekst i tipit „besim për shpëtim””. Edhe te 1 Gjonit, “mëkati” është mosbesimi (mëkati që çon në vdekje)!

8:35 Ky varg nuk lidhet drejtpërdrejt me v. 34, por me v. 36. Jezusi, jo Moisiu i judaizmit rabinik, është biri i vërtetë (shih Heb.1:2; 3:6; 5:8; 7:28). Vetëm besimi në të, dhe jo zbatimi i rregullave dhe ritualeve të pafundme, mund të na bëjnë të lirë (shih v. 32).

■ **“përjetë”** Shih Temën e Veçantë në 6:58.

8:36 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për një veprim të mundshëm.

8:37 “mirëpo ju përpiqeni të më vrisni” (shih 5:18; 7:1, 19; 8:37, 40; 11:53).

■ **“sepse fjala ime nuk ka vend në ju”** Kjo frazë mund të merret në disa kuptime. Një ndihmë e dobishme studimore është *The Bible in Twenty Six Translations (Bibla në 26 përkthime)*.

1. “sepse fjala ime nuk ka rrugë të lirë në ju” – American Standard Version
2. “nuk fiton aspak terren në ju” – *The New Testament*, nga Henry Alford
3. “nuk bën asnjë përparim ndër ju” – *The New Testament: A New Translation*, nga James Moffatt
4. “nuk gjen vend në ju” – *The Emphasized New Testament: A New Translation*, nga J. B. Rotherham
5. “sepse fjalët e mia nuk gjejnë vend në zemrat tuaja” – *The Four Gospels*, nga E. V. Rieu

Sërish, problemi është pranimi ose mospranimi i ungjillit. Është çështje shpëtimi, jo përparimi moral.

8:30 “që unë kam parë” Kjo është një DËFTORE E KRYER VEPRORE, e cila ka të bëjë me paraekzistencën e Jezusit dhe bashkësinë e tij të tanishme me Atin (shih v. 40, 42).

■ **“edhe ju bëni gjërat që keni dëgjuar nga ati juaj”** Përmendja e parë e “atit” mund të jetë referencë për traditën judaike (shih Isa. 29:13). Megjithatë, në v. 41-44, KRYERJALA cilësohet nga Satani/Djalli. Veprimet,

motive dhe fjalët e tyre, që gjoja mbështesnin “Moisiun”, tregojnë qartë orientimin e tyre shpirtëror. Njerëzit nuk marrin (as nuk janë në gjendje të marrin) nismën në fushën shpirtërore. Ka dy burime ndikimi (jo dualizëm): Perëndia/Krishti/Fryma ose Satani/dhe të vetët! Mënyra si njeriu reagon ndaj ungjillit (shih 1:12; 3:16; 10:1-18; 14:6) zbulon orientimin shpirtëror!

Ka disa alternative tekstuale që lidhen me këtë frazë.

1. Të dyja përmendjet e “atit” mund t’i referohen JHVH-së (s’ekziston PËREMRI “juaj”)
2. FOLJA është URDHËRORE, jo DËFTORE

(shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 225).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:39-47

³⁹Ata u përgjigjën dhe i thanë: “Ati ynë është Abrahami”. Jezusi u tha: “Nëse jeni fëmijë të Abrahamit, bëni veprat e Abrahamit. ⁴⁰Por, tani, ju po përpiqeni të më vrisni mua, një njeri që ju ka thënë të vërtetën, të cilën e dëgjova nga Perëndia; Abrahami këtë nuk e bëri. ⁴¹Ju po bëni veprat e atit tuaj”. Ata i thanë: “Ne s’kemi lindur nga kurvëria; ne një Atë kemi, pra Perëndinë”. ⁴²Jezusi u tha: “Nëse Perëndia është Ati juaj, ju do të më donit, sepse unë dola dhe erdha nga Perëndia, sepse nuk kam ardhur nga vetja ime, por më ka dërguar ai. ⁴³Pse nuk po kuptoni atë që ju them? Ngaqë nuk mund të dëgjoni thënien time. ⁴⁴Ju jeni të atit tuaj, djallit, dhe doni të bëni dëshirat e atit tuaj. Ai ishte vrasës që nga fillimi, nuk qëndron në të vërtetën dhe nuk ka të vërtetë në të. Sa herë që ai flet gënjeshtër, flet nga natyra e vet, sepse ai është gënjeshtar dhe babai i gënjeshtërve. ⁴⁵Por, ngaqë unë ju them të vërtetën, nuk besoni në mua. ⁴⁶Cili prej jush më bind për mëkat? Nëse flas të vërtetën, pse nuk më besoni? ⁴⁷Ai që është nga Perëndia dëgjon fjalët e Perëndisë; për këtë arsye, ju nuk i dëgjoni, sepse nuk jeni nga Perëndia”.

8:39 “Abrahami është ati juaj” Jezusi pohoi prejardhjen e tyre nga Abrahami, por vuri në dukje se ata kishin tiparet familjare të Satanit (shih v. 38, 4). Ajo që i vinte judenjtit në marrëdhënie të drejtë me Perëndinë ishte marrëdhënia e besimit personal, jo identiteti racor (shih LiP. 6:5, 13; Rom. 2:28-29; 9:6).

■ **“Nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË nga forma (në protazë – DËFTORJA E TASHME VEPRORE me *ei*), por mund të funksionojë si KUSHTORE E KLASIT TË DYTË (shih v. 19 dhe 42). Variantet e dorëshkrimeve greke përpiqeshin ta eliminonin këtë formë kushtore të përzier duke ndryshuar FOLJEN e parë në TË PAKRYER. Nëse do të ishte kështu, kjo do të lexonte: “Nëse do të ishit fëmijë të Abrahamit, por nuk jeni, atëherë do të bënit siç bëri Abrahami, por nuk po e bëni”. UBS⁴ i jep formës së përzier kushtore vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt).

8:40 “një njeri” Jezusi, jo vetëm që e kuptonte veten si përfaqësues të JHVH, i barabartë në esencën hyjnore me JHVH-në, por edhe si qenie të vërtetë njerëzore. Ky pohim hidhte poshtë pohimin e mësuesve të rremë gnostike për dualizmin e përjetshëm midis shpirtit dhe gjërave fizike (shih 1 Gjonit 1:1-4; 4:1-4).

TEMË E VEÇANTË: Gnosticizmi

- A. Pjesa më e madhe e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Gjithsesi, idetë e saj janë të pranishme në shekullin e parë (Pergamenat e Detit të Vdekur) dhe në shkrimet e apostullit Gjon.
- B. Problemi në Efes (1 Timoteut), Kretë (Tit) dhe Kolos (Kolosianëve) ishte një hibrid i proto-gnosticizmit dhe judaizmit legalist.
- C. Disa parime të gnosticizmit valentinian dhe kerintian të shekullit të dytë.
 - 1. materia dhe shpirti ishin të bashkëpërzjeshme (një dualizëm ontologjik). Materia është e keqe, shpirti është i mirë. Perëndia, që është shpirt, nuk mund të përfshihet drejtpërdrejt me modelimin e materies së ligë.
 - 2. midis Perëndisë dhe materies ekzistojnë “rrezatime” (*eon-et*, ose nivelet engjëlllore). I fundmi dhe më i ulëti i tyre ishte Jahve i DhV, i cili formoi universin (*kozmos*).
 - 3. Jezusi ishte një rrezatim si Jahve, por i një shkalle më të lartë, më pranë Perëndisë së vërtetë. Disa e vendosnin në shkallën më të lartë, por gjithsesi, si më të ulët se Perëndia dhe sigurisht jo si Hyjni të mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të kishte trup njerëzor dhe të mbetej prapëseprapë hyjnor. Ai ishte një fantazmë shpirtërore (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6).
 - 4. shpëtimi sigurohej me anë të besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cilat njihet vetëm nga persona të veçantë. Nevojitej njohuri (fjalëkalimet) për të kaluar përmes sferave qiellore. Për të arritur te Perëndia nevojitej dhe legalizmi judaik.
- D. Mësuesit e rremë gnostikë mbronin dy sisteme etike të kundërta.
 - 1. Për disa, mënyra e jetesës s’kishte fare lidhje me shpëtimin. Sipas tyre, shpëtimi dhe spiritualiteti kishin të bënin me njohurinë e fshehtë (fjalëkalime) për të kaluar përmes sferave engjëlllore (*eon-eve*).
 - 2. Për disa të tjerë, mënyra e jetesës ishte kyçe për shpëtim. Në këtë libër, mësuesit e rremë theksonin një mënyrë jetese askete si provë për shpëtimin e vërtetë (shih 2:16-23).
- E. Një libër i mirë reference është *The Nag Hammadi Library (Biblioteka e Nag Hammadi-t)* nga James M. Robinson dhe Richard Smith.

8:41

NASB, NKJV “Ne s’kemi lindur nga kurvëria”

NRSV “Ne s’jemi fëmijë të paligjshëm”

TEV “Ne jemi fëmijë të vërtetë”

NJB “Ne nuk kemi lindur jashtë kurore”

Kjo mund të lidhet me akuzën e v. 48 (“ti je samaritan”). Duket se judenjtë po pohonin se Jezusi ishte fëmijë i jashtëligjshëm, jo jude i plotë nga ana e gjakut. Burimet e mëvonshme rabinike do të thoshin se Jezusi kishte si baba një ushtar romak.

■ “ne një Atë kemi, pra, Perëndinë” Kjo thënie reflekton monoteizmin e rreptë të DhV (shih LiP. 4:35, 39; 6:4-5), i shprehur me fjalë prindërore (shih LiP. 32:6; Isa. 1:2; 63:16; 64:8). Këtu qëndronte dilema: këta krerë judenj pohonin se Perëndia ishte një (shih LiP. 6:4-5) dhe se bindja ndaj ligjit të Moisiut i sillte në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë (shih LiP. 6:1-3, 17, 24-25). Jezusi erdhi duke pohuar se ishte një me Perëndinë! Ai pohonte se pozita e drejtë me Perëndinë bazohej, jo te zbatimi i ligjit, por te besimi personal në Krishtin. Pësjtjellimi dhe ngurrimi i tyre është i kuptueshëm, por këtu është pika ku njohuria e Frymës dhe veprat e fuqishme të Jezusit shkaktojnë besim!

8:42 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, e quajtur “në kundërshtim me faktet”. “Nëse Perëndia do të ishte Ati juaj, por nuk është, ju do të më donit, por nuk më doni” (shih v. 47).

8:43 “nuk mund të dëgjoni thënien time” Këtu bëhet fjalë për pranueshmërinë dhe njohurinë shpirtërore. Ata nuk kishin veshë shpirtërorë (shih Isa. 6:9-10; Mat. 11:15; 13:9,15-16,43; Marku 4:9,23; 7:16; 8:18; Luka 8:8; 14:35; Veprat 7:51; 28:26-27).

8:44 “Ju jeni të atit tuaj, djallit” Ç’thënie tronditëse për krerët fetarë të kohës së tij (shih v. 47)! Ky koncept i tipareve të përbashkëta familjare shprehet me një idiomë hebraike, “bij të...” (shih Mat. 13:38; Veprat 13:10; 1 Gjonit 3:8, 10).

Për “djallin”, shih Temën e Veçantë në 12:31.

▣ **“vrasës që nga fillimi”** Kjo nuk synohet të nënkuptonte përjetësinë e ligësisë (p.sh., dualizmi i zoroastrianizmit), por pasqyron konceptin e tundimit shpirtëror të Adamit dhe Evës me anë të një fryme mashtrues që u fut brenda një gjarpri (shih Zanafilla 3). Vini re kontrastin e qëllimshëm mes Perëndisë, i cili është i Vërtetë, dhe djallit!

8:46 “Cili prej jush më bind për mëkat” Në kontekst, këtu bëhet fjalë për dëshminë e rreme. Satani gënjen, por Jezusi thotë të vërtetën. Jezusi i fton këta krerë judenj që të hedhin poshtë pohimet ose mësimet e tij, dhe ta provojnë se është i rremë! Në këtë kontekst, kjo thënie nuk duket se ka lidhje me pamëkatshmërinë e Jezusit si doktrinë teologjike.

Në Gjoni, “mëkati” është më tepër parim ligësie në një botë të rënë dhe të rebeluar kundër Perëndisë sesa një akt i veçantë mëkati. Mëkati është gjithçka që nuk është Jezusi! “Mëkati” më i rëndë është mosbesimi (shih 16:9).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:48-59

⁴⁸Judenjtë u përgjigjën dhe i thanë: “A nuk themi me të drejtë se ti je samaritan dhe ke një demon?” ⁴⁹Jezusi u përgjigj: “Unë nuk kam demon, por nderoj Atin tim, ndërsa ju më çnderoni. ⁵⁰Por unë nuk kërkoj lavdinë time; është Njëri që kërkon dhe gjykon. ⁵¹Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them, nëse dikush zbaton fjalën time, nuk do të shohë kurrë vdekje. ⁵²Judenjtë i thanë: “Tani e dimë se ke demon. Abrahami vdiq, edhe profetët po ashtu; kurse ti thua: „Nëse dikush zbaton fjalën time, nuk do të shijojë kurrë vdekje”. ⁵³Pa dyshim, ti s’je më i madh se ati ynë Abraham, që vdiq, apo jo? Edhe profetët vdiqën; kush pandeh se je?” ⁵⁴Jezusi u përgjigj: “Nëse unë përlëvdoj veten, lavdia ime s’është asgjë; është Ati im ai që më përlëvdon, për të cilin thoni: „Ai është Perëndia ynë”; ⁵⁵por ju ende s’e keni njohur, por unë e njoh; dhe nëse them se nuk e njoh, do të isha gënjeshtar si ju, por unë e njoh dhe zbatoj fjalën e tij. ⁵⁶Ati juaj, Abrahami, u gëzua për të parë ditën time, e pa dhe u gëzua”. ⁵⁷Atëherë, judenjtë i thanë: “Ti s’je as pesëdhjetë vjeç, dhe paske parë Abrahamin?” ⁵⁸Jezusi u tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: përpara se të lindte Abrahami, unë jam. ⁵⁹Për këtë arsye, ata morën gurë që t’i hidhnin kundër tij, por Jezusi u fsheh dhe doli nga tempulli.

8:48 “ti je samaritan dhe ke një demon” Ka një mundësi që kuptimi i vërtetë kontekstual të reflektohet në fjalën aramaike që përkthehet me fjalën greke “samaritan”, që donte të thoshte “kreu i demonëve”. Jezusi fliste aramaisht. Nëse kjo është e vërtetë, përputhet me akuzën e vazhdueshme nga krerët fetarë se fuqia e Jezusit vinte nga një burim i lig i mbinatyrshëm. Po kështu, ka mundësi që kur thuhej se dikush kishte demon, kjo donte të thoshte se ai po gënjente (shih v. 52). Të thoshe se Jezusi ishte samaritan (shih 4:9) ose se kishte demon (shih 7:20; 8:48, 49, 52; 10:20, 21, shih Temën e Veçantë në 12:31) ishte si të thoshe se nuk duhet t’i vije veshin Jezusit apo t’i përgjigjeshe mesazhit të tij. Pra, kjo, ashtu si dhe “Abrahami është ati ynë”, ishte një tjetër shembull i mospërgjigjes ndaj Jezusit ose mesazhit të tij.

8:49 Nuk mund të besosh në Atin pa besuar në Birin (shih 1 Gjonit 5:9-12); nuk mund të njohësh Atin pa nderuar Birin (shih 5:23). Ndonëse ata janë dy persona të veçantë, janë një (shih 10:30; 17:21-23).

8:50 “lavdinë time” Shih shënimin në 1:14.

8:51, 52 “nëse... Nëse” Këto janë të dyja FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Vini re se bindja lidhet me besimin (shih listën e pasazheve në v. 48).

▣ **“nuk do të shohë kurrë vdekje”** Kjo është një MOHORE E DYFISHTË, pra kategorike. Qartazi, bën fjalë për vdekjen shpirtërore (shih v. 21, 24), jo për vdekjen fizike (shih 5:24; 6:40, 47; 11:25-26). Mund të bëjë fjalë për frikën nga vdekja (shih 1 Kor. 15:54-57).

Koncepti i “vdekjes” (*thanatos*) në Bibël shprehet në tre faza.

1. vdekja shpirtërore, Zan. 2:17; 3:1-24; Isa. 59:2; Rom. 7:10-11; Jakobi 1:15 (marrëdhënia me Perëndinë është thyer)
2. vdekja fizike, Zan. 3:4-5; 5 (marrëdhënia me planetin është thyer)
3. vdekja e përjetshme, “vdekja e dytë”, Zbu. 2:11; 20:6, 14; 21:8 (marrëdhënia e thyer me Perëndinë bëhet e përhershme)

Vdekja është e kundërta e vullnetit të Perëndisë për krijimin e tij më të lartë (shih Zan. 1:26-27).

8:52 Kjo tregon se ata e keqkuptuan thënien e Jezusit (shih v. 51). Ata mendonin se bëhej fjalë për jetën fizike të Abrahamit dhe profetëve.

8:53 Kjo pyetje pret përgjigjen “jo”. Ç’thënie tronditëse! Por kjo ishte pikërisht ajo që po pohonte Jezusi.

1. Ai ishte më i madh se Abrahami, v. 53
2. Ai ishte më i madh se Jakobi, 4:12
3. Ai ishte më i madh se Jona, Mat. 12:41; Luka 11:32
4. Ai ishte më i madh se Gjon Pagëzori, 5:36; Luka 7:28
5. Ai ishte më i madh se Solomoni, Mat. 12:42; Luka 11:31

Gjithë libri i Hebrenjve tregon epërsinë e Jezusit ndaj Moisiut, e besëlidhjes së re ndaj besëlidhjes së vjetër (lexo falas komentarin tim për letrën e Hebrenjve në internet në www.freebiblecommentary.org).

▣ **“kush pandeh se je?”** Pikërisht këtu qëndronte puna! Jezusi e pohon qartazi përfundimin në v. 54 dhe 58, dhe ata përpiqen ta vrasin me gurë për blasfemi (shih v. 59).

8:54 “Nëse” Një tjetër FJALI KUSHTORE E KLASITË TRETË, që nënkuptonte veprim të mundshëm.

▣ **“përlëvdoj”** Këtu, përdoret në kuptimin e nderimit (shih Rom. 1:21; 1 Kor. 12:26).

8:55 “njoh... njoh” Kjo fjalë përkthen dy fjalë të ndryshme greqisht në këtë varg, *ginōskō* dhe *oida*, që, në këtë kontekst, duket se janë sinonime (shih 7:28-29). Jezusi e njeh Atin dhe ua zbulon ndjekësve të vet. Bota (edhe judenjtë) nuk e njohin Atin (shih 1:10; 8:19,55; 15:21;16:3; 17:25).

8:56 “Ati juaj, Abrahami” Kjo thënie është goditëse. Jezusi e distancon veten nga “judenjtë”, “ligji” (shih 8:17), “tempulli”, madje dhe nga patriarku Abraham. Kjo është ndarje e qartë nga Besëlidhja e Vjetër!

▣ **“u gëzua për të parë ditën time”** Kjo është DËFTORE AORISTE MESORE. Sa gjëra kuptonte Abrahami për Mesinë? Një sërë përkthimesh e përkthejnë këtë në kuptimin e ardhshëm. Këto alternativa janë marrë nga *Bibla në 26 përkthime*.

1. “u ngazëllye që do të shihte” – *The Emphasized New Testament: A New Translation*, nga J. B. Rotherham
2. “u gëzua që do të shihte ditën time” – Revised Standard Version
3. “ishte jashtëzakonisht i lumtur nga mundësia që të shihte” – *The Berkeley Version of the New Testament*, nga Gerrit Verkuyl
4. “që do të shihte ardhjen time” – *The New Testament: An American Translation*, nga Edgar J. Goodspeed
5. “u gëzua që njohu ditën time” – *The New Testament in the Language of Today*, nga William F. Beck

Po kështu, *The Analytical Greek Lexicon Revised*, redaktuar nga Harold K. Moulton e rendit kuptimin e kësaj FOLJEJE si “dëshiroj me zjarr”, nga përdorimi në Septuagintë (f. 2).

▣ **“e pa dhe u gëzua”** Kjo bën fjalë për një nga këto dy gjëra.

1. se Abrahami, gjatë jetës së vet, pati një vegim të Mesisë (shih 2 Esdra 3:14)
2. se Abrahami ishte gjallë (në qiell) dhe ishte i vetëdijshëm për veprën e Mesisë në tokë (shih Heb. 11:13)

Gjithë ideja e thënies së Jezusit është se Ati i kombit jude priste me përmallim epokën mesianike me gëzim të madh, por “fara” (brezi) e tanishme nuk pranonte të besonte dhe të ngazëllehej! Abrahami ishte ati i besimtarëve (shih Rom. 2:28-29), jo i jobesimtarëve!

8:57 Sërish, dëgjuesit ia keqkuptuan fjalët Jezusit për shkak se e morën në mënyrë të fjalëpërfjalshme! Ky pësjhtjellim mund të ketë qenë i qëllimshëm! Ata nuk shihnin për shkak se nuk donin të shihnin, ose, ndoshta, nuk ishin në gjendje të shihnin!

8:58 “përpara se të lindte Abrahami, unë jam” Kjo ishte blasfemi për judenjtë, ndaj u përpoqën ta vrasnin me gurë Jezusin (shih Eks. 3:12, 14). Ata e kuptonin plotësisht se çfarë po thoshte ai, pra, se ai ishte Perëndi paraekzistues (shih 4:26; 6:20; 8:24,28,54-59; 13:19; 18:5,6,8).

8:59 “ata morën gurë që t’i hidhnin kundër tij” Fjalët e Jezusit ishin shumë të qarta. Ai ishte Mesia dhe ishte një me Atin. Këta judenj, që në v. 31 thuhet se “besuan në të”, tani janë gati ta vrasin me gurë për blasfemi (shih Lev. 24:16). Ishte shumë e vështirë që këta judenj të pranonin mesazhin e ri dhe radikal të Jezusit.

1. ai nuk vepronte ashtu siç prisnin ata që të vepronte Mesia
2. ai sfidonte tradita e tyre të shenjta gojore
3. ai ua pësjhtjellonte monoteizmin e tyre të rreptë
4. ai pohonte se Satani, dhe jo JHVH, ishte “ati” i tyre

Ose duhet ta “vrasësh me gurë”, ose duhet “ta pranosh”! S’ka rrugë të mesme!

■ **“Jezusi u fsheh dhe doli nga tempulli”** Ky është një nga vargjet që i kanë bërë interpretuesit të hamendësojnë (dhe t’i shtojnë fraza tekstit greqisht) nëse

1. kjo ishte mrekulli (shih Luka 4:30 dhe shtesat tekstuale aty)
2. Jezusi u përzje me turmën ngaqë dukej njësoj si gjithë judenjtë e tjerë të pranishëm

Ekzistonte një kalendar hyjnor. Jezusi e dinte se kishte ardhur të vdiste dhe e dinte si, kur dhe ku. “Ora e tij nuk kishte ardhur ende”!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. A është Gjoni 7:53-8:11 pjesë origjinale e ungjillit të Gjonit? Pse, ose pse jo?
2. Cili është sfondi i thënies së Jezusit: “Unë jam drita e botës”?
3. Pse ishin kaq kundërshtues farisenjtë ndaj Jezusit?
4. Shpjego përdorimin e termit “besoj” në v. 30 në dritën e kontekstit që vijon.

GJONI 9

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërimi i atij që kishte lindur i verbër 9:1-12	Një i lindur i verbër shikon 9:1-12	Jezusi shfaq veten si Drita e jetës 9:1-12	Jezusi shëron një të lindur të verbër 9:1-2 9:3-5 9:6-7 9:8 9:9a 9:9b 9:10 9:11 9:12a 9:12b	Shërimi i të lindurit të verbër 9:1-5 9:6-7 9:8-12
Farisenjtë hetojnë shërimin 9:13-17	Farisenjtë përjashtojnë të shëruarin 9:13-34	9:13-17	Farisenjtë hetojnë shërimin 9:13-15 9:16a 9:16b 9:17a 9:17b	9:13-17
9:18-23		9:18-23	9:18-19 9:20-23	9:18-23
9:24-34		9:24-34	9:24 9:25 9:26 9:27 9:28-29 9:30-33 9:34	9:24-34
Verbëria shpirtërore 9:35-39	Shikimi i vërtetë dhe verbëria e vërtetë 9:35-41	9:35-41	Verbëria shpirtërore 9:35 9:36 9:37 9:38 9:39	9:35-39
9:40-41			9:40 9:41	9:40-41

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-41

- A. Shërimi i të verbrit, një mrekulli shumë e shpeshtë në shërbesën e Jezusit, çuditërisht kryhet me një sërë teknikash të ndryshme.
- B. Shërimi i të verbrit ishte shenjë mesianike (shih Isa. 29:18; 35:5; 42:7; Mat. 11:5). Domethënia e këtyre shërimeve shihet në kontekstin e atypëratyshëm të thënies së Jezusit se ai është Drita e botës (shih 8:12 & 9:5). Judenjtë donin një shenjë; atyre iu dhanë shumë të tilla! Vetëm JHVH mund të hapë sytë!
- C. Ky kapitull është një shëmbëlltyrë me veprime e verbërisë fizike të një njeriu dhe verbërisë shpirtërore të farisenjve (shih v. 39-41; Mat. 6:23).

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:1-12

¹Teksa po kalonte, pa një njeri të verbër nga lindja. ²Dhe dishepujt e pyetën: “Rabbi, kush mëkatoji, ky njeri apo prindërit e tij, që lindi i verbër?” ³Jezusi u përgjigj: “S’ishte as ky njeri që mëkatoji, as prindërit e tij; por kjo ndodhi që veprat e Perëndisë të shfaqen në të. ⁴Ne duhet të kryejmë veprat e atij që më dërgoi për sa kohë që është ditë; po vjen nata kur askush nuk mund të punojë. ⁵Për sa kohë jam në botë, unë jam Drita e botës”. ⁶Kur tha këtë, pështyu përtokë, bëri baltë me pështymën dhe ia vendosi baltën në sy, ⁷dhe i tha: “Shko, lahu në pellgun e Siloamit” (që përkthehet, i Dërguar). Kështu, ai iku, u la dhe u kthye duke parë. ⁸Atëherë, fqinjët dhe ata që e kishin parë më parë si lypës, po thoshin: “A nuk është ky ai që ulej dhe lypte?” ⁹Të tjerë thoshin: “Ky është”, ndërsa të tjerë thoshin: “Jo, por ngjan me të”. Ai u thoshte: “Unë jam ai”. ¹⁰Kështu, ata i thanë: “Po atëherë, si t’u hapën sytë?” ¹¹Ai u përgjigj: “Ai që quhet Jezus bëri baltë, më leu sytë dhe më tha: „Shko në Siloam dhe lahu“; kështu, shkova u lava, dhe mora shikimin”. ¹²Ata i thanë: “Ku është ai?” Ai u tha: “Nuk e di”.

9:1 “të verbër nga lindja” Ky është i vetmi shembull i këtij lloji shërimi. Nuk ekzistonte mundësia e mashtimit.

9:2 “dishepujt” Kjo është përmendja e parë e dishepujve të tij që nga kapitulli 6. Kjo fjalë nënkupton (1) dishepujt judeas të përmendur në kapitullin 7:3 ose (2) të Dymbëdhjetëve.

■ **“kush mëkatoji, ky njeri apo prindërit e tij, që lindi i verbër”** Kjo pyetje ka ngjallur shumë diskutime teologjike. Duhet ta interpretojmë në kuadër të judaizmit të lashtë, jo sipas feve lindore. Ka një sërë mundësish.

1. kjo bën fjalë për mëkatet e paralindjes, të cilat rabinët i teorizonin nga Zan. 25:22
2. bën fjalë për mëkatet e prindërve, ose paraardhësve të afërt, të cilat preknin fëmijën e palindur (shih Eks. 20:5; LiP. 5:9)
3. bën fjalë për marrëdhënien mes mëkatit dhe sëmundjes, diçka tejet e përhapur në teologjinë rabinike (shih Jakobi 5:15-16; Gjoni 5:14)

Kjo s’ka të bëjë fare me teologjinë ciklike lindore të rimishërimit, apo me rrotën e *karmës*. Ky është një kontekst judaik. Për një diskutim të vlefshëm për këtë çështje shih James W. Sire, *Scripture Twisting* (*Shtrembërimi i Shkrimit*), f. 127-144.

9:3 Ky varg jep përgjigjen e Jezusit për pyetjen e dishepujve në v. 2. Nënkuptohen një sërë të vërtetash: (1) mëkati dhe sëmundja nuk janë të lidhura në mënyrë automatike dhe (2) shpesh, problemet sigurojnë mundësinë për bekimin e Perëndisë.

9:4 “Ne... mua” Këto PËREMRA qartazi nuk përkojnë. Një sërë dorëshkrimesh greke ndryshojnë njëri-njëri ose tjetri për të sjellë përkim nga ana gramatikore. Duket se ato pasqyrojnë pozicionin teologjik se, ashtu si Jezusi ishte drita e botës, kështu dhe ne duhet ta pasqyrojmë atë dritë në kohën tonë (shih Mat. 5:14).

▣ **“po vjen nata”** Një krahasim me v. 5 tregon se kjo është qartazi metaforike. Nata mund të përfaqësojë

1. gjykimin e ardhshëm
2. një periudhë mundësie të mbyllur
3. refuzimin dhe kryqëzimin e Jezusit

9:5 “Për sa kohë jam në botë” Kjo duket se bën fjalë për periudhën e mishërimit, kohën nga Betlehemi në Kalvar/mali i Ullinjve. Jezusi ishte këtu vetëm për një periudhë të kufizuar. Dëgjuesit e tij duhet t’i përgjigjen tani mesazhit të tij. Kjo frazë është teologjikisht paralele me v. 4.

Pyes veten se sa shumë nënkupton termi “unë jam” në një kontekst si ky!

▣ **“unë jam Drita e botës”** Gjoni përdor shpesh “dritën” dhe “errësirën” si metafora të realiteteve shpirtërore. Jezusi si “drita e botës” (shih 1:4-5, 8-9; 3:17-21; 8:12; 9:5; 12:46) ndoshta reflekton nënkuptimet mesianike të DhV (shih Isa. 42:6; 49:6; 51:4; 60:1, 3). Shih shënimin në 8:12.

9:6 “bëri baltë me pështymën” Pështyma ishte ilaç shtëpiak për judenjët. Nuk lejohej të përdorej në shabat (shih v. 14). Ungjijtë regjistrojnë tre shembuj të përdorimit të pështymës nga Jezusi (shih Marku 7:33; 8:23 dhe këtu). Duke përdorur këtë metodë të pranuar, madje dhe të pritshme, shërimi, Jezusi po inkurajonte fizikisht besimin e këtij njeriu, por, gjithashtu, po sfidonte qëllimisht traditat dhe rregullat e farisenjve!

9:7 “pellgu i Siloamit” Siloam do të thotë “ai që është dërguar”. Ky pellg përdorej në ritualin e festës së Çadrave.

▣ **“(që përkthehet, i Dërguar)”** Termi “i dërguar” lidhet me faktin se uji i pellgut merrej me tubacion nga burimet e Gihonit, që ishte jashtë mureve të qytetit të Jerusalemit. Rabinët e lidhnin fjalën “i dërguar” me ngjyrimet mesianike. Ky është një tjetër koment redaktorial nga autori.

▣ **“lau”** Ky ishte akti i besimit të tij. Ai veptoi sipas fjalëve të Jezusit! Mirëpo ky s’ ishte ende “besim shpëtues” (shih v. 11, 17, 36, 38). Ishte besim në proces e sipër. Nga të gjithë ungjijtë, Gjoni zbulon “nivele” besimi. Kapitulli 8 tregon një grup që “besoi”, por jo për shpëtim (shih Mat. 13; Marku 4; shëmbëlltyra e llojeve të dheut).

TEMË E VEÇANTË: KOHËT E FOLJEVE GREQISHT QË PËRDOREN PËR SHPËTIMIN

Shpëtimi nuk është produkt, por marrëdhënie. Nuk përfundon kur njeriu beson në Krishtin; sapo ka filluar! Nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por një jetë ku njeriu sa vjen e bëhet si Krishti. Në Amerikë ekziston një proverb që thotë se, sa më tepër të jetojë çifti së bashku, aq më tepër i ngjasin njëri-tjetrit. Ky është synimi i shpëtimit!

SHPËTIMI SI VEPRIM I PLOTËSUAR (AORIST)

- Veprat 15:11
- Romakëve 8:24
- 2 Timoteut 1:9
- Titit 3:5
- Romakëve 13:11 (kombinon AORISTIN me një orientim TË ARDHSHËM)

SHPËTIMI SI GJENDJE EKZISTENCE (E KRYERA)

- Efesianët 2:5, 8

SHPËTIMI SI PROCES I VAZHDUAR (E TASHMJA)

- 1 Korintasve 1:18; 15:2
- 2 Korintasve 2:15
- 1 Pjetrit 3:21

SHPËTIMI SI PËRMBUSHJE E ARDHSHME (KOHË E ARDHME në FOLJE, ose konteksti)

- Romakëve 5:9, 10; 10:9, 13
- 1 Korintasve 3:15; 5:5
- Filipianëve 1:28
- 1 Thesalonikasve 5:8-9
- Hebrenjve 1:14; 9:28
- 1 Pjetrit 1:5, 9

Si rrjedhojë, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13), por kjo duhet të rezultojë në një proces besimi në stilin e jetesës (shih Rom. 8:29; Gal. 2:19-20; Efe. 1:4; 2:10), që, një ditë, do të përmbushet me shikim (shih 1 Gjonit 3:2). Kjo gjendje përfundimtar quhet përlëvdim. Kjo mund të ilustruhet si

1. Shpëtimi fillestar – shfajësimi (shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit)
2. Shpëtimi përparues – shenjtërimi (shpëtuar nga fuqia e mëkatit)
3. Shpëtimi përfundimtar – përlëvdimi (shpëtuar nga prania e mëkatit)

9:8 “fqinjët” Në këtë kapitull përmenden tre grupe që japin dëshmi për këtë mrekulli: (1) fqinjët e tij (v. 8); (2) vetë i verbri (v. 11); dhe (3) prindërit e tij (v. 18). Kishte mospajtime mes fqinjëve, ashtu siç kishte edhe mes farisenjve, për shërimin e tij.

■ **“A nuk është ky ai që ulej dhe lypte”** Kjo pyetje greqisht pret përgjigjen “po”.

9:9: “unë jam ai” Kjo është e njëjta shprehje në greqisht që Jezusi përdori në 4:26; 6:20; 8:24,28,58; 13:19; 18:5,6,8. Ky kontekst tregon se kjo formë nuk kishte automatikisht ngjyrimë hyjnore. E njëjta vagulli ekziston edhe për termin *kurios*, të përdorur në vargjet 36 (zotëri) dhe 38 (Zot) të këtij kapitulli.

9:11-12 Kjo bisedë tregon se shërimi i këtij njeriu nuk nënkuptoi aty për aty shpëtimin e tij shpirtëror. Besimi i tij zhvillohet përmes takimeve me Jezusin (shih v. 35).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:13-17

¹³Ata sollën të farisenjtë atë që më parë kishte qenë i verbër. ¹⁴Dhe ishte shabat dita kur Jezusi bëri baltën dhe i hapi sytë. ¹⁵Kështu, edhe farisenjtë e pyetën atë sërish sesi e kishte marrë shikimin. Dhe ai u tha: “Ai më vendosi baltë në sy, u lava dhe shikoj. ¹⁶Kështu, disa nga farisenjtë thanë: “Ky njeri nuk është nga Perëndia, sepse ai nuk mban shabatën”. Por të tjerë thoshin: “Si mundet një njeri që është mëkatar të kryejë shenja të tilla?” Dhe pati ndasi mes tyre. ¹⁷Kështu, ata i thanë sërish të verbrit: “Çfarë thua për të, meqë të hapi sytë?” Dhe ai u tha: “Ai është profet”.

9:13 “ata” Kjo duhet të nënkuptojë fqinjët.

■ **“farisenjtë”** Krerët e judenjve përmenden me dy terma të ndryshëm te Gjoni. Zakonisht, përmenden me termin “judenjtë” (shih v. 18, 22). Megjithatë, në këtë kapitull, quhen farisenj, në v. 13, 15, 16 dhe 40. Shih Temën e Veçantë në 1:24.

9:14 “ishte shabat dita kur Jezusi bëri baltën dhe i hapi sytë” Rregullat tradicionale të krerëve të judenjve (Traditat Gojore të kodifikuara në Talmud) kishin përparësi ndaj nevojave të këtij personi (shih 5:9; 9:16; Mat. 23:24). Duket pothuajse sikur Jezusi veproi në shabat qëllimisht me synim që të hynte në dialog teologjik me këta krerë. Shih shënimin në 5:9.

9:16 Farisenjtë ndoshta e bazuan gjykimin e tyre për Jezusin në LiP. 13:1-5.

■ **“pati ndasi mes tyre”** Jezusi gjithmonë shkakton përçarje (shih 6:52; 7:43; 10:19; Mat. 10:34-39).

9:17 “Ai është profet” Ky kapitull tregon zhvillimin e besimit të këtij njeriu (shih v. 36, 38). Për fjalën “Profet” shih Temën e Veçantë në 4:19.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:18-23

¹⁸Atëherë, judenjtë nuk besuan se kishte qenë i verbër dhe kishte marrë shikimin, derisa thirrën vetë prindërit e atij që kishte marrë shikimin ¹⁹dhe i pyetën duke u thënë: “A është ky biri juaj, që ju thoni që kishte lindur i verbër? Po atëherë, si sheh tani?” ²⁰Prindërit e tij iu përgjigjën dhe thanë: “Ne e dimë se ky është biri ynë, dhe se kishte lindur i verbër; ²¹por sesi shikon tani, nuk e dimë; as se kush i hapi sytë, nuk e dimë. Pyeteni; ai është në moshë, do të flasë për vete”. ²²Prindërit e tij thanë kështu ngaqë kishin frikë prej judenjve; sepse judenjtë kishin rënë tashmë dakord se, nëse dikush do ta rrëfente si Krisht, duhet të përjashtohet nga sinagoga. ²³Për këtë arsye, prindërit e tij thanë: “ai është në moshë; pyeteni”.

9:22-23 “nëse dikush do ta rrëfente si Krisht” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Prindërit u druheshin këtyre krerëve judenj. Kishte një sërë dëshmitarësh që e bënë të vlefshëm këtë shërim: (1) fqinjët (v. 8-10); (2) vetë i shëruari (v. 11-17, 24-33); dhe (3) prindërit e tij (v. 18-23).

TEMË E VEÇANTË: RRËFIMI

- A. Ka dy forma të së njëjtës rrënjë greqisht që përdoren për rrëfimin e mëkatit ose rrëfimin e besimit, *homologeō* dhe *eksomologeō*. Termi i përbërë që përdor Jakobi vjen nga *homo*, “i njëjtë”; *legō*, “flas”; dhe *eks*, “jashtë nga”. Kuptimi bazë është të thuash të njëjtën gjë, të pajtohesh me dikë. *Eks* i shtohet idesë së shpalljes publike.
- B. Përkthimet e grupit të kësaj fjale janë
1. Lavdëroj
 2. Pajtohem
 3. Shpall
 4. Rrëfej (besimin)
 5. Rrëfej (fajin)
- C. Ky grup fjalësh ka dy lloj përdorimesh që, në dukje, janë të kundërta
1. Lavdëroj (Perëndinë)
 2. Pranoj mëkatin
- Këto mund jenë zhvilluar nga ndjesia që ka njerëzimi për shenjtërinë e Perëndisë dhe për mëkatin e vet. Kur pranon një rën të vërtetë, ke pranuar dhe tjetrën.
- D. Përdorimet në DhR të këtij grupi fjalësh janë
1. Premtoj (shih Mat. 14:7; Veprat 7:17)
 2. Bie dakord, ose jap miratimin, për diçka (shih Gjoni 1:20; Luka 22:6; Veprat 24:14; Heb. 11:13)
 3. Lavdëroj (shih Mat. 11:25; Luka 10:21; Rom. 14:11; 15:9)
 4. Jap miratimin për
 - a. Një person (shih Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; Rom. 10:9; Fil. 2:11; 1 Gjonit 2:23; Zbu. 3:5)
 - b. Një të vërtetë (shih Veprat 23:8; 1 Gjonit 4:2)
 5. Bëj një shpallje publike (kuptimi ligjor u zhvillua në pohim fetar, shih Veprat 24:14; 1 Tim. 6:13)
 - a. pa pranuar fajin (shih 1 Tim. 6:12; Heb. 10:23)
 - b. me një pranim faji (shih Mat. 3:6; Veprat 19:18; Heb. 4:14; Jakobi 5:16; 1 Gjonit 1:9)

9:22 “duhet të përjashtohet nga sinagoga” Qartazi, prindërit i druheshin përjashtimit nga sinagoga (shih 12:42; 16:2). Kjo procedurë ndoshta daton që nga koha e Esdrës (shih 10:8). Nga literatura rabinike, dimë se kishte tre lloje përjashtimi: (1) për një javë; (2) për një muaj; ose (3) për gjithë jetën.

Gjoni, i cili shkruan nga vitet e fundit të shekullit të parë, e njëjtte mirë përjashtimin nga sinagoga për shkak të rrëfimit të besimit në Jezusin si Krisht. Këto “formula mallkimi” historike u zhvilluan nga farisenjtë pas vitit 70 pas K. kur judaizmi pati një ripërtëritje në Javne.

■ **“duhej përjashtuar nga sinagoga”** Kjo ishte vepër e rëndë përjashtimi nga bashkësia dhe komuniteti (shih 12:42; 16:2).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:24-34

²⁴Atëherë, ata e thirrën për së dyti njeriun që kishte qenë i verbër dhe i thanë: “Jepi lavdi Perëndisë; ne e dimë se ky njeri është mëkatar”. ²⁵Atëherë, ai u përgjigj: “Nëse është mëkatar, nuk e di; një gjë di, se isha i verbër, por tani shoh”. ²⁶Kështu, ata i thanë: “Çfarë të bëri ai? Si t’i hapi sytë?” ²⁷Ai u përgjigj: “Jua thashë tashmë dhe nuk më dëgjuat; pse doni ta dëgjoni sërish? S’besoj se doni të bëheni edhe ju dishepuj të tij, apo jo?” ²⁸Ata e fyen dhe i thanë: “Ti je dishepull i tij, por ne jemi dishepuj të Moisiut. ²⁹Ne e dimë se Perëndia i ka folur Moisiut, por sa për këtë njeri, nuk e dimë se nga vjen”. ³⁰Burri u përgjigj dhe u tha: “Epo, kjo qenka gjë e habitshme, që ju nuk dini nga vjen ai, e megjithatë ai më hapi sytë. ³¹Ne e dimë se Perëndia nuk dëgjon mëkatarët, por nëse dikush i druhet Perëndisë dhe bën vullnetin e tij, ai e dëgjon. ³²Që nga fillimi i kohës nuk është dëgjuar kurrë që dikush të hapte sytë e një njeri që kishte lindur i verbër. ³³Nëse ky njeri nuk do të ishte nga Perëndia, nuk do të mund të bënte asgjë”. ³⁴Ata iu përgjigjën: “Ti je lindur i tëri në mëkat, dhe na mëson ne?” Kështu e nxorën jashtë.

9:24 “Jepi lavdi Perëndisë” Kjo ishte formulë betimi për t’u siguruar se do të thuhej e vërteta (shih Jozueu 7:19).

9:25 Kjo përgjigje duhet t'i referohet v. 16. Ai njeri nuk donte të debatonte teologji, por pohon rezultatet e takimit me Jezusin.

9:27 “S”**besoj se dhe ju doni të bëheni dishepuj të tij, apo jo**” Forma gramatikore greqisht pret përgjigjen “jo”, por vetë shtrimi i kësaj pyetjeje ishte një ironi e fortë dhe tregon mendjemprehtësinë e këtij lypsi të verbër.

9:28a “**Ti je dishepull i tij**” Një pyetje reale është se në ç’ pikë të këtij kapitulli u bë besimtar ky njeri. Duket se, në fillim, shërimi i Jezusit nuk lidhej me besimin e këtij njeriu në të si Mesi; vetëm më vonë e përballi Jezusi me pohimet e tij mesianike (shih v. 36-38). Ky episod tregon se shërimi fizik nuk sjell domosdoshmërisht shpëtim.

9:28b-29 Kjo tregon vështirësinë me të cilën përballëshin krerët fetarë. Ata përpiqeshin të barazonin interpretimet e hollësishme dhe të veçanta të Traditës Gojore (Talmudit) me zbuluesën e frymëzuar të Moisiut. Atyre u ishin verbuar sytë nga paragjykimet teologjike (shih Mat. 6:23). Ishin dishepuj të traditave njerëzore (shih Isa. 29:13).

9:29 “**nuk e dimë se nga vjen [ai]**” Ky është një shembull tjetër i ironisë së Gjonit (shih 7:27-28; 8:14). Jezusi kishte ardhur nga Ati (shih 8:42; 13:3; 16:28), por, në verbërinë e tyre, dishepujt nuk e dinin

1. origjinën e tij
2. vendlindjen e tij

9:30 “**Epo, kjo qenka gjë e habitshme, që ju nuk dini nga vjen ai, e megjithatë ai më hapi sytë**” Ky është një tjetër shembull i mendjemprehtësisë së fortë dhe ironisë therëse të këtij lypsi të verbër teksa hedh poshtë logjikën e farisenjve.

9:31-33 Ky i verbër dhe i paarsimuar kishte një teologji më të mirë dhe më koherente sesa krerët fetarë!

9:33 “**Nëse**” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “në kundërshtim me faktin”. Duhet kuptuar kështu: “nëse ky njeri nuk do të kishte ardhur nga Perëndia, por ja që prej tij erdhi, atëherë s’do të mund të bënte asgjë të tillë, mirëpo e bëri”.

9:34 “**Ti je lindur i tëri në mëkat**” Është interesante të vërejmë se judaizmi rabinik nuk e kishte konceptin e “mëkatit fillestar” (shih Jobi 14:1, 4; Psa. 51:5). Rënia, në Zanafilla 3, nuk theksohej në judaizmin rabinik. Judenjtë pohonin se në çdo njeri kishte një synim (*jeceer*) të mirë dhe një të keq. Këta farisenj po thoshin se dëshmia dhe logjika e këtij njeriu të shëruar ishin të pavlefshme sepse, qartazi, ai ishte mëkatar; provë për këtë ishte fakti se kishte lindur i verbër.

■ “**e nxorën jashtë**” Fjalë për fjalë, “e flakën jashtë”. Bëhet fjalë për (1) anëtarësinë dhe pjesëmarrjen në sinagogën lokale, ose (2) përjashtimin nga ai takim. Në këtë kontekst, #2 duket më e mira.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:35-41

³⁵Jezusi dëgjoi që e nxorën jashtë dhe e gjeti. I tha: “A beson në Birin e Njeriut?” ³⁶Ai u përgjigj: “Kush është ai, Zot, që të besoj në të?” ³⁷Jezusi i tha: “Ti edhe e ke parë, edhe është ai që po të flet”. ³⁸Dhe ai tha: “Zot, unë besoj”. Dhe e adhuroi. ³⁹Jezusi i tha: “Për gjykim erdha në këtë botë, që ata që nuk shohin të shohin, ndërsa ata që shohin të verbohen”. ⁴⁰Ata prej farisenjve që ishin me Jezusin i dëgjuan këto gjëra dhe i thanë: “Mos jemi dhe ne të verbër?” ⁴¹Jezusi u tha: “Po të ishit të verbër, nuk do të kishit mëkat; por meqë thoni, „ne shohim“, mëkati juaj mbetet”.

9:35

NASB, NRSV,

TEV, NJB “A beson në Birin e Njeriut?”

NKJV “A beson në Birin e Perëndisë?”

Dorëshkrimet e lashta uncial greke A dhe L shkruajnë “Biri i Perëndisë”, ndërsa P⁶⁶, P⁷⁵, א, B, D dhe W shkruajnë “Biri i Njeriut”. Nga terminologjia e Gjonit, dhe nga të dhënat e dorëshkrimeve, “Biri i Njeriut” duket shumë më i përshtatshëm dhe ka gjasa të jetë origjinali. UBS⁴ i jep “njeriut” vlerësimin “A” (e sigurt). Nga ana gramatikore, kjo pyetje pret përgjigjen “po”.

9:36

NASB, NKJV “Zot”

NRSV, TEV,

NJB “zotëri”

Mund të shohim zhvillimin teologjik të besimit të këtij njeriu brenda këtij kapitulli; ai e thërret Jezusin

1. njeri (v. 11)
2. pastaj, profet (v. 17)
3. pastaj, i jep titullin e nderuar “Zotëri” (v. 36)
4. dhe, pastaj, “Zot”, në kuptimin e plotë teologjik të këtij termi (v. 38)

Fjala në greqisht është e njëjtë, si në v. 36, ashtu dhe në v. 38. Vetëm konteksti mund të përcaktojë ngjyrimin. Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë, në 6:20. Fjala greke *Kurios* reflekton fjalën hebraisht *Adon*, që u bë zëvendësuese gojore e JHVH-së.

9:30 “Për gjykim erdha në këtë botë” Kjo duket në përputhje me 5:22, 27, që bën fjalë për gjykimin në fund të kohës (eskatologjik). Sidoqoftë, duket sikur kundërshton 3:17-21 dhe 12:47, 48. Kjo mund të pajtohet nga fakti se Jezusi erdhi me qëllim shpengimin, por njerëzit që refuzojnë ofertën e tij dënojnë automatikisht vetveten.

■ **“që ata që nuk shohin të shohin, ndërsa ata që shohin të verbohen”** Kjo ishte përmbushje e dyfishtë e profecisë, sidomos asaj të Isaisë.

1. izraeliti krenar nuk do të kuptojë mesazhin e Perëndisë (shih Isa. 6:10, 42:18-19; 43:8; Jer. 5:21; Ezek. 12:2)
2. të varfrit, të përjashtuarit, të sëmurët fizikisht, që pendohen dhe përulen, do të kuptojnë (shih Isa. 29:18; 32:3-4; 35:5; 42:7,16)

Jezusi është drita e botës për gjithë ata që zgjedhin të shohin (shih 1:4-5, 8-9).

9:40 “Mos jemi dhe ne të verbër” Sintaksa në greqisht pret përgjigjen “jo” (shih Mat. 15:14; 23-24). Këto vargje të fundit tregojnë se ky kapitull ishte një shëmbëlltje e aktruar e verbërisë shpirtërore që nuk mund të shërohet (mëkati i pafalshëm i mosbesimit, shih Temën e Veçantë në 5:21), dhe e verbërisë fizike që mund të shërohet!

9:41 Ky varg shpreh një të vërtetë të përgjithshme (shih 15:22, 24; Rom. 3:20; 4:15; 5:13; 7:7, 9). Njerëzit konsiderohen përgjegjës për dritën që kanë, ose për dritën që kanë parë!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Çfarë trajton kryesisht ky kapitull: shërimin fizik, apo shërimin shpirtëror? Verbërinë fizike, apo verbërinë shpirtërore?
2. Si mund të kishte mëkatuar ky njeri para se të lindte?
3. Në ç’pikë në këtë kapitull merr shpëtimin ky njeri?
4. A erdhi Jezusi në botë për të gjykuar botën, apo për ta shpëtuar?
5. Shpjego sfondin e termi “Biri i Njeriut”.
6. Rendit pikat e ironisë në përgjigjet që i verbri u dha krerëve judenj.

GJONI 10

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shëmbëlltyra e vathës së dhenve 10:1-6	Jezusi, Bariu i vërtetë 10:1-6	Jezusi, Bariu që jep jetë 10:1-6	Shëmbëlltyra e bariut 10:1-5 10:6	Bariu i mirë 10:1-5 10:6
Jezusi, Bariu i mirë 10:7-18	Jezusi, Bariu i mirë 10:7-21	10:7-10 10:11-18	Jezusi, Bariu i mirë 10:7-10 10:11-16 10:17-18	10:7-18
10:19-21		10:19-21	10:19-20 10:21	10:19-21
Jezusi refuzohet nga judenjtë 10:22-30	Bariu i njeh delet e veta 10:22-30	10:22-30	Jezusi refuzohet 10:22-24 10:25-30	Jezusi pohon se është Biri i Perëndisë 10:22-30
10:31-39	Përpjekje të reja për të vuarë Jezusin me gurë 10:31-39	10:31-39	10:31-32 10:33 10:34-38 10:39	10:31-38 10:39
10:40-42	Besimtarët përtej Jordanit 10:40-42	10:40-42	10:40-42	Jezusi tërhiqet matanë Jordanit 10:40-42

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:1-6

¹“Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: ai që nuk hyn nga dera në vathën e dhenve, por ngjitet me ndonjë mënyrë tjetër, është vjedhës dhe kusar. ²Por ai që hyn nga dera është bari i deleve. ³Atij ia hap derëtari, delet ia dëgjojnë zërin, ai i thërret delet e tij me emër dhe u prin jashtë. ⁴Pasi i nxjerr delet e tij, shkon përpara tyre, dhe delet e ndjekin sepse ia njohin zërin. ⁵Një të huaj ato s’e ndjekin fare, por ikin me vrap prej tij, sepse nuk e njohin zërin e të huajve”. ⁶Këtë shëmbëlltje ua tha Jezusi, por ata nuk e kuptuan se çfarë po u thoshte.

10:1 “Me të vërtetë, me të vërtetë” Shih shënimin në 1:51.

■ **“por ngjitet me ndonjë mënyrë tjetër, është vjedhës dhe kusar”** Vini re se ka disa brenda vathës që nuk i përkasin bariut të mirë (shih Mat. 7:21-23 dhe “Shëmbëlltja e Grurit dhe Egjërës”, Mat. 13:24-30). Problemi këtu është se disa po përipiqen që, me forcat e tyre, të arrijnë atë që Perëndia na ofron falas në Krishtin (shih Rom. 3:19-31; 9:30-33; 10:2-4; Gal. 2:16; 5:4). Një shembull i kësaj janë farisenjtë e kapitullit 9.

10:2 “Por ai që hyn nga dera është bari i deleve” Kjo është një përzjerje shumë e dukshme metaforash në këtë kapitull. Jezusi është dera e dhenve, v. 7, por edhe bari i dhenve (v. 11 dhe 14). Gjithsesi, kjo përzjerje metaforash nuk është e pazakontë për Gjonin dhe DhR.

1. Jezusi është buka dhe dhënësi i bukës (shih vargjet 6:35, 51)
2. Jezusi është e vërteta dhe folësi i së vërtetës (shih v. 8:45-46 dhe 14:6)
3. Jezusi është udha dhe ai që dëfton udhën (14:6)
4. Jezusi është flija dhe ai që ofron flinë (shih Librin e Hebrenjve).

Titulli “bari” ishte një titull i zakonshëm në DhV për Perëndinë, por edhe për Mesinë (shih Psa. 23: Psa. 80:1; Isa. 40:10-11; 1 Pjet. 5:1-4). Krerët e judenjve thirren “barinj të rremë” te Jeremia 23; Ezekieli 34 dhe Isa. 56:9-12. Termi “bari” lidhet me termin “pastor” (shih Efe. 4:11; Titi 1:5, 7).

10:3 “delet ia dëgjojnë zërin” Njohja dhe bindja bazohen në marrëdhënie. Te Gjoni, si “dëgjoj” (shih 4:42; 5:24,25,28-29; 8:47; 10:16,27; 18:37), ashtu dhe “shoh” (shih 3:3; 12:40; 20:8), përdoren për besimin në Jezusin si Krishti.

■ **“ai i thërret delet e tij me emër”** Jezusi i njuh të vetët personalisht dhe individualisht (njësoj si JHVH, shih 10:29-31). Shpesh, barinjët u vinin nofka kafshëve të tyre, edhe kur kishin shumë bagëti.

Është tronditëse nga ana teologjike që Jezusi i thërret delet e tij të vërteta nga mesi i deleve të rreme të kombit të Judës. Populli i besëlidhjes nuk ishte populli i vërtetë i Perëndisë. Ky është skandali radikal i Besëlidhjes së Re. E ardhmja e njeriut përcaktohet nga besimi, jo prejardhja e tij! Besimi është personal, jo kombëtar.

■ **“dhe u prin jashtë”** Kjo nuk bën fjalë vetëm për shpëtimin, por edhe për udhëheqjen e përditshme (shih v. 4 & 9).

10:4 Ndoshta, këtu bëhet fjalë për zakonet e mbajtjes së disa tufave me bagëti brenda një vathe gjatë natës. Në mëngjes, bariu thërriste dhe deleve e tij shkonin tek ai.

10:5 Kisha është detyruar gjithmonë që të përballet me barinjët e rremë (shih 1 Tim. 4:1-3; 2 Tim. 4:3-4; 1 Gjonit 4:5-6; 2 Pjetrit 2).

10:6 “Këtë shëmbëlltje ua tha Jezusi” Kjo nuk është fjala normale që përkthehet “shëmbëlltje” (*parabolë*), por vjen nga e njëjta rrënjë (*paroiimian*). Kjo formë gjendet vetëm këtu dhe në 16:25, 2 dhe 2 Pjet. 2:22. Ndonëse është formë e ndryshme, duket se është sinonimike me termin më të zakonshëm “shëmbëlltje” (e përdorur në ungjijtë sinoptikë). Zakonisht, fjala “shëmbëlltje” do të thotë të vendosësh një veçori të zakonshme kulturore përbri një të vërtete shpirtërore në mënyrë që të ndihmosh dëgjuesin të kuptojë. Sidoqoftë, mund të nënkuptojë edhe fshehjen e së vërtetë nga sytë e verbër shpirtërorë (shih 16:29; Marku 4:11-12).

▣ **“por ata nuk e kuptuan”** Nëse kapitulli 10 lidhet nga ana kohore me kapitullin 9, “ata” janë farisenjtë. Ata pretendonin se shihnin (shih 9:41), por nuk shihnin (shih 10:20). Në vend të bëhet urë, shpesh feja bëhet pengesë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:7-10

⁷Kështu, Jezusi u tha atyre sërish: “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: unë jam dera e dhenve. ⁸Të gjithë ata që erdhën para meje janë vjedhës dhe kusarë, por delet nuk i dëgjuan. ⁹Unë jam dera; nëse dikush hyn përmes meje, do të shpëtohet, do të hyjë, do të dalë e do të gjejë kullotë. ¹⁰Vjedhësi hyn vetëm për të vjedhur, për të vrrarë dhe për të shkatërruar; unë erdha që ata të kenë jetë, madje ta kenë me bollëk”.

10:7 “unë jam dera e dhenve” Kjo është një nga shtatë pohimet e famshme “Unë Jam” të Jezusit. Kjo metaforë thekson të vërtetën se Jezusi është e vetmja udhë e vërtetë (shih 8, 10; 14:6). Shpesh, ky quhet skandali i ekskluzivizmit të ungjillit. Nëse Bibla është vetëzbuluesja e Perëndisë, atëherë ka vetëm një mënyrë për të qenë në rregull me Perëndinë – besimi në Krishtin (shih Veprat 4:12; 1 Tim. 2:5). Shih shënimin në 8:12.

10:8 “Të gjithë ata që erdhën para meje janë vjedhës dhe kusarë” Për shkak të kontekstit të kapitujve 9 dhe 10, festa e Përkushtimit, Hanukkah (shih 10:22), ka gjasa që kjo të ketë lidhje me pretendimet mesianike të makabejve dhe pasardhësve të tyre gjatë periudhës ndërthjatore. Megjithatë, ndoshta, kjo u referohet pasazheve të DhV që flasin për barinj të rremë (shih Isa. 56:9-12; Jeremia 23; Ezekieli 34; dhe Zakaria 11).

Kjo gjuhë tejet e figurshme, si dhe format e paqarta pararendëse, bënë që kopjuesit e hershëm të modifikonin ose zgjeronin tekstin në përpjekjen për të shpjeguar kuptimin. Një dorëshkrim (D) thjesht hoqi termin përfshirës “të gjithë”, ndërsa një sërë dorëshkrimesh të hershme (P⁴⁵, P⁷⁵, N*), hoqën frazën “para meje”.

10:9 “nëse dikush hyn përmes meje, do të shpëtohet” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË me një FOLJE TË ARDHSHME PËSORE. Jezusi është e vetmja udhë te Perëndia (shih 14:6). FOLJA “shpëtohet” në këtë kontekst ndoshta i referohet ngjyrimit të çlirimit fizik të DhV (pra, dhentë janë të sigurta). Megjithatë, shpesh, Gjoni zgjedh fjalë që kanë dy kuptime të mbivendosura. As koncepti i shpëtimit shpirtëror nuk mungon në këtë kontekst (v. 42).

10:10 “Vjedhësi” Kjo tregon motivet e fshehta të barinjve të rremë. Po kështu, pasqyron dhe synimin e të ligut! Ky qëndrim pakujdesie nga ana e punëtorëve rrogëtarë mund të shihet në v. 12-13.

▣ **“për të shkatërruar”** Shih Temën e Veçantë vijuese.

TEMË E VEÇANTË: SHKATËRRIMI (APOLLUMI)

Ky term ka një fushë të gjerë semantike, gjë që ka shkaktuar pështjellim të madh në lidhje me konceptet teologjike të gjykimit të përjetshëm përkundër asgjësimit. Kuptimi bazë i fjalëpërfjalshëm është “nga” apo plus *ollumi*, “shkatërroj, rrënoj”.

Problemi vjen nga përdorimet e figurshme të këtij termi. Kjo mund të shihet qartë në Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament, Based on Semantic Domains* [*Leksik greqisht-anglisht i Dhiatës së Re, bazuar në domenet semantike*], vëll. 2, f. 30. Ata rendisin disa kuptime të këtij termi

1. shkatërroj (p.sh. Mat. 10:28; Luka 5:37; Gjoni 10:10; 17:12; Veprat 5:37; Rom. 9:22 nga vëll. 1, f. 232)
2. s'arrij të përftoj (p.sh., Mat. 10:42; vëll. 1, f. 566)
3. humbas (p.sh., Luka 15:8, vëll. 1, f. 566)
4. i pavetëdijshëm për vendndodhjen (p.sh., Luka 15:4; vëll. 1, f. 330)
5. vdes (p.sh., Mat. 10:39, vëll. 1, f. 266)

Gerhard Kittel, *Theological Dictionary of the New Testament* [*Fjalor teologjik i Dhiatës së Re*] përpiket të përvijojë përdorimet e ndryshme duke renditur katër kuptime:

1. shkatërroj, ose vras (p.sh. Mat. 2:13; 27:20; Marku 3:6; 9:22; Luka 6:9; 1 Kor. 1:19)
2. humbas ose pësoj humbje nga (p.sh., Marku 9:41; Luka 15:4, 8)
3. humbas (p.sh. Mat. 26:52; Marku 4:38; Luka 11:51; 13:3,5,33; 15:17; Gjoni 6:12,27; 1 Kor. 10:9-10)
4. të jesh i humbur (p.sh., Mat. 5:29-30; Marku 2:22; Luka 15:4, 6, 24, 32; 21:18; Veprat 27:34)

Më tej, Kittel thotë: “në përgjithësi, mund të themi se #2 dhe #4 gjenden në thëniet që lidhen me këtë botë, si te ungjijtë sinoptikë, ndërsa #1 dhe #3 gjenden në ato thënie që lidhen me botën tjetër, si te Pali dhe Gjoni” (f. 394).

Këtu qëndron dhe pështjellimi. Ky term ka një përdorim kaq të gjerë semantik sa që autorë të ndryshëm të DhR e përdorin në një larmi mënyrash. Mua më pëlqen Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [*Sinonime të Dhiatës së Vjetër*], f. 275-277. Ai e lidh këtë term me ata njerëz që janë të shkatërruar moralisht dhe presin ndarjen e përjetshme nga Perëndia, në dallim nga ata njerëz që njohin Krishtin dhe kanë jetë të përjetshme në të. Grupi i dytë është “i shpëtuar”, ndërsa i pari shkatërrohet.

Personalisht, nuk mendoj se ky term nënkupton asgjësim (shih E. Fudge, *The Fire That Consumes* [*Zjarri që shkrumbon*]). Fjala “e përjetshme” përdoret si për ndëshkimin e përjetshëm, ashtu dhe për jetën e përjetshme, në Mat. 25:46. Nëse zhvlerëson njërin, zhvlerëson dhe tjetrën!

■ **“Unë erdha që ata të kenë jetë, madje ta kenë me bollëk”** Kjo frazë citohet shumë shpesh si premtim për gjëra materiale, por, në kontekst, bën fjalë për njohjen e Jezusit personalisht dhe për bekimet shpirtërore, jo për begatinë materiale, që sjell ai (është paralele me 4:14 dhe 7:38). Nuk ka të bëjë me pasjen e shumë gjërave në këtë jetë, por me njohjen dhe me zotërimin e jetës së vërtetë!

Ndërsa ungjijtë sinoptikë përmbajnë theksimin që i bën Jezusi mbretërisë së Perëndisë, Gjoni vë në dukje theksimin e jetës së përjetshme nga Jezusi. Mund ta kesh tani! Mbretëria është inauguruar!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:11-18

¹¹“Unë jam bari i mirë; bari i mirë lë jetën e vet për delet. ¹²Ai që është rrogëtar, dhe jo bari, që nuk është pronari i deleve, sheh ujkun që vjen, i braktis delet dhe ia mbath; dhe ujku i rrëmben dhe i shpërndan. ¹³Ai ia mbath ngaqë është rrogëtar dhe nuk do t’ia dijë për delet. ¹⁴Unë jam bari i mirë, i njoh delet e mia dhe ato më njohin, ¹⁵ashtu si Ati me një dhe unë njoh Atin; dhe jap jetën time për delet. ¹⁶Kam dhe dele të tjera, që nuk janë të kësaj vathe; do t’i mbledh edhe ato, dhe ato do të ma dëgjojnë zërin; dhe do të jetë një tufë e vetme, dhe një bari i vetëm. ¹⁷Për këtë arsye më do Ati, sepse unë jap jetën time, që ta marr sërish. ¹⁸Askush s’mund të ma marrë, por e jap vetë. Unë kam autoritet ta lë, e autoritet ta marr përsëri. Këtë urdhërim mora nga Ati im”.

10:11, 14 “Unë jam bari i mirë” Në DhV, ky ishte titull i Mesisë (shih Ezek. 34:23; Zak. 11; 1 Pjet. 5:4) dhe i Jahves (shih Psa. 23:1; 28:9; 77:20; 78:52; 80:1; 95:7; 100:3; Isa. 40:11; Jer. 23:1; 31:10; Ezek. 34:11-16).

Ka dy fjalë greqisht që mund të përkthehen “i mirë”: (1) *agathos*, që, zakonisht, te Gjoni përdoret për gjërat, dhe (2) *kalos*, që në Septuagintë përdorej për t’u referuar të mirës në dallim nga e keqja. Në DhR, kjo fjalë ka kuptimet “i bukur”, “fisnik”, “moral” dhe “i denjë”. Këto dy fjalë përdoren së bashku te Luka 8:15. Shih shënimin në 8:12.

10:11 “bariu i mirë lë jetën e vet për delet” Kjo nënkupton shlyerjen zëvendësuese të Krishtit (shih v. 11, 15, 17, 18). Ai e jep me dëshirë jetën e vet për njerëzimin e mëkatshëm (shih Isa. 52:13-53:12; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). Jeta e vërtetë dhe me mbushulli vjen vetëm nëpërmjet vdekjes së tij.

Libri i Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Komentar tekstual i Dhiatës së Re greqisht], thotë diçka interesante për këtë varg:

“Në vend të shprehjes „lë jetën time“, që është tipike për Gjonin (10:15, 17; 13:37, 38; 15:13; 1 Gjonit 3:16), një sërë dëshmitarësh (P⁴⁵, N*, D), e zëvendësojnë këtë shprehje me “jap jetën time”, që shfaqet në ungjijtë sinoptikë (Mat. 20:28; Marku 10:45)” (f. 230).

10:14 “i njoh delet e mia dhe ato më njohin” Ky është kuptimi hebraisht i fjalës “njoh” (shih Temën e Veçantë në 1:10). Ashtu si Biri njih Atin dhe Ati birin, kështu dhe Jezusi njih ata që besojnë në të dhe ata e njohin. Ata kanë “parë” dhe “dëgjuar” (shih v. 4) dhe i janë përgjigjur atij (shih 1:12; 3:16). Krishterimi është marrëdhënie personale (shih 17:20-26).

10:15 “ashtu si Ati më njih dhe unë njoh Atin” Kjo është temë e përsëritur te Gjoni. Jezusi vepron dhe flet në bazë të marrëdhënies së vet të ngushtë me Atin.

Analogjia e habitshme e v. 14-15 është se marrëdhënia e ngushtë mes Atit dhe Birit krahasohet me marrëdhënien e ngushtë të Birit me ndjekësit (shih 14:23). Gjoni përqendrohet të ngjyrimi hebraik i “njohjes” si bashkësi e ngushtë, jo si fakte që duhen njohur. Jezusi njih Atin; ata që njohin Jezusin, njohin Perëndinë!

10:16 “Kam dhe dele të tjera, që nuk janë të kësaj vathe” Ky është aludim për Isa. 56:6-8. Konteksti duket se kërkon që kjo të nënkuptojë (1) samaritanët (shih 4:1-42), ose (2) kishën e johebrenjve (shih 4:43-54). Kjo bën fjalë për unitetin e gjithë atyre që ushtrojnë besim në Krishtin. Besëlidhja e re bashkon judenjtë me johebrenjtë (shih Efe. 2:11-3:13; vini re dhe 1 Kor. 12:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11)! Zanafilla 3:15 shkrihet me Gjonin 3:16!

■ **“dhe do të jetë një tufë e vetme, dhe një bari i vetëm”** Ky ka qenë gjithmonë synimi i Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6). Aspektet teologjike të këtij uniteti diskutohen në Efe. 2:11-3:13 dhe 4:1-6.

10:17 “Për këtë arsye më do Ati” Ashtu si Biri nuk ishte i detyruar të jepte jetën e vet, as Ati nuk ishte i detyruar të jepte Birin e vet. Kjo nuk duhet interpretuar se Perëndia e shpërbleu njeriun Jezus për bindjen e vet (shpesh, kjo herezi quhet adopsionizëm, shih Fjalorthin).

■ **“unë jap jetën time që ta marr sërish”** Kjo nënkupton ringjalljen. Zakonisht, në DhR, ai që ngre Birin është Ati (shih 18b), për të treguar se ia ka pranuar flijimin. Por këtu theksohet pushteti i vetë Jezusit në ringjallje.

Kjo frazë është mundësi e shkëlqyer për të treguar se, shpesh, DhR ua atribuon veprën e shpengimit të tre personave të Hyjnisë.

1. Perëndia Atë ringjalli Jezusin (shih Veprat 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10)
2. Perëndia Bir ringjalli veten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë ringjalli Jezusin (shih Rom. 8:11)

10:18 “Unë kam autoritet” Ky është i njëjti term që u përdor edhe te 1:12. Mund të përkthehet “autoritet”, “e drejtë ligjore”, ose “pushtet”. Ky varg tregon pushtetin dhe autoritetin e Jezusit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:19-21

¹⁹Lindi sërish një përçarje mes judenjve për shkak të këtyre fjalëve. ²⁰Shumë prej tyre po thoshin: “Ai ka një demon dhe është i çmendur. Pse ia vini veshin?” ²¹Të tjerë po thoshin: “këto nuk janë thënie të një të demonizuar. Demoni s’mund t’u hapë sytë të verbërve, apo jo?”

10:19 Ashtu siç kishte mendime të ndara për Jezusin në 6:52; 7:12,25,43; 9:16; 10:19-21; 11:36-37, ky motiv vazhdon gjatë gjithë Gjonit. Misteri pse disa pranojnë ungjillin, ndërsa disa të tjerë e refuzojnë, është tensioni midis paracaktimit dhe vullnetit të lirë njerëzor!

10:20 “Ai ka një demon dhe është i çmendur” Kjo ishte akuzë e zakonshme kundër Jezusit nga dy pikëvështrime të ndryshme.

1. në këtë varg, ashtu si në 7:20, përdoret për të thënë se Jezusi kishte sëmundje mendore
2. po kjo akuzë përdorej nga farisenjtë në përpjekjen për të shpjeguar burimin e fuqisë së Jezusit (shih 8:48, 52)

10:21 Ka dy pyetje në v. 21.

1. v. 21a ka *ouk*, që pret përgjigjen “po”
2. v. 21b ka *mē*, që pret përgjigjen “jo”

Shih James Hewett, *New Testament Greek*, f. 171. Megjithatë, ky varg tregon sa e vështirë është të gjesh rregulla të prera e të pandryshueshme në greqishten *koine*. Përcaktuesi vendimtar është konteksti, jo forma gramatikore.

Shërimi i të verbërve ishte shenjë mesianike (shih Eks. 4:11; Ps. 146:8; Isa. 29:18; 35:5; 42:7). Në njëfarë kuptimi, këtu po tregohet verbëria e Izraelit (shih Isa. 42:19), ashtu si në kapitullin 9.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:22-30

²²Në atë kohë, në Jerusalem kremtohej festa e Përkushtimit; ²³ishte dimër, dhe Jezusi po ecte në tempull nën portikun e Solomonit. ²⁴Atëherë, judenjtë u mbledhën rreth tij dhe po i thoshin: “Për sa kohë do të na mbash pezull? Nëse je Krishti, na e thuaj troç”. ²⁵Jezusi iu përgjigj: “Unë ua thashë dhe nuk më besuat; veprat që bëj në emër të Atit tim, këto janë ato që dëshmojnë për mua. ²⁶Por ju nuk besoni sepse nuk jeni nga delet e mia. ²⁷Delet e mia më dëgjojnë zërin, unë i njoh dhe ato më ndjekin; ²⁸dhe unë u jap jetë të përjetshme, dhe ato nuk do të humbasin kurrë; dhe askush s’^{m’i} rrëmben dot nga dora. ²⁹Ati im, i cili ^{m’i} ka dhënë, është më i madh nga të gjithë; dhe askush s’është në gjendje t’i rrëmbëjë nga dora e Atit tim. ³⁰Unë dhe Ati jemi një”.

10:22 “festa e Përkushtimit” Jozefusi e quan “Festivali i Dritave”. Në kohën tonë njihet si Hanukkah. Ishte festë tetëditore dhe kremtohej rreth mesit të dhjetorit. Ajo kremton ripërkushtimin e tempullit në Jerusalem pas fitores ushtarake të Juda Makabeut më 164 para K. Më 168 para K., Antiok IV Epifani, i cili ishte udhëheqës seleucid, u përpoq t’i detyronte judenjtë të ndiqnin praktikata heleniste (shih Dan. 8:9-14). Ai e ktheu tempullin në Jerusalem në faltore pagane, madje vuri dhe një altar për Zeusin në Vendin e Shenjtë. Juda Makabeu, një nga bijtë e shumë të priftit të Modinit, e mposhti këtë udhëheqës sirian dhe e pastroi dhe ripërkushtoi tempullin (1 Mak. 4:36-59; 2 Mak. 1:18).

Gjoni i përdor festat e judaizmit si raste ku Jezusi përdor simbolizmin e tyre për t’iu zbuluar krerëve të judenjve, qytetarëve të Jerusalemit dhe turmave me pelegrinë (shih kapitujt 7-11).

■ **“portikun e Solomonit”** Kjo ishte një zonë e mbuluar përgjatë anës lindore të Oborrit të Grave, ku jepte mësim Jezusi. Jozefusi thotë se i kishte mbijetuar shkatërrimit babilonas të 586 para K.

10:23 “ishte dimër” Kjo është hollësi prej dëshmitari okular.

10:24 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij letrare. Ka disa FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË në këtë kontekst (shih v. 24, 35, 37 dhe 38). Ky përdorim në v. 24 tregon sesi mund të përdoret ky konstrukt në kuptimin letrar. Këta farisenj nuk besonin vërtet se Jezusi ishte Mesia; ata po i hidhnin karremin.

■ **“na e thuaj troç”** Ka disa gjëra për të diskutuar në këtë varg. Së pari, Jezusi mësoi me shëmbëlltyra, me gjuhë të figurshme dhe me thënie dualiste e të dykuptimshme. Kjo turmë në tempull donte që ai të shprehej qartë. Shih Temën e Veçantë: *Parrhësia* në 7:4

Së dyti, judenjtë e kohës së Jezusit nuk prisnin që Mesia të ishte Perëndia i mëshiruar. Me sa duket, Jezusi kishte aluduar për faktin se ishte një me Perëndinë në disa raste (shih 8:56-59), por, në këtë kontekst, ata po e pyesnin në mënyrë të veçantë për Mesinë. Judenjtë prisnin që ky i Vajosur të vepronte si Moisiu (shih LiP. 18:15, 19). Jezusi kishte bërë pikërisht këtë në kapitullin gjashtë. Veprat e tij përmbushën profecitë e DhV, sidomos

shërimin e të verbrit (kapitulli 9). Ata kishin gjithë provat e nevojshme. Problemi ishte se Jezusi nuk përshtatej me pritshmëritë e tyre tradicionale ushtarake dhe nacionaliste për Mesinë.

10:25 “veprat që bëj në emër të Atit tim, këto janë ato që dëshmojnë për mua” Jezusi pohoi se veprimet e tij vërtetonin pohimet e tij (shih 2:23; 5:36; 10:25, 38; 14:11; 15:24).

10:26 Ç’thënie tronditëse!

10:28 “u jap jetën e përjetshme” Jeta e përjetshme karakterizohet edhe nga sasia, edhe nga cilësia. Ajo është jeta e epokës së re. Tani, ajo është e disponueshme me anë të besimit në Krishtin (shih 3:36; 11:24-26).

■ **“ato nuk do të humbasin kurrë, dhe askush s’m’i rrëmben dot nga dora”** Kjo është një MOHORE E DYFISHTË me LIDHORE AORISTE MESORE. Ky është një nga pasazhet më të forta për sigurinë e besimtarit në gjithë DhR (shih 6:39). Është e qartë se i vetmi person që mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë është vetja jonë (shih Rom. 8:38-39; Gal. 5:2-4). Siguria e shpëtimit (shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 5:13) duhet ekuilibruar me qëndresën (shih Temën e Veçantë në 8:31). Siguria e shpëtimit duhet bazuar në karakterin dhe veprimet e Perëndisë Triun.

Ungjilli i Gjonit thekson sigurinë e atyre që vazhdojnë të vendosin besimin në Krishtin. Kjo fillon me një vendim fillestar pendimi dhe besimi, gjë që çon në besim në gjithë stilin e jetesës. Problemi teologjik është kur kjo marrëdhënie personale shtrembërohet në një produkt që e zotërojmë (“pasi shpëtohesh një herë, je gjithmonë i shpëtuar”). Besimi i vazhdueshëm është prova e shpëtimit të vërtetë (shih Hebrenjve, Jakobi dhe 1 Gjonit).

10:29

NASB, NKJV “Ati im, që m’i ka dhënë, është më i madh nga të gjithë”

NRSV “Ajo që më ka dhënë Ati im është më e madhe se gjithçka tjetër”

TEV “Ajo që më ka dhënë im Atë është më e madhe se gjithçka”

NJB “Ati im, për atë që më ka dhënë, është më i madh se të gjithë”

Pyetja është se cili është KUNDRINORI i frazës “më i madh se”: (1) populli që Perëndia i ka dhënë Jezusit (NRSV, TEV) apo (2) vetë Perëndia (NASB, NKJV, NJB). Pjesa e dytë e këtij vargu nënkupton se dikush mund të përpiqet të rrëmbejë ndjekësit e Jezusit. Teologjikisht, mundësia e dytë duket më e mira. Shih Temën e Veçantë për Sigurinë e Shpëtimit në 6:37.

Ky është një pasazh i mrekullueshëm për sigurinë e besimtarit, që bazohet në pushtetin e Atit! Siguria e besimtarit, ashtu si gjithë të vërtetat biblike, paraqitet me një model besëlidhjeje të mbushur me tension. Shpresa dhe siguria e shpëtimit të besimtarëve gjendet në karakterin e Perëndisë Triun, në mëshirën dhe hiri ne tij. Megjithatë, besimtari duhet të vazhdojë në besim. Shpëtimi fillon me një vendim fillestar të shtyrë nga Fryma, që çon në pendim dhe besim. Pastaj, ai duhet të rezultojë në pendim, besim, bindje dhe qëndresë të vazhdueshme! Shpëtimi nuk është produkt (siguracion jete, biletë për në qiell), por marrëdhënie personale gjithnjë e më e fortë me Perëndinë përmes Krishtit.

Prova vendimtare e marrëdhënies së drejtë me Perëndinë është jeta e ndryshuar (dhe në ndryshim e sipër) e besimit dhe shërbesës (shih Mateu 7). Ka shumë pak të dhëna biblike për të krishterët mishorë (shih 1 Korintasve 2-3). Rregulli është ngjashmëria me Krishtin tani, jo thjesht qielli pasi vdesim. Nuk ka mungesë sigurie dhe përforsimi biblik për ata që rriten, shërbejnë dhe, madje, luftojnë me mëkat. Por kush s’ka fryte, s’ka rrënjë! Shpëtimit vjen vetëm me anë të hirit, vetëm nëpërmjet besimit, por shpëtimi i vërtetë çon në “vepra të mira” (shih Efe. 2:10; Jakobi 2:14-26).

10:30-33 “Unë dhe Ati jemi një... judenjtë morën sërish gurë që ta vrisnin” Kjo është vetëm njëra nga thënie të forta të Jezusit për natyrën e tij mesianike dhe hyjnore (shih 1:1-14; 8:58; 14:8-10, sidomos 17:21-26, që përdor edhe fjalën “një”). Judenjtë e kuptuan plotësisht se ç’u tha ai dhe e konsideruan blasfemi (shih v. 33; 8:59). Ata do ta vrisnin me gurë sipas Lev. 24:16.

Në polemikën e hershme për personin e Krishtit (*Ariusi* – i parëlinduri; *Athanasia* – plotësisht Perëndi), v. 30 dhe 14:9 u përdorën shpesh nga Athanasia (shih *The Cambridge History of the Bible [Historia e Biblës sipas Kembrixhit]*, vëll. 1, f. 444). Për “arianizmin”, shih Fjalorthin.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:31-39

³¹Judenjtë morën sërish gurë që ta vrisnin. ³²Jezusi iu përgjigj: “Unë ju tregova shumë vepra të mira nga Ati; për cilën prej tyre po më vrisni me gurë?” ³³Judenjtë ia kthyen: “Nuk po të vrasim për vepër të mirë, por për blasfemi; dhe sepse ti, ndonëse je njeri, e bën veten Perëndi”. ³⁴Jezusi iu përgjigj: “A nuk është shkruar në Ligjin tuaj, „UNË THASHË: JU JENI PERËNDI”? ³⁵Nëse ai i quajti perëndi ata të cilët erdhin fjala e Perëndisë (dhe Shkrimi nuk mund të thyhet), ³⁶ju i thoni atij, që Ati ka shenjtëruar dhe ka dërguar në botë, „ti po blasfemon”, sepse thashë: „unë jam Biri i Perëndisë”? ³⁷Nëse nuk bëj veprat e Atit tim, mos besoni në mua; ³⁸por nëse i bëj, edhe sikur të mos më besoni mua, besojuni veprave, në mënyrë që të dini dhe të kuptoni se Ati është në mua dhe unë në Atin”. ³⁹Prandaj ata kërkonin sërish ta kapnin, por ai u ikte nga duart.

10:31 Ky varg lidhet me thënien e Jezusit në v. 30. Jezusi u përgjigjet akuzave të tyre me një argument tejet të pazakontë rabinik. Në thelb, kjo është lojë fjalësh me termin *Elohim*, i cili është një term i DhV për Perëndinë (shih Zan. 1), por në formë është SHUMËS dhe, shpesh, përdorej edhe për engjëjt dhe udhëheqësit njerëzorë (gjykatësit). Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë, në 6:20.

10:32 Bariu i mirë (*kalos*) bën veprat e mira (*kalos*) të Atit.

10:33 “për blasfemi” Jezusi e dinte se ata e kishin kuptuar drejt pohimin e tij se ishte një me Atin.

10:34 “në Ligjin tuaj” Jezusi citon nga Psalmet, por e quan “Ligji” (pra, Torah do të thotë “mësimet”, shih 12:34; 15:25; Rom. 3:9-19). Termi “Ligj” zakonisht nënkuptonte shkrimet e Moisiut (Torah), Zanafilla-Ligji i Përtërirë. Kjo tregon përdorimin më të gjerë të këtij termi për të nënkuptuar gjithë DhV.

■ “JU JENI PERËNDI” Jezusi përdori një citim nga Psa. 82:6. Aty *elohim* përdoret për gjykatësit njerëzorë (shih *Elohim*, në Temën e Veçantë në 6:20). Këta gjykatës (ndonëse të ligj) quhen “bijtë e më të Lartit”. Këta judenj po e sulmonin Jezusin sepse, ndonëse ishte njeri, pretendonte se ishte: (1) Biri i Perëndisë dhe (2) një me Perëndinë. Mirëpo edhe njerëz të tjerë (shih Eks. 4:16; 7:1; 22:8,9; Ps. 82:6; 138:1) quheshin “perëndi”.

Argumenti rabinik i Jezusit duket se ndjek këtë linjë: Shkrimet janë të vërteta, njerëzit quhen *elohim*, si rrjedhojë, pse më quani blasfemues pasi pohova se jam Biri i Perëndisë? Termi *Elohim* është SHUMËS në hebraisht, por përkthehet në NJËJËS dhe përdorte një FOLJE NË NJËJËS kur i referohej Perëndisë në DhV. Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë në 6:20. Kjo mund të jetë një lojë tipike fjalësh e Gjonit: (1) një term ka dy kuptime dhe (2) një pyetje greqisht që pret përgjigjen “po”.

10:35 “(dhe Shkrimi nuk mund të thyhet)” Shpesh, Gjoni komenton për dialogët e Jezusit. Është e paqartë nëse kjo është thënie e Jezusit, apo e Gjonit. Gjithsesi, meqë të dy janë të frymëzuar njësoj, s’ka rëndësi. Thelbi i citimit është besueshmëria e Shkrimit. Jezusi dhe apostujt e konsideronin DhV dhe interpretimet e tyre për të si fjalë të vetë Perëndisë (shih Mat. 5:17-19; 1 Kor. 2:9-13; 1 Thes. 2:13; 2 Tim. 3:16; 1 Pjet. 1:23-25; 2 Pjet. 1:20-21; 3:15-16).

Peshkopi H. C. G. Moule, në *The Life of Bishop Moule [Jeta e peshkopit Moule]*, thotë:

“Ai [Krishti] i besonte absolutisht Biblës dhe, ndonëse në të ka gjëra të pashpjegueshme dhe të ndërlikuara që mua më kanë bërë të vras mendjen së tepërmi, unë do t’i besoj, jo verbërisht, por me nderim këtij Libri, për shkak të Jezusit” (f. 138).

10:36 Në këtë varg, Jezusi pohon se Ati zgjodhi (ose “shenjtëroi”, “përkushtoi”) atë dhe e dërgoi (si Mesi). Pra, me siguri që ai ka të drejtën të quhet “bir i Perëndisë”. Ashtu si gjykatësit e Izraelit përfaqësonin Perëndinë (shih Psa. 82:6), Jezusi përfaqëson Atin me fjalë dhe me vepra. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*), në 5:24.

10:37 Kjo është pikërisht ajo që po thonë vargjet 19-21. Mrekullitë e Jezusit pasqyrojnë veprimtarinë e Perëndisë.

10:37, 38 “Nëse.. nëse” Këto janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË. Jezusi bëri veprat e Atit. Nëse ishte kështu, atëherë ata duhet të besonin në të, duke qenë të sigurt se ai dhe Ati janë një (shih v. 30, 38). Shih Temën e Veçantë: Qëndroj, në 1 Gjonit 2:10.

10:39 Kjo ishte një nga disa herët kur Jezusi iu shkau atyre që donin t'f'i bënin keq (shih Luka 4:29-30; Gjoni 8:59). Është e paqartë nëse këto largime ndodhnin me anë të (1) një mrekullie, apo (2) nëse ngjashmëria fizike e Jezusit me gjithë të tjerët i lejonte të shkrihej me turmën.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:40-42

⁴⁰Dhe ai u largua sërish përtej Jordanit, në vendin ku më parë pagëzonte Gjoni, dhe qëndroi aty. ⁴¹Shumë shkuan tek ai dhe thoshin: “Ndonëse Gjoni nuk kreu asnjë shenjë, gjithçka që tha për këtë njeri ishte e vërtetë”. ⁴²Atje, shumë besuan në të.

10:40 Këtu bëhet fjalë për zonën përtej Jordanit, përballë Jerikos, aftër një qyteti të quajtur Betani.

10:41 Sërish, Gjoni pohon mbështetjen që Gjoni Pagëzori i dha Jezusit (shih 1:6-8, 19-42; 3:22-30; 5:33)! Kjo mund të jetë bërë për t'u kundërvënë disa herezive që u zhvilluan rreth Gjoni Pagëzorit.

10:42 Ashtu si krerët judenj mohuan Jezusin, kështu dhe shumë prej popullit të thjeshtë (popullit të vendit) reagues me besim në të (shih 2:23; 7:31; 8:30). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'f'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse i përziën kaq shpesh metaforat Gjoni (shembull: “Jezusi është edhe dera e vathës, edhe bariu i mirë”)?
2. Cili është sfondi i DhV për Gjoniin 10?
3. Cila është domethënia e shprehjes së Jezusi “lë jetën e vet”?
4. Pse vazhduan judenjtë të akuzonin Jezusin se ishte i pushtuar nga një demon?
5. Pse janë kaq të rëndësishme veprat e Jezusit?
6. Si mund të lidhim “sigurinë e besimtarit” me “qëndresën e shenjtorëve”?

GJONI 11

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Vdekja e Lazarit 11:1-16	Vdekja e Lazarit 11:1-16	Vdekja e Lazarit 11:1-6 11:7-16	Vdekja e Lazarit 11:1-4 11:5-7 11:8 11:9-11 11:12 11:13-15 11:16	Ringjallja e Lazarit 11:1-4 11:5-10 11:11-16
Jezusi, ringjallja dhe jeta 11:17-27	Unë jam ringjallja dhe jeta 11:17-27	11:17-27	Jezusi, ringjallja dhe jeta 11:17-19 11:20-22 11:23 11:24 11:25-26 11:27	11:17-27
Jezusi qan 11:28-37	Jezusi dhe vdekja, armiku i fundit 11:28-37	11:28-37	Jezusi qan 11:28-31 11:32 11:33-34a 11:34b 11:35-36 11:37	11:28-31 11:32-42
Rikthimi i Lazarit në jetë 11:38-44	Ringjallja e Lazarit 11:38-44	11:38-44	Lazari rikthehet në jetë 11:38-39a 11:39b 11:40-44	11:43-44
Komploti për të vrarë Jezusin 11:45-53 11:54 11:55-57	Komploti për të vrarë Jezusin 11:45-57	11:45-53 11:54 11:55-57	Komploti kundër Jezusit 11:45-48 11:49-52 11:53-54 11:55-57	Krerët e judenjve vendosin për vdekjen e Jezusit 11:45-54 Afrohet Pashka 11:55-57

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

PËRMBLEDHJE TEOLOGJIKE

Rëndësia teologjike e kapitullit 11 është:

1. Shfaqja e pushtetit dhe autoritetit të Jezusit vazhdon.
2. Vdekja e Lazarit është në planin e Perëndisë për t'i siguruar Jezusit një mundësi që të përlëvdohet (shih 9:3).
3. Dialogu i Martës me Jezusin siguron një mundësi për rrëfimin e saj madhështor dhe për zbuluesën e mëtejshme të Jezusit për veten (pra, ringjallja dhe jeta, v. 25).
4. Jezusi jep jetë të përjetshme tani (eskatologjia e zbatuar). Kjo simbolizohet në ringjalljen e Lazarit. Jezusi kishte kontroll mbi vdekjen!
5. Edhe përballë kësaj mrekullie të fuqishme, mosbesimi vazhdon (pra, mëkati i pafalshëm, shih Temën e Veçantë në 5:21)!

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:1-16

¹Në atë kohë, ishte sëmurë njëfarë Lazari nga Betania, fshati i Marisë dhe motrës së saj, Martës. ²Kjo ishte Maria që vajosi Zotin me parfum dhe ia fshiu këmbët me flokët e saj, vëllai i së cilës, Lazari, ishte sëmurë. ³Kështu, motrat i çuan fjalë dhe i thanë: “Zot, ja, ai që ti do është i sëmurë”. ⁴Por, kur Jezusi dëgjoi këta, tha: “Kjo sëmundje nuk është për vdekje, por për lavdinë e Perëndisë, në mënyrë që nëpërmjet saj të përlëvdohet Biri i Perëndisë”. ⁵Jezusi e donte Martën, motrën e saj dhe Lazarin. ⁶Kështu, kur dëgjoi se ishte sëmurë, qëndroi dhe dy ditë të tjera në vendin ku ishte. ⁷Pastaj, pas kësaj, u tha dishepujve: “Le të shkojmë sërish në Jude”. ⁸Dishepujt i thanë: “Rabbi, judenjtë vetëm pak më parë po përpiqeshin të të vrisnin me gurë, dhe ti po kthehesh sërish aty?” ⁹Jezusi u përgjigj: “A nuk ka dymbëdhjetë orë dita? Nëse dikush ecën ditën, nuk pengohet, sepse sheh dritën e botës. ¹⁰Por, nëse dikush ecën natën, pengohet, sepse drita nuk është në të”. ¹¹Si tha këto, u tha atyre: “Miku ynë, Lazari, ka rënë në gjumë; por unë po shkoj që ta zgjoj nga gjumi”. ¹²Atëherë, dishepujt i thanë: “Zot, nëse ka rënë në gjumë, do të shërohet”. ¹³Por Jezusi e kishte fjalën për vdekjen e tij, ndërsa ata mendonin se po fliste për gjumin. ¹⁴Kështu, Jezusi u tha troç: “Lazari ka vdekur, ¹⁵dhe jam i lumtur për hirin tuaj që nuk isha atje, në mënyrë që të besoni; por le të shkojmë tek ai”. ¹⁶Atëherë, Thomai, që quhej Binjaku, u tha dishepujve të tjerë: “Le të shkojmë dhe ne që të vdesim me të”.

1:1 “ishte sëmurë njëfarë Lazari” Kjo është në KOHËN E PAKRYER. Nënkupton se ai kishte qenë i sëmurë për një periudhë të gjatë kohe. Sidoqoftë, KOHA E PAKRYER mund të përkthehet edhe “filloi të sëmurë”.

■ “Lazari” Ky është emri hebraisht “Eleazer”, që do të thotë “Perëndia ndihmon”, ose “Perëndia është ndihmues”. Gjoni e merrte për të qenë se lexuesit e dinin për miqësinë e Jezusit me Marinë, Martën dhe Lazarin (shih Luka 10:38-42, ku është hera e vetme që ata përmenden në ungujtë sinoptikë).

■ **“Betania”** Ky është vend tjetër nga Betania e përmendur në 1:28 dhe 10:40, e cila ishte pranë Jerikosë përbri lumit Jordan. Kjo Betani gjendet rreth 3 kilometra në juglindje të Jerusalemit në të njëjtën kreshtë me malin e Ullinjve. Ky ishte vendqëndrimi i preferuar i Jezusit kur vinte në Jerusalem.

■ **“Maria”** Ky është emri hebraisht “Miriam”.

■ **“Marta”** Kjo është një fjalë aramaisht që do të thotë “zonjë”. Është e pazakontë që Marta, më e madhja, nuk përmendet e para; kjo mund të ketë lidhje me Lukën 10:38-42.

11:2 “Kjo ishte Maria që vajosi Zotin me parfum dhe ia fshiu këmbët me flokët e saj, vëllai i së cilës, Lazari, ishte sëmurë” Vargu 2 është një tjetër shtesë redaktoriale nga Gjoni (p.sh., TEV, NET). Ky rrëfim i përkushtimit të Marisë (shih 12:2-8) gjen paralelin e vet te Mateu (shih 26:6-13) dhe te Marku (shih 14:3-9). Gruaja e përmendur në një vajosje të ngjashme te Luka 7:36 e më tej është grua tjetër.

Ky varg përshkruan një ngjarje që nuk është përmendur ende në këtë ungjill. Ajo shënohet në kapitullin 12. Shumë mendojnë se kjo nënkupton se Gjoni priste që lexuesit e vet të dinin gjëra për këtë familje nga burime të tjera.

TEMË E VEÇANTË: VAJOSJA NË BIBËL (BDB 603)

- A. Përdorej për zbulim (shih LiP. 28:40; Ruthi 3:3; 2 Sam. 12:20; 14:2; 2 Kro. 28:15; Dan. 10:3; Amosi 6:6; Mik. 6:15)
- B. Përdorej për mysafirët (shih Psa. 23:5; Luka 7:38, 46; Gjoni 11:2)
- C. Përdorej për shërim (shih Isa. 61:1; Jer. 51:8; Marku 6:13; Luka 10:34; Jakobi 5:14) [u përdor në kuptimin higjienik te Ezek. 16:9]
- D. Përdorej për përgatitjen për varrim (shih Zan. 50:2; 2 Kro. 16:14; Marku 16:1; Gjoni 12:3,7; 19:39-40)
- E. Përdorej në kuptimin fetar (për një objekt, shih Zan. 28:18; 31:13 [shtyllë]; Eks. 29:36 [altari]; Eks. 30:26; 40:9-16; Lev. 8:10-13; Num. 7:1 [tabernakulli])
- F. Përdorej për shugurimin e drejtuesve
 1. Priftërinjtë
 - a. Aaroni (Eks. 28:41; 29:7; 30:30)
 - b. Bijtë e Aaronit (Eks. 40:15; Lev. 7:36)
 - c. Frazë ose titull standard (Num. 3:3; Lev. 16:32)
 2. Mbretërit
 - a. nga Perëndia (shih 1 Sam. 2:10; 2 Sam. 12:7; 2 Mbret. 9:3,6,12; Ps. 45:7; 89:20)
 - b. nga profetët (shih 1 Sam. 9:16; 10:1; 15:1,17; 16:3,12-13; 1 Mbret. 1:45; 19:15-16)
 - c. nga priftërinjtë (shih 1 Mbret. 1:34, 39; 2 Mbret. 11:12)
 - d. nga pleqtë (shih Gjyq. 9:8,15; 2 Sam. 2:7; 5:3; 2 Mbret. 23:30)
 - e. për Jezusin si mbret mesianik (shih Ps. 2:2; Luka 4:18 [Isa. 61:1]; Veprat 4:27; 10:38; Heb. 1:9 [Ps. 45:7])
 - f. ndjekësit e Jezusit (shih 2 Kor. 1:21; 1 Gjonit 2:20, 27 [krizma])
 3. ndoshta për profetët (shih Isa. 61:1)
 4. instrumentet mosbesuese të çlirimit hyjnor
 - a. Kiri (shih Isa. 45:1)
 - b. Mbreti i Tirit (shih Ezek. 28:14, ku ai përdor metaforat e Edomit)
 5. termi ose titulli “Mesia” do të thotë “i Vajosuri” (BDB 603)

11:3 “motrat i çuan fjalë” Ato i dërguan lajm Jezusit, i cili ishte në Perea, përtej Jordanit.

■ **“ai që ti do, është i sëmurë”** Kjo tregon marrëdhënien unike që kishte Jezusi me këtë familje. Ky është termi greqisht *fileō*. Gjithsesi, në greqishten *koine*, termat *fileō* dhe *agapaō* janë të ndërkëmbyeshëm shih v. 5; 3:35; 5:20).

11:4 “Kjo sëmundje nuk është për vdekje, por për lavdinë e Perëndisë” Kjo nënkupton se Jezusi e dinte që Lazari ishte sëmurë. Ai do ta linte të vdiste në mënyrë që Ati të shfaqte fuqinë e vet përmes Jezusit, duke e

ringjallur nga vdekja. Sëmundja dhe vuajtja nganjëherë janë në vullnetin e Perëndisë (shih 9:3; libri i Jobit; 2 Kor. 12:7-10).

▣ **“lavdinë e Perëndisë”** Veprat e Jezusit zbulojnë “lavdinë e Perëndisë”. Shih shënimin në 1:14.

▣ **“që nëpërmjet saj të përlëvdohet Biri i Perëndisë”** Frazja GJINORE “i Perëndisë” nuk gjendet në dorëshkrimet e lashta greke në papirus P⁴⁶ dhe P⁶⁶. Sëmundja do t’i sillte lavdi, edhe Atit, edhe Birit. Lavdia e Jezusit në këtë kontekst është shumë e ndryshme nga ajo që mund të prisnim ne. Gjatë gjithë ungjillit të Gjonit, ky term i është referuar kryqëzimit dhe përlëvdimit të Jezusit. Ringjallja e Lazarit do të bënte që krerët e judenjve të bënin thirrje për vdekjen e Jezusit.

11:5 Një tjetër koment redaktorial nga Gjoni (shih v. 36).

11:6 “qëndroi dhe dy ditë të tjera në vendin ku ishte” Jezusi u vonua derisa vdiq Lazari! Jezusi nuk mbante me hatër. Në këtë sëmundje ekzistonte një qëllim hyjnor (shih v. 15; 9:3).

11:7 “pas kësaj, u tha dishepujve: „Le të shkojmë sërish në Jude” Diskutimi që vijon tregon se dishepujt ishin shumë të vetëdijshëm se judenjtë donin të vrisnin Jezusin (shih v. 8; 8:54; 10:31, 39). Dishepujt shfaqin një përzjerje të çuditshme besimi dhe frike (shih v. 16). Shpesh, Thomai mendohet si dishepulli dyshues, por këtu ai ishte gati të vdiste me Jezusin (shih v. 16).

Michael Magill, *NT TransLine* (f. 345 #43) bën vëzhgimin e saktë se “le të shkojmë” në v. 7 modifikohet nga “por unë po shkoj” në v. 11. Dishepujt kishin frikë dhe dyshime, por Jezusi ishte i sigurt. Ai që bashkohet me Jezusin në v. 16 është Thomai (“le të shkojmë”)!

11:9-10 Ndoshta, kjo është një mënyrë për të lidhur këtë kapitull me kapitullin e mëparshëm 8:12 dhe 9:4-5 (shih 12:35). Vargu 9a pret përgjigjen “po”.

Ka një kontrast të dukshëm mes atyre që po ndjekin vullnetin e Perëndisë (pra, Jezusin) dhe atyre që s’po e ndjekin (v. 10, judenjtë). Jezusi nuk po gabon kur shkon aty ku e udhëheq Perëndia, pasi ai është drita e botës!

Ky kontrast midis dritës dhe errësirës ishte karakteristik për letërsinë e urtësisë judaike dhe për shkrimet e Kumranit (pra, “Pergamena e Bijve të Dritës kundër Bijve të Errësirës”, ose “Lufta e Bijve të Dritës kundër Bijve të Errësirës”).

▣ **“Nëse... nëse”** Të dyja këto janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkuptonin veprim të mundshëm.

11:11 “Mik ynë, Lazari, ka rënë në gjumë” Kjo FOLJE është në DËFTOREN E KRYER PËSORE. Shpesh, dishepujt e keqkuptonin Jezusin sepse e merrnin tepër shabllon (shih v. 13). Përdorimi që i bënte Jezusi kësaj metafore për vdekjen pasqyron përdorimin e saj në DhV (shih LiP. 31:16; II Sam. 7:12; I Kgs. 1:21; 2:10; 11:21,43; 14:20, etj). Fjala anglisht “cemetery” [varrezë] vjen nga e njëjta fjalë me termin greqisht “gjumë”.

11:12 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij letrare.

▣ **“do të shërohet”** Fjalë për fjalë, kjo është fjala “shpëtohet” në përdorimin e saj të DhV si “çlirim fizik” (shih Jakobi 5:15). Sërish, dishepujt e keqkuptuan Jezusin sepse ia morën në mënyrë shabllon gjuhën e tij metaforike (pra, gjumi). Ky keqkuptim i dëgjuesve të Jezusit është karakteristik për ungjillin e Gjonit (p.sh., v. 23-24). Ai është nga lart – ata janë nga poshtë. Pa ndihmën e Frymës (pra, Rrëshajat), ata nuk mund të kuptojnë!

11:13 Ky është një tjetër koment redaktorial i Gjonit.

11:14 “Jezusi u tha troç” Shih Temën e Veçantë: *Parrhësia* në 7:4.

11:15 “dhe jam i lumtur për hirin tuaj që nuk isha atje, në mënyrë që të besoni” Jezusi pohon se ringjallja e Lazarit nuk do të ndodhte për shkak të miqësisë së tij me Jezusin, as për shkak të hidhërimit të Marisë dhe Martës, por për (1) të përforcuar besimin e dishepujve (v. 14) dhe (2) për të inkurajuar besimin e turmës së judenjve (v.

42). Besimi është një proces te Gjoni. Nganjëherë, ai zhvillohet (p.sh., dishepujt, shih 2:11), herë të tjera, jo (p.sh., spektatorët, shih 8:31-59).

11:16 Ky varg tregon qartë besimin e Thomait. Ai ishte gati të vdiste me Jezusin. Dishepujt kishin nevojë që t'u tregohej pushteti i Jezusit mbi vdekjen, frika më e madhe e njerëzimit.

Emri Thoma reflekton fjalën aramaisht “binjak” (një tjetër koment redaktorial), si fjala *Didimus* në greqisht. Sinoptikët e rendisin si apostull (Mat. 10:3; Marku 3:18; Luka 6:15); ungjilli i Gjonit e përmend shpesh (shih 11:16; 14:5; 20:24-29; 21:2). Shih Temën e Veçantë: Tabela e emrave të apostujve, në 1:45.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:17-27

¹⁷Kështu, kur Jezusi arriti, mësoi se ai kishte tashmë katër ditë në varr. ¹⁸Betania ishte afër Jerusalemit, rreth tre kilometra larg; ¹⁹dhe shumë nga judenjtë kishin ardhur te Marta dhe Maria, për t'i ngushëlluar në lidhje me të vëllanë. ²⁰Prandaj, Marta, kur dëgjoji se po vinte Jezusi, doli ta takonte, kurse Maria qëndroi në shtëpi. ²¹Atëherë, Marta i tha Jezusit: “Zot, nëse do të kishe qenë këtu, vëllai im nuk do të kishte vdekur. ²²Por edhe tani e di se, çfarëdo t'i kërkosh Perëndisë, ai do të ta japë”. ²³Jezusi i tha: “Vëllai yt do të ngjallet sërish”. ²⁴Marta i tha: “E di se do të ngjallet në ringjallje, ditën e fundit”. ²⁵Jezusi i tha: “Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua do të jetojë edhe sikur të vdesë, ²⁶dhe kushdo që jeton e beson në mua nuk do të vdesë kurrë. E beson këtë?” ²⁷Ajo i tha: “Po, Zot; unë kam besuar se ti je Krishti, Biri i Perëndisë, ai që vjen në botë”.

11:17 “ai kishte katër tashmë katër ditë në varr” Rabinët thoshin se shpirti i të vdekurit qëndronte pranë trupit për tri ditë. Jezusi u vonua katër ditë për t'u siguruar se Lazari kishte vdekur vërtet dhe ishte përtej çdo shprese rabinike.

11:18 “rreth tre kilometra” Vargu 18 është një tjetër koment redaktorial i Gjonit. Fjalë për fjalë, thuhet “pesëmbëdhjetë stade”.

11:19 “shumë nga judenjtë kishin ardhur te Marta dhe Maria” Ky ishte një përdorim jokarakteristik neutral i termit “judenjtë”, që zakonisht, te Gjoni, nënkupton armiqtë e Jezusit. Sidoqoftë, në këtë kontekst, nënkupton thjesht banorët e Jerusalemit që njihnin këtë familje (shih v. 31, 33, 45).

11:20 “Maria qëndroi në shtëpi” Pozicioni i zakonshëm për vajtimin e judenjve ishte ulja përtokë.

TEMË E VEÇANTË: RITET E VAJTIMIT

Izraelitët e shprehnin në mënyra të ndryshme hidhërimin për vdekjen e njeriut të dashur, apo pendimin për mëkat personal ose për krime kolektive:

1. shqyenin veshjen e jashtme (Zan. 37:29,34; 44:13; Gjyq. 11:35; 2 Sam. 1:11; 3:31; 2 Mbret. 21:27; Jobi 1:20)
2. vishnin thes (Zan. 37:34; 2 Sam. 3:31; 1 Mbret. 21:27; Jer. 48:37)
3. hiqnin këpucët (2 Sam. 15:30; Isa. 20:3)
4. vinin duart në kokë (2 Sam. 13:19; Jer. 2:37)
5. hidhnin pluhur në kokë (Joz. 7:6; 1 Sam. 4:12; Neh. 9:1)
6. uleshin përtokë (Vaj. 2:10; Ezek. 26:16 (shtriheshin përtokë, 2 Sam. 12:16); Isa. 47:1)
7. rrihnin gjoksin (1 Sam. 25:1; 2 Sam. 11:26; Nah. 2:7)
8. prisnin trupin (LiP. 14:1; Jer. 16:6; 48:37)
9. agjëronin (2 Sam. 12:16, 22; 1 Mbret. 21:27)
10. këndonin këngë vajtimi (2 Sam. 1:17; 3:31; 2 Kro. 35:25)
11. qetheshin qeros (flokun e shkullnin ose e rruanin) (Jer. 48:37)
12. prisnin mjekrën (Jer. 48:37)
13. mbulonin kokën ose fytyrën (2 Sam. 15:30; 19:4)

11:21, 32 “Marta i tha... nëse do të kishe qenë këtu, vëllai im nuk do të kishte vdekur” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “në kundërshtim me faktet”. Si rrjedhojë, duhet kuptuar kështu: “Po të kishte qenë këtu me ne, por nuk ishte, vëllai im nuk do të kishte vdekur, por ja që vdiq”. Pohimet e Martës dhe

Marisë (shih v. 32) para Jezusit janë shumë të ngjashme. Ato duhet të kenë diskutuar për këtë çështje shpesh gjatë atyre katër ditëve të vajtimit. Këto dy gra ndiheshin aq të afërta me Jezusin sa mund t'i shprehnin edhe zhgënjimin e tyre të fshehur se nuk kishte ardhur më herët.

11:22 “Por edhe tani e di se, çfarëdo t’i kërkosh Perëndisë, ai do të ta japë” Është e paqartë se çfarë saktësisht po i kërkon Marta Jezusit, sepse në v. 39 ajo u habit nga ringjallja e Lazarit.

11:23-24 “Vëllai yt do të ngjallet sërish” Marta kishte të njëjtën pikëpamje teologjike për jetën e përtejme si farisenjtë, të cilët besonin në ringjalljen trupore në ditën e fundit. Ka disa të dhëna të kufizuara biblike në DhV për këtë pikëpamje (shih Dan. 12:2; Jobi 14:14; 19:25-27). Jezusi e kthen këtë botëkuptim jude në shpallje të fuqisë dhe autoritetit të vet (shih v. 25; 14:6).

11:24 “ditën e fundit” Ndonëse është e vërtetë se Gjoni thekson natyrën e atypëratyshme të shpëtimit (eskatologjinë e realizuar), ai ende pret një përmbyshje në kohët e fundit. Kjo shprehet në mënyra të ndryshme.

1. një ditë gjykimi ringjalljeje (shih 5:28-29; 6:39-40,44,54; 11:24; 12:48)
2. “ora” (shih 4:23; 5:25,28; 16:32)
3. një ardhje e dytë e Krishtit (shih 14:3; është e mundur që 14:18-19, 28 dhe 16:16, 22 t’i referohen shfaqjeve të Jezusit pas ringjalljes dhe jo një ardhjeje eskatologjike)

11:25 “Jezusi i tha: „unë jam ringjallja dhe jeta” Kjo është një nga shtatë thëniet “Unë Jam” të Jezusit. Përballë vdekjes së Lazarit, Marta u inkurajua të besonte se ai do të jetonte. Kjo shpresë është e rrënjësuar në personin dhe pushtetin e Atit dhe Jezusit (shih 5:21). Shih shënimin në 8:12.

Çuditërisht, një dorëshkrim i hershëm në papirus (P⁴⁵) dhe disa versione në latinishten e vjetër dhe në gjuhën siriane, si dhe Diatessaron, nuk i përmbyjnë fjalët “dhe jeta”. UBS³ i jep përfshirjes së kësaj fjale vlerësimin “B”, ndërsa UBS⁴ i jep vlerësimin “A” (e sigurt).

11:26 “kushdo që jeton dhe beson në mua nuk do të vdesë kurrë” Ky varg ka një sërë tiparesh të rëndësishme sintaksore.

1. PËREMRI universal “të gjithë”
2. PJESORET E TASHME, që tregojnë nevojën për besim të vazhdueshëm (v 25 dhe 26)
3. MOHOREN E DYFISHTË dhe kategorike që lidhet me vdekjen, “nuk do të vdesë kurrën e kurrës”, që, qartazi, bën fjalë për vdekjen shpirtërore.

Te Gjoni, jeta e përjetshme është realitet i tanishëm për besimtarët, jo thjesht një ngjarje e ardhshme. Lazari synon të përçojë fjalët e Jezusit! Për Gjonin, jeta e përjetshme është realiteti i tashëm.

11:27 “Po, Zot; unë kam besuar se ti je Krishti, Biri i Perëndisë, ai që vjen në botë” Kjo shprehet në KOHËN E KRYER. Është rrëfim i fuqishëm i besimit të saj personal në Jezusin si Mesia i premtuar. Është teologjikisht e barasvlershme me rrëfimin e Pjetrit në Cezare (shih Mateu 16).

Ajo përdor një sërë titujsh të ndryshëm për të shprehur besimin e vet.

1. Krishti (që ishte përkthim në greqisht i fjalës Mesia, i Vajosuri)
2. Biri i Perëndisë (titull i Mesisë në DhV)
3. Ai që vjen (një tjetër titull i DhV për të premtuarin e Perëndisë, i cili do të sjellë një epokë të re drejtësie, shih 6:14)

Gjoni e përdor dialogun si teknikë letrare për përçimin e të vërtetës. Ka një sërë rrëfimesh besimi në Jezusin në ungjillin e Gjonit (shih 1:29,34,41,49; 4:42; 6:14,69; 9:35-38; 11:27). Shih Temën e Veçantë: Përdorimi i “Besoj” në Gjoni, në 2:23.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:28-29

²⁸Si tha këto, ajo u largua dhe thirri të motrën, Marinë, duke i thënë fshehtas: “Mësuesi është këtu dhe po të thërret”. ²⁹Dhe, kur ajo e dëgjoi, u ngrit me shpejtësi dhe shkoi tek ai.

11:28 “Mësuesi” Bibla studimore e NASB (f. 154) ka një koment madhështor: “një përshkrim domethënës kur jepet nga një femër. Rabinët nuk mësonin femrat (shih 4:27), kurse Jezusi i mësonte shpesh”.

TEMË E VEÇANTË: GRATË NË BIBËL

- I. Dhiata e Vjetër
- A. Nga ana kulturore, gratë konsideroheshin prona
1. përfshiheshin në listën e pronave (Eks. 20:17)
 2. trajtimi i skllaveve (Eks. 21:7-11)
 3. betimet e grave ishin të anulueshme nga meshkuj të përgjegjshëm nga ana sociale (Numrat 30)
 4. gratë si plaçka lufte (Ligji i Përtërirë 20:10-14; 21:10-14)
- B. Praktikisht, ekzistonte një reciprocitet
1. meshkujt dhe femrat të krijuara në shëmbëllimin e Perëndisë (Zan. 1:26-27)
 2. nderoni babanë dhe nënën (Levitiku 19:3; 20:9)
 3. burrat dhe gratë mund të ishin naziritë (Num. 6:1-2)
 4. bijat kishin të drejtë trashëgimie (Num. 27:1-11)
 5. pjesë e popullit të besëlidhjes (Ligji i Përtërirë 29:10-12)
 6. zbato mësimin e babait dhe nënës (Fja. 1:8; 6:20)
 7. bijtë dhe bijat e Hemanit (familje levite) drejtonin muzikën në tempull (1 Kron. 25:5-6)
 8. bijtë dhe bijat do të profetizojnë në epokën e re (Joeli 2:28-29)
- C. Gratë ishin në role udhëheqjeje
1. motra e Moisiut, Miriami, quhej profeteshë (Eks. 15:20-21, shih dhe Mikea 6:4)
 2. gratë që kishin dhunti nga Perëndia për të endur materiale për tabernakullin (Eks. 35:25-26)
 3. një grua, Debora, që ishte edhe profeteshë (shih Gjyq. 4:4), u priu gjithë fiseve (Gjyq. 4:4-5; 5:7)
 4. Hulda ishte profeteshë, të cilës mbreti Josia i bëri thirrje të lexonte dhe të interpretonte “Librin” e sapogjetur “të Ligjit” (2 Mbret. 22:14; 2 Kro. 34:22-27)
 5. mbretëresha Ester, një grua e perëndishme, shpëtoi judenjtë në Persi
- II. Dhiata e Re
- A. Nga ana kulturore, si në judaizëm ashtu dhe në botën romake, gratë ishin qytetare të dorës së dytë, me pak të drejta apo privilegje (me përjashtim të Maqedonisë).
- B. Gratë në role udhëheqjeje
1. Elizabeta dhe Maria, gra të perëndishme në dispozicion të Perëndisë (Luka 1-2)
 2. Ana, gruaja e perëndishme që shërbente në tempull (Luka 2:36)
 3. Lidia, besimtare dhe drejtuese e një kishe shtëpiake (Veprat 16:14, 40)
 4. Katër bijat e virgjra të Filipit ishin profeteshë (Veprat 21:8-9)
 5. Febja, dhjake e kishës në Kenkrea (Rom. 16:1)
 6. Priska (Prishila), bashkëpunëtorja e Palit dhe mësuesja e Apollos (Veprat 18:26; Rom. 16:3)
 7. Maria, Trifena, Trifoza, Persisi, Julia, motra e Nereut, një sërë grash bashkëpunëtoreshë të Palit (Rom. 16:6-16)
 8. Junia (KJV), ndoshta një grua apostull (Rom. 16:7)
 9. Evodia dhe Sintika, bashkëpunëtoreshë të Palit (Fil. 4:2-3)
- III. Si t’i drejtpeshojë shembujt e ndryshëm biblikë besimtarë të kohës së sotme?
- A. Si të përcaktojmë të vërtetat historike ose kulturore, që vlejné vetëm për kontekstin fillestar, dhe të vërtetat e përjetshme që vlejné për të gjitha kishat, për të gjithë besimtarët e të gjitha kohëve?
1. Duhet të marrim shumë seriozisht synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Bibla është Fjala e Perëndisë dhe i vetmi burim për besimin dhe praktikën.
 2. Duhet të ballafaqohemi me pasazhet e frymëzuara që, dukshëm, janë të kushtëzuara nga ana historike.
 - a. Kulti (pra, rituali dhe liturgjia) e Izraelit (shih Veprat 15; Gal. 3)
 - b. Judaizmi i shekullit të parë
 - c. Thëniet e kushtëzuara historikisht të Palit në 1 Korintasve
 - (1) sistemi ligjor i Romës pagane (1 Kor. 6)
 - (2) qëndrimi në skllavëri (1 Kor. 7:20-24)

- (3) beqaria (1 Kor. 7:1-35)
- (4) virgjëreshat (1 Kor. 7:36-38)
- (5) ushqimi që u flijohet idhujve (1 Kor. 8; 10:23-33)
- (6) veprime të padenja në Darkën e Zotit (1 Kor. 11)

3. Perëndia e zbuloi plotësisht dhe qartazi veten në një kulturë të veçantë dhe në një kohë të veçantë. Ne duhet të marrim seriozisht zbuluesën, por jo çdo aspekt të përshtatjes së saj historike. Fjala e Perëndisë u shkrua me fjalë njerëzore dhe iu drejtua një kulture të caktuar në një kohë të caktuar.

B. Interpretimi biblik duhet të kërkojë synimin e autorit fillestar. Çfarë po i thoshte ai ditës së vet? Kjo është themelore dhe kyçe për interpretimin e sakte. Por, më tej, këtë duhet ta zbatojmë në kohën tonë. Tani, këtu qëndron problemi me gratë në udhëheqje (problemi i vërtetë interpretues mund të jetë përcaktimi i termit. A kishte shërbesa të tjera përveç pastorëve që konsideroheshin udhëheqje? A shiheshin si drejtuese dhjaket ose profeteshat? Është shumë e qartë se Pali, në 1 Kor. 14:34-35 dhe 1 Tim. 2:9-15, po pohon se gratë nuk duhet të marrin drejtimin në adhurimin publik! Por si ta zbatoj këtë në kohën time? Nuk dua që kultura e Palit, apo e imja, t'i mbyllë gojën Fjalës dhe vullnetit të Perëndisë. Ndoshta, koha e Palit ishte tepër kufizuese, por ndoshta koha ime mund të jetë tepër e hapur. S'ndihem fare rehat të them se fjalët dhe mësimet e Palit janë të vërteta të kushtëzuara, situatore, lokale të shekullit të parë. Kush jam unë që t'i lejoj mendjes ose kulturës sime të mohojnë një autor të frymëzuar?!

Nga ana tjetër, si t'ia bëj kur gjej shembuj biblikë për gratë drejtuese (edhe në shkrimet e Palit, shih Romakëve 16)? Një shembull i qartë i kësaj është diskutimi që i bëu Pali adhurimit publik në 1 Korintasve 11-14. Në 11:5, ai duket se lejon predikimin dhe lutjen e grave në adhurimin publik, por me koka të mbuluara, ndërsa në 14:34-35 kërkon që ato të qëndrojnë në heshtje! Kishte dhjake (shih Rom. 16:1) dhe profetsha (shih Veprat 21:9). Është pikërisht kjo larmi që më jep lirinë t'i identifikoj komentet e Palit (në lidhje me kufizimet për femrat) si tipare që vlenin vetëm për Korintin dhe Efesin e shekullit të parë. Në të dyja ato vende kishte probleme me femrat që ushtronin lirinë e tyre të sapogjetur (shih Bruce Winter, *After Paul Left Corinth [Pasi Pali la Korintin]*), gjë që mund të ketë shkaktuar vështirësi për kishën që të ungjillizonte shoqërinë për Krishtin. Liria e tyre duhej kufizuar në mënyrë që ungjilli të ishte më i efektshëm.

Koha ime është plotësisht e kundërt me atë të Palit. Në kohën time, ungjilli mund të kufizohet nëse grave të trajnuara, që dinë të flasin, nuk u lejohej të ndajnë ungjillin ose të drejtojnë! Cili është synimi absolut i adhurimit publik? A nuk është ungjillizimi dhe dishepullizimi? A mund të nderohet dhe kënaqet Perëndia nga gratë drejtuese? Bibla në tërësi duket se thotë "po"!

Unë dua t'i nënshtrohem Palit; teologjia ime është kryesisht paliane. Nuk dua që të ndikohem ose manipulohem nga feminizmi modern! Megjithatë, mendoj se kisha ka qenë e ngadaltë për të reaguar ndaj të vërtetave të qarta biblike, si papranueshmëria e skllavërisë, racizmit, fanatizmit dhe seksizmit. Po kështu, ajo ka reaguar shumë me vonë ndaj abuzimit të femrave në botën e sotme. Perëndia, në Krishtin, e çliroi skllavin dhe femrën. Unë nuk guxoj që të lejoj një pasazh të kufizuar nga ana kulturore që t'i fusë sërish nën pranga.

Dhe një pikë e fundit: si interpretues, unë e di se Korinti ishte një kishë shumë problematike. Dhuntitë karizmatike vlerësoheshin dhe përdorshin për t'u mburrur. Në këtë gjë mund të jenë përfshirë dhe femrat. Po kështu, besoj se Efesi po ndikohet nga mësuesit e rremë, të cilët po përfitonin nga gratë dhe po i përdornin si folëse zëvendësuese në kishat shtëpiake të Efesit.

C. Sugjerime për lexime të mëtejshme

How to Read the Bible For All Its Worth [Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka], Gordon Fee dhe Doug Stuart (f. 61-77)

Gospel and Spirit: Issues in New Testament Hermeneutics [Ungjilli dhe Fryma: Çështje në hermeneutikën e Dhiatës së Re], Gordon Fee

Hard Sayings of the Bible [Thënie të vështira në Bibël], Walter C. Kaiser, Peter H. Davids, F. F. Bruce, dhe Manfred T. Branch (f. 613-616; 665-667)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:30-37

³⁰Ndërkaq, Jezusi nuk kishte ardhur ende në fshat, por ishte ende në vendin ku u takua me Martën. ³¹Atëherë, judenjtë që ishin me të në shtëpi dhe po e ngushëllonin, kur panë se Maria u ngrit me shpejtësi dhe doli, e ndoqën, duke menduar se ajo po shkonte te varri për të vajtuar aty. ³²Kështu, kur Maria mbërriti aty ku ishte Jezusi, e pa, i ra te këmbët dhe i tha: “Zot, nëse do të kishe qenë këtu, im vëlla nuk do të kishte vdekur”. ³³Kur Jezusi pa që ajo dhe judenjtë që kishin ardhur me të po qanin, u trondit thellë në shpirt dhe u trazua, ³⁴dhe i tha: “Ku e keni vënë?” Ata i thanë: “Zot, eja dhe shih”. ³⁵Jezusi qau. ³⁶Prandaj, judenjtë thanë: “Shih sa shumë e donte!” ³⁷Por disa prej tyre thanë: “A nuk mundej ky njeri, që i hapi sytë të verbrit, të bënte që ky të mos vdiste?”

11:30 Kjo është një tjetër hollësi prej dëshmitari okular nga autori apostolik.

11:33

NASB “u trondit thellë në shpirt dhe u trazua”

NKJV “psherëtiu në shpirt dhe u trondit”

NRSV “u shqetësua shumë në shpirt dhe u trazuar së tepërmi”

TEV “u prek në zemër dhe u trondit thellë”

NJB “Jezusi u trazua së tepërmi dhe, me një psherëtimë të thellë”

Fjalë për fjalë, “turfulloi në shpirt”. Kjo shprehje, zakonisht, përdorej për zemërimin (shih Dan. 11:30 [LXX]; Marku 1:43; 14:5). Por, në këtë kontekst, duhet preferuar përkthimi që shfaq ndjenjë të thellë (shih v. 38). Ndonëse disa komentatorë mendojnë se kjo ndjenjë e fortë, mundësisht zemërim, drejtohej kundër vdekjes, Jezusi kishte ndjenja vërtet njerëzore (shih v. 33, 35, 36, 38) dhe i shfaq këtu për miqtë e vet.

11:35 “Jezusi qau” Ky është vargu më i shkurtër në Bibël. Vdekja nuk ishte vullneti i Perëndisë për këtë planet. Ajo ishte rezultat i rebelimit njerëzor. Jezusi e ndien dhimbjen e humbjes së një njeriu të dashur. Atij i vjen keq për përjetimet e gjithë ndjekësve të vet në këtë jetë!

Qarja e Jezusit ishte e heshtur dhe personale, jo një vajtim publik, si ai që përmendet në v. 33.

11:37 Kjo pyetje pret përgjigjen “po”. Ky ishte mendimi i Martës në v. 21 dhe i Marisë në v. 32.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:38-44

³⁸Kështu, Jezusi, sërish i tronditur përbrenda, erdhi te varri. Ai ishte një shpellë, dhe një gur i ishte vendosur përpara. ³⁹Jezusi tha: “Hiqni gurin”. Marta, motra e të ndjerit, i tha: “Zot, tani duhet të qelbet erë, sepse ka katër ditë i vdekur”. ⁴⁰Jezusi i tha: “A nuk të thashë se, po të besosh, do të shohësh lavdinë e Perëndisë?” ⁴¹Kështu, ata hoqën gurin. Atëherë, Jezusi ngriti sytë dhe tha: “Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar. ⁴²E dija se ti gjithmonë më dëgjon; por e thashë për shkak të njerëzve që po më qëndrojnë përreth, në mënyrë që të besojnë se ti më ke dërguar”. ⁴³Si tha këto gjëra, bërtiti me zë të lartë: “Lazar, dil”. ⁴⁴I vdekuri doli, i lidhur këmbë e duar me rripa pëlhure, me fytyrën e mbështjellë me rizë. Jezusi u tha: “Zgjidheni dhe lëreni të shkojë”.

11:38 “një shpellë” Gjatë kësaj periudhe, në Palestinë, varret ishin ose

1. shpella natyrore (*Baba Bathra* 6:8)
2. shpella të gërmuara në shpate dhe të vulosura me gurë të rrumbullakët që rrotulloheshin në hendejë
3. gropa të gërmuara në tokë dhe të mbuluara me gurë të mëdhenj

Nga studimet arkeologjike në zonën e Jerusalemit, alternativa #1 përputhet më mirë se të tjerat.

11:39 “Hiqni gurin” Një gur i madh, që rrëshqiste brenda një hullie, ishte metoda që përdorej për të vulosur varret nga plaçkitësit dhe nga kafshët.

■ “ka katër ditë i vdekur” Kjo është shprehje greqisht, që fjalë për fjalë do të thotë “njeri katërditësh”.

11:40 “po të” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton se veprimi është i mundshëm. Ky varg është një pyetje që pret përgjigjen “po”.

■ **“lavdinë e Perëndisë”** Lavdia e Perëndisë zbulohet në veprimet e Jezusit (shih v. 4). Shih shënimin më të plotë në 1:14.

11:41 “Atëherë, Jezusi ngriti sytë” Qëndrimi normal në lutjen e judenjve ishte me duart dhe sytë (e hapur) të ngritur drejt qiellit. Kjo është shprehje për lutjen (shih 17:1).

■ **“që më ke dëgjuar”** Jezusi “e dëgjon” Atin (shih 8:26, 40; 15:15) dhe Ati “dëgjon” Birin. Ata që “dëgjojnë” Jezusin kanë jetën e përjetshme. Kjo është loja e vazhdueshme e fjalëve me termat “shoh” dhe “dëgjoj”, që janë paralele me “pranoj” (1:12) dhe “besoj” (3:16). Lazari “dëgjoji” zërin e Jezusit dhe u kthye në jetë.

11:42 Kjo shpreh synimin e lutjes dhe mrekullisë së Jezusit. Shpesh, Jezusi kryente mrekulli për të inkurajuar besimin e dishepujve, ndërsa, në këtë rast, për të ngjallur besim te judenjtë nga Jerusalemi.

Teologjikisht, Jezusi lartëson sërish autoritetin dhe përparësinë e Atit në veprat e veta (shih 5:19, 30; 8:28; 12:49; 14:10). Kjo mrekulli zbulon marrëdhënien e ngushtë të Jezusit me Atin. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*), në 5:24.

11:43 “bërtiti me zë të lartë: „Lazar, dil!” Dikush ka thënë se, nëse Jezusi s’do të kishte përmendur me emër Lazarin, gjithë të vdekurit e varrezës do të dilnin nga varret!

11:44 Trupi i të vdekurit përgatitej për varrim duke e larë me ujë, pastaj, duke e mbështjellë me rripa pëlhure, dhe duke e spërkatur me aroma që ndihmonin me erën e trupit. Kufomat duheshin varrosur brenda njëzetë e katër orësh sepse judenjtë nuk i balsamosnin të vdekurit.

TEMË E VEÇANTË: PRAKTIKAT E VARRIMIT

- I. Mesopotamia
 - A. Varrimi i duhur ishte shumë i rëndësishëm për një jetë të lumtur pas vdekjes.
 - B. Një shembull i një mallkimi mesopotamas është: “Mos jua pranofte toka kufomat”.
- II. Dhiata e Vjetër
 - A. Varrimi i duhur ishte shumë i rëndësishëm (shih Pre. 6:3).
 - B. Bëhej shumë shpejt (p.sh., Sara te Zanafilla 23 dhe Rakela te Zan. 35:19, dhe vini re LiP. 21:23).
 - C. Varrimi i pasaktë ishte shenjë refuzimi dhe mëkati.
 1. Ligji i Përtërirë 28:26
 2. Isaia 14:20
 3. Jeremia 8:2; 22:19
 - D. Varrimi bëhej, nëse ishte e mundur, në kubetë familjare në zonën e shtëpisë.
 - E. Nuk bëhej balsamosje si në Egjipt. Njerëzimi erdhi nga pluhuri dhe në pluhur duhet të kthehet (p.sh., Zan. 3:19; Psa. 103:14; 104:29).
 - F. Në judaizmin rabinik, ishte e vështirë të drejtpeshoje respektin dhe trajtimin e duhur të trupit me konceptin e ndotjes ceremoniale që kishte të bënte me trupat e vdekur.
- III. Dhiata e Re
 - A. Varrimi bëhej shpejt pas vdekjes, zakonisht brenda njëzetë e katër orësh. Shpesh, judenjtë vigjilonin te varri për tri ditë, pasi besonin se shpirti mund të kthehej te trupi brenda asaj periudhe kohore (shih Gjoni 11:39).
 - B. Varrimi përfshinte dhe pastrimin e mbështjelljen e trupit me erëza (shih Gjoni 11:44; 19:39-40).
 - C. Në Palestinën e shekullit të parë nuk kishte procedura të veçanta judaike apo të krishtera për varrimin, as nuk vendoseshin sende në varr.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:45-46

⁴⁵Për këtë arsye, shumë nga judenjtë që kishin ardhur te Maria dhe që panë se ç’bëri ai, besuan në të. ⁴⁶Por disa prej tyre shkuan te farisenjtë dhe u treguan se ç’kishte bërë Jezusi.

11:45 “Për këtë arsye, shumë nga judenjtë... besuan në të” Ky është motivi i shprehur i ungjillit (shih 20:30-31). Kjo frazë shndërrohet në motiv (shih 2:23; 7:31; 8:30; 10:42; 11:45; 12:11,42). Sidoqoftë, duhet të pohojmë sërish se besimi në ungjillin e Gjonit ka disa nivele dhe nuk është gjithmonë besim shpëtues (shih 2:23-25; 8:30 e më tej). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

11:46 “disa prej tyre shkuan te farisenjtë dhe u treguan se ç’kishte bërë Jezusi” Është e habitshme shkalla e verbërisë shpirtërore përballë një mësimi kaq të mahnitshëm dhe këtyre mrekullive kaq të fuqishme. Gjithsesi, Jezusi i ndan të gjitha grupet në ata që besojnë në të dhe në ata që refuzojnë të vërtetën për të. Edhe një mrekulli e fuqishme si kjo nuk ngjall besim (shih Luka 16:30-31).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:47-53

⁴⁷Atëherë, krerët e priftërinjve dhe farisenjtë u mbledhën në këshill dhe thanë: “Si t’ia bëjmë? Sepse ky njeri po kryen shumë shenja. ⁴⁸Nëse e lejojmë të vazhdojë kështu, gjithë njerëzit do të besojnë në të, dhe do të vijnë romakët e do të na e marrin vendin dhe kombin”. ⁴⁹Por njëri prej tyre, Kajafa, i cili ishte kryepriifti për atë vit, u tha: “Ju s’kuptoni asgjë, ⁵⁰dhe as nuk merrni parasysh se është e leverdishme për ju që një njeri të vdesë për popullin, në mënyrë që të mos humbasë gjithë kombi”. ⁵¹Por ai nuk e tha këtë nga vetja, por, duke qenë kryepriifti për atë vit, profetizoi se Jezusi do të vdiste për kombin, ⁵²madje, jo vetëm për kombin, por me qëllim që të mblidhte së bashku në një fëmijët e Perëndisë që janë të shpërndarë në botë. ⁵³Kështu, që nga ajo ditë, ata bënë plan së bashku që ta vrisnin.

11:47 “krerët e priftërinjve dhe farisenjtë u mbledhën në këshill” Bëhet fjalë për Sinedrin, gjykatën e lartë të judenjve në Jerusalem. Ai kishte 70 anëtarë lokalë. Krerët e priftërinjve kishin bindjet politike dhe fetare të saducenjve, të cilët pranonin vetëm shkrimet e Moisiut dhe mohonin ringjalljen. Farisenjtë ishin grupi më popullor dhe më legalist, që mbështeste (1) gjithë DhV; (2) shërbesën e engjëjve; (3) dhe jetën e përtejme. Është e habitshme sesi këto dy grupe rivale u bashkuan për një qëllim. Shih Temën e Veçantë: Farisenjtë në 1:24. Shih Temën e Veçantë: Sinedri në 3:1.

▣ **“Sepse ky njeri po kryen shumë shenja”** Përmendja e Jezusit si “ky njeri” është një mënyrë përçmuese për të mos ia përmendur emrin. Po kështu, është e habitshme që, në prani të këtyre mrekullive madhështore, si ringjallja e Lazarit, anësia e tyre plot paragjykime ua kishte verbuar kaq shumë sytë (shih 2 Kor. 4:4).

11:48 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

▣ **“të gjithë njerëzit do të besojnë në të”** Burimi i mosbesimit dhe frikës së tyre nga Jezusi ishte, jo vetëm mospajtimi teologjik, por edhe smira. “Të gjithë” mund të nënkuptojë edhe samaritanët me johebrenjtë (shih 10:16). Frika e tyre kishte dhe një aspekt politik (pra, kontrolli romak).

▣ **“do të vijnë romakët dhe do të na e marrin vendin dhe kombin”** Kjo është një nga ato profecitë ironike të ungjillit të Gjonit, pasi ajo u përmbush në mënyrë të fjalëpërfjalshme në vitin 70 pas K. nën gjeneralin romak (më vonë, perandorin romak) Titi.

Realiteti politik i pushtimit romak ishte pjesë e pandashme e shpresës judaike për fundin e kohës (eskatologjike). Ata besonin se Perëndia do të dërgonte një personalitet fetar/ushtarak, si Gjyqtarët e DhV, për t’i çliruar fizikisht nga Roma. Një sërë pretenduesish mesianikë nisën kryengritje në Palestinë për të përmbushur pikërisht këtë pritshmëri.

Jezusi pohoi se mbretëria e tij nuk ishte një mbretërim i përkohshëm/politik (shih 18:36), por një mbretërim shpirtëror që do të përmbushej globalisht në të ardhmen (pra, zbulesë). Ai pohoi se përmbushte profecitë e DhV, por jo në kuptimin e fjalëpërfjalshëm judaik dhe nacionalist. Për këtë, shumica e judenjve të kohës së vet e mohuan.

11:49 “Kajafa, i cili ishte kryepriifti për atë vit” Kryepriiftëria duhet të ishte një pozicion për gjithë jetën, që u transmetohej fëmijëve (shih Eksodi 28), por, pas pushtimit romak, ajo i shitej atij që jepte më shumë para për shkak të biznesit fitimprurës që kryhej në malin e Ullinjve dhe në zonën e tempullit. Kajafa ishte kryepriift nga viti 18-36 pas K. (dhëndri i Anës, kryepriift nga 6-15 pas K.).

11:50-52 Ky është një tjetër shembull i ironisë së Gjonit. Kajafa predikon ungjillin!

11:50 “një njeri të vdesë për popullin” Sfondi i kësaj në DhV është pikëpamja judaike e “kolektivitetit”. Një njeri (i mirë ose i keq) mund të ndikojë te gjithë kolektivi (p.sh., Adami/Eva; Akani). Ky koncept u bë bazë e sistemit flijues, sidomos për Ditën e Shlyerjes (Levitiku 16), ku një kafshë e pafajshme mbartte mëkatet e gjithë kombit. Ky bëhet koncepti mesianik që qëndron pas Isaisë 53. Në DhR, tipologjia e Adamit/Krishtit te Rom. 5:12-21 pasqyron këtë koncept.

11:51

NASB, REV,

NET “se Jezusi do të vdiste”

NKJV, NIV,

REB “se Jezusi do të vdiste”

NRSV “se Jezusi do të vdiste pas pak”

NJB “se Jezusi duhet të vdiste”

NIDOTTE, vëll. 1, f. 326, ka një koment të vyer për përdorimin teologjik të FOLJES *mellō* (“duhet”, “jam i sigurt”), kur ajo përdoret për vullnetin e Perëndisë për veprën shpënguese të Krishtit.

1. Marku 10:32

2. Mateu 17:22

3. Luka 9:31, 44; 24:21; Veprat 26:23

4. Gjoni 7:39; 11:51; 12:33; 14:22; 18:32

Përdoret edhe për domosdoshmërinë e tradhtisë së Judës

1. Luka 22:23

2. Gjoni 6:71; 12:4

Luka, te Veprat, e përdor për përmbushjen profetike (shih Veprat 11:28; 24:15; 26:22). Të gjitha ngjarjet shpënguese ishin në duart e Perëndisë (shih Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29)!

11:52 “me qëllim që të mblidhte së bashku në një fëmijët e Perëndisë” Ky duket se është koment redaktorial i Gjoni, që mund të jetë paralel me 10:16. Mund të nënkuptojë

1. Judenjtë që jetonin jashtë Palestinës

2. Gjysmëjudenjtë, si samaritanët

3. Johebrenjtë

Alternativa #3 duket si më e mira. Sido që të jetë, vdekja e Jezusit do t'i sjellë bashkim njerëzimit “besimtar” (shih 1:29; 3:16; 4:42; 10:16).

11:53 “Kështu, që nga ajo ditë, ata bënë plan së bashku që ta vrisnin” Ky është një motiv i përsëritur te Gjoni (shih 5:18; 7:19; 8:59; 10:39; 11:8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:54

⁵⁴Prandaj, Jezusi nuk ecte më haptazi ndër judenjtë, por prej andej u tërhoq në një vend pranë shkretëtirës, në një qytet të quajtur Efraim; dhe aty qëndroi me dishepujt e vet.

11:54 “Prandaj, Jezusi nuk ecte më haptazi ndër judenjtë” Gjoni 12 është përpjekja e fundit e Jezusit për t'u marrë me krerët fetarë.

Fjala te Gjoni që përkthehet “haptazi” (shih 7:26; 11:54; 18:20), zakonisht, do të thotë “me guxim”. Shih Temën e Veçantë në 7:4.

▣ **“në një qytet të quajtur Efraim”** Ky qytet ndoshta ndodhej pranë Betelit në Samari (shih 2 Kro. 13:19).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:55-57

⁵⁵Dhe Pashka e judenjve ishte afër, dhe shumë vetë nga ajo krahinë u ngjitën në Jerusalem përpara Pashkës për t'u pastruar. ⁵⁶Kështu, ata po kërkonin Jezusin dhe po i thoshin njëri-tjetrit teksa qëndronin në tempull: “Si mendoni? Do të vijë në festë?” ⁵⁷Krerët e priftërinjve dhe farisenjtë kishin dhënë urdhër që, nëse dikush e dinte ku ndodhej ai, duhet të raportonte që ata ta kapnin.

11:55-57 Këto vargjet lidhin së bashku kapitullin 11 me 12.

11:55 “për t’u pastruar” Bëhet fjalë për ritet e pastrimit në përgatitje për Pashkën. Ende ka debate se për sa kohë mësoi, predikoi dhe shërbeu Jezusi në Palestinë. Ungjijtë sinoptikë janë strukturuar në mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur një ose dy vite. Mirëpo Gjoni përmend disa Pashkë (një festë vjetor). Përmenden me siguri tre të tilla (shih 2:13; 6:4; dhe 11:55), dhe të paktën një e katërt nënkuptohet me termin “një festë” në 5:1.

11:57 Ky është një tjetër koment redaktorial nga Gjoni.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një koment studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse e lejoi Jezusi Lazarin të vdiste?
2. Kujt i drejtohej kjo mrekulli?
3. Cili është dallimi mes ringjalljes dhe rikthimit në jetë?
4. Pse u tmerruan kaq shumë krerët e judenjve nga ngjallja e Lazarit?

GJONI 12

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Vajosja në Betani 12:1-8	Vajosja në Betani 12:1-8	Vajosja në Betani 12:1-8	Jezusi vajoset në Betani 12:1-6 12:7-8	Vajosja në Betani 12:1-8
Komploti kundër Lazarit 12:9-11	Komploti për vrasjen e Lazarit 12:9-11	12:9-11	Komploti kundër Lazarit 12:9-11	12:9-11
Hyrje ngadhënjimtare në Jerusalem 12:12-19	Hyrja ngadhënjimtare 12:12-19	E diela e Palmave 12:12-19	Hyrja ngadhënjimtare në Jerusalem 12:12-13 12:14 12:15 12:16 12:17 12:18-19	Mesia hyn në Jerusalem 12:12-19
Disa grekë kërkojnë Jezusin 12:20-26	Kokrra e frytshme e grurit 12:20-26	Shërbesa publike e Jezusit përmbillet 12:20-26	Disa grekë kërkojnë Jezusin 12:20-21 12:22-26	Jezusi parathotë vdekjen dhe përlëvdimin e ardhshëm të vet 12:20-28a
Biri i Njeriut duhet të lartohet 12:27-36a	Jezusi parathotë vdekjen e vet në kryq 12:27-36	12:27-36a	Jezusi flet për vdekjen e vet 12:27-28a 12:28b 12:29 12:30-33 12:34 12:35-36a	12:28b 12:29-32 12:33-36a
Mosbesimi i judenjve 12:36b-43	Kush i ka besuar lajmit tonë? 12:37-41	12:36b-43	Mosbesimi i njerëzve 12:36b-38 12:39-40 12:41 12:42-43	12:36b Përfundimi: mosbesimi i judenjve 12:37-38 12:39-40 12:41 12:42-50
Gjykimi nga fjalët e Jezusit 12:44-50	Ecni në dritë 12:42-50	12:44-50	Gjykimi nga fjalët e Jezusit 12:44-50	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-50

- A. Të katërt ungjijtë përmendin vajosjen e Jezusit nga një grua. Si rrjedhojë, kjo ngjarje duhet të ketë patur rëndësi për shkruesit e ungjijve. Sidoqoftë, Marku 14:3-9, Mat. 26:6-13 dhe Gjoni 12:2-8 e identifikojnë atë si Maria e Betanisë, motra e Lazarit, ndërsa Luka 7:36-50 e identifikon si një grua mëkatore në Galile.
- B. Kapitulli 12 përmbyll shërbesën publike të Jezusit (shih v. 29). Ai ishte përpjekur pa pushim që t'i sillte krerët judenj në besim. Kapitulli 11 ishte përpjekja e tij për të sjellë në besim popullin e Jerusalemit.
- C. Në këtë kapitull përmenden pesë grupe njerëzish.
 1. turma që dëshmoi ngjalljen e Lazarit, v. 17
 2. një turmë nga Jerusalemi, v. 9
 3. turma e pelegrinëve që erdhën për Pashkën, v. 12, 18, 29, 34
 4. ndoshta, një turmë johebrenjsh, v. 20
 5. ndoshta, një turmë krerësh judenj që besuan në të, v. 42

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:1-8

¹Pra, Jezusi, gjashtë ditë përpara Pashkës, erdhi në Betani, ku ishte Lazari, të cilin Jezusi e kishte ngjallur nga vdekja. ²Kështu, ata i shtruan darkë aty, dhe Marta po shërbente; ndërsa Lazari ishte ndër ata që ishin shtruar në tryezë me Jezusin. ³Pastaj, Maria mori një libër parfumi erëkëndshëm shumë të shtrenjtë prej nardi të pastër, vajosi me të këmbët e Jezusit dhe ia fshiu këmbët me flokët e saj; dhe shtëpia u mbush me aromën e parfumit. ⁴Por Juda Iskarioti, një nga dishepujt, që synonte ta tradhtonte, tha: ⁵“Pse nuk u shit ky parfum për treqind dinarë dhe t’u jepej të varfërve?” ⁶Por ai e tha këtë, jo ngaqë shqetësohej për të varfrit, por ngaqë ishte hajdut, dhe meqë kishte qesen e parave vidhte ç’shtinin aty brenda. ⁷Prandaj, Jezusi i tha: “Lëre të qetë, që ta ruajë për ditën e varrimit tim. ⁸Sepse të varfrit do t’i keni gjithmonë me ju, por mua nuk do të më keni gjithmonë”.

12:1 “gjashtë ditë përpara Pashkës” Kjo është një rrjedhë e ndryshme kronologjike nga Mat. 26:2. Duhet të mos harrojmë se fokusi kryesor i ungjijve nuk është kronologjia, por veprimet përfaqësuese të Jezusit, që pasqyrojnë të vërtetën për personin dhe veprime e tij. Ungjijtë nuk janë biografë, por trakte ungjillëzuese për grupe të caktuara.

12:2 “ata” Me sa duket, bëhet fjalë për vendasit e Betanisë, të cilët shtruan darkë për Jezusin dhe për dishepujt në nderim të ngjalljes së Lazarit. Megjithatë, në Mat. 26:6, kjo ndodhi në shtëpinë e Simon Lebrozit.

12:3 “libër” Kjo ishte një fjalë latine që përdorej nga romakët, e barabartë me rreth 350 gram. Ky parfumi i shtrenjtë mund të ketë qenë paja e dasmës së Marisë. Shumë gra të pamartuara e varnin këtë lloj parfumi me shishkë rreth qafës.



NASB “një libër parfumi erëkëndshëm shumë të shtrenjtë prej nardi të pastër”

NKJV “një libër vaji shumë të shtrenjtë prej nardi të vërtetë”

NRSV “një libër parfumi të shtrenjtë, të bërë prej nardi të pastër”

TEV “një pintë të tërë parfumi shumë të shtrenjtë, të bërë prej nardi të pastër”

NJB “një libër vaji shumë të shtrenjtë, nard i pastër”

Ka patur shumë hamendësime për kuptimin e MBIEMRIT: (1) i pastër; (2) i lëngshëm; ose (3) emër vendi. Vetë parfumi vinte nga një rrënjë aromatike prej Himalajës, që ishte shumë e shtrenjtë. Shih James M. Freeman, *Manners and Customs of the Bible [Sjelljet dhe zakonet e Biblës]*, f. 379-380.

■ **“vajosi me të këmbët e Jezusit”** Rrëfimet që i bëjnë ungjijtë e tjerë kësaj ngjarjeje (me gjasë, mirënjohjes së Marisë për ringjalljen e Lazarit, v. 2) flasin për një grua që i vajos kokën. Me sa duket, Maria i vajosi gjithë trupin, duke ia nisur nga koka dhe duke vazhduar deri te këmbët. Arsyeja pse i dukeshin këmbët Jezusit ishte se ai mbështetej mbi bërrylin e majtë në një tryezë të ulët.

Kjo është një nga dykuptimësitë e Gjonit. Kjo aromë përdorej për të përgatitur trupin e të vdekurve për varrim (shih 19:40). Maria mund ta ketë kuptuar më mirë mesazhin e Jezusit për vdekjen e tij të afërt sesa dishepujt (shih v. 7). Shih Temën e Veçantë: Vajosja në 11:2.

■ **“dhe shtëpia u mbush me aromën e parfumit”** Çfarë detaji i gjallë prej dëshmitari okular (redaktorial). Gjonit i kujtohet shumë qartë ai çast!

12:4 “Juda Iskarioti” Termi “Iskariot” ka dy etimologji të mundshme: (1) një qytet në Jude (Kerioth, shih Joz. 15:25), ose (2) termi që përdorej për “thikën e vrasësit”. Nga gjithë shkrimtarët e ungjijve, Gjoni tha fjalët më të rënda për Judën (shih v. 6). Shih shënimin e plotë në 6:70-71.

■ **“tradhtonte”** Ky është një tjetër koment redaktorial. Normalisht, ky term nuk ka këtë ngjyrim. Fjalë për fjalë, do të thotë “dorëzoi” në kuptimin gjyqësor, ose “i besoi” diçka dikujt. Shih shënimin në 18:2.

12:5 “treqind dinarë” Një dinar ishte rroga ditore e një ushtari ose punëtori, pra, kjo ishte pothuajse sa rroga e një viti.

12:6 Ky varg është një tjetër koment redaktorial. Gjoni e dënon Judën më tepër se çdo ungjill tjetër.



NASB, NKJV “qesen e parave”

NRSV “qesen e përbashkët”

TEV “çantën e parave”

NJB “fondin e përbashkët”

Kjo fjalë do të thotë “kuti e vogël”. Në fillim, përdorej nga muzikantët për të mbajtur pjesët e gojës të instrumenteve të tyre.

■ **“vidhte ç’shtinin aty brenda”** Në greqisht, kjo fjalë është “transportoj”. Përdoret në dy kuptime: (1) ai transportonte kutinë, por (2) edhe merrte për vete përmbytjen e kutisë. Kjo thënie mund të jetë përfshirë për të treguar se, në të vërtetë, preokupimi i Judës për të varfrit në v. 5 është justifikim për të vjedhur për vete.

12:7 Ky është varg i çuditshëm. Qartazi, ai e lidh këtë akt bujarie dhe përkushtimi me një procedurë të ngjashme që bëhej në varrim (shih 19:40). Kjo është një tjetër thënie profetike e Gjonit.

12:8 “Sepse të varfrit do t’i keni gjithmonë me ju” Kjo lidhet me LiP. 15:4, 11. Nuk është thënie përçmuese për të varfrit por theksim i pranisë së Mesisë në Jezusin (shih v. 35; 7:33; 9:4). DhV është unike në gjithë literaturën e Lindjes së Afërt të lashtë për të drejtat dhe përkujdesjen e detyrueshme për të varfrit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:9-11

⁹Ndërkohë, turma e madhe e judenjve mësoi se ai ishte aty; dhe shkuan, jo vetëm për hir të Jezusit, por që të shihnin edhe Lazarin, të cilin e kishte ringjallur. ¹⁰Por krerët e priftërinjve planifikuan të vrisnin edhe Lazarin; ¹¹sepse për shkak të tij shumë prej judenjve po largoheshin dhe po besonin në Jezusin.

12:9 “turma e madhe e judenjve mësoi se ishte aty” Ky është një përdorim i pazakontë i termit “judenjtë” në Gjoni. Zakonisht, bën fjalë për krerët fetarë që i kundërviheshin Jezusit. Mirëpo, në 11:19, 45; 12:17, duket se bën fjalë për banorët e Jerusalemit që ishin miq me Lazarin dhe i kishin shkuar në funeral.

12:10 “krerët e priftërinjve planifikuan të vrisnin edhe Lazarin” Ata donin të hiqnin qafe provat! Motivi i tyre ishte frika (shih 11:48) dhe smira (shih 11:48; 12:11).

Ata duhet të kenë menduar se akti i ngjalljes së Lazarit ishte një ngjarje e izoluar dhe e rrallë. Verbëria dhe anësia e këtyre krerëve të judenjve pasqyron errësirën e njerëzimit të rënë.

12:11 Kjo kthehet pas te 11:45. Shih Temën e Veçantë: Përdorimi i FOLJES “Besoj” te Gjoni, në 2:23.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:12-19

¹²Të nesërmen, turma e madhe që kishte ardhur për festën, kur dëgjoi se Jezusi po vinte në Jerusalem, ¹³mori degë prej pemëve të palmave, doli për takuar dhe filloi të bërtiste: “Hozana! I BEKUAR ËSHTË AI QË VJEN NË EMRIN E ZOTIT, vetë mbreti i Izraelit”. ¹⁴Jezusi, si gjeti një kërric, u ul mbi të; siç është shkruar, ¹⁵“MOS KI FRIKË, BIJË E SIONIT: JA, MBRETI YT PO VJEN, I ULUR MBI NJË KËRRIÇ GOMARI”. ¹⁶Këto gjëra dishepujt e tij nuk i kuptuan në fillim; por, pasi Jezusi u përlevdua, iu kujtua se këto fjalë ishin shkruar për të dhe që i kishin bërë këto gjëra për të. ¹⁷Kështu, njerëzit, që kishin qenë me të kur i kishte thirrur Lazarit të dilte nga varri dhe e kishte ringjallur, vazhduan të dëshmonin për të. ¹⁸Për këtë arsye dhe njerëzit shkuan që ta takonin, sepse dëgjuan se kishte kryer edhe këtë shenjë. ¹⁹Kështu, farisenjtë i thanë njëri-tjetrit: “Ju e shihni se s’po bëni asgjë; ja, gjithë bota po shkon pas tij”.

12:12-19 Ky është versioni i Gjonit për hyrjen ngadhënjimtare të Jezusit në Jerusalem (shih Mat. 21:1-11; Marku 11:1-11; Luka 19:29-38).

12:12 “turma e madhe që kishte ardhur për festën” Këto ishin tre ditët e detyruara të festës për meshkujt judenj (shih Eks. 23:14-17; Lev. 23; LiP. 16:16). Dëshira më e madhe e jetës për judenjtë që jetonin jashtë Palestinës (në Diasporë) ishte të shkonin për festa në Jerusalem. Gjatë këtyre festave të përcaktuara, Jerusalemi fryhej sa trefishi ose pesëfishi i popullsisë së vet normale. Kjo frazë i referohet këtij numri të stërmadh pelegrinësh kureshtarë që kishin dëgjuar për Jezusin dhe donin ta shihnin (shih 11:56).

12:13 “degë prej pemëve të palmave” Kjo është një frazë e pazakontë greqisht për degët e palmave. Disa besojnë se, në një periudhë të caktuar, në shpatet e malit të Ullinjve rriteshin palma (p.sh., Jozefusi), ndërsa disa të tjerë besojnë se ato importoheshin nga Jeriko. Duket se ishin simbol fitoreje ose triumfi (shih Zbu. 7:9). Ato përdroreshin çdo vit në ritualin e festës së Çadrave (shih Lev. 23:40) dhe për Pashkë (traditë nga periudha e makabejve).

▣ **“filloi të bërtiste”** Kjo është në KOHËN E PAKRYER, që nënkupton (1) një veprim të përsëritur në të shkuarën, ose (2) fillimin e një veprimit në të shkuarën.

▣ **“Hozana”** Kjo fjalë donte të thoshte “shpëto tani”, ose “shpëto, të lutem” (shih Psa. 118:25-26). Gjatë ritualit të Pashkës, bëhej recitimi i Psalmeve “Hilel” (shih Psa. 113-118) ndërsa pelegrinët marshonin drejt tempullit. Shumë prej këtyre veprimeve dhe frazave përsëriteshin çdo vit gjatë festës së Pashkës. Por këtë vit në veçanti, ato gjetën kuptimin e tyre të plotë në Jezusin! Turma e ndjeu këtë. Farisenjtë e kuptuan.

▣ **“AI QË VJEN NË EMRIN E ZOTIT”** Pikërisht këtë ka pohuar dhe Jezusi. Ai ishte i Dërguari! Ai përfaqësonte JHVH-në.



NASB “vetë mbreti i Izraelit”

NKJV, NRSV

TEV, NJB “mbreti i Izraelit”

Kjo frazë nuk ishte pjesë e Psalmi, por e shtoi turma. Duket se përbën referencë të drejtpërdrejtë për Jezusin si Mbreti mesianik i premtuar në 2 Sam. 7 (shih 1:49; 19:19).

12:14 “një kërraç” Gomarët ishin kafshët mbretërore dhe ushtarake të barrës për mbretërit izraelitë (shih 1 Mbret. 1:33, 38, 44). Vetëm mbreti i hipte gomarit të vet, si rrjedhojë, ishte shumë e rëndësishme që Jezusit të hipte mbi një gomar që nuk e kishte ngarë askush më parë (shih Marku 11:2).

12:14-15 “siç është shkruar” Ky ishte citim nga Zak. 9:9. Kërraçi i gomarit nuk nënkupton vetëm natyrën mbretërore të Mesisë, por edhe përvulësinë e tij. Jezusi nuk erdhi si personalitet ushtarak pushtues, siç e prisnin judenjtë, por si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaisë, duke ngarë një kërraç gomari.

12:16 “Këto gjëra dishepujt e tij nuk i kuptuan në fillim” Ky ishte një tjetër kujtim i dhimbshëm prej dëshmitari okular i Gjonit. Është motiv i përsëritur (shih 2:22; 10:6; 16:18; Marku 9:32; Luka 2:50; 9:45; 18:34). Vetëm pas Ngjitjes dhe pas Rrëshajave iu hapën atyre plotësisht sytë shpirtërorë.

■ **“por, pasi Jezusi u përlëvdua, iu kujtua”** Kjo ishte një nga shërbesat e Frymës së Shenjtë (shih 14:26 dhe 2:22).

Ky varg tregon, gjithashtu, se shkruesit e ungjijve i strukturuan ungjijtë sipas përvojës së tyre personale me Krishtin e ringjallur. Ungjijtë sinoptikë e paraqesin Jezusin në zhvillim historik dhe ia fshehin lavdinë deri në pikën kulmore të prezantimeve të tyre, ndërsa Gjoni e shkruan gjithë ungjillin e vet në dritën e Mesisë së përlëvduar. Ungjijtë pasqyrojnë kujtime të mëvonshme dhe nevojat e komunitetit besimtar të këtyre burrave të frymëzuar. Si rrjedhojë, ka dy kontekste historike (konteksti i Jezusit dhe ai i shkruesve të ungjijve), por të dy janë të frymëzuar.

■ **“u përlëvdua”** Shih shënimin në 1:14.

12:17 Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit në 1:8. Shih Mësimet Kontekstuale, C.

12:19 “farisenjtë i thanë njëri-tjetrit” Ky është një tjetër parashikim profetik. Bën fjalë për (1) judenjtë, 11:48; 12:11 dhe (2) johebrenjtë, v. 20-23. Pasqyron dy kontekste historike: jetën e Jezusit dhe jetën e kishës së hershme.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:20-26

²⁰Kishte dhe disa grekë mes atyre që po ngjiteshin për të adhuruar në festë; ²¹këta, pra, erdhën te Filipi, i cili ishte nga Betsaida e Galilesë, dhe filluan të pyesnin duke i thënë: “Zotëri, ne duam të shohim Jezusin”. ²²Filipi shkoi dhe i tha Andreas; Andrea dhe Filipi shkuan dhe i thanë Jezusit. ²³Dhe Jezusi iu përgjigj duke thënë: “Ka ardhur ora që Biri i Njeriut të përlëvdohet. ²⁴Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them, se nëse kokrra e grurit nuk bie në tokë dhe vdes, mbetet e vetme; por, nëse vdes, prodhon shumë fryt. ²⁵Ai që e do jetën e vet, do ta humbasë, kurse ai që urren jetën e vet në këtë botë, do ta ruajë për jetën e përjetshme. ²⁶Nëse dikush më shërben mua, duhet të më ndjekë; dhe aty ku jam unë, do të jetë dhe shërbëtori im; nëse dikush më shërben, Ati do ta nderojë”.

12:20 “disa grekë” Kjo përdoret në kuptimin e johebrenjve, jo në veçanti për ata me kombësi greke.

■ **“mes atyre që po ngjiteshin për të adhuruar në festë”** KOHA E TASHME nënkupton se ata e kishin zakon të shkonin në Festë. Ata ishin, ose (1) njerëz që besonin në Perëndinë, ose (2) prozelitë të Portës. Të parët ishin adhurues të rregullt në sinagogë, ndërsa të dytët ishin bërë zyrtarisht besimtarë të besimit judaik.

12:21 “filluan ta pyesnin” Kjo është në KOHËN E PAKRYER, që nënkupton se (1) ata e pyetën vazhdimisht, ose (2) filluan ta pyesnin. Ata donin bisedë private me Jezusin. Me sa duket, ky ishte tik-taku i fundit i orës profetike përpara vdekjes së Jezusit (shih v. 23).

12:22 Filipi (“dashuruesi i kuajve”) dhe Andrea (“burrërori”) janë të vetmit apostuj që kanë emra grekë. Ndoshta, kjo i lejoj këta grekë (pra, johebrenj) që të ndiheshin se mund t’u afroreshin atyre.

12:23 “Ka ardhur ora” Kjo është në KOHËN E KRYER. Shpesh, Gjoni e përdori fjalën “orë” për t’iu referuar kryqëzimit dhe ringjalljes si ngjarjeve kulmore në misionin e Jezusit (shih 12:27; 13:1, 32; 17:1). Jezusi pohoi se kishte ardhur për delet e humbura të Izraelit (shih Mat. 15:24). Tani, mesazhi i tij po arrinte te johebrenjtë!

■ **“Biri i Njeriut”** Kjo ishte frazë aramaike që donte të thoshte thjesht “qenie njerëzore” (shih Psa. 8:4; Ezek. 2:1). Sidoqoftë, në Dan. 7:13 u përdor me ngjyrimin e mëtejshëm të Hyjnisë. Ky ishte titulli që kishte zgjedhur Jezusi për veten, dhe që kombinon dy natyrat e tij, atë njerëzore me atë hyjnore (shih 1 Gjonit 4:1-3).

■ **“të përlëvdohet”** Vdekja e Jezusit përmendet gjithmonë si “lavdia e tij”. Termi “lavdi” përdoret disa herë në këtë kontekst (shih v. 28 [dy herë]; 32 dhe 33). Shpesh, ajo përdoret për të nënkuptuar vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit (shih 13:1, 32; 17:1). Shih shënimin në 1:14.

12:24 “nëse kokrra e grurit nuk bie në tokë dhe vdes” Kjo është gjuhë fenomenologjike ose përshkruese, pra, flet për gjërat siç na shfaqen në pesë shqisat. Një farë mund të prodhojë shumë fara (shih 15:2, 4, 5, 8, 16; 1 Kor. 15:36). Vdekja e tij solli shumë vetë në jetën e vërtetë (shih Marku 10:45).

■ **“nëse”** Në këtë kontekst, ka një sërë FJALISH KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkuptojnë veprim të mundshëm (shih v. 24, 26, 37, 47).

12:25 “Ai që e do jetën e vet, do ta humbasë” Kjo është lojë fjalësh me fjalën greke *psyhē*, që i referohet esencës ose forcës jetësore njerëzore (shih Mat. 10:39; 16:24-25; Marku 8:34-35; Luka 9:23-24). Pasi njeriu beson në Krishtin, merr një jetë të re. Kjo jetë e re është dhuratë nga Perëndia për shërbesë, jo për përdorim personal. Besimtarët janë administratorë të kësaj jete të re. Ne jemi çliruar nga skllavëria e mëkatit për t’u bërë shërbëtorë të Perëndisë (shih Rom. 6:1-7:6).

Barinjët e rremë të kapitullit 10 përpiqeshin “të shpëtonin” jetën e tyre duke ia mbathur me vrap. Ndërsa Jezusi jep jetën e vet, kështu dhe besimtarët duhet të bëjnë të njëjtën gjë (shih 2 Kor. 5:12-15; Gal. 2:20).

■ **“do ta humbasë”** Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Kjo fjalë (shih Temën e Veçantë në 10:10) do të thotë “shkatërroj”, një tjetër fjalë me dy kuptime. Kjo është e kundërta e “jetës së përjetshme”. Nëse njeriu nuk ka besim në Krishtin, kjo është e vetmja alternativë. Ky shkatërrim nuk është asgjësim, por humbje e marrëdhënies personale me Perëndinë (ky është dhe thelbi i Ferrit).

■ **“urren”** Kjo është fjalë hebraike krahasimi. Perëndia duhet të jetë përparësia jonë (shih gratë e Jakobit, Zan. 29:30, 31; LiP. 21:15; Esau dhe Jakobi, Mal. 1:2-3; Romakëve 10-13; familja, Luka 14:26).

■ **“jetën”** Kjo është fjala greke *zoē*. Përdoret vazhdimisht te Gjoni për të nënkuptuar (1) jetën shpirtërore; (2) jetën e përjetshme; (3) jetën në epokën e re; dhe (4) jetën e ringjalljes. Jeta e vërtetë është liri nga tirania e “vetes”, gjë që përbën thelbin e Rënies.

12:26 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ **“duhet të më ndjekë”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për një marrëdhënie të vazhdueshme (shih Gjoni 15). Kjo është tema e anashkuar biblike e qëndresës së besimtarit (shih Temën e Veçantë: Nevoja për Qëndresë, në 8:31). Kjo temë shpesh pëshqjellohet nga tensioni teologjik mes Perëndisë sovran dhe vullnetit njerëzor. Megjithatë, gjëja më e mirë është që shpëtimin ta shohim si përjetim besëlidhjeje. Perëndia është gjithmonë ai që nis (shih 6:44, 65) dhe përcakton agjendën, por ai i kërkon njerëzimit që t’i përgjigjet ofertës së tij me pendim dhe me besim (shih Marku 1:15; Veprat 20:21), qoftë si vendim fillestar, ashtu dhe si dishepullizim gjithë jetën. Qëndresa është provë se ne e njohim Zotin (shih Mat. 10:22; 13:20-21; Gal. 6:9; 1 Gjonit 2:19; Zbu. 2:7,11,17,26; 3:5,12,21).

Doktrina e krishterë, për shkak se bazohet në Bibël, shpesh vjen me dyshe paradoksale, të mbushura me tension. Letërsia lindore karakterizohet nga këto modele të figurshme, me mendime të kundërta. Shpesh, lexuesit e sotëm perëndimorë i fusin forcërisht këto paradokse në zgjedhje të tipit “ose kjo, ose kjo tjetra”, kur në fakt ato duhen marrë si të vërteta plotësuese.

Për të ilustruar komentet e mia, kam përfshirë një pjesë nga Seminari im për Interpretimin e Biblës, me titull “Paradokset biblike”:

“Paradokset biblike:

1. Ky zbulim ka qenë tejet i dobishëm për mua personalisht, si një njeri që do Biblën dhe e beson si Fjalë të Perëndisë. Në përpjekjen për të marrë Biblën seriozisht, m’u bë e qartë se pasazhet e ndryshme e zbulojnë të vërtetën në mënyra të përzgjedhura, por jo sistematike. Një pasazh i frymëzuar nuk mund të anulohet apo zhvlerësojë një tjetër pasazh të frymëzuar! E vërteta vjen kur njohim gjithë Shkrimin (gjithë Shkrimi, dhe jo vetëm një pjesë e tij, është i frymëzuar, shih 2 Tim. 3:16-17), jo kur citojmë një pasazh të vetëm (si pasazh-provë)!
2. Shumica e të vërtetave biblike (në letërsinë lindore) paraqiten në dyshe dialektike ose paradoksale (mos harroni se autorët e DhR, përveç Lukës, janë mendimtarë hebrej, ndonëse shkruajnë në greqishten popullore). Letërsia e Urtësisë dhe Letërsia Poetike e paraqesin të vërtetën në rreshta paralele. Paralelizmi antitetik funksionon si paradoks. Ky paralelizëm sintetik funksionon si pasazhe paralele. Në njëfarë mënyre, të dyja janë njëlloj të vërteta! Këto paradokse janë të dhimbshme për traditat tona të preferuara dhe thjeshtëzuese!
 - a. paracaktimi përkundër vullnetit të lirë njerëzor
 - b. siguria e besimtarit përkundër nevojës për qëndresë
 - c. mëkati fillestar përkundër mëkatit me dashje
 - d. Jezusi si Perëndi përkundër Jezusit si njeri
 - e. Jezusi si i barabartë me Atin përkundër Jezusit si i nënshtruar ndaj Atit
 - f. Bibla si Fjalë e Perëndisë përkundër autorësisë njerëzore
 - g. mungesa e mëkatit (përsosmëria, shih Romakëve 6) përkundër pakësimit të mëkatit
 - h. shfajësimi dhe shenjtërimi fillestar e i atypëratyshëm përkundër shenjtërimin të përshkallëzuar
 - i. shfajësimi me anë të besimit (Romakëve 4) përkundër shfajësimit të vërtetuar me vepra (shih Jakobi 2:14-26)
 - j. liria e krishterë (shih Rom. 14:1-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33) përkundër përgjegjësisë së krishterë (shih Gal. 5:16-21; Efe. 4:1)
 - k. transcendenca e Perëndisë përkundër imanencës së tij
 - l. Perëndia si absolutisht i panjohur përkundër Perëndisë si i njohshëm në Shkrim dhe në Krishtin
 - m. metaforat e shumta të Palit për shpëtimin
 - (1) birësimi
 - (2) shenjtërimi
 - (3) shfajësimi
 - (4) shpengimi
 - (5) përlëvdimi
 - (6) paracaktimi
 - (7) pajtimi
 - n. mbretëria e Perëndisë si e tashme, përkundër përmbushjes së ardhshme
 - o. pendimi si dhuratë e Perëndisë përkundër pendimit si përgjigje e detyrueshme për shpëtim (shih Marku 1:15; Veprat 20:21)
 - p. DhV si e përhershme, përkundër DhV si e tejkaluar dhe e anuluar (shih Mat. 5:17-19 përkundër 5:21-48; Romakëve 7 përkundër Galatasve 3).
 - q. besimtarët si shërbëtorë/skllëvër ose si fëmijë/trashëgimtarë”

■ **“aty ku jam unë, do të jetë edhe shërbëtori im”** Ky motiv përsëritet në 14:3; 17:24; 2 Kor. 5:8; Fil. 1:23; 1 Thes. 4:17! Krishterimi është pikësepari marrëdhënie personale me Perëndinë! Synimi është marrëdhënia: prania e tij, bashkësia me të!

Ne jemi krijuar për bashkësi me Perëndinë (shih Zan. 1:26-27). Shpëtimi është rimëkëmbja e bashkësisë së prishur në Kopshtin e Edenit. Gjoni thekson se kjo bashkësi rimëkëmbet tani!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:27-36a

²⁷“Tani, shpirti im është i tronditur; dhe çfarë të them: „Atë, më shpëto nga kjo orë”? Por për qëllim kam ardhur në këtë orë. ²⁸Atë, përlëvdo emrin tënd”. Atëherë, nga qielli erdhi një zë: “E kam përlëvduar dhe do ta përlëvdoj sërish”. ²⁹Atëherë, turma e njerëzve që ishte e pranishme dhe e dëgjoi, po -thoshte se ishte bubullimë; të tjerë po thoshin: “Atij i foli një engjëll”. ³⁰Jezusi u përgjigj dhe tha: „Ky zë nuk ka ardhur për mua, por për hirin tuaj. ³¹Tani, gjykimi është mbi këtë botë; tani, sunduesi i kësaj bote do të flaket jashtë. ³²Dhe unë, pasi të lartësohem nga toka, do t’i tërheq gjithë njerëzit te vetja”. ³³Por ai po i thoshte këto për të treguar se me ç’lloj vdekjeje do të vdiste. ³⁴Atëherë, turma iu përgjigj: “Ne kemi dëgjuar nga Ligji se Krishti duhet të qëndrojë përjetë; atëherë, si mund të thuash: „Biri i Njeriut duhet lartësuar”? Kush është ky Biri i Njeriut?” ³⁵Kështu Jezusi u tha: “Edhe për pak kohë është Drita mes jush. Ecni ndërsa keni Dritën, që të mos ju zërë errësira; ai që ecën në errësirë nuk di se ku shkon. ³⁶Për sa kohë keni Dritën, besoni në Dritën, në mënyrë që të bëheni bij të Dritës”.

12:27 “shpirti im është i tronditur” Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE. Vepruesi (Ati, Satani, situatat, etj.) nuk shprehet. Kjo është një fjalë e fortë që përdoret në mënyra të ndryshme në DhR.

- frika nga Herodi (Mat. 2:3)
- frika e dishepujve (Mat. 14:26)
- ankthi i vazhdueshëm i Jezusit (Gjoni 12:27; 13:21; vini re dhe Mat. 26:38; Marku 14:34)
- kisha në Jerusalem (Veprat 15:24)
- prishja e kishave të Galatisë nga mësuesit e rremë (Gal. 1:7).

Kjo ishte mënyra sesi Gjoni shpreh betejën njerëzore të Jezusit me traumën e ardhshme të kryqëzimit (shih Marku 14:32 e më tej). Gjoni nuk e përmend agoninë e Jezusit në Gjetseman, por ky është i njëjti rast.

▣ **“më shpëto nga kjo orë”** Ka shumë diskutime për kuptimin e saktë të kësaj thënieje. A është lutje kjo (shih Mat. 26:39)? Apo është reagim i habitur për diçka që nuk duhet bërë (Bibla NET)?

▣ **“për këtë qëllim kam ardhur në këtë orë”** Jeta e Jezusit u shpalos sipas një plani hyjnor (shih Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28), gjë që Jezusi e kuptonte plotësisht (shih Mat. 20:28; Marku 10:45).

12:28 “përlëvdo emrin tënd” Ati përgjigjet në v. 28b. Kjo fjalë, “përlëvdoj”, është shumë e rrjedhshme. Mund të nënkuptojë

- lavdinë paraekzistuese të Jezusit (shih 17:5)
- zbulesën e Atit nga Jezusi (shih 17:4)
- kryqëzimin dhe ringjalljen e Jezusit (shih 17:1)

Shih shënimin në 1:14.

▣ **“nga qielli i erdhi një zë”** Këtë, rabinët e quanin *bath-kol*. Që nga koha e Malakisë, nuk kishte patur më zë profetik në Izrael. Që vërtetohej vullneti i Perëndisë, kjo duhej bërë nga një zë nga qielli. Ungjijtë përmendin se Perëndia foli tre herë gjatë jetës së Jezusit.

- në pagëzimin e Jezusit, Mat. 3:17
- në transformimin në mal, Mat. 17:5
- këtu, në këtë varg.

12:29 “Atëherë, turma e njerëzve që ishte e pranishme dhe e dëgjoi, po thoshte” Pati dy interpretime për atë që ndodhi: (1) ishte bubullimë. Kjo përdorej kur Perëndia fliste në DhV (shih 2 Sam. 22:14; Jobi 37:4; Psa. 29:3; 18:13; 104:7), ose (2) i foli një engjëll. Kjo është e ngjashme me pështjellimin për atë i ndodhi Saulit në Veprat 9:7; 22:9.

12:30 “Jezusi u përgjigj dhe tha: „Ky zë nuk ka ardhur për mua, por për hirin tuaj” Kjo frazë përbën një krahasim semitik. Kjo do të thotë se zëri nuk ishte vetëm për ta, por pikësepari për ta (shih 11:42).

12:31 “Tani, gjykimi është mbi këtë botë” Ky është konstrukt paralel me frazën e mëtejshme (“sunduesi i kësaj bote do të flaket jashtë”). Koha kur ndodhi kjo nuk qartësohet (shih Temën e Veçantë më poshtë).

Pa dyshim, unë bie dakord me F. F. Bruce, *Answers to Questions [Përgjigje për pyetjet]* (f. 198), se v. 31 është një tjetër shembull i asaj që C. H. Dodd e quajti “eskatologji e përmbushur”. Për Gjonin, Jezusi kishte sjellë

tashmë, edhe shpëtim për besimtarët, edhe gjykim për jobesimtarët. Në njëfarë kuptimi, kjo është e ngjashme me një formë gramatikore që quhet “E KRYERA PROFETIKE”. Diçka e ardhshme që është kaq e sigurt saqë shprehet sikur tashmë ka ndodhur!

■ **“sunduesi i kësaj bote”** Këtu bëhet fjalë për një forcë të ligë personale (shih 14:30; 16:11) që, në hebraisht, njihet si “Satani” ose “kundërshtari” (shih Jobi 1-2), ose, në greqisht, si “djalli” ose “akuzuesi” (shih Mat. 4:1, 5, 8, 11; 13:39; 25:41; Gjoni 6:70; 8:44; 13:2; 2 Kor. 4:4; Efe. 2:2). Këto dy emra janë sinonimikë në Mat. 4:1-11 dhe Gjoni 13:2, 27. Ai flaket nga qielli në mënyrë që të mos vazhdojë dot të akuzojë/fyejë ndjekësit e Jezusit.

TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON

Kjo është një temë shumë e vështirë për një sërë arsyesh.

1. DhV nuk zbulon një kryearmik ndaj së vërtetës, por një shërbëtor të JHVH-së, i cili i ofron njerëzimit një alternativë dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi (A. B. Davidson, *Old Testament Theology*, f. 300-306).
2. Koncepti i një kryearmiku personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërthjatore (jokanonike) nga ndikimi i fesë persiane (*zoroasrianizmi*). Nga ana e vet, ajo ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik.
3. DhR i zhvillon temat e DhV nëpërmjet kategorive çuditërisht të prera, por dhe të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, ose autor, ose gjini letrare, studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse ligësinë e studiojmë nga një qasje jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose e feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimit të DhR gjen pararendës në dualizmin persian dhe në spiritizmin greko-romak.

Nëse je i përkushtuar në mënyrë paraprake ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit, atëherë zhvillimi në DhR duhet parë si zbulesë e përshkallëzuar. Të krishterët duhet të ruhen që të mos lejojnë idetë popullore judaike apo letërsinë evropiane (p.sh., Danten dhe Miltonin) që të qartësojnë më tej këtë koncept. Pa dyshim që ka mister dhe vagulli në këtë zonë të zbulesës. Perëndia ka zgjedhur të mos na zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, origjinën dhe synimin e saj, por na ka zbuluar mposhtjen e saj!

Në DhV, termi Satan (BDB 966), ose akuzues, duket se përdoret për tre grupe të ndryshme.

1. akuzues njerëzorë (1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbret. 11:14,23,25; Ps. 109:6)
2. akuzues engjëj (Num. 22:22-23; Zak. 3:1)
3. akuzues demonë (1 Kro. 21:1; 1 Mbret. 22:21; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën ndërthjatore, identifikohet me Satanin gjarpri i Zanafillës 3 (shih Libri i Urtësisë 2:23-24; 2 Enokut 31:3); madje, kalon edhe më shumë kohë para se ky të bëhet mendim rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 bëhen engjëjt e ligj në 1 Enokut 54:6. Ata bëhen fillesa e ligësisë në teologjinë rabinike. Këtë po e përmend, jo për të pohuar saktësinë e saj teologjike, por për të treguar zhvillimin e saj. Në DhR, këto veprimtari të DhV i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëjlore (pra, Satanit) në 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9.

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (në varësi të pikëvështrimit) të përcaktohet nga DhV. Një arsye për këtë është monoteizmi i fortë i Izraelit (shih 1 Mbret. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi i atribuohet JHVH-së për të demonstruar natyrën unike dhe epërsinë e tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bijtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14; Ezekieli 28, ku mbretërit krenarë të lindjes së afërt (Babilonisë dhe Tirit) përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë s’jam shumë i bindur për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora të kopshtit të Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohjes së të Mirës dhe të Keqes (Ezekieli 31). Nga ana tjetër, Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një rebelim engjëjlor për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, kjo është një mënyrë dhe vend tejet i paqartë për këtë synim. Duhet t’i ruhem prirjes së teologjisë sistematike që të marrë pjesë të vogla dhe të vagullta nga dhiata, autorë, libra dhe gjini të ndryshme e t’i kombinojë si copëza të një enigme hyjnore.

Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah [Jeta dhe kohët e Jezus Mesisë]*, vëll. 2, shtojcat XIII [f. 748-763] dhe XVI [f. 770-776]) thotë se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi dhe hamendësimi demoniak pers. Rabinët nuk janë burim i mirë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi

ndryshon tërësisht nga mësimet e sinagogës. Unë mendoj se koncepti rabinik për ndërmjetësimi dhe kundërshtimi engjëllor në dhënien e ligjit që iu bë Moisiut në malin Sinai i hapi derën konceptit të armikut kryeengjëllor të JHVH-së dhe njerëzimit. Në dualizmin persian (zoroastrian) ka dy perëndi të larta, *Akhi-man* dhe *Ormaza*, e mira dhe e liga. Ky dualizëm u zhvillua në një dualizëm të kufizuar judaik të JHVH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, në DhR shohim përparimin e zbulësës në lidhje me zhvillimin e konceptit të ligësisë, por jo aq me hollësi sa ç'shpallin rabinët. Një shembull i mirë i këtij dallimi është "lufta në qiell". Rënia e Satanit është domosdoshmëri logjike, por detajet nuk jepen. Edhe ajo që jepet mbulohet me gjininë apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbyes i JHVH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t'i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ekziston vetëm një Perëndi dhe njerëzimi është përgjegjës për veprimet e veta. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara ashtu dhe pas shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe përmes tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet!

■ **"do të flaket jashtë"** Kjo është DËFTORE E ARDHME PËSORE. Shkrimi nuk tregon kohën e saktë të rënies së Satanit nga qielli. Satani ndoshta diskutohet në Isaia 14 dhe Ezekieli 28 në një kuptim dytësor. Pasazhet profetike flasin për mbretërit krenarë të Babilonisë dhe Tirit. Arroganca e tyre e mëkatshme reflekton atë të Satanit (shih Isa. 14:12, 15; Ezek. 28:16). Sidoqoftë, Jezusi tha se pa Satanin teksa binte gjatë udhëtimit misionar të të shtatëdhjetëve (shih Luka 10:18).

Gjatë gjithë DhV shohim një zhvillim të konceptit të Satanit. Në fillim, ai ishte engjëll shërbëtor, por nga krenaria, u bë armik i Perëndisë. Diskutimi më i mirë për këtë temë polemike gjendet në A. B. Davidson, *Old Testament Theology [Teologji e Dhiatës së Vjetër]*, f. 300-306.

TEMË E VEÇANTË: LUFTA NË QIELL (marrë nga komentari im për Zbulësën)

Ka patur shumë diskutime për kohën e kësaj përballjeje. Jezusi duket se e përmend te Luka 10:18 dhe Gjoni 12:31. Por përpjekja për t'i dhënë një datë kronologjike kësaj ngjarjeje është tmerrësisht e vështirë.

1. përpara Zanafillës 1:1 (përpara krijimit)
2. përpara Zanafillës 1:1 dhe 1:2 (teoria e "hapësirës kohore")
3. në DhV pas Jobit 1-2 (Satani në qiell)
4. në DhV pas 1 Mbret. 22:21 (Satani në këshillin qiellor)
5. në DhV pas Zakarias 3 (Satani në qiell)
6. në DhV, si te Isa. 14:21; Ezek. 28:15 dhe 2 Enokut 29:4-5 (dënimi i mbretërve lindorë)
7. në DhR pas tundimit të Jezusit (shih Mateu 4)
8. në DhR gjatë misionit të të shtatëdhjetëve (pashë Satanin që rrëzohej nga qielli, shih Luka 10:18)
9. në DhR pas hyrjes ngadhënjimtare në Jerusalem (sunduesi i kësaj bote flaket jashtë, shih Gjoni 12:31)
10. në DhR pas ringjalljes dhe ngjitjes së Jezusit në qiell (shih Efe. 4:8; Kol. 2:15)
11. në fund të kohës (shih Zbu. 12:7, ndoshta, kur Satani sulmoi qiellin në kërkim të Fëmijës)

Në duhet ta shohim thjesht si betejën e përvetshme mes Perëndisë dhe ushtrisë së ligësisë; ky konflikt do të përfundojë me disfatën e plotë të dragoit dhe ushtrisë së tij. Në Zbulësën 20, ata shporren dhe izolojnë!

12:31 "dhe unë, pasi të lartësohem" Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkuptonte një veprim të mundshëm. Ky term mund të ketë kuptimin

1. ngrihem lart (shih 3:14)
2. kryqëzohem (shih 8:28)
3. lartësohem (shih Veprat 2:33; 5:31)
4. lartësohem së tepërmi (shih Fil. 2:9)

Është pikërisht ky kuptim i shumëfishtë i fjalëve (fjalët me dy ose më shumë kuptime) që karakterizon ungjillin e Gjoni.

■ **"do t'i tërheq gjithë njerëzit te vetja"** Ky mund të jetë aludim për dashurinë e besëlidhjes që ka JHVH për Izraelin në Jer. 31:3, i cili, sigurisht, është pasazhi që flet për "besëlidhjen e re" (shih Jer. 31:31-34). Perëndia i

tërheq njerëzit me dashurinë dhe veprimet e tij për ta. Ky përdorim metaforik i këtij termi gjendet edhe te Gjoni 6:44 dhe shpjegohet te 6:65.

Këtu, “të gjithë” tregojnë ftesën dhe premtimin universal të shpengimit (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5; Isa. 2:2-4; Gjoni 1:9,12,29; 3:16; 4:42; 10:16; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titit 2:11; 2 Pjet. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14)!

Në këtë frazë gjendet një variant i rëndësishëm. “Të gjithë” mund të jetë në gjininë MASHKULLORE, që mund të përkthehet “të gjithë njerëzit” dhe gjendet në dorëshkrimet e lashta greke P^{75(VID)}, κ^2 , B, L dhe W, ndërsa gjinia ASNJANËSE, që do të përkthehej “të gjitha gjërat”, gjendet te P⁶⁶ dhe κ . Nëse është në gjininë ASNJANËSE, bëhet fjalë për shpengimin kozmik të Krishtit, të ngjashëm me Kol. 1:16-17, që ndoshta reflekton herezinë gnostike që përmendet shumë hapur te 1 Gjonit. UBS⁴ i jep gjinisë MASHKULLORE vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt).

12:33 “ai po i thoshte këto për të treguar se me ç’lloj vdekjeje do të vdiste” Ky është një tjetër koment redaktorial nga Gjoni. Kjo lidhet me LiP. 21:23, ku njeriu i varur në pemë konsiderohej “i mallkuar nga Perëndia”. Ja pse krerët fetarë e donin Jezusin të kryqëzuar, jo të vrrarë me gurë. Jezusi mbajti mallkimin e Ligjit për ne (shih Gal. 3:13).

12:34 “turma iu përgjigj:… Krishti duhet të qëndrojë përjetë” Ky mund të jetë aludim për Psa. 89:4, 29, 35-37. DhV priste vetëm një ardhje të Mesisë dhe themelimin nga ana e tij e një mbretërimi palestinas me paqe botërore (shih Psa. 11:4; Isa. 9:7; Ezek. 37:25; dhe Dan. 7:14). Për fjalën “përjetë” shih Temën e Veçantë në 6:58.

■ **“Biri i Njeriut”** Turma (shih Mësimet Kontekstuale, C) duhet të ketë dëgjuar Jezusin duke mësuar/predikuar (ndoshta në v. 23-24 për titullin dhe në v. 30-32 për FOLJEN “lartoj”) pasi përdori titullin unik me të cilën ai përcaktonte veten. Ky është i vetmi vend ku ky titull përdoret nga të tjerët. Nuk ishte titull standard për përcaktimin e Mesisë brenda judaizmit.

12:35 “Ecni ndërsa keni Dritën” Jezusi po i nxit dëgjuesit e vet që t’u përgjigjen menjëherë fjalëve të tij. Koha e tij në tokë ishte e kufizuar. Pas pak, ai do të hynte në javën e tij të fundit në tokë. Ora e tij e paracaktuar kishte ardhur (v. 23).

Në një farë kuptimi, kjo frazë (si në shumë raste të tjera te Gjoni) ka një referent historik dhe një referent ekzistencial. Ajo që tha Jezusi është e vërtetë për këdo që dëgjon ungjillin (p.sh., Shëmbëlltyra e Mbjellësit dhe Farës).

Ky është përdorim metaforik i “ecjes” si mënyrë jetese (shih Efe. 4:1, 17; 5:2, 15). Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, që vazhdon theksimin që i bën Jezusi besimit si një marrëdhënie dhe dishepullizim i vazhdueshëm, dhe jo thjesht si vendim fillestar (shih v. 44-46).

12:36 Ky motiv i Jezusit si drita e botës ishte një theksim kryesor dhe i përsëritur te Gjoni (shih 1:4, 5, 7, 8, 9; 3:19, 20, 21; 5:35; 8:12; 9:5; 11:9, 10; 12:35, 36, 46). Errësira dhe drita ishin realitete të kundërta shpirtërore edhe në literaturën e urtësisë judaike, si dhe në Pergamenat e Detit të Vdekur.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:36b-43

^{36b}Si tha këto gjëra, Jezusi u largua dhe u fsheh prej tyre. ³⁷Por, ndonëse kishte kryer kaq shumë shenja para tyre, ata nuk besonin në të. ³⁸Kjo ndodhi që të përmbushej fjala e profetit Isaia, kur tha: **“ZOT, KUSH I KA BESUAR LAJMIT TONË? DHE KUJT I ËSHTË ZBULUAR KRAHU I ZOTIT?”** ³⁹Për këtë arsye ata nuk ishin në gjendje të besonin, sepse Isaia tha sërish: ⁴⁰**“AI U KA VERBUAR SYTË DHE U KA NGURTËSUAR ZEMRËN, QË TË MOS SHOHIN ME SY DHE TË MOS KUPTOJNË ME ZEMËR, QË TË MOS KTËHEHEN DHE UNË T’I SHËROJ”.** ⁴¹Këto gjëra Isaia i tha për shkak se pa lavdinë e tij, dhe foli për të. ⁴²Megjithatë, edhe ndër krerët, shumë besuan në të, por për shkak të farisenjve nuk e rrëfenin hapur, nga frika se mos i përjashtonin nga sinagoga; ⁴³sepse miratimin e njerëzve e donin më shumë se miratimin e Perëndisë.

12:37 Sa koment i trishtueshëm. Verbëria shpirtërore është e tmerrshme (shih 2 Kor. 4:4). Ky varg karakterizon mëkatën e pafalshëm (shih Temën e Veçantë në 5:21).

12:38 “fjala e profetit Isaia” Ky ishte një citim nga pasazhi për shërbëtorin e përvuajtur te Isa. 53:1.

12:39-40 Këto janë vargje të vështira. A i ngurtëson Perëndia njerëzit që të mos jenë në gjendje të përgjigjen me besim? Unë kam përfshirë këtu komentet e mia nga Isaia 6:9-10 dhe Romakëve 11:7 (shih www.freebiblecommentary.org).

Isaia 6:9-10 Ashtu si JHVH zbulon synimin e tij për shërbesën e Isaisë, ai i zbulon Isaisë edhe përgjigjen që do të marrë mesazhi i tij nga Juda.

1. shko, v. 9, BDB 229, KB, *Kal* URDHËRORE
2. thuaju, v. 9, BDB 55, KB, *Kal* E KRYER
3. vazhdoni të dëgjoni, v. 9, *Kal* URDHËRORE dhe *Kal* PASKAJORE ABSOLUTE, BDB 1033, KB 1570
4. por pa kuptuar, v. 9, BDB 106, KB 122, *Kal* e PAKRYER e përdorur në kuptimin LEJUES, shih 1:3; 5:21; 10:13; 29:14
5. vazhdoni të shihni, *Kal* URDHËRORE dhe *Kal* PASKAJORE ABSOLUTE e BDB 906, KB 1157
6. por pa dalluar, v. 9, BDB 393, KB 380, *Kal* e PAKRYER e përdorur në kuptimin LEJUES
7. bëji të pandjeshme zemrat e këtij populli (fjalë për fjalë, “të dhjamosura”), v. 10, BDB 1031, KB 1566, *Hifil* URDHËRORE
8. ngurtëso veshët e tij, v. 10, BDB 457, KB 455, *Hifil* URDHËRORE
9. dhe errësoja sytë, v. 10, BDB 1044, KB 1612, *Hifil* URDHËRORE

Këto URDHËRORE ndiqen nga pasojat (tre TË PAKRYERA nga FOLJE të përdorura më parë, “shoh”, “dëgjoj” dhe “kuptoj”). Perëndia e di (ose me paranjohje, ose ngaqë u ka ngurtësuar mendjen dhe zemrën tashmë kryeneçe) se ata nuk do të përgjigjen që të shpëtohen.

1. se mos pendohen, BDB 996, KB 1427, *Kal* e KRYER e mohuar
2. se mos shërohen, BDB 950, KB 1272, *Kal* e KRYER e mohuar

Isaia do të predikojë dhe, ndonëse disa mund t’i përgjigjen me besim, shumica dërrmuese e popullit/shoqërisë së tij nuk do t’i përgjigjet (shih Rom. 1:24, 26, 28; Efe. 4:19), ose nuk mund t’i përgjigjet (shih Isa. 29:9-10; LiP. 29:4; Mat. 13:13; Rom. 11:8)! Isaia nuk është ungjilltar këtu, por profet i mosbindjes/pasojave të besëlidhjes (shih Mat. 13:13; Marku 4:12; Luka 8:10). Mesazhi i tij i shpresës është për një kohë të ardhshme, jo për kohën e tij!

Romakëve 11:7 “pjesa tjetër u ngurtësua” Kjo është DËFTORE AORISTE PËSORE (shih 2 Kor. 3:14). Ideja është se Perëndia i ngurtësoi ata (shih v. 8-10). Vepruesi i ngurtësimit është i ligu (shih 2 Kor. 4:4). “Ngurtësoi” (*pōroō*) është një term mjekësor për pandjeshmërinë ose verbërinë (shih Rom. 11:25; 2 Kor. 3:14; Efe. 4:18). Ky term përdoret edhe për apostujt te Marku 6:52. Ky është term i ndryshëm greqisht nga Rom. 9:18 (*sklērunō*) që është e kundërta e mëshirës (shih Heb. 3:8, 15; 4:7).

Ky varg është shumë i qartë dhe është përmbledhje e 11:1-6. Disa, që janë zgjedhur, besuan, disa të tjerë, që nuk janë zgjedhur, u ngurtësuan. Megjithatë, ky varg nuk u shkrua në izolim si slogan teologjik. Ai ishte pjesë e një argumenti të gjatë teologjik. Ekziston një tension mes së vërtetës së shprehur shumë qartë në këtë varg dhe ftesave universale të kapitullit 10. Këtu kemi një mister. Por zgjidhja nuk është të mohojmë apo minimizojmë njërin prej dy brirëve të dilemës, apo poleve paradoksale.

12:39 “Për këtë arsye, ata nuk ishin në gjendje të besonin” Kjo është një DËFTORE E PAKRYER MESORE (me kuptim vepror) dhe një URDHËRORE E TASHME VEPROR. Ata nuk ishin në gjendje të vazhdonin në një marrëdhënie besimi me Jezusin. Mrekullitë e tij i tërhiqnin, por nuk i çonin në besim shpëtues në Jezusin si Mesi. Te Gjoni, “besimi” ka disa nivele. Jo të gjithë e arrijnë shpëtimin. Shih shënimet në 8:31-59.

■ **“sepse Isaia tha sërish”** Isaia 6:10; 43:8 përmendin ngurtësimin e zemrave të judenjve në lidhje me mesazhin e Perëndisë përmes Isaisë (shih Jer. 5:21; Ezek. 12:2; LiP. 29:2-4).

12:40 “zemra” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: ZEMRA

Fjala greke *kardia* përdoret në Septuagintë dhe në DhR për të pasqyruar fjalën hebraisht *lēb* (BDB 523). Ajo përdoret në disa mënyra (shih Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon [Leksik greqisht-anglisht]*, f. 403-404).

1. qendra e jetës fizike, një metaforë për individin (shih Veprat 14:17; 2 Kor. 3:2-3; Jakobi 5:5)
2. qendra e jetës shpirtërore (pra, morale)
 - a. Perëndia njeh zemrën (shih Luka 16:15; Rom. 8:27; 1 Kor. 14:25; 1 Thes. 2:4; Zbu. 2:23)
 - b. përdoret për jetën shpirtërore të njerëzimit (shih Mat. 15:18-19; 18:35; Rom. 6:17; 1 Tim. 1:5; 2 Tim. 2:22; 1 Pjet. 1:22)
3. qendra e jetës mendore (pra, intelekti, shih Mat. 13:15; 24:48; Veprat 7:23; 16:14; 28:27; Rom. 1:21; 10:6; 16:18; 2 Kor. 4:6; Efe. 1:18; 4:18; Jakobi 1:26; 2 Pjet. 1:19; Zub. 18:7; zemra është sinonime me mendjen te 2 Kor. 3:14-15 dhe Fil. 4:7)
4. qendra e vullnetit (shih Veprat 5:4; 11:23; 1 Kor. 4:5; 7:37; 2 Kor. 9:7)
5. qendra e ndjenjave (shih Mat. 5:28; Veprat 2:26,37; 7:54; 21:13; Rom. 1:24; 2 Kor. 2:4; 7:3; Efe. 6:22; Fil. 1:7)
6. vendi unik i veprimtarisë së Frymës (shih Rom. 5:5; 2 Kor. 1:22; Gal. 4:6 [pra, Krishti në zemrat tona, Efe. 3:17])
7. Zemra është mënyrë metaforike për të nënkuptuar gjithë njeriun (shih Mat. 22:37, që citon LiP. 6:5). Mendimet, qëllimet dhe veprimet që i atribuohen zemrës zbulojnë llojin e individit. DhV ka disa përdorime goditëse të këtyre termave
 - a. Zan. 6:6; 8:21, “Perëndia u trishtua në zemër”, shih dhe Osea 11:8-9
 - b. LiP. 4:29; 6:5, “me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”
 - c. LiP. 10:16, “zemër e parrethprerë” dhe Rom. 2:29
 - d. Ezek. 18:31-32, “një zemër të re”
 - e. Ezek. 36:26, “një zemër të re” në dallim nga “një zemër guri”

12:41 “Këto gjëra Isaia i tha për shkak se pa lavdinë e tij” Ky është një pohim se profetët e DhV ishin të informuar për Mesinë (shih Luka 24:27). Shih shënimin për “lavdinë” në 1:14.

12:42 “Megjithatë, edhe ndër krerët, shumë besuan në të” Mesazhi i Jezusit dha vërtet fryt (shih v. 11; Veprat 6:7). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

■ **“nuk e rrëfenin hapur”** Shih Temën e Veçantë: Rrëfimi i besimit në 9:22-23.

■ **“nga frika se mos i përjashtonin nga sinagoga”** (shih 9:22; 16:2).

12:43 Kjo nënkupton se besimi i vërtetë mund të jetë i dobët dhe i frikësuar, madje dhe i pashpallur! Ungjilli i Gjonit e përdor fjalën besoj (*pisteuō*) në disa kuptime, që nga tërheqja fillestare e përgjigjja emocionale dhe deri te besimi i vërtetë shpëtues.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:44-50

⁴⁴Pastaj Jezusi thirri dhe tha: “Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në atë që më dërgoi.
⁴⁵Ai që më sheh mua, shikon atë që më dërgoi. ⁴⁶Unë kam ardhur si Dritë në botë, që kushdo që beson në mua të mos mbetet në errësirë. ⁴⁷Nëse dikush dëgjon fjalët e mia dhe nuk i zbaton, nuk do ta gjykoj; sepse nuk erdha për të gjykuar botën, por për ta shpëtuar. ⁴⁸Ai që më mohon mua dhe nuk pranon fjalët e mia, ka dikë që e gjykon: fjala që fola është ajo që do ta gjykojë në ditën e fundit. ⁴⁹Sepse unë nuk flas nga vetja ime, por Ati që më dërgoi më ka dhënë porosi se çfarë të them e çfarë të flas. ⁵⁰Unë e di se urdhërimi i tij është jetë e përjetshme; prandaj, gjërat që them unë, i them ashtu siç m’i ka thënë Ati.

12:44 “Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në atë që më dërgoi” Në fund fare, synimi i besimit është në Atin (shih 1 Kor. 15:25-27). Ky është një motiv i përsëritur (shih Mat. 10:40; Gjoni 5:24). Të njohësh Birin do të thotë të njohësh Atin (shih 1 Gjonit 5:10-12).

12:45 Ç’pamje ka Perëndia? Të shohësh Jezusin do të thotë të shohësh Perëndinë (shih 14:7-10)!

12:46 Bota është në errësirë që nga Zanafilla 3 (shih Zan. 6:5,11-12; 8:21; Ps. 14:3; Isa. 53:6; Rom. 3:9-23).

12:47 “Nëse dikush dëgjon fjalët e mia dhe nuk i zbaton” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për një veprim të mundshëm. Bindja e vazhdueshme është shenjë e marrëdhënies sonë të vazhdueshme personale me anë të besimit! Siguria e shpëtimit (shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 5:13) bazohet në jetën e ndryshuar, dhe në ndryshim e sipër, plot bindje dhe qëndresë (shih Temën e Veçantë në 8:31, shih dhe librat e Jakobit dhe 1 Gjonit).

12:47-48 “Sepse nuk erdha për të gjykuar botën, por për ta shpëtuar” Jezusi erdhi kryesisht për të shpënuar botën, por vetë fakti i ardhjes së tij i detyron njerëzit të vendosin. Nëse e mohojnë, gjykojnë vetveten (shih Temën e Veçantë në 8:31; shih dhe Gjoni 3:17-21).

12:49-50 Jezusi fliste me autoritetin e Perëndisë, jo të vetin.

12:50

NASB, NKJV “urdhërimi i tij është jetë e përjetshme”

NRSV, TEV,

NET “urdhërimi i tij sjell jetë të përjetshme”

NJB “urdhërimet e tij nënkuptojnë jetë të përjetshme”

REB “urdhërimet e tij janë jetë e përjetshme”

NIV “urdhërimi i tij çon në jetë të përjetshme”

NET (shënim) “urdhërimi i tij çon në jetë të përjetshme”

Opsioni i parë është teksti i fjalëpërfjalshëm në greqisht. Të tjerët përpiqen t’ia interpretojnë kuptimin.

NASB e përmend Gjonin 6:68 si pasazh paralel, ndërsa Michael Magill, në *NT TransLine*, përmend Gjonin 17:8. Komentari Biblik i Jeromit (f. 451) përmend si paralel Gjonin 10:18. Qartazi, kjo frazë është e vagullt.

Te Gjoni ekziston një luhatje mes NJËJËSIT dhe SHUMËSIT të fjalës “urdhërim”, por kjo nuk ka fare rëndësi nga ana ekzegjetike.

TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I FJALËS “URDHËRIM” NË SHKRIMET E GJONIT

1. Një herë përdoret për ligjin e Moisiut, Gjoni 8:5
2. Ati ia jep Jezusit
 - a. kontroll mbi flijimin e tij shpëngues, Gjoni 10:18; 12:49-50; 14:31
 - b. bota do të njihje dashurinë e Jezusit për Atin, Gjoni 14:31
 - c. Jezusi iu bind urdhërimit të Atit, Gjoni 15:10
3. Jezusi ua jep besimtarëve
 - a. qëndroni në dashurinë e tij, Gjoni 14:15; 15:10
 - b. të doni njëri-tjetrin, ashtu siç na deshi ai, Gjoni 13:34; 15:12,17; 1 Gjonit 2:7-8; 3:11,23; 4:7,21; 2 Gjonit 5
 - c. zbatoni urdhërimin e tij (pra, b.), Gjoni 14:15; 15:10,14; 1 Gjonit 2:3,4; 3:22,24; 5:1-3; 2 Gjonit 6
4. Ati ua jep besimtarëve
 - a. besoni në Jezusin, 1 Gjonit 3:23 (shih dhe Gjoni 6:29)
 - b. të doni njëri-tjetrin, 1 Gjonit 3:23

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse ia vajosi këmbët Jezusit Maria, motra e Lazarit?
2. Pse ndryshojnë disi nga njëri-tjetri Mateu, Marku dhe Gjoni në rrëfimin që i bëjnë kësaj ngjarjeje?
3. Ç' domethënie kishte fakti se turma e priti Jezusin me degë palme dhe me citimin nga Psalmi 118?
4. Pse u prek kaq shumë Jezusi nga kërkesa e grekëve që të flisnin me të?
5. Pse u trondit kaq thellë në shpirt Jezusi? (shih v. 27)
6. Shpjego pse e përdor Gjoni fjalën “besoj” në disa kuptime.

GJONI 13

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Larja e këmbëve të dishepujve 13:1-11	Zotëria bëhet shërbëtor 13:1-11	Darka e fundit 13:1-11	Jezusi u lan këmbët dishepujve 13:1 13:2-6 13:7 13:8a 13:8b 13:9 13:10-11	Larja e këmbëve 13:1 13:2-5 13:6-11
13:12-20	Edhe ne duhet të shërbejmë 13:12-30	13:12-20	13:12-17 13:18-20	13:12-16 13:17-20
Jezusi parathotë se do të tradhtohet 13:21-30		13:21-30	Jezusi parathotë se do të tradhtohet 13:21 13:22-24 13:25 13:26-29 13:30	Parashikimi i pabesisë së Juda Iskariotit 13:21-30
Urdhërimi i ri 13:31-35	Urdhërimi i ri 13:31-35	13:31-35	Urdhërimi i ri 13:31-35	Fjalimet e lamtumirës 13:31-35
Parashikimi i mohimit të Pjetrit 13:36-38	Jezusi parashikon mohimin e Pjetrit 13:36-38	13:36-38	Jezusi parashikon mohimin e Pjetrit 13:36a 13:36b 13:37 13:38	13:36-38

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 13:1-38

- A. Ungjilli i Gjonit i përmbyll shenjat e Jezusit në kapitullin 12. Kapitulli 13 nis javën e fundit të mundimeve të Krishtit.
- B. Shënimi i Biblës Studimore të NASB bën këtë koment interesant: “emri greqisht *agapē* („dashuri“) dhe folja *agapaō* („dua“) shfaqet vetëm tetë herë në kap. 1-12, por 31 herë në kap. 13-17”.
- C. Gjoni nuk e përmend Darkën e Zotit (eukaristinë) siç bëjnë ungjijtë sinoptikë. Gjithsesi, ai jep të vetmin rrëfim të dialogut në Dhomën e Sipërme atë natë (kapitujt 13-17, që përbëjnë një përqindje të madhe të ungjillit të Gjonit. Si rrjedhojë, kjo duhet të zbulojë personin dhe veprën e Jezusit në mënyra të reja e të fuqishme). Disa e shohin këtë mospërmendje si përpjekje të qëllimshme për t’i ulur kishës së hershme theksimin gjithnjë e më të madhe që po i bënte sakramentalizmit. Gjoni nuk flet kurrë në hollësi për pagëzimin e Jezusit, apo për Darkën e Zotit.
- D. Konteksti historik i Gjonit 13 mund të shihet te Luka 22:24. Dishepujt ende po debatonin se kush ishte më i madhi.
- E. Konteksti fizik i kapitujve 13-17 është një dhomë e sipërme në Jerusalem (ose, ndoshta, kap. 15-17 ndodhën gjatë rrugës për në Gjetseman, shih 14:31), ndoshta në shtëpinë e Gjon Markut, atë natë që Jezusi u tradhtua nga Juda.
- F. Duket se veprimi i larjes së këmbëve nga ana e Jezusit kishte dy qëllime të veçanta.
 - 1. v. 6-11 i paraprijnë veprës së tij në kryq për hirin tonë.
 - 2. v. 12-20 janë mësim si shembull në lidhje me përrulësinë (në dritën e Lukës 22:24)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:1-11

¹Kështu, përpara festës së Pashkës, Jezusi, duke e ditur se i kishte ardhur ora që të largohej nga kjo botë te Ati, duke i dashur të vetët që ishin në botë, i deshi deri në fund. ²Gjatë darkës, pasi djalli i kishte shtënë tashmë në zemër Judë Iskarriotit, birit të Simonit, që ta tradhtonte, ³Jezusi, duke ditur se Ati i kishte dhënë gjithçka në dorë, dhe se ai kishte dalë nga Perëndia dhe po kthehej te Perëndia, ⁴u ngrit nga darka dhe vuri mënjanë rrobat e veta; pastaj, si mori një peshqir, u ngjesh. ⁵Pastaj, hodhi ujë në legen dhe filloi t’u lante këmbët dishepujve dhe t’ua fshinte me peshqirin që kishte ngjeshur rreth vetes. ⁶Kështu, erdhi te Simon Pjetri. Ky i tha: “Zot, ti të më lash këmbët?” ⁷Jezusi u përgjigj dhe i tha: “Ti nuk e kupton atë që po bëj tani, por do ta kuptosh më vonë”. ⁸Pjetri i tha: “Kurrë s’do të m’i lash këmbët!” Jezusi ia ktheu: “Nëse nuk t’i laj, s’ke pjesë me mua”. ⁹Simon Pjetri i tha: “Zot, atëherë, më laj jo vetëm këmbët, por edhe duart e kokën”. ¹⁰Jezusi i tha: “Ai që ka bërë banjë, mjafton të lajë këmbët, dhe është krejt i pastër; dhe ju jeni të pastër, por jo të gjithë”. ¹¹Sepse e dinte se kush po e tradhtonte; për këtë arsye, tha: “jo të gjithë jeni të pastër”.

13:1 “përpara festës së Pashkës” Gjoni dhe ungjijtë sinoptikë nuk bien dakord nëse kjo ishte dita para darkës të Pashkës, apo vetë darka e Pashkës. Ata e vendosin darkën të enjten dhe kryqëzimin të premtën (shih 19:31; Marku 15:43; Luka 23:54). Kjo darkë e Pashkës përkujtonte çlirimin e Izraelit nga Egjipti (shih Eks. 12). Gjoni pohon se kjo ishte dita para darkës normale të Pashkës (shih 18:28; 19:14, 31, 42).

Ndoshta, komuniteti i esenëve përdorte kalendar tjetër (pra, kalendarin diellor nga librat e Jubileve dhe Enokut, si mënyrë për të treguar se e mohonin priftërinë e tanishme), sipas së cilit, Pashka binte një ditë përpara.

Komentari Biblik i Jeromit përmbledh mendimin e studiuesve të sotëm (f. 451) dhe mendon se “një ditë më parë” e Gjonit është e saktë dhe se ungjijtë sinoptikë shprehin simbolizmin e Pashkës të kësaj darke. Gjithmonë duhet të kemi parasysh se ungjijtë nuk janë histori kronologjike perëndimore, me shkak dhe efekt. Historia shkruhet në shumë mënyra, jo thjesht drejt ose gabim, apo e vërtetë ose e rremë. Historia është shpjegim i së shkuarës që u shërben pikëvështrimeve/problematikave/nevojave të tanishme. Çështja e vërtetë është kush e shkroi këtë histori dhe pse. Diskutimi më i mirë për gjininë e narrativës historike dhe ungjijve është Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka*, f. 89-126.

■ **“Jezusi, duke ditur se i kishte ardhur ora”** “Duke ditur” është PJESORE E KRYER VEPRORE (si në v. 3). Jezusi e kuptonte marrëdhënien e vet unike me Atin të paktën që nga mosha 12 vjeçare (Luka 2:41-51). Ardhja e grekëve për ta takuar në 12:20-23 i tregoi Jezusit se ora e vdekjes dhe përlëvdimit të tij kishte mbërritur (shih 2:4; 7:6,8,30; 8:20;12:23,27; 17:1).

■ **“që të largohet nga kjo botë te Ati”** Ungjilli i Gjonit vazhdon të theksojë dualizmin vertikal, lart/poshtë (shih v. 3). Jezusi u dërgua (shih 8:42) nga Ati dhe, tani, do të kthehet tek ai. Ungjijtë sinoptikë e portretizojnë Jezusin duke mësuar dualizmin horizontal të dy epokave judaike, tensionin “tashmë, por jo ende” të Mbretërisë së Perëndisë.

Ka shumë pyetje për ungjijtë, të cilat duhen trajtuar nga lexuesit modernë, por, në fund të fundit, këto shkrime të shenjta zbulojnë një botëkuptim biblik koherent.

1. ka vetëm një Perëndi të shenjtë
2. krijimi i tij i veçantë, njerëzimi, ka rënë në mëkat dhe rebelim
3. Perëndia ka dërguar një Shpengimtar të mishëruar (pra, Mesinë)
4. njerëzimi duhet të përgjigjet me besim, pendim, bindje dhe qëndresë
5. ekziston një forcë personale ligësie që është në kundërshtim me Perëndinë dhe vullnetin e tij
6. gjithë krijesa e vetëdijshme do t’i japë llogari Perëndisë për jetën e saj

FOLJA “largohem” (*metabainō*) në shkrimet e Gjonit ka kuptimin e kalimit nga ekzistenca e rënë fizike (pra, nga epoka e vjetër e mëkatit dhe rebelimit) në epokën e re të Frymës dhe jetës së përjetshme (shih 5:24; 13;1; 1 Gjonit 3:14; përveç përdorimit të saj në 7:3).

■ **“duke i dashur të vetët”** Kjo frazë greqisht përdoret në papiruset egjiptiane (Moulton, Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament [Fjalori i Dhiatës së Re greqisht]*) me kuptimin “kushërinj të afërt” (shih Luka 8:19-21).

■ **“që ishin në botë”** Gjoni e përdor termin botë (*kosmos*) në disa kuptime të ndryshme.

1. ky planet (shih 1:10; 11:9; 16:21; 17:5,11,24; 21:25)
2. njerëzimi (shih 3:16; 7:4; 11:27; 12:19; 14:22; 18:20,37)
3. njerëzimi i rebeluar (shih 1:10,29; 3:16-21; 4:42; 6:33; 7:7; 9:39; 12:31; 15:18; 17:25)

Shih Temën e Veçantë: Përdorimi i *Kosmos* nga Pali në 14:17.

■ **“i deshi deri në fund”** Kjo është fjala greke “*telos*”, që do të thotë “synim i përmbushur”. Bën fjalë për veprën e shpengimit që kreu Jezusi në kryq për njerëzimin. Një formë e kësaj fjale gjendet në fjalët e fundit të Jezusit në kryq (shih 19:30): “U krye”, që, nga papiruset egjiptiane, mësojmë se kishte edhe kuptimin “pagaaj plotësisht”!

13:2 “Gjatë darkës” Në këtë pikë, ka ndryshime në dorëshkrimet greke. Varianti bën fjalë për një shkronjë të vetme të një fjale greke,

1. *ginomenou*, PJESORE E TASHME (pra, gjatë darkës), dorëshkrimet α , B, L, W
2. *genomenou*, PJESORE AORISTE (pra, pas darkës), dorëshkrimet P⁶⁶, α ², A, D

Ndoshta, kjo do të thotë

1. pas darkës
2. pas Kupës së parë të Bekimit, kur zakoni kërkonte larjen e duarve
3. pas Kupës së tretë të Bekimit

TEMË E VEÇANTË: RENDI I SHËRBESËS SË PASHKËS NË JUDAIZMIN E SHEKULLIT TË PARË

- A. Lutja
- B. Kupa e verës
- C. I zoti i shtëpisë lan duart dhe ua kalon legenin të gjithëve
- D. Ngjyerja e bukës në një salcë me bimë të hidhura
- E. Qengji dhe vakti kryesor
- F. Lutja dhe ngjyerja e dytë e bukës në salcën me bimë të hidhura
- G. Kupa e dytë e verës me një kohë “pyetje-përgjigje” për fëmijët (shih Eks. 12:26-27)
- H. Këndimi i Psalmeve “Halel” 113-114 dhe lutja
- I. Kryesuesi i ceremonisë ngjyen nga një kafshatë për secilin pjesëmarrës pasi lan duart
- J. Të gjithë hanë derisa ngopen; e përfundojnë me një copë mishi nga qengji
- K. Kupa e tretë e verës pas larjes së duarve
- L. Këndimi i Psalmeve “Halel” 115-118
- M. Kupa e katërt e verës, që nënkuptonte ardhjen e Mbretërisë

Shumë besojnë se inaugurimi i Darkës së Zotit ndodhi në pikën “K”.

■ **“djalli i kishte shtënë tashmë në zemër Judë Iskariotit”** Kjo është PJESORE E KRYER VEPRORE. Jezusi e dinte që në fillim për Judën (shih 6:70). I ligu (shih Temën e Veçantë në 12:31) kishte kohë që po e tundonte Judën, por, në v. 27, djalli e vuri plotësisht nën kontroll. Shih Temën e Veçantë: Zemra në 12:40. Shih shënimin e plotë për Judën në 18:2.

13:3 “Jezusi, duke ditur se Ati i kishte dhënë gjithçka në dorë” Kjo është PJESORE E KRYER VEPRORE, si v. 1, e ndjekur nga një DËFTORE AORISTE VEPRORE. Kjo është një nga thëniet e mahnitshme të Jezusit për njohurinë dhe autoritetin e vet (shih 3:35; 17:2; Mat. 28:18). KOHA AORISTE është e rëndësishme. Ati i dha Jezusit “gjithçka” përpara kryqëzimit. Nuk ia dha thjesht si shpërblim për bindjen, por për shkak të Personit të Jezusit! Ai e dinte se kush ishte vetë, por u lau këmbët atyre që po debatonin se cili prej tyre ishte më i madhi!

■ **“se kishte dalë nga Perëndia”** Kjo është gjëja e dytë nga tri gjërat që përmenden në v. 3 se Jezusi i dinte

1. Ati i kishte dhënë gjithçka në dorë
2. Jezusi kishte dalë nga Perëndia
3. Po kthehej te Perëndia (shih 7:33; 14:12,28; 16:5,10,17,28; 20:17)

Dy të fundit janë pjesë e dualizmit “lart/poshtë”, diçka shumë e përdorur te Gjoni.

Pika #2 është një frazë unike për Gjonin (shih 8:42; 13:3; 16:28,30; 17:8). Nënkupton edhe origjinën edhe vendin (pra, Hyjnia nga qielli).

13:4 “u ngrit nga darka” Mos harroni se ata rrinin shtrirë, të mbështetur mbi bërrylin e majtë, me këmbët pas vetes, dhe jo të ulur në karrige.

■ **“vuri mënjanë rrobat e veta”** SHUMËSI nënkupton rrobën e jashtme të Jezusit (shih 19:23). Është interesante se e njëjta FOLJE përdoret edhe në 10:11, 15, 17, 18 për faktin se Jezusi jep jetën e vet (shih v. 37). Kjo mund të jetë një tjetër fjalë me dy kuptime e Gjonit. Ka mundësi që larja e këmbëve të ishte diçka më tepër sesa thjesht mësim praktik për përlësinë (shih v. 6-10).

13:5 “t’u lante këmbët dishepujve” Kjo fjalë greke përdorej për “larjen e vetëm një pjese të trupit”. Fjala në v. 10 përdorej për banjën e gjithë trupit. Larja e këmbëve ishte detyra e skllavit. As rabinët nuk lejonin që t’ua bënin dishepujt këtë gjë. Jezusi, duke ditur se ishte Perëndi, ishte i gatshëm t’u lante këmbët këtyre dishepujve xhelozë dhe ambiciozë (madje dhe Judës)!

13:6 Pyetja e Pjetrit ishte një mënyrë retorike për të refuzuar gjestin e Jezusit. Shpesh, Pjetri mendonte se e dinte çfarë duhet të bënte, ose të mos bënte, Jezusi (shih Mat. 16:22).

13:7 Apostujt, ndonëse jetonin me Jezusin, nuk ia kuptonin gjithmonë veprimet dhe mësimet (shih 2:22; 10:6; 12:16; 14:26; 16:18). Ky keqkuptim përbën një mënyrë për të shprehur dualizmin vertikal.

13:8 “Kurrë s’do të m’i lash këmbët” Ky është MOHIM I DYFISHTË, pra, i theksuar, që nënkupton “kurrën e kurrë, në asnjë rrethanë”.

■ **“Nëse nuk t’i laj, s’ke pjesë me mua”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË. Ky varg nënkupton se këtu po ndodhte më tepër sesa thjesht një mësim praktik. Vargjet 6-10 duket se lidhen me veprën e Jezusit në kryq për faljen e mëkateve.

Fraza e dytë ndoshta reflekton një idiomë të DhV që lidhet me trashëgiminë (shih LiP. 12:12; 2 Sam. 20:1; 1 Mbret. 12:16). Kjo është një idiomë shumë e fortë përjashtimi.

13:9 PJESORJA MOHORE greke “jo” (MĒ) tregon një URDHËRORE të nënkuptuar: “laj”.

13:10 “Ai që ka bërë banjë” Jezusi po fliste metaforikisht për shpengimin. Pjetri është larë (shpëtuar, shih 15:3; Titi 3:5), por ka nevojë të pendohet vazhdimisht (shih 1 Gjonit 1:9) për të ruajtur bashkësinë e ngushtë.

Mundësia tjetër kontekstuale është se Jezusi po flet për tradhtinë e Judës (shih v. 11 & 18). Kështu, metafora e larjes së gjithë trupit bën fjalë, ose (1) për trupin e Pjetrit, ose (2) për grupin e apostujve.

■ **“ju jeni të pastër, por jo të gjithë”** “Ju” është në SHUMËS, që nënkupton rrethin e ngushtë të dishepujt, përveç Judës (shih v. 11, 18; 6:70).

“Të pastër” bën fjalë për mesazhin e Jezusit, që ata e kishin pranuar (shih 15:3). Ata janë “të pastër” për shkak se kanë besuar/pranuar atë që është i pastër, Jezusin.

Për frazën “jo të gjithë”, shih Temën e Veçantë: Femohimi, në Gjoni 6:64.

13:11 TEV dhe NET e vënë këtë varg në kllapa, duke e interpretuar si një nga komentet e shumta redaktoriale të autorit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:12-20

¹²Kështu, pasi u lau këmbët, mori sërish rrobat, u ul në tryezë dhe u tha: “E kuptoni se çfarë kam bërë për ju? ¹³Ju më thërrisni Mësues dhe Zot; dhe keni të drejtë, sepse i tillë jam. ¹⁴Pra, nëse unë, Zoti dhe Mësuesi, ju lava këmbët, edhe ju duhet t’i lani këmbët njëri-tjetrit. ¹⁵sepse unë ju dhashë një shembull që edhe ju të bëni siç bëra unë me ju. ¹⁶Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: skllavi nuk është më i madh se i zoti, as ai që dërgohet nuk është më i madh se ai që e dërgoi. ¹⁷Nëse i dini këto gjëra, të bekuar jeni nëse i bëni. ¹⁸Nuk po flas për ju të gjithë. I njoh ata që kam zgjedhur, por duhet të përmbushet ky Shkrim: „AI QË HA BUKËN TIME, KA NGRITUR THEMBRËN KUNDËR MEJE“. ¹⁹Tani e tutje, po jua them përpara se të ndodhë, që kur të ndodhë, të besoni se unë jam ai. ²⁰Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: kush pranon atë që dërgoj unë, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar”.

13:12-20 Në dallim nga v. 6-10, këtu, Jezusi e përshkruan veprimin e vet si shembull përulësie. Apostujt po debatonin se kush ishte më i madhi (shih Luka 22:24). Në këtë kontekst, Jezusi kryen një veprim prej skllavi dhe, pastaj, shpjegon se ç’kuptim ka dhe si ta zbatojmë.

13:14 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij.

■ **“Zoti dhe Mësuesi”** Vini re NYJËN SHQUESE në v. 13 dhe 14. Po kështu, vini re se titujve u ndryshon radha. Ai është Personi që flet me autoritet. Ai zbulon Atin dhe pret bindje dhe besnikëri! Ata duhet të imitojnë veprimet e tij (v. 15).

13:14-15 “edhe ju duhet t’i lani këmbët njëri-tjetrit” A nënkupton kjo thënie se ky veprim përulësie duhet shndërruar në ritual të kishës? Shumica e grupeve të krishtera janë përgjigjur “jo”, sepse

1. nuk dokumentohet askund se kjo gjë kryhej nga ndonjë kishë në Veprat
2. nuk u përmend kurrë në letrat e DhR
3. nuk thuhet në mënyrë specifike se ky duhet të jetë sakrament i vazhdueshëm, si pagëzimi (shih Mat. 28:19) dhe Darka e Zotit (shih 1 Kor. 11:17-34).

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se ky s' mund të jetë një ngjarje e rëndësishme adhurimi.

“Shembulli” që u dha Jezusi nuk ishte vetëm përulja, por edhe shërbimi me sakrificë (shih 15:12-13). 1 Gjonit 3:16 e shpreh mirë këtë! Jezusi i do deri në fund (shih v. 1), ndaj edhe ata duhet të duan deri në fund (pra, një jetë vetëfljimi, përmbysjeje e Rënies).

13:16 “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them” Fjalë për fjalë, kjo është “Amen, amen” (si në v. 20). Kjo është një formë e fjalës “besim” në DhV (shih Hab. 2:4). Jezusi ishte i vetmi (në çdo shkrim greqisht) që e përdori këtë shprehje në hyrje të fjalisë. Zakonisht, ajo thuhet në fund (1) për të treguar miratim, ose (2) për të mbështetur një pohim ose veprim. Kur përdoret në fillim të një fjalie dhe në formë të dyfishtë, përbën një mjet letrar të autoritetshëm, që kërkon vëmendje. Shih Temën e Veçantë: Amen, në 1:51.

■ **“skllavi nuk është më i madh se i zoti”** Kjo është një frazë hyrëse për të përçuar disa të vërteta.

1. Gjoni 13:16, as i dërguari nuk është më i madh se ai që e ka dërguar
2. Gjoni 15:20
 - a. nëse më kanë përndjekur mua, do t'ju përndjekin dhe ju
 - b. nëse kanë zbatuar fjalën time, do të zbatojnë dhe tuajën
3. Luka 6:40 (e ngjashme), por kushdo, pasi është edukuar plotësisht, do të jetë si mësuesi i vet (shih Mat. 10:24)
4. Luka 22:27 (e ngjashme), por unë jam ndër ju si ai që shërben

13:17 “Nëse i dini këto gjëra, të bekuar jeni nëse i bëni” “Nëse”-ja e parë është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit. “Nëse”-ja e dytë në këtë varg është KUSHTORE KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Nëse dimë diçka, duhet ta bëjmë (shih Mat. 7:24-27; Luka 6:46-49; Rom. 2:13; Jakobi 1:22-25; 4:11)! Synimi nuk është njohuria, por jeta në ngjashmëri me Krishtin. Kjo reflekton FOLJEN hebraisht *shema*, “dëgjoni për të bërë” (shih LiP. 6:4)

13:18 “të përmbushet ky Shkrim” Këtu bëhet fjalë për Judën. Ky është misteri i ndërthurjes së paracaktimit me vullnetin e lirë njerëzor.

Jezusi dhe dishepujt e tij besonin në vërtetësinë e Shkrimit! Kur Shkrimi flet, duhet t'ij besojmë (shih Mat. 5:17-19). Disa herë, Gjoni thotë “se Shkrimet duhen përmbushur” (shih 12:14; 13:18; 15:25; 17:12; 19:24,36). Shpesh, pasazhi i DhV nuk kuptohet plotësisht derisa ndodh një ngjarje e caktuar në jetën e Krishtit (pra, tipologjia, p.sh., Osea 11:1), ose një ngjarje në DhR mund të jetë një përmbushje e shumëfishtë (shih Isa. 7:14 ose Dan. 9:27; 11:31; 12:11).

■ **“KA NGRITUR THEMBRËN KUNDËR MEJE”** Ky është citim nga Psalmi 41:9. Zakoni oriental i ngrënies së bashku si shenjë miqësie dhe besëlidhjeje e zmadhon më tepër krimin e Judës. Në Lindjen e Afërt, ishte shenjë përçmimi t'ij tregojë tjetrit thembrën.

3:19 Ky varg tregon qëllimin e shenjave të mrekullueshme dhe parashikimeve të Jezusit (shih 20:31). Te Gjoni, besimi është një përvojë e vazhdueshme dhe në rritje e sipër. Jezusi po zhvillon vazhdimisht besimin/bindjen e apostujve. Shih Temën e Veçantë në 9:7.

Jezusi ua zhvillon besimin me anë të

1. Fjalëve të tij
2. Veprave të tij
3. Paranjohjes së tij

Jezusi sollti një mënyrë “të re” dhe rrënjësore për të patur marrëdhënie të drejtë me Perëndinë. Ajo iu kundërvu traditave dhe bindjeve të këtyre burrave judenj.

1. Fokusi ishte Jezusi, jo Moisiu
2. Hiri, jo kryerja e veprave

■ **“unë jam ai”** Kjo i bën jehonë emrit të Perëndisë “JHVH”, që vjen nga FOLJA hebraisht “jam” (shih “Unë Jam”, Eks. 3:14). Jezusi po pohon qartë se është Mesia i premtuar, madje me ngjyime hyjnore (shih 4:26; 8:24,28,58; 13:19 dhe 18:5,6,8; vini re Mat. 24:5 dhe Marku 13:6; Luka 21:8)

Shih Temën e Veçantë: Emrat e Perëndisë, në 6:20.

13:20 Zakonisht, Gjoni përdor fjalën “besoj” (*pisteuō*), “besoj në” (*pisteuō eis*), ose “besoj se” (*pisteuō hoti*) kur e ka fjalën për të krishterët (shih Temën e Veçantë: Përdorimi i “besoj” te Gjoni, në 2:23), por ai përdor dhe terma të tjerë si “pranoj” ose “mirëpres” (shih 1:12; 5:43; 13:20). Ungjilli është edhe mirëpritje e një personi, edhe pranim i të vërtetave biblike për atë person, por edhe imitimi i atij personi me jetën tënde.

■ **“ai që pranon atë që kam dërguar unë, më pranon mua”** Ç’thënie e fuqishme për autoritetin e deleguar të dishepujve të Jezusit! Ajo mund të funksionojë në disa nivele.

1. udhëtimet misionare të të Dymbëdhjetëve (Mat. 10:40) dhe të Shtatëdhjetëve (Luka 10:16)
2. dëshmia e kishës (shih 17:20)

Mesazhi për Jezusin ka fuqi jetëndryshuese, pavarësisht nga personi që e shpall. Autoriteti qëndron në mesazhin (pra, ungjillin), jo në lajmëtarin tokësor.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:21-30

²¹Pasi tha këto, Jezusi u trondit në shpirt, dëshmoi dhe tha: “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them, se njëri nga ju do të më tradhtojë”. ²²Dishepujt nisën të vështronin njëri-tjetrin, pa e kuptuar se për kë po fliste. ²³Te kraharori i Jezusit ishte mbështetur një nga dishepujt e vet, të cilin Jezusi e donte. ²⁴Kështu, Pjetri ia bëri me shenjë dhe i tha: “Na thuaj se kush ishte ai për të cilin po fliste”. ²⁵Ai, duke u përkulur te kraharori i Jezusit, i tha: “Zot, kush është?” ²⁶Atëherë, Jezusi u përgjigj: “Është ai, të cilit do t’ia jap kafshatën pasi ta kem ngjyer”. Kështu, pasi ngjau kafshatën, e mori dhe ia dha Judës, birit të Simon Iskariotit. ²⁷Pas kafshatës, Satani hyri në të. Atëherë, Jezusi i tha: “Ç’ke për të bërë, bëje shpejt”. ²⁸Por asnjë nga ata që ishin në tryezë nuk e dinte për ç’qëllim ia tha këto fjalë. ²⁹Në fakt, disa mendonin se, meqë Juda kishte qesen e parave, Jezusi po i thoshte: “Bli gjërat që na nevojiten për festën”; ose që t’u jepte diçka të varfërve. ³⁰Kështu, pasi mori kafshatën, ai doli menjëherë; dhe ishte natë.

13:21 “u trondit në shpirt” Tradhtia e Judës e tronditi vërtet Jezusin (kjo fjalë përdoret për Jezusin edhe në 12:27). Jezusi e zgjodhi Judën për shkak të potencialit të tij shpirtëror, por ky potencial nuk u përmbush kurrë (shih v. 18).

■ **“Me të vërtetë, me të vërtetë”** Shih shënimin në 1:51.

13:22 Ky është varg i habitshëm. Dishepujt e rrethit të ngushtë kishin frikë se mos ndonjë plan i paracaktuar i shndërronte në tradhtarin e përmendur (shih Marku 14:19). Ky është problemi i determinizmit. Veprimet e Perëndisë nuk e shkelin vullnetin e lirë njerëzor, por vetëm sa ia theksojnë dhe finalizojnë pasojat!

13:23 “të cilin Jezusi e donte” Me sa duket, bëhet fjalë për vetë Gjoning (shih 13:23,25; 19:26-27,34-35; 20:2-5,8; 21:7,20-24). Kapitulli 19, v. 26, e vërteton këtë. Emri i Gjoning nuk përmendet kurrë në këtë ungjill. A kishte njerëz të ngushtë Jezusi? Ai kishte një rreth të ngushtë (Pjetrin, Jakobin dhe Gjoning) si dhe një familje të veçantë (Lazarin, Marinë dhe Martën).

13:25 Ky kontekst pasqyron pozicionin tipik të ngrënies në Palestinën e shekullit të parë. Dishepujt shtriheshin rreth një tryeze të ulët, me formë u-je, duke u mbështetur mbi bërrylin e majtë me këmbët pas vete, dhe duke ngrënë me dorën e djathtë. Gjoni ishte në të djathtë të Jezusit, ndërsa Juda në të majtë të tij (vendi i nderit). Arsyeya për këtë rend uljeje nuk na jepet në Shkrim. Gjoni u mbështet mbrapa dhe i bëri Jezusit një pyetje.

13:26 “Është ai, të cilit do t’ia jap kafshatën pasi ta kem ngjyer” Kjo ishte shenjë nderimi (shih Ruthi 2:14). Juda ishte shtrirë në të majtë të Jezusit, ku ishte vendi i nderit. Jezusi ende po përpiquej të bindte Judën!

Kafshata ishte me salcë prej bimësh të hidhura (shih Temën e Veçantë në 13:2). Paraleli me Markun (14:2) thotë “me mua”. Ky është një pështjellim që dëshmohet nga një dëshmitar okular.

■ **“Iskarioti”** Shih Temën e Veçantë më poshtë, si dhe shënimet në 6:71 dhe 18:2.

TEMË E VEÇANTË: ISKARIOTI

Juda kishte dëgjuar, vëzhguar Zotin dhe ishte shoqëruar me të në mënyrë të ngushtë për disa vjet, por, me sa duket, ende nuk kishte marrëdhënie personale me të nëpërmjet besimit (shih Mat. 7:21-23). Pjetri kalon nën të njëjtin intensitet tundimi si Juda, por me rezultate tërësisht të ndryshme. Shumë diskutime janë bërë për motivet e tradhtisë së Judës:

1. ishte, kryesisht, për hir të parave (shih Gjoni 12:6)
2. ishte, kryesisht, për motive politike (shih William Klassen, *Juda, tradhtar, apo mik i Jezusit?*)
3. ishte për motive shpirtërore (shih Gjoni 13:27)

Për temën e ndikimit satanik, apo pushtimit demoniak, ka disa burime shumë të mira (të renditura sipas rendit të vlerësimit tim).

1. Merrill F. Unger, *Biblical Demonology, Demons in the World Today* [*Demonologjia biblike: demonët në botë sot*]
2. Clinton E. Arnold, *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare* [*Tri pyetje kyçe për betejën shpirtërore*]
3. Kurt Koch, *Christian Counseling and Occultism, Demonology Past and Present* [*Këshillimi i krishterë dhe okultizmi: demonologjia e shkuar dhe e sotme*]
4. C. Fred Dickason, *Demon Possession and the Christian* [*Pushtimi demoniak dhe i krishteri*]
5. John P. Newport, *Demons, Demons, Demons* [*Demonët, demonët, demonët*]
6. John Warwick Montgomery, *Principalities and Powers* [*Principata dhe pushtete*]

Kujdes nga mitet dhe besëtytnitë kulturore! Satani ndikon te Pjetri te Mat. 16:23 për të tunduar Jezusin në të njëjtën mënyrë – vdekja e tij zëvendësuese. Satani është i njëtrajtshëm. Ai po përpiket me çdo mënyrë të mundshme të ndalë veprën shpenguese të Jezusit për hirin tonë.

1. Tundimi i Jezusit, Luka 4
2. Përdor Pjetrin
3. Përdor Judën dhe Sinedrin

Madje, Jezusi e përshkruan Judën si djall në Gjoni 6:70. Bibla nuk diskuton për temën e pushtimit demoniak dhe ndikimin që ka ai në lidhje me besimtarët. Por është e qartë se besimtarët ndikohen nga zgjedhjet e tyre personale dhe nga ligësia personale!

Etimologjia e kësaj fjale është disi e paqartë; gjithsesi, ka disa mundësi.

1. *Kerioth*, një qytet i Judesë (shih Joz. 15:25)
2. *Kartan*, një qytet në Galile (shih Joz. 21:32)
3. *Karōides*, një pyll me palma në Jerusalem ose në Jeriko
4. *skortea*, përparëse, ose qese lëkure (shih Gjoni 13:29)
5. *askara*, mbytje (hebraisht) nga Mat. 27:5
6. thika e vrasësit (greqisht), që do të thotë se Juda ishte zelot, si Simoni (shih Luka 6:15).

13:27 “Satani hyri në të” Ky është i vetmi përdorim i fjalës “Satan” në ungjillin e Gjonit. Në hebraisht do të thotë “kundërshtar” (shih Luka 22:3 dhe Gjoni 13:2). Shih Temën e Veçantë në 12:31. A është përgjegjës Juda pasi hyri Satani në të? Ka tension në Bibël midis veprimeve të sferës shpirtërore (Perëndia ia ngurtëson zemrën faraonit) dhe përgjegjësisë njerëzore në sferën fizike. Pa dyshim, njerëzit nuk janë aq të lirë në zgjedhjet e tyre sa mendojnë. Të gjithë ne jemi të kushtëzuar historikisht, gjenetikisht dhe nga ana e përvojës. Këtyre përcaktuesve fizikë u shtohet dhe sfera shpirtërore (Perëndia, Fryma, engjëjt, Satani dhe demonët). Ky është misteri! Megjithatë, njerëzit nuk janë robotë; ne jemi përgjegjës për veprimet, zgjedhjet tona, si dhe për pasojat e tyre. Juda veproi! Ai nuk veproi i vetëm! Megjithatë, është moralisht përgjegjës për veprimet e tij. Tradhtia e Judës ishte parathënë (v. 18). Satani ishte nxitësi (shih Temën e Veçantë: Ligësia si Person në 12:31). Është tragjike që Juda nuk arriti kurrë “të njihte” Jezusin, pra, t’i besonte plotësisht.

13:29 “Juda kishte qesen e parave” Juda kishte përgjegjësi për paratë e grupit (shih 12:6). Shih shënimin e plotë në 18:2.

13:30 “ishte natë” Çfarë është ky: element kohor, apo vlerësim shpirtëror? Shpesh, Gjoni i përdor këto fraza të dykuptimshme që mund të merren në disa mënyra (p.sh., Nikodemi, shih 3:2; 19:39).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:31-35

³¹Kështu, pasi doli ai, Jezusi tha: “Tani, Biri i Njeriut është përlëvdur, dhe Perëndia është përlëvdur në të; ³²nëse Perëndia është përlëvdur në të, Perëndia do ta përlëvdojë në vetvete, madje do ta përlëvdojë menjëherë. ³³Fëmijë të vegjël, edhe për | pak kohë jam me ju. Do të më kërkoni; dhe si, u thashë judenjve, tani, po jua them dhe juve: „Aty ku po shkoj unë, ju s’mund të vini”. ³⁴Po ju jap një urdhërim të ri: të doni njëri-tjetrin. Ashtu siç ju kam dashur unë, kështu duhet të doni njëri-tjetrin. ³⁵Nga kjo do të dinë të gjithë njerëzit se jeni dishepuj të mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin”.

13:31-38 Këto vargje janë pjesë e një konteksti më të gjerë me një sërë pyetjesh që ia bëjnë dishepujt (shih 13:36; 14:5, 8, 22; 16:17-19); këto pyetje ia bënë në dialogun në Dhomën e Sipërme natën e Darkës së Zotit. Është e qartë se thëniet e Jezusit se do të largohej i bënë apostujt të kishin shumë pyetje, të cilat bazoheshin në keqkuptimet e tyre për fjalët e Jezusit.

1. Pjetri (13:36)
2. Thomai (14:5)
3. Filipi (14:8)
4. Juda (jo Iskarioti) (14:22)
5. Disa prej dishepujve (16:17-19)

13:31 “Biri i Njeriut” Ky është termi që përdorte Jezusi për veten. Sfondi i tij vjen nga Ezek. 2:1 dhe Dan. 7:13. Ai nënkupton karakteristika njerëzore dhe hyjnore. Jezusi e përdorte pasi ky term nuk përdorej në judaizmin rabinik; si rrjedhojë, nuk kishte ngjyrimet nacionaliste ose ushtarake, por edhe kombinonte dy natyrat e Jezusit (shih 1 Gjonit 4:1-3).

13:32 Në këtë varg, ekziston një variant në dorëshkrimet greke. Teksti më i gjatë gjendet në NASB, NKJV, NRSV, TEV dhe NJB. Ai mbështetet nga dorëshkrimet ^c, A, C², K dhe Textus Receptus. Ai (pra “nëse Perëndia është përlëvdur në të”) nuk përmendet në dorëshkrimet P⁶⁶, ^x*, B, C*, D, L, W dhe X. Ky duket se është grupi më i mirë i dorëshkrimeve. Por ka gjasa që kopjuesit të jenë ngatërruar nga paralelizmi dhe kanë harruar të përfshijnë frazën e parë.

■ **“përlëvdohet”** Ky term përdoret katër ose pesë herë në v. 31 dhe 32 – dy ose tri herë në KOHËN AORISTE dhe dy herë në KOHËN E ARDHME. Bën fjalë për planin e shpengimit të Perëndisë përmes vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit (shih 7:39; 12:16, 23; 17:1, 5). Këtu, bën fjalë për ngjarjet që do të ndodhin pas pak në jetën e Jezusit. Ato do të ndodhin me kaq siguri sa që shprehen si të ishin ngjarje të shkuara (AORISTI). Shih shënimin në 1:14.

13:33 “Fëmijë të vegjël” Gjoni, i cili shkruan në moshë të thyer nga qyteti ose zona e Efesit, përdor të njëjtin titull për t’iu drejtuar dëgjuesve/lexuesve të vet në 1 Gjonit 2:1, 12, 28; 3:7, 18; 4:4; 5:21. Këtu, metafora e Jezusit është një mënyrë tjetër për ta identifikuar me Atin. Ai është baba, vëlla, shpëtimtar, mik dhe Zot. Ose, e thënë ndryshe, ai është edhe Hyjni transcendent, edhe mik imanent.

■ **“edhe për pak kohë jam me ju... dhe, siç u thashë judenjve”** Jezusi ua kishte thënë këtë krerëve judenj disa muaj më parë (shih 7:33); tani, ua thotë apostujve (shih 12:35; 14:19; 16:16-19). Si rrjedhojë, është e qartë se elementi kohor është disi i vagullt.

■ **“Aty ku po shkoj unë, ju s’mund të vini”** Krerët e judenjve nuk mund të vinin aspak (shih 7:34, 36; 8:21). Dishepujt nuk do të ishin me të derisa të vdisnin. Vdekja, ose rrëmbimi, do t’i bashkojë ndjekësit e tij me të (shih 2 Kor. 5:8; 1 Thes. 4:13-18).

13:34 “Po ju jap një urdhërim të ri: të doni njëri-tjetrin” “Të doni njëri-tjetrin” nuk ishte urdhërim i ri (shih Lev. 19:18; për fjalën “urdhërim”, shih Temën e Veçantë në 12:50). I ri ishte fakti se besimtarët duhet të donin njëri-tjetrin ashtu siç i kishte dashur Jezusi (shih 15:12,17; 1 Gjonit 2:7-8; 3:11,16,23; 4:7-8,10-12,19-20; 2 Gjonit 5).

Ungjilli është një person që duhet mirëpritur, një grup të vërtetash që duhet besuar, dhe një jetë që duhet jetuar (shih 14:15,21,23; 15:10,12; 1 Gjonit 5:3; 2 Gjonit 5,6; Luka 6:46). Ungjilli pranohet, besohet dhe jetohet! Ose jetohet me dashuri, ose nuk jetohet fare!

Mua më pëlqen thënia e Bruce Corley në artikullin e tij “Teologjia biblike e Dhiatës së Re” në librin e hermeneutikës *Foundations for Biblical Interpretation* [Themele për interpretimin biblik]: “Populli i Krishtit karakterizohet nga etika e dashurisë, nëpërmjet së cilës fakti i hirit lidhet me detyrimin e dashurisë përmes veprës së Frymës (shih Gal. 5:6, 25; 6:2; Jakobi 3:17-18; Gjoni 13:34-35; 1 Gjonit 4:7)” (f. 562).

13:35 “Nga kjo do të dinë të gjithë njerëzit se jeni dishepuj të mi” Dashuria është karakteristika e vetme që Satani s’mund ta kopjojë. Besimtarët duhet të karakterizohen nga dashuria (shih 1 Gjonit 3:14; 4:7-21).

▣ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Veprimet tona ndaj të krishterëve të tjerë vërtetojnë marrëdhënien tonë me Jezusin (shih 1 Gjonit 2:9-11; 4:20-21).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:36-38

³⁶Simon Pjetri i tha: “Zot, ku po shkon?” Jezusi iu përgjigj: “Aty ku po shkoj unë, ti s’mund të më ndjekësh tani; por do të më ndjekësh më vonë”. ³⁷Pjetri i tha: “Zot, pse nuk mund të të ndjek që tani? Unë do të jap dhe jetën për ty”. ³⁸Jezusi iu përgjigj: “Ti do të japësh jetën për mua? Me të vërtetë, me të vërtetë, po të them: gjeli s’ka për të kënduar pa më mohuar ti tri herë”.

13:36 “Simon Pjetri i tha” Kjo është e para në serinë e pyetjeve të dishepujve për thëniet Jezusit në v. 31-35 (shih 13:36; 14:5, 8, 22; 16:17-19). Jam shumë i lumtur që dishepujt ia bënë këto pyetje dhe që Gjoni i mbajti mend dhe i shkroi!

13:37 “Unë do të jap dhe jetën për ty” Pjetri e kishte me gjithë mend! Por kjo tregon sa i dobët është njerëzimi i rënë dhe sa i përkushtuar është Zoti ynë, i cili bëri pikërisht këtë gjë.

13:38 “Me të vërtetë, me të vërtetë” Shih shënimin në 1:51.

▣ **“gjeli nuk do të këndojë pa më mohuar ti tri herë”** Ky duhet të ketë qenë gjel romak. Judenjtë nuk lejonin kafshë në qytet, pasi Jerusalemi ishte vend i shenjtë. Ja pse shumica e njerëzve të pasur kishin kopshte (të cilëve u nevojitej pleh) jashtë mureve të qytetit në malin e Ullinjve. Kopshti i Gjetsemanit ishte pikërisht një kopsht i tillë.

Jezusi po përdor parashikimin për të nxitur besimin e tyre tek ai. Edhe diçka kaq negative sa kjo zbulon njohurinë e tij dhe kontrollin e tij mbi ngjarjet e ardhshme (shih 18:17-18, 25-27; Mat. 26:31-35; Marku 14:27-31; Luka 22:31-34).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse Gjoni nuk e përmend Darkën rituale të Zotit?
2. Pse ua lau Jezusi këmbët dishepujve? A duhet t’ia lajmë dhe ne këmbët njëri-tjetrit?
3. Pse zgjodhi Jezusi Judën që të ishte dishepull i tij?
4. Si mund ta dish vërtet nëse je i krishterë?

GJONI 14

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi, udha për te Ati	Udha, e vërteta dhe jeta	Marrëdhënia e besimtarëve me Krishtin e përlëvduar	Jezusi, udha për te Ati	Fjalimet e lamtumirës (13:31-14:31)
14:1-14	14:1-6	14:1-7	14:1-4 14:5 14:6-7	14:1-4 14:5-7
	Zbulimi i Atit 14:7-11	14:8-14	14:8 14:9-14	14:8-21
Premtimi i Frymës	Jezusi premtim një Ndhimës tjetër		Premtimi i Frymës së Shenjtë	
14:15-24	14:15-18 Brendabanimi i Atit dhe Birit 14:19-24	14:15-17 14:18-24	14:15-17 14:18-20 14:21 14:22	14:22-31
	Dhurata e paqes së tij		14:23-24	
14:25-31	14:25-31	14:25-31	14:25-26 14:27-31a 14:31b	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

SFONDI I GJONIT 14:1-31

- A. Nga Gjoni 13 deri 17 nuk duhet të ketë ndarje kapitujsh, pasi kjo është një njësi e vetme letrare, dialogu në Dhomën e Sipërme natën e Darkës së Zotit. Është e qartë se thëniet e Jezusit se do të largohej i bënë dishepujt të kishin shumë pyetje. Ky kontekst ndërtohet mbi një sërë prej këtyre pyetjeve, të cilat bazoheshin në keqkuptimet e apostujve për fjalët e Jezusit
 1. Pjetri (13:36)
 2. Thomai (14:5)
 3. Filipi (14:8)

4. Juda (jo Iskarioti) (14:22)
 5. disa prej dishepujve (16:17-19)
- Mos harroni se Gjoni e përdor dialogun për të komunikuar të vërtetën!

- B. Gjithsesi, këto pyetje i ndihmojnë besimtarët
1. Ato tregojnë se edhe apostujt, që ishin fizikisht me Jezusin, nuk e kuptonin gjithmonë.
 2. Disa prej fjalëve më të vjera dhe më të thella të Jezusit janë thënë si përgjigje e këtyre pyetjeve të ndershme që vinin nga keqkuptimi.
- C. Kapitulli 14 fillon me diskutimin e Jezusit për “ndihmuesin” që po vjen.
1. Përmendjet që i bën Jezusi Frymës së Shenjtë në këtë fjalim në Dhomën e Sipërme kanë lidhje të drejtpërdrejta me frikën dhe ankthin e dishepujve (dhe kufizohet vetëm me ta) në lidhje me largimin e Jezusit (shih 13:33, 36).
Michael Magill, *New Testament Transline* (f. 355) ka një skicim të mençur të përgjigjeve kontekstuale të Jezusit ndaj kësaj frike.
 - a. “një ditë, edhe ju do të jeni aty ku po shkoj unë”, v. 1-11
 - b. “është mirë për ju që unë o shkoj”, v. 12-17
 - c. “do të vij aty ku jeni dhe do t’ju zbulohem”, v. 18-26
 - d. “tani, po ju lë paqen time”, v. 27-31
 2. Ky diskutim i shërbesës së Frymës së Shenjtë ka gamë të kufizuar. Ka shumë aspekte kyçe të shërbesës së tij që nuk diskutohen aspak në këtë kontekst.
 3. Këtu theksohet detyra e Frymës si
 - a. zbulues i së vërtetës dhe
 - b. ngushëllues personal

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:1-7

¹“Mos u tronditni në zemrën tuaj; besoni në Perëndinë, besoni dhe në mua. ²Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; po të mos ishte kështu, do t’jua kisha thënë; sepse unë po shkoj t’ju përgatis një vend. ³Nëse shkoj dhe ju përgatis një vend, do të kthehem sërish që t’ju marr tek vetja ime, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju. ⁴Dhe ju e dini udhën ku po shkoj”. ⁵Thomai i tha: “Zot, ne nuk e dimë se ku po shkon; nga të dimë udhën?” ⁶Jezusi i tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje. ⁷Po të më kishit njohur, do të kishit njohur dhe Atin tim; sepse, që tani e tutje, ju e njihni dhe e keni parë”.

14:1 “Mos” Kjo është URDHËRORE PËSORE E TASHME me një PJESËZ MOHORE që, zakonisht, nënkupton ndalimin e një veprimi tashmë në kryerje e sipër. “Mjaft e latë zemrën t’ju tronditet”. Komentet e Jezusit për largimin e tij u kishin shkaktuar ankth të madh.

■ **“në zemrën tuaj”** Vini re SHUMËSIN. Jezusi po u flet të njëmbëdhjetëve. Përdorimi hebraik i fjalës “zemër” nënkupton gjithë personin e njeriut: mendjen, vullnetin dhe ndjenjat (shih LiP. 6:5; Mat. 22:37). Shih Temën e Veçantë në 12:40.

■ **“besoni në Perëndinë; besoni dhe në mua”** Këto të dyja janë, ose URDHËRORE TË TASHME VEPRORE (NASB, REB), ose DËFTORE TË TASHME VEPRORE, ose një kombinim i këtyre të dyjave (NKJV, NJB dhe NET thonë se e para është DËFTORE, ndërsa e dyta, URDHËRORE). Besimi është i vazhdueshëm, si diçka që të bëhet zakon. Struktura e ekuilibruar nga ana gramatikore e këtij vargu tregon se Jezusi po pohon barazinë me Perëndinë. Gjithashtu, mos harroni se këta ishin judenj, të cilit ishin të përkushtuar ndaj monoteizmit (shih LiP. 6:4-6), e megjithatë, i kuptonin rrjedhojat logjike të thënies së Jezusit (shih Temën e Veçantë: Trinia, në 14:26). Ndryshe është të besosh në një Qenie të Epërme, dhe komplet ndryshe është të jesh i krishterë. Kjo frazë nuk fokusohet te një besore doktrinale, por te personi i Jezu Krishtit.

14:2 “në shtëpinë e Atit tim” “Shtëpia” përdoret në DhV për Tabernakullin, ose për Tempullin (shih 2 Samueli 7). Gjithsesi, në këtë kontekst, qartazi ajo bën fjalë për rezidencën familjare të Perëndisë në qiell, ose banimin me të në tempullin e tij (Psa. 23:6; 27:4-6).



NASB, NRSV “banesat”
NKJV “vilat”
TEV “dhomat”
NJB “shumë vende”

Përkthimi i KJV, “vilat”, është i gabuar. Termi grek do të thotë “vendbanime të përhershme” (shih 14:23), pa idenë e luksit. Ideja është se të gjithë besimtarët do të kenë dhomat e tyre në shtëpinë e Atit (shih TEV, NJB), njësoj si një konvikt, ku të gjithë hanë së bashku përditë.

Po kështu, është interesante se kjo vjen nga e njëjta fjalë greke që do të thotë “banoj”, i cili është koncept shumë kyç (shih kap. 15) te Gjoni. Banesa jonë me Atin kryhet kur ne banojmë në Birin.

■ **“po të”** Kjo është një FJALI e pjesshme KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, e cila quhet “në kundërshtim me faktin”. Ka shumë dhoma në dispozicion. Kjo frazë është e vështirë të përkthehet.

NASB, REB, NIV	“po të mos ishte kështu, do t’ju kisha thënë”
NKJV	“po të mos ishte kështu, do t’ju kisha thënë”
TEV	“s’do t’ju thosha po të mos ishte kështu”
NJB, NET	“përndryshe, nuk do t’ju thosha”
Përkthimi i fjalëpërfjalshëm i Young	“përndryshe do t’ju kisha thënë”
New Berkeley Version	“Po të mos ishte kështu, do t’ju kisha thënë”
Williams Translation	“po të mos ishte kështu, do t’ju thosha”

■ **“po shkoj t’ju përgatis një vend”** Kjo nuk nënkupton se qielli, në kuptimin fizik, nuk ishte përgatitur përpara kësaj, por se jeta, mësimet dhe vdekja e Jezusit i lejon njerëzimit mëkatar që t’i afrohet Perëndisë së shenjtë dhe të banojë me të. Jezusi shkon përpara besimtarëve si udhërrëfyesi dhe pararendësi i tyre (shih Heb. 6:20).

14:3 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Jezusi u ka thënë se, së shpejti, do të kthehet tek Ati (p.sh., 7:33; 16:5, 10, 17, 28) dhe do të përgatisë një vend për ta.

Ndihma për përkthyesit, e Shoqërive të Bashkuara Biblike, për librin e Gjoni, e shkruar nga Newman dhe Wider, thotë se kjo fjalë duhet marrë nuk kuptimin kohor, “pasi të shkoj”, ose “kur të shkoj”, ose “meqë po shkoj” (f. 456).

■ **“do të kthehem sërish që t’ju marr tek vetja ime”** Kjo bën fjalë për Ardhjen e Dytë, ose për vdekjen (shih 2 Kor. 5:8; 1 Thes. 4:13-18). Kjo bashkësi ballë për ballë me Jezusin pasqyron bashkësinë e tij me Atin (shih 1:1, 2). Të krishterët do të marrin pjesë në lidhjen e ngushtë mes Jezusit dhe Atit (14:23; 17:1 e më tej).

FOLJA që përdoret këtu, pranoj (*paralambanō*), do të thotë “mirëpres një person”. Qielli është bashkësi personale me Perëndinë. Kjo ndryshon nga 1:12 (*lambanō*). Është e vështirë të sigurohemi për mbivendosjen e saktë semantike të këtyre dy termave; shpesh, ato janë sinonimike.

■ **“atje ku jam unë, të jeni edhe ju”** Qielli është aty ku është Jezusi (shih 17:24)! Në të vërtetë, qielli është bashkësi ballë për ballë me Perëndinë triumfues! DhR është e paqartë se kur do të ndodhë saktësisht kjo bashkësi e plotë.

1. në momentin e vdekjes, 2 Kor. 5:8
2. në Ardhjen e Dytë, 1 Thes. 4:13-18

Çuditërisht, Bibla është e heshtur për jetën pas vdekjes. Një libër i mirë dhe i shkurtër është ai i William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter (Bibla për jetën e përtejme)*.

TEMË E VEÇANTË: KU JANË TË VDEKURIT?

- I. Dhiata e Vjetër
- A. Të gjithë njerëzit shkojnë në *Sheol* (etimologjia e paqartë, BDB 1066), që nënkupton vdekjen ose varrin, kryesisht në letërsinë e urtësisë dhe në librin e Isaisë. Në DhV, kjo ishte një ekzistencë e errët, e vetëdijshme, por pa gëzim (shih Jobi 10:21-22; 38:17).
- B. Karakteri i *Sheolit*
1. shoqërohet me gjykimin (zjarrin) e Perëndisë, LiP. 32:22
 2. shoqërohet me ndëshkimin edhe përpara Ditës së Gjykimit, Psa. 18:4-5
 3. shoqërohet me *abandon*-in (shkatërrimin), ku është i pranishëm dhe Perëndia, Jobi 26:6; Psa. 139:8; Amosi 9:2
 4. shoqërohet me “Gropën” (varrin), Psa. 16:10; Isa. 14:15; Ezek. 31:15-17
 5. të ligjtë zbresin të gjallë në *Sheol*, Num. 16:30, 33; Psa. 55:15
 6. shpesh, personifikohet si kafshë me gojë të madhe, Num. 16:30; Isa. 5:14; Hab. 2:5
 7. njerëzit aty thirren *Refa'im*, Isa. 14:9-11
- II. Dhiata e Re
- A. Fjala hebraisht *Sheol* përkthehet në greqisht si *Hades* (bota e padukshme)
- B. Karakterizimi i *Hadesit*
1. i referohet vdekjes, Mat. 16:18
 2. lidhet me vdekjen, Zbu. 1:18; 6:8; 20:13-14
 3. shpesh nënkupton vendin e ndëshkimit të përhershëm (*Gehenna*), Mat. 11:23 (citim i DhV); Luka 10:15; 16:23-24
 4. shpesh nënkupton varrin, Luka 16:23
- C. Ndoshta i ndarë (rabinët)
- a. pjesa e të drejtëve quhet parajsë (në fakt, ky është një tjetër emër i qiellit, shih 2 Kor. 12:4; Zbu. 2:7), Luka 23:43
 - b. pjesa e të ligjve quhet *Tartar*, 2 Pjetrit 2:4, ku është vendi që mbahen engjëjt e ligj (shih Zan. 6; 1 Enokut)
- D. *Gehenna*
1. Reflekton frazën e DhV, “lugina e bijve të HInomit” (në jug të Jerusalemit). Ishte vendi ku perëndia fenikas i zjarrit, *Moleku* (BDB 574), adhurohej me fljime foshnjash (shih 2 Mbret. 16:3; 21:6; 2 Kro. 28:3; 33:6), gjë që ndalohej nga Lev. 18:21; 20:2-5.
 2. Jeremia e ndryshoi, nga vend adhurimi pagan, në një vend të ndëshkimit të JHVH-së (shih Jer. 7:32; 19:6-7). Kështu, ky u bë vendi i gjykimit të flaktë e të përjetshëm në 1 Enokut 90:26-27 dhe Sib. 1:103.
 3. Judenjtë e kohës së Jezusit ndienin kaq shumë neveri prej pjesëmarrjes së paraardhësve të tyre në adhurimin pagan me fljime foshnjash, sa që këtë zonë e shndërruan në vendgrumbullimi plehrash për Jerusalemin. Shumë prej metaforave të Jezusit për gjykimin e përjetshëm vinin nga ky vendgrumbullim (zjarri, tymi, krimbat, era e qelbur, shih Marku 9:44, 46). Fjala *Gehenna* përdoret vetëm nga Jezusi (përveçse te Jakobi 3:6).
 4. Përdorimi i *Gehenna*-s nga Jezusi
 - a. zjarr, Mat. 5:22; 18:9; Marku 9:43
 - b. i përhershëm, Marku 9:48 (Mat. 25:46)
 - c. vend shkatërrimi (i trupit dhe shpirtit), Mat. 10:28
 - d. paralel me *Sheolin*, Mat. 5:29-30; 18:9
 - e. karakterizon të ligjtë si “bij të ferrit”, Mat. 23:15
 - f. rezultat i dënimit të gjyqit hyjnor, Mat. 23:33; Luka 12:5
 - g. koncepti i *Gehenna*-s është paralel me vdekjen e dytë (shih Zbu. 2:11; 20:6, 14), ose me liqenin e zjarrtë (shih Mat. 13:42, 50; Zbu. 19:20; 20:10, 14-15; 21:8). Ka gjasa që liqeni i zjarrtë të bëhet vendbanimi i përhershëm i njerëzve (nga *Sheoli*) dhe i engjëjve të ligj (nga *Tartari*, 2 Pjet. 2:4; Juda v. 6, ose humnera, shih Luka 8:31; Zbu. 9:1-11; 20:1, 3).
 - h. nuk u krijua për njerëzit, por për Satanin dhe për engjëjt e tij, Mat. 25:41
- E. Ka gjasa që, për shkak të mbivendosjes së *Sheolit* me *Hadesin* dhe *Gehenna*-n,

1. në fillim, të gjithë njerëzit shkonin në *Sheol/Hades*
2. përvoja e tyre atje (e mirë/e keqe) përkeqësohet pas Ditës së Gjykimit, por vendi i të ligjeve mbetet i njëjtë (ja pse KJV e përktheu fjalën *hades* (varr) si *gehanna* (ferr))
3. I vetmi pasazh në DhR që përmend torturën përpara Gjykimit është shëmbëlltyra e Lukës 16:19-31 (Lazari dhe i Pasuri). *Sheoli* përshkruhet edhe si vend ndëshkimi tani (shih LiP. 32:22; Psa. 18:1-5). Megjithatë, s'mund të krijojmë një doktrinë në bazë të një shëmbëlltyre.

III. Gjendja e ndërmjetme midis vdekjes dhe ringjalljes

- A. DhR nuk mëson "pavdekshmërinë e shpirtit", që është një prej disa pikëpamjeve të lashta për jetën pas vdekjes.
 1. shpirti njerëzor ekziston përpara jetës së vet fizike
 2. shpirti njerëzor është i përjetshëm përpara dhe pas vdekjes fizike
 3. shpesh, trupi fizik shihet si burg, ndërsa vdekja si çlirim për t'u kthyer në gjendjen paraekzistuese
- B. DhR aludon për një gjendje të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes
 1. Jezusi flet për ndarjen e shpirtit dhe trupit, Mat. 10:28
 2. Abrahami mund të ketë një trup tani, Marku 12:26-27; Luka 16:23
 3. Moisiu dhe Elija kanë një trup fizik në çastin e shndërrimit në mal, Matu 17
 4. Pali pohon se, në Ardhjen e Dytë, shpirtat me Krishtin do të marrin të parët trupa të rinj, 1 Thes. 4:13-18
 5. Pali pohon se besimtarët do të marrin trupa të rinj shpirtërorë në Ditën e Ringjalljes, 1 Kor. 15:23, 52
 6. Pali pohon se besimtarët nuk shkojnë në *Hades*, por, pas vdekjes, janë me Jezusin, 2 Kor. 5:6, 8; Fil. 1:23. Jezusi mposhti vdekjen dhe i mori të drejtët në qiell me të (1 Pjet. 3:18-22).

IV. Qielli

- A. Kjo fjalë përdoret në tre kuptime në Bibël.
 1. atmosfera mbi tokë, Zan. 1:1, 8; Isa. 42:5; 45:18
 2. qiejt me yje, Zan. 1:14; LiP. 10:14; Psa. 148:4; Heb. 4:14; 7:26
 3. vendi i fronit të Perëndisë, LiP. 10:14; 1 Mbret. 8:27; Psa. 148:4; Efe. 4:10; Heb. 9:24 (qielli i tretë, 2 Kor. 12:2)
- B. Bibla nuk na zbulon shumë gjëra për jetën pas vdekjes, ndoshta për shkak se njerëzit e rënë nuk kanë kapacitetin që të kuptojnë (shih 1 Kor. 2:9).
- C. Qielli është edhe vend (shih Gjoni 14:2-3), edhe person (shih 2 Kor. 5:6 8). Qielli mund të jetë Kopshti i ripërtërirë i Edenit (Zanafilla 1-2; Zbulesa 21-22). Toka do të pastrohet dhe rimëkëmbët (shih Veprat 3:21; Rom. 8:21; 2 Pjet. 3:10). Shëmbëllimi i Perëndisë (Zan. 1:26-27) ripërtërihet në Krishtin. Tani, bashkësia e ngushtë e Kopshtit të Edenit bëhet sërish e mundshme.

Gjithsesi, kjo mund të jetë metaforike (qielli si qytet i stërmadh në formë kubi, i Zbu. 21:9-27), dhe jo e fjalëpërfjalshme. 1 Korintasve 15 përshkruan dallimin mes trupit fizik dhe trupit shpirtëror si dallimi mes farës dhe bimës së rritur. Sërish, 1 Kor. 2:9 (citim i Isa. 64:4 dhe 65:17) është një shpresë dhe premtim madhështor! Unë e di se, kur të shohim atë, do të jemi si ai (shih 1 Gjonit 3:2).

V. Burime të dobishme

- A. William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter* [*Bibla për jetën pas vdekjes*]
- B. Maurice Rawlings, *Beyond Death's Door* [*Përtej derës së vdekjes*]

14:4 "ju e dini udhën" Thënia e Jezusit bën që Thomai të shprehë dyshimin se nuk e dinë rrugën. Përgjigjja e Jezusit shprehet me tre terma që përdoren shpesh në DhV.

14:6 "Unë jam udha" Në DhV, besimi biblik përmendet si shteg i mënyrës së jetesës (shih LiP. 5:32-33; 31:29; Ps. 27:11; Isa. 35:8). Titulli i kishës së hershme ishte "Udha" (shih Veprat 9:2; 19:9, 23; 24:14, 22). Jezusi po

theksonte se ai ishte dhe është e vetmja udhë për të Perëndia. Ky është thelbi teologjik i ungjillit të Gjonit! Veprat e mira si mënyrë jetese janë dëshmi e besimit personal (shih Efe. 2:8-9, 10), jo mjet drejtësie. Shih shënimin në 8:12.

■ **“e vërteta”** Fjala “e vërtetë” në filozofinë greke kishte kuptimin e “së vërtetës” përkundrajt “të rremes”, ose “realitetit” përkundrajt “iluzionit”. Sidoqoftë, këta janë dishepuj aramaishtfolës, të cilët duhet të kenë kuptuar se Jezusi po fliste në kuptimin e DhV për të vërtetën, që nënkuptonte termin “besnikëri” (shih Psa. 26:3; 86:11; 119:30). Si “e vërteta”, ashtu dhe “jeta”, karakterizojnë “udhën”. Fjala “e vërtetë” përdoret shpesh te Gjoni për të përshkruar veprimtarinë hyjnore (shih 1:14; 4:23-24; 8:32; 14:17; 15:26; 16:13; 17:17,19). Shih Temat e Veçanta për të Vërtetën në 6:55 dhe 17:3.

■ **“jeta”** “Jeta” është *zoā*, dhe përdoret nga Gjoni për të përshkruar jetën e epokës së re. Në DhV, besimi i besimtarit, që shprehet me mënyrën e jetesës, përshkruhet si një shteg që të çon në jetë (shih Psa. 16:11; Fja. 6:23; 10:17). Të tre këto fjalë lidhen me besimin, që shprehet në mënyrën e jetesës, dhe që gjendet vetëm në marrëdhënien personale me Jezu Krishtin.

■ **“askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”** Ç’pohim tronditës! Është shumë kufizues, por edhe shumë i qartë, fakti se Jezusi besonte që njeriu mund të njohë Perëndinë vetëm nëpërmjet një marrëdhënieje personale me Jezusin (shih 1 Gjonit 5:10-12). Shpesh, ky është quajtur skandali përjashtues i krishterimit. Nuk ka asnjë terren të ndërmjetëm. Ose kjo thënie është e vërtetë, ose krishterimi është i rremë! Në një sërë mënyrash, kjo ngjan me Gjonin 10.

14:7 “Po të” Ekziston një variant në dorëshkrime që ka të bëjë me llojin e FJALISË KUSHTORE. Teksti greqisht i Shoqërive të Bashkuara Biblike mbështet FJALINË KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, gjë që përputhet me dorëshkrimet e lashta greke P⁶⁶, κ , dhe D. Kështu, kjo do të përkthehej: “po të më kishit njohur mua, dhe në fakt më njihni, atëherë do të kishit njohur dhe Atin tim, dhe në fakt e njihni”.

Por kjo mund të jetë edhe FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, e cila, shpesh, quhet “në kundërshtim me faktet”. Kështu, përkthimi do të ishte: “po të më kishit njohur mua, dhe nuk më njihni, atëherë do të kishit njohur dhe Atin tim, por nuk e njihni”. Kjo mbështetet nga dorëshkrimet A, B, C, D^b, K, L dhe X. Kjo është thënie e vështirë, pasi supozojmë se apostujt kishin besuar tashmë për shpëtimën e Jezusin si Mesia i dërguar nga JHVH. Kjo e vërtetë e re dhe, në thelb, përjashtuese, duhet të ketë qenë shumë e vështirë për ta që ta kuptonin. Ungjilli i Gjonit duket se flet për nivele besimi. Konteksti duket se mbështet KUSHTOREN E KLASIT TË DYTË. Gjithashtu, vini re të njëjtin kusht në v. 2 dhe 28.

■ **“Po të më kishit njohur”** Jezusi po i drejtohet sërish gjithë grupit të apostujve (shih v. 9). Fjala “njoh” përdoret në kuptimin e DhV, që bën fjalë për marrëdhënie të ngushtë personale, jo thjesht për njohuri njohëse (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5).

■ **“do të kishit njohur dhe Atin tim”** Kush sheh Jezusin, sheh Perëndinë (shih Gjoni 1:14-18; 5:24; 12:44-45; 2 Kor. 4:4; Kol. 1:15; Heb. 1:3)! Jezusi është shpëtimi i përsosur i Perëndisë së padukshëm. Askush që mohon Jezusin nuk mund të pretendojë se njeh Perëndinë (shih 1 Gjonit 5:9-12).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:8-14

⁸Filipi i tha: “Zot, na trego Atin dhe për ne është mjaft”. ⁹Jezusi i tha: “Kam qenë me ju prej kaq kohësh, dhe ti ende nuk më ke njohur, Filip? Ai që më ka parë mua, ka parë Atin; si mund të thuash: „Na trego Atin”? ¹⁰A nuk beson ti se unë jam në Atin, dhe Ati është në mua? Fjalët që po ju them nuk i them me nismën time, por Ati që banon në mua kryen veprat e tij. ¹¹Më besoni se unë jam në Atin dhe Ati është në mua; përndryshe, besoni për shkak të vetë veprave. ¹²Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: ai që beson në mua, do të kryejë dhe veprat që kryej unë; madje, do të kryejë vepra edhe më të mëdha se këto; sepse unë po shkoj te Ati. ¹³Çfarëdo të kërkoni në emrin tim, do ta bëj, në mënyrë që Ati të përlehtëhet në Birin. ¹⁴Nëse më kërkoni çfarëdo gjëje në emrin tim, do ta bëj.

14: 8 “Filipi i tha” Me sa duket, Filip (1) donte një vegim nga Perëndia (theofani), të ngjashme me atë të Moisiut, Isaisë, ose Ezekielit, ose (2) i keqkuptoi plotësisht fjalët e Jezusit. Jezusi i përgjigjet duke thënë se, kur Filipi kishte parë dhe njohur Jezusin, kishte parë dhe njohur Perëndinë (shih Kol. 1:15; Heb. 1:3)!



NASB “për ne është mjaft”

NKJV “mjafton për ne”

NRSV “do të jemi të kënaqur”

TEV “vetëm kaq na nevojitet”

NJB “atëherë do të jemi të kënaqur”

Këta dishepuj donin njëfarë konfirmimi, njësoj si farisenjtë. Mirëpo besimtarët duhet të ecin me besim, jo të varen nga shikimi (shih 2 Kor. 4:18; 5:7), për çështjet shpirtërore. Besimi është thelbi!

14:9 “Kam qenë me ju prej kaq kohësh” Vini re se kjo është në SHUMËS. Filipi bëri pyetjen që u kishte shkuar në mendje të gjithëve.

▣ **“Ai që më ka parë mua, ka parë Atin”** Kjo është PJESORE E KRYER VEPRORE dhe FOLJE E KRYER VEPRORE, që do të thotë “ka parë dhe vazhdon të shohë”. Jezusi zbulon plotësisht Hyjninë (shih Kol. 1:15; Heb. 1:3).

14:10 Pyetja e Jezusit në greqisht pret përgjigjen “jo”. Shih Temën e Veçantë: “Banoj” në Shkrimet e Gjonit në 1 Gjonit 2:10.

▣ **“ti... ju”** E para është në NJËJËS, sepse i drejtohet Filipit. E dyta është në SHUMËS, sepse i drejtohet gjithë grupit të apostujve (shih v. 7, 10).

▣ **“Fjalët që po ju them nuk i them me nismën time”** Jezusi po vepron në emër të Atit në gjithçka (shih v. 24; 5:19,30; 7:16-18; 8:28; 10:38; 12:49). Mësimet e Jezusit janë vetë fjalët e Atit (shih v. 24).

▣ **“por Ati që banon në mua kryen veprat e tij”** Kjo bashkësi mes Atit dhe Birit (p.sh., 7:14; 8:28; 10:38), që theksohet në lutjen kryepiftërore të Jezusit në kapitullin 17, bëhet baza për “banimin” e besimtarëve në Krishtin në kapitullin 15. Ungjilli i Gjonit e zbulon shpëtimin si (1) doktrinë; (2) bashkësi; (3) bindje; dhe (4) qëndresë.

14:11 “Më besoni” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, ose DËFTORE E TASHME VEPRORE (shih 14:1).

Në frazën hyrëse të këtij vargu ekziston një variant në dorëshkrime, që ka njëfarë vlere. Disa tekste të hershme greqisht (P⁶⁶, P⁷⁵, x, D, L dhe W) kanë vetëm FOLJEN “besoj”, të ndjekur nga (*hoti*) “se”, që nënkupton se ata duhet të pranorin të vërtetën për unitetin e Jezusit me Atin. Dorëshkrime të tjera të lashta (A dhe B) shtojnë DHANOREN “në mua”, që tregojnë objektin personal të besimit. Studiuesit e greqishtes në Shoqëritë e Bashkuara Biblike besojnë se alternativa e parë ishte origjinalja (shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, që i jep kësaj alternative vlerësimin “B” [pothuajse i sigurt], f. 244). Shumica e përkthimeve të sotme mbajnë “në mua”, por shtojnë edhe “se” (që tregon përmbajtjen që duhet besuar).

▣ **“përndryshe, besoni për shkak të vetë veprave”** Jezusi u thotë të besojnë në veprat e tij (shih Gjoni 5:36; 10:25, 38). Veprat e tij përmbushën profecinë e DhV. Veprat e tij zbulojnë se kush është ai! Apostujt, njësoj si të gjithë ne, duhet të rriteshin në besim.

14:12 “Me të vërtetë, me të vërtetë” Shih shënimin në 1:51.

▣ **“beson... do të kryejë”** Besimi nuk është vetëm veprimtari mendore, por edhe fjalë e orientuar ndaj veprimeve. Fraza “do të mund të bëjë gjëra edhe më të mëdha” është DËFTORE E ARDHME VEPRORE që duhet përkthyer: “do të bëjë gjëra më të mëdha”. Me gjasë, kjo nënkupton

1. gamën gjeografike (shih Mat. 28:18-20)
2. misionin te johebrenjtë
3. faktin se Fryma do të jetë me çdo besimtar
4. Lutja ndërmjetësuese e Jezusit (shih Heb. 7:25; 9:24)

Shih Temën e Veçantë: Lutja, e Pakufizuar, por edhe e Kufizuar, në 1 Gjonit 3:22, B. 2.

Fraza e fundit, “[ai] do të”, është kyçe për krishterimin biblik. Ashtu si Ati dërgoi Birin, Biri dërgon dishepujt e vet! Të jesh “në Krishtin”, të kesh “jetën e përjetshme”, nënkupton një mendje dhe zemër aktive për

“Porosinë e Madhe”. Krishterimi nuk është kredo, apo diçka që e marrim për ndonjë ditë të vështirë. Ai është orientim i ri i jetës, botëkuptim i ri! Ndryshon gjithçka! Kjo duhet kthyer në mënyrë jetese të qëllimshme, të përditshme, sakrifikuese dhe të orientuar drejt mbretërisë.

Kisha duhet të ripërtërijë

1. shërbesën e çdo besimtari
2. përparësinë e Porosisë së Madhe
3. shërbimin e përditshëm, të qëllimshëm dhe altruist
4. ngjashmërinë me Krishtin tani!

14:13-14 “Çfarëdo të kërkon në emrin tim, do ta bëj” Vini re se Jezusi pohon se do t’u përgjigjet lutjeve tona në bazë të karakterit të vet. Në Veprat 7:59, Stefani i lutet Jezusit. Në 2 Kor. 12:8, Pali i lutet Jezusit. Në 15:16 dhe 16:23, besimtarët duhet t’i drejtohen Atit. Lutja në emër të Jezusit nuk nënkupton ndonjë formulë magjike, të thënë në fund të lutjeve tona, por lutje në vullnetin dhe karakterin e Jezusit.

Ky është shembull i mirë i nevojës për të konsultuar pasazhe paralele përpara se të arrijmë në pohime dogmatike për temat biblike. Frazën “çfarëdo t’i kërkojmë” duhet ta drejtpeshojmë me të mëposhtmet:

1. “në emrin tim” (Gjoni 14:13-14; 15:7,16; 16:23)
2. “vazhdoni të kërkonin” (Mat. 7:7-8; Luka 11:5-13; 18:1-8)
3. “dy bien dakord” (Mat. 18:19)
4. “beso” (Mat. 21:22)
5. “pa dyshim” (Marku 11:22-24; Jakobi 1:6-7)
6. “pa egoizëm” (Jakobi 4:2-3)
7. “kryeni urdhërimet e tij” (1 Gjonit 3:22)
8. “sipas vullnetit të Perëndisë” (Mat. 6:10; 1 Gjonit 5:14-15)

Emri i Jezusit përfaqëson karakterin e tij. Kjo është një mënyrë tjetër të foluri për mendjen dhe zemrën e Jezusit. Kjo frazë shfaqet shpesh në Gjoni (shih 14:13-14, 26; 15:16; 16:23-26). Sa më tepër të jetë besimtari si Krishti, aq më shumë gjasa ka që lutjet e tij të marrin përgjigje pozitive. Gjëja më e keqe që mund t’u bënte Perëndia shpirtërisht shumicës së besimtarëve do të ishte t’u përgjigjej lutjeve të tyre egoiste dhe materialiste. Shih shënimin në 1 Gjonit 3:22.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA E EFEKTSHME

- A. Në lidhje me marrëdhënien personale të njeriut me Perëndinë triun
 1. Lidhur me vullnetin e Atit
 - a. Mat. 6:10
 - b. 1 Gjonit 3:22
 - c. 1 Gjonit 5:14-15
 2. Banimi në Jezusin
Gjoni 5:17
 3. Lutja në emrin e Jezusit
 - a. Gjoni 14:13, 14
 - b. Gjoni 15:16
 - c. Gjoni 16:23-24
 4. Lutja në Frymë
 - a. Efe. 6:18
 - b. Juda 20
- B. Në lidhje me motivet personale
 1. Pa u lëkundur
 - a. Mat. 21:22
 - b. Jakobi 1:6-7
 2. Kur lutesh gabim
Jakobi 4:3
 3. Lutja pa egoizëm
Jakobi 4:2-3

C. Në lidhje me zgjedhjet personale

1. Qëndresa
 - a. Luka 18:1-8
 - b. Kolosianëve 4:2
 - c. Jakobi 5:16
2. Mosmarrëveshjet në familje
1 Pjetrit 3:7
3. Mëkati
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Isaia 59:1-2

Të gjitha lutjet marrin përgjigje, por jo çdo lutje është e efektshme. Lutja është marrëdhënie me dy kahe. Gjëja më e keqe që mund të bënte Perëndia do të ishte t'iu përgjigjej lutjeve të papërshtatshme të besimtarëve. Shih Temën e Veçantë: Lutja Ndërmjetësuese në Kol. 4:3. Shih Temën e Veçantë: Lutja Ndërmjetësuese në 1 Gjonit 5:14. Skicën e gjeni te www.freebiblecommentary.org.

TEMË E VEÇANTË: EMRI I ZOTIT

Kjo ishte një frazë e zakonshme në DhR për praninë personale dhe fuqinë vepruese të Perëndisë triumfante. Nuk ishte formulë magjike, por thirrje për karakterin e Perëndisë.

Shpesh, kjo frazë i drejtohet Jezusit si Zot (shih Fil. 2:11)

1. në rrëfimin e besimit personal në Jezusin kur pagëzohesh (shih Rom. 10:9-13; Veprat 2:38; 8:12,16; 10:48; 19:5; 22:16; 1 Kor. 1:13,15; Jakobi 2:7)
2. në dëbimin e demonëve (shih Mat. 7:22; Marku 9:38; Luka 9:49; 10:17; Veprat 19:13)
3. në shërime (shih Veprat 3:6, 16; 4:10; 9:34; Jakobi 5:14)
4. në një veprim shërbese (shih Mat. 10:42; 18:5; Luka 9:48)
5. në kohën e disiplinës kishtare (shih Mat. 18:15-20)
6. gjatë predikimit ndër johebrenjtë (shih Luka 24:47; Veprat 9:15; 15:17; Rom. 1:5)
7. në lutje (shih Gjonit 14:13-14; 15:2,16; 16:23; 1 Kor. 1:2)
8. mënyrë për t'iu referuar krishterimit (shih Veprat 26:9; 1 Kor. 1:10; 2 Tim. 2:19; Jakobi 2:7; 1 Pjet. 4:14)

Çfarëdo gjë që bëjmë si shpallës, predikues, ndihmës, shërues, dëbues demonësh, etj., e bëjmë në karakterin, pushtetin dhe mbështetjen e tij – në Emër të tij!

■ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim të mundshëm.

■ **“më kërkoni çfarëdo gjëje”** Zakonisht, besimtarët nxiten që t'iu luten Atit në Frymë, përmes Birit. Ky varg është i vetmi varg në ungjillin e Gjonit ku Jezusi e drejton lutjen e besimtarëve drejt vetes.

Kjo mund të jetë arsyeja pse disa dorëshkrime të lashta greke nuk e përmbajnë fjalën “më” (p.sh., dorëshkrimet A, D, L dhe disa versione të vjetra latine, Vulgate, kopte, etiopiane dhe sllave). UBS⁴ i jep përfshirjes së kësaj fjale vlerësimin “B” (pothuajse sigurt). Ajo përfshihet në dorëshkrimet P⁶⁶, P⁷⁵, א, B, W dhe disa versione të vjetra latine, Vulgate dhe siriake).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:15-17

¹⁵“Nëse më doni, do të zbatoni urdhërimet e mia. ¹⁶Unë do t'iu lutem Atit, dhe ai do t'ju japë një Ndhimës tjetër, që të jetë me ju përjetë; ¹⁷ky është Fryma e së vërtetës, të cilin bota nuk mund ta marrë, pasi nuk e sheh atë dhe as nuk e njeh, por ju e njihni sepse ai banon me ju dhe do të jetë me ju”.

14:15 “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për një veprim të mundshëm. Dashuria për Perëndinë në Krishtin shprehet nëpërmjet bindjes. “Zbatoj” është DËFTORE E ARDHSHME VEPRORE e përdorur si URDHËRORE E TASHME (Friberg, *Analytical Greek New Testament*, f. 337). Bindja është tejet e rëndësishme (shih 8:51; 14:21, 23-24; 15:10; 1 Gjonit 2:3-5; 3:22, 24; 5:3; 2 Gjonit 6; Luka 6:46). Edhe vargjet 21, 23 dhe 24 theksojnë këtë të vërtetë. Bindja është dëshmi e kthimit të vërtetë në besim (shih Jakobi dhe 1 Gjonit).

NKJV ka URDHËROREN “zbatoni urdhërimet e mia”, që mbështetet nga dorëshkrimet A, D, W, Vulgata dhe shumë etër të kishës. UBS⁴ i jep DËFTORES SË ARDHSHME VEPRORE vlerësimin “C” (e vështirë për të vendosur), që mbështetet nga dorëshkrimet B, L dhe versioni koptik, si dhe nga disa etër të kishës.

14:16 “do t’ju japë” Shih shënimin në 14:26.



NASB, NKJV,

TEV “një Ndhmës tjetër”

NRSV “një Avokat tjetër”

NJB “një Paraklet tjetër”

Fjala “tjetër” përkthen një fjalë greke (*allos*) që do të thotë “një tjetër i të njëjtit lloj”. Fryma e Shenjtë është quajtur “Jezusi tjetër” (G. Campbell Morgan, shih Temën e Veçantë më poshtë).

Termi i dytë është fjala greke “*paraklētos*”, që përdoret për Jezusin në 1 Gjonit 2:1 (si ndërmjetës) dhe për Frymën e Shenjtë në Gjoni 14:26 dhe 16:7-14. Etimologjia e saj është “dikush që thirret përkrah për ndihmë”, në kuptimin ligjor. Si rrjedhojë, fjala “Avokat” e përkthen saktë këtë fjalë. Një formë e së njëjtës rrënjë në greqisht, “ngushëllim” (*parakalēo*), është përdorur për Atin në 2 Kor. 1:3-11.

Përkthimi i EMRIT “avokat” (*paraklētos*) vjen nga sistemi ligjor romak. Përkthimi “Ngushëllues” u përdor për herë të parë nga Uiklifi dhe pasqyron përdorimin e formës FOLJORE (*parakaleō*) në Septuagintë (p.sh., 2 Sam. 10:4; 1 Kro. 19:3; Jobi 16:2; Psa. 69:20; Pred. 4:1; Isa. 35:4). Mund të jetë ANTONIM i Satanit (akuzuesit).

Si Filoja, ashtu dhe Jozefusi, e përdorën këtë fjalë në kuptimin e “ndërmjetësuesit”, ose “këshilltarit”.

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA

Ekziston një rrjedhshmëri mes veprës së Frymës dhe asaj të Birit. G. Campbell Morgan tha se emri më i mirë për Frymën është “Jezusi tjetër” (sidoqoftë, ata janë persona të veçantë e të përbërshëm). Më poshtë vijon skica e krahasimit të veprës dhe titujve të Frymës dhe të Birit.

1. Fryma quhet “Fryma e Jezusit”, ose me shprehje të ngjashme (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11).
2. Të dy thirren me të njëjtat fjalë
 - a. “e vërteta”
 - 1) Jezusi (Gjoni 14:6)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:17; 16:13)
 - b. “avokati”
 - 1) Jezusi (1 Gjonit 2:1)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:16, 26; 15:26; 16:7)
 - c. “I Shenjtë”
 - 1) Jezusi (Marku 1:24; Luka 1:35; Veprat 3:14; 4:27, 30)
 - 2) Fryma (Luka 1:35; 4:34)
3. Të dy brendabanojnë besimtarët
 - a. Jezusi (Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
 - b. Fryma (Gjoni 14:16-17; Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
 - c. Ati (Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)

■ “që të jetë me ju përjetë” Tre parafjalë të ndryshme përdoren në lidhje me Frymën e Shenjtë.

1. “*meta*” (v. 16), “me”
2. “*para*” (v. 17), “përkrah”
3. “*en*” (v. 17), “në”

Vini re se Fryma e Shenjtë është me ne, përkrah nesh dhe brenda nesh. Detyra e tij është të shfaqë jetën e Jezusit në besimtarët. Ai do të qëndrojë me ta deri në fund të epokës (shih v. 18; Mat. 28:20).

Vini re se Fryma quhet “ai”. Kjo nënkupton se Fryma është personal. Shpesh, në KJV, për Frymën përdoret përemri jofrymor “it”, por kjo ndodh për shkak se fjala “frymë/shpirt” në greqisht është në gjininë ASNJANËSE (shih Gjoni 14:17, 26; 15:26). Ai është personi i tretë i Trinisë (shih Temën e Veçantë në 14:26).

Termi “Trini” nuk është biblik, por, nëse Jezusi është hyjnor dhe Fryma është person, atëherë bëhet fjalë për njëfarëlloj tri-uniteti. Perëndia është një esencë hyjnore, por tri shfaqje të përjetshme personale (shih Temën e Veçantë në 14:26; shih Mat. 3:16-17; 28:19; Veprat 2:33-34; Rom. 8:9-10; 1 Kor. 12:4-6; 2 Kor. 1:21-22; 13:14; Efe. 1:3-14; 2:18; 4:4-6; Titi 3:4-6; 1 Pjet. 1:2).

Për fjalën “përjetë” shih Temën e Veçantë në 6:58.

14:17 “Fryma e së vërtetës” “E vërteta” këtu ka të njëjtin kuptim si në v. 6 (shih 15:26; 16:13; 1 Gjonit 4:6). Shih Temën e Veçantë për të Vërtetën në 6:55 dhe 17:3. Ai është e kundërta e Satanit, babait të gënjeshtreve (shih 8:44).

▣ **“të cilin”** “Ky është ASNJANËS, që të përputhet me termin “frymë” (*pneuma*). Sidoqoftë, gjetkë, në greqisht, përdoret një PËREMËR MASHKULLOR (shih v. 26; 15:26; 16:7, 8, 13, 14). Fryma e Shenjtë s’është as mashkull, as femër. Ai është shpirt. Është e rëndësishme të mbajmë mend se ai është edhe person i veçantë (shih Temën e Veçantë në 14:26).

▣ **“bota nuk mund ta marrë”** Fryma e Shenjtë mund të përvetësohet vetëm prej atyre që kanë besim në Krishtin (shih 1:10-12). Ai siguron gjithçka që i nevojitet besimtarit (shih Rom. 8:1-11). Bota jobesimtare (*kosmos*, shih Temën e Veçantë më poshtë) nuk mund të kuptojë, as të vlerësojë, gjërat shpirtërore (shih 1 Kor. 2:14; 2 Kor. 4:4).

TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I *KOSMOS* (BOTË) NGA PALI

Pali përdor fjalën *kosmos* në një sërë mënyrash.

1. gjithë rendi i krijuar (shih Rom. 1:20; Efe. 1:4; 1 Kor. 3:22; 8:4,5)
2. ky planet (shih 2 Kor. 1:12; Efe. 1:10; Kol. 1:20; 1 Tim. 1:15; 3:16; 6:7)
3. njerëzit (shih 1 Kor. 1:27-28; 4:9,13; Rom. 3:6,19; 11:15; 2 Kor. 5:19; Kol. 1:6)
4. njerëzit, të organizuar dhe duke funksionuar veçmas Perëndisë (shih 1 Kor. 1:20-21; 2:12; 3:19; 11:32; Gal. 4:3; Efe. 2:2,12; Fil. 2:15; Kol. 2:8,20-24)
5. strukturat e tanishme të botës (shih 1 Kor. 7:29-31; Gal. 6:14, e ngjashme me Fil. 3:4-9, ku Pali përshkruan strukturat judaike).

Në disa mënyra, këto mbivendosen dhe është e vështirë të kategorizosh secilin përdorim të tyre. Kjo fjalë, ashtu si shumë të tjera në mendimin e Palit, duhen përcaktuar nga konteksti i atypëratyshëm dhe jo nga ndonjë përcaktim paraprak. Terminologjia e Palit është elastike (shih James Stewart, *A Man in Christ*). Ai nuk po përpiqej të formulonte një teologji sistematike, por të shpallte Krishtin. Kjo ndryshon gjithçka!

▣ **“njeh... njeh”** Kjo është ndoshta një rast tjetër dykuptimësie te Gjoni. Kuptimi hebraik ishte një marrëdhënie e ngushtë dhe personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). Kuptimi në greqisht do të ishte njohuria. Ungjilli është edhe personal, edhe njohës.

▣ **“ai banon me ju”** Banimi është koncept kyç në shkrimet e Gjonit (p.sh., kapitulli 15; shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 2:10). Ati banon në Birin, Fryma banon në besimtarët, ndërsa besimtarët banojnë në Birin. Ky banim është në KOHËN E TASHMË, jo një vendim i izoluar apo reagim emocional.

▣ **“dhe do të jetë me ju”** Kjo mund të kuptohet si “ndër ju” (SHUMËS, shih shënimin në fund të faqes te NRSV), ose “në ju” (SHUMËS, shih NASB, NKJV, NRSV, TEV & NJB). Brendabanimi i besimtarit nga Perëndia është një premtim i mrekullueshëm. DhR pohon se të tre Personat e Trinisë brendabanojnë besimtarin.

1. Jezusi (Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
2. Fryma (Gjoni 14:16-17; Rom. 8:11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
3. Ati (Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:18-24

¹⁸“Nuk do t’ju lë si jetimë; do të kthehem te ju. ¹⁹Pas pak, bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni; për shkak se unë jetoj, edhe ju do të jetoni. ²⁰Atë ditë, do të dini se unë jam në Atin, dhe ju në mua, si dhe unë në ju. ²¹Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton është ai që më do; dhe ai që më do mua do të ketë dashurinë e Atit tim, dhe unë do ta dua e do t’i zbulohem”. ²²Juda (jo Iskarioti) i tha: “Zot, po çfarë ka ndodhur që do të na zbulohesh vetëm neve, dhe jo botës?” ²³Jezusi u përgjigj dhe i tha: “Nëse dikush më do, do të zbatojë fjalën time; dhe Ati im do ta dojë, dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të vendosim banesën tonë me të. ²⁴Ai që s’më do, nuk i zbaton fjalët e mia; dhe fjala që dëgjoni nuk është e imja, por e Atit që më dërgoi”.

14:18 “Nuk do t’ju lë si jetimë; do të kthehem te ju” Jezusi përmbushi çdo premtim që u dha dishepujve darkën e së dielës pas Pashkës, kur iu shfaq për herë të parë pas ringjalljes në dhomën e sipërme (shih 20:19-31). Mirëpo disa komentues mendojnë se ky kontekst bën fjalë për ardhjen e Frymës ditën e Rrëshajave (Veprat 2), ose për ardhjen e dytë të Krishtit (shih v. 3).

14:19 “Pas pak, bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni” Vargu 20 tregon se kjo bën fjalë për shfaqjet e Jezusit pas ringjalljes. Nga kjo thënie merr shkas Juda në v. 22, kur i bën Jezusit një pyetje tjetër. Dishepujt ende po prisnin që ai të vendoste Mbretërinë Mesianike në tokë (shih Mat. 20:20-28; Marku 10:35-45) dhe u përshtjelluan së tepërmi kur ai u tha: “bota nuk do të më shohë”. Përgjigjja e Jezusit për pyetjen e Judës (jo Iskariotit) në v. 23 dhe 24 ishte se ai do të shfaqet në jetën e të krishterëve si individë dhe, në këtë mënyrë, bota do të shohë Jezusin përmes tyre!

▣ **“për shkak se unë jetoj, edhe ju do të jetoni”** Ringjallja e Jezusit ishte demonstrim i pushtetit dhe gatishmërisë së Perëndisë për të dhënë jetë (shih Rom. 8:9-11; 1 Kor. 15:20-23, 50-58).

14:20 “Atë ditë” Zakonisht, kjo frazë përdoret në kuptimin eskatologjik (shih Temën e Veçantë më poshtë), por këtu ndoshta bën fjalë për shfaqjet e Jezusit pas ringjalljes, ose për ardhjen e plotësisë së Frymës ditën e Rrëshajave.

TEMË E VEÇANTË: ATË DITË

Kjo frazë, “atë ditë”, ose “në atë ditë”, është mënyra sesi profetët e shekullit të tetë para Krishtit flisnin për vizitimin (praninë) e Perëndisë, si për gjykim, ashtu dhe për rimëkëmbje.

Osea		Amosi		Mikea	
pozitive	negative	pozitive	negative	pozitive	negative
1:11	1:5		1:14 (2)		2:4
	2:3		2:16		3:6
2:15			3:14	4:6	
2:16			5:18 (2)		5:10
2:21			5:20		7:4
	5:9		6:3	7:11(2)	
	7:5		8:3	7:12	
	9:5		8:9(2)		
	10:14		8:10		
		9:11	8:13		

Ky model është tipik për profetët. Perëndia do të veprojë kundër mëkatit në kohën e duhur, por ai ofron edhe një ditë pendimi dhe faljeje për ata që ndryshojnë zemrën dhe veprimet! Synimi i shpengimit dhe rimëkëmbjes së Perëndisë do të përmbushet! Ai do të ketë një popull që pasqyron karakterin e tij. Synimi i krijimit (bashkësia mes Perëndisë dhe njerëzimit) ka për t’u përmbushur!

▣ **“do të dini”** Shpesh, “di” ka kuptimin hebraik të bashkësisë personale, marrëdhënies së ngushtë, por, këtu, ndiqet nga “se” (*hoti*), që qartëson përmbajtjen njohëse. Kjo fjalë, ashtu si “besoj”, ka kuptim të dyfishtë. Gjoni zgjedh këto lloj fjalësh për të shprehur ungjillin. Besimtarët e njohin atë (besojnë në të), por, gjithashtu, dinë të vërteta për të (besojnë se). Shih Temën e Veçantë në 2:23.

■ **“unë jam në Atin, dhe ju në mua, ashtu si dhe unë në ju”** Shpesh, Gjoni thekson unitetin e Jezusit me Atin (shih 10:38; 14:10-11; 17:21-23). Ai shton të vërtetën se, ashtu si Ati dhe Jezusi janë të lidhur ngushtë, kështu janë të lidhur dhe Jezusi me ndjekësit e vet (shih Gjoni 17)!

14:21 “Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton” Këto janë dy PJESORE TË TASHME. Bindja është kyçe (shih shënimin në v. 15). Kjo është prova e kthimit të vërtetë në besim (shih v. 23).

Apostujt ishin judenj dhe, shpesh, përdornin terminologji semitike në shkrimet e tyre. Lutja judaike që fillon çdo kohë adhurimi ishte LiP. 6:4-5, e quajtur *shema*, që donte të thoshte “dëgjoj në mënyrë që të bëj”! Kjo ishte ideja e komentit të Gjoni (shih Jakobi 2:14-26).

■ **“dhe do t’i zbulohem”** Kjo bën fjalë, ose për (1) shfaqjet pas ringjalljes (shih Veprat 10:4-41), ose (2) për dërgimin e Frymës së Shenjtë për të zbuluar dhe formuar Krishtin në besimtarët (shih v. 26; Rom. 8:29; Gal. 4:19).

■ Jezusi besonte dhe pohonte se (1) përfaqësonte Atin; (2) fliste në emër të tij; dhe (3) zbulonte Atin. Për besimtarët, kjo fjalë e autoritetshme e thënë nga Jezusi dhe e regjistruar nga shkruarit apostolikë është i vetmi burim informacioni i qartë për Perëndinë dhe për synimet e tij. Besimtarët pohojnë se autoriteti i Jezusit dhe Shkrimit (i interpretuar drejt) janë autoriteti absolut: arsyeja, përvoja dhe tradita janë të dobishme, por jo përfundimtare.

Ekziston elasticitet mes punës së Frymës dhe asaj të Birit. G. Campbell Morgan tha se emri më i mirë për Frymën është “Jezusi tjetër”. Shih Temën e Veçantë në 14:16.

14:22 Shih shënimin në vargun 19.

■ **“Juda (jo Iskarioti)”** Ky ishte emri tjetër i Tadeut (shih Mat. 10:3; Marku 3:18). Shih Temën e Veçantë në 1:45.

14:23 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për vendim të mundshëm. Dashuria e dishepujve për Jezusin do të shihet në dashurinë e tyre për njëri-tjetrin (shih v. 15, 21).

14:24 “[ju] dëgjoni” Pyetja ekzegjetike është: “Kujt i drejtohet përemri i nënkuptuar „ju”?” Gramatikisht, PËREMRI është brenda FOLJES “dëgjoj” (DËFTORE E TASHME VEPRORE, VETA E DYTË SHUMËS). Ajo mund t’u drejtohet

1. njerëzve të botës që mohojnë mesazhin e Jezusit
2. dishepujve, kur ata pranojnë fjalët e Jezusit si vetë fjalët e Atit (shih v. 10-11).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:25-31

²⁵“Këto gjëra jua kam thënë për sa kohë që banoj me ju. ²⁶Por Ndhimuesi, Fryma e Shenjtë, të cilin Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë të gjitha gjërat dhe do t’ju sjellë në kujtesë gjithçka që ju kam thënë. ²⁷Po ju lë paqen; po ju jap paqen time; nuk po ju lë atë që jep bota. Zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë. ²⁸Dëgjuat se ju thashë: „unë po largohem dhe do të kthehem për ju”. Po të më donit, do të gëzoheshit sepse po shkoj tek Ati, sepse Ati është më i madh se unë. ²⁹Dhe jua kam thënë këtë përpara se të ndodhë, në mënyrë që, kur të ndodhë, të besoni. ³⁰Nuk do të flas më tepër me ju, pasi sundimtari i kësaj bote po vjen dhe nuk ka asgjë në mua; ³¹por, që bota të dijë se unë e dua Atin, bëj pikërisht ashtu siç më ka urdhëruar Ati. Ngrihuni, le të largohemi prej këtej”.

14:25 “Këto gjëra” Këtu bëhet fjalë për mësimet në dhomën e sipërme (kap. 13-17, por formulohet në mënyrë të veçantë në v. 15:11; 16:1, 4, 6, 25, 33).

14:26 “Fryma e Shenjtë” Ky titull për personin e tretë të Trinisë shfaqet vetëm në 1:33; 20:22, si dhe këtu te Gjoni (shih Temën e Veçantë: I Shenjti, në 1 Gjoni 2:20). Sidoqoftë, ai thirret dhe me disa emra të tjerë në ungjillin e Gjoni (Parakleti, Fryma e së Vërtetës, Fryma).

Ka një sërë pasazhesh në DhR që i drejtohen Frymës si person (shih Marku 3:29; Luka 12:12; Gjoni 14:26; 15:26; 16:7-15, shih Temën e Veçantë më poshtë). Ka dhe pasazhe të tjera ku për Frymën përdoret

PËREMRI ASNJANËS pasi fjala greqisht shpirt/frymë (*pneuma*) është në gjininë ASNJANËSE (shih 14:17; Rom. 8:26).

Po kështu, në këtë pikë dua të them shkurtimisht diçka për konceptin e Trinisë. Termi “trini” nuk është fjalë biblike, por, në një sërë pasazhesh, tre shfaqjet personale të Perëndisë së vetëm dhe të vërtetë shihen së bashku (shih Temën e Veçantë më poshtë). Nëse Jezusi është hyjnor dhe Fryma është person, atëherë, teologjikisht, si monoteistë (shih LiP. 6:4-6), jemi të detyruar të pranojmë një tri-unitet – jo tre shfaqje hyjnore njëra pas tjetrës, por tre persona të përjetshëm!

TEMË E VEÇANTË: TRINIA

Vini re veprimtarinë e të tre Personave të Trinisë në kontekste të bashkuara. Termi “trini”, i shpikur së pari nga Tertuliani, nuk është fjalë biblike, por koncepti i saj shfaqet kudo.

- A. Ungjijtë
 - 1. Mat. 3:16-17; 28:19 (dhe paralelet e saj)
 - 2. Gjoni 14:26
- B. Veprat – Veprat 2:32-33 38-39
- C. Pali
 - 1. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10
 - 2. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
 - 3. 2 Kor. 1:21-22; 13:14
 - 4. Gal. 4:4-6
 - 5. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4-6
 - 6. 1 Thes. 1:2-5
 - 7. 2 Thes. 2:13
 - 8. Titi 3:4-6
- D. 1 Pjet. 1:2
- E. Juda – v. 20-21

Në DhV, aludohet për një shumësi personash në Perëndinë.

- A. Përdorimi i SHUMËSIT për Perëndinë
 - 1. Emri *Elohim* është SHUMËS, por kur përdoret për Perëndinë ka gjithmonë një FOLJE në NJËJËS
 - 2. “Ne” te Zanafilla 1:26-27; 3:22; 11:7
- B. Engjëlli i Zotit ishte përfaqësues i dukshëm i Hyjnisë
 - 1. Zanafilla 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16
 - 2. Eksodi 3:2,4; 13:21; 14:19
 - 3. Gjyqtarët 2:1; 6:22-23; 13:3-22
 - 4. Zakaria 3:1-2
- C. Perëndia dhe Fryma e tij janë të pandashëm, Zan. 1:1-2; Ps. 104:30; Isa. 63:9-11; Ezek. 37:13-14
- D. Perëndia (JHVH) dhe Mesia (*Adon*) janë të veçantë, Psa. 45:6-7; 110:1; Zak. 2:8-11; 10:9-12
- E. Mesia dhe Fryma janë të veçantë, Zak. 12:10
- F. Të tre përmenden te Isa. 48:16; 61:1

Natyra hyjnore e Jezusit dhe personaliteti i Frymës shkaktonin probleme për besimtarët e hershëm që ishin monoteistë të rreptë.

- 1. Tertuliani – ia nënshtroi Birin Atit
- 2. Origeni – nënshtroi esencën hyjnore të Birit dhe të Frymës
- 3. Ari – mohoi natyrën hyjnore të Birit dhe të Frymës
- 4. Monarkianizmi – besonte në shfaqjen e njëpasnjëshme të njëjtit Perëndi si Atë, si Bir dhe, pastaj, si Frymë

Trinia është një formulim i zhvilluar nga ana historike, por i informuar nga materiali biblike

- 1. Natyra e plotë hyjnore e Jezusit, i barabartë me Atin, gjë që u pohua në 325 pas K. nga Këshilli i Nikesë
- 2. Personaliteti dhe natyra e plotë hyjnore e Frymës, i barabartë me Atin dhe me Birin, u pohua nga Këshilli i Kostandinopojës (381 pas K.)
- 3. Doktrina e Trinisë shprehet në mënyrë të plotë në veprën e Augustinit *De Trinitate*

Këtu kemi vërtet një mister. Por DhR duket se pohon një esencë të vetme hyjnore me tre shfaqje të përjetshme personale.

■ **“të cilin Ati do ta dërgojë”** Pati një polemikë të jashtëzakonshme në kishën e hershme (në shekullin e katërt) për faktin nëse Fryma erdhi prej Atit (shih Gjoni 3:34; 14:16; 16:26), apo prej Birit (shih Gjoni 15:26; 16:7; Luka 24:49; Veprat 2:33). Çështja teologjike në debatin mes Arit dhe Athanasit ishte natyrë e plotë dhe e përjetshme hyjnore e Birit, dhe barazia mes Perëndisë Atë dhe Jezusit Bir.

■ **“do t’ju mësojë të gjitha gjërat”** Kjo duhet cilësuar. Fryma nuk i mëson besimtarët në të gjitha fushat e njohurisë, por për të vërtetën shpirtërore, sidomos në marrëdhënie me personin dhe veprën e Jezusit, dhe ungjillin (shih 16:13-14; 1 Gjonit 2:20, 27).

TEMË E VEÇANTË: PERSONALITETI I FRYMËS

Në DhV, “Fryma e Perëndisë” (pra, *ruash*) ishte një forcë që përmbushte synimin e JHVH-së, por nuk na aludohet se ai ishte person (pra, në monoteizmin e DhV). Mirëpo, në DhR, dokumentohet personaliteti i plotë i Frymës.

1. Ai mund të shahet (shih Mat. 12:31; Marku 3:29)
2. Mëson të tjerët (shih Luka 12:12; Gjoni 14:26)
3. Dëshmon (shih Gjoni 15:26)
4. Bind, drejton (shih Gjoni 16:7-15)
5. Quhet “dikush” (pra, *hos*, Efe. 1:14)
6. Mund të brengoset (shih Efe. 4:30)
7. Mund të shuhet (shih 1 Thes. 5:19)

Edhe pasazhet trinitare flasin për tre persona.

1. Mat. 28:19
2. 2 Kor. 13:14
3. 1 Pjet. 1:2

Fryma lidhet me veprimtarinë njerëzore.

1. Veprat 15:28
2. Rom. 8:26
3. 1 Kor. 12:1
4. Efe. 4:30

Roli i Frymës theksohet që në fillim të Veprave. Dita e Rrëshajave nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Jezusi kishte gjithmonë Frymën. Pagëzimi i tij nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Luka e përgatit kishën për një kapitull të ri shërbese të efektshme. Jezusi është ende fokusi, fryma është ende mjeti i efektshëm dhe synimi është dashuria, falja e Atit dhe rimëkëmbja e gjithë njerëzve të krijuar në shëmbëllimin e tij!

■ **“dhe do t’ju sjellë në kujtesë gjithçka që ju kam thënë”** Synimet e Frymës janë

1. të bindë njerëzit për mëkat
2. t’i sjellë te Krishti
3. t’i pagëzojë në Krishtin
4. të formojë Krishtin në ta (shih 16:7-15)
5. të ndihmojë apostujt që t’u kujtohen të gjitha gjërat që u kishte thënë Jezusi dhe t’u qartësojë kuptimin në mënyrë që t’i hedhin në Shkrim (shih 2:22; 15:26; 16:13)

Edhe Jezusi vetë i udhëzoi apostujt pas ringjalljes, sidomos për mënyrën sesi DhV dëfton drejt tij dhe përmbushet në të (shih Luka 24:13 e më tej).

14:27 “Po ju lë paqen; po ju jap paqen time” Paqja e besimtarëve nuk lidhet me situatat, por me një qetësi që bazohet në premtimet dhe praninë e Jezusit (shih 16:33; Fil. 4:7; Kol. 3:15).

“Paqja” përdoret edhe në kuptimin objektiv, pra, si rimëkëmbja e lidhjes me Perëndinë, edhe në kuptimin subjektiv, si një ndjesi sigurie ose stabiliteti në situata të vështira. Ajo pasqyron përshëndetjen judaike, *Shalom*, që nënkuptonte mungesën e problemeve dhe praninë e kënaqësisë (shih 20:19, 21, 26; 3 Gjonit 14; Efe. 2:14; Num. 6:26; Psa. 29:11; Isa. 9:6). Ajo karakterizon epokën e re!

TEMË E VEÇANTË: I KRISHTERI DHE PAQJA

Në fillim, kjo fjalë në greqisht kishte kuptimin “lidh atë që ishte thyer”. Ka tre mënyra sesi flet për paqen DhR:

1. si aspekt objektiv i paqes sonë me Perëndinë përmes Krishtit (shih Kol. 1:20)
2. si aspekt subjektiv i marrëdhënies sonë të drejtë me Perëndinë (shih Gjoni 14:27; 16:33; Fil. 4:7)
3. se Perëndia ka bashkuar në një trup të vetëm, përmes Krishtit, si judenjtë ashtu johebrenjtë besimtarë (shih Efe. 2:14-17; Kol. 3:15).

Newman dhe Nida, *A Translator's Handbook on Paul's Letter to the Romans* [*Manual i përkthyesit për letrën e Palit drejtuar Romakëve*], f. 92, japin një koment me vend për “paqen”.

“Si në Dhiatën e Vjetër, ashtu dhe në atë të Re, fjala „paqe“ ka një gamë të gjerë kuptimore. Në thelb, ajo përshkruan mirëqenien e plotë të jetës së individit; madje, judenjtë e përshtatën edhe si formulë përshëndetjeje. Kjo fjalë ka një kuptim kaq të thellë saqë judenjtë e përdornin edhe si përshkrim të shpëtimit mesianik. Për shkak të këtij fakti, ka vende ku ajo përdoret pothuajse si sinonimike me kuptimin „të jesh në marrëdhënien e duhur me Perëndinë“. Këtu, kjo fjalë duket se përdoret si përshkrim i marrëdhënies harmonike të krijuar mes njeriut dhe Perëndisë në bazë të faktit se Perëndia e ka vendosur njeriun në marrëdhënie të duhur me të” (f. 92).

■ **“Ië”** Grant Osborne, *The Hermeneutical Spiral* [*Spiralja hermeneutike*] (f. 21) bën një koment të shkëlqyer për përparësinë e kontekstit në përcaktimin e kuptimit të fjalëve.

“Konteksti logjik

Në një kuptim shumë të vërtetë, konteksti logjik është faktori më bazë në interpretim. Studentëve në kurset e mia u them se, nëse dikush është gjysmë i përgjumur dhe nuk dëgjon një pyetje që i bëj unë, ekziston 50% mundësia që të jetë i saktë nëse më përgjigjet: “Konteksti!”. Vetë kjo fjalë mbulon një gamë të stërmadhe ndikimesh mbi tekstin. Këto mund të diagramohen më së miri si një sërë rrathësh bashkëqendrorë që lëvizin jashtë me pikënisje nga pasazhi.

Kur i afrohem më tepër qendrës, ndikimi të kuptimi i pasazhi rritet. Për shembull, gjinia letrare identifikon llojin e letërsisë dhe ndihmon interpretuesin që të identifikojë paralelizmat, por këto nuk janë aq ndikuese të pasazhi sa pjesa tjetre shkrimit. Për shembull, librin e Zbulesës mund ta identifikojmë si apokaliptik; mirëpo, ndonëse apokaliptika ndërthjatore dhe ajo helenistike na sigurojnë paralele të rëndësishme, shumica e simboleve janë marrë nga Dhiata e Vjetër. Në anën tjetër të peshores, konteksti i atypëratyshëm është gjyqtari përfundimtar për të gjitha vendimet që lidhen me kuptimin e një termi ose koncepti të caktuar. Nuk ka garanci se Pali e përdor një fjalë të Filipianët 2, njësoj siç e përdori të Filipianët 1. Gjuha thjesht nuk funksionon në atë mënyrë, pasi çdo fjalë ka shumë kuptime dhe përdorimi i shkrimtarit varet nga konteksti i momentit dhe jo nga përdorimi që i ka bërë autori asaj fjale në kontekste të mëparshme. Një shembull i mirë do të ishte përdorimi i *afimi* të Gjoni 14:27: “Paqen po ju *lë*”, dhe të 16:28: “po e *lë* sërish botën”. Zor se do ta interpretonim njërin fjalë me tjetrën, pasi përdorimi i tyre është plotësisht i kundërt. Në rastin e parë, Jezusi u jep diçka dishepujve, ndërsa, në të dytin, ai u heq diçka tyre (veten e tij!). Dhe as që bëhet fjalë që në këtë term të shihnim kuptimin e tij të zakonshëm “falje” (si të 1 Gjoni 1:9). Pasazhet e tjera na ndihmojnë që të përcaktojmë gamën semantike (gjërat e ndryshme që mund të nënkuptojë fjala), por vetëm konteksti i atypëratyshëm mund t’i ngushtojë mundësitë për të piketuar kuptimin real” (f. 21).

■ **“Zemra juaj mos u tronditë”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME PËSORE me një PJESËZ MOHORE që, zakonisht, do të thotë: “ndalimi i një veprimi tashmë në kryerje e sipër”, përsëritje e v. 1.

14:28 “Po të më donit” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, si v. 7, që quhet “në kundërshtim me faktet”. Do të jetë më mirë nëse Jezusi shkon tek Ati dhe u dërgon Frymën, por, sigurisht, ata nuk e kuptojnë tani këtë.

■ **“sepse Ati është më i madh se unë”** Ky pohim nuk përqendrohet në pabarazinë e Birit, por është një thënie që trajton funksionet brenda Trinisë në lidhje me shpëtimit e njerëzimit (shih 10:29-30). Ky nënshtrim i Birit ishte vetëm për një periudhë kohore, gjatë qëndrimit të tij në tokë për të përmbushur planin e zbulesës dhe shpengimit të Perëndisë Triun (shih 17:4-5; Fil. 2:6-11). Gjithsesi, në njëfarë kuptimi, Ati, si dërgues, është parësor (shih 13:16; 1 Kor. 15:27-28; Efe. 1:3-14).

14:29 “Dhe jua kam thënë këtë përpara se të ndodhë” Kjo ndodhi në mënyrë që besimi i tyre të forcohej (shih 13:19; 16:4).

14:30

NASB “sundimtari i kësaj bote”

NKJV, NRSV,

TEV, “sundimtari i kësaj bote”

NJB “princi i kësaj bote”

Bëhet fjalë për Satanin, sfera e veprimtarisë së të cilit tani është toka (shih 12:31; 16:11; 2 Kor. 4:4, “perëndia i kësaj bote”; Efe. 2:2, “princi i pushtetit të erës”). Ka gjasa që Jezusi e pa largimin e Judës si ardhje të Satanit (shih 13:27). Shih Temën e Veçantë në 12:31.

▣

NASB, NKJV “nuk ka asgjë në mua”

NRSV, TEV,

NJB “nuk ka pushtet mbi mua”

Kuptimi është se Satani nuk ka asnjë bazë për akuza, asnjë pushtet mbi Jezusin, dhe kurrfarë gjëje të përbashkët me të (shih Heb. 4:15).

1. James Moffatt e përktheu: “ai nuk ka ndikim te unë”
2. William F. Beck: “nuk ka autoritet mbi mua”
3. New English Bible: “nuk ka të drejta mbi mua”
4. The Twentieth Century New Testament: “asgjë të përbashkët me mua”

14:31 “por që bota të dijë” Satani është në vullnetin e Perëndisë dhe po instrumentalizohet për synimin përfundimtar të Perëndisë në shpengimin e njerëzimit. Shih A. B. Davidson, *The Theology of the Old Testament [Teologjia e Dhiatës së Vjetër]*, f. 300-306.

▣ **“Unë bëj pikërisht ashtu siç më ka urdhëruar Ati”** Ishte vullneti i Atit që Jezusi të vdiste (shih Isa. 53:10a,b; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). Shih Temën e Veçantë: Përdorimi i “Urdhërimit” në Shkrimet e Gjonit, në 12:50.

▣ **“Ngrihuni, le të largohemi prej këtej”** Kjo është URDHËRORE E TASHME MESORE. Është një frazë shumë e vështirë pasi shfaqet te Mateu dhe te Marku në kopshtin e Gjetsemanit kur Juda dhe grupi i policëve i afrohen Jezusit. Pse saktësisht përdoret në këtë kontekst në dhomën e sipërme (kapitujt 13-17) është e paqartë. Ka gjasa që Jezusi me dishepujt ishin larguar nga Dhoma e Sipërme dhe po i mësonte gjatë rrugës për në Gjetseman (shih 18:1).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Shpjego dallimin mes teizmit, deizmit dhe krishterimit në bazë të vargut 1.
2. Shpjego sfondin e DhV të tre emrave që gjenden në vargun 6.
3. A mund të ndërtojmë një teologji lutjeje duke u bazuar vetëm në vargun 13?
4. Cili është qëllimi kryesor i Frymës së Shenjtë? (si për të humburit, ashtu dhe për të shpëtuarit)
5. A është Satani në vullnetin e Perëndisë?

GJONI 15

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi, hardhia e vërtetë	Hardhia e vërtetë	Modeli i jetës së besimtarit të krishterë	Jezusi, hardhia e vërtetë	Hardhia e vërtetë
15:1-10	15:1-8 Përsosja e dashurisë dhe gëzimit 15:9-17	15:1-11	15:1-4 15:5-10	15:1-17
15:11-17		15:12-17	15:11-17	
Urrejta e botës	Urrejta e botës		Urrejta e botës	Dishepujt dhe bota 15:18-16:4a
15:18-25	15:18-25 Refuzimi i ardhshëm	15:18-25	15:18-25	
15:26-16:4a	15:26-16:4	15:26-27	15:26-16:4a	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË GJONIT 15:1-27

- A. Ky është një pasazh i mahnitshëm, por edhe shqetësues! Ai u jep besimtarëve inkurajim të madh për dashurinë e Perëndisë, si dhe premtimin e efektshmërisë, por përmban dhe paralajmërim të rënda! Traditat teologjike janë shumë të vështira për t'u diskutuar në këtë pikë; më lejoni të citoj një nga komentuesit e mi të preferuar, F. F. Bruce, në librin e tij *Answers to Questions* (Përgjigje për pyetje).

“Gjoni 15:4, 6. „Çfarë nënkuptohet me shprehjet “nëse nuk banoni” dhe “nëse dikush nuk banon” në Gjoni 15:4, 6? A është e mundur të mos banosh në Krishtin?”

Pasazhet e tilla nuk janë të vështira në vetvete; vështirësia del në pah kur përpiqemi t'i përputhim (bashkë me vargje të tjera) me teologjinë tonë, në vend që t'i përdorim si bazë për teologjinë. Pikërisht në kohën kur Zoti ynë po fliste, ekzistonte një shembull i hapur i një njeriu që nuk arriti të banonte në të – Juda Iskarioti, i cili sapo ishte larguar prej tyre. Juda ishte zgjedhur njësoj si njëmbëdhjetë kolegët e vet (Luka 6:13; Gjoni 6:70); lidhja e tyre me Zotin nuk u kishte dhënë asnjë privilegj më tepër nga ai që i ishte vënë në dispozicion Judës. Pasazhet e qarta të Shkrimit që mësojnë qëndresën përfundimtare të shenjtorëve nuk duhen përdorur si shfajësim për të zbutur pasazhet po aq të qarta që flasin për rrezikun e femohimit” (f. 71-72).

- B. Është e habitshme sa KOHË AORISTE përdoren në këtë kontekst, aty ku, nga ana teologjike, do të prisnim KOHËN E TASHME. AORISTET duket se përdorin në kuptimin e përmbledhjes së gjithë jetës së njeriut dhe shqyrtimit të saj si një e tërë.
- C. Ndarjet e paragrafëve në kapitullin 15 janë të paqarta. Gjoni, njësoj si 1 Gjonit, është tapiceri me ngjyra të ndryshme. Motivet shfaqen në mënyrë të përsëritur.
- D. Termi “banoj/qëndroj” (*menō*) përdoret rreth 112 herë në DhR. Dyzet herë shfaqet në ungjillin e Gjonit dhe 26 herë në letrat e tij. Kjo është fjalë kryesore teologjike te Gjoni. Ndonëse kapitulli 15 është shprehje klasike e porosisë së Jezusit që të banojmë në të, kjo fjalë ka fokus më të gjerë te Gjoni.
1. Ligji qëndron përjetë (Mat. 5:17-18); kështu dhe Krishti (12:34)
 2. Libri i Hebrenjve dëfton drejt një mënyre të re zbuluese, jo përmes një shërbëtori, por përmes një Biri që qëndron përjetë (Heb. 1:1-3, kështu dhe Gjoni 8:35)
 3. Jezusi thuhet se siguron ushqimin që qëndron (6:27) dhe prodhon fryte të qëndrueshme (15:16). Të dyja këto metafora shprehin të njëjtën të vërtetë, nevojën tonë për Krishtin, si (1) fillimisht, ashtu dhe (2) vazhdimisht (shih 6:53)
 4. Gjon Pagëzori pa Frymën të zbriste dhe të qëndronte mbi Jezusin në çastin e pagëzimit (1:32)
- E. Shih Temën e Veçantë: Banoj në 1 Gjonin 2:10.
- F. Në vargjet 11-16, dishepujve u premtohet gëzimi i Jezusit, ndërsa në vargjet 17-27, dishepujve u premtohet përndjekja e Jezusit. Konteksti i përndjekjes përshkon gjithë këtë pjesë deri te 16:4a. Sidoqoftë, në gjithçka, besimtarët duhet të duan njëri-tjetrin ashtu siç i deshi Jezusi!

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:1-11

¹“Unë jam hardhia e vërtetë, dhe Ati im është vreshtari. ²Çdo degë në mua që nuk jep fryt, ai e heq; dhe çdo degë që jep fryt, ai e krasit që të japë edhe më shumë fryt. ³Ju jeni të pastër tashmë për shkak të fjalës që ju kam thënë. ⁴Qëndroni në mua, dhe unë në ju. Ashtu si dega nuk jep dot fryt nga vetja, nëse nuk qëndron në hardhi, ashtu as ju, nëse nuk qëndroni në mua. ⁵Unë jam hardhia, ju jeni degët; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni dot asgjë. ⁶Nëse dikush nuk qëndron në mua, flaket jashtë si degë dhe thahet; pastaj, i mbledhin, i flakin në zjarr dhe digjen. ⁷Nëse qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të dëshironi dhe do t’ju bëhet. ⁸Nga kjo përlëvdohet Ati im: që të jepni shumë fryt dhe të provoni se jeni dishepujt e mi. ⁹Ashtu si Ati im më ka dashur, kështu ju kam dashur dhe unë; qëndroni në dashurinë time. ¹⁰Nëse zbatoni urdhërimet e mia, do të qëndroni në dashurinë time; ashtu siç kam zbatuar dhe unë urdhërimet e Atit tim dhe qëndroj në dashurinë e tij. ¹¹Këto gjëra jua kam thënë që gëzimi im të jetë në ju, dhe që gëzimi juaj të jetë i plotë.

15:1 “Unë jam hardhia e vërtetë” Kjo është një nga pohimet e famshme “unë jam” të Jezusit në ungjillin e Gjonit (shih 4:26; 6:35; 8:12; 10:7,9,10,11,14; 11:25; 14:6). Në DhV, hardhia ishte simbol i Izraelit (Psa. 80:8-16; Isa. 5:1-7; Jer. 2:21; Ezek. 15; 19:10; Osea 10:1; Mat. 21:33 e më tej; Marku 12:1-12, Rom. 11:17 e më tej). Në DhV, këta shembuj kanë gjithmonë ngjyrim negativ. Jezusi pohon se ai ishte Izraeliti Ideal (shih Isaia 53). Ashtu si Pali përdori trupin e Krishtit, nusen e Krishtit, dhe ndërtesën e Perëndisë si metafora për kishë, Gjoni përdori hardhinë. Kjo nënkupton se kisha është Izraeli i vërtetë për shkak të marrëdhënies së saj me Jezusin, hardhinë e vërtetë (shih Gal. 6:16; 1 Pjet. 2:5, 9; Zbu. 1:6). Shih Temën e Veçantë në 6:55 dhe 17:3. Shih shënimin në 8:12.

Disa interpretues janë shprehur se ligjërata në dhomën e sipërme përfundon në 14:31, “le të ikim prej këtej”. Nëse është kështu, atëherë kapitujt 15-17 u shprehën gjatë rrugës për në Gjetseman. Sërish, nëse është kështu, ka gjasa që metafora e “hardhisë” të ketë qenë shenjë vizuale e marrë nga hardhitë e florinjta të ndërtesave të tempullit ndërsa Jezusit me të njëmbëdhjetët përshkonin oborret e tij atë natë.

■ **“dhe Ati im është vreshtari”** Sërish, Jezusi pohon marrëdhënien e tij të ngushtë me Atin dhe, në të njëjtën kohë, nënshkrimin e tij ndaj vullnetit të Atit.

15:2 “Çdo degë në mua që nuk jep fryt, ai e heq... që jep fryt” PJESORJA E TASHME PËSORE shfaqet dy herë në këtë varg. Prova e shpëtimit është prodhimi i fryteve, jo rritja e bimës (shih Mat. 7:16, 20; 13:18 e më tej; 21:18-22; Luka 6:43-45). Konteksti lë të kuptohet se Jezusi po fliste (1) për tradhtinë e Judës (shih v. 6; 13:10; 17:12), ose (2) për dishepujt e rremë (shih 2:23-25; 8:30-47; 1 Gjonit 2:19; 2 Pjetrit 2). Ka nivele të ndryshme besimi te Gjoni.

■ **“ai e krasit”** Fjalë për fjalë, “pastron”. Kjo fjalë u përdor nga Filoja për krasitjen e vreshtave (BDB 386). Gjendet vetëm këtu në DhR. Ajo është një tjetër fjalë që zgjedh Gjoni për shkak të kuptimit të saj të dyfishtë (pra, krasitja dhe pastrimi, shih v. 3; 13:10). Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Vuajtja ka synim në jetën e besimtarëve (shih v. 17-22). Ai maksimizon prodhimin e frytit, nxjerr në shesh besimtarët e rremë dhe i mban besimtarët të varur nga Perëndia (shih Mat. 13:20-23; Rom. 8:17; 1 Pjet. 4:12-16). Dy libra të mirë dhe praktikë për këtë temë të vështirë janë (1) *Principles of Spiritual Growth (Parime të rritjes shpirtërore)* nga Miles Stanford dhe (2) *The Christian’s Secret of a Happy Life (Sekreti i të krishterit për një jetë të lumtur)* nga Hannah Whitehall Smith.

Për shkak të kontekstit të unifikuar të kapitujve 13-17, është e mundshme që këtë pastrim ta lidhim me larjen e këmbëve më herët në kapitullin 13. Ata ishin tashmë të larë (të shpëtuar), por duhet të lanin këmbët (falja e vazhdueshme). Kjo FOLJE NË KOHËN E TASHME IU drejtohet dishepujve, siç duket se pohon 1 Gjonit 1:9. Për “qëndrimin” nuk kërkohet vetëm bindje, por edhe pendim i vazhdueshëm!

Synimi i vuajtjes në jetën e besimtarit mund të ketë një sërë aspektesh.

1. Zhvillon ngjashmërinë me Krishtin (shih Heb. 5:8)
2. Ndëshkimi i përkohshëm për mëkatin
3. Thjesht jeta në një botë të rënë

Është gjithmonë e vështirë të dallosh qëllimin e Perëndisë, por #1 është gjithmonë një rezultat i mundshëm.

15:3 “ju jeni të pastër tashmë” Fjala “krasit” (*kathairō*) në v. 2 vjen nga e njëjta rrënjë greqisht si “pastroj” (*katharos*). Gjithë ky kontekst përmban provat e dishepullizimit të vërtetë. Fjala “tashmë” theksohet në pasazhin greqisht, gjë që u jepte njëmbëdhjetë dishepujve të mbetur sigurinë e pozicionit të tyre të patundur në Krishtin (krahasuar me të njëjtën rrënjë që u përdor për Juda Iskariotin në 13:10).

■ **“për shkak të fjalës që ju kam thënë”** (shih 17:17; Efe. 5:26; 1 Pjet. 1:23).

15:4

NASB, NKJV **“Qëndroni në mua, dhe unë në ju”**

NRSV **“Qëndroni në mua, siç qëndrojt dhe unë në ju”**

TEV **“Rrini të bashkuar me mua, dhe unë do të rri i bashkuar me ju”**

NJB **“Rrini në mua, siç rri dhe unë në ju”**

Kjo është një URDHËRORE AORISTE VEPRORE në SHUMËS (shih Gjoni 6:56; 1 Gjonit 2:6). Pyetja gramatikore është nëse fraza e dytë është përshkrim apo krahasim. Shumë herë, në këtë pasazh, theksi doktrinor teologjik vihet te qëndresa e shenjtorit të vërtetë (shih v. 4,5,6,7,9,10,14; Marku 13:13; 1 Kor. 15:2; Gal. 6:9; Zbu. 2:7,11,17,26; 3:5,12,21; 21:7, shih Temën e Veçantë në 8:31). Shpëtimi i vërtetë është edhe përgjigje fillestare, edhe përgjigje e vazhdueshme. Kjo e vërtetë teologjike shpesh anashkalohet nga entuziazmi ynë për sigurinë personale të shpëtimit. Siguria biblike lidhet me

1. qëndresën në besim
2. një mënyrë jetese plot pendim
3. bindjen e vazhdueshme (shih Jakobi dhe 1 Gjonit)
4. prodhimin e fryteve (shih Mat. 13:23)

Shih Temën e Veçantë “Qëndrojt” në 1 Gjonit 2:10.

■ **“dega nuk jep dot fryt”** Kjo tregon përparësinë e furnizimit hyjnor. Për “frytin”, shih shënimin në v. 5.

■ **“nëse nuk qëndron... nëse ju nuk qëndroni”** Këto janë të dyja FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Efektshmëria jonë shpirtërore lidhet me marrëdhënien tonë të vazhdueshme me Jezusin.

15:5 “kush qëndron në mua, dhe unë në të, do të japë shumë fryt” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORË, e ndjekur nga një DËFTORE E TASHME VEPRORË. Bashkësia e vazhdueshme (pra, marrëdhënia e besimit personal) është burimi i frytit të vazhdueshëm. Fryti ndoshta nënkupton jo vetëm veprimet e besimtarëve, por edhe veprimet e tyre (shih Mat. 7:15-23; Gal. 5:22-23; 1 Korintasve 13). Besimtarëve u premtohet fryt i efektshëm dhe jetëgjatë nëse qëndrojnë në Jezusin (shih v. 16).

■ **“sepse pa mua nuk bëni dot asgjë”** Kjo është një MOHORE E DYFISHTË, pra kategorike. Kjo është një pohim negativ i të vërtetës pozitive të v. 5 dhe Fil. 4:13.

15:6 “Nëse dikush nuk qëndron në mua, flaket jashtë” Kjo është FJALI KUSHTORE KLASIT TË TRETË. Druri i hardhisë ishte i padobishëm për qëllime shtëpiake (si dru zjarri), pasi digjej tepër shpejt dhe me nxehtësi tepër të lartë (shih Ezek. 15). Kjo duket se i drejtohet Judës, ndoshta dhe Izraelit. Nëse jo, duhet t’i referohet besimit të rremë (shih Mat. 13:41-42, 50; dhe 1 Gjonit 2:19).

Pa dyshim, këtu kemi të bëjmë me një metaforë eskatologjike! Do të ketë një “ditë grumbullimi” dhe një “ditë djegieje”. Mënyra si jetojmë zbulon burimin e jetës sonë (pra, Perëndinë ose Satanin). Do t’i njihni nga frytet (shih Mat. 7; Gal. 6:7).

■ **“zjarr”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: ZJARRI

Në Shkrim, zjarri ka edhe ngjyime pozitive, edhe negative.

A. Pozitive

1. ngroh (shih Isa. 44:15; Gjoni 18:18)
2. ndriçon (Isa. 50:11; Mat. 25:1-13)
3. pjek (shih Eks. 12:8; Isa. 44:15-16; Gjoni 21:9)
4. pastron (shih Num. 31:22-23; Fja. 17:3; Isa. 1:25; 6:6-8; Jer. 6:29; Mal. 3:2-3)
5. shenjtëri (shih Zan. 15:17; Eks. 3:2; 19:18; Ezek. 1:27; Heb. 12:29)
6. udhëheqja e Perëndisë (shih Eks. 13:21; Num. 14:14; 1 Mbret. 18:24)
7. fuqizimi i Perëndisë (shih Veprat 2:3)
8. mbrojtje (shih Zak. 2:5)

B. Negative

1. djeg (shih Joz. 6:24; 8:8; 11:11; Mat. 22:7)
2. shkatërron (shih Zan. 19:24; Lev. 10:1-2)
3. zemërim (shih Num. 21:28; Isa. 10:16; Zak. 12:6)
4. ndëshkim (shih Zan. 38:24; Lev. 20:14; 21:9; Joz. 7:15)
5. shenjë e rremë eskatologjike (shih Zbu. 13:13)

C. Zemërimi i Perëndisë kundër mëkatit shprehet me metafora zjarri

1. zemërimi i tij djeg (shih Os. 8:5; Sof. 3:8)
2. ai derdh zjarr (shih Nah. 1:6)
3. zjarri i përjetshëm (shih Jer. 15:14; 17:4)
4. gjykimi eskatologjik (shih Mat. 3:10; 13:40; Gjoni 15:6; 2 Thes. 1:7; 2 Pjet. 3:7-10; Zbu. 8:7; 16:8)

D. Ashtu si shumë metafora të tjera në Bibël (si majaja, luani), zjarri mund të jetë bekim ose mallkim, në varësi të kontekstit.

15:7 “Nëse qëndroni në mua, dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Lutja nuk merr përgjigje automatike! Jezusi ndryshon metaforat, nga fakti se ai qëndron në dishepujt tek qëndrimi i fjalëve të tij në ta. Jezusi zbulon Atin; të njëjtën gjë bëjnë dhe mësimet e tij. Ata janë burime të ndër-këmbëshme zbuluese. Ungjilli është edhe person, edhe mesazh.

■ **“kërkoni çfarë të dëshironi dhe do t’ju bëhet”** Kjo është URDHËRORE AORISTE MESORE (shih v. 16). Kjo frazë është keqpërdorur si pasazh-provë. Kujdesu që të kërkosh mësimin e gjithë Shkrimit dhe mos thekso pasazhe të izoluar (shih shënimin për 14:13). Shih Temën e Veçantë: Lutja, e kufizuar, por edhe e pakufizuar, te 1 Gjonit 3:22.

15:8 “përlëvdohet Ati im” Jeta e besimtarëve në ngjashmëri me Krishtin i sjell lavdi Perëndisë dhe provon se ata janë dishepuj të vërtetë. Te Gjoni 13:31-32; 14:13; 17:4; dhe Mat. 9:8; 15:31, Ati përlëvdohej nga puna e të Birit, ndërsa tani, nga veprat e besimtarëve (shih Mat. 5:16). Shih shënimin në 1:14.



NASB	“kështu provoni se jeni dishepujt e mi”
NKJV	“kështu do të jeni dishepujt e mi”
NRSV, TEV	“të bëheni dishepuj të mi”
NJB	“bëhuni dishepuj të mi”
REB	“kështu bëheni dishepuj të mi”
NIV, Goodspeed	“tregoni veten se jeni dishepuj të mi”
Bibla NET	“tregoni se jeni dishepuj të mi”
JB	“atëherë do të jeni dishepuj të mi”

Ndryshimet shkaktohen nga ndryshimi i KOHËS së FOLJES.

1. LIDHORE AORISTE, dorëshkrimet P⁶⁶, B, D, L
2. DËFTORE E ARDHME, dorëshkrimet Ɑ, A

Jeta (fryti) i besimtarëve zbulon se kush janë në të vërtetë! KOHA E FOLJES nuk është aq e rëndësishme sa realiteti i një jete të ndryshuar dhe të frytshme dashurie, bindjeje dhe shërbimi. Këto janë shenjat e besimtarit të vërtetë! Në nuk shpëtohem nga dashuria, bindja apo shërbesa jonë (shih Efe. 2:8, 9), por ato janë prova se ne jemi besimtarë (shih Efe. 2:10).

Në ungjillin e Gjonit, fjala “dishepuj” përdoret për ata besimtarë dhe ndjekës të vërtetë që bëjnë vullnetin e Perëndisë dhe pasqyrojnë karakterin e tij. Gjoni nuk e përdor asnjëherë fjalën “kishë” (*ekklësia*), prandaj, “dishepujt” bëhet fjala me të cilën ai përshkruan bashkësinë dhe tubimet e krishtera. Dishepullizimi është jeta e përditshme e epokës së re që jetohet në epokën e vjetër. Ai karakterizohet në mënyrën më të lartë nga dashuria, drita, bindja dhe shërbimi! Nga këto gjëra, të tjerët do të dinë se jemi dishepuj të Jezusit.

15:9 “Ashtu si Ati im më ka dashur, kështu ju kam dashur dhe unë” Ky zinxhir marrëdhëniesh me dashuri karakterizon familjen e Perëndisë; Ati do Birin, Biri do ndjekësit e vet, dhe ndjekësit e vet duan njëri-tjetrin.

▣ **“qëndroni në dashurinë time”** Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE. Besimtarët urdhërohen që të qëndrojnë në

1. lutje (v. 7; 14:14)
2. bindje (v. 10, 14, 17, 20; 14:15, 21, 23, 24)
3. gëzim (v. 11)
4. dashuri (v. 12; 14:21, 23, 24)

Të gjitha këto janë prova të marrëdhënies personale me Perëndinë. Shih Temën e Veçantë: Qëndroj në 1 Gjonit 2:10.

15:10 “nëse zbatoni urdhërimet e mia” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Bindja është provë e dishepullizimit të vërtetë (shih 8:31; 14:15-21, 23-24; Luka 6:46). Jezusi e përdor si shembull të besnikërisë së tij ndaj Atit.

▣ **“dashuri”** Kjo fjalë greke për dashurinë (*agapē*) nuk përdoret shumë në letërsinë klasike ose *koine* greke, derisa kisha filloi ta përdorte në një kuptim të specializuar. Ajo filloi të përdoret për të nënkuptuar dashurinë altruiste, sakrifikuese, besnike dhe vepruese. Dashuria është veprim, jo emocion (shih 3:16). Fjala e DhR *agapē* është sinonime nga ana teologjike me fjalën e DhV *hesed*, që donte të thoshte “dashuri dhe besnikëri ndaj besëlidhjes”.

▣ **“ashtu siç kam zbatuar dhe unë urdhërimet e Atit tim”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Atë marrëdhënie që Jezusi ka me Atin, e kanë edhe besimtarët me Jezusin. Midis Atit dhe Birit ekziston një unitet që duhet të riprodhohet edhe ndër besimtarët (shih 14:23).

15:11 “gëzimi juaj të jetë i plotë” Besimtarët duhet të kenë gëzimin e Jezusit (shih 17:13). Gëzimi është tjetër provë e dishepullizimit të vërtetë (shih 15:11 [dy herë]; 16:20, 21, 22, 24; 17:13). Në këtë botë, ka dhimbje dhe kriza; në Krishtin, ka gëzim, gëzim të plotë; ky është gëzimi i tij.

NIDOTTE, vëll. 1, f. 741, ka një koment të vlefshëm për mënyrën sesi “gëzimi” dhe “i plotë” përdoren së bashku në shkrimet e Gjonit.

“Në Gjn. dhe në letrat e Gjonit ekziston një lidhje e shpeshtë midis gëzimit (*khara*) si subjekt dhe foljes *plëroō* në formën pësore, „mbushem“. Ky gëzim është gëzimi i Jezusit (Gjn. 15:11; 17:13), të cilin ai e sjell nëpërmejt ardhjes së tij (3:29), fjalëve të tij (15:11; 17:13), dhe kthimit të tij (16:22) te dishepujt (15:11; 17:13). Ky gëzim zëvendëson trishtimin që mbush zemrën e tyre (16:16, 20). Kështu, gëzimi i Krishtit bëhet gëzimi i tyre (15:11; 16:24; shih 1 Gjonit 1:4). Ky gëzim karakterizon jetën e dishepujve në ecjen e tyre me Jezusin; ai bëhet i plotë (Gjn. 3:29; 15:11; 16:24; 17:13; 1 Gjn. 1:4; 2 Gjn. 12). Forma pësore nënvizon faktin se ai që e bën të plotë këtë gëzim është Perëndia”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:12-17

¹²“Ky është urdhërimi im, që të doni njëri tjetrin, ashtu siç ju kam dashur. ¹³Nuk ka njeri dashuri më të madhe se kjo: që dikush të japë jetën e vet për miqtë. ¹⁴Ju jeni miq të mi nëse bëni atë që ju urdhëroj. ¹⁵Nuk ju quaj më skllëvër, sepse skllavi nuk di atë që bën i zoti; por ju kam quajtur miq, sepse të gjitha gjërat që kam dëgjuar nga Ati im, jua kam bërë të njohur. ¹⁶Nuk më zgjodhët ju, por ju zgjodha unë dhe ju caktova që të shkoni dhe të jepni fryt, dhe që fryti juaj të qëndrojë, në mënyrë që çfarëdo që t’i kërkonti Atit në emrin tim, ai t’ua japë. ¹⁷Këtë ju urdhëroj: të doni njëri-tjetrin”.

15:12 “Ky është urdhërimi im” Jezusi e përsëriti shpesh këtë motiv (shih 13:34; 15:17; 1 Gjonit 3:11,23; 4:7-8, 11-12, 19-21; 2 Gjonit 5).

■ **“që të doni njëri-tjetrin”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, pra, urdhërim i vazhdueshëm. Dashuria është fryti i Frymës (shih Gal. 5:22). Dashuria nuk është ndjenjë, por veprim. Ajo përcaktohet në mënyrë praktike (shih Gal. 5:22-23; 1 Kor. 13).

■ **“ashtu siç ju kam dashur”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Ka gjasa që kjo të ketë qenë mënyrë e figurshme për të folur për kryqin (shih v. 13). Sërish, besimtarët duhet të shfaqin pikërisht llojin e veçantë të dashurisë së Jezusit, që dha veten për ta (shih 2 Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; 1 Gjonit 3:16).

15:13 “që dikush të japë jetën e vet për miqtë” Kjo i referohet shlyerjes zëvendësuese të Jezusit (shih 10:11, 15, 17, 18; Marku 10:45; Rom. 5:7-8; 2 Kor. 5:21; Isaia 53). Kjo është dashuri në veprim! Këtë thirren të bëjnë dishepujt (shih 1 Gjonit 3:16).

15:14 “Ju jeni miqtë e mi” Ky është EMRI greqisht *filos*, që shpesh shoqërohet me dashurinë për miqtë (*fileō*). Në greqishten *koine*, shpesh, FOLJET “*agapaō*” dhe “*fileō*” janë sinonime për dashurinë hyjnore (krahaso me 11:3 [*fileō*] dhe 5 [*agapaō*]; *fileō* përdoret edhe për dashurinë e Perëndisë në 5:20).

■ **“nëse bëni atë që ju urdhëroj”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Ajo jep kushtin për miqësinë, që është bindja (shih 14:15, 23-24; 15:10; Luka 6:46). Ashtu si Jezusi banonte në Atin dhe qëndronte në dashurinë e tij, kështu duhet të vepronjë dhe dishepujt e vet!

15:15 Jezusi i informon dishepujt për (1) të vërtetat e Perëndisë dhe (2) ngjarjet e ardhshme. Ai demonstroi fuqinë e vet në mënyrë që dishepujt të rriten në besim dhe në siguri besimi. Jezusi ndau me dishepujt e vet ato që kishte dëgjuar nga Ati (shih 3:32; 8:26, 40; 12:49; 15:15); ata duhet t’ua transmetonin të tjerëve (shih Mat. 28:20).

15:16 “Nuk më zgjodhët ju, por ju zgjodha unë” Këtu kemi një sërë elementesh kyçe nga ana gramatikore.

1. Të dyja FOLJET janë DËFTORE AORISTE MESORE – vetë Jezusi, një herë e përgjithmonë, i zgjodhi (shih 6:70; 13:18; 15:16, 19)
2. “*alla*” e fortë (“por”) KONTRASTUESE
3. Thënia “*ego*” ose “unë” e theksuar

Këtu kemi drejtpeshimin midis përgjigjes njerëzore dhe zgjedhjes hyjnore. Të dyja janë mësim biblike. Perëndia është ai që merr gjithmonë nismën (shih 6:44, 65; 15:16, 19), por njerëzit duhet t’i përgjigjen (shih 1:12; 3:16; 15:4, 7, 9). Marrëdhëniet e Perëndisë me njerëzimin janë gjithmonë në një marrëdhënie besëlidhjeje (“nëse... atëherë”). Shih Temën e Veçantë në 3:16.

FOLJA “zgjodhët” në këtë kontekst bën fjalë për të Dymbëdhjetët. Termi “zgjodha” ka ngjyrimin “zgjedhur për shërbesë” në DhR dhe vetëm në DhR futet në gamën semantike dhe koncepti i shtuar i “zgjedhur për shpëtim”. Besimtarët e DhR janë zgjedhur për ngjashmëri me Krishtin, pra, për shërbesë, altruizëm dhe sakrificë për Mbretërinë e Perëndisë, trupin e Krishtit dhe të mirën e përbashkët. Ky është demonstrim i qartë se egocentrizmi i Rënies është thyer.

Është karakteristike për Gjonin se ajo që thotë Jezusi në lidhje me të Dymbëdhjetët ka rrjedhoja dhe zbatime për gjithë besimtarët. Ata përfaqësojnë frytet e par të dishepullizimit, por marrëdhënia e tyre është

1. unike për sa i përket dëshmisë si dëshmitarë okularë (pra, frymëzimi)
2. e zbatueshme për të gjithë besimtarët për faktin se vullneti i Jezusit për ta është vullneti i tij për gjithë ata që besojnë dhe e ndjekin

■ **“ju caktova që të shkoni dhe të jepni fryt, dhe që fryti juaj të qëndrojë”** Këto janë tre folje LIDHORE TË TASHME VEPRORE (1) shkoni; (2) jepni fryte; dhe (3) fryti qëndron. Besimtarët janë në një mision (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8). Aspekti teologjik i termit “caktova” mund të shihet në Veprat 20:28; 1 Kor. 12:28; 2 Tim. 1:11. U përdor edhe për vdekjen e Krishtit për hir të besimtarëve (shih 10:11, 15, 17-8; 15:13).

■ **“në emrin tim”** Besimtarët duhet të riprodhojnë karakterin e Jezusit. Kjo frazë është sinonime me “vullnetin e Perëndisë” te 1 Gjonit 5:14. Dashuria dhe lutja që merr përgjigje lidhen këtu njësoj si te 14:13-15. Shih Temën e Veçantë: Emri i Zotit te Gjoni 14:13-14.

15:17: “Këtë ju urdhëroj: të doni njëri-tjetrin” Shih shënimin te vargu 12. Lutja që merr përgjigje lidhet me dashurinë dhe misionin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:18-25

¹⁸“Nëse bota ju urren, ta dini që më ka urreyer mua përpara jush. ¹⁹Po të ishit të botës, bota do t’i donte të vetët; por, për shkak se nuk jeni të botës, por ju zgjodha unë nga bota, për shkak të kësaj, kjo botë ju urren. ²⁰Kujtoni fjalën që ju thashë: „Skllavi nuk është më i madh se i zoti“. Nëse më përdoqën mua, do t’ju përndjekin dhe ju; nëse zbatuan fjalën time, do të zbatojnë dhe tuajën. ²¹Por të gjitha këto gjëra do t’ju bëjë për hir të emrit tim, pasi nuk e njohin atë që më dërgoi. ²²Po të mos kisha ardhur dhe t’ju flisja, nuk do të kishin mëkat, por, tani, nuk kanë shfajësim për mëkatin e tyre. ²³Ai që më urren mua, urren dhe Atin. ²⁴Nëse s’do të kisha kryer mes tyre veprat që s’i bëri askush tjetër, nuk do të kishin mëkat; por, tani, ata edhe kanë parë, edhe më kanë urreyer mua dhe Atin tim. ²⁵Por ata e kanë bërë këtë për të përmbushur fjalën që është shkruar në Ligj: „MË KANË URRYER PA SHKAK“.

15:18 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për hir të synimit të tij letrar. Bota, një sistem i rënë njerëzor, urren ndjekësit e Jezusit.

■ **“bota”** Gjoni e përdor këtë fjalë në mënyra të ndryshme: (1) planeti, si metaforë për gjithë njerëzimin (shih 3:16) dhe (2) si shoqëria njerëzore, që organizohet dhe funksionon veçmas Perëndisë (shih 10:8; 1 Gjonit 2:15-17). Shih Temën e Veçantë te 14:17.

■ **“ju urren”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE; bota vazhdon të urrejë (shih v. 20).

■ **“ta dini”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Njohuria e të vërtetave të DhR nga besimtarët do t’i ndihmojë që të përballen me përndjekjen e botës së rënë.

■ **“që më ka urreyer mua përpara jush”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. PËREMRI “mua” është theksues (shih 7:7). Kjo zbulon kundërshtimin që bota i bën Perëndisë, Mesisë së tij dhe popullit të tij (shih 17:14; 1 Gjonit 3:13).

Besimtarët janë një në dashurinë e Krishtit dhe një në përndjekjen e Krishtit (shih Rom. 8:17; 2 Kor. 1:5, 7; Fil. 3:10; 1 Pje. 4:13). Njëjtësimi me Krishtin na sjell paqe, gëzim, por edhe përndjekje, madje dhe vdekje!

15:19 “Po të” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “në kundërshtim me faktet”. Kjo duhet përkthyer: “po të ishit të botës, por nuk jeni të tillë, atëherë bota do t’ju donte, por nuk ju do”.

15:20 “Kujtoni” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, si v. 18, ose DËFTORE E TASHME VEPRORE, ndoshta si pyetje (LB).

▣ **“skllavi nuk është më i madh se i zoti”** Kur e krahason këtë varg me 13:16, del në pah se Jezusi i përdorte fjalët e urta në mënyra të ndryshme.

▣ **“nëse më përndoqën mua... nëse zbatuan fjalën time”** Këto janë dy FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, që merren si të vërteta nga pikëvështrimi i autorit. Fjala “përndjek” do të thotë “të ndjekësh si kafshë të egër”. Përndjekja është rregulli për ndjekësit e Krishtit në këtë botë të rënë (Mat. 5:10-12; Gjoni 16:1-3; 17:14; Veprat 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; 2 Kor. 4:16-18; 6:3-10; 11:23-30; Fil. 1:29; 1 Thes. 3:3; 2 Tim. 3:12; Jakobi 1:2-4; 1 Pjet. 4:12-16).

Sidoqoftë, vini re se, ndonëse disa do t’i refuzojnë fjalët e apostujve dhe, madje, do t’i përndjekin, do të ketë të tjerë që do t’ua vënë veshin dhe do të përgjigjen! Ata vetë janë provë e këtij realiteti!

15:21 “nuk e njohën atë që më dërgoi” Qartazi, kjo bën fjalë për Atin. Nënkupton se, jo vetëm johebrenjtë, por as judenjtë, nuk e njohin Perëndinë. “Njoh” përdoret në kuptimin semit (DhV) të marrëdhënies personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). Bota e humbur i përndjek besimtarët, sepse (1) ata i përkasin Jezusit, i cili ishte përndjekur gjithashtu, dhe (2) bota nuk e njeh Perëndinë!

15:22 “Po të mos kisha ardhur” Kjo është një tjetër FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që nënkupton diçka “në kundërshtim me faktet”. Duhet përkthyer: “Po të mos isha kthyer që t’u flisja, por ja që u ktheva, atëherë nuk do të kishin patur mëkat, por tani kanë mëkat”. Përgjegjësia lidhet me njohurinë (shih Tema e Veçantë: Mëkati i Pafalshëm te 5:21). Në këtë kontekst, degët pa fryte (pra, Juda dhe judenjtë) kishin mundësi të madhe njohjeje, shumë më tepër se ata që kishin vetëm zbuluesin e natyrshme (p.sh., johebrenjtë, shih Psa. 19:1-6; Rom. 1:18-20; ose 2:14-5).

15:23 Kundërshtimi i vazhdueshëm i Jezusit është kundërshtim i vazhdueshëm i Perëndisë (shih v. 24).

15:24 “Nëse” Kjo është një tjetër FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që është në “kundërshtim me faktet”. Duhet përkthyer: “Nëse s’do të kisha bërë mes tyre vepra që askush tjetër s’i bën (por ja që i bëra), atëherë ata s’do të kishin mëkat, por ja që kanë mëkat”.

Drita sjell përgjegjësi (shih 1:5; 8:12; 12:35, 46; 1 Gjonit 1:5; 2:8-9, 11; Mat. 6:23).

▣ **“ata edhe kanë parë, edhe më kanë urreyer mua dhe Atin tim”** Këto janë të dyja DËFTORE TË KRYERA VEPRORE, që tregojnë një qëndrim të vazhdueshëm. Të refuzosh Jezusin do të thotë të refuzosh Atin (shih 1 Gjonit 5:9-13).

15:25 Është e habitshme që fjala “Ligj” ose “Torah” përdoret për të përshkruar një citim të Psa. 35:19; 69:4. Zakonisht, kjo fjalë përdoret për shkrimet e Moisiut (Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë).

Misteri i refuzimit që judenjtë i bënë Jezusit pavarësisht një zbuluese kaq të dukshme lidhet me mosbesimin e qëllimshëm (shih Isa. 6:9-13; Jer. 5:21; Rom. 3:9-18).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:26-27

²⁶“Kur të vijë Ndhimuesi, të cilin do t’jua dërgoj nga Ati, pra, Fryma e së vërtetës që del nga Ati, do të dëshmojë për mua, ²⁷edhe ju do të dëshmoni, sepse keni qenë me mua që nga fillimi.

15:26 “Kur të vijë Ndhimuesi, të cilin do t’jua dërgoj” Frymën e dërgon edhe Ati, edhe Biri (shih 14:16, 26; 15:26; 16:7). Vepra e shpengimit përfshin të tre personat e Trinisë

▣ **“Fryma e së vërtetës”** Kjo përdoret në kuptimin se Fryma e Shenjtë është zbuluesi i Atit (shih 14:17, 26; 15:26; 16:13). Shih Temën e Veçantë për të Vërtetën në 6:55 dhe 17:3.

▣ **“Ai do të dëshmojë për mua”** Detyra e Frymës është të dëshmojë për Jezusin dhe për mësimet e tij (shih 14:26; 16:13-15; 1 Gjonit 5:7).

15:27 “edhe ju do të dëshmoni” “Edhe ju” është theksuese. Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Duhet të ketë të bëjë me frymëzimin e autorëve të DhR (pra, apostujt dhe shokët e tyre), të cilët kishin qenë me Jezusin gjatë jetës së tij tokësore (shih Luka 24:48). Shih Tema e Veçanta: Dëshmitarët e Jezusit 1:8 dhe Personaliteti i Frymës së Shenjtë 14:26.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Çfarë nënkupton “banimi/qëndrimi”?
2. Po sikur besimtari të pushojë së banuari në Zotin? Po sikur besimtari të mos japë më fryte?
3. Rendit provat e dishepullit të vërtetë.
4. Nëse vuajtja është rregulli për të krishterët, çfarë nënkupton kjo për ne sot?
5. Shpjego me fjalët e tua v. 16.

GJONI 16

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Urrejta e botës (15:18-16:4a)	Refuzimi i ardhshëm (15:26-16:4)	Marrëdhënia e të krishterit me botën	(15:18-16:4a)	Dishepujt dhe bota (15:18-16:4a)
Puna e Frymës së Shenjtë 16:4b-11	Puna e Frymës së Shenjtë 16:5-15	16:1-4a 16:4b-11	Puna e Frymës së Shenjtë 16:4b-11	Ardhja e Ngushëlluesit 16:4b-15
16:12-15		16:12-15	16:12-15	
Trishtimi do të kthehet në gëzim 16:16-24	Trishtimi do të kthehet në gëzim 16:16-24	16:16-24	Trishtimi dhe gëzimi 16:16 16:17-18 16:19-22 16:23-24	Jezusi do të kthehet shumë shpejt 16:16 16:17-28
Unë kam triumfuar 16:25-33	Jezu Krishti e ka mposhtur botën 16:25-33	16:25-28 16:29-33	Fitore mbi botën 16:25-28 16:29-30 16:31-33	16:29-33

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË GJONIT 16:1-33

- A. Konteksti letrar vijon nga 15:18-16:4a. Ndarjet e kapitujve nuk janë të frymëzuara dhe janë shitesa shumë të mëvonshme, si ndarja në paragrafë, shkronjat e mëdha, pikësimi dhe ndarja e vargjeve.
- B. Detyra e Frymës së Shenjtë ndaj të humburve shpirtërisht përcaktohet te 16:8-11; detyra e tij ndaj të shpëtuarve, te 16:12-15. Samuel J. Mikolaski ka bërë një përmbledhje interesante të veprimtarisë së Frymës në DhR në artikullin e tij “Teologjia e Dhiatës së Re”, në *The Exposition Bible Commentary [Komentari i Shtjellimit të Biblës]*, vëll. 1:

“Doktrina e shenjtërisht të DhR, ndonëse e lidhur ngushtë me shfaqësimin, është gjithësesi e veçantë prej tij. Ashtu si në DhV, shenjtërimi vë në dukje, së pari, gjendjen e veçantë—

transcendencën e shenjtë të Perëndisë—dhe, së dyti, një cilësi morale dhe një marrëdhënie që i ngjason Perëndisë. Shenjtërimi është vepër e Frymës së Shenjtë, i cili bashkon njeriun me Krishtin dhe ia ripërtërin jetën nga ana shpirtërore. Terminologji e DhR flet për pagëzimin në Frymë (1 Kor. 12:30; vulën e Frymës (Efe. 1:13, 14; 4:30), brendabanimin e Frymës (Gjoni 14:17; Rom. 5:5; 8:9-11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14), udhëzimin nga Fryma (Gjoni 14:26; 16:12-15), mbushjen e Frymës (Efe. 5:18) dhe frytin e Frymës (Gal. 5:22-23). Shenjtërimi lidhet me shfajësimin, i cili përbën qëndrimin para Perëndisë (Heb. 10:10), dhe mund të mendohet si zhvillim drejt një ideali të ri” (f. 474).

C. Vargu 17, ashtu si 13:36; 14:5, 8 dhe 22, është një tjetër pyetje që bëjnë apostujt.

D. Shumë besojnë se fraza “le të ikim prej këtej” (14:31), e kombinuar me 18:1, tregon se Jezusi i tha kapitujt 15-17 gjatë rrugës për në Gjetseman nëpër tempull dhe nëpër rrugët e Jerusalemit, jo në dhomën e sipërme.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:1-4

¹“Këto gjëra jua kam thënë që të ruheni se mos pengoheni. ²Ata do t’ju përjashtojnë nga sinagoga, por po vjen një orë kur kushdo që ju vret do të mendojë se po i bën shërbim Perëndisë. ³Këto gjëra do t’ju bëjnë sepse nuk kanë njohur as Atin, as mua. ⁴Por këto gjëra jua kam thënë që, kur të vijë ora e tyre, të mos harroni se jua thashë. Këto gjëra nuk jua thashë që në fillim, sepse isha me ju”.

16:1

NASB “që të ruheni mos pengoheni”

NKJV “që të mos detyroheni të pengoheni”

NRSV “që t’ju ruaj nga të penguarit”

TEV “që të mos hiqni dorë nga besimi”

NJB “që të mos largoheni”

Ky term grek (LIDHORJA AORISTE PËSORE e *skandalizo*, BAGD 752), në fillim, përdorej për një kurth të ngritur për kapjen e kafshëve. Shpesh, përkthehet “rrezohem” (shih Mat. 13:21; 24:10; Marku 4:17; 14:27, 29). Përdorimi i tij metaforik në këtë kontekst i referohet faktit se besimtarët nuk duhet të kapen të papërgatitur nga veprimet gjithë urrejtje të bashkëjudenjve të tjerë, madje as nga ato të krerëve fetarë.

16:2 “Ata do t’ju përjashtojnë nga sinagoga” Këtu bëhet fjalë për përjashtimin nga feja e judaizmit (shih 9:22, 34; 12:42). Ka shumë të panjohura për procedura judaike të përjashtimit nga bashkësia. Ekzistonte edhe përjashtim i përkohshëm, edhe i përhershëm, nga shërbesat e sinagogës. Më vonë, pas rënies së Jerusalemit, më 70 pas K., në Jahven të Izraelit, rabinët përpiluan një “zotim mallkimi” që lidhej me Krishtin; me anë të tij ata dëshironin t’i përjashtonin të krishterët nga shërbesat e sinagogave. Kjo ishte ajo që, në fund, bëri të detyrueshme ndarjen mes ndjekësve të Krishtit dhe sinagogave lokale të judenjve.

☐ **“kushdo që ju vret do të mendojë se po i bën shërbim Perëndisë”** Pikërisht kështu mendonin krerët e judenjve (shih Isa. 66:5; Mat. 5:10-12; 10:32). Sauli i Tarsit (Pali) është një shembull i qartë i këtij zelli të gabuar fetar (shih Veprat 26:9-11; Gal. 1:13-14).

16:3 “Këto gjëra do t’ju bëjnë” Sinqeriteti dhe përkushtimi ndaj një Qenieje Absolute nuk mjafton. Shpesh, në emër të Perëndisë kryhen ligësi, gabime dhe fanatizëm.

☐ **“sepse nuk kanë njohur as Atin, as mua”** Termi “njoh” përdoret me ngjyrimin e DhV për marrëdhënien e ngushtë dhe personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). Ky është pohim i fortë se refuzimi i Jezusit, në fund fare, do të thotë të refuzosh Perëndinë (shih 8:19; 15:21; 1 Gjonit 5:9-12).

Shpesh, Gjoni pohon verbërinë dhe padijen shpirtërore të botës (shih 1:10; 8:19, 55; 15:21; 16:3; 17:25). Sidoqoftë, synimi i ardhjes së Birit ishte që të shpëtonte botën (shih 3:16) dhe të zbulonte Atin në mënyrë që ta njihje bota (shih 17:23) përmes Krishtit.

16:4 Profecitë e Jezusit u dhanë si mënyrë për të inkurajuar besimin/sigurinë/bindjen e dishepujve në mes të përndjekjeve dhe refuzimit (shih 13:19; 14:29).

“Në fillim” nënkupton fillimin e shërbesës publike të Jezusit dhe thirrjen e veçantë të të Dymbëdhjetëve.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:5-11

⁵“Por, tani, po shkoj tek ai që më dërgoi; dhe askush prej jush nuk më pyet, „Ku po shkon?”“⁶Por për shkak se jua thashë këto gjëra, zemrën tuaj e ka mbushur trishtimi. ⁷Por, me të vërtetë ju them: është për dobinë tuaj që unë po largohem; sepse, nëse nuk largohem, nuk do të vijë Ndhimuesi te ju; por nëse shkoj, do t’jua dërgoj. ⁸Dhe, kur të vijë, ai do ta bindë botën për mëkat, drejtësi dhe gjykim; ⁹për mëkat, sepse nuk besojnë në mua; ¹⁰për drejtësi, sepse po shkoj tek Ati dhe nuk do të më shihni më; ¹¹dhe për gjykim, sepse sundimtari i kësaj bote është gjykuar”.

16:5 “askush prej jush nuk më pyet: „Ku po shkon?”” Duket sikur, në të vërtetë, Pjetri bën pikërisht këtë pyetje në kapitullin 13:36, por atij iu shpërqendrua menjëherë vëmendja nga dhimbja e largimit të Jezusit prej tyre dhe, pastaj, nga pyetja se çfarë do të bëhej me ta (shih v. 6). Gjoni 14:1-3 trajton ngritjen e Jezusit në qiell (shih Veprat 1:9-11).

Ky është vendi i duhur për t’i kujtuar vetes se ungjijtë nuk janë regjistrime fjalë për fjalë të bisedave të Jezusit. Ato janë përmbledhje, të kryera vite më vonë për synime teologjike. Nën frymëzim, shkruesit e ungjijve kishin mundësi të zgjidhnin, të rendisnin dhe të përshtatnin fjalët e Jezusit (shih Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *Si ta lexosh Biblën për gjithë sa vlen*). Unë nuk besoj se ata kishin të drejtën që ta bënin Jezusin të thoshte gjëra që s’kishte thënë vërtet. Ky strukturim teologjik i fjalëve, mësimëve dhe veprave të Jezusit për ungjillizimin e grupeve të veçanta të audiencave të tyre mund të shpjegojë shumë prej dallimeve në rrëfimet e ungjijve!

16:6 “zemrën tuaj e ka mbushur trishtimi” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Përjetimi në Dhomën e Sipërme ishte i mbushur me trishtim (shih 14:1; 16:6, 22). Fjala “zemër” përdoret në kuptimin hebraik të gjithë individit—mendje, ndjenja dhe vullnet. Shih Temën e Veçantë: Zemra në 12:40.

16:7 “është për dobinë tuaj që po largohem” Trupi fizik i Jezusit mund të ishte vetëm në një vend në një kohë, që ia kufizonte aftësinë për të mësuar gjithë dishepujt dhe për t’i ndihmuar. Po kështu, gjatë jetës së vet tokësore, ai u përqendrua pikësisht te Izraeli (shih Mat. 10:6; 15:24). Ardhja e Frymës së Shenjtë do të inauguronte një epokë të re që do të çonte në zgjerimin e shërbesës (shih Efe. 2:11-3:13).

Fjala “dobi” donte të thoshte “voli” dhe përdoret edhe te 11:50 dhe 18:14 në lidhje me vdekjen e Jezusit. Folja “largohem” ndoshta përfshin të gjitha ngjarjet e javës së fundit të Jezusit.

■ “sepse, nëse nuk largohem, nuk do të vijë Ndhimuesi te ju” Në këtë varg ka dy FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkuptojnë veprim të mundshëm. Jezusi duhet të largohet në mënyrë që të vinte plotësia e Frymës! Fjala *paraklētōs* mund të përkthehet “avokat”, “ngushëllues”, ose “ndihmues” (shih 14:16, 26; 15:26; shih shënimin e plotë te 14:16). Kjo fjalë shfaqet vetëm në shkrimet e Gjonit. Në literaturën greke përdoret për avokatin mbrojtës, që thirret për të dhënë ndihmë. Në v. 8-11, Fryma vepronte si prokuror për botën, kurse në v. 12-15 shihet avokatia e Frymës në ndihmë të besimtarëve.

Po ky term, *paraklētōs*, përdoret edhe për Birin te 1 Gjonit 2:1. Rrënja greke e kësaj fjale mund të përkthehet “ngushëllim”. Në këtë kuptim përdoret për Atin te 2 Kor. 1:3-11.

■ “do t’jua dërgoj” Fryma erdhi, edhe nga Ati, edhe nga Biri (shih 14:26).

16:8 “Dhe, kur të vijë, ai do të bindë botën” Vini re se të tria fushat (mëkati, drejtësia, gjykimi) e dëshmisë së Frymës kanë të bëjnë me nevojën e njerëzimit dhe me veprën shpenguese të Jezu Krishtit. Fjala “bind” ishte një term ligjor që nënkuptonte “marrjen në pyetje për të kundërshtuar dëshminë e dikujt”.

G. B. Caird, *The Language and Imagery of the Bible [Gjuha dhe simbolika e Biblës]*, f. 159, shpreh një kuptim interesant të këtyre tre fushave. Do të bindë botën se

1. e ka patur gabim që e gjykoi dhe ekzekutoi Jezusin
2. e ka patur gabim për kuptimin e mëkatis
3. e ka patur gabim për kuptimin e drejtësisë
4. e ka patur gabim për kuptimin e gjykimit

Nëse është kështu, atëherë Fryma po e zbulon plotësisht ungjillin përmes personit të Jezusit. Fetaria e tyre s'mund t'i shpëtojë. Gjykimi i pret të gjithë ata që hedhin poshtë Jezusin! "Mëkati" është mosbesimi! Jezusi është e vetmja rrugë drejt jetës me Perëndinë!

Fjala "botë" nënkupton shoqërinë e rënë njerëzore, që organizohet dhe funksionon veçmas Perëndisë. Shih Temën e Veçantë te 14:17.

16:9 "për mëkat, sepse nuk besojnë në mua" Ungjilli nis me pranimin e mëkatit të njerëzimit dhe e nevojës së tij për drejtësinë e Perëndisë (shih Rom. 3:9-18, 23; 6:23; Efe. 2:1-3). Mëkati nuk është pengesa kryesore drejt shpëtimit nga kjo anë e Kalvarit, por pengesa është mosbesimi i njerëzimit në veprën dhe personin e Jezu Krishtit (shih Gjoni 3:6-12; 8:24, 26). Fjala "besim" ka elemente njohëse dhe emocionale, por, pikësëpari, bën fjalë për vullnetin (shih Temën e Veçantë në 2:23). Ajo përqendrohet, jo te vlera apo puna e besimtarit, por te reagimi i tij me pendim dhe besim në premtimet e Perëndisë në Krishtin (shih Rom. 3:21-30).

16:10 "për drejtësi" Kjo mund të ketë të bëjë me

1. Faktin se vepra e ardhshme shpenguese e Krishtit në Kalvar dhe Ringjallja shihen si një njësi e vetme (shih v. 10)
2. Ata që mendojnë se janë të drejtë para Perëndisë pa Krishtin kur, në të vërtetë, vetëm Krishti është në rregull me Perëndinë, siç shihet nga Ngjijtja e tij në qiell.

16:11 "për gjykim, sepse sundimtari i kësaj bote është gjykuar" Po vjen një ditë kur engjëjt e rënë dhe njerëzimi mëkatar do të qëndrojnë para Perëndisë së drejtë (shih Fil. 2:9-11). Satani, ndonëse është ende forcë e madhe në këtë botë (shih 12:31; 14:30; 2 Kor. 4:4; Efe. 2:2; 1 Gjonit 5:19), është tashmë armik i mposhtur (DËFTORE E KRYER PËSORE). Fëmijët e tij (shih 8:44; Mat. 13:38; 1 Gjonit 3:8-10) korrin zemërimin e Perëndisë!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:12-15

^{12c}"Kam shumë gjëra të tjera për t'ju thënë, por nuk jeni në gjendje t'i mbani tani. ¹³Por kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, do t'ju udhëheqë në gjithë të vërtetën; sepse nuk do të flasë me nismën e vet, por do të flasë gjithçka që dëgjon; dhe ai do t'ju zbulojë gjërat që do të vijnë. ¹⁴Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t'ju zbulojë. ¹⁵Të gjitha gjërat që ka Ati janë të miat; prandaj ju thashë se ai do të marrë prej meje dhe do t'ju zbulojë juve".

16:12 "nuk jeni në gjendje t'i mbani tani" Fjala "mbaj" përdoret për kafshët që mbartnin një barrë fizike. Disa nga gjërat që ata s'kuptonin dot ishin

1. Vuajtja e Krishtit
2. Ringjallja e Krishtit
3. Misioni botëror i kishës

Lexuesit e sotëm duhet të mos harrojnë se, në shumë mënyra, jeta e Krishtit përfaqëson një periudhë kalimtare. Apostujt nuk i kuptuan shumë gjëra përpara shfaqjeve të Krishtit pas ringjalljes dhe përpara ardhjes së Frymës në plotësi në ditën e Rrëshajave.

Gjithsesi, duhet të mos harrojmë se ungjijtë u shkruan vite më vonë për synime ungjillizuese për disa audiencë të caktuara. Si rrjedhojë, ato pasqyrojnë një teologji të mëvonshme dhe të pjekur.

16:13 "Fryma e së vërtetës" E vërteta (*alētheia*) përdoret në kuptimin e saj të DhV si besueshmëri dhe, vetëm në mënyrë dytësore, si vërtetësi. Jezusi tha se ai ishte e vërteta te 14:6. Ky titull për Frymën e Shenjtë thekson rolin e tij si zbuluesi i Jezusit (shih 14:17, 26; 15:26; 16:13-14; 1 Gjonit 4:6; 5:7). Shih shënimin te Gjoni 6:55.

■ **"do t'ju udhëheqë në gjithë të vërtetën"** Këtu nuk bëhet fjalë për të vërtetën absolute në çdo fushë, por vetëm në fushën e së vërtetës shpirtërore dhe e të mësimave të Jezusit. Pikësëpari, këtu bëhet fjalë për frymëzimin e autorëve të Shkrimeve të DhR. Fryma i udhëhoqi në mënyra unike dhe të autoritetshme (të frymëzuara). Në kuptimin dytësor, kjo bën fjalë për veprën përndritëse të Frymës te lexuesit e mëvonshëm për të kuptuar të vërtetat e ungjillit. Shih Temat e Veçanta: e Vërteta te 6:55, dhe Personaliteti i Frymës së Shenjtë te 14:26.

TEMË E VEÇANTË: PËRNDRITJA

Perëndia ka vepruar në të kaluarën për t'iu zbuluar njerëzimit. Në teologji, kjo quhet zbuluesë. Ai përzgjedhi disa njerëz për ta shkruar dhe shpjeguar këtë vetëzbuluesë. Në teologji, kjo quhet frymëzim. Ai ka dërguar Frymën e vet për t'iu ndihmuar lexuesit që të kuptojnë Fjalën e tij. Në teologji, kjo quhet përndritje. Problemi vjen kur ne pohojmë se Fryma përfshihet në të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë—atëherë, pse ka kaq shumë interpretime të ndryshme të saj?

Një pjesë e problemit ka të bëjë me botëkuptimin ose përvojat personale të lexuesit. Shpesh, trajtohet një axhendë personale duke e përdorur Biblën si tekst-provues, ose në mënyrë të shkëputur nga konteksti. Shpesh, Biblës i imponohet një kuadër teologjik i caktuar, që e lejon Biblën të flasë vetëm në zona të caktuara dhe në mënyra të përzgjedhura. Përndritja nuk duhet barazuar kurrësi me frymëzimin, ndonëse Fryma përfshihet në të dyja.

Qasja më e mirë mund të jetë të përqipemi të shprehim idenë qendrore të një paragrafi, dhe jo të interpretojmë çdo hollësi të pjesës. Ai që përçon të vërtetën qendrore të autorit fillestar është mendimi tematik. Përvijimi i librit, ose njësia letrare, na ndihmon që të ndjekim synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Asnjë interpretues nuk është i frymëzuar. Ne s'mund të riprodhojmë metodën interpretuese të shkrimtarit biblik. Por ne mundemi dhe duhet të përqipemi të kuptojmë se çfarë po thoshte autori fillestar për kohën e vet dhe, pastaj, këtë të vërtetë ta përçojmë në kohën tonë. Ka pjesë të Biblës që janë të vagullta ose të fshehura (deri në një kohë ose periudhë të caktuar). Do të ketë gjithmonë mosmarrëveshje për disa tekste ose tema të caktuara, por duhet t'iu shprehim qartë të vërtetat qendrore dhe duhet të lejojmë njëfarë lirie për interpretimet individuale brenda caqeve të synimit të autorit fillestar. Interpretuesit duhet të ecin nën dritën që kanë, gjithmonë duke qenë të hapur për të marrë më tepër dritë nga Bibla dhe nga Fryma. Perëndia do të na gjykojë në bazë të nivelit të të kuptuarit tonë dhe në bazë të mënyrës sesi e zbatojmë atë që kuptojmë.

■ **“sepse nuk do të flasë me nismën e vet, por do të flasë gjithçka që dëgjon; dhe ai do t’ju zbulojë gjërat që do të vijnë”** Gjërat që do të vijnë janë ngjarjet shpenguese të atypëratyshme: Kalvari, Ringjallja, Ngjitja në qiell dhe Rrëshajat. Kjo nuk bën fjalë për një shërbesë profetike që parathotë të ardhmen (p.sh., Agabi, Veprat 21:10; shih Temën e Veçantë te 4:19).

Fryma do ta marrë të vërtetën nga Atin, njësoj si Jezusi, dhe do t’ua transmetojë besimtarëve, njësoj si Jezusi. Nuk vjen vetëm përmbajtja e mesazhit të Frymës nga Ati, por edhe metodologjia (pra, është personale, shih Temën e Veçantë te 14:26). Ati është më i larti nga ana funksionale (shih 1 Kor. 15:27-28).

16:14-15 “Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t’ju zbulojë”. Puna parësore e Frymës është lartësimi dhe shpjegimi i Jezus Mesisë (shih v. 15). Fryma nuk e hedh kurrë mbi vete dritën e projektorit, por gjithmonë mbi Jezusin (shih 14:26).

■ **“të gjitha gjërat që ka Ati janë të miat”** Ç’pohim i mahnitshëm (shih 3:35; 5:20; 13:3; 17:10; Mat. 11:27)! Brenda Trinisë ekziston një rend funksional, por jo një pabarazi. Ashtu si Jezusi pasqyrore Atin, edhe Fryma pasqyron Jezusin.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:16-24

¹⁶“Edhe pak dhe nuk do të më shihni më; por, sërish, pas pak, do më shihni”. ¹⁷Pastaj, disa prej dishepujve të tij i thanë njëri-tjetrit: “Çfarë është kjo që po na thotë: „edhe pak dhe nuk do të më shihni më; por, sërish, pas pak, do të më shihni“ dhe, „sepse unë po shkoj tek Ati“?” ¹⁸Kështu, ata po thoshin: “Ç’është kjo që po thotë ai: „edhe pak“? Nuk e dimë për çfarë po flet”. ¹⁹Jezusi e dinte se donin ta pyesnin dhe u tha: “Ju po bisedoni me njëri-tjetrin për këtë, ngaqë thashë: „Edhe pak dhe nuk do të më shihni; por, sërish, pas pak, do të më shihni“? ²⁰Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them: do të qani dhe do të vajtoni, por bota do të gëzohet; do të pikëlloheni, por pikëllimi do t’ju kthehet në gëzim. ²¹Sa herë që gruaja është në lindje, ka dhimbje ngaqë i ka ardhur ora; por pasi lind fëmijën, nuk i kujtohet më ankthi për shkak të gëzimit se në botë ka lindur një fëmijë. ²²Prandaj, edhe ju do të keni pikëllim; por do t’ju shoh sërish, dhe zemra juaj do të gëzohet, dhe askush s’do t’jua rrëmbejë gëzimin. ²³Atë ditë, nuk do të më pyesni për asgjë. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them: nëse i kërkoni Atit çfarëdo gjë në emrin tim, ai do t’ju japë. ²⁴Deri tani, nuk më keni kërkuar asgjë në emrin tim; kërkoni dhe do të merrni, në mënyrë që gëzimi juaj të bëhet i plotë”.

16:16 “edhe pak” Kjo frazë shfaqet shpesh te Gjoni (shih 7:33; 12:35; 13:33; 14:19). Ka patur një sërë teorish për kuptimin e kësaj fraze idiomatike.

1. Shfaqjet pas ringjalljes
2. Ardhja e Dytë
3. Ardhja e Jezusit nëpërmjet Frymës së Shenjtë

Në dritën e kontekstit, numri 1 është e vetmja mundësi (shih v. 22). Dishepujt ishin të pëstjelluar nga kjo thënie (shih v. 17-18).

16:17 “Pastaj, disa prej dishepujve të tij i thanë njëri-tjetrit” Kjo është një tjetër pyetje si 13:36; 14:5, 8, 22. Jezusi i përdor këto pyetje për t’i siguruar dhe për t’u zbuluar veten e tij. Një karakteristikë e Gjonit është se përdor dialogun për të zbuluar të vërtetën. Te Gjoni gjenden njëzet e shtatë biseda me, ose për, Jezusin. Po kështu, është karakteristike për Gjonin që dëgjuesit e Jezusit nuk kuptojnë atë që thotë ai (shih v. 18). Ai është nga lart; ata janë nga poshtë.

■ **“dhe „sepse unë po shkoj tek Ati”** Jezusi e shprehu këtë te 16:5, ndërsa frazën “pas pak” te 16:16. Në njëfarë mënyre, kjo është një referencë shumë e veçantë për Mesian (shih 13:1, 3; 16:28; 17:24).

■ **“nuk do të më shihni...do të më shihni”** Ka dy fjalë të ndryshme për “shoh” te v. 16 dhe 17. Duket se janë sinonime. Nëse është kështu, ndoshta këtu bëhet fjalë vetëm për një periudhë kohore dhe ka gjasa që kjo të ketë qenë koha midis vdekjes së Jezusit në kryq dhe mëngjesit të ringjalljes.

Të tjerë mendojnë se dy FOLJET dhe FRAZAT i referohen shikimit “fizik” dhe shikimit “shpirtëror dhe, në këtë mënyrë, i referohen (1) kohës midis Kalvarit dhe mëngjesit të së dielës, ose (2) kohës midis Ngjitjes në qiell dhe Ardhjes së Dytë.

Fakti se FOLJA e parë (*theōreō*) është në KOHËN E TASHME, si në v. 16 ashtu dhe 17, ndërsa e dyta (*horaō*) është në KOHËN E ARDHME, si në v. 16 ashtu dhe 17, duket se mbështet teorinë e sinonimisë.

16:18 “Kështu, ata po thoshin” Kjo është në KOHËN E PAKRYER, që mund të nënkuptojë se (1) ata po e thoshin vazhdimisht, ose (2) filluan të thoshin.

■ **“Ç’është kjo që po thotë ai?”** Ata që ishin me të, që e dëgjuan dhe panë mrekullitë e tij, nuk e kuptonin gjithmonë (shih 8:27,43; 10:6; 12:16; 18:4). Këtë do ta lehtësonte shërbesa e Frymës.

16:19: “Jezusi e dinte që donin ta pyesnin” Shpesh, Jezusi i njihte mendimet e njerëzve (shih 2:25; 6:61, 64; 13:11). Është e vështirë të dish me siguri nëse kjo ishte (1) nga natyra e tij hyjnore; (2) nga mençuria e tij për të kuptuar njerëzit dhe situatat; apo (3) nga të dyja.

16:20 “Me të vërtetë, me të vërtetë, po ju them” Fjalë për fjalë, kjo është “Amen, amen” (shih Temën e Veçantë në 1:51). “Amen” ishte fjalë e DhV (*aman, emeto, emunah*) që donte të thoshte “besim” (shih Hab. 2:4). Etimologjia e saj parësore ishte “të jesh i patundur”, ose “të jesh i sigurt”. Më vonë, u përdor në mënyrë të figurshme për besnikërinë e Perëndisë, gjë që përbën dhe sfondin e konceptit biblik të besimit/besnikërisë. Jezusi është i vetmi që e filloi ndonjëherë fjalinë me këtë fjalë. Duket se ka ngjyrimin: “kjo është një thënie e rëndësishme dhe besnike; dëgjojeni me kujdes”.

■ **“do të qani dhe do të vajtoni”** Kjo nënkuptonte trishtimin zëllartë dhe shprehës, që ishte karakteristikë e zakoneve të zisë judaike (shih 11:31, 33; 20:11). Tri herë, Jezusi përdori SHUMËSIN theksues “ju”, kur foli për trishtimin e dishepujve (v. 20 [dy herë] dhe v. 22). Udhëheqja do të thotë

1. natyrë prej shërbëtori
2. refuzim nga bota
3. përndjekje si Zotëria ynë

■ **“do të pikëlloheni, por pikëllimi do t’ju kthehet në gëzim”** Ç’premtim madhështor për dishepujt në mes të pëstjellimit dhe moskuptimit të tyre. Gjithçka që Jezusi i premtoi këtij grupi bazë të dishepujve u përmbush që në shfaqjen e parë të tij pas ringjalljes të dielën e parë në darkë, pas ringjalljes, në dhomën e sipërme.

1. Ai nuk do t’i braktisë (shih 14:18; 16:16, 19; 20:19)
2. Do të kthehej për ta (shih 14:18; 16:16, 19; 20:19)
3. Do t’u jepte paqe (shih 16:22; 20:19)

4. Do t'u jepte Frymën (shih 15:26; 20:22)

16:21 “Sa herë që gruaja është në lindje” Metafora e gruas në lindje është e përhapur në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Zakonisht, përdorej, për të theksuar natyrën e papritur ose pashmangshmërinë e lindjes, por, këtu, fokusi është te qëndrimi i nënës para dhe pas lindjes. Shpesh, kjo metaforë lidhet me “dhimbjet e lindjes” së Epokës së Re (shih Isa. 26:17-18; 66:7-14; Marku 13:8). Pikërisht për këtë e kishte fjalën Jezusi dhe kjo është arsyeja pse dishepujt, që ishin ende nga kjo anë e kryqit, ringjalljes dhe ngritjes në qiell, nuk i kuptuan fjalët e Jezusit!

16:23 “Atë ditë” Kjo është një tjetër fraze idiomatike hebraike (si lindja e fëmijës, shih v. 21), që, zakonisht, shoqërohet me ardhjen e Epokës së Re (shih 14:20; 16:25-26).

■ **“nuk do të më pyesni për asgjë”** Ka dy fjalë të ndryshme për “pyetje” dhe “pyes” në këtë varg (shih v. 26). E para nënkupton “bëj një pyetje” (shih 16:5, 19, 30). Nëse ky është përkthimi i saktë, Jezusi e kishte fjalën për të gjitha pyetjet e tyre të shprehura në kontekstin e kapitujve 13-17 (shih 13:36; 14:5, 8, 22; 16:17-18). Kështu, fjala e dytë duhet t'i referohet ardhjes së Frymës së Shenjtë (shih 14:16-31; 15:26-27; 16:1-15), I cili do t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve të tyre.

Në disa mënyra, kjo frazë më kujton premtimin e “besëlidhjes së re” të Jer. 31:31-34, ku ardhja e epokës së re do t'u sillte njohuri të plotë gjithë besimtarëve.

■

NASB “nëse i kërkonti Atit çfarëdolloj gjëje në emrin tim”

NKJV “çfarëdo që t'i kërkonti Atit në emrin tim”

NRSV “nëse i kërkonti çfarëdolloj gjëje Atit në emrin tim”

TEV “Ati do t'ju japë çfarëdo që t'i kërkonti në emrin tim”

NJB “çfarëdo që t'i kërkonti Atit, do t'ju japë në emrin tim”

Kjo është FJALI E PAPËRCAKTUAR LIDHORE, jo FJALI KUSHTORE. Duhet kuptuar kështu: lutja në emër të Jezusit nuk do të thotë thjesht që t'i mbyllim lutjet me një formulë rituale, por do të thotë të lutemi për vullnetin, mendjen dhe karakterin e Jezu Krishtit (shih 1 Gjonit 5:13). Shih shënimin në 15:16. Shih Temën e Veçantë: Lutja, e Pakufizuar, por e Kufizuar, në 1 Gjonit 3:22.

Ekziston një variant dorëshkrimor që lidhet me frazën “në emrin tim”. Me kë shkon kjo frazë: me “kërkoj”, apo “jap”, apo me të dyja? Konteksti është lutja, kështu që, ndoshta, duhet të shkojë me “kërkoj”, ndonëse në realitet, gjithçka nga Ati vjen përmes Jezusit (“emri im”, shih 14:13-14; 16:15, 24, 26). Shih Temën e Veçantë: Emri i Zotit në Gjoni 14:13-14.

16:24 “kërkonti dhe do të merrni” “Kërkonti” është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Kjo përqendrohet në faktin se lutjet e besimtarit duhet të jenë këmbëngulëse dhe të vazhdueshme. Në njëfarë kuptimi, besimtarët duhet të kërkojnë vetëm një herë, me besim; por, në një kuptim tjetër, lutja është miqësi me Perëndinë dhe besim i vazhdueshëm në të, pra, vazhdimësi kërkesë (shih Mat. 7:7-8; Luka 11:5-13; 18:1-8).

■ **“që gëzimi juaj të bëhet i plotë”** Kjo është PJESORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE (shih 1 Gjonit 1:4) Lutja që merr përgjigje është arsye për gëzimin tonë! Gëzimi është karakteristikë e ndjekësve të Jezusit (shih 15:11; 16:20-21, 24; 17:13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:25-28

²⁵“Këto gjëra jua kam thënë në mënyrë të figurshme: po vjen ora kur nuk do t'ju flas më me gjuhë të figurshme, por do t'ju flas shkoqur për Atin. ²⁶Atë ditë, do të kërkonti në emrin tim, dhe nuk ju them se do t'i lutem Atit në emrin tuaj; ²⁷sepse vetë Ati ju do, sepse ju më keni dashur dhe keni besuar se unë dola nga Ati. ²⁸Unë dola nga Ati dhe kam ardhur në botë; po e lë sërish botën dhe po kthehem tek Ati”.

16:25 “në mënyrë të figurshme” Mësimet e Jezusit kishin efekt të dyfishtë: (1) u hapnin mendjen njerëzve dhe (2) u bllokonte mendjen (shih Marku 4:10-11; Isa. 6:9-10; Jer. 5:21). Zemra e dëgjuesit është çelësi për t'i kuptuar gjërat në mënyrë të efektshme. Megjithatë, kishte të vërteta që as të shpëtuarit s'mund t'i kuptonin dot pa u kryer ngjarjet e javës së Mundimit (kryqëzimi, ringjallja, shfaqjet e ringjalljes, ngritja në qiell) dhe Rrëshajat.

Shfaqja pas ringjalljes e Jezusit para dy dishepujve në rrugën për në Emaus (shih Luka 24:13-35) mund të na japë disa shenja për mënyrën sesi i mësonte Jezusi apostujt (shih v. 25-27, 29). Ai vetë, në shfaqjet e tij pas ringjalljes, tregoi sesi vlente dhe shpjegonte DhV shërbesën e tij. Kjo përcaktoi modelin e predikimit të Pjetrit te Veprat (*kerigma*, shih Temën e Veçantë në 5:39).

▣ **“do t’ju flas shkoqur”** Shih Temën e Veçantë: Guximi (*Parrhësia*) në 7:4.

16:26 “Atë ditë, do të kërkoni në emrin tim, dhe nuk ju them se do t’i lutem Atit në emrin tuaj” Ky varg shpreh një të vërtetë të rëndësishme. Shumë të krishterë të sotëm mendojnë se nuk mund t’i afrohen Perëndisë drejtpërdrejt! Mirëpo Bibla na mëson se

1. Fryma lutet për besimtarët (shih Rom. 8:26-27)
2. Biri ndërmytetëson për besimtarët në 1 Gjonit 2:1
3. Besimtarët mund t’i afrohen Perëndisë drejtpërdrejt me lutje për shkak të Krishtit

16:27 “sepse vetë Ati ju do” Fjala “dashuri” këtu, *fileō*, përdoret edhe te 5:20 për dashurinë që ka Ati për Jezusin. Ç’thënie e jashtëzakonshme, që përforcon Gjonin 3:16 (që përdor fjalën *agapaō*). Jezusi nuk mundohet të qetësojë një Perëndi ngurrues, por një Atë të dashur, me të cilin Jezusi punon për të kryer synimet e tyre shpenguese!

▣

NASB “nga Ati”

NKJV, NRSV,

TEV, NJB “nga Perëndia”

Ka dy variante në dorëshkrimet greke: (1) “Perëndia” ose “Ati” dhe (2) prania ose mungesa e NYJËS SHQUESE. “Perëndi” shfaqet në dorëshkrimet P⁵, K², A dhe N, ndërsa “Perëndia” shfaqet në dorëshkrimet C³ dhe W. Ky duket dhe varianti më i vështirë dhe më i pazakontë. Një nga parimet e Kritikës së Tekstit (shih Shtojcën) është se fjala më e vështirë ose më e pazakontë ka gjasa të jetë origjinalja, sepse skribët prireshin ta ndryshonin. Dhiata e Re greqisht e United Bible Societies i jep vlerësimin “C” (në vështirësinë e vendimit).

Megjithatë, “Atë” shfaqet në dhe “Ati” në K¹ B, C*, D dhe L. Përputhet më mirë me kontekstin.

▣ **“sepse ju më keni dashur dhe keni besuar se unë dola”** Këto janë dy DËFTORE TË KRYERA VEPRORE. Dashuria dhe besimi në Jezusin përgatisin skenën për bashkësinë me Atin. Mendimi i Barclay Newman dhe Eugene Nida te *A Translator’s Handbook on the Gospel of John (Doracak i përkthyesit për ungjillin e Gjonit)* është shumë interesant:

“Këto thënie tregojnë se, për Gjonin, konceptet e dashurisë, bindjes dhe besimit janë thjesht mënyra të ndryshme për të shprehur lidhjen e besimtarit me Birin” (f. 518).

Për “keni besuar” shih Temën e Veçantë: Përdorimi i “Besoj” nga Gjoni, në 2:23.

16:28 “unë dola... dhe kam ardhur” Kjo është KOHË AORISTE e ndjekur nga KOHA E KRYER. Jezusi lindi në Betlehem (Mishërimi) dhe rezultatet e ardhjes së tij vazhdojnë (pra, “Unë jam gjithmonë me ju”, shih Mat. 28:20).

Fakti se Jezusi “doli nga Ati” (shih v. 27, 30; 8:42; 13:3; 17:8) nxjerr në pah

1. Paraekzistencën e tij
2. Natyrën e tij hyjnore
3. Zbulesën e plotë të Atit prej tij

▣ **“po e lë sërish botën dhe po kthehem tek Ati”** Bëhet fjalë për ngjitjen e tij të ardhshme në qiell dhe për fillimin e shërbesës së “Ndihmuesit”, si dhe shërbesën ndërmytetësuese të Jezusit (shih Heb. 7:25; 9:24; 1 Gjonit 2:1). Ashtu si në Gjoni 1:1 u shpreh paraekzistenca e Jezusit, në këtë varg shprehet rikthimi i Jezusit në lavdi dhe në pushtet (shih 17:5, 24).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 16:29-33

²⁹Dishepujt i thanë: “Ja, tani po flet shkoqur dhe nuk po përdor gjuhë të figurshme. ³⁰Tani e dimë se ti di gjithçka, dhe s’ke nevojë që të pyesë askush; nga kjo besojmë se ti erdhe nga Perëndia”. ³¹Jezusi iu përgjigj: “Tani besoni? ³²Ja, po vjen ora dhe madje tashmë ka ardhur, kur ju do të shpërndaheni, secili në shtëpi të vet, dhe do të më lini vetëm; e, megjithatë, nuk jam i vetëm, sepse kam Atin me mua. ³³Këto gjëra jua kam thënë që në mua të keni paqe. Në botë keni mundime, por merrni zemër; unë e kam mposhtur botën”.

16:29 “po flet shkoqur” Shih Temën e Veçantë: Guximi (*Parrhësia*) në 7:4.

16:30 Kjo fjali duhet kuptuar në kuadër të faktit se Jezusi e dinte pyetjen e dishepujve në v. 19. Ky pohim i tyre pasqyron besimin e tyre në rritje, por ende të paplotë. Ata kishin parë dhe dëgjuar shumë gjëra; a funksionoi realisht kjo ngjarje (v. 19) si pikëkthesë e rëndësishme në botëkuptimin e tyre? Mua, kjo më tingëllon si një nga ato thëniet me qëllim të mirë, por të tepruara, të Pjetrit (shih *The Jerome Biblical Commentary*, f. 456).

16:31 “Tani besoni?” Kjo mund të jetë, ose pyetje, ose thënie. Shumica e përkthimeve anglisht e kuptojnë si pyetje. Edhe në këtë periudhë kyçe, besimi i apostujve nuk ishte i plotë. Edhe besimi fillestar, por i dobët, i besimtarëve të sotëm pranohet nga Perëndia kur ata i përgjigjen Jezusit në bazë të dritës që kanë. Mungesa e besimit nga ana e dishepujve do të dalë në pah kur ta braktisin Jezusin gjatë gjykimeve dhe kryqëzimit të tij.

16:32 “ju do të shpërndaheni, secili në shtëpi të vet, dhe do të më lini vetëm” Me sa duket, vetëm Gjoni ishte i pranishëm në gjykimet dhe kryqëzimin e Jezusit (shih Mat. 26:31; nga Zak. 13:7). Gjoni 21:1-3 lë të kuptohet se një sërë apostujsh i ishin kthyer peshkimit si profesion.

Jezusi mbeti pa shoqëri njerëzore (shih Mat. 26:38, 40-41, 43, 45) por kurrë pa shoqëri hyjnore (shih 8:16, 29), deri në momentin e kryqëzimit, kur mbajti mbi vete mëkatën e gjithës botës (shih Mat. 27:45-46).



NASB “secili në shtëpi të vet”

NKJV “në të vetat”

NRSV “në shtëpinë e vet”

NJB “në jetën e vet”

TEV “në shtëpitë tuaja”

REB, NET,

NIV “në shtëpi të vet”

NKJV është përkthim i fjalëpërfjalshëm. Shumica e përkthimeve në anglisht mendojnë se bëhet fjalë për shtëpinë. Bultman mendon se bën fjalë për “pronat” ose “zotërimet” (NIDOTTE, vëll. 2, f. 839), duke iu referuar Jezusit si krijuesi (1:3; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2).

16:33 “në mua të keni paqe” Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE (shih 14:27). Si paqja objektive, ashtu dhe ajo objektive, gjenden dhe ruhen në Krishtin. Shih Temën e Veçantë: Paqja në 14:27

■ **“bota”** Gjoni e përdor “botën” në këtë kontekst për të nënkuptuar shoqërinë njerëzore që organizohet dhe funksionon pa Perëndinë. Shih Temën e Veçantë: *Kosmos* në 14:17.

■ **“keni mundime”** Ata do të përballen me përndjekjen që vuajti dhe Jezusi (shih 15:18-25; Mat. 5:10-12; Veprat 14:22; 1 Thes. 3:3). Përndjekja (pra, *thlipsis*) është një mënyrë që zbulon ndjekësit e vërtetë të Jezusit.

Te Zbulesa, ekziston një dallim teologjik midis “zemërimit” dhe “përndjekjes”. Zemërimi i Perëndisë nuk bie kur mbi besimtarët, por zemërimi i jobesimtarëve bie mbi besimtarët. Bota e zbulon veten si pjellë e Satanit nga sulmet që kryen kundër “dritës së botës” (shih 1:1-18; 3:17-21)!

■ **“merrni zemër”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE (shih Mat. 9:2, 22; 14:27; Marku 6:50; 10:49; Veprat 23:11). Duken si fjalët që Jahve i tha Jozueut (shih Joz. 1:6, 9, 18; 10:25).

■ “**unë e kam mposhtur botën**” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Fitorja është e siguruar përpara Gjetsemanit, përpara Kalvarit, përpara varrit bosh (shih Rom. 8:37; 1 Kor. 15:57; 2 Kor. 2:14; 4:7-15)! Ky s’është aspak dualizëm. Perëndia është në kontroll.

Ashtu si Jezusi e mposhti botën me dashuri dhe me bindjen ndaj atit, edhe besimtarët janë triumfues përmes tij (shih 1 Gjonit 2:13-14; 4:4; 5:4-5; Zbu. 3:21; 12:11).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Cila është lidhja mes kapitullit 15 dhe kapitullit 16?
2. Në marrëdhënie me vargun 5, si ta kuptojmë 13:36?
3. Cila është shërbesa e Frymës së Shenjtë ndaj botës së humbur?
4. Cila është shërbesa e Frymës së Shenjtë ndaj besimtarëve?
5. Pse vargjet 26-27 janë një e vërtetë kaq e rëndësishme kur kemi parasysh prirjet e sotme denominacionale?

GJONI 17

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHEMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Lutja e Jezusit	Jezusi lutet për veten	Lutja kryepriiftërore e Jezusit	Jezusi lutet për dishepujt e vet	Lutja e Jezusit
17:1-5	17:1-5	17:1-5	17:1-5	17:1-23
	Jezusi lutet për dishepujt e vet			
17:6-19	17:6-19	17:6-19	17:6-8	
	Jezusi lutet për gjithë besimtarët		17:9-19	
17:20-26	17:20-26	17:20-24	17:20-23	
		17:25-26	17:24-26	17:24-26

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-26

A. Konteksti historik

1. Ky kapitull është lutja kryepriiftërore e Jezusit për
 - a. vete (v. 1-5)
 - b. dishepujt e vet (v. 6-19)
 - c. ndjekësit e ardhshëm (v. 20-26)

Ajo u bë në një atmosferë sigurie besimi, jo dorëzimi (shih 16:33).

2. Ajo është lutja më e gjatë e regjistruar e Jezusit.
3. Ky kapitull është i vështirë të ndahet në tema sepse të njëjtat motive përsëriten vazhdimisht, diçka karakteristike për shkrimet e Gjonit. Ajo është si tapiceri me motive të përsëritura. Fjalët kyçe janë “lavdi”, “jap”, “njoh”, “dërgoi”, “emri”, “bota” dhe “një”.
4. Fryma e Shenjtë nuk përmendet në këtë kapitull. Kjo është e pazakontë për shkak të pozitës së tij të spikatur në kapitujt 14-16.

B. Karakteristikat e dishepujve në vargjet 6-19

1. Ata janë të zgjedhur
2. Janë të bindur
3. E njohin Perëndinë dhe Krishtin
4. Pranojnë të vërtetën
5. Jezusi është lutur për ta
6. Qëndrojnë në botë

7. Ruhen me anë të fuqisë së tij
8. Janë një, ashtu si Ati dhe Jezusi janë një
9. Kanë gëzimin e tij
10. Nuk janë të kësaj bote
11. Shenjtërohen nga e vërteta
12. Dërgohen ashtu siç u dërgua Jezusi
13. Janë të dashur nga Perëndia, ashtu si Ati deshi Jezusin

C. Fjala “lavdi” te Gjoni

1. Në Septuagintë (LXX), mbi 25 fjalë hebraisht përkthehen me të njëjtën fjalë greke: *doksa*. Fjala kryesore e DhV është *kabot*, që kishte kuptimin “i ndryshëm”, “peshë”, “rëndesë”, “denjësi”, “nam”, “nder”, ose “vezullim/shkëlqim”.
2. Fjala greke *doksa* vjen nga FOLJA “mendoj”, në kuptimin e namit.
3. Kjo fjalë ka shumë ngjyime të ndryshme kuptimore te Gjoni
 - a. Lavdia hyjnore (shih v. 5, 24; 1:14; 12:41; 12:16)
 - b. Zbulesa e Atit me anë të shenjave, mësimëve të Jezusit dhe veprave të tij gjatë javës së Mundimit (shih v. 4, 10, 22; 1:14; 2:11; 7:18; 11:4, 40)
 - c. Veçanërisht kryqi (shih v. 1, 4; 7:39; 12:23; 13:31-32)
 Qartazi, ekziston njëfarë rrjedhshmërie mes këtyre kuptimeve. E vërteta qendrore është se Perëndia i padukshëm zbulohet në një njeri (pra, në Jezu Krishtin) me anë të veprave dhe fjalëve të tij.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 17:1-5

¹Jezusi tha këto gjëra dhe, si ngriti sytë drejt qiellit, tha: “Atë, ora ka ardhur; përlëvdo Birin tënd, që edhe Biri të të përlëvdojë, ²ashtu si i ke dhënë autoritet mbi çdo mish, që të gjithëve atyre që i ke dhënë ti t’u japë jetë të përjetshme. ³Kjo është jeta e përjetshme, që të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezus Krishtin që ti ke dërguar. ⁴Unë të përlëvdova në tokë, pasi kreuva punën që më dhe të bëja. ⁵Tani, o Atë, përlëvdomë bashkë me ty, me lavdinë që kisha me ty para se të fillonte bota”.

17:1 “Jezusi tha këto gjëra” E ka fjalën për ligjëratat në dhomën e sipërme, në kapitujt 13-16.

▣ “**ngriti sytë drejt qiellit**” Ky ishte qëndrimi i zakonshëm judaik gjatë lutjes: duart, koka dhe sytë e hapur ngriheshin drejt qiellit si në bisedë me Perëndinë (shih 11:41; Marku 7:34; Luka 18:13; Psa. 123:1). Jezusi u lut shpesh. Kjo mund të dokumentohet qartë nga ungjilli i Lukës (3:21; 5:16; 6:12; 9:18, 28; 11:1; 22:41-45; 23:34).

▣ “**Atë**” Jezusi i drejtohej rëndom Perëndisë me këtë fjalë (shih 11:41; 12:27-28; Mat. 11:25-27; Luka 22:42; 23:34). Jezusi fliste aramaisht. Fjala aramaisht që përdori ai ishte *Abba*, e cila përdorej kur fëmija i thërriste të atit në shtëpi: “Babi” (shih Marku 14:36). Kjo duhet t’i ketë tronditur dhe fyer jodishepujt e Jezusit!

▣ “**ora ka ardhur**” Kjo tregon se Jezusi e dinte synimin dhe momentin e shërbesës së vet (shih 2:4; 7:6, 8, 30; 8:20; 12:23; 13:1). Ai nuk kapej i papërgatitur nga situatat e panjohura.

▣ “**përlëvdo Birin tënd**” Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE. Jezusi gjithmonë flet për vdekjen e vet me fjalë të ngjashme te Gjoni (shih v. 4; 7:39; 12:23; 13:31-32). Kjo fjalë lidhet edhe me natyrën paraekzistuese hyjnore të Jezusit (shih 1:14 dhe v. 5, 24). Veprimet e Jezusit përlëvdonin Atin. Kishte reciprocitet mes tyre! Shih shënimin në 1:14 dhe Mësimet Kontekstuale, C.

Për “Birin”, shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 3:8.

Ekziston një variant dorëshkrimor në lidhje me “Birin”.

1. Biri me NYJËN SHQUESE gjendet në dorëshkrimet P⁶⁰, x, B, C*, W

2. Biri me PËREMIRIN GJINOR gjendet në dorëshkrimet A, D, C²

UBS⁴ i jep formës #1 vlerësimin “B” (pothuajse i sigurt).

17:2 “autoritet mbi çdo mish” Kjo është një thënie e mahnitshme kur bëhet nga një marangoz nga fshati (shih Gjoni 5:27; Mat. 11:27; 28:18; Luka 10:22). Fjala “autoritet” (*eksusia*) përdoret edhe te 1:12; 5:27; 19:10, 11. Mund të përkthehet “e drejtë ligjore”, “autoritet”, ose “pushtet”.

Fraza “çdo mish” është në NJËJËS (një shprehje hebraisht që nënkupton gjithë njerëzimin; shih Zan. 6:12; Psa. 65:2; 145:21; Isa. 40:5; 66:23; Joeli 2:28).

■ **“të gjithëve atyre që i ke dhënë ti”** Fjala “të gjithëve” është ASNJANËSE dhe në NJËJËS (shih 7, 24) dhe përqendrohet te dishepujt si trup i Krishtit, jo si individë! Kjo FOLJE është DËFTORE E KRYER VEPRORE, dhe bën fjalë për një dhuratë të qëndrueshme! Kjo frazë mbështet paranjohjen dhe zgjedhjen hyjnore (shih v. 6, 9, 12; 6:37, 39; Rom. 8:29-30; Efe.1:3-14). Në DhV, zgjedhja bëhej për shërbesë, ndërsa në DhR bëhet për shpëtim shpirtëror, të sigurt e të përjetshëm. Besimtarët thirren edhe për shërbesë. Zgjedhja nuk është vetëm akt hyjnor, por duhet lidhur (me anë të besëlidhjes) me përgjegjësinë njerëzore. Ajo nuk fokusohet te vdekja, por te jeta! Besimtarët zgjidhen për “shenjteri” (shih Efe. 1:4), jo për një pozitë të privilegjuar. Kjo frazë nuk duhet kuptuar sikur Ati i jep Jezusit disa njerëz, por jo disa të tjerë.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhiatën e Vjetër, kjo fjalë përdorej pikësisht për shërbesë; në Dhiatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovranë të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjteria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte yjësia përkundrejt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të së vërtetave doktrimore (Perëndia si transcendent në dallim nga Perëndia si imanent). Për shembull: siguria e besimit përkundrejt qëndresës në besim; Jezusi si i barabartë me Atin përkundrejt Jezusit si i nënshtuar ndaj atit; liria e krishterë përkundrejt përgjegjësisë së të krishterit ndaj partnerit të besëlidhjes; etj.)

Koncepti teologjik i “besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë ai që merr nismën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ruhë që të mos e përdorësh vargje “provë” për njërën anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën, ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

■ **“t’u japë jetë të përjetshme”** Jeta e përjetshme është dhuratë e Perëndisë me anë të Krishtit (shih 5:21, 26; 6:40, 47; 10:28; 1 Gjonit 2:25; 5:11). Ajo do të thotë, “jeta e Perëndisë”, “jeta e epokës së re”, ose “jeta e ringjalljes”. Nuk është kryesisht sasi, por cilësi (shih 10:10).

17:3 “Kjo është jeta e përjetshme” Ky është përcaktimi i “jetës së përjetshme” që fut Gjoni. Ky varg tregon dy të vërteta madhore të krishterimit: (1) monoteizmi (shih LiP. 6:4-6) dhe (2) Jezusi si Mesia davidik (shih 2 Samueli 7). Kjo “jetë e përjetshme” nuk është diçka që rezervohet për të ardhmen, por është e disponueshme tani në Jezu Krishtin.

■ **“që të të njohin ty”** Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për të njohur të vërtetën njohëse në lidhje me Perëndinë, ndonëse ekziston një e vërtetë e tillë që duhet pohuar, por përdoret në kuptimin semitik të marrëdhënies personale. Gjithsesi, e vërteta është se Jezusi është Mesia, zbuluesi i plotë dhe tërësorë e Perëndisë së vetëm e të vërtetë (shih 1:12, 14; Kol. 1:15; Heb. 1:3) dhe se individit duhet të besojë, ta pranohet, të pendohet, t’i bindet dhe të ushtrojë qëndresë në të.

■ “të vetmin Perëndi të vërtetë” DhR ishte unike në theksimin që i bënte ekzistencës së të vetmit Perëndi (shih Eks. 8:10; 9:14; LiP. 4:35,39; 6:4; 33:26; 1 Sam. 2:2; 2 Sam. 7:22; 1 Mbre. 8:23; Isa. 37:20; 44:6,8; 45:6-7,14,18,21,22; 46:9; Gjoni 5:44; 1 Kor. 8:4,6; 1 Tim. 1:17; 2:5; Juda v. 25). Për të folur çiltër, duhet thënë se paraqitja që i bën DhV natyrës unike dhe të vetme të Perëndisë jepet në sfondin e botëkuptimit të lashtë në Lindjen e Afërt se ekzistonin shumë qenie shpirtërore. Ka vetëm një Perëndi, por ka dhe qenie të tjera shpirtërore (shih Eks. 15:11; LiP. 3:24; Psa. 86:8; 89:6).

TEMË E VEÇANTË: MONOTEIZMI

Koncepti i “monoteizmit” (vetëm një Perëndi), dhe jo thjesht i “perëndisë së lartë” të politeizmit, apo perëndisë së mirë të dualizmit iranian (zoroastrianizmi), është unik për Izraelin (Abrahami, 2000 para K.). Vetëm një përjashtim i rrallë ekzistoi shkurtimisht në Egjipt (Amenhotepi IV, i njohur edhe si Akhenateni, 1367-1350, ose 1386-1361 para K.).

Ky koncept shprehet me një sërë frazash në DhV.

1. “askush s’është si Jahve, *Elohim* ynë”, (Eks. 8:10; 9:14; LiP. 33:26; 1 Mbre. 8:23)
2. “askush tjetër përveç tij” (LiP. 4:35,39; 32:39; 1 Sam. 2:2; 2 Sam. 22:32; Isa. 45:21; 44:6,8; 45:6,21)
3. “Jahve është një” (LiP. 6:4; Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4,6; 1 Tim. 2:5; Jakobi 2:19)
4. “askush si ti” (2 Sam. 7:22; Jer. 10:6)
5. “Vetëm ti je Perëndi” (Psa. 86:10; Isa. 37:16)
6. “Para meje nuk ishte formuar asnjë perëndi, dhe s’do të ketë tjetër pas meje” (Isa. 43:10)
7. “Nuk ka tjetër; përveç meje... nuk ka tjetër” (Isa. 45:5, 6, 22)
8. “S’ka asnjë Perëndi tjetër” (Isa. 45:14, 18)
9. “S’ka tjetër veç meje” (Isa. 45:21)
10. “nuk ka tjetër... nuk ka tjetër si unë” (Isa. 46:9)

Duhet pranuar se kjo doktrinë kyçe është zbuluar në mënyrë të shkallëzuar. Pohimet e hershme mund të kuptohen si “henoteizëm”, ose si monoteizëm praktik (ekzistojnë perëndi të tjerë, por vetëm një perëndi për ne; shih Eks. 15:11; 20:2-5; LiP. 3:28; 5:7; 6:4,14; 10:17; 32:12; 1 Mbre. 8:23; Psa. 83:18; 86:8; 136:1-2).

Pasazhet e parë që fillojnë të vënë në dukje faktin se ka vetëm një perëndi (monoteizmi filozofik) janë të hershëm (shih Eks. 8:10; 9:14; LiP. 4:35, 39; 33:26). Pohimet e plota dhe tërësore gjenden te Isaia 43-36 (shih 43:11; 44:6, 8; 45:7, 14, 18, 22; 46:59, 9).

DhR aludon për LiP. 6:4 te Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4, 6; Efe. 4:6; 1 Tim. 2:5; dhe Jakobi 2:19. Jezusi e citon si urdhërimin e parë te Mat. 22:36-37; Marku 12:29-30; Luka 10:27. DhV, ashtu si DhR, pohon realitetin e qenieve të tjera shpirtërore (demonët, engjëjt), por vetëm një krijues/Perëndi shpengues (JHVH, Zan. 1:1).

Monoteizmi biblik karakterizohet nga si më poshtë:

1. Perëndia është një dhe i pashoq (ontologjia e tij merret si fakt i kryer, nuk specifikohet)
2. Perëndia është personal (shih Zan. 1:26-27; 3:8)
3. Perëndia është etik (shih Eks. 34:6; Neh. 9:17; Psa. 103:8-10)
4. Perëndia i krijoi njerëzit në shëmbëllimin e vet (Zan. 1:26-27) për bashkësi me ta (shih #2). Ai është Perëndi xheloz (shih Eks. 20:2-3)

Nga DhR:

1. Perëndia ka tre shfaqje të përjetshme dhe personale (shih Tema e Veçantë: Trinia, në 8:11)
2. Perëndia është zbuluar në mënyrë të përsosur dhe të plotë në Jezusin (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:15-19; Heb. 1:2-3)
3. Plani i përjetshëm i Perëndisë për shpengimin e njerëzimit ë rënë është ofrimi flijues i Birit të tij të vetëm (Isaia 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21; Fil. 2:6-11; Hebrenjve)

Në njëfarë kuptimi, disa pasazhe të DhV reflektojnë henoteizmin (ka shumë perëndi [*elohim*], por vetëm një Perëndi për Izraelin). Moisiu e pranonte ekzistencën e qenieve të tjera shpirtërore. Kjo nuk synonte të pohonte se idhujt e kombeve ishin reale, por se pas idhujve fizikë qëndronte realiteti demoniak (shih 1 Kor. 10:19-20).

MBIEMRI tjetër është “i vërtetë” (*alēthinos*). Ky term, si dhe termi i ngjashëm me të (*alēthēs*), përdoret kaq shpesh në shkrimet e Gjonit, por është e vështirë t’ua japësh kuptimin me saktësi. Ata kanë një fushë të gjerë kuptimore (semantike). Sfondi metaforik i DhV do të ishte diçka e besueshme dhe besnike (nga *emeto*). Sfondi grek do të nënkuptonte diçka që është e zbuluar, e shfaqur qartë. Në njëfarë kuptimi, e vërteta është e kundërta e

gënjeshtrës (shih Titi 1:2). Në greqisht, kur një emri i shtohet prapashtesa *inos* (*alēthinos*), ai nënkupton diçka nga e cila bëhet diçka tjetër. Ka gjasa, që përdorimet e mëposhtme do të na japin një kuptim të përgjithshëm për këto terma.

TEMË E VEÇANTË: “I VËRTETË” NË SHKRIMET E GJONIT

1. Perëndia Atë
 - a. Perëndia është i vërtetë/i besueshëm (shih Gjoni 3:33; 7:18,28; 8:26; 17:3; Rom. 3:4; 1 Thes. 1:9; 1 Gjonit 5:20; Zbu. 6:10)
 - b. Rrugët e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 15:3)
 - c. Gjykimet e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 16:7; 19:2)
 - d. Thëniet e Perëndisë janë të vërteta (shih Zbu. 19:11)
2. Perëndia Bir
 - a. Biri është i vërtetë/e vërteta
 - 1) drita e vërtetë (shih Gjoni 1:9; 1 Gjonit 2:8)
 - 2) hardhia e vërtetë (shih Gjoni 15:1)
 - 3) plot me hir dhe të vërtetë (shih Gjoni 1:14, 17)
 - 4) ai është e vërteta (shih Gjoni 14:6; 8:32)
 - 5) ai është i vërtetë (shih Zbu. 3:7, 14; 19:11)
 - b. Dëshmia e Birit është e vërtetë (shih Gjoni 18:37)
3. Mund të ketë kuptim krahasues
 - a. Ligji i Moisiut në dallim nga hiri dhe e vërteta e Jezusit (shih Gjoni 1:17)
 - b. Tabernakulli në shkretëtirë në dallim nga tabernakulli qiellor (shih Heb. 8:2; 9:1)
4. Siç ndodh shpesh te Gjoni, kjo fjalë ka një sërë ngjyrimesh kuptimore (hebraike dhe greke). Gjoni i përdor të gjitha për të përshkruar Atin dhe Birin si persona, si folës, dhe si mesazhin e tyre, i cili u duhet transmetuar ndjekësve të tyre (shih Gjoni 4:23; 19:35; Heb 10:22; Zbu. 22:6).
5. Për Gjonin, këto dy mbiemra përshkruajnë Atin si të vetmin hyjni të besueshëm (shih 5:44; 1 Gjonit 5:20) dhe Jezusin si zbuluesin e tij të vërtetë dhe të plotë duke pasur si synim faktet shpenguese, jo thjesht ato njohëse!

■ **“dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”** Ky mund të jetë një tjetër koment redaktorial i Gjonit. Ky theksim i Jezusit si “i dërguar” nga Ati është një dualizëm vertikal, i cili shfaqet në mënyrë të përsëritur te Gjoni (shih 3:17,34; 5:36,38; 6:29,38,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,8,18,21,23,25; 20:21). Rabinët e përdornin termin *apostellō* për të kuptuar dikë që dërgohej si përfaqësues zyrtar. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*) në 5:24.

17:4: “Unë të përlevdova në tokë” (Shih shënimin në 13:32). Fjala “lavdi” mund të përdoret në kuptimin (1) “i jap lavdi” dikujt; ose (2) “të zbuloj lavdinë e” dikujt. Vargu 6 nënkupton #2. Një nga detyrat kryesore të Jezusit ishte të zbulonte Atin (shih 1:14, 18).

■ **“pasi kreu punën”** Rrënja greke, *telos*, nënkupton “të përmbushësh plotësisht” (shih 4:34; 5:36; 19:30). Puna ishte e trefishtë.

1. Zbulesa e Atit (shih 1:14, 18)
2. Shpengimi i njerëzimit të rënë (shih Marku 10:45; 2 Kor. 5:21)
3. Një shembull i njerëzimit të vërtetë (shih 13:31; 1 Pje. 2:21)
4. Po kështu, puna ndërmjetësuese e Jezusit vazhdon (shih 1 Gjonit 2:1; Heb. 7:25; 9:24).

17:5 “përlevdome... lavdinë” Ky varg thekson paraekzistencën e Krishtit (shih 1:1,15; 6:62; 8:58; 16:28; 17:11,13,24; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-11; Kol. 1:17; Heb. 1:3; 10:5-8). Jezusi ua kishte zbuluar “lavdinë” dishepujve me anë të shenjave dhe mrekullive të tij (shih 1:14; 2:11; 11:4, 40; 12:28). Tani, “lavdia” e tij më e lartë do të ishte vdekja, ringjallja dhe ngritja e tij sërish në lavdinë e qiellit (shih v. 24; Fil. 2:5-6). Kjo FOLJE është URDHËRORE AORISTE VEPRORË, e përdorur si kërkesë ndaj Atit. Shih shënimin e plotë për “lavdinë” në 1:14.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 17:6-19

⁶“Ua kam zbuluar emrin tënd njerëzve që me dhe nga kjo botë; të tutë ishin dhe ti m’i dhe, dhe ata e kanë ruajtur fjalën tënde. ⁷Tani, ata kanë kuptuar se gjithçka që më ke dhënë është prej teje; ⁸sepse unë u kam dhënë fjalët që më dhe ti; dhe ata i pranuan dhe kuptojnë vërtetë se unë dola prej teje, dhe besuan se ti më dërgove. ⁹Unë lutem për ta; nuk lutem për botën, por për ata që më ke dhënë ti; sepse janë të tutë; ¹⁰dhe të gjitha gjërat e mia janë të tuat, dhe të tuat janë të miat; dhe unë jam përlëvduar në to. ¹¹Unë nuk jam më në botë; mirëpo atë vetë janë në botë, ndërsa unë po vij te ti. Atë i shenjtë, ruaji në emrin tënd, atë emër që më ke dhënë ti, që ata të jenë një ashtu si ne jemi një. ¹²Sa isha me ta, i ruajta në emrin tënd, që ti më ke dhënë; dhe unë i ruajta dhe asnjë prej tyre nuk humbi, përveç birit të humbjes, në mënyrë që të përmbushej Shkrimi. ¹³Por tani, unë vij te ti; dhe këto gjëra i them në botë në mënyrë që ata ta kenë të plotë gëzimin tim në ta. ¹⁴Unë u kam dhënë fjalën tënde, dhe bota i ka urryer, sepse nuk janë të botës, ashtu siç unë nuk jam i botës. ¹⁵Nuk po të lutem që t’i heqësh nga bota, por t’i ruash nga i ligu. ¹⁶Ata nuk janë të botës, ashtu si unë nuk jam i botës. ¹⁷Shenjtëroji në të vërtetën; fjala jote është e vërteta. ¹⁸Ashtu si më dërgove ti në botë, edhe unë i kam dërguar në botë. ¹⁹Për hiri e tyre e shenjtëroj veten, që dhe ata vetë të shenjtërohen në të vërtetën”.

17:6 “Ua kam zbuluar emrin tënd” Emrat hebraisht synonin të pasqyronin karakterin e personit që i mbante (shih v. 11, 12, 25-26; Psa. 9:10). Edhe nga ana teologjike, kjo frazë pohon se, të shohësh Jezusin do të thotë të shohësh Perëndinë (shih Gjoni 1:18; 12:45; 14:8-11; Kol. 1:15; Heb. 1:3).

“Emri” luan rol të rëndësishëm teologjik në dialogët e dhomës së sipërme (shih 14:13, 14, 26; 15:16, 21; 16:23, 24, 26; 17:6, 11, 12, 26). Në kapitullin 17, për Perëndinë përdoren dy tituj unikë.

1. Atë i shenjtë, v. 11
2. Atë i drejtë, v. 25

▣ **“njerëzve që më dhe”** Teologjikisht, këtu bëhet fjalë për zgjedhjen hyjnore (shih v. 2, 9, 24; 6:37, 39). Askush nuk vjen dot nëse

1. nuk ia jep Perëndia
2. nuk e tërheq Fryma (6:44, 65)
3. nuk pranon (1:12); beson (3:16)

▣ **“e kanë ruajtur fjalën tënde”** Bindja është kyçe (shih 8:51, 55; 14:23; 15:10, 20). Kjo përdoret në një kuptim të ngjashëm me fjalën e DhV “i panjollë” (shih Noeu, Zan. 6:9; Abrahami, Zan. 17:1; Izraeli, LiP. 18:13; Jobi, Jobi 1:1). Nuk nënkupton bindje të përsosur ose mungesë mëkati, por dëshirën për të dëgjuar dhe kryer gjithçka që të zbulohet; deri tani, bën fjalë për besimin e dishepujve në Jezusin, qëndrimin në Jezusin dhe dashurinë për njëri-tjetrin ashtu siç i ka dashur Jezusi.

17:7: “kanë kuptuar” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE, e ndjekur nga “se” (*hoti*), që i referohet përmbajtjes së një mesazhi. Për përdorimin që i bën Gjoni “*hoti*”-t, shih Temën e Veçantë në 2:23, #4.

▣ **“se gjithçka që më ke dhënë është prej teje”** Jezusi foli atë që i ishte zbuluar nga Ati (shih v. 8; 7:16; 12:48-49).

17:8 “ata i pranuan” Ata e pranuan mesazhin e Jezusit për Perëndinë. Nuk na jepet asnjë KUNDRINOR I DREJTË. Në 1:12, KUNDRINORI I DREJTË i pranoj/besoj është vetë Jezusi; këtu, është mesazhi për Perëndinë që ka sjellë Jezusi (shih v. 4). Kjo nxjerr në pah aspektet binjake të ungjillit si (1) person, dhe si (2) mesazh.

▣ **“pranuan... besuan”** Këto janë DËFTORE AORISTE VEPRORE. Këto të vërteta bëjnë fjalë për origjinën dhe mesazhin hyjnor të Jezusit (shih 5:19; 6:68-69; 12:48-49; 16:30; 17:18,21,23,25).

17:9 “Lutem për ta” Jezusi është Ndërmjetësuesi ynë (shih 1 Tim. 2:5; Heb. 8:6; 9:15; 12:24) dhe Avokati ynë (shih 1 Gjoni 2:1). Edhe Ati përfshihet në këto detyra (shih 16:26-27), bashkë me Frymën (shih Rom. 8:26-27). Të tre Personat e Trinisë përfshihen në të gjitha aspektet e shpengimit.

▣ **“bota”** *Kosmos* përdoret tetëmbëdhjetë herë në këtë kapitull. Jezusi kujdeset për (1) planetin (shih 17:5, 24) dhe (2) marrëdhënien e besimtarëve me natyrën e rëndë të planetit (shih 1:10; 17:6,9,11,13,14, 15,16,17,18,21,23). Në

Shkrimet e Gjonit, kjo fjalë do të thotë në mënyrë unike “shoqëria njerëzore, e organizuar dhe funksionuese veçmas Perëndisë”. Nganjëherë, nënkupton (1) planetin; (2) gjithë jetën në planet; ose (3) jetën veçmas Perëndisë. Shih Temën e Veçantë në 14:17.

17:10 “dhe të gjitha gjërat e mia janë të tuat, dhe të tuat janë të miat” Kjo zbulon unitetin e Trinisë (shih v. 11, 21-23; 16:15). Për Trininë, shih Temën e Veçantë në 14:26.

■ **“unë jam përlëvduar në to”** Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE. Jeta e dishepullit duhet t’i japë lavdi Jezusit, ashtu si ai i dha lavdi Atit. Sa përgjegjësi e mahnitshme!

17:11 “nuk jam më në botë” Kjo i referohet (1) të ardhmes së afërt (ngritjes në qiell), kur Jezusi do të kthehet tek Ati (shih Veprat 1:9-10) ose (2) shërbesës publike të Jezusit.

■ **“Atë i shenjtë”** Ky term, “i shenjtë”, përdoret vetëm këtu për Atin në gjithë DhR (përdoret edhe në titullin, “i shenjtë”, te Pje. 1:15) si në DhV. Ky MBIEMËR (*hagios*), shpesh, i jepet dhe Frymës (shih 1:33; 14:26; 20:22). Po kjo rrënjë greke përdoret edhe për dishepujt në v. 17 (*hagiasmos*) dhe për Jezusin në v. 19 (*hagiazō*).

Etimologjia bazë e kësaj rrënje është “të veçosh për shërbesën e Perëndisë” (shih v. 17, 19). Përdoret për njerëz, vende dhe gjëra që jepen vetëm për përdorim të Perëndisë. Përshkruan karakterin transcendent të Perëndisë (i Shenjti i Izraelit) dhe dallimin nga gjërat e rëna fizike dhe tokësore. Jezusi ishte i shenjtë; kur ndjekësit e tij bëhen më tepër si ai, edhe ata pasqyrojnë “shenjtërinë”. Rrënja e fjalës “shenjtë” vjen nga fjala greke “i shenjtë”. Besimtarët janë të shenjtë sepse janë në Krishtin, por ata duhet të bëhen të shenjtë edhe ndërsa jetojnë për të, si ai dhe në të.

TEMË E VEÇANTË: I SHENJTË

I. Dhiata e Vjetër

- A. Etimologjia e fjalës *kadosh* (BDB 872) është e paqartë; ka gjasa të jetë kanaanite. Ka mundësi që një pjesë e rrënjës së saj (pra, *kd*) të ketë kuptimin “ndaj”. Ky është burimi i përcaktimit popullor “i ndarë (nga kultura kanaanite, shih LiP. 7:6; 14:2, 21; 26:19) për përdorim nga Perëndia”.
- B. Ajo lidhet me praninë e Perëndisë në objekte, vende, kohë dhe persona të ndryshëm. Nuk përdoret te Zanafilla, por bëhet e zakonshme te Eksodi, Levitiku dhe Numrat.
- C. Në literaturën profetike (sidomos te Isaia dhe Osea), elementi personal, që më parë ishte i pranishëm por jo i theksuar, tani del në pamje të parë. Bëhet mënyrë për të përcaktuar thelbin e Perëndisë (shih Isa. 6:3). Perëndia është i shenjtë. Emri i tij, që përfaqëson karakterin e tij, është i shenjtë. Populli i tij, që duhet t’ia zbulojë kësaj bote nevojtarë karakterin e tij, është i shenjtë (nëse i bindet besëlidhjes me besim).
- D. Mëshira dhe dashuria e Perëndisë janë të pandashme nga konceptet teologjike të besëlidhjeve, drejtësisë dhe karakterit thelbësor. Këtu qëndron tensioni brenda Perëndisë kundrejt njerëzimit të pashenjtë, të rënë dhe rebel. Është një artikull shumë interesant për marrëdhënien e Perëndisë si “i meshirshëm” me Perëndinë si “i shenjtë”, te Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament (Sinonime të Dhiatës së Vjetër)*, f. 112-113.

II. Dhiata e Re

- A. Shkrimtarët e DhR (përveç Lukës) janë mendimtarë hebrenj, por janë të ndikuar nga greqishtja *koine* (pra, Septuaginta). Ajo që kontrollonte fjalorin e tyre nuk ishte feja, mendimi, apo literatura klasike greke, por përkthimi grek i DhV.
- B. Jezusi është i shenjtë ngaqë është nga Perëndia dhe si Perëndia (shih Luka 1:35; 4:34; Veprat 3:14; 4:27, 30). Ai është i Shenjti dhe i Drejti (shih Veprat 3:14; 22:14). Jezusi është i shenjtë ngaqë është i pamëkat (shih Gjoni 8:46; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 1:19; 2:22; 1 Gjonit 3:5).
- C. Për shkak se Perëndia është i shenjtë, fëmijët e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Lev. 11:44-45; 19:2; 20:7, 26; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:16). Për shkak se Jezusi është i shenjtë, edhe ndjekësit e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pje. 1:15). Të krishterët shpëtohen për të shërbyer në ngjashmëri me Krishtin (shenjtëria).

▣ **“ruaji në emrin tënd”** Jezusi po lutet (URDHËRORE AORISTE VEPRORE) që mbrojtja fuqizuese dhe prania personale që i ka dhënë JHVH (DËFTORE E KRYER VEPRORE) t’u jepet edhe dishepujve (shih v. 12). Kjo do t’u mundësojë të shërbejnë në këtë botë të rënë, ashtu siç shërbeu dhe ai në këtë botë të rënë (shih v. 18). Kjo është një nga dobitë e unitetit (shih v. 21) midis

1. Atit
2. Birit
3. Dishepujve

▣ **“që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një”** Kjo është LIDHORE E TASHME. Bën fjalë për unitetin në marrëdhënie brenda Perëndisë triun (shih v. 21, 22, 23; 10:30; 14:10). Kjo është kërkesë dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme edhe për të krishterët! Kjo thirrje për unitet mungon në ditën tonë (shih Efe. 4:1-6). Uniteti, por jo uniformiteti, është rruga për të ribashkuar kishën e përçarë të Perëndisë.

17:12 “I ruajta... i ruajta” FOLJA e parë është në KOHËN E PAKRYER, ndërsa e dyta në KOHËN AORISTE. Këto FOLJE janë sinonime. Thelbi i pasazhit është mbrojtja e vazhdueshme e Jezusit (shih 1 Pje. 1:3-9).

Në librin e tij, *Word Studies in the New Testament (Studime fjalësh në Dhiatën e Re)*, vëll. 1, M. R. Vincent bën dallimin mes këtyre dy termave. Ai thotë se i pari (*tēreō*) do të thotë “ruaj/konservoj”, ndërsa i dyti (*fulassō*) do të thotë “ruaj/mbroj” (f. 496).

▣ **“asnjë prej tyre nuk humbi”** Kjo tregon fuqinë mbrojtëse të Jezusit (shih 6:37, 39; 10:28-29). Kjo fjalë (*apollumi*) është e vështirë të përkthehet, pasi përdoret në dy kuptime të ndryshme. Në librin e vet, *Theological Dictionary of the New Testament*, vëll. 1, Gerhard Kittel thotë për këtë fjalë: “Në përgjithësi, mund të themi se 2 dhe 4 qëndrojnë në themel të thënieve që lidhen me këtë botë, si te ungjijtë sinoptikë, ndërsa 1 dhe 3 kanë të bëjnë me ato fjalë që lidhen me botën tjetër, si te Pali dhe Gjoni” f. 394. Përcaktimet që jep ai janë:

1. “shkatërroj ose vras”
2. “humb, ose pësoj humbje nga”
3. “humbas”
4. “të jesh i humbur”

Shpesh, kjo fjalë është përdorur për të mbështetur doktrinën e asgjësimit, pra, se njerëzit e pashpëtuar pushojnë së ekzistuari pas gjykimit të fundit. Kjo duket sikur bie ndesh me Dan. 12:2. Po kështu, kjo anashkalon dallimin mes ngjyimeve kuptimore që gjenden në ungjijtë sinoptikë dhe atyre te Gjoni dhe Pali, të cilët e përdorin në mënyrë metaforike për humbjen shpirtërore, jo për shkatërrimin fizik. Shih Temën e Veçantë në 10:10.

▣ **“përveç birit të humbjes”** Qartazi, kjo bën fjalë për Juda Iskariotin. Po kjo frazë përdoret edhe te 2 Thes. 2:3 për “Njeriun e Mëkatit” (Antikrishtin e kohëve të fundit). Kjo është një idiomë hebraike, që do të thotë “ai që është i destinuar të humbasë”. Është lojë fjalësh me termin “humbas”, që u përdor më herët në këtë varg: “askush nuk humbet përveç atij që është i destinuar të humbasë”. Shih Temën e Veçantë: Femohimi, në Gjoni 6:64.

▣ **“në mënyrë që të përmbushej Shkrimi”** Kjo i referohet Psalmi 41:9, i cituar te Gjoni 13:18; 6:70-71.

17:13 “Por tani, unë vij te ti” Këtu, mund të bëhet fjalë për

1. Lutjen e Jezusit (Gjoni 17)
2. Ngjitja e Jezusit në qiell (v. 11; Veprat 1)

▣ **“këto gjëra i them në botë”** Kjo frazë mund të ketë lidhje, më herët, me

1. 11:42, ku Jezusi flet me zë të lartë që ta dëgjojnë të tjerët
2. 15:11, ku fjalët e Jezusit lidhen drejtpërdrejt me “gëzimin” e dishepujve

▣ **“në mënyrë që ata të kenë të plotë gëzimin tim në ta”** Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE dhe PJESORE E KRYER PËSORE. Ç’premtim i mrekullueshëm (shih 15:11; 16:24)! Gjoni e përdor sërish të njëjtën frazë (shih 1 Gjoni 1:4; 2 Gjoni 12).

17:24 “Unë u kam dhënë fjalën tënde” Termi “fjalë” këtu është *logos*. Sinonimi greqisht *rhēma* përdoret në vargun 8. Ky është pohim i zbulësës hyjnore të personit, mësimëve dhe shembullit të Jezusit. Jezusi jep Fjalën dhe

është vetë Fjala. Fjala është edhe person, edhe përmbajtje njohëse. Ne e mirëpresim Personin e ungjillit dhe i besojmë mesazhit të ungjillit!

- **“bota i ka urreyer”** Refuzimi i botës është shenjë e pranimit nga Krishti (shih Gjoni 15:18-20; 1 Gjonit 3:13).
- **“sepse nuk janë të botës”** Besimtarët janë në botë, por jo të botës (shih v. 16; 1 Gjonit 2:15-17).
- **“ashtu siç unë nuk jam i botës”** “Bota” nënkupton këtë epokë të rënë të rebelimit njerëzor dhe engjëllor (shih 8:23). Ky është një tjetër shembull i dualizmit vertikal të Gjonit.

17:15 “Nuk po të lutem që t’i heqësh nga bota” Të krishterët kanë një mision në botë (shih v. 18; Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat 1:8). Nuk është koha që të shkojnë në shtëpi!

■
NASB, NKJV **“i ligu”**
NRSV **“i ligu”**
TEV, NJB **“i Ligu”**

Kjo fjalë është, ose ASNJANËSE, ose MASHKULLORE. Kjo njësi letrare e përmend shpesh forcën personale të ligësisë (shih 12:31; 13:27; 14:30; 16:11). Prandaj, ky vargu, ashtu si Mat. 5:37; 6:13; 13:19, 38, duhet të thotë “i ligu” (si person) (shih 2 Thes. 3:3; 1 Gjonit 2:13-14; 3:12; 5:18-19). Shih Temën e Veçantë në 12:31.

7:17 “Shenjtëroji” Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE, nga rrënja “i shenjtë” (*hagios*). Mund të ketë kuptimin

1. Besimtarët thirren për t’u bërë të ngjashëm me Krishtin (shih v. 19; Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3,7; 5:23; 1 Pje. 1:15). Kjo mund të ndodhë vetëm nëpërmjet njohjes të së vërtetës, e cila është edhe fjalë e gjallë (Jezusi, shih 1:1-14), edhe fjalë e shkruar (Bibla, shih 15:3).
2. “Shenjtëroj”, në kuptimin e DhV, në thelb do të thotë “të veçohesh për shërbesën e Perëndisë”. Vargu 18 qartëson synimin për “shenjtërimin” e tyre.

Çështja nuk është nëse #1 ose #2 është i vërtetë. Të dy janë të vërtetë. Jeta e Jezusit tregoi domosdoshmërinë e të dyve (shih v. 19).

Është shumë e mundur që Gjoni po thotë se dishepujt “shenjtërohen” për shërbesën e Perëndisë, si analogji për veçimin e priftërinjve të DhV për shërbesën e Perëndisë. Ata shërbenin si ndërmjetës të flijimeve të DhV, kurse dishepujt shërbenin si zbulues të flijimit të përsosur dhe unik të DhR: Krishtit (shih librin e Hebrenjve, që krahason DhV me DhR).

■ **“në të vërtetën; fjala jote është e vërteta”** E vërteta bën fjalë për mesazhin e Jezusit në lidhje me Perëndinë (shih 8:31-32). Jezusi thirret edhe mesazhi (*Logos*, shih 1:1, 14), edhe e vërteta (shih 14:6) e Perëndisë. Shpesh, Fryma përmendet si Fryma i së Vërtetës (shih 14:17; 15:26; 16:13). Vini re se edhe besimtarët shenjtërohen nga e vërteta (shih v. 19, PJESORE E KRYER PËSORE) dhe nga Fryma (shih 1 Pje. 1:2). Për një diskutim më të plotë të fjalës greqisht “e vërtetë, e vërteta” shih Temat e Veçanta për të Vërtetën në 6:55 dhe 17:3.

Ka mundësi që “fjala jote është e vërteta” të jetë aludim ose citim nga LXX i Ps. 119:142: “Drejtësia jote është një drejtësi e përjetshme, dhe ligji është e vërteta”. Sigurisht, është e mundur që Jezusi të jetë konsideruar si

1. Moisiu i ri (LiP. 18:15)
2. Dishepujt e tij si priftërinj të rinj (përdorimi i FOLJES “shenjtëroj”)
3. Jeta e tij si zbulues e vërtetë e Perëndisë të vetëm dhe të vërtetë
4. Uniteti i Perëndisë triumfues me dishepujt si synimi i përmbushur i krijimit (shih Zan. 1:26-27)
5. Jezusi si përmbushje e Zan. 3:15

17:18 “Ashtu si më dërgove ti në botë” Jeta me bindje dhe shërbesë e Jezusit, madje deri në pikën e vdekjes (2 Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; 1 Gjonit 3:16), përcakton modelin për ndjekësit e tij (shih v. 19). Ai do t’i dërgojë në botën e humbur me mision ashtu si u dërgua vetë në 20:21. Ata duhet të përfshihen në botë, jo të izoloohen prej saj. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*) në 5:24.

17:19 “e shenjtërojt veten” Në këtë kontekst, këtu bëhet patjetër fjalë për Kalvarin! Jezusi i caktoi vetes detyrën që të kryente vullnetin e Atit (pra, Marku 10:45).

▣ **“që edhe ata vetë të shenjtërohen në të vërtetën”** Kjo është fjali me *hina* (fjali qëllimi) me një PJESORE PERIFRASTIKE TË KRYER PËSORE, që nënkupton se rezultatet kanë ndodhur tashmë dhe vazhdojnë të jenë në fuqi. Mirëpo, ekziston dhe një element kushtëzimi i bazuar te

1. Vepra e ardhshme e Krishtit në kryq, ringjallja dhe ngjitja e tij në qiell
2. Reagimi i tyre i vazhdueshëm me besim dhe pendesë ndaj Jezusit dhe mësimëve të tij

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 17:20-24

²⁰“Nuk po të lutem vetëm për këta, por edhe për ata që besojnë në mua përmes fjalës së tyre; ²¹që ata të jenë të gjithë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty, që edhe ata të jenë në ne, në mënyrë që bota të besojë se ti më dërgove. ²²Lavdinë që më ke dhënë ti ua kam dhënë atyre, që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një; ²³unë në ta dhe ti në mua, që ata të jenë të përsosur në unitet, që bota të kuptojë se ti më dërgove dhe se i deshe, ashtu siç më ke dashur mua. ²⁴Atë, dëshiroj që edhe ata, që ti më ke dhënë, të jenë me mua aty ku jam, në mënyrë që të shohin lavdinë time që më ke dhënë ti, sepse ti më ke dashur që nga themelet e botës”.

17:20 “por edhe për ata që besojnë në mua” Kjo është në KOHËN E TASHME dhe funksionon si në KOHËN E ARDHME. Bën fjalë për gjithë besimtarët e mëvonshëm dhe, në 10:16, edhe për johebrenjtë. Shih Temën e Veçantë në 2:23.

▣ **“përmes fjalës së tyre”** Kjo është fjala *logos*. Për shkak të përdorimit të saj në v. 14 dhe sinonimit të saj *rhēma* në v. 8, ajo bën fjalë për transmetimin që do t'i bënin dishepujt mesazhit të zbulesës së Jezusit.

17:21 “që të jenë të gjithë një” Ky unitet s'është gjë tjetër veçse uniteti i Trinisë (shih v. 11, 22, 23; Efe. 4:1-6). Ky është një aspekt i mësimit të Jezusit që ndjekësit e tij nuk e kanë ndjekur.

▣ **“që bota të besojë se ti më dërgove”** Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE. Synimi i unitetit është ungjillizimi. Vargu 23 është pothuajse e njëjta strukturë dhe theks!

Lutja e Jezusit përmban një tension në vetvete. Ai nuk lutet për botën (shih v. 9), mirëpo i dërgon ndjekësit e vet në botë me mesazhin e tij, gjë që do të çojë në përndjekjen e tyre, për shkak se Perëndia e do botën (shih v. 21, 23; 3:16). Perëndia dëshiron që gjithë bota të besojë (shih 1 Tim. 2:4; Titu 2:11; 2 Pje. 3:9). Perëndia i do të gjithë ata që janë bërë në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e tij. Jezusi vdiq për mëkatet e gjithë botës. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*) në 5:24.

17:22 “Lavdinë që më ke dhënë ti, ua kam dhënë atyre” Këto janë të dyja DËFTORE TË KRYERA VEPRORE. Lavdia bën fjalë për mesazhin e zbulesës. Ata do të mbartin fjalën e tij për ta çuar në botë, ashtu si mbarti Jezusi fjalën e Atit. Kjo do të bëjë që ata të mbartin edhe përçmimin e tij! A. T. Robertson, në *Word Pictures in the New Testament*, vëll. V, thotë: “Ajo që përmendet në 17:24 është lavdia e Fjalës së Mishëruar (shih 1:14 dhe 2:11), jo lavdia e Fjalës së Përrjetshme” (f. 280). Shih shënimin e plotë për “lavdinë” në 1:14.

17:23 “që ata të jenë të përsosur në unitet” Kjo është një fjali *hina* me PJESORE PERIFRASTIKE TË KRYER PËSORE, si v. 19. Në v. 19, ekziston një element kushtëzimi i bazuar në (1) punën e ardhshme të Krishtit, ose (2) besimin e tyre të vazhdueshëm. Rrjedhimi është se ata janë bashkuar tashmë nga Jezusi dhe se ky bashkim do të qëndrojë! Synimi i unitetit është ungjillizimi.

▣ **“dhe se i deshe, ashtu siç më ke dashur mua”** Ky është premtim (shih 16:27 dhe 14:21, 23), por ka një kusht. Perëndia lidhet me njerëzit me anë të besëlidhjeve (“nëse... po”).

Dashuria (*agapeō*) shfaqet tetë herë në Gjoni 1-12, por 31 herë në Gjoni 13-17. Dialogët në dhomën e sipërme theksonin karakterin e zbuluar të Perëndisë Atë përmes fjalëve dhe veprimeve të Birit dhe, pak më vonë, pas ringjalljes dhe veçanërisht pas Rrëshajave, përmes dishepujve. Perëndia është dashuri (shih 1 Gjoni 4:7-21).

17:24 “të jenë me mua aty ku jam” Jezusi po kthehet në lavdi për t’u përgatitur një vend ndjekësve të vet (shih 14:1-3). Kjo botë nuk është as shtëpia e tij, por as e jona! Ajo është krijimi i tij (Zanafilla 1-2) dhe do të ripërtërihet (Zbulesa 21-22).

■ **“që të shohin lavdinë time që më ke dhënë ti”** Qartazi, fjala “lavdi” në këtë varg nuk nënkupton të njëjtën gjë si në v. 22. Këtu, duket se përfshin dhe madhësitin e natyrës paraekzistuese hyjnore të Jezusit.

■ **“përpara themelimit të botës”** Perëndia triun ishte veprues në shpengim edhe përpara krijimit. Kjo frazë përdoret disa herë në DhR (shih Mat. 25:34; Luka 11:50; Efe. 1:4; Heb. 4:3; 9:26; 1 Pje. 1:20; Zbu. 13:8; 17:8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 17:25-26

²⁵“O Atë i drejtë, ndonëse bota nuk të ka njohur, unë të kam njohur; dhe këta kanë njohur se ti më dërgove; ²⁶dhe unë ua kam bërë emrin tënd të njohur, dhe do t’ua bëj të njohur, në mënyrë që dashuria me të cilën më ke dashur ti të jetë në ta, dhe unë në ta”.

17:25 “Atë i drejtë” Ky titull shfaqet vetëm këtu në DhR. Është paralel me “Atë i Shenjtë” në v. 11. Vjen nga një fjalë hebraisht, që do të thotë “kallam matës”. Perëndia është standardi i gjyqimit! Shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 2:29.

■ **“bota nuk të ka njohur”** Bota, shoqëria njerëzore e organizuar veçmas Perëndisë, dhe që funksionon si e tillë (kuptimi unik që i jep Gjoni kësaj fjale), nuk e njeh Perëndinë (shih 17:25), as Birin e tij (shih 1:10). Ajo është e ligë dhe e ndyrë (shih 3:19-20; 7:7).

■ **“unë të kam njohur”** Jezusi është burimi më i lartë dhe më i pastër i informacionit për Perëndinë (shih 1:18; 3:11).

17:26 “unë ua kam bërë emrin tënd të njohur” Kjo bën fjalë për zbulesën që i bëri Jezusi karakterit dhe planit shpengues të Atit për njerëzimin (shih v. 6, 11, 12; Veprat. 2:23; 3:18; 4:28). Fjala “të njohur” përdoret pesë herë në v. 25-26.

■ **“dhe do t’ua bëj të njohur”** Kjo bën fjalë, ose për (1) zbulesën e vazhdueshme të Jezusit përmes Frymës, i cili qartëson mësimet e tij, ose (2) për ngjarjet e shpëtimit (Java e Mundimit) që do të ndodhin pas pak. Konteksti i pasazhit nënkupton alternativën 1. Shpëtimi nënkupton edhe një person, edhe një mesazh; edhe një vendim, edhe një stil jetese; edhe një besim fillestar, edhe një besim të vazhdueshëm. Ai përfshin, edhe ngjyrimin grek të fjalës “njoh”, edhe ngjyrimin hebraik të po kësaj fjale.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse është kaq e rëndësishme nga ana teologjike kjo pyetje?
2. A ishte Juda një besimtar që ra nga hiri?
3. Cili është synimi i unitetit tonë?
4. Pse është e rëndësishme paraekzistenca e Jezusit?
5. Përcakto në këtë kontekst fjalët kyçe:
 - a. “përlëvduar”
 - b. “jap”
 - c. “njoh”
 - d. “dërguar”
 - e. “emri”

f. "bota"

GJONI 18

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Tradhtia ndaj Jezusit dhe arrestimi i tij	Tradhtia dhe arrestimi në Gjetseman	Arrestimi, gjykimi, kryqëzimi, varrosja e Jezusit (18:1-19:42)	Arrestimi i Jezusit	Arrestimi i Jezusit
18:1-11	18:1-11	18:1-11	18:1-4 18:5a 18:5b 18:5c-7a 18:7b 18:8-9 18:10-11	18:1-9 18:10-11
Jezusi përpara kryepriiftit	Përpara kryepriiftit		Jezusi përpara Anës	Jezusi përpara Anës dhe Kajafës; Pjetri e mohon
18:12-14	18:12-14	18:12-14	18:12-14	18:12-14
Mohimi i Jezusit nga Pjetri	Pjetri mohon Jezusin		Pjetri mohon Jezusin	
18:15-18	18:15-18	18:15-18	18:15-17a	18:15-18
Kryepriifti merr Jezusin në pyetje	Jezusi merret në pyetje nga kryepriifti		Kryepriifti merr Jezusin në pyetje	
18:19-24	18:19-24	18:19-24	18:19-21 18:22 18:23 18:24	18:19-24
Pjetri e mohon sërish Jezusin	Pjetri e mohon dy herë më tepër		Pjetri e mohon Jezusin sërish	
18:25-27	18:25-27	18:25-27	18:25a	18:25-27
Jezusi përpara Pilatit	Në Gjykatën e Pilatit		Jezusi përpara Pilatit	Jezusi përpara Pilatit
18:28-38a	18:28-38	18:28-32	18:28-29 18:30 18:31 18:31b-32	18:28-32
		18:33-38a	18:33 18:34 18:35 18:36 18:37a 18:37b 18:38a	18:33-19:3
Jezusi dënohet me vdekje (18:38b-19:16c)	Zënia e vendit të Barabës		Jezusi dënohet me vdekje (18:38b-19:16a)	
18:38b-19:7		18:38b-19:7	18:38b-39	
	18:39-40			

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)**NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE**

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 18:1-40

- A. Gjoni nuk e përmend agoninë e Jezusit në Gjetseman (ndonëse kapitulli 17 mund të jetë paralel me të). Me sa duket, këtë e bën ngaqë po thekson karakterin dinamik të Jezusit, i cili ishte në kontroll të gjitha situatave. Ai e dha vetë jetën e vet (shih 10:11, 15, 17, 18).
- B. Rendi i ngjarjeve në këtë kapitull është disi ndryshe nga ungjijtë sinoptikë. Kjo mospërputhje duket se ka lidhje me
 1. natyrën e rrëfimeve të dëshmitarëve okularë
 2. qëllimet teologjike të autorit
- C. Gjoni është shumë i ndryshëm nga ungjijtë sinoptikë. –Pse” dhe –si” janë pyetje që bota studimore nuk mund t’u përgjigjet. Diskutimi më i mirë që kam parë për këtë çështje gjendet te Gordon Fee, Douglas Stuart, *Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka*, ku jepen një sërë teorish. Me sa duket, autorët e ungjijve, nën frymëzim, kishin lirinë që
 1. të përzgjidhnin
 2. të përshtatnin
 3. të rirrendisnin
 fjalët dhe veprat e Jezusit. Nuk mendoj se u lejohej të shpiknin fjalë dhe vepra të Jezusit, por mund t’i përshtatnin për qëllimet e tyre ungjillizuese, në mënyrë që t’u zbulonin Jezusin grupeve të ndryshme të njerëzve. Mos harroni se ungjijtë nuk janë histori perëndimore (pra, shkak/efekt, apo kronologjike), por histori lindore. Nuk janë biografi, por trakte ungjillizuese.
- D. Një libër i mirë reference për këtë kapitull, për sa i përket ligjshmërisë së gjyqeve të Jezusit (shih Sanhedrin, 4:1) është libri i A. N. Sherwin-White, *Roman Society and Roman Law in the NT* [Shoqëria romake dhe ligji romak në Dhr].

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:1-11

¹Pasi foli këto fjalë, Jezusi shkoi me dishepujt në luginën e Kidronit, ku ishte një kopsht, ku hyri bashkë me dishepujt. ²Edhe Juda, që do ta tradhtonte, e dinte vendin, sepse Jezusi ishte takuar shpesh aty me dishepujt. ³Kështu, Juda, pasi mori me vete kohortën romake dhe oficerë nga krerët e priftërinjve dhe farisenjtë, shkoi aty me pishtarë, kandila dhe armë. ⁴Kështu, Jezusi, duke ditur gjithçka që do t'i ndodhte, doli dhe u tha: “Kë kërkoni?” ⁵Ata iu përgjigjën: “Jezusin Nazareas”. Ai u tha: “Unë jam ai”. Edhe Juda, i cili do ta tradhtonte, po qëndronte me ta. ⁷Kështu, kur u tha: “Unë jam ai”, ata u tërhoqën dhe ranë përtokë. ⁷Atëherë, ai i pyeti sërish: “Kë kërkoni?” Dhe ata i thanë: “Jezusin Nazareas”. ⁸Jezusi u përgjigj: “Ju thashë se unë jam ai; kështu që, nëse më kërkoni mua, lërin këta të shkojnë”, ⁹për të përmbushur fjalën që kishte thënë: “Nga ata që më ke dhënë, nuk humba asnjërin”. ¹⁰Atëherë, Simon Pjetri, që kishte me vete një shpatë, e nxori dhe goditi skllavin e kryepriftit dhe i preu veshin e djathtë; dhe emri i skllavit ishte Malku. ¹¹Kështu, Jezusi i tha Pjetrit: “Fute shpatën në mill; kupën që më ka dhënë Ati, unë të mos e pi?”

■ **“luginë e Kidronit”** Termi —luginë” donte të thoshte —përrua dimri” ose —përrukë”. “Kidron” (BDB 871) kishte kuptimin (1) i kedrave, ose (2) i zi. Ky ishte një përrua që thahej plotësisht në verë, por rridhte gjatë stinës së dimrit. Ishte vendi ku kullohej gjaku i flijimeve nga mali Moria. Ky mund të jetë dhe burimi i përshkrimit —zi”. Ndodhej midis malit të tempullit dhe malit të Ullinjve (shih LXX 2 Samueli 15:23; 2 Mbre. 23:4, 6, 12; 2 Kro. 15:16; 29:16; 30:14; Jer. 31:40).

Ekziston një variant në këtë pikë në dorëshkrimet greqisht:

1. —kedrave” (*kedrōn*) në dorëshkrimet κ^c , B, C, L dhe një sërë dorëshkrimesh të tjera uncialë
2. —kedrit” (*kedrou*) në dorëshkrimet κ^* , D dhe W
3. —Kidronit” (*kedrōn*) në dorëshkrimet A dhe S

Botimi i katërt i United Bible Society përdor alternativën #3.

■ **“një kopsht”** Ky kapitull s’e përmend fare agoninë e Jezusit në Gjetseman, por, gjithsesi, ngjarjen e arrestimit e vendos në një kopsht. Ky ishte një vend qetësie i preferuar për Jezusin (shih v. 2; Luka 22:39). Me sa duket, Jezusi fjeti aty gjatë javës së fundit të jetës së vet (shih Luka 21:37).

Kopshtet nuk lejoheshin në Jerusalem për shkak se plehërueset e nevojshme e bënin të papastër. Prandaj, shumë pasanikë zotëronin hardhi, kopshte, etj, në malin e Ullinjve.

18:2 Ky është një tjetër koment redaktorial nga Gjoni.

■ **“Juda”** Ka shumë hamendësime në lidhje me Judën dhe me motivet e tij. Ai përmendet dhe shahet shpesh në ungjillin e Gjonit (shih 6:70-71; 12:4; 13:2, 26-27; 18:2-3, 5). Drama moderne —Jezu Krishti, Superstar” e pasqyron si një ndjekës besnik, por të zhgënjyer, i cili përpiqet ta detyrojë Jezusin që të përmbushë rolin e Mesisë judaik të DhV: me fjalë të tjera, që të mposhtë romakët, të ndëshkojë të ligjtë dhe ta bëjë Jerusalemin kryeqytet të botës. Mirëpo Gjoni shprehet se motivi i tij ishte lakmia dhe i frymëzuar nga Satani.

Problemi kryesor është çështja teologjike e sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor. A e manipuloi Judën Perëndia ose Jezusi? A është Juda përgjegjës për veprimet e tij nëse e kontrollonte Satani, ose nëse e kishte paracaktuar Perëndia dhe e kishte shtyrë që të tradhtonte Jezusin? Bibla nuk i trajton drejtpërdrejt këto pyetje. Perëndia është në kontroll të historisë; ai i njej ngjarjet e ardhshme, por njerëzimi është përgjegjës për zgjedhjet dhe veprimet e veta. Perëndia është i drejtë, jo manipulues.

Ka dalë një libër që përpiqet të mbrojë Judën —*Judas, Betrayer or Friend of Jezus?* [*Juda, tradhtar apo mik i Jezusit?*] — nga William Klassen, Fortress Press, 1996. Unë nuk bie dakord me këtë libër, pasi ai e zhvlerëson dëshminë e Gjonit për Judën, por, gjithsesi, është shumë interesant dhe të nxit të mendosh.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhiatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovranë të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte yjësia përkundrejt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të së vërtetave doktrinar:

1. Paracaktimi kundrejt vullnetit të lirë njerëzor
2. Siguria e besimtarëve përkundrejt nevojës për qëndresë
3. Mëkati fillestar përkundër mëkatit të vullnetshëm
4. Mungesa e mëkatit (—përsosmëria”) kundrejt mëkatimit më pak
5. Shfajësimi dhe shenjtërimi i atypëratyshëm fillestar dhe shenjtërimi i përshkallëzuar
6. Liria e krishterë përkundrejt përgjegjësisë së krishterë
7. Transcendenca e Perëndisë kundrejt imanencës së Perëndisë
8. Perëndia si i panjohshëm në mënyrë absolute përkundrejt Perëndisë si i njohshëm në Shkrimet
9. Mbretëria e Perëndisë si e tashme përkundrejt përmbushjes së ardhshme
10. Pendimi si dhuratë e Perëndisë kundrejt pendimit si reagim i domosdoshëm njerëzor ndaj besëlidhjes
11. Jezusi si hyjnor kundrejt Jezusit si njerëzor
12. Jezusi është i barabartë me Atin kundrejt Jezusit si i nënshtruar ndaj Atit

Koncepti teologjik i —besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë ai që merr nismën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ruhu që të mos e përdorësh vargje —përvë” për njërën anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën, ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

18:3

NASB “kohortën romake”

NKJV “një detachment trupash”

NRSV “një detachment ushtarësh”

TEV “një grup ushtarësh romakë”

NJB “kohortën”

Bëhet fjalë për një njësi ushtarake romake, e cila ishte sa një e dhjeta e legjionit dhe mund të përbëhej deri në 600 burra, që vendoseshin në fortesën e Antonios, përbri tempullit (shih Veprat 21:31, 33). Është e pagjasë që të ketë ardhur një grup kaq i madh. Romakët ishin të përgatitur për trazira në Jerusalem gjatë kohëve festive. Ata duhet të kenë marrë masat e nevojshme duke i transferuar trupat nga Cezarea bregdetare. Romakët u përfshinë në gjykimin e Jezusit për shkak se judenjtë donin që ai të kryqëzohej. Zakonisht, kjo gjë kërkonte disa ditë; ata mund ta bënin këtë gjë vetëm me lejen dhe bashkëpunimin e qeverisë romake.

■ **“dhe oficerë nga krerët e priftërinjve”** Garnizonin romak e shoqëronte policia levitike e Tempullit. Ata kishin dështuar tashmë ta arrestonin më parë Jezusin (shih 7:32, 45).

■ “armë” Ushtarët romakë mbanin shpata, ndërsa policia e tempullit mbante shkopinj druri (shih Mat. 26:43; Marku 14:43; Luka 22:52).

■ “Kështu, Jezusi, duke ditur gjithçka” Ky është theksim i fortë i njohurisë së Jezusit dhe kontrollin që kishte ai mbi arrestimin, gjykimet dhe kryqëzimin e tij (shih 10:11, 15, 17-18). Nuk ishte rastësi që Jezusi u kryqëzua (shih Marku 10:45; Veprat 2:23; 3:18; 4:28). Ky motiv është karakteristik për ungjillin e Gjonit dhe mund të jetë arsyeja pse ai nuk e përmend konfliktin e Jezusit në Gjetseman.

18:5

NASB, NJB “Jezusi Nazareas”

NKJV, NRSV,

TEV “Jezusi i Nazaretit”

Ka patur njëfarë diskutimi për etimologjinë e termit —*azareas*”. Ka gjasa që të ketë kuptimin (1) nazareas; (2) nazarit (shih Numrat 6); ose (3) nga Nazareti. Përdorimi në DhR (shih Mat. 2:23) konfirmon alternativën 3. Disa, madje, i kanë lidhur bashkëtingëlloret hebraisht *ncr* me titullin mesianik —*Deḡ*” (*necer*, shih Isa. 11:1; 14:19; 60:21).

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI NAZAREAS

Ka një sërë termash të ndryshëm greqisht që Dhiata e Re përdor për të folur për Jezusin.

A. Fjalë në DhR

1. Nazareti – qytet në Galile (shih Luka 1:26; 2:4, 39, 51; 4:16; Veprat 10:38). Ky qytet nuk përmendet në burimet e kohës, por është gjetur në mbishkrimet e mëvonshme.
Fakti se Jezusi ishte nga Nazareti nuk përbënte kompliment (shih Gjoni 1:46). Shenja mbi kryqin e Jezusit, që përfshinte emrin e këtij vendi, ishte shenjë e përçmimit jude.
2. *Nazarēnos* – duket sikur i referohet një vendndodhjeje gjeografike (shih Luka 4:34; 24:19).
3. *Nazōraios* – mund t’i referohet një qyteti, por ka gjasa të jetë lojë fjalësh me termin mesianik hebraisht —*Deḡ*” (*necer*, shih Isa. 4:2; 11:1; 53:2; Jer. 23:5; 33:15; Zak. 3:8; 6:12; në DhR, Zbu. 22:16). Luka e përdor për Jezusin te 18:37 dhe Veprat 2:22; 3:6; 4:10; 6:14; 22:8; 24:5; 26:9.
4. Lidhet me #3 *nāzir*, që do të thotë —shenjtëruar me anë të një zotimi”.

B. Përdorime historike jashtë DhR.

1. Përcaktonte një grup heretike jude (para krishterimit) (aramaisht, *nāsōrayyā*).
2. Në qarqet judaike përdorej për të përshkruar besimtarët në Krishtin (shih Veprat 24:5, 14; 28:2, *nori*).
3. U bë fjalë që përdorej rregullisht për të përshkruar besimtarët në kishat siriane (aramaie). —*krishterë*” u përdor në kishat greke për të nënkuptuar besimtarët.
4. Dikur pas rënies së Jerusalemit, farisenjtë u riorganizuan në Javne dhe nxitën ndarjen zyrtare të sinagogës me kishën. Një shembull i llojit të formulave me mallkime kundër të krishterëve gjendet në —*Tetëmbëdhjetë Bekimet*” e *Berakoth* 28b-29a, që i quan besimtarët —*azareas*”. —*Nazreasit* dhe heretikët u zhdukshin menjëherë; ata do të fshihen nga libri i jetës dhe nuk do të shkruhen me besnikët”.
5. U përdor nga Justin Martiri, *Dial.* 126:1, i cili e përdori fjalën *necer* të Isaisë për Jezusin.

C. Mendimi im

Unë habitem nga mënyrat e shumta sesi shqiptohet ky term, ndonëse e di se kjo s’ishte e padëgjuar në DhV, ku —*Jozueu*” shkruhej në shumë mënyra të ndryshme në hebraisht. Elementet e mëposhtme më lënë të pasigurt për kuptimin e saktë të kësaj fjale:

1. Shoqërimi i ngushtë i tij me termin mesianik —*Deḡ*” (*necer*) ose me termin e ngjashëm *nazir* (ai që shenjtërohet me anë të një zotimi)
2. Shoqërimi negativ me Galilenë
3. Qyteti i Nazaretit në Galile përmendet pak ose aspak
4. Fakti se vjen nga goja e një demoni në kuptimin eskatologjik (pra, —*Ke* ardhur të na shkatërrosh?”).

Për një bibliografi të plotë studimesh të këtij grupi fjalësh, shih Colin Brown (red.), *New International Dictionary of New Testament Theology*, vëll. 2, f. 346 ose Raymond E. Brown, *Birth*, f. 209-213, 223-225.

■ **“unë jam ai”** Fjalë për fjalë, kjo është —**në jam**”, FOLJA hebraisht —**jam**” (shih Tema e Veçantë në 6:20), që judenjtë e lidhnin me JHVH, emrin që përdorej në Besëlidhje për Perëndinë (shih Eks. 3:14; Isa. 41:4). Jezusi e bën këtë pohim të mahnitshëm të natyrës së vet hyjnore në të njëjtën mënyrë të shkurtër gramatikore (*ego eimi*) edhe në 4:26; 8:24, 28, 58 dhe 13:19. Ajo përsëritet tri herë në këtë kontekst për theksim (shih v. 6, 8). Kjo strukturë gramatikore ndryshon nga pohimet —**Unë jam...**” të Jezusit.

■ **“dhe Juda, i cili do ta tradhtonte, po qëndronte me ta”** Ky është një tjetër koment redaktorial nga autori dhe dëshmitari okular i ungjillit: Gjoni.

18:6 “ata u tërhoqën dhe ranë përtokë” Gjoni e shkroi këtë për të theksuar karakterin dhe praninë dinamike të Jezusit. Kjo nuk nënkupton nderim (përkuljeje para dikujt), por frikë.

18:7 “Atëherë, ai i pyeti sërish” Ka gjasë që Jezusi po e përqendronte vëmendjen te vetja, në mënyrë që të shpëtonte dishepujt. Kjo duket se përputhet me kontekstin e atypëratyshëm të vargut 8.

18:8 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË; ata po e kërkonin Jezusin.

■ **“lërimi këta të shkojnë”** Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE. Është përmbushja e një profecie të Zak. 13:7 (shih Mat. 26:31; Gjoni 16:32).

18:9 “për të përmbushur fjalën që kishte thënë” Duket se kjo i referohet 16:32, por citohet 17:12.

18:10 “Simon Pjetri, që kishte me vete një shpatë, e nxori dhe goditi skllavin e kryepriftit dhe i preu veshin e djathtë” Pjetri nuk kishte në shënjestër veshin, por kokën! Kjo tregon gatishmërinë e Pjetrit për të vdekur për hir të Jezusit. Veprimi i Pjetrit ndoshta vinte nga keqkuptimi i tij për pohimin e Jezusit te Luka 22:36-38. Luka 22:51 na vë në dijeni se Jezusi ia shëroi veshin atij burrit me një të prekur.

■ **“emri i skllavit ishte Malku”** Vetëm Gjoni ia përmend emrin atij në këtë koment redaktorial. Kjo tregon se bëhet fjalë për dëshmi okulare. Autori i Gjonit ishte në kopsht!

■ **“kupën”** Kjo është një metaforë që në DhV përdorej si simbol i fatit të njeriut, zakonisht në kuptimin negativ (shih Psa. 11:6; 60:3; 75:8; Isa. 51:17, 22; Jer. 25:15-16, 27-28).

Forma gramatikore e pyetjeve të Jezusit pret përgjigjen “po”. Sërish, Pjetri po vepron si një njeri që e di se cila është gjëra më e mirë për t’u bërë (shih Mat. 16:22; Gjoni 13:8).

Përdorimi i —**kpës**” këtu është shumë i ndryshëm nga kuptimi i —**kpës**” në rrëfimet sinoptike të agonisë së Jezusit në Gjetseman. Jezusi është plotësisht në kontroll të ngjarjeve! Gjoni e paraqet Jezusin si të sigurt, jo të frikësuar (shih v. 4; 13:1, 11)!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:12-14

¹²Atëherë kohorta romake, kapiteni dhe oficerët e judenjve, e arrestuan Jezusin dhe e lidhën,
¹³dhe, në fillim, e çuan te Ana; sepse ai ishte vjehri i Kajafës, i cili ishte kryeprifti i atij i viti. ¹⁴Kajafa ishte ai që i pati këshilluar judenjtë se ishte e leverdishme që një njeri të vdiste në emër të popullit.

18:12

NASB “kohorta romake dhe kapiteni”

NKJV “detashmenti i trupave dhe kapiteni”

NRSV “ushtarët, dhe oficeri i tyre”

TEV “ushtarët romakë me komandantin e tyre”

NJB “kohorta dhe tribuni i saj”

Emrat e njëjësive ushtarake romake janë nxjerrë nga numri i përbërjes së plotë të trupave të përmendur.

1. Kohorta – i referohet një njësie me 600 burra (shih v. 3)

2. Kapiteni – vjen nga numri 1,000 (*hiliarku*, p.sh., Veprat 21:31; 22:24; 23:10; 24:7)

Këta tituj s’na tregojnë asgjë sesa e madhe ose e vogël ishte njësia ushtarake që arrestoi Jezusin. Në Palestinë, #2 thjesht nënkuptonte drejtuesin e një grupi të vogël ushtarësh.

▣ **“e lidhën”** Kjo nuk nënkupton se ata i druheshin Jezusit, por se ishte pjesë e procedurave normale (shih v. 24).

18:13 “në fillim, e çuan te Ana” Ka shumë diskutime për rendin e këtyre gjykimeve përpara Anës dhe Kajafës. Ungjijtë sinoptikë nuk e përmendin kurrë takimin me Anën. Vargu 24 duket si shënim në fund të faqes te Gjonit, por përbën pjesë të rëndësishme të rrëfimeve sinoptike për gjykimet e Jezusit (shih Mat. 26:57; Marku 15:53).

Në DhV, kryepriiftëria zgjaste gjithë jetën dhe secili person duhet të ishte nga pasardhja e Aaronit. Mirëpo romakët e kishin kthyer këtë ofiq në kockë politike, që blihej nga një familje levite. Kryepriifti kontrollonte dhe administronte tregtinë në Oborrin e Grave. Pastrimi që i bëri tempullit Jezusi e tërboi këtë familje.

Sipas Flavius Jozefusit, Ana ishte kryepriift nga 6-14 pas K. Ai ishte caktuar nga Kuirini, guvernatori i Sirisë, dhe u hoq nga Valerius Grati. Të afërmit e tij (5 bij dhe 1 nip) i zunë vendin. Kajafa (18-36 pas K.), dhëndri i tij (shih Gjoni 18:13), ishte pasardhësi i tij i menjëhershëm. Ana ishte pushteti i vërtetë pas atij ofiqi. Gjoni e përshkruan si personin e parë tek i cili e çuan Jezusin (shih 18:13, 19-22).

18:14 Ky është një tjetër koment redaktorial nga Gjoni, si në vargjet 15 dhe 18.

▣ **“Kajafa”** Arsyeja kryesore pse Gjoni përmend Kajafën ishte se, pa e ditur, ai kishte profetizuar për vdekjen e Jezusit (shih 11:50). Ai ishte dhëndri i Anës dhe Kryepriift nga viti 18-36 pas K. Shih shënimin për vargun 11:49.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:15-18

¹⁵Simon Pjetri po ndiqte Jezusin, bashkë me një dishepull tjetër. Ai dishepull ishte i njohur i kryepriiftit dhe hyri bashkë me Jezusin në oborrin e kryepriiftit, ¹⁶ndërsa Pjetri po qëndronte jashtë portës. Kështu, dishepulli tjetër, i cili ishte i njohur i kryepriiftit, doli dhe i foli portieres dhe e futi Pjetrin brenda. ¹⁷Atëherë, skllavja që ruante portën i tha Pjetrit: “Ti s’je një nga dishepujt e atij njeriu, apo jo?” Ai i tha: “Jo, nuk jam”. ¹⁸Kështu, skllëverit dhe rojat po rrinin në këmbë aty, pasi kishin ndezur një zjarr me qymyr ngaqë ishte ftohtë, dhe po ngroheshin; edhe Pjetri ishte me ta, qëndronte në këmbë e ngrohej.

18:15 “Simon Pjetri po ndiqte Jezusin, bashkë me një dishepull tjetër” Ka patur shumë diskutime për identitetin e këtij dishepullit tjetër.

1. Teoria tradicionale ka qenë se ky ishte apostulli Gjon, pasi për të përdoret një frazë e ngjashme te 20:2, 3, 4, dhe 8. Po kështu, një tjetër lidhje e mundshme është Gjoni 19:25, i cili përmend nënë e Gjonit, e cila mund të ketë qenë motra e Marisë, që do të thotë se ai mund të ketë qenë levit dhe, si rrjedhojë, nga familje priiftërore (shih dëshminë e Polikarpit).
2. Ky mund të ketë qenë një ndjekës i papërmendur vendas, si Nikodemi, ose si Jozefi i Arimatesë, për shkak të shoqërimit të tyre me kryepriiftin dhe me familjen e tij (shih v. 15-16).

▣ **“Ai dishepull ishte i njohur i kryepriiftit”** Kjo është fjalë shumë e fortë për të thënë —njohur” dhe duket se ka kuptimin —**nik** i ngushtë” (shih Luka 2:44 dhe 23:49). Nëse ai është Gjoni, kjo ndoshta ka lidhje me profesionin e tij si peshkatar; kështu, familja e tij duhet të ketë sjellë shpesh peshq në Jerusalem.

18:17 “skllavja që ruante portën i tha Pjetrit: „Ti s’je një nga dishepujt e atij njeriu, apo jo?” Kjo formë gramatikore, ashtu si v. 25, pret përgjigjen –jo”. Ajo tregon përçmimin e atyre, pasi nuk e përmendin emrin e Jezusit. Ajo mund t’ia ketë bërë këtë pyetje për shkak të (1) lidhjes së Pjetrit me Gjonin, ose (2) theksin galileas të Pjetrit.

▣ **“Jo, nuk jam”** Pjetri ndoshta ishte gati të vdiste për Jezusin, por s’ishte gati t’i përgjigjej me sinqeritet pyetjes së një skllaveje! Në ungjijtë sinoptikë, këto tre mohime vihen përbri njëra-tjetrës, por, te Gjoni, ato ndahen nga marrja në pyetje e Jezusit prej Anës (shih v. 24).

18:18 Kjo histori rrëfhet me hollësi shumë të gjalla prej dëshmitari okular. Si vargu 18, ashtu dhe 25, kanë dy **KOHË TË PAKRYERA PERIFRASTIKE**.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:19-24

¹⁹Atëherë, kryepriifti e pyeti Jezusin për dishepujt dhe për mësimin e tij. ²⁰Jezusi iu përgjigj: “Unë i kam folur haptazi botës; kam mësuar gjithmonë në sinagoga dhe në tempull, ku mblidhen të gjithë judenjtë; dhe s’kam thënë asgjë në fshehtësi. ²¹Pse më pyet mua? Pyet ata që kanë dëgjuar atë që u kam thënë; ata e dinë se çfarë kam thënë”. ²²Kur tha kështu, një nga oficerët që qëndronin aty pranë e goditi Jezusin dhe i tha: “Kështu i përgjigjesh kryepriiftit?” ²³Jezusi iu përgjigj: “Nëse kam folur gabim, dëshmo për gëzimin; por nëse kam folur drejt, pse më godet?” ²⁴Kështu, Ana e dërgoi të lidhur te Kajafa, kryepriifti.

18:19 “Atëherë, kryepriifti e pyeti Jezusin për dishepujt dhe për mësimin e tij” Këtu bëhet fjalë për Anën, jo Kajafën. Ana ishte pushteti i vërtetë pas postit. Ai sundoi nga 6 deri më 15 pas K. Ai u pasua menjëherë nga dhëndri i vet dhe, më vonë, nga pesë djemtë dhe nipi i tij. Ana, i cili zotëronte të drejtat tregtare në zonën e tempullit, ndoshta mezi priste të merrte në pyetje ata që kishte pastruar tempullin (ndoshta, dy herë). Është interesante se Ana donte të mësonte, jo vetëm për mësimet e Jezusit, por edhe për dishepujt e tij.

18:20 Është, pa diskutim, e vërtetë se Jezusi jepte mësim publikisht. Megjithatë, është po aq e vërtetë se shumë mësimet e tij ishin të mbuluara si me vel për publikun (shih Marku 4:1-12). Problemi i vërtetë ishte verbëria shpirtërore e dëgjuesve të tij.

Fjalët dhe metoda mësimore e Jezusit regjistrohen ndryshe te ungjijtë sinoptikë dhe te Gjoni. Sinoptikët nuk kanë asnjë thënie —Uë jam...”. Jezusi mëson me shëmbëlltyra; Gjoni nuk shënon asnjë shëmbëlltyrë. Unë mendoj se dallimet mund të shpjegohen me faktin se sinoptikët shënojnë mësimet publike të Jezusit, ndërsa Gjoni shkruan për sesionet private.

18:21 “Pse më pyet?” Në v. 20, Jezusi pohon natyrën publike të shërbesës së tij mësimdhënëse. Jezusi po i vinte në dukje Anës se pyetjet e tij ishin të jashtëligjshme sipas ligjit judaik dhe se përbënin njohuri publike.

18:22 “një nga oficerët që qëndronin aty pranë e goditi Jezusin dhe i tha” Në fillim, kjo fjalë kishte kuptimin —qdas me pëllëmbë” ose —rah me shkop”. Më vonë, mori kuptimin —qdas me dorë të hapur”. Ky është aludim për Isa. 50:6. Jezusi thotë se, po të kishte bërë diçka të gabuar, ta akuzonin; përndryshe, pse po e godisnin?

18:23 “Nëse... nëse” Këto janë dy FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, që supozohen si të vërteta nga pikëvështrimi i autorit ose për synimet e tij letrare. Këtu, e pra është mënyrë letrare për të theksuar një realitet të rremë. Jezusi po e sfidon anën që t’i paraqesë faktet që disponon.

18:24 Rendi i këtyre gjykimeve përmbyset në ungjijtë sinoptikë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:25-27

²⁵Simon Pjetri po qëndronte në këmbë dhe po ngrohej. Kështu, ata i thanë: “Ti s’je një nga dishepujt e tij, apo jo?” Ai e mohoi dhe tha: “S’jam”. ²⁶Një nga skllëvërit e kryepriiftit, që ishte i afërm i atij që i preu veshin Pjetri, tha: “A nuk të pashë në kopsht me të?” ²⁷Atëherë, Pjetri e mohoi sërish, dhe menjëherë këndoi gjeli.

18:26 “Një nga skllëvërit e kryepriiftit, që ishte i afërm i atij që i preu veshin Pjetri, tha” Ekziston njëfarë mospërkimi mes katër ungjijve për atë se kush ia bëri pyetjet Pjetrit.

1. Te Marku, është një shërbëtorë që bën pyetjen e parë (shih Marku 14:69)
2. Te Mateu, është një tjetër shërbëtorë (shih Mat. 26:71)
3. Te Luka 22:58, është një burrë
4. Te Gjoni, një skllav/shërbëtor i Kryepriifti

Është e qartë, nga konteksti historik, se një person ia bëri pyetjen rreth zjarrit dhe pastaj iu bashkuan të tjerët (shih v. 18).

18:26 “A nuk të pashë në kopsht me të?” Në dallim nga dy pyetjet e tjera në v. 17 dhe 25, kjo formë gramatikore pret përgjigjen “po”.

18:27 “Atëherë, Pjetri e mohoi sërish” Nga Marku 14:71 dhe Mat. 26:74, kuptojmë se Pjetri e mohoi duke sharë dhe mallkuar.

▣ **“menjëherë, këndoi gjeli”** Kronologjia e ngjarjeve nga të katërt ungjijtë nënkupton se kjo ndodhi midis orës 12:00 dhe 3:00 të mëngjesit. Judenjtë nuk lejonin pula brenda kufijve të qytetit të Jerusalemit, kështu që ky duhet të ketë qenë gjel romak.

Luka 22:61, në këtë pikë, thotë se Jezusi vështrroi Pjetrin. Ndoshta, Ana dhe Kajafa jetonin në të njëjtën shtëpi dhe rojat po e çonin Jezusin nga takimi me Anën te takimi me Kajafën dhe Sinedrin. Pikërisht gjatë kësaj lëvizjeje, Jezusi vështrroi Pjetrin. E gjithë kjo është hamendësim sepse nuk kemi informacione të mjaftueshme historike për të qenë dogmatikë për radhën e ngjarjeve të këtyre gjyqeve natën.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:28-32

²⁸Atëherë, e çuan Jezusin nga Kajafa te Pretoriumi, dhe ishte herët; ndërsa vetë ata nuk hynë në Pretorium që të mos ndoteshin, por të mund të hanin Pashkën. ²⁹Atëherë, Pilati doli te ta dhe u tha: “Çfarë akuze sillni kundër këtij Njeriu?” ³⁰Ata iu përgjigjën dhe thanë: “Nëse ky njeri nuk do të ishte keqbërës, nuk do të ta kishim dorëzuar ty”. ³¹Kështu, Pilati u tha: “Merreni vetë dhe gjykojeni sipas ligjit tuaj”. Judenjtë i thanë: “Ne nuk na lejohet që të vrasim njeri”. ³²për të përmbushur fjalën që tha Jezusi, kur tha se me ç’loj vdekjeje do të vdiste.

18:28

NASB, NKJV,

JB “te Pretoriumi”

NRSV “te selia e Pilatit”

TEV “te pallati i guvernatorit”

Ky është një term latin që bën fjalë për rezidencën zyrtare të guvernatorëve romakë kur ishin në Jerusalemin. Kjo mund të ketë qenë fortesa Antonio, që ishte përbri Tempullit, ose pallatit të Herodit të Madh.

TEMË E VEÇANTË: ROJA PRETORIANE

Në fillim, termi —*pretorian*” nënkuptonte çadrën (*praetor*) e gjeneralit romak, por, pas epokës së pushtimeve romake, filloi të përdorej në kuptimin administrativ për të nënkuptuar selinë ose rezidencën e administratës politike/ushtarake (shih Mat. 27:27; Gjonit 18:28, 33; 19:9; Veprat 23:35).

Sidoqoftë, në botën romake të shekullit të parë, përdorej për oficerët që përbënin Rojën e veçantë Perandorake. Ky grup elitar ushtarak u krijua nga Augusti por, në fund, u përqendrua në Romë nga Tiberi. Ata

1. ishin të gjithë të të njëjtit rang, centurionë
2. merrnin pagë të dyfishtë
3. kishin privilegje të veçanta
4. u bënë kaq të fuqishëm saqë zgjedhja e tyre për Perandorin nderohej gjithmonë.

Ky grup elitar, i fuqishëm nga ana politike, u shpërnda më në fund vetëm në kohën e Konstandinit.

▣ **“ishte herët”** Nga të dhënat romake, dimë se zyrtarët romakë në Palestinë dilnin për të gjykuar në agim. Me sa duket, Sinedri u mblodh pikërisht në agim për t’u dhënë një dukje besueshmërie dhe ligjshmërie gjyqeve të paligjshme të natës. Ata e çuan menjëherë Jezusin te Pilati.

▣ **“ata vetë nuk hynë në Pretorium, që të mos ndoteshin”** Duke hyrë në banesën e një johebriu, ata do të ndoteshin për darkën e Pashkës. Është ironike se ishin kaq shumë pedantë për çështjet ceremoniale, por nuk i brente fare ndërgjegjja që të vrisnin dikë në mënyrë të paligjshme.

Ky varg është qendra e një polemike për një mospërputhje (në dukje) historike midis ungjijve sinoptikë, të cilët pohojnë se Jezusi e hëngri darkën e Pashkës me dishepujt (shih Mat. 26:17; Marku 14:12; Luka 22:1) dhe Gjonit, i cili thotë se kjo ndodhi një ditë më parë (të enjten), në ditën e përgatitjes së festës tradicionale të Pashkës. Studiuesi i mirënjohur katolik për literaturën e Gjonit, Raymond Brown, bën këto komente në *The Jerome Biblical Commentary (Komentari Biblik i Jeronimit)*:

—Nëse kronika e ngjarjeve që raportohen në traditën sinoptike preferohet gjithmonë ndaj kronikës së Gjonit nga pikëvështrimi i *‘historicitetit’*, pasazhi i mëposhtëm—raportimi i një dëshmitari që e njihnte me siguri traditën sinoptike—paraqet disa vështirësi të pazgjidhshme. Nga ana tjetër, nëse themi se dëshmia

okulare prej së cilës është formuar Gjoni, shpesh, është më pranë ngjarjeve faktike sesa skica skematike e sinoptikëve, ky pasazh bëhet më i kuptueshëm” (f. 458).

Ekziston dhe njëfarë gjase e dy datave të ndryshme për kremtimin e Pashkës, të enjten dhe të premten. Po kështu, ekziston dhe problem tjetër se fjala —Paskë” mund të përdoret për festën njëditore, por edhe për festën tetëditore (Pashka e kombinuar me Bukët e Ndorme, shih Eks. 12).

■ **“të mund të hanin Pashkën”** Ka ende probleme për datën e saktë të Darkës së Zotit. Ungjijtë sinoptikë duket se nënkuptojnë se bëhet fjalë për vaktin e Pashkës, por Gjoni thotë se kjo ndodhi ditën përpara vaktit zyrtar të Pashkës (shih Gjoni 19:14 dhe ky varg). Përgjigjja mund të gjendet

1. në faktin se termi —Paskë” mund t’i referohet javës, vaktit, ose shabatit të veçantë
2. në faktin se disa grupime separatiste judaike (p.sh., esenët) ndiqnin një kalendar hënor që vinte nga libri ndërthjor i Jubileve.
3. në faktin se —kuptimet e dyfishta” të Gjoniit e paraqesin Jezusin si qengjin e Pashkës (1:29), i cili thërrin një ditë përpara Pashkës

18:29 Perëndia përdori personalitetin e Pilatit njësoj siç përdori dhe atë të faraonit në librin e Eksodit. Ai u caktua guvernator i Judesë më 26 pas K. nga perandori Tiber. Zëvendësoi Valer Gratin (i cili e hoqi Anën si Kryepriift). Ponc Pilati ishte guvernatori i pestë romak. Ai administroi mbretërinë e Arkelaut (birit të Herodit të Madh), që përfshinte Samarinë, Judenë, Gazën dhe Detin e Vdekur. Shumica e informacionit për Pilatin na vjen nga shkrimet e Flavius Jozefusit.

TEMË E VEÇANTË: PONC PILATI

- I. Njeriu
 - A. Vendi dhe data e lindjes e panjohur
 - B. Nga një rend kalorësiak (klasa e sipërme e mesme e shoqërisë romake)
 - C. I martuar, por s’dihet të ketë patur fëmijë
 - D. Postet e mëparshme administrative (duhet të ketë pasur disa të tilla) nuk dihen
- II. Personaliteti i tij
 - A. Dy pikëpamje të ndryshme
 1. Filoja (*Legatio and Gaium*, 299-305) dhe Jozefusi (*Antik*. 18.3.1 dhe *Luftërat judaike* 2.9.2-4) e pasqyrojnë si diktator mizor dhe të pamëshirshëm.
 2. DhR (ungjijtë, Veprat) paraqesin një guvernator romak të dobët dhe lehtësisht të manipulueshëm
 - B. Paul Barnett, *Jesus and the Rise of Early Christianity (Jezusi dhe ngritja e krishterimit të hershëm)*, f. 143-148, jep një shpjegim të besueshëm të këtyre dy pikëpamjeve.
 1. Pilati u caktua guvernator më 26 pas K. nën Tiberin, i cili ishte pro judenjve (shih Filo, *Legatio and Gaium*, 160-161), me këshillë të Sejanit, kryekëshilltarit antijude të Tiberit.
 2. Tiberi pësoi një humbje pushteti politik ndaj L. Aelius Sejanit, prefektit të tij pretorin, i cili u bë pushteti i vërtetë politik pas fronit dhe që i urrente judenjtë (Filo, *Legatio and Gaium*, 159-160).
 3. Pilati ishte i mbrojtur nga Sejanit dhe përpiquej t’i linte përshtypje
 - a. duke sjellë flamuj romakë në Jerusalem (26 pas K.), gjë që guvernatorët e tjerë nuk e kishin bërë. Këto simbole të perëndive romake i tërbuan judenjtë (shih Jozefusi, *Ant.* 18.3.1; *Luftërat e judenjve* 2.9.2-3).
 - b. duke shtypur monedha (29-31 pas K.) ku ishin skalitur pamje të adhurimit romak. Jozefusi thotë se ai po përpiquej qëllimisht që të përmbyste ligjet dhe zakonet e judenjve (shih Jozefusi, *Ant.* 18.4.1-2).
 - c. duke marrë para nga thesari i tempullit për të ndërtuar një akuedukt në Jerusalem (shih Jozefusi, *Ant.* 18.3.2; *Luftërat e judenjve* 2.9.3).
 - d. duke vrarë disa galileas ndërsa ofronin flijime për Pashkën në Jerusalem.
 - e. duke sjellë mburoja romake në Jerusalem më 31 pas K. I biri i Herodit të Madh iu përgjërue që t’i largonte, por nuk pranoi, kështu që ata i shkruan Tiberit, i cili urdhëroi që mburojat ta ktheheshin në Cezare në anë të detit (shih Filo, *Legatio*

and *Gaium*, 299-305).

- f. duke urdhëruar therjen e shumë samaritanëve në malin Gerizim (36/37 pas K.), teksa po kërkonin për sende të shenjta të fesë së tyre, që ishin humbur. Kjo bëri që eprori vendas i Pilatit (Viteli, prefekti i Sirisë) ta hiqte nga posti dhe ta dërgonte në Romë (shih Jozefusi, *Ant.* 18.4.1-2).
4. Sejani u ekzekutua më 31 pas K. dhe Tiberi rifitoi pushtetin e plotë politik; prandaj, #a, b, c dhe d ka mundësi që të jenë bërë nga Pilati për të fituar besimin e Sejanit; #e dhe f mund të kenë qenë përpjekje për të fituar besimin e Tiberit, por ndoshta mund t'i jenë kthyer kundër.
5. Është e qartë se, me rikthimin e perandorit pro-jude, plus një letër zyrtare drejtuar guvernatorëve nga Tiberi që të tregoheshin të njerëzishëm me judenjtë (shih Filo, *Legatio and Gaium*, 160-161), udhëheqësit e judenjve në Jerusalem përfituan nga cenueshmëria politike e Pilatit para Tiberit dhe e manipuluan që të kryqëzonte Jezusin. Kjo teori e Barnett i bashkon dy pikëpamjet për Pilatin në mënyrë të besueshme.

III. Fundi i tij

- A. E thirrën dhe mbërriti në Romë pak pas vdekjes së Tiberit (37 pas K.).
- B. Nuk i dhanë post tjetër.
- C. Jeta e tij pas kësaj është e panjohur. Ka shumë teori të mëvonshme, por asnjë fakt të sigurt.

18:30 “Nëse ky njeri s’do të ishte keqbërës, nuk do të ta kishim dorëzuar ty” Kjo është një FJALI KUSHTORE E RENDIT TË DYTË, shpesh e quajtur —~~a~~ kundërshtim me faktet”. Jezusi nuk ishte keqbërës. Kjo ishte një thënie ironike e Pilatit, i cili nuk pranonte që të humbiste kohën me akuzat —igoroze” fetare të judenjve.

FOLJA —~~drëzuar~~” është e njëjta që, zakonisht, përkthehet —~~radhtuar~~”, kur u përdor për Judën (shih 6:64, 71; 12:4; 13:2, 11, 21; 18:2, 5). Fjalë për falë, do të thotë —~~ia~~ dorëzoi dikujt autoriteteve”, ose —~~transmetoj~~ një traditë”. Në lidhje me Judën, ky term është intensifikuar nga ana kuptimore nga përkthyesit në anglisht.

18:31 “Ne nuk na lejohet që të vrasim njeri” Krerët e judenjve e kishin dënuar Jezusin për blasfemi, por, që ta ekzekutonin romakët, përdorën akuzën e kryengritjes. Për krerët e judenjve, ishte shumë e rëndësishme që Jezusi të kryqëzohej për shkak të LiP. 21:23 (rabinët e shekullit të parë mendonin se kryqëzimi do të thoshte mallkim nga Perëndia). Jezusi e kishte parathënë këtë në v. 32; 3:14; 8:28; 12:32, 33; dhe Gal. 3:13.

18:32 “kur tha se me ç’loj vdekjeje duhet të vdiste” Pse e donin të kryqëzuar Jezusin krerët e judenjve? Nga Veprat 7, është e qartë se ata i ekzekutonin të dënuarit për blasfemi me vrasje të menjëhershme me gurë. Ka mundësi që të ketë lidhje me mallkimin hyjnor në DhV të LiP. 21:22-23. Në fillim, nënkuptonte varjen pas vdekjes, por rabinët e kohës e interpretonin këtë varg në dritën e kryqëzimit romak. Ata donin që Jezusi, i cili pretendonte se ishte Mesia, të mallkohej nga Perëndia. Ky ishte plani i Perëndisë për shpengimin e njerëzimit të rënë. Jezusi, Qengji i Perëndisë (1:29), ofroi veten si zëvendësues (shih Isa. 53; 2 Kor. 5:21). Jezusi u bë —~~mallkimi~~” për ne (shih Gal. 3:13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:33-38

³³Atëherë, Pilati hyri sërish në Pretorium, thirri Jezusin dhe i tha: “A je mbreti i judenjve?”
³⁴Jezusi iu përgjigj: “Këtë po e thua me nismën tënde, apo të folën të tjerët për mua?” ³⁵Pilati iu përgjigj: “Unë s’jam jude, apo jo? Vetë kombi yt dhe kryepriiftërinjtë të dorëzuan te mua; çfarë ke bërë?” ³⁶Jezusi u përgjigj: “Mbretëria ime nuk është e kësaj bote. Nëse mbretëria ime do të ishte e kësaj bote, shërbëtorët e mi do të luftonin që të mos më dorëzonin te judenjtë; por, në fakt, mbretëria ime nuk është nga kjo botë”. ³⁷Atëherë Pilati i tha: “Pra, ti je mbret?” Jezusi iu përgjigj: “Ti mund të thuash me të drejtë se jam mbret. Për këtë jam lindur, dhe për këtë kam ardhur në botë, për të dëshmuar për të vërtetën. Kushdo që është nga e vërteta e dëgjon zërin tim”. ³⁸Pila i tha: “Çfarë është e vërteta?”

18:33 “Pretorium” Shih Temën e Veçantë në 18:28.

■ **“A je mbreti i judenjve?”** Jezusi u akuzua për tradhti (shih Mat. 27:11; Marku 15:2; Luka 23:2 dhe Gjoni 19:3, 12, 15, 19-22).

18:34 “Jezusi iu përgjigj: „Këtë o e thua me nismën tënde, apo të folën të tjerët për mua?” Nëse Pilati po e bënte këtë pyetje në lidhje me një mbretërim politik, Jezusi duhet ta mohonte. Nëse ia kishin sugjeruar judenjtë, atëherë këtu bëhej fjalë për natyrën e tij mesianike, dhe Jezusi duhet ta pranonte. Me sa duket, Pilati nuk ishte gati që të diskutonte për hollësitë e mendimit fetar judaik (shih v. 35).

18:35 Pyetja e parë pret përgjigjen “jo”. Pilati po shprehte përçmimin e vet për fenë judaike.

18:36 “Nëse mbretëria ime do të ishte e kësaj bote, atëherë shërbëtorët e mi do të luftonin” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet —~~a~~ kundërshtim me faktet”. Duhet përkthyer: —~~N~~ëse mbretëria ime do të ishte e kësaj bote, por nuk është, atëherë shërbëtorët e mi do të luftonin, por nuk po luftojnë”. Frazja —~~s~~hërbëtorët e mi” mund të nënkuptojë (1) dishepujt, ose (2) engjëjt (shih Mat. 26:53).

18:37 “Atëherë, Pilati i tha: „Pra, ti je mbret?” Kjo ishte ironi e skajshme nga buzët e këtij simboli të pushtetit tokësor (pra, Romës), që përballë me Jezusin dhe me mbretërinë e tij shpirtërore. Kjo pyetje pret përgjigjen “po”.

▣ **“Ti mund të thuash me të drejtë se jam mbret. Për këtë jam lindur, dhe për këtë kam ardhur në botë, për të dëshmuar për të vërtetën”** Frazja e parë është e vështirë të përkthehet për shkak të dykuptimësisë së saj. Ky është pohim me cilësime (shih Mat. 27:11; Marku 15:2; Luka 23:3). Jezusi e dinte kush ishte (dy FOLJE NË KOHËN E KRYER) dhe pse erdhi (shih Gjoni 13:1, 3; Marku 10:45; Luka 2:49; Mat. 16:22 e më tej). Pilati nuk do ta kishte kuptuar!

▣ **“Për këtë jam lindur”** Jezusi e ka fjalën për detyrën e tij që të zbulonte Atin (pra, —~~t~~ë dëshmoj për të vërtetën”). Në thelb, ka tre arsye pse erdhi Jezusi.

1. për të zbuluar plotësisht dhe tërësisht karakterin dhe qëllimin e Perëndisë (shih 1:18; 3:32)
2. për të vdekur si qengji i pafajshëm i Perëndisë që të largonte mëkatën e botës (shih 1:29)
3. për t’u dhënë besimtarëve një shembull sesi të jetojnë dhe të kënaqin Perëndinë

▣ **“Kushdo që është nga e vërteta e dëgjon zërin tim”** Gjithmonë prekem thellë nga —~~k~~ushdo”, —~~j~~thsecili”, —~~φ~~o njeri”, —~~j~~thë ata që”! E mahnitshme! Jahve po plotëson Zan. 3:15 në Krishtin. Jezusi rikthen shëmbëllimin e Perëndisë të dëmtuar nga Rënia. Bashkësia e ngushtë dhe personale bëhet përsëri e mundshme! Bashkësia rikthehet tani (eskatologjia e përmbushur).

Vetëm ata që kanë sy dhe veshë shpirtërorë (pra, 10:3, 16, 27; 18:37) mund ta kuptojnë të vërtetën (shih Mat. 11:15; 13:9,16,43; Marku 4:9,23; Luka 8:8; 10:23,24; 14:35; Zbu. 2:7,11,17,29; 3:6,13,22). Jezusi është e vërteta (14:6)! Kur ai flet, ndjekësit e dëgjojnë (shih 10:1-5). Në shkrimet e Gjonit, —~~a~~ shohësh” ose —~~a~~ dëgjosh” të vërtetën, nga ana teologjike, do të thotë të marrësh —~~j~~etën e përvetshme”.

18:38 “Pilati i tha: „Çfarë është e vërteta?” Pilati ia bëri këtë pyetje, por, me sa duket, u largua përpara se të merrte përgjigjen. Pilati donte të sigurohej se Jezusi nuk përbënte kërcënim për qeverisjen romake. Dhe u sigurua. Pastaj, u përpoq ta lëshonte Jezusin siç ishte zakoni i judenjve për atë ditë gjatë stinës së Pashkës (shih v. 39; Mat. 27:15). Ashtu si Luka, Gjoni po shkruan për të treguar se krishterimi nuk ishte kërcënim për perandorinë romake (p.sh., 18:38b; 19:4; Luka 23:4, 14, 22).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 18:38b-40

^{38b}Dhe, pasi tha kështu, doli sërish te judenjtë dhe u tha: “Nuk gjej asnjë faj në të. ³⁹Por ju keni një zakon, që t’ju liroj dikë për Pashkë; atëherë, dëshironi që t’ju liroj mbretin e judenjve?” ⁴⁰Kështu, ata thirrën sërish, duke thënë: “Jo këtë njeri, por Barabën”. Baraba ishte kusar.

18:39 “ju keni një zakon” Kjo shpjegohet te Mat. 27:15 dhe Luka 23:17 (por është e panjohur nga të dhënat historike jashtë DhR).

18:40 “Kështu, ata thirrën sërish, duke thënë: „Jo këtë njeri, por Barabën” Është ironike që, me sa duket, Baraba ishte anëtar i partisë së zelotëve dhe, si rrjedhojë, fajtor pikërisht për akuzën për të cilën u dënua Jezusi (shih Marku 15:7; Luka 23:19, 25). Me sa duket, kjo turmë po priste atje për të mbështetur heroin e tyre popullor vendas. Autoritetet judaike përfituan nga kjo mundësi që të siguroheshin se do të dënohej Jezusi (shih Marku 15:11).

Po kështu, është ironike që emri —Baba” do të thotë —biri i një ati”. Gjoni i përdor këto lojëra fjalësh në gjithë ungjillin e vet. Turma donte që të lirohej —biri i atit”, jo —Bi i Atit”. Errësira kishte ardhur plotësisht!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse shkoi Jezusi në një vend ku e dinte se do ta gjente Juda?
2. Pse nuk e përmend Gjoni agoninë e Jezusit në Gjetseman?
3. Pse e çoi Sinedri Jezusin te Pilati?
4. Pse rendi i ngjarjeve të Gjoni dhe të ungjijve sinoptikë është kaq pështjellues?
5. Pse e pasqyron Gjoni Pilatin se po përpiqej ta lironte Jezusin?

GJONI 19

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ^d	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jezusi dënohet me vdekje (18:38b-19:16a) 18:38b-19:7	Ushtarët tallen me Jezusin 19:1-4 Vendimi i Pilatit 19:5-16	(18:38b-19:7) 18:38b-19:7	Jezusi dënohet me vdekje (18:38b-19:16) 18:40-19:3 19:4-5 19:6a 19:6b 19:7	Jezusi përpara Pilatit (18:28-19:11) 18:33-19:3 19:4-7
19:8-12		19:8-12	19:8-9a 19:9b-10 19:11 19:12	19:8-11 Jezusi dënohet me vdekje 19:12-16a
19:13-16a		19:13-16a	19:13-14 19:15a 19:15b 19:15c 19:16a	
Kryqëzimi i Jezusit 19:16b-22	Mbreti në kryq 19:17-24	19:16b-25a	Jezusi kryqëzohet 19:16b-21 19:22	Kryqëzimi 19:16b-22 Ndarja e rrobave të Jezusit
19:23-27	Ja, nëna jote 19:25-27	19:25b-27	19:23-24 19:25-26 19:27	19:23-24 Jezusi dhe nëna e tij 19:25-27
Vdekja e Jezusit 19:28-30	Ka përfunduar 19:28-30	19:28-30	Vdekja e Jezusit 19:28 19:29-30a 19:30b	Vdekja e Jezusit 19:28 19:29-30
Shpimi i brinjës së Jezusit 19:31-37	Brinja e Jezusit shpohet 19:31-37	19:31-37	Brinja e Jezusit shpohet 19:31-37	Brinja e shpuar 19:31-37
Varrimi i Jezusit 19:38-42	Jezusi varroset në varrin e Jozefit 19:38-42	19:38-42	Varrimi i Jezusit 19:38-42	Varrimi 19:38-42

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:1-7

¹Pastaj, Pilati mori Jezusin dhe e fshikulloi. ²Dhe ushtarët thurën një kurorë me gjemba, ia vunë në kokë dhe i hodhën përsipër një mantel të purpurt; ³dhe filluan të shkonin tek ai dhe t'i thoshin: "Nderime, mbreti i judenjve!" dhe e godisnin me shuplaka në fytyrë. ⁴Pilati doli sërish dhe u tha: "Ja, po jua nxjerr jashtë që të dini se nuk gjej asnjë faj në të". ⁵Pastaj, Jezusi doli jashtë, duke mbajtur kurorën me gjemba dhe mantelin e purpurt. Pilati u tha: "Ja, njeriu!" ⁶Kështu, kur krerët e priftërinjve dhe oficerët e panë, bërtitën duke thënë: "Kryqëzoje! Kryqëzoje!" Pilati u tha: "Merreni vetë dhe kryqëzoheni, sepse unë nuk gjej asnjë faj në të". ⁷Judenjtë iu përgjigjën: "Ne kemi një ligj, dhe sipas atij ligji ai duhet të vdesë sepse e bëri veten Bir të Perëndisë".

19:1 "Pilati e mori Jezusin dhe e fshikulloi" Radha kohore dhe numri i fshikullimeve është i paqartë. Të gjithë të burgosurit që dënoheshin me kryqëzim rriheshin me kamxhik. Ishte diçka kaq e dhunshme sa shumë njerëz vdisnin prej fshikullimit. Mirëpo, në këtë kontekst, duket se Pilati e fshikulloi Jezusin që të fitonte keqardhje, me qëllim që ta lironte (shih Luka 23:16, 22; Gjoni 19:12). Kjo mund të jetë përmbushje profetike e Isa. 53:5.

Fshikullimi romak ishte një ndëshkim tmerrsisht i dhimbshëm dhe i dhunshëm për ata që s'ishin shtetas romakë. Një kamxhik me rripa lëkure dhe me copa kockash ose metali të lidhura në majë të tyre përdorej për të rrahur të dënuarin, i cili rrinte i kërrusur me duart e lidhura te një shkop i ulët. Numri i goditjeve nuk ishte i përcaktuar. Zakonisht, kryhej përpara kryqëzimit (shih Livi XXXIII:36).

Ungjijtë përdorin fjalë të ndryshme për të përshkruar rrahjet në duart e romakëve.

1. Mat. 27:26; Marku 15:15 - *fragelloō*, fshikulloj ose rrah me kamxhik
2. Luka 23:16, 22- *paideuō*, në fillim, përdorej për disiplinimin e fëmijës shih Heb. 12:6-7,10), por, këtu, ashtu si dhe te 2 Kor. 6:9, përdoret për rrahjen
3. Gjoni 19:1 – *mastigoō*, në fillim përdorej si emër për kamxhikun (Mat. 10:17; 20:19; 23:34; Veprat 22:24-25; Heb. 11:36)

Mund të jenë të gjitha sinonime, ose mund të përshkruajnë dy rrahje të ndryshme

- a. Një rrahje më të vogël nga Pilati
- b. Një fshikullim me kamxhik përpara kryqëzimit

19:2 "ushtarët thurën një kurorë me gjemba, ia vunë në kokë" Kjo ishte një mënyrë torture, ku gjembat i nguleshin në vetulla Jezusit. Megjithatë, është plotësisht e mundur që kjo të përfaqësonte një kurorë mbretërore, që bëhej me gjethe palme, dhe kjo ishte një mënyrë tjetër sesi e tallnin Jezusin si mbret (shih Mat. 27:27-31; Marku 15:15-20).

Fjala greke "kurorë" (*stefanos*) përdorej për kurorën me dafina, që jepej për fitore atletike, ose që vihej nga perandori.

■ **"i hodhën përsipër një mantel të purpurt"** Purpuri (*porfiros*) ishte shenjë mbretërie, pasi kjo bojë ishte shumë e shtrenjtë sepse bëhej prej një guaske molusku. E kuqja ishte ngjyra e manteleve të oficerëve romakë (Marku 15:17, 20). Ngjyra e kuqe bëhej nga luspa e një insekti që gjendej në pemët e ahut. Ky mantel ishte

aludim për mantelin mbretëror me ngjyrë të purpurt, por, në të vërtetë, ndoshta ishte manteli i oficerit romake, me ngjyrë të kuqe të hapur (shih Mat. 27:28).

19:3

NASB “dhe filluan të shkonin tek ai dhe t’i thoshin”

NKJV “pastaj, i thanë”

NRSV “Vinin vazhdimisht tek ai dhe i thoshin”

TEV “dhe vinin tek ai dhe i thoshin”

NJB “Vinin vazhdimisht tek ai dhe i thoshin”

Këto janë KOHË TË PAKRYERA. Me sa duket, ushtarët e bënin këtë gjë me radhë. Kjo tallje ishte më tepër përçmim për judenjtë në përgjithësi, sesa për Jezusin në veçantë. Ka gjasa që Pilati donte që kjo të ngjallte keqardhje për Jezusin, por nuk funksionoi.

Sërisht, ën shkrimet e Gjonit, shpesh thënie profetike vihen në gojën e kundërshtarëve. Këta ushtarë thanë më tepër nga ç’kuptonin.

▣ “dhe e godisnin me shuplaka në fytyrë” Në fillim, kjo fjalë kishte kuptimin “rrah me shkop”, por më vonë përdorej thjesht si “godas me dorë të hapur”. Më tepër se rrahje e dhunshme në fytyrë, ky mund të ketë qenë një gjest tallës i përshëndetjes mbretërore.

19:4

NASB “nuk gjej asnjë faj në të”

NKJV “nuk gjej asnjë faj në të”

NRSV “nuk gjej asnjë argument kundër tij”

TEV “nuk gjej asnjë arsye që ta dënoj”

NJB “nuk gjej asnjë argument kundër tij”

Një nga synimet e Gjonit ishte të tregonte se krishterimi nuk përbënte kërcënim për qeverinë romakë, ose për zyrtarët e saj. Gjoni shkruan se Pilati u përpoq ta lironte Jezusin disa herë (shih 18:38; 19:6; Luka 23:4, 14, 22).

19:5

NASB, NKJV “Ja, njeriu!”

TEV, NET “Shikoni! Ky është njeriu!”

NRSV, NJB,

REB “Ja, njeriu!”

Ka patur disa mënyra sesi është kuptuar kjo frazë.

1. Jezusi i veshur si mbret, për tallje
2. Jezusi i rrahur, për të ngjallur keqardhje
3. Aludim për Zak. 6:12 (referenti mesianik “Dega”)
4. Një pohim i mëvonshëm i natyrës njerëzore të Jezusit (në kundërshtim me gnosticizmin e kohës së Gjonit)
5. Lidhej me termin aramaik “biri i njeriut”, *bar nashā* (një tjetër referent i fshehur mesianik)

19:6 “bërtitën: “Kryqëzoje! Kryqëzoje!” Arsyeja pse krerët e judenjve donin që Jezusi të kryqëzohej ishte që të hynte në efekt mallkimi i LiP. 21:23. Kjo është një arsye pse Pali, ndoshta, kishte dyshime kaq të mëdha për Jezusin e Nazaretit si Mesia i Perëndisë. Sidoqoftë, nga Gal. 3:13, mësojmë se Jezusi mbarti mallkimin tonë në kryq (shih Kol. 2:14).

▣ “nuk gjej asnjë faj në të” Pilati e thotë tri herë këtë gjë (shih 18:38; 19:4).

19:7 “Ai duhet të vdesë sepse e bëri veten Bir të Perëndisë” Jezusi pohoi vërtet se ishte një me Perëndinë, dhe ishte vetë Biri i tij. Judenjtë, që ia kishin dëgjuar këto thënie dhe ua kuptonin qëllimin, nuk kishin dyshime se ai po pohonte se ishte hyjnor (shih 5:18; 8:53-59; 10:33). Akuza e vërtetë e judenjve kundër Jezusit ishte blasfemia (shih Mat. 9:3; 26:65; Marku 2:7; 14:64; Luka 5:21; Gjoni 10:33, 36). Akuza për blasfemi ndëshkohej me vrasje me gurë (shih Lev. 24:16). Nëse Jezusi nuk është Hyjnia i mishëruar dhe paraekzistues, duhet vrarë me gurë!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:8-12

⁸Atëherë, kur Pilati dëgjoi këtë thënie, u frikësua edhe më tepër; ⁹dhe hyri sërish në Pretorium dhe i tha Jezusit: “Nga je ti?” Por Jezusi nuk i dha asnjë përgjigje. ¹⁰Kështu, Pilati i tha: “Ti nuk flet me mua? A nuk e di se unë kam autoritet të të liroj, dhe kam autoritet të të kryqëzoj?” ¹¹Jezusi iu përgjigj: “Ti nuk ke asnjë autoritet mbi mua, përveçse nëse të është dhënë nga lart; për këtë arsye, ai që më dorëzoi te ti ka mëkatën më të madh”. ¹²Për shkak të kësaj, Pilati bëri përpjekje që ta lironte, por judenjtë bërtisnin duke thënë: “Nëse liron këtë njeri, nuk je mik i Cezarit; kushdo që bën veten mbret, i kundërvihet Cezarit”.

19:8 “kur Pilati dëgjoi këtë thënie, u frikësua edhe më tepër” Gruaja e kishte paralajmëruar tashmë Pilatin për Jezusin (shih Mat. 27:19) dhe, tani, krerët e judenjve po thoshin se ai kishte pretenduar se ishte Biri i Perëndisë. Pilati, duke qenë besëtytë, u frikësua. Ishte shumë e zakonshme që perënditë e panteonit grek dhe romak ta vizitonin njerëzimin të veshur me formë njerëzore.

19:9

NASB, NKJV,

NRSV

“Nga vjen ti?”

TEV, NJB,

NIV

“Nga vjen ti?”

Pilati nuk po pyet për vendlindjen e Jezusit, por për origjinën e tij. Pilati po fillon të shquajë rëndësinë e personit që kishte përballë. Jezusi e dinte nga komentet e tij në 18:38 se Pilatit nuk i interesonte e vërteta, por leverdia politike, kështu që nuk iu përgjigj.

Pilati i bashkohet një numri njerëzish që mahniten nga Jezusi, por nuk ia kuptojnë origjinën (shih 4:12; 6:42; 7:27-28, 41-42; 8:14; 9:29-30). Kjo është pjesë e dualizmit vertikal të Gjonit. Jezusi është nga lart dhe askush poshtë nuk mund të njohë/kuptojë/shohë/dëgjojë pa prekjen e Atit (shih 6:44, 65; 10:29).

▣ **“Jezusi nuk i dha asnjë përgjigje”** Pilatit duhet t’i jetë kujtuar përgjigja e Jezusit (shih 18:37)! Disa e shohin këtë si përmbushje të Isaisë 53:7.

19:10 “dhe kam autoritet të të kryqëzoj” Pilati pohon se ka autoritetin politik të jetës dhe vdekjes, por, përballë një turme të pashtuar, heq dorë nga kjo e drejtë për të bërë vullnetin e tyre. Nga ana gramatikore, pyetja e Pilatit pret përgjigjen “po”.

19:11 “ti nuk ke asnjë autoritet mbi mua, përveçse nëse të është dhënë nga lart” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet “në kundërshtim me faktet”. Jezusi nuk i druhet Pilatit. Ai e di se kush është dhe pse ka ardhur! Bibla pohon se Perëndia qëndron pas çdo autoriteti njerëzor (shih Rom. 13:1-7).

▣ **“ai që ma dorëzoi te ti ka mëkatën më të madhe”** Në lexim të parë, duket sikur këtu bëhet fjalë për Juda Iskariotin (shih 6:64, 71; 13:11), por shumica e komentuesve besojnë se bën fjalë për Kajafën, i cili ua dorëzoi zyrtarisht Jezusin romakëve. Kjo frazë mund të kuptohet në mënyrë kolektive sikur bën fjalë për (1) krerët e paligjshëm të judenjve, ose (2) për popullin jude në tërësi (shih Mat. 21:33-46; Marku 12:1-12; Luka 20:9-19; Romakëve 9-11).

19:12 “Pilati bëri përpjekje që ta lironte” Kjo është një KOHË E PAKRYER, që nënkupton veprim të përsëritur në të shkuarën. Ai u përpoq disa herë.

▣ **“nëse liron këtë njeri, nuk je mik i Cezarit”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Krerët e judenjve po kërcënonin se do ta raportonin Pilatin te eprorët e vet në Romë nëse nuk plotësonte dëshirën e tyre që ta dënonte Jezusin me vdekje. Frazja “mik i Cezarit” ishte një frazë zhargon që reflektonte një titull nderi që jepej nga perandori romak (që e nisi Augusti ose Vespasiani).

Cezari ishte titull i perandorit romak. Vinte nga Jul Cezari dhe u përdor nga Augusti.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:13-16

¹³Kështu, kur Pilati dëgjoi këto fjalë, e nxori Jezusin jashtë dhe u ul në fronin e gjyqimit në një vend të quajtur “Kalldrëm”, kurse në hebraisht “Gabbatha”. ¹⁴Ishte dita e përgatitjes për Pashkën; ishte rreth orës së gjashtë. Dhe u tha judenjve: “Ja, mbreti juaj!” ¹⁵Kështu, ata bërtitën: “Largoje, largoje, kryqëzoje!” Pilati u tha: “Të kryqëzohet mbretin tuaj?” Krerët e priftërinjve iu përgjigjen: “Ne s’kemi mbret përveç Cezarit”. ¹⁶Kështu, ai ua dorëzoi që të kryqëzohej.

19:13 “kur Pilati dëgjoi këto fjalë, e nxori Jezusin jashtë dhe u ul në fronin e gjyqimit” Teksti është i paqartë se kush ulet në fronin e gjyqimit. Williams dhe Goodspeed, në përkthimet e tyre, thonë se aty u vu vetë Jezusi, në mënyrë tallëse si Mbreti i Judenjve. Mirëpo, konteksti nënkupton Pilatin, i cili pas pak do të jepte gjykimin.



NASB, NKJV,

NJB “i quajtur „Kalldrëm“, kurse në hebraisht, „Gabbatha””

NRSV “i quajtur Kalldrëmi me Gurë, ose në hebraisht Gabbatha”

TEV “i quajtur „Kalldrëmi me Gurë“ (në hebraisht, ky emër është „Gabbatha”)”

Përdorimi i fjalëve hebraisht/aramaisht, bashkë me përcaktimet e tyre, tregon se lexuesit e synuar të Gjonit për ungjillin e tij ishin johebrej (shih v. 17). Ky kalldrëm me gurë ishte vendi ku jepeshin deklaratat ligjore romake. Termi aramaik *Gabbatha* do të thotë “gurë të ngritur” ose “vend i ngritur”.

19:14 “ishte dita e përgatitjes për Pashkën” Ka një mospërkim të dukshëm mes datimit të ungjijve sinoptikë dhe datimit të Gjonit. Te sinoptikët, Jezusi e hëngri darkën e Pashkës me dishepujt përpara arrestimit (shih Marku 15:42), kurse te Gjoni darka ndodhi në Ditën e Përgatitjes përpara Festës. Shih shënimin e plotë në 18:28.

■ **“ishte rreth orës së gjashtë”** Kronologjia e gjyqit të Jezusit përpara Pilatit dhe e kryqëzimit të tij është:

	<u>Mateu</u>	<u>Marku</u>	<u>Luka</u>	<u>Gjoni</u>
Vendimi i Pilatit				ora e gjashtë 19:14
Kryqëzimi		Ora e tretë 15:25		
Ra errësira	Ora e gjashtë-nëntë 27:45	Ora e gjashtë-nëntë 15:33	Ora e gjashtë-nëntë 23:44	
Jezusi bërtiti	Ora e nëntë 27:46	Ora e nëntë 15:34		

Kur këto përcaktime kohore krahasohen me njëra-tjetrën, dalin dy mundësi interpretuese.

1. Janë e njëjta gjë. Gjoni përdori kohën romake, që niste nga ora 12:00 e drekës (shih Gleason L. Archer, *Encyclopedia of Bible Difficulties* [Enciklopedia e vështirësive biblike], f. 364), ndërsa sinoptikët përdorin kohën judaike, që niste nga 6:00 e mëngjesit.
2. Gjoni po shpreh një kohë të mëvonshme për kryqëzimin e Jezusit, që do të ishte një tjetër shembull i dallimeve mes sinoptikëve dhe Gjonit.

Nga Gjoni 1:39 dhe 4:6, duke se Gjoni po përdor kohën judaike, jo atë romake (shih M. R. Vincent, *Word Studies*, vëll. 1, f. 403).

Përcaktimet kohore mund të jenë simbolike në të gjitha ungjijtë, pasi lidhen me

1. kohën e fljimeve të përditshme në tempull (9 e mëngjesit dhe 3 e drekës; shih Veprat 2:15; 3:1)
2. pak pas mesditës ishte koha tradicionale për therjen e Qengjit të Pashkës në pasditen e 14 Nisanit

Si libër i lashtë lindor, Bibla nuk përqendrohet te kronologjia, ndryshe nga rrëfimet historike perëndimore të kohës sonë.

■ **“Ja, mbreti juaj”** Ashtu si vargu 5 mund të jetë aludim për Zak. 6:12, edhe kjo frazë mund të jetë aludim për Zak. 9:9 (shih F. F. Bruce, *Answers to Questions*, f. 72).

19:14 Fjali e parë është një tjetër koment redaktorial.

19:15 “Largoje, largoje, kryqëzoje!” Kjo frazë ka tre URDHËRORE AORISTE VEPRORE. Rrënja e fjalës “kryqëzoj” donte të thoshte “ngre” ose “lartësoj”; kjo mund të jetë një tjetër fjali me dy kuptime nga ana e Gjonit (shih 3:14; 8:28; 12:32).

■ **“Krerët e priftërinjve u përgjigjën: „Ne s’kemi mbret përveç Cezarit”** Ironia këtu është e jashtëzakonshme. Këta krerë të judenjve ishin fajtorë për blasfemi, pikërisht ajo akuzë që patën ngritur ndaj Jezusit. Në DhV, vetëm Perëndia është Mbreti i popullit të vet (shih 1 Sam. 8).

19:16 “ua dorëzoi” Te Mat. 27:26-27 dhe Marku 15:15-16, ky PËREMËR u referohet ushtarëve romakë. Te Gjoni, nënkuptohet se Pilati ua dorëzoi Jezusin dëshirave të krerëve të judenjve dhe turmës.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:17-22

¹⁷Kështu, ata e morën Jezusin dhe ai doli, duke mbajtur kryqin e vet, te vendi që quhet Vendi i Kafkës, që në hebraisht quhet Golgota. ¹⁸Aty, e kryqëzuan dhe, bashkë me ty, dy burra të tjerë, secili nga njëra anë dhe Jezusi në mes. ¹⁹Po kështu, Pilati shkroi një mbishkrim dhe e vuri mbi kryq. Aty thuhej: **“JEZUSI NAZAREAS, MBRETI I JUDENJVE”**. ²⁰Kështu, shumë prej judenjve e lexuan këtë mbishkrimin, pasi vendi ku ishte kryqëzuar Jezusi ishte pranë qytetit; dhe ishte shkruar në hebraisht, latinisht dhe greqisht. ²¹Kështu, krerët e priftërinjve të judenjve po i thoshin Pilatit: “Mos shkruaj „Mbreti i judenjve”, por se ai tha „unë jam mbreti i judenjve””. ²²Pilati u përgjigj: “Atë që e shkrova, e shkrova”.

19:17 “duke mbajtur kryqin e vet” Forma e kryqit në Palestinën e shekullit të parë është e paqartë; mund të ketë qenë në formën e një T-je të madhe, një t-je të vogël, ose e një X-je. Nganjëherë, disa të burgosur kryqëzoheshin te e njëjta skelë. Cilado të ketë qenë forma e kryqit, i burgosuri i dënuar, i cili sapo ishte fshikulluar me kamxhik, duhet ta mbartte pjesën e drunjte deri te vendi i kryqëzimit (shih Mat. 27:32; Marku 15:21; Luka 14:27; 23:26).

■ **“Vendi i Kafkës, që në hebraisht quhet Golgota”** Kuptimi i saktë i kësaj fraze është i paqartë. Në hebraisht/aramaisht, kjo fjalë nuk i referohej një kodre që i ngjante një kafke të plotë, por një kodre të ulët e të zhveshur që ndodhej në një rrugë kryesore që të çonte në Jerusalem. Romakët i kryqëzonin njerëzit për të parandaluar kryengritjet. Arkeologjia moderne është e paqartë për vendin e saktë të mureve të lashta të qytetit. Jezusi u vra jashtë murit të qytetit në një vend të mirënjohur publik për ekzekutimet!

19:18 “Aty e kryqëzuan” Asnjë nga ungjijtë nuk hyn në hollësitë fizike të kryqëzimit romak. Romakët e kishin mësuar nga kartagenasit, të cilët e patën mësuar nga persët. Edhe forma e kryqit nuk dihet me saktësi. Gjithsesi, dimë që ishte një vdekje e dhunshme dhe e ngadaltë! Ishte krijuar që ta mbante njeriun gjallë dhe në dhimbje për ditë të tëra. Zakonisht, vdekja vinte nga asfiksioni. Synohej si mjet parandalimi kryengritjesh kundër Romës.

■ **“dy burra të tjerë”** Kjo përmbushi profecinë e Isa. 53:9, e regjistruar te Mat. 27:38; Marku 15:27; dhe Luka 23:33.

19:19 “Po kështu, Pilati shkroi dhe një mbishkrim” Pilati mund ta ketë shkruar me dorë këtë titull (*titlon*), dhe pastaj dikush tjetër e shkroi në pllakën prej druri. Mateu e quan “akuza” (*aitian*, shih Mat. 27:37), ndërsa Marku dhe Luka e quajnë mbishkrim (*epigrafi*, shih Marku 15:26; Luka 23:38).

19:20 “dhe ishte shkruar në hebraisht, latinisht dhe greqisht” “hebraisht” nënkupton gjuhën aramaisht (shih 5:2; 19:13, 17; 20:16; Jozefusi, *Ant.* 2.13.1). Është interesante të vërejmë larminë mes ungjijve për fjalët e sakta të akuzës që u vendosën mbi kokën e Jezusit në kryq.

1. Mat. 27:37 – “Ky është Jezusi, Mbreti i judenjve”
2. Marku 15:26 – “Mbreti i judenjve”
3. Luka 23:38 – “Ky është Mbreti i judenjve”
4. Gjoni 19:19 – “Jezusi nazareas, Mbreti i judenjve”

Secili është ndryshe, por në thelb, është i njëjti. Kjo është e vërtetë për shumicën e larmive të hollësive historike midis ungjijve. Secili shkrimtar i regjistroi kujtimet e veta në mënyra disi të ndryshme, por janë gjithsesi i njëjti rrëfim prej dëshmitari okular.

Pilati synonte të acaronte krerët e judenjve duke vendosur mbi kryqin e Jezusit vetë titullin që i druheshin (shih v. 21-22).

19:22 “Atë që e shkrova, e shkrova” Këto janë dy FOLJE NË KOHËN E KRYER, që theksojnë përmbushjen dhe karakterin përfundimtar të asaj që ishte shkruar.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:23-25a

²³Atëherë, ushtarët, pasi e kryqëzuan Jezusin, ia morën rrobat e jashtme dhe bënë katër pjesë, nga një pjesë për secilin ushtar, dhe tunikën; tunika ishte pa tegela, e endur nga një copë e vetme. ²⁴Kështu, i thanë njëri-tjetrit: “Le të mos e grismi, por të hedhim short për të, që të vendosim e kujt do të jetë”; kjo u bë për të përmbushur Shkrimin: “ATA M’I NDANË VESHJET E JASHTME MES NJËRI-TJETRIT, NDËRSA PËR TUNIKËN TIME HODHËN SHORT”. ²⁵Kështu, ushtarët i bënë këto gjëra.

19:23 “bënë katër pjesë, nga një pjesë për secilin ushtar” Ushtarët lozën kumar për rrobat e Jezusit. Këtu bëhet fjalë vetëm për veshjen e jashtme. Nuk është e qartë sesi mund të ndaheshin në katër pjesë rrobat e Jezusit. Këtu duhet të bëhet fjalë për këpucët e tij, shallin e lutjes (*tallith*), rripit të mesit dhe veshjeve të jashtme. Është e paqartë nëse Jezusi kishte veshur turban apo jo. Judenjtë duhet të ndiheshin të fyer nga zhveshja e plotë. Kjo është një tjetër profeci e përmbushur, e cituar në v. 24 (shih Psa. 22:18).

■ **“tunika”** Veshja e jashtme e Jezusit përmendet me termin në SHUMËS *himatia*. Veshja e tij e gjatë dhe e brendshme, që vishej mbi lëkurë, ishte tunika (*hitōn*). Dallimi mes këtyre mund të shihet te Mat. 5:40 dhe Luka 6:29. Dorka i bënte të dyja këto lloj veshjesh (shih Veprat 9:39). Me sa duket, judenjtë e shekullit të parë vishnin dhe një veshjeje tjetër të brendshme që quhej “veshja e ijëve”. Jezusin nuk e zhveshën plotësisht.

Fraza e fundit e v. 23 është një tjetër koment redaktorial nga një njeri që kishte jetuar me Jezusin.

■ **“tunika ishte pa tegela, e endur nga një copë e vetme”** Kjo mund të ketë domethënie teologjike. Një tunikë e tillë ishte e pazakontë dhe mund të ketë qenë e shtrenjtë. Duket jashtë karakteri që Jezusi të ketë patur një veshje jashtëzakonisht të shtrenjtë. Nga Jozefusi (*Ant.* 3.7.4) dimë se Kryepriifti mbante një mantel të tillë, pasi tradita rabinike thotë se këtë e kishte bërë dhe Moisiu. Mos ndoshta kjo është referencë për Jezusin si

1. Kryepriift (shih Hebrenjve)
2. Ligdhënësi i ri

Kuptimet e dyfishta janë gjithmonë të mundshme në ungjillin e Gjonit, por interpretuesit duhet të jenë të kujdesshëm që të mos alegorizojnë çdo hollësi!

19:24 “kjo u bë për të përmbushur Shkrimin” Psalmi 22 përbënte sfondin e DhV për kryqëzimin.

1. Psalmi 22:1-2 – Mat. 27:46; Marku 15:34
2. Psalmi 22:7-8 – Mat. 27:39,43; Marku 15:29; Luka 23:35
3. Psalmi 22:15 – Mat. 27:48; Marku 15:36; Luka 23:36; Gjoni 19:28, 29
4. Psalmi 22:16 – Mat. 27:35; Marku 15:24; Gjoni 20:25
5. Psalmi 22:18 – Mat. 27:35; Marku 15:24; Luka 23:34; Gjoni 19:24
6. Psalmi 22:27-28 – Mat. 27:54; Marku 15:39; Luka 23:47; (Gjoni 20:31; Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:25b-27

^{25b}Por, përbri kryqit të Jezusit, po qëndronin nëna e tij, motra e nënës së tij, Maria gruaja e Kleopës dhe Marie Magdalena. ²⁶Atëherë, kur Jezusi pa nënën e vet dhe dishepullin që e donte duke qëndruar përbri, i tha nënës: “Grua, ja biri yt!” ²⁷Pastaj, i tha dishepullit: “Ja nëna jote!” Që nga ajo orë, dishepulli e mori në shtëpinë e vet.

19:25 “përbri kryqit të Jezusit, po qëndronin nëna e tij, motra e nënës së tij, Maria gruaja e Kleopës, dhe Marie Magdalena” Ka shumë diskutime nëse këtu kemi katër emra, apo tre. Ka gjasa që këtu kemi katër emra, pasi nuk mund të kishte dy motra me të njëjtin emër: Marie. Motra e Marisë, Salomeja, përmendet te Marku 15:40 dhe 16:1. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë kjo do të thoshte se Jakobi, Gjoni dhe Jezusi ishin kushërinj. Një traditë e shekullit të dytë (*Hegesipi*) thotë se Kleopa ishte vëllai i Jozefit. Marie Magdalena ishte ajo prej së cilës Jezusi

dëboi shtatë djaj, dhe e para të cilës ai zgjodhi t'i shfaqej pas ringjalljes (shih 20:1-2, 11-18; Marku 16:1; Luka 24:1-10).

TEMË E VEÇANTË: GRATË QË NDIQNIN JEZUSIN

- A. Përmendja e parë e grave ndjekëse të Jezusit, që ndihmonin atë dhe grupin e apostujve, është Luka 8:1-3.
1. Maria, që quhej Magdalena (v. 2)
 - a. Mat. 27:56, 61; 28:1
 - b. Marku 15:40, 47; 16:1, 9
 - c. Luka 8:2; 24:10
 - d. Gjoni 19:25; 20:1, 11, 16, 18
 2. Joana, gruaja e Kuzës (shërbëtori i Herodit, v. 3), renditet edhe te Luka 24:10
 3. Suzana (v. 3)
 4. “dhe shumë të tjera që kontribuonin për mbështetjen e tyre nga pasuria e tyre personale” (v. 3)
- B. Një grup grash përmenden si të pranishme në kryqëzim
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (27:56)
 - b. Maria, nëna e Jakobit dhe Jozefit (27:56)
 - c. Nëna e bijve të Zebedeut (27:56)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (15:40)
 - b. Maria, nëna e Jakobit të vogël dhe Jozeut (15:40)
 - c. Salomeja (15:40)
 3. Luka thotë vetëm “gratë që e shoqëronin nga Galileja” (23:49)
 4. Lista e Gjorit
 - a. Maria, nëna e Jezusit (19:25)
 - b. Motra e nënës së tij (19:25)
 - c. Maria e Kleopës [*tu Cleopas*, që mund të ketë kuptimin “gruaja e Kleopës”, ose “bija e Kleopës”] (19:25)
 - d. Marie Magdalena (19:25)
- C. Përmendet një grup grash që vëzhguan vendin e varrimit të Jezusit
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (27:61)
 - b. Maria tjetër (27:61)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (15:47)
 - b. Maria, nëna e Jozes (15:47)
 3. Luka thotë vetëm “gratë që kishin ardhur me të nga Galileja” (23:55)
 4. Gjoni nuk thotë asgjë për gratë që panë varrin
- D. Një grup grash erdhën te varri të dielën herët në mëngjes
1. Lista e Mateut
 - a. Marie Magdalena (28:1)
 - b. Maria tjetër (28:1)
 2. Lista e Markut
 - a. Marie Magdalena (16:1)
 - b. Maria, nëna e Jakobit (16:1)
 - c. Salomeja (16:1)
 3. Lista e Lukës
 - a. “ato erdhën te varri” (24:1-5, 24)
 - (1) Marie Magdalena (24:10)
 - (2) Joana (24:10)
 - (3) Maria, nëna e Jakobit (24:10)
 4. Jakobi rendit vetëm Marie Magdalenën (20:1, 11)
- E. Gratë përmenden si të pranishme në dhomën e sipërme (Veprat 1:14)

1. “gratë” (1:14)
 2. Maria, nëna e Jezusit (1:14)
- F. Marrëdhënia e saktë midis grave të ndryshme në këto lista të ndryshme është e paqartë. Qartazi, Marie Magdalena luan rol kryesor. Një artikull i mirë për “gratë” në jetën dhe shërbesën e Jezusit gjendet te *Dictionary of Jesus and the Gospels [Fjalor i Jezusit dhe i ungjijve]*, botuar nga IVP, f. 880-886.

19:26 “dishepullin që e donte” Meqë Gjoni nuk përmendet me emër në këtë ungjill, shumë mendojnë se kjo ishte mënyra e tij për të identifikuar veten (shih 13:23; 19:26; 21:7, 20). Në secilin prej tyre, ai përdor fjalën *agapaō*, por te 20:2 përdor të njëjtën frazë me foljen *fileō*. Këto fjalë janë sinonime të Gjoni; krahaso me 3:35, *agapaō* dhe 5:20, *fileō*, ku bëjnë fjalë për dashurinë e Atit për Birin.

19:27 “që nga ajo orë, dishepulli e mori në shtëpinë e vet” Kjo nuk do të thotë medoemos se Gjoni e mori menjëherë Marinë në shtëpinë e vet, ndonëse kjo mund të nënkuptohet nga fakti se ajo nuk renditet me gratë e tjera te Mat. 27:56 dhe Marku 15:40. Tradita thotë se Gjoni u kujdes për Marinë derisa vdiq dhe, pastaj, shkoi në Azinë e Vogël (veçanërisht në Efes), ku pati një shërbesë të gjatë dhe të suksesshme. Pikërisht i nxitur nga pleqtë efesianë, Gjoni, kur ishte plak, shkroi kujtimet e veta për jetën e Jezusit (pra, ungjillin e Gjoni).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:28-30

²⁸Pas kësaj, Jezusi, duke ditur se gjithçka ishte përmbushur tashmë, për të plotësuar Shkrimin, tha: “Jam i etur”. ²⁹Aty ishte një qyp plot me uthull; kështu, vunë një sfungjer plot me uthull mbi një degë hisopi dhe ia vunë te goja. ³⁰Kështu, kur mori uthullën, Jezusi tha: “Ka përfunduar!” Dhe uli kryet e dha shpirt.

19:28 “Jezusi, duke ditur se gjithçka ishte përmbushur tashmë, për të përmbushur Shkrimin, tha: „Jam i etur” Nga ana sintaksore, është e paqartë nëse Shkrimi i përmendur i referohet frazës “jam i etur”, apo “gjithçka ishte përmbushur tashmë”. Nëse merret në mënyrën tradicionale, atëherë “jam i etur” i referohet Psa. 69:21.

19:29 “Aty ishte një qyp plot me uthull” Kjo ishte verë e lirë, e thartuar. Përdorej edhe për ushtarët, edhe për të kryqëzuarit. Atyre u jepeshin sasi të vogla lëngu me qëllim që ta bënin kryqëzimin të zgjaste më tepër.

▣ **“uthull”** Fjalë për fjalë, “verë e thartuar”. Kjo ishte pija e të varfërve. Vini re se Jezusi nuk e pi verën e droguar që i ofruan gratë e Jerusalemit (shih Marku 15:23; Mat. 27:34). Ka gjasa që arsyeja pse ai e pranoi këtë pije ishte për të përmbushur Psa. 22:15. Ai ishte tepër i tharë nga goja që të fliste, dhe donte të thoshte diçka të fundit.

▣ **“mbi një degë hisopi”** Disa e shohin këtë si përdorim simbolik të bimës se veçantë që përdorej në shërbesën e Pashkës (shih Eks. 12:22). Të tjerë besojnë se ka ndodhur një ndryshim i lashtë kopjues i këtij termi dhe se, në fillim, shkruante “heshtë”, “heshtë e gjatë”, ose “shkop” (shih NEB, por REB i rikthehet hisopit). Mateu 27:48 dhe Marku 15:36 shkruajnë “kallam”.

Arsyeja pse shumë shohin një ndryshim kopjues këtu është se bima e hisopit nuk kishte kërcell shumë të gjatë (vetëm 50 cm deri në 1 metër), por duhet të mos harrojmë se kryqet nuk ngriheshin shumë lart si nivel. Pikturat tona tradicionale me një kryq të lartë mund të vijnë si keqkuptim i 3:14. Këmbët e Jezusit mund të kenë qenë vetëm 30-60 cm mbi tokë.

19:30 “Ka përfunduar!” Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE. Nga ungjijtë sinoptikë, mësuam se ai e tha këtë gjë duke bërëtitur me zë të lartë (shih Marku 15:37; Luka 23:46; Mat. 27:50). Këtu bëhet fjalë për veprën e përfunduar të shpengimit. Kjo formë e fjalës (*telos*) në papiruset egjiptiane (Moulton dhe Milligan) ishte term tregtar që donte të thoshte “paguar plotësisht”.

▣ **“Uli kryet dhe dha shpirt”** Frazja “uli kryet” ishte shprehje, që donte të thoshte “shkoi për të fjetur”. Vdekja e Jezusit ishte çast i qetë për të. Aludimi është se, në vdekje, aspekti shpirtëror i njeriut ndahet nga ai fizik. Kjo duket se kërkon ekzistencën e një gjendjeje të patrupëzuar për besimtarët midis vdekjes dhe ditës së ringjalljes (shih 2 Kor. 5; 1 Thes. 4:13-18; shih William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter*).

Paralelet në ungjijtë e tjerë, Marku 15:37 dhe Luka 23:46, shkruajnë “ai dha frymën e fundit”. Fjalët hebraisht “frymë” dhe “marr frymë” janë njësoj. Asti kur fryma e Jezusit la trupin e tij (shih Zan. 2:7).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:31-37

³¹Atëherë judenjët, për shkak se ishte dita e përgatitjes, që trupat të mos qëndronin në kryq gjatë shabatit (sepse ai shabat ishte ditë e rëndësishme), i kërkuan Pilatit që atyre t'u thyheshin këmbët dhe të hiqeshin prej andej. ³²Kështu ushtarët erdhën dhe i thyen këmbët burrit të parë, si dhe atij të dytë, që ishte kryqëzuar me të; ³³por, kur erdhën te Jezusi dhe panë se ai kishte vdekur tashmë, nuk ia thyen këmbët. ³⁴Por një nga ushtarët ia shpoi brinjën me heshtë, dhe i rrodhi menjëherë gjak dhe ujë. ³⁵Dhe ai që e ka parë ka dëshmuar, dhe dëshmia e tij është e vërtetë; dhe ai e di se po thotë të vërtetën, në mënyrë që ju të mund të besoni. ³⁶Sepse këto gjëra ndodhën që të përmbushnin Shkrimin: “Asnjë kockë e tij nuk do të thyhet”. ³⁷Dhe, sërish, një Shkrim tjetër thotë: “ATA DO TË KËQYRIN ATË QË TEJSHPUAN”.

19:31 “që trupat të mos qëndronin në kryq gjatë shabatit” Judenjët ishin shumë të preokupuar se mos trupat e vdekur e ndynin ceremonialisht vendin (shih LiP. 21:23), sidomos të shtunën e tërëshenjët të Pashkës.

▣ **“(sepse ai shabat ishte ditë e rëndësishme)”** Kjo është interpretuar në dy mënyra.

1. Darka e Pashkës dhe shabati përkonin atë vit (judenjët përdornin kalendarin hënor)
2. Festa e Bukëve të ndorme përkonte me shabatin atë vit

Festa e Pashkës dhe Bukëve të Ndorme (shih Eksodi 12) ishin bërë festë tetëditore.

▣ **“që atyre t'u thyheshin këmbët dhe të hiqeshin prej andej”** Me sa duket, kjo situatë kishte ndodhur edhe më parë. Një çekiç i madh përdorej për t'u thyer kërcinjtë personave të kryqëzuar. Zakonisht, kryqëzimi shkaktonte vdekjen nga asfiksia. Thyerja e këmbëve e shkaktonte vdekjen pothuajse menjëherë pasi i kryqëzuar nuk ishte në gjendje të shtyhej lart me këmbë për të marrë frymë.

19:33 “panë se ai kishte vdekur tashmë, nuk ia thyen këmbët” Edhe kjo mund të jetë një profeci e përmbushur, që kthehet pas te Eks. 12:46; Num. 9:12 dhe Psa. 34:20.

19:34 “një nga ushtarët ia shpoi brinjën me heshtë dhe i rrodhi menjëherë gjak dhe ujë” Kjo është një hollësi mjekësore prej dëshmitari okular, që tregon se ai ishte vërtet i vdekur dhe, në këtë mënyrë, pohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezus Mesisë. Ungjilli i Gjonit, si dhe 1 Gjonit, u shkruan në kohën e rritjes së gnosticizmit, i cili pohonte natyrën hyjnore të Jezusit por ia mohonte natyrën njerëzore.

19:35 Ky varg është koment nga Gjoni, i cili ishte i vetmi dëshmitar okular i të gjitha ngjarjeve të (1) gjyqeve natën; (2) gjyqit romak; dhe (3) kryqëzimit. Ky koment për vdekjen e Jezusit është paralel me 20:30-31, gjë që tregon qëllimin ungjillizues të këtij ungjilli (shih 21:24). Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit 1:8.

Ekziston një variant në dorëshkrimet greke i FOLJES në fjalinë e fundit. Disa dorëshkrime kanë KOHËN E TASHME, ndërsa disa të tjera kanë KOHËN AORISTE. Nëse, në origjinal, ka qenë koha AORISTE, ai po fokusohet te jobesimtarët, njësoj si 20:30-31. Mirëpo, nëse origjinal është varianti i kohës së TASHME, ungjilli po fokusohet te vazhdimësia dhe zhvillimi i besimit. Ungjilli i Gjonit duket se u drejtohet të dyja grupeve.

▣ **“i vërtetë... të vërtetën”** Shih Temat e Veçanta në 6:55 dhe 17:3.

19:36 Ky mund të jetë aludim për Qengjin e Pashkës, nga Eks. 12:46; Num. 9:12; ose Psa. 34:20. Varet se për cilën frazë bëhet fjalë: (1) teyshpuan, ose (2) thyen. Vetë Jezusi ia tregoi kishës së hershme këto Shkrime gjatë 40 ditëve që qëndroi në tokë pas ringjalljes (shih Luka 24:27; Veprat 1:2-3). Predikimi i kishës së hershme (te Veprat) i reflekton këto profeci të përmbushura të DhV, të cilat ua kishte treguar Jezusi.

19:37 Ky është citim nga Zak. 12:10, që është një nga premtimet madhështore se

1. një ditë, Izraeli do t'i kthehej me besim Jezus Mesisë (shih Zbu. 1:7)
2. shumë judenj që kishin besuar tashmë, ishin aty dhe po vajtonin për vdekjen e Jezusit
3. kjo u referohet ushtarëve romakë (shih Mat. 27:54) që përfaqësonin kombet pagane (shih 12:32).

Është interesante se ky citim, me sa duket, është nga teksti hebraisht masoretik, dhe jo nga Septuaginta, e cila citohet zakonisht nga shkrimtarët e ungjijve. Septuaginta thotë “tallën”, ndërsa teksti masoretik thotë “teyshpuan”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 19:38-42

³⁸Pas këtyre gjërave, Jozefi i Arimatesë, i cili ishte dishepull i Jezusit, por i fshehtë, nga frika e judenjve, i kërkoi Pilatit që ta hiqte trupin e Jezusit; dhe Pilati i dha leje. Kështu, ai erdhi dhe ia mori trupin. ³⁹Erdhi dhe Nikodemi, i cili më parë kishte shkuar tek ai natën, dhe solli një përzierje mire dhe aloesh, rreth 45 kilogramë. ⁴⁰Kështu, ata e morën trupin e Jezusit dhe e mbështollën me pëlhura liri me erëza, siç është zakoni i varrimit për judenjtë. ⁴¹Në vendin ku ishte kryqëzuar ai ndodhej një kopsht, dhe në kopsht, një varr i ri, ku nuk ishte vendosur ende askush. ⁴²Prandaj, për shkak të ditës judaike të përgatitjes, meqë varri ishte aty afër, aty vunë Jezusin.

19:38-39 “Jozefi... Nikodemi” Këta dy anëtarë të pasur dhe me ndikim të Sinedrit ishin dishepuj të fshehtë të Jezusit, por që, në këtë çast kritik dhe të rrezikshëm, dolën hapur.

19:39 “solli një përzierje mire dhe aloesh, rreth 45 kilogramë” Këto ishin erëzat tradicionale dhe aromatike të varrimit për popullin jude të shekullit të parë. Kjo sasi ishte disi e tepruar; shumë e shohin si simbolikë të faktit se Jezusi po varrosej si mbret (shih 2 Kro. 16:14). Shih temën e veçantë të vajosjes në 11:2.

Fjala greke “përzierje” (*migma*), e gjetur në dorëshkrimet P⁶⁶, κ^2 , A, D, L dhe në shumicën e etërve të kishës dhe versionet në gjuhët e tjera, çuditërisht ndryshohet në “paketë” (*eligma*) në dorëshkrimet κ^* , B, W dhe disa versione kopte. UBS⁴ i jep “përzierjes” vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt).

TEMË E VEÇANTË: ERËZAT E VARRIMIT

- A. Mira, një rrëshirë aromatike nga pemë arabike
 - 1. Kjo erëz përmendet dymbëdhjetë herë në DhV, kryesisht në letërsinë e urtësisë, si parfum
 - 2. Ishte një nga dhuratat që i sollën dijetarët foshnjës Jezus (shih Mat. 2:11)
 - 3. Simbolizmi i saj është goditës
 - a. përdorej në “vajin e shenjtë vajosës” (Eks. 30:23-25)
 - b. përdorej si dhuratë për mbretin (Mat. 2:11)
 - c. u përdor për të vajosur Jezusin kur e varrosën (shih Gjoni 19:39 dhe, simbolikisht, Gjoni 11:2). Kjo ishte sipas zakonit jude të përshkruar në Talmud (p.sh., Berakhoth 53a).
- B. Aloet, një lloj druri aromatik
 - 1. lidhej me një parfum erëmirë (shih Num. 24:6; Psa. 45:8; Fja. 7:17; Kënga e Këngëve 4:14)
 - 2. i përzier me mirë, përdorej nga egjiptianët si pjesë e procesit balsamosës
 - 3. Nikodemi solli një sasi të madhe të kësaj për varrimin e Jezusit dhe e vajosi Jezusin me të (shih Gjoni 19:39). Kjo ishte sipas zakonit jude në Talmud (p.sh., Betsah 6a).

19:40 “Kështu, ata e morën trupin e Jezusit dhe e mbështollën me pëlhura liri me erëza” Erëzat përdorshin për dy qëllime: (1) për të mbytur erën e keqe dhe (2) për të mbajtur të lidhura pëlhurat e varrimit.

19:41 “Në vendin ku ishte kryqëzuar ai ndodhej një kopsht” Është kyçe që të kuptojmë nxitimin me të cilin vepruan Jozefi dhe Nikodemi. Jezusi vdiq në 3 të pasdites dhe duhet të varrosej para orë 6 të pasdites, që shënonte fillimin e shabatit të Pashkës së judenjve.

■ **“një varr i ri, ku nuk ishte vendosur ende askush”** Kjo është një PJESORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE. Nga Mat. 27:60 mësuam se ky ishte vetë varri i Jozefit. Kjo është përmbushje e Isaisë 53:9, e cituar te Mateu 27:57.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse e fshikulluan dhe e tallën ushtarët Jezusin?
2. Cila është domethënia e përpjekjes së përsëritur të Pilatit për ta liruar Jezusin?
3. Pse është kaq goditëse thënia e priftërinjve judenj në vargun 15?
4. Pse ndryshojnë nga njëri ungjill në tjetrin hollësitë e kryqëzimit?
5. Ç'lidhje ka Ligji i Përtërirë 21:23 me kryqëzimin e Jezusit?

GJONI 20

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ringjallja e Jezusit 20:1-10	Varri bosh 20:1-10	Ringjallja 20:1-10	Varri bosh 20:1-10	Varri bosh 20:1-2 20:3-10
Shfaqja e Jezusit para Marie Magdalenës 20:11-18	Marie Magdalena sheh Zotin e ringjallur 20:11-18	20:11-18	Jezusi i shfaqet Marie Magdalenës 20:11-13a 20:13b 20:14-15a 20:15b 20:16a 20:16b 20:17 20:18	Shfaqja para Marie Magdalenës 20:11-18
Shfaqja e Jezusit para dishepujve 20:19-23	Autorizimi i apostujve 20:19-23	20:19-23	Jezusi u shfaqet dishepujve të vet 20:19-23	Shfaqja para dishepujve 20:19-23
Jezusi dhe Thomai 20:24-29	Shiko dhe beso 20:24-29	20:24-29	Jezusi dhe Thomai 20:24-25a 20:25b 20:26-27 20:28 20:29	20:24-29
Qëllimi i librit 20:30-31	Që ju të besoni 20:30-31	20:30-31	Qëllimi i librit 20:30-31	Përfundimi i parë 20:30-31

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-29

- A. Çdo premtim që Jezusi u dha apostujve në kapitujt 14-17 u përmbush darkën e të dielës së parë pas ringjalljes. Shih shënimin në 16:20.

- B. Rrëfimet e ungjijve ndryshojnë në detaje në lidhje me ringjallje, sepse
1. Janë rrëfime dëshmitarësh okularë
 2. Kishin kaluar vite
 3. Secili i shkroi një grupi të përzgjedhur dhe theksoi gjëra të ndryshme (shih Mateu 28; Marku 16; Luka 24)

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:1-10

¹Ditën e parë të javës, Marie Magdalena erdhi herët te varri, ndërsa ishte ende errët, dhe pa gurin e larguar tashmë nga varri. ²Kështu, vrapoi dhe shkoi te Simon Pjetri dhe te dishepulli tjetër, që Jezusi e donte, dhe u tha: “E kanë hequr Zotin nga varri, dhe ne nuk e dimë se ku e kanë vënë”. ³Kështu, Pjetri dhe dishepulli tjetër dolën jashtë dhe shkuan te varri. ⁴Të dy po vraponin së bashku; dhe dishepulli tjetër vrapoi përpara, me shpejt se Pjetri, dhe arriti i pari te varri; ⁵si u kërrus dhe hodhi një sy, pa pëlhurat prej liri të shtrira atje; por nuk hyri brenda. ⁶Kështu, arriti dhe Pjetri, që e ndiqte, dhe hyri në varr; dhe pa pëlhurat prej liri të shtrira aty, ⁷dhe rizën e fytyrës që e kishte patur në kokë, e cila s’ishte bashkë me pëlhurat prej liri, por ishte mbështjellë në një vend veç. ⁸Atëherë hyri edhe dishepulli tjetër, që kishte arritur i pari te varri; pa dhe besoi. ⁹Sepse ende nuk e kuptonin Shkrimin, se ai duhet të ringjallet nga vdekja. ¹⁰Kështu, dishepujt u kthyen sërish në shtëpitë e tyre.

20:1 “Ditën e parë të javës” Kjo ishte e diela, dita e parë e punës, që vijonte pas shabatit të rëndësishëm të javës së Pashkës, kur në tempull ofroheshin frytet e para. Jezusi ishte frytet e para nga të vdekurit (shih 1 Kor. 15:23). Shfaqjet e Jezusit gjatë tre netëve rresht të së dielës përgatiti terrenin që besimtarët të adhuronin të dielave (shih v. 19, 26; Luka 24:36 e më tej; Veprat 20:7; 1 Kor. 16:2).

☐ **“Marie Magdalena”** Kjo ishte një nga disa gratë që shoqëruan Jezusin dhe apostujt. Në Galile, Jezusi e pati çliruar nga shumë demonë (shih Marku 16:9 dhe Luka 8:2). Ajo ishte e pranishme në kryqëzim. Shih shënimet në 19:25.

Ndonëse ungjilli i Gjonit nuk e shpreh synimin e vizitës së Marisë, Marku 16:1 dhe Luka 23:56 përmendin faktin se disa gra (shih v. 2) erdhën herët për ta vajosur trupin e Jezusit me erëza. Me sa duket, ato nuk e dinin për vajosjen e Jozefit dhe Nikodemit, ose mendonin se duhet ta vajosnin edhe më tepër.

☐ **“ndërsa ishte ende errët”** Me sa duket, ajo dhe të tjerat ishin larguar nga shtëpia ndërsa ishte ende terr, por kur arritën, ishte agim (shih Mat. 28:1; Marku 16:2).

☐ **“gurin e larguar tashmë nga varri”** Fjalë për fjalë thuhet “hequr” (PJESORE E KRYER PËSORE) nga brazda e vet (shih Mat. 28:2). Mos harroni se guri ishte hequr për të lejuar që në varr të hynin dëshmitarët okularë, jo që të dilte Jezusi. Trupi i tij i ringjalljes nuk kishte caqet fizike të trupit të vet tokësor (shih 20:19, 26).

20:2 “Kështu, vrapoi” Me sa duket, ajo u largua nga varri bosh herët, që t’u tregonte dishepujt për faktin se Jezusi s’ishte aty (shih Mat. 28:5).

☐ **“dishepulli tjetër që donte Jezusi”** Kjo fjalë greqisht për dashurinë është *fileō*, që ka kuptimin “dashuri vëllazërore”. Sidoqoftë, në greqishten *koine* (300 para K. – 300 pas K.), ajo po përdorej në mënyrë sinonimike me *agapaō*. Dishepulli i përmendur duket se është Gjoni, autori i ungjillit (shih v. 4-8 dhe 13:23). Këtu, ai lidhet me Pjetrin.

☐ **“E kanë hequr Zotin”** Kjo është DËFTORE AORISTE VEPRORE (pra, veprim i përfunduar). Jezusi s’ishte më. Për mendimin e Marisë, “ata” ishin krerët e judenjve. Me sa duket, apostujt dhe dishepujt e pranishëm në dhomën e sipërme u habitën nga ringjallja!

☐ **“ne”** Kjo përfshin Marinë e Magdalës, Marinë nënën e Jakobit, Salomenë, Joanën dhe gratë e tjera (shih Mat. 28:1; Marku 16:1; Luka 24:10).

20:4 “dishepulli tjetër vranoi përpara, me shpejt se Pjetri, dhe arriti i pari te varri” Ndoshta, Gjoni ishte më i riu ndër apostujt (sipas traditës).

20:5 “u kërrus” Varret e kësaj periudhe kishin një hyrje të ulët, rreth 90-120 cm të lartë. Duhet të kërruseshe (shih v. 11) që të hyje në shpellë/vendin e gërmuar.

▣ **“hodhi një sy”** Fjalë për fjalë, “picërroi sytë që të shihte”. Kjo ndodhi për shkak të kontrastit mes dritës së mëngjesit dhe varrit të errësuar.

▣ **“pëlhurat e lirit të shtrira atje”** Ku dhe si ishin shtrirë pëlhurat nuk na qartësohet nga teksti në greqisht. Nëse trupi do të ishte vjedhur, edhe pëlhurat do të ishin marrë, pasi erëzat vepronin si ngjitës!

20:6 “Simon Pjetri” Simon (*Kefa*) ishte emri i tij hebraisht (aramaisht), ndërsa Pjetër (*Petros*) ishte emri i tij grek, që ia kishte dhënë Jezusi. Në greqisht kishte kuptimin “gur ose shkëmb i shkëputur” (shih Mat. 16:18). Në aramaisht nuk bëhet asnjë dallim mes *Petros* dhe *Petra*.

20:7 “rizën e fytyrës” Fytyra mbështillej me një pëlhurë të veçantë (shih 11:44). Ka gjasa që kjo shami të përdorej (1) duke ia vënë të ndjerit mbi fytyrë; (2) për t’ia mbështjellë fytyrën (shih NJB); ose (3) për t’ia lidhur nofullën që të mos lëvizte (shih TEV).

▣ **“por ishte mbështjellë në një vend veç”** Kjo është një tjetër PJESORE E KRYER PËSORE, që nënkupton se personi që e kishte palosur ishte kujdesur në mënyrë të veçantë për këtë. Me sa duket, kjo i rroku vëmendjen Gjorit dhe nxiti besim në të (v. 8).

20:8 “pa dhe besoi” Gjoni pa provat fizike dhe besoi se Jezusi ishte gjallë! Besimi në ringjallje bëhet pikë teologjike kyçe.

1. Romakëve 10:9-13
2. 1 Korintasve 15

1 Korintasve 15:12-19 është përmbledhje e mirë e pasojave nëse Jezusi nuk është ringjallur! Ringjallja u bë e vërteta qendrore e predikimeve të hershme apostolike në Veprat; ky predikim quhej *kerygma*. Shih Temën e Veçantë në 5:39.

20:9 “nuk e kuptonin Shkrimin” Ky është një tjetër koment redaktorial nga autori. Mund t’i referohet Psa. 16:10, që Pjetri e citon ditën e Rrëshajave në Veprat 2:27. Sidoqoftë, mund t’i referohet edhe Isa. 53:10-12 ose Os. 6:2. Sinedri e kuptonte profecinë e Jezusit për ringjalljen e vet (shih Mat. 27:62-66), ndërsa dishepujt jo. Çfarë ironie!

Ky varg mund të ketë funksionuar nga ana teologjike si përforcues i së vërtetës së Fryma nuk kishte ardhur ende në plotësinë e vet te dishepujt. Pasi të jepej, Fryma do t’i ndihmonte besimtarët që të kuptonin fjalët dhe veprimet e Jezusit (shih 2:22; 14:26).

20:10 Kjo mund të ketë kuptimin (1) ata u kthyen në Galile (shih Mat. 26:32; 28:7, 10, 16; Gjoni 21 i gjen duke peshkuar në detin e Galilesë), ose (2) shkuan në banesat e tyre në Jerusalem. Për shkak se ngjarjet pas ringjalljes ndodhën në dhomën e sipërme, #2 është më i mundshëm.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:11-18

¹¹Por Maria po qëndronte jashtë varrit duke qarë; dhe, ndërsa po qante, u kërrus dhe vështrroi në varr; ¹²dhe pa dy engjëj me të bardha që rrinin ulur, njëri te kryet dhe tjetri te këmbët, ku kishte qenë i shtrirë trupi i Jezusit. ¹³Dhe ata i thanë: “Grua, pse po qan?” Ajo u tha: “Sepse kanë hequr Zotin tim, dhe nuk e di se ku e kanë vënë”. ¹⁴Kur tha kështu, u kthye dhe pa Jezusin që qëndronte në këmbë, por nuk e njohu se ishte Jezusi. ¹⁵Jezusi i tha: “Grua, pse po qan? Kë po kërkon?” Duke menduar se ishte kopshtari, ajo i tha: “Zotëri, nëse e ke hequr ti, më thuaj ku e ke vendosur dhe do ta marr”. ¹⁶Jezusi i tha: “Mari!” Ajo u kthye dhe i tha në hebraisht, “Rabboni!” (që do të thotë Mësues). ¹⁷Jezusi i tha: “Mjaft u mbajte pas meje, sepse s’jam ngjitur ende tek Ati; por shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj: „Po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj””. ¹⁸Marie Magdalena erdhi dhe lajmëroi dishepujt: “Kam parë Zotin”, dhe se ai i kishte thënë këto gjëra.

20:11 “duke qarë” Fjalë për fjalë, “duke vajtuar” (shih 11:31). Kjo është në KOHËN E PAKRYER, që nënkupton një veprim të vazhduar në kohën e shkuar. Praktikën e funeraleve lindore, në mënyrë tipike, ishin shumë emocionale.

20:12 “dy engjëj” Gjoni dhe Luka 24:23) pohojnë se ishin dy engjëj. Mateu, që zakonisht i ka nga dy gjithçka (shih 8:28; 9:27; 20:30), ka vetëm një engjëll! Ky është një shembull i dallimeve të pashpjegueshme mes ungjijve.

Ungjijtë janë rrëfime dëshmitarësh okularë që përzgjedhin, përshtatin dhe kombinojnë veprat dhe fjalët e Jezusit për qëllimet e tyre (të frymëzuara) teologjike dhe për grupet e tyre të caktuara të lexuesve. Lexuesit e sotëm, shpesh, bëjnë pyetje të tilla si (1) cili prej ungjijve është i saktë nga ana historike, ose (2) kërkojnë më tepër hollësi historike për një ngjarje ose mësim të caktuar nga ç’është regjistruar nga shkrimtari i frymëzuar i ungjillit në fjalë. Interpretuesit duhet që, së pari, të kërkojnë synimin autorit fillestar, siç shprehet në ungjillin në fjalë. Nuk kemi nevojë për më tepër hollësi historike për ta kuptuar ungjillin.

■ **“me të bardha”** Sfera shpirtërore, ose qeniet shpirtërore, përshkruhen si të veshur me të bardha.

1. Rrobat e Jezusit në shpërfytyrimin në mal – Mat. 17:2; Marku 9:3; Luka 9:29
2. Engjëjt te varri – Mat. 28:3; Marku 16:5; Luka 24:4; Gjoni 20:12
3. Engjëjt në çastin e ngjitjes në qiell – Veprat 1:10
4. Shenjtorët me Krishtin e përlevduar – Zbu. 3:4-5, 18
5. Pleqtë (engjëjt) rreth fronit të Perëndisë – Zbu. 4:4
6. Martirët nën fronin e Perëndisë – Zbu. 6:11
7. Të gjithë të shpënguarit – Zbu. 7:9, 13-14 (shih Dan. 12:10)
8. Ushtritë (e engjëjve) në qiell – Zbu. 19:14
9. Simbolika e DhV për faljen – Psa. 51:7; Isa. 1:18 (që simbolizon dëlirësinë e Perëndisë, shih Dan. 7:9)

20:14 “nuk e njohu se ishte Jezusi” Marie Magdalena nuk e njohu Jezusin. Arsytet e mundshme për këtë janë:

1. Kishte lot në sy
2. Po shikonte nga errësira drejt dritës
3. Shfaqja e Jezusit ishte disi ndryshe (shih Mat. 28:17 dhe Luka 24:16, 37)

20:15 “Zotëri” Kjo është fjala greke *kurios*. Këtu, përdoret në kuptimin joteologjike (shih 12:21). Mund të ketë kuptimin, “zotëri”, “zoti filan”, “padron”, “imzot”, “bashkëshort”, ose “Zot”. Maria mendonte se po fliste me (1) një kopshtar, ose (2) me të zotin e kopshtit.

Por vini re përdorimin teologjik të kësaj fjale te 20:28!

■ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i folësit. Ajo besonte se dikush e kishte vjedhur trupin.

20:16 “Mari... Rabooni” Fjalë për fjalë, Maria është “Miriam”. Të dyja këto fjalë janë në armaisht (“hebraisht”) nënkupton gjuhën aramaike; shih 5:2; 19:13, 17, 20). Me sa duket, Jezusi ia tha emrin në mënyrë karakteristike. Ai duhet të ketë bërë të njëjtën lloj gjëje kur u lut për ata të dy në rrugën për në Emaus (shih Luka 24:30-31). Shkronja “i” në fund të “Rabboni” mund të ketë kuptimin, “Rabini im”, “Zotëria im”, ose “Mësuesi im”.

TEMË E VEÇANTË: SHFAQJET E JEZUSIT PAS RINGJALLJES

Jezusi iu shfaq shumë njerëzve për t'u vërtetuar ringjalljen e vet.

1. grave te varri, Mat. 28:9
2. njëmbëdhjetë dishepujve, Mat. 28:16
3. Simonit, Luka 24:34
4. dy burrave, Luka 24:15
5. dishepujve, Luka 24:36
6. Marie Magdalenës, Gjoni 20:15
7. dhjetë dishepujve, Gjoni 20:20
8. njëmbëdhejtë dishepujve, Gjoni 20:26
9. shtatë dishepujve, Gjoni 21:1
10. Kefës (Pjetrit), 1 Kor. 15:5
11. Të dymbëdhjetëve (apostujve), 1 Kor. 15:5
12. 500 vëllezërve, 1 Kor. 15:6, e kombinuar me Mat. 28:16-17
13. Jakobit (familjes së vet tokësore), 1 Kor. 15:7
14. të gjithë apostujve, 1 Kor. 15:7
15. Palit, 1 Kor. 15:8 (Veprat 9)

Me sa duket, disa prej këtyre rasteve bëjnë fjalë për të njëjtën shfaqje. Jezusi donte që ta dinin me siguri se ishte gjallë!

20:17

NASB “mjaft u mbajte pas meje”

NKJV “mos u mbaj pas meje”

NRSV “mos u mbaj tek unë”

TEV “mos u mbaj tek unë”

NJB “mos u mbaj tek unë”

KJV e përkthen: “mos më prek”. Kjo është URDHËRORE E TASHME MESORE, me një PJESORE MOHORE, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi që po kryhet tashme. Maria e kishte mbërthyer dhe po mbahej pas tij! Këtu nuk na jepet asnjë kuptim teologjik për prekjen e trupit të Jezusit përpara ngjitjes në qiell. Te Gjoni 20:27, Jezusi e lejon Thomain që ta prekë dhe, te Mat. 28:9, ai lejon gratë që t'i kapin këmbët.

■ “nuk jam ngjitur ende” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Jezusi do të ngjitet në qiell vetëm pas 40 ditësh pas ringjalljes (shih Veprat 1:9).

■ “shkoni te vëllezërit e mi” Zoti i ringjallur dhe i përlëvdur i quan këta frikacakë “vëllezër” (shih Mat. 12:50).

■ “unë po ngjitem” Kjo është në KOHËN E TASHME. Kjo ndodhi vetëm pas dyzet ditësh, kur ai ishte në prani të tyre (shih Luka 24:50-52; Veprat 1:2-3). Gjoni e përdor në mënyrë të vazhdueshme dualizmin vertikal “lart”/“poshtë”. Jezusi është nga Ati (paraekzistenca e tij) dhe kthehet tek Ati (përlëvdimi).

■ “tek Ati im dhe Ati juaj” Ç’pohim i mahnitshëm! Sidoqoftë, duhet të themi se kjo nuk nënkupton se birëria e besimtarëve është e barabartë me birërinë e Jezusit. Ai është Biri unik i Atit (3:16), plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri. Besimtarët bëhen anëtarë të familjes vetëm nëpërmjet tij. Ai është edhe Zot, edhe Shpëtimtar, edhe vëlla!

20:18 Edhe Maria është dëshmitare!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:19-23

¹⁹Kështu, darkën e po asaj dite, ditën e parë të javës, kur dyert e vendit ku ishin dishepujt ishin të mbyllura nga frika e judenjve, Jezusi erdhi, qëndroi në mes të tyre dhe u tha: “Paqja qoftë me ju”.

²⁰Dhe, pasi tha kështu, u tregoi duart dhe brinjën. Atëherë, dishepujt u ngazëllyen kur panë Zotin.

²¹Kështu, Jezusi u tha sërish: “Paqja qoftë me ju; ashtu si më dërgoi Ati, po ju dërgoj dhe ju”. ²²Dhe, si tha kështu, fryu mbi ta dhe u tha: “Merrni Frymën e Shenjtë”. ²³“Nëse ia falni dikujt mëkatet, do t’i jenë falur mëkatet; nëse ia mbani dikujt mëkatet, do t’i jenë mbajtur”.

20:19 “darkën e po asaj dite” Koha judaike fillon dhe përfundon në muzg (shih Zan. 1:5), që këtu është rreth orës 6 të mëngjesit ditën e diel.

■ **“ditën e parë të javës”** E diela ishte dita e parë e punës, siç kemi ne të hënën. Kjo u bë dita e takimit të kishës për të përkujtuar ringjalljen e Jezusit. Ai vetë e përcaktoi këtë model kur u shfaq në Dhomën e Sipërme tre net të dielash rresht (shih v. 19, 26; Luka 24:36 e më tej; Veprat 20:7; 1 Kor. 16:2).

Besimtarët e brezit të parë vazhduan të takoheshin ditën e shabatit në sinagogat lokale, dhe në tempull në ditët e caktuara të festave. Mirëpo rabinët vendosën një “zotim mallkues” që i detyronte anëtarët e sinagogave ta refuzonin Jezusin si Mesi (pas 70 pas K.). Në atë pikë, besimtarët i lanë shërbesat e shabatit, por vazhduan të mbledheshin me besimtarë të tjerë të dielën, ditën e ringjalljes, për të përkujtuar ringjalljen e Jezusit.

■ **“dyert ishin mbyllur”** Kjo është PJESORE E KRYER PËSORE. SHUMËSI nënkupton se ishin kyçur edhe dyert e poshtme, edhe ato të sipërme. Kjo përmendet (1) për të theksuar shfaqjen e Jezusit, ose (2) për të treguar frikën e tyre se mos arrestoheshin.

■ **“dishepujt”** Thomai nuk ishte i pranishëm. Të pranishëm ishin edhe dishepujt të tjerë përveç të njëmbëdhjetëve (shih Luka 24:33).

■ **“Paqja qoftë me ju”** Kjo tregon habinë dhe, ndoshta, frikën e tyre. Jezusi u pati premtuar paqe (shih 14:27; 16:33). Kjo ndoshta reflekton përshëndetjen hebraisht *Shalom*. Jezusi e përsëriti tri herë (shih 19, 21, 26).

20:20 “u tregoi duart dhe brinjën” Me sa duket, Gjoni përqendrohet te shpimi i brinjës së Jezusit më tepër se ungjijtë e tjerë (shih 19:37; 20:25). Këmbët e tij përmenden vetëm te Luka 24:39 dhe Psa. 22:16. Trupi i përlëvdur i Jezusit mbart shenjat e kryqëzimit të tij (shih 1 Kor. 1:23; Gal. 3:1).

■ **“Zotin”** Ky titull përdoret këtu në kuptimin e vet të plotë teologjik, që e lidh me Jahven e DhV (shih Eks. 3:14). Përdorimi i një titulli të DhV për Perëndinë Atë, duke ia atribuar Jezusit, është një mënyrë sesi autorët e Dhr pohuan natyrën e plotë hyjnore të Jezusit. Shih Temën e Veçantë në 6:20.

20:21 “ashtu si më dërgoi Ati” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE (shih 17:18). Kisha ka një mandat hyjnor (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8). Edhe besimtarët janë dërguar në një mision flijues (shih 2 Kor. 5:14-15; 1 Gjonit 3:16).

Jezusi përdor dy fjalë të ndryshme për termin “dërgoj”. Te Gjoni, ato janë sinonime. Kjo shihet qartazi në kapitullin 8, ku përdoret *pempō* për dërgimin e Jezusit nga Ati (shih 8:16, 18, 26, 29), ndërsa *apostellō* përdoret në 8:42. E njëjta gjë vlen edhe për kapitujt 5 dhe 6. Shih Temën e Veçantë “Dërgoj” (*Apostellō*) në 5:24.

20:22 “fry mbi ta” Kjo është lojë fjalësh me termin “fry”. Hebraishtja *ruakh* dhe greqishtja *pneuma* mund të kenë kuptimin “fry”, “erë”, ose “shpirt”. E njëjta FOLJE, në Septuagintë, përdoret në DhV për veprimtarinë krijuese të Perëndisë në Zan. 2:7 dhe për rigjallërimin e Izraelit në Ezek. 37:5, 9. PËREMRI “ta” nënkupton një grup më të gjerë se apostujt (shih Luka 24:33).

■ **“Merrni Frymën e Shenjtë”** Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE. Sesi lidhet kjo me ardhjen e Frymës në ditën e Rrëshajave është e paqartë. Jezusi përmbushi gjithçka që u pati premtuar dishepujt në këtë shfaqje të parë. Ajo lidhet me pajisjen që u bëri Jezusi për detyrën e tyre të re në shërbesë, ashtu siç e kishte pajisur dhe atë Frymë në çastin e pagëzimit.

Ky varg u përdor në debatin e fortë të kishës së hershme për çështjen e daljes së Frymës nga Ati, apo nga Ati dhe nga Biri. Në të vërtetë, të tre personat e Trinisë përfshihen në të gjitha aktet e shpengimit.

Në *A Theology of the New Testament (Teologji e Dhiatës së Re)*, George Ladd i përmbledh kështu interpretimet e mundshme të këtij pasazhi:

“Ky pasazh ngre vështirësi në kuadër të ardhjes së Frymës ditën e Rrëshajave, që mund të zgjidhet në tre mënyra. Ose Gjoni nuk dinte gjë për Rrëshajat dhe e zëvendëson me këtë histori, duke e shndërruar realisht këtë gjë në Rrëshajën e Gjonit; ose pati dy dhurime të Frymës; ose fryrja që Jezusi u bëri dishepujve ishte një shëmbëlltje me veprime që premtonte dhe priste ardhjen reale të Frymës në ditën e Rrëshajave” (f. 289).

Shënimi #24 (f. 1965) në Biblën NET pohon se kjo na kujton Zan. 2:7 (LXX). Ashtu si jepet jeta fizike në Zanafillë, jepet edhe jeta e përvetshme në DhR. Ky theksim i “frymës së Perëndisë” gjen paralelin e vet në Ezekieli 37, ku Jahve i jep jetë të re popullit të vet me anë të fryrjes së Frymës.

20:23 “Nëse ia falni dikujt mëkatet” Këto janë dy FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË me “an”, që zakonisht përdoret me FJALITË KUSHTORE TË KLASIT TË DYTË, jo “ean”. Ky kusht i përzier përforcon kushtëzimin që lidhet me ata që shprehin ungjillin dhe me ata që reagojnë me besim. Dikush, që ka njohurinë e ungjillit, zgjedh t’ia shprehë dikujt tjetër, dhe dikush e dëgjon ungjillin dhe zgjedh ta pranojë. Të dyja aspektet janë të nevojshme. Ky varg nuk i jep autoritet arbitrar klerit, por u jep fuqi të mahnitshme jetëdhënëse dëshmitarëve besimtarë! Ky autoritet u dëshmuar në udhëtimin misionar të të shtatëdhjetëve gjatë jetës së Jezusit.

▣ **“do t’i jenë falur mëkatet”** Ky formim gramatikor është DËFTORE E KRYER PËSORE. FORMA PËSORE nënkupton faljen e Perëndisë, që është plotësisht e disponueshme nëpërmjet shpalljes së ungjillit. Besimtarët kanë çelësat e mbretërisë (shih Mat. 16:19) nëse duan t’i përdorin. Ky premtim është për kishën, jo për individin. Nga ana teologjike, kjo është e ngjashme me “lidhjen dhe zgjidhjen” e Mat. 18:18.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:24-25

²⁴Por Thomai, një nga të dymbëdhjetët, i quajtur Didimus, nuk ishte me ta kur erdhi Jezusi.

²⁵Kështu, dishepujt e tjerë po i thoshin: “Kemi parë Zotin!” Por ai u tha: “Nëse nuk shoh në duart e tij shenjën e gozhdëve dhe nëse nuk vendos gishtin në vendin e gozhdëve dhe dorën në brinjën e tij, nuk do të besoj”.

20:24 “Por Thomai, një nga të dymbëdhjetët, i quajtur Didimus, nuk ishte me ta kur erdhi Jezusi” Në greqisht, Didimus do të thotë “binjak” (shih 11:16). Shpesh, njerëzit e kanë përdorur këtë pasazh për ta quajtur Thomain dyshues, por mos harroni 11:16. Thomai shfaqet më shpesh në ungjillin e Gjonit se në çdo ungjill tjetër (shih 11:16; 14:5; 20:24, 26, 27, 28, 29; 21:2).

20:25 “Nëse nuk... nuk do të besoj” “Nëse nuk” është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, me një NEGATIVE TË DYFISHTË e të fortë: “unë s’kam për ta besuar kurrën e kurrës” pa e parë dhe pa e prekur. Jezusi e nderoi këtë kërkesë. Jezusi punoi me besimin e dishepujve përmes (1) mrekullive të tij dhe (2) profecive të tij. Mesazhi i Jezusit është rrënjësisht i ri. Ai u lejoi kohë për të kuptuar dhe përvetësuar pohimet dhe rrjedhojat e ungjillit.

▣ **“shenjën”**. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: FORMË (TUPOS)

Problemi është me fjalën *tupos*, që ka një larmi përdorimesh.

1. Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament* [*Fjalori i Dhiatës së Regreqisht*], f. 645
 - a. Model
 - b. Plan
 - c. Formë ose mënyrë shkrimi
 - d. Dekret ose porosi
 - e. Verdikt ose vendim
 - f. Model trupi njerëzor si oferta kushtimore për perëndinë shërues
 - g. FOLJA përdoret në kuptimin e përforsimit të porosive të ligjit
2. Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon* [*Leksiku greqisht-anglisht*], vëll. 2, f. 249
 - a. Vragë (shih Gjoni 20:25)
 - b. Shëmbëllim (shih Veprat 7:43)
 - c. Model (shih Heb. 8:5)
 - d. Shembull (shih 1 Kor. 10:6; Fil. 3:17)
 - e. Arketip (shih Rom. 5:14)
 - f. Lloj (shih Veprat 23:25)
 - g. Përmbajtje (shih Veprat 23:25)
3. Harold K. Moulton, *The Analytical Greek Lexicon Revised* [*Leksiku analitik greqisht, i rishikuar*], f. 411
 - a. Goditje, vragë, shenjë (shih Gjoni 20:25)
 - b. Përvijim
 - c. Shëmbëllim (shih Veprat 7:43)
 - d. Formulë, skemë (shih Rom. 6:17)
 - e. Formë, përmbajtje (shih Veprat 23:25)
 - f. Figurë, përkim (shih 1 Kor. 10:6)
 - g. Simbol parathënës, tip (shih Rom. 5:14; 1 Kor. 10:11)
 - h. Model (shih Veprat 7:44; Heb. 8:5)
 - i. Model moral (shih Fil. 3:17; 1 Thes. 1:7; 2 Thes. 3:9; 1 Tim. 4:12; 1 Pje. 5:3)

Në këtë kontekst, #1 më sipër duket më e sakta. Ungjilli ka edhe rrjedhoja doktrinale, edhe rrjedhoja për stilin e jetesës. Dhurata falas e shpëtimit në Krishtin kërkon dhe një jetë në ngjashmëri me Krishtin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:26-29

²⁶Pas tetë ditësh, dishepujt e tij ishin sërish brenda, dhe Thomai ishte me ta. Jezusi erdhi, ndërkohë që dyert ishin të mbyllura, qëndroi në mes të tyre dhe tha: “Paqja qoftë me ju”. ²⁷Pastaj, i tha Thomait: “Vendos këtu gishtin dhe shikomë duart; zgjate dorën dhe vendosma te brinja; dhe mos u bëj mosbesues, por besues”. ²⁸Thomai u përgjigj dhe i tha: “Zoti im dhe Perëndia im!” ²⁹Jezusi i tha: “Ngaqë më pe, ke besuar? Luma ata që nuk shohin, por prapëseprapë besojnë”.

20:26 “Pas tetë ditësh” Kjo, në hebraisht, nënkupton një javë. Kjo ishte një tjetër darkë e së dielës. Jezusi iu shfaq dishepujve në dhomën e sipërme (ka gjasa të ketë qenë shtëpia e Gjon Markut) tri net të diele rresht dhe, në këtë mënyrë, përcaktoi modelin për adhurimin e të krishterëve. Shih shënimin v. 19.

20:27 “dhe mos u bëj mosbesues, por besues” Kjo është URDHËRORE E TASHME MESORE (me veprim te vetja) me një PJESËZ MOHORE, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Të gjithë besimtarët janë një përzjerje e çuditshme dyshimi dhe besimi!

28:28 Rrëfimi i Thomait mund të jetë i lidhur teologjikisht me vargun 17. Rrëfimi i Thomait mund të ketë një precedent në DhV, pasi sa herë që titujt JHVH dhe *Elohim* (shih Zan. 2:4) shfaqeshin së bashku, emri përkthehet “Zoti Perëndi”. Jezusi e pranon plotësisht këtë thënie tronditëse për natyrën e vet hyjnore. Nga kapitulli 1, vargu 1, ungjilli i Gjonit pohon natyrën hyjnore të Jezusit të Nazaretit.

Jezusi e pohoi natyrën e vet hyjnore disa herë në ungjillin e Gjonit (shih 8:58; 10:30; 14:9; 20:28) dhe autori e shpreh këtë natyrë hyjnore të Jezusit te 1:1, 14-18; 15:18. Edhe autorët e tjerë të DhR pohojnë qartë se

Jezusi është hyjnor (shih Veprat 20:28; Rom. 9:5; Fil. 2:6-7; Kol. 1:15-17; 2 Thes. 1:12; Titi 2:13; Heb. 1:8; 2 Pje. 1:1, 11; 1 Gjonit 5:20).

20:29 Kjo frazë hapëse mund të jetë thënie, ose pyetje që pret përgjigjen “po”. Struktura gramatikore e saj është e paqartë. Kjo ngjason me bekimin në 17:20 (shih 1 Pje. 1:8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 20:30-31

³⁰Kështu, Jezusi kreu dhe shumë shenja të tjera në prani të dishepujve, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër; ³¹por këto janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë; dhe që, duke besuar, të keni jetën në emër të tij.

20:30 Vargjet 30-31 janë qartazi tema dhe synimi kryesor i ungjillit. Ky është trakt ungjillizues! Shkruesit e ungjijve, të frymëzuar, kishin të drejtën dhe aftësinë e dhënë nga Perëndia për të përzgjedhur, renditur, përshtatur dhe përmbledhur veprat dhe fjalët e Jezusit në mënyrë që t’ua komunikonin qartë audiencave të tyre të përzgjedhura (judenj, romakë dhe johebrenj) të vërtetat madhështore për Jezusin. DhR nuk është Talmud i krishterë.

Carl F. H. Henry, në artikullin hyrës me titull “Autoriteti dhe Frymëzimi i Biblës” në *The Expositor’s Bible Commentary*, vëll. 1, thotë:

“Bibla nuk synon të paraqesë një kronologji të plotë të ngjarjeve, qoftë kur trajton rrëfimin e krijimit, apo historinë e shpëtimit, përfshi dhe historinë e mishërimit. Por qëllimi i shprehur i shkrimeve biblike është që t’i japin njeriut gjithçka të nevojshme dhe të mjaftueshme për shpëtimin e tij shpengues dhe për shërbesën e tij plot bindje ndaj Krijuesit. Ndonëse, nganjëherë, shkruesit biblikë e shohin të njëjtën vepër shpëtuese të Perëndisë nga kënde të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, ajo që na rrëfejnë ata është e besueshme dhe e mjaftueshme. Mateu ia nënshtron një pjesë të mirë të kronologjisë së shërbesës së Jezusit një renditjeje tematike, që është në funksion të udhëzimit. Luka lë pa përmendur një pjesë të mirë të materialit që gjendet te Marku, duke na dhënë gjithsesi një rrëfim të rregullt që mbështet indoktrinimin katekizmor (shih 1:4). Gjoni komenton haptazi për përzgjedhjen e fortë që qëndron në themel të ungjillit të katërt (20:30-31)” (f. 27-28).

■ **“Jezusi kreu dhe shumë shenja të tjera në prani të dishepujve”** Këto “shenja” mund të kuptohen në mënyra të ndryshme.

1. Shenjat që ai ishte vërtet gjallë
 - a. Prekja që ata i bën plagëve të tij
 - b. Ai hëngri me ta (shih Luka 24:43)
2. Shenja të veçanta e të paregjistruara, të kryera në dhomën e sipërme në prani të tyre
3. Përmendja e veprës së jetës së tij (që fokusohet tek e shkuara), që i përgatiti ata për të shkruar ungjijtë (shih Luka 24:46-48)

20:31

NASB, NKJV,

TEV, NJB “që ju të besoni”

NRSV “që ju të arrini të besoni”

Disa dorëshkrime të hershme greke, P⁶⁶, κ^* , B dhe teksti greqisht i përdorur nga Origeni, kanë një LIDHORE TË TASHME, që nënkupton se Gjoni u shkrua për të inkurajuar besimtarët që të vazhdojnë në besim.

Dorëshkrimet të tjera unciale greke (pra, κ^2 , A, C, D, L, N, W) kanë formën LIDHORE AORISTE, që nënkupton se Gjoni po u shkruante jobesimtarëve. UBS⁴ jep formën AORISTE në tekst, por i jep vlerësimin “C” (e vështirë për t’u vendosur). Ky varg është synimi i shprehur i ungjillit. Gjoni, ashtu si dhe ungjijtë e tjerë, është trakt ungjillizues.

■ **“Krishti”** Ky është përkthimi grek i fjalës hebraisht “Mesia”, që fjalë për fjalë do të thotë “i Vajosuri”. Ky ishte pasardhësi i Davidit që, në DhV, u profetizua se do të sillte epokën e re të drejtësisë. Jezusi i Nazaretit (shih 1:45) është Mesia jude (shih 11:27).

Ky përcaktim i Jezusit gjendet herët në këtë ungjill (shih 1:41). Sidoqoftë, titulli “Zot”, jo “Mesia”, ishte titulli normal që përdorej për Jezusin në kontekste johebraike (shih Rom. 10:9-13; Fil. 2:9-11).

Koncepti i “Mesisë” kishte domethënie eskatologjike: (1) për farisenjtë shkaktonte pritshmëri politike dhe kombëtare dhe (2) në letërsinë apokaliptike judaike, ky term ngjallte pritshmëri kozmike dhe të përbotshme.

■ **“Biri i Perëndisë”** Ky titull përdoret me kursim në sinoptikët (ndoshta, për shkak të keqkuptimit të mundshëm nga johebrenjtë), por përdoret herët te Gjoni (shih 1:14, 34, 49). Ishte mënyra sesi Gjoni pohonte marrëdhënien unike që kishte Jezusi me Atin (shih përdorimin e *huios*). Gjoni e përdor këtë metaforë familjare në mënyra të ndryshme.

1. Si titull
2. Në lidhje me “të vetëmlindurin” (*monogenēs*, shih 1:18; 3:16; 1 Gjonit 4:9)
3. Në kombinim me përdorimin e titullit “Ati” (shih 20:17).
Shih Temën e Veçantë: Biri i Perëndisë në 1 Gjonit 3:8.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Kush erdhi te varri? Kur? Pse?
2. Pse nuk e kishin pritur dishepujt ringjalljen? A e priste dikush tjetër?
3. Pse nuk e njohu Jezusin Maria?
4. Pse i tha Jezusi Marisë që të mos mbahej pas tij?
5. Shpjego vargjet 22-23 me fjalët e tua.
6. A është e drejtë ta quajmë Thomain dyshues?
7. Përcakto fjalën “besoj”, siç kuptohej në kohën e Jezusit, jo tonën.

GJONI 21

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE

UBS ^d	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shfaqja e Jezusit para shtatë dishepujve 21:1-14	Mëngjes në anë të detit 21:1-14	Epilog 21:1-3 21:4-8 21:9-14	Jezusi u shfaqet shtatë dishepujve 21:1-3a 21:3b-5a 21:5b 21:6 21:7-10 21:11-14	Shfaqja në bregun e Tiberiadës 21:1-3 21:4-8 21:9-14
Jezusi dhe Pjetri 21:15-19	Jezusi rimëkëmb Pjetrin 21:15-19	21:15-19	Jezusi dhe Pjetri 21:15a 21:15b 21:15c-16a 21:16b 21:16c-17a 21:17b 21:17c-19	21:15-19
Jezusi dhe dishepulli i dashur 21:20-23 21:24 21:25	Dishepulli i dashur dhe libri i tij 21:20-25	21:20-23 21:24-25	Jezusi dhe dishepulli tjetër 21:20-21 21:22 21:23 21:24 Përfundim 21:25	21:20-23 Përfundimi i dytë 21:24 21:25

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË VARGJEVE 1-25

- A. Ka patur shumë diskutime për mendimin se kapitulli 21 është shtesë, pasi ungjilli duket se përfundon në 20:31. Megjithatë, asnjë dorëshkrim grek nuk është pa kapitullin 21.
- B. Shpesh, vargu 25 mendohet se është shtesë e mëvonshme pasi, në disa dorëshkrime, pas vargut 24 futet Gjoni 7:53-8:11. Po kështu, në dorëshkrimin e lashtë Sinaitikus, kopjuesi në fillim s'e shkroi vargun 25, dhe iu desh të kthehej e të shuante një kolofon zbukurues me qëllim që ta fuste.
- C. Ndonëse nuk është pjesë integrale e ungjillit të Gjonit, kapitulli 21 është shkruar padyshim nga dora e këtij apostulli. Ai u përgjigjet dy pyetjeve të kishës së hershme:
 - 1. A u rimëkëmb Pjetri?
 - 2. Po legjenda në lidhje me jetëgjatësinë e Gjonit?

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:1-3

¹Pas këtyre gjërave, Jezusi iu shfaq sërish dishepujve në detin e Tiberiadës, dhe iu shfaq në këtë mënyrë. ²Simon Pjetri, Thomai i quajtur Didimus, Natanieli i Kanës në Galile, bijtë e Zebedeut dhe dy dishepujt të tjerë ishin së bashku. ³Simon Pjetri u tha: “Po shkoj për peshkim”. Ata i thanë: “Do të vijmë dhe ne me ty”. Dolën dhe hipën në barkë; dhe atë natë s'kapën asgjë.

21:1 “detin e Tiberiadës” Tiberiada ishte kryeqyteti administrativ i Galilesë në periudhën romake. Ky pellg uji njihet edhe me emrin “deti i Galilesë” (shih 6:1), ose “liqeni i Genesaretit” (shih Mat. 14:34; Marku 6:53; Luka 5:1) dhe, në DhV, si “liqeni i Keneretit” (shih Num. 34:11; LiP. 3:17; Joz. 11:2; 12:3; 13:27; 19:35; 1 Mbre. 15:20).

■ **“iu shfaq në këtë mënyrë”** Kjo FOLJE ka kuptimin “shfaq plotësisht ose qartazi” (shih 1:31; 2:11; 7:4; 9:3; 1 Gjonit 1:2; 2:28; 3:2; 4:9). Te Mateu, ndodh një takim në Galile që ndodhi në një mal (shih 26:32; 28:7, 10, 16), i cili ishte konteksti i “Porosisë së Madhe”. Te Gjoni, Jezusi shfaqet në detin e Tiberiadës. Në këtë takim, Jezusi trajton dy pyetje që i interesonin kishës së hershme:

1. A u rimëkëmb Pjetri si drejtues?
2. Po legjenda se Gjoni nuk do të vdiste para kthimit të Jezusit?

21:2 “Thomai, i quajtur Didimus” Shih Temën e Veçantë për emrat e apostujve në 1:45. Me sa duket, shtatë nga të njëmbëdhjetët shkuan për peshk.

21:3 “Simon Pjetri u tha: “Po shkoj për peshkim”. Kjo është në KOHËN E TASHME. Ka një sërë teorish në lidhje me këtë rrugë për peshk.

1. ishte një udhëtim qetësues për të kaluar kohën deri në kohën e caktuar nga Jezusi për takim (shih Mat. 26:32; 28:7, 10)
 2. ishte me qëllim që të fitonin para
 3. ishte rikthim i Pjetrit në profesionin e tij si peshkatar
- Ky kapitull është shumë i ngjashëm me Lukën 5.

■ **“dhe atë natë s'kapën asgjë”** Vini re se këta burra, që ishin në gjendje të shëronin të sëmurët dhe të dëbonin demonët, nuk kishin fuqi të mrekullueshme në të gjitha rastet dhe për të gjitha qëllimet. Kjo FOLJE përdoret gjetkë në DhR për kapjen e peshqve. Zakonisht, përdoret për arrestimin e dikujt.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:4-8

⁴Por kur po zbardhte dita, Jezusi ndenji në breg; mirëpo dishepujt nuk e dinin se ishte Jezusi. ⁵Kështu, Jezusi u tha: “Fëmijë, nuk keni asnjë peshk, apo jo?” Ata iu përgjigjën: “Jo”. ⁶Dhe ai u tha: “Hidheni rrjetën në të djathtë të barkës dhe do të gjeni peshq”. Kështu ata e hodhën dhe, pastaj, s’ishin në gjendje ta tërhiqnin nga numri i madh i peshqve. ⁷Prandaj dishepulli që Jezusi donte i tha Pjetrit: “Është Zoti”. Kështu, kur Simon Pjetri e dëgjoi se ishte Zoti, u mbështoll me rrobën e jashtme (sepse ishte zhveshur për punë), dhe u hodh në det. ⁸Por dishepujt e tjerë erdhën me barkën e vogël, sepse nuk ishin larg nga bregu, rreth 100 metra, duke tërhequr rrjetën plot me peshq.

21:4 “mirëpo dishepujt nuk e dinin se ishte Jezusi” Ka patur disa teori për mosaftësinë e tyre për të njohur Jezusin.

1. ishte tepër errët
2. ai ishte tepër larg
3. ata ishin tepër të lodhur
4. Jezusi dukej disi ndryshe (shih Gjoni 21:12; Mat. 28:16-17; Luka 24:13 e më tej)
5. ata ishin të penguar në mënyrë hyjnore që të mos e njihnin (shih Luka 24:16)

21:5 “Fëmijë” Kjo përdoret në mënyrë metaforike. Kishte dy fjalë për “fëmijë të vegjël” që u përdorën zakonisht në DhR. Kjo (*paidion*) përdoret më pak dhe ndryshon nga termi më i zakonshëm (*teknion*), i cili përdoret te Gjoni dhe 1 Gjonit. Kjo fjalë shfaqet në këtë ungjill vetëm në 4:49; 16:21 dhe këtu. Këto fjalë duket se përdoren në mënyrë sinonimike te 1 Gjonit, *paidion* në 2:13, 18, ndërsa *teknion* në 2:1, 12, 28.

▣ **“nuk keni asnjë peshk”** Fjala “peshk” (*prosfagion*), në fakt, nënkupton ushqim të çdo lloji që hahet me bukë, por në këtë kontekst, kërkohet fjala “peshk”. Kjo pyetje pret përgjigjen “jo”.

21:6 Jezusi po sillej në të njëjtën mënyrë si atëherë kur i thirri për herë të parë (Luka 5:1-11). Si tipar karakteristik i këtij kapitulli (shih shënimin në v. 15), përdoren dy fjalë të ndryshme greke për barkën, *pluzion* në v. 3 dhe 6, dhe *ploiaron* (barkë e vogël) në v. 8. Gjoni tregon disa herë larminë e vet letrare në këtë kapitull.

21:7 “Prandaj dishepulli që Jezusi donte” Këtu bëhet fjalë për autorin e ungjillit, apostullin Gjon (shih 13:23; 20:2, 3, 8; 21:20). Gjoni s’përmendet kurrë me emër në ungjill.

▣

NASB “u mbështoll me rrobën e jashtme (sepse ishte zhveshur për punë)”

NKJV “Hodhi përsipër rrobën e jashtme (sepse e kishte hequr)”

NRSV “veshi disa rroba, sepse ishte lakuriq”

TEV “mbështolli rreth vetes rrobën e jashtme (sepse i kishte zhveshur rrobat)”

NJB “Pjetri lidhi rreth vetes rrobën e jashtme (sepse s’kishte asgjë në trup)”

Në Palestinën e shekullit të parë, njerëzit vishnin një rrobë të jashtme dhe të brendshme të gjata, që rrinin ngjitur pas trupit. Pjetri e kishte hequr rrobën/mantelin e jashtëm dhe i kishte zhveshur të brendshmet deri në brez.

▣ **“Është Zoti”** Fjala *kurios* ishte një fjalë greke që përdorej për “zoti filan”, “zotëri”, “padron”, “pronar”, ose “zot”. Në disa kontekste, është thjesht formë politese, ndërsa në të tjera është pohim teologjik i natyrës hyjnore të Jezusit. Në këtë kontekst, këta peshkatarë e dalluan këtë person që rrinte në breg si ZOTIN e ringjallur dhe të përlëvduar!

Origjina e këtij përkthimi vjen nga përdorimi i kësaj fjale në DhV, ku JHVH përkthehet ZOT. Kjo ndodhi për shkak se judenjtë druheshin ta shqiptonin emrin e besëlidhjes së Perëndisë, prandaj e zëvendësuan me një tjetër term hebraisht, *Adonai*, që përkon me fjalën *kurios*. Shih Temën e Veçantë në 6:20.

“Zot” është titulli mbi çdo emër tjetër te Fil. 2:9-11. Ishte pjesë e rrëfimit pagëzimor të kishës së hershme: “Jezusi është ZOT” (shih Rom. 10:9-13).

21:8 “dishepulli tjetër” Me sa duket, gjithë rrethi i brendshëm kishte shkuar me Pjetrin dhe Gjonin për një pushim peshkimi si mënyrë për të fituar disa para për shpenzime (nuk mund të mbështeteshin më te gratë që patën udhëtuar me Jezusin).

- “**rrjetën plot me peshq**” Edhe në këtë kohë të vonët, Jezusi ende
 1. po u ndërton besimin
 2. po u siguron nevojat
 3. po vërteton ringjalljen dhe autoritetin e vet (mbi natyrën)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:9-14

⁹Kështu, pasi dolën në tokë, panë një zjarr qymyri, që ishte ndezur tashmë, disa peshq të vendosur mbi të, dhe bukë. ¹⁰Jezusi u tha: “Sillni disa nga peshqit që kapët tani”. ¹¹Simon Pjetri shkoi dhe tërhoqi rrjetën në tokë, plot me peshq të mëdhenj, njëqind e pesëdhjetë e tre; dhe ndonëse ishin shumë, rrjeta nuk ishte shqyer. ¹²Jezusi u tha: “Ejani dhe hani mëngjes”. Asnjë nga dishepujt nuk guxoi ta pyeste: “Kush je ti?” sepse e dinin që ishte Zoti. ¹³Jezusi erdhi, mori bukën dhe ua dha; të njëjtën gjë bëri dhe me peshqit. ¹⁴Kjo ishte hera e tretë që Jezusi u ishte shfaqur dishepujve pasi ishte ringjallur nga vdekja.

21:9 “një zjarr qymyri, që ishte ndezur tashmë, disa peshq të vendosur mbi të, dhe bukë” Synimi i këtij mëngjesi të herët ishte miqësia dhe reflektimi teologjik. Rrjedhjet teologjike të tij janë

1. Kjo pjesë trajton mohimin e Pjetrit në një kontekst të një zjarri tjetër me prush (shih 18:18). Ky term gjendet edhe aty, edhe këtu.
2. Ungjilli i Gjonit dhe 1 Gjoni u shkruan për të luftuar herezinë e gnosticizmit, që mohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezus Mesisë. Jezusi hëngri me ta.

21:10 Në këtë paragraf, përdoren dy fjalë të ndryshme për peshqit: (1) në v. 9, 10 & 13, fjala është *opsarion*, që donte të thoshte “peshk i vogël” dhe (2) në v. 6, 8 & 11, fjala është *ikthus*, që nënkuptonte peshq të mëdhenj. Ato duket se përdoren në mënyrë të përkëmbyeshme në këtë kontekst.

21:11 “njëqind e pesëdhjetë e tre” Në kontekst, duket se ky numër s’ka asnjë domethënie simbolike; është thjesht hollësi prej dëshmie okulare. Megjithatë, prirja e papërshtatshme e kishës së hershme për t’i alegorizuar të gjitha numrat dhe hollësitë e detyroi këtë varg që të kishte këto kuptime:

1. Kirili thoshte se numri 100 përfaqësonte johebrenjtë, 50 përfaqësonte judenjtë, ndërsa 3, Trininë.
2. Augustini pohonte se ky numër u referohet Dhjetë Urdhërimeve dhe shtatë dhuntive të Frymës, që është baras me numrin shtatëmbëdhjetë. Nëse i mbledh me njëri-tjetrin me radhë numrat nga 1 deri në 17, përfton shifrën 153. Augustini tha se ky ishte numri i plotë që erdhi te Krishti përmes ligjit dhe hirit.
3. Jeronimi tha se ka 153 lloje të ndryshme peshqish; prandaj, kjo simbolizon ardhjen e të gjitha kombeve te Krishti. Kjo metodë alegorike interpretimi vë në dukje zgjuarsinë e interpretuesit, por jo synimin e autorit të frymëzuar fillestar!

- “**dhe ndonëse ishin shumë, rrjeta nuk ishte shqyer**” Kjo është, ose hollësi e zakonshme prej dëshmie okulare, ose mrekulli e nënkuptuar.

21:14 “Kjo ishte hera e tretë që Jezusi u ishte shfaqur dishepujve” Pa dyshim, këtu bëhet fjalë për dy rastet në kapitullin 20 që i shtohen këtij të fundit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:15-19

¹⁵Kështu, pasi mbaruan mëngjesin, Jezusi i tha Simon Pjetrit: “Simon, biri i Gjonit, a më do më shumë se këta?” ¹⁶Ai i tha: “Po, Zot; ti e di se të dua”. Ai i tha: “Kulloti qengjat e mi”. I tha sërish për të dytën herë: “Simon, biri i Gjonit, a më do?” Ai i tha: “Po, Zot; ti e di se të dua”. Ai i tha: “Kulloti delet e mia”. ¹⁷I tha për të tretën herë: “Simon, biri i Gjonit, a më do?” Pjetri u brengos që i tha për herë të tretë: “A më do?” dhe i tha: “Zot, ti di gjithçka; ti e di se të dua”. Jezusi i tha: “Kulloti delet e mia. ¹⁸Me të vërtetë, me të vërtetë po të them: kur ishe më i ri, ngjisheshe dhe shkoje ku të dëshiroje; por, kur të plakesh, do të shtrish duart dhe dikush tjetër do të të ngjeshë dhe do të të çojë atje ku s’dëshiron të shkosh”. ¹⁹Ai e tha këtë, duke treguar se me ç’lloj vdekjeje do ta përlëvdonte Perëndinë. Dhe pasi tha këto, i tha: “Më ndiq!”

21:15 “Simon, biri i Gjonit” Vini re se Jezusi nuk e quan “Simon Pjetër”; ky burrë s’ishte aspak shkëmb! Ekziston një variant në dorëshkrime në lidhje me emrin e të atit të Simonit.

1. Gjon – κ^1 , B, C*, D, L, W
2. Jona – A, C²
3. S'përmendet fare - κ^*

UBS4 i jep alternativës #1 vlerësimin B (pothuajse e sigurt), duke ndjekur 1:42 (P⁶⁶, P⁷², κ , B*, L, W)

▣ **“do... do... do”** Qartazi, ka një përsëritje të trefishtë që duket se lidhet me mohimet e trefishta të Pjetrit në oborrin e Kryepriutit (shih 18:17, 25, 27). Në gjithë këtë pjesë, kemi një larmi paralelesh dhe kontrastesh.

1. do (*fileō*) dhe do (*agapaō*)
2. qengjat dhe delet
3. njoh (*ginoskō*) dhe njoh (*oida*)

Ka patur shumë diskutime nëse kjo ndodh për shkak të larmisë letrare, apo nëse autori synon një kontrast midis këtyre termave. Shpesh, Gjoni përdor larminë e fjalëve, sidomos në këtë kapitull (dy fjalë të ndryshme për “fëmijë”, “barkë” dhe “peshq”). Në këtë kontekst, duket se ekziston njëfarë dallimi mes fjalëve greqisht *agapaō* dhe *fileō*, por kjo nuk duhet tepruar pasi, në greqishten *koine*, ato janë sinonimike (shih 3:35; 5:20; 11:3, 5).

▣ **“a më do më shumë se këta”** Sintaksa është e paqartë për kundrinorin e kësaj pyetjeje. Disa thonë se bën fjalë për

1. peshkimin si profesion
2. thëniet e mëparshme të Pjetrit se e donte Jezusin më shumë se dishepujt e tjerë (shih Mat. 26:33; Marku 14:29 dhe Gjoni 13:37)
3. i pari do të jetë shërbëtori i të gjithëve (shih Luka 9:46-48; 22:24-27)

▣ **“Kulloti qengjat e mi”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Të tria këto thënie kanë të njëjtën formë gramatikore (shih v. 16 dhe 17), por fjalë disi të ndryshme në greqisht (kullot dhe kujdesu për delet e mia).

21:17 “Zot, ti di gjithçka” Pjetri po mëson që të mos flasë më shpejt se ç’duhet. Ai shpreh teologji të shëndoshë (shih 2:25; 6:61, 64; 13:11; 16:30).

▣ **“Ti e di se të dua”** Ka një ndryshim në greqisht për fjalën “njoh/di” mes v. 16 (*oida*) dhe v. 17 (*oida* dhe *ginoskō*). Arsyeja për këtë është e paqartë dhe mund të jetë thjesht për t’i dhënë larmi tekstit.

21:18 “do të shtrish duart” Kjo mund të jetë një zhargon teknik që përdorej (1) në kishën e hershme dhe (2) në literaturën greke për të nënkuptuar fjalën “kryqëzim”.

21:19 “duke treguar se me ç’lloj vdekjeje do ta përlevdonte Perëndinë” Tradita pohon se Pjetri vdiq i kryqëzuar kokëposhtë. Në *Historia kishtare*, vëll. 3:1, Euzebi thotë: “Pjetri besohet se predikoi në Pont, Galati, Bitini, Kapadoki dhe Azi për judenjtë e diasporës. Kur shkoi në Romë, e kryqëzuan kokëposhtë me kërkesën e vet”. Shih shënimin në 1:14.

▣ **“Më ndiq”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, si në v. 22. Ka të bëjë me ripërtëritjen dhe ripohimin e thirrjes së Pjetrit për të qenë udhëheqës (shih Mat. 4:19-20).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:20-23

²⁰Pjetri u kthye dhe pa se dishepulli që donte Jezusi po i ndiqte; ishte ai që ishte mbështetur në kraharorin e tij gjatë darkës dhe e kishte pyetur: “Zot, kush është ai që po të tradhton?” ²¹Prandaj, kur e pa, Pjetri i tha Jezusit: “Zot, po ky njeri?” ²²Jezusi i tha: “Nëse dua që ai të mbetet derisa të vij, ç’punë ke ti? Ti më ndiq!” ²³Prandaj, mes vëllezërve qarkulloi thënia se ky dishepull nuk do të vdiste; por Jezusi nuk i tha se nuk do të vdiste, por vetëm: “Nëse dua që ai të mbetet derisa të vij, ç’punë ke ti?”

21:20 “dishepulli që donte Jezusi” Këtu bëhet fjalë për rrëfimin e 13:25. Pse titullohet në këtë mënyrë kriptike është e paqartë (shih 13:23; 19:26; 20:2; 21:7, 20). Teori të mundshme janë

1. shkrimet tradicionale judaike të shekullit të parë nuk e përmendin autorin me emër
2. Gjoni ishte shumë i ri kur u bë ndjekës i Jezusit
3. Gjoni ishte i vetmi apostull që qëndroi me Jezusin gjatë gjyqeve dhe kryqëzimit të tij

21:22 “Jezusi i tha: “Nëse dua që ai të mbetet derisa të vij, ç’punë ke ti” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË. Duhet të mos harrojmë që të merremi me dhuntitë dhe shërbesat tona, dhe jo me atë që Perëndia ka planifikuar për të tjerët! Një arsye e mundshme pse u shtua kapitulli 21 ishte që t’i përgjigjej keqkuptimit pikërisht për këtë çështje. Me sa duket, ekzistonte një thashetheme i hershëm (ndoshta, gnostik) se Gjoni do të jetonte deri në Ardhjen e Dytë (Gjoni flet vërtet për *Parousia*-n, shih 1 Gjonit 3:2).

▣ **“më ndiq”** Kjo pothuajse përmbledh ftesën personale të ungjillit të Gjonit (shih 1:43; 10:27; 12:26; 21:19, 22). Kjo thekson aspektin personal të ungjillit, ndërsa “besoni se” thekson aspektin e përmbajtjes së ungjillit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:24

²⁴**Ky është dishepulli që po dëshmon për këto gjëra dhe që i shkroi këto gjëra, dhe ne e dimë se dëshmia e tij është e vërtetë.**

21:24 “shkroi këto gjëra” Për kë bën fjalë kjo: për (1) v. 20-23; (2) kapitullin 21, apo (3) gjithë ungjillin? Përgjigjja është e paqartë.

▣ **“ne e dimë se dëshmia e tij është e vërtetë”** Grupi i saktë të cilit i referohet PËREMRI “ne” është i paqartë. Qartazi, këtu po futen njerëz të tjerë për të pohuar të vërtetën e ungjillit të Gjonit. Ndoshta, këtu bëhet fjalë për pleqtë efesianë. Kjo ishte zona ku jetoi, shërbeu dhe vdiq Gjoni. Tradita e hershme thotë se drejtuesit e kishës efesiane e nxitën Gjonin plak që të shkruante ungjillin e vet për shkak të vdekjes së të gjithë apostujve të tjerë dhe për shkak të herezive për Jezusin. Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në 1:8.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 21:25

²⁵**Ka dhe shumë gjëra të tjera që bëri Jezusi, që, po të shkruheshin me hollësi, besoj se as bota vetë s’do të mund t’i përmbante librat që do të shkruheshin.**

21:25 Vargu 25 është vënë në diskutim për dy arsye: (1) në dorëshkrimet e hershme, midis vargjeve 24 dhe 25 futet Gjoni 7:53-8:11; (2) në dorëshkrimin e Sinaitikus (Ⲙ), kopjuesi fshiu kolofonin zburues dhe, më vonë, futi v. 25. Kjo është vërejtur me rreze ultravjollcë në Muzeun Britanik. Ky varg, në mënyrë të veçantë, na informon se shkrimtarët e ungjijve ishin përzgjedhës në ato që shkruan. Pyetja hermeneutike është që të pyesim gjithmonë; “Pse e shkruan këtë gjë në këtë mënyrë, dhe nuk nxituan që t’i kombinonin të katërt ungjijtë?” (shih Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka*).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse ngjan Gjoni 21 me Lukën 5?
2. Pse nuk e njohën menjëherë dishepujt Jezusin?
3. Kush ishte dishepulli që Jezusi e donte?
4. Pse e pyeti Jezusi tri herë Pjetrin për dashurinë e tij për të?
5. A tha Jezusi se Gjoni do të jetonte derisa të kthehej sërish?
6. Për kë bëhet fjalë në vargun 24?
7. A është origjinal vargu 25?

1 GJONIT

HYRJE PËR 1 GJONIT

SHËNIME HYRËSE

- A. Libri i 1 Gjonit nuk është letër personale, as letër drejtuar një kishe të caktuar, por më tepër është një “Memorandum i Flaktë Zyre nga Selia Qendrore” (letër kolektive).
1. Nuk ka hyrje tradicionale (prej kujt, drejtuar kujt).
 2. Nuk ka përshëndetje personale, as mesazh përmbyllës.
- B. Nuk përmenden emra të përveçëm. Kjo është tejet e pazakontë dhe shfaqet vetëm në librat që u shkruhen shumë kishave, si letra e Efesianëve dhe Jakobi. E vetnja letër e DhR që nuk përfshin emrin e autorit është ajo e Hebrenjve. Megjithatë, është e qartë se 1 Gjoni iu shkrua besimtarëve që, në atë kohë, po përballeshin si kishë me problemin e brendshëm të mësuesve të rremë (gnostikët).
- C. Kjo letër është trajtesë e fuqishme teologjike
1. Pozicioni qendror i Jezusit
 - a. plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri
 - b. shpëtimi vjen me anë të besimit në Jezu Krishtin, jo nga një përjetim mistik apo një njohuri e fshehtë (mësuesit e rremë)
 2. Kërkesa për një stil jetese të krishterë (tre provat e krishterimit të vërtetë)
 - a. Dashuria vëllazërore
 - b. Bindja
 - c. Refuzimi i sistemit të rënë botëror
 3. Siguria e shpëtimit të përjetshëm përmes besimit në Jezusin e Nazaretit (“di” përdoret 27 herë)
 4. Si të dallosh mësuesit e rremë
- D. Shkrimet e Gjonit (sidomos 1 Gjonit) janë shkruar në greqishten më pak të koklavitur *koine*, të përdorur nga shkrimtarët e DhR; gjithsesi, librat e tij, si kurrkush tjetër, përshkojnë thellësitë e të vërtetave të thella e të përjetshme të Perëndisë në Jezu Krishtin (pra, Perëndia është Dritë, 1 Gjonit 1:5; Perëndia është Dashuri, 1 Gjonit 4:8, 16; Perëndia është frymë, Gjoni 4:24).
- E. Ka gjasa që 1 Gjonit të jetë shkruar si letër sqaruese për ungjillin e Gjonit. Herezia gnostike e shekullit të parë përbën sfondin për të dy këta libra. Ungjilli i Gjonit ka thelb ungjillizues, ndërsa 1 Gjoni u shkruar për besimtarët (pra, për dishepullizim).
Komentuesi i shquar Westcott u shpreh se ky ungjill pohon natyrën hyjnore të Jezusit, ndërsa 1 Gjoni thekson natyrën e tij njerëzore. Këta libra shkojnë dorë për dorë!
- F. Gjoni shkruan me terma bardhezi (dualistë). Kjo është karakteristike për Rrotullat e Detit të Vdekur dhe për mësuesit e rremë gnostikë. Dualizmi i strukturuar letrar i 1 Gjonit është, edhe verbal (drita kundrejt errësirës), edhe stilistikor (një pohim negativ vijohet nga një pohim pozitiv). Kjo ndryshon nga ungjilli i Gjonit, i cili përdor dualizmin vertikal (Jezusi nga lart kundrejt gjithë njerëzve nga poshtë).
- G. Është shumë e vështirë që ta përvijosh 1 Gjonin për shkak të përdorimit të përsëritur të tematikave nga ana e Gjonit. Ky libër është si një tapiceri të vërtetash, që janë thurur së bashku me motive të përsëritura (shih Bill Hendricks, *Tapestries of Truth, The Letters of John [Tapiceri të vërtetash: letrat e Gjonit]*).

AUTORI

- A. Autorësia e 1 Gjonit është pjesë e debatit për autorësinë e shkrimeve të Gjonit: ungjilli, 1 Gjonit, 2 Gjonit, 3 Gjonit dhe Zbulesa.

B. Ekzistojnë dy pozicione bazë

1. Tradicionali

- a. Tradita ndër etërit e hershëm të kishës ishte unanime se Gjoni, apostulli i dashur, ishte autori i 1 Gjonit.
- b. Përmbledhja e të dhënave nga kisha e hershme
 - (1) Klementi i Romës (90 pas K.) aludon për 1 Gjonin
 - (2) Polikarpi i Smirnës, *Filipianëve* 7 (110-140 pas K.), citon 1 Gjonin
 - (3) Justin Martiri, *Dialogu* 123:9 (150-160 pas K.) citon 1 Gjonin
 - (4) Aludimet për 1 Gjonin bëhen edhe në shkrimet e
 - (a) Ignacit të Antiokisë (data e shkrimeve të tij është e paqartë, por në fillim të viteve 100 pas K.)
 - (b) Papiasit të Hierapolisit (lindur mes 50-60 pas K. dhe i martirizuar rreth 155 pas K.)
 - (5) Ireneu i Lionit (130-202 pas K.) ia atribuon 1 Gjonin apostullit Gjon. Tertuliani, një apolog i hershëm, që shkroi 50 libra kundër heretikëve, e citonte shpesh 1 Gjonin
 - (6) Shkrime të tjera të hershme që ia atribuojnë apostullit Gjon autorësinë e kësaj letre janë Klementi, Origeni dhe Dionisi, të tre nga Aleksandria, Fragmenti Muratorian (180-200 pas K.) dhe Euzebi (shekulli i tretë).
 - (7) Jeronimi (gjysma e dytë e shekullit të katërt) pohoi autorësinë e Gjonit, por pranoi se disa në kohën e tij e mohonin.
 - (8) Theodori i Mopsuestias, peshkopi i Antiokisë nga 392-428 pas K., e mohonte autorësinë e Gjonit.
- c. Nëse ishte Gjoni, çfarë dimë për apostullin Gjon?
 - (1) Ishte i biri i Zebedeut dhe Salomesë
 - (2) Ishte peshkatar në detin e Galilesë, bashkë me të vëllanë, Jakobin (ndoshta zotëronin disa barka)
 - (3) Disa besojnë se e ëma e tij ishte motra e Marisë, nënës së Jezusit (shih Gjoni 19:25; Marku 15:20)
 - (4) Me sa duket, ishte i pasur, pasi kishte
 - (a) shërbëtorë me pagesë (shih Marku 1:20)
 - (b) disa barka
 - (c) shtëpi në Jerusalem
 - (5) Gjoni kishte mundësi hyrjeje në shtëpinë e Kryepriutit në Jerusalem, gjë që tregon se ishte njeri me njëfarë emri (shih Gjoni 18:15-16)
 - (6) Pikërisht Gjonit iu besua përkujdesja për Marinë, nënën e Jezusit
- d. Tradita e kishës së hershme dëshmon njëzëri se Gjoni jetoi më shumë se të gjithë apostujt e tjerë dhe, pas vdekjes së Marisë në Jerusalem, ai u transferua në Azinë e vogël dhe u vendos në Efes, qyteti më i madh i asaj zone. Nga ky qytet, u syrgjynos në ishullin e Patmosit (afër vijë bregdetare) dhe, më vonë, u lirua dhe u kthye në Efes (Euzebi citon Polikarpin, Papiasin dhe Ireneun).

2. Studiuesit e sotëm

- a. Shumica dërrmuese e studiuesve të sotëm pranojnë ngjashmërinë e të gjitha shkrimeve johanine me njëra-tjetrën, sidomos në frazat, fjalorin dhe format gramatikore. Shembull i qartë i kësaj është kontrasti i fortë që karakterizon këto shkrime: jeta kundrejt vdekjes, e vërteta kundrejt të rremes. E njëjta dikotomi e thekët mund të shihet edhe në shkrime të tjera të kohës, si në Rrotullat e Detit të Vdekur ose në shkrimet e gnosticizmit që po lindte.
- b. Ka patur një sërë teorish për marrëdhënien e ndërthurur të pesë librave që i janë atribuar tradicionalisht Gjonit. Disa grupe pohojnë autorësinë e një personi, të dy personave, të tre personave, e kështu me radhë. Duket se pozicioni më i pranueshëm është se të gjitha shkrimet johanine janë rezultat i mendimeve të një njeriu të vetëm, edhe nëse janë shkruar me gjasë nga disa prej dishepujve të tij.
- c. Bindja ime personale është se Gjoni, apostulli i moshuar, i shkroi të pestë këta libra nga fundi i shërbesës së vet në Efes.

3. Çështja e autorësisë është çështje hermeneutike, jo frymëzimi. Në fund fare, autori i Shkrimit është Perëndia!

DATA – Qartazi, kjo lidhet me autorësinë

- A. Nëse këto letra, dhe posaçërisht 1 Gjonit, u shkruan nga apostulli Gjon, bëhet fjalë për një kohë diku nga fundi i shekullit të parë. Kjo do të lejonte kohë për zhvillimin e sistemeve të rreme teologjike/filozofike gnostike, si dhe do të përputhej me terminologjinë e 1 Gjonit (“fëmijë të vegjël”), që duket se nënkupton se një i moshuar po i flet një grupi më të ri me besimtarë. Jeronimi thotë se Gjoni jetoi 68 të tjera pas kryqëzimit të Jezusit. Kjo duket se përputhet me këtë traditë.
- B. A. T. Robertson mendonte 1 Gjonit u shkrua midis 85-95 pas K., ndërsa ungjilli i Gjonit u shkrua diku nga viti 95.
- C. *The New International Commentary Series on 1 John* [Seria e Komentareve të Rinj Ndërkombëtare: 1 Gjonit], e shkruar nga I. Howard Marshall, shprehet se një datë mes 60-100 pas K. është gjëja më e sigurt që mund të shprehë bota e sotme studimore në vlerësimin e datës së shkrimeve johanine.

MARRËSIT

- A. Tradita pohon se ky libër u shkrua për provincën romake të Azisë së vogël (Turqia perëndimore), ku Efesi ishte zona kryesore metropolitane.
- B. Kjo letër duket se i është shkruar një grupi të veçantë kishash në Azinë e Vogël, të cilat po përballëshin me problemin e mësuesve të rremë (si Kolosianët dhe Efesianët), veçanërisht me
 1. Gnostikët docetikë, të cilët mohonin natyrën njerëzore të Krishtit, por pohonin natyrën e tij hyjnore
 2. Gnostikët antinomianë, të cilët e ndanin teologjinë nga etika/morali
- C. Augustini (shekulli i katërt pas K.) thotë se iu shkrua partëve (Babiloni). Ai ndiqet nga Kasidori (fillimi i shekullit të gjashtë pas K.). Ndoshta, kjo vjen nga ngatërrimi i frazës “zonja e zgjedhur”, 2 Gjonit 1, me frazën “ajo që është në Babiloni”, 1 Pjetrit 5:13.
- D. Fragmenti Muratorian, një listë e hershme kanonike librash të DhR, e shkruar mes 180-200 pas K. në Romë, pohon se kjo letër u shkrua “pas nxitjes që i bënë Gjonit bashkëdishepujt dhe peshkopët e tjerë” (në Azinë e Vogël).

HEREZIA

- A. Vetë letra është qartazi reagim ndaj një lloji mësimi të rremë (p.sh., “Nëse themi...” 1:6 e më tej dhe “ai që thotë...” 2:9; 4:20 [diatriba]).
- B. Ne mund të mësojmë disa nga parimet bazë të kësaj herezie nga të dhënat e brendshme të 1 Gjonit.
 1. Mohimi i mishërimit të Jezu Krishtit
 2. Mohimi i rolit qendror të Jezu Krishtit në shpëtim
 3. Mungesa e një stili të përshtatshëm të krishterë të jetesës
 4. Theksimi i njohurisë (shpesh, i fshehtë)
 5. Prirja drejt ekskluzivizmit
- C. Konteksti i shekullit të parë
Bota romake e shekullit të parë ishte një kohë eklektizmi ndër fetë lindore dhe perëndimore. Perënditë e panteonit grek dhe atij romak po kalonin ditë të këqija. Fetë e “mistershme” ishin shumë të përhapura për shkak të theksimit që i bënin marrëdhënies personale me hyjninë dhe njohurisë së fshehtë. Filozofia laike greke ishte e përhapur dhe po shkrihej me botëkuptime të tjera. Në këtë botë fesh eklektike erdhi natyra përjashtuese e besimit të krishterë (Jezusi është e vetmja udhë te Perëndia, shih Gjoni 14:6). Cilido të ketë qenë sfondi i saktë i herezisë, ajo ishte një përpyetje për ta bërë të pranueshme natyrën në dukje të ngushtë të krishterimit dhe të pranueshme nga ana intelektuale për një audiencë më të gjerë greko-romake.

D. Alternativa të mundshme se për cilin grup gnostikësh e ka fjalën Gjoni

1. Gnosticizmi që po lindte

- a. Mësimi bazë i gnosticizmit që po lindte në shekullin e parë duket se ishte theksimi i dualizmit ontologjik (të përjetshëm) midis shpirtit dhe materies. Shpirti (Perëndia i lartë) konsiderohej i mirë, ndërsa materia ishte qenësisht e ligë. Kjo dikotomi i ngjan ideale të platonizmit kundrejt fizikes, qiellores kundrejt tokësore, të padukshmes kundrejt të dukshmes. Po kështu, mbitheksohej rëndësia e njohurisë së fshehtë (fjalëkalimet ose kodet e fshehta, që i lejojnë shpirtit të kalojë përmes sferave engjëllore [*aeon*] deri te perëndia i lartë) si e domosdoshme për shpëtim.
- b. Gnosticizmi që po lindte kishte dy forma, të cilat me sa duket përbëjnë sfondin e I Gjonit:
 - (1) Gnosticizmi docetik, që mohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit për shkak se materia është e ligë
 - (2) Gnosticizmi kerintian, që thotë se Krishti ishte një nga *aeon*-et, ose nivelet engjëllore, të shumta midis perëndisë së mirë e të lartë dhe materies së ligë. Ky “Shpirt Krisht” brendabanoi njeriun Jezusi në momentin e pagëzimit dhe e braktisi para kryqëzimit.
 - (3) Nga këto dy grupe, disa praktikonin asketizmin (nëse trupi do diçka, është e ligë), ndërsa të tjerët antinomianizmin (nëse trupi do diçka, jepja). Nuk ka të dhëna me shkrim për një sistem të zhvilluar gnosticizmin në shekullin e parë. Për informacione të mëtejshme për “gnosticizmin” shih
 - (a) *The Gnostic Religion* [*Feja gnostike*], nga Hans Jonas, botuar nga Beacon Press
 - (b) *The Gnostic Gospels* [*Ungjijtë gnostikë*], nga Elaine Pagels, botuar nga Random House
 - (c) *The Nag Hammadi Gnostic Texts and the Bible* [*Tekstet gnostike të Nag Hamadit dhe Bibla*], nga Andrew Helmbold

2. Ignaci shpreh një tjetër burim të mundshëm herezie në shkrimet e veta në letrën drejtuar smirneasve iv-v. Ata mohanin mishërimin e Jezusit dhe bënë një stil jetese antinomia.
3. Një tjetër mundësi më pak e mundshme për burimin e herezisë ishte Meandri i Antiokisë, i cili njihet nga shkrimet e Ireneut, *Kundër Herezive XXIII*. Ai ishte ndjekës i Simon Samaritanit dhe ishte përkrahës i njohurisë së fshehtë.

E. Herezia sot

1. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit përpiqen ta kombinojnë të vërtetën e krishterë me sisteme të tjera mendimi.
2. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit theksojnë doktrinën e “saktë”, por e shkëpusin nga marrëdhënia personale dhe nga besimi që çon në një stil të krishterë jetese.
3. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit e kthejnë krishterimin në një grup elitare dhe intelektual përjashtues.
4. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit fetarë i kthehen asketizmit ose antinomianizmit.

QËLLIMI

A. Ka një fokus praktik për besimtarët

1. që t’u japë gëzim (shih 1:4)
2. që t’i inkurajojë të bëjnë jetë të perëndishme (shih 1:7; 2:1)
3. që t’i urdhërojë (dhe t’u kujtojë) të duan njëri-tjetrin (shih 4:7-21) dhe jo botën (shih 2:15-17)
4. që t’u japë sigurinë e shpëtimit të tyre në Krishtin (shih 5:13)

B. Ka një fokus doktrinor për besimtarët

1. që të refuzojnë gabimin e natyrës hyjnore dhe njerëzore të Jezusit
2. që të refuzojnë gabimin e ndarjes së botës shpirtërore në një intelektualizëm që është i boshatisur nga jetesa e perëndishme
3. që të refuzojnë gëzimin se njeriu mund të shpëtohet, si i shkëputur nga njerëzit e tjerë

CIKLI NJË I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

1 GJONIT 1:1-2:2

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Fjala e jetës	Ajo që u dëgjua, u pa dhe u prek	Hyrje	Fjala e jetës	Fjala e mishëruar dhe bashkësia me Atin dhe me Birin
1:1-4	1:1-4	1:1-4	1:1-4	1:1-4
Perëndia është dritë	Baza e bashkësisë me të	Qëndrimi i duhur ndaj mëkatit	Perëndia është dritë	Të ecim në dritë (1:5-2:28)
1:5-10	1:5-2:2	1:5-10	1:5-7 1:8-10	1:5-7 Kushti i parë: ndahu nga mëkati 1:8-2:2

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

SFONDI TEOLOGJIK

- A. Ky pasazh lidhet me Prologun e ungjillit të Gjonit (1:1-18, përpara krijimit fizik), i cili lidhet me Zan. 1:1 (krijimi fizik). Sidoqoftë, këtu, ai lidhet me fillimin e shërbesës publike të Jezusit.
- B. Theksi vihet tek
 1. natyra e plotë njerëzore e Jezu Krishtit
 - a. PJESORET që lidhen me shqisat njerëzore: shikimi, dëgjimi, prekja (shih v. 1, 3). Jezusi ishte vërtet njeri dhe qenie fizike
 - b. Titujt e plotë të Jezusit
(1) Fjala e jetës (shih v. 1)

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

- (2) Biri i tij, Jezu Krishti (shih v. 3)
2. Natyra hyjnore e Jezusit të Nazaretit
 - a. paraekzistenca e tij (v. 1, 2)
 - b. mishërimi (v. 2)

Këto të vërteta jepen për të kundërshtuar pikëpamjen e mësuesve të rremë gnostikë.

SINTAKSA

A. Vargjet 1-4

1. Vargjet 1-3a përbëjnë një fjali të vetme në greqisht.
2. FOLJA kryesore “shpall” gjendet në v. 3. Theksi vihet te përmbajtja e predikimit apostolik.
3. Ka katër FJALI LIDHORE në v. 1, të cilat vendosen përpara në fjalitë e tyre kryesore për efekt theksimi.
 - a. “ajo që ishte që nga fillimi”
 - b. “që ne kemi dëgjuar”
 - c. “që ne kemi parë me sytë tanë”
 - d. “ajo që vështruam dhe prekëm me duart tona”
4. Vargu 2 duket se është parantezë në lidhje me mishërimin e Krishtit. Fakti se është shumë i vështirë nga ana gramatikore, të bën që t’i kushtosh vëmendje!
5. Vargjet 3 dhe 4 përcaktojnë synimet e shpalljes apostolike të Gjonit: bashkësia dhe gëzimi. Rrëfimet e apostujve si dëshmitarë okularë ishin një nga kriteret e kishës së hershme për kanunizimin e shkrimeve të DhR.
6. Vini re rrjedhën e KOHËVE TË FOLJEVE në vargun 1
 - a. E PAKRYER (paraekzistoi)
 - b. E KRYER, E KRYER (e vërtetë e vazhdueshme)
 - c. AORISTE, AORISTE (shembuj të veçantë)

B. Vargjet 1:5-2:2

1. PËREMRAT në 1:5-2:2 janë shumë të paqartë, por mendoj se pothuajse të gjithë ata, përveç v. 5, i referohen Atit (e ngjashme me Efe. 1:3-14)
2. Të gjitha “nëse”-të janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që bëjnë fjalë për veprim të mundshëm.
 - a. KOHA E TASHME E FOLJES kundrejt AORISTES në lidhje me “mëkatin”
 - b. NJËJËSI dhe SHUMËSI, “mëkati” kundrejt “mëkatet”

HERETIKËT

- A. Pretendimet e rreme të heretikëve mund të shihen në 1:6, 8, 10; 2:4, 6, 9.
- B. Vargjet 5-10 kanë të bëjnë me përpjekjen teologjike të ndarjes së njohjes së Perëndisë (teologjia) nga ndjekja e Perëndisë (etika). Ky ishte një mbitheksim i padrejtë i njohurisë nga gnostikët. Ata që njohin Perëndinë do të zbulojnë karakteristikat e tij në stilin e tyre të jetesës.
- C. Vargjet 1:8-2:2 duhen të ekuilibrohen me 3:6-9. Ato janë dy anë të së njëjtës monedhë. Ndoshta, apo mohojnë dy gabime të ndryshme:
 1. gabimi teologjik (pa mëkat)
 2. gabimi moral (mëkati s’ka rëndësi)
- D. 1 Gjonit 2:1-2 përpiqet të japë ekuilibrin midis marrjes së mëkatis me moskokëçarje (antinomianizmi) dhe problemit të vazhdueshëm të gjykimit të krishterë, legalizimit kulturor ose asketizmit.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:1-4

¹Atë që ishte nga fillimi, që ne e kemi dëgjuar, që e kemi parë me sytë tanë, që e kemi vështruar dhe e kemi prekur me duart tona, në lidhje me Fjalën e jetës ²dhe jeta u shfaq, dhe ne kemi parë dhe ju dëshmojmë dhe shpallim juve jetën e përjetshme, që ishte me Atin dhe na u shfaq ne; ³atë që kemi parë dhe dëgjuar po jua shpallim dhe juve, në mënyrë që edhe ju të keni bashkësi me ne; dhe, me të vërtetë, bashkësia jonë është me Atin dhe me Birin e tij, Jezu Krishtin. ⁴Këto gjëra jua shkruajmë, që gëzimi ynë të bëhet i plotë.

1:1 “Atë” Libri fillon me një PËREMËR ASNJANËS. Bën fjalë për aspektet e dyfishta të mesazhit të Perëndisë, që janë

1. Mesazhi për Jezusin
2. Personi i vetë Jezusit

Ungjilli është mesazh, person dhe stil jetese.

▣ “ishte” Kjo është DËFTORE E PAKRYER. Pohon paraekzistencën e Jezusit (pra, kjo është tematikë e përsëritur në shkrimet e Gjonit, shih v. 2; Gjoni 1:1, 15; 3:13; 8:57-58; 17:5). Kjo ishte një mënyrë sesi pohohej natyra e tij hyjnore. Jezusi zbulon Atin sepse ka qenë me Atin që nga fillimi.

▣ “nga fillimi” Kjo është qartazi aludim për Zanafillën 1 dhe Gjonin 1, por këtu bën fjalë për fillimin e shërbesës publike të Jezusit (shih Temën e Veçantë: në Gjoni 1:1). Ardhja e Jezusit nuk ishte “Plani B”. Ungjilli ishte gjithmonë plani i Perëndisë për shpengimin (shih Zan. 3:15; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29). Kjo frazë, në këtë kontekst, bën fjalë për fillimin e takimit personal të dymbëdhjetë apostujve me Jezusin.

Gjoni e përdor shpesh konceptin e “fillimit” (*arhē*). Shumica e shfaqjeve të kësaj fjale ndahen, në thelb, në dy kategori.

1. nga krijimi
 - a. Gjoni 1:1, 2 (Jezusi në fillim)
 - b. Gjoni 8:44; 1 Mbre. 3:8 (Satani, vrasës dhe gënjeshtar që nga fillimi)
 - c. Zbu. 3:14; 21:6, 12 (Jezusi, fillimi dhe fundi)
2. Nga koha e mishërimit dhe shërbesës së Jezusit
 - a. Gjoni 8:25; 1 Gjonit 2:7 [dy herë]; 3:11; 2 Gjonit 5, 6 (mësimet e Jezusit)
 - b. Gjoni 15:27; 16:4 (me Jezusin)
 - c. 1 Gjonit 1:1 (nga fillimi i shërbesës publike të Jezusit)
 - d. 1 Gjonit 2:13, 24 [dy herë] (nga besimi i tyre në Jezusin)
 - e. Gjoni 6:64 (nga refuzimi që ata i bënë Jezusit)
3. Konteksti favorizon #2

TEMË E VEÇANTË: GJONI 1 KRAHASUAR ME 1 GJONIT 1

Ungjilli

1. Në fillim (1:1, 2)
2. Fjala (*logos*) (1:1)
3. Jeta (*zōē*) (1:4)
4. Drita në Jezusin (1:4)
5. Drita e zbuluar (1:4)
6. Errësira (1:5)
7. Dëshmia për dritën (1:6-8)
8. Njerëzit sillen te Perëndia (1:7, 12-13)
9. Vështruam lavdinë e tij (1:14)

Letra

1. Nga fillimi (1:1)
2. Fjala (*logos*) (1:1)
3. Jeta (*zōē*) (1:1, 2)
4. Drita në Perëndinë (1:5)
5. Drita e zbuluar (1:5)
6. Errësira (1:5)
7. Dëshmia për dritën (1:3, 5)
8. Njerëzit sillen te Perëndia (1:3)
9. Vështruam lavdinë e tij (1:1-3)

▣ “ne” Kjo nënkupton dëshminë kolektive, por edhe personale, të apostujve (pra, të shkruesve të DhR). Kjo dëshmi kolektive është karakteristike e Gjonit. Përdoret mbi 50 herë.

Disa e shohin këtë PËREMËR i përgjithshëm që u referohet atyre të “traditës së Gjonit”. Nënkupton kujdestarët ose mësuesit që kishin pikëvështrimin unik teologjik të Gjonit.

■ **“kemi dëgjuar... kemi parë”** Këto janë të dyja DËFTORE TË KRYERA VEPRORE, që theksojnë rezultate që vazhdojnë. Gjoni po thekson natyrën njerëzore të Jezusit duke përdorur vazhdimisht PJESORE që lidhen me pesë shqisat në v. 1 dhe 3. Në këtë mënyrë, ai pohon se ishte dëshmitar okular i jetës dhe mësimeve të Jezusit të Nazaretit.

■ **“kemi vështruar... dhe prekëm”** Këto janë të dyja DËFTORE AORISTE, që theksojnë ngjarje të veçanta. “Vështruar” do të thotë “të vëzhgosh me kujdes” (shih Gjoni 1:14), “prekëm” do të thotë “shqyrtoj me kujdes duke prekur” (shih Gjoni 20:20, 27; Luka 24:39).

Fjala greke “prek” ose “mbaj në dorë” (*psēlafao*) gjendet vetëm në dy vargje në DhR: këtu dhe te Luka 24:39. Te Luka, përdoret për një takim me Jezusin pas ringjalljes. 1 Gjoni e përdor në të njëjtin kuptim.

■ **“Fjalën e jetës”** Përdorimi i fjalës *logos* shërbente për të rrokur vëmendjen e mësuesve të rremë grekë, si në Prologun e ungjillit të Gjonit (shih 1:1). Kjo fjalë përdorej gjerësisht në filozofinë greke. Por kishte dhe një sfond të veçantë në jetën e hebrenjve (shih hyrjen e Gjonit 1, C). Këtu, kjo frazë bën fjalë edhe për përmbajtjen e ungjillit, edhe për personin e ungjillit.

1:2 Ky varg përbën një parantezë që përcakton “jetën”.

■ **“jeta”** “*Zōē*” (v. 2 dy herë) përdoret në mënyrë të njëtrajtshme në shkrimet e Gjonit për të nënkuptuar jetën shpirtërore, jetën e ringjalljes, jetën e epokës së re, ose jetën e Perëndisë (shih Gjoni 1:4; 3:15,36 [dy herë]; 4:14,36; 5:24 [dy herë],26 [dy herë],29,39,40; 6:27,33,35,40,47,48,51,53,54,63,68; 8:12; 10:10,28; 11:25; 12:25,50; 14:6; 17:2,3; 20:31; 1 Gjoni 1:1,2; 2:25; 3:14-15; 5:11,12,13,16,20). Jezusi e quajti veten “jeta” (shih Gjoni 14:6).

■ **“u shfaq”** Kjo FOLJE përdoret dy herë në këtë varg, dhe të dyja janë DËFTORE AORISTE PËSORE. Shpesh, FORMA PËSORE përdoret për veprimet e Atit Perëndi. Kjo fjalë (*faneroō*) nënkupton “nxjerr në dritë atë që ishte tashmë e pranishme”. Kjo ishte fjalë e preferuar e Gjonit (shih Gjoni 1:31; 3:21; 9:3; 17:6; 1 Gjoni 1:2[dy herë]; 2:19; 3:5,8,10; 4:9). KOHA AORISTE thekson mishërimin (shih Gjoni 1:14), që mësuesit e rremë e mohonin.

■ **“dëshmojmë”** Kjo i referohet përvojës personale të Gjonit (pra, DËFTORE E TASHME VEPRORE). Shpesh, kjo fjalë përdorej për dëshminë në gjykatë. Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në Gjoni 1:8.

■ **“shpallim”** Kjo nënkupton dëshminë e autoritetshme të Gjonit (pra, DËFTORE E TASHME VEPRORE), e cila u zbulua dhe u shpall në predikimet dhe shkrimet e tij. Kjo është FOLJA kryesore e v. 1-3. Përsëritet dy herë (v. 2 dhe v. 3).

■ **“ishte me Atin”** Ashtu si v.1, edhe ky varg pohon paraekzistencën e Jezusit. Frazologjia i ngjan Gjoni 1:1. Hyjnia është mishëruar si njeri (shih Gjoni 1:14). Të njohësh Jezusin do të thotë të njohësh Perëndinë (shih Gjoni 14:8-11). Ky është një shembull i dualizmit vertikal të Gjonit.

1:3 “atë që kemi parë dhe dëgjuar, po jua shpallim dhe juve” Kjo është FJALIA e pestë LIDHORE, që i rikthehet mendimit të v. 1 pas parantezës së v. 2. Ajo përsërit FOLJET e perceptimit, që gjenden në v. 1.

■ **“jua shpallim dhe juve”** Kjo është FOLJA kryesore e v. 1-3. Është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Njohja e Perëndisë kërkon bashkësi me fëmijët e tij!

■ **“që edhe ju të keni bashkësi me ne”** Kjo është FJALI QËLLIMI (*hina*) me një FOLJE LIDHORE TË TASHME VEPRORE. Synimi i shprehur i ungjillit ishte që ata që s’e kishin dëgjuar ose parë kurrë Jezusin të shpëtoheshin me anë të dëshmisë së apostujve (shih Gjoni 17:20; 20:29-31). Është pikërisht kjo bashkësi në hirin zbulues që sjell “gëzim”, “paqe” dhe “siguri”! Kisha është komunitet besimtarësh, trup besimtarësh! Ungjilli është për gjithë botën.

TEMË E VEÇANTË: KOINŌNIA

Termi “bashkësi” (*koinōnia*) do të thotë

1. shoqërim i ngushtë me një person
 - a. me Birin (shih 1 Gjonit 1:6; 1 Kor. 1:9)
 - b. me Frymën (shih 2 Kor. 13:14; Fil. 2:1)
 - c. me Atin dhe me Birin (shih 1 Gjonit 1:3)
 - d. me vëllezërit/motrat e tjerë të besëlidhjes (shih 1 Gjonit 1:7; Veprat 2:42; Gal. 2:9; Filemoni 17)
2. shoqërim i ngushtë me gjëra ose grupe
 - a. me ungjillin (shih Fil. 1:5; Filemoni 6)
 - b. me gjakun e Krishtit (shih 1 Kor. 10:16)
 - c. jo me errësirën (shih 2 Kor. 6:14)
 - d. e vuajtjet (shih Fil. 3:10; 4:14; 1 Pje. 4:13)
3. dhuratë ose kontribut, që jepet në mënyrë bujare (shih Rom. 12:13; 15:26; 2 Kor. 8:4; 9:13; Fil. 4:15; Heb. 13:16)
4. Dhurata e hirit të Perëndisë përmes Krishtit, e cila rimëkëmb bashkësinë e njerëzimit me të dhe me vëllezërit e motrat e tij

Kjo thekson marrëdhënien horizontale (njeri me njeri) që shkaktohet nga marrëdhënia vertikale (njeriu me Krijuesin). Ajo thekson dhe nevojën për komunitetin e krishterë, si dhe gëzimin e këtij komuniteti. Koha e foljes thekson fillimin dhe vazhdimësinë e kësaj përvoje të komunitetit (shih 1:3 [dy herë], 6, 7). Krishterimi është kolektiv!

TEMË E VEÇANTË: KRISHTERIMI ËSHTË KOLEKTIV

- A. Metaforat e Palit dhe Pjetrit në shumës
 1. trupi
 2. fusha
 3. ndërtesa
- B. Termi “shenjtor” është gjithmonë në SHUMËS (përveç Fil. 4:21; por edhe aty edhe në sensin kolektiv)
- C. Theksi që Martin Luteri dhe Reformacioni vinin te “priftëria e besimtarit” nuk është vërtet biblik. Biblike është priftëria e *besimtarëve* (shih Eks. 19:6; 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6).
- D. Secili besimtar ka dhunti për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7)
- E. Vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin mund të jetë i frytshëm populli i Perëndisë. Shërbesa është kolektive (shih Efe. 4:11-12).

■ **“me Atin... dhe me Birin e tij”** Këto fraza, nga ana gramatikore, janë paralele me anë të PARAFJALËS dhe NYJËS SHQUESE. Kjo sintaksë konfirmon barazinë e Jezusit me Atin dhe natyrën e tij hyjnore (shih Gjoni 5:18; 10:33; 19:7). Është e pamundur të kesh Atin (Perëndinë e Lartë) pa Birin (Perëndinë e Mishëruar), siç linin të kuptohej mësuesit e rremë (shih 1 Gjonit 2:23; 5:10-12).

Kjo bashkësi me Atin dhe me Birin është shumë e ngjashme me pasazhin e Gjonit 14:23, që flet për “brendabanimin” reciprok.

1:4 “Këto gjëra jua shkruajmë” Kjo mund të ketë parasysh gjithë librin, ose në veçanti v. 1-3. Kjo paqartësi shihet edhe te 2:1. Autori shpreh një nga synimet e tij këtu (shih 2:1).

■ **“që gëzimi ynë të bëhet i plotë”** Kjo është LIDHORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE (shih Gjoni 15:11; 16:20, 22, 24; 17:13; 2 Gjonit 12; 3 Gjonit 4). Gëzimi i besimtarëve u bë i plotë nga bashkësia me Atin, Birin dhe Frymën. Ky ishte një element i rëndësishëm kur kemi parasysh trazirat që krijonin mësuesit e rremë. Synimet e shprehura të Gjonit pse e shkroi këtë libër janë

1. bashkësia me Perëndinë dhe me fëmijët e tij
2. gëzimi

3. siguria
4. nga ana negative, synimi i tij ishte të pajiste besimtarët kundër teologjisë së rreme të mësuesve gnostikë

Në këtë varg, ekziston një variant në greqisht midis

1. “gëzimi ynë”, dorëshkrimet 8, B, L; NASB, NRSV, NJB, REB, NIV
2. “gëzimi juaj”, dorëshkrimet A, C; NKJV

UBS4 preferon #1. Kujt i referohet “ynë”: dëshmitarëve okularë (pra, apostujve), apo besimtarëve? Për shkak të thelbit të 1 Gjonit, që përqendrohet te siguria e krishterë, mendoj se u drejtohet të gjithë besimtarëve.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:5-2:2

⁵Ky është mesazhi që kemi dëgjuar prej tij dhe po jua shpallim: se Perëndia është Dritë dhe, në të, nuk ka kurrfarë errësire. ⁶Nëse themi se kemi bashkësi me të, por ecim në errësirë, gënjejmë dhe nuk praktikojmë të vërtetën; ⁷por, nëse ecim në Dritë ashtu si ai vetë është në dritë, kemi bashkësi me njëritjetrin dhe gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat. ⁸Nëse themi se s’kemi mëkat, po mashtrujmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. ⁹Nëse i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo padrejtësi. ¹⁰Nëse themi se s’kemi mëkatuar, e bëjmë atë gënjeshtar dhe fjala e tij nuk është në ne. ^{2:1}Fëmijët e mi të vegjël, po jua shkruaj këto gjëra që të mos mëkatoni. Por, edhe nëse dikush mëkaton, kemi një Avokat tek Ati, Jezu Krishtin, të Drejtin; ²dhe ai vetë është shlyerja për mëkatet tona; madje, jo vetëm për tonat, por edhe për ato të gjithë botës.

■ **“mesazhi që kemi dëgjuar”** PËREMRI (i nënkuptuar nga folja “ne” përfshin Gjonin dhe dëshmitarët e tjerë okularë, që ishin dëgjues dhe ndjekës të Jezusit gjatë jetës së tij tokësore. Gjoni u flet drejtpërdrejt lexuesve të vet (“ju”) në 2:1, ndoshta duke nënkuptuar kishat e Azisë së Vogël.

FOLJA “dëgjuar” është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Kjo reflekton termin e gjallë dhe të përsëritur që lidhet me shqisat fizike në 1:1-4. Në njëfarë kuptimi, me këtë gjë apostulli Gjon po vërteton praninë e vet personale në sesionet mësimore të Jezusit. Gjoni po transmeton zbuluesat e Jezusit, jo të vetat! Madje, ka mundësi që dhe shprehjet unike “Unë Jam” të ungjillit të tij të kenë qenë kujtime të Gjonit për mësimet private të Gjonit.

■ **“prej tij”** “Prej tij” është i vetmi PËREMËR në gjithë pjesën e 1:5-2:2 që i referohet Jezusit. Jezusi erdhi për të zbuluar Atin (shih Gjoni 1:18). Nga ana teologjike, Jezusi erdhi për tre synime.

1. për të zbuluar Atin (shih 1:5)
2. për t’u dhënë besimtarëve një shembull për të ndjekur (shih 1:7)
3. për të vdekur për hir të njerëzimit mëkatar (shih 1:7; 2:2)

■ **“Perëndia është Dritë”** Nuk jepet NYJË SHQUESE. Kjo thekson aspektet zbuluese dhe etike të natyrës së Perëndisë (shih Psa. 27:1; Isa. 60:20; Mikea 7:8; 1 Tim. 6:16; Jakobi 1:17). Mësuesit e rremë gnostikë thoshin se drita nënkuptonte njohurinë, kurse Gjoni thotë se këtu bëhet fjalë për pastërtinë etike. “Drita” dhe “errësira” ishin terma të zakonshëm (një dualizëm etik, që përdor këto terma, gjendet edhe në Rrotullat e Detit të Vdekur dhe në gnosticizmin e hershëm). Kjo lidhet me dualizmin midis së mirës dhe ligësisë (shih Gjoni 1:5; 8:12; 12:46) dhe, me gjasë, me dualizmin gnostik të shpirtit kundrejt materies. Kjo është një nga thëniet e thjeshta, por thellësisht teologjike, të Gjonit për natyrën hyjnore. Të tjera janë: (1) “Perëndia është dashuri” (shih 4:8, 16); dhe (2) “Perëndia është frymë” (shih Gjoni 4:24). Familja e Perëndisë, ashtu si Jezusi (shih Gjoni 8:12; 9:5), duhet të pasqyrojë karakterin e tij (shih Mat. 5:14). Kjo jetë e ndryshuar (dhe në ndryshim e sipër) dashurie, faljeje dhe pastërtie është një nga provat e kthimit të vërtetë në besim.

■ **“në të, nuk ka kurrfarë errësire”** Kjo është MOHORE E DYFISHTË për efekt theksimi. Është pohim i karakterit të pandryshueshëm e të shenjtë të Perëndisë (shih 1 Tim. 6:16; Jakobi 1:17; Psa. 102:27; Mal. 3:6).

1:6 “Nëse themi” Kjo është një nga disa FJALITË KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që u referohen pretendimeve të mësuesve të rremë (shih 1:8, 10; 2:4, 6, 9). Këto thënie janë e vetmja mënyrë për të identifikuar pohimet e mësuesve të rremë. Këta duket se ishin gnostikë (në embrion) të hershëm.

Teknika letrare e një kundërshtuesi të hamendësuar quhet “diatribë”. Kjo ishte mënyrë për ta paraqitur të vërtetën me një format pyetje/përgjigje. Kjo mund të shihet qartë te Malakia (shih 1:2,6,7,12; 2:14,17; 3:7,14) dhe te Romakët (shih 2:3,17,21-23; 3:1,3,7-8,9,31; 4:1; 6:1; 7:7).

■ **“kemi bashkësi me të”** Heretikët thoshin se bashkësia bazohej vetëm te njohuria. Ky ishte një aspekt i filozofisë greke të Platonit. Ndërsa Gjoni pohon se të krishterët të bëjnë një jetë si Krishti (shih v. 7; Lev. 19:2; 20:7; Mat. 5:48).

■ **“por ecim në errësirë”** “Ec” është LIDHORE E TASHME VEPRORË. Kjo është një metaforë biblike që shpreh një stil moral jetese (shih Efe. 4:1, 17; 5:2, 15). Perëndia është dritë pa errësirë. Fëmijët e tij duhet të jenë si ai (shih Mat. 5:48).

■ **“gënjejme dhe nuk praktikojmë të vërtetën”** Këto janë të dyja FOLJE NË KOHËN E TASHME. Gjoni thërret gënjeshtarë një sërë tipash njerëzish fetarë (shih 1:10; 2:4, 22; 4:20; Isa. 29:13). Veprimet e stilit të jetesës zbulojnë vërtet zemrën (shih Mat. 7). Shih Temën e Veçantë: E Vërteta në Shkrimet e Gjoni në Gjoni 6:55.

1:7 “por nëse ecim në dritë” Kjo është një tjetër KOHË E TASHME, që thekson veprim të vazhduar. “Ec” është metaforë e DhR për jetën e krishterë (shih Efe. 4:1, 17; 5:2, 15).

Vini re sesi, shpesh, “ec” dhe FOLJET E KOHËS SË TASHME lidhen me jetën e krishterë. E vërteta është diçka që e jetojmë, jo diçka që e dimë! E vërteta është koncept kyç te Gjoni. Shih Temat e Veçanta te Gjoni 6:55 dhe 17:3.

■ **“ashtu si ai vetë është në dritë”** Besimtarët duhet të mendojnë dhe të jetojnë si Perëndia (shih Mat. 5:48). Ne duhet të pasqyrojmë karakterin e tij para botës së humbur. Shpëtimi është rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzimin (shih Zan. 1:26, 27), i cili ishte dëmtuar nga rënia e Zanafillës 3.

■ **“kemi bashkësi me njëri-tjetrin”** Fjala “bashkësi” është termi greqisht *koinōnia*, që do të thotë pjesëmarrje e përbashkët mes dy personash (shih Temën e Veçantë në 1:3). Krishterimi bazohet në pjesëmarrjen e besimtarëve në jetën e Jezusit. Nëse pranojmë jetën e tij në falje, duhet ta pranojmë dhe shërbesën e tij të dashurisë (shih 1 Gjoni 3:16). Njohja e Perëndisë nuk është e vërtetë abstrakte, por ajo është nismëtare e bashkësisë dhe jetesës së perëndishme. Synimi i krishterimit nuk është vetëm qielli pasi të vdesim, por ngjashmëria me Krishtin tani. Heretikët gnostikë ishin të prirur drejt ekskluzivimit. Megjithatë, kur njeriu është në marrëdhënie të drejtë me Perëndinë, do të ketë marrëdhënie të drejtë edhe me të krishterët e tjerë. Mungesa e dashurisë ndaj të krishterëve të tjerë është shenjë e qartë e një problemi në marrëdhënien tonë me Perëndinë (shih 4:20-21 dhe Mat. 5:7; 6:14-15; 18:21-35).

■ **“gjaku i Jezusit”** Kjo i referohet vdekjes flijuese të Krishtit (shih Isa. 52:13-53:12; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21). Është shumë e ngjashme me 2:2: “flijimi shlyes (shlyerja) për mëkatet tona”. Ky është thelbi i shprehjes së Gjoni Pagëzorit: “ja, Qengji i Perëndisë, që largon mëkatet e botës” (shih Gjoni 1:29). I pafajshmi vdiq për hir të fajtorëve!

Gnostikët e hershëm e mohonin natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit. Përdorimi i “gjakut” nga Gjoni përforcon natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit.

Ekziston një variant në dorëshkrimet greke në lidhje me këtë emër.

1. Jezusit – NASB, NRSV, NJB, REB, NET
2. Krishtit – dorëshkrimet Ɑ, B, C
3. Jezu Krishtit - NKJV

Ky është një shembull i përdorur nga Bart D. Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture (Shprishja ortodokse e Shkrimit)*, f. 153, për të treguar sesi kopjuesit e lashtë përpiqeshin ta bënin tekstin më të shkoqur për të kundërshtuar heretikët e kohës. Mundësia #3 ishte përpjekje për të pajtuar ndryshimet në dorëshkrimet e ndryshme.

■ **“na pastron nga çdo mëkat”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORË. Fjala “mëkat” është NJËJËS, pa NYJË. Kjo nënkupton çdo lloj mëkati. Vini re se ky varg nuk po fokusohet te një pastrim që ndodh vetëm një herë (shpëtimi, v. 7), por te një pastrim i vazhdueshëm (jeta e krishterë, v. 9). Të dyja janë pjesë e përjetimit të krishterë (shih Gjoni 13:10).

1:8 “Nëse themi se s’kemi mëkat” Kjo është një tjetër FJALI KUSHTORË E KLASIT TË TRETË. Mëkati është një realitet shpirtëror në një botë të rënë, edhe për besimtarët (shih Romakëve 7). Ungjilli i Gjoni e trajton shpesh këtë çështje (shih 9:41; 15:22, 24; 19:11). Ky varg hedh poshtë çdo pretendim të lashtë dhe modern që mohon përgjegjësinë morale të individit.

■ **“po mashtrojmë vetveten”** Kjo frazë greke nënkupton refuzimin personal dhe kryeneç të së vërtetës, jo padijen e saj.

■ **“e vërteta nuk është në ne”** Mënyra e pranimit nga Perëndia i Shenjtë nuk është mohimi, por pranimi i mëkateve tona dhe pranimi i asaj që na ka siguruar ai në Krishtin (shih Rom. 3:21-31). “E vërteta” mund të ketë të bëjë me mesazhin për Jezusin, ose për personin e Jezusit (shih Gjoni 14:6). Shih Temat e Veçanta në Gjoni 6:55 dhe 17:3.

1:8, 9 “Nëse” Të dyja këto janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

1:9 “rrëfejmë” Kjo është një fjalë e përbërë greqisht që vjen nga “flas” dhe “të njëjtën”. Besimtarët vazhdojnë të bien dakord me Perëndinë se e kanë shkelur shenjtërinë e tij (shih Rom. 3:23). Kjo është në KOHËN E TASHME, që nënkupton veprim të vazhdueshëm. Rrëfimi nënkupton

1. përmendjen e mëkateve në veçanti (v. 9)
2. pranimin publik të mëkateve (shih Mat. 10:32; Jakobi 5:16)
3. kthimin nga mëkate të veçanta (shih Mat. 3:6; Marku 1:5; Veprat 19:18; Jakobi 5:16)

1 Gjoni e përdor shumë shpesh këtë term (shih 1:9; 4:2, 3, 15; 2 Gjoni 7). Vdekja e Jezusit është mjete i faljes, por njerëzimi i mëkatshëm duhet të përgjigjet dhe të vazhdojë të përgjigjet me besim për t’u shpëtuar (shih Gjoni 1:12; 3:16). Shih Temën e Veçantë: Rrëfimi në Gjoni 9:22-23.

■ **“mëkatet tona”** Vini re SHUMËSIN. Bëhet fjalë për veprime të veçanta mëkati.

■ **“ai është besnik”** Kjo i referohet Perëndisë Atë (shih LiP. 7:9; 32:4; Ps. 36:5; 40:10; 89:1,2,5,8; 92:2; 119:90; Isa. 49:7; Rom. 3:3; 1 Kor. 1:9; 10:13; 2 Kor. 1:18; 1 Thes. 5:24; 2 Tim. 2:13). Karakteri i pandryshueshëm, i mëshirshëm e besnik i Perëndisë Atë është shpresa jonë më e sigurt! Kjo frazë thekson besnikërinë e Perëndisë ndaj Fjalës së vet (shih Heb. 10:23; 11:11). Kjo mund t’i referohet edhe premtimit të Besëlidhjes së Re të Perëndisë, që u bë te Jer. 31:34, që premtonte faljen e mëkateve.

■ **“dhe i drejtë”** Ky term është i pazakontë në një kontekst që flet për një Perëndi të shenjtë që fal lirisht njerëzit e pashenjtë. Megjithatë, ky është i saktë nga ana teologjike sepse Perëndia i merr seriozisht mëkatet tona, por ka siguruar dhe mjetin për faljen tonë me anë të vdekjes zëvendësuese të Krishtit (shih Rom. 3:21-31). Shih Temën e Veçantë në 2:29.

■ **“falë... pastrojë”** Këto janë të dyja LIDHORE AORISTE VEPRORE. Këto dy terma janë sinonime në këtë kontekst; bëjnë fjalë, si për shpëtimin e të humburve, ashtu dhe për pastrimin e vazhdueshëm që nevojitet për bashkësinë me Perëndinë (shih Isa. 1:18; 38:17; 43:25; 44:22; Psa. 103:3, 11-13; Mik. 7:19). Mësuesit e rremë që mohonin ungjillin, kishin nevojë për shpëtim. Besimtarët që vazhdojnë të kryejnë akte mëkati kanë nevojë për rimëkëmbje bashkësie me Zotin. Gjoni duket se i drejtohet në mënyrë të tërthortë grupit të parë dhe shkoqur grupit të dytë.

1:10 “Nëse themi” Shih shënimin në 1:6.

■ **“nuk kemi mëkatuar”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE, që nënkupton se dikush nuk ka mëkatuar kurrë, as në të shkuarën, as në të tashmen. Fjala “mëkatuar” është NJËJËS dhe i referohet mëkatit në përgjithësi. Fjala greke do të thotë “nuk godas në shenjë”. Kjo do të thotë se mëkati është, edhe kryerje mëkatesh, por edhe moskryerje gjërash të zbuluara në Fjalën e Perëndisë. Mësuesit e rremë pretendonin se shpëtimi kishte të bënte vetëm me njohurinë, jo me jetën.

■ **“e bëjmë atë gënjeshtar”** Ungjilli bazohet në mëkatshmerinë e gjithë njerëzimit (shih Rom. 3:9-18, 23; 5:1; 11:32). Ose Perëndia (shih Rom. 3:4) po gënjen, ose ata që pretendojnë se janë të pamëkatë.

2:1 “Fëmijët e mi të vegjël” Gjoni përdor dy fjalë të ndryshme përkëdhelëse për “fëmijët” në 1 Gjoni.

1. *teknon* (shih 2:1,12,28; 3:7,18; 4:4; 5:21; Gjoni 13:33)
2. *paidion* (shih 2:14, 18)

Ato janë sinonime dhe nuk shfaqin asnjë dallim të nënkuptuar teologjik. Këto fjalë përkëdhelëse ndoshta vijnë nga mosha e vjetër e Gjonit në kohën kur i shkroi.

Gjoni e përdori termin “fëmijë” për t’iu referuar dishepujve të Gjoni 13:33.

■ **“po jua shkruaj këto gjëra që të mos mëkatoni”** Kjo është LIDHORE AORISTE VEPRORE. Gjoni po bën një dallim të qartë midis KOHËS SË TASHME, një stili të vazhdueshëm dhe zakonor mëkati në jetën e njeriut (shih 3:6, 9), dhe veprave individuale të mëkatshme që kryhen nga të krishterë të paqëndrueshëm dhe të tunduar. Ai po përpiqet të vendosë drejtpeshimin mes dy ekstremeve

1. marrja tepër lehtë e mëkatit (shih Rom. 6:1; 1 Gjonit 1:8-10; 3:6-9; 5:16)
2. ashpërsia dhe brishtësia e të krishterit ndaj mëkateve personale

Këto dy ekstreme ndoshta reflektojnë dy shkolla të ndryshme mësimesh gnostike. Njëri grup mendonte se shpëtimi ishte çështje intelektuale; nuk kishte rëndësi si jetonte njeriu, pasi trupi ishte i lig. Edhe grupi tjetër i gnostikëve mendonte se trupi ishte i lig, por, si rrjedhojë, duhej që të kufizohej në lidhje me dëshirat e veta.

■ **“edhe nëse dikush mëkaton”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që bën fjalë për veprim të mundshëm. Çdo i krishterë mëkaton (shih Romakëve 7).

■ **“kemi një Avokat tek Ati”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për ndërmjetësimin e vazhdueshëm të Jezusit tek Avokati ynë qiellor (*paraklētōs*). Ky ishte term ligjor për avokatin mbrojtës, dikush “që thirrej për ndihmë” (nga *para*, përbri dhe *kaleō*, thërras). Përdoret për Frymën e Shenjtë, avokatin tonë tokësor dhe brendabanues në fjalimin në dhomën e sipërme në ungjillin e Gjonit (shih Gjoni 14:16, 26; 15:26; 16:7). Megjithatë, ky është përdorimi i vetëm i këtij termi për Jezusin (ndonëse nënkuptohet në Gjoni 14:16; Rom. 8:34; Heb. 4:14-16; 7:25; 9:24). Pali e përdori këtë koncept për veprën ndërmjetësuese të Krishtit në Rom. 8:34. Në po këtë pasazh, ai flet edhe për ndërmjetësimin e Frymës së Shenjtë (Rom. 8:26). Ne kemi një Avokat në qiell (Jezusin) dhe një Avokat përbrenda (Frymën); të dy ata i dërgoi Ati i dashur në emrin e vet.

■ **“Jezu Krishtin, të drejtin”** Ky karakterizim përdoret për Perëndinë Atë në 1:9. Autorët e Dhiatës së Re përdorin një sërë teknikash të ndryshme letrare për të pohuar natyrën hyjnore të Jezusit.

1. përdorin për Jezusin tituj që përdoren për Perëndinë
2. flasin për veprime të Perëndisë që kryhen nga Jezusi
3. përdorin fraza gramatikisht paralele që u referohen të dyve (KUNDRINORË të FOLJEVE, ose PARAFJALËVE)

Kjo flet për pamëkatshmërinë (shenjtërinë, natyrën si Perëndia) të Krishtit (shih 3:5; 2 Kor. 5:21; Heb. 2:18; 4:15; 7:26; 1 Pje. 2:22). Ai ishte mjeti i Atit për t’i sjellë “drejtësi” një populli.

2:2

NASB, NKJV **“Ai vetë është shlyerja për mëkatet tona”**

NRSV **“Ai është flijimi shlyes për mëkatet tona”**

TEV **“Krishti vetë është mjeti me të cilin na falen mëkatet”**

NJB, RSV **“Ai është flijimi për të shlyer mëkatet tona”**

Termi *hilasmos* në Septuagintë përdoret për kapakun e Arkës së Besëlidhjes, që quhej vendi i mëshirës, ose pajtimore. Jezusi e vuri veten në vendin tonë fajtor përpara Perëndisë (shih 4:10; Rom. 3:25).

Në botën greko-romake kjo fjalë mbartte konceptin e ripërtëritjes së miqësisë me një perëndi të tëhuajtur me anë të pagimit të një çmimi, por kjo fjalë nuk përdoret në këtë kuptim në Septuagintë (mos harroni se shkrimtarët e DhR [me përjashtim të Lukës] ishin mendimtarë hebrenj që shkruanin në greqishten *koine*). Në Septuagintë, dhe në Heb. 9:5, përdoret për të përkthyer termin “pajtimore”, që ishte kapaku i Arkës së Besëlidhjes që gjendej në Vendin Shumë të Shenjtë, aty ku sigurohej shlyerja e fajit në emër të kombit në Ditën e Shlyerjes (shih Levitiku 16).

Ky term duhet trajtuar në një mënyrë që nuk ia ul Perëndisë neverinë për mëkatin, por që pohon edhe qëndrimin e tij pozitiv shpengues ndaj mëkatarëve. Një diskutim i mirë gjendet në librin e James Stewart, *A Man in Christ* (Një Njeri në Krishtin), f. 214-224. Një mënyra për ta arritur këtë gjë është që këtë fjalë ta përkthejmë në një mënyrë që reflekton veprën e Perëndisë në Krishtin: “një flijim pajtues”, ose “me fuqi pajtuese”.

Përkthimet moderne në anglisht ndryshojnë në mënyrën sesi e kuptojnë këtë term flijues. Fjala “shlyerje/pajtim” nënkupton se Jezusi ia shoi zemërimin Perëndisë (shih Rom. 1:18; 5:9; Efe. 5:6; Kol. 3:6). Shenjtëria e Perëndisë fyhet nga mëkati i njerëzimit. Këtë e shlyen shërbesa e Jezusit (shih Rom. 3:25; 2 Kor. 5:21; Heb. 2:17).

Disa studiues (p.sh., C. H. Dodd) mendojnë se koncepti pagan grek (që fashit zemërimin e një hyjnie) nuk i duhet zbatuar JHVH-së. Pra, ata preferojnë fjalën “shlyerje”, sipas së cilës shërbesa e Jezusit shleu fajin e njerëzimit (shih Gjoni 1:29; 3:16) përpara Perëndisë, dhe jo zemërimin e Perëndisë kundër mëkatit. Megjithatë, të dyja janë të vërteta nga ana biblike.

■ **“për mëkatet tona; madje jo vetëm për tonat, por edhe për ato të gjithë botës”** Këtu bëhet fjalë për mundësinë që përmban shlyerja e pakufizuar (shih 4:14; Gjoni 1:29; 3:16, 17; 12:47; Rom. 5:18; 1 Tim. 4:10; Titit 2:11; Heb. 2:9; 7:25). Jezusi vdiq për mëkatën dhe për mëkatet e gjithë botës (shih Zan. 3:15). E vetmja gjë që e pengon botën për t’u shpëtuar nga mëkati është mosbesimi. Sidoqoftë, njerëzit duhet të përgjigjen (dhe të vazhdojnë të përgjigjen) me besim, pendim, bindje dhe qëndresë!

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Pse përdor Gjoni kaq shumë folje që lidhen me pesë shqisat?
2. Rendit fjalët flijuese që gjenden në v. 7 dhe 9.
3. Shpjego bindjet e heretikëve që po lufton Gjoni.
4. Si lidhet v. 9 me gnostikët dhe besimtarët?
5. Përshkruaj dhe përcakto termin “rrëfim”.

1 GJONIT 2:3-27

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Krishti, Avokati ynë	Baza e bashkësisë me të (1:5-2:2)	Bindja	Krishti, Ndihmuesi ynë	Të ecësh në dritë (1:5-2:28) Kushti i parë: ndarja nga mëkati (1:8-2:3)
2:1-6	Prova e njohjes së tij 2:3-11	2:1-2 2:3-6	2:1-2 2:3-6	Kushti i dytë: zbatimi i urdhërimeve, veçanërisht ai i dashurisë 2:3-11
Urdhërimi i ri 2:7-14	Gjendja e tyre shpirtërore 2:12-14 Mos e doni botën	Dashuria për njëri-tjetrin 2:7-11 Marrëdhënia e vërtetë me Perëndinë në Krishtin 2:12-14 Vlerësimi i vërtetë i botës	Urdhri i ri 2:7-8 2:9-11 2:12-13 2:14	Kushti i tretë: shkëputja nga bota 2:12-17
2:15-17	2:15-17	2:15-17	2:15-17	
Antikrishti	Mashtrimet e orës së fundit	Besnikëria ndaj besimit të vërtetë	Armiku i Krishtit	Kushti i katërt: ruhuni nga antikrishtët
2:18-25	2:18-23 E vërteta të banojë në ju 2:24-27	2:18-25	2:18-19 2:20-21 2:22-23 2:24-25	2:18-28
2:26-27		2:26-27	2:26-27	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 2:3-27

- A. Është shumë e vështirë ta përvijosh 1 Gjonin pasi ka shumë tematika që përsëriten. Megjithatë, shumica e komentuesve bien dakord se kapitulli 2 vazhdon temat e kapitullit 1, të cilat janë karakteristikat e bashkësisë me Perëndinë, si pozitive, ashtu dhe negative.
- B. Mes kapitujve 1 dhe 2 ekziston një paralelizëm strukturor. Gjoni e paraqet mesazhin në kontrast me pohimet e rreme të gnostikëve.

Kapitulli 1

1. nëse themi... (v. 6-7)
2. nëse themi... (v. 8-9)
3. nëse themi... (v. 10)

Kapitulli 2

1. Ai që thotë ... (v. 4-5)
2. Ai që thotë... (v. 6)
3. Ai që thotë... (v. 8-11)

- C. Ky kontekst rendit një sërë provash ose të dhënash që zbulojnë besimtarin e vërtetë (2:3-25)
 1. Gatishmëria për të rrëfyer mëkatën (fillimisht dhe vazhdimisht) (1:8)
 2. Bindja si stil jetese (2:3-6)
 3. Dashuria si stil jetese (2:7-11)
 4. Fitorja mbi ligësinë (2:12-14)
 5. Braktisja e botës (2:15-17)
 6. Qëndresa (2:19)
 7. Doktrina e saktë (2:20-24; 4:1-3)
- D. Koncepte të veçanta teologjike (në 2:18-19)
 1. “ora e fundit” v. 18)
 - a. Kjo frazë, bashkë me fraza të ngjashme, si “ditët e fundit”, bëjnë fjalë për periudhën kohore nga lindja e Jezusit në Betlehem e deri në Ardhjen e Dytë. Mbretëria ka ardhur, por nuk është përmbushur ende plotësisht.
 - b. Populli i Izraelit, gjatë periudhës ndërdhjatore, filloi të besonte në dy epoka: epoka e tanishme e ligë dhe epoka e drejtësisë, e inauguruar nga Fryma, e cila ishte ende në të ardhmen. Ajo që nuk zbuloi qartë DhV ishin dy ardhjet e Mesisë, së pari si Shpëtimtar dhe së dyti si Përmbushës. Këto dy epoka mbivendosen. Shih Temën e Veçantë në 2:17.
 - c. Ky është përdorimi metaforik i termit “ora” (*kairos*) si periudhë e paspecifikuar kohore (shih Gjoni 4:21, 23; 5:25, 28; 16:2).
 2. “antikrishti” (v. 18)

Vetëm Gjoni e përdor termin “antikrisht” (shih 2:18, 22; 4:3; 2 Gjonit 7). Vini re se, në 2:18, kjo fjalë jepet edhe në NJËJËS, edhe në SHUMËS (shih 2 Gjonit 7).

 - a. Edhe në shkrimtarët e tjerë biblikë gjenden referenca për këtë person të kohës së fundit.
 - 1) Danieli – “Bisha e Katërt” (shih 7:7-8, 23-26; 9:24-27)
 - 2) Jezusi – “Neveria e Shkatërrimit” (shih Marku 13; Mat. 24)
 - 3) Gjoni – “Bisha që doli nga deti” (shih Zbu. 13)
 - 4) Pali – “Njeriu i Mëkatit” (shih 2 Thes. 2)
 - b. Gjoni bën dhe një dallim midis personit eskatologjik dhe frymës ose qëndrimit të përsëritur që është gjithmonë i pranishëm në botë (shih 2:18; 4:3; 2 Gjonit 7; Marku 13:6, 22; Mat. 24:5, 24).
 - c. Parafjala *anti* në greqisht mund të ketë kuptimin (1) kundër, ose (2) në vend të. Kjo është po aq domethënëse sa dhe përdorimi i NJËJËSIT dhe SHUMËSIT në v. 18. Historia është e mbushur me ata që i janë kundërvënë Perëndisë dhe Krishtit të tij
 - 1) Antiok IV Epifani (briri i vogël i Danielit 8; 11:36-45)
 - 2) Neroni dhe Domiciani (pretenduan se ishin hyjnorë, por jo Mesi)
 - 3) Komunizmi ateist

4) Humanizmi shekullar

Por kjo përkon edhe me ata që nuk janë kundër Krishtit, por që pretendojnë se janë Krishti (përdorimi #2).

- 1) Mësuesit e rremë (Marku 13:6,22; Mat. 24:5, 24)
 - 2) Drejtuesit e sotëm të kulteve
 - 3) Antikrishti (Dan. 7:8, 23-26; 9:24-27; 2 Thes. 2:3; dhe Zbu. 13)
 - d. Të krishterët e çdo epoke do të përjetojnë, edhe mësuesit e rremë që mohojnë Krishtin, edhe Mesi të rremë, që pretendojnë se janë Krishti. Sidoqoftë, një ditë, në ditën e fundit, një mishërim i veçantë i ligësisë (pra, Antikrishti) do t'i bëjë të dyja këto pretendime!
3. “qëndron në ju” (v. 19, 24, 27, 28)
- a. Shumica e ungjillorëve të sotëm theksojnë nevojën e një vendimi fillestar personal për të besuar në Krishtin, dhe kjo është padyshim e vërtetë. Megjithatë, Bibla nuk thekson vendimet, por dishepullizimin (shih Mat. 28:19-20).
 - b. Doktrina e Sigurisë së Besimtarit duhet të jetë pandashmërisht e lidhur me doktrinën e Qëndresës. Shih Temën e Veçantë: Nevoja për Qëndresë në Gjoni 8:31. Nuk është me alternativa “ose këtë, ose atë”, por një realitet i tipit “edhe kjo/edhe ajo”. Në të vërtetë, “qëndrimi” është paralajmërim biblik (shih Gjoni 15)!
 - c. Pasazhe të tjera që flasin për qëndrimin janë Mat. 10:22; 13:1-9,18-23; Marku 13:13; Gjoni 8:31; 15:1-27; 1 Kor. 15:2; Gal. 6:1; Zbu. 2:2,7,11,17,26; 3:5,12,21; 21:7. Shih Temën e Veçantë: “Qëndrimi” në 2:10.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:3-6

³Nga kjo e dimë se e kemi njohur: nëse zbatojmë urdhërimet e tij. ⁴Ai që thotë, “unë e kam njohur atë”, por nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të; ⁵por kushdo që zbaton fjalën e tij, në të është përsosur vërtet dashuria e Perëndisë. Nga kjo e dimë se jemi në të: ⁶ai që thotë se qëndron në të, duhet të ecë dhe vetë njësoj siç eci ai.

2:3 “Nga kjo e dimë se e kemi njohur” Fjalë për fjalë, thuhet: “e dimë se e kemi njohur”. Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE, e ndjekur nga një DËFTORE E KRYER VEPRORE, që thekson se të krishterët e këtyre kishave të tronditura mund të kenë sigurinë e plotë të shpëtimit përballë mësimëve të rreme gnostike.

Fjala “njoh” përdoret në kuptimin hebraik të marrëdhënies personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5) dhe në kuptimin greke të fakteve për diçka ose për dikë. Ungjilli është, edhe person, edhe një grup të vërtetash. Thekset e kësaj fraze janë:

1. ne mund ta njohim Perëndinë
2. mund të dimë se çfarë dëshiron ai për jetën tonë
3. mund të dimë se mund ta njohim! (shih 5:13)

Një nga siguritë për marrëdhënien tonë me Perëndinë zbulohet nga veprimet dhe motivet tona (shih Mateu 7; Jakobi; 1 Pjetrit). Kjo është tematikë që përsëritet vazhdimisht te 1 Gjonit (shih 2:3, 5; 3:24; 4:13; 5:2, 13).

Shkrimet e Gjonit përdorin shpesh dy fjalë greke për termin “njoh” (*ginōskō* dhe *oida*), madje në mënyrë sinonimike. Nuk duket se ka ndonjë dallim të qartë semantik mes këtyre dy termave në greqishten *koine*. Zgjedhja është stilistikore. Po kështu, është interesante se Gjoni nuk e përdor termin e përforuar *epiginōskō*.

Gjoni po shkruan që të inkurajojë besimtarët, si dhe që të hedhë poshtë herezitë. Ungjilli i Gjonit dhe 1 Gjoni përdorin fjalë që kanë kuptimin “njoh” më tepër se çdo libër tjetër në DhR. 1 Gjonit është një libër për sigurinë, e cila bazohet në njohurinë e ungjillit dhe në dashurinë e bindjen përkuese në stilin e jetesës (shih librin e Jakobit).

■ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ **“nëse zbatojmë urdhërimet e tij”** Vini re elementin kushtëzues (LIDHORJA E TASHME VEPRORE).

Besëlidhja e re është e pakushtëzuar si ofertë e Perëndisë, por e kushtëzuar në lidhje me besimin pendues dhe përgjigjen me bindje të njerëzimit (shih 2:3-5; 3:22, 24; 5:2, 3; Gjoni 8:51-52; 14:15, 21, 23; 15:10; Zbu. 2:26; 3:8, 10; 12:17; 14:12). Një nga provat e kthimit të vërtetë në besim është bindja ndaj Dritës (ndaj Jezusit dhe ndaj

ungjillit, shih Luka 6:46). Edhe në DhV, bindja ishte më e mirë se rituali i fljimeve (shih 1 Sam. 15:22; Jer. 7:22-23). Bindja nuk sjell shpëtim, as nuk na siguron shpëtimin, por përbën provë të shpëtimit. Nuk është baza (shih Efe. 2:8-9), por fryti i shpëtimit (shih Efe. 2:10).

2:4 “Ai që thotë” Kjo është shenjë tekstuale e formatit të diatribës në shkrimet e Gjonit.

▣ **“unë e kam njohur atë”** Kjo është një nga pohimet e shumta të mësuesve të rremë (shih 1:6, 8, 10; 2:4, 6, 9). Kjo është diatribë (“ai që thotë...”), e ngjashme me Malakinë, Romakëve dhe Jakobin. Mësuesit e rremë pretendonin se e njihnin (KOHA E KRYER) Perëndinë, por po përpiqeshin ta ndanin shpëtimin nga jetesa e perëndishme. Ata po e ndanin shfaqjesimin nga shenjtërimi. Pretendonin se kishin njohuri superiore (pra, të fshehtë) të Perëndisë, por stili i tyre i jetesës ua nxirrte motivet e tyre të vërteta në shesh.

▣ **“dhe nuk zbaton urdhërimet e tij”** Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për një veprim të vazhdueshëm, që është stil jetese. Jeta jonë zbulon orientimin tonë shpirtëror (shih Mateu 7). Vargu 4 e shpreh të vërtetën në mënyrë negative, ndërsa vargu 5 e shpreh këtë të vërtetë në mënyrë pozitive.

▣ **“është gënjeshtar”** Nuk ka gjë më të keqe se mashtrimi i vullnetshëm! Bindja është provë e kthimit të vërtetë në besim. Do t’i njihni nga frytet e tyre (shih Mat. 7).

Gjoni quan gënjeshtarë një sërë njerëzish fetarë (mësues, predikues) (shih 1:6; 2:4, 22; 4:20). Ata janë fetarë, por nuk janë në rregull me Perëndinë!

2:5 “por kushdo që zbaton Fjalën e tij” Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për një veprim të vazhdueshëm, që është bërë stil jetese. Autorët e *A Handbook on the Letters of John* [*Manual për letrat e Gjonit*] (Haas, Jonge dhe Swellengrebel) e UBS japin një koment interesant për këtë formë fjali greke: “përemri lidhor me një pjesëz greqisht, „an“ ose „an“, dhe folja vijuese në kohën lidhore, gjendet te 3:17, 22; 4:15; 5:15; 3 Gjonit 5. Duket se shpreh rrethana përgjithësisht të përsëritura” (f. 40). Bindja është aspekt kyç i besëlidhjes së besimit. Ky është mesazhi qendror i 1 Gjonit dhe Jakobit. S’mund të themi se e njohim Perëndinë, dhe pastaj të mohojmë edhe Fjalën e gjallë, edhe Fjalën e shkruar, me anë të mëkatit si stil jetese (shih 3:6, 9)!

▣ **“në të është përsosur vërtet dashuria e Perëndisë”** Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE, që bën fjalë për një veprim të plotësuar (shih 4:12, 17, 18). Është e paqartë gramatikisht nëse GJINORJA bën fjalë për

1. dashurinë e Perëndisë për ne (shih 4:12)
2. dashurinë tonë për Perëndinë (shih 5:3)
3. thjeshtë për dashurinë e Perëndisë në përgjithësi në zemrën tonë

Fjala “e përsosur” (*telos*, shih 4:12, 17, 18) do të thotë e pjekur, e plotë, ose plotësisht e pajisur për një detyrë të caktuar (shih Efe. 4:12), jo pa mëkat (shih 1:8, 10).

▣ **“qëndron”** Shih Temën e Veçantë në 2:10. DhR thotë, gjithashtu, se në ne banon/qëndron edhe Ati, edhe Biri (shih Gjoni 14:23 dhe 17:21). Vini re se, edhe në një fjali që thekson sigurinë e besimit, ekziston nevoja për termin “duhet”, madje dhe paralajmërohemi për të (shih 2:6, PASKAJORJA E TASHME, “qëndron në të”). Ungjilli është besëlidhje e kushtëzuar, me të drejta dhe me përgjegjësi!

▣ **“duhet të ecë dhe vetë njësoj siç eci ai”** Ky është një tjetër theksim i “besimit të vërtetë” si stil jetese (shih Jakobi 2:14-26). Besimi nuk është vetëm vendim, por edhe një marrëdhënie e vazhdueshme personale me Jezusin që, natyrshëm, ka rrjedhoja për jetën e përditshme në ngjashmëri me Krishtin. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme! Kjo është paralele me 1:7. Synimi i krishterimit nuk është vetëm qielli pasi të vdesim, por edhe ngjashmëri me Krishtin tani (shih Rom. 8:29-30; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pje. 1:15)! Ne shpëtohem për të shërbyer. Dërgohemi në mision, ashtu siç u dërgua dhe ai në mision. Ashtu si ai dha jetën e vet për të tjerët, kështu dhe ne duhet ta shohim veten si shërbëtorë (shih 1 Gjonit 3:16).

“Ai” është fjalë për fjalë “Ai Person”, që përbën një idiomë të zakonshme në shkrimet e Gjonit për “Jezusin” (shih Gjoni 2:21; 19:35; 1 Gjonit 2:6; 3:3,5,7,16; 4:17).

Nëse “Ai Person” i referohet Jezusit, atëherë kujt i referohet fraza “në të” në 6a? Shpesh, Gjoni përdor një dykuptimësi të qëllimshme. Mund të bëhet fjalë për Atin (shih Gjoni 15:1-2, 9-10) ose për Birin (15:4-6). Kjo dykuptimësi mund të ilustruhet edhe tek “i Shenjti” i v. 20.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:7-11

⁷Të dashur, nuk po ju shkruaj një urdhërim të ri, por një urdhërim të vjetër, që e kishit nga fillimi; urdhërimi i vjetër është fjala që keni dëgjuar. ⁸Nga ana tjetër, po ju shkruaj një urdhërim të ri, që është i vërtetë në të dhe në ju, sepse errësira po shkon dhe Drita e vërtetë tashmë po shndrit. ⁹Ai që thotë se është në Dritë, por urren vëllanë e vet, është në errësi deri tani. ¹⁰Ai që do vëllanë qëndron në Dritë dhe nuk ka shkak pengese në të. ¹¹Por ai që urren vëllanë është në errësi dhe ecën në errësi, dhe nuk e di se ku po shkon, pasi errësira ia ka verbuar sytë.

2:7 “Të dashur” Shpesh, Gjoni i thërret lexuesit e vet me fjalë të përzemërta (shih 2:1). Kjo fjalë u përdor nga Ati për Jezusin në pagëzimin e tij (shih Mat. 3:17) dhe në shndërrimin në mal (shih Mat. 17:5). Ky është termi i zakonshëm për të shpëtuarit në letrat e Gjonit (shih 3:2, 21; 4:1, 7, 11; dhe 3 Gjonit 1, 2, 5, 11).

Tekstus Receptusi përmban termin “vëllezër” (dorëshkrimet K, L; NKJV), por 1 Gjonit e përdor këtë fjalë vetëm në 3:13. “Të dashur” mbështetet nga dorëshkrimet uncial greke (α, A, B, C, P dhe Vulgata, Peshita, versioni kopt dhe versionet armene [shih Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, f. 708]).

■ **“nuk po ju shkruaj një urdhërim të ri, por një urdhërim të vjetër”** Kjo është karakteristike për shkrimet e Gjonit (shih Gjon 13:34; 15:12, 17). Urdhërimi nuk ishte i ri për sa i përket kohës, por i ri për sa i përket cilësisë. Besimtarët porositen që të duan njëri-tjetrin ashtu siç i deshi Jezusi (shih Gjon 13:34).

“Urdhërimi i vjetër” mund të merret në dy kuptime.

1. Ligji i Moisiut (shih Lev. 19:18)
2. Mësimet e Jezusit, të shkruara në ungjillin e Gjonit (shih Gjon 13:34; 15:12, 17)

■ **“urdhërimi i vjetër”** Në 2:3, fjala “urdhërim” është në SHUMËS, por këtu është në NJËJËS. Kjo duket se nënkupton që dashuria i përmbush gjithë urdhërimet e tjera (shih Gal. 5:22; 1 Kor. 13:13). Dashuria është urdhri i ungjillit.

■ **“që e kishit nga fillimi”** Kjo është DËFTORE E PAKRYER VEPRORE, që bën fjalë për takimin e parë të dëgjuesit me mesazhin e ungjillit (shih v. 24; 1:1; 3:11; 2 Gjonit 5-6).

■ **“keni dëgjuar”** Tekstus Receptus shton frazën “nga fillimi” (që u përdor edhe në pjesën e parë të këtij vargu).

2:8 “që është i vërtetë në të” Gjinia e këtij PËREMRI ndryshon nga FEMËRORJA në v. 7, e cila përputhet me gjininë e fjalës “urdhërim” (në greqisht), në ASNJANËSE, që bën fjalë për gjithë ungjillin. Një ndryshim i ngjashëm PËREMRI gjendet edhe në Efe. 2:8-9.

■ **“errësira po shkon”** Kjo është DËFTORE E TASHME MESORE (sipas *Word Pictures in the New Testament*, A. T. Robertson, f. 212). Për ata që njohin Perëndinë në Krishtin, epoka e re ka aguar dhe po vazhdon të agojë në zemrën dhe mendjen e tyre (pra, eskatologjia e përmbushur).

■ **“Drita e vërtetë tashmë po shndrit”** Jezusi është drita e botës (shih Gjon 1:4-5, 9; 8:12), që është metaforë biblike për të vërtetën, zbuluesën dhe dëlirësinë morale. Shih shënimet e 1:5 dhe 1:7. Epoka e re ka aguar!

2:9 “por urren vëllanë e vet” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për një qëndrim të ngulitur dhe të vazhdueshëm. Urrejta është provë e errësirës (shih Mat. 5:21-26).

2:10 “Ai që do vëllanë qëndron në Dritë” FOLJET NË KOHËN E TASHME dominojnë në këtë kontekst. Dashuria është provë e shpëtimit të besimtarit, njohjes së të vërtetë dhe dritës dhe marrëdhënies së tij me këto të dyja. Ky është urdhërimi i ri, që gjithsesi është edhe i vjetër (shih 3:11, 23; 4:7, 11, 21).

TEMË E VEÇANTË: “QËNDRIMI” NË SHKRIMET E GJONIT

Ungjilli i Gjonit përshkruan një marrëdhënie të veçantë mes Perëndisë Atë dhe Jezusit Bir. Është një lidhje e ngushtë dhe reciproke, e bazuar te nënshtrimi dhe barazia. Gjatë gjithë këtij ungjilli, Jezusi thotë ato që dëgjon nga Ati, bën ato që sheh se bën Ati. Jezusi nuk vepron me nismën e vet, por sipas vullnetit të Atit.

Kjo bashkësi e ngushtë dhe kjo marrëdhënie shërbyese përcaktojnë modelin për marrëdhënien e Jezusit me ndjekësit e vet. Ky shoqërim i ngushtë nuk nënkuptonte përpirjen e individit (si në misticizmin lindor), por një stil etik dhe moral jetese që duhet imituar. Bashkësia ishte (1) njohëse (botëkuptimi i ungjillit si Fjala e Perëndisë); (2) por edhe me bazë marrëdhënien (Jezusi ishte Mesia i premtuar nga Perëndia, tek i cili duhet të besojmë dhe të mbështetemi); dhe (3) etike (karakteri i tij duhet riprodhuar te besimtarët e perëndishëm).

Jezusi është njeriu ideal, izraeliti i vërtetë, standardi i njerëzimit. Ai zbulon se atë që duhet dhe mund të kishte qenë Adami (nga ana njerëzore). Jezusi është “shëmbëllimi” absolut “i Perëndisë”. Ai ia ripërtërin njerëzimit këtë shëmbëllim të rënë (1) duke zbuluar Perëndinë; (2) duke vdekur për hirin tonë (shlyerja zëvendësuese); dhe (3) duke u siguruar njerëzve një shembull që duhet ta ndjekin. Fjala “qëndroj/banoj” (*menō*) pasqyron synimin e besimtarit që të bëhet si Krishti (shih Rom. 8:29), rikthimin e gjendjes para Rënies (shih Zan. 3).

Ky ribashkim i Perëndisë me krijimin e tij më të lartë, njerëzimin, me qëllim miqësinë mes tyre është ajo që nënkupton Pali me termin “në Krishtin” dhe apostulli Gjon me frazën “qëndroni/banoni në mua”.

Vini re përdorimin nga ana e Gjonit:

1. Qëndrimi/banimi i Atit me Birin
 - a. Ati në Birin (Gjoni 10:38; 14:10,11; 17:21,23)
 - b. Biri në Atin (Gjoni 10:38; 14:10,11; 17:21)
2. Qëndrimi/banimi mes hyjnisë dhe besimtarit
 - a. Ati në besimtarin (Gjoni 14:20,23; 1 Gjonit 3:24; 4:12-13,15)
 - b. Besimtari në Atin (Gjoni 14:20,23; 17:21; 1 Gjonit 2:24,27; 4:13,16)
 - c. Biri në besimtarin (Gjoni 6:56; 14:20,23; 15:4,5; 17:23)
 - d. Besimtari në Birin (Gjoni 6:56; 14:20,23; 15:4,5,7; 1 Gjonit 2:6,24,27,28)
3. Elemente të tjera qëndruese (pozitive)
 - a. Fjala e Perëndisë
 - 1) negativisht (Gjoni 5:38; 8:37; 1 Gjonit 1:10; 2 Gjonit 9)
 - 2) pozitivisht (Gjoni 8:31; 15:2; 1 Gjonit 2:14; 2 Gjonit 9)
 - b. Dashuria e Perëndisë (Gjoni 15:9-10; 17:26; 1 Gjonit 3:17; 4:16)
 - c. Fryma e Perëndisë
 - 1) Mbi Birin (Gjoni 1:32)
 - 2) Në besimtarin (Gjoni 14:17)
 - d. Bindja tregon qëndrim/banim (Gjoni 15:10; 1 Gjonit 3:24)
 - e. Dashuria tregon se njeriu qëndron në dritë (1 Gjonit 2:10)
 - f. Kryerja e vullnetit të Perëndisë tregon qëndrim (1 Gjonit 2:17)
 - g. Vajosja qëndron/mbetet (1 Gjonit 2:27)
 - h. E vërteta qëndron/mbetet (2 Gjonit 2)
 - i. Biri qëndron/mbetet (Gjoni 8:35; 12:34)
4. Elemente të tjera qëndruese (negative)
 - a. Zemërimi i Perëndisë qëndron/mbetet (Gjoni 3:36)
 - b. Qëndron në errësirë (Gjoni 12:46)
 - c. Hidhet tej... digjet (nuk qëndron/mbetet) (Gjoni 15:6)
 - d. Mëkatimi (jo qëndresa) (1 Gjonit 3:14)
 - e. Asnjë vrasës (ka jetë të përjetshme të qëndrueshme) 1 Gjonit 3:15
 - f. Në vdekje (1 Gjonit 3:14)



NASB, NKJV “dhe nuk ka shkak pengese në të”

NRSV “në një njeri të tillë nuk ka shkak për pengesë”

TEV “nuk ka asgjë në ne që ta bëjë dikë tjetër të mëkatojë”

NJB “në të nuk ka asgjë që ta bëjë të humbasë”

Ky varg ka dy interpretime të mundshme.

1. Besimtari që ecën në dashuri nuk do të pengohet vetë (shih v. 11)
2. Besimtarit që ecën në dashuri nuk do t'ı bëjë të tjerët që të pengohen (shih Mat. 18:6; Rom. 14:13; 1 Kor. 8:13)

Të dyja janë të vërteta! Ungjilli ka dobi edhe për besimtarin, edhe për të tjerët (si për besimtarët e tjerë, ashtu dhe për të humburit).

Në DhV, “pengimi” është e kundërta e besimit (qëndrimi i palëkundur dhe me këmbë të palëvizshme). Vullneti dhe porositi e Perëndisë ilustroheshin si një shteg ose udhë pa pengesa. Prandaj dhe fjala “ecje” mund të shërbejë si metaforë për stilin e jetesës.

Shih Temën e Veçantë: Besoj, Besim dhe Besnikëri në DhV, në Gjoni 1:14.

2:11 “Por ai që urren vëllanë është në errësirë dhe ecën në errësirë” Këtu kemi një PJESORE TË TASHME VEPRORE (urren), e ndjekur nga një DËFTORE E TASHME VEPRORE (ecën). Urrejtja është shenjë mosbesimi (shih 3:15; 4:20). Drita dhe errësira, dashuria dhe urrejtja, nuk mund të ekzistojnë tek i njëjti person. Kjo është tipike për pohimet bardhezi të Gjoni. Ai shpreh idealin! Mirëpo, shpesh, besimtarët përleshën me paragjykimin, mungesën e dashurisë dhe neglizhimin në jetën e tyre! Ungjilli sjell edhe një ndryshim të atypëratyshëm, edhe një ndryshim të shkallëzuar.

■ **“errësira ia ka verbuar sytë”** Kjo mund të ketë të bëjë, ose me natyrën mëkatore që mbetet te besimtari (shih 2 Pje. 1:5-9), ose me veprimet e Satanit (shih 2 Kor. 4:4). Armiku ka tre armi: (1) sistemin e rënë botëror; (2) tunduesin engjëllor, i cili është person; pra, Satanin, dhe (3) natyrën tonë të rënë prej Adamit (shih Efe. 2:2-3, 16; Jakobi 4).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:12-14

¹²Po ju shkruaj juve, fëmijë të vegjël, sepse mëkatet ju janë falur për hir të emrit të tij. ¹³Po ju shkruaj juve, etër, sepse e njihni atë që ka qenë prej fillimit. Po ju shkruaj juve, djem të rinj, sepse e keni mposhtur të ligun. ¹⁴Ju kam shkruar juve, fëmijë, sepse e njihni Atin. Ju kam shkruar juve, etër, sepse e njihni atë që ka qenë prej fillimit. Ju kam shkruar juve, djem të rinj, sepse jeni të fortë dhe fjala e Perëndisë banon në ju, dhe e keni mposhtur të ligun.

2:12-14 Të gjitha FOLJET në këto vargje (përveç “po shkruaj” [NASB 1970], “kam shkruar” [NASB 1995]; UBS⁴ i jep së dytës vlerësimin “A” [e sigurt]) janë në KOHËN E KRYER, që bën fjalë për një veprim në të shkuarën që çon në një gjendje të vazhdueshme qenieje. Ndërsa konteksti i mëparshëm u drejtohej mësuesve të rremë, ky kontekst i drejtohet besimtarit. Ka tre tituj të ndryshëm që u jepen besimtarëve: “fëmijë të vegjël”, “etër”, dhe “djem të rinj”. Ky paragraf nuk përputhet plotësisht me kontekstin e dëshmimeve të sigurisë së shpëtimit në bazë të stilit të jetesës. Ndoshta, nuk kemi të bëjmë me tre grupe, por me një mjet letrar që përshkruan gjendjen e sigurt të gjithë të krishterëve.

Ka katër gjëra të renditura, që besimtarët i dinë.

1. se mëkatet u janë falur (v. 12)
2. se përmes Krishtit ata e kanë mposhtur djallin (v. 13)
3. se ata e “dinë” që kanë bashkësi me Atin (v. 14) dhe me Birin (v. 13-14)
4. se janë të fortë në Fjalën e Perëndisë (v. 14)

Kjo listë shprehet gramatikisht në (1) frazën “po ju shkruaj” dhe (2) në gjashtë FJALITË *hoti* (sepse).

2:12 “sepse mëkatet ju janë falur për hir të emrit të tij” Shërbesa e Jezusit është shpresa e vetme e njerëzimit për falje (DËFTORE E KRYER PËSORE). Në botëkuptimin hebraik, emri tregon karakterin dhe personalitetin e personit (shih 3:23; 3 Gjoni 7; Rom. 10:9-13; Fil. 2:6-11).

Kemi një seri prej gjashtë FJALISH me *hoti* në v. 12-14. Ato mund të jenë FJALI QËLLIMORE (NASB, NRSV, NJB, “sepse”) ose thjesht mënyrë letrare për të prezantuar pohime fakti (NET, “se”).

2:13 “atë që ka qenë prej fillimit” PËREMRRAT në 1 Gjoni janë të paqartë dhe mund t'ı referohen Perëndisë Atë, ose Perëndisë Bir. Në kontekst, ky përemër i referohet Jezusit. Është pohim i paraekzistencë dhe, si rrjedhojë, i natyrës së tij hyjnore (shih Gjoni 1:1, 15; 3:13; 8:48-59; 17:5, 24; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3).

■ **“e keni mposhtur”** Ky është një premtim dhe paralajmërim i përsëritur në 1 Gjoni (shih 2:14; 4:4; 5:4-5, 18-19). Kjo shprehet me një DËFTORE TË KRYER VEPRORE, që bën fjalë për pikën kulmore të një procesi.

Sërish, këtu Gjoni po shkruan me fjalë bardhezi (kjo fitore e përmbushur eskatologjike na kujton së tepërmi ungjillin e Gjonit). Besimtarët janë ngadhënjyes, mirëpo për shkak të tensionit “tashmë, por ende jo” të mbretërisë së Perëndisë, ata ndeshen me mëkatën, tundimin, përndjekjen dhe vdekjen.

■ **“të ligun”** Kjo është referencë për Satanin, i cili përmendet sërish në v. 14. Vargjet 13 dhe 14 janë paralele me njëra-tjetrën. Shih Temën e Veçantë në Gjoni 12:31.

■ **“sepse e njihni Atin”** Koncepti biblik i “njoh” përfshin kuptimin hebraik të marrëdhënies së ngushtë personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5) dhe konceptin grek të “fakteve për dikë/diçka”. Ungjilli është edhe person që duhet mirëpritur (Jezusi), edhe mesazh (doktrinë) që duhet pranuar dhe zbatuar, si dhe jetë që duhet jetuar.

TEMË E VEÇANTË: “NJOH” (duke përdorur kryesisht Ligjin e Përtërirë si paradigmë)

Fjala hebraisht “njoh” (BDB 393) ka shumë kuptime (fusha semantike) në formën *Kal*.

1. kuptoj të mirën dhe të keqen – Zan. 3:22; LiP. 1:39; Isa. 7:14-15; Jona 4:11
2. njoh duke kuptuar – LiP. 9:2, 3, 6; 18:21
3. njoh me anë të përvojës – LiP. 3:19; 4:35; 8:2, 3, 5; 11:2; 20:20; 31:13; Joz. 23:14
4. shqyrtoj – LiP. 4:39; 11:2; 29:16
5. njoh personalisht
 - a. një person – Zan. 29:5; Eks. 1:8; LiP. 22:2; 33:9
 - b. një perëndi – LiP. 11:28; 13:2,6,13; 28:64; 29:26; 32:17
 - c. JHVH – LiP. 4:35,39; 7:9; 29:6; Isa. 1:3; 56:10-11
 - d. Seksualisht – Zan. 4:1,17,25; 24:16; 38:26
6. Njohuri ose mjeshtëri e mësuar – Isa. 29:11, 12; Amosi 5:16
7. Të jesh i urtë – LiP. 29:4; Fja. 1:2; 4:1; Isa. 29:24
8. Njohuri e Perëndisë
 - a. nga ana e Moisiut – LiP. 34:10
 - b. nga ana e Izraelit – LiP. 31:21

2:14 “jeni të fortë” Vini re se forca e tyre bazohen në fjalën e qëndrueshme të Perëndisë. Kjo është e ngjashme me paralajmërimet e Palit në Efe. 6:10-18. Fjala e qëndrueshme është ungjilli. Ajo është edhe konceptuale dhe personale, edhe e nisur nga Perëndia edhe e pranuar nga individit, edhe vendim edhe dishepullizim, edhe e vërtetë edhe vërtetësi.

■ **“fjala e Perëndisë banon në ju”** Kjo personifikon konceptin e fjalës së Perëndisë (ungjilli, shih v. 24). Ky është aludim për Gjonin 15. Përdoret në kuptimin negativ në Gjoni 5:38 dhe 8:37.

■ **“e keni mposhtur të ligun”** Kjo thekson qëndresën e shenjtorëve të vërtetë. Gjetet sërish në v. 17, 19, 24, 27, 28; 5:18; dhe 2 Gjonit 9. Doktrina e sigurisë së besimtarit duhet drejtpeshuar me të vërtetën se ata që janë të shpenguar vërtet do të qëndrojnë deri në fund (shih Zbu. 2:7, 11, 17, 26; 3:5, 12, 21). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për Qëndresë në Gjoni 8:31. Kjo nuk nënkupton gjendjen e pamëkatshme tani, ndonëse kjo është mundësi teorike për shkak të veprës së përfunduar të Krishtit (shih Romakëve 6).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:15-17

¹⁵Mos e doni botën, as gjërat në botë. Nëse dikush e do botën, dashuria e Atit nuk është në të.

¹⁶Sepse gjithçka që është në botë, epshi i mishit, epshi i syve dhe krenaria mburravece e jetës, nuk është nga Ati, por është nga bota. ¹⁷Bota po kalon, bashkë me epshet e saj; por ai që bën vullnetin e Perëndisë jeton përjetë.

2:15 “Mos e doni” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZ MOHORE, që nënkupton ndalimin e një veprimi që tashmë është në kryerje e sipër. Dashuria e botës karakterizonte një grup të mësuesve të remë gnostikë.

■ **“botën”** Ky term përdoret në dy kuptime të ndryshme në DhR: (1) planeti fizik dhe/ose universi i krijuar (shih Gjoni 3:16; 16:33; 1 Gjonit 4:14) dhe (2) shoqëria njerëzore që organizohet dhe funksionon veçmas Perëndisë

(shih 1 Gjonit 2:15-17; 3:1, 13; 4:4-5; 5:4-5, 19). E para i referohet krijimit fillestar fizik (shih Zanafilla 1-2), ndërsa e dytë i referohet krijimit të rënë (shih Zanafilla 3). Shih Temën e Veçantë: *Kosmos* në Gjoni 14:17.

TEMË E VEÇANTË: QEVERIA NJERËZORE

I. HYRJE

- A. Përcaktim – Qeveria është organizimi i njerëzimit për të përmbushur dhe siguruar nevojat e perceptuara (p.sh., Zanafilla 4 dhe 11). Njerëzit janë qenie shoqërore (edhe përpara Rënies [shih Zan. 2:18]). Familjet, fiset dhe kombet na japin komunitet.
- B. Qëllimi – Vullneti i Perëndisë është që rendi është i preferueshëm ndaj anarkisë.
 - 1. Legjislacioni i Moisiut, veçanërisht Dekalogu, është vullneti i Perëndisë për njerëzimin në shoqëri. Ai ekuilibron adhurimin dhe jetën.
 - 2. Në Shkrim nuk përkrahet asnjë formë ose strukturë qeverisjeje, ndonëse teokracia e Izraelit të lashtë është forma paraprirëse e qiellit. As demokracia, as kapitalizmi, nuk janë e vërteta biblike. Të krishterët duhet të veprojnë siç duhet në çfarëdo sistemi qeverisës që të gjenden. Qëllimi i të krishterit është ungjillizimi dhe shërbesa, jo revolucioni. Të gjitha qeveritë janë kalimtare!
- C. Origjina e qeverisjes njerëzore
 - 1. Katolicizmi është shprehur se qeveria njerëzore është nevojë e qenësishme, madje dhe përpara Rënies. Aristoteli duket se ishte i pari që e siguroi këtë premisë. Ai thotë: “njeriu është kafshë politike”; me këtë nënkupton se qeveria “ekziston për përkrahjen e jetës së duhur”.
 - 2. Protestantizmi, veçanërisht Martin Luteri, ka pohuar se qeveria njerëzore është e qenësishme pas Rënies. Ai e quan “dora e majtë e mbretërisë së Perëndisë”. Luteri thotë se “mënyra e Perëndisë për të bërë zap njerëzit e këqij është duke i mbajtur nën kontroll”.
 - 3. Karl Marksi ka thënë se qeveria është mjet me anë të së cilit një elitë pakicë mban nën kontroll masat. Për të, qeveria dhe feja luajnë rol të ngjashëm.

II. MATERIALI BIBLIK

A. Dhiata e Vjetër

- 1. Izraeli është modeli që do të përdoret në qiell. Në Izraelin e lashtë, Mbret ishte JHVH. Teokracia është termi që përdoret për të përshkruar sundimin e drejtpërdrejtë të Perëndisë (shih 1 Sam. 8:4-9).
- 2. Sovraniteti i Perëndisë në qeverisjen njerëzore mund të shihet qartë në faktin se ai cakton.
 - a. të gjithë mbretërit (Dan. 2:21; 4:17, 24-25)
 - b. mbretërimin mesianik (Dan. 2:44-45)
 - c. Nebukadnecarin (neo-Babilonia) (Jer. 27:6; Dan. 5:28)
 - d. Kirin II (Parsi) (2 Kro. 36:22; Esdra 1:1; Isa. 44:28; 45:1)
- 3. Populli i Perëndisë duhet të jetë i nënshtruar dhe respektues edhe ndaj qeverive pushtuese dhe zaptuese:
 - a. Danieli 1-4, Nebukadnecari (neo-Babilonia)
 - b. Danieli 5, Belshacari (neo-Babilonia)
 - c. Danieli 6, Dari (Persia)
 - d. Esdra dhe Nehemia (Persia)
- 4. Judea e mëkëmbur duhet të lutej për Kirin dhe për mbretërimin e pasardhësve të tij
 - a. Esdra 6:10; 7:23
 - b. Judenjtë duhet të luteshin për autoritetet civile, Mishnah, Avot. 3:2

B. Dhiata e Re

- 1. Jezusi tregonte respekt për qeveritë njerëzore
 - a. Mateu 17:24-27; ai pagoi taksën e tempullit (autoritetet fetare dhe civile duhet të ishin një; shih 1 Pje. 2:17)
 - b. Mateu 22:15-22; Marku 12:13-17; Luka 20:20-26; ai përkrahu dhënien e taksës romake dhe, në këtë mënyrë, edhe autoritetin civil romak
 - c. Gjoni 19:11; Perëndia lejon autoritetin civil
- 2. Fjalët e Palit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Romakëve 13:1-5; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile, pasi janë caktuar nga Perëndia

- b. Romakëve 13:6-7; besimtarët duhet të paguajnë taksat dhe të nderojnë autoritetet civile
 - c. 1 Timoteut 2:1-3; besimtarët duhet të lutën për autoritetet civile
 - d. Titi 3:1; besimtarët duhet t'ua nënshtrohen autoriteteve civile
3. Fjalët e Pjetrit në lidhje me qeveritë njerëzore
- a. Veprat 4:1-31; 5:29; Pjetri dhe Gjoni përpara Sinedrit (kjo tregon precedentin biblik për mosbindjen civile).
 - b. 1 Pjetrit 2:13-17; besimtarët duhet t'ua nënshtrohen autoriteteve civile për të mirën e shoqërisë dhe ungjillizimit
4. Fjalët e Gjoni në lidhje me qeveritë njerëzore
- a. Zbulesa 17; lavirja e Babilonisë simbolizon qeverisjen njerëzore, e cila organizohet dhe funksionon veçmas Perëndisë
 - b. Zbulesa 18; lavirja e Babilonisë shkatërrohet

III. PËRMBYLLJE

- A. Qeverisja njerëzore (në këtë botë të rënë) caktohet nga Perëndia. Kjo nuk është “e drejta hyjnore mbretërve”, por detyra hyjnore e qeverisjes. Asnjë formë nuk përkrahet mbi të tjerat.
- B. Detyra fetare e besimtarëve është t'ia binden autoritetit civil dhe të lutet për të.
- C. Detyra e besimtarëve është ta mbështesin qeverinë njerëzore me anë të taksave, duke shfaqur qëndrimin e duhur plot respekt.
- D. Qeveria njerëzore ekziston me qëllim që të ruajë rendin. Ata janë shërbëtorë të Perëndisë për këtë detyrë.
- E. Qeveria njerëzore nuk është absolute. Ajo është e kufizuar në autoritetin e vet. Besimtarët duhet të veprojnë për hir të ndërgjegjes duke refuzuar autoritetin civil kur ai i tejkalon caqet që i ka caktuar Perëndia. Siç pohoi Augustini në *Qytetin e Perëndisë*, ne jemi qytetarë të dy mbretërve, asaj të përkohshme dhe asaj hyjnore (shih Fil. 3:20). Ne kemi përgjegjësi ndaj të dyjave, por absolutja është mbretëria e Perëndisë! Jepet një fokus individual dhe kolektiv në lidhje me përgjegjësinë tonë ndaj Perëndisë.
- F. Ne duhet t'ia inkurajojmë besimtarët e sistemeve demokratike që të marrin pjesë aktive në procesin e qeverisjes dhe që të zbatojnë, aty ku është e mundur, mësimet e Shkrimit.
- G. Ndryshimi shoqëror duhet paraprirë nga kthimi individual në besim. Nuk ekziston asnjë shpresë e qëndrueshme dhe e vërtetë eskatologjike në qeverinë njerëzore. Të gjitha qeveritë e njerëzve, ndonëse të caktuara dhe të përdorura nga Perëndia, janë shprehje të mëkatshme të organizimit njerëzor që funksionon veçmas Perëndisë. Ky koncept shprehet në përdorimin që i bën Gjoni fjalës “botë” (shih 1 Gjoni 2:15-17).

■ **“as gjërat në botë”** Me sa duket, këtu bëhet fjalë për dashurinë për objektet materiale (shih v. 16), ose për gjërat që ofron bota: pushteti, prestigji, ndikimi, etj. (shih Rom. 12:2; Jakobi 1:27). Sistemi i kësaj bote të rreme përpique që t'ia përbushë të gjitha nevojat njerëzimit, por pa Perëndinë. Ai e strukturon jetën në mënyrë të tillë që njerëzit të duket sikur janë të pavarur. Institucionet, për të cilat duhet të jemi të gjithë mirënjohës, mund të bëhen idhujtare nëse lejojnë pavarësinë nga Perëndia. Shembuj të tillë janë: (1) sistemet e qeverisëse njerëzore; (2) sistemet arsimore njerëzore; (3) sistemet ekonomike njerëzore; (4) sistemet mjekësore, etj.

Siç tha shumë bukur Augustini: “njeriu ka një vrimë me formë Perëndie” në jetën e vet. Ne përpiqemi që atë vrimë ta mbushim me gjëra njerëzore, por paqe dhe përbushje mund të gjejmë vetëm në të! Pavarësia është mallkim i Edenit!

■ **“Nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim të mundshëm. Gjëra që duam janë dëshmi se kujt i përkasim: Perëndisë apo Satanit.

2:16 “epshi i mishit” Kjo bën fjalë për qëndrimin e njerëzimit, që kërkon të përbushë tekat e veta (shih Gal. 5:16-21; Efe. 2:3; 1 Pje. 2:11). Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarks*) në Gjoni 1:14.

■ **“epshi i syve”** Judenjve thoshin se sytë janë dritarja e shpirtit. Mëkati fillon në mendje dhe shfaqet me veprime. Veprimet e njeriut zhvillohen në një stil jetese që të merr nën zotërim (p.sh., Fja. 23:7).

■ **“dhe krenaria mburravece e jetës”** Kjo bën fjalë për krenarinë njerëzore veçmas Perëndisë (pra, njerëzit besojnë në burimet e tyre). Në *The Jerome Bible Commentary*, vëll. 2, Raymond Brown, një studiues i shquar katolik i Gjonit, thotë për këtë frazë:

“Gjithsesi, *alazoneia*, që gjendet edhe në Jakobi 4:16, ka një kuptim më aktiv sesa krenaria e thjeshtë: ajo nënkupton arrogancën, gjendjen mburravece, bindjen se je i vetëmjaftueshëm” (f. 408).

Fjala “jeta” është *bios*, e cila nënkupton jetën tokësore, fizike dhe të përkohshme në këtë lanet (atë që njerëzimi e ka të përbashkët me bimët dhe kafshët; shih 1 Gjonit 3:17). Këto karakterizime përshkruajnë të dyja grupet e mësuesve të rremë gnostikë dhe njerëzimin e rënë e të parilindur. Zoti na ndihmoftë, pasi ato përshkruajnë dhe të krishterët e papjekur!

■ **“nuk është nga Ati, por është nga bota”** Këto janë dy arsye të krishterët nuk duhet ta duan botën.

1. ajo dashuri nuk është nga Ati (shih v. 16)
2. bota po kalon (shih v. 17)

2:17 “Bota po kalon” Kjo është DËFTORE E TASHME MESORE (shih 2:8). Kjo lidhet me dy epokat judaike. Epoka e re dhe e përmbushur po vjen; epoka e vjetër e mëkatit dhe rebelimit po kalon (shih Rom. 8:18-25).

TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA E ARDHSHME

Profetët e DhV e shihnin të ardhmen si zgjatim të së tashmes. Për ta, e ardhmja do të shënojë rimëkëmbjen e Izraelit gjeografik. Sidoqoftë, edhe ata e shihnin si ditë të re (shih Isa. 65:17; 66:22). Me refuzimin e vazhdueshëm kokëfortë të JHVH-së nga pasardhësit e Abrahamit (edhe pas robërisë), në letërsinë apokaliptike ndërhytore të judenjve u zhvillua një paradigmë e re (p.sh., 1 Enoku, 4 Esdra, 2 Baruku). Këto shkrime filluan të bënin dallimin mes dy epokave: epoka e ligë e tanishme, e dominuar nga Satani, dhe epoka e ardhshme e drejtësisë, e dominuar nga Fryma dhe e inauguruar nga Mesia (shpesh, si luftëtar dinamik).

Në këtë zonë të teologjisë (eskatologjia) ekziston një zhvillim i dukshëm. Teologët e quajnë këtë “zbulesë e shkallëzuar”. DhR e pohon këtë realitet të ri kozmik të dy epokave (pra, një dualizëm kohor).

<u>Jezusi</u>	<u>Pali</u>	<u>Hebrenjve</u>
Mateu 12:32	Romakëve 12:2	1:2
Mateu 13:22, 39	1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:18	6:5
Marku 10:30	2 Kor. 4:4	11:3
Luka 16:8	Galatasve 1:4	
Luka 18:30	Efe. 1:21; 2:1, 7; 6:12	
Luka 20:34-35	1 Timoteut 6:17	
	2 Timoteu 4:10	
	Titit 2:12	

Në teologjinë e Dhiatës së Re, këto dy epoka judaike janë mbivendosur për shkak të parashikimeve të papritura dhe të anashkaluara për dy ardhjet e Mesisë. Mishërimi i Jezusit përmbushi profecitë e DhV për inaugurimin e epokës së re (Dan. 2:44-45). Mirëpo DhV parapa edhe ardhjen e tij si Gjykatës dhe Fitimtar, por herën e parë ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53; Zak. 12:10), i përulur dhe i butë (shih Zak. 9:9). Ai do të kthehet me fuqi, pikërisht siç e paratha dhe DhV (shih Zbulesa 19). Kjo përmbushje me dy faza bëri që Mbretëria të jetë e tashme (e inauguruar), por edhe e ardhshme (e papërmbushur plotësisht). Ky është tensioni i DhR: tashmë, por ende jo!

■ **“por ai që bën vullnetin e Perëndisë jeton përjetë”** Vini re sesi jeta e përjetshme (pra, fjalë për fjalë “qëndron në epokën”) lidhet me një stil jetese plot dashuri, dhe jo thjesht me një rrëfim të shkuar besimi (shih Mat. 25:31-46; Jakobi 2:14-26). Shih Temën e Veçantë për Vullnetin e Perëndisë në Gjoni 4:34.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:18-25

¹⁸Fëmijë, është ora e fundit; dhe, ashtu siç dëgjuar se antikrishti po vjen, madje dhe tani janë shfaqur shumë antikrishtë; nga kjo e dimë se është ora e fundit. ¹⁹Ata dolën prej nesh, por nuk ishin vërtet tanët; sepse, po të ishin tanët, do të kishin qëndruar me ne; por ata dolën, në mënyrë që të tregohej se nuk ishin tanët. ²⁰Por ju keni vajosje nga i Shenjti, dhe ju të gjithë e dini. ²¹Nuk ju kam shkruar ngaqë nuk e njihni të vërtetën, por ngaqë e njihni, dhe ngaqë asnjë gënjeshtër nuk vjen nga e vërteta. ²²Kush është gënjeshtari, përveç atij që mohon se Jezusi është Krishti? Ky është antikrishti, ai që mohon Atin dhe Birin. ²³Kushdo që mohon Birin, nuk e ka Atin; ai që rrëfen Birin, ka dhe Atin. ²⁴Sa për ju, le të qëndrojmë në ju ajo që dëgjua nga fillimi. Nëse ajo që dëgjuar nga fillimi qëndron në ju, edhe ju do të qëndroni në Birin dhe në Atin. ²⁵Ky është premtimi që na dha ai vetë: jeta e përjetshme.

2:18 “Fëmijë” Shih shënimin në 2:1.

■ “**është ora e fundit**” Fjala për fjalë, “orë e fundit” pa NYJË SHQUESE (gjendet vetëm këtu). Ashtu si “ditët e fundit”, edhe kjo është një nga frazat e përdorura në DhR për të përshkruar Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit (shih Gjoni 6:39-40, 44). Ky është koncept i rëndësishëm te Gjoni sepse, në kohën tonë, shumë e shumë interpretues janë ndikuar nga “eskatologjia e përmbushur” e C. H. Dodd (një parim kryesor i amilenializmit). Pa dyshim, është e vërtetë se Gjoni mëson në mënyrë unike dhe të fuqishme se Mbretëria e Perëndisë ka ardhur në Jezusin. Megjithatë, ky tekst zbulon se ekziston dhe një përmbushje e ardhshme (ngjarje, ose periudhë). Të dyja janë të vërteta. Kjo është një tjetër shprehje e tensionit të DhR (paradoks) midis “tashmë dhe ende jo” (pra, “po vjen”) të dy epokave të judenjve, të cilat tani mbivendosen nga ana kohore.

■ “**antikrishti... antikrishtë**” Kjo frazë përshkruese është edhe NJËJËS, edhe SHUMËS; asnjëri nga këto dy terma nuk e ka NYJËN (duke ndjekur dorëshkrimet α^* , B, C). Vetëm Jezusi e përdor këtë term në DhR (shih 2:18, 22; 4:3; 2 Gjoni 7). Shih shënimin më të plotë në Mësimet Kontekstuale te 2:3-27, D.

■ “**po vjen**” Kjo është DËFTORE E TASHME MESORE (deponente). Në greqishten *koine*, disa forma të FOLJES greke pushuan së u përdoruri dhe funksionin e tyre e morën disa forma të tjera. FOLJET depononte kanë formë MESORE ose PËSORE, por përkthehen si të kishin kuptim VEPROR. Këtu, E TASHMJA përdoret për të shprehur sigurinë e një ngjarjeje të ardhshme. Antikrishti (në NJËJËS) po vjen dhe shumë mësues të rremë ose mesi të rremë, të ngjashëm me të, janë shfaqur tashmë (antikrishtë).

Teologjikisht, ka mundësi që, meqë Satani nuk e di kohën e kthimit të Krishtit, ka përgatitur tashmë dikë që të marrë përsipër udhëheqjen e botës në çdo moment që do t’i jepet kjo mundësi.

■ “**janë shfaqur**” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPROR. Fryma e “anti”-Krishtit është tashmë e pranishme dhe vepruese në këtë botë të rënë (pra, mësuesit e rremë), por ende pritet një shfaqje e ardhshme. Disa komentues mendojnë se kjo bën fjalë për perandorinë romake në kohën e Gjoni, ndërsa disa të tjerë mendojnë se bën fjalë për një perandori të ardhshme botërore në kohën e fundit. Në shumë kuptime, të dyja janë të sakta! Ora e fundit është inauguruar me Mishërimin e Jezusit dhe do të zgjasë deri në momentin e përmbushjes (Ardhja e Dytë e Krishtit).

2:19 “**Ata dolën prej nesh, por nuk ishin vërtet tanët**” Ky është shembull i përsosur i mësimin të rremë dhe i rrëfimeve të rreme në kishën e dukshme (shih Mat. 7:21-23; 13:1-9, 18-23, 24-30). Mungesa e së vërtetës, dashurisë dhe qëndresës nga ana e tyre janë dëshmi se ata nuk janë besimtarë. Herezia vjen gjithmonë nga brenda!

Autori i 1 Gjoni është shumë i kujdesshëm në mënyrën sesi zgjedh KOHËT E FOLJEVE. Vargu 19 pasqyron

1. mësuesit e rremë janë larguar (AORISTI)
2. nuk ishin kurrë vërtet pjesë e besimtarëve (E PAKRYER)
3. po të kishin qenë pjesë, nuk do të ishin larguar (FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË me FOLJE në kohën e KRYER TË TEJSHKUAR).

Shih Temën e Veçantë: Femohimi në Gjoni 6:64.

■ “**po të**” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË, që quhet në kundërshtim me faktin. Duhet përkthyer: “Po të na kishin përkitur neve, gjë që s’është e vërtetë, atëherë do të kishin qëndruar me ne, gjë që nuk e bënë”.

■ **“do të kishin qëndruar me ne”** Kjo është DËFTORE VEPRORE E KRYER E TEJSHKUAR, që bën fjalë për një veprim të përmbushur në të shkuarën. Kjo është një nga referencat e shumta të doktrinës së Qëndresës (shih v. 24, 27, 28). Besimi i vërtetë mbetet dhe jep fryt (shih Mat. 13:1-23). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 8:31.

2:20 “ju keni vajosje nga i Shenjti” “Ju” është në SHUMËS, gjë që theksohet në tekstin greqisht për të bërë kontrastin me ata që ishin larguar nga bashkësia e të krishterëve. Ka gjasa që gnostikët të jenë ndikuar nga fetë “e mistershme” lindore dhe mësonin për një vajosje të veçantë që sillte njohurinë dhe njëjtësimin me hyjninë. Gjoni thotë se ata që kishin vajosjen (lidhjen e veçantë) me hyjninë ishin besimtarët, jo gnostikët.

TEMË E VEÇANTË: I SHENJTI

“I Shenjti” mund t’i referohet

1. Perëndisë Atë (shih pasazhet e shumta në DhV për “të Shenjtin e Izraelit”)
2. Perëndisë Bir (shih Marku 1:24; Luka 4:34; Gjoni 6:69; Veprat 3:14)
3. Perëndisë Frymë (titulli i tij, “Fryma e Shenjtë”, shih Gjoni 1:33; 14:26; 20:22)

Veprat 10:38 është një varg ku të tre personat e Hyjnisë përfshihen në vajosje. Jezusi ishte i vajosur (shih Luka 4:18; Veprat 4:27; 10:38). Këtu, ky koncept zgjerohet për të përfshirë gjithë besimtarët (shih 1 Gjonit 2:27). I Vajosuri është shndërruar në të vajosurit! Kjo mund të jetë paralele me Antikrishtin dhe antikrishtët (shih 1 Gjonit 2:18). Akti simbolik i vajosjes fizike me vaj në DhV (shih Eks. 29:7; 30:25; 37:29) kryhej tek ata që ishin thirrur dhe pajisur nga Perëndia për një detyrë të veçantë (d.m.th., profetët, priftërinjtë dhe mbretërit). Fjala “Krisht” është përkthim i fjalës hebraisht “i vajosuri”, ose Mesia.

■ **“vajosje”** Shih Temën e Veçantë: Vajosja në Bibël, në Gjoni 11:2.

■

NASB “dhe ju të gjithë e dini”

NKJV “dhe ju dini gjithçka”

NRSV “dhe të gjithë ju keni njohuri”

TEV “dhe, kështu, të gjithë ju e njihni të vërtetën”

NJB “dhe të gjithë keni marrë njohuri”

Ky ishte një pohim domethënës kur kemi parasysh thëniet arrogante të mësuesve të rremë gnostikë për njohurinë e tyre të fshehtë. Gjoni thotë se besimtarët kanë njohuri të krishterë bazë (v. 27 dhe Gjoni 16:7-14 dhe Jer. 31:34), jo njohuri shteruese për fenë apo për sfera të tjera të njohurisë (shih 3:2). Për Gjonin, e vërteta është edhe konceptuale, edhe personale; po kështu, vajosja mund t’i referohet, edhe ungjillit, edhe Frymës.

Ekziston një variant në dorëshkrimet greke për këtë frazë. NKJV ndjek dorëshkrimet uncial A, C dhe K, që kanë *panta* (të gjitha gjërat), pra një SHUMËS ASNJANËS që përdoret si KUNDRINOR I DREJTË, ndërsa NASB ndjek dorëshkrimet x, B dhe P, që kanë *pantes* (të gjithë ju), një SHUMËS MASHKULLOR, që fokusohet te KRYEFJALA “të gjithë ju”. Në dritën e pohimeve përjashtuese të mësuesve të rremë, mundësia e dytë është më e mira. UBS⁴ i jep vlerësimin “B” (pothuajse e qartë). Vajosja dhe njohuria u jepen të gjithë besimtarëve, jo një pakice të përzgjedhur, të veçantë, intelektuale dhe shpirtërore!

2:21 Ky është një nga vargjet e shumtë që pohojnë se lexuesit e Gjonit kanë siguri besimi për shpengimin dhe se njohin të vërtetën. Në këtë varg, siguria bazohet te vajosja nga Fryma, i cili u ka dhënë besimtarëve uri për ungjillin dhe njohuri për të.

2:22 “Kush është gënjeshtari” Kjo frazë e ka NYJËN SHQUESE, kështu që Gjoni po i referohet

1. ose një mësuesi të rremë në veçanti (mundësisht, Kerinti)
2. ose “gënjeshtres së madhe” dhe mohimit të ungjillit (shih 5:10)

“Gënjeshtari” është paralel me “antikrishtin”. Fryma e antikrishtit është e pranishme në çdo epokë. Një përcaktim bazë (dy ngjyrimet e PARAFJALËS “anti”) është “ai që mohon se Jezusi është Krishti” ose “ai që përpiqet të zëvendësojë Krishtin”.

■ **“se Jezusi është Krishti”** *The Jerome Biblical Commentary*, f. 408, jep një mendim të drejtë:

“Autori nuk nënkupton thjesht përmbushjen nga Jezusi të pritshmërisë së DhV dhe judenjve për mesinë. Këtu, „Krishti“ ka kuptimin e vet të plotë si termi i preferuar i DhR për Jezusin, fjalët dhe veprat e të cilit e kanë shpallur se është Shpëtimtar hyjnor i njerëzimit (shih Veprat 2:31; Rom. 1:4)”.

Ka mundësi që ky pohim doktrinor të ketë funksionuar

1. si polemikë kundër gnosticizmit
2. si formulë besoreje izraelite që e ndante qartë sinagogën nga kisha; ndoshta, reflekton formulat e mallkimit të rabinëve pas Javnes (70 pas K.)
3. ashtu si “Jezusi është Zot”, ky mund të ketë qenë pohim pagëzimor

2:22-23 “Kushdo që mohon Birin” Me sa duket, mësuesit e rremë gnostikë pretendonin se e njihnin Perëndinë, por mohonin, decentralizonin dhe zhvlerësonin rolin e Jezu Krishtit (shih 4:1-6; 5:1-12; Gjoni 5:23).

Në bazë të shkrimeve të gnostikëve nga shekulli i dytë pas K., komenteve brenda DhR, si dhe etërve të kishës, në pah dalin bindjet e mëposhtme gnostike.

1. Gnostikët përpiqeshin ta martonin krishterimin me filozofinë greke (Platonin) dhe me fetë e mistereve lindore.
2. Ata mësonin se Jezusi ishte hyjnor, por jo njerëz, sepse shpirti është i mirë, kurse lënda (mishi) është e keqe. Si rrjedhojë, nuk ekzistonte mundësia e mishërimit fizik të Perëndisë.
3. Ata mësonin dy gjëra në lidhje me shpëtimin
 - a. një grup thoshte se njohuria e veçantë e sferave engjëllore (*aeon*) sillte shpëtimin e shpirtit, pa patur lidhje me veprimet e trupit në planin fizik.
 - b. një tjetër grup theksonte asketizmin fizik (shih Kol. 2:20-23). Ata thoshin se mohimi i plotë i nevojave dhe dëshirave trupore ishte kyç për shpëtimin e vërtetë.

2:23 Ky varg në Tekstus Receptus, i cili ndjek dorëshkrimet unciale K dhe L, e ka shkurtuar aksidentalisht tekstin original duke lënë pa përmendur referencën e dytë paralele të Atit, e cila mbështetet fuqishëm nga dorëshkrimet e tjera unciale greke: א, A, B dhe C.

▣ **“ai që rrëfen”** Kjo është pikërisht e kundërta e “kushdo që mohon” në v. 22 [dy herë] dhe 23 [një herë] dhe 26 [një herë]. Shih Temën e Veçantë: Rrëfimi, në Gjoni 9:22-23.

▣ **“Birin”** Miqësia me Perëndinë është e disponueshme vetëm nëpërmjet besimit në Birin (shih 5:10-12, 13). Besimi në Jezusin nuk është fakultativ! Ai është e vetmja rrugë për tek Ati (shih Gjoni 5:23; 14:6; Luka 10:16).

2:24 “Sa për ju” Kjo tregon kontrastin shumë të theksuar midis lexuesve të Gjoni dhe mësuesve të rremë e ndjekësve të tyre, të cilët u larguan nga bashkësia (shih v. 27).

▣ **“le të qëndrojnë në ju ajo që dëgjuat nga fillimi”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE, që thekson nga ana gramatikore termin “ju” (që ndodhet në fillim të frazës greqisht), në kontrast me mesazhin e mësuesve të rremë. Ungjilli personifikohet dhe përshkruhet si mysafir brendabanues. Kjo është e para nga dy arsyet që jepen për fitoren e të krishterëve ndaj mësuesve të rremë (gënjeshtarëve). Arsyeja e dytë gjendet në v. 20 dhe 27, ku përmendet vajosja e Frymës. Sërish, ungjilli, si mesazh dhe si person, lidhet nga fraza “nga fillimi” (shih v. 13, 14, 24 [dy herë]). Fjala e Perëndisë është edhe përmbajtje, edhe personale, edhe e shkruar, edhe e gjallë (shih 1:8, 10; 2:20, 24)! Shih Temën e Veçantë: Banimi/Qëndrimi në 2:10.

▣ **“Nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Kjo vazhdon paralajmërimin dhe qortimin që lidhet me “qëndrimin”. Fakti se pushuan së qëndruari zbulon se nuk kishin qenë kurrë pjesë (shih 2:18-19). Provat e stilit të jetesës për “qëndrimin” sjellin siguri besimi (shih Gjoni 15). Qëndrimi është një mesazh i dëgjuar dhe i pranuar, si dhe një bashkësi me Birin dhe me Atin (shih Gjoni 14:23), i cili zbulohet në zgjedhjet e stilit të jetesës, si në mënyrë pozitive (dashuria) ashtu dhe negative (refuzimi i botës).

2:25 “Ky është premtimi që na dha ai vetë: jeta e përjetshme” Sërish, PËREMRRAT në v. 25 janë shumë të paqarta dhe mund t’i referohen edhe Atit Perëndi, edhe Birit. Ndoshta, kjo ishte qëllimshme (si te 2 Pjetrit 1). Me sa duket, ky pohim i ngjason së tepërmi Gjoni 3:15-16 dhe 6:40. Shpresa e besimtarit qëndron në karakterin dhe premtimet e Perëndisë (shih Isa. 45:23; 55:11). Bashkësia jonë e ngushtë me Perëndinë Triun rezulton në shpresë, po, madje në premtimin e jetës së përjetshme (shih 5:13). Jeta e përjetshme ka tipare të dukshme.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:26-27

²⁶Këto gjëra jua shkrova në lidhje me ata që po përpiqen t'ju mashtrojnë. ²⁷sa për ju, vajosja që morët prej tij qëndron në ju, dhe s'keni nevojë që kurrkush t'ju mësojë; por, për shkak se vajosja e tij ju mëson për gjithçka, dhe është e vërtetë e jo gënjeshtër, ashtu siç ju ka mësuar, qëndroni në të.

2:26 “ata që po përpiqen t'ju mashtrojnë” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Në çdo epokë ka mashtrues (shih Mat. 7:15; 24:11, 24; 2 Gjonit 7). Shpesh, këta janë fetarë të sinqertë që marrin pjesë dhe janë aktivë në takimet e krishtera.

2:27 “vajosja” Kjo duket se thekson rezultatin e vajosjes, jo mjetin (Frymën), apo elementet (të vërtetat e ungjillit). Vajosja ishte koncepti i DhV për thirrjen dhe pajisjen e veçantë të një personi për një detyrë, që ia kishte dhënë Perëndia. Profetët, priftërinjtë dhe mbretërit vajoseshin. Ky term është i lidhur në mënyrë etimologjike me termin “Mesi”. Këtu, bën fjalë për stabilitetin që i sjell besimtarit ndriçimi i mendjes dhe zemrës së tij nga ana e Frymës. Shih Temën e Veçantë: Vajosja në Bibël, në Gjoni 11:2.

Mësuesit e rremë pretendonin se kishin marrë zbulësë të veçantë nga Perëndia (pra, vajosje të veçantë). Gjoni thotë se të gjithë besimtarët e kanë tashmë vajosjen e vërtetë kur besojnë në të Vajosurin, mbushen me Frymën e Shenjtë dhe qëndrojnë në fjalën e Perëndisë.

■ **“që morët”** Kjo është DËFTORE AORISTE VEPRORE, që tregon për një veprim të përfunduar në të shkuarën. “Vajosja” është paralele me “që dëgjuat” në v. 24. Ungjilli duhet pranuar (1) individualisht me besim (shih Gjoni 1:12; 3:16) dhe (2) si grup të vërtetash (shih 2 Gjonit 9-10; 1 Kor. 15:1-4; Juda 3). Të dyja këto veprime kryhen me anë të Frymës së Shenjtë.

■ **“dhe s'keni nevojë që kurrkush t'ju mësojë”** Vargu 27 është paralel me v. 20 (pra, Besëlidhja e Re, shih Jer. 31:34). Gjoni po përdor motive të përsëritura (v. 20, 24, 27). Fryma e Shenjtë, dhe jo mësuesit e rremë gnostikë, është mësuesi ynë absolut dhe i domosdoshëm (shih Gjoni 14:26). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ofiqi dhe dhuntia e mësuesit nuk është aktive në kishën e hershme dhe sot (shih Efe. 4:11; Efe. 13:1; 1 Kor. 12:28). Kjo thjesht do të thotë se gjërat bazë në lidhje me shpëtimin vijnë nga Fryma e Shenjtë dhe nga Bibla, jo nga ndonjë mësues i veçantë dhe i talentuar njerëzor, ndonëse Perëndia i përdor shpesh këta njerëz si mjete.

■ **“por, për shkak se vajosja e tij ju mëson gjithçka, dhe është e vërtetë e nuk është gënjeshtër”** Bëhet fjalë për të vërtetën shpirtërore. Çdo i krishterë ka Frymën e Shenjtë, që ia udhëheq ndërgjegjen. Duhet të jemi të vetëdijshëm ndaj udhëheqjes së butë të Frymës në zonat e së vërtetës dhe etikës.

■ **“ashtu siç ju ka mësuar, qëndroni në të”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Gjoni e përdor konceptin e “qëndrimit/banimit” së tepërmi në këtë letër si element sigurie besimi për lexuesit e vet (shih Gjoni 15). Besimi biblik është besëlidhje, në të cilën Perëndia merr nismën dhe përcakton axhendën, por njerëzit duhet t'ij përgjigjen fillimisht dhe të vazhdojnë (të qëndrojnë)! Qëndrimi përfshin edhe një aspekt hyjnor, edhe një aspekt njerëzor. Shih Temën e Veçantë: Qëndrimi në 2:10.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'ij kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Përshkruaj bindjet e mësuesve të rremë.
2. Jep provat sesi mund të dimë se jemi vërtetë të shpenguar.
3. Shpjego marrëdhënien mes mëkatit zakonor dhe akteve të izoluar të mëkatit.
4. Shpjego marrëdhënien mes qëndresës së shenjtoreve dhe sigurisë së besimtarëve.
5. Rendit dhe përcakto tre armiqtë e njeriut.

1 GJONIT 2:28-3:24

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Fëmijë të Perëndisë (2:28-3:10)	Fëmijët e Perëndisë	Besnikëria ndaj besimit të vërtetë (2:18-29)	Armiku i Krishtit (2:18-29)	Të jetojmë si fëmijë të Perëndisë (2:29-4:6)
2:28-3:3	2:28-3:3	2:28 2:29 Marrëdhënia prej biri shfaqet me sjelljen e duhur 3:1-10	2:28-29 Fëmijë të Perëndisë 3:1-3	2:29-3:2 Kushti i parë: ndahu prej mëkatit 3:3-10
3:4-10	Mëkati dhe fëmija i Perëndisë 3:4-9		3:4-6 3:7-8 3:9-10	
Ta doni njëri-tjetrin	Urdhërimi i dashurisë 3:10-15	Dashuria për njëri-tjetrin	Ta doni njëri-tjetrin	Kushti i dytë: zbato urdhërimet, veçanërisht jetën 3:11-24
3:11-18		3:11-18	3:11-12 3:13-18	
Siguria para Perëndisë	Rrjedhohat e dashurisë 3:16-23	Siguria e të krishterit	Kuraja para Perëndisë	
3:19-24	Fryma e së vërtetës dhe fryma e gabimit 3:24-4:6	3:19-24	3:19-24	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

4. Etj.

MËSIMI KONTEKSTUALE

- A. Kapitulli 2 u drejtohet mësuesve të rremë gnostikë (sidomos gnostikëve docetikë, të cilit mohonin natyrën njerëzore të Jezusit)
- B. Kapitulli 3 vijon duke aluduar për mësuesit e rremë, të cilët e ndanin shpëtimin (shfajësimin) nga etika dhe morali (shenjtërimi). Mirëpo kapitulli 3 i drejtohet edhe besimtarit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:28-3:3

²⁸Tani, fëmijë të vegjël, qëndroni në të që, kur të shfaqet ai, të mund të kemi siguri dhe të mos zbrapsemi prej tij të turpëruar në ardhjen e tij. ²⁰Nëse e dini se ai është i drejtë, e dini se kushdo që praktikon drejtësinë ka lindur prej tij. ^{3:1}Shihni sa dashuri të madhe na ka falur Ati, që të quhemi fëmijë të Perëndisë; dhe të tillë jemi. Për këtë arsye, bota nuk na njeh, sepse nuk njeh atë. ²Të dashur, tani jemi fëmijë të Perëndisë, dhe nuk është shfaqur ende çfarë do të jemi. E dimë se, kur ai të shfaqet, do të jemi si ai, sepse do ta shohim ashtu siç është. ³Dhe kushdo që ka këtë shpresë të ngulitur në të, e pastron veten, ashtu siç është dhe ai i pastër.

2:28 Ndër komentuesit ka shumë diskutime nëse paragrafi i ri fillon në vargun 28, 29, apo 3:1. Për shkak të përsëritjes midis v. 27 dhe 28, ndarja e paragrafëve ndoshta e ka vendin këtu.

■ “fëmijë të vegjël” Shihni shënimin në 2:1.

■ “qëndroni në të” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORË. Kjo është URDHËRORJA e tretë E TASHME që përdoret për të nxitur qëndresën e të krishterit (shih v. 15, 24). Shih Temat e Veçanta: Nevoja për Qëndresë në Gjoni 8:31, dhe Qëndrimi në 1 Gjonit 2:10.

Shpesh, është e vështirë të gjesh se kujt i referohen PËREMRAT, por, në këtë paragraf, janë të qartë.

1. “në të”, v. 28a – Jezusi
2. “prej tij”, v. 28b – Jezusi
3. “e tij”, v. 28b – Jezusi
4. “ai është i drejtë” v. 29 – Ati
5. “lindur prej tij”, v. 29 – Ati (shih shënimin)
6. “njihni atë”, 3:1 – Atin (shih Gjoni 15:21; 16:2-3)
7. “shfaqet”, 3:2 – Jezusi
8. “si ai”, 3:2 – Jezusi
9. “ta shohim”, 3:2 – Jezusi
10. “është”, 3:2 – Jezusi
11. “në të”, 3:3 – Jezusi
12. “siç është dhe ai i pastër” 3:3 – Jezusi

Konteksti, konteksti, konteksti!

■ “kur të shfaqet ai” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, si v. 29, dhe si fraza “kurdoherë që të kthehet Jezusi” e 3:2. Kjo nuk synohet që të përçojë një ngjarje të paqartë, por një kohë të paqartë (e ngjashme me përdorimin e fjalës “shpresë” në DhR; shih 3:3).

■ “të mund të kemi siguri” Fjala greke “siguri” (*parrhēsia*) vjen nga rrënja “flas lirisht”. Siguria është një stil i tanishëm jetese, që bazohet në njohurinë e ungjillit të Jezu Krishtit nga besimtari dhe në besimin e tij në të.

Shih Temën e Veçantë: Guximi në Gjoni 7:4.

■

NASB “dhe të mos zbrapsemi prej tij të turpëruar”

NRSV “dhe të mos turpërohem para tij”

NRSV “dhe të turpërohem para tij”

TEV “dhe të mos fshihemi nga turpi prej tij”

NJB “dhe të mos zmbrespsemi prej tij të turpëruar”

Kjo është LIDHORE AORISTE PËSORE (depononte), që do të thotë se mund të kuptohet kështu:

1. vetë besimtari do të ndiejë turp (NASB, TEV, NJB)
2. besimtari ka për t'u turpëruar (NRSV)

■ **“në ardhjen e tij”** Kjo bën fjalë për Ardhjen e Dytë. Kjo fjalë, *Parousia*, përdoret vetëm këtu në të gjitha shkrimet e Gjonit dhe ka ngjyrimin kuptimor të një vizite të afërt mbretërore.

Fjalë për fjala, thuhet “deri në *Parousia*”, që do të thotë “prani” dhe përdoret për vizitat mbretërore.

Terma të tjerë të DhR që përdoren për Ardhjen e Dytë janë:

1. *epifaneia*, “shfaqje ballë përballë”
2. *apokalupsis*, “heqje mbuluese”
3. “Dita e Zotit” dhe përdorimet e ndryshme të kësaj fraze

TEMË E VEÇANTË: TERMA TË DHR PËR KTHIMIN E KRISHTIT

Theksimi eskatologjik i një dite të veçantë në të ardhmen, kur njerëzit do të dalin përpara Jezusi (si Shpëtimtar dhe Gjykatës), përmendet me terma të ndryshëm në shkrimet e Palit.

1. “dita e Zotit tonë Jezu Krisht” (shih 1 Kor. 1:8)
2. “dita e Zotit” (shih 1 Kor. 5:5; 1 Thes. 5:2; 2 Thes. 2:2)
3. “dita e Zotit Jezus” (shih 2 Kor. 1:14, dorëshkrimi ñ ka “Zoti Jezus” në 1 Kor. 5:5)
4. “dita e Jezu Krishtit” (shih Fil. 1:6)
5. “dita e Krishtit” (shih Fil. 1:10; 2:16)
6. “dita e tij (Birit të Njeriut)” (shih Luka 17:24)
7. “dita kur do të zbulohet Biri i Njeriut” (shih Luka 17:30)
8. “zbulosa e Zotit tonë Jezu Krisht” (shih 1 Kor. 1:7)
9. “kur Zoti Jezus të zbulohet nga qielli” (shih 2 Thes. 1:7)
10. “në prani të Zotit Jezus, në ardhjen e tij” (shih 1 Thes. 2:19)

Ka të paktën katër mënyra sesi autorët e DhR i referohen kthimit të Jezusit.

1. *Epifaneia*, që nënkupton shkëlqimin vezullues që lidhet teologjikisht (ndonëse jo etimologjikisht) me “lavdinë”. Në 2 Tim. 1:10; Titit 2:11 dhe 3:4 i referohet ardhjes së parë të Jezusit (pra, mishërimit), si dhe Ardhjes së tij të dytë. Përdoret dhe në 2 Thes. 2:8, që përfshin të tria fjalët kryesore për Ardhjen e Dytë: 1 Tim. 6:14; 2 Tim. 4:1, 8; Titit 2:13.
2. *Parousia*, që do të thotë “prani” dhe, në fillim, bënte fjalë për vizitën e mbretit. Është termi i përdorur më gjerësisht (shih Mat. 24:3,27,37,39; 1 Kor. 15:23; 1 Thes. 2:19; 3:13; 4:15; 5:23; 2 Thes. 2:1,8; Jakobi 5:7,8; 2 Pje. 1:16; 3:4,12; 1 Gjonit 2:28).
3. *Apokalupsis*, që do të thotë “heqje veli me qëllim zbuluese”. Është emri i librit të fundit të DhR (shih Luka 17:30; 1 Kor. 1:7; 2 Thes. 1:7; 1 Pje. 1:7; 4:13).
4. *Faneroō*, që do të thotë “nxjerr në dritë”, ose “zbuloj, shfaq qartazi”. Ky term përdoret shpesh në DhR për shumë aspekte të zbulësës së Perëndisë. Ashtu si *epifaneia*, edhe kjo fjalë mund t'i referohet ardhjes së parë të Krishtit (shih 1 Pje. 1:20; 1 Gjonit 1:2; 3:5, 8; 4:9), ose edhe ardhjes së dytë të tij (shih Mat. 24:30; Kol. 3:4; 1 Pje. 5:4; 1 Gjonit 2:28; 3:2).
5. Fjala shumë e përdorur për “ardhjen”, *erhōmai*, përdoret ndonjëherë edhe për kthimin e Krishtit (shih Mat. 16:27-28; 23:39; 24:30; 25:31; Veprat 1:10-11; 1 Kor. 11:26; Zbu. 1:7, 8).
6. Përdoret edhe me frazën “dita e Zotit” (shih 1 Thes. 5:2), që është titulli i DhV për ditën e bekimit (ringjalljes) dhe gjykimit të Perëndisë.

DhR në tërësi u shkrua brenda botëkuptimit të DhV, që pohonte

- a. një epokë e tanishme, e ligë dhe rebele
- b. një epokë e re e ardhshme drejtësie
- c. një epokë që do të vijë me anë të Frymës nëpërmjet veprës së Mesisë (të Vajosurit).

Supozimi teologjik i zbulësës përparuese është i nevojshëm për shkak se autorët e DhR e modifikojnë disi pritshmërinë e Izraelit. Në vend të një ardhjeje ushtarake dhe nacionaliste (izraelite) të Mesisë, ka dy ardhje. Ardhja e parë është mishërimi i hyjnishë në ngjizjen dhe lindjen e Jezusit të Nazaretit. Ai erdhi si

“shërbëtor i përvuajtur” jo ushtarak, jo gjyqësor, i Isa. 53; po kështu, ai erdhi si kalorësi i përlulur mbi kërricin e një gomari (jo një kali lufte apo mushke mbretërore) i Zak. 9:9. Ardhja e parë inauguroi Epokën e Re Mesianike, mbretërinë e Perëndisë në tokë. Në një kuptim, mbretëria është këtu, por, sigurisht, në një kuptim tjetër, është ende larg. Pikërisht ky tension midis dy ardhjeve të Mesisë, në njëfarë kuptimi, është mbivendosja e dy epokave judaike që ishin të paparë, ose të paktën të paqarta, në DhR. Në të vërtetë, kjo ardhje e dyfishtë thekson përkushtimin e JHVH-së për të shpenguar gjithë njerëzimin (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5 dhe predikimin e profetëve, veçanërisht Isaisë dhe Jonës).

Kisha nuk po pret përmëshjen e profecisë së DhV, sepse shumica e profecive kanë të bëjnë me ardhjen e parë (shih *Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka*, f. 165-166). Ajo që presin besimtarët është ardhja e lavdishme e të ringjallurit Mbret mbi Mbretër dhe Zot mbi Zotër, përmëshja e prituri historike e epokës së re të drejtësisë në tokë, ashtu si dhe në qiell (shih Mat. 6:10). Përshkrimet simbolike të DhV nuk ishin të pasakta, por të paplota. Ai do të vijë sërish, ashtu siç parathanë profetët me fuqinë dhe autoritetin e JHVH-së.

Ardhja e Dytë nuk është term biblik, por ky koncept është botëkuptimi dhe korniza e gjithë DhR. Perëndia do ta vërë gjithçka në vendin e vet. Bashkësia mes Perëndisë dhe njerëzimit të krijuar në shëmbëllimin e tij do të ripërtërihet. Ligësia do të gjykohej dhe shfaroset. Synimet e Perëndisë nuk mund (dhe nuk do të) dështojnë!

2:29 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim të mundshëm. Këtu, bën fjalë për një njohuri të supozuar që e kanë besimtarët, por që mësuesit e rremë s’e kanë kuptuar.

■ **“e dini”** Nga ana gramatikore, kjo është ose DËFTORE E TASHME VEPRORE, që shpreh një njohuri të vazhdueshme, ose URDHËRORE E TASHME VEPRORE, që bën fjalë për njohurinë e nevojshme të besimtarit. Përdorimi i “di/njoh” nga ana e Gjonit si diçka që e zotërojnë të gjithë ata që kanë Frymën na tregon se forma këtu është DËFTORE.

■ **“ai”** Bëhet fjalë për Jezusin (shih 2:1, 28; 3:7). Megjithatë, PËREMRI i fundit “lindur prej tij” duket se i referohet Perëndisë Atë pasi fraza “lindur prej Perëndisë” përdoret shumë shpesh (shih 3:9; 4:7; 5:1, 4, 18; Gjoni 1:13).

■ **“i drejtë... drejtësinë”** Ky është tipar i pritshëm familjar!

TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA

“Drejtësia” është temë kaq kyçe sa studiuesi i Biblës duhet të bëjë një studim të hollësishëm personal të këtij koncepti.

Në DhV, karakteri i Perëndisë përshkruhet si “i drejtë” (BDB 841). Vetë kjo fjalë mesopotamase vjen nga një kallam lumi, që përdorej si vegël ndërtimi për të gjykuar drejtësinë horizontale të mureve dhe gardheve. Perëndia e zgjodhi këtë term për ta përdorur në mënyrë metaforike për natyrën e vet. Ai është shkopi i drejtë (vizorja) me të cilin maten të gjitha gjërat. Ky koncept pohon edhe drejtësinë e Perëndisë, edhe të drejtën e tij për të gjykuar.

Njeriu u krijua në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; 5:1, 3; 9:6). Njerëzimi u krijua për miqësi me Perëndinë. Gjithë krijimi është skenë ose sfond për ndërveprimin e Perëndisë me njerëzimin. Perëndia donte që krijesa e tij më e lartë, njeriu, ta njihte, ta donte, t’i shërbente dhe të ishte si ai! Besnikëria e njerëzimit u vu në sprovë (shih Zanafilla 3) dhe çifti i parë dështoi. Kjo çoi në prishjen e marrëdhënies së Perëndisë me njerëzimin (shih Zanafilla 3; Rom. 5; 12-21).

Perëndia premtoi se do ta ndreqte dhe rimëkëmbte këtë bashkësi (shih Zan. 3:15). Ai e bën këtë me vullnetin e vet dhe me anë të Birit të vet. Njerëzit janë të paafët për ta ndrequr këtë çarje (shih Rom. 1:18-3:20).

Pas Rënies, hapi i parë i Perëndisë drejt ripërtëritjes së miqësisë është koncepti i besëlidhjes, i bazuar në ftesën e tij dhe në përgjigjen e njerëzimit me pendim, besim dhe bindje. Për shkak të Rënies, njerëzit s’janë të aftë që të kryejnë veprimin e duhur (shih Rom. 3:21-31; Galatasve 3). Vetë Perëndisë iu desh të merrte nismën për të rimëkëmbur njerëzit që thyen besëlidhjen. Ai e bëri këtë

1. duke e shpallur njerëzimin të drejtë përmes veprës së Krishtit (pra, drejtësia ligjore).
2. duke i dhënë lirisht njerëzimit një drejtësi me anë të veprës së Krishtit (pra, drejtësia e llogaritur).

3. duke siguruar Frymën brendabanues, i cili prodhon drejtësi (pra, ngjashmëria me Krishtin, rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë) në njerëzimin.

Gjithsesi, Perëndia kërkon një përgjigje ndaj besëlidhjes. Ai vendos (pra, jep lirisht) dhe siguron, por njerëzit duhet të përgjigjen dhe të vazhdojnë të përgjigjen me

1. pendim
2. besim
3. bindje në stilin e jetesës
4. qëndresë

Prandaj, drejtësia është një veprim reciprok i besëlidhjes mes Perëndisë dhe krijesës së tij më të larët. Ajo bazohet në karakterin e Perëndisë, veprën e Krishtit dhe aftësimin e Frymës, dhe çdo individ duhet t'i përgjigjet siç duhet, personalisht dhe vazhdimisht. Ky koncept quhet "shfajësim me anë të besimit". Ky koncept zbulohet në ungjijtë, por jo me këto fjalë. Në fillim, u përcaktua nga Pali, i cili e përdor termin greqisht "drejtësi" në forma të ndryshme mbi 100 herë.

Pali, si rabin i trajnuar, termin *dikaionē* e përdor në kuptimin e saj hebraik *SDQ*, të përdorur edhe nga Septuaginta, dhe jo nga literatura greke. Në shkrimet greke, kjo fjalë përdorej për dikë që përputhej me pritshmëritë e Hyjnës dhe shoqërisë. Në kuptimin e saj hebraik, kjo fjalë strukturohej gjithmonë në kuadër të besëlidhjes. JHVH është Perëndi i drejtë, etik dhe moral. Ai do që populli i tij të reflektojë karakterin e tij. Njerëzimi i shpenguar bëhet krijesë e re. Kjo risi çon në një stil të re jetese me perëndishmëri (fokusi katolik te shfajësimi). Meqë Izraeli ishte teokraci, nuk kishte dallim të qartë mes laikes (rregullave shoqërore) dhe së shenjtës (vullnetit të Perëndisë). Ky dallim shprehet duke i përkthyer fjalët hebraisht dhe greqisht në anglisht si "justice" (drejtësia që lidhet me shoqërinë) dhe "righteousness" (drejtësia që lidhet me fenë).

Ungjilli (lajmi i mirë) i Jezusit është se njerëzimi i rënë është rikthyer në bashkësi me Perëndinë. Kjo është arritur përmes dashurisë, mëshirës dhe hirit të Atit; jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Birit; dhe nxitjes e afrimit që na ka bërë Fryma me ungjillin. Shfajësimi është akt falas i Perëndisë, por duhet të çojë në perëndishmëri (pozicioni i Augustinit, i cili reflekton edhe theksin e reformacionit te natyra falas e ungjillit, por edhe theksin katolik për jetën e ndryshuar plot dashuri dhe besnikëri). Për reformatorët, termi "drejtësi e Perëndisë" është GJINORE KUNDRINORE (pra, akti që e bën njerëzimin e mëkatshëm të pranueshëm nga Perëndia [shenjtërimi pozicional]), ndërsa për katolikët është GJINORE KRYEFJALORE, që nënkupton procesin ku njeriu bëhet gjithnjë e më tepër si Perëndia [shenjtërimi përparues dhe i përjetuar]. Në të vërtetë, ajo është patjetër të dyja bashkë!).

Për mendimin tim, e gjithë Bibla, nga Zanafilla 4 deri te Zbulesa 20, tregon sesi Perëndia rimëkëmb miqësinë e Edenit. Bibla ia nis me miqësinë e Perëndisë me njerëzimin në një kontekst tokësor (shih Zanafilla 1-2) dhe e përfundon me të njëjtin kontekst (shih Zbulesa 21-22). Shëmbëllimi dhe qëllimi i Perëndisë do të rimëkëmbet!

Për të dokumentuar diskutimet e mësipërme, vini re pasazhet e mëposhtme, të përzgjedhura nga DhR, që ilustrojnë grupin e fjalëve greke.

1. Perëndia është i drejtë (shpesh lidhet me Perëndinë si Gjykatës)
 - a. Romakëve 3:26
 - b. 2 Thesalonikasve 1:5-6
 - c. 2 Timoteut 4:8
 - d. Zbulesa 16:5
2. Jezusi është i drejtë
 - a. Veprat 3:14; 7:52; 22:14 (titulli i Mesisë)
 - b. Mateu 27:19
 - c. 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7
3. Vullneti i Perëndisë për krijimin e vet është drejtësia
 - a. Levitiku 19:2
 - b. Mateu 5:48 (shih 5:17-20)
4. Mënyra e Perëndisë për të siguruar dhe prodhuar drejtësinë
 - a. Romakëve 3:21-31
 - b. Romakëve 4
 - c. Romakëve 5:6-11
 - d. Galatasve 3:6-14
 - e. Jepet nga Perëndia
 - 1) Romakëve 3:24; 6:23

- 2) 1 Korintasve 1:30
- 3) Efesianëve 2:8-9
- f. Merret me anë të besimit
 - 1) Romakëve 1:17; 3:22, 26; 4:3, 5, 13; 9:30; 10:4, 6, 10
 - 2) 2 Korintasve 5:7, 21
- g. Përmes veprave të Birit
 - 1) Romakëve 5:21
 - 2) 2 Korintasve 5:21
 - 3) Filipianëve 2:6-11
5. Vullneti i Perëndisë është që ndjekësit e tij të jenë të drejtë
 - a. Mateu 5:3-48; 7:24-27
 - b. Romakëve 2:13; 5:1-5; 6:1-23
 - c. 1 Timoteut 6:11
 - d. 2 Timoteut 2:22; 3:16
 - e. 1 Gjonit 3:7
 - f. 1 Pjetrit 2:24
6. Perëndia do ta gjykojë botën me drejtësi
 - a. Veprat 17:31
 - b. 2 Timoteut 4:8

Drejtësia është karakteristikë e Perëndisë, dhe i jepet lirisht njerëzimit të mëkatshëm me anë të Krishtit.

Ajo është

1. vendim i Perëndisë
2. dhuratë e Perëndisë
3. akt i Krishtit

Por ajo është edhe proces i të bërit i drejtë; ky proces duhet ndjekur me forcë dhe këmbëngulje dhe do të përmbushet një ditë, në Ardhjen e Dytë. Bashkësia me Perëndinë rikthehet në çastin e shpëtimit, por përparon gjatë gjithë jetës dhe bëhet takim ballë përballë në çastin e vdekjes, ose në *Parousia*!

Ja një citim i duhur për ta përmyllur këtë diskutim. Është marrë nga *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalori i Palit dhe letrave të tij], nga IVP:

“Kalvini, shumë më tepër se Luteri, thekson aspektin e marrëdhënies të drejtësisë së Perëndisë. Pikëpamja e Luterit për drejtësinë e Perëndisë duket se përmban aspektin e deklarimit të pafajësisë. Kalvini thekson natyrën e mrekullueshme të komunikimit ose përçimit të drejtësisë së Perëndisë te ne” (f. 834).

Për mua, marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë ka tre aspekte.

1. ungjilli është person (theksi i kishës lindore dhe Kalvinit)
2. ungjilli është e vërtetë (theksi i Augustinit dhe Luterit)
3. ungjilli është jetë e ndryshuar (theksi katolik)

Këto janë të tria të vërteta dhe duhen mbajtur të bashkuara për të patur një krishterim të shëndetshëm, të shëndoshë dhe biblik. Nëse ndonjëra prej tyre mbithekskohet ose nënvlerësohet, shfaqen probleme.

Duhet ta mirëpresim Jezusin!

Duhet t’i besojmë ungjillit!

Duhet të ndjekim ngjashmërinë me Krishtin!

■ **“lindur”** Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE, që nënkupton një gjendje të qëndrueshme, e shkakuar nga një veprues i jashtëm. Perëndia Atë (shih Gjoni 3:3). Vini re përdorimin e një metafore tjetër familjare (shih 3:9) për të përshkruar krishterimin (si familje). Shih shënimin në 3:1d.

3:1 “Shihni, sa dashuri të madhe” Fjalët që përdoren këtu (dhe në gjithë 1 Gjonin) për dashurinë janë *agapaō* (FOLJE) ose *agapē* (EMËR; shih 2:5, 15; 3:1, 16, 17; 4:7, 8, 9, 10, 12, 16, 17, 18; 5:3). Kjo fjalë përdorej edhe në greqishten klasike, por jo shpesh. Duket se kisha e hershme e ripërcaktoi në dritën e ungjillit. Nga ana kuptimore, përfaqëson dashurinë e thellë dhe të qëndrueshme. S’është e drejtë të themi e ajo simbolizon “një lloj dashurie vetëmohuese që i ngjan Perëndisë”, sepse në ungjillin e Gjonit kjo fjalë përdoret në mënyrë sinonimike me *fileō* (Gjoni 5:20; 11:3, 36; 12:25; 15:19; 16:27; 20:2; 21:15, 16, 17). Megjithatë, është interesante se (te 1 Gjoni) ajo

përdoret gjithmonë në lidhje me dashurinë e besimtarit për besimtarin. Besimi dhe bashkësia me Jezusin na e ndryshon marrëdhënien me Perëndinë dhe njerëzimin!

■ **“na ka falur Ati”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORË. Përdorimi i kësaj KOHE në lidhje me dhuratën e shpëtimit të Perëndisë në Krishtin është një bazë biblike për doktrinën e sigurisë së besimtarit (shih Gjoni 6:35-40; 10:1 e më tej; Efe. 2:5, 8; 5:1). Shih Temën e Veçantë: Siguria e të krishterit, në Gjoni 6:37.

TEMË E VEÇANTË: TË DHËNA TË DH.R. PËR SHPËTIMIN PERSONAL

Bazohet në Besëlidhjen e Re (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) në Jezusin:

1. në karakterin e Atit (shih Gjoni 3:16), veprën e Frymës (shih 2 Kor. 5:21) dhe shërbesën e Frymës (shih Rom. 8:14-16), jo në përpjekjet njerëzore, as në shpërblimin për shkak të bindjes, as në kredot
2. është dhuratë (shih Rom. 3:24; 6:23; Efe. 2:5, 8-9)
3. është jetë e re, botëkuptim i ri (shih Jakobi dhe 1 Gjonit)
4. është njohuri (ungjilli), bashkësi (besimi në dhe me Jezusin) dhe stil i ri jetese (ngjashmëri me Krishtin, nën udhëheqjen e Frymës); të tria së bashku, jo njëra në dallim nga të tjerat
5. Shih provat e shpëtimit të vërtetë në Mësimet Kontekstuale në 1 Gjonit 2:3-27, C.

■ **“që të quhemi”** Kjo është LIDHORE AORISTE PËSORE, që përdoret në kuptimin e një titulli nderi (“fëmijë të Perëndisë”) që jep Perëndia.

■ **“fëmijë të Perëndisë”** Ky është fokusi i 2:29-3:10. Kjo pohon nismën e Perëndisë në shpëtimin tonë (shih Gjoni 6:44, 65). Gjoni përdor fjalë familjare për të përshkruar marrëdhënien e re të besimtarit me Perëndinë (shih 2:29; 3:1, 2, 9, 10; Gjoni 1:12).

Është interesante se Gjoni (shih Gjoni 3:3) dhe Pjetri (shih 1 Pje. 1:3, 23) përdorin metaforën familjare “të rilindur” ose “të lindur nga lart”, ndërsa Pali përdor metaforën familjare të “birësimit” (shih Rom. 8:15, 23; 9:4; Gal. 4:1-5; Efe. 1:5), ndërsa Jakobi përdorë metaforën familjare të “lindjes” (shih Jakobi 1:18), ose “aktit të lindjes” për të përshkruar marrëdhënien e re të besimtarit me Perëndinë përmes Krishtit. Krishterimi është familje.

■ **“dhe të tillë jemi”** Kjo është DËFTORE E TASHME. Kjo frazë nuk gjendet në versionin King Xhejms të Biblës, pasi nuk përfshihet në dorëshkrimet e mëvonshme greke (pra, K dhe L), mbi të cilat bazohet KJV. Megjithatë, kjo frazë shfaqet në një sërë dorëshkrimesh greke nga më të lashtat (P⁴⁷, א, A, B dhe C). UBS⁴ i jep përfshirjes së saj vlerësimin “A” (e sigurt). Shih Shtojcën 2 për Kritikën e Tekstit.

■ **“bota nuk na njeh”** Fjala “botë” përdoret në mënyrë të ngjashme teologjike edhe në 2:15-17. Bota nënkupton shoqërinë njerëzore, të organizuar dhe duke funksionuar veçmas Perëndisë (shih Gjoni 15:18-19; 17:14-15). Përndjekja dhe refuzimi nga bota është tjetër provë e pozicionit tonë në Krishtin (shih Mat. 5:10-16).

■ **“sepse nuk e njeh atë”** Me sa duket, këtu bëhet fjalë për Perëndinë Atë, sepse në ungjillin e Gjonit Jezusi thotë vazhdimisht se bota nuk e njeh (shih Gjoni 8:19, 55; 15:18, 21; 16:3). PËREMRAAT në 1 Gjonit janë të paqartë (shih shënimin në 2:28). Në këtë kontekst, paraprijësi nga ana gramatikore është Ati, por referenti teologjik në v. 2 është Biri. Gjithsesi, në Gjonin, kjo mund të jetë vagulli e qëllimshme pasi, kur shohim Jezusin, shohim Atin (shih Gjoni 12:45; 14:9).

3:2 “nuk është shfaqur ende çfarë do të jemi” Kjo bën fjalë për paaftësinë e Gjonit për të përshkruar këto ngjarje të kohëve të fundit (shih Veprat 1:7), ose natyrën e saktë të trupit të ringjallur (shih 1 Kor. 15:35-49). Po kështu, kjo tregon se 2:27 nuk nënkupton njohuri shteruese në çdo fushë. Edhe njohuria e Jezusit për këtë ngjarje ishte e kufizuar gjatë kohës që ishte i mishëruar (shih Mat. 24:36; Marku 13:22).

■ **“kur ai të shfaqet”** Fjala “kur” prezanton një FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË. Këtu, përdoret jo për të vënë në dyshim Ardhjen e Dytë, por për të shprehur datën e saj të panjohur. Ndonëse thekson shpëtimin e plotë tani, Gjoni pret edhe Ardhjen e Dytë.

■ **“do të jemi si ai”** Bëhet fjalë për çastin kur do të bëhemi plotësisht si Krishti (shih 2 Kor. 3:18; Efe. 4:13; Fil. 3:21; dhe Kol. 3:4). Shpesh, ky quhet “përlëvdim” (shih Rom. 8:28-30). Kjo është pika kulmore e shpëtimit tonë! Ky transformim eskatologjik lidhet me rikthimin e plotë të shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzit e krijuar në ngjashmërinë e tij (shih Zan. 1:26; 5:1, 3; 9:6). Bashkësia e ngushtë me Perëndinë është sërish e mundshme!

■ **“sepse do ta shohim ashtu siç është”** Jobi mezi priste të shihte Perëndinë (shih Jobi 19:25-27). Jezusi na tha se të pastrit në zemër do të shohin Perëndinë (shih Mat. 5:8). Të shohësh Perëndinë në plotësinë e tij do të thotë të ndryshohemi në ngjashmërinë e tij (shih 1 Kor. 13:12). Kjo i referohet përlëvdimit të besimtarit (shih Rom. 8:29) në Ardhjen e Dytë. Nëse “shfajësimi” do të thotë liri nga ndëshkimi mëkatit dhe “shenjtërimi” do të thotë liri nga pushteti i mëkatit, atëherë “përlëvdimi” do të thotë liri nga prania e mëkatit!

3:3 “kushdo” Fjala greke *pas* shfaqet shtatë herë nga 2:29 te 3:10. Nuk ka përjashtime. Gjoni e paraqet të vërtetën me kategori të prera, bardhezi. Njeriu është, ose fëmijë i Perëndisë, ose fëmijë i Satanit (shih 2:29; 3:3, 4, 6 [dy herë], 9, 10).

■ **“këtë shpresë”** Te Pali, kjo fjalë shpesh i referohet Ditës së Ringjalljes (shih Veprat 23:6; 24:15; 26:6-7; Rom. 8:20-25; 1 Thes. 2:19; Titit 2:13; 1 Pje. 1:3, 21). Ajo shpreh sigurinë e ngjarjes, por me një element të paqartë kohor.

Gjoni nuk flet për “shpresën” e Ardhjes së Dytë aq shpesh sa autorët e tjerë të DhR. Ky është i vetmi përdorim i këtij termi në shkrimet e tij. Ai përqendrohet në dobitë dhe detyrimet e “qëndrimit” në Krishtin tani! Megjithatë, nuk po themi se Gjoni nuk pret gjykimin e ligësisë në kohët e fundit (shih 2:18), si dhe përlëvdimin e besimtarit në fund të kohës (shih 3:1-3).

■ **“e pastron veten, ashtu siç është dhe ai i pastër”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Pastërtia është e rëndësishme (shih Mat. 5:8, 48). Ne duhet të bashkëpunojmë në procesin e shenjtërimit (shih 2 Kor. 7:1; Jakobi 4:8; 1 Pje. 1:22; 2 Pje. 3:13, 14), ashtu si Gjoni 1:12 flet për bashkëpunimin tonë në procesin e shfajësimit. Po ky tension midis pjesës së Perëndisë (sovrانيتi i tij) në shpëtimin tonë dhe pjesës sonë (vullneti i lirë njerëzor) mund të shihet qartë kur krahasojmë Ezek. 18:31 me 36:26-27. Perëndia merr gjithmonë nismën (shih Gjoni 6:44, 65), por kërkon që populli i besëlidhjes të përgjigjet me pendim dhe besim fillestar, si dhe me pendim, besim, bindje, shërbim, adhurim dhe qëndresë të vazhdueshme.

Ky mund të jetë aludim për lutjen kryepriftërore të Jezusit në Gjoni 17, veçanërisht v. 17, 19. Ai shenjtëron veten, ndërsa ndjekësit e tij shenjtërojnë veten e tyre. Është disi e habitshme që përdoren forma të ndryshme të së njëjtës rrënjë fjale bazë.

1. Gjoni 17:17, 19 – *hagiazō* (*hagios*, shih Gjoni 10:36)
2. 1 Gjonit 3:3 – *hagnizō* (*hagnos*, shih Gjoni 11:55)

MËSIMET KONTEKSTUALE PËR 3:4-10

- A. Ky pasazh ka qenë qendra e polemikës midis perfeksionizmit të krishterë (shih Romakëve 6; nganjëherë, i quajtur “shenjtërimi i plotë”) dhe mëkatimit të vazhdueshëm të krishterë (shih Romakëve 7).
- B. Nuk duhet t’i lejojmë anësisë sonë teologjike që të ndikojë në eksegjezën që i bëjmë këtij pasazhi. Po kështu, nuk duhet t’u lejojmë pasazheve të tjera që të ndikojnë në këtë pasazh derisa ta kemi përfunduar në mënyrë të pavarur studimin e këtij pasazhi dhe derisa të jemi siguruar për atë që po thoshte Gjoni, si në kapitullin 3, ashtu dhe në gjithë librin e 1 Gjonit!
- C. Ky pasazh paraqet qartë synimin që mezi presin të gjithë besimtarët: çlirimin e plotë nga mëkati. Ky ideal paraqitet edhe në Romakëve 6. Me anë të fuqisë së Krishtit, ne kemi potencialin e jetesës së pamëkatë.
- D. Sidoqoftë, ky pasazh duhet të përputhet me kontekstin më të gjerë të gjithë librit të 1 Gjonit.
 1. Do të ishte marrëzi ta interpretonim këtë pasazh në lidhje me 1:8-2:22 (të krishterët mëkatojnë ende).
 2. Marrëzi do të ishte edhe po ta interpretonim këtë pasazh në një mënyrë që hedh poshtë qëllimin e plotë të 1 Gjonit: siguria e shpëtimit kundër pretendimeve të mësuesve të rremë.
 3. Ky pasazh duhet të lidhet me pretendimet e mësuesve të rremë se ishin të pamëkatë, ose se mëkati s’kishte rëndësi. Ndoshta 1:8-2:2 merret me njërin ekstrem të mësuesve të rremë, ndërsa 3:1-10

merret me tjetrin. Mos harroni se interpretimi i letrave të DhR është si të dëgjosh njëren anë të bisedës telefonike.

- E. Midis këtyre dy pasazheve ekziston një marrëdhënie paradoksale. Mëkati në jetën e të krishterit është problem i përsëritur në DhR (shih Romakëve 7). Kjo përbën të njëjtin tension dialektik si ai midis paracaktimit dhe vullnetit të lirë, ose sigurisë dhe qëndresës. Paradoksi na siguron një drejtpeshim teologjik dhe sulmon pozicionet ekstreme. Mësuesit e rremë po paraqisnin dy gabime në zonën e mëkatit.
- F. Gjithë ky diskutim teologjik bazohet në keqkuptimin e dallimit mes
1. Pozicionit tonë në Krishtin
 2. Përpjekjes sonë për ta përmbushur atë pozicion në mënyrë të përjetuar në jetën e përditshme
 3. Premtimi se fitorja do të jetë e jona një ditë!
Ne jemi të lirë nga ndëshkimi i mëkatit (shfajësimi) në Krishtin, por ende përleshemi me fuqinë e tij (shenjtërimi i përshkallëzuar) dhe, një ditë, do të jemi të lirë nga prania e tij (përlëvdimi). Ky libër, në tërësi, mëson përparësinë e rrëfimit të mëkatit dhe përpjekjes për të ecur drejt pamëkatshmërisë.
- G. Një tjetër alternativë vjen nga dualizmi letrar i Gjonit. Ai shkroi me kategori bardhezi (që gjenden edhe në Pergamenat e Detit të Vdekur). Për të, njeriu ishte ose në Krishtin dhe, si rrjedhojë, i drejtë, ose në Satanin dhe, si rrjedhojë, mëkatar. Nuk kishte kategori të tretë. Kjo shërben si “alarm zgjimi” kundër krishterimit periferik, kulturor, me kohë të pjesshme, vetëm për funerale dhe vetëm për Pashkë!
- H. Disa referenca për këtë temë të vështirë:
1. Për shtatë interpretimet tradicionale të këtij pasazhi, shih “Letrat e Gjonit” në *The Tyndale New Testament Commentaries [Komentarët e Dhiatës së Re Tyndale]*, nga John R. W. Stott, botuar nga Eerdmans (f. 130-136).
 2. Për një trajtim të saktë të pozicionit të “përsosmërisë”, shih *Christian Theology [Teologji e krishterë]*, vëll. 2, f. 440 e më tej, nga H. Orton Willie, botuar nga Beacon Hill Press.
 3. Për një trajtim të saktë të doktrinës së mëkatit të vazhdueshëm në jetën e të krishterit, shih “Perfeksionizmi”, nga B. B. Warfield, botuar nga The Presbyterian and Reformed Published Company.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:4-10

⁴Kushdo që praktikon mëkatin, praktikon dhe paligjshmërinë; dhe mëkati është paligjshmëri. ⁵Ju e dini se ai u shfaq për të hequr mëkatet; dhe në të nuk ka mëkat. ⁶Askush që qëndron në të nuk mëkaton; askush që mëkaton nuk e ka parë atë, as nuk e njeh atë. ⁷Fëmijë të vegjël, sigurohuni që askush të mos ju mashtrorë; ai që praktikon drejtësinë është i drejtë, siç është dhe ai i drejtë; ⁸ai që praktikon mëkatin është nga djalli; sepse djalli ka mëkatuar që nga fillimi. Biri i Perëndisë u shfaq për këtë qëllim: që të shkatërronte veprat e djallit. ⁹Kushdo që ka lindur nga Perëndia nuk praktikon mëkatin, sepse fara e tij qëndron në të; dhe s'mund të mëkatojë, sepse ka lindur nga Perëndia. ¹⁰Nga kjo dalin në pah fëmijët e Perëndisë dhe fëmijët e djallit; kushdo që nuk praktikon drejtësinë, nuk është nga Perëndia; as ai që nuk do të vëllanë.

3:4

NASB “Kushdo që praktikon mëkatin, praktikon dhe paligjshmërinë”

NKJV “Kushdo që kryen mëkat, kryen dhe paligjshmëri”

NRSV “Kushdo që kryen mëkat, është fajtor për paligjshmëri”

TEV “Kushdo që mëkaton është fajtor për shkeljen e ligjit të Perëndisë”

NJB “Kushdo që mëkaton, vepron me ligësi”

PËREMRI “kushdo” vihet përpara këtu dhe në v. 6. Ky kontekst flet për gjithë njerëzimin!

Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE dhe DËFTORE E TASHME VEPRORE. Është domethënëse fakti se këto FOLJE NË KOHËN E TASHME theksojnë veprime zakonore, të vazhdueshme, të lidhura me stilin e jetesës, në dallim nga LIDHORE AORISTE VEPRORE në 2:1-2. Megjithatë, problemi

teologjik i këtij pasazhi (krahaso me 1:7-10 dhe 3:6-9) nuk mund të zgjidhet plotësisht me një KOHË FOLJEJE. Ai zgjidhet nga konteksti historik i dy llojeve të mësuesve të rremë gnostikë dhe nga konteksti i plotë i librit.

Një tjetër tipar dallues i këtij pasazhi është përdorimi i termit “paligjshmëri”. Kjo nuk bën fjalë për thyerjen e ndonjë ligji (ligjit të Moisiut apo rregullave shoqërore), por më tepër ka të bëjë me një qëndrim rebelimi. E njëjta fjalë përdoret për të përshkruar edhe Antikrishtin në 2 Thes. 2:3, 7. Ndoshta, ky është një përcaktim më i plotë i mëkatit (shih Gjoni 9:41; Rom. 14:23; Jakobi 4:17; 1 Gjonit 5:17), e kundërta e ngjashmërisë me Krishtin (shih v. 5), dhe jo thjesht shkelja e një rregulli ose standardi të caktuar.

3:5 “Ai u shfaq” Kjo është DËFTORE AORISTE PËSORE, që bën fjalë për mishërimin e Jezusit (shih v. 8; 2 Tim. 1:10). E njëjta FOLJE, *faneroō*, përdoret dy herë në v. 2 për Ardhjen e tij të Dytë. Së pari, ai erdhi si shpëtimtar (shih Marku 10:45; Gjoni 3:16; 2 Kor. 5:21), por do të kthehet si Përmbushës! Në komentarin e tij, *The Letters of John [Letrat e Gjonit]*, një nga mësuesit e mi të preferuar, Bill Hendricks tha:

“Dy nga thëniet më depërtuese për të kuptuar synimin e ardhjes së Krishtit gjenden në këtë varg dhe në vargun 8. Ai u dërgua nga Perëndia për të larguar mëkatet (3:5), dhe ai u zbulua për të shkatërruar veprat e djallit (3:8). Gjetkë, Luka vëren se synimi i ardhjes së Jezusit ishte që të kërkonte dhe të shpëtonte ata që janë të humbur (Luka 19:10). Ungjilli i Gjonit thotë se Jezusi erdhi që delet e tij të mund të kenë jetë me bollëk (Gjoni 10:10). Mateu e nënkuptoi qëllimin e ardhjes së Jezusit në interpretimin që i bëri emrit Jezus: ai do të shpëtojë popullin e vet nga mëkatet (Mat. 1:21). Fakti bazë në të gjitha këto shprehje është se Jezu Krishti ka bërë për njeriun diçka që njeriu s’mund ta bënte dot për vete” (f. 79-80).

▣ **“për të hequr mëkatet”** Kjo është LIDHORE AORISTE. Veprimi varet nga përgjigjja njerëzore (pra, pendimi dhe besimi). Sfondi i kësaj thënieje lidhet me dy burime të mundshme.

1. Dita e Shlyerjes (shih Levitiku 16), ku një nga dy cjeptë e merrnin simbolikisht me vete mëkatet duke e larguar nga kampi i Izraelit (shih përdorimi i Gjon Pagëzorit, në Gjoni 1:29)
2. Një referencë e asaj që bëri Jezusi në kryq (shih Isa. 53:11-12; Gjoni 1:29; Heb. 9:28; 1 Pje. 2:24)

▣ **“dhe në të nuk ka mëkat”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Pamëkatshmëria e Jezu Krishtit (shih Gjoni 8:46; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 1:19; 2:22) është baza për shlyerjen e tij zëvendësuese për hirin tonë (Isaia 53).

Vini re se “mëkat” është në SHUMËS në pjesën e parë të v. 5, por në NJËJËS në këtë pjesë të dytë. E para merret me veprimet e mëkatit, ndërsa e dyta, me karakterin e drejtë të Krishtit. Synimi është që besimtarët të marrin pjesë edhe në shenjtërimin pozicional, edhe në shenjtërimin e përshkallëzuar, të Krishtit. Mëkati është një gjë e huaj për Krishtin dhe për ndjekësit e tij.

TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIMI

DhR pohon se, kur mëkatarët kthehen te Jezusi me pendim dhe besim, shfajësohen aty për aty dhe shenjtërohen. Ky është pozicioni i tyre i ri në Krishtin. Drejtësia e tij u është llogaritur atyre (shih Romakëve 4). Ata shpallen të drejtë dhe të shenjtë (akt ligjor i Perëndisë).

Por, gjithashtu, DhR u bën thirrje besimtarëve për shenjtëri, ose shenjtërim. Ky është edhe pozicion teologjik në bazë të veprës së përfunduar të Jezu Krishtit, edhe thirrje për të qenë si Krishti në qëndrim dhe në veprime në jetën e përditshme. Ashtu si shpëtimi është dhuratë falas dhe stil jetese që të kushton gjithçka, kështu ndodh dhe me shenjtërimin.

Përgjigjja fillestare

Veprat 26:18
Romakëve 15:16
1 Korintasve 1:2-3; 6:11
2 Thesalonikasve 2:13
Hebrenjve 2:11; 10:10, 14; 13:12
1 Pjetrit 1:12

Ngjashmëria gjithnjë e më madhe me Krishtin

Romakëve 6:19
2 Korintasve 7:1
Efesianëve 1:4; 2:10
1 Thesalonikasve 3:13; 4:3-4, 7; 5:23
1 Timoteut 2:15
2 Timoteut 2:21
Hebrenjve 12:14
1 Pjetrit 1:15-16

3:6 “Askush që qëndron në të nuk mëkaton” Ashtu si 3:4, edhe kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE dhe DËFTORE E TASHME VEPRORE. Ky pasazh duhet vënë në kontrast me 1:8-2:2 dhe 5:16.

▣ **“askush që mëkaton nuk e ka parë atë, as nuk e njih atë”** Ky varg ka një PJESORE TË TASHME VEPRORE, të ndjekur nga dy DËFTORE TË KRYERA VEPRORE. Mëkatimi i vazhdueshëm dhe i hapur demonstroi se personi nuk e njih Krishtin dhe nuk e ka njohur kurrë atë. Të krishterët që mëkatojnë

1. pengojnë misionin e Krishtit
2. pengojnë synimin e ngjashmërisë me Krishtin
3. zbulojnë origjinën shpirtërore të atij individi (shih Gjoni 8:44)

3:7 “sigurohuni që askush të mos ju mashtrojë” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE me një PJESËZ MOHORE, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Prania e mësuesve të rremë (shih 2:26) përcakton situatën historike për të kuptuar siç duhet nga ana teologjike 1 Gjonin në tërësi dhe vargjet 1:7-10 dhe 3:4-10 në veçanti.

▣ **“ai që praktikon drejtësinë është i drejtë”** Ky varg nuk mund të izolohet nga konteksti i përgjithshëm dhe të përdoret për të përkratur apo për të goditur një pozicion doktrinor të caktuar (“drejtësia me anë të veprave”). DhR është e qartë se qeniet njerëzore nuk i afrohen dot Perëndisë së Shenjtë me meritat e tyre personale. Njerëzit nuk shpëtohen dot nga përpjekjet vetjake. Gjithsesi, njerëzit duhet t’i përgjigjen ofertës së shpëtimit të Perëndisë me anë të veprës së përfunduar të Krishtit. Përpjekjet tona nuk na çojnë te Perëndia. Gjithsesi, demonstrojnë se jemi takuar me të. Ato na zbulojnë qartë gjendjen shpirtërore (shih Zbu. 22:11) dhe pjekurinë pas shpëtimit. Ne nuk shpëtohemi “me anë të” veprave të mira, por “për” vepra të mira. Synimi i dhuratës falas të Perëndisë është një ndjekës që i ngjason Krishtit (shih Efe. 2:8-9, 10). Vullneti absolut i Perëndisë për çdo besimtar nuk është thjesht qielli pas vdekjes (shfajësimi ligjor), por ngjashmëria me Krishtin (shenjtërimi kohor) tani (shih Mat. 5:48; Rom. 8:28-29; Gal. 4:19)! Për një studim të fjalës drejtësi, shih Temën e Veçantë në 2:29.

3:8 “ai që praktikon mëkatin është nga djalli” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Fëmijët e Perëndisë njihen nga mënyra si jetojnë; edhe fëmijët e Satanit (shih 3:10; Mat. 7:13; Efe. 2:1-3).

▣ **“sepse djalli ka mëkatuar që nga fillimi”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Djalli vazhdon të mëkatojë që nga fillimi (shih Gjoni 8:44). A i referohet kjo krijimit, apo rebelimit të engjëjve?

Teologjikisht, është e vështirë të përcaktohet se kur mëkatoi Satani kundër Perëndisë. Jobi 1-2; Zakaria 3 dhe 1 Mbretërve 22:19-23 duket se tregojnë se Satani është shërbëtor i Perëndisë dhe një nga këshilltarët engjëjlore. Ka gjasë (por s’besoj se është e mundur) që krenaria, arroganca dhe ambicia e mbretërve lindorë (të Babilonisë, Isa. 14:13-14, ose Tirit, Ezek. 28:12-16) përdoren për të shprehur rebelimin e Satanit (me sa duket, ai ishte kerubin mbulues, Ezek. 28:14, 16). Sidoqoftë, në Luka 10:18, Jezusi tha se pa Satanin të rrëzohej nga qielli si vetëtimë, por nuk na thotë saktësisht se kur. Origjina dhe zhvillimi i ligësisë duhet të mbetet diçka e paqartë për shkak të mungesës së zbulimit. Ruhuni që të mos sistematizoni dhe dogmatizoni pasazhe të izoluara, të paqarta dhe të figurshme! Diskutimi më i mirë për zhvillimin që i bën DhV Satanit nga shërbëtor në armik të urreyer është libri i A. B. Davidson, *Old Testament Theology [Teologji e Dhiatës së Vjetër]*, botuar nga T & T Clark, f. 300-306. Shih Temën e Veçantë: Ligësia Personale në Gjoni 12:31.

▣ **“Biri i Perëndisë”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: BIRI I PERËNDISË

Ky është një nga titujt kryesorë në DhR për Jezusin. Pa dyshim që ka ngjyime hyjnore. Ajo e përfshinte Jezusin si “Biri”, ose si “Biri im”, dhe Perëndisë i drejtohet me termin “Atë”. Në DhR shfaqet mbi 124 herë. Edhe vetëpërcaktimi si “Bir i Njeriut” ka ngjyrim hyjnor nga Dan. 7:13-14.

Në DhV, termi “bir” mund t’u referohet katër grupeve të veçanta.

1. engjëjve (zakonisht, në SHUMËS, shih Zan. 6:2; Jobi 1:6; 2:1)
2. Mbreti i Izraelit (shih 2 Sam. 7:14; Psa. 2:7; 89:26-27)
3. kombi i Izraelit në tërësi (shih Eks. 4:22-23; LiP. 14:1; Os. 11:1; Mal. 2:10)
4. gjykatësit e Izraelit (shih Psa. 82:6)

Ajo që lidhet me Jezusin është faza e dytë. Në këtë mënyrë, “biri i Davidit” dhe “biri i Perëndisë” lidhen me 2 Samuelin 7; Psalmi 2 dhe 89. Në DhV, “biri i Perëndisë” nuk përdoret kurrë në mënyrë të veçantë për Mesinë, përveç si mbreti eskatologjik, si një nga “ofiçet e vajosura” të Izraelit. Sidoqoftë, në Pergamenat e Detit të Vdekur, ky titull me ngjyime mesianike është i zakonshëm (shih referencat e veçanta në *Dictionary of Jesus and the Gospels [Fjalori i Jezusit dhe i ungjijve]*, f. 770). Po kështu, “Biri i Perëndisë” është titull mesianik në dy vepra judaike apokaliptike në periudhën ndërdhjatore (shih 2 Esdra 7:28; 13:32, 37, 52; 14:9 dhe 1 Enokut 105:2).

Sfondi i saj në DhR, kur përdoret për Jezusin, përmbledhet më së miri nga një sërë kategorish.

1. paraekzistenca e tij (shih Gjoni 1:1-18)
2. lindja e tij unike (e virgjër) (shih Mat. 1:23; Luka 1:31-35)
3. pagëzimi i tij (shih Mat. 3:17; Marku 1:11; Luka 3:22. Zëri i Perëndisë nga qielli bashkon mbretin mbretëror të Psalmi 2 me shërbëtorin e përvuajtur të Isaisë 53).
4. tundimi i tij mesianik (shih Mat. 4:1-11; Marku 1:12, 13; Luka 4:1-13). Ai tundohet për të vënë në dyshim natyrën e tij birnore, ose të paktën, që ta arrinte synimin e saj me mjete të ndryshme nga kryqi).
5. pranimiti i tij nga rrëfyes të papranueshëm
 - a. demonët (shih Marku 1:23-25; Luka 4:31-37, 41; Marku 3:11-12, 5:7)
 - b. jobesimtarët (shih Mat. 27:43; Marku 14:61; Gjoni 19:7)
6. pranimiti i tij nga dishepujt
 - a. Mat. 14:33; 16:16
 - b. Gjoni 1:34, 49; 6:69; 11:27
7. rrëfimi që ai dha për veten
 - a. Mateu 11:25-27
 - b. Gjoni 10:36
8. përdorimi nga ana e tij e metaforës familjare të Perëndisë si Atë
 - a. përdorimi i fjalës “abba” për Perëndinë
 - 1) Marku 14:36
 - 2) Romakëve 8:15
 - 3) Galatasve 4:6
 - b. përdorimi i përsëritur i fjalës Atë (*patēr*) për të përshkruar marrëdhënien e tij me Perëndinë

Si përmbledhje, titulli “Bir i Perëndisë” kishte kuptim të madh teologjik për ata që e njihnin DhV dhe premtimet e kategoritë e saj, por shkruesit e DhR ishin nervozë për ta përdorur këtë term me johebrenjtë, për shkak të sfondit të tyre pagan ku “perënditë” merrnin gra dhe fëmijët që lindnin prej tyre quheshin “titanë” ose “gjigantë”.

■ **“u shfaq”** Kjo është fjala greke *faneroō*, që do të thotë “nxjerr në dritë për të qartësuar”. Vargjet 5 dhe 8 janë paralele dhe e përdorin termin në FORMËN PËSORE, që flet për Krishtin si i zbuluar vërtet në mishërimin e tij (shih 1:2). Problemi i mësuesve të rremë nuk ishte se ungjillin e kishin të paqartë, por se kishin agjendën e tyre teologjike/filozofike.

■ **“për të shkatërruar veprat e djallit”** Qëllimi i shfaqjes së Jezusit në kohë dhe në mish ishte për të “shkatërruar” (LIDHORE AORISTE VEPRORE e *luō*), që do të thotë “lëshoj”, “zgjdh”, ose “shkatërroj”. Jezusi bëri pikërisht këtë në Kalvar, por njerëzit duhet t’i përgjigjen veprës së tij të përfunduar dhe dhuratës falas (shih Rom. 3:24; 6:23; Efe. 2:8) duke e pranuar Krishtin me besim (shih Gjoni 1:12; 3:16).

Tensioni “tashmë, por ende jo” i DhR lidhet edhe më shkatërrimin e ligësisë. Djalli është mposhtur, por është ende veprues në botë deri në përmbushjen e plotë të Mbretërisë së Perëndisë.

3:9 “kushdo që ka lindur nga Perëndia” Kjo është PJESORE E KRYER PËSORE (shih paralelen në v.9c; 2:29; dhe 5:18), që bën fjalë për një gjendje të qëndrueshme, e prodhuar nga një veprues i jashtëm (Perëndia).

■ **“praktikon mëkatën”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE, në dallim nga 2:1, ku përdoret dy herë LIDHORJA AORISTE PËSORE. Ka dy teori për domethënien e kësaj thënieje.

1. Ka të bëjë me mësuesit e rremë gnostikë, sidomos me atë grupim që e redukton shpëtimin në koncept intelektual, duke larguar në këtë mënyrë nevojën e një stili jetese moral
2. FOLJA E TASHME thekson veprimtarinë e vazhdueshme, zakonore dhe të mëkatshme (shih Rom. 6:1), jo akte të izoluara mëkati (shih Rom. 6:15)

Ky dallim teologjik ilustron edhe te Romakëve 6 (pamëkatshmëria e mundshme në Krishtin) dhe Romakëve 7 (beteja e vazhdueshme e besimtarit që mëkaton më pak).

Qasja historike #1 duket më e mira, por mbetet gjithsesi nevojja për ta zbatuar këtë të vërtetë sot, gjë që trajtohet nga #2. Ky varg i vështirë diskutohet më së miri në *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të vështira të Biblës], nga Walter Kaiser, Peter Davids, F. F. Bruce dhe Manfred Brauch, f. 736-739.

■ **“sepse fara e tij qëndron në të”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Ka patur një sërë teorish se çfarë saktësisht nënkupton fraza greke “fara e tij”

1. Augustini dhe Luteri thoshin se kjo është Fjala e Perëndisë (shih Luka 8:11; Gjoni 5:38; Jakobi 1:18; 1 Pje. 1:23)
2. Kalvini thoshte se bën fjalë për Frymën e Shenjtë (shih Gjoni 3:5, 6, 8; 1 Gjonit 3:24; 4:4, 13)
3. të tjerë thoshin se bëhet fjalë për Natyrën Hyjnore, ose për veten e re (shih 2 Pje. 1:4; Efe. 4:24)
4. ka gjasa që t’i referohet vetë Krishtit si “fara e Abrahamit” (shih Luka 1:55; Gjoni 8:33, 37; Gal. 3:16)
5. disa thonë se është sinonimike me frazën “lindur nga Perëndia”
6. me sa duket, ky ishte një term që përdorej nga gnostikët për të folur për shkëndijën hyjnore në çdo njeri

Numri 4 duket si mundësia më e mirë kontekstuale nga të gjitha të tjerat, por Gjoni e zgjodhi terminologjinë e vet për të hedhur poshtë proto-gnostikët (pra, #6)

3:10 Kjo është përmbledhje e v. 4-9. Përmban dy DËFTORE TË TASHME VEPRORE dhe dy PJESORE TË TASHME VEPRORE, që bëjnë fjalë për një veprim në kryerje e sipër. Teologjikisht, kjo është paralele me thënien e Jezusit në Predikimin në Mal (shih Mat. 7:16-20). Jeta zbulon zemrën e njeriut, orientimin e tij shpirtëror.

Kjo është paralelja negative e 2:29!

■ **“fëmijët e Perëndisë... fëmijët e djallit”** Kjo tregon sfondin semitik të Gjonit. Hebraishtja, si gjuhë e lashtë pa MBIEMRA, përdorte termin “fëmija i...” si mënyra për të përshkruar njerëzit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:11-12

¹¹Sepse ky është mesazhi që keni dëgjuar nga fillimi, që duhet ta duam njëri-tjetrit; ¹²jo si Kaini, i cili ishte nga i ligu dhe e vrau të vëllanë. Dhe për ç’arsye e vrau? Sepse veprat e tij ishin të liga, ndërsa ato të vëllait ishin të drejta.

3:11 “mesazhi” Kjo fjalë greqisht (*aggelia*, që zakonisht lexohet *angelia*) përdoret vetëm në 1 Gjonit 1:5 dhe 3:11. Përdorimi i parë duket se është doktrinor, ndërsa i dyti, etik. Kjo është në përputhje me ekuilibrin që vendos Gjoni midis këtyre dy aspekteve të krishterimit (shih 1:8, 10; 2:20, 24; 3:14).

■ **“keni dëgjuar nga fillimi”** Kjo frazë është mjet letrar që flet për Jezusin si Fjala e gjallë e Perëndisë (shih Gjoni 1:1) dhe si zbulues i Fjalës së Perëndisë (shih 1:1; 2:7, 13, 14, 24; 2 Gjonit 5, 6).

■ **“duhet ta duam njëri-tjetrit”** Kjo është prova me të cilën besimtarët e dinë se janë vërtet të shpenguar (shih v. 10, 14). Kjo reflekton fjalët e Jezusit (shih Gjoni 13:34-35; 15:12, 17; 1 Gjonit 3:23; 4:7-8, 11-12, 19-21).

3:21 “Kaini” Rrëfimi i jetës së Kainit regjistrohet në Zanafilla 4. Referenca e saktë është Zan. 4:4 (shih Heb. 11:4), ku ballafaqohen ofrimet e Kainit me ato të Abelit. Veprimet e Kainit zbulojnë ndikimin e rënies së njerëzimit (shih Zan. 4:7; 6:5, 11-12, 13b). Si në traditën judaike, ashtu dhe atë të krishterë (shih Heb. 11:4; Juda 11), Kaini është shembull i rebelimit të lig.

☐ **“i cili ishte nga i ligu”** Ky formim gramatikor mund të jetë MASHKULLOR NJËJËS (i ligu, v. 10), ose ASNJANËS NJËJËS (ligësia). Kjo vagulli gramatikore gjendet edhe te Mat. 5:37; 6:13; 13:19, 38; Gjoni 17:15; 2 Thes. 3:3; 1 Gjonit 2:13, 14; 3:12; dhe 5:18-19. Në një sërë rastesh, konteksti duket qartë se bën fjalë për Satanin (shih Mat. 5:37; 13:38; Gjoni 17:15).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:13-22

¹³Mos u habisni, vëllezër, nëse bota ju urren. ¹⁴Ne e dimë se kemi kaluar nga vdekja në jetë, pasi i duam vëllezërit. Ai që nuk do, qëndron në vdekje. ¹⁵Kushdo që urren vëllanë është vrasës; dhe ju e dini se asnjë vrasës nuk ka jetë përjetshme që të banojë brenda tij. ¹⁶Ne e njohim dashurinë nga kjo, se ai ka dhënë jetën e vet për ne; edhe ne duhet ta japim jetën për vëllezërit. ¹⁷Por kushdo që ka të mirat e kësaj bote, dhe sheh vëllanë në nevojë, por e mbyll zemrën ndaj tij, si banon dashuria e Perëndisë në të? ¹⁸Fëmijë të vegjël, le të mos duam me fjalë apo me gjuhë, por me vepra dhe me të vërtetë. ¹⁹Nga kjo do të dimë se i përkasim së vërtetës dhe do ta sigurojmë zemrën përpara tij ²⁰në çfarëdo gjë që zemra na dënon; sepse Perëndia është më i madh se zemra dhe njëj gjithçka. ²¹Të dashur, nëse zemra nuk na dënon, kemi siguri para Perëndisë; ²²dhe çfarëdo të kërkojmë, e marrim prej tij, sepse zbatojmë porositë e tij dhe bëjmë gjërat që i pëlqejnë atij.

3:13 “Mos u habisni” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZ MOHORE, që shpesh, nënkupton ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër (shih 1 Pje. 4:12-16). Kjo s’është botë e drejtë; nuk është bota që kishte ndërmend Perëndia

☐ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit ose për synimet e tij letrare.

☐ **“bota ju urren”** Ajo ka urreyer Jezusin; edhe ndjekësit e tij do t’i urrejë. Kjo është temë e përhapur në DhR (shih Gjoni 15:18; 17:14; Mat. 5:10-11; 2 Tim. 3:13) dhe një tjetër dëshmi se dikush është besimtar.

3:14 “e dimë” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE (*oida* ka formë TË KRYER, por kuptim TË TASHËM). Kjo është një tjetër temë e përhapur. Siguria e fëmijëve të Perëndisë lidhet me (1) një ndryshim mendjeje dhe (2) një ndryshim veprimesh, që janë kuptimet rrënjë të fjalës “pendohem” në greqisht dhe në hebraisht.

☐ **“kemi kaluar nga vdekja në jetë”** Kjo është një tjetër DËFTORE E KRYER VEPRORE (shih Gjoni 5:24). Një nga dëshmitë e kalimit nga vdekja në jetë (pra, siguria e të krishterit, shih Temën e Veçantë në Gjoni 6:37) është se duam njëri-tjetrin. Dëshmia tjetër është se bota na urren.

☐ **“pasi i duam vëllezërit”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. Dashuria është tipari kryesor i familjes së Perëndisë (shih Gjoni 13:34-35; 15:12, 17; 2 Gjonit 5; 1 Kor. 13; Gal. 5:22) sepse është karakteristikë e Perëndisë vetë (shih 4:7-21). Dashuria nuk është baza e marrëdhënies njerëzore me Perëndinë, por rezultat i saj. Dashuria nuk është baza e shpëtimit, por një tjetër dëshmi e tij.

☐ **“Ai që nuk do, qëndron në vdekje”** Kjo është PJESORE E TASHME, e përdorur si KRYEFJALË me një FOLJE DËFTORE TË TASHME VEPRORE. Ashtu si besimtarët vazhdojnë të qëndrojnë në dashuri, edhe jobsimtarët qëndrojnë në urrejtje. Urrejtja, ashtu si dashuria, është dëshmi e orientimit shpirtëror të njeriut. Mos harroni kategoritë e forta dhe dualiste të Gjonit: njeriu ose banon në dashuri, ose banon në vdekje. S’ka rrugë të mesme.

3:15 “Kushdo” Gjoni e ka përdorur 8 herë këtë term (*pas*) që nga 2:29. Domethënia e kësaj është se nuk ka përjashtime për ato që po thotë Gjoni. Ka vetëm dy lloje njerëzish: dashuruesit dhe urryesit. Gjoni e sheh botën bardhezi, pa ngjyra të ndërmjetme.

▣ **“Kushdo që urren vëllanë është vrasës”** Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE (pra, një urrejtje e vazhdueshme, që është bërë zakon). Mëkati shfaqet së pari në mendime. Në Predikimin në Mal, Jezusi mësoi se urrejtja është baras me vrasjen, ashtu si epshi është baras me kurorëshkeljen (shih Mat. 5:21-22).

▣ **“dhe ju e dini se asnjë vrasës nuk ka jetë të përjetshme që të banojë brenda tij”** Kjo nuk do të thotë se dikush që kryen vrasje s’ mund të jetë besimtar. Mëkati është i falshëm, por veprimet e stilit të jetesës zbulojnë zemrën. Këtu po thuhet se njeriu që e ka zakon urrejtjen s’ mund të jetë i krishterë. Dashuria dhe urrejtja e përjashtojnë njëra-tjetrën! Urrejtja merr jetë, ndërsa dashuria e jep jetën e vet.

3:16 “Ne e njohim” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Fjala greke në v. 15 është *oida*; këtu, është *ginōskō*. Ato përdoren si sinonime në shkrimet e Gjonit.

▣ **“dashurinë nga kjo”** Jezusi ka treguar shembullin absolut të natyrës së dashurisë. Besimtarët duhet të ndjekin shembullin e tij (shih 2 Kor. 5:14-15).

▣ **“ai ka dhënë jetën e vet për ne”** Kjo është KOHË AORISTE, që i referohet Kalvarit duke përdorur fjalët e vetë Jezusit (shih Gjoni 10:11, 15, 17, 18; 15:13).

▣ **“ne duhet”** Besimtarët detyrohen të ndjekin shembullin e Jezusit (shih 2:6; 4:11).

▣ **“ta japim jetën për vëllezërit”** Krishti është shembulli. Ashtu si ai ka dhënë jetën e vet për të tjerët, edhe të krishterët duhet ta japin jetën, nëse është e nevojshme, për vëllezërit. Vdekja ndaj egoizmit është

1. zmbropsje e Rënies
2. rikthim i shëmbëllimit të Perëndisë
3. jetesa për të mirën kolektive (shih 2 Kor. 5:14-15; Fil. 2:5-11; Gal. 2:20; 1 Pje. 2:21)

3:17 “Por kushdo që ka të mirat e kësaj bote, edhe sheh vëllanë në nevojë” Këto janë folje FOLJE TË TASHME LIDHORE. Dhënia e jetës në v. 16 tani vendoset në sferën e ndihmesës praktike të vëllait. Këto vargje ngjasojnë shumë me Jakobin (shih Jakobi 2:15-16).

▣ **“por e mbyll zemrën ndaj tij”** Kjo është LIDHORE AORISTE VEPRORE. Fjala “zemër” është fjalë për fjalë “të përbrendshmet”, një idiomë hebraishte që nënkupton ndjenjat. Sërish, veprimet tona zbulojnë Atin.

▣ **“dashuria e Perëndisë”** Sërish, kjo është GJINORE OBJEKTIVE, SUBJEKTIVE, apo qëllimisht e paqartë?

1. Dashuria për Perëndinë
2. Dashuria e Perëndisë për ne
3. Të dyja

Alternativa 3 përputhet me shkrimet e Gjonit!

3:18 “le të mos duam me fjalë apo me gjuhë” Veprimet flasin më fort se fjalët (shih Mat. 7:24; Jakobi 1:22-25; 2:14-26).

▣ **“por me vepra dhe me të vërtetë”** Fjala “e vërtetë” është e habitshme. Mund të prisnim një sinonim të “veprës”, si p.sh., “veprime”. Kjo fjalë duket se ka kuptimin “autentike” (NJB), “reale” (TEV), si përdorimi i “mesazhit” në 1:5 dhe 3:1, që thekson edhe doktrinën edhe stilin e jetesës; kjo ndodh edhe në rastin e “së vërtetës”. Vepra dhe qëllimi duhet të motivohen nga dashuria altruiste (e Perëndisë), dhe jo nga veprat për mburrje, që ushqejnë egon e dhënësit ose siguruesit.

3:19 “Nga kjo do të dimë” Bëhet fjalë për veprimet e nxitura nga dashuria, që u përmendën më sipër. Kjo është DËFTORE E ARDHME MESORE (me kuptim vepror), që përbën një tjetër dëshmi të kthimit të vërtetë në besim.

■ **“se i përkasim së vërtetës”** Stili i jetesës, që karakterizohet nga dashuria, tregon dy gjëra: (1) se besimtari është në anën e së vërtetës; dhe (2) se ndërgjegjja e tyre është e pastër. Shih Temën e Veçantë: E Vërteta, në Gjoni 6:55.

3:19-20 Ka shumë konfuzion sesi duhet përkthyer teksti greqisht i këtyre dy vargjeve. Një interpretim i mundshëm thekson gjykimin e Perëndisë, ndërsa tjetri thekson dhembshurinë e Perëndisë. Për shkak të kontekstit, alternativa e dytë duket më e përshtatshme.

3:20-21 Të dyja këto vargje janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË.

3:20

NASB “në çfarëdo gjë që zemra na dënon”

NKJV “sepse, nëse zemra na dënon”

NRSV “kurdoherë që zemra na dënon”

TEV “nëse ndërgjegjja na dënon”

NJB “edhe nëse ndjenjat na dënojnë”

Të gjithë besimtarët kanë përjetuar brengosje të brendshme kur nuk kanë jetuar sipas “standardit” që mendojnë se nënkupton vullneti i Perëndisë për jetën e tyre (shih Rom. 7). Këto brejtje ndërgjegjeje mund të vijnë nga Fryma e Perëndisë (që të shkaktojnë pendim), ose nga Satani (që të shkaktojnë vetëshkatërrim ose humbjen e dëshmisë). Ekziston edhe ndjenja e fajit me vend, edhe ndjenja e fajit pa vend. Besimtarët e dinë dallimin mes tyre duke lexuar librin e Perëndisë (ose duke dëgjuar të dërguarit e tij). Gjoni po përpiqet të ngushëllojë besimtarët që po jetojnë sipas standardit të dashurisë, por që ende po ndeshin në vështirësi me mëkatën (si nga veprimet e mëkatshme, ashtu dhe nga mosveprimet me mëkatshme). Shih Temën e Veçantë: Zemra, në Gjoni 12:40.

■ **“dhe njeh gjithçka”** Perëndia i njeh motivet tona të vërteta (shih 1 Sam. 2:3; 16:7; I Mbre. 8:39; 1 Kro. 28:9; 2 Kro. 6:30; Psa. 7:9; 44:21; Fja. 15:11; 20:27; 21:2; Jer. 11:20; 17:9-10; 20:12; Luka 16:15; Veprat 1:24; 15:8; Rom. 8:26,27).

3:21 “nëse zemra nuk na dënon” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË. Të krishterët ende ndeshen me mëkatën dhe me veten (shih 2:1; 5:16-17). Ende përballen me tundime dhe vepronë në mënyrë të gabuar në situata të veçanta. Shpesh, ndërgjegjja e tyre i dënon. Ashtu si thotë himni i Henri Tuells “Në muzg, përpara se të binte dielli”:

“dhe askush, o Zot, s’ka prehje të përsosur,

Sepse askush s’është i lirë plotësisht nga mëkati;

Dhe ata që të shërbejnë më së miri

Janë më të vetëdijshëm se të tjerët për mëkatën nga brenda”.

Njohuria e ungjillit, bashkësia e ëmbël me Jezusin, nënshtrimi ndaj udhëheqjes së Frymës dhe gjithënjohja e Atit na qetësojnë zemrën tonë prej pluhuri (shih Psa. 103:8-14)!

■ **“kemi siguri para Perëndisë”** Me fjalë të tjera, mund të hymë sa herë të duam dhe pa frikë në prani të Perëndisë. Kjo është një fjalë e përsëritur shpesh nga Gjoni (shih 2:28; 3:21; 4:17; 5:14; Heb. 3:6; 10:35; shih Temën e Veçantë në 7:4). Kjo frazë prezanton dy nga dobitë e sigurisë së besimit.

1. se besimtarët kanë siguri të përsosur para Perëndisë
2. se marrin prej tij gjithçka që i kërkojnë

3:22 “çfarëdo të kërkojmë, e marrim prej tij” Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE me një DËFTORE TË TASHME VEPRORE. Reflekton thëniet e Jezusit në Mat. 7:7; 18:19; Gjoni 9:31; 14:13-14; 15:7, 16; 16:23; Marku 11:24; Luka 11:9-10. Këto premtimet biblike ndryshojnë shumë nga përjetimi i besimtarit në lutje. Ky varg duket sikur premtim të pakufizuar, që merr përgjigje. Në këtë pikë, krahasimi me pasazhe të tjera nga Bibla na ndihmon që të vendosim një ekuilibër teologjik.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA, E PAKUFIZUAR, POR E KUFIZUAR

A. Ungjijtë sinoptikë

1. besimtarët inkurajohen që të këmbëngulin në lutje dhe Perëndia do t'ju sigurojë “gjëra të mira” (Mateu), ose “Frymën e tij” (Luka); Mat. 7:7-11; Luka 11:5-13
2. në kontekstin e disiplinës së kishës, besimtarët (dy të tillë) inkurajohen që të bashkohen në lutje (Mat. 18:19)
3. në kontekstin e gjykimit të judaizmit, besimtarëve u kërkohet të luten me besim, pa dyshuar (Mat. 21:22; Marku 11:23-24)
4. në kontekstin e dy shëmbëlltyrave (Luka 18:1-8; gjykatësi i padrejtë dhe Luka 18:9-14, fariseu dhe mëkatar), besimtarët inkurajohen që të veprojnë ndryshe nga gjykatësi i paperëndishëm dhe nga fariseu arrogant. Perëndia e dëgjon të përlurin dhe të penduarin (Luka 18:1-14)

B. Shkrimet e Gjonit

1. në kontekstin e njeriut të lindur të verbër, të cilin Jezusi e shëron, zbulohet verbëria e vërtetë e farisenjve. Lutjet e Jezusit (ashtu si të kujtdo tjetër) marrin përgjigje sepse ai e njihte Perëndinë dhe jetonte në përputhje me të (Gjoni 9:31).
2. Fjalimi i Jezusit në dhomën e sipërme (Gjoni 13:17)
 - a. 14:12-14 – lutja besimtare karakterizohet nga si më poshtë
 - 1) vjen nga besimtarët
 - 2) bëhet në emër të Jezusit
 - 3) dëshirohet që të lavdërohet Ati
 - 4) zbatohen urdhërimet (v. 15)
 - b. 15:7-10 – lutja e besimtarëve karakterizohet nga si më poshtë
 - 1) Qëndrojnë në Jezusin
 - 2) Fjala e tij qëndron në ta
 - 3) Dëshirojnë që të lavdërohet Ati
 - 4) Japin shumë fryte
 - 5) Zbatojnë urdhërimet (v. 10)
 - c. 15:15-17 – lutja e besimtarëve karakterizohet nga si më poshtë
 - 1) Zgjedhja e tyre
 - 2) Ata japin fryte
 - 3) Luten në emër të Jezusit
 - 4) Zbatojnë urdhërimin e dashurisë për njëri-tjetrin
 - d. 16:23-24 – lutja e besimtarëve karakterizohet nga si më poshtë
 - 1) Luten në emër të Jezusit
 - 2) Dëshirojnë që gëzimi t'u bëhet i plotë
3. Letra e parë e Gjonit (1 Gjonit)
 - a. 3:22-24 – lutja e besimtarëve karakterizohet nga si më poshtë
 - 1) Zbatojnë urdhërimet e tij (v. 22, 24)
 - 2) Jetojnë siç duhet
 - 3) Besojnë në Jezusin
 - 4) Duan njëri-tjetrin
 - 5) Qëndrojnë në të, ashtu si ai në ne
 - 6) Kanë dhuratën e Frymës
 - b. 5:14-16 – lutja e besimtarëve karakterizohet nga
 - 1) Siguria në Perëndinë
 - 2) Sipas vullnetit të tij
 - 3) Besimtarët luten për njëri-tjetrin

C. Jakobi

1. 1:5-7 – besimtarëve, që përballen me sprova të ndryshme, u bëhet thirrje që të kërkojnë urtësi pa dyshuar
2. 4:2-3 – besimtarët duhet të kërkojnë për arsytet e duhura
3. 5:13-18 – inkurajohen dhe besimtarët me probleme shëndetësore
 - a. që t'u kërkojnë pleqve të luten
 - b. që të luten me besim, që të shpëtohen

c. të luten që mëkatet t'u falen

d. t'i rrëfejnë mëkatet njëri-tjetrit dhe të luten për njëri-tjetrin (e ngjashme me 1 Gjonit 5:16)

Çelësi për lutjen e efektshme është ngjashmëria me Krishtin. Këtë kuptim ka “lutja në emër të Jezusit”. Gjëja më e keqe që mund të bënte Perëndia për shumicën e të krishterëve do të ishte t'u përgjigjej të gjitha lutjeve të tyre egoiste! Në njëfarë kuptimi, të gjitha lutjet marrin përgjigje. Aspekti më i vyer i lutjes është se besimtari ka kaluar kohë me Perëndinë, duke i besuar Perëndisë.

▣ **“sepse zbatojmë porositë e tij dhe bëjmë gjërat që i pëlqejnë atij”** Vini re, në këtë kontekst, dy kërkesat për lutjen që merr përgjigje.

1. bindja

2. kryerja e gjërave që i pëlqejnë Perëndisë (shih Gjoni 8:29)

1 Gjonit është libër “me përgjigje praktike” për jetesën dhe shërbesën e efektshme të të krishterit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:23-24

²³Ky është urdhërimi i tij, që ne të besojmë në emër të Birit të tij, Jezu Krishtit, dhe të duam njëri-tjetrin, ashtu siç na urdhëroi ai. ²⁴Ai që zbaton urdhërimet e tij qëndron në të, dhe ai në të. Nga kjo e dimë që ai banon në ne: nga Fryma që na ka dhënë.

3:23 “Ky është urdhërimi... që ne të besojmë... dhe të duam” Vini re se fjala “urdhërim” është në NJËJËS, dhe ka dy aspekte. Aspekti i parë është besimi personal; FOLJA “besoj” është LIDHORE AORISTE VEPRORE (shih Gjoni 6:29, 40). Aspekti i dytë është etik; FOLJA “dua” është LIDHORE E TASHME VEPRORE (shih 3:11; 4:7). Ungjilli është mesazh që duhet besuar, person që duhet pranuar, dhe stil jetese që duhet jetuar!

▣ **“që ne të besojmë në emër të Birit të tij, Jezu Krishtit”** Koncepti “besoj” është kyç për të kuptuar besimin biblik. Fjala e DhV, *aman*, reflektonte “besnikëri”, besueshmëri, “integritet”, ose “besnikëri” (shih Temën e Veçantë për këtë fjalë nga DhV në 1 Gjonit 2:10). Në DhV, fjala greke “*pisteuō*” përkthehet me tre fjalë të ndryshme në gjuhën angleze: believe [besoj], faith [besim], ose trust [besim te dikush] (shih Temën e Veçantë për këtë fjalë greqisht në Gjoni 2:23). Më tepër se besueshmërinë e të krishterit, kjo fjalë pasqyron besueshmërinë e Perëndisë. Themeli i patundur është pikërisht karakteri, zbulesa dhe premtimet e Perëndisë, jo besnikëria apo besueshmëria e njerëzve të rënë, madje as e atyre që janë shpenguar!

Koncepti i besimit në “emër” të dikujt, ose i lutjes “në emër” të dikujt, pasqyron botëkuptimin e Lindjes së Mesme se emri përfaqëson personin.

1. Jezusi, në Mat. 1:21,23,25; 7:22; 10:22; 12:21; 18:5,20; 19:29; 24:5,9; Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 14:26; 15:21; 17:6; 20:31

2. Ati, në Mat. 6:9; 21:9; 23:39; Gjoni 5:43; 10:25; 12:13; 17:12

3. Trinia, në Mat. 28:19.

Thjesht një shënim të shkurtër teknik për këtë varg. Në librin e tij *Word Pictures in the New Testament [Simbolet e fjalëve në Dhiatën e Re]* (f. 228), A. T. Robertson përmend një problem në dorëshkrimet greke që lidhet me FOLJEN “besoj”. Dorëshkrimet germëmëdha greke B, K dhe L e kanë foljen në LIDHORE AORISTE VEPRORE, ndërsa x, A dhe C e kanë në LIDHORE TË TASHME VEPRORE. Të dyja përshtaten me kontekstin dhe stilin e Gjonit.

3:24 “Ai që zbaton... qëndron...” Të dyja këto janë në KOHËN E TASHME. Bindja lidhet me qëndrimin. Dashuria është provë se ne jemi në Perëndinë dhe Perëndia është në ne (shih 4:12, 15-16; Gjoni 14:23; 15:10). Shih Temën e Veçantë për qëndrimin/banimin në 2:10.

▣ **“nga Fryma që na ka dhënë”** Gjoni përdor një sërë dëshmish për të vlerësuar besimtarët e vërtetë (shih Rom. 4:13; 8:14-16; shih Mësimet Kontekstuale në 2:3-27, C). Dy prej tyre lidhen me Frymën e Shenjtë.

1. Rrëfimi i besimit në Jezusin (shih Rom. 10:9-13; 1 Kor. 12:3)

2. Jetesa në ngjashmëri me Krishtin (shih Gjoni 15; Gal. 5:22; Jakobi 2:14-26)

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Cila është tema përbashkuese e vargjeve 11-24? (shih 1 Gjonit 2:7-11)?
2. Shpjego marrëdhënien e vargut 16 me vargun 17. Ç'lidhje ka dhënia e jetës me ndihmën e një vëllai në nevojë?
3. Çfarë theksojnë vargjet 19-20: rreptësinë e gjykit të Perëndisë, apo dhembshurinë e madhe të Perëndisë, që na qetëson frikën?
4. Si mund ta lidhim thënien e Gjonit për lutjen (v. 22) me jetën e përditshme?
5. Si mund ta pajtojmë theksimin, në dukje paradoksal, që Gjoni i bën nevojës që i krishteri të pranojë dhe të rrëfejë mëkatën me thënien e tij për përsosmërinë pa mëkat?
6. Pse po i mëshon kaq shumë Gjoni stilit të jetesës?
7. Shpjego të vërtetat teologjike që lidhen me "lindjen sërish".
8. Si lidhet ky pasazh me jetën e përditshme të të krishterit?

1 GJONIT 4

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Fryma e Perëndisë dhe Fryma e Antikrishtit	Fryma e së vërtetës dhe fryma e gabimit 3:24-4:6	Dallimi i së vërtetës dhe gabimit	Fryma e vërtetë dhe fryma e rreme	Kushti i tretë: ruhu nga antikrishtët dhe nga bota
4:1-6		4:1-6	4:1-3 4:4-6	4:1-6 Burimi i dashurisë dhe besimit (4:7-5:13)
Perëndia është dashuri	Njohja e Perëndisë përmes dashurisë	Bekimi i dashurisë	Perëndia është dashuri	Burimi i dashurisë
4:7-12	4:7-11 Si të shohim Perëndisë përmes dashurisë 4:12-16	4:7-12	4:7-10 4:1-12	4:7-5:4
4:13-16a		4:13-16a	4:13-16a	
4:16b-21	Përmëshja e dashurisë 4:17-19 Bindja me anë të besimit 4:20-5:5	4:16b-21	4:16b-18 4:19-21	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

MËSIMET KONTEKSTUALE NGA 4:1-21

- A. Gjoni 4 është një pjesë shumë e specializuar letrare sesi të krishterët duhet të vlerësojnë dhe të verifikojnë ata që thonë se flasin në emër të Perëndisë. Ky pasazh lidhet me
1. këta profetë të rremë të quajtur “antikrishtë” (shih 2:18-25)
 2. ata që përpiqen të mashtrjnë (shih 2:26; 3:7)
 3. ndoshta, ata që thonë se kanë njohuri të të vërtetave të veçanta shpirtërore (shih 3:24)
- Për të kuptuar plotësisht gjendjen e vështirë të të krishterëve të hershëm, duhet të dimë se shumë pretendonin se flisnin në emër të Perëndisë (shih 1 Kor. 12:10; 14:29; 1 Thes. 5:20-21; 1 Gjonit 4:1-6). Asokohe, Dhiata e re nuk ishte përfunduar dhe nuk ishte e disponueshme. Dallueshmëria shpirtërore përdorte edhe sprova doktrinale, edhe sprova shoqërore (shih Jakobi 3:1-12).
- B. Letra e 1 Gjonit është shumë e vështirë të përvijohet për shkak të modelit të përsëritur të tematikave. Pa diskutim, kjo është e vërtetë edhe për kapitullin 4. Duket se ky kapitull rithekson të vërtetë të shprehura edhe në kapitujt e mëparshëm, sidomos nevojën që besimtarët të duan njëri-tjetrin (shih v. 7-21; 2:7-12 dhe 3:11-24).
- C. Gjoni po shkruan, si për të kundërshtuar mësuesit e rremë, ashtu dhe për të inkurajuar besimtarët e vërtetë. Këtë gjë e bën duke përdorur një sërë sprovash:
1. sprova doktrinale (besimi në Jezusin; shih 1 Gjonit 2:18-25; 4:1-6, 14-16; 5:1, 5, 10)
 2. sprova e stilit të jetesës (bindja, shih 1 Gjonit 2:3-7; 3:1-10, 22-24)
 3. sprova shoqërore (dashuria, shih 1 Gjonit 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21; 5:1-2)
- Pjesë të ndryshme të Shkrimit flasin për mësues të ndryshëm të rremë. 1 Gjonit trajton herezinë e mësuesve të rremë gnostikë. Shih hyrjen e 1 Gjonit, “Herezia”. Pjesë të tjera të DhR trajtojnë gënjeshtër të tjera (shih Gjoni 1:13; Rom. 10:9-13; 1 Kor. 12:3). Secili kontekst duhet studiuar në mënyrë të veçantë për të kuptuar se për ç’gabim bëhet fjalë. Gabimi vinte nga burime të ndryshme.
1. Legalistët judenj
 2. Filozofët grekë
 3. Antinomianët grekë
 4. Ata që pretendonin se merrnin zbulesa shpirtërore, ose përjetime të veçanta shpirtërore.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:1-6

¹Të dashur, mos i besoni çdo fryme, por vëri në provë frymët për të parë nëse janë nga Perëndia, pasi në botë kanë dalë shumë profetë të rremë. ²Nga kjo do ta njihni Frymën e Perëndisë: çdo frymë që rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia; ³dhe çdo frymë që nuk rrëfen Jezusin, nuk është nga Perëndia; kjo është fryma e antikrishtit, për të cilën keni dëgjuar se po vjen, madje është tashmë në botë. ⁴Ju jeni nga Perëndia, fëmijë të vegjël, dhe i keni mposhtur ata; sepse ai që është në ju është më i madh se ai që është në botë. ⁵Ata janë nga bota; prandaj, flasin si nga bota, dhe bota i dëgjon. ⁶Ne jemi nga Perëndia; ai që njeh Perëndinë, na dëgjon; ai që nuk është nga Perëndia, nuk na dëgjon. Nga kjo e njohim frymën e së vërtetës dhe frymën e gabimit.

4:1 “mos i besoni” Kjo është URDHËRORE E TASHME me një PJESËZ MOHORE, që zakonisht nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Priorja e të krishterëve është të pranojnë personalitetet e forta, argumentet logjike, ose ngjarjet e mrekullueshme sikur vijnë nga Perëndia. Me sa duket, mësuesit e rremë po pretendonin se (1) flisnin në emër të Perëndisë, ose (2) kishin zbulesa të veçanta nga Perëndia.

TEMË E VEÇANTË: A DUHET TA GJYKOJNË TË KRISHTERËT NJËRI-TJETRIN?

Kjo çështje duhet trajtuar në dy mënyra.

1. Besimtarët paralajmërohen që të mos gjykojnë njëri-tjetrin (shih Mat. 7:1-5; Luka 6:37, 42; Rom. 2:1-11; 1 Tim. 3:1-13; dhe 1 Gjonit 4:1-6)
2. Besimtarët nxiten që të vlerësojnë drejtuesit (shih Mat. 7:6, 15-16; 1 Kor. 14:29; 1 Thes. 5:21; 1 Tim. 3:1-13; dhe 1 Gjonit 4:1-6)

Na nevojiten disa kritere për vlerësimin e drejtë.

1. vlerësimi duhet kryer me qëllim afirmimin (shih 1 Gjonit 4:1 – “sprova” që synon aprovimin)
2. vlerësimi duhet kryer me përlësi dhe butësi (shih Gal. 6:1)
3. vlerësimi nuk duhet të përqendrohet në çështje preferencash personale (shih Rom. 14:1-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33)
4. vlerësimi duhet të identifikojë ata drejtues që nuk “preken nga kritikant” brenda kishës, apo nga komuniteti (shih 1 Timoteut 3).

■ **“çdo frymë”** Fryma përdoret në kuptimin e njeriu si person. Shih shënimin në 4:6. Këtu bëhet fjalë për një mesazh të supozuar nga Perëndia. Herezia vjen nga brenda kishës (shih 2:19). Mësuesit e rremë po pretendonin se flisnin në emër të Perëndisë. Gjoni thotë se ka dy burime shpirtërore pas fjalëve dhe veprimeve njerëzore: Perëndia, ose Satani.

■ **“por vëri në provë frymë”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Kjo është, edhe dhunti shpirtërore (shih 1 Kor. 12:10; 14:29), edhe diçka e domosdoshme për çdo besimtar, njësoj si lutja, ungjillizimi dhe dhënia. Fjala greke *dokimazō* ka ngjyrimin kuptimor: “vë në provë me qëllim miratimin”. Besimtarët duhet të mendojnë më të mirën për të tjerët, përveçse kur provohet më e keqja (shih 1 Kor. 13:4-7; 1 Thes. 5:20-21).

TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE

Ka dy fjalë greke që përçojnë idenë e vënies dikujt në provë për një qëllim të caktuar.

1. *Dokimazō, Dokimion, Dokimasia*

Kjo fjalë është term metalurgjik për vënien në provë të autenticitetit të diçkaje (pra, metaforikisht, të dikujt) me anë të zjarrit. Zjarri zbulon metalin e vërtetë dhe djeg (pra, pastron) skoriet. Ky proces fizik u shndërrua në zhargon të fuqishëm teologjik ku Perëndia, dhe/ose Satani, dhe/ose njerëzit vënë në sprovë të tjerët. Kjo fjalë përdoret vetëm në kuptimin pozitiv të sprovimit me synim që dikush të miratohet. Në DhR përdoret për të vënë në sprovë

- a. qetë – Luka 14:19
- b. vetveten – 1 Kor. 11:28
- c. besimin tonë – Jakobi 1:3
- d. madje dhe Perëndinë – Heb. 3:9

Rezultatet e këtyre sprovave merren si pozitive (shih Rom. 2:18; 14:22; 16:10; 2 Kor. 10:18; 13:3; Fil. 2:27; 1 Pje. 1:7), prandaj, ky term përçon idenë e shqyrtimit dhe miratimit të dikujt si

- a. i vlefshëm
- b. i mirë
- c. i vërtetë
- d. i vyer
- e. i nderuar

2. *Peirazō, Peirasmos*

Shpesh, ky term ka ngjyrimin e shqyrtimit me qëllim gjetjen e të metave, ose refuzimin. Shpesh, përdoret në lidhje me tundimin e Jezusit në shkretëtirë.

- a. Përçon përpjekjen për ta shtënë Jezusin në kurth (shih Mat. . 4:1; 16:1; 19:3; 22:18, 35; Marku 1:13; Luka 4:2; Heb. 2:18).
- b. Kjo fjalë (*peirazōn*) përdoret edhe si titull i Satanit në Mat. 4:3; 1 Thes. 3:5.
- c. Përdoret nga Jezusi për të na paralajmëruar që të mos e vëmë Perëndinë në sprovë (shih Mat. 14:7; Luka 4:12) [ose Krishtin, shih 1 Kor. 10:9]. Po kështu, ajo nënkupton përpjekjen për të bërë diçka që ka

dështuar (shih Heb. 11:29). Përdoret në lidhje me tundimin dhe sprovat e besimtarëve (shih 1 Kor. 7:5; 10:9, 13; Gal. 6:1; 1 Thes. 3:5; Heb. 2:18; Jakobi 1:2, 13, 14; 1 Pje. 4:12; 2 Pje. 2:9). Perëndia i lejon tre armiqtë e njerëzimit (pra, botën, mishin dhe djallin) që të shfaqen në kohë dhe vende të caktuara.

■ **“pasi në botë kanë dalë shumë profetë të rremë”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE (shih Jer. 14:14; 23:21; 29:8; Mat. 7:15; 24:11, 24; Veprat 20:28-30; 2 Pje. 2:1; 1 Gjonit 2:18-19, 24; 3:7; 2 Gjonit 7). Ideja është se ata kanë lënë kishën (shtëpitë-kisha), por ende vazhdojnë të pretendojnë se flasin në emër të Perëndisë. Shih Temën e Veçantë: Profecia në DhR, në Gjoni 4:19.

4:2 “Nga kjo do ta njihni Frymën e Perëndisë” Kjo formë gramatikore është, ose DËFTORE E TASHME VEPRORE (pohim), ose URDHËRORE E TASHME VEPRORE (urdhër). Kjo paqartësi forme gjendet edhe te “qëndroj”, 2:27, dhe “di/njoh”, 2:29. Fryma e Shenjtë gjithmonë ngre lart Jezusin (shih Gjoni 14:26; 15:26; 16:13-15). Kjo sprovë mund të shihet edhe në shkrimet e Palit në 1 Kor. 12:3.

■ **“çdo frymë që rrëfen”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE, që tregon për një rrëfim të vazhdueshëm, jo thjesht një rrëfim të shkuar besimi. Termi greqisht “rrëfej” përbëhet nga fjalët “i njëjtë” dhe “flas”, që do të thotë: “flas të njëjtën gjë”. Kjo është temë e përsëritur te 1 Gjonit (shih 1 Gjonit 1:9; 2:23; 4:2-3; 4:15; Gjoni 9:22; 2 Gjonit 7). Kjo fjalë nënkupton pranimin e veçantë, publik dhe të zëshëm të pranimit dhe përkushtimit ndaj ungjillit të Jezu Krishtit. Shih Temën e Veçantë në Gjoni 9:22.

■ **“se Jezu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia”** Kjo është PJESORE E KRYER VEPRORE. Kjo është sprovë thelbësore doktrinator për mësuesit e rremë (pra, gnostikët), të cilët Gjoni po i lufton në këtë libër. Pohimi bazë i kësaj sprove është se Jezusi është plotësisht njeri (pra, mish, që gnostikët e mohonin), por edhe plotësisht Perëndi (shih 1:1-4; 2 Gjonit 7; Gjoni 1:14; 1 Tim. 3:16). KOHA E KRYER pohon se natyra njerëzore e Jezusit nuk ishte e përkohshme, por e përhershme. Kjo s’ishte vogëlsi. Jezusi është vërtet një me njerëzimin dhe një me Perëndinë.

4:3 “çdo frymë që nuk rrëfen Jezusin” Nga ana teologjike, është interesante se versioni i vjetër latinisht i dhe shkrimtarët patristikë, Klementi, Origeni i Aleksandrisë, Ireneu dhe Tertuliani kanë fjalën *leui* (zgjdh), që nënkupton “ndan Jezusin”, pra, me sa duket, e ndan në një frymë njerëzore dhe në një frymë të veçantë hyjnore, gjë që karakterizonte së tepërmi shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Por kjo është një shtesë tekstuale, që reflekton jetën e kishës së hershme dhe luftën për jetë a vdekje me herezinë (shih Bart Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture*, f. 125-135).

■ **“fryma e antikrishtit”** Këtu, ky term (shih 2:18-25) përdoret në kuptimin “mohues i Krishtit”, dhe jo si përpjekje për t’i uzurpuar pozitën Krishtit.

■ **“keni dëgjuar se po vjen, madje është tashmë në botë”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE, që nënkupton se Gjoni e ka diskutuar më parë këtë temë me ta dhe se rëndësia e kësaj teme është ende e vlefshme. Në greqisht, PËREMRI (i nënkuptuar në shqip) “ajo” përputhet me ASNJANËSEN “frymë”. Si në 2:18, kjo frazë reflekton faktin se fryma e antikrishtëve ka ardhur tashmë, por edhe pritet të vijë. Këta mësues të rremë gnostikë krijojnë një zinxhir informacioni të rremë, stilesht jetese të rreme, dhe rrëfimesh të rreme në gjithë epokat, që nga i ligu i Zanafillës 3 e deri te shfaqja e mishërimit të ligësisë dhe e Antikrishtit në fund të kohës (shih 2 Thesalonikasve 2; Zbulesa 13).

4:4-6 “Ju... Ata... Ne” Të gjithë këta PËREMRA theksohen. Gjoni po u drejtohet tre grupeve.

1. besimtarëve të vërtetë (Gjoni dhe lexuesit e tij)
2. besimtarëve të rremë (mësuesit gnostikë dhe ndjekësit e tyre)
3. ekipi misionar (ose grupi teologjik) i Gjonit

I njëjta lloj triade shihet edhe te Hebrejve 6 dhe 10.

4:4 “i keni mposhtur ata” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Me sa duket, bëhet fjalë për polemikën doktrinator, por edhe për jetën ngadhënjimtare të krishterë. Ç’fjalë e mrekullueshme inkurajuese për ta dhe për ne!

Gjoni po flet për fitoren e të krishterit mbi mëkatën dhe djallin. Ai e përdor këtë term (*nikaō*) 6 herë te 1 Gjonit (shih 2:13, 14; 4:4; 5:4, 5), 11 herë te Zbulesa, dhe 1 herë në ungjillin e tij (shih 16:33). Fjala “fitore” është përdorur vetëm një herë te Luka (shih 11:22) dhe vetëm dy herë në shkrimet e Palit (Rom. 3:4; 12:21).

■ **“sepse ai që është në ju është më i madh se ai që është në botë”** Këtu theksohet Hyjnia brendabanuese. Këtu, duket se bëhet fjalë për brendabanimin e Atit (shih Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16). DhR thekson edhe (1) brendabanimin e Birit (shih Mat. 28:20; Kol. 1:27) dhe (2) brendabanimin e Frymës së Shenjtë (shih Rom. 8:9; 1 Gjonit 4:13). Fryma dhe Biri identifikohen ngushtë me njëri-tjetrin (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:16; Fil. 1:19; 1 Pje. 1:11). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 14:16.

Fraza “ai që është në botë” bën fjalë për Satanin (shih Gjoni 12:31; 14:30; 16:11; 2 Kor. 4:4; Efe. 2:2; 1 Gjonit 5:19) dhe ndjekësit e tij. Fjala “botë” në 1 Gjonit ka gjithmonë ngjyrimet kuptimore negative (pra, shoqëria njerëzore, që funksionon dhe organizohet veçmas Perëndisë. Shih Temën e Veçantë: *Kosmos* në Gjoni 14:17).

4:5 “Ata janë nga bota” Kjo është RRJEDHORE e burimit. Fjala “botë” këtu përdoret në kuptimin e shoqërisë së rënë njerëzore, që përpiqet t’i përmbushë të gjitha nevojat pa Perëndinë (shih 2:15-17). Bën fjalë për shpirtin kolektiv dhe të pavarur të njerëzimit! Një shembull i kësaj është Kaini (shih 3:12). Shembuj të tjerë janë (1) Elija dhe profetët e Ba’alit (1 Mbre. 18) dhe (2) Jeremia kundër Hananias (Jeremia 28).

■ **“bota i dëgjon”** Një tjetër provë dallimi mes mësuesve të krishterë dhe atyre të rremë është personi që i dëgjon (shih 1 Tim. 4:1).

4:6 “ai që njih Perëndinë na dëgjon” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Besimtarët e vërtetë vazhdojnë të dëgjojnë të vërtetën apostolike dhe t’i përgjigjen! Besimtarët arrijnë t’i dallojnë predikuesit/mësuesit e vërtetë nga përmbajtja e mesazhit të tyre, si dhe nga personat që i dëgjojnë dhe u binden.

■ **“Nga kjo e njohim frymën e së vërtetës dhe frymën e gabimit”** Kjo mund t’i referohet Frymës së Shenjtë (shih Gjoni 14:17; 15:26; 16:13; 1 Gjonit 4:6; 5:7) dhe frymës së ligë. Besimtarët duhet të jenë në gjendje të dallojnë burimin e mesazhit. Shpesh, të dy këto lloj mesazhesh jepen në emër të Perëndisë, gjoja nga folës të Perëndisë. Njëri mesazh ngre lart Jezusin dhe ngjashmërinë me të, ndërsa tjetri lartëson hamendësimin njerëzore dhe lirinë personale.

Robert Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [*Sinonime të Dhiatës së Vjetër*], përmban një diskutim interesantë për përdorimet e termit “frymë” në DhR.

1. frymët e liga
2. fryma njerëzore
3. Fryma e Shenjtë
4. Gjërat që prodhon Fryma në frymën njerëzore dhe përmes kësaj të fundit
 - a. „jo një frymë skllavërie, por një frymë birësimi” – Rom. 8:15
 - b. „një frymë butësie” – 1 Kor. 4:21
 - c. „një frymë besimi” – 2 Kor. 4:13
 - d. „një frymë urtësie dhe zbulesë në njohurinë e tij” – Efe. 1:17
 - e. „jo një frymë frike, por fuqie, dashurie dhe disiplinë” – 2 Tim. 1:7
 - f. „fryma e gabimit përkundër frymës të së vërtetës” – 1 Gjonit 4:6 (f. 61-63).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:7-14

⁷Të dashur, le ta duam njëri-tjetrin, sepse dashuria është nga Perëndia; dhe kushdo që do, ka lindur nga Perëndia dhe e njih Perëndinë. ⁸Ai që nuk do, nuk e njih Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri. ⁹Nga kjo u shfaq dashuria e Perëndisë në ne: se Perëndia ka dërguar Birin e tij të vetëmlindur në botë që ne të jetojmë nëpërmjet tij. ¹⁰Këtu qëndron dashuria: jo se e kemi dashur ne Perëndinë, por se na ka dashur ai dhe ka dërguar Birin e vet për të qenë pajtim për mëkatet tona. ¹¹Të dashur, nëse Perëndia na ka dashur kaq shumë, edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin. ¹²Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë; nëse duam njëri-tjetrin, Perëndia banon në ne dhe dashuria e tij përsoset në ne. ¹³Nga kjo e dimë se banojmë në të dhe ai në ne, sepse ai na ka dhënë Frymën e tij. ¹⁴Ne kemi parë dhe dëshmojmë se Ati ka dërguar Birin për të qenë Shpëtimtari i botës.

4:7 “le ta duam njëri-tjetrin” Kjo është LIDHORE E TASHME VEPRORE. Stili i jetesës, dashuria e përditshme, është një nga tiparet e përbashkët të të gjithë besimtarëve (shih 1 Kor. 13; Gal. 5:22). Ky është një motiv i përsëritur në shkrimet e Gjonit dhe është thelbi i sprovës etike (shih Gjoni 13:34; 15:12, 17; 1 Gjonit 2:7-11; 3:11, 23; 2 Gjonit 5, shih Mësimet Kontekstuale, C). MËNYRA LIDHORE shpreh gjendje të kushtëzuar.

■ **“sepse dashuria është nga Perëndia”** Burimi i dashurisë është Perëndia, jo bamirësia, mëshira, apo ndjenja njerëzore (shih v. 16). Ajo nuk është parësisht veprim emocional, por i qëllimshëm (pra, Ati dërgon Birin që të vdesë për ne, shih v. 10; Gjoni 3:16).

■ **“kushdo që do, ka lindur nga Perëndia dhe e njeh Perëndinë”** FOLJET janë DËFTORE E KRYER PËSORE dhe DËFTORE E TASHME VEPRORE. Fjalët më të preferuara të Gjoni kur përshkruan njeriun që kthehet në besim lidhen me lindjen fizike (shih 2:29; 3:9; 4:7; 5:1, 4, 18; Gjoni 3:3, 7).

Fjala “njoh” reflekton idenë hebraike të bashkësisë së ngushtë e të vazhdueshme (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5). Kjo është temë e përsëritur te 1 Gjoni, përdoret mbi 77 herë. Shih Temën e Veçantë në Gjoni 1:10.

4:8 “Ai që nuk do, nuk e njeh Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri” Dashuria si stil jetese është prova e vërtetë e njohjes së Perëndisë.

Kjo është një nga thëniet e thjeshta por të thella të Gjoni; “Perëndia është dashuri” është paralele me “Perëndia është dritë” (shih 1:5) dhe “Perëndia është frymë” (shih Gjoni 4:24). Një nga mënyrat më të mira për të ballafaquar dashurinë e Perëndisë me zemërimin e tij është të krahasojmë LiP. 5:9 me 5:10 dhe 7:9.

4:9 “Nga kjo u shfaq dashuria e Perëndisë në ne” Kjo është DËFTORE AORISTE PËSORE (shih Gjoni 3:16; 2 Kor. 9:15; Rom. 8:32). Perëndia ka treguar qartë se na do, duke dërguar Birin e tij të vetëm që të vdiste në vendin tonë. Dashuria është veprim, jo thjesht ndjenjë. Besimtarët duhet ta imitojnë këtë gjë përditë në jetën e tyre (shih 1 Gjonit 3:16). Të njohësh Perëndinë do të thotë të duash si ai.

■ **“Perëndia ka dërguar Birin e tij të vetëmlindur në botë”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE; mishërimi dhe rezultatet e tij mbeten! Të gjitha dobitë e Perëndisë vijnë përmes Krishtin.

Fjala “i vetëmlindur” është *monogenēs*, që do të thotë “unik”, “i pashoq”, jo i lindur sipas mënyrës seksuale. Lindja e virgjër nuk ishte përjetim seksual për Perëndinë apo për Marinë. Gjoni e përdor disa herë këtë fjalë, për të nënkuptuar Jezusin (shih Gjoni 1:14, 18; 3:16, 18; 1 Gjonit 4:9). Shih shënimin e mëtejshëm te Gjoni 3:16. Jezusi është Biri i Perëndisë në një kuptim unik (ontologjik). Besimtarët janë fëmijë të Perëndisë vetëm në një kuptim dytësor.

■ **“që ne të jetojmë nëpërmjet tij”** Kjo është LIDHORE AORISTE VEPRORE, që nënkupton një gjendje të kushtëzuar; është i nevojshëm reagimi me besim. Synimi i mishërimit ishte jeta e përjetshme dhe jeta me bollëk (shih Gjoni 10:10).

4:10 “Këtu qëndron dashuria” Dashuria e Perëndisë demonstron qartë në jetën dhe vdekjen e Jezusit (shih Rom. 5:6, 8). Të njohësh Perëndinë do të thotë të duash!

■ **“jo se e kemi dashur ne Perëndinë”** Dhiata e Re është unike ndër fetë botërore. Në mënyrë tipike, feja është kërkimi i njerëzimit për Perëndinë, ndërsa krishterimi është kërkimi i Perëndisë për njerëzimin e rënë! E vërteta e mrekullueshme nuk është dashuria jonë për Perëndinë, por dashuria e tij për ne. Ai na ka kërkuar pavarësisht mëkatit, egos, rebelimit dhe krenarisë sonë. E vërteta e lavdishme e krishterimit është se Perëndia e do njerëzimin e rënë dhe ka nisur dhe ruajtur një kontakt jetëndryshues me të.

Ekziston një variant në dorëshkrime për formën e FOLJES këtu.

1. kemi dashur dhe vazhdojmë të duam – E KRYER – dorëshkrimi B

2. deshëm, AORIST – dorëshkrimi 8

UBS⁴ i jep KOHËS SË KRYER vlerësimin “B” (pothuajse e sigurt).

■ **“ka dërguar Birin e vet për të qenë pajtim për mëkatet tona”** Shih shënimin në 2:2.

4:11 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij letrare. Perëndia na do vërtet (shih Rom. 8:31)!

■ **“Perëndia na ka dashur kaq shumë”** “Kaq” duhet kuptuar “në mënyrë të tillë”, si në Gjoni 3:16.

■ **“edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin”** Për shkak se ai na ka dashur, edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin (shih 2:10; 3:16; 4:7). Kjo thënie pa diskutim që nënkupton sjelljen dhe veprimet përçarëse të mësuesve të rremë.

4:12 “Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë” Kjo është DËFTORE E KRYER MESORE (deponente). Kjo fjalë do të thotë “vështroj i përqendruar dikë ose diçka” (shih Eks. 33:20-23; Gjoni 1:18; 5:37; 6:46; 1 Tim. 6:16). Ka gjasa që mësuesit gnostikë, disi të ndikuar nga fetë e mistershme lindore, pretendonin se kishin ndonjëfarë lloj vegimi nga Perëndia ose se shihnin Perëndinë. Jezusi erdhi për të zbuluar plotësisht Atin. Duke kundruar atë, njohim Perëndinë!

■ **“nëse”** Kjo është KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ **“Perëndia banon në ne”** Shih Temën e Veçantë për Banimin/Qëndrimin në 2:10.

■ **“dashuria e tij përsoset në ne”** Kjo është PJESORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE. Të krishterët e dashur janë provë e dashurisë së qëndrueshme dhe të përsosur të Perëndisë (shih 2:5; 4:17).

4:13 “Ai na ka dhënë Frymën e tij” Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Fryma e Shenjtë brandabanues (shih 3:24; Rom. 8:9) dhe ndikimi i tij transformues janë dëshmia e shpëtimit tonë të vërtetë (shih Rom. 8:16). Duket se v. 13 është dëshmia subjektive e Frymës, ndërsa v. 14 është dëshmia objektive e dëshmisë apostolike. Tre personat e Trinisë shfaqen qartazi në v. 13-14. Shih Temën e Veçantë: Trinia në Gjoni 14:26.

■ **“Ne kemi parë dhe dëshmojmë”** FOLJET janë DËFTORE E MESME (deponente) E KRYER, së bashku me një DËFTORE TË TASHME VEPRORE. Bëhet fjalë për dëshminë okulare të Gjorit në lidhje me personin e Krishtit, njësoj si 1:1-3.

Fjala “parë” është e njëjta fjalë greke si në v. 12, që do të thotë “vështroj i përqendruar”. Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në Gjoni 1:8.

■ **“se Ati ka dërguar Birin”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE. Fakti se Perëndia Atë dërgoi Perëndinë Bir në botë (shih Gjoni 3:16) hedh poshtë mësimin e rremë gnostik për dualizmin e hamendësuar midis shpirtit (i mirë) dhe materies (e ligë). Jezusi ishte vërtet hyjnor dhe u dërgua në këtë botë të ligë e të mëkatshme për ta shpenguar (shih Romakëve 8:18-25) nga mallkimi i Zanafillës 3 (shih Gal. 3:13).

■ **“për qenë Shpëtimtari i botës”** Fakti se Ati zgjodhi të përdorte Jezusin si mjet shpëtimi hedh poshtë mësimin e rremë gnostik se shpëtimi fitohet përmes një njohuri të veçantë e të fshehtë, që lidhet me nivelet engjëlllore. Këto nivele engjëlllore ata i quanin *eon*-a ose sfera autoritetesh engjëlllore midis Perëndisë së lartë dhe perëndisë së ulët që formoi botën nga lënda paraekzistuese.

Fraza “Shpëtimtari i botës” ishte (1) titull për perënditë (p.sh., Zeusi) dhe (2) titull i zakonshëm për Cezarin romak. Për të krishterët, këtë titull mund ta mbante vetëm Jezusi (shih Gjoni 4:42; 1 Tim. 2:4; 4:10). Pikërisht kjo shkaktoi përndjekjen nga ana e kulteve lokale të Cezarit në Azinë e vogël.

Vini re se kjo është frazë gjithëpërfshirëse. Ai është shpëtimtari i të gjithëve (jo disave) nëse i përgjigjen (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 5:18; 10:9-13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:15-21

¹⁵Kushdo që rrëfen se Jezusi është Biri i Perëndisë, në të banon Perëndia, dhe ai banon në Perëndinë. ¹⁶Ne kemi njohur dhe kemi besuar dashurinë që Perëndia ka për ne. Perëndia është dashuri, dhe ai që banon në dashuri banon në Perëndinë, dhe Perëndia banon në të. ¹⁷Nga kjo, dashuria është përsosur me ne, që të mund të kemi siguri besimi në ditën e gjykimit; sepse, siç është ai, ashtu jemi dhe ne në këtë botë. ¹⁸Nuk ka frikë në dashuri; por dashuria e vërtetë e dëbon frikën, sepse frika nënkupton ndëshkimin, dhe ai që ka frikë nuk është i përsosur në dashuri. ¹⁹Ne duam, sepse ai na deshi i pari. ²⁰Nëse dikush thotë, “e dua Perëndinë”, por urren vëllanë, është gënjeshtar; sepse ai që nuk do vëllanë, të cilin e ka parë, nuk mund ta dojë Perëndinë, të cilin nuk e ka parë. ²¹Dhe këtë urdhërim kemi prej tij: që ai që do Perëndinë, duhet të dojë edhe vëllanë.

4:15 “Kushdo që rrëfen se Jezusi është Biri i Perëndisë” Kjo është LIDHORE AORISTE VEPRORE. Për “rrëfen”, shih shënimin në v. 2. Një nga tre sprovat e të krishterit të vërtetë, sipas Gjonit, është e vërteta teologjike në lidhje me personin dhe veprën e Jezusit (shih 2:22-23; 4:1-6; 5:1, 5). Kjo përputhet edhe me mesazhin e 1 Gjonit dhe Jakobit, që flasin për dashurinë dhe bindjen si stil jetese. Krishterimi është person, grup të vërtetash dhe stil jetese. Shih Mësimet Kontekstuale, C.

Termi përfshirës “kushdo” është ftesa madhore e Perëndisë për këdo dhe gjithkënd që të shkojnë tek ai. Të gjithë njerëzit janë krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; 5:3; 9:6). Perëndia i premtoi shpengim racës njerëzore në Zan. 3:15. Thirrja e tij për Abrahamin ishte një thirrje për të përfshirë gjithë botën (shih Zan. 12:3; Eks. 19:5). Vdekja e Jezusit i dha fund problemit të mëkatit (shih Gjoni 3:16). Gjithkush mund të shpëtohet nëse u përgjigjet detyrimeve të besëlidhjes për pendim, besim, bindje, shërim dhe qëndresë. Fjala e Perëndisë për të gjithë është “Eja!” (shih Isaia 55).

TEMË E VEÇANTË: ANËSIA UNGJILLORE E BOBIT

Duhet të të rrëfej, o lexues, se, në këtë pikë, unë kam anësinë time. Teologjia ime sistematike nuk është as kalvinizmi, as dispensacionalizmi, por është ungjillizimi që ndjek Porosinë e Madhe (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8). Unë besoj se Perëndia kishte një plan të përjetshëm për shpengimin e gjithë njerëzimit (p.sh., Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Jer. 31:31-34; Eze. 18; 36:22-38; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Rom. 3:9-18, 19-20, 21-31), të gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e tij (shih Zan. 1:26-27). Besëlidhjet janë bashkuar në Krishtin (shih Gal. 3:28-29; Kol. 3:11). Jezusi është misteri i Perëndisë, i fshehur, por tani i zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13)! Çelësi i Shkrimit nuk është Izraeli, por ungjilli i DhR.

Ky botëkuptim paraprak ngjyros gjithë interpretimet e mia të Shkrimit. Unë i lexoj të gjitha pasazhet përmes tij! Pa dyshim që kjo është anësi (të gjithë interpretuesit i kanë!), por është bazuar në Shkrimet.

■ **“në të banon Perëndia, dhe ai banon në Perëndinë”** Kjo reflekton strukturën e besëlidhjes së marrëdhënies që Perëndia ka me njerëzimin. Perëndia është ai që merr gjithmonë nismën, përcakton axhendën dhe siguron bazën e besëlidhjes, por njerëzit kanë përgjegjësinë që t’i përgjigjen fillimisht atij dhe të vazhdojnë më tej me këtë gjë.

Qëndrimi/banimi është kërkesë e besëlidhjes, por edhe premtim i mrekullueshëm (shih Gjoni 15). Përfytyro Krijuesin e universit, të Shenjtin e Izraelit, që banon me njerëzit e rënë (i brendabanon) (shih Gjoni 14:23)! Shih Temën e Veçantë për Banimin/Qëndrimin në 2:10.

4:16 “Ne kemi njohur dhe kemi besuar” Këto FOLJE janë të dyja DËFTORE TË KRYERA VEPRORE. Baza e marrëdhënies së besimtarëve është siguria plot besim që ata kanë në dashurinë e Perëndisë në Krishtin, dhe jo rrethanat e jetës. Shih Temën e Veçantë: Siguria në 5:13.

■ **“që Perëndia ka për ne”** Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE, që shpreh dashurinë e vazhdueshme të Perëndisë.

■ **“Perëndia është dashuri”** Kjo e vërtetë e rëndësishme përsëritet (shih v. 8).

4:17 “Nga kjo, dashuria është përsosur” Kjo vjen nga fjala greke *telos* (shih v. 12). Nënkupton plotësi, pjekuri dhe përmbushje, jo pamëkatshmëri.

■ **“me ne”** Kjo NDAJFOLJE (*meta*) mund të përkthehet “në ne” (TEV, NJB), “ndër ne” (NKJV, NRSV, NIV, REB) ose “me ne” (NASB).

■ **“që të mund të kemi siguri besimi”** Në fillim, kjo fjalë donte të thoshte “liri shprehjeje”. Gjoni e përdor vazhdimisht (shih 2:28; 3:21; 5:14). Nënkupton guxim tonë për t’iu afruar Perëndisë së shenjtë (shih Heb. 3:6; 10:35). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 7:4.

■ **“në ditën e gjykimit; sepse siç është ai, ashtu jemi dhe ne në këtë botë”** Të krishterët duhet të duan siç dëshoi Jezusi (shih 3:16; 4:11). Ata mund të refuzohen dhe përndiqen si ai, por gjithashtu kanë edhe dashurinë dhe mbrojtjen e Atit dhe Frymës, njësoj si ai! Një ditë, të gjithë njerëzit do të japin llogari para Perëndisë për dhuratën

e jetës (shih Mat. 25:31-46; 2 Kor. 5:10; Zbu. 20:11-15). Dita e Gjykimit nuk përbën aspak frikë për ata që janë në Krishtin.

4:18 “Nuk ka frikë në dashuri” Kur arrijmë ta njohim Perëndinë si Atë, nuk i druhami më si Gjykatës. Shumica e kthimeve në besimin e krishterë (në mos po të gjitha) përfshijnë frikën: frikën nga gjykimi, nga dënimi, nga ferri. Mirëpo në jetën e njerëzve të shpenguar ndodh diçka e mahnitshme: ajo që nis me frikë, përfundon pa frikë!

■ **“frika nënkupton ndëshkimin”** Kjo është një fjalë e rrallë, që përdoret vetëm këtu dhe në Mat. 25:46 (forma FOLJORE gjendet në 2 Pje. 2:9), që është edhe kontekst eskatologjik. FOLJA në KOHËN E TASHME nënkupton se frika nga zemërimi i Perëndisë është edhe e përkohshme (diçka që ndodh në kohë), edhe eskatologjike (në fund të kohës). Njerëzit janë krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27), që nënkupton aspektet e personalitetit, njohurisë, zgjedhjes dhe pasojave. Ky është univers moral. Njerëzit nuk i thyejnë ligjet e Perëndisë; ata thyhen prej ligjeve të Perëndisë kur mundohen t’i shkelin!

4:19 “Ne duam” Kjo është DËFTORE E TASHME VEPRORE. NKJV shton një KUNDRINOR TË DREJTË pas “ne duam”. Variantet e dorëshkrimeve për një KUNDRINOR TË DREJTË janë:

1. në një dorëshkrim germëmadh grek (Ⲁ), shtohet fjala “Perëndinë” (*ton theon*)
2. në dorëshkrimin Ψ shtohet “atë” (*auton*) (KJV)
3. në versionin e Vulgatës shtohet “njëri-tjetrin”

Këta KUNDRINORË TË DREJTË mund të jenë shtesa të mëvonshme. UBS⁴ i jep FOLJES (pa kundrinorin) vlerësimin “A” (e sigurt).

■ **“sepse ai na deshi i pari”** Ky është theksi i përsëritur i v. 10. Perëndia e merr gjithmonë nismën i pari (shih Gjoni 6:44, 65), por njerëzimi i rënë duhet t’i përgjigjet ftesës (shih Gjoni 1:12; 3:16). Besimtarët besojnë në besnikërinë e tij dhe kanë besim në vërtetësinë e tij. Karakteri i dashur, besnik dhe veprues i Perëndisë triumfohet shpresa dhe siguria e njerëzimit të shpenguar.

4:20 “Nëse dikush thotë” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkuptonte një veprim të mundshëm. Ky është një tjetër shembull ku Gjoni citon pohimet e mësuesve të rremë me qëllim që të jepte idenë e vet (shih 1:6, 8, 10; 2:4, 6). Kjo teknikë letrare quhet diatribë (shih Malakia, Romakëve dhe Jakobi).

■ **“,e dua Perëndinë”, por urren vëllanë”** Dashuria si stil jetese zbulon qartazi nëse jemi të krishterë (shih Marku 12:28-34). Konflikti është i mundshëm, por urrejtja si stil jetese nuk është e lejueshme (KOHA E TASHME). Shih Temën e Veçantë: Racizmi në Gjoni 4:4.

■ **“është gënjeshtar”** Gjoni quan gënjeshtarë një sërë gjoja-besimtarësh (shih 2:4, 22; 4:20). Po kështu, Gjoni thotë se ata që predikojnë të vërtetë të rreme e bëjnë Perëndinë gënjeshtar (shih 1:6, 10; 5:10). Këta janë patjetër fetaristë të vetëmashtruar!

4:21 Ky varg përmbledh kapitullin! Dashuria është dëshmia e pafalsifikueshme e besimtarit të vërtetë. Urrejtja është dëshmi e fëmijës së të ligut. Mësuesit e rremë po e përçanin tufën dhe po shkaktonin konflikt.

■ **“vëllanë”** Duhet pranuar se fjala “vëlla” është e papërcaktuar. Mund të nënkuptojë “bashkë të krishterim” ose “njerëzit e tjerë”. Megjithatë, nga përdorimi i vazhdueshëm që Gjoni i bën fjalës “vëlla” për të nënkuptuar besimtarët, aludohet për kuptimin e parë (shih 1 Tim. 4:10).

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit tri provat kryesore të krishterimit të vërtetë.

2. Si ta dimë nëse dikush flet vërtet nga Perëndia?
3. Rendit dy burimet e së vërtetës (subjektive dhe objektive).
4. Çfarë është domethënëse për titullin “Shpëtimtari i botës”?
5. Rendit veprimet që nxjerrin në shesh gënjeshtarët (pra, besimtarët e rremë).

1 GJONIT 5

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Besimi është fitore mbi botën	Bindja me anë të besimit 4:20-5:5	Besimi fitimtar	Fitorja jonë mbi botën	
5:1-5		5:1-5	5:1-5	Burimi i besimit
Dëshmia për Birin	Siguria e dëshmisë së Perëndisë		Dëshmia për Jezu Krishtin	5:5-13
5:6-12	5:6-13	5:6-12	5:6-12	
Njohuria e jetës së përjetshme		Përmbyllje	Jeta e përjetshme	
5:13-15	Siguria dhe mëshira në lutje 5:14-17	5:13 5:14-17	5:13-15	Lutja për mëkatarët 5:14-17
5:16-17	Njih të vërtetën, hidh poshtë të rremen		5:16-17	Përmbledhja e letrës
5:18-21	5:18-21	5:18-20 5:21	5:18 5:19 5:20 5:21	5:18-21

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:1-4

¹Kushdo që beson se Jezusi është Krishti, ka lindur nga Perëndia, dhe kushdo që do Atin, do dhe fëmijën e lindur prej tij. ²Nga kjo e dimë se i duam fëmijët e Perëndisë, kur duam Perëndinë dhe zbatojmë urdhërimet e tij. ³Sepse kjo është dashuria e Perëndisë, që të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda. ⁴Sepse çdo gjë që lind nga Perëndia e mposht botën; dhe kjo është fitorja që ka mposhtur botën: besimi ynë.

5:1 “Kushdo” (dy herë) Fjala *pas* përdoret në mënyrë të përsëritur në 1 Gjonit (shih 1 Gjonit 2:29; 3:3, 4, 6 [dy herë], 9, 10; 4:7; 5:1). Askush nuk përjashtohet nga kategoritë teologjike bardhezi të Gjonit. Kjo është ftesa universale e Perëndisë që të pranojmë Jezu Krishtin (shih Gjoni 1:12; 3:16; 1 Tim. 2:4; 2 Pje. 3:9). Kjo është e ngjashme me ftesën madhështore të Palit në Rom. 10:9-13.

▣ **“beson”** Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Ky është emri greqisht (EMËR – *pistis*; FOLJA – *pisteuō*) që mund të përkthehet “besim” ose “besoj”. Megjithatë, në 1 Gjonit dhe në letrat pastorale (1 dhe 2 Timoteut dhe Titit) përdoret shpesh në kuptimin e përmbajtjes doktrinale (shih Juda v. 3, 20). Në ungjijtë dhe në Palin, përdoret në kuptimin e besimit dhe përkushtimit personal. Ungjilli është edhe e vërtetë që duhet besuar, edhe person që duhet besuar edhe, siç bëjnë të qartë 1 Gjonit dhe Jakobi, një jetë dashurie dhe shërbese që duhet jetuar. Shih Temën e Veçantë në Gjoni 2:23.

▣ **“se Jezusi është Krishti”** Thelbi i gabimit të mësuesve të rremë përqendrohet në personin dhe veprën e njeriut Jezus, i cili ishte edhe plotësisht hyjnor (shih v. 5). Jezusi i Nazaretit është Mesia i premtuar! Çuditërisht, Mesia (që vjen si fjalë nga DhV) është edhe hyjnor. Kjo frazë ishte betim, ndoshta në momentin e pagëzimit (shih 2:22), që i shtohet dhe fraza “Biri i Perëndisë” (shih 4:15; 5:5). Me siguri, ky pohim i natyrës mesianike të Jezusit vlente për njerëzit që kishin sfond nga DhV (pra, judenjtë, prozelitët dhe ata që i druheshin Perëndisë).

▣ **“ka lindur nga Perëndia”** Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE, që thekson pikën kulmore të një veprimi, që prodhohet nga një veprues i jashtëm (Perëndia, shih v. 4, 18; 2:29) për të krijuar një gjendje të përhershme ekzistence.

▣

NASB “do dhe fëmijën e lindur prej tij”

NKJV “do atë që ka lindur prej tij:

NRSV “do prindin, do dhe fëmijën”

TEV “do atin, do edhe fëmijën”

NJB “do atin, do dhe të birin”

Ndoshta, kjo frazë flet për dashurinë e Atit për Jezusin për shkak të përdorimit të (1) NJËJËSIT; (2) KOHËS AORISTE; dhe (3) përpjekjeve të mësuesve të rremë për ta ndarë Jezusin teologjikisht nga Ati. Megjithatë, mund të bëjë fjalë edhe për temën e përsëritur të dashurisë së të krishterëve për njëri-tjetrin (shih v. 2), sepse të gjithë kemi të njëjtin Atë.

5:2 Ky varg, bashkë me vargun 3, përsërit një nga temat kryesore të 1 Gjonit. Dashuria, pra, dashuria e Perëndisë, shprehet me anë të dashurisë (2:7-11; 4:7-21) dhe bindjes së vazhdueshme (2:3-6). Vini re faktet e një besimtari të vërtetë.

1. do Perëndinë
2. do fëmijën e Perëndisë (v. 1)
3. do fëmijët e Perëndisë (v. 2)
4. bindet (v. 2-3)
5. triumfon (v. 4-5)

5:3 “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë, që të zbatojmë urdhërimet e tij” GJINORJA mund të jetë KUNDRINORE, ose KRYEFJALORE, ose kombinim i të dyjave. Dashuria nuk është sentimentale, por e orientuar drejt veprimit, si nga ana e Perëndisë, ashtu dhe jona. Bindja është kyçe (shih 2:3-4; 3:22, 24; Gjoni 14:15, 21, 23; 15:10; 2 Gjonit 6; Zbu. 12:17; 14:12).

■ **“urdhërimet e tij nuk janë të rënda”** Besëlidhja e re ka përgjegjësi (shih Mat. 11:29-30, ku Jezusi përdor fjalën “zgjedhë”; rabinët e përdornin për ligjet e Moisiut, Mat. 23:4). Ato rrjedhin nga marrëdhënia jonë me Perëndinë, por nuk përbëjnë bazën e kësaj marrëdhënie, e cila është e bazuar në hirin e Perëndisë, dhe jo në punën ose meritat njerëzore (shih Efe. 2:8-9, 10). Udhëzimet e Jezusit janë shumë të ndryshme nga mësuesit e rremë, të cilët ose nuk kishin rregulla (ishin antinomianë), ose kishin më shumë rregulla se ç’duhet (legalistët)! Duhet të pranojmë se, sa më tepër i shërbej Perëndisë duke u shërbyer njerëzve të tij, aq më tepër u druham dy ekstremeve të libertinizmit dhe legalizimit.

Shih Temën e Veçantë: Përdorimi i Fjalës “Urdhërim” në shkrimet e Gjonit, në Gjoni 12:50.

5:4

NASB, NKJV,

NRSV **“Sepse çdo gjë që lind nga Perëndia”**

TEV, NJB **“u bë çdo fëmijë i Perëndisë”**

Teksti greqisht e vendos të parën fjalën “gjithçka” (*pas*) për efekt theksimi, si në v. 1. Përdoret NJJËSI ASNJANËS (*pan*), që përkthehet “çfarëdo gjë”. Megjithatë, konteksti kërkon një ngjyrim personal (pra, kuptim të përgjithshëm), pasi kombinohet me PJESOREN E KRYER PËSORE të “lindur”. Ai që mposht botën është ai që beson në Jezusin dhe ka lindur nga Perëndia (shih 4:4; 2:13, 14).

■ **“mposht botën”** “Mposht” është DËFTORE E TASHME VEPRORE e *nikaō* (shih 2:13, 14; 4:4; 5:4, 5). Po kjo rrënjë përdoret dy herë të tjera në v. 4.

1. EMRI, “fitore”, *nikē* s

2. PJESORJA AORISTE VEPRORE, *nikaō*, “e ka mposhtur”

Jezusi e ka mposhtur tashmë botën (DËFTORE E KRYER VEPRORE, shih Gjoni 16:33). Për shkak se besimtarët qëndrojnë të bashkuar me të, edhe ata kanë fuqinë që të mposhtin botën (shih 2:13-14; 4:4).

Fjala “botë” këtu do të thotë “shoqëria njerëzore, e organizuar veçmas Perëndisë dhe që funksionon pa të”. Qëndrimi i pavarësisë është thelbi i Rënies dhe i rebelimit njerëzor (shih Zanafilla 3). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 14:17.

■ **“fitorja”** Kjo është forma EMËRORE (*nikos*) e FOLJES “ka mposhtur”. Në fund të v. 4 përdoret PJESORJA AORISTE VEPRORE e së njëjtës rrënjë. Pastaj, sërish në v. 5, përdoret një tjetër formë PJESOREJE e *Rikos*. Besimtarët janë triumfues dhe vazhdojnë të jenë triumfues përmes fitores së Krishtit mbi botën. Fjala “*nike*”, që është kaq e famshme sot nga marka e shquar e atleteve *Nike*, vjen nga i njëjti emër grek i perëndeshës së fitores.

■ **“besimi ynë”** Ky është përdorimi i vetëm i formës EMËRORE të fjalës “besim” (*pistis*) në të gjitha shkrimet e Gjonit! Ndoshta, Gjoni ishte i shqetësuar nga mbitheksimi i “teologjisë së drejtë” (si sistem bindjesh), në dallim nga ecja e përditshme me Krishtin. FOLJA (*pisteuō*) përdoret gjerësisht nga Gjoni. Besimi ynë sjell fitore sepse

1. lidhet me fitoren e Jezusit

2. lidhet me marrëdhënien tonë të re me Perëndinë

3. lidhet me fuqinë e Frymës së Shenjtë brendabanues

Shih Temat e Veçanta në Gjoni 1:7; 2:23; dhe 1 Gjoni 2:10.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:5-12

⁵Kush është ai që mposht botën, përveç atij që beson se Jezusi është Biri i Perëndisë? ⁶Ky është ai që erdhi me anë të ujit dhe gjakut, Jezu Krishti: jo vetëm me anë të ujit, por me anë të ujit dhe gjakut. ⁷Është Fryma ai që dëshmon, sepse Fryma është e vërteta. ⁸Sepse janë tre që dëshmojnë: Fryma, uji dhe gjaku; dhe të tre janë në një mendje. ⁹Nëse pranojmë dëshminë e njerëzve, dëshmia e Perëndisë është më e madhe; sepse kjo është dëshmia e Perëndisë, që ai e ka dëshmuar në lidhje me Birin e vet. ¹⁰Kush beson në Birin e Perëndisë, ka dëshminë në vetvete; kush nuk beson Perëndinë, e ka bërë gënjeshtar, sepse nuk ka besuar në dëshminë që Perëndia ka dhënë në lidhje me Birin e vet. ¹¹Dhe dëshmia është kjo: se Perëndia na ka dhënë jetë të përjetshme, dhe kjo jetë është në Birin e vet. ¹²Kush ka Birin, ka jetën; kush nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën.

5:5 **“Jezusi është Biri i Perëndisë”** Ky varg përcakton qartë përmbajtjen e besimit tonë, që përmendet në v. 4. Fitorja jonë është rrëfimi i besimit tonë në Jezusin, i cili është plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi (shih 4:1-6).

Vini re se besimtarët pohojnë se Jezusi është (1) Mesia (v. 1); (2) fëmija i Perëndisë (v. 1); (3) Biri i Perëndisë (v. 5, 10); dhe (4) Jeta (shih 1:2; 5:20). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 2:23, që rendit të gjitha FJALITË *hoti* që lidhen me FOLJEN “besoj”.

■ **“Biri i Perëndisë”** Shih Temën e Veçantë në 3:8.

5:6 “Ky është ai që erdhi” Kjo është PJESORE AORISTE VEPRORE, që thekson Mishërimin (Jezusi njeri dhe Perëndi) dhe vdekjen e tij flijuese; të dyja këto mohoheshin nga mësuesit e rremë.

■ **“me anë të ujit dhe gjakut”** Duket se “uji” bën fjalë për lindjen fizike të Jezusit (shih Gjoni 3:1-9), ndërsa “gjakut” bën fjalë për vdekjen e tij fizike. Në kontekstin e refuzimit që i bënin mësuesit e rremë gnostikë natyrës së vërtetë njerëzore të Jezusit, këto dy përvoja përmbledhin dhe zbulojnë natyrën e tij njerëzore.

Mundësia tjetër që lidhet me mësuesit e rremë gnostikë (Kerintin) është se “uji” i referohet pagëzimit të Jezusit. Ata thoshin se “shpirti i Krishtit” erdhi mbi njeriun Jezus në pagëzimin e tij (në ujë) dhe e braktisi përpara vdekjes së njeriut Jezus në kryq (gjakut, shih një përmbledhje të saktë në Biblën Studimore NASB, f. 1835).

Një mundësi e tretë është ta lidhim këtë frazë me vdekjen e Jezusit. Heshta bëri që nga trupi i Jezusit të derdhej “ujë dhe gjak” (shih Gjoni 19:34). Mësuesit e rremë ndoshta e nënvlerësonin vdekjen zëvendësuese të Jezusit.

■ **“Është Fryma ai që dëshmon”** Roli i Frymës së Shenjtë është të zbulojë ungjillin. Ai është ajo pjesë e Trinisë që bind për mëkat, çon te Krishti, pagëzon në Krishtin dhe formon Krishtin te besimtari (shih Gjoni 16:7-15). Fryma dëshmon gjithmonë për Krishtin, jo për veten (shih Gjoni 15:26).

■ **“Fryma është e vërteta”** (shih Gjoni 14:17; 15:26; 16:13; 1 Gjonit 4:6). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 6:55 dhe Gjoni 17:3.

5:7 Në përkthimet e Biblës anglisht ekziston njëfarë pështjellimi se ku fillojnë dhe mbarojnë v. 6,7 dhe 8. Pjesa e v. 7 që gjendet në KJV, që thotë “në qiell, Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjtë, dhe këta të tre janë një”, nuk gjendet në tre dorëshkrimet kryesore të lashta greke (me germa të mëdha) të DhR: Aleksandrinus (A), Vatikanus (B), apo Sinaitikus (Ⲱ), dhe as në dorëshkrimet e familjes bizantineve. Ajo shfaqet vetëm në katër dorëshkrime të vona germëvogle.

1. Dorëshkrimi 61, i datuar në shekullin 16
2. Dorëshkrimi 88, i datuar në shekullin 12, ku ky pasazh është futur në skaj të librit nga një dorë e mëvonshme
3. Dorëshkrimi 629, i datuar në shekullin 14 ose 15,
4. Dorëshkrimi 635, i datuar në shekullin 11, ku ky pasazh është futur në skaj të librit nga një dorë e mëvonshme

Ky varg nuk citohet nga asnjë prej Etërve të hershëm të kishës, madje as në debatet e tyre doktrinale për Trininë. Mungon në të gjitha versionet e lashta (përkthimet e Biblës në gjuhë të tjera), me përjashtim të një familjeje të vonët të dorëshkrimeve latinisht (*Siksto-Klementini*). Nuk gjendet as në versionin e vjetër latin, as në Vulgatën e Jeronimit. Shfaqet për herë të parë në një trajtesë të heretikut spanjoll Prishilianit, i cili vdiq në 385 pas K. Citohet nga etërit latinë në Afrikën veriore dhe në Itali në shekullin e pestë. Ky varg nuk është aspak pjesë e fjalëve origjinale e të frymëzuara të 1 Gjonit.

Doktrina biblike e një Perëndie (monoteizmi), por me tre shfaqje personale (Ati, Biri dhe Fryma), nuk ndikohet nga refuzimi i këtij vargu. Ndonëse është e vërtetë se Bibla nuk e përdor kurrë fjalën “trini”, shumë pasazhe biblike flasin për faktin se tre personat e Hyjnisë veprojnë së bashku:

1. në pagëzimin e Jezusit (Mat. 3:16-17)
2. në porosinë e madhe (Mat. 28:19)
3. dërgimi i Frymës (Gjoni 14:26)
4. predikimi i Pjetrit ditën e Rrëshajave (Veprat 2:33-34)
5. diskutimi që i bën Pali mishit dhe frymës (Rom. 8:7-10)
6. diskutimi që u bën Pali dhuntive shpirtërore (1 Kor. 12:4-6)
7. planet e udhëtimeve të Palit (2 Kor. 1:21-22)
8. urata e Palit për besimtarët (2 Kor. 13:14)
9. diskutimi që i bën Pali plotësimit të kohës (Gal. 4:4-6)
10. lutja lavdëruese e Palit për Atin (Efe. 1:3-14)

11. diskutimi i Palit për tëhuajtjen e mëparshme të johebrenjve (Efe. 2:18)
12. diskutimi i Palit për faktin se Perëndia është një (Efe. 4:4-6)
13. diskutimi i Palit për mirësinë e Perëndisë (Titit 3:4-6)
14. hyrja e Pjetrit (1 Pje. 1;2)

Shih Temën e Veçantë për Trininë, në Gjoni 14:26.

5:8 „Fryma, uji dhe gjaku; dhe të tre janë në një mendje” Në DhV, dy ose tre dëshmitarë nevojiteshin për të vërtetuar një çështje (shih LiP. 17:6; 19:15). Këtu, ngjarjet historike të jetës së Jezusit jepen si dëshmitare të natyrës së tij të plotë njerëzore dhe hyjnore. Në këtë varg, “uji” dhe “gjaku” përmenden sërish së bashku me “Frymën”. Fjalët “ujë” dhe “gjak” përmenden në v. 6. “Fryma” ndoshta i referohet pagëzimit të Jezusit për shkak të zbritjes së pëllumbit mbi të. Ka njëfarë debati për aludimin e saktë historik që përfaqëson secili prej këtyre të treve. Patjetër që duhet të kenë lidhje me refuzimin që i bënin mësuesit e rremë natyrës së vërtetë njerëzore të Jezusit.

5:9 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për hir të qëllimeve të tij letrare. Kishat, të cilave po u shkruan Gjoni, ishin të pëshptjelluara sepse, me sa duket, kishin dëgjuar predikimet ose mësime të mësuesve gnostikë.

▣ **“Nëse pranojmë dëshminë e njerëzve, dëshmia e Perëndisë është më e madhe”** Kjo dëshmi hyjnore, në kontekst, i referohet

1. dëshmisë së Frymës së Shenjtë
2. dëshmisë së apostujve për jetën dhe vdekjen e Jezusit (shih 1:1-3)

▣ **“ai e ka dëshmuar në lidhje me Birin e vet”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE që nënkupton një veprim në të shkuarën që tani është përmbushur, por pasojat e tij vazhdojnë. Ndoshta, bëhet fjalë për miratimin e zëshëm të Perëndisë në pagëzimin e Jezusit (shih Mat. 3:17), ose në shndërrimin në mal (shih Mat. 17:5; Gjoni 5:32, 37; 8:18), ose për shkrimin e këtyre të dyjave në Shkrim (shih ungujijtë). Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit, në Gjoni 1:8.

5:10 “ka dëshminë në vetvete” Këtë frazë mund ta interpretojmë në dy mënyra.

1. dëshmia e brendshme dhe subjektive e Frymës në besimtarët (shih Rom. 8:16)
2. e vërteta e ungujllit (shih Zbu. 6:10; 12:17; 19:10)

Shih Temën e Veçantë: Dëshmitarët e Jezusit në Gjoni 1:8.

▣ **“e ka bërë gënjeshtar”** Kjo është një tjetër DËFTORE E KRYER VEPRORE. Ata që refuzojnë dëshminë apostolike për Jezusin, refuzojnë Perëndinë (shih v. 12), sepse e bëjnë gënjeshtar Perëndinë.

▣ **“sepse nuk ka besuar”** Kjo është një tjetër DËFTORE E KRYER VEPRORE, që thekson gjendjen e palëkundshme të të parilindurit.

5:11-12 “se Perëndia na ka dhënë jetë të përjetshme” Kjo është një DËFTORE AORISTE VEPRORE, që bën fjalë për një veprim të shkuar, ose një veprim të përfunduar (shih Gjoni 3:16). Jeta e përjetshme përcaktohet në Gjoni 17:3. Në disa raste, kjo frazë i referohet vetë Jezusit (shih 1:2; 5:20), ndërsa në disa raste të tjera është dhuratë nga Perëndia (shih 2:25; 5:11; Gjoni 10:28), e cila merret me anë të besimit në Krishtin (shih 5:13; Gjoni 3:16). S’mund të kesh bashkësi me Atin pa besim personal në Birin!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:13-15

¹³Këto gjëra jua kam shkruar juve që besoni në emër të Birit të Perëndisë, që të dini se keni jetë të përjetshme. ¹⁴Kjo është siguria që kemi para tij, që, nëse kërkojmë çfarëdo gjëje sipas vullnetit të tij, ai na dëgjon. ¹⁵Dhe, nëse e dimë se ai na dëgjon në çfarëdo gjë që i kërkojmë, e dimë se i kemi kërkesat që kemi kërkuar prej tij.

5:13 besoni në emër” Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE, që thekson besimin e vazhdueshëm. S’bëhet fjalë për ndonjë përdorim magjik apo mistik të emrit (si misticizmi jude, i bazuar në emrat e Perëndisë, *Kabbala*), por për përdorimin në DhV të emrit si përfaqësues i personit që e mban. Shih Temën e Veçantë në Gjoni 2:23.

■ **“që të dini”** Kjo është LIDHORE E KRYER VEPRORE (*oida* ka formë TË KRYER, por përkthehet si E TASHME). Siguria e shpëtimit është koncept kyç, madje një synim i shprehur shpesh te 1 Gjonit. Ka dy sinonime greqisht (*oida* dhe *ginōskō*) që përdoren gjatë gjithë kësaj letre/predikimi, të cilat përkthehen “di/njoh”. Është e qartë se siguria është trashëgimi e gjithë besimtarëve! Po kështu, është e qartë se, për shkak të situatës lokale atëherë dhe kontekstit kulturor të tanishëm, ka besimtarë të vërtetë që nuk kanë siguri shpëtimi. Ky varg është i ngjashëm nga ana teologjike me përmbylljen e ungjillit të Gjonit (shih 20:31).

Konteksti përmbyllës i 1 Gjonit (5:13-20) rendit shtatë gjëra që dinë besimtarët. Njohuria që kanë ata për të vërtetat e ungjillit na siguron një botëkuptim që, kur kombinohet me besimin personal në Krishtin, përbën themelin e patundur të sigurisë së shpëtimit.

1. besimtarët kanë jetë të përjetshme (v. 13, *oida*, LIDHORE E KRYER VEPRORE)
2. Perëndia dëgjon lutjet e besimtarëve (v. 15, *oida*, DËFTORE E KRYER VEPRORE)
3. Perëndia u përgjigjet lutjeve të besimtarëve (v. 14, *oida*, DËFTORE E KRYER VEPRORE)
4. besimtarët kanë lindur nga Perëndia (v. 18, *oida*, DËFTORE E KRYER VEPRORE)
5. besimtarët janë nga Perëndia (v. 19, *oida*, DËFTORE E KRYER VEPRORE)
6. besimtarët e dinë se Mesia ka ardhur dhe u ka dhënë njohuri (v. 20, *oida*, DËFTORE E KRYER VEPRORE)
7. besimtarët e njohin të Vërtetin – ose Atin, ose Birin (v. 20, *ginōskō*, LIDHORE E TASHME VEPRORE)

TEMË E VEÇANTË: SIGURIA E SHPËTIMIT

- A. A mund ta dinë të krishterët se janë të shpëtuar (shih 1 Gjonit 5:13)? 1 Gjonit ka tre prova ose dëshmi.
 1. Doktrinë (besimi) (shih v. 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16; 5:11-12)
 2. Të stilit të jetesës (bindja) (shih 2-3; 2:3-6; 3:1-10; 5:18)
 3. Shoqërore (dashuria) (v. 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)
- B. Siguria e shpëtimit është bërë çështje denominacionale
 1. Gjon Kalvini e bazonte sigurinë e shpëtimit në zgjedhjen e Perëndisë. Ai thoshte se nuk mund të jemi kurrë të sigurt në këtë jetë.
 2. Gjon Uezli e bazonte sigurinë në përjetimin fetar. Ai besonte se ne kemi aftësinë të jetojmë pa kryer mëkate të njohura.
 3. Katolikët romakë dhe denominacioni “Kisha e Krishtit” e bazojnë sigurinë e shpëtimit në kishën e autoritetshme. Grupi të cilit i përket njeriu është çelësi për të patur siguri shpëtimi.
 4. Shumica e ungjillorëve e bazojnë sigurinë në premtimet e Biblës, që lidhet me frytin e Frymës në jetën e besimtarit (shih Gal. 5:22-23).
- C. Unë mendoj se siguria parësore e njerëzimit të rënë lidhet me karakterin e Perëndisë triumfator
 1. dashuria e Perëndisë Atë
 - a. Gjoni 3:16; 10:28-29
 - b. Romakëve 8:31-39
 - c. Efesianëve 2:5, 8-9
 - d. Filipianëve 1:6
 - e. 1 Pjetrit 1:3-5
 - f. Gjoni 4:7-21
 2. veprimet e Perëndisë Bir
 - a. vdekja për hirin tonë
 - 1) Veprat 2:23
 - 2) Romakëve 5:6-11
 - 3) 2 Korintasve 5:21
 - 4) 1 Gjonit 2:2; 4:9-10
 - b. lutja kryepriiftërore (Gjoni 17:12)
 - c. ndërmjetësimi i vazhdueshëm
 - 1) Romakëve 8:34
 - 2) Hebrenjve 7:25
 - 3) 1 Gjonit 2:1

3. shërbesa e Perëndisë Frymë
 - a. thirrja (Gjoni 6:44, 65)
 - b. vulosja
 - 1) 2 Korintasve 1:22; 5:5
 - 2) Efesianëve 1:13-14; 4:3
 - c. dhënia e sigurisë
 - 1) Romakëve 8:16-17
 - 2) 1 Gjonit 5:7-13
- D. Por njerëzit duhet t'i përgjigjen ofertës së besëlidhjes së Perëndisë (qoftë në fillim, ashtu dhe në vazhdimësi)
 1. besimtarët duhet t'i kthejnë shpinën mëkatit (pendimi) dhe të kthehen te Perëndia përmes Jezusit (besimi)
 - a. Marku 1:15
 - b. Veprat 3:16, 19; 20:21
 2. besimtarët duhet të marrin ofertën e Perëndisë në Krishtin
 - a. Gjoni 1:12; 3:16
 - b. Romakëve 5:1 (dhe, në mënyrë të ngjashme, 10:9-13)
 3. besimtarët duhet të vazhdojnë në besim
 - a. Marku 13:13
 - b. 1 Korintasve 15:2
 - c. Galatasve 6:9
 - d. Hebrenjve 3:14
 - e. 2 Pjetrit 1:10
 - f. Juda 20-21
 - g. Zbulesa 2:2-3, 7, 10, 17, 19, 25-26; 3:5, 10, 11, 21
 4. besimtarët përballen me tre sprova
 - a. doktrimore (v. 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16)
 - b. të stilit të jetesës (v. 2-3; 2:3-6; 3:1-10)
 - c. shoqërore (v. 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)
- E. Siguria e shpëtimit është e vështirë sepse
 1. shpesh, besimtarët kërkojnë disa përjetime që nuk premtohen në Bibël
 2. shpesh, besimtarët nuk e kuptojnë plotësisht ungiillin
 3. shpesh, besimtarët vazhdojnë të mëkatojnë me dashje (shih 1 Kor. 3:10-15; 9:27; 1 Tim. 1:19-20; 2 Tim. 4:10; 2 Pje. 1:8-11)
 4. disa lloje personaliteti (pra, perfeksionistët) s'e pranojnë dot kurrë pranimin dhe dashurinë e pakushtëzuar të Perëndisë
 5. në Bibël ka shembuj rrëfimesh të rreme besimi (shih Mat. 13:3-23; 7:21-23; Marku 4:14-20; 2 Pje. 2:19-20; 1 Gjonit 2:18-19)

5:14: “siguria që kemi para tij” Kjo është temë që rishfaqet (shih 2:28; 3:21; 4:17). Ajo shpreh guximin, ose lirinë, që kemi kur i afrohem Perëndisë (shih Heb. 4:16). Shih Temën e Veçantë në Gjoni 7:4.

■ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton një veprim të mundshëm.

■ **“nëse kërkojmë çfarëdo gjëje sipas vullnetit të tij”** Thëniet e Gjonit duket se nuk kufizohen nga aftësia e besimtarit për t'iu lutur Perëndisë. Një dëshmi tjetër e besimtarit të vërtetë është mënyra si lutet dhe gjërat për të cilat lutet. Për më tepër, kur e shqyrtojmë më tej, kuptojmë se lutja nuk është të kërkojmë vullnetin tonë, por të kërkojmë vullnetin e Perëndisë për jetën tonë (shih 3:22; Mat. 6:10; Marku 14:36). Shih shënimin më të plotë në 3:22. Për Temën e Veçantë: Vullneti i Perëndisë, shih Gjoni 4:34. Shih Temën e Veçantë: Lutja, e Pakufizuar, por e Kufizuar, në 3:22.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA NDËRMJETËSUESE

I.

Hyrje

- A. Lutja është e rëndësishme për shkak të shembullit të Jezusit.
 1. Lutja personale (Marku 1:35; Luka 3:21; 6:12; 9:29; 22:31-46)
 2. Pastrimi i Tempullit (Mat. 21:13; Marku 11:17; Luka 19:46)
 3. Lutja model (Mat. 6:5-13; Luka 11:2-4)
- B. Lutja është vënia në veprim konkret e besimit tonë në Perëndinë personal dhe të dashur i cili është i pranishëm, i gatshëm dhe ia aftë të veprojë për hirin tonë dhe të tjerëve, përmes lutjeve tona.
- C. Perëndia e ka kufizuar personalisht veten për të vepruar në bazë të lutjeve të fëmijëve të tij në shumë zona (shih Jakobi 4:2)
- D. Synimi kryesor i lutjes është bashkësia dhe koha jonë me Perëndinë trium.
- E. Gama e lutjes është gjithçka ose kushdo që preokupon besimtarët. Ne mund të lutemi një herë (me besim), ose në mënyrë të përsëritur, sa herë që na kthehet në mendje preokupimi në fjalë.
- F. Lutja mund të përfshijë një sërë elementesh
 1. lavdërimi dhe adhurimi i Perëndisë trium
 2. falënderimi i Perëndisë për praninë, miqësinë dhe furnizimin e tij
 3. rrëfimi i mëkatit tonë, si të kaluar ashtu dhe të tashëm
 4. lutje për nevojat ose dëshirat tona të perceptuara
 5. ndërmjetësim, kur sjellim para Atit nevojat e të tjerëve
- G. Lutja ndërmjetësuese është mister. Perëndia i do shumë më tepër se ne personat për të cilët lutemi, mirëpo, shpesh, lutjet tona shkaktojnë një ndryshim, përgjigje, ose nevojë, jo vetëm në ne, por edhe ë ta.

II.

Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Disa shembuj të lutjes ndërmjetësuese:
 - a. Abrahami përgjërohet për Sodomën (Zan. 18:22 e më tej)
 - b. Lutjet e Moisiut për Izraelin
 - (1) Eksodi 5:22-23
 - (2) Eksodi 32:31 e më tej
 - (3) Ligji i Përtërirë 5:5
 - (4) Ligji i Përtërirë 9:18, 25 e më tej
 - c. Samueli lutet për Izraelin:
 - (1) 1 Samuelit 7:5-6, 8-9
 - (2) 1 Samuelit 12:16-23
 - (3) 1 Samuelit 15:11
 - d. Davidi lutet për fëmijën e vet, 2 Samueli 12:16-18
2. Perëndia kërkon ndërmjetësues, Isaia 59:16
3. Mëkati i njohur dhe i parrëfyer, ose qëndrimi i papenduar, ndikon në lutjet tona
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2; 64:7

B. Dhiata e Re

1. Shërbesa ndërmjetësuese e Birit dhe Frymës
 - a. Jezusi
 - (1) Romakëve 8:34
 - (2) Hebrenjve 7:25
 - (3) 1 Gjonit 2:1
 - b. Fryma e Shenjtë, Romakëve 8:26-27
2. Shërbesa ndërmjetësuese e Palit
 - a. Lutet për judenjtë
 - (1) Romakëve 9:1 e më tej
 - (2) Romakëve 10:1
 - b. Lutet për kishat
 - (1) Romakëve 1:9

- (2) Efesianëve 1:16
- (3) Filipianëve 1:3-4, 9
- (4) Kolosianëve 1:3, 9
- (5) 1 Thesalonikasve 1:2-3
- (6) 2 Thesalonikasve 1:11
- (7) 2 Timoteut 1:3
- (8) Filemonit, v. 4
- c. Pali u kërkoi kishave të luten për të
 - (1) Romakëve 15:30
 - (2) 2 Korintasve 1:11
 - (3) Efesianëve 6:19
 - (4) Kolosianëve 4:3
 - (5) 1 Thesalonikasve 5:25
 - (6) 2 Thesalonikasve 3:1
- 3. Shërbesa ndërmjetësuese e kishës
 - a. Lutuni për njëri-tjetrin
 - (1) Efesianëve 6:18
 - (2) 1 Timoteut 2:1
 - (3) Jakobit 5:16
 - b. Kërkohen lutje për grupe të veçanta
 - (1) Armiqtë tanë, Mat. 5:44
 - (2) Punëtorët e krishterë, Hebrenjve 13:18
 - (3) Sundimtarët, 1 Timoteut 2:2
 - (4) Të sëmurët, Jakobit, 5:13-16
 - (5) Ata që rrëshqasin në besim, 1 Gjonit 5:16
- III. Kushtet për lutjen që merr përgjigje
 - A. Marrëdhënia jonë me Krishtin dhe me Frymën
 - 1. Qëndroni në të, Gjoni 15:7
 - 2. Në emër të tij, Gjoni 14:13, 14; 15:16; 16:23-24
 - 3. Në Frymën, Efesianëve 6:18; Juda 20
 - 4. Sipas vullnetit të Perëndisë, Mateu 6:10; 1 Gjonit 3:22; 5:14-15
 - B. Motivet
 - 1. Pa u lëkundur, Mateu 21:22; Jakobi 1:6-7
 - 2. Përlësi dhe pendim, Luka 18:9-14
 - 3. Kur kërkohet gabim, Jakobi 4:3
 - 4. Egoizmi, Jakobi 4:2-3
 - C. Aspekte të tjera
 - 1. Qëndresa
 - a. Luka 18:1-8
 - b. Kolosianëve 4:2
 - 2. Kërkoni vazhdimisht
 - a. Mateu 7:7-8
 - b. Luka 11:5-13
 - c. Jakobi 1:5
 - 3. Mosmarrëveshjet në familje, 1 Pjetrit 3:7
 - 4. Të mos keni asnjë mëkat të ditur
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2
 - d. Isaia 64:7
- IV. Përmbyllje teologjike
 - A. Sa privilegj, mundësi, detyrë dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme!
 - B. Jezusi është shembulli ynë. Fryma është udhërrëfyësi ynë. Ati po na pret me shumë përmallim.
 - C. Kjo mund të të ndryshojë ty, familjen, miqtë dhe botën.

5:15 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË (por me *ean* dhe me DËFTORE, shih A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, f. 243), që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij letrare. Kjo është një fjali e pazakontë kushtore.

1. ka *ean*, në vend të *ei* (shih Veprat 8:31; 1 Thes. 3:8)
2. ka *ean* të lidhur me një LIDHORE (pra, kërkojmë), që është forma normale gramatikore për KUSHTOREN E KLASIT TË TRETË
3. ka KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË edhe në v. 14 dhe 16
4. teologjia e lutjes së të krishterit lidhet me vullnetin e Perëndisë (v. 14) dhe me emrin e Jezusit (v. 13)

■ **“e dimë”** Kjo është një tjetër DËFTORE E KRYER VEPRORE, e përkthyer si e TASHME, që është paralele me v. 14. Siguria e besimtarit është se Ati i dëgjon dhe u përgjigjet fëmijëve të tij.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:16-17

¹⁶Nëse dikush sheh vëllanë e vet që kryen një mëkat që nuk çon në vdekje, duhet të lutet dhe, për hir të tij, Perëndia do t’u japë jetë atyre që kryejnë mëkat që nuk çon në vdekje. Ka dhe mëkat që çon në vdekje; nuk them se duhet të lutet për këtë. ¹⁷Çdo padrejtësi është mëkat, por ka mëkat që nuk çon në vdekje.

5:16 “Nëse” Kjo është KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm. Vargu 16 thekson nevojën që të lutemi për të krishterët e tjerë (shih Gal. 6:1; Jakobi 5:13-18) brenda disa caqeve të caktuara (jo për mëkatin që çon në vdekje), që duket se lidhet me mësuesit e rremë (shih 2 Pje. 2).

■ **“sheh vëllanë e vet që kryen një mëkat që nuk çon në vdekje”** Gjoni ka renditur një sërë kategorish për mëkatin. Disa lidhen me (1) bashkësinë tonë me Perëndinë; (2) bashkësinë me besimtarët e tjerë; dhe (3) bashkësinë me botën. Mëkati absolut është refuzimi i besimit në Jezu Krishtin. Ky është mëkati që çon në vdekjen përfundimtare! W. T. Conners, në librin e tij *Christian Doctrine* (Doktrina e krishterë), thotë:

“Gjithsesi, kjo nuk nënkupton mosbesimin në kuptimin e refuzimit për të pranuar një doktrinë ose dogmë të caktuar. Këtu bëhet fjalë për mosbesim që nënkupton refuzimin e dritës morale dhe shpirtërore, veçanërisht si dritë e mishëruar në Jezu Krishtin. Është refuzim i zbulesës përfundimtare të Perëndisë në Krishtin. Kur ky refuzim bëhet i pakthyeshëm dhe kokëfortë, shndërrohet në mëkatin që çon në vdekje (1 Gjonit 5:13-17). Kështu, kthehet në vetëvrasje shpirtërore. Si të thuash, njeriu i nxjerr vetë sytë nga ana shpirtërore. Kjo ndodh vetëm në lidhje me një shkallë të lartë përndritjeje. Përbën refuzimin e qëllimshëm, të vullnetshëm dhe të lig të Krishtit si zbulesa e Perëndisë, ndonëse personi e di se ai është zbulesë e tillë. Është njësoj si ta quash qëllimisht të zezën të bardhë” (f. 135-136).

TEMË E VEÇANTË: ÇFARË ËSHTË MËKATI QË ÇON NË VDEKJE?

A. Shqyrtime hermeneutike

1. Identifikimi i duhur duhet lidhur me kontekstin historik të 1 Gjonit
 - a. prania e mësuesve të rremë gnostikë në kisha (shih 2:19, 26; 3:7; 2 Gjonit 7)
 - (1) gnostikët “kerintas” mësonin se njeriu Jezus mori frymën “Krisht” në pagëzim dhe se fryma “Krisht” e la përpara se të vdiste në kryq (shih 5:6-8)
 - (2) gnostikët docetikë mësonin se Jezusi ishte frymë hyjnor, por jo qenie e vërtetë njerëzore (shih 1:1-3)
 - (3) gnosticizmi, i zbuluar në shkrimet e shekullit të dytë, reflektonte dy pikëpamje të ndryshme për trupin njerëzor
 - (a) meqë shpëtimi ishte një e vërtetë që i zbulohet mendjes, trupi njerëzor ishte i parëndësishëm për sferën shpirtërore. Prandaj, trupi mund të merrte ç’ të dëshironte. Shpesh, këta quhen gnostikë “antinomianë” ose “libertinë”.
 - (b) grupi tjetër arrinte në përfundimin se, meqë trupi ishte qenësish i lig (pra, filozofia greke), çdo dëshirë trupore duhet shmangur. Këta quhen gnostikët “asketë”.
 - b. këta mësues të rremë ishin larguar nga kisha (shih 2:19), por ndikimi i tyre ishte ende aty!
2. identifikimi i duhur duhet lidhur me kontekstin letrar të gjithë librit
 - a. 1 Gjonit u shkrua për të luftuar mësimin e rremë dhe për të siguruar besimtarët e vërtetë
 - b. këto dy synime mund të shihen në provat e besimtarëve të vërtetë

- (1) doktrinare
 - (a) Jezusi ishte vërtet njeri (shih 1:1-3; 4:14)
 - (b) Jezusi ishte vërtet Perëndi (shih 1:2; 5:20)
 - (c) Njerëzit janë të mëkatshëm dhe përgjegjës para një Perëndie të shenjtë (shih 1:6, 10)
 - (d) Po kështu, njerëzit falen dhe bëhen të drejtë para Perëndisë me anë të
 - i. vdekjes së Jezusit (shih 1:7; 2:1-2; 3:16; 4:9-10,14; 5:6-8)
 - ii. besimit në Jezusin (shih 1:9; 3:23; 4:15; 5:1,4-5,10-12,13)

- (2) praktike (pozitive)
 - (a) bindja si stil jetese (shih 2:3-5; 3:22,24; 5:2-3)
 - (b) dashuria si stil jetese (shih 2:10; 3:11,14,18,23; 4:7,11-12,16-18,21)
 - (c) ngjashmëria me Krishtin si stil jetese (“nuk mëkaton”, shih 1:7; 2:6,29; 3:6-9; 5:18)
 - (d) fitorja mbi ligësinë si stil jetese (shih 2:13, 14; 4:4; 5:4)
 - (e) fjala e tij banon në ta (shih 1:10; 2:14)
 - (f) ata kanë Frymën (shih 3:24; 4:4-6, 13)
 - (g) lutja që merr përgjigje (shih 5:14-15)

- (3) praktike (negative)
 - (a) mëkati si stil jetese (shih 3:8-10)
 - (b) urrejtja si stil jetese (shih 2:9, 11; 3:15; 4:20)
 - (c) mosbindja si stil jetese (shih 2:4; 3:4)
 - (d) njeriu që do botën (shih 2:15-16)
 - (e) mohimi i Krishtit (“mohon Atin dhe Birin”, shih 2:22-23; 4:2-3; 5:10-12)

3. identifikimi i saktë duhet lidhur me elementet specifike në pasazhin e duhur (shih 5:16-17)
 - a. a lidhet termi “vëlla” (v. 16) vetëm me ata që kryejnë një mëkat që nuk çon në vdekje, apo edhe me ata që kryejnë mëkatin që çon në vdekje?
 - b. a ishin këta shkelës dikur anëtarë të kishës (shih 2:19)?
 - c. cila është domethënia tekstuale e:
 - (1) mungesës së njëjës shquese në fjalën “mëkat”?
 - (2) FOLJA “sheh” si KUSHTORE E KLASIT TË TRETË me një LIDHORE AORISTE VEPRORE?
 - d. si mundën lutjet e një të krishteri (shih Jakobi 5:15-16) që t’i rikthejnë dikujt tjetër jetën e përjetshme (zōē) pa pendimin personal të mëkatarit në fjalë?
 - e. si lidhet v. 17 me llojet e mëkatis (që çon në vdekje, që nuk çon në vdekje)?

B. Probleme teologjike

1. a duhet interpretuesi që të përpiket ta lidhë këtë pasazh me
 - a. mëkatin “e pafalshëm” të ungjijve?
 - b. mëkatin “pasi mohon besimin” të Hebrenjve 6 dhe 10

Konteksti i 1 Gjonit duket vërtet si paralel me mëkatin e pafalshëm të farisenjve në ditën e Jezusit (shih Mat. 12:22-37; Marku 3:2-29), si dhe me judenjtë mosbesues të Hebrenjve 6 dhe 10. Të tre këto grupe (farisenjtë, judenjtë mosbesues dhe mësuesit e rremë gnostikë) e dëgjonin qartë ungjillin, por refuzonin të besonin në Jezu Krishtin.

2. a duhet që pyetjet e sotme denominacionale të shërbejnë si kornizë teologjike për të kuptuar këtë pasazh?

Bota ungjillore e ka mbitheksuar fillimin e përjetimit të krishterë dhe ka anashkaluar dëshmitë e stilit të jetesës për të provuar besimin e vërtetë. Pyetjet tona teologjike moderne do t’i kishin tronditur të krishterët e shekullit të parë. Ne duam që “siguria” të bazohet në “pasazhe prova” biblike dhe në deduksionet tona logjike, ose në anësitë tona denominacionale.

Pyetjet, kornizat dhe dallimet tona teologjike reflektojnë pasiguritë tona. Ne duam më shumë informacione dhe qartësime nga ç’na siguron Bibla, kështu që teologjitë tona sistematike marrin pjesë të vogla të Shkrimit dhe thurin rrjete të stërmëdha doktrinash logjike, specifike dhe perëndimore!

Fjalët e Jezusit në Mateu 7 dhe Marku 7 i mjaftonin kishës së hershme! Jezusi kërkonte dishepuj, jo vendime; besim afatgjatë si stil jetese, jo besim afatshkurtër emocional (shih Mat. 13:10-23; Gjoni 8:31-59). Krishterimi nuk është një veprim i izoluar i së shkuarës, por një pendim, besim, bindje dhe qëndresë e vazhdueshme. Krishterimi nuk është biletë për në qiell, që e ke blerë në të shkuarën, as siguracion kundër zjarri që paguhet për të të mbrojtur nga një stil jetese i mbushur me egoizëm dhe paperëndishmëri!

3. Ç'nënkupton mëkati që çon në vdekje: vdekjen fizike, apo atë të përjetshme? Përdorimi që i bën Gjoni fjalës *zōē* në këtë kontekst nënkupton se kontrasti në fjalë ka parasysh vdekjen e përjetshme. A është e mundur që Perëndia të marrë (me anë të vdekjes fizike) fëmijët që mëkatojnë? Nënkuptimi i këtij konteksti është se (1) lutjet e bashkëbesimtarëve dhe (2) pendimi personal i shkelësit kombinohen për t'i ripërtërirë besimtarët, por nëse vazhdojnë me një stil jetese që i sjell turpëri komunitetit besimtar, atëherë rezultati mund të jetë një largim "i parakohshëm" ose i hershëm fizik nga kjo jetë (shih *When Critics* [Kur kritikët], nga Norman Geisler dhe Thomas Howe, f. 541)

■ **"për hir të tij, Perëndia do t'u japë jetë"** Problemi teologjik dhe leksikor këtu është kuptimi i fjalës "jetë" (*zōē*). Shkrimet e Gjoni e përmendin këtë fjalë për ta lidhur me jetën e përjetshme, por, në këtë kontekst, duket se ajo nënkupton rimëkëmbjen e shëndetit ose faljen (pra, si përdorimi që i bën Jakobi fjalës "shpëtohem" në Jakobi 5:13-15). Personi për të cilin bëhet lutja quhet "vëlla"; kjo nënkupton fuqishëm një besimtar (nga përdorimi që i bën vetë Gjoni kësaj fjale kur u flet lexuesve).

5:17 Çdo mëkat është serioz, por çdo mëkat mund të falet përmes pendimit (fillestar, shih Marku 1:15; Veprat 20:21; të vazhdueshëm, shih 1 Gjonit 1:9) dhe besimit në Krishtin, përveç mëkatit të mosbesimit!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:18-20

¹⁸E dimë se askush që lindet nga Perëndia nuk mëkaton; por Ai që lindi nga Perëndia e ruan, dhe i ligu nuk e prek. ¹⁹E dimë se jemi të Perëndisë dhe se gjithë bota dergjet nën pushtetin e të ligut. ²⁰Dhe e dimë se Biri i Perëndisë ka ardhur dhe na ka dhënë njohuri, që të mund të njohim Atë që është i vërtetë; dhe ne jemi në Atë që është i vërtetë, në Birin e tij Jezu Krishtin. Ky është Perëndia i vërtetë dhe jeta e përjetshme.

5:18 "E dimë" Shih shënimet në paragrafin e dytë të 5:13.

■ **"askush që lindet nga Perëndia nuk mëkaton"** Kjo është PJESORE E KRYER PËSORE. Ky është një pohim bardhezi i 3:6 dhe 9. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme. Stili i jetesës së mësuesve të rremë antinomianë zbulonte zemrën e tyre të parilindur (shih Mateu 7)!

Gjoni po u drejtohet dy llojeve të ndryshme mësuesish të rremë. Njëri grup mohonte çdo lloj përfshirjeje me mëkatin (shih 1:8-2:1) ndërsa tjetri thoshte se mëkati s'kishte vlerë (shih 3:4-10 dhe këtu). Mëkati duhet rrëfyer fillimisht dhe duhet shmangur ekzistencialisht. Mëkati është problemi kryesor, madje është vazhdimisht problem (shih 5:21).

Bruce Metzger, *A Textual Commentary of the Greek New Testament* (f. 718), shprehet se ndryshimet në dorëshkrimet greke bazohet në atë që mendonin kopjuesit se nënkuptonte fraza "lindet nga Perëndia".

1. Jezusit – në këtë rast, më e përshtatshme është *auton* (A*, B*)
2. Besimtarëve – atëherë, *eauton* është më e përshtatshme (⋈, A^c)

UBS⁴ i jep #1 vlerësimin "B" (pothuajse e sigurt).

■ **"por Ai që lindi nga Perëndia e ruan"** FOLJA e parë është PJESORE AORISTE PËSORE, që nënkupton një veprim të përfunduar, të kryer nga një veprues i jashtëm (pra, Fryma, shih Rom. 8:11). Kjo i referohet Mishërimit.

FOLJA e dytë është DËFTORE E TASHME VEPRORE, dhe shoqëron "atë" (*auton*). Fjalë për fjalë, thuhet "Ai që lindi nga Perëndia vazhdon ta ruajë". Kjo bën fjalë për faktin se Krishti e mbron vazhdimisht besimtarin. Ky përkthim ndjek dorëshkrimet e lashta germëmëdha greke A* dhe B*. Ky interpretim gjendet në përkthimet anglisht të Biblës NASB, RSV dhe NIV.

Dorëshkrimet ⋈ dhe A^c përmbajnë një PËREMËR tjetër, "ruan veten" (*eauton*), që nënkupton se ai që ka lindur nga Perëndia ka përgjegjësinë që të ruajë veten. FOLJA e përdorur këtu "ka lindur" nuk përdoret asgjëkund tjetër për Jezusin. Koncepti vetëvepror përdoret për besimtarët në 3:3 dhe 5:21. Ky interpretim ndiqet nga përkthimet anglisht të Biblës KJV dhe ASV.



NASB “dhe i ligu nuk e prek”

NKJV “i ndyri nuk e prek”

NRSV “i ligu nuk i prek”

TEV “i Ligu nuk i prek”

NJB “i Ligu nuk ka pushtet mbi të”

Kjo është DËFTORE E TASHME MESORE, që nënkupton se i ligu nuk mund të vazhdojë “ta mbajë nën pushtetin e tij”. I vetmi përdorim tjetër i këtij termi në shkrimet e Gjonit është në ungjillin e tij, 20:17. Është e qartë nga Bibla dhe përvoja se të krishterët tundohen.

Ka patur tre teori kryesore për kuptimin e kësaj fraze.

1. besimtarët janë të lirë nga dënimi i të ligut që bazohet në shkeljen e ligjit (shfajësimi)
2. Jezusi lutet për ne (shih 1 Gjonit 2:1; Luka 22:32-33)
3. Satani nuk mund të na e rrëmbejë shpëtimin (shih Rom. 8:31-39), por ai mund t’ia prishë dëshminë Perëndisë në jetën tonë dhe për këtë arsye, në bazë të v.16-17, besimtari mund të largohet para kohe nga kjo botë!

5:19 “E dimë se jemi të Perëndisë” Kjo është siguria që vjen nga besimi i sigurt, botëkuptimi i besimtarit në Krishtin Jezusit (shih 4:6). Gjithçka tjetër bazohet në këtë të vërtetë të mrekullueshme (shih v. 13). Shih shënimin në 5:13.

▣ **“gjithë bota dergjet nën pushtetin e të ligut”** Kjo është DËFTORE E TASHME MESORE (deponente) (shih Gjoni 12:31; 14:30; 16:11; 2 Kor. 4:4; Efe. 2:2; 6:12). Kjo ndodhi për shkak (1) të mëkatit të Adamit; (2) të rebelimit të Satanit; dhe (3) zgjedhjes personale të individit për të kryer mëkat.

5:20 “e dimë” Shih shënimin e plotë në paragrafin e dytë të 5:13.

▣ **“Biri i Perëndisë ka ardhur”** Kjo është një tjetër DËFTORE E KRYER VEPRORE. Njohurinë e duhur për të njohur Perëndinë na e ka siguruar Jezusi, jo mësuesit e rremë gnostikë. Jezusi na e ka zbuluar plotësisht Atin me anë të jetës, mësimëve, veprimeve, vdekjes dhe ringjalljes së vet! Ai është Fjala e gjallë e Perëndisë; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet tij (shih Gjoni 14:6; 1 Gjonit 5:10-12).

▣ **“ne jemi në Atë që është i vërtetë, në Birin e tij Jezu Krishtin. Ky është Perëndia i vërtetë dhe jeta e përjetshme”** Faza e parë “në atë që është i vërtetë” i referohet Perëndisë Atë (shih Temën e Veçantë në 6:55 dhe Gjoni 17:3), por personi që nënkuptohet nga fraza e dytë “Perëndia i vërtetë” është më i vështirë për t’u identifikuar. Në kontekst, duket sikur edhe ai i referohet Atit, por nga ana teologjike, mund t’i referohet Birit. Kjo “paqartësi” gramatikore mund të jetë e qëllimshme, siç ndodh shpesh në shkrimet e Gjonit, sepse, për të qenë në Atin, duhet që njeriu të jetë edhe në Birin (shih v. 12). Natyra hyjnore dhe vërtetësia e Atit dhe Birit mund të jetë kuptimi i synuar teologjik këtu (shih Gjoni 3:33; 7:28; 8:26). DhR e pohon natyrën e plotë hyjnore të Jezusit të Nazaretit (shih Gjoni 1:1, 18; 20:28; Fil. 2:6; Titit 2:13; dhe Heb. 1:8). Megjithatë, edhe mësuesit gnostikë e pohonin natyrën hyjnore të Jezusit (të paktën me anë të brendabanimit të frymës hyjnore).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:21

²¹Fëmijë të vegjël, ruajeni veten nga idhujt.

5:21

NASB “ruajeni veten nga idhujt”

NKJV, NRSV “largojuni idhujve”

TEV “ruajeni veten të sigurt nga perënditë e rreme!”

NJB “ruhuni nga perënditë e rreme”

Kjo është URDHËRORE AORISTE VEPRORE, një e vërtetë e përgjithshme dhe e theksuar. Bën fjalë për pjesëmarrjen aktive të të krishterëve në shenjtërim (shih 3:3), gjë që ata po e shijojnë tashmë në Jezu Krishtin (shih Efe. 1:4; 1 Pje. 1:5).

Fjala “idhuj” (që përdoret vetëm dy herë në shkrimet e Gjonit, këtu dhe në një citim të DhV në Zbu. 9:20) lidhet, ose me mësimet dhe stilin e jetesës së mësuesve të rremë, ose, për shkak se Pergamenat e Detit të Vdekur e përdorin këtë term në kuptimin e “mëkatit”, fjalët “idhull” dhe “mëkat” janë sinonime.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t'i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit tre provat kryesore që i sigurojnë besimtarët se janë në Krishtin.
2. Për çfarë bëjnë fjalë termat “ujë” dhe “gjak” në v. 6 dhe 8?
3. A mund ta dimë se jemi të krishterë? A ka disa të krishterë që nuk e dinë këtë?
4. Cili është mëkati që çon në vdekje? A mund të kryhet prej besimtarit?
5. Çfarë na ruan nga tundimi: fuqia ruajtëse e Perëndisë, apo përpjekjet tona?

2 GJONIT

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetja	Përshëndetje zonjës së zgjedhur		Hyrje	Përshëndetje
v. 1-3	v. 1-3	v. 1-2 v. 3	v. 1-3	v. 1-3
E vërteta dhe dashuria	Ecni në urdhërimet e Krishtit		E vërteta dhe dashuria	Ligji i dashurisë
v. 4-11	v. 4-6 Ruhuni nga mashtruesit antikrishtë v. 7-11	v. 4-6 v. 7-11	v. 4-6 v. 7-8 v. 9-11	v. 4-5 v.6 Armiqtë e Krishtit v. 7-11
Përshëndetjet e fundit	Përshëndetja e lamtumirës së Gjonit		Fjalët e fundit	
v. 12-13	v. 12-13	v. 12 v. 13	v. 12 v. 13	v. 12 v. 13

HYRJE E SHKURTËR

2 Gjonit lidhet qartazi me mesazhin dhe stilin letrar të 1 Gjonit. Mund të jenë shkruar nga i njëjti autor, dhe mund të jenë shkruar rreth së njëjtës kohë. Në shekullin e parë, ishte tipike që letrat personale të shkruheshin në formë të përcaktuar dhe mjaftonte një fletë papirusi për gjithë letrën.

1 Gjonit iu shkrua disa kishave (dhe, në njëfarë kuptimi, të gjitha kishave), ndërsa 2 Gjonit i drejtohet një kishë lokale dhe drejtuesit të saj (ndonëse, ashtu si në rastin e shumicës së letrave personale të DhR, ajo iu lexua gjithë kishës). Ajo na hap një dritare të vogël e të mrekullueshme për të kuptuar jetën e kishës së shekullit të parë në Azinë e vogël (Turqinë e sotme).

CIKLI NJË I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

CIKLI DY I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijto temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:1-3

¹Plaku, zonjës së zgjedhur dhe fëmijëve të saj, të cilët i dua me të vërtetë; dhe jo vetëm unë, por gjithë ata që njohin të vërtetën, ²për hir të së vërtetës që banon në ne dhe do të jetë me ne përjetë: ³Hiri, mëshira dhe paqja do të jenë me ne, nga Ati Perëndi dhe nga Jezu Krishti, Biri i Atit, në të vërtetë dhe në dashuri.

v. 1 “Plaku” Ky titull (*presbuteros*) përdoret për të identifikuar autorin e dy letrave: 2 dhe 3 Gjonit. Ka një larmi kuptimesh në Bibël.

Shkrimet johanine i shfaqin në mënyra të ndryshme përmendjet e autorit.

1. Ungjilli përdor frazën e misterhme “dishepulli i dashur”
2. Letra e parë është anonime
3. Letra e dytë dhe ajo e tretë kanë titullin “plaku”
4. Zbulesa, gjë që është shumë jokarakteristike për shkrimet apokaliptike, thotë se autori është “shërbëtori i Tij, Gjoni”.

Ka patur shumë diskutime midis komentuesve dhe studiuesve për autorësinë e këtyre shkrimeve. Të gjitha kanë shumë ngjashmëri dhe dallime gjuhësore dhe stilistikore. Në këtë pikë, asnjë shpjegim nuk pranohet nga të gjithë mësuesit e Biblës. Unë mendoj se autori i të gjithave është apostulli Gjon, por kjo është çështje hermeneutike; s'ka të bëjë me frymëzimin. Në të vërtetë, autori i vërtetë i Biblës është Fryma e Perëndisë. Kjo është zbulësë e besueshme, por njerëzit e sotëm thjesht nuk e njohin, ose nuk e kuptojnë, procesin letrar të shkrimit ose përpilimit të kësaj zbulëse.

TEMË E VEÇANTË: PLAKU

1. përdoret për engjëjt e Perëndisë, që përbëjnë këshillin e engjëjve (shih Isa. 24:23). Po kjo terminologji përdoret për krijesat engjëjllore të Zbulesës (shih 4:4,10; 5:5,6,8,11,14; 7:11,13; 11:16; 14:3; 19:4).
2. përdoret për krerët fisnorë (*zaken*) në DhV (shih Eks. 3:16; Num. 11:16). Më vonë, në DhR, kjo fjalë përdoret për një grup drejtuesish nga Jerusalemi, të cilët përbënin gjykatën e lartë të judenjve, Sinedrin (shih Mat. 21:23; 26:57). Në kohën e Jezusit, ky grup prej shtatëdhjetë anëtarësh kontrollohej nga një priftëri e korruptuar.
3. përdoret për drejtuesit lokalë të kishave të DhR. Ishte një nga tre fjalët sinonimike (pastor, mbikëqyrës dhe plak; shih Titit 1:5, 7; Veprat 20:17, 28). Pjetri dhe Gjoni e përdorin për të përfshirë dhe veten në grupin e drejtuesve (shih 1 Pje. 5:1; 2 Gjonit 1; 3 Gjonit 1).
4. përdoret për burrat e moshuar të kishës, që s'ishin medoemos pjesë e drejtuesve (shih 1 Tim. 5:1; Titit 2:2).

■ **“zonjës së zgjedhur dhe fëmijëve të saj”** Ka patur shumë diskutime për këtë titull. Shumë janë përpjekur të thonë se kjo iu shkrua një zonje që quhej, ose *Elekta*, nga fjala greke “i zgjedhur” (Klementi i Aleksandrisë), ose *Kyria*, nga fjala greke zonjë (Athanasia). Megjithatë, unë bie dakord me Jeronimin se bëhet fjalë për një kishë, për arsyet e mëposhtme:

1. fjala greqisht “kishë” është FEMËRORE (v. 1)
2. në Septuagintë, “i zgjedhuri” i referohet një grupi njerëzish (shih 1 Pje. 2:9)
3. kjo mund t'i referohet kishës si nusja e Krishtit (shih Efe. 5:25-32; Zbu. 19:7-8; 21:2)
4. kjo kishë ka anëtarë, të cilët quhen “fëmijë” (shih v. 13)
5. kjo kishë ka një motër, që duket se nënkupton një tjetër kishë lokale (shih v. 13)
6. në gjithë kapitullin, NJËJËSI ndërthuret me SHUMËSAT (NJËJËS në v. 4, 5, 13; SHUMËSAT në v. 6, 8, 10, 12)
7. kjo fjalë përdoret në mënyrë të ngjashme për kishën në 1 Pje. 5:13

■ **“të cilët”** Është e habitshme që ky është një PËREMËR MASHKULLOR SHUMËS, sepse duhet të lidhej, ose me “zonjën”, që është në FEMËRORE, ose me “fëmijët”, që është në ASNJANËSE. Mendoj se, në këtë mënyrë, Gjoni donte të thoshte se kjo frazë është simbolike.

■ **“i dua”** Gjoni e përdor FOLJEN *fileō* në mënyrë sinonimike me *agapaō* në ungjillin e tij dhe te Zbulesa, por te 1, 2 dhe 3 Gjonit, ai përdor vetëm *agapaō* (shih v. 3, 5, 6; 1 Gjonit 3:18).

■ **“vërtetë”** E vërteta është një temë e përsëritur shpesh (shih v. 1 [dy herë], 2, 3, 4). Faza “ky mësim” në v. 9 [dy herë] dhe 10 është sinonimike me “të vërtetën”. Kjo fjalë ndoshta theksohet për shkak të herezisë lokale, e cila është e dukshme në këtë letër të shkurtër (shih v. 4, 7-10), ashtu si dhe në 1 Gjonit.

“E vërteta” mund të nënkuptojë një nga këto tre gjëra: (1) Frymën e Shenjtë në Gjoni (shih 14:17); (2) vetë Jezu Krishtin (shih Gjoni 8:32; 14:6); dhe (3) përmbajtjen e ungjillit (shih 1 Gjonit 3:23). Shih Temat e Veçanta në 6:55 dhe 17:3.

v. 2 “që banon në ne” Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e një nga fjalëve të parapëlqyera të Gjonit për të përshkruar besimtarët, “banoj”. Shih Temën e Veçantë në 2:10. Kjo duket se i referohet Frymës së Shenjtë brendabanues (shih Rom. 8:9; ose Birit, Rom. 8:9-10). Të gjithë Personat e Trinisë, në fakt, banojnë në/me besimtarët (shih Gjoni 14:23).

■ **“do të jetë me ne përjetë”** E vërteta banon në gjithë besimtarët (dhe qëndron në ta) përjetë. Ç’pohim madhështor sigurie! Shih Temën e Veçantë në 1 Gjonit 5:13. E vërteta është, edhe personi i ungjillit, edhe mesazhi i ungjillit. Kjo “e vërtetë” rezulton gjithmonë në dashuri, në dashurinë për Perëndinë, për vëllezërit/motrat e tjera në besëlidhje dhe për botën e humbur (shih 1 Gjonit 4:7-21).

Fjalë për fjalë, “përjetë” është “deri në epokë” (shih Gjoni 4:14; 6:51,58; 8:35,51; 10:28; 11:26; 12:34; 13:8; 14:16; 1 Gjonit 2:17). Shih Temën e Veçantë: Përjetë, në Gjoni 6:58.

v. 3 “Hiri, mëshira dhe paqja” Kjo është hyrje tipike e një letre greke të shekullit të parë, me dy përjashtime. Së pari, ajo është ndryshuar disi për t’i dhënë shijen unike të një letre të krishterë. Fjala greke “përshëndetje” është *hairein*. Ajo është ndryshuar në *haris*, që do të thotë “hir”. Kjo hyrje është shumë e ngjashme me letrat pastorale (1 Tim. 1:2; 2 Tim. 1:2). Dy nga këto fjalë përsëriten edhe në hyrjen e letrave të Palit drejtuar Galatasve dhe 1 Thesalonikasve.

Së dyti, formula normale gramatikore është një lutje ose një urim për shëndet të mirë. Mirëpo 2 Gjoni na jep një pohim të vërtetë, një premtim pozitive me Perëndinë, që do të ketë një rrjedhojë të dëshiruar hyjnore.

Nga ana teologjike, të duket se midis këtyre fjalëve ekziston një rend ose marrëdhënie e qëllimshme. Hiri dhe mëshira pasqyrojnë karakterin e Perëndisë, që sjell shpëtimin falas përmes Krishtit për njerëzimin e rënë. Paqja reflekton marrësin e dhuratës së Perëndisë. Besimtarët përjetojnë një transformim të plotë. Ashtu si Rënia preku gjithë aspektet e jetës njerëzore, kështu dhe shpëtimi sjell rimëkëmbjen, në fillim përmes pozicionit (shfajësimi me anë të besimit), dhe pastaj përmes një zhvendosjeje rrënjësore të botëkuptimit, që bëhet e mundur nga Fryma brendabanues; kjo gjë çon në ngjashmërinë gjithmonë e më të madhe me Krishtin (shenjtërimi i shkallëzuar). Kështu rikthehet shëmbëllimi i Perëndisë në njerëzimin (shih Zan. 1:26-27)!

Mundësia tjetër lidhet me nevojën për këto tre fjalë për shkak të mësuesve të rremë. Ata e vinin në dyshim “hirin” dhe “mëshirën” dhe sillnin gjithçka tjetër veç “paqes”. Po kështu, është interesante të vërejmë se ky është i vetmi përdorim i fjalës “mëshirës” (*eleōs*) në të gjitha shkrimet e Gjonit. “Hiri” (*haris*) përdoret vetëm këtu, në ungjillin e Gjonit 1:14, 16,17, dhe te Zbulesa (shih 1:4; 22:21).

Komentari biblik i Jeronimit përmend faktin se këto tre fjalë kanë lidhje me besëlidhjen e Dhiatës së Vjetër (f. 412). Shkruesit e DhR (përveç Lukës) ishin mendimtarë hebrenj që shkruanin në greqishten e kohës. Një pjesë e mirë e fjalorit të DhR i ka fillesat nga Septuaginta, përkthimi më i vjetër i DhV në greqisht.

▣ **“nga Ati Perëndi dhe nga Jezu Krishti”** Të dy EMRAT kanë PARAFJALËN (*para*), që nga ana gramatikore, i vendos në të njëjtin nivel. Kjo është një mënyrë gramatikore e Gjonit për të pohuar natyrën e plotë hyjnore të Jezu Krishtit.

▣ **“Biri i Atit”** Diçka që theksohet vazhdimisht në 1 Gjonit është se nuk mund ta kesh Atin pa patur dhe Birin (shih 1 Gjonit 2:23; 4:15; 5:10). Mësuesit e rremë pretendonin se kishin një marrëdhënie unike dhe të veçantë me Perëndinë, por, nga ana teologjike, e zhvlerësonin personin dhe veprën e Birit. Gjoni e përsërit vazhdimisht se Jezusi është (1) zbulesa e plotë e Atit dhe (2) e vetmja udhë (shih Gjoni 14:6) për tek Ati.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:4-6

⁴U gëzova shumë kur mësova se disa nga fëmijët e tu po ecin në të vërtetën, ashtu siç jemi porositur nga Ati. ⁵Tani, o zonjë, të kërkoj, jo sikur po të shkruaj ndonjë urdhërim të ri, por atë që e kishim që nga fillimi, që të duam njëri-tjetrin. ⁶Dhe kjo është dashuria: që të ecim sipas urdhërimeve të tij. Ky është urdhërimi, ashtu siç e keni dëgjuar që nga fillimi se duhet të ecni në të.

v. 4 “U gëzova shumë” Kjo është DËFTORE AORISTE PËSORE (deponente). Ndoshta, Plaku kishte dëgjuar për këtë kishë nga disa anëtarë të saj, që kishin udhëtuar.

▣ **“kur mësova se disa nga fëmijët e tu po ecin në të vërtetën”** Kjo i referohet, ose

1. jetëve të perëndishme dhe plot dashuri të disave në kishë (shih 2 Gjonit 3-4)
2. ose përbën një mënyrë për të treguar praninë e heretikëve brenda bashkësisë, të cilët i kishin nxjerrë disa nga udha e duhur

▣ **“ashtu siç jemi porositur nga Ati”** Kjo është një DËFTORE AORISTE VEPRORE, që i referohet dhënies së porosisë që të duam njëri-tjetrin, ashtu siç na deshi Jezusi (shih Gjoni 13:34-35; 15:12; 1 Gjonit 3:11; 4:7, 11-12, 21).

v. 5 “kishim që nga fillimi” Kjo është DËFTORE E PAKRYER VEPRORE, që bën fjalë për fillimin e mësimit të Jezusit (shih 1 Gjonit 2:7, 24; 3:11). Përmbajtja e urdhërimit rishprehet me fjalët “të duam njëri-tjetrin” (shih v. 5) dhe të pranojmë “se Jezu Krishti ka ardhur në mish” (shih v. 7). Vini re se bëhet fjalë për përmbajtje personale dhe për stil jetese.

▣ **“që të duam njëri-tjetrin”** Kjo është një LIDHORE E TASHME VEPRORE (njësoj si FOLJA e fundit në po këtë varg, “ecim”). Në mënyrë tipike, heretikët ishin përjashtues dhe u mungonte dashuria. Kjo përbën të parin nga tre provat e Gjonit për kuptuar nëse dikush është i krishterë ose jo. Në librin e 1 Gjonit, këto tri prova janë: dashuria, stili i jetesës dhe doktrina. Këto tri prova përsëriten edhe në 2 Gjonit.

1. Dashuria (shih 5; 1 Gjonit 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12,16-21; 5:1-2)
2. Bindja (shih v. 6; 1 Gjonit 2:3-6; 3:1-10; 5:2-3)
3. Përmbajtja doktrinor (shih v. 7; 1 Gjonit 1:1 e më tej; 2:18-25; 4:1-6,14-16; 5:1,5,10)

v. 6 **“Dhe kjo është dashuria”** Dashuria (*agapē*) është një veprim i vazhdueshëm (KOHA E TASHME), jo thjesht ndjenjë. Dashuria është “shenja” e të gjithë besimtarëve të vërtetë (shih 1 Korintasve 13; Gal. 5:22; 1 Gjonit 4:7-21).

▣ **“nga fillimi”** Shih shënimin në 1 Gjonit 1:1. Mendoj se kjo frazë përdoret në 1 dhe 2 Gjonit për të nënkuptuar fillimin e shërbesës publike të Jezusit.

▣ **“ecni në të”** Krishterimi është, edhe përkushtim fillestar, edhe ndryshim që zgjat gjithë jetën (shih 1 Gjonit 2:6). Stili i jetesës nuk na shpëton, por vërteton se jemi të shpëtuar (shih Efe. 2:8-9 dhe 2:10).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:7-11

⁷Sepse shumë mashtrues kanë dalë në botë, ata që nuk pranojnë se Jezu Krishti ka ardhur në mish. Ky është mashtruesi dhe antikrishti. ⁸Ruajuni se mos humbni atë që kemi arritur, por që të merrni shpërblimin e plotë. ⁹Kushdo që shkon më larg se ç’duhet dhe nuk qëndron në mësimet e Krishtit, nuk e ka Perëndinë; ai që qëndron në mësimin ka edhe Atin, edhe Birin. ¹⁰Nëse ju vjen dikush dhe nuk sjell këtë mësim, mos e pranoni në shtëpi, dhe mos i jepni përshëndetje; ¹¹sepse ai që i jep përshëndetje merr pjesë në veprat e tij të liga.

v. 7 **“Sepse shumë mashtrues”** Fjala “mashtrues” vjen nga fjala greke *planē*, nga e cila rrjedh dhe fjala “planet”. Në botën e lashtë, lëvizja e trupave qiellorë përpilohej nëpër harta dhe studiohej (*zodiaku*). Yjet formojnë grupe të qëndrueshme, por disa yje (pra, planete) lëviznin në mënyrë të çrregullt. Të lashtët i quanin “endacakë”. Kjo u zhvillua në mënyrë metaforike në konceptin se disa njerëz enden larg së vërtetës.

Këta mësues të rremë nuk ishin thjesht njerëz të mashtruar, ose që ishin sinqerisht në gabim, nga padija e ungjillit. Në shkrimet e Gjonit, edhe farisenjtë, edhe mësuesit e rremë, ngrenë krye kundër dritës së qartë që kanë marrë. Prandaj dhe rebelimi i tyre quhet “mëkat i pafalshëm” ose “mëkati që çon në vdekje” (shih shënimet në 1 Gjonit 5:16). Tragjedia është se ata bënin që t’i ndiqnin pas dhe të tjerët në këtë shkatërrim. DhR zbulon qartazi se mësuesit e rremë do të vijnë dhe do të shkaktojnë probleme të mëdha (shih Mat. 7:15; 24:11, 24; Marku 13:22; 1 Gjonit 2:26; 3:7; 4:1).

▣ **“kanë dalë në botë”** Këtu, bota është thjesht planeti ynë fizik. Këta mësues të rremë, ose janë larguar nga kisha e krishterë (shih 1 Gjonit 2:19), ose janë me detyra misionare (shih 3 Gjonit).

▣ **“ata që nuk pranojnë”** Këtu, fjala është *homologeō*, që nënkupton një rrëfim publik besimi në Krishtin. Shih Temën e Veçantë: Rrëfimi, në Gjoni 9:22-23.

▣ **“Jezu Krishti ka ardhur në mish”** Këta mashtrues vazhdojnë me mësimet e tyre të rreme për personin e Krishtit. Ky varg përsërit këshillën “vini në provë frymët” (1 Gjonit 4:1-6), sidomos kur bëhet fjalë për natyrën e plotë njerëzore të Jezusit (shih Gjoni 1:14; 1 Tim. 3:16). Gnosticizmi besonte në një dualizëm të përjetshëm mes “shpirtit” (Perëndisë) dhe “materies” (mishit). Për ta, Jezusi nuk mund të ishte edhe plotësisht Perëndi, edhe plotësisht njeri.

Duket se, në mendimin e hershëm gnostik, ekzistonin të paktën dy rryma teologjike:

1. mohimi i natyrës njerëzore të Jezusit (docetikët); ai dukej sikur ishte njeri, por në fakt ishte frymë
2. mohimi se Jezusi vdiq në kryq; ky grup (kerintasit) thoshin se “fryma „Krisht“” erdhi mbi njeriun Jezus në pagëzim dhe e braktisi para se të vdiste në kryq

Ndoshta, KOHA E TASHME, “ardhur në mish”, përdoret nga Gjoni për të refuzuar gnosticizmin kerintas; ndërsa 1 Gjonit 4:1-6 shërben për të kundërshtuar gnosticizmin docetik.

▣ **“Ky është mashtruesi dhe antikrishti”** Në 1 Gjonit 2:18, bëhet dallimi midis “antikrishtëve” në SHUMËS dhe “Antikrishtit” në NJËJËS. Ata të shumtët kishin ardhur në kohën e Gjonit dhe ishin larguar nga kishat (shih 1 Gjonit 2:19), por antikrishti në NJËJËS projektohet në të ardhmen (shih “njeriu i paligjshmërisë” në 2 Thesalonikasve 2). Megjithatë, në këtë varg përdoret NJËJËSI, ashtu siç përdoret SHUMËSI në 1 Gjonit 2:18-25.

v. 8 “ruajuni” Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Është fjala “shikoj” (*blepō*), që përdoret në mënyrë metaforike si paralajmërim ndaj ligësisë (shih Mat. 24:4; Marku 13:5; Luka 21:8; Veprat 13:40; 1 Kor. 8:9; 10:12; Gal. 5:12; Heb. 12:25). Besimtarët janë përgjegjës për të dalluar gabimet, sepse

1. njohin ungjillin
2. kanë Frymën
3. kanë bashkësi të vazhdueshme me Krishtin

▣

NASB “se mos humbni atë që kemi arritur”

NKJV “se mos humbim ato gjëra për të cilat kemi punuar”

NRSV “që të mos humbni atë për të cilën kemi punuar”

TEV “që të mos humbni atë për të cilën kemi punuar”

NJB “përndryshe, kemi për ta humbur gjithë punën tonë”

Në këtë varg ekziston një ndryshim në dorëshkrimet greke, që lidhet me PËREMURIN e parë: duhet të jetë “ju” (NASB, NRSV, TEV), apo “ne” (NKJV)? Teksti i UBS⁴ mbështet “ju”, që nënkupton se besimtarët në fjalë mund të mos i arrijnë synimet e ungjillit, të cilat ua kishte dhënë dëshmia e apostujve.

▣ **“por që të merrni shpërblimin e plotë”** Kjo është një LIDHORE AORISTE, që u kujton pranimin fillestar të ungjillit. Kushtëzimi i LIDHORES nuk lidhet me shpëtimin e tyre, por me pjekurinë dhe përhapjen e ungjillit prej tyre (shih 1 Kor. 9:27; 15:10, 14, 58; 2 Kor. 6:1; Gal. 2:2; Fil. 2:16; 1 Thes. 2:1; 3:5).

v. 9

NASB “Kushdo që shkon më larg se ç’duhet dhe nuk qëndron në mësimin e Krishtit”

NKJV “Kushdo që bën shkelje dhe nuk qëndron në doktrinën e Krishtit”

NRSV “Kushdo që nuk qëndron në mësimin e Krishtit”

TEV “Kushdo që nuk rri në mësimin e Krishtit, por e tejkalon cakun”

NJB “Nëse dikush nuk qëndron në mësimin e Krishtit, por shkon përtej tij”

Së pari, vini re përdorimin negativ të *pas*. Ftesa e ungjillit është për “të gjithë”, por, mjerisht, e tillë është dhe mundësia për herezi. Kjo herezi e mundshme karakterizohet nga dy PJESORE TË TASHME VEPRORE; “shkon më larg se ç’duhet” dhe “nuk qëndron”. E para mund të jetë fjalë kyçe për mësuesit e rremë, që nënkupton se e kishin çuar të vërtetën përtej apostujve që ishin dëshmitarë okularë.

Besimtarët karakterizohen nga fakti se fjala e së vërtetës qëndron në ta (shih Gjoni 8:31; 15:7; 1 Gjonit 2:14; negative në Gjoni 5:38; 1 Gjonit 1:10). Shih Temën e Veçantë: Qëndresa, në Gjoni 8:31 dhe Femohimi, në Gjoni 6:64.

FRAZA GJINORE “e Krishtit” mund të nënkuptojë

1. mësimet e Krishtit
2. mësimet për Krishtin
3. kuptimin e dyfishtë nga ana e Gjonit (që ishte i zakonshëm për shkrimet e tij)

GJINORET janë të shumta dhe të vagullta! Vetëm konteksti mund të përcaktojë kuptimet e synuara të tyre, por, shpesh, si këtu, ato mbivendosen.

▣ **“nuk e ka Perëndinë”** “Mësimi i Krishtit” dhe “e vërteta” në v. 2 janë paralele me njëra-tjetrën. Mësuesit e rremë dhe ndjekësit e tyre nuk kanë asnjë shpërblim (shih v. 8). Ata janë shpirtërisht të humbur dhe s’janë me Perëndinë, sepse për të patur Atin duhet të kesh Birin (shih 1 Gjonit 5:10-12). Përdorimi i FOLJES “ka” (dy herë, DËFTORE E TASHME VEPRORE) me fjalën “Perëndi” gjendet vetëm k dhe te 1 Gjonit 2:23.

v. 10 “Nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që merret si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit, ose për synimet e tij letrare. Mësuesit e rremë do të vijnë!

■ **“mos e pranoni në shtëpi”** Kjo është URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PLESËZËN MOHORE që, shpesh, nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër (konteksti duhet ta përcaktojë këtë).

“Shtëpia” ndoshta i referohet mikpritjes së krishterë (shih Mat. 25:35; Rom. 12:13; 1 Tim. 3:2; Titit 1:8; Heb. 13:2; 1 Pje. 4:9; ose 3 Gjonit 5-6), por, në kontekst, ndoshta bëhet fjalë për ftesën që i bëhej një predikuesi shtegtes që t’i fliste kishës, që mblidhej në një shtëpi (shih Rom. 16:5; 1 Kor. 16:19; Kol. 4:15; Filemonit 2).

■ **“dhe mos i jepni përshëndetje”** Kjo është një tjetër URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PLESËZ MOHORE. Mos e identifikoni veten me këtë “të ashtuquajtur të krishterë”. Çdo shenjë miqësie mund të keqkuptohet si miratim (shih v. 11). Kjo thënie është shumë e vështirë për t’u zbatuar sot. Shumë pretendojnë se janë të krishterë. Megjithatë, në përpjekjen për të biseduar me ta, duhet të jemi të sjellshëm dhe aktivë në bisedë. Sidoqoftë, drejtuesit e krishterë duhet t’i ruhen çdo identifikimi me herezinë. Sigurisht, kjo nuk vlen për denominacionet e krishtera!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:12-13

¹²Ndonëse kam shumë gjëra për t’ju shkruar, nuk dua ta bëj me kartë e bojë; por shpresoj të vij tek ju dhe të flasim ballë përballë, që gëzimi juaj të bëhet i plotë. ¹³Fëmijët e motrës sate të zgjedhur të përshëndesin.

v. 12 **“kam shumë gjëra për t’ju shkruar”** Kjo ngjason me fundin e 3 Gjonit 13-14.

■ **“gëzimi juaj të bëhet i plotë”** Kjo është një shprehje PERIFRASTIKE LIDHORE E KRYER PËSORE synimi (një fjali synimi që tregon kushtëzim). Kjo është temë e përsëritur te Gjoni (shih Gjoni 3:29; 15:11; 16:24; 17:13; 1 Gjonit 1:4). Ky gëzim bazohej në

1. praninë e mësuesit

2. njohjen e së vërtetës që sillte ai

Gjoni e përmendi në vargun 4 “gëzimin” që ndiente ai ngaqë ata po ecnin në dashuri dhe bindje.

v. 13 Ky varg, ashtu si dhe v. 1, përdor gjuhë metaforike për të folur për kishën motër dhe për anëtarët e saj.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Rendit tre provat që gjenden në 1 Gjonit dhe që përsëriten në 2 Gjonit.
 - a.
 - b.
 - c.
2. Kuju i shkrua kjo letër: një zonje, apo një kishë?
3. Si e kupton nga kjo letër e shkurtër se heretikët ishin të pranishëm në bashkësi?
4. Kush, ose çfarë, është mashtruesi dhe antikrishti në v. 7?
5. A e kundërshtojnë vargjet 10 dhe 11 urdhrin e DhR që t’u tregojmë mikpritje dhe dashuri edhe armiqve tanë?

3 GJONIT

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE MODERNE*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje	Përshëndetje për Gajin		Hyrje	Përshëndetje hyrëse
v. 1	v. 1-4	v. 1	v. 1a v. 1b	v. 1-4
v. 2-4		v. 2-4	v. 2-4	
Bashkëpunimi dhe kundërshtia	Përgëzimi për bujarinë		Gaji përgëzohet	
v. 5-8	v. 5-8 Diotrefi dhe Demetri	v. 5-8	v. 5-8 Diotrefi dhe Demetri	v. 5-8 Ruhuni nga shembulli i Diotrefit
v. 9-10	v. 9-12	v. 9-10	v. 9-10	v. 9-11
v. 11-12		v. 11-12	v. 11 v. 12	Lëvdimi i Demetrit v. 12
Përshëndetjet e fundit	Përshëndetje lamtumire		Përshëndetjet e fundit	Epilogu
v. 13-15	v. 13-15	v. 13-14 v. 15	v. 13-14 v. 15a v. 15b	v. 13-15

CIKLI NJË I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit.
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (shih f. v)

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë librin biblik njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

* Ndonëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet në paragrafë janë kyçe për të kuptuar dhe ndjekur synimin e autorit fillestar. Secili përkthim modern i ka ndarë dhe përmbledhur paragrafët. Secili paragraf ka një temë, të vërtetë, ose mendim qendror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Kur të lexosh tekstin, pyet veten se cili përkthim i përshtatet logjikës tënde për temën dhe për ndarjet në vargje.

Në çdo kapitull, së pari duhet të lexojmë Biblën dhe të përpiqemi të identifikojmë temat e saj (paragrafët), pastaj ta krahasojmë njohurinë tonë me versionet moderne. Biblën mund ta kuptojmë vërtet vetëm pasi kuptojmë synimin e autorit fillestar duke dalluar logjikën dhe prezantimin e tij. Vetëm autori fillestar është i frymëzuar; lexuesit nuk kanë të drejtë t'ia ndryshojnë ose modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë vërtet përgjegjësinë që ta zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjithë termat teknike dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

1. Tema e njësisë së parë letrare.
2. Tema e njësisë së dytë letrare.
3. Tema e njësisë së tretë letrare.
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih f. v)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT FILLESTAR NË NIVELIN E PARAGRAFËVE

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexo gjithë kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjet e tua tematike me pesë përkthimet moderne. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është çelësi për të ndjekur synimin e autorit fillestar, gjë që është thelbi i interpretimit. Secili paragraf ka vetëm një temë të vetme.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

MËSIMET KONTEKSTUALE TË 3 GJONIT

HYRJE

- A. Kjo letër e shkurtër titullohet “3 Gjonit” vetëm për shkak se është paksa më e shkurtër se 2 Gjonit. Unë mendoj se 2 Gjonit dhe 3 Gjonit përbëjnë një mesazh të ekuilibruar për një kishë lokale, ndoshta diku në provincën romake të Azisë së Vogël, nga fundi i shekullit të parë.
- B. 2 Gjonit trajton problemin e predikuesve heretikë dhe shëtitës, ndërsa 3 Gjonit trajton nxitjen për të ndihmuar predikuesit shëtitës të krishterë.
- C. Në letrën e 3 Gjonit përmenden me emër tre burra.
 1. Gaji (njeri i perëndishëm në kishën që mori letrën)
 - a. Ka tre Gaj të ndryshëm që përmenden në pjesë të tjera të Biblës: Gaji i Maqedonisë (Veprat 19:29); Gaji i Derbës (Veprat 20:4); dhe Gaji i Korintit (Rom. 16:23; 1 Kor. 1:14).
 - b. Shkrimet e njohura me titullin “Kushtetuta apostolike” e përmendin Gajin e 3 Gjonit si peshkop të Pergamit, i caktuar nga Gjoni.
 2. Diotrefi (një njeri problematik dhe i paperëndishëm në kishën që mori letrën)
 - a. Kjo është përmendja e vetme e këtij njeriu në DhR. Emri i tij është shumë i rrallë dhe do të thotë “i ushqyer nga Zeusi”. Sa ironik është fakti që ai që kishte emrin “Zeus” ishte kundër udhëtarëve, ndonëse “Zeusi” ishte “mbrojtësi i udhëtarëve”.
 - b. Qëndrimi i tij demaskohet në vargjet 9-10.
 3. Demetri (korrieri që ia çoi kësaj kisha lokale letrën e Gjonit)
 - a. Me sa duket, ai ishte një nga misionarët rrugëtues dhe mbartësi i letrës nga apostulli Gjon në Efes.
 - b. Tradita e quajtur “Kushtetuta apostolike” e rendit Demetrin si peshkop të Filadelfias, i caktuar nga apostulli Gjon.
- D. Kisha e hershme përballej me problemin sesi të vlerësonte dhe të mbështeste predikuesit/mësuesit/ungjilltarët shëtitës. Një shkrim i hershëm jokanonik nga shekulli i dytë, i quajtur *Didakeja*, ose *Mësimi i Dymbëdhjetë Apostujve*, jep këto udhëzime:
KAPITULLI 11: PËR MËSUESIT, APOSTUJT DHE PROFETËT
 “Prandaj, kushdo që vjen dhe ju mëson të gjitha këto gjëra që janë thënë më parë, pranojeni. Por, nëse vetë mësuesi kthehet dhe mëson një doktrinë tjetër, që e shkatërron këtë, mos

e dëgjoni; por nëse mëson gjëra që rrisin drejtësinë dhe njohurin e Zotit, pranojeni si vetë Zotin. Por, në lidhje me apostujt dhe profetët, sipas porosisë së ungjillit, bëni kështu: çdo apostull që vjen te ju duhet ta pranoni si Zotin. Por ai nuk duhet të rrijë më tepër se një ditë; dhe, nëse është e nevojshme, edhe të nesërmen; por, nëse qëndron tri ditë, është profeti rremë. Dhe, kur apostulli largohet, të mos marrë asgjë me vete përveç bukës, derisa të gjejë vend tjetër për të qëndruar; por, nëse kërkon para, është profet i rremë” (f. 380).

KAPITULLI 12: PRITJA E TË KRISHTERËVE

“Por kushdo që thotë në Frymë: “më jepni para, ose diçka tjetër”, mos e dëgjoni; por nëse ju thotë të jepni për hir të ndonjë tjetri që është nevojtar, askush të mos e gjykojë. Por kushdo që vjen në emër të Zotit duhet mikpritur dhe, më pas, do ta provoni dhe do ta njihni; sepse kështu do ta njihni në hollësi. Nëse ai që vjen është udhëtar, ndihmoheni me aq sa mundeni; por nuk duhet të qëndrojë te ju, përveç dy-tri ditë, nëse është e nevojshme. Por, nëse dëshiron të jetojë me ju, dhe është zanatçi, le të punojë e të hajë; por, nëse s’ka zanat, sipas situatave tuaja, përpiquni që, si i krishterë, ai të mos jetoj dembel mes jush. Por, nëse nuk dëshiron të punojë, është matrapaz i Krishtit. Ruhuni që të tillëve t’u qëndroni larg” (f. 381).

STUDIMI I FJALËVE DHE FRAZAVE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGU 1

¹Plaku, Gajit të dashur, të cilin e dua në të vërtetën.

v. 1 “**Plaku**” Fjala “plak” është sinonime me emrin “pastor” dhe “peshkop” (shih Titit 1:5, 7; Veprat 20:17, 28). Shih shënimin e plotë në 2 Gjonit, v. 1.

■ “**të dashur**” Kjo është tipike për letrat e Gjonit (shih 1 Gjonit 2:7; 3:2, 21; 4:1, 7, 11; 3 Gjonit 1, 2, 5, 11), por nuk gjendet si titull për besimtarët në ungjillin e tij, ose te Zbulesa.

■ “**Gajit**” Ka patur shumë diskutime nëse pastori i kësaj kishe lokale ishte Gaji apo Diotrefi. Është e vështirë të jesh dogmatik nga kaq pak informacion që kemi në dispozicion. Për shkak të v. 9, ku përmenden “kisha” dhe “ata”, ka mundësi që Diotrefi të ketë qenë drejtuesi i njëres prej kishave shtëpiake, ndërsa Gaji, drejtuesi i një tjetre kishe shtëpiake aty pranë, por ky është thjesht hamendësim.

■ “**të cilin e dua në të vërtetën**” “Dashuria” dhe “e vërteta” gjenden shpesh së bashku në letrat e Gjonit (shih 2 Gjonit 1, 2, 3, 4; 3 Gjonit 1, 3, 4, 8, 12). E vërteta ndoshta nënkupton

1. Frymën e Shenjtë (shih Gjoni 14:17)
2. Birin, pra, Jezusin (shih Gjoni 8:32; 14:6)
3. Përmbajtjen e ungjillit (shih 1 Gjonit 2:2; 3:23)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGJET 2-4

²I dashur, lutem që në të gjitha drejtimit të kesh mbarësi dhe të jesh mirë me shëndet, ashtu siç ka mbarësi dhe shpirti yt. ³Sepse u gëzova së tepërmi kur erdhën vëllezërit dhe dëshmuuan për të vërtetën tënde, pra, se si po ecën në të vërtetën. ⁴Nuk kam gëzim më të madh se ky: kur dëgjoj se fëmijët e mi po ecin në të vërtetën.

v. 2 “**lutem**” Kjo ndjek të njëjtën linjë me hyrjet tipike të letrave greke. Është një lutje/dëshirë për mbarësinë dhe shëndetin e marrësit. Ishte mënyrë për të përshëndetur të dashurit. Kjo s’mund të përdoret si pasazh-provë për “ungjillin e shëndetit dhe prosperitetit”, që është kaq i përhapur në Amerikën e sotme. Shih Gordon Fee (një studiues karizmatik), *The Disease of the Health, Wealth Gospel* [Sëmundja e ‘Ungjillit të shëndetit dhe prosperitetit’]. Për pikëpamjet e mia për shërimin, shih shënimet e mia për Jakobin 5 në internet në

www.freebiblecommentary.org

■ **“që në të gjitha drejtimit të kesh mbarësi dhe të jesh mirë me shëndet”** Kjo është lutje tipike hyrëse për letrat e botës greko-romake të shekullit të parë. Synimi i saj nuk ishte aspak që të përdorej si pasazh-provë nga predikuesit e “shëndetit, pasurisë dhe prosperitetit”. Kur hiqen nga konteksti, pasazhet e Biblës mund të përdoren për të thënë çdo lloj gjëje. Ky pasazh nuk mund të ketë sot një kuptim që s’e pati kurrë në kohën e vet. I vemi person i frymëzuar është autori fillestar. Ne duhet të ndjekim mendimet e tij, jo të ndërpusim mendimet tona!

■ **“shpirti”** Kjo fjalë “*psyhe*” (shpirt) është pothuajse sinonimike me “*pneuma*”. Përdoren për të përshkruar thelbin e personit ose vetes. Nuk i referohet ndonjë pjese të izoluar të njeriut (trup, shpirt, frymë). Njerëzit janë unitet (shih Zan. 2:7). Ne jemi shpirt; nuk kemi shpirt.

v. 3 **“u gëzova së tepërmi”** (shih 2 Gjonit 4; Fil. 4:10).

■ **“erdhën dhe dëshmuar”** Të dyja këto janë PJESORE TË TASHME, që nënkuptojnë se

1. anëtarët e kësaj kishe udhëtonin rregullisht në Efes dhe i raportonin Gjonit
2. se misionarët e kthyer i kishin raportuar për bujarinë e Gajit

Si duket, Gjoni, plak në moshë, nuk e kishte të lehtë të udhëtonte, por donte shumë të dëgjonte për gjendjen dhe ritjen e kishave.

■ **“po ecin në të vërtetën”** Nga ana teologjike, kjo frazë është paralele me “ec në dritë” (shih 1 Gjonit 1:7). Krishterimi nuk është pikësëpari kredo, ritual, apo institucion ku duhet të bëhemi pjesë, por një jetë që duhet jetuar në marrëdhënie me Jezun Krishtin. Kisha e hershme, në fillim, quhej “Udha” (shih Veprat 9:2; 19:9, 23; 24:22). E vërteta nuk është vetëm mendore (përmbajtje), por edhe marrëdhënie (së pari me Perëndinë nëpërmjet Krishtit, gjë që çon në dashuri për njëri-tjetrin). Shih Temat e Veçantë për të Vërtetën në Gjonit 6:55 dhe 17:3.

v. 4 **“fëmijët e mi”** Ky është përcaktim i zakonshëm në letrat e Gjonit (shih 1 Gjonit 2:12,13,18,28; 3:7,18; 4:4; 5:21). Këtu, theksi është te (1) autoriteti apostolik i Gjonit, ose (2) kjo fjalë tregon dashurinë e Gjonit për kishat dhe të krishterët e provincës romake të Azisë së vogël (Turqia perëndimore), ku ai kaloi vitet e fundit të shërbesës.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGJET 5-8

⁵I dashur, ti po vepron besnikërisht në gjithçka që kryen për vëllezërit, sidomos kur ata janë të huaj; ⁶dhe ata kanë dëshmuar për dashurinë tënde para kishës. Do të bësh mirë t’i dërgosh për rrugë në një mënyrë të denjë për Perëndinë. ⁷Sepse ata dolën për hir të Emrit, duke mos pranuar asgjë nga paganët. ⁸Prandaj, duhet t’i mbështesim të tillë njerëz, që të jemi bashkëpunëtorë me të vërtetën.

v. 5 **“ti po vepron besnikërisht”** Këto veprime të Gajit janë pikërisht e kundërta e veprimeve të Diotrefit në v. 9-10. Shih Temat e Veçanta: Besoj, Besim dhe Besnikëri në Gjonit 1:7 dhe Gjonit 1:14.

■ **“në gjithçka që kryen”** Ky është PËREMËR lidhor me *ean* dhe me një FOLJE LIDHORE AORISTE MESORE, që shpreh një kusht, me synimin e përbushjes. Gaji i kishte ndihmuar misionarët rrugëtues në çdo rast dhe në çdo mënyrë të mundshme.

■ **“sidomos kur ata janë të huaj”** Kisha duhet t’i kishte mirëpritur dhe mbështetur këta misionarë të krishterë rrugëtues, por për shkak të situatës ku ndodhej, vetëm Gaji po i ndihmonte këta vëllezër, ndonëse nuk i njihte fare; ai dinte vetëm se ata njihnin, donin dhe i shërbenin Jezun Krishtin.

v. 6 **“ata kanë dëshmuar për dashurinë tënde para kishës”** Me sa duket, kisha e hershme në Efes kishte një kohë raportimi për misionarët gjatë kohës së adhurimit si bashkësi.

TEMË E VEÇANTË: KISHA (EKKLESIA)

Kjo fjalë greke, *ekklesia*, vjen nga dy fjalë: “jashtë prej” dhe “i thirrur”. Pra, si fjalë nënkupton njerëz që janë të thirrur nga jashtë në mënyrë hyjnore. Kisha e hershme e mori këtë fjalë nga përdorimi i përditshëm laik (shih Veprat 19:32, 39, 41), si dhe për shkak se Septuaginta e kishte përdorur në kuptimin e “asamblesë” së Izraelit (*Kahal*, BDB 874, shih Num. 16:3; 20:4). Ata e përdornin për vete si vazhdimësia e popullit të Perëndisë në DhV. Kisha ishte Izraeli i ri (shih Rom. 2:28-29; Gal. 6:16; 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6), përmbushja e misionit mbarëbotëror të Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8).

Kjo fjalë përdoret në një sërë kuptimesh në ungjijtë dhe në Veprat:

1. takim laik i qytetit (Veprat 19:32, 39, 41)
2. populli mbarëbotëror i Perëndisë në Krishtin (Mat. 16:18 dhe Efesianëve)
3. bashkësi lokale besimtarësh të krishterë (Mat. 18:17; Veprat 5:11; në këto vargje, kisha në Jerusalem)
4. populli i Izraelit në mënyrë kolektive (Veprat 7:38; në predikimin e Stefanit)
5. populli i Perëndisë në një rajon të caktuar (Veprat 8:3; në vendin e Judesë)

▣ **“Do të bësh mirë”** Kjo është një shprehje greke që gjendet në papiruset egjiptiane (shih Moulton dhe Milligan, *Fjalori i Dhiatës Greke*) për fjalën “please” [të lutem] (shih Veprat 10:33).

▣ **“t’i dërgosh për rrugë”** Kjo është shprehje teknike që nënkupton faktin se Gaji duhet t’i pajiste misionarët rrugëtues, t’u furnizonte sipas nevojave dhe të lutej për ta (shih Veprat 15:3; Rom. 15:24; 1 Kor. 16:6; 2 Kor. 1:16; Titit 3:13).

▣ **“në një mënyrë të denjë për Perëndinë”** Me fjalë të tjera, në mënyrë domethënëse, me bollëk dhe me dashuri (shih Kol. 1:10; 1 Thes. 2:12). Besimtarët duhet t’i trajtojnë punëtorët e ungjillit në një mënyrë që i ka hije Atij që i shërbejnë (shih Efe. 4:1).

v. 7

NASB, REB “ata dolën”

NKJV “shkuan”

NRSV “e nisën udhëtimin e tyre”

TEV, NJB “u nisën”

Kjo FOLJE shumë e zakonshme përdoret për

1. mësuesit e rremë, kur ata lanë kishën, në 1 Gjonit 2:19
2. profetët e rremë që dolën në botë, në 1 Gjonit 4:1
3. shumë mashtrues, që dolën në botë, në 2 Gjonit v. 7
4. dëshmitarët e vërtetë apostolikë që dolën (në botë), në 3 Gjonit, v. 7

▣

NASB “për hir të Emrit”

NKJV “për hir të emrit të tij”

NRSV “për hir të Krishtit”

TEV “në shërbim të Krishtit”

NJB “plotësisht për hir të emrit”

Ky është një shembull kur “emri” përdoret për të përfaqësuar personin dhe veprën e Jezu Krishtit.

Besimtarët besojnë në emrin e tij (shih Gjoni 1:12; 3:18; Rom. 10:9; 1 Kor. 12:3; Fil. 2:9-11), falen në emër të tij (1 Gjonit 2:13), por edhe veprojnë për emrin e tij (shih Mat. 10:22; 24:9; Marku 13:13; Luka 21:12,17; Gjoni 15:21; 20:31; Veprat 4:17; 5:41; 9:14; Rom. 1:5; 1 Pje. 4:14,16; Zbu. 2:3).

▣

NASB “duke mos pranuar asgjë nga paganët”

NKJV “duke mos marrë asgjë nga paganët”

NRSV “duke mos pranuar asnjë mbështetje nga jobesimtarët”

TEV “pa pranuar asnjë ndihmë nga jobesimtarët”

NJB “pa u mbështetur për asgjë te jobesimtarët”

Kjo frazë nënkupton se këta dëshmitarë i besonin Perëndisë për furnizimin e tij, njësoj si fjalët që u tha Jezusi të Dymbëdhjetëve në Mat. 10:5-15 dhe të Shtatëdhjetëve në Luka 10:4-7.

Në fund të shekullit të parë, fjala “paganët” përdorej për të nënkuptuar paganët, ose jobesimtarët (shih Mat. 5:47; 1 Pje. 2:12; 4:3). Besimtarët duhet ta mbështesin veprën e ungjillit! Zemra e njeriut del në pah nga njerëzit që ai ndihmon.

Në kohën e Gjonit, shumë mësues shëtitës jepnin mësim për hir të parasë dhe namit. Mësuesit/predikuesit/ungjilltarët e Perëndisë duheshin ndihmuar, jo për fjalët e tyre, por për shkak të Zotit të tyre; ata ishin përfshirë në mënyrë sakrifikuase në misionin e tij.

v. 8 “duhet” Kjo është një porosi morale e përsëritur shpesh (shih Gjoni 13:14; 19:7; 1 Gjonit 2:6; 3:16; 4:11). Fjala *opheilō*, në mënyrë të fjalëpërfjalshme, ka kuptimin “jam në borxh nga ana financiare”, por më vonë përdorej në mënyrë të figurative për detyrimin që mund t’i kishte dikujt.

■ **“t’i mbështesim të tillë njerëz”** Mikpritja ishte detyrë kyçe për kishën e hershme për shkak të kushteve të mjerueshme morale të shumicës së bujtinave (shih Mat. 25:35; Rom. 12:13; 1 Tim. 3:2; 5:10; Titit 1:8; Heb. 13:2; 1 Pje. 4:9).

■ **“që të jemi bashkëpunëtorë me të vërtetën”** Kur besimtarët ndihmojnë misionarët, përfshihen në punën e tyre për hir të besimit dhe së vërtetës. Ky është parim i ungjillit! Udhëzimet e DhR për bujarinë e krishterë jepen në 2 Korintasve 8-9.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGJET 9-10

⁹I shkrova diçka kishës; por Diotrefi, që i pëlqen të jetë i pari ndër ta, nuk pranon ato që themi ne. ¹⁰Për këtë arsye, nëse vij, do t’i kujtoj veprat që po bën, duke na akuzuar padrejtësisht me fjalë të liga; dhe, duke mos u kënaqur me kaq, vetë ai nuk i pranon vëllezërit, por ndalon edhe ata që dëshirojnë ta bëjnë këtë gjë dhe i përjashton nga kisha”.

v. 9 “I shkrova diçka kishës” Ndoshta bëhet fjalët për 1 ose 2 Gjonin, ose për ndonjë letër të humbur; me shumë gjasë, bën fjalë për 2 Gjonin. Shih Temën e Veçantë: Kisha (*Ekklesia*) në v. 6.

■ **“Diotrefi, që i pëlqen të jetë i pari ndër ta”** Kjo është PJESORE E TASHME VEPRORE. Kjo është një fjalë e përbërë nga fjalët “dua” (*fileō*) dhe “mbaj vendin e parë” (*prōteuō*). Përdoret vetëm këtu në gjithë DhR, ndërsa termi i dytë përdoret në Kol. 1:18 për epërsinë e Krishtit. Ky njeri është i pari “njeri pushteti” ose “bos kishë” që shënohet në DhR. Nuk e dimë nëse ishte pastor, apo thjesht një njeri laik i rëndësishëm. Gjithsesi, kjo tregon motivet e tij. Ky lloj individit egoist ka qenë i pranishëm në kishë në çdo epokë! Nuk është e qartë dhe as e shprehur shkoqur nëse ai ishte edhe gnostik, ndonëse kjo është e mundur.

James Dunn, *Unity and Diversity in the New Testament* [Uniteti dhe larmia në Dhiatën e Re], f. 392, e sheh Diotrefin si shembull të “katolicizmit të hershëm”.

“Në veçanti, individualizmi i Gjonit mund të kuptohet shumë thjesht pikërisht si *protestë* kundër atyre lloj prirjeve institucionalizuese që ishin kaq të dukshme në letrat pastorale (sipër, në f. 129 e më tej, shih sërish Hebrenjve dhe Zbulesën - §§31, 2, 3). Në mënyrë të ngjashme, shkrimet e Gjonit duket se i kundërvihen atij lloj sakramentalizmi që është tashmë i ngulitur qartë në katolicizmin e hershëm të Ignatit (“ilaçi i pavdekësisë” – Efe. 20.2) (shih më sipër §41). Më interesanti është sulmi i „plakut“ ndaj Diotrefit në 3 Gjonit 9 e më tej. Është e qartë se Diotrefi e kishte nën kontroll të paktën kishën; jo vetëm që ishte në gjendje të refuzonte mikpritjen ndaj të krishterëve vizitorë, por edhe „përjashton nga kisha“ ata që e zemërojnë. Me fjalë të tjera, Diotrefi po vepronte me autoritetin e një peshkopi monarkik (shih Ignati, Efe. 6.1; Tral. 7.2; Smirn. 8.1 e më tej) dhe pikërisht kundër këtij epshi për epërsi dhe pushtet kishtar (*filoproteuon*) shkroi „plaku“. Me fjalë të tjera, nëse supozojmë se 3 Gjonit vjen nga i njëjti rreth si 1 dhe 2 Gjonit, kjo shihet më së miri si përgjigje e një krishterimi të llojit tradicional, e një pietizmi antiinstitucional dhe individualist, që proteston kundër ndikimit gjithnjë e më të madh të katolicizmit të hershëm”.

■ **“nuk pranon ato që themi ne”** Diotrefi, jo vetëm që refuzonte autoritetin apostolik të Gjonit, por edhe merrej në mënyrë agresive me refuzimin e politikës apostolike, madje dhe hakmerrej ndaj atyre që ndiqnin Gjonin!

v. 10 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që nënkupton veprim të mundshëm.

■ “do t’i kujtoj veprat që po bëjnë” Gjoni dëshiron të nxjerrë qartazi në pah motivet e këtij njeriu (shih v. 9) dhe veprimet e tij (shih v. 10):

1. NASB – “duke na akuzuar padrejtësisht me fjalë të liga”
NKJV – “duke llogotitur kundër nesh me fjalë keqdashëse”
NRSV – “duke përhapur akuza të rreme kundër nesh”
TEV – “gjërat e tmerrshme që thotë për ne dhe gënjeshttrat që përhap”
NJB – “akuzat e liga që po qarkullon kundër nesh”
2. “ai vetë nuk i pranon vëllezërit”
3. “ai ndalon edhe ata që dëshirojnë ta bëjnë këtë”
4. “i përjashton nga kisha”

Ky njeri dëshiron të jetë në qendër të vëmendjes dhe nuk e ndan famën me askënd. Po kështu, largon nga kisha atë që s’bie dakord (ose që mund të mos bjerë dakord) me të.

■ “i përjashton nga kisha” Po kjo FOLJE e fortë (*ekballō*) përdoret te Gjoni 9:34, 35 për të verbrin që Jezusi e shëroi dhe, pastaj, e përjashtuan nga sinagoga. Përdoret edhe për shporrjen e Satanit në Gjoni 12:31.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGJET 11-12

¹¹I dashur, mos imito të ligën, por të mirën. Ai që bën të mirën është nga Perëndia; ai që bën të ligën nuk e ka parë Perëndinë. ¹²Demetri ka marrë dëshmi të mirë nga të gjithë, dhe nga vetë e vërteta; dhe ne i shtojmë dëshminë tonë, dhe e dini se dëshmia jonë është e vërtetë.

v. 11 “mos imito të ligën” Kjo është URDHËRORE E TASHME MESORE (deponente) që, shpesh, nënkupton ndalimin e një veprimi në kryerje e sipër. Fjalën “mimikë” e kemi marrë pikërisht nga kjo fjalë greke (*mimēomai*). Duhet t’i zgjedhim me kujdes njerëzit që i kemi si modele për jetën tonë. Ata duhet të jenë të krishterë të pjekur në kishë (shih 2 Thes. 3:7, 9; Heb. 6:12; 13:7). Demetri ishte shembull i mirë, ndërsa Diotrefi ishte shembull i keq.

■ “Ai që bën të mirën është nga Perëndia” Letrat e Gjonit kanë tre prova që të kuptojmë nëse jemi të krishterë. Këtu bëhet fjalë për provën e bindjes (shih 1 Gjonit 2:3-6, 28-29; 3:4-10; 5:18; 2 Gjonit 6). Bëhen aludime dhe për dy provat e tjera: (1) doktrina (v. 3-4) dhe (2) dashuria (v. 1-2, 6).

■ “ai që bën të ligën nuk e ka parë Perëndinë” Mësuesit e rremë pretendonin se e njihnin së afërmi Perëndinë, por bënë jetë të paperëndishme dhe pa dashuri. Kjo reflekton sjelljen e gnostikëve antinomianë dhe të shthurur, që besonin se shpëtimi ishte një e vërtetë mendore që duhej pranuar, por që s’kishte asnjë lidhje me jetën e përditshme.

v. 12 “Demetri ka marrë dëshmi të mirë” Kjo është DËFTORE E KRYER PËSORE. Në fakt, kjo duket si letër rekomandimi për misionarin Demetër, që Gjoni ia dërgon Gajit; ndoshta, vetë Demetri ia dorëzoi letrën e 3 Gjonit Gajit. Për letra të tjera rekomandimi në DhR, shih Veprat 18:27; Rom. 16:1; 1 Kor. 16:3; 2 Kor. 3:1; 8:16-24; Kol. 4:10.

■ “dhe nga vetë e vërteta” E vërteta (shih Temat e Veçanta në Gjoni 6:55 dhe 17:3) personifikohet si një tjetër dëshmitare për dëshminë e mirë të Demetrit.

■ “e dini se dëshmia jonë është e vërtetë” Edhe vetë Gjoni po shpreh dëshminë e tij besnike në lidhje me Krishtin (shih Gjoni 19:35; 21:24).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): VARGJET 13-14

¹³Kisha shumë gjëra për të shkruar, por nuk dua të t’i shkruaj me pendë dhe bojë; ¹⁴por shpresoj të shihemi së shpejti, që të flasim ballë për ballë.

v. 13 Kjo ngjason së tepërmi me 2 Gjonit 12.

v. 14 “Paqja qoftë me ty” Qartazi, këtu bëhet fjalë për shprehjen hebraike *shalom* (shih Luka 10:5). Mund të ketë kuptimin “përshëndetje” ose “mirupafshim”. Ajo shpreh jo vetëm mungesën e problemeve, por edhe praninë e bekimeve të Perëndisë. Këto ishin fjalët e para që Krishti i ringjallur u tha dishepujve në dhomën e sipërme (shih Gjoni 20:19, 21, 26). Pali (shih Efe. 6:23) dhe Pjetri (shih 1 Pje. 5:14) e përdorën si lutje përmyllëse për popullin e Perëndisë.

PYETJE PËR DISKUTIM

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje për diskutim t’i kam dhënë për të të ndihmuar që të analizosh çështjet kryesore të kësaj pjese të librit. Ato synojnë të të nxisin mendimin, jo të kenë natyrë shteruese.

1. Ka patur shumë teori përse Gaji kishte mosmarrëveshje me Diotrefin. Disa nga mendimet e dhëna kanë qenë:
 - a. arsyet teologjike
 - b. arsyet shoqërore
 - c. arsyet kishtarë
 - d. arsyet moraleShpjego secilën prej këtyre mundësive dhe si mund të lidhen ato me 3 Gjonit.
2. Ç’lidhje ka 2 Gjonit me 3 Gjonit?
3. Rendit tri provat për sigurinë e krishterë, që gjenden në 1 Gjonit dhe që përsëriten në 2 Gjonit dhe 3 Gjonit.

SHTOJCA NJË

PËRCAKTIVE TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT

Grequishtja *koine*, shpesh e quajtur grequishtja heleniste, ishte gjuha e përbashkët e botës mesdhetare, duke filluar që nga pushtimi i Aleksandrit të Madh (336-323 para K.) dhe duke zgjatur rreth tetëqind vjet (300 para K. – 500 pas K.). Ajo nuk ishte thjesht greqishte klasike e thjeshtëzuar, por, në shumë mënyra, ishte një formë më e re e greqishtes, e cila u bë gjuha e dytë e Lindjes së mesme dhe botës mesdhetare në lashtësi.

Grequishtja e Dhiatës së Re ishte unike në shumë mënyra pasi përdoruesit e saj, përjashto Lukën dhe autorin e Hebrenjve, ndoshta përdornin aramaishten si gjuhë të parë. Si rrjedhojë, shkrimet e tyre u ndikuan nga idiomat dhe format strukturore të aramaishtes. Po kështu, ata lexonin dhe citonin Septuagintën (përkthimin greqisht të DhV), e cila ishte shkruar gjithashtu në greqishten *koine*. Mirëpo edhe Septuaginta ishte shkruar nga studiues judenj, gjuha amtare e të cilëve nuk ishte greqisht.

Kjo na shërben si kujtesë se nuk mund ta futim forcërisht Dhiatën e Re brenda një strukture të ngushtë gramatikore. Ajo është unike, por, megjithatë, ka shumë të përbashkëta me (1) Septuagintën; (2) shkrimet judaike si ato të Jozefit; dhe (3) papiruset e gjetura në Egjipt. Po atëherë, si duhet t'i qasemi analizës gramatikore të Dhiatës së Re?

Tiparet gramatikore të greqishtes *koine* dhe greqishtes *koine* të Dhiatës së Re janë të paqëndrueshme. Në shumë mënyra, bëhet fjalë për një periudhë thjeshtëzimi të gramatikës. Si udhërrëfyes kryesor do të kemi kontekstin. Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst më të gjerë, prandaj, struktura gramatikore mund të kuptohet vetëm në dritën e (1) stilit individual të autorit; dhe (2) kontekstit të veçantë. Asnjë përcaktim përfundimtar i formave dhe strukturave greke nuk është i mundshëm.

Grequishtja *koine* ishte kryesisht një gjuhë foljore. Shpesh, çelësi drejt interpretimit është lloji dhe forma e trajtave FOLJORE. Në shumicën e rasteve, FOLJA shfaqet e para, duke treguar epërsinë e saj. Në analizën e FOLJES greke, duhen vërejtur tre pjesë informacioni: (1) theksimi bazë i KOHËS, DIATEZËS dhe MËNYRËS (eptimi, ose morfologjia); (2) kuptimi bazë i FOLJES (leksikografia); dhe (3) rrjedha e kontekstit (sintaksa).

I. KOHA

A. Koha ose aspekti ka të bëjë me marrëdhënien e FOLJEVE me veprimin e përfunduar ose të papërfunduar. Shpesh, ai quhet “I KRYER”, ose “I PAKRYER”.

1. KOHËT E KRYERA përqendrohen te kryerja e një veprimi. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk jepet përveç faktit se diçka ka ndodhur! Nuk trajtohet fillimi, vazhdimi, apo kulmimi i veprimit.
2. KOHËT E PAKRYERA përqendrohen te procesi i vazhduar i një veprimi. Mund të përshkruhet në kuadër të veprimit linear, veprimit durativ, veprimit progresiv, etj.

B. Kohët mund të kategorizohen sipas mënyrës sesi autori sheh përparimin e veprimit

1. Ndodhi = AORIST
2. Ndodhi, dhe rezultatet vazhdojnë = E KRYER
3. Po ndodhte në të kaluarën dhe rezultatet po vazhdonin, por jo tani = E KRYER E TEJSHKUAR
4. Po ndodh = E TASHME
5. Po ndodhte = E PAKRYER
6. Do të ndodhë = E ARDHME

Një shembull konkret sesi ndihmojnë këto KOHË në interpretim do të ishte fjala “shpëtoj”. Ajo përdoret në disa kontekste të ndryshme për të treguar, si procesin, ashtu dhe kulmimin e tij:

1. AORISTI = “shpëtoi” (shih Rom. 8:24)
2. E KRYER = “jemi shpëtuar dhe rezultati vazhdon” (shih Efe. 2:5, 8)
3. E TASHME = “po shpëtohem” (shih 1 Kor. 1:18; 15:2)
4. E ARDHME = “do të shpëtohem” (shih Rom. 5:9; 10: 9)

C. Kur përqendrohet te KOHËT E FOLJES, interpretuesi kërkon arsyen pse autori fillestar zgjodhi të shprehej në një KOHË të caktuar. Koha standarde, “pa lajlulë”, ishte AORISTI. Kjo ishte forma e rregullt FOLJORE “e paspecifikuar”, “e paklasifikuar”, ose “e pashënuar”. Ajo mund të përdoret në një larmi të madhe mënyrash, të cilat duhet t'i qartësojë konteksti. Kjo kohë thjesht pohon se diçka ka

ndodhur. Aspekti i kohës së shkuar përdoret vetëm në MËNYRËN DËFTORE. Nëse përdoret një KOHË tjetër, po theksohej diçka më e veçantë. Por çfarë?

1. KOHA E KRYER. Bën fjalë për një veprim të përfunduar, por me rezultate që vazhdojnë. Në disa mënyra, ky ishte një kombinim i KOHËS AORISTE me atë TË TASHME. Zakonisht, fokusi është te rezultatet e vazhdueshme, ose te plotësimi i një veprimi (shembull: Efe. 2:5 dhe 8: “ju jeni shpëtuar dhe po vazhdoni të shpëtoheni”).
2. KOHA E KRYER E TEJSHKUAR. Kjo ishte si E KRYERA, përveçse këtu rezultatet e vazhduara kanë përfunduar. Për shembull: Gjoni 18:16, “Pjetri kishte qëndruar përjashta te porta”.
3. KOHA E TASHME. Flet për një veprim të papërfunduar ose të pakryer. Zakonisht, fokusi është te vazhdimi i ngjarjes. Shembull: 1 Gjoni 3:6 dhe 9, “Kushdo që banon në të nuk vazhdon të mëkatojë”. “Kushdo që është lindur nga Perëndia nuk vazhdon të kryejë mëkat”.
4. KOHA E PAKRYER. Në këtë kohë, marrëdhënia me KOHËN E TASHME është e ngjashme me marrëdhënien mes TË KRYERËS dhe TË KRYERËS SË TEJSHKUAR. E PAKRYERA flet për një veprim të paplotë që po ndodhte por që, tani, ka përfunduar, ose për fillimin e një veprimi në të shkuarën. Shembull: Mateu 3:5, “atëherë gjithë Jerusalemi po vazhdonte të shkonte tek ai”, ose, “atëherë, gjithë Jerusalemi filloi të shkonte tek ai”.
5. KOHA E ARDHME. Bën fjalë për një veprim që, zakonisht, vendoset në një kornizë kohore në të ardhmen. Fokusohej te mundësia e një ndodhie, sesa te një ndodhi aktuale. Shpesh, flet për sigurinë e ngjarjes. Shembull: Mat. 5:4-9, “Të bekuar janë... Ata do të...”.

II. DIATEZA

- A. DIATEZA përkrah marrëdhënien mes veprimit të FOLJES dhe KRYEFJALËS së saj.
- B. DIATEZA VEPRORE ishte mënyra normale, e pritshme dhe e patheksuar për të pohuar se kryefjala po kryente veprimin e FOLJES.
- C. DIATEZA PËSORE do të thotë se kryefjala po merrte veprimin e FOLJES të kryer nga një veprues i jashtëm. Vepruesi i jashtëm që kryente veprimin tregohet në DhR greqisht me anë të këtyre PARAFJALËVE dhe rasave:
 1. Një veprues personal i drejtpërdrejtë, nga *hupo* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22; Veprat 22:30).
 2. Një veprues personal i ndërmjetëm, nga *dia* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22).
 3. Një veprues jopersonal, zakonisht nga *en* me RASËN MJETORE.
 4. Nganjëherë, një veprues personal ose jopersonal, vetëm me anë të RASËS MJETORE.
- D. DIATEZA MESORE tregon se kryefjala prodhon veprimin e FOLJES dhe, gjithashtu, është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e FOLJES. Shpesh, ajo quhet diateza e interesit të shtuar vetjak. Ky konstrukt theksonte në njëfarë mënyre kryefjalën e fjalisë ose periudhës. Ky konstrukt nuk gjendet në anglisht. Ka një mundësi të gjerë kuptimesh dhe përkthimesh në greqisht. Disa shembuj të kësaj forme janë:
 1. VETVETORE – veprimi i drejtpërdrejtë i kryefjalës mbi veten. Shembull: Mat. 27:5: “vari veten”.
 2. INTENSIVE – kryefjala e kryen veprimin për vete. Shembull: 2 Kor. 11:14: “vetë Satani e maskon veten si engjëll drite”.
 3. E NDËRSJELLË – veprimi i ndërsjellë i dy vepruese. Shembull: Mat. 26:4: “ata këshillonin njëri-tjetrin”.

III. MËNYRA (ose “MODALITETI”)

- A. Greqishtja *koine* ka katër MËNYRA. Ato tregojnë marrëdhënien e FOLJES me realitetin, të paktën në mendjen e autorit. MËNYRAT ndahen në dy kategori të përgjithshme: ajo që tregonte realitetin (DËFTORE) dhe ajo që tregonte mundësinë (LIDHORE, URDHËRORE dhe DËSHIRORE).
- B. MËNYRA DËFTORE ishte forma normale për të shprehur një veprim që kishte ndodhur ose që po ndodhte, të paktën në mendjen e autorit. Ishte e vetmja mënyrë greqisht që shprehte një kohë të përcaktuar, ndonëse edhe këtu ky aspekt ishte dytësor.

- C. MËNYRA LIDHORE shprehte veprim të ardhshëm të mundshëm. Diçka nuk kishte ndodhur ende, por kishte mundësi që të ndodhte. Kishte shumë të përbashkëta me DËFTOREN E ARDHME. Dallimi ishte se LIDHORJA shpreh njëfarë mase dyshimi. Shpesh, në anglisht, shprehet me termat “mund të”, “do të”, “mund”.
- D. MËNYRA DËSHIRORE shprehte një dëshire që ishte teorikisht e mundshme. Konsiderohej si një hap më larg realitetit nga LIDHORJA. DËSHIRORJA shprehte mundësi në disa kushte të caktuara. DËSHIRORJA është e rrallë në Dhiatën e Re. Përdorimi i saj më i shpeshtë është në frazën e famshme të Palit, “Kurrë mos qoftë!” (KJV, “Mos e dhëntë Zoti”), e përdorur pesëmbëdhjetë herë (shih Rom. 3:4, 6, 31; 6:2, 15; 7:7, 13; 9:14; 11:1, 11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Shembuj të tjerë gjenden te Luka 1:38; 20:16; Veprat 8:20; dhe 1 Thes. 3:11.
- E. MËNYRA URDHËRORE theksonte një urdhër që ishte i mundshëm, por theksin e vinte te synimi i folësit. Ajo theksonte vetëm një mundësi dëshirore dhe kushtëzohej nga zgjedhjet e tjetrit. URDHËRORJA përdorej në mënyrë të veçantë në lutjet dhe në kërkesat e vetës së tretë. Këto urdhra gjenden vetëm në KOHËN E TASHME dhe atë AORISTE në DhR.
- F. Disa gramatika kategorizojnë edhe PJESORET si një tjetër lloj MËNYRE. Ato janë shumë të zakonshme në DhR greqisht, dhe zakonisht përcaktohen si MBIEMRA FOLJORË. Ato përkthehen në lidhje me FOLJEN kryesoren me të cilën kanë të bëjnë. Ekzistonte një larmi e madhe mundësish për përkthimin e PJESOREVE. Gjëja më e mirë është të konsultosh disa përkthime të Biblës në anglisht. *The Bible in Twenty Six Translations (Bibla në 26 përkthime)*, e botuar nga Baker, është shumë e dobishme në këtë pikë.
- G. DËFTORJA AORISTE VEPRORRE ishte mënyra normale, ose “e paklasifikuar”, për të shënuar një veprim. Çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte një domethënie të veçantë interpretuese që dëshironte të komunikonte autori fillestar.

IV. Për ata që nuk e njohin greqishtes, ndihmat e mëposhtme studimore do t’u sigurojnë informacionet e nevojshme:

- A. Friberg, Barbara dhe Timothy. *Analytical Greek New Testament (Dhiata e Re analitike në greqisht)*. Grand Rapids: Baker, 1988.
- B. Marshall, Alfred. *Interlinear Greek-English New Testament (Dhiata e Re ndërlineare greqisht-anglisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1976.
- C. Mounce, William D. *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament (Leksiku analitik i Dhiatës së Re greqisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1993.
- D. Summers, Ray. *Essentials of New Testament Greek (Elementet bazë të greqishtes së Dhiatës së Re)*. Nashville: Broadman, 1950.
- E. Kurse greqishteje *koine* me korrespondence, të akredituar nga ana akademike, janë të disponueshme përmes Institutit Biblik Moody në Çikago, Illinois

V. EMRAT

- A. Nga ana sintaksore, EMRAT klasifikohen sipas RASËS. RASA ishte forma e eptuar e EMRIT, që tregonte marrëdhënien e tij me FOLJEN dhe me pjesë të tjera të fjalisë. Në greqishten *koine*, shumë prej funksioneve të RASËS tregoheshin nga PARAFJALËT. Meqë forma e RASËS ishte në gjendje të identifikonte një sërë marrëdhëniesh të ndryshme, u zhvilluan PARAFJALËT për t’u dhënë një ndarje më të qartë këtyre funksioneve të mundshme.

- B. RASAT greke kategorizoheshin në tetë mënyrat e mëposhtme:
1. RASA EMËRORE përdorej për të emërtuar dhe, zakonisht, ishte KRYEFJALA e fjalisë ose periudhës. Po kështu, përdorej edhe për EMRAT KALLZUESORË dhe MBIEMRAT me FOLJET lidhëse “jam” ose “bëhem”.
 2. RASA GJINORE përdorej për përshkrim dhe, zakonisht, i caktonte një cilësi ose sasi fjalës me të cilën lidhej. I përgjigjej pyetjes, “Çfarë lloji?” Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “i/e [dikujt]”.
 3. RASA RRJEDHORE përdoret të njëjtën formë të eptuar si GJINORJA, por përdoret për të përshkruar ndarje. Zakonisht, shënonte ndarje nga një pikë në kohë, hapësirë, burim, origjinë ose shkallë. Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “nga/prej”.
 4. RASA DHANORE përdorej për të përshkruar interes vetjak. Mund të shënonte një aspekt pozitiv, ose negativ. Shpesh, ajo ishte KUNDRINORI I ZHDREJTË. Shpesh, në anglisht shprehet me PARAFJALËN “to”.
 5. RASA VENDORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA, por përshkruante pozicionin ose vendndodhjen në hapësirë, kohë, ose kufij logjikë. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “në, mbi, mes, gjatë, me anë të, përbri”.
 6. RASA MJETORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA dhe VENDORJA. Shprehte mjete ose shoqërimi. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “nga” ose “me”.
 7. RASA KALLËZORE përdorej për të përshkruar përfundimin e një veprimi. Shprehte kufizim. Kryesisht, përdorej për KUNDRINORIN E DREJTË. I përgjigjej pyetjes, “Sa larg?”, ose “Deri në çfarë mase?”
 8. RASA THIRRORE përdorej për thirrjen e drejtpërdrejtë.

VI. LIDHËZAT DHE LIDHËSET

- A. Greqishtja është gjuhë shumë precize, për shkak se ka një numër shumë të madh fjalësh lidhëse. Ato lidhin mendimet (PERIUDHAT, FJALITË dhe PARAGRAFËT). Janë caq të zakonshme saqë, shpesh, mungesa (asindetit) e tyre ka rëndësi nga ana ekzegjetike. Në fakt, këto LIDHËZA dhe LIDHËSE tregojnë drejtimin e mendimit të autorit. Shpesh, kanë rol kyç në përcaktimin e saktë të asaj që po përpiqet të përçojë ai.
- B. Ja një listë me disa prej LIDHËZAVE dhe LIDHËSEVE, si dhe kuptimet e tyre (ky informacion është qëmtuar kryesisht nga libri i H. E. Dana dhe Julius K. Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament [Gramatikë praktike e Dhiatës së Re greqisht]*).
1. Fjalët lidhëse kohore
 - a. *epei, epeidē, hopote, hōs, hote, hotan* (LIDH.) – “kur”
 - b. *heōs* – “ndërsa”
 - c. *hotan, epan* (LIDH.) – “kurdo”
 - d. *heōs, achri, mechri* (LIDH.) – “derisa”
 - e. *prin* (PASK.) – “përpara”
 - f. *hōs* – “që kur”, “kur”, “ndërsa”
 2. LIDHËZA logjikë
 - a. Qëllim
 - (1) *hina* (LIDH.), *hopōs* (LIDH.), *hōs* – “me qëllim që”, “që”
 - (2) *hōste* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
 - (3) *pros* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) ose *eis* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
 - b. Rezultat
 - (1) *hōste* (PASKAJORE, kjo është më e përhapura) – “me qëllim që”, “kështu”
 - (2) *hina* (LIDH.) – “në mënyrë që”
 - (3) *ara* – “kështu”
 - c. Shkakore, ose arsye
 - (1) *gar* (shkak/efekt, ose arsye/përfundim) – “sepse,” “pasi”
 - (2) *dioti, hoti* – “sepse”
 - (3) *epei, epeidē, hōs* – “meqë”
 - (4) *dia* (me kallëzore) dhe (me pask. nyjore) – “për shkak”

- d. Rrjedhimore
 - (1) *ara, poinun, hōste* – “prandaj”
 - (2) *dio* (LIDHËZA më e fortë rrjedhimore) – “për shkak të kësaj”, “si rrjedhojë”, “prandaj”
 - (3) *oun* – “prandaj”, “kështu”, “atëherë”, “rrjedhimisht”
 - (4) *toinoun* – “në këtë mënyrë”
 - e. Kundërshtore, ose kontrast
 - (1) *alla* (KUNDËRSHTORE e fortë) – “por”, “përveç”
 - (2) *de* – “por”, “megjithatë”, “gjithsesi”, “nga ana tjetër”
 - (3) *kai* – “por”
 - (4) *mentoi, oun* – “sidoqoftë”
 - (5) *plēn* – “gjithsesi” (kryesisht te Luka)
 - (6) *oun* – “megjithatë”
 - f. Krahasim
 - (1) *hōs, kathōs* (prezanton FJALITË KRAHASUESE)
 - (2) *kata* (në fjalë të përbëra, *katho, kathoti, kathōsper, kathaper*)
 - (3) *hosos* (te Hebrenjve)
 - (4) *ē* – “sesa”
 - g. Vazhduese, ose seri
 - (1) *de* - “dhe”, “tani”
 - (2) *kai* – “dhe”
 - (3) *te* – “dhe”
 - (4) *hina, oun* – “që”
 - (5) *oun* – “atëherë” (te Gjoni)
3. Përdorimet theksuese
- a. *alla* – “sigurisht”, “po”, “madje”
 - b. *ara* – “me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - c. *gar* – “por me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - d. *de* – “me të vërtetë”
 - e. *ean* – “madje”
 - f. *kai* – “madje”, “me të vërtetë”, “vërtet”
 - g. *mentoi* – “me të vërtetë”
 - h. *oun* – “vërtetë”, “patjetër”

VII. PERIUDHA KUSHTORE

- A. PERIUDHA KUSHTORE është ajo që përmban një ose më tepër fjali të varura kushtore. Kjo strukturë gramatikore i vjen në ndihmë interpretimit për shkak se jep kushtet, arsyet, ose shkaqet pse ndodh ose pse nuk ndodh veprimi i FOLJES kryesore. Ka katër lloje PERIUDHASH KUSHTORE. Ato variojnë nga ajo që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit (ose për synimet e tij) tek ajo që është vetëm dëshirë.
- B. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË PARË shprehte veprim ose qenie që supozohej si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrimtarit (ose për synimet e tij), ndonëse shprehej me “nëse”. Në një sërë kontekstesh, mund të përkthehet “meqë” (shih Mat. 4:3; Rom. 8:31). Sidoqoftë, me këtë nuk nënkuptojmë se të gjitha KLASET E PARË përputhen me realitetin. Shpesh, ato përdoren për të vërtetuar një argument ose për të theksuar një ide të gabuar (shih Mat. 12:27).
- C. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË DYTË shpesh quhet “kundër fakteve”. Ajo shpreh diçka që ishte e pavërtetë ndaj realitetit, në mënyrë që të argumentonte diçka. Shembuj:
 - 1. “Po të ishte vërtet profet, dhe nuk është i tillë, do të dinte se kush dhe ç’karakter është kjo gruaja që po varet tek ai, por ja që nuk e di” (Luka 7:39)
 - 2. “Po t’i kishit besuar vërtet Moisiut, por ju nuk i besoni, do të besonit edhe në mua, por ja që nuk po e bëni” (Gjoni 5:46)
 - 3. “Po të përpiqesha ende që të kënaqja njerëzit, gjë që nuk po e bëj, nuk do të isha aspak skllav i Krishtit, por ja që jam i tillë” (Gal. 1:10).

- D. KLASI I TRETË bën fjalë për një veprim të mundshëm në të ardhmen. Shpesh, supozon probabilitetin e veprimit. Zakonisht, nënkupton kushtëzim nga rrethanat. Veprimi i FOLJES kryesore varet nga veprimi në fjalinë e varur që fillon me “nëse”. Shembuj nga 1 Gjoni: 1:6-10; 2:4, 6, 9, 15, 20, 21, 24, 29; 3:21; 4:20; 5:14, 16.
- E. KLASI I KATËRT është më i largëti për sa i përket mundësisë. Është i rrallë në DhR. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë PERIUDHË e plotë KUSHTORE E KLASIT TË KATËRT, ku të dyja pjesët e kushtit të përputhen me këtë përcaktim. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë hapëse është 1 Pje. 3:14. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë përmbyllëse është Veprat 8:31.

VIII. NDALIMET

- A. URDHËRORJA E TASHME me PJESËZËN MË shpesh (por jo ekskluzivisht) thekson ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër. Disa shembuj: “mos mblidhni më pasuri në tokë...” (Mat. 6:19); “mos u shqetësoni më për jetën tuaj...” (Mat. 6:25); “mos i ofroni më mëkatit gjymtyrët e trupit tuaj si mjete keqbërjeje...” (Rom. 6:13); “duhet të ndalni së fyeri Frymën e Shenjtë të Perëndisë...” (Efe. 4:30); dhe “ndalni së u dehuri me verë...” (5:18).
- B. LIDHORJA AORISTE me PJESËZËN MË ka këtë theks: “as mos fillo apo nis të bësh një veprim”. Disa shembuj: “As mos fillo të mendosh se...” (Mat. 5:17); “kurrë mos fillo të shqetësohesh...” (Mat. 6:31); “kurrë s’duhet të kesh turp...” (2 Tim. 1:8).
- C. MOHORJA E DYFISHTË me MËNYRËN LIDHORE përbën një mohim shumë të theksuar. “Kurrën e kurrës”, ose “në asnjë lloj rrethane”. Disa shembuj: “Ai nuk do të përjetojë kurrën e kurrës vdekje” (Gjoni 8:51); “Unë, kurrën e kurrës, nuk...” (1 Kor. 8:13).

IX. NYJA SHQUESE

- A. Në greqishten *koine*, NYJA SHQUESE kishte një përdorim të ngjashëm me një shquese “*the*” në anglisht. Funkzioni bazë i saj ishte të shërbente si “dëftues”, si mënyrë për të tërhequr vëmendjen ndaj një fjale, emri, ose fraze. Përdorimi i saj ndryshon nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. NYJA SHQUESE mund të funksionojë edhe si
1. mjet ballafaques, si PËREMËR dëftor;
 2. shenjë për t’iu referuar një teme ose personi të prezantuar më herët;
 3. mënyrë për të identifikuar KRYEFJALËN në fjali me një FOLJE lidhëse. Shembuj: “Perëndia është Frymë” (Gjoni 4:24); “Perëndia është dritë” (1 Gjoni 1:5); “Perëndia është dashuri” (4:8, 16).
- B. Greqishtja *koine* nuk kishte NYJË JOSHQUESE si në anglisht, “a” ose “an”. Mungesa e NYJËS SHQUESE mund të nënkuptonte
1. Një përqendrim te karakteristikat ose cilësitë e diçkaje
 2. Një fokus në kategorinë e diçkaje
- C. Autorët e DhR ndryshonin së tepërmi nga njëri-tjetri për mënyrën si e përdornin NYJËN.

X. MËNYRA PËR TË TREGUAR THEKSIMIN NË DHIATËN E RE GREQISHT

- A. Teknikat për të treguar theksimin ndryshojnë nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. Shkrimtarët më të njëtrajtshëm dhe më formalë ishin Luka dhe autori i Hebrenjve.
- B. Më herët, pohuam se DËFTORJA AORISTE VEPRORË ishte standarde dhe e paklasifikuar për theksim, por çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte domethënie nga ana interpretuese. Me këtë nuk po themi se DËFTORJA AORISTE VEPRORË nuk përdorej shpesh në një kuptim gramatikor domethënës. (Shembull: Rom. 6:10 [dy herë]).

C. Rendi i fjalëve në greqishten *koine*

1. Greqishtja *koinè* ishte një gjuhë e eptuar që, në dallim nga anglishtja, nuk varej nga rendi i fjalëve. Si rrjedhojë, autori mund ta ndryshojë rendin e pritshëm dhe normal të fjalëve për të treguar
 - a. atë që autori donte t'i theksonte lexuesit
 - b. atë që autori mendonte se do të ishte e papritur për lexuesin
 - c. atë që autori e kishte shumë për zemër
2. Rendi normal i fjalëve në greqisht është ende një çështje e pazgjidhur. Megjithatë, rendi i supozuar normal është ky:
 - a. për FOLJET lidhëse
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) PLOTËS
 - b. për FOLJET KALIMTARE
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) KUNDRINOR
 - (4) KUNDRINOR I ZHDREJTË
 - (5) FRAZË PARAFJALORE
 - c. për FRAZAT EMËRORE
 - (1) EMËR
 - (2) PËRCAKTOR
 - (3) FRAZË PARAFJALORE
3. Rendi i fjalëve mund të jetë një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme ekzegjetike. Shembuj:
 - a. “dorën e djathtë na dhanë mua dhe Barnabës për miqësi”. Fraza “dora e djathtë e miqësisë” ndahet dhe është vendosur në krye për të treguar domethënien e vet (Gal. 2:9).
 - b. “me Krishtin” vendoset në fillim. Vdekja e tij ishte qendrore (Gal. 2:20).
 - c. “ishte pjesë-pjesë dhe në shumë mënyra të ndryshme” (Heb. 1:1) vendoset në fillim. Kontrasti që po jepet është mënyra sesi Perëndia e zbuloi veten, jo fakti i zbulësës.

D. Zakonisht, njëfarë shkalle theksimi tregohet nga

1. Përsëritja e PËREMËRIT që ishte tashmë i pranishëm në formën e eptuar të FOLJES. Shembull: “unë, vetë, do të jem patjetër me ju...” (Mat. 28:20).
2. Mungesa e një LIDHËZE të pritshme, ose ndonjë tjetër mjeti lidhës mes fjalëve, frazave, fjalive, ose periudhave. Kjo gjë quhet asindet (“jo e lidhur”). Mjeti lidhës pritej, prandaj mungesa e tij tërhiqte vëmendje. Shembuj:
 - a. “Lum”-et në Mal, Mat. 5:3 e më tej (e theksoi listën)
 - b. Gjoni 14:1 (temë e re)
 - c. Romakëve 9:1 (pjesë e re)
 - d. 2 Kor. 12:20 (thekson listën)
3. Përsëritja e fjalëve ose frazave të pranishme në një kontekst të dhënë. Shembuj: “për lëvdimin e lavdisë së tij” (Efe. 1:6, 12 & 14). Kjo frazë përdoret për të treguar veprën e secilit person të Trinisë.
4. Përdorimi i një idiome ose loje fjalësh (tingujsh) mes termave
 - a. eufemizmat – zëvendësim fjalësh për disa tema tabu, si “gjumi” për vdekjen (Gjoni 11:11-14), ose “këmbët” për gjenitalet mashkullore (Ruthi 3:7-8; 1 Sam. 24:3).
 - b. perifrazimet – zëvendësim fjalësh për emrin e Perëndisë, si “Mbretëria e qiejve” (Mat. 3:21), ose “një zë nga qielli” (Mat. 3:17).
 - c. FIGURAT LETRARE
 - (1) ekzagjerime të pamundura (Mat. 3:9; 5:29-30; 19:24)
 - (2) pohime disi të tepruara (Mat. 3:5; Veprat 2:36)
 - (3) personifikime (1 Kor. 15:55)
 - (4) ironi (Gal. 5:12)
 - (5) pasazhe poetike (Fil. 2:6-11)
 - (6) lojë tingujsh mes fjalëve
 - (a) “kisha”
 - i. “kisha” (Efe. 3:21)

- ii. “thirrja” (Efe. 4:1, 4)
- iii. “i thirrur” (Efe. 4:1, 4)
- (b) “i lirë”
 - i. “grua e lirë” (Gal. 4:31)
 - ii. “liri” (Gal. 5:1)
 - iii. “i lirë” (Gal. 5:1)
- d. gjuha idiomatike – terminologji që, zakonisht, është e veçantë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme:
 - (1) përdorimi figurativ i fjalës “ushqim” (Gjoni 4:31-34)
 - (2) përdorimi figurativ i fjalës “tempull” (Gjoni 2:19; Mat. 26:61)
 - (3) idioma hebraike për termin dhembshuri, “urrej” (Zan. 29:31; LiP. 21:15; Luka 14:36; Gjoni 12:25; Rom. 9:13)
 - (4) “Të gjithë” përkundër “shumë”-ve. Krahaso Isa. 53:6 (“të gjithë”) me 53:11 & 12 (“shumë”). Këta terma janë sinonimikë, siç e tregojnë dhe Rom. 5:18 dhe 19.
- 5. Përdorimi i një fraze të plotë gjuhësore, në vend të një fjale të vetme. Shembull: “Zoti Jezu Krisht”.
- 6. Përdorimi i veçantë i *autos*
 - a. kur ka NYJË (pozicioni atributiv), përkthehej “i njëjti”.
 - b. kur s’ka NYJË (pozicioni kallëzuesor), përkthehej si PËREMËR VETVETOR INTENSIV – “veten e tij”, “veten e saj”.
- E. Studiuesi i Biblës që nuk di greqisht mund ta identifikojë theksimin në mënyra të ndryshme:
 - 1. Përdorimi i një leksiku analitik dhe i një teksti ndërlinear greqisht/anglisht.
 - 2. Krahasimi i përkthimeve në gjuhën angleze, sidomos ato përkthime që kanë teori të ndryshme përkthimi. Shembull: krahasimi i një përkthimi “fjalë për fjalë” (KJV, NKJV, ASV, NASB, RSV, NRSV) me një përkthim të “ekuivalencës dinamike” (Williams, NIV, NEB, REB, JB, NJB, TEV). Ndhimë e dobishme këtu do të ishte *The Bible in Twenty-Six Translations*, përkthyer nga Baker.
 - 3. Përdorimi i *The Emphasized Bible (Bibla e theksuar)*, nga Joseph Bryant Rotherham (Kregel, 1994).
 - 4. Përdorimi i një përkthimi shumë të fjalëpërfjalshëm
 - a. *The American Standard Version* i vitit 1901
 - b. *Young’s Literal Translation of the Bible*, nga Robert Young (Guardian Press, 1976).

Studimi i gramatikës është i mërzitshëm, por i domosdoshëm për interpretimin e saktë. Këto përcaktime të shkurtra, komente dhe shembuj synojnë të inkurajojnë dhe të pajisin personat që nuk dinë greqisht që të përdorin shënimet gramatikore të dhëna në këtë vëllim. Pa dyshim, këto përcaktime janë të mbithjeshtëzuara. Ato nuk duhen përdorur në mënyrë dogmatike dhe të pandryshueshme, por si trampolina drejt të kuptuarit më të mirë të sintaksës së Dhiatës së Re. Shpresoj se këto përcaktime do t’u mundësojnë lexuesve edhe që të kuptojnë komentet e ndihmave të tjera studimore, si komentaret teknikë për Dhiatën e Re.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimin tonë ta verifikojmë në bazë të informacionit që gjendet në tekstin e Biblës. Gramatika është një nga pjesët më të dobishme të këtij informacioni; elementet e tjera përfshijnë sfondin historik, kontekstin letrar, përdorimin bashkëkohor të fjalëve, dhe pasazhet paralele.

SHTOJCA DY

KRITIKA E TEKSTIT

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojmë shënimet tekstuale që gjenden në këtë komentari. Do të përdorim përvijimin e mëposhtëm:

- I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht
 - A. Dhiata e Vjetër
 - B. Dhiata e Re
- II. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kritikës së ulët”, e quajtur edhe „kritika e tekstit”.
- III. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

A. Dhiata e Vjetër

1. Teksti Masoretik (MT) – teksti bashkëtingëllor hebraisht u përcaktua nga rabini Akiva më 100 pas K. Pikat e zanoreve, thekset, shënimet anësore, pikësimi dhe pikat e aparatusit filluan të shtoheshin në shekullin në shekullin e gjashtë pas K. dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas K. Kjo u bë nga një familje studiuesish judenj të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që përdorën ata ishte e njëjta që përdoret në Mishnah, Talmud, Targumet, Peshita dhe Vulgatë.
2. Septuaginta (LXX) – Tradita thotë se Septuaginta u prodhua nga 70 studiues judenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë, me sponsorizimin e mbretit Ptoleme II (285-246 pas K.). Me gjasë, përkthimi u kërkua nga një udhëheqës jude që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristeas”. Shpesh, LXX bazohet në një traditë tekstuale hebraisht që ndryshon nga teksti i rabinit Akiva (MT).
3. Pergamenat e Detit të Vdekur (DSS) – Pergamenat e Detit të Vdekur u shkruan në periudhën romake para Krishtit (200 para K. deri më 70 pas K.) nga një sekt separatisësh judenj të quajtur “esenë”. Dorëshkrimet hebraisht, të gjetura në vendndodhje të ndryshme përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraisht disi të ndryshme nga ajo e MT dhe LXX.
4. Disa shembuj të veçantë për mënyrën sesi krahasimi i këtyre teksteve ka ndihmuar interpretuesit që të kuptojnë Dhiatën e Vjetër
 - a. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) LXX, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë do të mahnitën me të”.
 - (2) MTT, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë u habitën me ty”.
 - (3) Në Isa. 52:15 konfirmohet dallimi përemëror i LXX
 - (a) LXX, “kështu dhe shumë kombe do të mrekullohen prej tij”
 - (b) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”
 - b. DSS kanë ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) DSS, në Isa. 21:8: “atëherë vrojtuesi bërtiti, „Mbi një kullë roje po qëndroj...”
 - (2) MT, në Isa. 21:8: “dhe unë bërtita, një luan! Zoti im, unë do të qëndroj gjithmonë në kullën e rojës ditën...”
 - c. Si LXX, ashtu dhe DSS, kanë ndihmuar për qartësimin e Isa. 53:11
 - (1) LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij, ai do të shohë dritë dhe do të kënaqet”
 - (2) MT, “ai do të shohë... e mundimit të shpirtit të tij, do të kënaqet”

B. Dhiata e Re

1. Kanë mbijetuar mbi 5,300 dorëshkrime të gjithë Dhiatës së Re, ose të pjesëve të saj. Rreth 85 janë shkruar në papirus ndërsa 268 prej tyre janë shkruar vetëm me shkronja të mëdha (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas K., u zhvillua një shkrim i lidhur (minuskul). Dorëshkrimet greqisht, në formë të shkruar, numërojnë rreth 2,700. Po kështu, kemi dhe rreth 2,100 kopje me lista pasazhesh biblike që përdorëshin në adhurim, të cilat i quajmë leksionarë.
2. Rreth 85 dorëshkrime greqisht, që përmbajnë pjesë të Dhiatës së Re të shkruara në papirus, gjenden në muze. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas K., por shumica janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas K. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban gjithë Dhiatën e Re. Thjesht fakti se ato janë kopjet më të lashta të Dhiatës së Re nuk do të thotë automatikisht se kanë më pak variante. Shumë prej tyre u

kopjuan me shpejtësi për përdorim lokal. Nuk u ushtrua kujdes në këtë proces. Si rrjedhojë, ato përmbajnë shumë variante.

3. Kodiku Sinaitikus, i njohur me shkronjën hebraisht **א** (*alef*), ose (01), i gjetur në manastirin e shën Katerinës në malin Sinai nga Tischendorf. Daton nga shekulli i katërt pas K. dhe përmban, si LXX-në e DhV, ashtu dhe Dh.R. greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
4. Kodiku Aleksandrinus, i njohur si “A”, ose (02), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili u gjet në Aleksandri të Egjiptit.
5. Kodiku Vatikanus, i njohur si “B”, ose (03), i gjetur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas K. Përmban si LXX-në e Dhiatës së Vjetër, ashtu dhe Dhiatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
6. Kodiku Ephraemi, i njohur si “C”, ose (04), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili është shkatërruar pjesërisht.
7. Kodiku Bezae, i njohur si “D”, ose (05), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë ose të gjashtë. Është përfaqësuesi kryesor i atij që quhet “tekst perëndimor”. Përmban shumë shtesa dhe është dëshmitari kryesor në greqisht për përkthimin e King James Version.
8. Dorëshkrimet e DhR mund të grupohen në tre, ndoshta dhe katër, familje që ndajnë disa karakteristika.
 - a. Teksti aleksandrian nga Egjipti
 - (1) P⁷⁵, P⁶⁶ (rreth 200 pas K.), që përmbajnë ungjijtë
 - (2) P⁴⁶ (rreth 225 pas K.), që përmban letrat e Palit
 - (3) P⁷² (rreth 225-250 pas K.), që përmban Pjetrin dhe Judën
 - (4) Kodiku B, i quajtur Vatikanus (rreth 325 pas K.), që përfshin gjithë DhV dhe DhR
 - (5) Origeni citon nga ky lloj teksti
 - (6) Dorëshkrime të tjera që shfaqin këtë lloj teksti janë **א**, C, L, W, 33
 - b. Teksti perëndimor nga Afrika veriore
 - (1) Citime nga etërit e kishës në Afrikën veriore, Tertuliani, Qipriani dhe përkthimi i “Vjetër Latin”
 - (2) Citime nga Ireneu
 - (3) Citime nga Tatiani dhe përkthimi “i Vjetër Siriak”
 - (4) Kodiku D, “Beza”, ndjek këtë lloj teksti
 - c. Teksti bizantin i lindjes, nga Kostandinopoja
 - (1) Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 dorëshkrimeve
 - (2) Citohet nga etërit e kishës në Antioki të Sirisë, Kapadokianët, Gojarti dhe Theodoret
 - (3) Kodiku A, vetëm në ungjijtë
 - (4) Kodiku E (shekulli i tetë) për gjithë DhR
 - d. Lloji i katërt i mundshëm është ai “cezareas”, nga Palestina
 - (1) Kryesisht, shihet vetëm te Marku
 - (2) Disa dëshmitarë të tij janë P⁴⁵ dhe W

II. Problemet dhe teoritë e “kritikës së ulët”, ose “kritikës së tekstit”.

A. Si u shfaqën variantet

1. të paqëllimshëm ose aksidentalë (shumica dërrmuese e tyre)
 - a. shkarje syri në kopjimin me dorë, ky syri lexon rastin e dytë të dy fjalëve të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, lë pa shkruar të gjitha fjalët e ndërmjetme (homoioteleuton)
 - (1) shkarje syri, duke lënë pa shkruar një shkronjë, fjalë, ose frazë, që duhej shkruar dy herë (haplografi)
 - (2) shkarje mendjeje, duke përsëritur një frazë ose rresht të tekstit greqisht (ditografi)
 - b. shkarje veshi, që ndodhte në kopjimin me diktim gojor, ku ndodh një keqshqiptim (itacizëm). Shpesh, keqshqiptimi nënkupton ose shqipton një fjalë tjetër greqisht, që tingëllon në mënyrë të ngjashme.
 - c. teksti më i hershëm greqisht nuk kishte ndarje në kapituj apo vargje, pak ose aspak pikëzim dhe asnjë ndarje mes fjalëve. Është e mundur që t’i ndash shkronjat në vende të ndryshme, duke formuar fjalë të ndryshme.
2. të qëllimshëm
 - a. bëheshin ndryshime për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar

- b. bëheshin ndryshime duke kombinuar dy ose më tepër variante të ndryshme në një tekst të gjatë e të kombinuar (bashkëshkrimje)
 - c. bëheshin ndryshime për të korrigjuar ndonjë problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
 - d. disa informacione shtesë në lidhje me sfondin historik ose interpretimin e duhur të tekstit vendoseshin në anë të faqes nga njëri kopjues, ndërsa një kopjues i dytë i fuste në tekst (shih Gjoni 5:4)
- B. Parimet bazë të kritikës së tekstit (udhërrëfytes logjikë për përcaktimin e leximit original të një teksti kur ekzistojnë forma variante)
- 1. Teksti më i vështirë, ose më i pazakontë nga ana gramatikore, ka gjasa të jetë origjinali
 - 2. Teksti më i shkurtër ka gjasa të jetë origjinali
 - 3. Tekstit më të vjetër i jepet më tepër peshë për shkak të afërsisë së tij historike me origjinalin, në rast se gjithçka tjetër është në ekuilibër
 - 4. MSS që janë të larmishme nga ana gjeografike zakonisht kanë leximin origjinal
 - 5. Duhet preferuar tekstet më të dobët nga ana doktrimore, sidomos ato që lidhen me diskutimet kryesore teologjike të periudhës së ndryshimeve në dorëshkrime, si Trinia në 1 Gjonit 5:7-8.
 - 6. Teksti që arrin të shpjegojë më mirë origjinën e varianteve të tjerë
 - 7. Dy citime që ndihmojnë për të treguar ekuilibrin për këto variante shqetësuese
 - a. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism*, f. 68:
 “Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet nga një tekst i debatueshëm; dhe studiuesi i DhR duhet të ketë kujdes që të mos dëshirojë që teksti i tij të jetë më ortodoks, ose më i fortë nga ana doktrinor, sesa vetë origjinali i frymëzuar”.
 - b. W. A. Criswell i tha Greg Garrisonit të *The Birmingham News* se ai (Criswell) nuk besonte se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut të sotëm nga shekuj përkthyesish”. Criswell tha: “unë jam besimtar i fortë në kritikë e tekstit. Si i tillë, unë mendoj se gjysma e fundit e kapitullit 16 të Markut është herezi: nuk është e frymëzuar, por thjesht e shpikur.... Kur e krahason me dorëshkrimet më të lashta, nuk ekziston diçka e tillë si përmbyllja e librit të Markut. Dikush e shtoi...”
 Patriarku i atyre të SBC-së që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës pohoi gjithashtu se “ndërhyrja” është e dukshme edhe në Gjoni 5, në rrëfimin e Jezusit te pellgu i Betezdës. Po kështu, ai diskuton për dy rrëfimet e ndryshme të vetëvrasjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat 1): “Këtu kemi thjesht një pikëpamje të ndryshme të vetëvrasjes”, tha Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një shpjegim për këtë. Dhe dy rrëfimet e vetëvrasjes së Judës janë në Bibël”. Criswell shtoi: “Kritika e tekstit është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Nuk është kalimtare, nuk është e pacipë. Ajo është dinamike dhe qendrore...”

III. Problemet në dorëshkrime (kritika e tekstit)

A. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

- 1. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual (Kritika e Biblës: historike, letrare dhe tekstuale)*, nga R. H. Harrison
- 2. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption, and Restoration (Teksti i Dhiatës së Re: transmetimi, shprishja dhe ndreqja e tij)*, nga Bruce M. Metzger
- 3. *Introduction to New Testament Textual Criticism (Hyrje në kritikën e tekstit të Dhiatës së Re)*, nga J. H. Greenlee

SHTOJCA TRE

FJALORTH

A priori. Në thelb, ky është sinonim i termit “presupozim”. Nënkupton arsyetim mbi bazën e përcaktimeve, parimeve, ose pozicioneve të pranuar më parë, të cilat merren si të vërteta. Pra, nënkupton atë që pranohet pa shqyrtim ose analizë.

Adopsionizmi. Ishte një nga pikëpamjet e hershme për marrëdhënien e Jezusit me hyjninë. Në thelb, pohonte se Jezusi ishte njeri normal në të gjitha mënyrat dhe se u birësua në mënyrë të veçantë nga Perëndia në çastin e pagëzimit (shih Mat. 3:17; Marku 1:11), ose në ringjalljen e tij (Rom. 1:4). Jezusi bëri një jetë kaq shembullore saqë Perëndia, në një pikë të caktuar, (në pagëzim, ose në ringjallje) e adoptoi si “birin” e vet (shih Rom. 1:4; Fil. 2:9). Kjo ishte një pikëpamje pakice në kishën e hershme në shekullin e tetë. Në vend që Perëndia të bëhet njeri (Mishërimi), kjo pikëpamje e përmbys radhën dhe, tani, njeriu bëhet Perëndi!

Ajo është tejet simbolike dhe imagjinare, me shumë terma kriptikë. Shpesh, të vërtetën e shpreh me ngjyra, numra, vegime, ëndrra, ndërmjetësime engjëjsh, fjalë të fshehta e të koduara dhe, shpesh, me një dualizëm të fortë mes mirësisë dhe ligësisë.

Alegori. Ky është një lloj interpretimi biblik që, së pari, u zhvillua brenda judaizmit aleksandrian. U popullarizua nga Filoja i Aleksandrisë. Thelbi bazë i alegorisë është dëshira për t’i dhënë Shkrimit peshë aktuale në sistemin filozofik ose kulturor të kohës duke anashkaluar sfondin historik dhe/ose kontekstin letrar të Biblës. Ajo kërkon një kuptim të fshehur ose shpirtëror pas çdo teksti të Shkrimit. Duhet pranuar se Jezusi, në Mateu 13, dhe Pali, në Galatasve 4, përdorën alegori për të përçuar të vërtetën. Sidoqoftë, këtë e bënë në formë tipologjie, jo ngushtësisht alegorie.

Aleksandrinus. Ky dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë nga Aleksandria, në Egjipt, përfshin Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe shumicën e Dhiatës së Re. Ai është një nga dëshmitarët tanë kryesorë për gjithë Dhiatën e Re në greqisht (me përjashtim të disa pjesëve të Mateut, Gjonit dhe 2 Korintasve). Kur ky dorëshkrim, që emërtohet me shkronjën “A”, përkon me dorëshkrimin e emërtuar “B” (Vatikanus) për ndonjë variant të caktuar teksti, konsiderohet si teksti origjinal nga shumica e studiuesve në shumicën e rasteve.

Analogjia e Shkrimit. Kjo frazë përdoret për të përshkruar pikëpamjen se gjithë Bibla është frymëzuar nga Perëndia dhe se, si rrjedhojë, nuk është kontradiktore, por plotësuese, në vetvete. Ky pohim parasupozues është baza për përdorimin e pasazheve paralele për të interpretuar pjesët biblike.

Anësi. Ky është një term që përdoret për të përshkruar një predispozitë të fortë kundrejt një objekti ose pikëpamjeje. Është një mendësi ku paanësia është e pamundur në lidhje me një objekt ose pikëpamje të caktuar. Anësia është një pozicion i paragjykuar.

Antitetik. Ky është një nga tre termat përshkruar që përdoren për të përcaktuar marrëdhënien mes rreshtave të poezisë hebraike. Ajo përshkruan ato rreshta poezie që janë të kundërt në kuptim me njëra-tjetrën (shih Prov. 10:1; 15:1).

Antropomorfik. Ky term do të thotë “të kesh karakteristika që shfaqen në qeniet njerëzore” dhe përdoret për të përshkruar terminologjinë tonë fetare në lidhje me Perëndinë. Ai vjen nga fjala greke “njerëzim”. Do të thotë se ne flasim për Perëndinë si të ishte njeri. Perëndia përshkruhet me fjalë fizike, sociologjike dhe psikologjike që lidhen me qeniet njerëzore (shih Zan. 3:8; 1 Mbret. 22:19-23). Sigurisht, kjo është thjesht analogji. Sidoqoftë, s’kemi ç’kategori ose fjalë të tjera të përdorim përveç atyre njerëzore. Si rrjedhojë, ndonëse e vërtetë, njohuria jonë për Perëndinë është e kufizuar.

Apolog (Apologjetikë). Kjo vjen nga rrënja e fjalës greke “mbrojtje ligjore”. Përbën një disiplinë të veçantë brenda teologjisë, e cila përpiket të japë fakte dhe argumente racionale për besimin e krishterë.

Arianizëm. Ari ishte presbiter në kishën e Aleksandrisë, në Egjipt, në shekullin e tretë dhe në fillim të shekullit të katërt. Ai thoshte se Jezusi ishte paraekzistues, por jo hyjnor (jo i së njëjtës substance si Ati), ndoshta duke ndjekur Fjalët e Urta 8:22-31. Ai u sfidua nga peshkopi i Aleksandrisë, i cili (më 318 pas K.) nisi një polemikë që zgjati shumë vjet. Arianizmi u bë kredoja zyrtare e kishës lindore. Këshilli i Nikesë, më 325 pas K., e dënoi Arin dhe pohoi barazinë e plotë të Birit me Atin si dhe natyrën e tij të plotë hyjnore.

Aristoteli. Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë, nxënës i Platonit dhe mësues i Aleksandrit të Madh. Edhe sot, ndikimi i tij depërton në shumë fusha të studimeve moderne. Kjo ndodh për shkak se ai theksonte njohurinë përmes vëzhgimit dhe klasifikimit. Ky është një nga parimet bazë të metodës shkencore.

- Autografet.** Ky është një emër që u jepet shkrimeve origjinale të Biblës. Të gjitha këto dorëshkrime origjinale, të shkruara me dorë, kanë humbur. Kanë mbetur vetëm kopjet e kopjeve. Ky është burimi i shumë varianteve tekstuale në dorëshkrimet hebraisht dhe greqisht dhe në versionet e lashta.
- Autori fillestar.** Me këtë, kuptojmë autorët/shkruesit realë të Shkrimit.
- Autoriteti biblik.** Ky term përdoret në një kuptim shumë të specializuar. Përcaktohet si përpjekja për të kuptuar atë që tha autori fillestar në kohën e vet dhe për ta zbatuar këtë të vërtetë në kohën tonë. Zakonisht, autoriteti Biblik përcaktohet si “konsiderimi i Biblës vetë si udhërrëfyesi ynë i vetëm me autoritet”. Sidoqoftë, në dritën e disa interpretimeve të papërshtatshme të kohës sonë, këtë koncept e kam kufizuar për të nënkuptuar interpretimin e Biblës sipas parimeve të metodës historiko-gramatikore.
- Beza.** Ky është një dorëshkrim greqisht dhe latinisht i shekullit të gjashtë pas K. Emërtohet “D”. Përmban ungjijë, Veprat dhe disa nga letrat e përgjithshme. Karakterizohet nga shumë shtesa shkruarish. Përbën bazën e “Textus Receptus”, tradita kryesore e dorëshkrimeve greqisht që qëndron pas King James Version.
- Deduktive.** Kjo metodë logjike ose arsyetimi kalon nga parimet e përgjithshme në zbatime të veçantë me anë të arsyes. Është e kundërta e arsyetimit induktiv, i cili reflekton metodën shkencore duke kaluar nga elementet e veçanta të vëzhguara në përfundime të përgjithshme (teori).
- Dialektike.** Kjo është metoda arsyetuese me anë të së cilës ajo që duket kontradiktore ose paradoksale mbahet e bashkuar brenda një tensioni, duke kërkuar një përgjigje të unifikuar që përfshin të dyja anët e paradoksit. Shumë doktrina biblike kanë çifte dialektike, paracaktimi-vullneti i lirë; siguria-qëndresa; besimi-veprat; vendimi-dishepullizimi; liria e krishterë-përgjegjësia e krishterë.
- Diaspora.** Ky është termi teknik që përdoret nga judenjtë e Palestinës për të përshkruar judenjtë e tjerë që jetonin jashtë kufijve gjeografikë të Tokës së Premtuar.
- Disa parime të shprehura të gnosticizmit valentinian dhe kerintian në shekullin e dytë janë: (1) materia dhe shpirti janë të bashkëpërbërshme (dualizmi ontologjik). Materia është e keqe, shpirti është i mirë. Perëndia, i cili është shpirti, nuk mund të merret drejtpërdrejt me modelimin e materies së ligë; (2) midis Perëndisë dhe materies ekzistojnë “rrezatime” (*eon-et*, ose nivelet engjëlllore). I fundmi dhe më i ulëti i tyre ishte Jahve i DhV, i cili formoi universin (*kozmos*); (3) Jezusi ishte një rrezatim si Jahve, por i një shkalle më të lartë, më pranë Perëndisë së vërtetë. Disa e vendosnin në shkallën më të lartë, por gjithsesi, si më të ulët se Perëndia dhe sigurisht jo si Hyjni të mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të kishte trup njerëzor dhe të mbetej prapëseprapë hyjnor. Ai ishte një fantazmë shpirtërore (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6); dhe (4) shpëtimi sigurohej me anë të besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cilat njihet vetëm nga persona të veçantë. Nevojitej njohuri (fjalëkalimet) për të kaluar përmes sferave qiellore. Për të arritur te Perëndia nevojitej dhe legalizmi judaik.
- Disa shembuj të kësaj gjinie janë (1) në Dhiatën e Vjetër, Ezekieli (kapitujt 36-48), Danieli (7-12), Zakaria, dhe (2) në Dhiatën e Re, Mateu 24, Marku 13; 2 Thesalonikasve 2; dhe Zbulesa.
- Dorëshkrim.** Ky term ka të bëjë me kopjet e ndryshme të Dhiatës së Re në greqisht. Zakonisht, ato ndahen në lloje të ndryshme sipas (1) materialit ku janë shkruar (papirus, lëkurë), ose (2) formës së vetë shkrimit (shkrim me shkronja të mëdha, ose me shkronja të lidhura kursive). Shkurtimi i saj është “MS” (njëjës), ose “MSS” (shumës).
- Dykuptimësia.** Kjo ka të bëjë me pasigurinë që rezulton në një dokument të shkruar kur ka dy ose më tepër kuptime të mundshme, ose kur përmenden dy ose më tepër gjëra në të njëjtën kohë. Ka gjasa që Gjoni të ketë përdorur dykuptimësinë e qëllimshme (fjalë më kuptim të dyfishtë).
- Eisegjezë.** Kjo është e kundërta e eksegjezës. Nëse eksegjeza është “nxjerrja jashtë” e synimit të autorit fillestar, ky term nënkupton “futjen” e një ideje ose mendimi të huaj në tekst.
- Eklektik.** Ky term përdoret në lidhje me kritikën e tekstit. Nënkupton praktikën e përzgjedhjes së varianteve nga dorëshkrime të ndryshme greqisht me qëllim që të arrijmë te një tekst që supozohet se është pranë autografeve origjinalë. Ai refuzon pikëpamjen se një familje e caktuar dorëshkrimesh greqisht përmban tekstin origjinal.
- Eksegjezë.** Ky është një term teknik për praktikën e interpretimit të një pasazhi të caktuar. Do të thotë “të nxjerrësh jashtë” (nga teksti), që nënkupton se synimi ynë është të kuptojmë synimin e autorit fillestar në dritën e sfondit historik, kontekstit letrar, sintaksës dhe kuptimit të fjalëve në kohën që u shkruan.
- Ekuivalenca dinamike.** Kjo është një teori e përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkthimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë

për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35, dhe në Hyrjen e Robert Bratcher për versionin TEV.

Etimologji. Ky është një aspekt i studimit të fjalëve që përqipet të sigurojë kuptimin fillestar të fjalëve. Nga ky kuptim rrënjë, identifikohen më lehtë përdorimet e specializuara të fjalëve. Në interpretim, fokusin kryesor nuk e përbën etimologjia, por kuptimi dhe përdorimi i fjalëve në kohën e autorit.

Është e vështirë të shpjegojmë me fjalë sesi Jezusi, Perëndia Bir, një hyjni paraekzistues, u shpërblye ose u lartësua për jetën shembullore që kreu. Nëse ai ishte tashmë Perëndi, si mund të shpërblehej? Nëse kishte lavdinë hyjnore paraekzistuese, si mund të nderohej më tepër? Ndonëse e kemi të vështirë që ta kuptojmë, Ati në njëfarë mënyre e nderoi Jezusin në një kuptim të veçantë për përmbushjen e përsosur që ai i bëri vullnetit të Atit.

Fragmenti Muratorian. Kjo është një listë e librave kanonikë të Dhiatë së Re. U shkrua në Romë përpara vitit 200 pas K. Jep po ata njëzet e shtatë libra që kemi në DhR protestante. Kjo tregon qartazi se, praktikisht, kishat lokale në pjesë të ndryshme të perandorisë romake e kishin përcaktuar kanonin përpara këshillave të mëdhenj të kishës në shekullin e katërt.

Frymëzim. Ky është koncepti se Perëndia i ka folur njerëzimit duke udhëhequr autorët biblikë që të shënojnë saktë dhe qartë zbulesën e tij. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

Fushë semantike. Ka të bëjë me gamën e plotë të kuptimeve që shoqërohen me një fjalë të caktuar. Në thelb, nënkupton ngjyrimet e ndryshme që ka një fjalë në kontekste të ndryshme.

Gnosticizëm. Shumica e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Sidoqoftë, idetë fillestare të tij ishin të pranishme në shekullin e parë (dhe më herët).

Gjini letrare. Kjo ka të bëjë me format e veçanta që mund të marrë komunikimi njerëzor, si poezia ose narrativa historike. Secili lloj letërsie ka procedurat e veta të veçanta nga ana hermeneutike, përpos parimeve të përgjithshme që vlejné për çdo letërsi të shkruar.

Gjinia. Vjen nga një term francez (“zhanër”) që nënkupton llojet e ndryshme të letërsisë. Thelbi i këtij termi është ndarja e formave letrare në kategori që kanë karakteristika të përbashkëta: narrativa historike, poezia, fjalët e urta, apokaliptikja dhe legjislacioni.

Gjuhë përshkrimi. Kjo përdoret në lidhje me idiomat ku është shkruar Dhiata e Vjetër. I flet botës sonë në kuadër të mënyrës sesi na shfaqen gjërat ndaj pesë shqisave. Nuk është përshkrim shkencor, dhe as nuk synon të jetë i tillë.

Hermeneutikë. Ky është term teknik për parimet që i prijné eksegezës. Ajo është edhe një grup parimesh të veçanta, edhe art. Hermeneutika biblike, ose e shenjtë, zakonisht ndahet në dy kategori: parimet e përgjithshme dhe parimet e veçanta. Ato lidhen me llojet e ndryshme të literaturës që gjendet në Bibël. Secili lloj (gjini) i veçantë ka parimet e veta unike, por ndan edhe disa supozime dhe procedura të përbashkëta interpretimi.

I fjalëpërfjalshëm. Ky është një emër tjetër i metodës historike dhe me fokus tekstin, që erdhi nga Antiokia. Do të thotë se interpretimi përfshin kuptimin normal dhe të dukshëm të gjuhës njerëzore, ndonëse pranon gjithsesi dhe praninë e gjuhës së figurshme.

Idiomë. Kjo fjalë përdoret për frazat që gjenden në kultura të ndryshme, të cilat kanë kuptim të specializuar që nuk lidhet me kuptimin e zakonshëm të termave në vetvete. Disa shembuj të sotëm janë: “ishte tmerrësisht e shkëlqyer”, ose “ti më heq trurin”. Edhe Bibla përmban këto lloj frazash.

Induktive. Kjo është një metodë logjike ose arsyetuese që kalon nga elementet e veçanta te tërësia. Është metoda empirike e shkencës moderne. Në thelb, është qasja e Aristotelit.

JHVH. Ky është emri i Besëlidhjes i Perëndisë në Dhiatën e Vjetër. Përcaktohet në Eksodi 3:14. Është forma KAUZATIVE e termit hebraisht “jam”. Judenjtë druheshin të shqiptonin emrin, që të mos e merrnin më kot; prandaj, e zëvendësonin me termin hebraisht *Adonai*, “zot”. Kështu u përkthye në anglisht ky emër besëlidhjeje.

Judaizmi rabinik. Kjo fazë e jetës së popullit jude filloi me robërinë babilonase (586-538 para K.). Me humbjen e ndikimit të priftërinjve dhe Tempullit, sinagogat lokale u bënë fokusi i jetës judaike. Këto qendra lokale të kulturës, bashkësisë, adhurimit dhe studimit biblik jude u bënë fokusi i jetës fetare të kombit. Në kohën e Jezusit, kjo “fe e skribëve” ishte paralele me atë të priftërinjve. Pas rënies së Jerusalemit më 70 pas Krishtit, forma skribale, e mbizotëruar nga farisenjtë, vuri nën kontroll drejtimin e jetës fetare judaike. Karakterizohet nga interpretimi praktik dhe legalist i Torahut, i cili shpjegohet nga tradita gojore (Talmudi).

Kanon. Ky është një term i përdorur për të përshkruar ato shkrime që besohet se janë frymëzuar në mënyrë unike. Përdoret për Shkrimet e Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re.

Këta njerëz të urtë guxuan të bënin pyetjet e vështira të jetës. Shpesh, ata i sfidonin pikëpamjet fetare tradicionale (Jobi dhe Predikuesi). Ata formojnë një ekuilibër dhe tension ndaj përgjigjeve të lehta për tragjeditë e jetës.

Kjo kategori teologjike po rritet nga lëvizja e “tokës së vjetër” ndër shkencëtarët e krishterë (p.sh., shkrimet e Hugh Ross). Ata e përdorin këtë kategori për të pohuar se gjithë e vërteta është e vërteta e Perëndisë. Natyra është derë e hapur për njohurinë rreth Perëndisë; është e ndryshme nga zbulesa e veçantë (Bibla). Ajo i jep shkencës moderne lirinë që të hulumtojë rendin natyror. Për mendimin tim, ajo përbën një mundësi të re të shkëlqyer për t’i dëshmuar botës së sotme shkencore në përfundim.

Komentar. Ky është një lloj i specializuar libri kërkimor. Ai jep një sfond të përgjithshëm për librin biblik. Pastaj, përpiqet të shpjegojë kuptimin e çdo pjese të librit. Disa komentare fokusohen te zbatimi, ndërsa të tjerë e trajtojnë tekstin në mënyrë më teknike. Këta libra janë të dobishëm, por duhen përdorur pasi të kesh përfunduar studimin paraprak personal. Interpretimet e komentuesit nuk duhen pranuar kurrë me symbyllur. Zakonisht, krahasimi i disa komentareve që japin pikëvështrime të ndryshme teologjike është diçka e dobishme.

Kristocentrik. Ky është një term që përdoret për të përshkruar natyrën dhe rolin qendror të Jezusit. Unë e përdor në lidhje me konceptin se Jezusi është Zoti i gjithë Biblës. Dhiata e Vjetër dëfton drejt tij dhe ai është përmbushja dhe synimi i saj (shih Mat. 5:17-48).

Kritika e lartë. Kjo është ajo procedurë e interpretimit biblik që fokusohet te sfondi historik dhe te struktura letrare e një libri të veçantë biblik.

Kritika e ulët. Shih “kritika e tekstit”.

Kritikë e tekstit. Ky është studimi i dorëshkrimeve të Biblës. Kritika e tekstit është e domosdoshme pasi nuk ekziston asnjë dorëshkrim origjinal dhe kopjet ndryshojnë nga njëra-tjetra. Ajo përpiqet të shpjegojë variantet dhe të arrijë (sa më tepër të mundet) te fjalët origjinale të autografeve të Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re. Shpesh, quhet “kritika e ulët”.

Legalizëm. Ky qëndrim karakterizohet nga mbitheksimi i rregullave ose ritualeve. Priret të bazohet në zbatimet njerëzore të rregullave si mjet pranimi nga Perëndia. Priret të nënvlerësojë marrëdhënien dhe lartëson veprat, ndonëse këto janë të dyja aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së besëlidhjes mes Perëndisë së shenjtë dhe njerëzimit të mëkatshëm.

Leksik analitik. Ky është një lloj mjeti kërkimor që të lejon të identifikosh çdo formë greqisht në Dhiatën e Re. Leksiku është një përmbledhje, në rendin alfabeti greqisht, e formave dhe përcaktimeve bazë. Në kombinim me një përkthim ndërlinear, u mundëson besimtarëve që s’lexojnë dot greqisht që të analizojnë format gramatikore dhe sintaksore greqisht të Dhiatës së Re.

Letërsia apokaliptike. Kjo ishte në masën mbizotëruese (ndoshta, edhe në mënyrë unike) një gjini judaike. Ishte një lloj kriptik shkrimi që përdorej në kohë pushtimi dhe okupimi të judenjve nga fuqitë e huaja botërore. Supozimi i saj është se ngjarjet botërore janë krijuar dhe kontrollohen nga një Perëndi personal dhe shpengues, dhe se Izraeli ka rëndësi të veçantë për të dhe për përkujdesjen e tij. Kjo literaturë premtan fitoren përfundimtare përmes përpjekjes së veçantë të Perëndisë.

Letërsia e urtësisë. Kjo ishte një gjini letërsie e përhapur në lindjen e afërt në lashtësi (si dhe në botën moderne). Në thelb, ishte përpjekje për të udhëzuar brezin e ri me udhëzime për jetë të suksesshme përmes poezisë, fjalëve të urta, ose eseve. I drejtohej më tepër individit sesa shoqërisë si kolektiv. Nuk përdorte aludime për historinë, por bazohej në përvojën dhe vëzhgimet nga jeta. Në Bibël, Jobi e deri te kënga e Këngëve merrnin si të sigurt praninë dhe adhurimin e JHVH, por ky botëkuptim fetar nuk është i shkoqur çdo herë, apo në çdo përjetim njerëzor.

Metonimia. Kjo është një figurë letrare, ku emri i diçkaje përdoret për të paraqitur diçka tjetër që shoqërohet me të. Për shembull, “po zien çajniku” do të thotë “po zien uji në çajnik”.

Mësuesit e rremë gnostikë përkrahnin dy sisteme të kundërta etike: (1) për disa, stili i jetesës s’kishte fare lidhje me shpëtimin. Sipas tyre, shpëtimi dhe spiritualiteti përmbledhen në një njohuri të fshehtë (fjalëkalime) për të kaluar përmes sferave engjëlllore (*eon-eve*); ose (2) për disa të tjera, mënyra e jetesës ishte kyçe për shpëtim. Ata theksonin një stil asket jetese si provë spiritualiteti të vërtetë.

Ndërlineare. Ky është një lloj mjeti kërkimor, i cili u lejon atyre që nuk njohin gjuhën biblike që të arrijnë të analizojnë kuptimin dhe strukturën e saj. Kjo metodë e vendos përkthimin në gjuhën tonë në nivelin “fjalë për fjalë”, poshtë gjuhës origjinale biblike. Ky mjet, i kombinuar me “leksikun analitik”, jep format dhe përcaktimet bazë të hebraishtes dhe greqishtes.

Nestorianizëm. Nestori ishte patriarku i Kostandinopojës në shekullin e petë. Ishte edukuar në Antioki të Sirisë dhe pohonte se Jezusi kishte dy natyra, një plotësisht njerëzore dhe një plotësisht hyjnore. Kjo pikëpamje shmangej nga pikëpamja ortodokse e Aleksandrisë se Krishti ka një natyrë. Preokupimi kryesor i Nestorit ishte titulli “nëna e Perëndisë”, që i ishte dhënë Marisë. Nestori (dhe, rrjedhimisht, edukimi i tij antiokas) u kundërshtua nga Kirili i Aleksandrisë. Antiokia ishte qendra e qasjes historiko-gramatikore dhe tekstuale ndaj interpretimit biblik, ndërsa Aleksandria ishte qendra e shkollës së katërfishtë (alegorike) të interpretimit. Në fund, Nestorin e hoqën nga posti dhe e çuan në syrgjyn.

Njësi letrare. Ka të bëjë me ndarjet kryesore të mendimit në librat biblikë. Mund të përbëhet nga disa vargje, paragrafë ose kapituj. Ajo përbën një njësi të vetëpërmbajtur me temë qendrore.

Papirus. Ky është një lloj materiali nga Egjipti mbi të cilin mund të shkruhej. Bëhej nga kallamet e lumit.

Papirusi është materiali në të cilin janë shkruar kopjet më të hershme të Dhiatës së Re në greqisht.

Paradoks. Ka të bëjë me ato të vërteta që duket sikur janë kontradiktore, por janë të dyja të vërteta, ndonëse në tension me njëra-tjetrën. Ato e inkuadrojnë të vërtetën duke e paraqitur nga anë të kundërta. Një pjesë e mirë e së vërtetës biblike paraqitet në formë dyshesh paradoksale (ose dialektike). Të vërtetat biblike nuk janë yje të izoluar, por janë yjësi që përbëhen nga formacione yjesh.

Parafrazë. Ky është emri i një teorie të përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35.

Paragraf. Kjo është njësi interpretuese bazë në prozë. Përmban një mendim qendror dhe zhvillimin e tij. Nëse qëndrojmë te mesazhi i tij kryesor, nuk do të përqendrohemi te pikat anësore, as nuk do të humbasim synimin e autorit fillestar.

Pasazhet paralele. Ato janë pjesë e konceptit se gjithë Bibla është e dhënë nga Perëndia dhe, si rrjedhojë, është interpretuesja më e mirë e vetes si dhe drejtpeshuesja e të vërtetave paradoksale. Kjo është e dobishme edhe kur përpiqemi të interpretojmë një pasazh të paqartë ose të dykuptimtë. Pasazhet paralele na ndihmojnë edhe që të gjejmë pasazhin më të qartë për një temë të dhënë, si dhe gjithë aspektet e tjera biblike të një teme të dhënë.

Pergamenat e Detit të Vdekur. I referohet një serie me tekste të lashta, të shkruara në hebraisht dhe aramaisht, që u gjetën pranë Detit të Vdekur më 1947. Ato ishin bibliotekat fetare të judaizmit sektar të shekullit të parë. Trysnia e pushtimit romak dhe luftërat zelote të viteve '60 i shtynë që t'i fshihnin pergamenat në qypa qeramike të mbyllur hermetikisht, duke i vendosur në shpella ose vrime. Ato na kanë ndihmuar të kuptojmë sfondin historik të Palestinës së shekullit të parë dhe kanë vërtetuar se Teksti Masoretik është shumë i saktë, të paktën që nga fundi i periudhës para Krishtit. Ato emërtohen me shkurtimin “DSS”.

Përkues. Ky është një lloj mjeti kërkimor për studimin e Biblës. Ai rendit çdo përdorim të çdo fjale në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Na ndihmon në një sërë mënyrash: (1) përcakton fjalën hebraisht ose greqisht që qëndron pas çdo fjale të caktuar në gjuhën tonë; (2) krahason pasazhet ku është përdorur e njëjta fjalë në greqisht ose hebraisht; (3) tregon se ku dy terma të ndryshëm hebraisht ose greqisht janë përkthyer me të njëjtën fjalë në gjuhën tonë; (4) tregon shpeshësinë e përdorimit të disa fjalëve në libra ose autorë të caktuar; (5) na ndihmon të gjejmë një pasazh të caktuar në Bibël (shih Walter Clark, *How to Use New Testament Greek Study Aids*, f. 54-55).

Përndritja. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia i ka folur njerëzimit. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

Përshkrimi simbolik i botës dhe botëkuptimi. Këta terma janë shoqëruar të njëri-tjetrit. Të dy janë koncepte filozofike të lidhur me krijimin. Termi “përshkrim simbolik i botës” lidhet me “si-në” e krijimit, ndërsa “botëkuptimi” lidhet me “Kush-in”. Këta terma gjejnë përdorim në interpretimin se Zanafilla 1-2 trajton kryesisht “Kush-in”, jo “si-në”, e krijimit.

Platoni. Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë. Filozofia e tij pati ndikim të jashtëzakonshëm në kishën e hershme përmes studiuesve nga Aleksandria e Egjiptit dhe, më vonë, nga Augustini. Platoni besonte se gjithçka në tokë ishte iluzion dhe thjesht kopje e një arketipi shpirtëror. Më vonë, teologët i barazuan “format/idetë” e Platonit me sferën shpirtërore.

Presupozim. Ka të bëjë me mënyrën e parakonceptuar si kuptojmë diçka. Shpesh, mendimet ose gjykimet tona për çështje të ndryshme i formojmë përpara se të shkojmë te vetë Bibla. Kjo predispozitë njihet edhe si anësi, si pozicion *a priori*, si supozim, ose si botëkuptim paraprak.

Provincializëm. Ka të bëjë me anësitë e rrënjësura në një sfond lokal teologjik/kulturor. Ai nuk e njeh natyrën ndërkulturore të së vërtetës biblike, apo zbatimin e saj.

Septuagintë. Ky është emri që iu dha përkthimit greqisht të Dhiatës së Vjetër hebraike. Tradita thotë se u shkrua në shtatëdhjetë ditë nga shtatëdhjetë studiues judenj për bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Data tradicionale është rreth 250 para K. (në të vërtetë, u deshën mbi njëqind vjet që të përfundonte). Ky përkthim është i rëndësishëm pasi (1) na jep një tekst të lashtë për ta krahasuar me tekstin hebraisht Masoretik; (2) na tregon gjendjen e interpretimit judaik në shekullin e tretë dhe të dytë para K.; (3) na jep botëkuptimin mesianik të judenjve përpara se të refuzonin Jezusin. Shkurtimi i tij është “LXX”.

Si gjini, ajo shprehte të vërtetën të përgjithshme. Sidoqoftë, kjo gjini nuk mund të përdoret në çdo situatë të veçantë. Këto janë pohime të përgjithshme që nuk zbatohen gjithmonë në çdo situatë individuale.

Sinaitikus. Ky është një dorëshkrim greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjet nga studiuesi gjerman, Tischendorf, në manastirin e shën Katerinës në Xhebel Musa, vendi tradicional i malit Sinai. Ky dorëshkrim u emërtua me shkronjën e parë të alfabetit hebraik “*alef*” [א]. Përmban Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Është një nga dorëshkrimet tona më të lashta unciale.

Sinonimik. Ka të bëjë me terma që kanë kuptime të njëjta ose shumë të ngjashme (ndonëse, në realitet, dy fjalë nuk kanë kurrë mbivendosje të plotë semantike). Ato janë të lidhura kaq ngushtë sa që mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në fjali pa i humbur kuptimin. Ky term përdoret edhe për të përcaktuar një nga tri format e paralelizmit poetik hebre. Në këtë kuptim, u referohet dy rreshtave poetikë që shprehin të njëjtën të vërtetë (shih Psa. 103:3).

Sintaksë. Ky është një term greqisht që i referohet strukturës së fjalisë. Lidhet me mënyrat sesi bashkohen pjesë e fjalisë për të dhënë një mendim të plotë.

Sintetik. Ky është një nga tri termat që lidhet me llojet poezisë hebraike. Ky term bën fjalë për ata rreshta poetikë që ndërtohen mbi njëri-tjetrin në mënyrë shtuese, nganjëherë, e quajtur “kulmore” (shih Psa. 19:7-9).

Shkolla aleksandriane. Kjo metodë e interpretimit biblik u zhvillua në Aleksandri të Egjiptit në shekullin e dytë pas Krishtit. Ajo përdor parimet interpretuese bazë të Filos, i cili ishte ndjekës i Platonit. Shpesh, ajo quhet metoda alegorike. Ajo mbizotëroi në kishë deri në kohën e Reformacionit. Përkrahësit më të aftë të saj ishin Origeni dhe Augustini. Shih Moises Silva, *Has The Church Misread The Bible?* (Academic, 1987).

Shkolla antiokase. Kjo metodë interpretimi biblik u zhvillua në Antioki të Sirisë në shekullin e tretë pas Krishtit si reagim ndaj metodës alegorike të Aleksandrisë në Egjipt. Thelbi bazë i saj ishte përqendrimi te kuptimi historik i Biblës. Ajo e interpretonte Biblën si letërsi normale dhe njerëzore. Kjo shkollë u përfshi në polemikën nëse Krishti kishte dy natyra (nestorianizmi) apo një natyrë (plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri). U shpall heretike nga kisha katolike e Romës dhe u zhvendos në Persi, por shkolla pati pak peshë. Më vonë, parimet e saj hermeneutike bazë u bënë parime interpretuese të reformatorëve klasikë të protestantizmit (Luteri dhe Kalvini).

Shpirtërizim. Ky term është sinonimik me alegorizimin, në kuptimin se përjashton kontekstin historik e letrar të pasazhit dhe interpreton në bazë të kriterëve të tjera.

Talmudi. Ky është titulli i kodifikimit të traditës gojore judaike. Judenj të besojnë se Perëndia ia dha Moisiut në malin Sinai. Në të vërtetë, Talmudi duket se është urtësia kolektive e mësuesve judenj ndër vite. Ekzistojnë dy versione të ndryshme të shkruara të Talmudit: versioni babilonas dhe versioni më i shkurtër dhe i papërfunduar palestinas.

Teksti Masoretik. Kjo u referohet dorëshkrimeve hebraisht të Dhiatës së Vjetër në shekullin e nëntë, të prodhuara nga breza studiuesish judenj, të cilat përmbajnë pikësime zanoresh dhe të tjera shënime tekstuale. Ai përbën tekstin bazë për Dhiatën e Vjetër në gjuhën tonë. Teksti i tij është vërtetuar historikisht nga dorëshkrimet në hebraisht, sidomos Isaia, të njohura si Pergamenat e Detit të Vdekur. Shkurtohet si “MT”.

“Teksti provë”. Kjo është praktika e interpretimit të Shkrimit duke cituar një varg pa patur parasysh kontekstin e tij të atypëratyshëm apo kontekstin më të gjerë të njësisë së tij letrare. Kjo i largon vargjet nga synimi i autorit fillestar dhe, zakonisht, përfshin përpjekjen për të provuar një mendim personal duke pretenduar autoritet biblik.

Tekstus Receptus. Ky përcaktim u zhvillua në botimin e DhR greqisht prej Elzevirit më 1633 pas K. Në thelb, kjo është një formë e DhR greqisht që u prodhua nga disa dorëshkrime të vona greqisht dhe versione

latinisht të Erazmit (1510-1535), Stefanusit (1546-1599) dhe Elzevirit (1624-1678). Në *An Introduction to the Textual Criticism of the New Testament*, f. 27, A. T. Robertson thotë: “praktikisht, teksti bizantin është Textus Receptus”. Teksti bizantin është më pak i vlefshmi nga tre familjet e dorëshkrimeve të hershme greqisht (perëndimore, aleksandriane dhe bizantine). Ai përmban gabimet e akumuluar prej shekujsh të teksteve të kopjuara me dorë. Megjithatë, edhe A. T. Robertson thotë: “Textus Receptus ka ruajtur për ne një tekst, në thelb, të saktë” (f. 21). Kjo traditë e dorëshkrimeve greqisht (sidomos botimi i tretë i Erazmit i 1522) përbën bazën e përkthimit të King James Version më 1611.

Teologji sistematike. Kjo është një fazë interpretimi që përqipet t’i lidhë të vërtetat e Biblës në mënyrë të unifikuar dhe logjike. Ajo përbën një paraqitje logjike, jo thjesht historike, të teologjisë së krishterë nëpërmjet kategorive (Perëndia, njeriu, mëkati, shpëtimi, etj.).

Tipologjik. Ky është një lloj i specializuar interpretimi. Zakonisht, nënkupton të vërtetën e Dhiatës së Re që gjendet në pasazhet e Dhiatës së Vjetër me anë të një simboli analogjik. Kjo kategori e hermeneutikës është element kryesor i metodës aleksandriane. Për shkak të abuzimit me këtë lloj interpretimi, duhet që përdorimin e tij t’ia rezervojmë vetëm shembujve të veçantë të regjistruar në Dhiatën e Re.

Torah. Ky është term hebraisht, që do të thotë “mësim”. U bë titulli zyrtar për shkrimet e Moisiut (Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë). Për judenjtë, është pjesa më e autoritetshme e kanonit hebre.

Vatikanus. Ky është dorëshkrimi greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjend në bibliotekën e Vatikanit. Në fillim, përmbante gjithë Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe Dhiatën e Re. Sidoqoftë, disa pjesë humbën (Zanafilla, Psalmet, Hebrenjve, letrat pastorale, Filemoni dhe Zbulesa). Është dorëshkrim shumë i dobishëm për përcaktimin e fjalëve origjinale të autografeve. Është emërtuar me shkronjën e madhe “B”.

Vulgata. Ky është emri i përkthimit të Biblës në latinisht nga Jeronimi. Ai u bë përkthimi bazë, ose “i përbashkët”, i kishës katolike të Romës. U bë në vitet 380 pas K.

Zbulesa e natyrshme. Kjo është një kategori e vetëzbulesës së Perëndisë ndaj njeriut. Ajo përfshin rendin e natyrshëm (Rom. 1:19-20) dhe ndërjegjen morale (Rom. 2:14-15). Përmendet në Psa. 19:1-6 dhe Rom. 1-2. Duhet dalluar nga zbulesa e veçantë, e cila është vetëzbulesa e veçantë e Perëndisë në Biblën dhe, epërsisht, në Jezusin e Nazaretit.

Zbulesë. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia ka folur me njerëzimin. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

SHTOJCA KATËR

SHPALLJE DOKTRINORE

S'është se dua t'ia di për shpalljet doktrimore apo kredot. Parapëlqej të pohoj vetë Biblën. Gjithsesi, e kuptoj se një shpallje besimi do t'u sigurojë atyre që s'më njohin një mënyrë për të vlerësuar këndvështrimin tim doktrinor. Në kohën tonë, të mbushur me kaq shumë gabime dhe mashtrime teologjike, ofroj shkurtimisht më poshtë përmbledhjen e teologjisë sime.

1. Bibla, si Dhiata e Vjetër ashtu dhe e Reja, është Fjala e frymëzuar, e pagabueshme, e autoritetshme dhe e përjetshme e Perëndisë. Ajo është vetëzbuluesja e Perëndisë, e shkruar nga njerëzit nën drejtimin e mbinatyrshëm hyjnor. Ajo është burimi ynë i vetëm i së vërtetës së qartë për Perëndinë dhe për synimet e tij. Po kështu, ajo është burimi i vetëm i besimit dhe praktikës për kishën e tij.

2. Ekziston vetëm një Perëndi i përjetshëm, krijues dhe shpengues. Ai është krijuesi i të gjitha gjërave, të dukshme dhe të padukshme. Ai e ka zbuluar veten si Perëndi i dashur dhe i dhembshur, ndonëse është edhe i paanshëm e i drejtë. Ai e ka zbuluar veten në tre persona të veçantë: Ati, Biri dhe Fryma; vërtet të veçantë por, megjithatë, të njëjtë për nga substanca.

3. Perëndia është aktivisht në kontroll të botës së vet. Ekziston një plan i përjetshëm për krijimin e tij, që është i pandryshueshëm, por edhe një plan i fokusuar tek individë, që lejon vullnetin e lirë njerëzor. Asgjë nuk ndodh pa njohurinë dhe lejen e Perëndisë, por, megjithatë, ai lejon zgjedhje individuale ndër engjëjt dhe njerëzit. Jezusi është Njeriu i Zgjedhur i Atit dhe të gjithë janë potencialisht të zgjedhur në të. Paranjohja e ngjarjeve nga ana e Perëndisë nuk i ul njerëzit në nivelin e një skenari të parashkruar dhe të paracaktuar. Të gjithë jemi përgjegjës për mendimet dhe veprat tona.

4. Njerëzimi, ndonëse i krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë dhe i lirë nga mëkati, zgjodhi të ngrinte krye kundër Perëndisë. Ndonëse u tunduan nga një veprues i mbinatyrshëm, Adami dhe Eva ishin përgjegjës për egoizmin e tyre rebel. Kryengritja e tyre ka prekur njerëzimin dhe krijimin. Të gjithë kemi nevojë për mëshirën dhe hirin e Perëndisë, si për gjendjen tonë kolektive në Adamin, ashtu dhe për kryengritjen tonë të vullnetshme si individë.

5. Perëndia i ka siguruar njerëzimit të rënë një mënyrë faljeje dhe rimëkëmbjeje. Jezu Krishti, biri i pashoq i Perëndisë, u bë njeri, bëri një jetë të pamëkatë dhe, me anë të vdekjes së vet zëvendësuese, pagoi dënimin për mëkatin e njerëzimit. Ai është e vetmja rrugë për rimëkëmbjen dhe bashkësinë me Perëndinë. Nuk ka mënyrë tjetër shpëtimi përveçse përmes besimit në veprën e përfunduar të tij.

6. Secili prej nesh duhet të pranojë personalisht ofertën e faljes së Perëndisë dhe rimëkëmbjes në Jezusin. Kjo arrihet me anë të besimit të vullnetshëm në premtimet e Perëndisë përmes Jezusit, duke i kthyer vullnetshëm shpinën mëkateve të njohura.

7. Të gjithë ne falemi dhe rimëkëmbemi plotësisht në bazë të besimit në Krishtin dhe pendimit nga mëkati. Sidoqoftë, provat për këtë marrëdhënie të re shihen në jetën e ndryshuar dhe në ndryshim e sipër të besimtarit. Synimi i Perëndisë për njerëzimin nuk është vetëm qielli dikur në të ardhmen, por ngjashmëria me Krishtin tani. Ata që janë vërtet të shpenguar, ndonëse mëkatojnë ndonjëherë, do të vazhdojnë me besim dhe pendim gjatë gjithë jetës.

8. Fryma e Shenjtë është "Jezusi tjetër". Ai është i pranishëm në botë për të drejtuar të humburit të Krishti dhe për të zhvilluar ngjashmërinë me Krishtin të shpëtuarit. Dhuntitë e Frymës jepen kur shpëtohem. Ato janë jeta dhe shërbesa e Jezusit, të ndara brenda trupit të tij, kishës. Dhuntitë, të cilat në thelb janë qëndrimet dhe motivet e Jezusit, duhen motivuar me anë të frytit të Frymës. Fryma është po aq veprues në kohën tonë sa dhe në kohët biblike.

9. Ati e ka bërë Jezu Krishtin e ringjallur Gjykatës të të gjitha gjërave. Ai do të kthehet në tokë për të gjykuar gjithë njerëzimin. Ata që kanë besuar në Jezusin, emrat e të cilëve janë në librin e jetës së Qengjit, do të marrin trupa të përlëvdur dhe të përjetshëm kur të kthehet ai. Ata do të jenë përjetësisht me të. Ndërsa ata që s'kanë pranuar t'i përgjigjen së vërtetës së Perëndisë do të ndahen përjetësisht nga gëzimet e bashkësisë me Perëndinë Triun. Ata do të dënohen së bashku me Djallin dhe engjëjt e tij.

Sigurisht, kjo nuk është as e plotë, as tërësore, por shpresoj se do t'ju japë sadopak ngjyrimin teologjik të zemrës sime. Mua më pëlqen shprehja:

"Në thelbësoret – unitet; në jothelbësoret – liri; në gjithçka – dashuri".